REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2019

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bajram Ljatifi, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bekim Sejdiu, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Safet Hoxha, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi-Peci, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Radomir Laban, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Nexhmi Rexhepi, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Kontribuesit:

Suzana Krasniqi
Arbana Beqiri-Plakolli
Veton Dula
Burim Hoxha
Altin Nika

© 2019 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqëson formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2019

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tabela e Përmbajtjes:

1. Parathënie: ..... 11#
2. KO162/18, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr. 06/2156/DO-1156 ..... 13#
3. KO157/18, Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.7, të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës ..... 25#
4. KO171/18, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ..... 55#
5. KO43/19, Parashtrues: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë ..... 124#
6. KO58/19, Parashtrues: Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019 .....157#
7. KO65/19, Parashtrues i kërkesës: Avokati i Popullit, vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar), i cili ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 2018. ..... 185#
8. KO124/19, Parashtrues i kërkesës: Kryeministri i Republikës së Kosovës, kërkesë për interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e

kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit ..... 214#
9. KI48/18, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U.ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017 .....228#
10. KI01/18, Parashtrues i kërkesës: Gani Dreshaj-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. A. – U. ZH. nr. 64/2017, të 26 dhjetorit 2017 ..... 319#
11. KI87/18, Parashtruesi i kërkesës: Kompania e Sigurimeve „IF Skadeforsikring“, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018, i cili i është dorëzuar më 7 mars 2018 ..... 373#
12. KI31/18, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.....396#
13. KI25/18, Parashtrues: Vasilije Antović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 24 prillit 2017.....440#
14. KI 24/17, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 janarit 2017 ..... 461#
15. KI145/18, Parashtruesit: Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018.....483#
16. KI128/17, Parashtrues i kërkesës: Naser Husaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2017, të 23 gushtit 2017 .....499#
17. Rastet nr. KI87/18 dhe KI11/19, Parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 226/2018, të 16 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018 ..... 521#
18. KI10/18, Parashtrues: Fahri Deqani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017.....545#

19. MENDIM MOSPAJTUES i Gjyqtares Selvete Gërxhaliu – Krasniqi në rastin KI10/18 ..... 578#
20. KI32/18 Parashtrues i kërkesës: SH.A. „Kosvik“, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I.-17-0469, të 26 tetorit 2017..... 586#
21. KI96/18,KI97/18,KI98/18, KI99/18,KI100/18,KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, Parashtrues: Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së 16 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 26 marsit dhe 12 prillit 2018 ..... 597#
22. KI06/18, Parashtrues: Shkumbin Mehmeti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 94/2017, të 13 nëntorit 2017..... 616#
23. KI 09/18 Parashtrues: „FINCA“ Kosovë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, CML. nr. 3/2017, të 21 shtatorit 2017..... 628#
24. KI138/18, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Urdhrit, I. GJA. nr. 1/2018-141, të Kryetarit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, z. Ymer Hoxha, të 8 gushtit 2018..... 643#
25. KI78/18 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS-së), nr. AC-I-17-0466-A001, të 12 prillit 2018..... 664#
26. KI59/18 Parashtrues i kërkesës: Strahinja Spasić, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme AA–UŽ. nr. 58/2017, të 1 dhjetorit 2017 ..... 677#
27. KI113/17, Parashtrues: X, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 13/2017, të 4 gushtit 2017..... 691#
28. KI94/18, Parashtrues: Miodrag Šešlija, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-211/15 ..... 704#
29. KI185/18, Parashtrues: Limak Kosovo International Airport SH.A. "Adem Jashari”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të

Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 271/2018, të 10 tetorit 2018 ..... 717#
30. KI02/19, KI03/19, KI04/19 dhe KI05/19, Parashtrues: Halil Mustafa dhe 3 të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së 4 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 27 korrikut 2011 dhe 14 tetorit 2013 ..... 734#
31. KI 111/18, Parashtrues të kërkesës: Dragomir Vlasačević dhe të tjerët, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0519-0001/0003, të 15 marsit 2018 ..... 750#
32. KI18/19, Parashtrues: Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA". Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Ministrisë së Administratës Publike, KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018 ..... 765#
33. KI154/17 dhe KI05/18 Parashtrues: Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 3917/17, të 25 tetorit 2017 ..... 795#
34. KI133/17, Parashtrues i kërkesës: Ali Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 96/2017, i 1 qershorit 2017 ..... 822#
35. KI108/18 – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 64/04 të Agjencisë së Regjistrimit Civil, të 13 qershorit 2018 ..... 842#
36. KI91/18 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ. UZV. nr.1/2018, i datës 25 janar 2018 ..... 904#
37. KI96/19, Parashtrues: Đeljalj Kazagić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pzd. nr. 820/2019, të 5 shkurtit 2019 ..... 926#
38. KI78/19, Parashtrues i kërkesës: Miodrag Pavić, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 270/2018 të Gjykatës Supreme të 18 dhjetorit 2018 ..... 937#
39. KI73/18, Parashtrues i kërkesës është N. S. i cili kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme CML. nr. 36/2018 të 10 prillit 2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CN. nr. 89/2015, të 14 gushtit 2015..... 951#

40. KI81/19, Parashtruesi i kërkesës: Skender Podrimqaku, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-19-0007, të 14 marsit 2019 ..... 974#
41. KI76/19, Parashtrues A. C., D. C., dhe F C., Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 48/2019, të datës 27 Mars 2019 ..... 993#
42. KI122/18, Parashtrues: Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.128/2018, 23 prillit 2018 ..... 1008#
43. INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE ..... 1024#
44. INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS ..... 1036#

Parathënie:

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës, të shkruaj këtë parathënie për Buletinin e 9-të të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Buletini është bërë pikë e dobishme referimi për ata që punojnë në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut. Synimi ynë themelor është që përmes këtij Buletini, jo vetëm të paraqesim disa nga rezultatet kryesore të punës sonë gjatë vitit 2019, por edhe të krijojmë një mekanizëm hulumtues i cili mundëson qasje të lehtë e praktike në jurisprudencën e Gjykatës.

Ky edicion i Buletinit përmban të gjitha aktgjykimet e Gjykatës të vitit 2019 dhe një seleksionim të aktvendimeve më të veçanta. Në mes tjerash, ky edicion përfshinë: (i) kërkesën e dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit përkitazi me vlerësimin e amendamenteve kushtetuese në lidhje me përfshirjen e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje në nenin 22 të Kushtetutës; (ii) kërkesën e dorëzuar nga Kryeministri për interpretimin e aktit të dorëheqjes së Kryeministrit dhe përcaktimin e kompetencave apo qartësimin e funksioneve të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit; (iii) dy kërkesat e dorëzuara nga deputetët e Kuvendit në lidhje me vlerësimin e Ligjit për Delegacionin Shtetëror, dhe vlerësimin e vendimeve të Presidentit përkitazi me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; si dhe (iv) dy kërkesat e dorëzuara nga Avokati i Popullit përkitazi me vlerësimin e dispozitave të caktuara të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe Ligjit për Noterinë, respektivisht.

Gjatë vitit 2019, Gjykata, po ashtu, ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm vendimesh që ndërlidhen me kërkesat individuale. Në ato raste janë trajtuar pretendimet e parashtruesve dhe duke aplikuar parimet e vendosura nga praktika e saj e konsoliduar gjyqësore dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë gjetur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike si rezultat i vendimeve kundërthënëse. Në veçanti, vlen të theksohet se për herë të parë në historikun e funksionimit të saj, Gjykata, ka trajtuar në merita pretendimin për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe në dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur shkelje të kësaj të drejte si rezultat i mosarsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta për vazhdimin e paraburgimit.

Është e rëndësishme që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, të konsultojnë me vëmendje Buletinet dhe të vlerësojnë paraprakisht perspektivën e

mundshme të suksesit për rastet e tyre. Do të ishte shumë e dobishme për zhvillimin e mëtejmë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese nëse parashtruesit njoftohen paraprakisht me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe e përdorin të njëjtën për të ndërtuar argumentet e tyre kushtetuese. Buletini sigurisht mund t'u shërbejë edhe kolegëve të gjykatave të rregullta dhe institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë për sa veprimtaria dhe funksionet e tyre ndërlidhen me të drejtat dhe liritë kushtetuese apo përgjithësisht të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara kushtetuese. Studentët dhe studiuesit mund të përfitojnë nga një paraqitje gjithëpërfshirëse dhe sistematike e rasteve të zgjedhura.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për gjithë stafin e Gjykatës, me punën dhe përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi i këtij edicioni të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KO162/18, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr. 06/2156/DO-1156

KO162/18, Aktgjykim i miratuar më 19 dhjetor 2018, publikuar më 7.2.2019

Fjalët kyç: *Kërkesë institucionale, amendament i propozuar kushtetues, Kapitulli II i Kushtetutës, kërkesë e pranueshme*

Më 24 tetor 2018, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, një amendament të Kushtetutës, të propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata të bëjë vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar zvogëlon ndonjë nga të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Amendamenti i propozuar parasheh që të shtohet një paragraf i ri pas paragrafit 8 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, respektivisht të shtohet edhe paragrafi 9, si në vijim:

> "(9) *Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*".

Propozuesit e amendamentit pretendojnë se amendamenti i propozuar përcakton standarde të rëndësishme në fushën e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe ka për qëllim mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Gjykata konstatoi se formulimi i amendamentit të propozuar nuk zvogëlon asnjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për më tepër, ajo vetëm i avancon dhe i zhvillon këto të drejta.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO162/18

Parashtrues

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr. 06/2156/DO-1156

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) një amendament kushtetues, të propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të dorëzuar me shkresën nr. 06/2156/DO-1156 (në tekstin e mëtejmë: amendamenti i propozuar).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i amendamentit të propozuar, nëse i njëjti zvogëlon ndonjë të drejtë dhe liri të garantuar me Kapitullin II të Kushtetutës.

3. Në amendamentin e propozuar thuhet:

"Në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9) si në vijim:

(9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.9 dhe në nenin 144.3 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 78 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës (Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës) me shkresën nr. 06/2156/DO-1156, i referoi Gjykatës amendamentin e propozuar për vlerësim paraprak nga Gjykata nëse ky amendament zvogëlon ndonjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

6. Më 25 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

7. Më 26 tetor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Për më tepër, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'ia ofrojë një kopje të këtij njoftimi secilit deputet të Kuvendit, ashtu që atyre t'u mundësohet t'ia paraqesin Gjykatës komentet e tyre, nëse kanë, për kërkesën e lartpërmendur.

8. Po të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit. Gjykata nuk ka pranuar komente nga asnjëra palë.

9. Më 19 dhjetor 2018, Gjykata e shqyrtoi kërkesën dhe njëzëri vendosi që kërkesa është e pranueshme dhe që amendamenti i propozuar në Kushtetutë nuk zvogëlon të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 11 maj 2011, Këshilli i Evropës miratoi Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (në tekstin e mëtejmë: Konventa), e cila, ndër të tjera, ka për qëllim mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

11. Konventa, ndër të tjera, parasheh dhe rregullon çështjet e të drejtave themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin, detyrimet e shtetit dhe masat paraprake për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, çështjen e mjeteve juridike, politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave, çështjen e hetimit dhe të ndjekjes penale dhe masat mbrojtëse.

12. Për më tepër, Konventa në dispozitat përfundimtare, respektivisht nenin 73 [Efektet e kësaj Konvente], parasheh:

> *"Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë dispozitat e ligjit të brendshëm dhe instrumentet detyruese ndërkombëtare, të cilat tashmë janë në fuqi ose mund të hyjnë në fuqi, sipas të cilave të drejtat më të favorshme u janë dhënë ose do t'ju jepen personave në parandalimin edhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".*

13. Më 22 tetor 2018, 80 (tetëdhjetë) deputetë ia përcollën Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozimin e tyre për amendamentimin e nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, që këtij neni t'i shtohet paragrafi (9) respektivisht "*Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*".

14. Më 24 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës (Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës) në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës i referoi Gjykatës amendamentin e propozuar të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata të bëj vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar zvogëlon ndonjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar, dhe së dyti duhet të përcaktojë nëse ka juridiksion për të vlerësuar amendamentin e propozuar.

17. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës:

> *"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend [...]"*,

18. Gjykata vëren se Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, dorëzoi amendamentin e propozuar dhe se, rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës.

19. Më tej, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, ajo duhet:

> "[...] *të konstatojë nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës"*.

20. Rrjedhimisht, Gjykata ka juridiksion për të vlerësuar nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

21. Kështu, pasi që është dorëzuar nga pala e autorizuar dhe pasi që Gjykata ka juridiksion të trajtojë rastin, kërkesa është e pranueshme në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.

Fushëveprimi i vlerësimit kushtetues

22. Siç u tha më lart, në pjesën "Procedura në Gjykatë", parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës amendamentin e propozuar.

23. Prandaj, Kushtetuta, si akti më i lartë juridik, duhet të respektohet zyrtarisht dhe solemnisht me rastin e propozimit të amendamenteve për të. Gjykata, duke shprehur kujdesin për nevojën e sigurisë juridike në lidhje me këtë çështje, thekson që, në bazë të nenit 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII të Kushtetutës "*Gjykata Kushtetuese*

*është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën". (*Shih rastin nr. KO44/14, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2014, paragrafi 24)

24. Në këtë drejtim, Gjykata konfirmon që vlerësimi i kushtetutshmërisë, sipas nenit 144.3 të amendamentimit të propozuar të Kushtetutës, duhet të trajtohet në dritën e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], duke përfshirë rendin juridik të Republikës së Kosovës, bazë e të cilit – sipas nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit II të Kushtetutës – janë të drejtat dhe liritë e njeriut të përmendura në atë Kapitull (Shih rastin nr. KO29/12 dhe KO48/12, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 korrikut 2012; shih, po ashtu, rastin nr. KO61/12, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 tetorit 2012, paragrafi 18, po ashtu rastin nr. KO44/14, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2014).

25. Gjykata, po ashtu, konsideron se neni 21 i Kushtetutës duhet lexuar në frymën e nenit 7.1 të Kushtetutës, që definon vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës e që është i bazuar *"në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut".*

26. Gjykata vëren se amendamenti i propozuar është në përputhje me detyrimet që burojnë nga nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, përmes të cilit kërkohet që të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

27. Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykatë nuk do t'i marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përfshira në Kapitullin II, por tërë shkronjën, përmbajtjen dhe frymën e Kushtetutës (Shih rastin nr. KO29/12 dhe rastin KO48/12, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 korrikut 2012).

28. Në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata tani do ta shqyrtojë amendamentin e propozuar.

Amendamenti i propozuar: paragrafi i ri (9), i nenit 22 të Kushtetutës

29. Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, aktualisht parasheh:

> *"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*
>
> > *(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
> > *(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
> > *(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
> > *(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
> > *(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
> > *(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
> > *(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
> > *(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese".*

30. Gjykata rikujton se amendamenti i propozuar parasheh që të shtohet një paragraf i ri pas paragrafit 8 të nenit 22, respektivisht të shtohet edhe paragrafi 9, si në vijim:

> "(9) *Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*".

Arsyet për amendamentin e propozuar siç janë theksuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë

31. Propozuesit e amendamentit pretendojnë se amendamenti i propozuar përcakton standarde të rëndësishme në fushën e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe ka për qëllim "*mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*".

32. Propozuesit e amendamentit janë të mendimit se përmes kësaj Konvente, "*Shteti i Republikës së Kosovës manifeston përkushtimin për tolerancë zero ndaj çdo dhune ndaj grave*".

33. Sipas autorëve të amendamentit "*Shteti si i tillë duhet të ketë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjet shkeljes së të drejtave të njeriut që i parasheh kjo konventë*".

34. Deputetët që propozojnë këtë amendament, më tej, konsiderojnë se përmes kësaj Konvente sanksionohen *"veprat e tilla si: gjymtimi gjinorë, martesën e detyruar, përndjekjen, abortin dhe sterilizimin e detyruar. Kjo do të thotë që shteti ynë t'i përfshijë për herë të parë këto vepra penale në sistemin tonë ligjor si dhe t'i mbështesë veprat e tjera që janë pjesë e kodit penal.*
Përmes kësaj konvente, do të tentojmë të ndryshojmë sjelljen e shoqërisë, të roleve dhe stereotipave gjinore që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave, trajnime të profesionistëve që punojnë me viktimat [...]".

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar

35. Gjykata rikujton se përveç të drejtave të përfshira në mënyrë shprehimore në Kapitullin II, Gjykata duhet po ashtu të vlerësojë pajtueshmërinë e amendamentit të propozuar me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të garantuara me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

37. Gjykata vëren se përmes amendamentit të propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë, parashtruesi i kërkesës propozon që të shtohet një paragraf i ri pas paragrafit 8, të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, respektivisht të shtohet edhe paragrafi "(9) *Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*".

38. Gjykata specifikon se instrumentet ndërkombëtare të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme, nuk e përjashtojnë dhe kufizojnë njëra tjetrën dhe as nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara me dispozita tjera të përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

39. Gjykata edhe një herë rikujton qëllimin e Konventës, e cila, ndër të tjera përcakton:

a. *Mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;*

b. *Kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;*

c. *Hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;*

d. *Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;*

e. *Ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar dhe për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.*

40. Për më tepër Konventa në mënyrë specifike obligon shtetet që të ndërmarrin masa të nevojshme legjislative, si dhe masa të tjera duke krijuar mekanizma në funksion të zbatimit të plotë të saj.

41. Rrjedhimisht, Gjykata vë në pah se implementimi i Konventës prodhon detyrime të natyrave të ndryshme për shtetet anëtare të natyrës legjislative (plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ligjore në fuqi), implikime buxhetore, etj.

42. Konventa, ndër të tjera specifikon nevojën e krijimit të politikave gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara, që kërkojnë mbledhjen dhe kërkimin e të dhënave, trajnimin e profesionistëve që merren me viktimat ose autorët e të gjitha akteve të dhunës të mbuluara nga dispozitat e kësaj Konvente .

43. Përveç kësaj me dispozitat e kësaj Konvente përcaktohet edhe krijimi i mekanizmave të monitorimit, shërbimeve mbështetëse të specializuara, strehimin e viktimave, marrja e masave legjislative, në përputhje me parimet ndërkombëtare.

44. Konventa parasheh edhe vënien në dispozicion të mjeteve ligjore të natyrës civile kundër autoriteteve shtetërore që nuk përmbushin detyrimet e tyre. Për më tepër, neni 30 [Kompensimi] i Konventës përcakton kompensim adekuat nga shtetet, të atyre viktimave që kanë pësuar dëme të rënda trupore ose dëme ndaj shëndetit.

45. Gjykata gjithashtu vëren se propozuesit e amendamentit të propozuar nuk kanë paraqitur para Gjykatës ndonjë analizë paraprake të ndikimit që mund të ketë zbatimi i Konventës, siç janë implikimet financiare apo mekanizmat dhe institucionet e nevojshme, që duhen të krijohen në funksion të zbatimit të saj.

46. Në mënyrë specifike, këto dispozita kanë si rrjedhojë ndikim të lartë financiar, që nënkupton vlerësimin dhe përfshirjen e kësaj kostoje në kornizën adekuate buxhetore.

47. Në dritën e shpjegimeve të më sipërme ,Gjykata vëren se edhe në kuadër të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës ka qëndrime të ndryshme rreth miratimit të Konventës, si dhe mënyrës së miratimit të saj.

48. Në vijim, Gjykata vëren se Konventa, është miratuar nga Këshilli i Evropës, më 11 maj 2011 në Turqi dhe është ratifikuar nga 33 (tridhjetë e tre) shtete anëtare të Këshillit të Evropës, ndërsa 13 (trembëdhjetë) shtete vetëm e kanë nënshkruar dhe 21 (njëzet e një) shtete kanë shprehur rezervat e tyre lidhur me aplikimin e disa dispozitave të kësaj Konvente. Pjesa më e madhe e shteteve të cilat kanë shprehur rezervat e tyre në lidhje me aplikimin e disa dispozitave, kryesisht kanë të bëjnë me nenin 30 [Kompensimi] si dhe me nenin 44 [Juridiksioni] të kësaj Konvente.

49. Gjykata për më tepër, rikujton nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *(1) Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*
> *(2) Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën*

politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore.

50. Gjykata konsideron se amendamenti i propozuar shkon në drejtim të pasurimit të këtyre vlerave.

51. Në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk zvogëlon asnjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për më tepër, ajo vetëm i avancon dhe i zhvillon këto të drejta.

52. Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 144, paragrafi 4, të Kushtetutës, ndryshimet e propozuara në Kushtetutë hyjnë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës.

53. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) të Rregullores
së punës, në seancën e saj të mbajtur më 19 dhjetor 2018, njëzëri

VENDOS SI NË VIJIM:

I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;.

II. Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit me 24 tetor 2018, nuk i zvogëlon të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës;

III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Safet Hoxha Arta Rama-Hajrizi

KO157/18, Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.7, të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës

KO157/18, Aktgjykim i miratuar më 13 mars 2019, publikuar më 29 mars 2019

Fjalët kyç: kërkesë institucionale, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi1.7, të Ligjit për Kryqin e Kuq, kërkesë e pranueshme, papajtueshmëri e nenit 14, paragrafi 1.7, të Ligjit të kontestuar me nenin 24, 46 dhe 119 të Kushtetutës

Kjo kërkesë është dorëzuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë se nenit 14, paragrafi 1.7, të Ligjit për Kryqin e Kuq, duke ngritur dyshime për papajtueshmërinë e tij me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 119 [Marrëdhëniet Ekonomike] dhe 120 [Financat Publike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Thelbi i kërkesës së gjykatës referuese, duke u thirrur edhe në pretendimet e Kompanisë "Illyria" të paraqitura para saj, konsistonte në pretendimin se paragrafi 1.7, i nenit 14 të ligjit të kontestuar, i cili i detyronte kompanitë e sigurimeve në Kosovë për të paguar 1% nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjeteve të siguruara dhe i cili nuk parasheh ndonjë detyrim për kontribut për kompanitë tjera në Kosovë, i vendoste kompanitë e sigurimeve në pozitë të pabarabartë në raport me kompanitë e tjera, në kundërshtim me parimin e vendosur në paragrafin 2, të nenit 119 të Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme], ku parashihet që *"Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme"*.

Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe që janë saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës.

Pasi vlerësoi në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideroi se, ndonëse ligjvënësi nëpërmjet kufizimit të të drejtave kishte për qëllim arritjen e një qëllimi që përkon me interesin e përgjithshëm shoqëror, megjithatë nuk ishte i qartë fakti se pse ligjvënësi nuk e kishte shtrirë dhe shpërndarë detyrimin financiar, të vendosur me dispozitën e ligjit të kontestuar edhe te subjektet e tjera ekonomike, por vetëm të kompanitë e sigurimeve që ofrojnë këtë lloj të sigurimit. Pra, Gjykata vërejti se as Kuvendi

dhe as ndonjë instancë tjetër përkatëse nuk kishin paraqitur ndonjë arsyetim të qëndrueshëm se përse ligji i kontestuar i ngarkon me detyrim vetëm kompanitë e sigurimit, për të kontribuar në financimin e Kryqit të Kuq. Gjykata, konsideroi me tej se po qe se pagesa e paraparë me dispozitën e ligjit të kontestuar do të shpërndahej në mënyrë të arsyeshme dhe proporcionale ndaj të gjitha subjekteve ekonomike, kjo do të ishte në pajtim me kërkesat e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, me pozitën e barabartë në treg të garantuar me nenin 119 të Kushtetutës, si dhe me kërkesat paragrafëve 4 dhe 5, të nenit 55, të Kushtetutës.

Në dritën e shtjellimeve të mësipërme, Gjykata konsideroi se detyrimi vetëm i kompanive të sigurimit për të paguar shumën e caktuar nga të hyrat e realizuara nga sigurimi i autopërgjegjësisë, si kontribut për buxhetin e Kryqit të Kuq, nuk është i justifikuar, gjegjësisht nuk është i bazuar në arsye objektive. Rrjedhimisht, nuk ekziston një qëllim legjitim që do të arsyetonte trajtimin e pabarabartë të kompanive të sigurimit të automjeteve.

Në ndërlidhje me këtë, Gjykata konsideron se si rrjedhojë e trajtimit të pabarabartë të kompanive të sigurimit në raport me kompanitë e tjera në Kosovë, dhe duke pasur parasysh se pagesa nga kompanitë e sigurimeve të 1% të shumës nga bruto primi i autopërgjegjësisë zvogëlon pasurinë e kompanive të sigurimeve, paragrafi 1.7 i nenit 14 të ligjit të kontestuar gjithashtu nuk është në pajtueshmëri me të drejtën e pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës.

Gjykata gjithashtu rikujtoi se gjykata referuese po ashtu kishte ngritur edhe çështjen e pajtueshmërisë së ligjit të kontestuar me nenin 120 [Financat Publike] të Kushtetutës. Mirëpo, duke pasur parasysh se Gjykata gjeti shkelje të nenit 24, 46 dhe 119 të Kushtetutës, ajo nuk e konsideron të nevojshme vlerësimin e pajtueshmërisë së ligjit të kontestuar me nenin 120 të Kushtetutës.

Si përmbledhje, Gjykata konkludoi se paragrafi 1.7, i nenit 14 të ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO157/18

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata referuese), e nënshkruar nga kryetari Enver Peci.

Ligji i kontestuar

2. Gjykata referuese ngre dyshime për kushtetutshmërinë e nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179, për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, të shpallur në Gazetën Zyrtare, më 20 korrik 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit të kontestuar, për të cilin ngrihen dyshime se nuk është në pajtueshmëri me nenet 24 [Barazia para

Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 120 [Financat Publike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.8 të Kushtetutës, në nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 77 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 tetor 2018, gjykata referuese dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

7. Më 19 tetor 2018, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës gjykatën referuese, Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Avokatin e Popullit, Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryqi i Kuq), Kompaninë e Sigurimeve "Illyria" sh. a. (në tekstin e mëtejmë: Kompania "Illyria") dhe Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës.

8. Gjykata po ashtu njoftoi gjykatën referuese, se në bazë të nenit 52 të Ligjit për Gjykatën dhe të rregullit 77 (5) të Rregullores së punës, procedura lidhur me rastin që ndërlidhet me kërkesën e parashtruar në Gjykatë pezullohet, derisa të merret vendimi nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata po ashtu kërkoi nga gjykata referuese që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të dorëzojë kopjen e dosjes së lëndës në lidhje me të cilën ka parashtruar kërkesën në Gjykatë dhe kopjen e ligjit të kontestuar. Ndërsa, Kryqi i Kuq (në cilësinë e palës së interesuar) u njoftua se komentet e tyre, nëse kanë, mund t'i paraqesin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga Gjykata.

9. Më 23 tetor 2018, gjykata referuese dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara me shkresën e 19 tetorit 2018.

10. Më 5 nëntor 2018, Kryqi i Kuq paraqiti komente në lidhje me kërkesën.

11. Më 8 nëntor 2018, Gjykata njoftoi gjykatën referuese, Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Avokatin e Popullit, Kompaninë "Illyria" dhe Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës, në lidhje me komentet e Kryqit të Kuq. Gjykata referuese u njoftua se komentet e saj në lidhje me komentet e Kryqit të Kuq, nëse ka, mund t'i paraqes deri më 29 nëntor 2018. Gjykata referuese nuk paraqiti komente në lidhje me komentet e Kryqit të Kuq.

12. Më 13 mars 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

13. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri votoi se kërkesa është e pranueshme dhe se neni 14, paragrafi 1.7 i Ligjit të kontestuar, nuk është në pajtueshmëri me nenet 24, 119 dhe 46 të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 10 qershor 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e kontestuar, i cili u shpall në Gazetën Zyrtare, më 20 korrik 2010.

15. Më 26 nëntor 2010, Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, bazuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, parashtroi kërkesë në Gjykatë për anulimin e nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar (pra, bëhet fjalë për të njëjtin nen të ligjit të kontestuar, që është objekt shqyrtimi).

16. Më 23 maj 2011, Gjykata me Aktvendimin për papranueshmëri KI118/10, parashtrues, *Shoqata e Sigurimeve të Kosovës*, deklaroi kërkesën të papranueshme, pasi konstatoi se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të kontestuar ligjin e cekur më lart.

17. Më 2 dhjetor 2014, Rr. P., drejtor i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, bazuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, parashtroi kërkesën KI174/14, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit të kontestuar (pra, bëhet fjalë për të njëjtin nen të ligjit të kontestuar, që është objekt shqyrtimi).

18. Më 3 shkurt 2015, Gjykata me aktvendim e shpalli kërkesën KI174/14 të papranueshme, pasi konstatoi se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të kontestuar ligjin e cekur më lart.

19. Në një datë të pacaktuar, Kryqi i Kuq paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), kundër Kompanisë "Illyria", duke kërkuar që t'ia paguaj asaj një përqind (1%) të bruto primit të vlerës së sigurimit të obliguar të automjeteve të realizuar nga Kompania "Illyria", për periudhën 2010-2016.

20. Më 16 nëntor 2016, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 546/13 e aprovoi kërkesëpadinë e Kryqit të Kuq dhe e detyroi Kompaninë "Illyria" që, në emër të grumbullimit të bruto primit nga sigurimi i automjeteve për 1 %, "*për periudhën prej dt. 05.08.2010 e deri me datën 31.07.2016, t'i paguajë shumën prej 248.648,16€, me kamatë [...] dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.065€, në afat prej 15 ditëve*". Gjykata Themelore arsyetoi se obligimi për pagesën e shumës së vendosur me aktgjykimin e cekur më lart rrjedh nga neni 14, paragrafi 1.7 i Ligjit të kontestuar.

21. Më 16 shkurt 2017, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Kompania "Illyria" paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), me pretendimin se ka pasur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që rasti të kthehet në rivendosje. Kompania e Sigurimeve po ashtu pretendoi se ligji i kontestuar është jokushtetues dhe kërkoi që Gjykata e Apelit të kërkoj vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, në Gjykatën Kushtetuese.

22. Më 14 tetor 2017, Kompania "Illyria" paraqiti parashtresë në Gjykatën e Apelit për zgjerimin e ankesës, duke konsideruar se ligji i kontestuar po ashtu është në kolizion me Ligjin për Investime të Huaja.

23. Më 12 qershor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin AC. nr. 1165/2017, e refuzoi si të pathemeltë ankesën dhe zgjerimin e ankesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në lidhje me pretendimin e Kompanisë "Illyria" se ligji i kontestuar është jokushtetues dhe kërkesën që çështjen e kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar ta referojë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë, Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim: *"[është vlerësim i Gjykatës së Apelit se, ligji i kontestuar], është ligj i cili nuk ka ndonjë të metë që i njëjti të konsiderohet jokushtetues, siç pa të drejtë pretendon [Kompania "Illyria"], kështu që sikurse gjykata e shkallës së parë, e cila nuk e ka parë të arsyeshme që ky ligj të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim, njëjtë konsideron edhe Gjykata e Apelit, sepse ligji si i tillë*

është në rregull dhe duhet të zbatohet nga ata të cilët ky ligj i obligon me dispozitat e tij, siç është në rastin konkret dispozita e nenit 14 paragrafi 1.7 të të njëjtit ligj e që u referohet Kompanive të Sigurimeve në Kosovë".

24. Më 15 gusht 2018, Kompania "Illyria" paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të cekur më lart. Ajo po ashtu kërkoi nga Gjykata Supreme që lënda të referohet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën, si dhe kërkoi që të pezullohet zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese.

25. Për më tepër, Kompania "Illyria", në parashtresën e saj të 15 gushtit 2018, argumentoi: *"Duke qenë se as Rregullorja [e BQK-së] për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, e as Ligji nr. 04/ L-018 [për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia], nuk e kanë specifikuar që primi i sigurimit duhet të përmbajë financimin e Kryqit të Kuq, e paditura e ka pas të pamundur të inkasoj mjete për llogari të Kryqit të Kuq. Në anën tjetër, lartësia e primit, nuk mund të rritet ngase kjo nuk është autorizuar nga BQK-ja. Që këtej, Ligji i Kryqit të Kuq, përbën shpronësim direkt të të ardhurave të padituës. Në anën tjetër, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në Kapitullin II të saj, garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sipas nenit 21 par. 4 i Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme. Në këtë drejtim, duhet të potencohet se e paditura ka statusin e personit juridik dhe dispozitat e këtij kapitulli aplikohen edhe ndaj saj".*

26. Më 15 tetor 2018, gjykata referuese (përkatësisht Gjykata Supreme) dorëzoi në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë së dispozitës së nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, me Kushtetutën.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Gjykata referuese pretendon se neni 14, paragrafi 1.7, i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 120 [Financat Publike] të Kushtetutës.

28. Thelbi i kërkesës së gjykatës referuese, duke u thirrur edhe në pretendimet e Kompanisë "Illyria" të paraqitura para saj, konsiston në pretendimin se paragrafi 1.7, i nenit 14 të Ligjit të kontestuar, i cili i detyron kompanitë e sigurimeve në Kosovë për të paguar një (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjeteve të siguruara dhe i cili nuk parasheh ndonjë detyrim për kontribut për kompanitë tjera në Kosovë, i vendosë kompanitë e sigurimeve në pozitë të diskriminuar në raport me kompanitë tjera, në kundërshtim me parimin e vendosur në paragrafin 2, të nenit 119 të Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme], ku parashihet që *"Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme"*.

29. Gjykata referuese po ashtu pohon se *"e drejta e pronës së qytetarëve si persona fizikë dhe ndërmarrjeve private të ndryshme vendore dhe të jashtme është e garantuar me ligj dhe me Kushtetutë. Në këtë kontekst, konsiderojmë se me të drejtë e paditura e ngre çështjen e përputhshmërisë së dispozitës së lartpërmendur ligjore, duke konsideruar se e njëjta dispozitë ligjore është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.

30. Për të mbështetur pretendimet e saj, gjykata referuese thirret në një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, U-I-2441/2002, U-I-1107/2002, të 12 shkurtit 2013. Në lidhje me këtë, gjykata referuese vë në pah se Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të njëjta të Ligjit të Kroacisë, si paragrafit 1.7, të nenit 14 të Ligjit të kontestuar, kishte konstatuar se ato dispozita *"janë në mospërputhje me dispozitat e nenit 49, paragrafi 2 (Shteti ju siguron të gjithë sipërmarrësve pozitën e barabartë juridike në treg) si dhe nenit 51, paragrafi 1 (Çdo kush është i obliguar të merr pjesë në mbulimin e shpenzimeve publike në përputhje me mundësitë e veta ekonomike) të Kushtetutës së Kroacisë"*.

31. Gjykata referuese pohon se "*[edhe Avokati i Popullit [...], në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) me parashtresën nr.1553/2018, të datës 04.07.2018, ka dhënë mendim juridik se kjo dispozitë ligjore kontestuese është në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura kushtetuese"*.

32. Në fund, gjykata referuese pohon se *"[për arsyet e paraqitura më lart, dëshirojmë t'ju njoftojmë se edhe vendimi meritor i Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me normën ligjore të kontestuar më lart, kështu që Gjykata Supreme*

nuk mund të vendosë sipas revizionit, deri sa Gjykata Kushtetuese [...] të merr vendim meritor lidhur me këtë kërkesë".

Komentet e Kryqit të Kuq

33. Kryqi i Kuq, fillimisht, duke ju referuar aktgjykimeve të Gjykatës në rastet KO126/16 dhe KO142/16, rithekson kriteret e pranueshmërisë në lidhje me kërkesat e paraqitura sipas nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, ata pretendojnë se sipas interpretimit të Gjykatës, e drejta *"për të referuar një kërkesë për kontroll incidental i njihet gjyqtarit apo trupit gjykues i cili është kompetent për të gjykuar rastin konkret. [...] Në rastin konkret, [...], kërkesa nuk është referuar nga trupi gjykues që janë kompetent për të vendosur në meritat e rastit".*

34. Kryqi i Kuq po ashtu pretendon se procedura paraprake për inicim të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së një norme, në procedurën e kontrollit incidental, obligon gjykatën referuese që të shqyrtojë fillimisht vet në përbërjen e saj (trup gjykues) dyshimin për kundërkushtetutshmërinë e normës. Vetëm nëse trupi gjykues me shumicë të votave konsideron se norma është kundër kushtetuese, ajo mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së dispozitës konkrete. Në rastin konkret, një vlerësim i tillë nuk është zhvilluar nga trupi gjykues kompetent.

35. Kryqi i Kuq po ashtu pohon se, pasi gjykata referuese nuk ka dorëzuar "*dosjen në Gjykatën Kushtetuese"*, nuk mund të kuptohet thelbi i kontestit dhe nëse kriteret e tjera të zbatimit të drejtpërdrejtë të normës së kontestuar në rastin konkret dhe që kushtetutshmëria e normës së kontestuar të jetë parakusht për zgjidhjen e rastit, janë plotësuar. Rrjedhimisht, ata pretendojnë se kriteret e pranueshmërisë, sipas nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, nuk janë plotësuar.

36. Ata po ashtu pohojnë se gjykata referuese nuk ka arsyetuar kërkesën e saj ashtu si kërkohet me Aktgjykimin në rastin KO126/16, pasi që ata vetëm shkarazi kanë përmendur nenin 46 dhe 120 të Kushtetutës. Gjithashtu nga kërkesa e gjykatës referuese shihet që Kryetari i Gjykatës Supreme ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë dhe ka njoftuar se procedura në rastin konkret do të jetë e pezulluar. Kjo përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe cenim të gjykatës së pavarur, pasi procedura mund të pezullohet vetëm me një vendim gjyqësor dhe nga trupi gjykues i rastit konkret.

37. Sa i përket meritave të rastit, Kryqi i Kuq pretendon se gjykata referuese vetëm shkarazi konsideron se dispozitat e kontestuara "*cenojnë nenet 46 dhe 120 të Kushtetutës dhe për më tepër, ka përmendur një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë dhe një parashtresë të Avokatit të Popullit*", duke shtuar se *"vendimi i Gjykatës së Kroacisë mund të shërbej, krahas disa vendimeve të gjykatave tjera kushtetuese evropiane si referencë për të mbështetur pretendimet e veta",* por jo që të ceken shkarazi nenet kushtetuese dhe pastaj të ceket se kështu ka vepruar Gjykata Kushtetuese e Kroacisë.

38. Në lidhje me këtë, Kryqi i Kuq thekson se Gjykata Kushtetuese e Kroacisë nuk ka gjetur shkelje të së drejtës në pronë, siç pretendon gjykata referuese.

39. Për sa i përket cenimit të nenit 120 Kryqi i Kuq pohon se, *"Gjykata Kushtetuese në një sërë vendimesh i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara kërkesat e individëve për shkelje të pretenduara të neneve tjera jashtë kapitullit për liritë dhe të drejtat themelore"*.

40. Kryqi i Kuq, në fund, kërkon që kërkesa e *"Kryetarit [të gjykatës referuese] të shpallet e papranueshme"*, duke kërkuar që lëshimet procedurale dhe substanciale të gjykatës referuese të trajtohen me seriozitet.

Dispozitat përkatëse të ligjit të kontestuar (Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës):

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon statusin, veprimtarinë dhe burimet financiare të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kryqi i kuq i Kosovës është e vetmja Shoqatë Kombëtare e Kryqit të Kuq në Kosovë, e cila e zhvillon aktivitetin e vet humanitar, vullnetar, jofitimprurës në tërë territorin e Kosovës.
2. Kryqi i Kuq i Kosovës është ndihmëse e autoriteteve vendore për çështje humanitare në mbarë vendin dhe si i tillë gëzon përkrahjen e Institucioneve Qeveritare.

Neni 7
Misioni i Kryqit të Kuq të Kosovës

Misioni i Kryqit të Kuq i Kosovës është lehtësimi i vuajtjeve të individëve dhe bashkësive të rrezikuara përmes programeve të fokusuara, prioritare dhe të qëndrueshme si ndihmesë e

autoriteteve qendrore dhe lokale, në përputhje me Parimet Themelore të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Neni 14
Burimet Financiare

1. Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga:
1.1. anëtarësimi në Kryqin e Kuq të Kosovës;
1.2. veprimtaritë për realizimin e të cilave Republika e Kosovës, personat fizikë dhe juridikë ia besojnë Kryqit të Kuq të Kosovës;
1.3. aktivitetet tradicionale;
1.4. donacionet nga personat fizikë dhe juridikë të Republikës së Kosovës dhe shteteve të jashtme;
1.5. të ardhurat nga pronat dhe patundshmëritë e Kryqit të Kuq të Kosovës;
1.6. të hyrat nga realizimet e programeve të kontraktuara me marrëveshje të bashkëpunimit me ministritë përkatëse;
1.7. sigurimi i obligueshëm i automjeteve, një përqind (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit;
1.8. nga fondi i ndarë për mbështetje humanitare nga Lotaria e Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
1.9. Kryqi i Kuq i Kosovës nuk pranon donacione që drejtpërsëdrejti burojnë nga të ardhurat e veprimtarive që bien ndesh me parimet themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Neni 19
Dispozitat ndëshkuese

Për mospërfillje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 13 nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe nenin 14 paragrafët 1.7, 1.8, 1.9, gjykata kompetente për kundërvajtje i cakton dënim me të holla, personit juridik, në shumën prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) €, ndërsa personit fizik përkatësisht përfaqësuesit ligjor të personit fizik, në shumë prej pesëqind 500) deri njëmijë (1000) €.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 8, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

43. Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 51
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikojë se cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Neni 52
Procedura para Gjykatës

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 53
Vendimi

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

44. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 39 dhe 77 të Rregullores së punës, që specifikojnë:

Rregulli 39 [Kriteret e pranueshmërisë]

" [...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dështon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
[...]

Rregulli 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit]

(1) Kërkesa e ngritur sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit.

(2) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë një kërkesë sipas këtij rregulli, me kusht që:

(a) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata në lidhje me çështjen në pritje; dhe

(b) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin lidhur me rastin në pritje të gjykatës.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën. Dokumenti i shqyrtuar nga Gjykata i bashkëngjitet kërkesës.

(4) Gjykata referuese mund të parashtrojë kërkesë ex officio ose me kërkesën e njërës prej palëve në rast dhe pavarësisht nëse një palë në rast ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

(5) Pas parashtrimit të kërkesës, Gjykata urdhëron gjykatën referuese që të pezullojë procedurën lidhur me rastin në fjalë derisa të merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

45. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, rezulton se çdo kërkesë e dorëzuar sipas nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, që të jetë e pranueshme, duhet t'i plotësojë kriteret në vijim:

a) Kërkesa të jetë dorëzuar nga një "gjykatë";
b) Gjykata (referuese) duhet të mos jetë e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën;
c) Gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozitat të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën;
d) Ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj;
e) Ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin në shqyrtim.

46. Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj gjyqësore e cila konfirmon kriteret e lartpërmendura, përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave të paraqitura në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih*, mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO126/16, parashtrues: *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, të 27 marsit 2017, paragrafi 62, si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KO142/16, parashtrues: *Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, të 9 majit 2017, paragrafi 58).

47. Rrjedhimisht, Gjykata fillimisht vlerëson nëse gjykata referuese është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.

48. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kërkesa është dorëzuar nga Gjykata Supreme dhe është nënshkruar nga kryetari i saj, në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij. Kërkesa theksohet qartë se ajo paraqitet nga Gjykata Supreme e cila duhet të vendosë për revizionin e Kompanisë "Illyria". Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme është dorëzuar nga "gjykata" në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO04/11, parashtrues: *Gjykata Supreme e Kosovës*, të 1 marsit 2011. Shih gjithashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese, KO126/16).

49. Gjykata po ashtu vëren se gjykata referuese ka ngritur dyshime për sa i përket kushtetutshmërisë së ligjit të kontestuar. Pra, gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën.

50. Për më tepër, gjykata referuese ka specifikuar në mënyrë të veçantë paragrafin 1.7, të nenit 14 të Ligjit të kontestuar, si dispozitë të cilën e konsideron se mund të jetë në shpërputhje me Kushtetutën.

51. Në vijim, Gjykata vlerëson nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti nga gjykata referuese në lëndën në shqyrtim e sipër para saj dhe nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga gjykata referuese.

52. Gjykata konsideron se "zbatimi i drejtpërdrejtë" i normës konkrete nënkupton se nga zbatimi apo moszbatimi i drejtpërdrejtë i saj varet rezultati i vendimit nga ana e gjykatës referuese. Përkatësisht, si pasojë e zbatimit apo moszbatimit të drejtpërdrejtë të normës konkrete, gjykatat e rregullta do të mund të merrnin vendime me rezultate të ndryshme (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO126/16, të cekur më lart, paragrafi 64).

53. Së këndejmi, në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë, duhet të ketë një raport të domosdoshëm ndërmjet vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga kjo Gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjykata referuese, në kuptimin që gjykimi nga gjykata referuese nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese" (shih, *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO126/16, të cekur më lart, paragrafi 65, dhe Gjykatës Kushtetuese, KO142/16, të cekur më lart, paragrafi 62.)

54. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit të kontestuar:

> *"1. Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj, Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga:*
>
> *[...]*
>
> *1.7 sigurimi i obligueshëm i automjeteve, një përqind (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit".*

55. Gjykata vëren se padia e Kryqit të Kuq ishte iniciuar për shkak se ajo kishte konsideruar se Kompania "Illyria" nuk e ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, për të paguar një përqind (1%) të bruto primit të vlerës së sigurimit të automjetit nga sigurimi i obligueshëm i automjeteve.

56. Kërkesëpadinë e Kryqit të Kuq e kishte aprovuar Gjykata Themelore dhe e kishte vërtetuar Gjykata e Apelit, duke detyruar Kompaninë "Illyria" që t'ia paguaj Kryqit të Kuq shumën e caktuar, duke u bazuar tërësisht në dispozitat e nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar.

57. Gjykata rikujton se, pas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në lidhje me padinë e Kryqit të Kuq, Kompania "Illyria" ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, ku pretendimet e revizionit lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me ligjin e kontestuar dhe kushtetutshmërinë e normës ligjore të kontestuar. Në lidhje me këtë, gjykata referuese sqaron se *"ajo nuk mund të vendosë sipas revizionit deri sa Gjykata Kushtetuese të merr vendim meritor lidhur me këtë kërkesë"*.

58. Andaj, duke pasur parasysh atë që u tha më sipër, Gjykata konsideron ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti nga gjykata referuese në lëndën në shqyrtim e sipër para saj.

59. Për më tepër, Gjykata konsideron së kushtetutshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin nën shqyrtim para saj, pasi shpallja (jo) kushtetues i dispozitave të kontestuara do të kishte ndikim vendimtar në epilogun e vendosjes për revizionin, nga Gjykata Supreme (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO126/16, të cekur më lart, paragrafi 65.)

60. Rrjedhimisht, për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, Gjykata konstaton se gjykata referuese është palë e autorizuar, ka ngritur mëdyshje të arsyeshme për ligjin e kontestuar dhe ka dëshmuar se ai ligj duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastin nën shqyrtim para saj. Po ashtu, Gjykata referuese ka arsyetuar se ligjshmëria, përkatësisht kushtetutshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin nën shqyrtim dhe ka qartësuar se cilat dispozitat të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me dispozita konkrete të Kushtetutës.

61. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa gjithashtu nuk është e papranueshme në asnjë nga bazat e tjera të përfshira në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

62. Prandaj, Gjykata deklaron që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim të meritave të saj.

Meritat e kërkesës

63. Gjykata rikujton se gjykata referuese gjatë shqyrtimit të rastit konkret ka ngritur dyshime për papajtueshmërinë e nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit të kontestuar, me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], dhe 120 [Financat Publike] të Kushtetutës.

64. Gjykata rikujton edhe njëherë paragrafin 1.7, të nenit 14 të Ligjit të kontestuar, që parasheh:

> *"1. Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga:*
>
> *[...]*
>
> *1.7 sigurimi i obligueshëm i automjeteve, një përqind (1%) nga bruto primi i vlerës se sigurimit të automjetit".*

65. Thelbi i kërkesës së gjykatës referuese konsiston në pretendimin se paragrafi 1.7, i nenit 14 të Ligjit të kontestuar, duke i detyruar për të paguar një përqind (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjeteve të siguruara nga kompanitë e sigurimeve në Kosovë dhe duke mos paraparë ndonjë detyrim të tillë për kompanitë tjera në Kosovë, i vendosë kompanitë e sigurimeve në pozitë të diskriminuar në raport me kompanitë tjera. Kjo, në kundërshtim me parimin e vendosur në nenin 24, paragrafin 2, dhe nenin 119 të Kushtetutës.

66. Në lidhje me këtë, gjykata referuese, bazuar në pretendimet e Kompanisë "Illyria", argumenton se lartësia e primit të cilën e paguajnë të siguruarit nuk mund të rritet për të mbuluar kërkesat e ligjit të kontestuar, pasi rritja e primit duhet të autorizohet nga Banka Qendrore e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK), në bazë të strukturës së primit dhe kjo pagesë nuk parashihet në strukturën e primit. Andaj, shuma e pagesës prej një përqind (1%) e bruto primit të sigurimeve të automjeteve, duhet të paguhet nga buxheti i kompanive të sigurimeve që ofrojnë këtë shërbim. Rrjedhimisht, sipas tyre, trajtimi i pabarabartë, i kompanive të sigurimit që ofrojnë këtë lloj të sigurimit në raport me kompanitë tjera në Kosovë rezulton edhe në cenimin e të drejtës së tyre në pronë sipas nenit 46 të Kushtetutës.

67. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
> *2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
> *3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të*

drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".

68. Gjykata më tej i referohet nenit 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër".

69. Në lidhje me nenin 14 të Konventës, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera".

70. Gjykata më tej i referohet nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.
[...]".

71. Gjykata po ashtu i referohet nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 120 [Financat Publike] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"Neni 119 [Parimet e Përgjithshme]

1. *Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.*

2. *Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.*

8. Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.
[...]

Neni 120 [Financat Publike]

1. *Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.*

2. *Administrimi i politikës fiskale në të gjitha nivelet e qeverisë do të jetë në pajtim me kushtet për inflacion të ulët dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës.*

3. *Huat publike rregullohen me ligj dhe duhet të jenë në pajtim me stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale".*

72. Gjykata sjellë në vëmendje se thelbi i pretendimeve të kërkesës ka të bëjë me papajtueshmërinë e nenit 14 (1.7) të Ligjit të kontestuar me nenet 24, 46 dhe 119 të Kushtetutës.

73. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata fillimisht thekson se, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, "*të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

74. Gjithashtu, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"[të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

Parimet e përgjithshme në lidhje me barazinë para ligjit dhe të drejtën në pronë

75. Gjykata përsërit që neni 24 i Kushtetutës përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore.

76. Në lidhje me këtë të drejtë, GJEDNJ-ja ka përsëritur se *"neni 14 [i KEDNJ-së] i plotëson dispozitat e tjera substanciale të Konventës dhe të protokolleve. Nuk ka ekzistencë të pavarur, pasi që ka efekt vetëm në lidhje me 'gëzimin e të drejtave dhe lirive' të mbrojtura nga këto dispozita"*(Shih rasti i GJEDNJ-së, *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë*, Kërkesat nr. 60367/08 dhe 961/11, Aktgjykimi i 24 janarit 2017, para. 53. Më tutje, GJEDNJ ka përcaktuar se, "*edhe pse zbatimi i nenit 14 nuk parakupton shkeljen e atyre dispozitave [të tjera] – dhe në këtë kuptim është i pavarur – nuk mund të ketë hapësirë për zbatimin e tij përderisa faktet e rastit nuk bien në kuadër të ndonjërës prej atyre [dispozitave],* (shih rastin *Sejdic and Finci v. Bosnia and Herzegovina*, Aktgjykimi i 22 janarit 2009).

77. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme*, ose status,* mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (Shih, *mutatis mutandis Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976, para. 56; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, 16 mars 2010, para. 61).

78. Gjykata konsideron se, për qëllimet e interpretimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, një trajtim ndryshe është i pabarabartë dhe arbitrar nëse: 1) nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se nuk ndjek një qëllim legjitim, ose 2) kur nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatësisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet (Shih, *mutatis mutandis Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesat nr. 9214/80; 9473/81 dhe 9474/81, 24 prill 1985 paragrafi 72).

79. Gjykata thekson se Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë, përkatësisht një hapësirë diskrecionale, kur

vlerësojnë nëse dhe deri në çfarë mase mund të arsyetohet trajtimi i pabarabartë në rrethana të njëjta. Fushëveprimi i kësaj margjine ndryshon sipas rrethanave, sipas objektit të çështjes dhe sipas historisë së rastit. Një margjinë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (Shih, *mutatis mutandis, Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13378/05, 29 prill 2008, paragrafi 60; *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 64).

80. Gjykata vë në pah se thelbi i kërkesës ka të bëjë me pretendimet për papajtueshmëri të ligjit të kontestuar me nenin 24 të Kushtetutës. Sidoqoftë, kërkesa ngre pretendime edhe sa i përket të drejtave pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata thekson se paragrafi 1, i nenit 46 të Kushtetutës e garanton të drejtën e pronës; paragrafi 2, i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik dhe në paragrafin 3, garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet në të cilat prona mund të eksproprijohet (shih, *mutatis mutandis*, rasti KI50/16, parashtrues i kërkesës *Veli Berisha dhe të tjerët*, Aktvendimi për papranueshmëri i 10 marsit 2017, paragrafi 31).

81. Gjykata vëren se edhe GJEDNJ ka konstatuar se e drejta e pronës përbëhet nga tri parime themelore. Parimi i parë, i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pronës; kjo përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë. Parimi i dytë përfshin privimin nga prona dhe ia nënshtron të njëjtin kushteve të caktuara; kjo përcaktohet në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf. Parimi i tretë ua njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ato ligje që ato i çmojnë të nevojshme për këtë qëllim; kjo përcaktohet në paragrafin e dytë (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 shtatorit 1982, *Sporrong dhe Lonnrot kundër Suedisë*, nr. 7151/75; 7152/75, para. 61).

82. Të tri parimet nuk janë, megjithatë, "të ndryshme" në kuptimin e të qenurit të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe, prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (Shih, *mutatis*

mutandis, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme të trajtimit të barabartë në lidhje me të drejtë në pronë në rastin konkret

A. Në lidhje me trajtimin e pabarabartë

83. Gjykata së pari përcakton nëse ekziston një dallim në trajtimin e kompanive që ofrojnë sigurime të automjeteve, në njërën anë, dhe kompanive të tjera që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në Kosovë (duke përfshirë edhe ato që ofrojnë shërbime të tjera të sigurimeve), në anën tjetër.

84. Fillimisht, Gjykata vë në dukje se ligji i kontestuar përcakton disa burime financimi për Kryqin e Kuq të Kosovës, ku neni 14 (1.7) krijon detyrime specifike për një kategori subjektesh ekonomike, përkatësisht kompanitë e sigurimeve që ofrojnë sigurim nga autopërgjegjësia.

85. Gjykata vëren se paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit të kontestuar parasheh që për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj, Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare, duke inkasuar një përqind (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit. Kjo shumë e caktuar duhet të paguhet vetëm nga kompanitë që ofrojnë këtë lloj të sigurimit në Kosovë. Megjithatë, subjektet tjera ekonomike që veprojnë në Kosovë, të cilat ofrojnë sigurime në Kosovë, por nuk ofrojnë sigurime të automjeteve, nuk janë të detyruara që të paguajnë këtë shumë të caktuar për Kryqin e Kuq. Kontribut të ngjashëm nuk janë të obliguara të paguajnë as subjektet e tjera ekonomike që veprojnë në Kosovë.

86. Gjykata vë në dukje se nga paragrafi 1.7, të nenit 14 të Ligjit të kontestuar, rrjedh se vetëm kompanitë që ofrojnë këtë lloj të sigurimit janë të obliguara të paguajnë një përqindje nga të hyrat e tyre për Kryqin e Kuq.

87. Gjykata konsideron se kompanitë e sigurimeve që ofrojnë shërbime të sigurimit të automjeteve, në njërën anë, dhe kompanitë që ushtrojnë veprimtari të tjera në Kosovë, në anën tjetër, janë në situatë analoge ose në situatë të ngjashme, kundruall veprimtarisë së Kryqit të Kuq. Pra, të gjitha, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë. Megjithatë, për shkak të fushëveprimit të tyre, ofrimit të sigurimit të automjeteve, ato janë vënë në pozita të ndryshme, për sa i përket detyrimit për të kontribuar në buxhetin e Kryqit të Kuq.

88. Gjykata më tej vëren se fushëveprimatria e kompanive, në këtë rast ofrimi i sigurimit të automjeteve, është kriter për vendosjen e detyrimit për të kontribuar në buxhetin e Kryqit të Kuq. Gjykata rikujton se fushëveprimatria përbën një aspekt të statusit personal, për qëllimet e nenit 24 të Kushtetutës. Neni 24 kërkon që askush nuk mund të diskriminohet, ndër të tjera, në bazë të *"ndonjë statusi tjetër personal"*, ndërsa, ndërlidhur me këtë, neni 119 i Kushtetutës përcakton se *"Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme"*.

89. Prandaj, Gjykata konsideron se dallimi në obligimin për të kontribuar për Kryqin e Kuq është bërë në varësi nga fushëveprimtaria e kompanive në Kosovë, duke rezultuar në një situatë në të cilën kompanitë që ofrojnë sigurime të automjeteve në Kosovë, janë të obliguara që të paguajnë një përqind (1%) të primit nga sigurimet e automjeteve, por jo edhe ato që ofrojnë lloje të ndryshme të sigurimit apo që ushtrojnë veprimtari tjetër në Kosovë. Megjithatë, të gjitha kompanitë që ushtrojnë veprimtarinë në Kosovë janë në një situatë relativisht të ngjashme.

90. Si rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundim se ekziston një dallim në trajtimin të kompanive në Kosovë, që janë në një situatë analoge ose në situatë të ngjashme, që manifestohet përmes detyrimit për të paguar një shumë të caktuar nga të hyrat e tyre për financimin e Kryqit të Kuq të Kosovës. Ky fakt kufizon të drejtën e tyre për barazi para ligjit, që rezulton edhe në kufizimin e të drejtës për mbrojtje të pronës, sipas nenit 24, 119 dhe 46 të Kushtetutës.

B. Në lidhje me arsyetimin e kufizimeve të të drejtave

91. Gjykata rikujton se të drejtat e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë mund të kufizohen në raste të caktuara, nëse kufizimi ndjek një qëllim legjitim dhe nëse ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

92. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. "Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar".

93. Në dritën e kësaj dispozite kushtetuese, si dhe me praktikën e GJEDNJ-së lidhur me nenin 14 të KEDNJ-së (e cila i referohet të njëjtave kushte, për sa i përket vlerësimit të diskriminimit), në rastin në fjalë Gjykata do të analizojë:

1) nëse kufizimi i të drejtave është paraparë me ligj;
2) nëse kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihet me kufizim; dhe
3) nëse kishte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të të drejtave dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej.

1) nëse kufizimi është i paraparë me ligj

94. Gjykata, fillimisht rikujton se institucionet e pushtetit publik gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë të çështjeve të interesit të përgjithshëm dhe të mbulimit të sferave të ndryshme me norma të shkruara, përkatësisht me ligje.

95. Në këtë kuptim, Kushtetuta në kapitullin II të saj iu ka dhënë rëndësi të posaçme të drejtave dhe lirive të njeriut dhe gjithashtu ka paraparë edhe rastet kur këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse këtë e kërkon interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe i Shtetit.

96. Sa i përket kufizimit të paraparë me ligj, Gjykata vëren se kufizimi i të drejtave në rastin konkret ishte paraparë me nenin 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, i cili ishte miratuar nga Kuvendi, më 10 qershor 2010, institucion të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ.

97. Prandaj, nisur nga fakti se një e drejtë e garantuar me kapitullin II të Kushtetutës mund të kufizohet me ligj, kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, Gjykata konsideron se kufizimi i të drejtave është në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 1, të nenit 55 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se obligimi i kompanive të sigurimit për të pagur një përqind (1%) të primit nga sigurimet e automjeteve, në rastin konkret, ka qenë i paraparë me ligj.

2) nëse kufizimi ndjekë një qëllim legjitim dhe është proporcional

98. Sa i përket kriterit të dytë, Gjykata vë në dukje praktikën gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, nga ku rrjedhë se trajtimi i pabarabartë nuk është në pajtim me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të Konventës, nëse nuk ndjekë një qëllim legjitim apo nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet (Shih, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO01/17). Përgjatë kësaj vije argumentuese, GJEDNJ *në rastin Sejdic dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, theksoi se: "*[...] diskriminim do të thotë trajtim i pabarabartë, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, i personave në rrethana të ngjashme. Mungesa e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm, nënkupton që dallimi nuk ndjekë një qëllim legjitim, ose që nuk ka marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimeve që dëshirohet të arrihen*".

99. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se ligjvënësi nëpërmjet nxjerrjes së ligjit të kontestuar kishte si qëllim rregullimin e statusit, veprimtarisë dhe burimeve financiare të Kryqit të Kuq. Në bazë të nenit 2 të Ligjit të kontestuar, Kryqi i Kuq i Kosovës është shoqatë e cila e zhvillon veprimtarinë e vet humanitare, vullnetare, jofitimprurëse në tërë territorin e Kosovës - veprimtari kjo e cila gëzon përkrahjen e institucioneve qeveritare të Republikës së Kosovës. Misioni i Kryqit të Kuq, sipas nenit 7 të Ligjit të kontestuar është mbështetja e autoriteteve qendrore dhe lokale, në lehtësimin e vuajtjeve të individëve, të bashkësive të rrezikuara dhe të edukimit shëndetësor të tyre.

100. Për më tepër, ndonëse Kryqi i Kuq i Kosovës është themeluar si shoqatë, statusi i saj rregullohet me ligj të veçantë të nxjerrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky fakt dëshmon për dobishmërinë publike të Kryqit të Kuq të Kosovës dhe, rrjedhimisht, nevojën për sigurimin e burimeve të qëndrueshme të financimit të saj.

101. Në këtë sfond, Gjykata vë në pah se institucionet e pushtetit në bazë të kompetencave të tyre dhe vlerësimit të lirë të tyre konsideruan se nxjerrja e ligjit të kontestuar është interes i përgjithshëm i vendit, duke pasur parasysh misionin dhe veprimtarinë e Kryqit të Kuq, në ofrimin e ndihmës dhe të mbështetjes së institucioneve qendrore dhe lokale në dobi të individit dhe shoqërisë dhe i shërben interesit publik.

102. Megjithatë, Gjykata rikujton kërkesat e paragrafit 4, të nenit 55 të Kushtetutës, i cili në mënyrë të qartë parasheh se cilat janë obligimet dhe detyrimet e institucioneve të pushtetit publik dhe të gjykatave, në rastet e kufizimit të të drejtave. Kjo depozitë, shprehimisht përcakton që institucionet në fjalë duhet t'i kushtojnë kujdes thelbit së të drejtave që kufizohen, rëndësisë, qëllimit të kufizimit të të drejtave, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim sa më të vogël të të drejtave, që nënkupton ekzistimin e një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.

103. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të vlerësojë nëse pagesa e përcaktuar me dispozitën e ligjit të kontestuar ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dhe nëse është proporcional, deri në masën sa ky detyrim të mos e cenojë esencën e të drejtave që Kushtetuta dhe KEDNJ ua garanton personave fizikë dhe juridikë, në radhë të parë të drejtën e barazisë para ligjit.

104. Fillimisht, Gjykata dëshiron të theksojë se dispozita e ligjit të kontestuar, përkatësisht paragrafi 1.7, i nenit 14 është dispozitë e karakterit detyrues, e cila parasheh njërën nga format e financimit të Kryqit të Kuq. Karakterin detyrues kësaj dispozite ia jep neni 19 [Dispozitat ndëshkuese] i Ligjit të kontestuar, i cili parasheh:

> "*Për mospërfillje të detyrimeve të përcaktuara në ... nenin 14 paragrafët 1.7 ... gjykata kompetente për kundërvajtje i cakton dënim me të holla, personit juridik, në shumën prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) €, ndërsa personit fizik përkatësisht përfaqësuesit ligjor të personit fizik, në shumë prej pesëqind (500) deri njëmijë (1000) €*".

105. Gjykata, gjithashtu, vëren se përveç karakterit detyrues, dispozita e ligjit të kontestuar po ashtu ka edhe karakter selektiv, sepse e njëjta obligon vetëm një kategori subjektesh ekonomike, gjegjësisht vetëm kompanitë e sigurimeve, që nga pasuria e tyre (prona) e inkasuar nga sigurimi i obligueshëm i automjeteve të ndajnë një përqind (1%) të bruto primit për financimin e Kryqit të Kuq dhe jo edhe subjektet tjera ekonomike që operojnë në Republikën e Kosovës.

106. Gjykata konsideron se, ndonëse ligjvënësi nëpërmjet kufizimit të të drejtave kishte për qëllim arritjen e një qëllimi që përkon me interesin e përgjithshëm shoqëror, megjithatë nuk është e qartë pse ligjvënësi nuk e ka shtrirë dhe shpërndarë detyrimin financiar, të vendosur me dispozitën e ligjit të kontestuar edhe tek subjektet tjera ekonomike, por vetëm te kompanitë e sigurimeve që ofrojnë këtë lloj të sigurimit.

107. Pra, Gjykata vëren se as Kuvendi dhe as ndonjë instancë tjetër përkatëse, nuk kanë paraqitur ndonjë arsyetim të qëndrueshëm se përse ligji i kontestuar i ngarkon me detyrim vetëm kompanitë e sigurimit, për të kontribuar në financimin e Kryqit të Kuq.

108. Gjykata, konsideron se poqëse pagesa e paraparë me dispozitën e ligjit të kontestuar do të shpërndahej në mënyrë të arsyeshme dhe proporcionale ndaj të gjitha subjekteve ekonomike, kjo do të ishte në pajtim me kërkesat e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, me pozitën e barabartë në treg të garantuar me nenin 119 të Kushtetutës, si dhe me kërkesat e paragrafëve 4 dhe 5, të nenit 55 të Kushtetutës.

109. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, nr. U-I-244112002, U-I-1107/2002, të 12 shkurtit 2003, rast të cilit gjithashtu i është referuar gjykata referuese. Në rastin e Kroacisë, kërkesa ishte parashtruar nga Zyra Kroate e Sigurimeve dhe Oda Ekonomike e Kroacisë, të cilët nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë kërkuan vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 12, paragrafit 3 dhe nenin 24 paragrafi 1.1 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kroacisë (ligji i kontestuar), me nenet 3, 49, 50 dhe 51 të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë.

110. Me nenin 12, paragrafi 3 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kroacisë, parashihej që: *"Nga sigurimi i detyrueshëm i automjeteve, në vit ndahet 1% të mjeteve në dobi të Kryqit të Kuq të Kroacisë, për avancimin e veprimtarisë së ofrimit të ndihmës së parë me qëllim të zvogëlimit të aksidenteve të trafikut"*. Ndërsa, me nenin 24 (dispozita ndëshkuese), paragrafi 1, pika (1) përcaktohej aplikimi i gjobës në rast të moszbatimit të nenit 12, paragrafit 3, nga kompanitë e sigurimeve të automjeteve të Kroacisë.

111. Sa i përket përputhshmërisë së dispozitës së Ligjit të Kryqit të Kuq të Kroacisë, me nenin 49, paragrafi 2 të Kushtetutës së Kroacisë (pozita e barabartë), Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, konsideroi se kjo dispozitë e ligjit të kontestuar: *"Është në kundërshtim me garancinë kushtetuese të pozitës së barabartë juridike të të gjithë sipërmarrësve në treg, përcaktimi i obligimeve me të cilat një grup i sipërmarrësve vihet në pozitë të pabarabartë në raport me të tjerët. Pikërisht kjo është bërë me dispozitën e kontestuar ligjore ndaj shoqërive të sigurimit, të cilat, të vetme në mesin e të gjitha shoqërive tregtare, duhet të ndajnë mjete nga primet e sigurimit, në rastin konkret të atyre sigurimeve në të cilat pronarët ose shfrytëzuesit e mjeteve motorike janë siguruar nga përgjegjësia për dëmet të cilat u shkaktohen palëve të treta në komunikacion (...)"*.

112. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë konstatoi gjithashtu se dispozita e ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri edhe me nenin 51 të Kushtetutës së Kroacisë, duke arsyetuar se: *"[...] nëse ligjvënësi ka konsideruar se është e nevojshme që në interes të bashkësisë shoqërore në tërësi të përmirësohen kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së Kryqit të Kuq të Kroacisë në përgjithësi, atëherë obligimi i ndarjes së rritur për këtë qëllim ishte dashur të përcaktohet për të gjitha subjektet ekonomike në përputhje me mundësitë e tyre, dhe kjo do të ishte në pajtim edhe me dispozitën e nenit 51, paragrafi 1 të Kushtetutës "Çdokush është i obliguar të merr pjesë në mbulimin e shpenzimeve publike, në përputhje me mundësitë e veta ekonomike"*.

113. Në dritën e shtjellimeve të mësipërme, Gjykata konsideron se detyrimi vetëm i kompanive të sigurimit për të paguar shumën e caktuar nga të hyrat e realizuara nga sigurimi i autopërgjegjësisë, si kontribut për buxhetin e Kryqit të Kuq, nuk është i justifikuar, gjegjësisht nuk është i bazuar në arsye objektive. Rrjedhimisht, nuk ekziston një qëllim legjitim që do të arsyetonte trajtimin e pabarabartë të kompanive të sigurimit të automjeteve.

114. Gjykata i referohet praktikës së saj (shih Aktgjykimin në rastin KO01/17), kur ka konstatuar se mosekzistimi i qëllimit legjitim, të trajtimit të pabarabartë, e bënë të panevojshme analizën e proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet.

115. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata konsideron se si rrjedhojë e trajtimit të pabarabartë të kompanive të sigurimit në raport me kompanitë tjera në Kosovë, dhe duke pasur parasysh se pagesa nga kompanitë e

sigurimeve të një përqind (1%) të shumës nga bruto primi i autopërgjegjësisë zvogëlon pasurinë e kompanive të sigurimeve, paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit të kontestuar gjithashtu nuk është në pajtueshmëri me të drejtën e pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës.

116. Nga si u tha më lart, Gjykata konsideron se dispozita e ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me kërkesat e nenit 24 [Barazia para Ligjit], paragrafit 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

117. Gjykata rikujton se gjykata referuese po ashtu ngre edhe çështjen e pajtueshmërisë së ligjit të kontestuar me nenin 120 [Financat Publike] të Kushtetutës. Mirëpo, duke pasur parasysh se Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 24, 46 dhe 119 të Kushtetutës, ajo nuk e konsideron të nevojshme vlerësimin e pajtueshmërisë së ligjit të kontestuar me nenin 120 të Kushtetutës.

118. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se paragrafi 1.7, i nenit 14 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113. 8 dhe 116. 3 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 51 të Ligjit dhe rregullat 39 dhe 59 (a) të Rregullores së punës, më 13 mars 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË SHPALLË që paragrafi 1.7, i nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës;

III. VENDOS, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, që paragrafi 1.7, i nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, është i pavlefshëm, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

V. TË PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KO171/18, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

KO171/18, Aktgjykim i 25 prill 2019, publikuar më 20 maj 2019

Fjalët kyç: kërkesë institucionale, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

Kërkesa ishte parashtruar nga Avokati i Popullit, në cilësinë e palës së autorizuar në bazë të paragrafit 2, nënparagrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (të tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar) dhe kërkoi vendosjen e masës së përkohshme.

Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Ligji i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe me Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës ishin rreth: (i) tejkalimit të fushëveprimit të ngushtë të Këshillit, i përcaktuar me Kapitullin VI të Kushtetutës; (ii) shkeljes së pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese; dhe (iii) dhënies së imunitetit anëtarëve të Këshillit.

Gjykata konstatoi që kërkesa i plotëson kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës dhe në meritat e Aktgjykimit adresoi secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës. Gjykata vlerësoi dhe konstatoi si në vijim:

Së pari, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me tejkalimin e fushëveprimit të ngushtë të Këshillit, Gjykata konsideroi se shprehja "Shërbimi Civil" sipas leximit dhe interpretimit të nenit 101 të Kushtetutës, duhet kuptuar në kontekstin e saj dhe në qëllimin që ka pasur hartuesi, qëllim i cili është i shprehur në nenin 1 të Ligjit të Shërbimit Civil, duke evituar kështu mundësinë e keqinterpretimeve ose të interpretimeve

teknike të normës në fjalë. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se neni 2 i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil], paragrafin 1 dhe 2 të Kushtetutës.

Së dyti, sa i përket setit të dytë të pretendimeve, Gjykata fillimisht, duke rikujtuar edhe praktikën e saj gjyqësore në të cilën kishte zhvilluar parimet lidhur me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, theksoi që këto të fundit nuk lirohen nga detyrimi që në rregullore apo në aktet juridike t'i rregullojnë specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet e tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar; dhe gjatë zbatimit të Ligjit të kontestuar duhet t'u njihet funksioni i tyre, ndër të tjera, në nxjerrjen dhe në aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, deri në masën e nevojshme, për të mbrojtur pavarësinë e tyre.

Ndërsa, sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar në lidhje me institucionet e tjera publike, Gjykata konkludoi se neni 4 (paragrafi 1), në ndërlidhje me nenin 3 (paragrafi 1.1), i cili rregullonte statusin e Këshillit, nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën sepse Gjykata vlerësoi që Këshilli nuk mund të kategorizohet me statusin e institucionit të pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës.

Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 6 (paragrafi 1.2), dhe nenit 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8) të Ligjit të kontestuar, nene këto të cilat rregullonin mbikëqyrjen e përzgjedhjes së nëpunësve civilë për pozita të nivelit të lartë drejtues nga ana e Këshillit, Gjykata konstatoi se nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Gjykata konsideroi se trajtimi i pabarabartë i shërbyesve civilë në raport me kompetencën e Këshillit për mbikëqyrje të përzgjedhje të shërbyesve civilë, i përcaktuar me këto dispozita të Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me të drejtën kushtetuese për barazi para ligjit.

Gjykata konstatoi që dispozitat vijuese të Ligjit të kontestuar, konkretisht neni 2 për fushëveprimin; neni 3 (paragrafi 1.2, 1.3, 1.4) për përkufizimet "nëpunës civil", "nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues", "nëpunës civil i nivelit drejtues"; neni 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4) për kompetencat e Këshillit; neni 11 (paragrafi 3) për imunitetet; neni 18 për mënyrat e vendosjes për ankesat; neni 20 (paragrafi 5) për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit; neni 21 për vendimet e Këshillit; neni 22 për inicimin e konfliktit administrativ; neni 23 për procedurat në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit; nenit 24 për sanksionet administrative; dhe neni 25 (paragrafët 2 dhe 3) lidhur me bashkëpunimin e institucioneve, të Ligjit të kontestuar, janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Së treti, Gjykata, marrë pasur parasysh imunitetin e limituar që u garantohet me Ligjin e kontestuar anëtarëve të Këshillit, vlerësoi se masa e përdorur është proporcionale dhe konstatoi që neni 11, paragrafi 3, i Ligjit të kontestuar, është në përputhje me të drejtën për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KENDJ-së.

Në fund, në lidhje me vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata konsideroi që nuk është e nevojshme të shqyrtohet meqenëse është vendosur për meritat e rastit.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO171/18

Parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar), i cili hyri në fuqi më 25 gusht 2018, gjegjësisht neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1,

nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3) 18, 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të referuara më lart të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë zbatimin e neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3) 18, 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 2, nënparagrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2, të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e Përkohshme], 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] dhe 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 2 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 5 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 7 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.

9. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës me udhëzimin që t'ua shpërndajë kërkesën të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Kryesuesit të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Këshilli), me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 21 nëntor 2018.

10. Kërkesa iu komunikua edhe Sekretariatit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga i cili u kërkua që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante lidhur me kërkesën.

11. Më 9 nëntor 2018, kërkesa iu komunikua Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Bankës Qendrore të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur për Media, me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 21 nëntor 2018.

12. Më 12 nëntor 2018, Sekretariati i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin përkitazi me procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të Ligjit të kontestuar në Kuvend, mes tjerash, si vijon: nismën legjislative, përkatësisht Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë Projektligjin); mendimin e Qeverisë lidhur me Projektligjin; transkriptin e seancës për miratim në parim të projektligjit; transkriptin e seancës në të cilin u miratua Ligji i kontestuar; dhe Vendimin e Kuvendit për miratimin e Ligjit të kontestuar.

13. Më 20 nëntor 2018, Komisioni i Pavarur i Mediave dërgoi shkresën, përmes së cilës konfirmon se mbështet pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

14. Më 21 nëntor 2018, Këshilli dorëzoi komentet e tyre, përmes të cilave në tërësi kundërshtojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke dorëzuar edhe dokumente shtesë.

15. Më 29 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigjen ndaj komenteve të Këshillit të 21 nëntorit 2018.

16. Më 28 mars 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

17. Më 25 prill 2019, Gjykata votoi për pranueshmërinë e kërkesës dhe për të gjetur shkelje në lidhje me Ligjin e kontestuar.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 22 dhjetor 2001 u nxor Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, e cila themeloi Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

19. Më 16 gusht 2010, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës u shpall në Gazetën Zyrtare.

20. Në janar 2018, Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Republikës së Kosovës inicioi procedurën për miratimin e Ligjit të kontestuar.

21. Më 23 korrik 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e kontestuar, me 58 (pesëdhjetë e tetë) vota për, 1 (një) votë kundër dhe 7 (shtatë) abstenime.

22. Më 8 gusht 2018, Ligji i kontestuar u shpall nga Presidenti i Republikës së Kosovës (Dekreti nr. DL - 028-2018).

23. Më 10 gusht 2018, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

24. Me nenin 32 të Ligjit të kontestuar parashihet që "*Ky ligji hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*".

25. Me nenin 31 të Ligjit të kontestuar parashihet që *"pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës konteston dispozitat e Ligjit të kontestuar, përkatësisht nenet 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi

3) 18, 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3).

27. Parashtruesi i kërkesës, përkitazi me dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar, ngre pretendime në lidhje me: (i) *shkeljen e pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit; (ii) tejkalimin e fushëveprimit të ngushtë të Këshillit, të përcaktuar me Kapitullin VI (Qeveria e Republikës së Kosovës) të Kushtetutës; dhe (iii) imunitetet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, lidhur me kryerjen e funksioneve të Këshillit.*

(i) Përkitazi me pretendimin për shkeljen e pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit

28. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht, duke iu referuar nenit 2 [Fushëveprimi] të Ligjit të kontestuar, pretendon se *"funksionet dhe kompetencat që Ligji ia përcakton Këshillit në mbikëqyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, mes institucioneve të tjera",* pa paraparë përjashtim sa i përket këtij fushëveprimi në raport me institucionet e pavarura, cenojnë rëndë *"pavarësinë kushtetuese të këtij Institucioni*". Sipas parashtruesit të kërkesës, *"...kjo pavarësi kushtetuese garantohet me nenin 132, par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton se "Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës".* Këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës e mbështetë duke ju referuar edhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KO73/16.

29. Parashtruesi i kërkesës përmbledh pretendimet e veta dhe dispozitat e kontestuara të Ligjit të ri për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, si në vijim: *"Duke autorizuar udhëzime dhe ndërhyrje të drejtpërdrejtë në Institucionin e Avokatit të Popullit, Ligji ia jep Këshillit të drejtën që të:*

- *"shqyrtojë dhe marrë vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil (neni 6, par. 1, nënparagrafi 1);*
- *"mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendosë nëse emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil (neni 6, par. 1, nënparagrafi 2);*
- *"monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe*

parimeve të legjislacionit për shërbimin civil" (neni 6, par. 1, par. 3);
• "ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil" (neni 7, par. 1, nënparagrafi 2);
• "intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit" (neni 7, par. 1, nënparagrafi 3);
• "kërkojë dhe marrë nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij" (neni 7, par. 1, nënparagrafi 4);
• "vendosë ... shfuqizimin ose anulimin e aktit administrativ" (neni 18, par. 1, nënparagrafi 2);
• "vendosë ... ndryshimin e aktit administrativ" (neni 18, par. 1, nënparagrafi 3);
• "anulojë procedurën e përzgjedhjes, kur konstaton që është zhvilluar në kundërshtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil (neni 19, par. 5, nënparagrafi 2) dhe
• "për çdo vit të monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë ... përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil (neni 20, par. 1 dhe 2).

30. Parashtruesi i kërkesës duke ju referuar dispozitave të Ligjit të kontestuar, të cilat i referohen obligimit të zbatimit të rekomandimeve të Këshillit (nenit 20, paragrafit 5), pasojave për personin përgjegjës të institucionit në rast se nuk zbatohet Vendimi i Këshillit (nenit 21, paragrafëve 1 dhe 3), si dhe obligimit për bashkëpunim me Këshillin (nenit 25, paragrafit 2), thekson se *"këto dispozita e bëjnë të qartë se Avokati i Popullit nuk mund të trajtojë vendimet dhe veprimet e tjera të Këshillit thjesht si rekomandime ose sugjerime. Përkundrazi, Ligji pretendon ta detyrojë Avokatin e Popullit që t'u bindet këtyre vendimeve dhe veprimeve".*

31. Më tej, parashtruesi i kërkesës, duke ju referuar dispozitave të Ligjit të kontestuar që kanë të bëjnë me raportimin e Këshillit në rast të moszbatimit të vendimit të tij dhe në rast të mosbashkëpunimit (neni 23, paragrafët 1 dhe 3), dhe pasojave financiare në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit (neni 24, paragrafi 1), pretendon se *"të gjitha këto dispozita të Ligjit për Këshillin, e kanë edhe qëllimin edhe efektin që ta detyrojë Avokatin e Popullit të pranojë udhëzime dhe ndërhyrje nga Këshilli. Në këtë mënyrë, Ligji paraqet një shkelje të*

drejtpërdrejtë të nenit 132, par. 2 të Kushtetutës, i cili e detyron Avokatin e Popullit pikërisht që të mos "pranojë udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera". Sipas parashtruesit të kërkesës: *"[...] udhëzimet dhe ndërhyrjet që parashikohen me Ligjin për Këshillin, nuk janë të parëndësishme. Përkundrazi, këto udhëzime dhe ndërhyrje e prekin vetë thelbin e pavarësisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke e cenuar rëndë pavarësinë organizative të këtij Institucioni".*

32. Parashtruesi i kërkesës, më tej, thekson se *"Ligji për Këshillin është kushtetutshmërisht i mangët për arsye se ai imponon mbi Avokatin e Popullit pikërisht [...] qasje "teknike dhe unifikuese", e cila i jep Këshillit të njëjtat kompetenca kundrejt të gjitha institucioneve, pa bërë "dallimin e domosdoshëm ndërmjet institucioneve të pavarura dhe organeve të tjera të shtetit". Madje, kjo qasje "teknike dhe unifikuese" dallon, për shembull, prej Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili parashikon shprehimisht se: "Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi" (po aty, neni 3, par. 7). Asnjë dispozitë e tillë, e cila mund të kishte theksuar se, gjatë zbatimit të Ligjit për Këshillin "respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga Këshilli", nuk përfshihet askund në Ligj. Pa përfshirjen e këtij diferencimi, Ligji për Këshillin paraqet shkelje të pavarësisë kushtetuese, jo vetëm të Avokatit të Popullit, por të të gjitha institucioneve të pavarura".*

33. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës sqaron se "*Këshilli prapëseprapë mund të luajë një rol këshillues për Avokatin e Popullit, lidhur me çështjet në fushëveprimin e Këshillit, si p.sh., zhvillimin e konkurseve për punësim. Mirëpo, në fund të fundit, duhet të jetë vetë Avokati i Popullit ai që vendosë nëse do të zbatojë sugjerimet e Këshillit apo jo. Me fjalë të tjera, në mënyrë që të jenë në përputhje me Kushtetutën, këto sugjerime duhet të mbeten thjesht sugjerime, jo udhëzime të obligueshme, e cila është mënyra se si paraqiten në Ligjin aktual. Ky dallim, ndërmjet sugjerimeve jo të obligueshme dhe udhëzimeve të obligueshme, është i rëndësishëm për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të ndryshme të Ligjit".*

(ii) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit se është tejkaluar fushëveprimi i ngushtë i Këshillit, i përcaktuar me Kapitullin VI (Qeveria e Republikës së Kosovës) të Kushtetutës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se fushëveprimi i Ligjit të kontestuar, i përcaktuar në nenin 2, *"[...] bie në kundërshtim të*

drejtpërdrejtë me fushëveprimin e tij të ngushtë që parashikohet me Kushtetutë".

35. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike thekson se: *"Kushtetuta nuk e përkufizon shprehimisht termin "shërbimi civil", as nuk e përcakton se punonjësit e cilave institucione konsiderohen pjesë e këtij "shërbimit civil", Mirëpo, edhe në mungesë të një përkufizimi të tillë, fakti që neni 101 përfshihet brenda Kapitullit VI, tregon qartë se, në nivelin kushtetues, shërbimi civil konsiderohet pjesë e Qeverisë".*

36. Parashtruesi i kërkesës vazhdon: *"jo vetëm në këtë rast, por në të gjithë strukturën e Kushtetutës, klasifikimi i institucioneve sipas kapitullit ku paraqiten përbën një parim të rëndësishëm të interpretimit. Për shembull, Kushtetuta, në asnjë dispozitë të saj, nuk përcakton shprehimisht se Auditori i Përgjithshëm e ka statusin e institucionit të pavarur (shih Kushtetutën, nenet 136-138). Mirëpo, fakti që neni 136 ("Auditori i Përgjithshëm i Kosovës") përfshihet brenda Kapitullit XII ("Institucionet e Pavarura"), mjafton për të vërtetuar statusin e këtij institucioni si institucion i pavarur, edhe në mungesën e një përcaktimi të tillë eksplicit".*

37. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se *"për më tepër, duke marrë parasysh faktin e evidentuar më lart, që Kushtetuta e detyron Avokatin e Popullit që të mos pranojë "udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera", është e domosdoshme që Kushtetuta të mos interpretohet në atë mënyrë që t'i jepet Këshillit kompetenca për të mbikëqyrur Institucionin e Avokatit të Popullit. Në të kundërtën, do të kishte një kontradiktë të drejtpërdrejtë ndërmjet nenit 101 të Kushtetutës, i cili do t'i jepte Këshillit të drejtën për të udhëzuar dhe për të ndërhyrë në Institucionin e Avokatit të Popullit, dhe nenit 132, i cili e ndalon pikërisht një gjë të tillë. Në mënyrë që të shmanget kjo kontradiktë, është e domosdoshme që termi "shërbimi civil" të interpretohet në mënyrë të kufizuar, duke mos përfshirë stafin e Institucionit të Avokatit të Popullit".*

38. Në lidhje më këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se: *"një parim i rëndësishëm i interpretimit është që termat kushtetues kanë një kuptim autonom që nuk varen prej akteve të tjera më të ulëta juridike".*

39. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke ritheksuar se *"[...] duke i dhënë Këshillit kompetencën për të mbikëqyrur institucionet jashtë*

Qeverisë, Ligji bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kapitullin VI të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili qartazi e përcakton shërbimin civil si pjesë të Qeverisë".

(iii) Përkitazi me pretendimin se Ligji i kontestuar "i jep kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, lidhur me kryerjen e funksioneve të Këshillit"

40. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se *"ky imunitet i gjerë nuk ka asnjë bazë në Kushtetutë. Kushtetuta shprehet shumë qartë dhe shumë hollësisht se cilët zyrtarë shtetërorë gëzojnë imunitet, dhe se sa i gjerë është ky imunitet në secilin rast. Në këtë drejtim, sipas Kushtetutës, vetëm deputetët e Kuvendit (neni 75), Presidenti (neni 89), anëtarët e Qeverisë (neni 98), gjyqtarët e gjykatave të rregullta (neni 107), gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (neni 117) dhe Avokati i Popullit (neni 134) gëzojnë imunitet. Për dallim prej këtyre, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk i jepet asnjë lloj imuniteti në tekstin e Kushtetutës. Për këtë arsye, në bazë të praktikës së kësaj Gjykate, edhe nuk duhet të gëzojë asnjë lloj imuniteti".*

41. Në vijim, parashtruesi, duke ju referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KO98/11 (parashtrues: *Qeveria e Republikës së Kosovës, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011)",* pohon se *"Imuniteti nuk mund të jepet me akte të tjera juridike nëse nuk parashikohet nga vetë Kushtetuta. Kushtetuta është i vetmi akt juridik që përcakton se cilët zyrtarë gëzojnë imunitet dhe sa i gjerë është ky imunitet. Me fjalë të tjera, është Kushtetuta ajo që e ka fjalën e parë dhe të fundit për sa i përket çështjes së imunitetit të zyrtarëve shtetërorë".*

42. Rrjedhimisht, parashtruesi pohon se *"neni 11, par. 3 i Ligjit për Këshillin, duke u dhënë kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, duhet të jetë pa vlerë juridike, pasi në Kushtetutë nuk ka imunitet të tillë".*

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, gjegjësisht pezullimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit të kontestuar, *"ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport*

me Avokatin e Popullit", deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate.

44. Parashtruesi pretendon se "*argumentet e parashtruara në këtë kërkesë japin baza më shumë se prima facie për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara*".

45. Parashtruesi po ashtu pretendon se "*në mungesën e miratimit të masës së përkohshme, funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit do të pengohet rëndë prej ndërhyrjeve të vazhdueshme të Këshillit në këtë institucion".*

46. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës sqaron se *"deri tani, Këshilli ka anuluar rezultatet e katër konkurseve për punësim të shpallura nga Avokati i Popullit. Mungesa e stafit të mjaftueshëm për të trajtuar ankesat e qytetarëve që vijnë në dyert e Institucionit do të rezultojnë në pamundësinë e stafit ekzistues për t'u dhënë vëmendjen e duhur këtyre ankesave, duke përfshirë ankesat e natyrës urgjente. Sidomos në këto rastet urgjente, ndërhyrjet e vazhdueshme të Këshillit do të shkaktojnë dëme të pariparueshme për qytetarët e Republikës së Kosovës".* Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës po ashtu konsideron se *"në mënyrë që të shmangen këto dëme, [...] është e domosdoshme që kjo Gjykatë t'i pezullojë menjëherë dispozitat e kontestuara, në bazë të të cilave Këshilli po pengon punën efikase të Avokatit të Popullit dhe punonjësve të tij".*

47. Si përfundim, parashtruesi pretendon se *"Institucioni i Avokatit të Popullit shpeshherë shërben si shpresa e fundit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut që t'i adresojnë këto shkelje si dhe t'u japin zgjidhje. Pamundësia e funksionimit normal dhe ushtrimit të mandatit të Avokatit të Popullit, si institucion i vetëm kombëtar për të drejtat e njeriut pashmangshmërisht do të pamundësonte mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të Republikës së Kosovës".*

48. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se *"[...] miratimi i masës së përkohshme, me qëllim që të sigurohet plotësimi sa më i shpejtë i stafit të Institucionit, është qartazi me interes publik".*

Komentet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës

49. Këshilli dorëzoi komentet e tij në lidhje me kërkesën dhe kundërshtoi në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

50. Fillimisht, Këshilli sqaroi se *"funksionet dhe kompetencat e Këshillit që nga themelimi me Rregulloren e UNMIK-ut e deri tani nuk kanë ndryshuar dhe ato janë të përqendruar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit drejtues në institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal"*. Në vijim, Këshilli arsyetoi se shumica e dispozitave të ligjit të mëparshëm janë të njëjta me ato të Ligjit të kontestuar.

51. Në komentet e tij, Këshilli ofroi komentet e tij në lidhje me kërkesën, duke sqaruar dhe arsyetuar qëndrimin e tij në lidhje me: (i) funksionet dhe kompetencat e Këshillit të përcaktuara me Ligjin e kontestuar; tejkalimin e mandatit të parashtruesit dhe kompetencave të Këshillit; (ii) fushëveprimin e Ligjit të kontestuar; (iii) çështjen e pavarësisë së institucioneve të pavarura; (iv) çështjen e imuniteteve; (v) përzgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e nëpunësve civil; dhe (vi) sanksionet.

(i) Përkitazi me çështjen e funksioneve dhe kompetencave të Këshillit

52. Këshilli vlerëson se parashtruesi i kërkesës *"ka dalur jashtë mandatit të tij që të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike sepse tendenca e tij [parashtruesit të kërkesës] për minimizimin e rolit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si institucion i pavarur kushtetues (shih nenin 101.2 të Kushtetutës) si dhe kërkesa e tij për heqjen e funksioneve të Këshillit të përcaktuar me ligj, do të ndikonin drejtpërdrejtë që autoritetet publike t'ju krijohet hapësirë që të abuzojnë dhe shkelin të drejtat nga marrëdhënia e punës së shërbyesve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil"*. Andaj, sipas tyre, heqja e kompetencave të Këshillit, të parapara me Ligjin e kontestuar, ashtu si kërkon parashtruesi i kërkesës do të cenonte të drejtat e shërbyesve civil dhe kandidatëve për shërbim civil, ndërkohë që *"[...] asnjë autoritet publik, duke përfshirë institucionet e pavarura kushtetuese, nuk mund të cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut"*.

(ii) Përkitazi me fushëveprimin e Ligjit të kontestuar

53. Përkitazi me fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, Këshilli specifikon: *"Avokati i Popullit nuk e ka të qartë adresën sa i përket fushëveprimit të shërbimit civil të Republikës së Kosovës sepse ky fushëveprim nuk*

përcaktohet me Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës por me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, prandaj Këshilli sipas nenit 101.2 të Kushtetutës i ushtron kompetencat në shërbimin civil, rrjedhimisht në kuadër të fushëveprimit që i ka dhënë shërbimit civil, Ligji përkatës për Shërbimin Civil.

Prandaj, fushëveprimi i Ligjit për Këshillin varet drejtpërsëdrejti prej kufizimit të termit "nëpunës civil" në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

54. Në vijim, Këshilli specifikon se *"[...] në nenin 32, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, është përcaktuar që "ndaj të punësuarve tjerë të Institucionit të Avokatit të Popullit zbatohen dispozitat ligjore në fuqi për nëpunësit civil".*

55. Rrjedhimisht, Këshilli vlerëson se: *"duke marrë parasysh edhe dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit, konstatohet se Këshilli ka mandat të plotë që t'i ushtroj funksionet kushtetuese dhe ligjore, ndaj nëpunësve civil të punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, duke respektuar pavarësinë kushtetuese në pajtim me nenin 3, paragrafi 7 të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi".*

56. Në lidhje me këtë, Këshilli po ashtu i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI129/11, parashtrues *Viktor Marku*, përkatësisht paragrafit 42 të këtij Aktgjykimi, ku Gjykata, ndër të tjera, kishte arsyetuar *"[...] të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion [Këshilli] lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil [...] Vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë[...]".*

57. Sipas Këshillit, nëse *"shërbimi civil duhet kuptuar vetëm si pjesë e Qeverisë", atëherë, Avokati i Popullit si parashtrues i kësaj kërkese, është dashur që të ngrit çështjen e përputhshmërisë së Ligjit për Shërbimin Civil me Kushtetutën sepse me këtë ligj përcaktohet fushëveprimi i shërbimit civil, i cili ka përcaktuar fushëveprimin e shërbimit civil edhe jashtë degës së ekzekutivit, respektivisht: "administratën e Kuvendit, Administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatorë dhe administratën komunale".*

(iii) Përkitazi me pavarësinë institucionale

58. Këshilli vlerëson se çështja e pavarësisë institucionale *"ndërlidhet me funksionet kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit, por nuk ndërlidhet me të drejtën kushtetuese dhe ligjore të Këshillit që të mbikëqyrë respektimin e legjislacionit të shërbimit civil lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve civil të këtyre institucioneve"*.

59. Këshilli gjithashtu i referohet Vendimit të tij nr. 144/2017, të 5 shtatorit 2017, me të cilin kishte konstatuar se "*kërkesa për marrjen e autorizimit së shpalljes së konkurseve për nëpunësit civil të institucioneve të pavarura kushtetuese nga Ministria e Administratës Publike si dhe marrja e konfirmimit buxhetor nga Ministria e Financave, përbënë ndërhyrje në pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese [...]"*.

60. Këshilli më tej specifikon se *"kriteret e konkursit i cakton vet institucioni i pavarur kushtetues, sepse caktimi i kritereve të shkollimit dhe përvojës së punës për pozitat e nëpunësve civil të institucioneve të pavarura kushtetuese, përbën ndërhyrje në pavarësinë e tyre institucionale"*. Po ashtu, në lidhje me pagat e nëpunësve civil në institucionet e pavarura kushtetuese, Këshilli pohon se Kuvendi i Kosovës i kishte rekomanduar se *"parimi pagë e njëjtë për punë të njëjtë nuk duhet të vlejë edhe për institucionet e pavarura"*.

iv) Përkitazi me imunitetin funksional

61. Sa i përket imunitetit funksional, Këshilli theksoi se sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017 (në tekstin e mëtejmë: rasti KI33/16), është përcaktuar që *"[Këshilli] gëzon prerogativat e një gjykate [...]"*. Prandaj, sipas Këshillit, ata gëzojnë prerogativat e "gjykatës", përkatësisht *"ato të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta (neni 75 i Kushtetutës)"*. Për më tepër, Këshilli i referohet edhe Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit edhe zëvendësit dhe personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit gëzojnë të njëjtin imunitet.

(v) Përkitazi me përzgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e nëpunësve civil

62. Në vijim, sa i përket pretendimit të Avokatit të Popullit për kompetencën e Këshillit për "*përzgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e nëpunësve civil",* Këshilli thekson se kompetenca e tyre kufizohet

vetëm në vlerësimin nëse procedura e përzgjedhjes dhe e emërimit të tyre është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

63. Këshilli, më tej sqaron se "ndërprerja *e marrëdhënies së punës bëhet nga Komisioni Disiplinor i organit të punësimit dhe Këshilli nuk ka kompetencë që të shkarkoj nëpunësin civil nga shërbimi civil, as në institucionet e pavarura kushtetuese dhe as në ndonjë institucion tjetër të administratës publike që ka të punësuar nëpunës civil*".

64. Këshilli specifikon se nëse do të shfuqizoheshin dispozitat kontestuese të Ligjit të kontestuar, ashtu siç ka kërkuar parashtruesi i kërkesës atëherë ligji do të bëhej jofunksional, rrjedhimisht edhe Këshilli.

65. Këshilli, në fund thekson se *"kërkesa e Avokatit të Popullit që të hiqet fuqi ekzekutive e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, do të ndikonte drejtpërdrejtë në mbrojtjen e marrëdhënies së punës së nëpunësve civil e cila ndërlidhet me të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit të përcaktuar me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.

(vi) Përkitazi me çështjen e sanksioneve

66. Në fund, sa i përket çështjes së sanksioneve, Këshilli thekson se sanksionet janë caktuar me qëllim që të ndikojnë në zbatimin e vendimeve të Këshillit, dhe, sipas tyre, nëse hiqen sanksionet do të mbrohet vetëm *"zyrtari i papërgjegjshëm"* që nuk ka zbatuar ligjin dhe rrjedhimisht ka shkelur liritë dhe të drejtat themelore të nëpunësve civil dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që aplikojnë për pranim në shërbimin civil.

Përgjigjja e parashtruesit të kërkesës ndaj komenteve të Këshillit

67. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës sqaroi se nuk e ka kontestuar kompetencën e Këshillit lidhur me shërbyesit civil, të punësuar në autoritetet publike, por se njëjtë sikur në rastin KO73/16 ka ngritur çështjen e kompetencës së Këshillit në institucionet e pavarura, njëjtë sikur që ka vepruar edhe në rastin KO73/16.

68. Parashtruesi i kërkesës, më tej, thekson se *"çështja e ngritur në rastin konkret paraqet çështje kushtetuese në kuptimin e pavarësisë së Avokatit të Popullit e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe liritë themelore [...] për shkak se Avokati i Popullit nuk mund të ushtrojë mandatin e tij/saj në rast se cenohet pavarësia e tij/saj"*.

69. Në lidhje me komentet e Këshillit për imunitetin e parashtruesit të kërkesës, ai theksoi se imuniteti i Avokatit të Popullit e ka *"bazën në Kushtetutë, imunitet ky i cili pastaj shtrihet edhe te zëvendësit e tij dhe stafi, për shkak se secili veprim të cilin e ndërmarrin zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe stafi, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, merret në emër të Avokatit të Popullit. Shtrirja e imunitetit për zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe stafin është arsyetuar dhe është rekomanduar edhe nga Komisioni i Venedikut"*.

70. Në lidhje me çështjen e imuniteteve, parashtruesi i kërkesës specifikon se meqenëse sipas Këshillit *"Këshilli "gëzon prerogativat e një gjykate" [...], konsiderojmë, se [Këshilli] bën një interpretim të shtrembër dhe të pjesshëm. Kur bëhet fjalë për nenin 6 të KEDNJ-së, duhet të theksohet se ai është i aplikueshëm edhe në procedurat administrative. Gjykata Kushtetuese në po të njëjtin Aktgjykim (KI33/16), përcakton se një vendim i Këshillit prodhon efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është përfundimtar administrativ (theks i shtuar) dhe i përmbarueshëm, duke lënë kështu të kuptohet se Këshilli është një organ administrativ, por që për nga aspekti i vendosjes së çështjeve, brenda kompetencave të tij, në bazë të rregullave të së drejtës gëzon prerogativat e një gjykate. Por kjo nuk do të thotë se Këshilli detyrimisht duhet të gëzojë imunitet. Madje, Këshilli mund të mos jetë i vetmi organ administrativ që në kuadër të kompetencave të përcaktuara ligjore mund të ketë prerogativat e një gjykate"*.

71. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës përfundon se *"[...] një interpretim i tillë nga ana e Këshillit nuk është i qëndrueshëm për nga aspekti kushtetues, sepse vetë Kushtetuta përcakton se në Republikën e Kosovës pushtetet janë të ndara, e në këtë kuptim Këshilli, si organ administrativ, nuk mund të jetë pjesë e gjyqësorit dhe nuk mund të gëzojë imunitetin e gjyqtarëve"*.

72. Në lidhje me shpalljen e konkurseve për nëpunësit civil, për të cilën procedurë Këshilli kishte theksuar se institucionet e pavarura nuk kanë nevojë të marrin aprovim nga Ministria e Administratës Publike dhe ajo e Financave, parashtruesi i kërkesës vlerëson se komentet e Këshillit janë kundërthënëse sepse nuk pasqyrojnë vendimet e Këshillit për anulimin e procedurave të rekrutimit tek Institucioni i Avokatit të Popullit. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës citon një vendim të Këshillit të nxjerrë më 28 nëntor 2018, ku Këshilli arsyeton se "*nuk është marrë aprovimi për autorizim të shpalljes publike nga Ministria e Administratës Publike [...]"*.

73. Sa i përket shembullit të Këshillit përkitazi me mbikëqyrjen nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit (në tekstin e mëtejmë: ZKA) tek institucionet e pavarura, parashtruesi potencon dy dallime ndërmjet Këshillit dhe ZKA-së. Dallimi i parë konsiston në atë që ZKA-ja jep rekomandime ndërsa Këshilli udhëzime. Ndërsa, dallimi i dytë sipas parashtruesit të kërkesës është se Auditori i Përgjithshëm për dallim nga Këshilli është institucion i pavarur sipas kapitullit XII të Kushtetutës.

74. Në fund, parashtruesi i kërkesës vlerëson se *"Ligji i kontestuar nuk përmban dispozita të cilat bartin frymën kushtetuese të pavarësisë së Avokatit të Popullit dhe se deri në çfarë shkalle shtrihen kompetencat e Këshillit karshi institucioneve të pavarura, prandaj konsiderojmë se dispozitat e kontestuara të Ligjit janë në kundërshtim me Kushtetutën".*

Komentet e dorëzuara nga Komisioni i Pavarur i Mediave

75. Komisioni i Pavarur i Mediave dorëzoi një shkresë, përmes të cilës konfirmoi se mbështet pretendimet e ngritura nga Avokati i Popullit për sa i përket respektimit të pavarësisë së institucioneve të pavarura dhe njëkohësisht kërkon nga Gjykata Kushtetuese që, në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor që ka, të rikonfirmojë pavarësinë kushtetuese dhe rëndësinë e Institucioneve të Pavarura, të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar:

"Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji përfshinë Këshillin dhe të gjitha institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – nënkupton institucionin e pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil

1.2. Nëpunës civil - nënkupton nëpunësin civil sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;
1.3. Nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues - nënkupton nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;
1.4. Nëpunës civil i nivelit drejtues - nënkupton nëpunësit civil të nivelit drejtues sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;
[...]

Neni 4
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

1. Këshilli është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.
[...]

Neni 6
Funksionet e Këshillit

1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:
1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Neni 7
Kompetencat e Këshillit

1. Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli ka të drejtë të:
[...]
1.2. ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;

1.3. intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
1.4. kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;

[...]

Neni 11
Mandati i anëtarëve të Këshillit

[...]
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.
[...]

Neni 18
Mënyrat e vendosjes për ankesat

1. Kolegji i Këshillit që shqyrton ankesat, vendos në këtë mënyrë:
1.1. lënien në fuqi të aktit administrativ dhe refuzimin e ankesës;
1.2. shfuqizimin ose anulimin e aktit administrativ dhe aprovimin e ankesës;
1.3. ndryshimin e aktit administrativ duke aprovuar pjesërisht ankesën;
1.4. detyrimin e organit administrativ kompetent për të nxjerrë aktin administrativ kur pa të drejtë është refuzuar nxjerrja e tij;
1.5. përfundimin e procedimit administrativ;
1.6. kthimin në rishqyrtim;
1.7. hedhjen poshtë të ankesës;
1.8. shpalljen jokompetent;
1.9. pezullimin e procedurës.
2. Kolegjet e Këshillit që shqyrtojnë ankesat, bazuar në paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të këtij neni, kanë të drejtë të ndryshojnë masën disiplinore në rastet kur vërtetohet se nëpunësi civil e ka kryer shkeljen, mirëpo organi i punësimit nuk i ka shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer.

Neni 19
Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil
të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues

[...]
5. Këshilli pas shqyrtimit të raportit, nxjerr vendim dhe vendos që:

5.1. të aprovojë procedurën e përzgjedhjes, kur konstaton që është zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;

5.2. të anulojë procedurën e përzgjedhjes, kur konstaton që është zhvilluar në kundërshtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil.

6. Këshilli është i obliguar që të nxjerr vendim për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të dosjes komplete nga organi i punësimit.

7. Nëse zhvillimi i procedurës për përzgjedhjen e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, bëhet pa njoftim të Këshillit për pjesëmarrje në mbikëqyrje, procedura konsiderohet e pavlefshme dhe Këshilli sipas detyrës zyrtare nxjerr vendim për anulimin e procedurës.

8. Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.

Neni 20
Monitorimi i institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

[...]

5. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

Neni 21
Vendimi i Këshillit

1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi

përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.
2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.
3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.

Neni 22
Inicimi i konfliktit administrativ

1. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.
2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Neni 23
Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit

1. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e Këshillit brenda afatit të paraparë me nenin 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet të njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit, Komisionin përkatës për administratë publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për zbatim.
2. Në rastet kur personi përgjegjës për zbatim të vendimit të Këshillit është në kuadër të degës së ekzekutivit, për moszbatim të vendimit duhet të njoftohet me shkrim edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës.
3. Në rastet kur personi përgjegjës për zbatim të vendimit të Këshillit është Kryetari i Komunës, për moszbatim të vendimit duhet të njoftohet me shkrim Ministri përkatës i pushtetit lokal dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës.
4. Njoftimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër personit përgjegjës për zbatim, e cila procedurë zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara me legjislacionin në fuqi.
5. Kryeministri ose eprori përgjegjës është i obliguar për fillimin e procedurës disiplinore ndaj personit përgjegjës për zbatim, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga Kryetari i Këshillit.

6. Në rast se nuk ndërmerren veprimet sipas paragrafit 5 të këtij neni, Kryetari i Këshillit e njofton me shkrim Kryetarin e Kuvendit dhe Komisionin përkatës për administratë publike. Kryetari i Kuvendit, kërkon me shkrim nga Kryeministri apo eprori përgjegjës i institucionit, që të ndërmerren të gjitha veprimet për zbatimin e menjëhershëm të vendimit të Këshillit dhe marrjen e masave ndaj personit përgjegjës në pajtim me dispozitat e parapara me legjislacionin në fuqi.
7. Brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim të vendimit të Këshillit, pala mund të fillojë procedurën e përmbarimit të vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbarimore.

Neni 24
Sanksionet administrative për moszbatimin e vendimit të Këshillit

1. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.
2. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni, i dërgohet për zbatim zyrtarit kryesor administrativ të Ministrisë përkatëse për menaxhimin e listës së pagave, i cili është i obliguar që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të zbatojë vendimin dhe të njoftojë me shkrim Këshillin për zbatimin e vendimit.
3. Kundër vendimit për ndalimin e 50 % të pagës mujore, pala e pakënaqur ka të drejtë të inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente për çështje administrative, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.
4. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.
5. Në rast të moszbatimit të vendimit të Kryetarit të Këshillit për ndalimin e 50% të pagës mujore, Këshilli brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim mund të fillojë procedurën e përmbarimit të vendimit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbarimore.

Neni 25
Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike
[...]
2. Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civilë, që

ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin.
3. Në rastet kur organi i punësimit apo personi përgjegjës nuk bashkëpunon, Këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili njoftimin ia përcjell Kryeministrit ose eprorit të drejtpërdrejtë të personit përgjegjës".

Pranueshmëria e kërkesës

76. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.

77. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

78. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2, nënparagrafi 1 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën".

79. Gjykata, gjithashtu, i referohet paragrafit 4, të nenit 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], i cili parasheh që: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".*

80. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që ngre çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të kontestuar në Gjykatë, në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës.

81. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 30 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 67, paragrafi 4 të Rregullores së punës që përcaktojnë se kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

82. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi më 25 gusht 2018, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, më 2 nëntor 2018.

83. Për më tepër, Gjykata merr parasysh nenin 29 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton që:

> *"1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës se Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.*
>
> *2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.*
>
> *3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar".*

84. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 67 të Rregullores, i cili specifikon:

> Rregulli 67
> Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit
>
> *"(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.*
> *(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.*
> *(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.*
> *(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar".*

85. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar dispozitat përkatëse kushtetuese që pretendon se janë shkelur, gjithashtu ka

specifikuar dispozitat e Ligjit të kontestuar që konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën dhe ka paraqitur prova që mbështesin pretendimet e tij.

86. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka identifikuar dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar, ka specifikuar pretendimet e tij kushtetuese, ka paraqitur dëshmi mbështetëse dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar.

87. Rrjedhimisht, Gjykata deklaron që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim të meritave të saj.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

88. Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, përkatësisht neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3) 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3), duke pretenduar se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

89. Në lidhje me këtë, ai pretendon se dispozitat e kontestuara:

(i) *E "vesh[in] Këshillin me kompetencën për të mbikëqyrur jo vetëm institucionet e Qeverisë por edhe institucionet tjera, duke e tejkaluar fushëveprimin e ngushtë të Këshillit, të përcaktuar me Kapitullin VI (Qeveria e Republikës së Kosovës) të Kushtetutës";*

(ii) E "*vesh[in] Këshillin me kompetencat për të dhënë udhëzime dhe për të ndërhyrë ne Institucionin e Avokatit të Popullit, duke paraqitur shkelje të pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit"; dhe*

(iii) *Dispozitat e Ligjit të kontestuar imunitetet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, lidhur me kryerjen e funksioneve të Këshillit.*

(i) Përkitazi me pretendimin për tejkalimin e fushëveprimit të ngushtë të Këshillit, të përcaktuar me Kapitullin VI (Qeveria e Republikës së Kosovës) të Kushtetutës

90. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Kushtetuta nuk e përkufizon shprehimisht termin "Shërbimi Civil", dhe as nuk e përcakton se punonjësit e cilave institucione konsiderohen pjesë e këtij shërbimi civil. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se fakti që neni 101 përfshihet brenda kapitullit VI [Qeveria e Republikës së Kosovës], tregon qartë se në nivelin kushtetues shërbim civil konsiderohen vetë nëpunësit e Qeverisë.

91. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se fushëveprimi i Ligjit të kontestuar, i përcaktuar me nenin 2 të Ligjit në fjalë, shkel nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

92. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet sërish nenit 2 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton:

> *"Fushëveprimi i këtij ligji përfshinë Këshillin dhe të gjitha institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë".*

93. Gjykata gjithashtu iu referohet dispozitave të nenit 101 [Shërbimi Civil], të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *"1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.*
>
> *2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës".*

94. Para së gjithash, Gjykata dëshiron të qartësojë se interpretimi i normave kushtetuese nuk duhet kuptuar si krijim i një norme të re, por si lexim dhe interpretim i drejtë i normave ekzistuese, kur ato krijojnë paqartësi në kuptimin e përmbajtjes dhe qëllimit të tyre.

95. Gjykata rikujton se neni 101 [Shërbimi Civil] i Kushtetutës, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 2 i Ligjit të kontestuar bie ndesh, përmendet në fund të kapitullit VI të Kushtetutës.

96. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kapitulli VI, rregullon çështjet vijuese: 1) përbërjen, kompetencat, zgjedhjen, përgjegjësitë, imunitetin e anëtarëve të Qeverisë, procedurat, dhe mocionin e votëbesimit të Qeverisë, 2) kompetencat e Kryeministrit, 3) themelimin, numrin e ministrive dhe përfaqësimin e komuniteteve brenda tyre. Në fund të këtij kapitulli ligjvënësi, me dispozitat e nenit 101 të Kushtetutës, përmend shprehjen "Shërbimi civil". Ky nen i Kushtetutës, në paragrafin 1 përcakton: 1) përbërjen (shumëllojshmërinë) e shërbimit civil në nivel të Republikës e Kosovës, dhe 2) themelimin e një institucioni të pavarur, që e mbikëqyrë respektimin e normave dhe të parimeve të shërbimit civil. Këto dy dispozitat sipas kuptimit të nenit 101 të Kushtetutës janë në ndërvarësi zinxhirore mes tyre, megjithatë jo edhe në ndërvarësi zinxhirore me nenet e tjera të kapitullit VI të Kushtetutës.

97. Duke e lexuar këtë nen në kontekst, respektivisht për nga përmbajtja dhe qëllimi, arrijmë në konkluzion se kemi të bëjmë me një normë kushtetuese e cila kërkon që materia (shërbimi civil) më specifikisht të rregullohet me akte të posaçme.

98. Në këtë kuptim, e drejta për të nxjerrë një ligj të posaçëm për rregullimin e shërbimit civil në Republikën e Kosovës, buron nga paragrafi 1, i nenit 101 të Kushtetutës, ndërsa e drejta për të nxjerrë një ligj të posaçëm për Këshillin, buron nga paragrafi 2, i nenit 101 të Kushtetutës.

99. Nga si më sipër, paragrafi 2 i nenit 101, ndërlidhet ngushtë dhe është derivat i paragrafit 1, i cili në mënyrë specifike kërkon që zbatimi i normave juridike që rregullojnë shërbimin civil do të mbikëqyret nga një "këshill i pavarur mbikëqyrës". Andaj, në ndërlidhje me këtë , Gjykata vëren se fushëveprimi i Këshillit, është i kufizuar dhe i lidhur ngushtë me ligjin bazik, respektivisht me ligjin e posaçëm që rregullon shërbimin civil.

100. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave relevante të Ligjit për Shërbimin Civil, që përcaktojnë si në vijim:

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

"1. Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale.

2. Për qëllim të këtij ligji, institucionet e administratës qendrore dhe komunale, që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji

përfshijnë: administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale.
[...]
4. Institucionet e administratës qendrore, të cilat rregullohen me ligj të posaçëm, do t'iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji, përveç rasteve kur ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme nga ai.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
1.1. Shërbimi civil - i tërë trupi i personelit administrativ të punësuar, në institucionet e administratës qendrore dhe komunale të parapara me këtë ligj, të cilët zbatojnë politikat dhe sigurojnë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse.
[...]

Neni 3
Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës

[...]
7. Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi".
[...]

101. Sipas dispozitave të mësipërme, qëllimi i këtij ligji është rregullimi i statusit dhe i marrëdhënies së punës së të punësuarve në institucionet e administratës qendrore dhe lokale. Më tej, ligjvënësi në paragrafin 2, të nenit 1, përcakton që administrata qendrore përfshin administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore, si dhe administratën komunale.

102. Megjithatë, ligjvënësi me paragrafin 4, të nenit 1, ka paraparë gjithashtu kufizimet e fushëveprimit dhe zbatimit të dispozitave të LSHC-së, duke përcaktuar që institucionet e administratës qendrore, do t'iu nënshtrohen dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, përveç nëse ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme nga Ligji për Shërbimin Civil. Për më tepër, ashtu si është elaboruar më lart, ligjvënësi gjatë hartimit të ligjit ka pasur parasysh po ashtu pavarësinë kushtetuese të institucioneve të pavarura dhe me nenin 3, paragrafin 7, të Ligjit të Shërbimit Civil, ka përcaktuar që gjatë zbatimit të këtij ligji duhet të respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi.

103. Gjykata, gjithashtu, vëren se ligjvënësi në nenin 2 [Përkufizimet] të Ligjit të Shërbimit Civil, sqaron edhe përkufizimet (shprehjet) e përdorura në ligj. Gjithnjë sipas këtij neni, shprehja "Shërbimi Civil" iu referohet të punësuarve në administratën qendrore dhe komunale dhe jo vetëm nëpunësve civil të administratës së Qeverisë, përkatësisht ministrive, siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

104. Andaj, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konsideron se shprehja "Shërbimi Civil", sipas leximit dhe interpretimit të nenit 101 të Kushtetutës, duhet kuptuar në kontekstin e saj dhe qëllimin që ka pasur hartuesi. Ky qëllim është i shprehur në nenin 1 të Ligjit për Shërbimin Civil, së bashku me kufizimet e fushëveprimit të parashikuara me paragrafin 4, të nenit 1 të LSHC-së, duke përcaktuar që institucionet e administratës qendrore do t'iu nënshtrohen dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, përveç nëse ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme nga Ligji për Shërbimin Civil, duke evituar kështu mundësinë e keqinterpretimeve ose interpretimeve teknike të normës në fjalë.

105. Për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 2 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe nuk cenon esencën e nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se neni 2 i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil], paragrafin 1 dhe 2 të Kushtetutës.

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkeljen e pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese

106. Përkitazi me institucionet e pavarura kushtetuese, Gjykata i referohet institucioneve të pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], konkretisht neneve: 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave], si dhe përkitazi me Gjykatën Kushtetuese, siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.

107. Gjykata rikujton se në lidhje me pavarësinë kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura, parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se:

a) Ligji i kontestuar, duke i dhënë kompetenca Këshillit, mes tjerash, për mbikëqyrjen e përzgjedhjes dhe emërimeve të personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese, për të

vendosur për ankesat në lidhje me shkeljet e legjislacionit të shërbimit civil, gjegjësisht duke nxjerrë vendime dhe rekomandime detyruese për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil për Avokatin e Popullit; dhe

b) duke aplikuar në mënyrën e njëjtë/uniforme dispozitat e Ligjit, ndaj personelit të parashtruesit të kërkesës dhe institucioneve të tjera të pavarura në njërën anë, dhe institucionet e tjera që punësojnë shërbyes civil, në anën tjetër, cenon pavarësinë organizative të parashtruesit të kërkesës në kundërshtim me nenin 132, paragrafi 2 të Kushtetutës dhe pavarësinë e institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese.

108. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konteston kompetencat e Këshillit të parapara me Ligjin e kontestuar për të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil dhe për të nxjerrë vendime të detyrueshme, në lidhje me zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese, pa i marrë parasysh rregullat e tyre të brendshme të nxjerra në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të veçanta. Parashtruesi pretendon se legjislacioni për shërbimin civil nuk mund të zbatohet ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese, në veçanti ndaj Avokatit të Popullit, njësoj si ndaj shërbyesve civil të institucioneve tjera, pasi që kjo cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese të garantuar me Kushtetutë dhe ligje të veçanta.

109. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata fillimisht vëren se Këshilli, sipas Ligjit të kontestuar është organ i themeluar me nenin 101, paragrafin 2 të Kushtetutës dhe në mënyrë specifike është i mandatuar që të "*sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil [...]*".

110. Në lidhje me statusin juridik të Këshillit, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore ku kishte konstatuar se Këshilli është institucion i pavarur i themeluar me ligj, në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente, sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizimit të së drejtës së fituar në procedurë administrative (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 6 korrikut 2017, para.

56; KI50/12, parashtrues *Agush Llolluni*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, para. 36; dhe KI129/11, parashtrues *Viktor Marku*, Aktgjykim i 11 korrikut 2012, para. 42*)*.

111. Gjykata vëren se në Ligjin e kontestuar në mënyrë të hollësishme është specifikuar, përveç kompetencës së Këshillit për të pranuar ankesa nga palët e pakënaqura me zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil nga autoritet shtetërore, kompetenca e mbikëqyrjes gjatë përzgjedhjes së nëpunësve të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues. Ky Ligj nuk bënë dallim në mes të personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore.

112. Gjykata po ashtu vëren se në nenin 19 të Ligjit të kontestuar është shtuar mbikëqyrja e përzgjedhjes së nëpunësve civil për pozita të nivelit të lartë drejtues, përderisa Ligji i shfuqizuar kishte përcaktuar apo rregulluar se 1 (një) anëtar i Këshillit "*do të marrë pjesë si vëzhgues"* në procedurën e përzgjedhjes apo avancimit të kandidatëve për pozitën e nivelit drejtues.

113. Gjykata vëren se në Ligjin e kontestuar, përkatësisht në nenin 19, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, për dallim nga Ligji i shfuqizuar, përcaktohet që pas përfundimit të procedurës së mbikëqyrjes dhe dorëzimit të raportit nga anëtari i Këshillit, i cili ka mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes, Këshilli nxjerr vendim, i cili në bazë të paragrafit 8 të këtij neni të kontestuar konsiderohet si *"vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ"*. Përderisa në Ligjin e mëparshëm (të shfuqizuar), në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil në pozita të nivelit drejtues pas dorëzimit të raportit nga anëtari i Këshillit në cilësinë e vëzhguesit, Këshilli kishte kompetencën që të nxirrte vetëm rekomandim nëse "*vendimet e komisioneve të emërimit nuk janë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës*".

114. Bazuar në sa më sipër, Gjykata thekson se Këshilli, përkitazi me procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, ka kompetencë që njëkohësisht të mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe në fund të nxjerrë një vendim, i cili është vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm në lidhje me rregullsinë e procedurës së përzgjedhjes, pa marrë parasysh nëse ekziston një konflikt dhe nëse është paraqitur një ankesë në lidhje me atë procedurë apo jo.

115. Në fakt, Gjykata vëren se Këshilli konsideron se duke marrë parasysh Ligjin e kontestuar dhe dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit, Këshilli ka mandat të plotë që t'i ushtroj funksionet kushtetuese dhe ligjore ndaj nëpunësve civil të punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, përkatësisht që të mbikëqyrë respektimin e legjislacionit për shërbimin civil lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve civil të Avokatit të Popullit dhe kjo nuk ndikon në ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit. Pra, sipas Këshillit, personeli i Avokatit të Popullit janë shërbyes civil dhe normat për shërbimin civil janë të aplikueshme edhe ndaj tyre, njësoj si për institucionet e tjera të administratës shtetërore.

116. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar nuk parasheh përjashtim në fushëveprimin e Këshillit, në lidhje me ushtrimin e kompetencave të tij të cekura më lart ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese dhe as në aplikimin e rregullave të legjislacionit për shërbimin civil ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese. Respektivisht, Ligji i kontestuar nuk parasheh që gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, do të merren në konsideratë ligjet e veçanta të institucioneve të pavarura dhe rregullat e tyre të brendshme.

Parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës

117. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Ligjin e kontestuar edhe në raport me institucionet e tjera të pavarura, ku përfshihen mes tjerash edhe Gjykata Kushtetuese dhe institucionet e pavarura të përfshira në Kapitullin XII të Kushtetutës. Gjykata vëren së në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës përmend vetëm pavarësinë e tij të garantuar me nenin 132 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata rithekson se i takon vetë asaj të karakterizojë faktet e rastit *vis-à-vis* normave kushtetuese dhe se nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtruesi i kërkesës (shih, ndër autoritete të tjera, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë,* GJEDNJ, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 44).

118. Gjykata po ashtu rikujton se në rastin KO73/16, parashtrues *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016, Aktgjykimi i 16 nëntorit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi KO73/16), objekt shqyrtimi kishte qenë pikërisht pavarësia e institucioneve të pavarura kushtetuese, në veçanti, pavarësia e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatës.

119. Në Aktgjykimin e lartcekur, Gjykata kishte theksuar se *"Kushtetuta është e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Përveç tri degëve të pushtetit, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësorit të rregullt, Kushtetuta i garanton status special Zyrës së Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kushtetuta, gjithashtu, ia garanton statusin special Gjykatës Kushtetuese, si garantues dhe interpretues përfundimtar i Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë pjesë e legjislativit, e ekzekutivit dhe e gjyqësorit të rregullt. E njëjta vlen për institucionet e tjera të pavarura të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës"* (shih*, mutatis mutandis*, Aktgjykimin KO73/16, para. 63, 64, 65. Shih, po ashtu, Aktgjykimin në rastin KO98/11, të 20 shtatorit 2011, parashtrues *Qeveria e Kosovës,* lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para. 44).

120. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton edhe njëherë nenin 132. 2 të Kushtetutës që përcakton se "*Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës"* si dhe nenin 133 [Zyra e Avokatit të Popullit], që përcakton se *"Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj"*.

121. Gjykata i referohet edhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përkatësisht nenit 3 [Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit], paragrafi 2, i cili përcakton se *"Institucioni i Avokatit të Popullit gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligj",* si dhe nenit 32 [Personeli], paragrafi 2, që përcakton se: *"ndaj të punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit, zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit"*.

122. Gjithashtu, Gjykata rikujton se sipas nenit 37 [Rregulloret e Institucionit] të ligjit të Avokatit të Popullit*, "Avokati i Popullit nxjerr Rregulloren e punës, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe*

sistematizimin e vendeve të punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin".

123. Gjykata në Aktgjykimin KO73/16 kishte theksuar se *"Zyra e Avokatit të Popullit është institucion i pavarur që është krijuar për të siguruar llogaridhënie nga autoritetet publike vis-à-vis të drejtave dhe lirive të individëve. Në përmbushjen e kësaj detyre, ky institucion ushtron në mënyrë të pavarur mandatin e tij duke mos pranuar asnjë instruksion apo ndërhyrje nga ndonjë autoritet tjetër shtetëror. Gjithashtu, Kushtetuta, u vë obligim organeve të shtetit, nëpërmjet mjeteve legjislative dhe mjeteve të tjera, që të sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë, dinjitetin dhe efektshmërinë e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura"* (shih Aktgjykimin KO73/16, para. 68 dhe 69).

124. Për më tepër, Gjykata kishte theksuar se të gjitha institucionet janë të obliguara me Kushtetutë të respektojnë pavarësinë e Zyrës së Avokatit të Popullit. Po ashtu, Gjykata kishte theksuar se Avokati i Popullit është i obliguar të sigurojë pavarësinë e tij duke nxjerrë rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike në atë mënyrë që ato të mos kufizojnë pavarësinë e tij funksionale, organizative dhe financiare (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin KO73/16, para. 69).

125. Gjykata, në Aktgjykimin e mësipërm, në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, i ishte referuar nenit 112, paragrafit 2, të Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme] ku përcaktohet që *"Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj",* si dhe nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] ku specifikohet se *"Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin" (*shih Aktgjykimin KO73/16).

126. Për më tepër, Ligji për Gjykatën Kushtetuese në nenin 14 [Buxheti] përcakton se *"pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit të saj vjetor dhe ia dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. [...] Buxheti i propozuar nga Gjykata Kushtetuese përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim".* Ky nen gjithashtu specifikon se*, "Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës (*shih Aktgjykimin KO73/16, paragrafi 90).

127. Gjithashtu, neni 12, paragrafi 5 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton se ndaj të punësuarve të Sekretarisë zbatohen dispozitat ligjore për shërbyesit civil. Përveç kësaj, rregulli 20 [Personeli i Sekretariatit], paragrafi 4 i Rregullores së punës së Gjykatës përcakton se *"dispozitat ligjore të parashikuara për shërbyesit civil, siç parashihet në nenin 12 të Ligjit zbatohen për punonjësit e Gjykatës deri në atë masë sa ato dispozita ligjore të mos kenë ndikim në pavarësinë e Gjykatës, të garantuar me nenin 112.2 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të Ligjit"*.

128. Ngjashëm si për parashtruesin e kërkesës, sa i përket Gjykatës Kushtetuese, në Aktgjykimin e saj KO73/16, Gjykata kishte konstatuar se mandati për të nxjerrë rregulloren e vet të punës është vendosur brenda kompetencës ekskluzive të Gjykatës, duke arsyetuar edhe qëllimin e këtij përcaktimi si në vijim: *"qartazi, autorët e Kushtetutës kishin për qëllim sigurimin e pavarësisë dhe të efikasitetit të Gjykatës Kushtetuese, duke ia mundësuar Gjykatës që vetë të krijojë Rregulloren e punës ashtu që të parandalojë çfarëdo ndërhyrje në ushtrimin e përgjegjësive që i janë caktuar asaj. Kjo, po ashtu, tregon dhe konfirmon që Gjykata ka pozicion dhe autoritet të veçantë sipas Kushtetutës dhe brenda sistemit të institucioneve shtetërore. Rrjedhimisht, pavarësia e Gjykatës e kërkon që ajo të udhëhiqet nga rregulla specifike, për më tepër të vlerave kushtetuese, dhe e obligon Qeverinë dhe degët e saj t'i respektojnë ato"* (shih Aktgjykimin KO73/16, para. 79 dhe 80).

129. Gjykata po ashtu ka theksuar se ajo duhet të jetë në gjendje të vendosë vetë për organizimin e saj të brendshëm dhe të arrijë funksionim efikas. I takon Kuvendit të përcaktojë dhe të miratojë buxhetin e institucioneve të Republikës së Kosovës, por në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kushtetuta e obligon ligjvënësin dhe ekzekutivin të mos cenojnë pavarësinë e Gjykatës (shih, për shembull, *Vendimin përkitazi me pranueshmërinë dhe meritat të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës* në rastin nr. U. 6/06, të 29 marsit 2008).

130. Ky status i veçantë i parashtruesit të kërkesës dhe të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës, reflektohen edhe në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht, paragrafi 4, i nenit 1 [Qëllimi dhe fushëveprimi] që përcakton se *"institucionet e administratës qendrore, të cilat rregullohen me akte të posaçme, iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji [Ligjit për Shërbimin Civil], përveç nëse ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme"* dhe nenin 3 [Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës] që përcakton se

"gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi".

131. Gjykata vëren gjithashtu se në Aktgjykimin e saj KO73/16, ku kishte vlerësuar Qarkoren e Qeverisë për klasifikimin e pozitave në shërbimin civil, kishte deklaruar se *"implementimi i ligjeve dhe i politikave shtetërore është njëra nga detyrat kushtetuese të Qeverisë. Megjithatë, Qeveria duhet të marrë parasysh statusin e veçantë të Avokatit të Popullit, të Gjykatës dhe të institucioneve të tjera të pavarura në pajtim me garancinë kushtetuese të pavarësisë së tyre siç është theksuar më lart. Rrjedhimisht, përgatitja, përmbajtja dhe aplikueshmëria e çfarëdo norme lidhur me funksionimin e tyre dhe me përshkrimet e brendshme të vendeve të punës dhe të pagave duhet të zhvillohet dhe të përcaktohet në mënyrë të duhur. Qeveria nuk mund të mjaftohet duke aplikuar kritere identike me ato që aplikohen për agjencitë qeveritare, t'i aplikojë në mënyrë të njëjtë edhe për institucionet e pavarura të definuara në Kushtetutë"* (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin KO73/16, para. 69).

132. Gjykata, në rastin KO73/16 në lidhje me pavarësinë e institucioneve të pavarura, i është referuar edhe Vendimit (V-19-07) të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, që arsyetoi:

> "*Nocioni i pavarësisë nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën përmbajtje apo kuptim referuar në tërësi të gjithë organeve apo institucioneve kushtetuese. Ai ndryshon në varësi të natyrës së organit, detyrave dhe funksioneve të tij kushtetuese. Megjithatë, marrë në tërësi, duhet vënë në dukje se pavarësia e tyre e garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet organike përkatëse, ka si përbërës apo elementë të qenësishëm të saj pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare. Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtuesve apo funksionarëve të tjerë të lartë të organeve dhe institucioneve kushtetuese, ndër të tjera, pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, përfshirë këtu edhe të drejtën e caktimit të drejtorëve dhe këshilltarëve, numrin dhe përbërjen e funksionarëve të kabineteve ndihmëse, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, etj. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese [...]. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje*

ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese [...]. Nga ana tjetër, dispozitat kushtetuese dhe ligjet organike përkatëse përcaktojnë qartazi se menaxhimi i këtij buxheti në përputhje me ligjin duhet t'u lihet në dorë vetë këtyre organeve. Sigurisht, ato i dinë dhe i vlerësojnë më mirë se kushdo tjetër kërkesat dhe problemet e tyre, nevojat për investime, objektivat që synojnë të arrijnë etj." (shih Vendimin (V-19-07) në rastin nr. 43/13, të 3 majit 2007, të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).

133. Andaj, sa i përket statusit të personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese, në veçanti parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatës Kushtetuese, ashtu si përcaktohet nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, Gjykata vëren se:

a) dispozitat e legjislacionit relevant, duke e përfshirë legjislacionin e shërbimit civil, nuk i referohen në mënyrë specifike personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese si shërbyes civil, por parashohin që ndaj tyre aplikohet legjislacioni i shërbimit civil;

b) legjislacioni i shërbimit civil, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, aplikohen ndaj personelit të këtyre institucioneve të pavarura kushtetuese vetëm për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre;

c) Kushtetuta dhe ligjet e veçanta i autorizojnë dhe obligojnë institucionet e pavarura, veçanërisht, parashtruesin dhe Gjykatën, që të nxjerrin rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike, për të rregulluar specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet e tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, në atë mënyrë që ato të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative, por vetëm për aq sa është e nevojshme për të siguruar pavarësinë e tyre të paraparë me Kushtetutë dhe ligje të veçanta.

d) rregulloret dhe aktet e tjera juridike të institucioneve të pavarura kushtetuese, që rregullojnë specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të institucioneve të pavarura që burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, duhet të respektohen nga të gjitha institucionet, përfshirë

ekzekutivin dhe institucionet tjera, siç është Këshilli, dhe kanë përparësi ndaj ligjeve tjera.

134. Në anën tjetër, Gjykata ka theksuar se institucionet e pavarura, përfshirë parashtruesin e kërkesës, nuk mund të veprojnë në vakum në raport me kornizën ligjore. Gjykata konsideron se pavarësia e parashtruesit të kërkesës dhe e Gjykatës, gjithashtu i nënshtrohet disa kufizimeve dhe kontrollit. Këto i përmban neni 14.3 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese që parasheh: "*Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës*". Ngjashëm, neni 35.4 i Ligjit për Avokatin e Popullit parasheh: *"Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës"* (shih Aktgjykimin KO73/16, para. 90).

135. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se sipas nenit 137 të Kushtetutës [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës], Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është i vetmi autoritet i themeluar me Kushtetutë që mund të auditojë aktivitetin ekonomik të parashtruesit të kërkesës dhe të Gjykatës, si dhe të të gjitha institucioneve të tjera publike në Republikën e Kosovës (shih Aktgjykimin KO73/16, para. 91).

136. Gjykata për më tepër rikujton se sipas nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, "*secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*".

137. Andaj, edhe institucionet e pavarura kushtetuese nuk mund të lirohen nga detyrimi që në rregullore dhe akte të tjera juridike, për të rregulluar specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, të sigurojnë që askujt të mos i cenohet e drejta që të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve administrative të tyre, ashtu si garantohet me nenin 32 të Kushtetutës.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar në lidhje me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera publike

138. Gjykata fillimisht vëren se Ligji i kontestuar nuk parasheh përjashtim në fushëveprimin e Këshillit në nenin 2 [Fushëveprimi], apo në ndonjë dispozitë tjetër të tij, sa i përket institucioneve të pavarura kushtetuese

të përfshira në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës, siç bënë Kushtetuta, ligjet e veçanta dhe Ligji për Shërbimin Civil.

139. Megjithatë, Gjykata ka vlerësuar kushtetutshmërinë e nenit 2 të Ligjit të kontestuar, ku sqaroi se shprehja "Shërbimi Civil" sipas leximit dhe interpretimit të nenit 101 të Kushtetutës duhet kuptuar në kontekstin e saj dhe qëllimin që ka pasur hartuesi, qëllim i cili është i shprehur në nenin 1 të Ligjit për Shërbimin Civil, së bashku me kufizimet e fushëveprimit të parashikuara me paragrafin 4, të nenit 1 të LSHC-së, duke përcaktuar se institucionet e administratës qendrore do t'iu nënshtrohen dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, përveç nëse ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme nga Ligji për Shërbimin Civil, duke evituar kështu mundësinë e keqinterpretimeve ose interpretimeve teknike të normës në fjalë.

140. Më tej, Këshilli, sipas nenit 4 të Ligjit të kontestuar (dhe ashtu si është interpretuar edhe nga vet Këshilli në përgjigjen e tij drejtuar Gjykatës), kryen funksionet e veta duke u bazuar ekskluzivisht në zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil, por jo edhe në rregullat e brendshme të institucioneve të pavarura kushtetuese, të nxjerra bazuar në Kushtetutë dhe ligje të veçanta dhe i konsideron nëpunësit e institucioneve të pavarura si shërbyes civil me automatizëm.

141. Gjykata rikujton se kompetencat e Këshillit përfshijnë, mes tjerash:

- shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve të detyrueshme dhe përfundimtare për ankesat e nëpunësve civil (neni 6 (1.1), neni 18);
- mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes, të nivelit drejtues dhe të lartë drejtues të nëpunësve civil, pa ndonjë ankesë nga palët e interesuara (neni 6 (1.2), neni 19) duke nxjerrë vendim të detyrueshëm në lidhje me to; dhe
- monitorimin e rregullt vjetor dhe të jashtëzakonshëm, të institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil (neni 6 (1.3) dhe neni 20) dhe duke dhënë rekomandime të detyrueshme në lidhje me to.

142. Gjykata për më tepër vëren se Këshilli ka të drejtë, sipas nenit 24 të Ligjit të kontestuar, që të vendosë sanksione për moszbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit si dhe, sipas nenit 7 dhe 25 të Ligjit të kontestuar, të kërkoj nga të gjitha institucionet bashkëpunim me Këshillin, qasje në secilën dosje dhe dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit civil, intervistimin e çdo nëpunësi civil dhe informata tjera.

143. Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar parasheh një qasje uniforme për të vlerësuar zbatimin e ligjeve për shërbimin civil ndaj të gjitha institucioneve publike, duke përfshirë edhe institucionet e pavarura kushtetuese.

144. Gjykata rikujton edhe njëherë se sipas Kushtetutës dhe ligjeve të veçanta ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil, për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Kjo nënkupton edhe ligjet që rregullojnë mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve, si dhe të Ligjit të kontestuar. Megjithatë, ashtu siç buron nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, institucionet e pavarura, veçanërisht parashtruesi dhe Gjykata, janë të autorizuara që të nxjerrin rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike, për të rregulluar specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, në atë mënyrë që ato të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Këto norma të veçanta duhet të respektohen nga të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe Këshillin.

145. Andaj, Gjykata konsideron se gjatë zbatimit të Ligjit të kontestuar duhet të njihen funksionet dhe autoriteti specifik i institucioneve të pavarura kushtetuese që reflektohet, *inter alia,* në nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligje të veçanta, deri në masën e nevojshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre organizative, funksionale dhe buxhetore, ashtu siç kërkohet me parimet e elaboruara më lart, duke përfshirë rregullat e brendshme të këtyre institucioneve dhe specifikat e punës së personelit të tyre.

146. Gjykata, rrjedhimisht, konkludon se kompetencat e Këshillit të parapara me Ligjin e kontestuar zbatohen edhe ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese, përderisa kjo nuk cenon pavarësinë e tyre të garantuar me Kushtetutë, e që kjo pavarësi reflektohet në nxjerrjen e akteve të brendshme të këtyre institucioneve, në bazë të kompetencave të tyre të parapara me Kushtetutë dhe ligje të veçanta, për të mbrojtur pavarësinë e tyre.

147. Për më tepër, Gjykata konsideron se çështjet që ngrit parashtruesi i kërkesës, në lidhje me dispozitat e kontestuara, kanë shtrirje edhe në institucionet e tjera publike që kanë të punësuar nëpunësit civil, përveç institucioneve të pavarura.

148. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson edhe njëherë se i takon vetë asaj të karakterizojë faktet e rastit *vis-à-vis* normave kushtetuese dhe se

nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtruesi i kërkesës (shih, ndër autoritete të tjera, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë,* GJEDNJ, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 44).

149. Andaj, Gjykata në vazhdim do të merret edhe me vlerësimin individual të kushtetutshmërisë së neneve të kontestuara të Ligjit, në lidhje me aplikimit e tyre ndaj të gjitha institucionet publike, përveç neneve 2 dhe 11 (paragrafi 3) që trajtohen ndaras si pjesë e pretendimeve konkrete të parashtruesit të kërkesës,

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 3 (paragrafi 2, 3 dhe 4) të Ligjit të kontestuar

150. Gjykata i referohet përsëri nenit 3 (paragrafi 2, 3 dhe 4) të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

"Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: [...]
1.2. Nëpunës civil - nënkupton nëpunësin civil sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;
1.3. Nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues - nënkupton nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;
1.4. Nëpunës civil i nivelit drejtues - nënkupton nëpunësit civilë të nivelit drejtues sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil;
[...]".

151. Gjykata vëren se përkufizimet e përcaktuara me dispozitat e lartpërmendura janë të njëjta me përkufizimet e përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil.

152. Andaj, Gjykata konstaton se neni 3, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar nuk kufizojnë dhe nuk cenojnë esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 4 (paragrafi 1.) të Ligjit të kontestuar në lidhje me nenin 3 (paragrafi 1.1.) të Ligjit të kontestuar

153. Gjykata rikujton nenin 3 (paragrafi 1.1.) dhe nenin 4 (paragrafi 1.) të Ligjit të kontestuar, që përcaktojnë:

"Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
1.1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – nënkupton institucionin e pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil;
[...]

Neni 4
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

1. Këshilli është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.
[...]"

154. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston nenin 4, paragrafin 1 të Ligjit të kontestuar, i cili është në lidhje të drejtpërdrejtë me nenin 3, paragrafin 1.1, ku, sipas dispozitave të lartpërmendura, Këshillit i është dhënë statusi i institucionit të pavarur kushtetues. Prandaj, Gjykata do të merret me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 4, paragrafit 1 në lidhje me nenin 3, paragrafin 1.1 të Ligjit të kontestuar.

155. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Kushtetuta i ka përcaktuar në Kapitullin XII të saj, në mënyrë shprehimore, institucionet e pavarura kushtetuese, duke përcaktuar edhe rolin dhe statusin e tyre.

156. Gjykata gjithashtu vëren se në Kapitullin XII, neni 142 i Kushtetutës ka krijuar bazën ligjore për themelimin e agjencive të pavarura, duke përcaktuar se:

"Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës".

157. Gjykata vëren se agjencitë e pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës nuk kanë statusin e njëjtë me atë të institucioneve të

pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo pasi themelimi, roli dhe statusi i institucioneve të pavarura kushtetuese është i rregulluar në mënyrë shprehimore me Kapitullin XII të Kushtetutës, për shkak të rëndësisë dhe specifikave të autorizimeve kushtetuese që ato ushtrojnë. Ndërsa roli, statusi dhe kompetencat e agjencive të pavarura rregullohen me ligjin e miratuar nga Kuvendi në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 142 të Kushtetutës.

158. Kapitulli XII i Kushtetutës nuk e autorizon Kuvendin e Kosovës që përmes ligjit të themelojë institucione të tjera të pavarura kushtetuese me statusin e njëjtë të institucioneve të pavarura të përfshira në kapitullin XII, por vetëm agjenci të pavarura duke i dhënë autorizimet e përcaktuara sipas nenit 142 të Kushtetutës.

159. Andaj, Gjykata vlerëson se Këshilli nuk mund të kategorizohet si institucion i pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës.

160. Për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 4, paragrafi 1, në ndërlidhje me nenin 3.1, nënparagrafin 1.1. të Ligjit të kontestuar nuk janë në pajtim me Kapitullin XII të Kushtetutës. Rrjedhimisht, këto dispozita nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 6 të Ligjit të kontestuar

161. Gjykata rikujton nenin 6 të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

"Neni 6
Funksionet e Këshillit

1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:
1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil".

162. Gjykata rikujton se kompetencat e Këshillit bazuar në nenin 6 përfshijnë:

- shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve të detyrueshme dhe përfundimtare për ankesat e nëpunësve civil;
- mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes, të nivelit drejtues dhe të lartë drejtues të nëpunësve civil, pa ndonjë ankesë nga palët e interesuara duke nxjerrë vendim të detyrueshëm në lidhje me to; dhe
- monitorimin e rregullt vjetor dhe të jashtëzakonshëm, të institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil.

163. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton edhe njëherë se në rastin KI33/16, kishte deklaruar se Këshilli gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së dhe se "gjykata" kategorizohet në kuptimin substancial të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë [...]", duke përcaktuar se vendimet e Këshillit janë "përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme" dhe se Këshilli nga pikëpamja e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së është i pavarur ngase (a) është i pavarur prej ekzekutivit dhe (b) ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që vendosen para tyre ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, rastin KI33/16, *Minire Zeka*, cituar më lart, paragrafi 59. Në lidhje me pavarësinë e një "tribunali të pavarur" shih rastin KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, i 9 majit 2017, para. 75).

164. Gjykata rikujton se aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, varet nga ekzistimi i "konfliktit" (në anglisht "dispute"). Sipas këtij koncepti, konflikti duhet të jetë i vërtetë dhe serioz dhe të ndërlidhet jo vetëm më ekzistimin e së drejtës por edhe më fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të asaj të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Denisov kundër Ukrainës,* nr. 76639/11, Aktgjykim i 25 shtatorit 2018, paragrafi 44).

165. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se Këshilli është konsideruar si institucion "*kuazi gjyqësor",* përkatësisht si tribunal përkitazi me shërbimin civil (emërtimi "tribunal" gjënë përdorim më të gjerë në diskursin e GJEDNJ). Si i tillë, ai gëzon prerogativat e një gjykate pikërisht për shkak të pavarësisë nga ekzekutivi dhe si institucion që ka juridiksion të plotë dhe që nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje

me konfliktet në mes të shërbyesve civil ose kandidatëve për shërbyes civil në njërën anë, dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër.

166. Andaj, dhënia e kompetencave Këshillit që për disa pozita të caktuara të vendos për përzgjedhjen e nëpunësve civil, duke u bërë pjesë e vendimmarrjes pa marrë parasysh a ka një konflikt apo jo në lidhje me një pozitë të caktuar, dhe në fund të këtij procesi të nxjerr vendim detyrues për ligjshmërinë e përzgjedhjes, bie në kundërshtim me rolin e tij si institucion "*kuazi gjyqësor*" që ka prerogativat e një "*tribunali*" të pavarur nga ekzekutivi, që vendos sipas ankesave së palëve të autorizuara, ashtu siç është përcaktuar tashmë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

167. Gjykata konsideron se funksioni primar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është zgjidhja e kontesteve që kanë lindur në mes të nëpunësve civil apo kandidatëve për nëpunës civil, në njërën anë, dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër. Marrja përsipër e funksioneve ekzekutive nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me rolin e tij "kuazi gjyqësor", i cili është funksioni parësor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

168. Gjykata, gjithashtu, vëren se në lidhje me shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil dhe monitorimin e rregullt vjetor, Këshilli ka kompetencë në raport me të gjithë shërbyesit civil pa përjashtim. Ndërsa, në lidhje me mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes së nëpunësve civil, kompetencat e Këshillit janë të kufizuara vetëm në pozitat e nivelit drejtues dhe ato të nivelit të lartë drejtues. Kjo kompetencë e Këshillit nuk përfshin mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes në raport me pjesën tjetër të nëpunësve civil, duke rezultuar në trajtim të ndryshëm të nëpunësve civil në raport me kompetencat e Këshillit.

169. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 24 të Kushtetutës që përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje ligjore.

170. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme*, ose status,* mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis Kjeldsen, Busk Madsen*

dhe Pedersen kundër Danimarkës, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976, para. 56; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, 16 mars 2010, para. 61).

171. Gjykata konsideron se për qëllimet e interpretimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, një trajtim ndryshe është i pabarabartë dhe arbitrar nëse: 1) nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se nuk ndjek një qëllim legjitim, ose 2) kur nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatësisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet (shih, *mutatis mutandis Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesat nr. 9214/80; 9473/81 dhe 9474/81, 24 prill 1985, paragrafi 72).

172. Gjykata thekson se Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë, përkatësisht një hapësirë diskrecionale, kur vlerësojnë nëse dhe deri në çfarë mase mund të arsyetohet trajtimi i pabarabartë në rrethana të njëjta. Fushëveprimi i kësaj margjine ndryshon sipas rrethanave, sipas objektit të çështjes dhe sipas historisë së rastit. Një margjinë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (shih, *mutatis mutandis, Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13378/05, 29 prill 2008, paragrafi 60; *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 64).

173. Andaj, Gjykata do të vlerësojë konkretisht nëse neni 6, paragrafi 1.2, i Ligjit të kontestuar është në përputhje me të drejtat për barazi para ligjit, sipas nenit 24 të Kushtetutës.

a) Trajtimi i pabarabartë

174. Gjykata së pari përcakton nëse ekziston një dallim në trajtimin e nëpunësve civil në situatë analoge ose në situatë relevante të ngjashme.

175. Gjykata vëren se sipas paragrafit 1.2 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Këshilli mbikëqyrë përzgjedhjen e nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe nivelit të lartë drejtues dhe lëshon vendim detyrues për ligjshmërinë e përzgjedhjes së tyre, që është vendim përfundimtar në procedurë administrative. Palët e pakënaqura, pastaj, kanë mundësi që të sfidojnë këtë vendim, përmes hapjes së konfliktit administrativ. Ndërsa, në lidhje me pjesën tjetër të shërbyesve civil, një monitorim i tillë nuk parashihet, por lejohet mundësia e ankesës në Këshill për

palët e pakënaqura, dhe pastaj, palët e pakënaqura me vendimet e Këshillit kanë të drejtë të hapin konflikt administrativ.

176. Gjykata vëren se nga ajo që u tha më lart, rrjedh se shërbyesit civil të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues, kanë mbikëqyrjen e Këshillit për përzgjedhjen e tyre, i cili lëshon një vendim detyrues, ndërsa ndaj nëpunësve të tjerë civil ky detyrim nuk parashihet, por vetëm mundësia e ankesës në Këshill.

177. Gjykata konsideron se të dy kategoritë, edhe nëpunësit civil të nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues, në njërën anë, si dhe nëpunësit e tjerë civil në anën tjetër, janë në situatë analoge ose në situatë relativisht të ngjashme, gjegjësisht të gjithë janë nëpunës civil. Megjithatë, për shkak të nivelit të pozitës së tyre, janë në një gjendje të ndryshme thelbësore në lidhje me procedurën për përzgjedhjen e tyre.

178. Prandaj, Gjykata konsideron se dallimi në mënyrën e përzgjedhjes së tyre dhe rolin e Këshillit në përzgjedhjen e tyre është bërë në varësi të pozitës së tyre në shërbimin civil. Si rrjedhojë, Gjykata konkludon se ekziston një dallim në trajtimin e nëpunësve civil, që janë në një situatë analoge ose në situatë relevante të ngjashme, e cila përbën një kufizim në të drejtën për përzgjedhjen në shërbimin civil.

b. Legjitime dhe proporcionale

179. Gjykata rikujton atë që u tha më lart, se trajtimi i pabarabartë nuk është në pajtim me nenin 24 të Kushtetutës nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

180. Në lidhje me këtë, Gjykata do të analizojë nëse:

(1) Kufizimi është paraparë me ligj;
(2) Ekziston një qëllim legjitim që synohet të arrihet me kufizim; dhe
(3) Ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet.

181. Përkitazi me kriterin (1), Gjykata vëren se kompetenca e këshillit për mbikëqyrje të përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe të lartë drejtues, është paraparë me nenin 6, paragrafi 1.2 të Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ.

Gjykata konkludon se kufizimi i të drejtës për barazi para ligjit është paraparë me ligj.

182. Përkitazi me kriterin (2), Gjykata vëren se neni 1 i Ligjit të kontestuar përcakton se qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i funksioneve, kompetencave dhe organizimit të Këshillit.

183. Megjithatë, Gjykata vëren se nga dispozitat e Ligjit të kontestuar, nuk mund të përcaktohet se cili ka qenë qëllimi i dispozitës me të cilën është përcaktuar roli mbikëqyrës i Këshillit vetëm për pozitat e nivelit drejtues dhe të nivelit të lartë drejtues dhe jo për kategoritë e tjera të shërbimit civil.

184. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ekziston ndonjë qëllim legjitim që synohet të arrihet me trajtimin ndryshe të kandidatëve/shërbyesve civil.

185. Gjykata i referohet praktikës së saj (shih Aktgjykimin në rastin KO01/17, dhe KO157/18), kur ka konstatuar se mosekzistimi i qëllimit legjitim, të trajtimit të pabarabartë, e bënë të panevojshme analizën e proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet.

186. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se trajtimi i pabarabartë i shërbyesve civil në raport me kompetencën e Këshillit për mbikëqyrje të përzgjedhjes së shërbyesve civil, i përcaktuar me nenin 6, paragrafi 1.2, i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4) të Ligjit të kontestuar

187. Gjykata rikujton nenin 7 (paragrafi 1, nënparagrafët, 2, 3 dhe 4) të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

"Neni 7
Kompetencat e Këshillit

1. Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli ka të drejtë të:

[...]
1.2. ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;

1.3. intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
1.4. kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;

[...]"

188. Në lidhje me këtë, duke pasur parasysh atë që u tha në lidhje me kompetencat e Këshillit që të vendos për përzgjedhjen e një kategorie të nëpunësve civil, Gjykata thekson se kompetencat e Këshillit të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen vetëm me funksionet e Këshillit përkitazi me vlerësimin e ankesave kur ekziston një *"konflikt"* dhe rolin e tij monitorues për zbatimin e parimeve dhe rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

189. Andaj, Gjykata konstaton se neni 7, paragrafi 1, nënparagrafët, 2, 3 dhe 4, të Ligjit të kontestuar nuk kufizojnë dhe cenojnë thelbin e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 18 të Ligjit të kontestuar

190. Gjykata rikujton nenin 18 të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

"Neni 18
Mënyrat e vendosjes për ankesat

1. Kolegji i Këshillit që shqyrton ankesat, vendos në këtë mënyrë:
1.1. lënien në fuqi të aktit administrativ dhe refuzimin e ankesës;
1.2. shfuqizimin ose anulimin e aktit administrativ dhe aprovimin e ankesës;
1.3. ndryshimin e aktit administrativ duke aprovuar pjesërisht ankesën;
1.4. detyrimin e organit administrativ kompetent për të nxjerrë aktin administrativ kur pa të drejtë është refuzuar nxjerrja e tij;
1.5. përfundimin e procedimit administrativ;
1.6. kthimin në rishqyrtim;
1.7. hedhjen poshtë të ankesës;
1.8. shpalljen jokompetent;
1.9. pezullimin e procedurës.

2. Kolegjet e Këshillit që shqyrtojnë ankesat, bazuar në paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të këtij neni, kanë të drejtë të ndryshojnë masën disiplinore në rastet kur vërtetohet se nëpunësi civil e ka kryer shkeljen, mirëpo organi i punësimit nuk i ka shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer.

191. Në lidhje me këtë, kompetencat e lartcekura ndërlidhen vetëm me funksionet e Këshillit në lidhje me ankesat kur ekziston një *"konflikt"*. Gjithashtu, duke pasur parasysh atë që u sqarua me lart, se Këshilli gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, Këshilli, përveç pavarësisë nga ekzekutivi duhet të këtë *"juridiksion të plotë"* për të vendosur për një çështje që është vendosur para saj, që përfshijnë kompetencën për të anuluar në të gjitha aspektet, në çështje ligjore dhe faktike, vendimet e organit që ka nxjerr apo që kërkohet të nxjerr vendim *(shih Schmautzer kundër Austrisë,* cituar më lart, paragrafi 36*; Gradinger kundër Austrisë,* cituar më lart, paragrafi 44*;* dhe *Terra Woningen B.V. kundër Holandës,* cekur më lart, paragrafi 52*).*

192. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe kompetencat e listuara në nenin 18 të Ligjit të kontestuar. Andaj, Gjykata konstaton se neni 18, i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8) të Ligjit të kontestuar

193. Gjykata rikujton se neni 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8) të Ligjit të kontestuar, përcaktojnë se:

Neni 19
Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civilë
të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues

[...]

5. Këshilli pas shqyrtimit të raportit, nxjerr vendim dhe vendos që:

5.1. të aprovojë procedurën e përzgjedhjes, kur konstaton që është zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;

5.2. të anulojë procedurën e përzgjedhjes, kur konstaton që është zhvilluar në
kundërshtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil.

6. Këshilli është i obliguar që të nxjerr vendim për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të dosjes komplete nga organi i punësimit.

7. Nëse zhvillimi i procedurës për përzgjedhjen e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, bëhet pa njoftim të Këshillit për pjesëmarrje në mbikëqyrje, procedura konsiderohet e pavlefshme dhe Këshilli sipas detyrës zyrtare nxjerr vendim për anulimin e procedurës.

8. Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ".

194. Në lidhje me këtë, duke pasur parasysh që neni 6, paragrafi 1.2 i Ligjit të kontestuar që e parasheh kompetencën e Këshillit për të vendosur me vendim detyrues pa ndonjë ankesë dhe pa pasur ende një "konflikt" në lidhje me ligjshmërinë e mbikëqyrjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është deklaruar nga Gjykata se është në kundërshtim me rolin e tij "kuazi gjyqësor" i cili është funksion parësor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe se i njëjti nuk është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para ligjit] të Kushtetutës.

195. Andaj, Gjykata konstaton se edhe neni 19. paragrafët 5, 6, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar, pasi rregullojnë çështjen e vendimit detyrues lidhur me përzgjedhjen e një kategorie të nëpunësve civil, po ashtu nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 20 (paragrafi 5) të Ligjit të kontestuar

196. Gjykata rikujton se neni 20 (paragrafi 5) i Ligjit të kontestuar, përcakton se:

"Neni 20
Monitorimi i institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

[...]

5. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit".

197. Gjykata thekson se, duke pasur parasysh që Gjykata nuk ka gjetur shkelje të nenit 6, paragrafi 1.3 ku ka vlerësuar nenin 6 të Ligjit të kontestuar që e parasheh kompetencën e Këshillit për monitorim të institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunësve civil.

198. Andaj, për këto arsye, Gjykata konstaton se edhe neni 20. paragrafi 5 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 21 të Ligjit të kontestuar

199. Gjykata rikujton nenit 21 të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

Neni 21
Vendimi i Këshillit

"1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.
2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.
3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.

200. Gjykata thekson se, duke pasur parasysh atë që u tha në lidhje me nenin 6, paragrafi 1.2 të Ligjit të kontestuar, Gjykata thekson se kompetencat e Këshillit të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen vetëm me funksionet e Këshillit përkitazi me vlerësimin e ankesave kur ekziston një *"konflikt"* dhe rolin e tij monitorues për zbatimin e parimeve dhe rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

201. Andaj, për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 21i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 22 të Ligjit të kontestuar

202. Gjykata rikujton nenit 22 të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

Neni 22
Inicimi i konfliktit administrativ

1. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.
2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

203. Gjykata vëren se ky nen i Ligjit të kontestuar ndërlidhet edhe me nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konflikte Administrative, që përcakton se *"padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe"*. Për më tepër, neni 22 i Ligjit të kontestuar konfirmon mbrojtjen gjyqësore për palët e pakënaqura me vendimet e Këshillit.

204. Andaj, për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 22 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 23 të Ligjit të kontestuar

205. Gjykata rikujton nenit 23 të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

Neni 23
Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit

1. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e Këshillit brenda afatit të paraparë me nenin 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet të njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit, Komisionin përkatës për administratë publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për zbatim.
2. Në rastet kur personi përgjegjës për zbatim të vendimit të Këshillit është në kuadër të degës së ekzekutivit, për moszbatim të vendimit duhet të njoftohet me shkrim edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës.
3. Në rastet kur personi përgjegjës për zbatim të vendimit të Këshillit është Kryetari i Komunës, për moszbatim të vendimit duhet të njoftohet me shkrim Ministri përkatës i pushtetit lokal dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës.
4. Njoftimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër personit përgjegjës për zbatim, e cila procedurë zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara me legjislacionin në fuqi.
5. Kryeministri ose eprori përgjegjës është i obliguar për fillimin e procedurës disiplinore ndaj personit përgjegjës për zbatim, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga Kryetari i Këshillit.
6. Në rast se nuk ndërmerren veprimet sipas paragrafit 5 të këtij neni, Kryetari i Këshillit e njofton me shkrim Kryetarin e Kuvendit dhe Komisionin përkatës për administratë publike. Kryetari i Kuvendit, kërkon me shkrim nga Kryeministri apo eprori përgjegjës i institucionit, që të ndërmerren të gjitha veprimet për zbatimin e menjëhershëm të vendimit të Këshillit dhe marrjen e masave ndaj personit përgjegjës në pajtim me dispozitat e parapara me legjislacionin në fuqi.
7. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim të vendimit të Këshillit, pala mund të fillojë procedurën e përmbarimit të vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbarimore.

206. Gjykata thekson se kompetencat e Këshillit të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen vetëm me funksionet e Këshillit përkitazi me vlerësimin e ankesave kur ekziston një *"konflikt"* dhe rolin e tij monitorues për zbatimin e parimeve dhe rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

207. Andaj, për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 23i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozitë

konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 24 të Ligjit të kontestuar

208. Gjykata rikujton nenin 24 të Ligjit të kontestuar, që përcakton:

Neni 24
Sanksionet administrative për moszbatimin e vendimit të Këshillit

1. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.
2. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni, i dërgohet për zbatim zyrtarit kryesor administrativ të Ministrisë përkatëse për menaxhimin e listës së pagave, i cili është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të zbatojë vendimin dhe të njoftojë me shkrim Këshillin për zbatimin e vendimit.
3. Kundër vendimit për ndalimin e 50 % të pagës mujore, pala e pakënaqur ka të drejtë të inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente për çështje administrative, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.
4. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.
5. Në rast të moszbatimit të vendimit të Kryetarit të Këshillit për ndalimin e 50% të pagës mujore, Këshilli brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim mund të fillojë procedurën e përmbarimit të vendimit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbarimore.

209. Gjykata thekson se kompetencat e Këshillit të përcaktuara në këtë nen, kanë për qëllim krijimin e mekanizmit për zbatimin e vendimeve të saj. Kompetenca të tilla për zbatimit të vendimeve të saj kanë edhe institucionet e tjera administrative. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet edhe Ligjit nr.2002/09, për Inspektoratin e Punës në Kosovë, të ndryshuar dhe plotësuar përmes Ligjit nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9, që përcakton se Kryeinspektori i punës mbikëqyrë ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me cenimin e ligjit të punës, rregullave të mbrojtjes në punë si dhe sanksionet e ndërmarra.

Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 92 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 që përcakton se, *"1. personi fizik ose personi juridik që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji , në procedurë ligjore, do të dënohej me të holla pre njëqind (100) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro. 2. Ky ligj gjithashtu parasheh se, kur shkelja është bërë kundër të punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, punëdhënësi apo personit tjetër përgjegjës, do të gjobitet me gjobë në lartësinë e dyfishit të përcaktuar në paragrafin 1".*

210. Gjykata rikujton se në rast të moszbatimit të vendimeve të saj, Këshilli ka të drejtë të inicioj procedurën e përmbarimit sipas ligjit të procedurës përmbarimore. Neni 24 i Ligjit të kontestuar, gjithashtu, parasheh edhe mbrojtjen gjyqësore për personat e pakënaqur me vendimet e Këshillit.

211. Andaj, për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 24i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 25 të Ligjit të kontestuar

212. Gjykata rikujton nenin 25 të Ligjit të kontestuar, që përcakton se:

"Neni 25
Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike

[...]
2. Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin.
3. Në rastet kur organi i punësimit apo personi përgjegjës nuk bashkëpunon, Këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili njoftimin ia përcjell Kryeministrit ose eprorit të drejtpërdrejtë të personit përgjegjës".

213. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se kompetencat e Këshillit të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen vetëm me funksionet e Këshillit përkitazi me vlerësimin e ankesave kur ekziston një *"konflikt"* dhe

rolin e tij monitorues për zbatimin e parimeve dhe rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

214. Për këto arsye, Gjykata konstaton se neni 25, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit të kontestuar nuk kufizojnë dhe cenojnë esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht këto dispozita janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

(iii) Përkitazi me pretendimin për imunitetet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, lidhur me kryerjen e funksioneve të Këshillit

215. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston edhe nenin 11 [Mandati i anëtarëve të Këshillit] paragrafin 3, të Ligjit të kontestuar përkitazi me imunitetin e anëtarëve të Këshillit, që përcakton:

> *"3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi".*

216. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës, i cili theksoi se imuniteti i anëtarëve të Këshillit nuk ka bazë në Kushtetutë pasi ajo saktëson qartë zyrtarët shtetërorë që gëzojnë imunitet. Ai thekson se sipas Kushtetutës, vetëm deputetët e Kuvendit anëtarët e Qeverisë, gjyqtarët e gjykatave të rregullta, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Avokati i Popullit gëzojnë imunitet.

217. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar Aktgjykimit KO98/11 të Gjykatës, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës*, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 20 shtatorit 2011 (në tekstin e mëtejmë: rasti KO98/11), pohon se ky lloj imuniteti nuk mund të përcaktohet me akte të tjera juridike nëse nuk parashikohet nga vetë Kushtetuta.

218. Gjykata vëren se Këshilli në anën tjetër, arsyetimin e vet për imunitet e mbështet edhe duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, KI33/16, të cekur më lart, ku Gjykata kishte deklaruar se Këshilli gëzon prerogativat e një *"gjykate"* në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së.

219. Gjykata vlerëson së Këshilli pretendon se anëtarët e tij duhet të gëzojnë imunitet pasi ata gëzojnë prerogativat e një *"gjykate"* dhe si të tillë duhet të kenë imunitet të njëjtë sikur gjyqtarët e gjykatave të rregullta.

220. Andaj, Gjykata do të vlerësojë, fillimisht, nëse anëtarët e Këshillit mund të gëzojnë me automatizëm imunitetin që gëzojnë gjyqtarët.

221. Gjykata rikujton se në rastin KI33/16, kishte deklaruar se Këshilli *"gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së"* dhe se *"gjykata" kategorizohet në kuptimin substancial të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë[...]"*.

222. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson që në rastin KI33/16, referimi tek neni 6 i KEDNJ-së është bërë me qëllim që të theksohet se vendimet e Këshillit janë *"përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme" dhe se Këshilli nga pikëpamja e nenit 6 është i pavarur pasi (a) që organi është i pavarur prej ekzekutivit dhe (b) ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që vendosen para tyre ashtu si kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së* (shih, *mutatis mutandis*, rastin KI33/16, *Minire Zeka,* cituar më lart, paragrafi 59. Në lidhje me pavarësinë e një *"tribunali të pavarur"* shih rastin KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, i 9 majit 2017, para.75).

223. Si rrjedhojë, rasti KI33/16, nuk mund të shfrytëzohet si bazë për ta kategorizuar Këshillin si një "gjykatë" në kuptim të asaj se çka tashmë e ka përcaktuar Kushtetuta në paragrafin 1 i nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] ku përcaktohet që *"pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat"*.

224. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se ekzistenca e faktorëve që i bëjnë të domosdoshme të drejtat e palëve në një procedurë të caktuar, nuk i japin me automatizëm privilegjet e një *"gjykate"* autoritetit/organit që është kompetent për ta zhvilluar atë procedurë administrative, përkatësisht Këshillit në rastin konkret.

225. Andaj, Gjykata thekson se bazuar në konstatimin që Këshilli nuk është një gjykatë në kuptim të nenit 102 të Kushtetutës, dhe në faktin që referimi tek "gjykata" dhe neni 6 i KEDNJ-së në rastin KI33/16, është bërë në mënyrë të kufizuar dhe vetëm për qëllim të dhënies së palëve një mbrojtje më të gjerë juridike pranë Këshillit dhe në raport me efektet juridike të vendimeve të Këshillit, anëtarët e Këshillit nuk mund të përfitojnë nga një status i tillë. Shfrytëzimi i precedentit në rastin KI33/16, me qëllim të rritjes së privilegjeve të statusit të

anëtarëve të Këshillit nuk është në kundërshtim me vet frymën e rastit në fjalë.

226. Argumenti i Këshillit që ai është një organ i pavarur sipas Kushtetutës nuk duhet ngatërruar me llojin e pavarësisë që bartë dhe u garantohet organeve të pushtetit gjyqësor, të cilat hyjnë në tërësinë e tyre në kornizat e nenit 6 të KEDNJ-së. Organe të pavarura të shkallës finale administrative, vendimet e të cilave janë subjekt i të njëjtave garancione procedurale për palët, janë të shumta, por ato nuk duhet ngatërruar me pushtetin gjyqësor dhe karakteristikat që e shoqërojnë një pushtet të tillë, në prizmin e lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

227. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se anëtarët e Këshillit nuk mund të konsiderohen "gjyqtarë" në kuptim të Kushtetutës dhe imuniteteve që gëzojnë gjyqtarët në bazë të nenit 107 të Kushtetutës.

228. Gjykata, në vazhdim, do të vlerësojë nëse neni 11, paragrafi 3 i Ligjit të kontestuar cenon dispozitat e Kushtetutës ashtu siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

229. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës ka përmendur nenet e Kushtetutës të cilët parashohin imunitetin për Presidentin e Republikës, deputetët e Kuvendit, anëtarët e Qeverisë, gjyqtarët e gjykatave të rregullta, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Avokatin e Popullit.

230. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nenet e Kushtetutës që përcaktojnë imunitet për zyrtarët e cekur më lart, e në të cilat është thirrur parashtruesi i kërkesës, nuk janë shteruese, në kuptimin që rregullojnë imunitet për zyrtarët e cekur më lart por nuk kufizojnë apo ndalojnë në mënyrë shprehimore që imunitetet për zyrtarët e tjerë të caktohen me ligje të veçanta. Kjo çështje nuk rregullohet as në nenin 101, paragrafi 2 të Kushtetutës që përcakton Këshillin si institucion për të mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil.

231. Praktika e dhënies së imunitetit përmes ligjit edhe pse Kushtetuta nuk e ka paraparë në mënyrë shprehimore një gjë të tillë, është e njohur edhe në vendet e tjera dhe dhënia e imunitetit në lidhje me disa institucione shtetërore është inkurajuar edhe nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si "Komisioni i Venecias". Komisioni i Venecias në "përmbledhjen e Komisionit të Venecias në lidhje me Institucionin e Avokatit të Popullit" ka vlerësuar ligjet e shteteve të ndryshme të cilat kanë paraparë imunitet funksional për

Avokatin e Popullit, zëvendësit e tij por edhe për stafin mbështetës të institucionit të Avokatit të Popullit.

232. Në lidhje me këtë, Komisioni i Venecias duke vlerësuar Ligjin e Armenisë për Avokatin e Popullit ka deklaruar se Avokati i Popullit dhe stafi mbështetës duhet të kenë imunitet nga proceset ligjore sa i përket fjalëve të shprehura apo të shkruara apo veprimeve të kryera nga ta në kapacitet zyrtar-imuniteti funksional (shih përmbledhjen e Komisionit të Venecias në lidhje me Institucionin e Avokatit të Popullit, CDL-PI (2016)001, të 5 shkurtit 2016, faqe 14).

233. Një vlerësim të ngjashëm për dhënien përmes ligjit të imunitetit jo vetëm për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij, por edhe për stafin mbështetës të këtyre institucioneve, Komisioni i Venecias e ka bërë edhe kur ka vlerësuar ligjet që kanë të bëjnë me institucionet e Avokatit të Popullit, të Moldavisë, Malit të Zi dhe Serbisë, të cilat jodomosdoshmërisht e kanë pasur imunitetin e rregulluar me Kushtetutë (shih përmbledhjen e Komisionit të Venecias në lidhje me Institucionin e Avokatit të Popullit, CDL-PI (2016)001, të 5 shkurtit 2016, faqe 14).

234. Dhënia e imunitetit përmes ligjeve është vlerësuar nga Komisioni i Venecias edhe në rast të imunitetit të prokurorëve (shih përmbledhjen e Opinioneve te Raporteve të lidhje me Prokurorët, CDL-PI (2018)001, të 11 nëntorit 2017).

235. Megjithatë, ajo që duhet të vlerësohet është nëse dhënia e imunitetit për anëtarët e Këshillit, cenon ndonjë nga të drejtat e parapara me Kushtetutë.

236. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se çështja e imunitetit të zyrtarëve publik ndërlidhet me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenim 6 të Konventës. Andaj, Gjykata u referohet dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, që përcaktojnë:

"Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të

arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar.*
[...]".

237. Gjykata thekson po ashtu se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës: *"të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

238. Në lidhje me imunitetet, GJEDNJ ka theksuar se imuniteti mund t'iu jepet disa kategorive të zyrtarëve shtetërorë dhe kjo mund të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Gryzanov v. Russia*, nr. 19673/03, Aktgjykim i 12 qershorit 2012.)

239. Gjykata thekson se, GJEDNJ ka konstatuar se neni 6, paragrafi 1 garanton "të drejtën në gjykatë", nga e cila "e drejta për qasje", kjo do të thotë, e drejta për të filluar procedurat para gjykatës për çështje civile, përbën një aspekt të saj, si pjesë thelbësore e të drejtës për një gjykim të drejtë. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute, dhe mund të kufizohet; këto kufizime janë të lejuara pasi e "drejta për qasje" për nga natyra e saj kërkon që kjo çështje të rregullohet nga shtetet. Në këtë aspekt shtetet gëzojnë një margjinë të vlerësimit, dhe vendimi përfundimtar për respektimin e kërkesave të së drejtës për një gjykim të drejtë i takon Gjykatës (shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 87/1997/871/1083, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, para. 147; shih rastin e GJEDNJ-së, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë,* nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 44).

240. Gjykata duhet të vlerësojë nëse kufizimet e aplikuara nuk e kufizojnë qasjen në gjykata për individët në atë mënyrë apo deri në atë masë që vet esenca e së drejtës të cenohet. Për më tepër, kufizimi nuk do të ishte në pajtueshmëri me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, nëse nuk

ndjek një qëllim objektiv dhe nëse nuk ka një raport të arsyeshëm të proporcionaliteti në mes të masës së ndërmarrë dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 87/1997/871/1083, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, para. 147; shih rastin e GJEDNJ-së, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë,* nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 44).

241. Rrjedhimisht, Gjykata në rastin konkret do të vlerësojë nëse imuniteti i paraparë për anëtarët e Këshillit sipas Ligjit të kontestuar, (i) ndjek një qëllim legjitim, dhe (ii) është proporcional në kuptimin që aplikantët kanë alternativë të arsyeshme të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre sipas vendimeve të Këshillit.

242. Gjykata rikujton se imuniteti i anëtarëve të Këshillit sipas nenit 11, paragrafi 3 të Ligjit të kontestuar u ofron imunitet lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore në lidhje me të cilat anëtarët e Këshillit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.

243. Pra, imuniteti për anëtarët e Këshillit është imunitet funksional, ashtu si është sqaruar nga Gjykata edhe në rastin KO98/11, në lidhje me imunitetin e Presidentit, deputetëve dhe anëtarëve të Qeverisë, që nënkupton se anëtarët e Këshillit lirohen nga përgjegjësia për çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si anëtarë të Këshillit dhe veprimet e tjera të ndërmarra gjatë kohës që janë duke kryer detyrat e tyre. Ky lloj imuniteti vazhdon edhe pasi mandati i tyre të mbarojë dhe ka kohëzgjatje të pakufizuar. Ata nuk do të jenë të detyruar t'i përgjigjen askujt apo ndonjë gjykate për veprime dhe vendime të tilla (shih, rastin KO98/11, cituar më lart, paragrafi 54).

244. Megjithatë, imuniteti funksional që u garantohet anëtarëve të Këshillit sipas Ligjit të kontestuar është i limituar dhe ata nuk kanë mbrojtje të posaçme për veprimet jashtë atij fushëveprimi të tyre si anëtarë të Këshillit, apo nëse ata akuzohen për vepra penale, që nuk ndërlidhen thjesht me faktin që ata kanë ushtruar funksionet e tyre që ndërlidhen me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre. Ata gjithashtu nuk kanë imunitet as nga arrestimi.

245. Gjykata vëren se, Ligji i kontestuar nuk parasheh imunitet tjetër për anëtarët e Këshillit, përveç imunitetit funksional që u sqarua më lart, e që ka të bëjë me paprekshmëri për veprimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Këshillit. Andaj, në cilësinë e tyre si

qytetarë të rëndomtë, anëtarët e Këshillit trajtohen njëlloj si të gjithë qytetarët e tjerë.

246. Në lidhje me qëllimin që dëshirohet të arrihet me imunitetin Gjykata gjithashtu rikujton Aktgjykimin e saj në rastin KO98/11, dhe me anë të të cilit Gjykata ka theksuar se *"[...] ata që e zbatojnë pushtetin dhe që i ushtrojnë detyrat në shtet gëzojnë imunitet dhe status të posaçëm për ta siguruar pavarësinë e tyre në mënyrë që të mund ta kryejnë detyrën e tyre me efikasitet për të siguruar që pushtetet e tjera pengohen për të ndërhyrë në punën e tyre për të ndaluar abuzimin"* (shih rastin KO98/11, cituar më lart, paragrafi 47).

247. Rrjedhimisht, edhe në rastin konkret Gjykata vlerëson se qëllimi i imunitetit është që anëtarët e Këshillit të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre, andaj imuniteti i shërben këtij qëllimi dhe Gjykata konsideron se është legjitim.

248. Në lidhje me këtë, GJEDNJ, në rastin G*ryaznov kundër Rusisë,* kishte elaboruar që imuniteti është në të mirën e publikut, në interesin e të cilëve është që gjyqtarët të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave, ndërsa palët ndërgjyqëse të mund të mbrojnë veten nga gabimet gjyqësore duke pasur mundësi të dërgojnë ankesat e tyre në një gjykatë të apelit pa u drejtuar në paditë për përgjegjësi personale (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, G*ryaznov kundër Rusisë*, nr. 19673/03 Aktgjykim i 12 qershorit 2012, paragrafi 78).

249. Andaj, ajo që është e rëndësishme është nëse palët kanë të drejtë, të përdorin mjete juridike, ndaj vendimeve të Këshillit pa pasur nevojë që të ngrisin përgjegjësinë personale.

250. Në lidhje me këtë Gjykata rikujton nenin 22 [Inicimi i konfliktit administrative] të Ligjit të kontestuar, që përcakton se *"Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ"*.

251. Andaj, palët e pakënaqura kanë alternativë të arsyeshme dhe mund të realizojnë të drejtat e tyre ndaj vendimeve të Këshillit duke hapur konflikt administrativ para gjykatave për të mbrojtur të drejtat e tyre.

252. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh imunitetin e limituar që u garantohet anëtarëve të Këshillit përmes nenit 11, paragrafi 3 të Ligjit

të kontestuar, si dhe faktin që ndaj vendimeve të Këshillit palët kanë të drejtë të hapin konflikt administrativ, Gjykata vlerëson se masa e përdorur është proporcionale me qëllimin që dëshirohet të arrihet pasi palët e interesuara kanë mundësi të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre ndaj vendimeve të Këshillit duke hapur konflikt administrativ.

253. Prandaj, Gjykata gjen se neni 11, paragrafi 3 i Ligjit të kontestuar, është në përputhshmëri me të drejtën për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht ky nen është në përputhshmëri me Kushtetutën.

Kërkesa për masë të përkohshme

254. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, gjegjësisht pezullimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit të kontestuar *"ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport me Avokatin e Popullit",* deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate.

255. Duke pasur parasysh se Gjykata ka vendosur për meritat e rastit, nuk e konsideron të nevojshme që ta shqyrtojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për miratimin e masës së përkohshme.

Përfundim

256. Duke marrë parasysh dhe duke iu referuar arsyeve të shtjelluara më lartë, Gjykata, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për tejkalimin e fushëveprimit të ngushtë të Këshillit, të përcaktuar me Kapitullin VI (Qeveria e Republikës së Kosovës) të Kushtetutës, konkludon se:

   i. neni 2 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, neni 2 i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil], paragrafin 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe i njëjti duhet të interpretohet nga të gjitha autoritetet publike në pajtim me interpretimin e paraqitur në këtë Aktgjykim.

257. Gjykata, përkitazi me vlerësimi e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar në lidhje me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera publike, konkludon se:

ii. gjatë zbatimit të Ligjit të kontestuar duhet të njihen funksionet dhe autoriteti specifik i institucioneve të pavarura kushtetuese që reflektohet, *inter alia,* në nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligje të veçanta, deri në masën e nevojshme, për të mbrojtur pavarësinë e tyre organizative, funksionale dhe buxhetore, duke përfshirë specifikat e punës së personelit të tyre

iii. neni 3, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar nuk kufizojnë dhe cenojnë esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht dispozitat në fjalë janë në përputhshmëri me Kushtetutën,

iv. neni 4, paragrafi 1, në ndërlidhje me nenin 3.1, nënparagrafi 1.1. të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kapitullin XII të Kushtetutës,

v. neni 6, paragrafi 1.2 i Ligjit të kontestuar në lidhje me kompetencën e Këshillit për të vendosur nëse emërimi i shërbyesve civil të nivelit të lartë drejtues dhe në rastet kur nuk ekziston një *"konflikt"* paraqet trajtim të pabarabartë të nëpunësve civil, nuk është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës,

vi. neni 7, paragrafi 1, nënparagrafët, 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar nuk kufizojnë dhe cenojnë esencën e ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht dispozitat në fjalë janë në përputhshmëri me Kushtetutën,

vii. neni 18, i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht dispozitat në fjalë janë në përputhshmëri me Kushtetutën,

viii. neni 19, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar, pasi që rregullojnë çështjen e vendimit detyrues lidhur me përzgjedhjen e një kategorie të nëpunësve civil, edhe në rastet kur nuk ekziston një *"konflikt",* po ashtu nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës,

ix. neni 20, paragrafi 5 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht neni në fjalë është në përputhshmëri me Kushtetutën,

x. neni 21 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht të njëjtat janë në përputhshmëri me Kushtetutën,

xi. neni 22 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht dispozitat në fjalë janë në përputhshmëri me Kushtetutën,

xii. neni 23 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht dispozitat ne fjalë janë në përputhshmëri me Kushtetutën,
xiii. neni 24 i Ligjit të kontestuar nuk kufizon dhe cenon esencën e ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht dispozitat ne fjalë janë në përputhshmëri me Kushtetutën,
xiv. neni 25, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit të kontestuar nuk kufizojnë dhe cenojnë esencën ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht të njëjtat janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

258. Gjykata, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për imunitetet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, lidhur me kryerjen e funksioneve të Këshillit, konkludon se:

xv. neni 11, paragrafi 3 i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me të drejtën për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht neni në fjalë është në përputhshmëri me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe me rregullat 56, 57 dhe 59 të Rregullores së punës, më 25 prill 2019

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, njëzëri, që neni 4 (paragrafi 1) në lidhje me nenin 3 (paragrafi 1.1), neni 6 (paragrafi 1.2) dhe neni 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën;

III. VENDOS, njëzëri, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, që nenet 3 (paragrafi 1.1), 4 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.2), dhe 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, janë të pavlefshme nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi;

IV. TË KONSTATOJË, njëzëri, që nenet 2, 3 (paragrafi 1.2, 1.3, 1.4), 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 18, 20 (paragrafi

5), 21, 22, 23, dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë në pajtueshmëri me Kushtetutën;

V. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, që nenet 11 (paragrafi 3) dhe 24 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, janë në pajtueshmëri me Kushtetutën;

VI. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

VIII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Arta Rama-Hajrizi

KO43/19, Parashtrues: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë

KO43/19, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, publikuar më 27 qershor 2019

Fjalët kyçe: kërkesë institucionale, kompetencat e Kuvendit, kompetencat e Qeverisë dhe kompetencat e Kryeministrit, ndarja e pushtetit, vlerat demokratike dhe të sundimit të ligjit

Kërkesa ishte parashtruar nga tridhjetë e dy (32) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 113 paragrafi 5 i Kushtetutës. Objekt i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 1, 2, 4, 10 (paragrafi 4 nën-paragrafët 1 dhe 2) dhe 11 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë (Ligji i kontestuar). Parashtruesit e kërkesës pretenduan se Ligji i kontestuar, në tërësi, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën, përkatësisht se nuk është në pajtueshmëri me nenin 2 [Sovraniteti], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], nenin 20 [Bartja e Sovranitetit], nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe nenin 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës.

Në kuadër të Ligjit të kontestuar ishte paraparë themelimi i delegacionit shtetëror, fushëveprimi i tij, si dhe ishte përcaktuar hierarkia institucionale dhe procedura vendimmarrëse në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Më tej me këtë Ligj, ishte rregulluar dhe funksionimi i delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën e Serbisë, dhe për të njëjtin ishte paraparë struktura organizative, veprimtaria, si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e delegacionit shtetëror.

Parashtruesit e kërkesës në thelb para Gjykatës kishin tri pretendime kryesore: *(i) përcaktimi dhe ndryshimi i hierarkisë institucionale kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë; (ii) kompetencat ligjore të delegacionit shtetëror ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ, si dhe (iii) dhënia e karakterit lex specialis Ligjit të kontestuar*. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkuan dhe vendosjen e masës së përkohshme.

Gjykata vlerësoi se kërkesa e parashtruesve është e pranueshme në bazë të kritereve të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe

Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese. Në shtjellimin e meritave të kërkesës, Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës rreth: *(i) përcaktimi dhe ndryshimi i hierarkisë institucionale kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë,* dhe *(ii) kompetencat ligjore të delegacionit shtetëror ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ,* dhe gjeti si në vijim:

Gjykata konstatoi, se delegacioni shtetëror i cili është themeluar me Ligjin e kontestuar, nuk është i paraparë me Kushtetutë, dhe nuk është i paraparë brenda formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit. Si i tillë, delegacioni shtetëror, nuk mund të përfshihet në ndërveprimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit të pushteteve dhe nuk mund të ndërhyjë në formën e qeverisjes, gjegjësisht strukturën e ndarjes së pushtetit sikurse është e përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës.

Më tej, Gjykata konstatoi se bartja e kompetencave të institucioneve kushtetuese tek "mekanizmi i posaçëm" i krijuar me Ligjin e kontestuar, është ndërhyrje në ushtrimin e kompetencave të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë. Bartja e kompetencave tek "mekanizimi i posaçëm", paraqet ndërhyrje në formën e qeverisjes, ndarjen e pushtetit, si dhe nuk është në pajtim me vlerat demokratike dhe të sundimit të ligjit, siç janë të përcaktuara me nenin 7 të Kushtetutës, sepse i mvesh Delegacionit shtetëror funksione të cilat nuk përkojnë me normat kushtetuese.

Gjykata po ashtu konstatoi se me normat kushtetuese, në mënyrë shprehimore është paraparë obligimi lidhur me ushtrimin e kompetencave kushtetuese në sferën e politikës së jashtme për institucionet kompetente. Kompetenca për të dialoguar me një shtet të tretë, nuk mund të bartet tek delegacioni shtetëror si "mekanizëm i posaçëm" përmes një akti më të ulët juridik, siç është Ligji i kontestuar.

Me tutje, Gjykata konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar ta mbikëqyrë politikën e jashtme në kuadër të kompetencave kushtetuese të parapara sipas paragrafit 12 të nenit 65 të Kushtetutës. Gjykata po ashtu theksoi se paragrafi 1, i nenit 93 të Kushtetutës i përcakton kompetencat e Qeverisë në "*propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit", si dhe* paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94, përcaktojnë se Kryeministri si i pari i Qeverisë "*Përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë"* si dhe *"Këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit"*.

Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se përfaqësimi në sferën e politikës së jashtme është detyrë e institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo kompetence është e përcaktuar me Kushtetutë, dhe nënkupton, para së gjithash, që çdo negocim apo veprim tjetër që ka të bëjë me lidhjen e

marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës, duhet të jetë brenda detyrimeve kushtetuese që kanë institucionet e Republikës së Kosovës. Gjykata po ashtu konkludoi se kompetenca për arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, nuk mund të bartet ose transferohet nga institucionet kushtetuese në një "mekanizëm të posaçëm" siç parashihet me Ligjin e kontestuar.

Gjykata njëzëri, vendosi që nenet 1 (paragrafi 1), 2, 4, 10 (paragrafi 4, nën-paragrafët 1 dhe 2), dhe neni 11 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, nuk janë në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafin 12 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1, të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se, meqë nenet thelbësore të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, i njëjti, në tërësinë e tij, është i papajtueshëm me Kushtetutën.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO43/19

Parashtrues

Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Avdullah Hoti, Glauk Konjufca, Vjosa Osmani-Sadriu, Albulena Haxhiu, Ismet Beqiri, Saranda Bogujevci, Lumir Abdixhiku, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Arbër Rexhaj, Doruntina Maloku, Ali Lajçi, Arben Gashi, Drita Millaku, Hykmete Bajrami, Xhelal Sveçla, Lutfi Zharku, Ismajl Kurteshi, Besa Gaxheri, Fitore Pacolli, Arban Abrashi, Shemsi Syla, Lirije Kajtazi, Valon Ramadani, Kujtim Shala, Salih Zyba, Haxhi Avdyli, Liburn Aliu, Mirjeta Kalludra, Albin Kurti, Driton Selmanaj dhe Anton Quni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputetët e Kuvendit, Albulena Haxhiu dhe Driton Selmanaj, që t'i përfaqësojë ata në

procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë në mënyrë specifike nenet 1, 2, 4, 10 (paragrafi 4 nën-paragrafët 1 dhe 2) dhe 11 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar), të miratuar nga Kuvendi më 7 mars 2019.

4. Parashtruesit e kërkesës, shpjegojnë se nenet e lartcekura nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, dhe për shkak të papajtueshmërisë së këtyre neneve me Kushtetutën, Ligji i kontestuar në tërësi, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, i cili pretendohet se në tërësi, nuk është në pajtueshmëri me nenin 2 [Sovraniteti], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], nenin 20 [Bartja e Sovranitetit], neni 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe nenin 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

6. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, kërkojnë vënien e masës së përkohshme, me arsyetimin që *"Zbatimi i Ligjit të kontestuar do të krijonte precedent të rrezikshëm në raport me parimin e ndarjes së pushteteve, sepse do të lejonte një trup antikushtetues të ndërhyjë në kompetencat e Kuvendit dhe të Qeverisë [...]"*.

7. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.

Baza juridike

8. Kërkesa bazohet në paragrafin 5, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, dhe në nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) si dhe në rregullat 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] dhe 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të

Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

9. Më 15 mars 2019, parashtruesit e kërkesës parashtruan në Gjykatë kërkesën me dokumentet e bashkëlidhura.

10. Më 15 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues: të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtar).

11. Më 18 mars 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

12. Më 18 mars 2019, Gjykata njoftoi Presidentin e Republikës së Kosovës, për regjistrimin e kërkesës duke i përkujtuar se, në pajtueshmëri me paragrafin 2, të nenit 43 [Afatet] të Ligjit, Ligji i kontestuar nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte ligjore, përderisa Gjykata përfundimisht të vendosë lidhur me çështjen e ngritur para saj. Gjykata gjithashtu kërkoi nga Presidenti që t'ia paraqet Gjykatës komentet e tij, nëse ka, deri më datën 1 prill 2019.

13. Më 18 mars 2019, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Kryetari i Kuvendit të Republikës Kosovës, që t'ia ofrojë një kopje të këtij njoftimi secilit deputet të Kuvendit, ashtu që atyre t'u mundësohet t'ia paraqesin Gjykatës komentet e tyre, nëse kanë, për kërkesën e lartpërmendur deri më datën 1 prill 2019.

14. Më 18 mars 2019, Gjykata njoftoi Kryeministrin e Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi nga ai që t'ia paraqet Gjykatës komentet e tij, nëse ka, deri më datën 1 prill 2019.

15. Më 18 mars 2019, Gjykata njoftoi Sekretariatin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga ai që jo më vonë se me datën 1 prill 2019, të dorëzonte në Gjykatë të gjithë dokumentacionin relevant lidhur me kërkesën.

16. Më 27 mars 2019, Sekretariati i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumentet si në vijim:

a) Procesverbalin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, shqyrtimi në parim i Ligjit të kontestuar;
b) Raportin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, shqyrtimi në parim i Ligjit të kontestuar;
c) Ftesën dhe rendin e ditës për Seancën plenare të Kuvendit të Republikës se Kosovës, shqyrtimi i parë i Ligjit të kontestuar;
d) Transkriptin e Seancës Plenare, shqyrtimi i parë i Ligjit të kontestuar, të 2 dhe 3 shkurtit 2019;
e) Procesverbali i Seancës Plenare, shqyrtimi i parë i Ligjit të kontestuar, të 2 dhe 3 shkurtit 2019;
f) Vendimi i Kuvendit për miratimin në parim të Ligjit të kontestuar, i 12 shkurtit 2019;
g) Kërkesën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për mbajtjen e Seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 7 mars 2019, ora 10:00, shqyrtimi i dytë i Ligjit të kontestuar;
h) Ftesën dhe rendin e ditës për Seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës se Kosovës, shqyrtimi i dytë i Ligjit të kontestuar i 7 marsit 2019;
i) Procesverbali i Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, shqyrtimi i Ligjit të kontestuar, i 6 marsit 2019;
j) Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, proceduar për shqyrtim në komisionet e përhershme, më 6 mars 2019;
k) Procesverbalin e Komisionit funksional për Integrime Evropiane, shqyrtimi i Ligjit të kontestuar, i 6 marsit 2019;
l) Raportin e Komisionit për Integrime Evropiane, i 6 marsit 2019;
m) Procesverbali i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtimi i Ligjit të kontestuar, i 6 marsit 2019;
n) Raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, i 6 marsit 2019;
o) Procesverbalin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimi i Ligjit të kontestuar, i 6 marsit 2019;
p) Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i 6 marsit 2019;
q) Procesverbalin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtimi i Ligjit të kontestuar, i 6 marsit 2019;

r) Raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i 7 marsit 2019;
s) Procesverbalin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, shqyrtimi i raportit final i Ligjit të kontestuar, i 6 marsit 2019;
t) Raportin final me amendamente i Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, i proceduar për shqyrtim në seancë plenare, i 7 marsit 2019;
u) Transkriptin e Seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit, shqyrtimi i dytë i Ligjit të kontestuar, i 7 marsit 2019;
v) Vendimi i Kuvendit për miratimin e Ligjit të kontestuar, i 7 marsit 2019;
w) Ligjin e kontestuar, Ligji nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë.

17. Në afatin e dhënë nga Gjykata, Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe deputetët nuk dorëzuan komente pranë Gjykatës.

18. Më 13 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

19. Më 13 qershor 2019, Gjykata votoi për pranueshmërinë e kërkesës, dhe njëzëri vendosi se Ligji i kontestuar, në tërësi, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 24 dhjetor 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Vendimit nr. 02/81, miratoi Ligjin (projektligjin) e kontestuar, duke e dërguar në Kuvend, me qëllim që i njëjti të shqyrtohet dhe miratohet sipas procedurës së përcaktuar.

21. Më 30 janar 2019, Komisioni Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike i Kuvendit shqyrtoi, dhe e miratoi në parim Ligjin e kontestuar, me 6 (gjashtë) vota për dhe 3 (tri) vota kundër. Po të njëjtën ditë, Komisioni Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike konstatoi që Ligji i kontestuar, i plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

22. Më 2 shkurt 2019, Kuvendi në seancën e mbajtur, miratoi Ligjin e kontestuar në parim në lexim të parë, ku të pranishëm ishin 61 (gjashtëdhjetë e një) deputetë dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) deputetë votuan për, nuk pati votë kundër dhe as abstenime.

23. Më 2 shkurt 2019, Kuvendi përmes Vendimit nr. 06-V-315 pas miratimit në parim në lexim të parë të Ligjit të kontestuar, i ngarkoi dhe i obligoi që të paraqesin raporte me rekomandime për shqyrtim të Ligjit të kontestuar, Komisionet si në vijim:

    1. Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike;
    2. Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
    3. Komisioni për Buxhet dhe Financa;
    4. Komisioni për të Drejtat dhe interesat e Komuniteteve dhe Kthim; dhe
    5. Komisioni për Integrime Evropiane.

24. Më 6 mars 2019, Kryeministri i Republikës së Kosovës, përmes shkresës me nr. 2345/2019, kërkoi nga Kryetari i Kuvendit mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për shqyrtimin e dytë të Ligjit të kontestuar.

25. Më 6 mars 2019, Komisioni Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, në mbledhjen e mbajtur, i shqyrtoi dhe miratoi dy amendamentet e propozuara në Ligjin e kontestuar.

26. Më 6 mars 2019, Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, e shqyrtoi Ligjin e kontestuar, me amendamentet e propozuara dhe vlerësoi se Ligji i kontestuar dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe mund të procedohen në Kuvend.

27. Më 6 mars 2019, Komisioni për Integrime Evropiane, në mbledhjen e mbajtur, shqyrtoi Ligjin e kontestuar dhe rekomandimet e Komisionit Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike dhe vlerësoi që "*Projektligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.*"

28. Më 6 mars 2019, Komisioni për Buxhet dhe Financa, shqyrtoi Ligjin e kontestuar, me amendamentet e propozuara dhe vlerësoi se Ligji i kontestuar dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore shtesë.

29. Më 7 mars 2019, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, shqyrtoi Ligjin e kontestuar, me amendamentet e propozuara dhe vlerësoi se të njëjtat nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandoi që Ligji i kontestuar të procedohet në Kuvend.

30. Më 7 mars 2019, Komisioni Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, në mbledhjen e mbajtur, miratoi raportin me rekomandime nga Komisionet e lartcekura për Ligjin e kontestuar. Po të njëjtën ditë, Komisioni Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e përcolli raportin me rekomandime te deputetët e Kuvendit.

31. Më 7 mars 2019, Kuvendi në seancën e mbajtur, miratoi Ligjin e kontestuar në lexim të dytë, ku votuan gjithsej 61 (gjashtëdhjetë e një) deputetë nga të cilët 58 (pesëdhjetë e tetë) deputetë votuan për, ndërsa 3 (tre) deputetë abstenuan.

32. Rrjedhimisht, më 7 mars 2019, Kuvendi përmes Vendimit nr. 06-V-336, miratoi Ligjin e kontestuar dhe vendosi që Ligji i kontestuar t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dekretim dhe shpallje.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

33. Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesve të kërkesës se Ligji i kontestuar, në tërësi, nuk është në pajtueshmëri me nenin 2 [Sovraniteti], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], nenin 20 [Bartja e sovranitetit], nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë], nenin 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës.

34. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "*Projektligji përmban një numër shkeljesh kushtetuese bazuar në pikat si në vazhdim:*

    1. *Përcaktimi dhe ndryshimi i hierarkisë institucionale kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë;*
    2. *Kompetencat ligjore të Delegacionit shtetërorë ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ;*
    3. *Projektligji për Detyrat, Përgjegjësitë Dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë i është dhënë karakter lex*

specialis me qëllim që dispozitat e këtij Projektligji të mbivendosin në rast kolizioni me ligje të tjera."

(i) Argumentet e parashtruesve të kërkesës sa i përket "*përcaktimit dhe ndryshimit të hierarkisë institucionale kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë*"

35. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se një numër i dispozitave të Ligjit të kontestuar, *"cenojnë rëndë hierarkinë institucionale të paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe në veçanti, kompetencat e parapara qartë për këto institucione."*

36. Parashtruesit e kërkesës duke iu referuar nenit 1 [Fushëveprimi i ligjit], nenit 2 [Synimi dhe qëllimi], nenit 4 [Procedura për ngritjen e Delegacionit Shtetërorë], nenit 10.4 [Kompetencat e Delegacionit Shtetëror] dhe paragrafit 3, të nenit 11 [Raporti i Delegacionit Shtetëror me Institucionet Kushtetuese] të Ligjit të kontestuar pretendojnë se *"[...] ushtrimi i sovranitetit popullor, është autorizim eksplicit për përfaqësuesit e popullit, që një sistem parlamentar sikurse ky i Republikës së Kosovës, materializohet në institucionin e Kuvendit të Kosovës. Projektligji siç mund të konstatohet përmes një leximi të kujdesshëm të qëllimit të tij, ka për qëllim që mandatin e Kuvendit si ushtrues (përfaqësues) i sovranitetit popullor ta tjetërsojë duke ia bartur atë delegacionit Shtetëror, dhe, në të njëjtën kohë, t'i hapë rrugë të ashtuquajturave 'institucione tjera kushtetuese' që të ndërhyjnë edhe më tutje në eksluzivitetin e Kuvendit për ta formësuar vullnetin politik në raport me atë çfarë mund dhe nuk mund të negociohet në Dialogun me Serbinë".*

37. Parashtruesit e kërkesës më tutje pretendojnë se "*Kushtetuta, pra ka qartësuar hierarkinë institucionale, duke paraparë Kuvendin si pushtetin më të lartë përfaqësues e legjislativ, i cili, ndër të tjera, përcakton orientimet e politikës së jashtme (nëpërmjet ligjeve që miraton) dhe mbikëqyrë atë politikë nëpërmjet instrumenteve të kontrollit mbikëqyrës parlamentar mbi ekzekutivin, pra Qeverinë, e cila ndërton dhe zbaton politikën e jashtme. Të autorizosh 'Delegacionin', si një trup jokushtetues, që të negociojë dhe të arrijë Marrëveshje me Serbinë, e cila, sipas deklaratave publike mund të prekë edhe çështje të sovranitetit, integritetit territorial, paqes e çështje të tjera politike, jashtë përcaktimit të asaj çfarë duhet të konsiderohet të jetë formësim i vullnetit politik të sovranit që është prerogativë esenciale kushtetutbërëse e Kuvendit, është në kundërshtim të hapur me nenin 65 të Kushtetutës."*

38. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"Duke vendosur Delegacionin shtetëror mbi Kuvendin dhe Qeverinë, ky projektligj cenon balancin dhe kontrollin e pushteteve dhe i jep këtij trupi jokushtetues të drejtën që të kontrollojë veprimet e Qeverisë e Kuvendit në raport me shtetet e tjera si dhe të përfaqësojë mënyrën e përfaqësimin në kundërshtim me Kushtetutën."*

39. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se *"Kushtetuta e Kosovës, lejon bartjen e kompetencave shtetërore tek organizatat ndërkombëtare vetëm në përputhje me nenin 20, atëherë kur kjo bëhet nëpërmjet ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Pra, asnjë dispozitë kushtetuese nuk lejon bartjen e kompetencave te trupa të ri të krijuar me një shumicë të thjeshtë në Kuvend."*

(ii) Argumentet e parashtruesve të kërkesës sa i përket pretendimit lidhur me "*Kompetencat ligjore të Delegacionit shtetëror ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ*"

40. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se "*Neni 93 par. 1 i Kushtetutës përcakton si kompetencë të parë të pushtetit ekzekutiv (qeverisë) propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme". Qeveria e Republikës së Kosovës ka kompetencë të parë për nga rëndësia dhe ekskluzive për nga natyra, propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme. [...] Konkretizimin e nenit 93, par 1 të Kushtetutës së Kosovës e përcakton nenin 4 i Ligjit nr. 04/L-052, i cili thekson se të drejtën e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare e kanë organet shtetërore të Republikës së Kosovës në përputhje me Kushtetutën [...]."*

41. Parashtruesit e kërkesës më tutje pohojnë se *"Meqenëse, neni 94, par 1 përcakton se qeveria përfaqësohet dhe udhëhiqet nga Kryeministri i Kosovës, dialogu me Serbinë duhet të drejtohet nga përfaqësuesi dhe udhëheqësi i Qeverisë së Republikës së Kosovës". Në këtë kuptim, Kuvendi i Kosovës me miratimin e këtij Projektligj i ka dhënë delegacionit shtetëror kompetenca për të drejtuar dhe përfaqësuar shtetin në dialog (negociata) me Serbinë, duke cenuar rëndë nenin 4, par 1 dhe 4 lidhur me nenin 7, si dhe nenin 93, par 1 lidhur me nenin 94, par.1 të Kushtetutës së Kosovës."*

(iii) Argumentet e parashtruesve të kërkesës sa i përket pretendimit që Ligjit të kontestuar "*i është dhënë karakter lex specialis me qëllim që dispozitat e këtij Projektligji të mbivendosen në rast kolizioni me ligje të tjera*"

42. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "*paragrafi 5 i nenit 18, i cili përcakton parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj. Në kuptimin ekstenziv të nenit 18 dhe konkretisht në kuptim të neni 18, par.5 buron Ligji nr. nr. 04/L-052 për marrëveshjet Ndërkombëtare. [...] Qëllimi i Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare dhe shumica e shprehjeve të këtij ligji, nga neni 18 i Kushtetutës e bën ligjin tërësisht burimor të dalur nga fryma e nenit 18 të Kushtetutës dhe njëkohësisht e bën ligj të përgjithshëm i cili nuk mundet në asnjë mënyrë të dërgohet me ligj special siç parashihet në nenin 1, par 2 të projektligjit që është objekt kontesti [...].*"

43. Parashtruesit e kërkesës i referohen Aktgjykimit KO97/12, të 12 prillit 2012, të Gjykatës, të parashtruar nga Avokati i Popullit, ku ishte kontestuar Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nr. 04/L-093. Parashtruesit e kërkesës theksojnë paragrafin 128 të theksohet "*Gjykata është e vetëdijshme për ekzistencën e parimit lex specialis, që nënkupton që ligji special ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm dhe, në këtë drejtim, një ligj i ri nuk mund t'i anulojë dispozitat e një ligji ekzistues pa ndryshuar dispozitat relevante, të cilat përbëjnë parimet e përgjithshme sepse kjo do të vinte në rrezik parimin e sigurisë juridike dhe sundimin e ligjit.*"

Sa i përket kërkesës për masë të përkohshme

44. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme duke potencuar tri arsye: "*në mënyrë që të parandalohet zbatimi i Projektligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror, nëpërmjet të cilit tentohet të barten dhe transferohen kompetenca të padelegueshme kushtetuese; së dyti, për shkak se nëpërmjet masës së përkohshme do të parandihej zbatimi i këtij projektligji i cili shkelë parimin e ndarjes së pushteteve dhe privon Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës nga ushtrimi i të drejtave të veta kushtetuese; së treti, për shkak se nëpërmjet këtij Projektligji cenohet rendi kushtetues dhe hierarkia institucionale e Republikës së Kosovës; si dhe së fundi, sepse ky delegacion, nëpërmjet vendimeve që do të merrte dhe marrëveshjeve që do të arrinte me Republikën e Serbisë, do të mund të krijonte pasoja të paripërueshme nëpërmjet obligimeve ndërkombëtare për Kosovën.*"

Zgjidhja e kërkuar

45. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:

I. Të shpallë të pranueshme këtë kërkesë;
II. Të vendosë menjëherë masën e përkohshme mbi Projektligjin;
III. Të shpallë Projektligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës s ë Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
[...].

Dispozitat relevante juridike

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Nenit 2
[Sovraniteti]

"1.Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

Neni 4
[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

Neni 7
[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit,

mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

Neni 18
[Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore;
(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.
2.Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.
4. Amendamentimi ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendimmarrjes sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.
5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.

Neni 20
[Bartja e Sovranitetit]

1.Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare.
2.Nëse një marrëveshje anëtarësimi e ratifikuar nga Republika e Kosovës për pjesëmarrje në një organizatë ndërkombëtare në mënyrë eksplicite kërkon zbatim të drejtpërdrejtë të normave të kësaj organizate, ligji me të cilin ratifikohet marrëveshja e anëtarësisë miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe ato norma kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

[...]

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:
(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

[...]

(12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;

Neni 93
[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

(1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
[...]

Neni 94
[Kompetencat e Kryeministrit]

Kryeministri ka këto kompetenca:

(1) përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë;
[...]
(9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;

Dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar

Neni 1
Fushëveprimi i ligjit

1.Ky ligj përcakton hierarkinë institucionale dhe procedurën vendimmarrëse në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: dialogu).Po ashtu, rregullon funksionimin e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë (në tekstin e mëtejmë: delegacioni shtetëror), duke përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e delegacionit shtetëror. Mes të tjerash, ligji definon qartë edhe ndërlidhjen që delegacioni shtetëror mban me institucionet tjera kushtetuese të Republikës së Kosovës.

2. Ky ligj e ka statusin e Lex Specialis. Në rast të kolizionit të ndonjë dispozite tjetër ligjore me këtë ligj do të mbizotërojnë nenet e këtij ligji.

Neni 2
Synimi dhe qëllimi

Në pajtim me këtë ligj, Delegacioni Shtetëror i Republikës së Kosovës për Dialogun me Republikën e Serbisë autorizohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për negociim dhe arritje të marrëveshjeve gjatë procesit të Dialogut, në konsultim me Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Neni 4
Procedura për ngritjen e Delegacionit Shtetëror

Delegacionit Shtetëror për dialogun me Republikën e Kosovës do të mandatohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Delegacioni Shtetëror do të jetë organ i vetëm i autorizuar për ta drejtuar Dialogun. Në këtë drejtim Delegacioni konsultohet me Institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Neni 10
Kompetencat e Delegacionit Shtetëror

4. Delegacioni Shtetëror:
4.1. Drejton Dialogun me Serbinë;
4.2. Përfaqëson Republikën Kosovës në Dialog;

Neni 11

Raporti i Delegacionit Shtetëror me Institucionet Kushtetuese

3.Çfarëdo veprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me Republikën e Serbisë duhet të bashkërendohen dhe të miratohen dyanshëm në mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Delegacionit shtetëror.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 të Kushtetutës, që përcakton se *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

48. Përkitazi me këto kritere, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur kërkesën e tyre në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, që parasheh si në vijim:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur."*

49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është ngritur nga 32 (tridhjetë e dy) deputetë të Kuvendit të Kosovës, që është më shumë se minimumi i kërkuar me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, është plotësuar kriteri për palë të autorizuar.

50. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit që rregullon parashtrimin e kërkesës në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës dhe i cili kërkon që të paraqiten informatat e mëposhtme:

> *"1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
> *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti."*

51. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"[...]*
>
> *(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:*
>
> > *(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe

(c) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.

(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës."

52. Gjykata konstaton që përveç emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve që kanë parashtruar kërkesën, ata kanë cekur edhe Ligjin e kontestuar dhe dispozitat relevante të Kushtetutës, si dhe paraqitën prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar.

53. Sa i përket afatit kohor, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar, është miratuar nga Kuvendi më 7 mars 2019 (Vendimi nr. 06-V-336), ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 15 mars 2019.

54. Marrë parasysh rregullin 30 (1) të Rregullores së punës, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës, llogaritet si në vijim: "*kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasuese pasi kishte ndodhur një ngjarje"*. Nisur nga kjo, Gjykata konstaton që kërkesa është parashtruar brenda afatit të paraparë kushtetues prej 8 (tetë) ditësh.

55. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës dhe njëkohësisht pretendimet e parashtruesve të kërkesës ngrehin çështje të rëndësishme të kushtetutshmërisë të cilat kërkojnë trajtim në merita të kërkesës.

Meritat

56. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë vetëm aspektin përmbajtjesor të Ligjit të kontestuar dhe jo procedurën e ndjekur gjatë miratimit të tij.

57. Gjykata vëren që Ligji i kontestuar përmban 19 (nëntëmbëdhjetë) nene, është i ndarë në katër krerë, në të rregullohet fushëveprimtaria; procedura për ngritjen e delegacionit shtetëror; përbërja e delegacionit shtetëror; themelimi i komisioneve punuese;

funksionimi, kompetencat si dhe vendimmarrja e delegacionit shtetëror. Gjykata poashtu vëren se Ligji i kontestuar, përmban edhe dispozita të tjera që kanë të bëjnë me administratën e delegacionit shtetëror, buxhetin si dhe dispozitat përfundimtare.

58. Gjykata vëren, se parashtruesit e kërkesës, i kanë shtjelluar vetëm pretendimet që kanë të bëjnë me nenet 1, 2, 4, 10 (paragrafi 4 nënparagrafi 1 dhe 2), 11 (paragrafi 3) të Ligjit të kontestuar, duke theksuar se këto nene nuk janë në pajtueshmëri me nenet 2, 4, 7, 18, 20, 65, 93 dhe 94 të Kushtetutës. Gjykata vëren, se në fakt parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, nuk është në pajtim me Kushtetutën.

59. Parashtruesit e kërkesës i kanë grupuar pretendimet e tyre në tri kategori: (i) *përcaktimit dhe ndryshimit të hierarkisë institucionale kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë;* (ii) *kompetencat ligjore të delegacionit shtetëror ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ, si dhe (iii) dhënia e karakterit lex specialis Ligjit të kontestuar.*

60. Në dritën e shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do të bëjë interpretimin e dispozitave kushtetuese në kuadër të autoritetit të saj, i cili është i bazuar në nenin 112 të Kushtetutës. Me këtë rast, Gjykata do të respektojë shkronjën dhe frymën e Kushtetutës dhe parimet e qeverisjes demokratike (shih, *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO103/14, parashtrues *Presidentja e Republikës së Kosovës,* përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84. 14 [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafi 58).

A. Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës sa i përket "përcaktimit dhe ndryshimit të hierarkisë institucionale kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë"

61. Gjykata rikujton argumentet e parashtruesve të kërkesës, lidhur me kategorinë e parë të pretendimeve. Parashtruesit e kërkesës në thelb pohojnë se Ligji i kontestuar, ka cenuar sovranitetin popullor, si autorizim shprehimor për përfaqësuesit e popullit i cili materializohet në Kuvend. Sipas parashtruesve të kërkesës është në kundërshtim me Kushtetutën, të vendoset një delegacion shtetëror në hierarkinë institucionale mbi Qeverinë dhe Kuvendin, në çështjen e negocimit dhe arritjes së marrëveshjes me një shtet tjetër.

62. Në adresimin e pretendimeve të lartcekura të parashtruesve të kërkesës, në raport me nenet e Kushtetutës, Gjykata në lexim të përbashkët do të shtjellojë parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me formën e qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit si dhe vlerat demokratike të mishëruara në Kushtetutë.

63. Kushtetuta, përcakton se Kuvendi është institucioni më i lartë në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Legjitimiteti i Kuvendit, si institucioni më i lartë, buron drejtpërdrejtë nga vullneti i popullit të Republikës së Kosovës, i shprehur nëpërmjet zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare.

64. Lidhshmëria mes autorizimeve që populli iu jep përfaqësuesve të zgjedhur, është konfirmuar në praktikën e Gjykatës ku është theksuar, se "*Demokracia, "vox populi" (zëri i popullit), kërkon zgjedhjen e atyre që do të përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të Shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky është subjekti më i lartë drejtues i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Një nga përgjegjësitë kryesore të parlamentit është që të vendosë duke votuar se kë të fuqizojë me funksione ekzekutive [...]*" (shih, *mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO103/14, parashtrues *Presidentja e Republikës së Kosovës,* përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84. 14 [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafi 49).

65. Gjykata vë në dukje se në një vend me demokraci përfaqësuese, roli i Kuvendit manifestohet përmes veprimtarisë së tij ligjvënëse. Megjithatë, Gjykata thekson se Kuvendi si organ ligjvënës, gjatë miratimit të ligjeve, duhet të mbrojë frymën dhe shkronjën e Kushtetutës, duke marrë parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, si atribut qenësor i qeverisjes demokratike.

66. Në këtë rast, Gjykata rithekson se Kuvendi është organi më i lartë në Republikën e Kosovës, i cili ka autorizim të përfaqësimit të popullit dhe ushtrimin e pushtetit legjislativ. Bazuar në tekstin e Kushtetutës, Kuvendi si institucioni më i lartë shtetëror, njëkohësisht është i veshur me shumëllojshmëri të kompetencave. Në ushtrimin e kompetencave të tij, Kuvendi i nënshtrohet parimit demokratik të ndarjes së pushtetit, kontrollit dhe balancimit ndërmjet tyre.

67. Gjykata vëren se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës ndër të tjera, bazohet në vlerat demokratike të ndarjes së pushtetit dhe

sundimit të ligjit. Rrjedhimisht, besimi i popullit në vlerat demokratike dhe sundim të ligjit, paraqet thelbin e funksionimit të demokracisë përfaqësuese në vend. Gjykata, gjithashtu rikujton dhe praktikën e saj të mëhershme, ku thekson se Kuvendi është institucioni që ka përgjegjësinë e ushtrimit të pushtetit legjislativ, ndërsa Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të miratuara në Kuvend (shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti KO12/18 parashtrues: *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafi 104).

68. Gjykata thekson, se parimet e përgjithshme demokratike, janë të bazuara në funksionimin e një varg mekanizmash institucional, të parapara me Kushtetutë dhe ligje të nxjerra nga Kuvendi. Me këtë rast, Gjykata e ka parasysh se Kuvendi me ligj mund të themelojë trupa/institucione që bartin një mandat të caktuar në bazë të ligjit, por kjo kompetencë gjithmonë duhet të ushtrohet në bazë të Kushtetutës, duke respektuar parimin e ndarjes së pushtetit dhe duke mos i cenuar kompetencat tashmë të paracaktuara me Kushtetutë për institucionet përkatëse.

69. Gjykata ri-thekson se në kuadër të sistemit juridik kushtetues të gjitha normat tjera iu nënshtrohen epërsisë së normës kushtetuese. Gjykata vlerëson që, kur një materie është e përcaktuar me Kushtetutë, ajo nuk mund të ndryshohet, minohet, apo transformohet përmes një akti me fuqi më të ulët juridike sikurse që është ligji. Bazuar në epërsinë e normës kushtetuese, Gjykata rikujton se të gjitha aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me të.

70. Në këtë rast Gjykata, në kuadër të pretendimit të parë, do të vlerësojë kushtetutshmërinë e nenit 1 (paragrafi 1) të Ligjit të kontestuar, nëse i njëjti është në pajtueshmëri me parimet e ndarjes së pushtetit dhe formën e qeverisjes [neni 4], si dhe vlerat [neni 7] të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit 1 (paragrafi 1) të Ligjit të kontestuar

Neni 1
[Fushëveprimi i ligjit]

"1. Ky ligj përcakton hierarkinë institucionale dhe procedurën vendimmarrëse në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: dialogu). Po ashtu, rregullon funksionimin e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë (në tekstin e mëtejmë: delegacioni shtetëror), duke

përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e delegacionit shtetëror. Ndër të tjera, ligji definon qartë edhe ndërlidhjen që delegacioni shtetëror mban me institucionet tjera kushtetuese të Republikës së Kosovës".

71. Gjykata vëren se në Ligjin e kontestuar, në paragrafin 1, të nenit 1 parashihen tri çështje: (i) përcaktimi i një hierarkie institucionale me procedurë të veçantë vendimmarrëse "në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë"; (ii) rregullimi i funksionimit të delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për Dialogun me Serbinë (delegacioni shtetëror), si dhe (iii) definohet ndërlidhja që delegacioni shtetëror mban me institucionet tjera kushtetuese.

72. Në dritën e kësaj që u tha më lartë, Gjykata vëren se me Ligjin e kontestuar janë përcaktuar parametrat mbi të cilat është normuar një delegacion shtetëror, të cilin parashtruesit e kërkesës e cilësojnë si hierarki e re institucionale, e cila qëndron mbi Qeverinë dhe Kuvendin. Në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se ndarja e pushtetit, forma e qeverisjes, balancimi dhe kontrolli i pushteteve është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 4 të Kushtetutës.

73. Gjykata përkujton, se në kuadër të nenit 4 të Kushtetutës, i cili përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, Kuvendi si përfaqësues i popullit sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Kushtetutës, është në të njëjtën kohë edhe organi më i lartë i cili ushtron pushtetin legjislativ; sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit, si dhe është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Kushtetutës, Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar nga ana e Kuvendit. Me këtë rast Gjykata thekson se parimi i ndarjes së pushteteve paraqet vlerë demokratike në kuadër të organizimit të rendit kushtetues në Republikën e Kosovës.

74. Në kuadër të elaborimit të formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit, si dhe duke i ndërlidhur me pretendimet e parashtrueseve, dhe në bazë të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë, Gjykata do të kufizohet vetëm në mandatin e institucioneve kushtetuese të cilat kanë autorizime që lidhen drejtpërdrejtë me politikën e jashtme. Gjykata vë në pah se këtë rast organizimi institucional në Republikën e Kosovës, është i bazuar në formën e qeverisjes demokratike, të ndarjes dhe kontrollit të pushtetit, si dhe në sundim të ligjit.

75. Gjykata thekson se, "delegacioni shtetëror" i cili është i përkufizuar me Ligjin e kontestuar, duke mos qenë i paraparë me Kushtetutë, po ashtu duke mos qenë i paraparë brenda formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit, nuk mund të përfshihet në ndërveprimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit të pushteteve. Nga sa u tha më lartë, rezulton se delegacioni shtetëror i paraparë me Ligjin e kontestuar, nuk është i paraparë me Kushtetutë dhe nuk mund të ndërhyjë në formën e qeverisjes, gjegjësisht strukturën e ndarjes së pushtetit sikurse është e përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës.

76. Gjykata po ashtu vëren se Ligji i kontestuar "*rregullon funksionalizimin e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë*" si "mekanizëm i posaçëm" me qëllim të arritjes së marrëveshjes me një shtet të tretë.

77. Me këtë rast, Gjykata konsideron që secila degë e pushtetit shtetëror duhet të veprojë në pajtim me Kushtetutën, dhe përbrenda fushëveprimit kushtetues, duke garantuar kështu, parimin e ndarjes së pushteteve dhe vlerave demokratike të qeverisjes. Gjykata rithekson se Kuvendi, si organ ligjvënës dhe si shtyllë e ndarjes së pushtetit, ka mandat për nxjerrjen e ligjeve në fusha dhe për çështje që i konsideron të rëndësishme për t'u rregulluar me ligj. Këtu mund të hyjë edhe çështja e negocimit dhe lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare me shtete të ndryshme. Megjithatë, gjatë nxjerrjes së ligjeve, Kuvendi duhet të këtë kujdes që ligjet e nxjerra të jenë në pajtim me fushëveprimin e institucioneve kushtetuese.

78. Më tej, me Ligjin e kontestuar kërkohet *"ndërlidhja e delegacionit shtetëror me institucionet tjera kushtetuese"*, mirëpo, Gjykata thekson se krijimi ndërvarësisë së institucioneve kushtetuese në raport me delegacionin shtetëror, e bartë përgjegjësinë e institucioneve kompetente në kundërshtim me normën kushtetuese tek një "mekanizëm i posaçëm" siç është delegacioni shtetëror.

79. Gjykata konstaton se bartja e kompetencave të institucioneve kushtetuese tek "mekanizmi i posaçëm" i krijuar në Ligjin e kontestuar, është ndërhyrje në ushtrimin e kompetencave të institucioneve kushtetuese në sferën e politikës së jashtme.

80. Gjykata konkludon se neni 1 (paragrafi 1) i Ligjit të kontestuar, ndërhyn në formën e qeverisjes, ndarjen e pushtetit, si dhe cenon vlerat demokratike dhe të sundimit e ligjit, sepse i vesh delegacionit shtetëror funksione të cilat nuk përkojnë me normat kushtetuese, si dhe krijon ndërvarshmërinë e institucioneve kushtetuese në raport me një mekanizëm ligjor respektivisht me delegacionin shtetëror.

Rrjedhimisht, Gjykata gjen se neni 1 (paragrafi) 1 i Ligjit të kontestuar, në të tri çështjet e shtjelluara, nuk është në pajtim me parimet e përgjithshme kushtetuese të mishëruara në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 dhe në paragrafin 1 të nenit 7 të Kushtetutës.

81. Nisur nga ato që u thanë më sipër, Gjykata konkludon që neni 1 (paragrafi 1) i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 dhe paragrafin 1 të nenit 7 të Kushtetutës.

B. Përkitazi me pretendimet se "kompetencat ligjore të Delegacionit shtetëror ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ"

82. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kompetencat ligjore të Delegacionit shtetëror ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ, konkretisht në kompetencat e Kuvendit, Qeverisë dhe Kryeministrit.

83. Në kuadër të këtij grupi të pretendimeve, Gjykata vlerëson kushtetutshmërinë e nenit 2, 4, 10 (paragrafi 4 nën-paragrafi 1 dhe 2), dhe 11 (paragrafi 3) të Ligjit të kontestuar.

Kushtetutshmëria e nenit 2 të Ligjit të kontestuar

Neni 2
[Synimi dhe qëllimi]

Në pajtim me këtë ligj, Delegacioni Shtetëror i Republikës së Kosovës për Dialogun me Republikën e Serbisë autorizohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për negociim dhe arritje të marrëveshjeve gjatë procesit të Dialogut, në konsultim me Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

84. Gjykata, vëren se neni 2 i Ligjit të kontestuar, e parasheh autorizimin në bazë të të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës, ia mvesh delegacionit shtetëror kompetencën për negocim dhe arritje të marrëveshjes me një shtet të tretë.

85. Duke i trajtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, të cilët pohojnë se delegacioni shtetëror ndërhyn në kompetencat konkrete të Qeverisë, Kryeministrit dhe Kuvendit në fushën e politikës së

jashtme, Gjykata do të referohet në dispozitat përkatëse, siç janë shprehimisht të përcaktuara me Kushtetutë.

86. Gjykata, rikujton që kompetencat konkrete për institucionet kushtetuese janë të përcaktuara në Kushtetutë, përfshirë këtu edhe kompetencat e tyre në sferën e politikës së jashtme. Konkretisht, paragrafi 1, i nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] në fushën e politikës së jashtme e obligon Qeverinë për të ushtruar kompetencën e saj në "*propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit*."

87. Më tej, Gjykata vëren se në kuadër të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit], paragrafi 1 thekson se Kryeministri "*Përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë*" si dhe paragrafi 9 përcakton që Kryeministri *"Këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit"*. Si rrjedhojë, në kuadër të kompetencave kushtetuese të parapara në nenin 93, paragrafi 1 dhe neni 94, paragrafët 1 dhe 9 të Kushtetutës, në mënyrë shprehimore është e paraparë që Qeveria/Kryeministri në këshillim me Presidentin zbatojnë politikën e jashtme të vendit.

88. Gjykata vëren se obligimet e ushtrimit të kompetencave në politikën e jashtme u janë besuar institucioneve kushtetuese, duke përfshirë edhe arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo kompetencë në kuadër të politikës së jashtme nuk mund të bartet tek një trup si "delegacioni shtetëror" përmes një akti më të ulët juridik, siç është Ligji i kontestuar.

89. Në lidhje me përfaqësimin e jashtëm të Republikës së Kosovës nga institucionet e saj kushtetuese, Gjykata rithekson detyrimin e institucioneve në fjalë, përkatësisht të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë, që kompetencat e tyre në politikën e jashtme t'i ushtrojnë brenda mandatit të tyre kushtetues. Kjo nënkupton, para së gjithash, që çdo negocim apo veprim tjetër që ka të bëjë me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës, duhet të jetë brenda detyrimeve kushtetuese që ka institucioni i Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë për të ushtruar kompetencat e tyre brenda frymës dhe shkronjës së Kushtetutës.

90. Gjykata vlerëson, se bartja e kompetencave të parapara me paragrafin 1 të nenit 93, dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 të Kushtetutës, në delegacionin shtetëror si "mekanizëm i posaçëm", është në kundërshtim me kompetencat konkrete të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë. Institucionet e përcaktuara me Kushtetutë, janë kompetente në të gjitha fazat e dialogut për arritjen

e marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe një kompetencë e tillë nuk mund të bartet ose transferohet. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se, neni 2 i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me kompetencat konkrete të institucioneve kushtetuese të parapara me paragrafin 1, të nenit 93 dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 të Kushtetutës, kompetencë kjo e cila nuk mund të bartet tek delegacioni shtetëror.

91. Në vijim, Gjykata vlerëson pretendimin e parashtruesve të kërkesës se neni 2 i Ligjit të kontestuar, është në kundërshtim me nenin 65, paragrafin 12 të Kushtetutës që ka të bëjë me kompetencën e Kuvendit në mbikëqyrjen e politikës së jashtme dhe të sigurisë.

92. Gjykata vëren se në kuadër të funksioneve të tij, Kuvendi është i autorizuar të ushtrojë funksionin e mbikëqyrjes së politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në rastin konkret, Kuvendi në kuadër të Ligjit të kontestuar ka themeluar një "mekanizëm të posaçëm", i cili nuk i nënshtrohet kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare siç është e paparë me Kushtetutë. Në këtë rast, funksioni dhe detyra e mbikëqyrjes parlamentare në fushën e politikës së jashtme, është kompetencë kushtetuese e Kuvendit, e cila ushtrohet ndaj institucioneve që parashihen me Kushtetutë.

93. Gjykata, konstaton se neni 2 i Ligjit të kontestuar, nuk është në pajtim me mandatin e Kuvendit, i cili ka obligim ushtrimin e kontrollit parlamentar mbi pushtetin ekzekutiv. Gjykata konkludon se neni 2 i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtim me nenin 65 paragrafin 12 të Kushtetutës.

94. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kompetencat ligjore të parapara me nenin 2 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në pajtueshmëri me kompetencat kushtetuese të institucioneve të parapara me Kushtetutë, konkretisht me nenin 65 paragrafin 12, nenin 93 paragrafin 1, dhe nenin 94 paragrafin 1 dhe 9 të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e neneve 4 dhe 10 (paragrafi 4 nënparagrafi 1 dhe 2) të Ligjit të kontestuar

Neni 4
[Procedura për ngritjen e Delegacionit Shtetëror]

Delegacionit Shtetëror për dialogun me Republikën e Kosovës do të mandatohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Delegacioni Shtetëror do të jetë organ i vetëm i autorizuar për ta drejtuar Dialogun. Në këtë drejtim Delegacioni konsultohet me Institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Neni 10
[Kompetencat e Delegacionit Shtetëror]

4. Delegacioni Shtetëror
4.1. Drejton Dialogun me Serbinë;
4.2. Përfaqëson Republikën e Kosovës në Dialog;

95. Gjykata vëren se neni 4 dhe neni 10 (paragrafi 4, nënparagrafi 1 dhe 2) i Ligjit të kontestuar e emëron delegacionin shtetëror si *"organ i vetëm i autorizuar për ta drejtuar dialogun"* si dhe i jep atij kompetencën që të "*Përfaqëson Republikën e Kosovës në Dialog*".

96. Gjykata, konstaton se delegacionit shtetëror të paraparë me Ligjin e kontestuar nuk mund t'i atribuohet kompetenca si i vetmi organ i autorizuar për ta drejtuar dialogun. Autorizimi i dhënë, me Ligjin e kontestuar, për delegacionin shtetëror, është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në autorizimet konkrete të Qeverisë sipas paragrafit 1 të nenit 93 të Kushtetutës dhe Kryeministrit sipas nenit 94 paragrafit 1 dhe 9 të Kushtetutës.

97. Për më tepër, Gjykata konsideron se përfaqësimi i Republikës së Kosovës në kuadër të paragrafit 1 të nenit 93 përcakton si kompetencë të Qeverisë *"propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit,"* si dhe në kuadër të paragrafëve 1 dhe 9 të nenit 94 të Kushtetutës, Kryeministri "*Përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë"* dhe *"Këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit"*.

98. Nga teksti i neneve të elaboruara të Kushtetutës, rrjedh se institucionet e autorizuara në fushën e politikës së jashtme sipas paragrafit 1 të nenit 93 dhe paragrafëve 1 dhe 9 të nenit 94 të Kushtetutës, janë Qeveria, Kryeministri në këshillim me Presidentin.

99. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që neni 4 dhe 10 (paragrafi 4 nën-paragrafi 1 dhe 2) i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 93 dhe paragrafin 1 dhe 9 të nenit 94 të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit 11 (paragrafi 3) të Ligjit të kontestuar

Neni 11
[Raporti i Delegacionit Shtetëror me Institucionet Kushtetuese]

3.Çfarëdo veprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me Republikën e Serbisë duhet të bashkërendohen dhe të miratohen dyanshëm në mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Delegacionit shtetëror.

100. Gjykata, vëren se ky nen i Ligjit të kontestuar imponon bashkërendimin dhe miratimin e dyanshëm, mes institucioneve kushtetuese në njërën anë dhe delegacionit shtetëror si "mekanizëm i posaçëm" i përcaktuar me ligj në anën tjetër. Gjykata po ashtu vëren, se me anë të këtij neni institucioneve kushtetuese iu kushtëzohet që në veprimet e tyre në lidhje me dialogun të jenë të varura nga miratimi i delegacionit shtetëror, si "mekanizëm i posaçëm".

101. Sidoqoftë, Gjykata thekson se institucionet kushtetuese i kanë detyrat dhe kompetencat konkrete të përcaktuara me Kushtetutë. Çfarëdo krijimi i ndërvarësisë të përcaktuar me ligj, për miratim të dyanshëm e cenon kompetencën dhe mandatin e institucioneve kushtetuese ashtu siç është e paraparë me Kushtetutë.

102. Gjykata rikujton, që institucionet kushtetuese kompetente në sferën e politikës së jashtme, përkatësisht, Qeveria/Kryeministri dhe Presidenti, janë të obliguara për këshillim ndërinstitucional ndërmjet tyre. Por, ky obligim i bashkërendimit/këshillimit, nuk shtrihet në trupa tjerë të cilët nuk janë të paraparë me Kushtetutë, siç është delegacioni shtetëror.

103. Gjykata rithekson se obligimi për miratimin e veprimeve në mënyrë të dyanshme ndërmjet delegacionit shtetëror dhe institucioneve kushtetuese, nuk mund ta obligojë as Kuvendin si institucionin më të lartë në Republikën e Kosovës. Me këtë rast, Gjykata konkludon se çdo mekanizëm që nuk është i paraparë me Kushtetutë dhe nuk ka mandat kushtetues, nuk mund ta kushtëzojë bashkërendimin dhe miratimin e veprimeve me institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës.

104. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se neni 11 (paragrafi 3) nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 12 të nenit 65, paragrafin 1 të nenit 93, dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 të Kushtetutës.

C. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës, se Ligjit të kontestuar i "është dhënë karakter lex specialis me qëllim që dispozitat e këtij Projektligji të mbivendosen në rast kolizioni me ligje të tjera."

105. Me këtë rast Gjykata rikujton, që parashtruesit e kërkesës pohojnë se Ligji i kontestuar në paragrafin 2, të nenit 1 duke u përcaktuar si *lex specialis,* vë në rrezik parimin e sigurisë juridike. Tutje, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se "*paragrafi 5 i nenit 18 [i Kushtetutës], i cili përcakton parimet dhe procedura për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj"* duke pretenduar, në fakt, se ligj organik është Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

106. Megjithatë, pasi Gjykata ka konstatuar shkelje kushtetuese në nenet esenciale të Ligjit të kontestuar, përkatësisht nenet të cilat kanë rregulluar: Fushëveprimin; Synimin dhe Qëllimin; Procedurën për ngritjen e Delegacionit Shtetëror; Kompetencat e Delegacionit shtetëror; dhe Raportin e Delegacionit Shtetëror me Institucionet Kushtetuese, nuk e sheh të nevojshme trajtimin e pretendimit të tretë të parashtruesve të kërkesës.

Përfundim

107. Nga vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve të Ligjit të kontestuar, të apostrofuara më lart, Gjykata gjen se nenet 1 (paragrafi 1), 2, 4, 10 (paragrafi 4, nën-paragrafët 1 dhe 2), dhe neni 11 (paragrafi 3) nuk janë në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafin 12 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1, të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës.

108. Përderisa Gjykata ka konstatuar papajtueshmërinë e neneve kryesore të Ligjit të kontestuar me nenet përkatëse të Kushtetutës, Gjykata shpall se Ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, është i papajtueshëm me Kushtetutën.

109. Meqenëse Ligji i kontestuar, në tërësi është shpallur i papajtueshëm me Kushtetutën, përkatësisht me nenin 4 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, nenin 7 paragrafi 1, nenin 65 paragrafi 12, nenin 93 paragrafi 1, dhe nenin 94 paragrafët 1 dhe 9 të Kushtetutës, Gjykata, nuk do të lëshohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, në raport me nenet 2, 18 dhe 20 të Kushtetutës.

Kërkesa për masë të përkohshme

110. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme me arsyetimin që *"Zbatimi i [Ligjit të kontestuar] do*

të krijonte precedent të rrezikshëm në raport me parimin e ndarjes së pushteteve, sepse do të lejonte një trup antikushtetues të ndërhyjë në kompetencat e Kuvendit dhe të Qeverisë[...].”

111. Gjykata më sipër ka konkluduar se Ligji i kontestuar, në tërësi, nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafin 12 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës. Për më tepër, kur kontestohet një Ligj sipas nenit 113, paragrafi 5, Gjykata njofton Presidentin duke i rikujtuar që në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 43 [Afatet] të Ligjit, Ligji i kontestuar nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte ligjore, përderisa Gjykata përfundimisht të vendosë lidhur me çështjen e ngritur para saj.

112. Gjykata më 18 mars 2019, kishte njoftuar Presidentin dhe si rrjedhojë, ligji nuk mund të prodhonte efekte juridike.

113. Prandaj, Gjykata në pajtim me atë që u tha më sipër dhe në pajtim me nenin 27.1 [Masat e Përkohshme] të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

Kërkesa për seancë dëgjimore

114. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.

115. Gjykata rikujton rregullin 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] paragrafi 2 i Rregullores së punës përcakton që *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit.”*

116. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI34/17,

parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 - ku thuhet se "*Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast [...]"*).

117. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.

118. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 42 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) (a) të Rregullores së punës, më 13 qershor 2019

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se nenet 1 (paragrafi 1), 2, 4, 10 (paragrafi 4, nën-paragrafët 1 dhe 2), dhe neni 11 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, nuk janë në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafin 12 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1, të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës.

III. TË KONSTATOJË, njëzëri, meqë nenet thelbësore të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, rrjedhimisht Gjykata shpall të njëjtin, në tërësinë e tij, të papajtueshëm me Kushtetutën.

IV. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;

V. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për seancë dëgjimore;

VI. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

VII. TË PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

VIII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KO58/19, Parashtrues: Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019

KO58/19, Aktgjykim i miratuar më 29 korrik 2019, i publikuar më 14 gusht 2019

Fjalët kyç: *Kërkesë institucionale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), grupet parlamentare, çështje kushtetuese*

Kërkesa ishte parashtruar nga 30 (tridhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 113, paragrafi 2 nënparagrafi 1 i Kushtetutës. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të KQZ-së të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

1. Vendimi nr. 57/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Čemajl Kurtiši si anëtar i KQZ-së nga komuniteti boshnjak;
2. Vendimi nr. 58/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Stevan Veselinović si anëtar i KQZ-së nga komuniteti serb;
3. Vendimi nr. 59/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Ercan Şpat si anëtar i KQZ-së nga komuniteti turk;
4. Vendimi nr. 60/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Alfred Kinolli si anëtar i KQZ-së, si përfaqësues i komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian;
5. Vendimi nr. 61/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e znj. Nazlie Bala si anëtare e KQZ-së;
6. Vendimi nr. 62/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Adnan Rrustemi si anëtar i KQZ-së;
7. Vendimi nr. 63/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Florian Dushi si anëtar i KQZ-së;
8. Vendimi nr. 65/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Sami Hamiti si anëtar i KQZ-së.

Parashtruesit e kërkesës pretendonin që vendimet e lartpërmendura nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parashtruesit e kërkesës në thelb para Gjykatës kishin këto pretendime kryesore:
Kundërshtimi i parë kishte të bënte me formën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Parashtruesit konsideronin nevojën

e vënies së theksit tek terminologjia që ka përdorur Kushtetuta e Kosovës në dispozitën përkatëse nga neni 139, paragrafi 4 i Kushtetutës, ku theksohet si në vijim:*"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend"*. Pra, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që termi *"të përfaqësuara"* ka karakter *post festum,* që në vete nënkupton që*"jo domosdoshmërisht subjekti politik që ka fituar mandate të caktuara në Kuvend do të jetë përfaqësuar në nivel të grupit parlamentar me po aq deputetë të mandatuar"*.

Gjithashtu, ata pretendojnë që është dispozita e nenit 70, paragrafit 1 të Kushtetutës e cila i jep lirinë e ushtrimit të funksionit të deputetit brenda mandatit të tij duke mos iu nënshtruar asnjë mandati tjetër të detyrueshëm. Sipas parashtruesve të kërkesës *"emërimi i anëtarëve të KQZ-së duke marrë parasysh strukturën e grupeve parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të subjekteve politike, do të konservonte lirinë politike të përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës dhe do të mohonte iniciativat politike në formën e grupeve parlamentare të deputetëve"*.

Parashtruesit pretendojnë se, Presidenti, duke interpretuar "grupet më të mëdha parlamentare" si partia, koalicioni, iniciativa qytetare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe duke emëruar anëtarët e KQZ-së, përmes akteve të kontestuara, sipas këtij interpretimi, ka bërë shkelje të dispozitave kushtetuese. Kjo pasi sipas parashtruesve "grupet më të mëdha parlamentare" sipas nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, janë grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat ekzistojnë si të tilla në momentin që Presidenti emëron anëtarët e KQZ-së.

Gjykata vlerësoi se kërkesa e parashtruesve është e pranueshme në bazë të kritereve të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Në shtjellimin e meritave të kërkesës, Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se vendimet e kontestuara, plotësojnë kushtet për të qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata në bazë të nenit 113, paragrafi 2, nënparagrafi 1 të Kushtetutës. Kjo pasi, Gjykata vlerëson se vendimet e kontestuara, pavarësisht emërtimit të tyre janë të një natyre të detyrueshme dhe kanë të bëjnë me caktimin e anëtarëve të KQZ-së që është një institucion i pavarur kushtetues i mandatuar për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve në Kosovë, në bazë të autorizimeve të dhëna në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Zgjedhjet).

Gjykata rikujton fillimisht se Kushtetuta, përveç që përcakton mënyrën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së dhe nga cilat grupe parlamentare emërohen, ajo nuk përmban ndonjë definicion specifik në lidhje me atë nëse grupet parlamentare për qëllim të emërimit të anëtarëve të KQZ-së, janë grupet parlamentare: *i)* që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, apo, *ii)* ato që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në lidhje me këtë, Gjykata vlerësoi dispozitat kushtetuese dhe dispozitat e tjera të ndërlidhura në lidhje me grupet parlamentare të Kuvendit duke marrë për bazë (i) rolin kushtetues të KQZ-së si institucion i pavarur për administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve; (ii) mënyrën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së; (iii) kohëzgjatjen e mandatit dhe (iv) kohën e emërimit të tyre.

Gjykata rikujton se anëtarët e KQZ-së nuk kanë mandat të caktuar kohor. Mandati i tyre është i lidhur me mandatin e ciklit zgjedhor dhe në parim, fillon jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, përveç përjashtimeve të parapara në nenin 61, paragrafi 3 nënparagrafin (e) të Ligjit për Zgjedhjet.

Andaj, sipas dispozitave të lartcekura, zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së nuk është e lidhur me çështjen e konstituimit të Kuvendit, që mund të bëhet apo jo brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore, as me grupet parlamentare në kuptimin e ngushtë të fjalës, që formohen pas konstituimit të Kuvendit, kur edhe fillon jeta parlamentare në kuptimin e plotë të fjalës, që mundëson organizimin e deputetëve në grupe parlamentare që mund të dallojnë nga partitë apo koalicionet që kanë dalë prej zgjedhjeve.

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së bazuar në rezultatet që kanë dalur nga zgjedhjet e përgjithshme, siguron që në KQZ të mos ketë vakum institucional pavarësisht kohës së konstituimit të Kuvendit. Kjo nënkupton që Presidenti, bazuar në nenin 61.4 të Ligjit të Zgjedhjeve, të mund të ushtroj përgjegjësitë e tij për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas certifikimit të zgjedhjeve, sipas grupeve parlamentare/subjekteve politike, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve për Kuvend.

Andaj, Gjykata konstaton se grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, për qëllim të nenin 139, paragrafi 4 të Kushtetutës konsiderohen 6 (gjashtë) partitë, koalicionet, iniciativat qytetare, që kanë më shumë vende në Kuvend, se çdo tjetër parti, koalicion, iniciativë qytetare që kanë marrë pjesë si të tilla në zgjedhjet për Kuvend.

Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se aktet e kontestuara nuk cenojnë dispozitat e Kushtetutës, përkatësisht, paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO58/19

Parashtrues

Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Bilall Sherifi, Aida Dërguti, Besa Baftiu, Dardan Sejdiu, Dardan Molliqaj, Driton Çaushi, Dukagjin Gorani, Faton Topalli, Fisnik Ismaili, Frashër Krasniqi, Salih Salihu, Shqipe Pantina, Visar Ymeri, Muharrem Nitaj, Rasim Selmanaj, Bekë Berisha, Teuta Haxhiu, Shkumbin Demaliaj, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Gani Dreshaj, Ahmet Isufi, Labinot Tahiri, Time Kadrijaj, Blerim Kuçi, Haxhi Shala, Albulena Balaj-Halimaj, Enver Hoti, Zafir Berisha dhe Ilir Deda (në testin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar z. Bilall Sherifi që t'i përfaqësojë ata në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë vendimet e Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidenti) për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KQZ), si në vijim:

1. Vendimi nr. 57/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Čemajl Kurtiši si anëtar i KQZ-së nga komuniteti Boshnjak;
2. Vendimi nr. 58/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Stevan Veselinović si anëtar i KQZ-së nga komuniteti Serb;
3. Vendimi nr. 59/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Ercan Şpat si anëtar i KQZ-së nga komuniteti Turk;
4. Vendimi nr. 60/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Alfred Kinolli si anëtar i KQZ-së si përfaqësues i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
5. Vendimi nr. 61/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e znj. Nazlie Bala si anëtare e KQZ-së;
6. Vendimi nr. 62/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Adnan Rrustemi si anëtar i KQZ-së;
7. Vendimi nr. 63/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Florian Dushi si anëtar i KQZ-së;
8. Vendimi nr. 65/2019, i 28 marsit 2019, për emërimin e z. Sami Hamiti si anëtar i KQZ-së.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, për të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë që nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafi 2, nënparagrafi 1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 prill 2019, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë duke kontestuar dekretin e Presidentit në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së.

7. Më 8 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama -Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 12 prill 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 12 prill 2019, kërkesa iu komunikua Presidentit dhe u informua se mund të paraqes komente në lidhje me kërkesën deri më 26 prill 2019. Gjithashtu, Gjykata kërkoi nga zyra e Presidentit që të dërgohen edhe kopjet e dekreteve të Presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së.

10. Më 12 prill 2019, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit), Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri), Avokatin e Popullit dhe Kryetaren e KQZ-së.

11. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe të gjithë deputetët u ftuan që të dorëzojnë komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, deri më 26 prill 2019.

12. Më 16 prill 2019, parashtruesit e kërkesës e plotësuan kërkesën duke i dorëzuar në Gjykatë vendimet e kontestuara.

13. Më 26 prill 2019, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejmë: LVV), dorëzoi në Gjykatë komentet e saj përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë.

14. Më 26 prill 2019, Zyra e Presidentit të Kosovës dërgoi në Gjykatë komentet përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë.

15. Më 8 maj 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës përkitazi me komentet e pranuara në lidhje me kërkesën si dhe i ftoi që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 21 maj 2019.

16. Të njëjtën ditë, Gjykata po ashtu njoftoi Presidentin, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Avokatin e Popullit dhe Kryetaren e KQZ-së përkitazi me komentet e pranuara në lidhje me kërkesën. Presidenti u informua se mund t'i paraqes komentet e tij, nëse ka, deri më 21 maj 2019. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që kopjet e të gjitha komenteve t'u dorëzohen të gjithë deputetëve të Kuvendit, dhe të njoftohen që komentet e tyre, nëse kanë, mund t'i dorëzojnë deri më 21 maj 2019. Gjykata nuk ka marrë asnjë koment nga palët e interesuara.

17. Më 26 korrik 2019, gjyqtari Bajram Ljatifi kishte kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës që të përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës nr. KO58/19, sepse më herët kishte qenë pjesë e KQZ-së.

18. Më 26 korrik 2019, Kryetarja në pajtim me nenin 18.1 (1.3) të Ligjit dhe me rregullin 9 (4) të Rregullores së punës, nxori vendim nëpërmjet të cilit u aprovua kërkesa për përjashtim nga procesi i shqyrtimit dhe i vendimmarrjes lidhur me rastin KO58/19.

19. Më 29 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

20. Me 29 korrik 2019, Gjykata votoi për pranueshmërinë e kërkesës, dhe njëzëri vendosi se aktet e kontestuara, nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 11 qershor 2017, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.

22. Më 8 korrik 2017, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend, bazuar në listën vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:
    a. Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Socialdemokrate, Balli Kombëtar i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PDK, AAK dhe Nisma), 39 deputetë;
    b. LVV, 32 deputetë;
    c. Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re (në tekstin e mëtejmë: LDK dhe AKR), 29 deputetë;
    d. Građanska Iniciativa Srpska lista, 9 deputetë;
    e. Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;
    f. Koalicija "Vakat", 2 deputetë;

g. Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;
h. Samostalna Liberalna Stranka, 1 deputet;
i. Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, 1 deputet;
j. Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputet;
k. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;
l. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet; dhe

Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

23. Më 3 gusht 2017, Kuvendi mbajti seancën konstituive dhe mes tjerash formoi Komisionin *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe mandateve (në tekstin e mëtejmë: Komisioni *ad hoc*).

24. Të njëjtën ditë, Komisioni *ad hoc* paraqiti raportin, bazuar në listën e rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve dhe konstatoi mandatet në bazë të rezultateve të certifikuara.

25. Më 7 shtator 2017, me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve u konstituua Kuvendi.

26. Në shtator të vitit 2017, një numër deputetësh, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Nisma Socialdemokrate.

27. Në shtator të vitit 2017, një numër deputetësh, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AAK).

28. Më 14 mars 2018, 12 (dymbëdhjetë) deputetë, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e grupit të ri parlamentar, Grupi i Deputetëve të Pavarur, më vonë të regjistruar si grupi parlamentar Partia Socialdemokrate (në tekstin e mëtejmë: PSD).

29. Më 27 mars 2018, Presidenti iu drejtua Kryetarit të Kuvendit me kërkesë që të njoftojë grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit (ve) në KQZ dhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë në Kosovë të cilët mbajnë vende të garantuara, që të bëjnë propozimin/caktimin e emrit/ave të anëtarëve për KQZ.

30. Më 7 qershor 2018, Presidenti, në bazë të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës, dorëzoi në Gjykatë kërkesën KO79/18, me të cilën kishte kërkuar nga Gjykata që të interpretojë paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës.

31. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata publikoi Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KO79/18. Në atë rast, Gjykata e kishte

shpallur kërkesën të papranueshme dhe kishte konstatuar se neni 84. 9 i Kushtetutës nuk është i pavarur prej nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtrimi i çështjeve kushtetuese në Gjykatë duhet të bëhet vetëm mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës.

32. Më 14 dhjetor 2018, Zyra e Presidentit, i është drejtuar grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, për të nominuar kandidatët/të propozuarit e grupeve parlamentare për anëtarë të KQZ-së, të cilët do të emëroheshin nga Presidenti. Kërkesa e Zyrës së Presidentit ishte e mbështetur në nenin 139. 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 61 dhe 62 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Zgjedhjet).

33. Ndërmjet 15 dhe 26 dhjetorit 2018, grupet parlamentare të deputetëve që parashtrojnë këtë kërkesë, PSD, AAK dhe Nisma dorëzuan nominimet e tyre për anëtarë të KQZ-së.

34. Ndërmjet 18 dhe 26 dhjetorit 2018, Zyra e Presidentit i është drejtuar personave kontaktues të grupeve parlamentare, me njoftimin se janë pranuar për shqyrtim nominimet për anëtarë të KQZ-së. Gjithashtu, është kërkuar dërgimi i dokumenteve shtesë për të nominuarit për anëtarë të KQZ-së.

35. Ndërmjet 20 dhjetorit 2018 dhe 9 janarit 2019, grupet parlamentare të deputetëve që parashtrojnë kërkesën kanë dorëzuar dokumentacionin shtesë në Zyrën e Presidentit.

36. Më 28 mars 2019, Presidenti përmes Vendimeve nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019, emëroi anëtarët e KQZ-së, nga partitë politike, koalicionet parazgjedhore dhe nismat qytetare, që kanë fituar më së shumti ulëse, sipas rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend, të 11 qershorit 2017. Presidenti nuk emëroi të propozuarit e PSD, AAK dhe Nisma për anëtarë të KQZ-së.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimet e kontestuara janë në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës.

38. Parashtruesit e kërkesës i kundërshtojnë në tërësi vendimet e Presidentit. Ata kundërshtojnë interpretimin e Presidentit që grupet parlamentare sipas nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, janë partitë

politike, koalicionet apo nismat qytetare që kanë fituar më së shumti vende në Kuvend sipas rezultatit të zgjedhjeve.

39. Parashtruesit e kërkesës, e bazojnë pretendimin e tyre në *"njohjen e gjendjes aktuale dhe faktike, përfshirë këtu edhe gjendjen juridike"* në Kuvend, pasi që sipas tyre *"në rastin konkret kemi të bëjmë edhe me statusin aktual të përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës"*.

40. Kundërshtimi i parë i parashtruesve të kërkesës ka të bëjë me formën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Parashtruesit konsiderojnë nevojën e vënies së theksit tek terminologjia që ka përdorur Kushtetuta e Kosovës në dispozitën përkatëse nga neni 139, paragrafi 4 i Kushtetutës, ku theksohet si në vijim: *"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend"*. Pra, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që termi *"të përfaqësuara"* ka karakter *post festum,* që në vete nënkupton që *"jo domosdoshmërisht subjekti politik që ka fituar mandate të caktuara në Kuvend do të jetë përfaqësuar në nivel të grupit parlamentar me po aq deputetë të mandatuar"*.

41. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se të nominuarit e anëtarëve për përfaqësim në KQZ *"ndërlidhet ngushtë me autorizimet kushtetuese lidhur me morfologjinë e mandatit kushtetues të deputetëve, si anëtarë të organit më të lartë kushtetues me karakter ligjvënës"*. Gjithashtu, ata pretendojnë që *"është dispozita e nenit 70, paragrafit 1 e cila i jep lirinë e ushtrimit të funksionit të deputetit brenda mandatit të tij duke mos iu nënshtruar asnjë mandati tjetër të detyrueshëm"*.

42. Parashtruesit po ashtu pohojnë se *"përforcimi i lirisë së përcaktimit politik brenda strukturës politike të deputetëve si anëtarë të Kuvendit, ndërlidhet me vetë natyrën e përfaqësimit. Përfaqësimi është nocion dinamik. Pra është i lëvizshëm. Dinamizmi i tij shprehet edhe me përkufizimin e mandatit në kuptim kohor. Këto janë madje ndër prerogativat themelore të demokracisë përfaqësuese, meqë përmes kufizimit kohor të mandateve stimulohet dinamizmi i përfaqësimit"*. Mbi këtë bazë, sipas parashtruesve të kërkesës *"emërimi i anëtarëve të KQZ-së duke marrë parasysh strukturën e grupeve parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të subjekteve politike, do të konservonte lirinë politike të përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës dhe do të mohonte iniciativat politike në formën e grupeve parlamentare të deputetëve"*.

43. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë që *"çështjet e rëndësishme siç janë mandati dhe kushtet për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk janë fare të specifikuara me dispozita kushtetuese. Në anën tjetër, dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, qysh nga hyrja në fuqi të këtyre dispozitave kanë jetësuar zbatimin e normave kushtetuese nga neni 139 të Kushtetutës së Kosovës"*. Sipas tyre neni 61, paragrafi 3 i Ligjit të lartpërmendur, në përmbajtje rregullon afatin e emërimit të anëtarëve të KQZ-së. Rrjedhimisht, sipas tyre kjo dispozitë përmban standardin e njohjes së gjendjes faktike dhe juridike *post festum*.

44. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë që përkundër asaj që neni 18 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme njeh vetëm koalicionet parazgjedhore, paragrafi 3, i nenit 18 thekson që pas shpërbërjes së koalicionit secila nga partitë politike të regjistruara që kanë qenë pjesë e koalicionit do të përgjigjen në mënyrë solidare në raport me borxhet dhe gjobat eventuale të shqiptuara.

45. Sipas parashtruesve të kërkesës, Presidenti nuk ka vepruar sipas dispozitave të Rregullores së Punës së Kuvendit *"sipas të cilave dispozita, po ai është i obliguar që paraprakisht, pra pas ciklit përkatës të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvend të Kosovës, me shkresë zyrtare dhe EX OFFICIO, të kërkojë përgjigje të saktë dhe po ashtu zyrtare, se sa grupe parlamentare ka Kuvendi i Kosovës në rastin e pakufishëm, në mënyrë që më pas, bazuar në gjendjen faktike, reale dhe koncize, edhe të kërkojë nga po ato grupe parlamentare - të subjekteve përkatëse politike, që në afat prej 21 ditësh, po të njëjtat, në përputhje të plotë me dispozitat e paragrafit 4 të nenit 139, të Kushtetutës së Kosovës, si dhe në përputhje me parimin e reprezentimit - përfaqësimit dhe të proporcionalitetit demokratik, t'i nominojnë kandidatët e tyre potencial, për anëtarë të Komisionit qendror të zgjedhjeve të Kosovës. Në praktikën e deri tanishme, Presidenti gjithmonë i është drejtuar Kuvendit, përmes Kryetarit të Kuvendit, në pyetjen se cilat janë gjashtë grupet parlamentare ekzistuese në kuvend, në lidhje me procesin e emërimit të anëtarëve të KQZ-së. Në këtë kuptim, kërkesa është dërguar në Kuvend, por që përgjigje asnjëherë nuk ka pasur në drejtim të Presidentit"*.

46. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë që Zyra e Presidentit gabimisht i zbaton parimet e Aktgjykimit KO119/14 që *"[...] kishte të bënte me një çështje krejtësisht tjetër dhe jo me zbatimin e dispozitave të nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës së Kosovës [...]. Sipas këtij aktgjykimi, është bërë e qartë, se për çfarë ka qenë përgjigja për pyetjen e parashtruar, pra, grupet parlamentare, që dalin nga*

zgjedhjet nuk mund të krijohen grupe të reja deri sa të konstituohen institucionet dhe e ka bërë të qartë cilat institucione, pra nuk është thënë të gjitha institucionet, por, në rastin e Kuvendit (Kryesisë me Kryetarin dhe Qeverinë). Norma e cila zbatohet për grupet parlamentare, e që është neni 139 i Kushtetutës, nuk është e lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës për themelimin e institucioneve ...". Rrjedhimisht, sipas parashtruesve të kërkesës,*"[...] Neni 139 është normë origjinare/burimore i cili thotë se secili grup parlamentar ka të drejtën e dërgimit të anëtarit në KQZ dhe se Aktgjykimi KO119/14 ka të bëjë vetëm për një situatë juridike speciale, e veçantë e cila është iniciuar në atë kohë [...]".*

47. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu thirren në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me anëtarët e KQZ-së, duke theksuar që *"[...] Procesi i përzgjedhjes, intervistimit dhe tërësisht procedurës parlamentare për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, nuk vjen nëpërmjet grupeve parlamentare që kanë dalë nga zgjedhjet e fundit, por, nga udhëheqësit e secilit grup parlamentar ekzistues në Kuvend. (Ligji nr. 03/L-121 Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 6, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2)".*

48. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që metoda e emërimit të anëtarëve të KQZ-së duke u bazuar në konstatimin e grupeve parlamentare që kanë dalë nga rezultati zgjedhor është absurde, pasi që nuk jep zgjidhje në raste të shpërbërjes së një grupi parlamentar apo subjektit politik i cili nominalisht ka fituar vende në Kuvendin e Kosovës, mirëpo ndërkohë deputetët që kanë fituar mandatet nën listën e kandidatëve të subjektit gjegjës politik, është shuar së ekzistuari.

49. Si konkluzion, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shpallë kërkesën e pranueshme si dhe të shfuqizojë vendimet e Presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së për shkak të zbatimit të gabuar të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës.

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i LVV-së

50. Grupi Parlamentar i LVV-së përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë fillimisht përshkruan përbërjen, format e organizimit dhe funksionet e Komisioneve Qendrore të Zgjedhjeve. Ata vënë theksin në tri forma të organizimit të Komisioneve Qendrore: a) të përbëra nga gjyqtarët apo ekspertët të rekrutuar përmes konkursit; b) të përbëra ekskluzivisht nga partitë politike të regjistruara që marrin pjesë në zgjedhje; dhe c) komisionet e përziera me përbërje pjesërisht politiko-partiake, pjesërisht nga ekspertë apo gjyqtarë.

51. LVV më tej specifikon që Kosova është e përcaktuar për modelin e pastër politiko-partiak, me përjashtim të Kryesuesit të KQZ-së që vjen nga sistemi gjyqësor dhe që emërimi i tij është kompetencë ekskluzive e Presidentit të Republikës së Kosovës. Sipas tyre, roli i Presidentit në emërimin e anëtarëve të tjerë të KQZ-së, është vetëm i natyrës së konfirmimit të nominimeve të subjekteve politike, pas sigurimit të përmbushjes së kritereve dhe kushteve mbi përshtatshmërinë e kandidatit nga ana e Zyrës së Presidentit.

52. Në vijim ata theksojnë që paragrafi 4, i nenit 61 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme përcakton afatin e fillimit të mandatit të anëtarëve të KQZ-së, i cili lidhet me datën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe jo me datën e konstituimit të Kuvendit. Rrjedhimisht, sipas tyre, funksionalizimi i KQZ-së nuk ka kurrfarë lidhje me konstituimin e Kuvendit, i cili mund të shkojë përtej periudhës prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

53. LVV, gjithashtu thekson që paragrafi 118 i Aktgjykimit të Gjykatës nr. KO119/14, ka krijuar pasoja juridike lidhur me interpretimin e konceptit të grupit parlamentar, duke u dhënë të drejtë grupeve parlamentare siç përcaktohet në këtë paragraf që të propozojnë kandidatët në përputhje me Ligjin për Zgjedhje në cilësinë e anëtarëve të KQZ-së.

54. Sa i përket Rregullores së Kuvendit të Kosovës e cila në vazhdimësi lejon formimin e grupeve parlamentare, LVV konsideron që përbërja e KQZ-së nuk mund të ndjekë dinamikat e brendshme në Kuvendin e Kosovës. Rrjedhimisht, sipas tyre, *"... grupet e tilla parlamentare nuk kanë të drejtë kushtetuese dhe ligjore të delegojnë individë të caktuar në institucione kushtetuese përfshirë edhe anëtarët e KQZ-së"*.

55. Përfundimisht, LVV thekson që kur bëhet fjalë për përbërjen e KQZ-së, fryma e nenit 139, paragrafit 4 të Kushtetutës nënkupton grupet parlamentare në kuptimin e subjekteve politike që kanë kaluar pragun zgjedhor, i cili vlen vetëm për subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe që emri i tyre është paraqitur në fletëvotim.

Komentet e dorëzuara nga Presidenti i Kosovës

56. Presidenti, përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, përshkruan logjikën dhe bazën ligjore të marrjes së vendimeve të kontestuara.

57. Fillimisht, Presidenti ofron një sfond historik të procesit të emërimit të anëtarëve të KQZ-së në legjislaturat e kaluara. Ndërsa, për emërimin e anëtarëve të KQZ-së në legjislaturën aktuale i kanë paraprirë veprimet vijuese: a) Shkresa adresuar Kryetarit të Kuvendit e 27 marsit 2018 me kërkesën që t'i njoftojë grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarëve në KQZ; b) pas propozimit të kandidatëve nga Grupet Parlamentare, Presidenti ka hasur në dilema ligjore lidhur me atë se nga kandidatët e cilave grupe parlamentare duhet të emërohen anëtarë të KQZ-së. Mbi këtë bazë, Presidenti thekson që ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të interpretojë nenin 139, paragrafi 4 të Kushtetutës duke qartësuar pyetjet në ndërlidhje të emërimit të anëtarëve të KQZ-së; dhe c) Gjykata më 21 nëntor 2018 ka deklaruar të papranueshme kërkesën për interpretimin e nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës (Aktvendimi për papranueshmëri për rastin KO79/18) duke theksuar që Gjykatës i është kufizuar mundësia e marrjes së rolit konsultativ dhe këshillëdhënës. Rrjedhimisht, pyetja e parashtruar nga Presidenti ka mbetur pa përgjigje.

58. Në vijim, Presidenti thekson legjislacionin në fuqi sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së, duke përmendur nenin 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, nenet 61 dhe 62 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe problemet e legjislacionit në fuqi sa i përket emërimit të anëtarëve të KQZ-së.

59. Zyra e Presidentit gjithashtu thirret në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO119/14, ku edhe referohet në konkluzionet e dala nga ky Aktgjykim. Sipas paragrafit 118 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO119/14, grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend nënkuptojnë grupet parlamentare që i ka zgjedhur populli, në bazë të listave dhe fletëvotimeve, ashtu siç kanë marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme.

60. Përfundimisht, Presidenti thekson që emërimi i anëtarëve të KQZ-së është bërë në përputhje me nenin 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, duke marrë parasysh grupet parlamentare që kanë qenë të përfaqësuara në seancën e parë të Kuvendit, për shkak se grupet parlamentare të krijuara më vonë, përkundër asaj që janë krijuar në bazë të Rregullores së Kuvendit, të njëjtat nuk përfaqësojnë vullnetin e popullit, të transmetuar në zgjedhjet e lira të mbajtura në vitin 2017.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

61. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregullore të punës.

62. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

63. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2 (1), të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë si në vijim:

> *"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
>
> *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;*
> *[...]."*

64. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet edhe neneve 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit që parashohin:

> *Neni 29*
> *Saktësimi i kërkesës*
>
> *1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, [...].*
>
> *2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.*
>
> *3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.*
>
> *Neni 30*
> *Afatet*
>
> *Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.*

65. Gjykata po ashtu i referohet edhe rregullit 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës, që përcakton:

"(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar."

66. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, rezulton se çdo kërkesë e dorëzuar nga Kuvendi sipas paragrafit 2 (1), të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që të jetë e pranueshme, duhet t'i plotësojë kriteret në vijim:

a. të jetë dorëzuar nga të paktën një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit;
b. të jetë ngritur lidhur me çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
c. të specifikojë nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën;
d. të specifikojë kundërshtimet e ngritura lidhur me kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar;
e. të dorëzohet brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

67. Në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën *a)* Gjykata vëren se kërkesa ishte nënshkruar nga 30 (tridhjetë) deputetë të Kuvendit, dhe ishte dorëzuar nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës sipas autorizimit të dhënë nga ta. Andaj, Gjykata vlerëson se kërkesa u paraqit nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, në pajtim me nenin 113, paragrafi 2, nënparagrafi 1 të Kushtetutës në ndërlidhje me

nenin 29, paragrafi 1 të Ligjit. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

68. Gjykata vëren po ashtu se parashtruesit e kërkesës, në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën *b)* specifikuan aktet, kushtetutshmërinë e të cilave e kontestojnë para Gjykatës, përkatësisht, vendimet e Presidentit si në vijim: Vendimi nr. 57/2019, Vendimi nr. 58/2019, Vendimi nr. 59/2019, Vendimi nr. 60/2019, Vendimi nr. 61/2019, Vendimi nr. 62/2019, Vendimi nr. 63/2019 dhe Vendimi nr. 65/2019, të 28 marsit 2019.

69. Në lidhje me këtë, neni 113 paragrafi 2, nënparagrafi 1, është pikë kryesore e referimit për të vlerësuar se cilat akte të Presidentit mund të kontestohen në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, duke përmendur taksativisht: dekretet e Presidentit.

70. Vendimet e Presidentit nuk janë të cekura në mënyrë specifike në nenin 113 paragrafi 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata rikujton se në praktikën e saj gjyqësore Gjykata Kushtetuese ka trajtuar kushtetutshmërinë e akteve të tjera të Qeverisë dhe të Kryeministrit, edhe pse ato nuk janë të cekura në mënyrë shprehimore në nenin 113 paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës.

71. Kështu, në Vendimin KO73/16, Gjykata kishte gjetur se "*Qarkorja Administrative [nr. 01/2016], e nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, pavarësisht emrit të saj, është e një natyre të detyrueshme dhe, në fakt, prek statusin kushtetues të institucioneve të pavarura*" dhe rrjedhimisht konstatoi se ajo përbën një akt juridik, kushtetutshmëria e të cilit mund të vlerësohet nga Gjykata (shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KO73/16, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 58).

72. Njëlloj, në rastin KO12/18 Gjykata kishte vendosur se: *"vendimet e Qeverisë mund të pranohen për vlerësim kushtetues nga Gjykata Kushtetuese vetëm atëherë kur argumentohet se ato akte ngrenë çështje të rëndësishme kushtetuese. [...] Gjykata vëren se çështja thelbësore për të cilën parashtruesit dhe Qeveria paraqesin pretendime të kundërta, ka të bëjë me raportin ndërmjet vendimit të Qeverisë për rritje të pagave dhe Ligjit për Buxhetin e vitit 2018. [...] Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se vendimi në fjalë ngre çështje të rëndësishme kushtetuese, që kanë të bëjnë me ushtrimin e kompetencave kushtetuese nga Kuvendi dhe Qeveria"* dhe mund të vlerësohet nga Gjykata edhe pse "vendimet" si akte juridike nuk janë të cekura specifikisht në nenin 113, paragrafi 2 (1), të Kushtetutës

(shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KO12/18, parashtrues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafët, 88, 89 dhe 90).

73. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se bazuar edhe në praktikën e saj të mëhershme të cekur më lart në lidhje me aktet e Qeverisë, edhe aktet e tjera juridike të Presidentit, pavarësisht se a emërtohen si "dekrete", mund të vlerësohen nga Gjykata nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara më lart dhe nëse ngritin çështje kushtetuese.

74. Andaj, në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimet e Presidentit janë akte juridike individuale të karakterit të detyrueshëm, që rregullojnë një situatë individuale dhe të cilat nxirren në bazë të autorizimeve që i janë dhënë Presidentit drejtpërsëdrejti me Kushtetutë apo ligj të caktuar.

75. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se vendimet e kontestuara, plotësojnë kushtet për të qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata në bazë të nenit 113, paragrafi 2, nënparagrafi 1 të Kushtetutës. Kjo pasi, Gjykata vlerëson se vendimet e kontestuara, pavarësisht emërtimit të tyre janë të një natyre të detyrueshme dhe kanë të bëjnë më caktimin e anëtarëve të KQZ-së që është një institucion i pavarur kushtetues i mandatuar për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve në Kosovë, në bazë të autorizimeve të dhëna në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

76. Për më tepër, çështjet që ngritin parashtruesit e kërkesës, janë të një rëndësie kushtetuese që ndërlidhet me të drejtën e grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend që të propozojnë anëtarët e KQZ-së sipas nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës.

77. Sa i përket kriterit të përcaktuar në pikën *c)* dhe *d)* parashtruesit e kërkesës, specifikuan se aktet e kontestuara i kundërshtojnë në tërësinë e tyre, si dhe paraqitën kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara në pajtim me nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës, nenin 29, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit, dhe rregullin 67, paragrafët (2) dhe (3) të Rregullores së punës. Gjykata po ashtu konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 30 të Ligjit dhe rregullit 67, paragrafit (4) të Rregullores së punës.

78. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve është e pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

79. Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës së parashtruesve ka të bëjë me pretendimin se me aktet e kontestuara për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, Presidenti ka cenuar nenin 139, paragrafin 4 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. [...]."*

80. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, Presidenti, duke interpretuar "grupet më të mëdha parlamentare" si partia, koalicioni, iniciativa qytetare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe duke emëruar anëtarët e KQZ-së, përmes akteve të kontestuara, sipas këtij interpretimi, ka bërë shkelje të dispozitave kushtetuese. Kjo pasi "grupet më të mëdha parlamentare" sipas nenit 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, janë grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat ekzistojnë si të tilla në momentin që Presidenti emëron anëtarët e KQZ-së.

81. Argumentet e tyre në lidhje me kërkesën ata i ndërlidhin me faktin se me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të Zgjedhjeve të Përgjithshme është paraparë që anëtarët e KQZ-së të emërohen 10 (dhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit edhe pse zgjedhjet ishin mbajtur 7 (shtatë) muaj më herët. Ata argumentojnë se qëllimi ishte që anëtarët e KQZ-së të propozohen nga grupet parlamentare ekzistuese në momentin e emërimit e jo subjektet politike që kanë dalë si rezultat i zgjedhjeve.

82. Për më tepër, sipas tyre, interpretimi që i është bërë termit "grup parlamentar" nga Presidenti i Republikës, përveç që është në kundërshtim me nenin 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, gjithashtu mohon iniciativat e lira politike në formimin e grupeve parlamentare të deputetëve.

83. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu e përmendin edhe procedurën për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, me ç' rast theksojnë se ky proces menaxhohet nga grupet parlamentare ekzistuese në Kuvend.

84. Gjykata rikujton fillimisht se Kushtetuta, përveç që përcakton mënyrën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së dhe nga cilat grupe parlamentare emërohen, ajo nuk përmban ndonjë definicion specifik

në lidhje me atë nëse grupet parlamentare për qëllim të emërimit të anëtarëve të KQZ-së, janë grupet parlamentare: *i)* që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, apo, *ii)* ato që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

85. Në kuadër të autoritetit të vet sipas nenit 112 të Kushtetutës, Gjykata, duke marrë për bazë çështjet specifike të parashtruara nga parashtruesi, do të bëjë interpretimin e nevojshëm të nenit 139, paragrafit 4 të Kushtetutës duke respektuar shkronjën dhe frymën e Kushtetutës dhe parimet e demokracisë, në ndërlidhje me dispozitat tjera relevante ligjore.

86. Në këtë aspekt, Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e emërimit të 6 (gjashtë) anëtarëve të KQZ-së nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së që propozohen nga radhët e partive apo koalicioneve që mbajnë vendet e rezervuara, përkatësisht kushtetutshmëria e Vendimit nr. 57/2019, Vendimi nr. 58/2019, Vendimi nr. 59/2019 dhe Vendimi nr. 60/2019, nuk janë objekt shqyrtimi i kërkesës.

87. Gjykata rikujton se shprehja "grupi më i madh parlamentar" e përdorur në nenin 139, paragrafi 4 të Kushtetutës, përdoret edhe në nenin 67, paragrafët 2 dhe 3 përkitazi me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, përkatësisht "parti politike ose koalicion" në nenin 84, paragrafi 14 dhe nenin 95, paragrafi 1 të Kushtetutës në lidhje me caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë.

88. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton Aktgjykimin e saj në rastin KO119/14, në të cilin rast kishte konstatuar se: "*për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe për formimin e Qeverisë, Kushtetuta përdor shprehje të ndryshme për të njëjtin realitet. Shprehje të ndryshme konkretisht janë: Vendet (...) ndahen (...) në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara (...) në zgjedhjet (...) [Neni 64 (1) i Kushtetutës], grupi më i madh parlamentar [Neni 67 (2) i Kushtetutës], partia politike ose koalicioni, që përbën shumicën e Kuvendit [Neni 84 (14) i Kushtetutës], partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend [Neni 95 (1) i Kushtetutës]" (shih Aktgjykimin në rastin KO119/14, Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014, Aktgjykim i 26 gushtit 2014, paragrafi 104).*"

89. Sipas të njëjtit Aktgjykim, *"grupi më i madh parlamentar, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës duhet të konsiderohet partia, koalicioni, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë më shumë vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64 (1) të Kushtetutës, se çdo tjetër parti, koalicion, iniciativë qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë marrë pjesë si të tillë në zgjedhje. [...]" (*shih Aktgjykimin në rastin KO119/14, *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* të cekur më lart, paragrafi 116).

90. Ndërsa në lidhje me përdorimin e termeve "parti politike ose koalicion", të cilat përmenden në nenin 84.14 dhe 95.1 të Kushtetutës, Gjykata rikujton Aktgjykimin e saj në rastin KO103/14, përmes të cilit vendosi që *"[...] partia politike ose koalicioni mund të jetë vetëm ajo që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje, respektivisht numrin më të madh të vendeve në Kuvend"* (shih rastin KO103/14, parashtrues *Presidentja e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafi 86).

91. Andaj, sipas aktgjykimeve të lartcekura del se deri në konstituimin e Kuvendit dhe për qëllime të konstituimit të tij sipas nenit 67 të Kushtetutës, grupet parlamentare reflektojnë përbërjen e partive politike, koalicioneve apo iniciativave qytetare që kanë dalë nga zgjedhjet. I njëjti përkufizim vlen edhe për partinë ose koalicionin që ka fituar zgjedhjet dhe që ka të drejtë të propozojë mandatarin për formimin e Qeverisë sipas neneve 84, paragrafi 14 dhe 95, paragrafi 1 të Kushtetutës. Gjykata thekson se ky interpretim zbatohet vetëm për konstituimin e Kuvendit, respektivisht, për përcaktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë.

92. Gjykata po ashtu rikujton praktikën e saj gjyqësore ku kishte konstatuar se "*grupi parlamentar, në kuptimin më të ngushtë të fjalës (in stricto sensu), dhe sipas Rregullores së punës të Kuvendit e shtojcave të saj, mund të regjistrohet vetëm pas konstituimit të Kuvendit, pra, pas zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit. Në momentin e thirrjes së seancës konstituive të Kuvendit, grupi parlamentar përbëhet nga kandidatë që janë zgjedhur anëtarë të Kuvendit në fletëvotimin e partisë, të koalicionit, të iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që janë regjistruar për zgjedhje, kanë marrë pjesë në to, e kanë kaluar pragun ligjor dhe kanë fituar vende në proporcion me numrin e votave të vlefshme të fituara në zgjedhjet për Kuvend*" (shih Aktgjykimin në rastin KO119/14, *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit*, të cekur më lart, paragrafi 117 dhe 118).

93. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës që përcakton: *"Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues",* si dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës që përcakton: *"Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës* së *Kuvendit".*

94. Gjykata rikujton edhe nenin 20, paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së punës së Kuvendit, që përcakton:

> *"1. Deputetët mund të formojnë grup parlamentar sipas përkatësisë së tyre partiake ose të përcaktimeve programore.*
>
> *2. Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në një grup parlamentar, të tërhiqet nga grupi, ta formojë një grup të ri parlamentar, t'i bashkëngjitet një grupi tjetër ose të veprojë si deputet i pavarur. Për secilin rast deputeti është i obliguar që, për vendimin e tij, ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit.*
>
> *[...]"*

95. Sipas asaj që u theksua më lart, deputetët, pas konstituimit të Kuvendit, janë të lirë të formojnë një grup parlamentar, të dalin nga një grup parlamentar apo t'i bashkëngjiten një grupi tjetër parlamentar dhe të realizojnë të drejtat e tyre si grupe parlamentare sipas Kushtetutës dhe Rregullores së punës.

96. Ky interpretim është gjithashtu në harmoni me praktikën e krijuar në Kuvend që lejon që ndryshimi i anëtarëve të një grupi parlamentar të reflektohet edhe në anëtarësinë në komisionet e përhershme dhe komisionet *ad hoc* të Kuvendit. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Vendimit të Kuvendit, nr. 06-V006 për formimin e 14 (katërmbëdhjetë) komisioneve parlamentare, të 3 tetorit 2017; Vendimit të Kuvendit, nr. 06-V-011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006, të 26 tetorit 2017; dhe Vendimit të Kuvendit, nr. 06-V-032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006, të 26 tetorit 2017.

97. Megjithatë, në lidhje me çështjet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse grupet parlamentare për qëllime të emërimit të anëtarëve të KQZ-së, sipas paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, konsiderohen ato që kanë dalë nga zgjedhjet për Kuvend apo grupet parlamentare që formohen pas konstituimit të Kuvendit.

98. Në lidhje me këtë, Gjykata do të vlerësojë dispozitat kushtetuese dhe dispozitat e tjera të ndërlidhura në lidhje me grupet parlamentare të Kuvendit duke marrë për bazë (i) rolin kushtetues të KQZ-së si institucion i pavarur për administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve; (ii) mënyrën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së; (iii) kohëzgjatjen e mandatit dhe (iv) kohën e emërimit të tyre.

99. Gjykata i referohet nenit 139, paragrafit 1 të Kushtetutës, i cili përcakton që: *"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe shpall rezultatet e tyre."*

100. Andaj, KQZ është organ i përhershëm i mandatuar për administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve në Kosovë, që kryen funksionet e saj në mënyrë profesionale dhe të paanshme, e pavarur nga çdo interes politik. Rrjedhimisht, Kushtetuta i atribuon KQZ-së natyrën e organit të përhershëm shtetëror, si dhe ia njeh asaj autoritetin e vetëm dhe të pavarur për të kontrolluar dhe certifikuar mandatin e institucioneve përfaqësuese.

101. Gjykata gjithashtu rikujton praktikën e saj gjyqësore ku kishte vlerësuar rolin e institucioneve të pavarura kushtetuese të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës, dhe ku kishte konstatuar se institucionet e pavarura, duke përfshirë edhe KQZ-në, nuk janë pjesë e legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit të rregullt dhe se Kushtetuta këtyre institucioneve i'u garanton status të veçantë, sa i përket pavarësisë së tyre (shih, *mutatis mutandis*, rastin KO73/16, parashtrues*, Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016, Aktgjykimi i 16 nëntorit 2016, paragrafët 61-65).

102. Gjykata rikujton edhe njëherë nenin 139, paragrafin 4 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. [...]."*

103. Gjykata rikujton gjithashtu nenin 61, paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, që përcaktojnë:

61.3. Neni 139 (4) i Kushtetutës së Kosovës parasheh se caktimi i anëtarëve të KQZ-së duhet të bëhet sipas procedurave në vijim:

a) Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit (ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës;
[...]
d) Përfundimi i mandatit bëhet në ditën e fundit të muajit kalendarik, në të njëjtin muaj në të cilin ka filluar mandati;
e) Pavarësisht nga pika (d) e këtij paragrafi mandati që përfundon nëntëdhjetë (90) ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

61.4 Mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend.

104. Gjykata rikujton se sipas dispozitave të lartcekura kushtetuese, anëtarët e KQZ-së nuk kanë mandat të caktuar kohor. Mandati i tyre është i lidhur me mandatin e ciklit zgjedhor dhe në parim, fillon jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, përveç përjashtimeve të parapara në nenin 61, paragrafin 3 nënparagrafin (e) të Ligjit për Zgjedhjet.

105. Sipas kësaj që u theksua, qëllimi i ligjvënësit ishte që anëtarët e KQZ-së të emërohen në afatin sa më të shkurtër, pas përfundimit të zgjedhjeve për Kuvend, duke përcaktuar afatin më të vonë 60 (gjashtëdhjetë) ditor, që fillon të rrjedhë, jo nga dita e konstituimit të Kuvendit, por nga certifikimi i rezultateve zgjedhore, dhe të shërbejnë si anëtarë të KQZ-së deri pas certifikimit të zgjedhjeve të ardhshme për Kuvend, me përjashtimet e parapara në nenin 61, paragrafin 3 nënparagrafin (e) të Ligjit për Zgjedhjet.

106. Andaj, sipas dispozitave të lartcekura, zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së nuk është e lidhur me çështjen e konstituimit të Kuvendit, që mund të bëhet apo jo brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore, as me grupet parlamentare në kuptimin e ngushtë të fjalës, që formohen pas konstituimit të Kuvendit, kur edhe

fillon jeta parlamentare në kuptimin e plotë të fjalës, që mundëson organizimin e deputetëve në grupe parlamentare që mund të dallojnë nga partitë apo koalicionet që kanë dalë prej zgjedhjeve.

107. Anëtarët e KQZ-së, megjithëse propozohen nga grupet parlamentare, koha e emërimit të tyre është i lidhur me datën e certifikimit të zgjedhjeve, dhe jo me konstituimin e Kuvendit apo të organizimit të grupeve parlamentare në kuptim të ngushtë të fjalës për qëllime të punës së Kuvendit.

108. Sa i përket procedurës për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata vëren që ky proces lidhet me grupet parlamentare pas konstituimit të Kuvendit, dhe rrjedhimisht nuk paraqet situatë të ngjashme me procesin e emërimit të anëtarëve të KQZ-së.

109. Edhe nga praktika e vendeve tjera, shihet se anëtarët e komisioneve zgjedhore ku ata propozohen nga Kuvendi, kryesisht propozohen nga partitë politike apo koalicionet që dalin nga zgjedhjet dhe ku propozimet bëhen nga partitë politike apo koalicionet që përfaqësojnë pozitën dhe opozitën (shih praktikën e Kroacisë, Sllovakisë dhe Bulgarisë).

110. Nga kjo që u tha më lart del se, përbërja e KQZ-së ka për qëllim të reflektojë përbërjen e Kuvendit sipas rezultateve të zgjedhjeve, që nënkupton se subjektet politike të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe të cilat kanë fituar më së shumti vende për Kuvend, kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KQZ-së të cilët emërohen nga Presidenti, dhe si pjesë e KQZ-së, si institucion i përhershëm i mandatuar me Kushtetutë për administrimin e procesit zgjedhor dhe referendumeve, dhe kanë mandat deri në zgjedhjet e tjera të përgjithshme, sipas përjashtimeve të cekura në nenin 61, paragrafin 3 nënparagrafin (e) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kur caktohet përbërja e re e KQZ-së.

111. Rrjedhimisht, anëtarët e KQZ-së nuk mund të ndryshojnë sa herë që ndryshon përbërja ose anëtarësia e grupeve parlamentare brenda të njëjtës legjislaturë, siç ndodh me përbërjen e komisioneve parlamentare të cilat reflektojnë ndryshimet që bëhen në grupet parlamentare gjatë një legjislature.

112. Përkufizimi apo roli i grupeve parlamentare në kuptimin e ngushtë dhe për qëllime të funksionimit të Kuvendit, që përmenden në dispozitat e tjera kushtetuese apo ashtu siç është përcaktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit, nuk mund të zbatohen në mënyrë

automatike dhe të vlejnë njëlloj edhe në rastin e dispozitës specifike kushtetuese që ka të bëjë me KQZ-në. Një praktikë e tillë, e ndryshimit të përbërjes së KQZ-së sa herë që ndryshojnë grupet parlamentare në Kuvend, përveç që nuk ka bazë në Kushtetutë dhe ligj, gjithashtu do të cenonte stabilitetin institucional të funksionimit të KQZ-së të paraparë me Kushtetutë.

113. Për më tepër, një praktikë e tillë dinamike, e ndryshimit të vazhdueshëm brenda mandatit, nuk mbështetet jo vetëm nga praktika e deritanishme institucionale e KQZ-së të Kosovës, por as nga praktika relevante e komisioneve zgjedhore të shteteve të tjera. Shih praktikat e Sllovakisë, Bulgarisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kroacisë.

114. Një praktikë e tillë nuk favorizohet as nga Komisioni i Venecias dhe OSCE/ODIHR që theksojnë se komisioni qendror i zgjedhjeve duhet të jetë i përhershëm për nga natyra dhe se organet që i emërojnë anëtarët e këtyre komisioneve, nuk duhet të jenë të lirë që të shkarkojnë ata, pasi kjo do të vinte në dyshim pavarësinë e tyre (shih *Kodi i Praktikave të Mira në Çështje të Zgjedhjeve,* miratuar nga Komisioni i Venecias në Takimin e 52-të Plenar të 18-19 tetorit 2002, faqe 10 dhe 26 dhe, *Ligji Elektoral,* Komisioni i Venecias, CDL-EL(2013)006, i 3 korrikut 2013, faqe 17 dhe 18. Shih gjithashtu, *Udhërrëfyesin për Rishikimin e Kornizës Ligjore për Zgjedhje*, Edicioni dytë, OSBE/ODIHR 2013, faqe 29).

115. Emërimi i anëtarëve të KQZ-së bazuar në rezultatet që kanë dalur nga zgjedhjet e përgjithshme, siguron që në KQZ të mos ketë vakum institucional pavarësisht kohës së konstituimit të Kuvendit. Kjo nënkupton që Presidenti, bazuar në nenin 61.4 të Ligjit të Zgjedhjeve, të mund të ushtrojë përgjegjësitë e tij për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas certifikimit të zgjedhjeve, sipas grupeve parlamentare/subjekteve politike, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve për Kuvend.

116. Rrjedhimisht, bazuar në atë që u theksua më lart, Gjykata konsideron se bazuar në nenin 139, paragrafin 4 të Kushtetutës si dhe në bazë të dispozitave tjera juridike të ndërlidhura me nenin 139 të Kushtetutës, anëtarët e KQZ-së, emërohen nga grupet parlamentare, të cilat dalin drejtpërdrejtë nga partitë politike, koalicionet apo iniciativat qytetare si rezultat i zgjedhjeve të përgjithshme dhe rrjedhimisht fitojnë më së shumti ulëse në Kuvend. Kjo, duke marrë për bazë rolin e KQZ-së të përcaktuar me Kushtetutë si institucion i përhershëm për administrimin e zgjedhjeve, faktin që mandati i anëtarëve të KQZ-së ndërlidhet me ciklin e zgjedhjeve për Kuvend, mënyrën specifike të emërimit të tyre, dhe veçanërisht kohën e emërimit të anëtarëve të

KQZ-së, që nuk ndërlidhet me kohën e konstituimit të Kuvendit dhe as me mënyrën e funksionimit të Kuvendit, por me datën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve.

117. Andaj, Gjykata konstaton se grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, për qëllim të nenit 139, paragrafit 4 të Kushtetutës, konsiderohen 6 (gjashtë) partitë, koalicionet, iniciativat qytetare, që kanë më shumë vende në Kuvend, se çdo tjetër parti, koalicion, iniciativë qytetare që kanë marrë pjesë si të tilla në zgjedhjet për Kuvend.

118. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se aktet e kontestuara nuk cenojnë dispozitat e Kushtetutës, përkatësisht, paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës.

119. Gjykata vlerëson se interpretimi i grupeve parlamentare për qëllim të nenit 139, paragrafit 4 të Kushtetutës, nuk cenon iniciativën e lirë dhe organizimin e brendshëm të partive politike, individëve apo iniciativave të tjera në Kuvend, pasi aplikohet vetëm për qëllim të kësaj dispozite. Sipas Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit, deputetët janë të lirë dhe kanë të drejtë për t'u organizuar në grupe parlamentare, dhe që ky organizim, duke përfshirë formimin, apo ndryshimin e grupeve parlamentare, të reflektohet në pajtim me Kushtetutë dhe ligj, në punën e përditshme të Kuvendit dhe organeve të tij gjatë gjithë legjislaturës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113, paragrafit 2 nënparagrafit 1 të Kushtetutës, neneve 29 dhe 30 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 59 (1) dhe 67 të Rregullores së punës, më 29 korrik 2019:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita;

II. TË KONSTATOJË se Vendimi nr. 57/2019, Vendimi nr. 58/2019, Vendimi nr. 59/2019, Vendimi nr. 60/2019, Vendimi nr. 61/2019, Vendimi nr. 62/2019, Vendimi nr. 63/2019, Vendimi nr. 65/2019, të 28 marsit 2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20, paragrafi 4 të Ligjit; dhe

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Arta Rama-Hajrizi

KO65/19, Parashtrues i kërkesës: Avokati i Popullit, vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar), i cili ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 2018.

KO65/19, Aktgjykim i 29 korrikut 2019, i publikuar më 23 gusht 2019

Fjalët kyç: *avokati i popullit, kërkesë institucionale, masë e përkohshme, mbrojtja e pronës, shërbimi i noterisë, gjuhët, pritjet legjitime, kufizim i të drejtave, veprim retroaktiv i ligjit, pensionimi, proporcionaliteti*

Parashtruesi i kërkesës konteston nenet 32 (paragrafi 1), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar, duke theksuar që nenet e cekura janë në shkelje të nenit 5 [Gjuhët] dhe paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Për sa i përket nenit 32 (1), parashtruesi i kërkesës pretendoi se neni në fjalë është në kundërshtim me nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës sepse lejon lëshimin e dokumenteve edhe në gjuhët tjera që nuk janë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Për sa i përket nenit 41 (1.3) dhe (1.4), parashtruesi i kërkesës pretendoi se neni në fjalë është në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] sepse kërkon nga noterët që disa shërbime t'i kryejnë pa pagesë.

Për sa i përket nenit 76 (2), parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, pretendoi se neni në fjalë me veprim retroaktiv ka ndryshuar moshën e pensionimit të noterëve nga mosha 70 vjeç në 65 vjeç, me ç 'rast atyre u janë mohuar pritjet legjitime dhe fitimi i ardhshëm çka ka rezultuar me shkelje të së drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Gjykata, në bazë të analizës së saj, konkludoi:

i) që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 32 i ligjit të kontestuar shkelë nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës janë të pabazuara sepse shërbimit noterial nuk i vendosen drejtpërdrejt detyrime të reja, porse ato paraqiten ekskluzivisht si "*mundësi*" dhe se zbatimi dhe realizimi i tyre do të varet nga secili ushtrues i funksioneve noteriale individualisht. Gjykata konkludoi që neni 32 i ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim dhe nuk shkelë të drejtat nga neni 5 [Gjuhët] i Kushtetutës.

ii) që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar janë në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës janë të pabazuara sepse ligjvënësi, duke ndjekur trendët bashkëkohorë në një shoqëri demokratike, dhe me qëllim të promovimit dhe përmirësimit të të drejtave pronësore të të dy gjinive, me zgjidhjet ligjore në nenin 41 (1.3) dhe (1.4) kanë paraparë saktësisht masën në të cilën ushtruesit e funksioneve të noterit duhet të kryejnë disa punë të caktuara juridike pa kompensim monetar. Gjykata konkludoi që paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim dhe nuk i shkelin të drejtat nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës.

iii) që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3), të ligjit të kontestuar janë në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës janë të pabazuara sepse, mes tjerash, "pritjet legjitime", vetvetiu, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk ofrojnë garanci që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional. Gjykata konkludoi se neni 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim dhe nuk i shkelin të drejtat nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së.

iv) në fund, Gjykata shpjegoi se ligjvënësi – për shkak të pozitës së tij dhe legjitimitetit demokratik – është në pozitë më të mirë se sa ajo për të përcaktuar dhe avancuar politikat e ekonomike dhe sociale të vendit.

v) gjithashtu, Gjykata, duke pasur parasysh konkluzionet e veta në lidhje me nenin 76 (paragrafi 2), nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar, konkludoi që nuk ka bazë ligjore për vazhdim të mëtejmë të masës së përkohshme, e cila ishte caktuar më 20 maj 2019, dhe ishte vazhduar më 20 maj 2019.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO65/19

Parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar), i cili ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve të kontestuara të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 5 [Gjuhët] dhe me paragrafët 1 dhe 3, të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon që Gjykata Kushtetuese e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme dhe të pezullojë zbatimin e neneve të kontestuara deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate, duke pretenduar se *"kërkesa është prima facie e bazuar, dhe se me nenet e kontestuara të ligjit të kontestuar subjekteve të caktuara u shkaktohen dëme të paripërueshme ..."*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 2, nënparagrafin 1, të nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) dhe në paragrafët 1 dhe 2, të nenit 116 (Efekti Juridik i Vendimeve) të Kushtetutës, nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 32, 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 prill 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 24 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Bajram Ljatifi.

8. Më 25 prill 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.

9. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës me udhëzimin që t'ua shpërndajë kërkesën të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), Kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe Kryetarin e Odës së Noterëve të Kosovës për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi nga ata që të dorëzojnë të gjitha

dokumentet relevante dhe komentet lidhur me kërkesën, nëse kanë, deri më 16 maj 2019.

10. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe Sekretarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të gjitha dokumentet relevante lidhur me Ligjin e kontestuar t'i dorëzojë në Gjykatë deri më 16 maj 2019.

11. Më 7 maj 2019, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës dorëzoi dokumentet në vijim, në lidhje me kërkesën në shqyrtim: (1) Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë, proceduar nga Qeveria në Kuvend më 12 tetor 2017; (2) Procesverbalin e Komisionit Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtim në parim i Projektligjit për Noterinë, më 14 nëntor 2017; (3) Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtim në parim i Projektligjit për Noterinë, më 14 nëntor 2017; (4) ftesën dhe rendin e ditës për Seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-10 për Noterinë, më 23 nëntor 2017; (5) Transkriptin e Seancës plenare, shqyrtimi i parë Projektligjit për Noterinë, më 23, 24, 29 dhe 30 nëntor 2017; (6) Procesverbalit të Seancës plenare, shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë, më 23, 24, 29 dhe 30 nëntor 2017; (7) Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin në parim të Projektligjit për Noterinë, nr. 06-V-025, më 30 nëntor 2017; (8) Procesverbalin e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtim në parim i Projektligjit për Noterinë, më 7 qershor 2018; (9) Raportin me amendamente në Projektligjin për Noterinë të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtim në parim i Projektligjit për Noterinë, më 7 qershor 2018; (10) Procesverbalin e Komisionit funksional për Integrime Evropiane, shqyrtimi i Projektligjit për Noterinë me amendamentet e Komisionit Funksional, më 26 qershor 2018; (11) Raportin e Komisionit funksional për Integrime Evropiane, shqyrtimi i Projektligjit për Noterinë me amendamentet e Komisionit Funksional, më 26 qershor 2018; (12) Procesverbalin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimi i Projektligjit për Noterinë me amendamentet e Komisionit funksional, më 20 qershor 2018; (13) Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimi i Projektligjit për Noterinë me amendamentet e Komisionit funksional, më 20 qershor 2018; (14) Procesverbalin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtim i Projektligjit për Noterinë me amendamentet e Komisionit funksional, më 20 qershor

2018; (15) Raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtim i Projektligjit për Noterinë me amendamentet e Komisionit funksional, më 20 qershor 2018; (16) Procesverbalin e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtim i raportit final të Projektligjit për Noterinë, më 26 qershor 2018; (17) Raportin final me amendamentet e propozuara në Projektligjin për Noterinë të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, i proceduar për shqyrtim në Seancën plenare, më 26 qershor 2018; (18) Ftesën dhe rendin e ditës për Seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shqyrtim i dytë i Projektligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, më 23 nëntor 2018; (19) Transkriptin e Seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shqyrtim i dytë i Projektligjit për Noterinë, më 13, 14 dhe 23 nëntor 2018; (20) Procesverbalin e Seancës plenare, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Noterinë, më 13, 14, 20 shtator, 15 tetor 1, 2, 7, 23 nëntor, 21 dhjetor 2018; dhe (21) Ligjin nr. 06/L-010 për Noterinë.

12. Më 16 maj 2019, Kryetari i Odës së Noterëve sqaroi se nuk ka ndonjë koment shtesë jashtë kërkesës së dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës dhe se në tërësi pajtohet se dispozitat e kontestuara ligjore janë kundër kushtetuese.

13. Më 20 maj 2019, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit përmbledhës të gjyqtarit raportues, miratoi caktimin e masës së përkohshme deri më 20 korrik 2019.

14. Më 19 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe paraqiti komentet e tij. Gjykata në përbërje të plotë gjithashtu paraqiti komentet e saj lidhur me raportin e gjyqtarit raportues dhe nxori vendimin për vazhdimin e masës së përkohshme për tre muaj, përkatësisht deri më 21 tetor 2019.

15. Më 29 korrik 2019, gjyqtari raportues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë, raportin me komentet e renditura të bëra nga gjyqtarët në përbërje të plotë në seancën e kaluar.

16. Të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë njëzëri vendosi që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 23 nëntor 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin e kontestuar. Më 26 dhjetor 2018, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

18. Më 19 prill 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatë kërkesën në të cilën kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 2), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit të kontestuar.

19. Njëkohësisht, parashtruesi kërkoi nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme dhe të pezullojë zbatimin e neneve të kontestuara të Ligjit me qëllim që të evitohet shkaktimi i dëmeve të pariparueshme për subjektet e caktuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës konteston nenet 32 (paragrafi 2), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit të kontestuar, duke pretenduar se nenet e përmendura janë në kundërshtim me nenin 5 [Gjuhët] dhe paragrafët 1 dhe 3, të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

21. Konkretisht, sa i përket nenit 32 (paragrafi 2) të Ligjit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"dispozita kontestuese e nenit 32 (paragrafi 1) të Ligjit për Noterinë i jep autorizime ushtruesit të një funksioni publik që të lëshojë dokumente edhe në gjuhë tjera, jashtë atyre që Kushtetuta i përcakton si gjuhë zyrtare, gjuhë zyrtare në nivel komune dhe në përdorim zyrtar, varësisht nga vlerësimi i njohjes së asaj gjuhe nga vetë noteri. Meqenëse Kushtetuta si gjuhë zyrtare i njeh vetëm gjuhën shqipe dhe serbe, kurse si gjuhë zyrtare në nivel komune dhe në përdorim zyrtar e njeh gjuhën turke, atë boshnjake dhe rome, dokumentet publike në Republikën e Kosovës nuk* mund *të lëshohen në gjuhë tjera. Prandaj, duket se neni 32, paragrafi 1, i Ligjit për Noterinë, në fjalinë e tij të dytë, ka bërë një tejkalim të dispozitës kushtetuese për gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe, rrjedhimisht, është në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës".*

22. Sa i përket nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) të Ligjit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"sipas nenit 2 (paragrafi 4) të Ligjit për Noterinë, shërbimi i noterisë, pavarësisht se është një*

shërbim publik, megjithatë si veprimtari *është biznes individual. Prandaj, nuk është e qartë se mbi çfarë baze ligji kërkon nga një biznes privat me autorizime publike që të kryejë veprimtari të caktuara pa pagesë, duke ndikuar në këtë mënyrë në uljen e të ardhurave të biznesit privat. [...] Duke qenë se me nenin 41 (paragrafi 1.3 dhe 1.4) të Ligjit për Noterinë cenohen të ardhurat e noterëve si biznese individuale, ekziston bazë për të vlerësuar se neni në fjalë paraqet shkelje të të drejtave pronësore të noterëve, të garantuara me nenin 46 (paragrafi 1 dhe 3) të Kushtetutës së Kosovës, i cili e garanton pronën dhe ndalon privimin arbitrar nga prona".*

23. Sa i përket nenit 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"me ligjin e vjetër për noterinë, mosha deri në të cilën mund të ushtrohej funksioni i noterit ka qenë mosha 70 vjeç. Ligji i ri (Ligji nr. 06/ L-010 për Noterinë), në nenin 2 (paragrafi 7), këtë moshë e ulë në 65 vjeçare, sikurse edhe neni 22 (*nënparagrafi *1.3). Neni 76 (paragrafi 2) e përcakton veprimin retroaktiv të dispozitës mbi përcaktimin e moshës deri kur mund të ushtrohet shërbimi i noterisë, duke përcaktuar se vetëm noterët të cilët e kanë mbushur moshën 65 vjeçare, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, mund ta vazhdojnë shërbimin e noterisë edhe për dy vjet tjera. Nga kjo dispozitë kuptohet se të gjithë noterëve tjerë u ndërpritet shërbimi me arritjen e moshës 65 vjeçare, duke i përfshirë edhe noterët të cilët e kanë filluar shërbimin sipas ligjit të vjetër, i cili parashihte moshën 70 vjeçare si moshë e përfundimit të shërbimit. Duke qenë se shërbimi i noterisë është burim i të ardhurave për personat që e ushtrojnë këtë shërbim, duke i marrë parasysh edhe investimet materiale dhe në punë të noterëve për t'u certifikuar dhe për të shërbyer si noterë, si dhe pritshmëritë e tyre që nga momenti kur kanë aplikuar për noterë, është e qartë se një dispozitë e tillë me efekt prapaveprues është në kundërshtim jo vetëm me parimin e moszbatimit retroaktiv të ligjeve, që cenon rëndë sigurinë juridike të qytetarëve, por paraqet edhe cenim të të drejtave pronësore dhe të punës së noterëve të certifikuar gjer me hyrjen në fuqi të ligjit të ri".*

24. Parashtruesi i kërkesës shton se *„në pajtim edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në lëndën* KI *40/09, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 76 (paragrafi 2) i Ligjit për Noterinë, me zbatimin retroaktiv të një kufizimi, përbën cenim të të drejtave pronësore të noterëve të licencuar, në kuptim të cenimit të investimeve të tyre materiale, financiare dhe të punës, si dhe të të ardhurave të pritura, duke*

shkelur kështu nenin 46 (par. 1 dhe par. 3) të Kushtetutës, i cili e garanton pronën dhe ndalon privimin arbitrar nga prona".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

26. Së pari, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës i cili përcakton "*Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar*".

27. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nënparagrafit (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
>
> *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën."*

28. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], i cili parasheh: "Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që në Gjykatë ngre çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të kontestuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 2 të Kushtetutës.

30. Gjykata gjithashtu merr parasysh nenin 30 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 67 (4) të Rregullores së punës, të cilat parashikojnë që kërkesa duhet të dorëzohet brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

31. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar u botua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 26 dhjetor 2018 dhe se parashtruesi e parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 19 prill 2019.

32. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 29 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

"1 Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, nga Presidenti i Republikës se Kosovës , Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikoje, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen te jene ne kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar."

33. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 67 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 67
„Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.
(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.
(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.
(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar."

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka përmendur dispozitat përkatëse kushtetuese që pretendon se janë shkelur, gjithashtu i referohet dispozitave të Ligjit të kontestuar, të cilat ai i konsideron të papajtueshme me Kushtetutën dhe ka paraqitur dëshmi që mbështesin pretendimet e tij.

35. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka identifikuar dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar, ka paraqitur pretendimet e tij kushtetuese, ka paraqitur

dëshmi mbështetëse dhe ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar.

36. Prandaj, Gjykata deklaron se kërkesa është e pranueshme.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

37. Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, përkatësisht nenet 32 (paragrafi 1), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) duke pretenduar se ato nuk janë në përputhje me nenin 5. [Gjuhët] dhe paragrafët 1 dhe 3 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

38. Në pajtim me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të lëshohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë të secilit pretendim individualisht dhe do të analizojë veçmas të tre nenet e ligjit të kontestuar në mënyrë që të përcaktojë meritat e tyre.

39. Në fillim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të cilat do të paraqiten ndaras në vazhdimin e raportit, Gjykata rikujton që neni 2 i ligjit të kontestuar përcakton se çka është shërbimi i noterisë dhe noterët.

"Neni 2
Shërbimi i noterisë dhe noterët

Shërbimi i noterisë është shërbim publik, të cilin e ushtrojnë noterët e emëruar nga Ministri i Drejtësisë (më tej Ministri) sipas dispozitave të këtij ligji. Noterët janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e shërbimit të noterisë"

40. Gjykata vëren se noteria nuk është kategori kushtetuese, por se kompetenca dhe të drejtat e saj rregullohen me ligj. Noteria sipas ligjit, është një profesion autonom dhe i pavarur në fushën e së drejtës të cilit i është besuar autorizimi publik për të përpiluar dokumente për çështjet ligjore dhe fakte të tjera të rëndësishme për qarkullimin e të hollave, mallrave dhe shërbimeve, si dhe për të kryer disa procedura gjyqësore në cilësinë e komisionarit të gjykatës.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1) të ligjit të kontestuar

41. Gjykata rikujton se, sa i përket nenit 32 (paragrafi 1) i ligjit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendon *„Dispozita kontestuese e nenit 32 (paragrafi 1) të Ligjit për Noterinë i jep autorizime ushtruesit të një funksioni publik që të* lëshojë *dokumente edhe ne gjuhë tjera, jashtë atyre që Kushtetuta i përcakton si gjuhë zyrtare, gjuhe zyrtare në nivel komune dhe në përdorim zyrtar, varësisht nga vlerësimi i njohjes së asaj gjuhe nga vetë noteri. Meqenëse Kushtetuta si gjuhë zyrtare i njeh vetëm gjuhen shqipe dhe serbe, kurse si gjuhë zyrtare në nivel komune dhe në përdorim zyrtar e njeh gjuhën turke, atë boshnjake dhe rome, dokumentet publike në Republikën e Kosovës nuk mund të lëshohen në gjuhë tjera. Prandaj, duket se neni 32, paragrafi 1, i Ligjit për Noterinë, në fjalinë e tij të dytë, ka bërë një tejkalim të dispozitës kushtetuese për gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe, rrjedhimisht, është në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës."*

42. Gjykata vëren se neni 32 i kontestuar (paragrafi 1) i Ligjit të kontestuar parasheh:

Neni 32
"Përdorimi i gjuhës në dokumentet noteriale

1. Të gjitha dokumentet noteriale lëshohen në gjuhën shqipe apo serbe varësisht nga gjuha që njihet më mirë nga noteri që lëshon aktin. Dokumentet noteriale mund të lëshohen edhe në gjuhët tjera, në rastet kur noteri merr përgjegjësi personale juridike lidhur me njohjen e saj,
[...]"

43. Gjithashtu, Gjykata vëren se dispozita e nenit 5 [Gjuhët] të Kushtetutës në pjesën përkatëse, parasheh si më poshtë:

"Neni 5 [Gjuhët]

1. *Gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.*
2. *Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj".*

44. Duke vlerësuar nenin 32 paragrafi 1 të Ligjit të kontestuar, Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se paragrafi 1 i

përmendur nuk është në përputhje me nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se neni 32 i kontestuar i ligjit të kontestuar përmban 3 paragrafë, të cilat së bashku përbëjnë një pjesë integrale të nenit 32 të kontestuar të Ligjit, dhe se vetëm pas leximit të tre paragrafëve të nenit 32 të ligjit të kontestuar, jepet një pasqyrë e qartë e esencës dhe kuptimit të tij.

45. Në lidhje me këtë, në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje që t'i përgjigjet kërkesës së parashtruesit, Gjykata e konsideron të nevojshme të tregojë dhe analizojë në raport të 3 paragrafët e nenit 32 të ligjit të kontestuar:

"Neni 32
Përdorimi i gjuhës në dokumentet noteriale

1. Të gjitha dokumentet noteriale lëshohen në gjuhën shqipe apo serbe varësisht nga gjuha që njihet më mirë nga noteri që lëshon aktin. Dokumentet noteriale mund të lëshohen edhe në gjuhët tjera, në rastet kur noteri merr përgjegjësi personale juridike lidhur me njohjen e saj,
2. Në nivelin komunal ku gjuhët kanë statusin e gjuhëve zyrtare ose janë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin, palët kanë të drejtë të kërkojnë nga noteri që t'ju lëshoj një kopje të dokumentit noterial në gjuhën të cilën ata e dëshirojnë. Kjo kopje do të konsiderohet si dokument noterial sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Nëse ndonjëra nga palët nuk e kupton gjuhën në të cilin përpilohet akti apo nëse atë e kërkon pala, në përpilimin e dokumentit noterial duhet të merr pjesë përkthyesi. Në fund të dokumentit noterial noteri duhet të shënojë se pjesëmarrësit i është përkthyer teksti i aktit".

46. Gjykata nga neni i cituar 32 paragrafët 1, 2 dhe 3 të ligjit të kontestuar, vëren se organi ligjvënës në vetë titullin e nenit 32 ka theksuar „*Përdorimi i gjuhës në* dokumentet *noteriale*", ndërsa në paragrafët 1, 2 dhe 3, ai jep udhëzime, rregullon të drejtat dhe obligimet, si dhe mënyrën në të cilën ato realizohen.

47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se për parashtruesin e kërkesës në lidhje me nenin 32 është i kontestuar fakti se organi legjislativ "*autorizon zyrtarët publikë për të lëshuar dokumente në gjuhë të tjera, përveç atyre të specifikuara në Kushtetutë si gjuhë zyrtare".*

48. Gjykata rikujton se pikërisht autorizimi kushtetues i organit legjislativ të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet, dhe kjo nënkupton edhe

autorizimin e tij për të ndryshuar përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve, ku organi legjislativ është i detyruar të respektojë kërkesat e vendosura para tij nga Kushtetuta, sidomos ato që rrjedhin nga parimi i sundimi i ligjit dhe ato me të cilat mbrohen të mirat dhe vlerat kushtetuese të caktuara.

49. Duke shqyrtuar paragrafin 1 të nenit 32 të ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se ligjvënësi, në pjesën e parë të paragrafit 1 pikërisht parasheh lëshimin e dokumenteve noteriale në gjuhën kushtetuese në pajtim me nenin 5 të Kushtetutës, ndërsa në pjesën e dytë të paragrafit 1 parasheh vetëm një "mundësi" të lëshimit të një dokumenti noterial edhe në gjuhë të tjera, por vetëm kur një noter publik merr përsipër përgjegjësinë ligjore për lëshimin e tij. Prandaj, Gjykata është e mendimit se me paragrafin e lartcekur nuk shkelen të drejtat ose obligimet që dalin nga fushëveprimi i nenit 5 të Kushtetutës.

50. Më tej, Gjykata, pasi shqyrtoi paragrafin 2 të nenit 32 të ligjit të kontestuar, gjithashtu konkludoi se nuk është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe kjo për arsye se, sipas paragrafit 2, ligjvënësi parasheh obligimin që të gjithë ushtruesit e funksioneve noteriale duhet të lëshojnë dokumente noteriale në ato gjuhë, në të cilat palët konsiderojnë se kanë të drejtë sipas nenit 5 të Kushtetutës.

51. Sa i përket paragrafit 3 të nenit 32 të ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se ligjvënësi e ka kuptuar kompleksitetin e nenit 5 të Kushtetutës në kuptim të zbatimit të tij në Republikën e Kosovës dhe për këtë qëllim, në paragrafin 3 ai ka paraparë një mekanizëm i cili mundëson krijimin e një situate që kontribuon në parimin e respektimit të të drejtave nga neni 5 i Kushtetutës. Më konkretisht, ligjvënësi në paragrafin 3 parasheh që "*Nëse ndonjëra nga palët nuk e kupton gjuhën në të cilin përpilohet akti apo nëse atë e kërkon pala, në përpilimin e dokumentit noterial duhet të merr pjesë përkthyesi*".

52. Gjykata është e mendimit se pikërisht paragrafi 3 i nenit 32 të ligjit të kontestuar parashikon detyrimin ligjor, si për noterin publik i cili harton një dokument noterial që mund të prodhojë pasoja juridike, po ashtu edhe siguri juridike edhe për palën, e cila, nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën përpilohet dokumenti, ka të drejtë për një përkthyes, i cili do t'i mundësojë asaj të kuptojë përmbajtjen e të njëjtit, dhe me këtë të gjitha palët në procedurë para noterit vendosen në pozitë të barabartë.

53. Një zgjidhje e tillë ligjore sipas nenit 32 të ligjit të kontestuar, sipas mendimit të Gjykatës dhe në pajtim me nenin 5 të Kushtetutës, i cili parasheh detyrimin që ushtruesit e funksioneve noteriale të lëshojnë

dokumente publike në gjuhët kushtetuese, shqipe dhe serbe dhe, nëse palët e kërkojnë, ata janë të obliguar t'i lëshojnë ato edhe në gjuhën turke, boshnjake ose rome, të cilat kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal.

54. Në bazë të lartcekurave, Gjykata konsideron se paragrafët 1.2 dhe 3 të nenit 32 të Ligjit të kontestuar i zgjerojnë të drejtat e gjuhës, por duke bërë kështu, ushtruesve të funksioneve noteriale nuk u vendosen drejtpërdrejt detyrime të reja, por se ato në nenin 32 paraqiten ekskluzivisht si "*mundësi*" dhe se zbatimi dhe realizimi i tyre do të varet nga secili ushtrues i funksioneve noteriale individualisht.

55. Gjykata, në bazë të asaj që u tha më sipër, konstaton se me një analizë të hollësishme të paragrafëve 1, 2 dhe 3 të nenit 32 të ligjit të kontestuar ka gjetur se ligjvënësi nuk ka cenuar asnjë të drejtë apo vendosur ndonjë detyrim përtej fushëveprimit të nenit 5 të Kushtetutës në ndonjërin nga paragrafët e mësipërm dhe në pajtim me këtë, Gjykata konkludon se neni 32 i ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) të ligjit të kontestuar

56. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që, sa i përket nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) të ligjit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *„sipas nenit 2 (paragrafi 4) të Ligjit për Noterinë, shërbimi i noterisë, pavarësisht se është një shërbim publik, megjithatë si veprimtari është biznes individual. Prandaj, nuk është e qartë se mbi çfarë baze ligji kërkon nga një biznes privat me autorizime publike që të kryejë veprimtari të caktuara pa pagesë, duke ndikuar në këtë* mënyrë *në uljen e të ardhurave të biznesit privat. […] Duke qenë se me nenin 41 (paragrafi 1.3 dhe 1.4) të Ligjit për Noterinë cenohen të ardhurat e noterëve si biznese individuale, ekziston bazë për të vlerësuar se neni në fjalë paraqet shkelje të të drejtave pronësore të noterëve, të garantuara me nenin 46 (paragrafi 1 dhe 3) të Kushtetutës së Kosovës, i cili e garanton pronën dhe ndalon privimin arbitrar nga prona".*

57. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata së pari rikujton se ligji i përcakton qartë noterët si nëpunës publikë, siç është sqaruar nga gjykata në paragrafët 38 dhe 39 të raportit, prandaj, pretendimet se është në pyetje biznesi privat janë të pabazuara dhe gjykata nuk do të merret me to.

58. Përveç kësaj, duke pasur parasysh pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës se me nenin 41, paragrafët 1.3 dhe 1.4 të Ligjit të kontestuar shkelen të drejtat e ushtruesve të funksioneve noteriale, të cilat mbrohen me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se neni 41 i kontestuar (paragrafët 1.3 dhe 1.4) të Ligjit të kontestuar parasheh:

„Neni 41
Solemnizimi i dokumenteve të hartuara nga pala apo përfaqësuesi i tij [...]

[...]
1.3. dhënia e pëlqimit nga bashkëshorti për mosregjistrim të pronës së përbashkët në emër të dy (2) bashkëshortëve, të bëhet me pëlqim të veçantë, jo përmes kontratës, pa kosto financiare;
1.4. dhënia e pëlqimit të serishëm, pas një periudhe të caktuar kohore, për të njëjtën pronë, nga bashkëshorti që ka hequr dorë më parë për regjistrimin e pronës së përbashkët, në emër të dy bashkëshortëve, të bëhet pa ndonjë tarifë shtesë financiare, me kusht që kjo procedurë të bëhet për lëndën/pronën e njëjtë, tek i njëjti noter dhe tek i njëjti përfaqësues ligjor i palës;
[...]“

59. Gjithashtu, Gjykata vëren se dispozita e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] paragrafët 1 dhe 3 parasheh:

„Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
[...]
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet“.

60. Gjykata po ashtu rikujton dispozitat e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), ku thuhet:

Neni 1 i Protokollit 1 „Mbrojtja e pronës “

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera".

61. Gjykata, pas shqyrtimit të paragrafëve 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, konstatoi se ligjvënësi kishte parashikuar dy lloje të punëve juridike për të cilat ushtruesit e funksionit noterial nuk do të kompensohen, përkatësisht nuk do kenë mundësinë që sipas tarifës financiare, të paguhen për punën e tyre pasi ato të jenë kryer.

62. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pikërisht ato punë juridike për të cilat në pajtim me paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar, ushtruesit e funksioneve noteriale, nuk mund të paguhen, i sheh si bazë për shkelje të pretenduar të nenit 46 të Kushtetutës.

63. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimit të tij për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës e thekson faktin se "*shërbimi i noterisë, pavarësisht se është një shërbim publik, megjithatë si veprimtari është biznes individual. Prandaj, nuk është e qartë se mbi çfarë baze ligji kërkon nga një biznes privat me autorizime publike që të kryejë veprimtari të caktuara pa pagesë, duke ndikuar në këtë mënyrë në uljen e të ardhurave të biznesit privat".*

64. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës pronësore, Gjykata rikujton që përmbajtja e rregullave që e përbëjnë të drejtën e gëzimit paqësor të pronës është paraqitur në vendimet e shumta të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ). Sipas interpretimit të GJEDNJ-së, kjo e drejtë bazohet në tri rregulla (shih vendimet e GJEDNJ-së, James *dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 2 shkurtit 1986, Seria A nr. 98, f. 29-30, paragrafi 37, *Asmundsson kundër Islandës*, kërkesa nr. 60669 2000, paragrafi 39), dhe ato janë:

– rregulli i parë (paragrafi i parë i nenit 1, fjalia e parë), i cili ka një karakter të përgjithshëm, përcakton parimin e gëzimit paqësor të pronës së një personi fizik ose juridik;

– rregulli i dytë (paragrafi i parë i nenit 1, fjalia e dytë) ka për objekt mundësinë e privimit të së drejtës për gëzimin paqësor të pronës, në kushte të caktuara;

– rregulli i tretë (paragrafi i dytë i nenit 1) ua njeh shteteve nënshkruese të KE-së, ndër të tjera, të drejtën për të kontrolluar ose kufizuar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm.

65. Rregulli i dytë dhe i tretë që mundësojnë privimin ose kufizimin e të drejtës për gëzim paqësor të pronës duhet të interpretohen në bazë të një parimi të përgjithshëm me të cilin përcaktohet e drejta e çdo individi (fizik ose juridik) në gëzim paqësor të pronës.

66. Gjykata, duke vlerësuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se ushtruesve të funksionit të noterit, me paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar u shkelen të drejtat nga neni 46 i Kushtetutës në lidhje me gëzimin paqësor të pronës, si dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rastin konkret nuk kualifikohen në pretendimet për shkelje të pretenduar të së drejtës për gëzimin paqësor të pronës nga neni 1 i Protokollit 1, paragrafi 1 i nenit 1 (fjalia e parë), por që këto pretendime më tepër mund të klasifikohen në kufizimet e përmendura në paragrafin 2 të nenit 1 të Protokollit 1 (fjalia e parë) të KEDNJ-së.

67. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se kufizimet e të drejtës pronësore të parashtruesit të kërkesës pretendohet të jenë krijuar në bazë të paragrafëve 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, Gjykata duhet të analizojë dhe të shqyrtojë nëse ligjvënësi me zgjidhjen e paraparë ligjore në paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar ka zvogëluar/kufizuar të drejtat pronësore të ushtruesve të funksionit të noterit.

68. Gjykata rikujton praktikën e GJEDNJ-së sipas së cilës kufizimet e të drejtës pronësore, të cilat përbëjnë përmbajtjen e rregullit të dytë të rregullave themelore të sipërpërmendura janë të justifikuara (legjitime):

"(1) nëse ato janë të ligjshme, përkatësisht të përcaktuara me ligjin e shtetit palë, pasi kjo siguron sundimin e ligjit, i cili duhet të jetë një parim i natyrshëm në të gjitha dispozitat e Konventës (në këtë mënyrë, për shembull, ka arsyetuar GJEDNJ në rastin Iatridis kundër Greqisë, kërkesa nr. 31107/96, paragrafi 58,

1999-II, Wieczorek kundër Polonisë, kërkesa nr. 18176/2005, par. 58);

(2) nëse ato janë bërë për të arritur një qëllim legjitim, përkatësisht në interesin publik ose të përgjithshëm; nocioni i "interesit publik" është i gjerë dhe në këtë mënyrë, me rastin e kufizimit të disa përfitimeve sociale, duhet të merren parasysh faktorët ekonomikë dhe socialë të shtetit të dhënë (gjykata rikujton se një arsyetim i tillë është dhënë në rastin Wieczorek kundër Polonisë, nr. i kërkesës 18176/2005, paragrafi 59) dhe

(3) nëse ato janë proporcionale, që do të thotë se e drejta e individit për gëzimin paqësor të pronës duhet të matet me interes të përgjithshëm, gjegj. me qëllimet që duhet të arrihen për të mirën e përbashkët: "proporcionaliteti nuk do të arrihet nëse individit në fjalë i është vënë barrë e madhe" (Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë, vendimi i 23 shtatorit 1982, paragrafi 69-74, Seria A nr. 52 , Wieczorek kundër Polonisë, nr. 18176/2005, para. 60)".

69. Në dritën e sa më sipër, Gjykata vëren se, sa i përket rregullit të parë, nëse kufizimet e pretenduara mbi të drejtat pronësore janë në përputhje me ligjin, së pari vëren se ligjvënësi në nenin 41 të ligjit të kontestuar ka paraparë që:

„1.3. dhënia e pëlqimit nga bashkëshorti për mosregjistrim të pronës së përbashkët në emër të dy (2) bashkëshortëve, të bëhet me pëlqim të veçantë, jo përmes kontratës, pa kosto financiare;
1.4. dhënia e pëlqimit të serishëm, pas një periudhe të caktuar kohore, për të njëjtën pronë, nga bashkëshorti që ka hequr dorë më parë për regjistrimin e pronës së përbashkët, në emër të dy bashkëshortëve, të bëhet pa ndonjë tarifë shtesë financiare, me kusht që kjo procedurë të bëhet për lëndën/pronën e njëjtë, tek i njëjti noter dhe tek i njëjti përfaqësues ligjor i palës;
[...]"

70. Nga kjo rrjedh se kufizimet e pretenduara kanë rezultuar nga paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe prandaj janë të ligjshme dhe jo arbitrare.

71. Sa i përket rregullit të dytë, a janë bërë ato kufizime për të arritur një qëllim legjitim, gjegj. në interes publik ose të përgjithshëm, Gjykata thekson se çdo ndërhyrje e një autoriteti publik në gëzimin paqësor të pronës mund të justifikohet vetëm nëse i shërben një interesi publik legjitim (ose të përgjithshëm).

72. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që autoriteti ose ligjvënësi kombëtar, për shkak të njohurive të drejtpërdrejta të shoqërisë dhe nevojave të saj, është në një pozitë të tillë, që mund të vendosë se çfarë është "*në interesin publik*". Megjithatë, kur përcaktohet se çfarë është "*në interesin publik*", autoriteti kombëtar, përkatësisht ligjvënësi është i obliguar të bëjë një vlerësim fillestar të ekzistencës së një problemi me interes publik që justifikon masat që pengojnë gëzimin paqësor të pronës (shih *Terazzi Srl kundër Italisë*, nr. 27265/95 , paragrafi 85, 17 tetor 2002 dhe *Elia Srl kundër Italisë*, nr. 37710/97, § 77, KEDNJ 2001-IKS).

73. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ligjvënësi, duke ndjekur trendët bashkëkohorë në një shoqëri demokratike, dhe me qëllim të promovimit dhe përmirësimit të të drejtave pronësore të të dy gjinive, me zgjidhjet ligjore në nenin 41 të Ligjit të kontestuar në paragrafët 1.3 dhe 1.4 kanë paraparë saktësisht masën në të cilën ushtruesit e funksioneve të noterit duhet të kryejnë disa punë të caktuara juridike pa kompensim monetar, me çka arrihet në përfundimin se zgjidhja ligjore e paraparë ka gjithashtu baza të arsyeshme për të ndjekur një qëllim të caktuar.

74. Sa i përket rregullit të tretë nëse kufizimet e pretenduara nga paragrafët 1.3 dhe 1.4 të ligjit të kontestuar janë proporcionale, Gjykata thekson se kufizimet e parapara në paragrafët e mësipërm parashikojnë ekskluzivisht kufizime për dy veprime juridike që ushtruesit e funksioneve të noterit duhet të caktojnë, duke ushtruar funksionin e tyre publik, të cilat i kanë në pajtim me ligjin.

75. Për më tepër, me zgjidhjen ligjore nuk parashihet detyrimi që ushtruesit e funksioneve të noterit të kryejnë të gjitha punët juridike që, sipas ligjit të aplikueshëm, mund t'i kryejnë pa kompensim monetar. Me këtë mund të konkludohet se zgjidhja e parashikuar ligjore në paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar nuk përbën një barrë të tepruar për ushtruesit e funksionit të noterit, sepse është në përpjesëtim të arsyeshëm me qëllimin që duhet të arrihet.

76. Gjykata vlerëson se në zgjidhjen ligjore të nenit 41, paragrafët 1.3 dhe 1.4 ekziston një proporcionalitet ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave të individit dhe se barra e imponuar ushtruesve të funksionit të noterit nuk është as e tepruar dhe as joproporcionale.

77. Bazuar në të gjitha sa më sipër, Gjykata konkludon se paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim dhe

nuk ua shkelin ushtruesve të funksionit të noterit të drejtat nga neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) i ligjit të kontestuar

78. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës si shkelje primare në kërkesë përmend nenin 76 (paragrafi 2) të ligjit të kontestuar, megjithatë, të njëjtën kohë, i referohet edhe nenit 2 (paragrafi 7) dhe nenit 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar.

79. Prandaj, Gjykata rikujton se nenet 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar theksojnë:

"Neni 76 Aktet nënligjore

[...]

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, noterët që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e noterit edhe për dy (2) vite".

Neni 2 Shërbimi i noterisë dhe noterët

[...]

7. Noteri mund ta ushtroj shërbimin e noterisë deri në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, nëse nuk paraqiten shkaqet e pushimit të detyrës së noterit nga nenet 22, 23, 24 dhe 25 të këtij ligji"

Neni 22 Arsyet për pushimin e shërbimit të noterit

[...]

"1.3. me arritjen e moshës gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare"..

80. Nga të lartcekurat rrjedh se neni 2 (paragrafi 7) i ligjit të kontestuar merret me çështjet e ndërprerjes së shërbimit, si dhe arsyet e veçanta që mund të ndikojnë në ndërprerjen e shërbimit të noterëve publikë, ndërsa neni 22 (paragrafi 1.3) përcakton moshën për ndërprerjen e veprimtarisë së noterëve.

81. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se tri nenet e lartpërmendura të ligjit të kontestuar janë të kushtëzuar reciprokisht dhe lidhen drejtpërsëdrejti me thelbin e pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës, dhe në pajtim me këtë Gjykata do të analizojë të tri nenet

e ligjit të kontestuar si pjesë përbërëse të pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës.

82. Gjykata sërish përsërit pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me nenin 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3): *"Me ligjin e vjetër për noterinë, mosha deri në të cilën mund të ushtrohej funksioni i noterit ka qenë mosha 70 vjeç. Ligji i ri (Ligji nr. 06/ L-010 për Noterinë), në nenin 2 (paragrafi 7), këtë moshë e ulë në 65 vjeçare, sikurse edhe neni 22 (nënparagrafi 1.3). Neni 76 (paragrafi 2) e përcakton veprimin retroaktiv të dispozitës mbi përcaktimin e moshës deri kur mund të ushtrohet shërbimi i noterisë, duke përcaktuar se vetëm noterët të cilët e kanë mbushur moshën 65 vjeçare, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, mund ta vazhdojnë shërbimin e noterisë edhe për dy vjet tjera. Nga kjo dispozitë kuptohet se të gjithë noterëve tjerë u ndërpritet shërbimi me arritjen e moshës 65 vjeçare,* duke *i përfshirë edhe noterët të cilët e kanë filluar shërbimin sipas ligjit të vjetër, i cili parashihte moshën 70 vjeçare si moshë e përfundimit të shërbimit[...] Duke qenë se shërbimi i noterisë është burim i të ardhurave për personat që e ushtrojnë këtë shërbim, duke i marrë parasysh edhe investimet materiale dhe në punë të noterëve për t'u certifikuar dhe për të shërbyer si noterë, si dhe pritshmëritë e tyre që nga momenti kur kanë aplikuar për noterë, është e qartë se një dispozitë e tillë me efekt prapaveprues është në kundërshtim jo vetëm me parimin e moszbatimit retroaktiv të ligjeve, që cenon rëndë sigurinë juridike të qytetarëve, por paraqet edhe cenim të të drejtave pronësore dhe të punës së noterëve të certifikuar gjer me hyrjen në fuqi të ligjit të ri".*

83. Parashtruesi i kërkesës shton *"se në pajtim me vendimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI 40/09, në pajtim me praktikën gjyqësore të* Gjykatës *Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 76 (paragrafi 2) të Ligjit për Noterinë me zbatimin retroaktiv të kufizimeve përbën shkelje të të drejtave pronësore të noterëve të licencuar në kuptimin e shkeljes së investimeve materiale, financiare dhe të punës si dhe të hyrave të pritura, duke shkelur kështu nenin 46 (paragrafët 1 dhe 3) të Kushtetutës së Kosovës që garanton pronën dhe ndalon privimin arbitrar të pronës".*

84. Gjykata fillimisht paraqet qëndrimin e saj se për të nuk është kontestues fakti se me ligjin e vjetër për noterinë është rregulluar që noterët, në ditën kur i mbushin 70 (shtatëdhjetë) vjet shkojnë në pension. Po ashtu, për Gjykatën nuk është kontestues fakti se me zgjidhjen e re ligjore, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, të nenit 76, paragrafi 2 të Ligjit të kontestuar parashihet se noterët shkojnë në pension në ditën kur i mbushin 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjet. Me këto

norma kalimtare parashihet mundësia e vazhdimit të funksionit të noterëve edhe për 2 vjet. Këto dispozita kalimtare të nenit 76, paragrafi 2 kanë të bëjnë vetëm me ata noterë të cilët i kanë mbushur 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjet në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri për noterët. Me këto norma kalimtare jepet mundësia ligjore që ata noterë të cilët e kanë kaluar moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeçare, kanë të drejtë të punojnë edhe 2 (dy) vjet në funksionin e noterëve, gjegjësisht më së shumti deri në moshën 70 (shtatëdhjetë) vjeçare, siç ishte paraparë me zgjidhjen e ligjit të vjetër.

85. Në bazë të të gjitha pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës, mund të konkludohet se dyshimet kryesore në lidhje me shkeljen e të drejtës në pronë lidhen me çështjen e "pritjeve legjitime", të cilat ushtruesit e funksioneve noteriale i kanë pasur duke marrë funksionin të noterit në pajtim me ligjin e vjetër, dhe se me zgjidhjen e re ligjore në paragrafin 2 të nenit 76 të ligjit të kontestuar, nuk do të realizohet si e tillë, duke shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe me zbatimin retroaktiv të zgjidhjes së re ligjore në lidhje me moshën e daljes në pension të ushtruesve të funksioneve noteriale.

86. Prandaj, Gjykata në vazhdim do të merret veçmas me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me i) konceptin e "pritjeve legjitime" lidhur me të drejtën e pronës dhe ii) aplikimin retroaktiv të zgjidhjes së re ligjore lidhur me moshën e daljes në pension të ushtruesve të funksioneve noteriale.

i) Koncepti i pritjeve legjitime lidhur me të drejtën e pronës

87. Gjykata rikujton se bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, koncepti i pronës (*possessions*) i përmendur në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ka kuptim autonom që nuk kufizohet në pronësi të të mirave materiale dhe është i pavarur nga klasifikimi formal nga e drejta vendore: disa të drejta dhe interesa tjera që janë vlera (*assets*) gjithashtu mund të konsiderohen si të "drejta pronësore" (*property rights*) dhe rrjedhimisht "pronë" (*possessions*) për qëllime të kësaj dispozite. Çështja që duhet vlerësuar në secilin rast është nëse rrethanat e rastit, shikuar në tërësi, i akordojnë parashtruesit titull ndaj një interesi material të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (shih Rastin *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], ankesë nr. 31443/96, paragrafi 129).

88. Neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së zbatohet vetëm ndaj pronës ekzistuese të personit. Prandaj, fitimi i ardhshëm nuk mund të konsiderohet pronë përveç nëse tashmë është fituar ose është pa asnjë "mëdyshje i pagueshëm". Veç kësaj, shpresa për "rigjallërim" (*revive*) të së drejtës ndaj pronës së humbur kohë më parë (*long-extinguished property*) nuk mund të konsiderohet pronë; e njëjta vlen dhe për pretendimin e kushtëzuar që ka skaduar i rrjedhojë e dështimit për ta përmbushur atë kusht (shih Rastin *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (Aktvendim) [DHM], ankesë nr. 39794/98, paragrafi 69).

89. Megjithatë, në disa rrethana, "pritjet legjitime" (*legitimate expectation*) për të fituar një "vlerë" (*asset*) po ashtu mund të gëzojë mbrojtje nga neni 46 në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Prandaj, kur një interes pronësor shprehet në formë të pretendimit, personit që i është veshur ai interes mund të konsiderohet se ka "pritje legjitime" nëse për atë interes ka bazë të mjaftueshme në të drejtën vendore, për shembull kur ka jurisprudencë të konsoliduar të gjykatave vendore që konfirmojnë ekzistencën e tij (shih Rastin *Kopecky kundër Sllovakisë* [DHM], ankesë nr. 44912/98, paragrafi 52). Mirëpo, asnjë pritje legjitime nuk mund të thuhet se është ngritur në rastet ku ka mosmarrëveshje lidhur me zbatimin dhe interpretimin e drejtë të së drejtës vendore dhe ku më pas pretendimet e parashtruesit janë refuzuar nga gjykatat vendore (Ibidem, *Kopecky,* paragrafi 50).

90. Bazuar në sa më sipër, rrjedh se doktrina e pritjes legjitime vjen në shprehje vetëm kur, nga rrethanat e rastit, është e qartë se parashtruesi nuk ka "pronë ekzistuese" dhe më pas shqyrtohet nëse personi ka ndonjë "të mirë" ("asset") në lidhje me të cilën mund të thuhet se ka pritje legjitime që ai do të jetë në gjendje ta gëzojë atë. (Shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Kopecký kundër Sllovakisë* të 28.9.2004, kërkesa nr. 44912/98, para. 40, 41, 42).

91. Gjykata gjithashtu thekson se nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së mund të konkludohet se doktrina e pritjeve legjitime vlerësohen brenda një konteksti nëse pritjet legjitime mbështeten në një akt juridik të pushtetit (baza e pritjeve legjitime) i justifikuar në kuptimin që ai mund të supozojë se ligji ose norma nuk do të anulohet më pas (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ *Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët kundër Irlandës*).

92. Gjykata, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës në rastin në fjalë, si bazë për pretendimet e supozuara legjitime, që i kanë ushtruesit e funksioneve noteriale, e ka bazuar në ligjin e vjetër për noterët, konstaton që "pritjet legjitime", vetvetiu, sipas praktikës së

GJEDNJ-së, nuk u garantojnë që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ *X kundër Gjermanisë*, vendimi i vitit 1979, kërkesa nr. 8410/78).

93. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ndryshimi i ligjit për noterët është proporcional: i) sepse ndryshimi është në kuadër vlerësimit të lirë ligjor të ligjvënësit, ii) ligjvënësi, në kuadër të politikës së pensionimit, ka bërë harmonizimin me kuadrin ligjor ekzistues, iii) profesioni i noterit nuk ka specifika të tilla që do të nxisnin ligjvënësin të bënte një hap të veçantë në devijimin nga politika e pensionimit, e cila është paraparë me kuadrin ligjor ekzistues në Kosovë.

94. Përveç kësaj, Gjykata vëren se korniza e lartpërmendur ligjore i barazon vitet e pensionimit, konkretisht neni 67, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, parashikon se "Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet, mes tjerash, kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç". Gjykata po ashtu vëren se neni 91 (1) i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, parashikon se: "*Mosha e pensionimit e nëpunësve civilë, si të gjinisë mashkullore ashtu edhe të asaj femërore, është* gjashtëdhjetepesë *(65) vjeç*". Kjo nënkupton se ligjvënësi me ndryshimin e moshës së pensionimit të noterëve nga mosha 70 vjeç në moshën 65 vjeç ka vepruar brenda hapësirës së tij të vlerësimit dhe në mënyrë proporcionale sepse: (i) ka harmonizuar moshën e pensionimit në pajtim me legjislacionin përkatës; (ii) caktimi i moshës së pensionimit të noterëve në moshën 65 vjeç nuk përbën barrë individuale dhe të tepruar ndaj tyre; (iii) ndryshimi i dispozitës ligjore te pensionimi i noterëve nga mosha 70 vjeç në moshën 65 vjeç-sikurse të punësuarit tjerë në Republikën e Kosovës-nuk rezulton të jetë pa bazë të arsyeshme; dhe, (iv) rrjedhimisht nuk është cenuar thelbi i të drejtës për gëzim paqësor të pronës.

95. Në dritën e sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se ndryshimi i ligjit në ndonjë mënyrë shkaktoi shkelje të të drejtave në kontekstin e "pritjeve legjitime" në pajtim me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

ii) zbatimi retroaktiv i zgjidhjes së re ligjore në lidhje me moshën e daljes në pension të ushtruesve të funksioneve noteriale

96. Gjykata rikujton që retroaktiviteti në ligj nënkupton zbatimin e një norme ligjore për ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes së saj në fuqi. Normat ligjore zbatohen për të ardhmen (*pro futuro*), që nga momenti më i hershëm i nxjerrjes. Zbatimi retroaktiv i normave ligjore paraqet

përjashtim nga parimi që normat ligjore nuk mund të kenë fuqi kthyese.

97. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ligjvënësi ka parashikuar që neni 76 i Ligjit të kontestuar prodhon efekt juridik në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri për noterinë, me çka konkludohet që ligjvënësi nuk e ka ndarë posaçërisht nenin 76 të ligjit të kontestuar, duke i dhënë afate të posaçme, të ndryshme kohore për zbatimin e tij, të cilat do të ndryshonin nga afatet kohore për hyrjen në fuqi të ligjit për noterinë.

98. Kështu, mund të konkludohet me siguri se neni 76 i ligjit të kontestuar nuk ka devijime nga tërësia e ligjit lidhur me afatet kohore për hyrjen në fuqi dhe njëkohësisht si pjesë përbërëse e ligjit prodhon efekt juridik për të ardhmen (*pro futuro*).

99. Megjithatë, krahas faktit se neni 76 i Ligjit të kontestuar vepron *(pro futuro)*, ashtu që ligji nuk ka efekt prapaveprues, Gjykata vëren se, megjithatë, me zgjidhjen e re ligjore për pensionim, me të cilën noterëve u shkurtohet mosha e pensionimit, nga 70 (shtatëdhjetë) në 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjet, kufizohen pritjet e tyre legjitime në lidhje me të drejtën në pronë, dhe atë, të atyre noterëve të cilët të drejtën e ushtrimit të funksionit të noterisë e kanë arritur me ligjin e vjetër, me të cilin kanë pasur të drejtë që ta ushtrojnë funksionin e noterit deri në moshën 70 (shtatëdhjetë) vjeçare.

100. Në lidhje me këtë, Gjykata shton se, efekti të cilin e prodhon neni 76 i Ligjit të kontestuar në disa ushtrues të shërbimit të noterisë, në vetvete nuk ndikon në thelbin e të drejtave të tyre në pronë, sepse vetëm kufizimi i të drejtave në pronë sa u përket pritjeve të tyre legjitime, nuk nënkupton automatikisht shkeljen e të drejtave në pronë, e që Gjykata vetëm se e ka arsyetuar në paragrafët e lartpërmendur 76 dhe 77 të këtij Aktgjykimi. (Shih mutatis mutandis Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. KO142/16, i 18 korrikut 2017, paragrafi 80).

101. Gjykata veçanërisht dëshiron të theksojë se Ligji, si akt i përgjithshëm juridik që rregullon marrëdhëniet e caktuara shoqërore është i kufizuar në hapësirë dhe kohë. Efekti prapaveprues i ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore, sipas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, ekziston në rastet kur ligji, rregulloret dhe aktet tjera zbatohen për marrëdhëniet që tashmë janë përfunduar para se rregullorja hyri në fuqi. Në sistemin juridik të vendit ka nevojë të vazhdueshme për ndryshime dhe plotësime të ligjeve ekzistuese, dhe nevoja për nxjerrjen e ligjeve të reja, të cilat kanë mënyra të ndryshme të përcaktimit të situatave ligjore në lidhje me ligjin e mëparshëm. Sipas rregullit të përgjithshëm, për arsye të sigurisë juridike, ligji i ri

zbatohet për kohën e ardhme. Objektivi kryesor i ndalimit kushtetues të efektit retroaktiv të ligjeve, sipas Gjykatës Kushtetuese, është mbrojtja e parimit të sigurisë juridike dhe mundësinë e një përjashtimi nga ky rregull, për mbrojtjen e interesave të justifikuara shoqërore.

102. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm thekson se "*ndryshimi retroaktiv i moshës së pensionimit për noterët konteston të drejtat pronësore të noterit dhe parimin e sigurisë juridike*".

103. Megjithatë, Gjykata tashmë ka shpjeguar se ndryshimet e përmendura hyjnë brenda fushëveprimit të vlerësimit të lirë ligjor të ligjvënësit dhe se barazimi i moshës së pensionimit të noterit me një person tjetër i cili është i punësuar nuk rezulton të jetë pa bazë të arsyeshme ose proporcionale. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk argumenton ndonjë veçanti të profesionit të noterit – për dallim nga profesionet e tjera - të cilat mund të detyrojnë ligjvënësin që t'u lejojë noterëve të kryejnë detyrat e tyre deri në moshën 70 vjeçare.

104. Prandaj, sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka pengesa kushtetuese dhe ligjore, për qëllim të interesit publik parësor – me legjislacionin e ri rregullohet mjedisi ligjor për ushtruesit e funksionit të noterit publik, dhe me këtë rregullohen edhe të drejtat e tyre, detyrimet, dhe çështjet që lidhen me daljen e noterëve në pension.

105. Gjykata thekson se, në pajtim edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është brenda fushëveprimit të saj që të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga ligjvënësi. Parimi i ndarjes së pushteteve obligon Gjykatën që të respektojë përcaktimin e politikave nga ligjvënësi. Ligjvënësi – për shkak të pozitës së tij dhe legjitimitetit demokratik – është në pozitë më të mirë se sa Gjykata për të përcaktuar dhe avancuar politikat e ekonomike dhe sociale të vendit (shih, *mutatis mutandis, Dubska dhe Krejzova kundër Republikës Çeke* [DHM], § 175).

106. Sa më sipër, Gjykata konsideron se ndryshimi i moshës së pensionimit të noterëve nga mosha 70 vjeç në moshën 65 vjeç nuk rezulton të jetë pa bazë të arsyeshme apo jo proporcional. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se neni 76 (2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim me garancitë e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së.

Përfundim

107. Gjykata në bazë të analizës së saj, konkludon:

i) se janë të pabazuara pretendimet parashtruesit të kërkesës se me nenin 32 të ligjit të kontestuar është shkelur neni 5 [Gjuhët] të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konkludon se neni 32 i ligjit të kontestuar (nuk është në kundërshtim) nuk i kufizon të drejtat sipas nenit 5 [Gjuhët] të Kushtetutës.

ii) se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar, është shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konkludon se paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të ligjit të kontestuar (nuk janë në kundërshtim) nuk kufizojnë të drejtat sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës,

iii) se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me nenin 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3), të ligjit të kontestuar janë shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konkludon se neni 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të ligjit të kontestuar (nuk janë në kundërshtim), nuk kufizojnë të drejtat sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së.

iv) Gjykata, duke marrë parasysh gjetjet e saj në lidhje me nenin 76 (paragrafi 2) të nenit 2 (paragrafi 7) dhe nenit 22 (paragrafi 1.3), të ligjit të kontestuar, gjithashtu konstaton se nuk ka bazë ligjore për qëndrim të mëtejmë në fuqi të masës së përkohshme të vendosur më 20 maj 2019, dhe e cila është vazhduar më 19 korrik 2019.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113. 2 (1) dhe 116.2 të Kushtetutës, nenet 27 (1), 29 dhe 30 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 29, 54, 55 dhe 56 (1), 57 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2019,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË njëzëri se nenet e kontestuara 32 (paragrafi 1), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4), në lidhje me nenet 2 (paragrafi 7) dhe 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/010 për Noterinë, nuk janë në kundërshtim me nenet 5 [Gjuhët], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës;

III. TË KONSTATOJË me shumicë votash se neni i kontestuar 76 (paragrafi 2) i Ligjit nr. 06/010 për Noterinë nuk është në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës;

IV. TA SHFUQIZOJË vendimin për caktim të masës së përkohshme të 20 majit 2019, të vazhduar më 19 korrik 2019, në lidhje me nenin 76 (paragrafi 2), nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/10 për Noterinë;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban Arta Rama-Hajrizi

KO124/19, Parashtrues i kërkesës: Kryeministri i Republikës së Kosovës, kërkesë për interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit

KO124/19, Aktvendim i miratuar më 4 shtator 2019, i publikuar më 16 shtator 2019

Fjalët kyç: *kërkesë institucionale, kompetencat e qeverisë, çështje kushtetuese, dorëheqja e kryeministrit, jurisdiksioni i gjykatës kushtetuese, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesi i kërkesës bazuar në nenin 93 (10) [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës parashtroi pyetje për interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit.

Gjykata së pari iu referua jurisprudencës së saj më të re përkitazi me pyetjet juridike të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata konsideroi se duhet vlerësuar nëse kërkesa e parashtruesit e bazuar në nenin 93 (10) është arsyetuar në kuadër të jurisdiksionit të Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Gjykata gjithashtu vuri në pah se kërkesa e tanishme e parashtruar në bazë të nenit 93 (10), sikurse edhe kërkesat tjera të ngjashme që më herët ishin dorëzuar në bazë të nenit 84 (9) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, duhet medoemos të arsyetohen në kuadër të jurisdiksionit të Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës.

Në këtë drejtim, Gjykata ritheksoi se përmbajtja e dispozitës së nenit 113 të Kushtetutës, marrë në tërësinë e saj, është e qartë dhe konkrete për sa u përket kompetencave të Qeverisë që dalin nga konteksti i palës së autorizuar në Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, me gjithë nevojën që mund të paraqitet në praktikë për interpretim lidhur më çështje tjera të rëndësishme përkitazi me kompetencat e Qeverisë, rezulton që neni 113 i Kushtetutës paraqet bazën themelore dhe të vetme jurisdiksionale të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me autorizimet e Qeverisë si palë e autorizuar për të dërguar çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata më tej theksoi se kërkesa e parashtruar, pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit, do të mund të shtrohej vetëm në kuadër të nenit 113, paragrafi 2, ku palët e autorizuara mund të kontestojnë në Gjykatë çështje që ndërlidhen me përputhshmërinë me Kushtetutën të dekreteve të

Kryeministrit, si dhe të rregulloreve të Qeverisë ose në bazë të nenit 113, paragrafi 3, si çështje që ndërlidhen me situata të konfliktit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe të Qeverisë.

Nga sa më sipër, Gjykata konkludoi se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës nuk hyjnë në fushëveprimin e jurisdiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht përkundër rëndësisë së tyre dhe dilemave legjitime që mund të ngritin, Gjykata nuk mund të jap përgjigje në pyetjet e parashtruara përderisa nuk janë parashtruar në Gjykatë sipas procedurave të parapara me Kushtetutë.

Rrjedhimisht, Gjykata përfundoi se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme për shkak se nuk hyn brenda kufijve të jurisdiksionit të saj të përcaktuar me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO124/19

Parashtrues

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Kërkesë për interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është kërkesa për interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit.

3. Parashtruesi i kërkesës i parashtroi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pyetjen si në vijim:

   (i) *"pas dorëheqjes së Kryeministrit, a mund të konsiderohet se situata e krijuar pas këtij akti, siç përcaktohet me nenin 95, paragrafi 5, është situatë analoge me situatën kur Qeveria konsiderohet në dorëheqje në kuptim të nenit 100, paragrafi 6 të Kushtetutës dhe shpërbërjes së Kuvendit, në kuptim të nenit 82, paragrafi 1, nën paragrafi 2[?]"* dhe

   (ii) *"cilat janë kompetencat dhe funksionimi i Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit?."*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 10 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], në lidhje me nenin 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Të njëjtën datë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

7. Të njëjtën datë, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi nga një kopje të kërkesës Presidentit të Republikës së Kosovës, shkëlqesisë së tij, z. Hashim Thaqi (në tekstin e mëtejmë: Presidenti) dhe Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit) me kërkesë që e njëjta t'iu dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit. Me atë rast, Gjykata e ftoi Presidentin dhe Kryetarin e Kuvendit dhe deputetët e Kuvendit që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 12 gusht 2019.

8. Më 13 gusht 2019, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejmë: LVV) të përfaqësuar nga deputetja Albulena Haxhiu, dorëzuan komentet e tyre në Gjykatë.

9. Më 14 gusht 2019, Gjykata i dërgoi një kopje të komenteve nga Grupi Parlamentar i LVV-së parashtruesit të kërkesës duke i dhënë

mundësinë për komente, nëse ka, si dhe i kërkoi që ta dorëzojë aktin e dorëheqjes si Kryeministër i Republikës së Kosovës, deri më 21 gusht 2019.

10. Të njëjtën datë, nga një kopje të komenteve nga Grupi Parlamentar i LVV-së, iu dërgua Presidentit, dhe Kryetarit të Kuvendit me kërkesë që kopja e komenteve t'iu shpërndahet deputetëve të Republikës së Kosovës.

11. Më 4 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 11 qershor 2017, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.

13. Më 8 korrik 2017, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend. Më 7 shtator 2017, me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve u konstituua Kuvendi.

14. Në të njëjtën ditë, Presidenti mandatoi Ramush Haradinaj, si kandidat i propozuar nga PDK, AAK dhe Nisma, për formimin e Qeverisë.

15. Më 9 shtator 2017, Kuvendi, me gjashtëdhjetë e dy (62) vota *"për"* zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës me Kryeministër Ramush Haradinaj.

16. Më 19 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 111-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, deklaroi dorëheqjen e parevokueshme nga pozita e Kryeministrit.

17. Më 22 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar zyrtarisht Presidentit dhe Kryetarit të Kuvendit, me njoftimin për dorëheqje nga pozita e Kryeministrit. Në paragrafin 3 të asaj letre, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se *"deri në zgjedhjen e Qeverisë së re, do ta kryej detyrën time kushtetuese si Kryeministër dhe Qeveri në dorëheqje"*.

Pretendimet e parashtruesit

Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 93 (10) [Kompetencat e Qeverisë] i Kushtetutës shprehimisht i jep Qeverisë kompetencë për të

referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Parashtruesi pretendon se: *"[...] Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës"*.

19. Parashtruesi i referohet aktgjykimit të kësaj Gjykate në rastin nr. KO98/11, me ç'rast përkitazi me kërkesën e dorëzuar bazuar në nenin 93 (10), Gjykata, mes tjerash, kishte konstatuar: "*nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë, Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme*".

20. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton: "*Nga autorizimi kushtetues i Qeverisë buron edhe e drejta e Kryeministrit për të ngritur çështje kushtetuese të cilat përndryshe nuk mund të ngritën në bazë të nenit 113, paragrafët 2 dhe 3 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Kjo nga fakti se ka akte juridike dhe rrethana që konsiderohen "çështje kushtetuese" por që formalisht nuk mund të ngritën pranë Gjykatës Kushtetuese sepse nuk kane formën e ligjit, dekretit, rregulloreve apo statutit të komunës (sipas nenit 113, paragrafi 2 i Kushtetutës). I tillë është rasti me "Dorëheqjen e Kryeministrit", akti i cili nuk është ligj apo dekret por është veprim që ka shkaktuar një efekt juridiko-politik me peshë që ekziston nevoja shoqërore për interpretim të Kushtetutës*".

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dorëheqja e kryeministrit, pas fjalimit dhe njoftimit të dërguar tek Presidenti dhe Kryetari i Kuvendit, mund të konsiderohet se bie në kuadër të jurisdiksionit material (*ratione materiae*) të Gjykatës duke qenë se çështjet e ngritura hyjnë në rrethin e çështjeve kushtetuese siç edhe është reflektuar në rastet nr. KO80/10 dhe KO103/14 të kësaj Gjykate. Parashtruesi i kërkesës shton: "*Është plotësisht e qartë që, karakteristikë e kriterit të "çështjes kushtetuese", gjë e përcaktuar edhe me rastet e lartpërmendura, është që çështja të hyjë në fushëveprimin e Kushtetutës së Republikës se Kosovës si në kuptimin e shkronjës ashtu edhe të frymës*".

22. Për sa i përket jurisprudencës më të re të Gjykatës, më konkretisht rastin nr. KO79/18, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, pohon: "*Në Aktvendimin Nr. KO79/18, Gjykata Kushtetuese përmend frazën "në përbërjen e saj aktuale" duke lënë të kuptohet se ekziston konsensusi i tanishëm i brendshëm që të trajtohen vetëm çështjet që burojnë nga neni 113 që shpërfaqë diskrecionin e Gjykatës që vetë të definojë "çështjet kushtetuese". Gjithashtu në të njëjtin vendim paraqitet një vështrim historik i pranimit të "çështjeve kushtetuese".*

23. Në fund, parashtruesi i kërkesës pohon se kërkesa e tanishme bie në radhën e çështjeve kushtetuese që ndikojnë në ndarjen e pushteteve, ruajtjen e rendit kushtetues dhe shtetndërtimit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"[...] Gjykata me herët i ka trajtuar dhe duke marrë parasysh se Gjykata ka cekur se ka diskrecion në definimin e ngushtë apo të gjerë të "çështjeve kushtetuese", ky diskrecion në këtë rast duhet të përdoret në definimin e gjerë të pranueshmërisë. Kjo për shkak se shtetndërtimi duhet të kuptohet in perpetuum dhe "nevojat shoqërore që Gjykata të përfshihet në interpretime të neneve specifike të Kushtetutës" nuk duhet të reflektojnë me kohën e veprimit, përbërjen aktuale e as evoluimin e diskrecionit të Gjykatës Kushtetuese".*

Përkitazi me meritat e kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kushtetuta nuk përcakton kompetencat e Qeverisë në dorëheqje si dhe në mungesë të Ligjit për Qeverinë, situatat e tilla mbesin juridikisht të parregulluara. Parashtruesi i kërkesës për sa i përket nenit 95 (5) [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës shton: "*Kushtetuta nuk përcakton nëse, në rastin e cekur si më lartë, Qeveria konsiderohet në dorëheqje, ashtu siç është rasti kur votohet mocioni i mosbesimit për Qeverinë në tërësi, i përcaktuar me nenin 100, paragrafi 6 të Kushtetutës*".

25. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pohon se në periudhën para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, ka paraparë situatën e Qeverisë në dorëheqje, e cila në pjesën 3, pika 9.3.13, kishte përcaktuar: "*Pas dorëheqjes së Kryeministrit, e gjithë Qeveria jep dorëheqjen. Qeveria vazhdon cilësinë e Kryeministrit të përkohshëm deri në zgjedhjen e Kryeministrit të ri*".

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në kuptim të nenit 95 (5) të Kushtetutës, shkarkimi i Qeverisë, nënkupton kalimin e suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë nga Kuvendi. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Lidhur me kuptimin e nenit 95, paragrafi 5 të Kushtetutës, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me autorë Prof. Dr. Enver Hasani / Prof. Dr. Ivan Čukalović, thotë se "Në kuptim të nenit 95.5, Qeveria bartet nga Kryeministri, dhe shkarkimi, dorëheqja apo mbetja e ulëses së Kryeministrit vakante, sjell ipso iure pasojën e konsiderimit të Qeverisë si të shkarkuar".*

27. Për sa i përket nenit 100 (6) [Mocioni i Votëbesimit] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Po që se marrim për bazë praktikën e deritanishme të zbatimit të Kushtetutës ne situatat e përcaktuara me nenin 100 (kur ka kaluar mocioni i suksesshëm i*

mosbesimit) apo ne rastet sipas nenit 82 paragrafi 1, nën paragrafi 2, (kur Kuvendi vetë ka vendosur për shpërbërjen), pra, në të dyja këto situata, Qeveria (Qeveria Thaqi I, Qeveria Thaqi II, Qeveria Mustafa), gjatë periudhës prej kalimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, gjegjësisht shpërbërjes së Kuvendit, deri në zgjedhjen e Qeverisë së re, ka vazhduar të ushtrojë funksionin, të organizojë dhe të mbajë mbledhje të rregullta të Qeverisë, duke u kufizuar nga ushtrimi i plotë i kompetencave kushtetuese, si p. sh. nuk ka miratuar projektligj".

28. Parashtruesi i kërkesës po ashtu iu referohet dispozitave kushtetuese e ligjore të vendeve në rajon siç janë Republika e Shqipërisë, Republika e Kroacisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, për çështje që rregullojnë kompetencat e qeverive në dorëheqje.

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i LVV-së

29. Grupi Parlamentar i LVV-së, në komentet e tyre lidhur me kërkesën theksojnë se parashtruesi i kërkesës në asnjë rast nuk mund të dërgojë çështje kushtetuese nëse çështja nuk përcaktohet në nenin 113 të Kushtetutës. Sipas grupit parlamentar të LVV-së , nga përmbajtja e kërkesës mund të konstatohet se ajo "*prima facie*" nuk bie nën jurisdiksion të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës.

30. Duke iu referuar jurisprudencës më të re të Gjykatës, më konkretisht Aktvendim për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO79/18, *Presidenti i Republikës së Kosovës,* të 21 nëntorit 2018, për çështje të jurisdiksionit të përcaktuar me nenin 1113 të Kushtetutës, Grupi Parlamentar i LVV-së, pohuan se parashtruesi i kërkesës nuk mund ta shfrytëzojë nenin 93 (10) të Kushtetutës për të referuar çështje në Gjykatë nëse çështja nuk bie në fushëveprimin e nenit 113 të Kushtetutës. Ata shtuan se këtë lloj referimi të çështjeve kushtetuese nuk ka mundur ta shfrytëzojë as Presidenti duke u bazuar në nenin 84 (9) të Kushtetutës.

31. Po ashtu, duke iu referuar jurisprudencës më të re të Gjykatës, më konkretisht Aktvendim për papranueshmëri në rastin KO131/18, *Presidenti i Republikës së Kosovës,* i 6 marsit 2019, për çështje të jurisdiksionit të përcaktuar me nenin 1113 të Kushtetutës, Grupi Parlamentar i LVV-së, shtuan: *"[...] sipas Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, autoriteti i Presidentit për të referuar çështje kushtetuese duhet të kuptohet në lidhje dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me jurisdiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës dhe se dispozita kushtetuese e përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës ku thuhet se*

Presidenti mund të "referojë çështje kushtetuese" – është e ndërlidhur me nenin 113 të Kushtetutës".

32. Përfundimisht, Grupi Parlamentar i LVV-së, konsiderojnë: *"[...] Meqenëse asnjë veprim ose mosveprim juridik (çështje kushtetuese) i parashtruesit (Kryeministrit në dorëheqje) nuk bie në nenin, 113, të Kushtetutës, konkretisht jurisdiksionit të Gjykatës Kushtetuese, Grupi Parlamentar i [LVV-së] konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk ka mbështetje kushtetuese dhe ligjore [...] Gjykata Kushtetuese duhet të nxjerrë Aktvendim për Papranueshmëri me të cilën do të vendosë që kërkesa të tilla pa kuptim dhe jashtë çdo logjike juridike t'i deklaroi si të papranueshme*".

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata fillimisht vlerëson nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe saktësuar më tej në Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

34. Neni 113, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton që *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

35. Gjykata thekson që Qeveria është palë e autorizuar sipas nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës.

36. Në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës, "*Kuvendi i Kosovë, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria, dhe Avokati i Popullit, janë të autorizuar të ngrejë rastet në vijim*:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit, dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës më Kushtetutën.

37. Më tej, neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës, përcakton që *[...], Qeveria [...][është e] autorizuar të ngrejë çështjet në vijim:*

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

38. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, shprehimisht parashohin rastet që Qeveria mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese.

39. Në lidhje me rastin konkret Gjykata rikujton se parashtruesi në kërkesën e tanishme kërkon *"Interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dorëheqjes së Kryeministrit"*.

40. Parashtruesi i kërkesës, më konkretisht para Gjykatës ngrit pyetjen në vijim:

> *"pas dorëheqjes së Kryeministrit, a mund të konsiderohet se situata e krijuar pas këtij akti, siç përcaktohet me nenin 95, paragrafi 5 [të Kushtetutës], është situate analoge me situatën kur Qeveria konsiderohet në dorëheqje në kuptim të nenit 100, paragrafi 6 të Kushtetutës dhe shpërbërjes së Kuvendit, në kuptim të nenit 82, paragrafi 1, nënparagrafi 2, rrjedhimisht, cilat janë kompetencat dhe funksionimi i Qeverise pas dhënies së dorëheqjes se Kryeministrit?"*

41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, lidhur me pranueshmërinë e kërkesës thekson se: "*Neni 93, paragrafi 10, i Kushtetutës [...] shprehimisht i jep Qeverisë kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës."*

42. Në mbështetje të argumenteve të tij, parashtruesi i kërkesës më tej shton se *"sipas vendimit te Gjykatës Kushtetuese në rastin KO98/11, ku ka shqyrtuar pranueshmërinë e kërkesës së bërë nga Qeveria e Kosovës sipas nenit 93, paragrafi 10 te Kushtetutës, ka vendosur qe "nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë, Qeveria do te jete palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme." sipas nenit 93, paragrafi 10 të Kushtetutës."*

43. Prandaj parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa duhet të shpallet e pranueshme pasi *"dorëheqja e Kryeministrit"* bie në radhën e *"çështjeve kushtetuese" dhe qartësimi i kësaj çështje ka ndikim në "ndarjen e pushteteve dhe në ruajtjen e rendit kushtetues"*.

44. Në lidhje me këtë, ashtu siç me të drejtë specifikohet në përmbajtjen e kërkesës së parashtruesit, Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113, paragrafit 1 të Kushtetutës ka jurisdiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

45. Në këtë kuptim, Gjykata është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112, paragrafit 1 të Kushtetues, në lidhje me rastet e ngritura para saj sikurse përcaktohet me nenin 113. Lidhur më këtë, Gjykata e ka bërë të qartë se ajo nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO79/18, *Presidenti i Republikës së Kosovës,* Aktvendim për papranueshmëri i 21 nëntorit 2018).

46. Në lidhje me kuptimin dhe me kufijtë e nenit 93, paragrafit (10) të Kushtetutës, e cila thekson se Qeveria mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatë Kushtetuese, në të cilin thirret parashtruesi, Gjykata thekson se kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda jurisdiksionit të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3.

47. Gjykata, ashtu si ka potencuar parashtruesi në kërkesë, në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore, duke aplikuar kuptimin e të nocionit *"çështje kushtetuese"*, kishte shqyrtuar kërkesa që nuk përfshihen shprehimisht në kufijtë e jurisdiksionit të saj të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykatës i ishte parashtruar një kërkesë nga Qeveria lidhur me imunitetin e deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të cilat Gjykata ka vlerësuar se përbëjnë *"çështje kushtetuese"*. (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KO98/11, *Qeveria e Republikës së Kosovës;* Aktgjykim i 20 shtatorit 2011). Gjithashtu, Gjykatës i ishte kërkuar nga Presidenti e Republikës që të interpretojë kuptimin e dispozitave specifike të

Kushtetutës (shih, p. sh., rastin nr. KO80/10, *Presidenti i Republikës së Kosovës;* Aktgjykim i 7 tetorit 2010; rasti nr. KO97/10, *Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 28 dhjetorit 2010; rasti nr. KO57/12, *Presidentja* e *Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 22 tetor 2012; rasti nr. KO103/14, *Presidentja* e *Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 1 korrikut 2014)·

48. Mbi bazën e këtij qëndrimi, Gjykata kishte shpallur si të papranueshme kërkesat e paraqitura nga Presidenti i Republikë së Kosovës, mbi bazën e nenit 84, paragrafit 9 të Kushtetutës, pasi kishte vlerësuar se ato nuk binin në kufijtë e nenit 113, paragrafin 2 dhe 3 të Kushtetutës., dhe rrjedhimisht nuk mund të shqyrtoheshin nga Gjykata (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KO79/18, *Presidenti i Republikës së Kosovës,* Aktvendim për papranueshmëri i 21 nëntorit 2018; KO131/18, *Presidenti i Republikës së Kosovës,* Aktvendim për papranueshmëri i 6 marsit 2019; dhe, KO181/18, *Presidenti i Republikës së Kosovës,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershori 2019).

49. Për me tepër, Gjykata vëren se praktika gjyqësore e Gjykatës e vendosur në rastin e Gjykatës KO79/18, të cekur më lart, ishte e njohur edhe për Parashtruesin e kërkesës. _Lidhur me këtë, Gjykata vëren se në përgjigjen e tij lidhur me kërkesën e Presidentit të Republikë së Kosovës, në rastin KO181/18, të cekur më lart, Kryeministri kishte deklaruar se *"edhe këtë herë si në rastin KO79/18 [Presidenti] ka mbështetur referimin në nenin 84 paragrafin 9, si dhe në nenin 112, paragrafi 1, të Kushtetutës. Për këtë rast të veçantë, gjithnjë sipas sqarimit të Gjykatës Kushtetuese, theksohet shprehimisht se ajo nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose me mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës.*

[...]
Andaj, duke marrë parasysh bazën mbi të cilën është parashtruar kërkesa, duke mos mohuar të drejtën e Presidentit të ngrisë çështje para Gjykatës, shihet se kërkesa nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë për shkak të mungesës së bazës themelore jurisdiksionale të Gjykatës në lidhje me autorizimet e Presidentit si palë e autorizuar e që rrjedhin kryekëput nga neni 113 i Kushtetutës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO181/18, *të cekur më lart,* paragrafi 33 dhe 34).

50. Andaj, Gjykata rithekson se përmbajtja e dispozitës së nenit 113 të Kushtetutës, marrë në tërësinë e saj, është e qartë dhe konkrete për sa u përket kompetencave të Qeverisë që dalin nga konteksti i palës së autorizuar para Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, me gjithë

nevojën që mund të paraqitet në praktikë për interpretim lidhur më çështje tjera të rëndësishme përkitazi me kompetencat e Qeverisë, rezulton që neni 113 i Kushtetutës paraqet bazën themelore dhe të vetme jurisdiksionale të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me autorizimet e Qeverisë si palë e autorizuar para Gjykatës Kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO79/18, të cekur më lart, paragrafi 78).

51. Andaj, në rastin konkret, Gjykata rikujton edhe një herë se me kërkesë parashtruesi i kërkesës kërkon *"Interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dorëheqjes së Kryeministrit"*.

52. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruar nuk bie në kufijtë dhe nuk është arsyetuar në kuadër të nenit 113, dhe këtë gjë e konfirmon edhe parashtruesi i kërkesës, për shkak se në bazë të nenit 113, paragrafi 2, Qeveria mund të ngrejë çështje që ndërlidhen me përputhshmërinë me Kushtetutën të ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit, si dhe të rregulloreve të Qeverisë të përcaktuara në 113.2 (1), si dhe të Statutit të Komunës, të përcaktuar në 113.2 (2) të Kushtetutës.

53. Ndërsa, në bazë të nenit 113, paragrafi 3, Qeveria është e autorizuar të ngrejë çështje që ndërlidhen me situata të konfliktit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe të Qeverisë; përputhshmërinë e referendumit me Kushtetutën; përputhshmërinë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë kësaj gjendjeje, me Kushtetutën; përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet ndërkombëtare dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur; si dhe kushtetutshmërinë e procesit të zgjedhjes së Kuvendit.

54. Gjykata thekson se çështja e statusit juridik të Qeverisë, pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit, do të mund të shtrohej para Gjykatës vetëm nëse ajo ngritët në kuadër të nenit 113, paragrafi 2, ku palët e autorizuara mund të kontestojnë para Gjykatës çështje që ndërlidhen me përputhshmërinë me Kushtetutën të dekreteve të Kryeministrit , si dhe të rregulloreve të Qeverisë ose në bazë të nenit 113, paragrafi 3, si çështje që ndërlidhen me situata të konfliktit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe të Qeverisë.

55. Prandaj, bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata konkludon se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk hyjnë në fushëveprimin e jurisdiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht përkundër

rëndësisë së tyre dhe dilemave legjitime që mund të ngritin, Gjykata nuk mund të jap përgjigje në pyetjet e parashtruara përderisa nuk janë parashtruar në Gjykatë sipas procedurave të parapara me Kushtetutë.

56. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, me rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Arta Rama-Hajrizi

KI48/18, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U.ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017

KI 48/18, parashtrues Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Aktgjykim i datës 23 janar 2019

Fjalët kyçe: *kontest zgjedhor, zgjedhje lokale, kryetar komune, të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, mbrojtja gjyqësore e të drejtave*

Kërkesa KI48/18 u parashtrua nga z. Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Z. Arban Abrashi ishte kandidat për Kryetar të Komunës në zgjedhjet lokale të vitit 2017 dhe para kësaj Gjykate u paraqit në cilësinë e individit, përkatësisht personit fizik; ndërkaq, Lidhja Demokratike e Kosovës ishte subjekti politik përmes të cilit z. Arban Abrashi garonte për Kryetar të Komunës së Prishtinës dhe para kësaj Gjykate u paraqit si subjekt politik, përkatësisht person juridik.

Parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretenduan se Gjykata Supreme, por edhe PZAP-i, në procedurat e zhvilluara për shqyrtimin e ankesave dhe apeleve të tyre, kanë dështuar të ofrojnë mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe, për pasojë, vendimet e këtyre autoriteve publike, kanë rezultuar në shkelje të të drejtave të tyre zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita pasi konstatoi se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara; kontestojnë vendime të autoriteteve publike; kanë shteruar mjetet juridike siç është elaboruar në Aktgjykim; kanë saktësuar të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendojnë se janë shkelur; kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit; kërkesa nuk është qartazi e pabazuar; dhe Gjykata nuk gjeti asnjë kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar. Si rrjedhojë, kërkesa e kaloi testin e pranueshmërisë dhe u shpall e pranueshme për shqyrtim në merita.

Para shqyrtimit të meritave të rastit, Gjykata e trajtoi çështjen e juridiksionit të saj lidhur me kontestet zgjedhore. Në këtë drejtim, Gjykata sqaroi kompetencën e saj kushtetuese për sa i takon kërkesave individuale lidhur me kontestet zgjedhore, duke theksuar se ajo në këtë aspekt, është e kufizuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të

Kushtetutës, përkatësisht në vlerësimin nëse një akt i autoritetit publik mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë themelore përkatëse individuale dhe pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Gjykata më pas trajtoi të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës në veçanti dhe në tërësinë e tyre, duke aplikuar mbi këtë vlerësim: (i) garancitë kushtetuese që ndërlidhen me të drejtat e kontestuara, nenin 45 e 54 të Kushtetutës, respektivisht; (ii) parimet themelore që rezultojnë nga trashëgimia evropiane për zgjedhje demokratike të përmbledhura nga Komisioni i Venecias; dhe (iii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Pas aplikimit të këtyre garancive, parimeve dhe testeve të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata njëzëri konstatoi se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, nuk kanë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe të drejtën për mjet juridik të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), sepse në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Supreme, drejtë kishte vlerësuar çështjet që ndërlidhen me: (i) konfirmimin/anulimin e rezultatit zgjedhor; (ii) shpalljen e pasaftshme të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidheshin me parregullsitë në ditën e votimit, e të cilat ishin paraqitur për herë të parë në PZAP, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar; dhe (iii) fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta, pasi PZAP-i kishte hetuar materialin zgjedhor në qendrat e kontestuara të votimit dhe kishte konstatuar se parregullsitë nuk *"kanë ndikim në rezultatin final*". Për më tepër, vendimet e Gjykatës Supreme ishin "*mjaftueshëm të arsyetuara*" në raport me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe në harmoni me standardet e përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias, për sa i përket arsyetimit të vendimeve në konteste zgjedhore. Konstatimet e Gjykatës Supreme u konsideruan të jenë në përputhshmëri me garancitë kushtetuese, me praktikën gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së dhe me parimet themelore të Komisionit të Venecias e që ndërlidhen me një "*sistem efektiv ankesash*", si pjesë përbërëse të "*garancive procedurale*", kusht ky thelbësor për jetësimin e pesë parimeve themelore që ndërlidhen me cilësitë e votës.

Gjykata po ashtu njëzëri konstatoi se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk kanë shkelur të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje të drejtën për zgjedhje të lira të garantuar me neni 3 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së, sepse, në rrethanat e rastit konkret, të njëjtat nuk janë nxjerrë në kundërshtim me: (i) kushtet për mbrojten e parimeve themelore për cilësitë e votës, siç janë të garantuara me Kushtetutë, ligje zgjedhore dhe Kodin e

Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias; (ii) kushtin e "*garancive procedurale*" për jetësimin e parimit të "*votës së lirë*" dhe "*votës së barabartë*"; (iii) "*parimin e transparencës*" në konteste zgjedhore, siç është përcaktuar nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të parimeve themelore të Komisionit të Venecias; dhe (iv) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të "*të drejtave pas-zgjedhore*".

Gjykata po ashtu, njëzëri, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për seancë dëgjimore sepse nuk konsideroi se kishte ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"*. Gjykata konstatoi se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.

Si rrjedhojë, në fund, Gjykata, njëzëri konstatoi se: (i) Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017 i Gjykatës Supreme nuk është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të subjektit politik LDK, dhe është në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 45 e 54 të Kushtetutës; dhe se (ii) Aktgjykimi [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i 7 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme nuk është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të z. Arban Abrashi dhe të subjektit politik LDK, dhe është në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore e tyre të garantuara me nenet 45 e 54 të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI48/18

Parashtrues

Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të
7 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Arban Abrashi, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës në zgjedhjet lokale të vitit 2017 (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i parë i kërkesës), si dhe nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i dytë i kërkesës).

2. Parashtruesi i parë i kërkesës si dhe parashtruesi i dytë i kërkesës (në tekstin e mëtejmë kur Gjykata iu referohet bashkërisht: parashtruesit e kërkesës), përfaqësohen nga z. Durim Berisha.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin [AA. nr. 52/2017] e 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimin [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] e 7 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

4. Përmes Aktvendimit [AA. nr. 52/2017] të 25 nëntorit 2017 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i parë i Gjykatës Supreme) ishte pranuar si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe ishte ndryshuar Vendimi [ZL. A. nr. 1102/2017] i 22 nëntorit 2017 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), në të cilin palë në procedurë ishte vetëm subjekti politik LDK, përkatësisht parashtruesi i dytë i kërkesës; ndërsa, përmes Aktgjykimit [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] të 7 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme) ishte refuzuar, si e pabazuar, ankesa e të dy parashtruesve të kërkesës e paraqitur kundër Vendimit [ZL. Anr. 1125/2017] të 1 dhjetorit 2017 të PZAP-it.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartpërmendura, me të cilat, sipas pretendimit, parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

7. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) miratoi, në seancë administrative,

plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018, dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

8. Më 29 mars 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

9. Më 30 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 4 prill 2018, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që të sqarojë se a e përfaqëson edhe parashtruesin e dytë të kërkesës në procedurat para Gjykatës, pasi që kishte dorëzuar autorizim vetëm për parashtruesin e parë të kërkesës. Në rast të përgjigjes pozitive, Gjykata e ftoi të dorëzojë një autorizim që dëshmon këtë gjë. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës të dorëzojë në Gjykatë kopjen e Aktvendimit [AA. nr. 52/2017] të 25 nëntorit 2017 të Gjykatës Supreme. Për sqarimet e mësipërme si dhe për dokumentacionin shtesë të kërkuar, Gjykata i caktoi parashtruesve të kërkesës një afat prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës njoftuese.

11. Më 10 prill 2018, Posta e Kosovës e ktheu zarfin në Gjykatë dhe e njoftoi atë se dorëzimi i shkresës njoftuese të 4 prillit 2018 ka dështuar, meqë adresa e dhënë nga parashtruesit e kërkesës në formularin e dorëzuar në Gjykatë ishte jo e plotë.

12. Më 13 prill 2018, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës iu drejtua Gjykatës përmes postës elektronike dhe kërkoi që të gjitha komunikimet dhe shkresat përkitazi me kërkesën KI48/18 t'i dërgohen nëpërmjet postës elektronike. Në bazë të kësaj kërkese, në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të njoftimit të 4 prillit 2018.

13. Më 13 prill 2018, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës e dorëzoi kopjen e Aktvendimit të kërkuar.

14. Më 23 prill 2018, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës e dorëzoi autorizimin për përfaqësimin e parashtruesit të dytë në procedurat para Gjykatës.

15. Më 27 prill 2018, Gjykata i dërgoi nga një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe PZAP-it. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi z. Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës dhe kandidat i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për Kryetar të Komunës së Prishtinës në zgjedhjet lokale të vitit 2017, në cilësinë e palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës si dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e tij, nëse ka, në afat prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës njoftuese.

16. Më 11 maj 2018, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata, z. Shpend Ahmeti dorëzoi komentet e tij në Gjykatë.

17. Më 14 maj 2018, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për pranimin e komenteve nga z. Shpend Ahmeti si dhe ua dërgoi një kopje të tyre.

18. Më 31 maj 2018, Gjykata pranoi komente shtesë nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me komentet e dorëzuara nga z. Shpend Ahmeti.

19. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

20. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

21. Më 14 shtator 2018, Gjykata e njoftoi z. Shpend Ahmeti për pranimin e komenteve shtesë nga parashtruesit e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të tyre.

22. Më 14 shtator 2018, Gjykata e njoftoi Lëvizjen VETËVENDOSJE!, në cilësinë e palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës së bashku me nga një kopje të komenteve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës dhe nga z. Shpend Ahmeti. Gjykata e ftoi atë që të dorëzojë komentet e saj, nëse ka, në afat prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës njoftuese. Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk dorëzoi komente në Gjykatë.

23. Më 26 tetor 2018, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur iu kaloi mandati i tyre si gjyqtar të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë

të Ligjit dhe Rregullores së punës, caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

24. Më 20 dhjetor 2018, gjyqtari Bajram Ljatifi kishte kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës që të përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës nr. KI48/18, sepse më herët kishte qenë pjesë e vendimmarrjes për të njëjtën kërkesë përkitazi me procedurat e zhvilluara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ).

25. Më 21 dhjetor 2018, Kryetarja, në pajtim me nenin 18.1 (1.3) të Ligjit dhe me rregullin (9) të Rregullores së punës, nxori vendim nëpërmjet të cilit u aprovua kërkesa për përjashtim nga procesi i shqyrtimit dhe i vendimmarjes lidhur me rastin KI48/18.

26. Më 22 janar 2019, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për mbajtjen e seancës dëgjimore.

27. Më 23 janar 2019, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

28. Në të njejtën ditë, Gjykata votoi njëzëri, se kërkesa është e pranueshme, dhe se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimi [A.A. UZH. nr. 62/2017] i 7 dhjetorit 2017, janë në përputhshmëri me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

29. Në të njejtën ditë, Gjykata votoi njëzëri, për të refuzuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për seancë dëgjimore.

Përmbledhja e fakteve

30. Më 22 tetor 2017, u mbajt raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i parë i kërkesës, z. Arban Abrashi, ishte kandidat i LDK-së për Kryetar të Komunës së Prishtinës. Parashtruesi i dytë i kërkesës, LDK, ishte subjekt politik i cili garonte në Komunën e Prishtinës nëpërmjet kandidatit të saj, z. Arban Abrashi.

31. Rezultatet përfundimtare të raundit të parë zgjedhor përcaktuan se gara për Kryetar të Komunës së Prishtinës do të vendosej nga rezultati i raundit të dytë zgjedhor (balotazhit), që do të zhvillohej ndërmjet dy kandidatëve me më së shumti vota në raundin e parë, përkatësisht ndërmjet parashtruesit të parë të kërkesës, z. Arban Abrashi, dhe z. Shpend Ahmeti, kandidat i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për Kryetar të Komunës së Prishtinës.

32. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve lokale, ku për Kryetar të Komunës së Prishtinës garuan dy kandidatët e lartpërmendur.

33. Sipas rezultateve preliminare të shpallura nga KQZ-ja, z. Shpend Ahmeti kishte akumuluar 41.401 vota, ndërsa z. Arban Abrashi 41.164 vota. Rezultatet preliminare të shpallura nga KQZ-ja, në këtë fazë të procesit, nuk përfshinin votat me kusht, votat me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta. Diferenca në vota në këtë fazë të procedurave zgjedhore ishte gjithsej 237 vota më shumë për z. Shpend Ahmeti.

Procedura pas shpalljes së Rezultateve Preliminare të raundit të dytë (balotazhit) të zgjedhjeve lokale të vitit 2017 për Kryetar të Komunës së Prishtinës

34. Më 20 nëntor 2017, parashtruesi i dytë i kërkesës parashtroi ankesë në PZAP. Nëpërmjet kësaj ankese, parashtruesi i dytë i kërkesës kërkoi që të bëhet verifikimi i të gjitha fletëvotimeve të cilat ishin cilësuar si fletëvotime të pavlefshme, sipas shkresave të lëndës, 610 sosh, dhe si fletëvotime të zbrazëta, sipas shkresave të lëndës, 473 sosh. Parashtruesi i dytë i kërkesës, nëpërmjet kësaj ankese, pretendonte se komisionerët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, duke ditur rezultatin e ngushtë ndërmjet kandidatëve, kishin shpallur një numër të konsiderueshëm të fletëvotimeve si të pavlefshme ose si të zbrazëta, e sipas pretendimit, "*përkundër faktit që në ato fletëvotime mund të vërehej qartë vullneti i shprehur i votuesit*".

35. Më 21 nëntor 2017, PZAP gjeti se ankesa e lartpërmendur e parashtruesit të dytë të kërkesës përbën një ankesë të përgjithësuar dhe si e tillë nuk mund të procedohet tutje për shqyrtim. Si rrjedhojë, PZAP i kërkoi parashtruesit të dytë të kërkesës që të plotësojë ankesën ashtu që të specifikojë me saktësi qendrat e votimit dhe vendvotimet në të cilat supozohet se janë shpallur fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta.

36. Në po të njëjtën ditë, më 21 nëntor 2017, parashtruesi i dytë i kërkesës, bëri plotësimin e ankesës sipas kërkesës së PZAP-it.

37. Më 22 nëntor 2017, PZAP nëpërmjet Vendimit [ZL. A. nr. 1102/2017] pranoi, si të bazuar, ankesën e parashtruesit të dytë të kërkesës. Mbi bazën e kësaj ankese, PZAP-i urdhëroi KQZ-në që të rinumërojë/rivlerësojë fletëvotimet e: (i) shpallura si të pavlefshme; (ii) përdorura nga votuesit por të paplotësuara, rrjedhimisht të zbrazëta; si dhe (iii) regullta në vendvotimet e specifikuara në Vendimin përkatës. PZAP-i kërkoi nga KQZ-ja që vlerësimi i fletëvotimeve të shpallura si të pavlefshme si dhe i fletëvotimeve të konsideruara si të zbrazëta, të bëhet konform Doracakut të Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së si dhe në prezencë të vëzhguesve të akredituar, përfshirë ata të LDK-së dhe të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Në fund, PZAP-i urdhëroi që rezultati i cili del nga rinumërimi dhe rivlerësimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar që do të shpallet nga KQZ-ja. Këtë Vendim të saj, PZAP-i e arsyetoi duke u bazuar në "*numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta*" dhe në "*rezultatin e ngushtë në mes të dy kandidatëve*".

38. Brenda afatit 24-orësh, Lëvizja VETËVENDOSJE! paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme dhe kërkoi që të anulohet Vendimi i lartpërmendur i PZAP-it si dhe të urdhërohet PZAP-i dhe KQZ-ja që të vazhdojnë numërimin e votave me kusht dhe me postë për kandidatët për Kryetar të Komunës së Prishtinës. Brenda po të njëjtit afat, PZAP-i parashtroi përgjigje ndaj ankesës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe kërkoi që ankesa e kësaj të fundit të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i kontestuar i PZAP-it të vërtetohet nga Gjykata Supreme.

39. Më 25 nëntor 2017, Gjykata Supreme nxori Vendimin e parë të saj [AA. nr. 52/2017] nëpërmjet të cilit e pranoi si të bazuar ankesën e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, dhe e ndryshoi Vendimin [ZL.A. nr. 1102/2017] e 22 nëntorit 2017 të PZAP-it, ashtu që ankesa e parashtruesit të dytë të kërkesës u refuzua si e pabazuar. Gjykata Supreme arsyetoi se vendimi i kontestuar i PZAP-it nuk është bazuar në prova bindëse dhe se nuk janë dëshmuar pretendimet ankimore të parashtruesit të dytë të kërkesës. Për më tepër, Gjykata Supreme konsideroi se PZAP-i nuk e kishte bazuar vlerësimin e saj në Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme (në tekstin e mëtejmë: LZP) së bashku me Ligjin nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së (në tekstin e mëtejmë Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së) , meqenëse asnjë dispozitë ligjore nuk parasheh që për shkak të "*rezultatit të ngushtë mes kandidatëve*" dhe për "*mospërputhjet e fletëvotimeve të pavlefshme ose të paplotësuara*" të shkohet në rinumërim. Sipas arsyetimit të Gjykatës Supreme, është e drejtë e çdo votuesi të dalë në

zgjedhje dhe të votojë dhe se fletëvotimet e përdorura dhe të paplotësuara, në natyrën e vet, nuk mund të merren për bazë që të shkohet në rinumërim. Më tutje, Gjykata Supreme theksoi se në Komunën e Prishtinës, nga monitoruesit vendës dhe ndërkombëtarë, nuk është raportuar asnjë shkelje dhe nuk është raportuar ndonjë vërejtje në librin e votimit dhe si rrjedhojë është vlerësuar se në këto zgjedhje nuk ka pasur parregullsi që *"do të cenojnë procesin e zgjedhjeve."*

40. Më 29 nëntor 2017, KQZ-ja, pas përfundimit të procedurave për kontestim të rezultateve preliminare në PZAP dhe në Gjykatë Supreme, shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë për Kryetar të Komunës së Prishtinës. Sipas atyre rezultateve, parashtruesi i parë i kërkesës, z. Arban Abrashi, kishte marrë gjithsej 41,897 vota, përkatësisht 49.78% të votave, ndërsa z. Shpend Ahmeti kishte marrë gjithsej 42,262 vota, përkatësisht 50.22% të votave. Diferenca në vota në këtë fazë përfundimtare të procedurës zgjedhore kur KQZ-ja kishte numëruar të gjitha votat, përfshirë votat me kusht, votat me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta, ishte gjithsej 365 vota më shumë në favor të z. Shpend Ahmeti. Në bazë të këtyre rezultateve, z. Shpend Ahmeti u shpall fitues i garës për Kryetar të Komunës së Prishtinës.

Procedura pas shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale të vitit 2017 për Kryetar të Komunës së Prishtinës

41. Më 30 nëntor 2017, një ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në PZAP kundër vendimit të KQZ-së të 29 nëntorit 2017, duke kundërshtuar rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Prishtinës. Parashtruesit e kërkesës pretenduan: (i) shkelje të LZP-së dhe të rregullave zgjedhore; si dhe (ii) shkelje të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës. Sipas parashtruesve të kërkesës, të drejtat e tyre ishin shkelur meqë Lëvizja VETËVENDOSJE! duke përdorur mënyra të ndryshme kishte ndikuar në vullnetin e lirë të qytetarëve, ndër të tjera, duke përfshirë: (i) shfrytëzimin e shërbimeve të transportit rrugor/taksive; (ii) thirrjeve telefonike; dhe (iii) dërgimit të sms-ve. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretenduan parregullsi sa i përket fletëvotimeve të pavlefshme, fletëvotimeve të zbrazëta dhe mungesës së fletëvotimeve në disa nga fletëvotimet me kusht e që si rezultat do të mund të jenë përdorur për zbatimin e praktikës së të ashtuquajturit "*tren bullgar*".

42. Nëpërmjet kësaj ankese, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga PZAP që të urdhërohet: (i) rinumërim i tërësishëm i votave në Komunën e

Prishtinës; (ii) vlerësimi i fletëvotimeve të shpallura si të pavlefshme, të zbrazëta dhe të dëmtuara; dhe (iii) kontrollimi i zarfeve të fletëvotimeve me kusht të cilat nuk janë konfirmuar dhe sipas pretendimit, si rrjedhojë nuk janë hapur fare. Më tutje, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga PZAP që, në rast se as pas rinumërimit nuk do të mund të evitohen shkeljet e pretenduara, atëherë të urdhërohet votim i ri për Kryetar të Komunës së Prishtinës.

43. Më 1 dhjetor 2017, PZAP nëpërmjet Vendimit [ZL. A nr. 1125/2017] iu përgjigj ankesës së parashtruesve të kërkesës. PZAP-i e ndau vlerësimin e ankesës në dy pika të ndryshme e të cilat i shqiptoi në dy pika të dispozitivit të saj. Nëpërmjet pikës I të dispozitivit, PZAP-i e hodhi si të palejueshëm apelin e parashtruesve të kërkesës për pjesën që kishte të bëjë me parregullsitë e pretenduara në ditën e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, përkatësisht për datën 19 nëntor 2017. Për fazën pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, PZAP-i i konsideroi këto pretendime si të pasafatshme. Nëpërmjet pikës II të dispozitivit, PZAP-i e refuzoi si të pabazuar apelin e parashtruesve të kërkesës për pjesën që kishte të bënte me rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja më 29 nëntor 2017. PZAP-i arsyetoi ndarjen e Vendimit të vet në dy aspekte të vlerësimit të pranueshmërisë duke theksuar që LZP-ja dhe Rregullat Zgjedhore përcaktojnë që secila fazë e procesit zgjedhor i ka afatet e caktuara ligjore për të parashtruar ankesa dhe apele në PZAP e që ndërlidhen me fazën specifike të procesit zgjedhor e cila është duke u zhvilluar. Në këtë drejtim, PZAP-i theksoi se, në rastin konkret, procesi zgjedhor gjendet në fazën e *"paspublikimit të rezultatit përfundimtar"* nga ana e KQZ-së, dhe rrjedhimisht vetëm ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së që kanë të bëjnë me të njëjtën fazë, janë të pranueshme.

44. Si rrjedhojë, dhe më specifikisht, për sa i takon pikës I të dispozitivit, PZAP-i arsyetoi se ankesat e parashtruesve të kërkesës që përkojnë me ditën e votimit, përkatësisht me parregullsitë e pretenduara të 19 nëntorit 2017, e të cilat sipas parashtruesve të kërkesës kanë të bëjnë me: (i) shfrytëzimin e shërbimeve të transportit rrugor/taksive; (ii) thirrjeve telefonike; dhe (iii) dërgimit të sms-ve, janë të pasaftshme dhe të palejueshme në këtë fazë të procesit zgjedhor. Kjo sepse, sipas arsyetimit të PZAP-it, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me paragrafin 1 të nenit 119 të LZP-së, afati për të parashtruar ankesë lidhur me pretendimet mbi ato parregullsi ka qenë 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit, rrjedhimisht deri më 20 nëntor 2017, në orën 19:00. Për më tepër, PZAP-i sqaroi se për pretendimet që ndërlidhen me parregullsitë në ditën e votimit tashmë ishte vendosur nga Gjykata Supreme nëpërmjet Aktvendimit [AA. nr. 52/2017] të 25 nëntorit 2017.

45. Për sa i takon pikës II të dispozitivit, PZAP-i vlerësoi se ankesa e parashtruesve të kërkesës është e pabazuar meqenëse ata nuk kanë arritur që me prova të vërtetojnë pretendimet e tyre të paraqitura në ankesë përkitazi me mospërputhjet e rezultatit përfundimtar.

46. PZAP-i theksoi se parashtruesit e kërkesës kishin bashkëngjitur si provë një listë me 31 vendvotime ku në secilin prej tyre, sipas parashtruesve të kërkesës, ishin shpallur 5 deri në 9 fletëvotime të pavlefshme. Sipas vendimit, me qëllim të hetimit dhe të verifikimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për sa i takon mospërputhjeve të rezultatit përfundimtar, përkatësisht, parregullsive në lidhje me fletëvotimet e pavlefshme, fletëvotimet e zbrazëta, dhe mungesën e zarfeve që përmbanin vota me kusht, e që mund të ketë rezultuar në parregullsi të karakterit zingjiror të njohura si "*treni bullgar*", PZAP-i, bazuar në nenin 14 të Rregullës nr. 02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it (në tekstin e mëtejmë: Rregulli nr. 02/2015), angazhoi ekipet hetuese të përbëra nga 8 gjyqtarë dhe nga 10 zyrtarë të sekretariatit. Ky ekip hetues, sipas arsyetimit të PZAP-it, kishte shikuar dhe rivlerësuar votat e pavlefshme në të gjitha 31 vendvotimet e specifikuara nga parashtruesit e kërkesës dhe kishte konstatuar se 4 nga 183 fletëvotimet të cilat ishin shpallur të pavlefshme, ishin në fakt të vlefshme. Si rrjedhojë, PZAP-i arsyetoi se, përveç ndryshimeve në 4 vota, e të cilat ishin shpallur si të vlefshme nga paneli hetues dhe ishin inkuadruar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, ekipet e PZAP-it nuk kishin gjetur asnjë parregullsi tjetër në 31 vendvotimet që ishin objekt i hetimit, sipas kërkesave të parashtruesve të kërkesës. Më tutje, PZAP-i theksoi se, përveç rivlerësimit të fletëvotimeve të pavlefshme, ekipet hetuese të PZAP-it i kanë rinumëruar edhe fletëvotimet e rregullta, rinumërim ky që ka rezultuar të jetë në përputhje me rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja.

47. PZAP-i gjithashtu i ishte referuar përgjigjes së KQZ-së ndaj ankesës së parashtruesve të kërkesës përmes të cilit KQZ-ja kishte theksuar se nuk ekziston baza ligjore për pretendimet e parashtruesve të kërkesës se fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta mund konsiderohen si prova për rinumërim. Sipas KQZ-së, kjo sepse anëtarët e Këshillit të Vendvotimit i nënshkruajnë Formularët e Rezultateve Përfundimtare (FRP) dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) pas përfundimit të votimit dhe numërimit dhe një gjë e tillë nënkupton se në momentin e nënshkrimit të formularëve të lartcekur, Këshilli i Vendvotimit pajtohet me përmbylljen e procesit.

48. Më 5 dhjetor 2017, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën Supreme kundër Vendimit [ZL. A nr. 1125/2017] të 1 dhjetorit 2017 të PZAP-it. Në ankesën e tyre, parashtruesit e kërkesës ngritën tri kategori çështjesh, përkatësisht pretendime ankimore kundër Vendimit të PZAP-it. Kategoria e parë e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës kishte të bënte me faktin që, sipas tyre, PZAP-i nuk kishte vlerësuar fare pretendimin e tyre për sa i takon ndikimit të pretenduar joligjor në vullnetin e votuesve që kishte ushtruar Lëvizja VETËVENDOSJE! nëpërmjet, ndër të tjera, transportimit të votuesve, thirrjeve telefonike dhe dërgimit të sms-ve. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë faktin që PZAP-i e kishte shpallur këtë ankesë si të palejueshme bazuar në dispozitat e LZP-së, duke arsyetuar se ankesat që kanë të bëjnë me ditën e votimit duhet të paraqiten brenda afatit 24 orësh, mirëpo parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ngjarja ishte bërë e njohur një orë pas afatit brenda të cilit ata kanë mundur të ankohen për çështjet që i takojnë ditës së votimit. Kategoria e dytë e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, kishte të bënte me fletëvotimet e pavlefshme, për të cilat, sipas tyre, PZAP-i nuk kishte vendosur fare. Sipas parashtruesve të kërkesës, duke marrë parasysh që hetimi i PZAP-it kishte rezultuar në shpalljen të vlefshme të një numri (4) të fletëvotimeve të cilat ishin shpallur të pavlefshme paraprakisht, ishte e rëndësishme për procesin dhe saktësinë e rezultateve përfundimtare që të gjitha fletëvotimet të rivlerësohen. Kategoria e tretë e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës kishte të bënte me hapjen e zarfeve të fletëvotimeve me kusht e për të cilat, sipas pretendimit, PZAP-i nuk kishte vendosur se duhet të hapeshin dhe të kontrolloheshin, përkundër faktit që, sipas tyre, kërkesa e tyre për sqarim të mungesës së fletëvotimeve ishte plotësisht e ligjshme dhe e arsyeshme, duke pasur parasysh rrezikshmërinë që paraqet praktika e njohur si "*treni bullgar*". Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës.

49. Parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata Supreme që: (i) të aprovojë ankesën e tyre si të bazuar dhe ta ndryshojë Vendimin e kontestuar të PZAP-it ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesa e tyre për rinumërim të të gjitha fletëvotimeve dhe rivlerësim të fletëvotimeve të pavlefshme; dhe (ii) të shpallë të kundërligjshëm transportimin e qytetarëve e që, sipas parashtruesve të kërkesës, ka pasur për pasojë ndikimin e përgjithshëm në parregullsinë e procesit zgjedhor dhe në rezultatet përfundimtare për Kryetar të Komunës së Prishtinës.

50. Më 7 dhjetor 2017, Gjykata Supreme nxori Vendimin e dytë të saj [A.A. U.ZH. nr. 62/2017], nëpërmjet të të cilit e refuzoi si të pabazuar

ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe e mbajti në fuqi Vendimin [A. ZL. nr. 1125/2017] e 1 dhjetorit 2017 të PZAP-it. Në këtë drejtim, për sa i takon pikës I të dispozitivit të Vendimit të kontestuar të PZAP-it, Gjykata Supreme konsideroi se PZAP-i kishte vendosur drejt me rastin e hedhjes poshtë të ankesës së parashtruesve të kërkesës si të palejueshme. Kjo sepse, sipas Gjykatës Supreme, kishte kaluar afati i ankimit për parregullsitë që ndërlidheshin me ditën e votimit. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme kishte konkluduar që PZAP-i kishte vendosur drejtë kur kishte hedhur poshtë si të palejueshme ankesën e parashtruesve të kërkesës, pasi që mbi bazën e nenit 13 të Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me nenin 119 të LZP-së, afati i ankesës është 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit, dhe rrjedhimisht afati i ankimit ishte 20 nëntori 2017, ora 19:00, kurse këto pretendime ishin parashtruar pas 10 ditësh, përkatësisht me 30 nëntor 2017. Gjykata Supreme në arsyetimin e vet kishte theksuar se kjo fazë e procesit zgjedhor është e ankueshme vetëm sa i përket vendimeve të KQZ-së, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar.

51. Më tutje, për sa i takon pikës II të dispozitivit të Vendimit të kontestuar të PZAP-it, Gjykata Supreme vlerësoi se pretendimet e parashtruesve të kërkesës sa i përket rezultateve përfundimtare janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP-i. Sipas Gjykatës Supreme, duke u bazuar në nenin 14 të Rregullit nr. 02/2015, paneli hetues i PZAP-it kishte konstatuar se nga 31 kuti të votimeve në të cilat janë shpallur të pavlefshme 183 fletëvotime, vetëm 4 janë të vlefshme, ndërsa të tjerat janë të pavlefshme ashtu siç fillimisht ishin shpallur nga Këshillat e Vendvotimeve. Më tutje, Gjykata Supreme theksoi se përveç 4 votave të pavlefshme, ekipet hetuese të PZAP-it nuk kishin gjetur asnjë parregullsi tjetër në 31 vendvotime të cilat ishin objekt i hetimit. Po ashtu, Gjykata Supreme theksoi se PZAP-i kishte rinumëruar të gjitha fletëvotimet e rregullta dhe kishte verifikuar vulat në çdo fletëvotim, duke arritur kështu në përfundimin se rezultati përfundimtar është në harmoni me atë të shpallur nga KQZ-ja. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Vendimi i kontestuar i PZAP-it ishte i qartë dhe i kuptueshëm dhe si i tillë përmbante arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe se e drejta materiale ishte zbatuar drejt.

52. Më 11 dhjetor 2017, KQZ-ja certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Prishtinës. Me atë rast, z. Shpend Ahmeti u shpall zyrtarisht Kryetar i Komunës së Prishtinës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

53. Parashtruesit e kërkesës fillimisht pretendojnë që Gjykata duhet të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tërë procesit zgjedhor, duke

vlerësuar edhe faktet edhe procedurën e zhvilluar dhe jo të kufizohet vetëm në vlerësimin e të drejtave dhe lirive themelore. Në mbështetje të këtij argumenti, parashtruesit e kërkesës i referohen Opinionit të Komisionit të Venecias (CDL-PI (2017) 007) dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë (E 17/2016-20) të 1 korrikut 2016.

54. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017, rrjedhimisht Vendimi i parë i Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimi [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i 7 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme, rrjedhimisht Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe kanë rezultuar në cenimin e "*parimit të shtetit të së drejtës*" dhe "*parimit të demokracisë kushtetuese*", si parime themelore të Kushtetutës.

55. Më specifikisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme, nëpërmjet Vendimit të saj të parë dhe të dytë, ka shkelur të drejtat e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, sepse nëpërmjet vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme është vlerësuar vetëm ligjshmëria e vendimeve të PZAP-it, pa u trajtuar kushtetutshmëria e tyre, dhe kjo, për pasojë, ka rezultuar edhe në shkeljen e të drejtave të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës.

56. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Pretendimet për shkeljen e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës

57. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se gjykatat e rregullta shërbejnë si instancë parakushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe janë të obliguara që, kur vlerësojnë pretendimet, të garantojnë zbatimin e dispozitave kushtetuese. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh parimin "*in dubio pro libertate*", sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore duhet të interpretohen gjerësisht dhe në dobi të individit, i cili në të gjitha fazat e procedurës është në pozitë të pabarabartë ndaj institucioneve shtetërore. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesit e kërkesës i referohen një numri vendimesh të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë (BVerfGE 9, 237 § 242, 247; BVerfGE 8, 2010 § 216; BVerfGE 3, § 225 240; BVerfGE 63,

230 342; BVerfGE 6, 32 § 42) dhe rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) *Golder kundër Mbretërisë së Madhe*.

58. Parashtruesit e kërkesës specifikisht pretendojnë se Gjykata Supreme nëpërmjet të dyja Vendimeve të saj ua shkel atyre të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, sepse sipas tyre të njëjtat: (i) bëjnë vlerësimin vetëm të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë së pretendimeve përkatëse; dhe (ii) janë arbitrare.

59. Sa i përket kategorisë së parë të pretendimeve, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme nuk e ka përmbushur detyrimin kushtetues që të vlerësojë pretendimet e ndërlidhura me të drejtat zgjedhore si pjesë përbërëse e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe është kufizuar vetëm në vlerësimin e ligjshmërisë se vendimeve të PZAP-it. Sipas pretendimit, duke u kufizuar vetëm në vlerësimin e ligjshmërisë, Gjykata Supreme përmes Vendimeve të saj, ka cenuar edhe *"parimin e supremacisë kushtetuese"*.

60. Ndërsa, sa i përket kategorisë së dytë të pretendimeve, përkatësisht arbitraritetit të vendimeve të kontestuara, parashtruesit e kërkesës ndërtojnë pretendimet e tyre kryesisht duke u bazuar në interpretim të gabuar e arbitrar të ligjit të aplikueshëm.

61. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: (i) arsyetimi i Gjykatës Supreme në Vendimin e parë të saj [AA. nr. 52/2017] se "*ligji nuk e parasheh rezultatin e ngushtë mes kandidatëve si kusht për rinumërim",* është kundërkushtetues sepse, sipas tyre, "*asnjë shtet nuk numëron kushte apo raste kur urdhërohet rinumërimi – sepse ajo është e drejtë në vetvete – për konfirmimin procesit zgjedhor*"; (ii) Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] nuk ka bazë ligjore. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se arsyetimi i Gjykatës Supreme që në procedurën ankimore ajo është kufizuar vetëm në vlerësimin e *"parregullsive që kanë të bëjnë me administrimin e të dhënave",* nuk ka mbështetje në ligjin e aplikueshëm. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës arsyetojnë se pretendimet ankimore rreth kësaj të fundit, përkatësisht rreth *"parregullsive rreth administrimit të të dhënave në QNR* [Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve]*"*, mbështeten vetëm në procedurën e veçantë të paraparë me nenin 105 të LZP-së, ndërsa parashtruesit e kërkesës kanë dorëzuar ankesat në bazë të nenit 119 të LZP-së. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë së nenet 118.4 dhe 119.1 të LZP-së dhe plotësim-ndryshimet përkatëse, njohin të drejtën e plotësimit të ankesave të dorëzuara në PZAP me prova dhe

me fakte të reja. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen Opinionit (CDL-PI (2017) 007) të Komisionit të Venecias, duke argumentuar se kriteret e pranueshmërisë, në raste të tilla, duhet të jenë qartazi të specifikuara në ligj, me qëllim që të parandalohet shpallja e ankesave si të palejueshme; dhe, në fund, (iii) konstatimet e Gjykatës Supreme janë arbitrare sepse të njëjtat konstatojnë se *"gjatë numërimit të disa nga vendvotimet, janë vërejtur parregullsi, mirëpo kanë qenë minimale dhe të balancuara, sepse janë prekur të dy kandidatët"*. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"shkelja e të drejtave kushtetuese ekziston ose nuk ekziston – nuk mund të thuhet se është shkelur pak apo shumë"*.

Pretendimet për shkeljen e nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës

62. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që, duke dështuar t'i ofrojnë mbrojtje gjyqësore të të drejtave themelore parashtruesve të kërkesës, rrjedhimisht, duke vepruar në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Supreme kanë rezultuar gjithashtu në shkelje të nenit 45 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë të jenë shkelur tri parime zgjedhore të mishëruara në nenin 45 të Kushtetutës, e të cilat sipas parashtruesve të kërkesës janë të përcaktuara gjithashtu përmes paragrafit 2 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, dhe përfshijnë si në vijim: (i) parimin e votës së lirë/lirisë së votës; (ii) parimin e votës së barabartë; dhe (iii) parimin e publicitetit (transparencës). Të gjitha këto parime, sipas parashtruesve të kërkesës, janë shkelur në rastin e tyre nga Gjykata Supreme, nga PZAP-i dhe nga KQZ-ja. Më specifikisht:

Sa i përket parimit të votës së lirë/lirisë së votës

63. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se parimi i votës së lirë duhet të garantojë që (i) "*rezultati zgjedhor duhet të pasqyroj vullnetin e vërtetë të votuesve*"; (ii) "*votuesi duhet të jetë i lirë nga çdo lloj ndikimi shtetërorë apo joshtetërorë*"; (iii) "*liria e votuesit për të vendosur se për kënd dëshiron të votoj, nuk guxon të cenohet para se ai të votojë"*. Në ndërtimin e kontekstit të "*parimit të votës së lirë*", parashtruesit e kërkesës i referohen Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë VfSlg 2.037/1950; dhe Vendimeve të Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë, BVerfGE 66, 369 e BVerfGE 9, 335.

64. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjatë procedurave në gjykata të rregullta kanë ofruar prova mbi "*ndikimin e qytetarëve të Prishtinës përmes dërgimit të SMS-ve në emër të OJQ-ve, ofrimit të kuponëve*

për transport falas dhe ndikimit përmes aktivistëve", e të cilat rrjedhimisht, sipas pretendimit, rezultojnë në shkelje të "*parimit të votës së lirë/lirisë së votimit*". Sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata Supreme në Vendimin e dytë të saj [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i kishte trajtuar këto pretendime si të reja, duke evituar arsyetimin rreth tyre dhe jo si prova që duhej t'i administronte. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përkundër faktit që PZAP i kishte konsideruar dëshmitë e tyre të mjaftueshme për të dyshuar mbi rregullsinë e procesit zgjedhor, Gjykata Supreme, në asnjë procedurë të vendimmarrjes, nuk merret me vlerësimin e këtyre pretendimeve. Parashtruesit e kërkesës sërish theksojnë se, duke mos trajtuar këto pretendime, atyre u është mohuar e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Sa i përket parimit të votës së barabartë

65. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se parimi i votës së barabartë duhet të garantojë: (i) barazi strikte dhe formale; (ii) barazi të mundësive; (iii) *"jo vetëm barazi të peshës së votës, por edhe barazinë e peshës së suksesit të votës"*; si dhe (iii) jo vetëm *"të drejtën për të përfituar mandatin, por të drejtën për mbrojtje të mandatit nga cenimet gjatë procesit zgjedhor"*. Në ndërtimin e kontekstit të "*parimit të votës së barabartë*", parashtruesit e kërkesës i referohen Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë, VfSlg 8.644/1979; vendimeve të Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë, BVerfGE120, 82, BVerfGE 121, 266, BVerfGE 63, 230, BVerfGE 95, 408 dhe BVerfGE 151, 179; si dhe Aktgjykimit të kësaj Gjykate në rastin KI34/17, paragrafit 91.

66. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme, PZAP-i dhe KQZ-ja kanë dështuar të garantojnë një proces zgjedhor ku "*pesha e votës*" është e barabartë. Parashtruesit e kërkesës theksojnë që, pavarësisht që Gjykata Supreme në Vendimin e saj të dytë [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] konstaton që *"procesi zgjedhor është dëmtuar",* ajo nuk e ka konsideruar të nevojshme rinumërimin e kutive nga të gjitha vendvotimet, gjë që, sipas tyre, do të kishte mundësi të verifikonte rezultatin dhe lëshimet e mundshme. Sipas parashtruesve të kërkesës, kërkesa e tyre për rinumërim të kutive në të gjitha vendvotimet ishte refuzuar në mënyrë kundër kushtetuese.

Sa i përket parimit të publicitetit (transparencës)

67. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ky parim, përkundër faktit që nuk është parim i shkruar kushtetues, është rezultat i bashkëveprimit të neneve kushtetuese dhe, sipas parashtruesve të kërkesës, ndër të tjera nënkupton që: (i) "*votuesi duhet të bindet me efektivitetin e aktit*

të votimit dhe rrjedhimisht ai duhet të bindet që "pesha e votës së tij, në të gjitha fazat nga hedhja e votës në kutinë e votimit, administrimi i materialit zgjedhor e deri të publikimi i rezultatit – ka qenë përputhje me rregullat dhe parimet zgjedhore"; dhe se, (ii) *"pjesëmarrësit e procesit zgjedhor, kandidatët apo votuesit, do të kenë mundësinë që në rast të dyshimeve mbi vërtetësinë e rezultateve të publikuara të ushtrojnë mjete juridike përmes së cilave ato dyshime sqarohen".* Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesit e kërkesës i referohen vendimeve të Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë BVerfGE 123, 39 dhe BVerfGE 121, 266.

68. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës i referohen Opinionit (CLD-AD (2002) 23 rev) të Komisionit të Venecias, duke theksuar detyrimin e shtetit që të garantojë transparencë të proceseve, duke përfshirë edhe të drejtën e rinumërimit të votave në raste të apelit. Sipas parashtruesve të kërkesës, e drejta në rinumërim, ndër të tjera, është përcaktuar edhe me nenet 101 dhe 106 të LZP-së, të cilat ia kanë lënë kompetencën dhe mundësinë KQZ-së që, sipas detyrës zyrtare, të urdhërojë rinumërimin apo edhe përsëritjen e votimit para certifikimit të rezultateve.

69. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se arsyetimi i Gjykatës Supreme, sipas të cilit *"askund në ligj nuk parashihet rinumërimi në rast të diferencës së vogël të kandidatëve"*, u shkel atyre të drejtën për konfirmim dhe verifikim të rezultatit zgjedhor. Për më tepër, sipas parashtruesve të kërkesës, ky arsyetim nuk merr parasysh dhe nuk vlerëson të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që: *"në rast të rezultatit të ngushtë të zgjedhjeve"*, rinumërimi është e drejtë themelore e cila iniciohet nëpërmjet KQZ-së apo me kërkesë të palës. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës i referohen Vendimit IC_275/2009 të 1 tetorit 2009 të Gjykatës Kushtetuese Zvicerane, sipas të cilës "*nëse ekzistojnë dyshime mbi rregullsinë e procesit – duhet të rinumërohen të gjitha fletëvotimet me qëllim që të tentohet të evitohet çdo parregullsi*".

70. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë se PZAP-i dhe Gjykata Supreme "*kanë konfirmuar se rinumërimi i mostrave – i zhvilluar pa prezencën e palëve në procedurë – konstaton se ka pasur parregullsi*", mirëpo, sipas parashtruesve të kërkesës, PZAP-i dhe Gjykata Supreme, nëpërmjet Vendimit të saj të dytë [A.A. U.ZH. nr. 62/2017], "*të njëjtat i konsiderojnë të balancuara në mes dy kandidatëve në garë*". Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "*nuk ka shkelje të madhe apo të vogël*" dhe se me rastin e konstatimit të çfarëdo shkeljeje, do të duhej të urdhërohej përsëritja

e votimeve të balotazhit. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës i referohen Vendimit (E I 4/2015–25) të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë.

71. Parashtruesit e kërkesës, më tutje, pretendojnë që Gjykata Supreme me Vendimin e saj të parë [AA. nr. 52/17] e ka shfuqizuar vetëm Vendimin e PZAP-it [ZL.Anr.1102/2017] të 22 nëntorit 2017, por jo edhe Vendimin e KQZ-së [2343-2017] për rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve të rregullta në vendvotimet të përcaktuara me vendimin e lartcekur të PZAP-it.

72. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu përsërisin pretendimin se Gjykata Supreme, me Vendimin e saj të dytë [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] dhe me Vendimin e PZAP-it [ZL. Anr. 1125/2017] të 1 dhjetorit 2017, në trajtimin e ankesës së tyre të 30 nëntorit 2017, nuk kanë trajtuar provat e parashtruesve të kërkesës si "*prova të reja dhe të veçanta*" dhe nuk ka trajtuar pretendimet e tyre për shkelje kushtetuese.

73. Parashtruesit e kërkesës pretendojmë se parimi i transparencës është shkelur edhe me rastin e *"asgjësimit të materialit zgjedhor"* nga ana e KQZ-së, e me atë rast edhe e drejta e tyre për rinumërim.

Kërkesat konkrete të parashtruesve të kërkesës

74. Parashtruesit e kërkesës theksojnë që, qëllimi i tyre në kërkimin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, ka qenë që të kërkohet urdhërimi i rinumërimit të fletëvotimeve, siç kanë kërkuar në të gjitha fazat e procedurës. Por parashtruesit e kërkesës theksojnë se, një kërkesë e tillë, ndërkohë është pamundësuar duke marrë parasysh që *"KQZ ka asgjësuar të gjithë materialin zgjedhor"*. Duke theksuar se me aktin *"e asgjësimit të materialit zgjedhor"* është shkelur jo vetëm parimi i transparencës, por edhe e drejta e parashtruesve të kërkesës në rinumërim, e vetmja zgjidhje, sipas parashtruesve të kërkesës, mbetet *"përsëritja e votimeve të raundit të balotazhit"*.

75. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës; (iii) të konstatojë se si rrjedhojë e shkeljes së nenit 54 të Kushtetutës ka rezultuar shkelja e nenit 45 të Kushtetutës; (iv) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] e Gjykatës Supreme dhe të gjitha vendimet e instancave të mëhershme; (v) të shpallë të pavlefshëm procesin zgjedhor (balotazhin) për Kryetar të Komunës së Prishtinës të datës 19 nëntor 2017; si dhe (vi) të urdhërojë KQZ-në që, në afat prej 30 ditësh nga

pranimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të organizojë raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës Prishtinës.

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar, z. Shpend Ahmeti

76. Në cilësi të palës së interesuar, z. Shpend Ahmeti, ka dorëzuar komente lidhur me: (i) pranueshmërinë e kërkesës; (ii) juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi këtë çështje; si dhe (iii) për meritat e kërkesës.

77. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, z. Shpend Ahmeti pohon se kërkesa duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet juridike. Në këtë drejtim, për sa i përket pretendimeve për parregullsitë në ditën e votimit, z. Shpend Ahmeti thekson se parashtruesit e kërkesës kanë dështuar t'i shfrytëzojnë mjetet juridike brenda afateve ligjore të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës të Gjykatës.

78. Specifikisht, ai argumenton se, në bazë të nenit 36 të LZP-së dhe nenit 25.1 të Rregullës zgjedhore 9/2013, parashtruesit e kërkesës, lidhur me pretendimet e tyre për parregullsi në ditën e zgjedhjeve, duhej të ishin ankuar brenda afatit 24 orësh pas mbylljes së vendvotimeve, e assesi pas shpalljes të rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së.

79. Më tutje, z. Shpend Ahmeti argumenton se kërkesa për përsëritjen e balotazhit nuk është paraqitur para instancave gjyqësore. Në këto të fundit, parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar vetëm rinumërimin e votave. Z. Shpend Ahmeti pohon se parashtruesi i kërkesës nuk mund të kërkojë nga Gjykata përsëritjen e balotazhit nëse të njëjtën nuk e ka kërkuar nga instancat e tjera të gjykatave të rregullta.

80. Për më tepër, në aspekt të pranueshmërisë së kërkesës dhe shterrjes së mjeteve juridike anash, z. Shpend Ahmeti pohon se kërkesa është gjithashtu qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e tillë, sepse parashtruesit e kërkesës nuk janë subjekt i shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë ose sepse ata nuk kanë arritur të arsyetojnë mjaftueshëm para Gjykatës pretendimet e tilla.

81. Lidhur me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, z. Shpend Ahmeti pohon se kjo e fundit, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk ka kompetencë të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor. Kjo dispozitë kushtetuese, sipas z. Shpend Ahmeti, e kufizon Gjykatën në lidhje me kërkesat e parashtruara nga individët *"vetëm në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave individuale të garantuara me Kushtetutë."*

82. Më tutje lidhur me çështjen e juridiksionit të Gjykatës, z. Shpend Ahmeti thekson se është e nevojshme të bëhet *"dallimi në mes të gjykimit kushtetues dhe gjykimit nga ana e organeve të sistemit të gjykatave të rregullta"*. Në këtë drejtim, ai thekson se pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës ka të bëjë me argumentet e tyre për pavlefshmërinë absolute të Vendimit të dytë të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [A.A.U.ZH.nr.62/2017] dhe heshtjen e palës kundërshtare [Gjykatës Supreme] në raport me kërkesat e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljet e pretenduara kushtetuese, respektivisht cenimin e nenit 45 të Kushtetutës. Sipas z. Shpend Ahmeti, përderisa Gjykata Kushtetuese bën vlerësimin e kushtetutshmërisë, gjykatat e rregullta bëjnë vlerësimin e ligjshmërisë me rastin e vendosjes për çështjen konkrete. Në këtë drejtim, z. Shpend Ahmeti thekson se pretendimi për pavlefshmërinë absolute të Vendimit të dytë të Gjykatës Supreme është tërësisht i pabazuar në raport me kompetencën lëndore të Gjykatës Supreme, të përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatat. Për më tepër, z. Shpend Ahmeti, në argumentimin e kompetencës së gjykatave për të vlerësuar ligjshmërinë e pretendimeve, thekson se gjykatat e rregullta, në rast dyshimi për kushtetutshmërinë e ligjit të cilit e vlerësojnë, mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese përmes paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës.

83. Përkitazi me meritat e kërkesës, z. Shpend Ahmeti pohon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e neneve 45 e 54 të Kushtetutës, janë të artikuluara në mënyrë abstrakte dhe pohojnë se vetë ligji *"ka pranuar fakticitetin relativ të procesit zgjedhor"* dhe se kjo ka qëllim sigurinë juridike. Sipas kësaj, për çfarëdo parregullsie (administrative apo penale) parashihen sanksione për përgjegjësit. Tutje, z. Shpend Ahmeti pohon se një insistim i reparacionit, do të cenonte të drejtën e shumicës së qytetarëve të cilët kanë shprehur vullnetin e tyre politik.

84. Më konkretisht në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës, z. Shpend Ahmeti pohon se nuk ka pasur shkelje të këtij neni dhe se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë konkretizuar cenimin e të drejtave të garantuara me këtë nen. Sipas tij, një pretendim i tillë, i *"pakualifikuar dhe i artikuluar në mënyrë abstrakte*", nuk mund të jetë objekt i trajtimit nga ana e Gjykatës. Në zgjedhjet e raundit të dytë për Kryetar të Prishtinës nuk është provuar asnjë rast i cenimit të karakterit personal të votës, barabarësisë së saj, lirisë në zgjedhje apo fshehtësisë së saj. Z. Shpend Ahmeti më tej thekson faktin që, në fund të procesit zgjedhor, të gjithë formularët janë nënshkruar nga të gjithë

anëtarët e komisioneve të votimit, që sipas tij, është dëshmi për një proces të rregullt dhe korrekt zgjedhor.

85. Më konkretisht në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, z. Shpend Ahmeti pohon se nuk ka pasur shkelje të këtij neni dhe se ekziston një keqinterpretim lidhur me këtë dispozitë, të cilës, sipas z. Shpend Ahmeti, parashtruesit i kanë dhënë një *"domethënie abstrakte ekstensive"*. Sipas z. Shpend Ahmeti, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të garantuara me Kushtetutë duhet kuptuar brenda logjikës strukturore të ligjeve në fuqi. Për rastin konkret, sipas komenteve, të rëndësishme janë dispozitat konkrete të Ligjit për Gjykatat, me të cilat bëhet përkufizimi i kompetencave të organeve gjyqësore si dhe dispozitat e LZP-së, që përkufizojnë kompetencën lëndore për ankesat që paraqiten pranë Gjykatës Supreme si organ gjyqësor, i cili bën kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të nxjerra nga PZAP-i. Specifikisht, z. Shpend Ahmeti, i referohet nenit 12 të Ligjit për Plotësim dhe Ndryshimin e LZP-së, i cili përkufizon kompetencën e Gjykatës Supreme në trajtimin e ankesave.

86. Lidhur me provat e dorëzuara në Gjykatë nga ana e parashtruesve të kërkesës, përkatësisht raportet televizive, z. Shpend Ahmeti thekson se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë në të cilën administrohen prova të tilla të cilat veçse janë administruar nga gjykatat e rregullta. Për më tepër, z. Shpend Ahmeti konsideron se parashtruesit e kërkesës kanë pasur mundësi ligjore që të paraqesin të gjitha pretendimet e tyre pranë organeve të drejtësisë (në Polici, në Prokurori, në gjykata) dhe këto organe do të mund të vendosnin lidhur me shkeljet e palëve të treta. Mirëpo, sipas tij, në asnjë rast nuk mund të konstatohet se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, duke u bazuar në raporte televizive të deponuara si prova nga ana e parashtruesve të kërkesës. Kjo, sipas komenteve, nuk është diçka që mund të kërkohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila mund të bëjë vetëm vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.

87. Lidhur me referimin e parashtruesve të kërkesës në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Austrisë (E I 4/2015–25), z. Shpend Ahmeti pohon se krahasimi me këtë vendim nuk qëndron, për arsye se rezultati zgjedhor në Austri është anuluar për shkak se ka pasur shkelje të Ligjit Federal për Zgjedhje të Presidentit, ku votat janë hapur më herët nga personat jokompetentë; kriteri i ndikimit të shkeljes në raport me rezultatin ka qenë i bazuar në 77,000 vota; si dhe janë gjetur shkelje të procedurave nga instancat më të ulëta. Më tutje, ai thekson se i gjithë Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Austrisë

ka pasur të bëjë me një situatë krejt të ndryshme nga ajo që pasqyrohet nga parashtruesit e kërkesës.

88. Për sa i takon petitumit final të parashtruesve të kërkesës për përsëritje të balotazhit, z. Shpend Ahmeti thekson se nëse eventualisht do të urdhërohej përsëritja e balotazhit, një gjë e tillë do të rezultonte në shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës. Kjo për shkak se Kryetari i Komunës së Prishtinës është zgjedhur në një proces të rregullt zgjedhor dhe përsëritja e procesit pasi që kanë kaluar disa muaj pas zgjedhjeve do të ndikonte negativisht për vetë Kryetarin, duke ia cenuar atij të drejtat e garantuara me nenin 45 të Kushtetutës.

89. Z. Shpend Ahmeti gjithashtu thekson se parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur qëllim numërimin e votave, por rivotimin, sepse kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e kanë bërë vetëm pasi është shkatërruar materiali zgjedhor nga KQZ-ja, ndërsa para se të ndodhte kjo e fundit, sipas komenteve, parashtruesit e kërkesës kanë pasur mundësinë t'i drejtohen Gjykatës duke kërkuar masën e përkohshme dhe ruajtjen e materialit zgjedhor. Në këtë aspekt, z. Shpend Ahmeti gjithashtu thekson se "*po të ekziston në të vërtetë shkeljet e procesit zgjedhor, parashtruesit kanë pasur mundësi të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese masën e sigurisë përmes së cilës do ndalohej shkatërrimi i materialit zgjedhor [...].*"

90. Në fund, z. Shpend Ahmeti, kërkon nga Gjykata të deklarojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës si "*qartazi të papranueshme*", meqenëse, sipas tij, kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë qartazi të pabaza dhe nuk arsyetohen *prima facie*.

Komentet shtesë të dorëzuara nga parashtruesit e kërkesës

91. Parashtruesit e kërkesës, nëpërmjet komenteve të parashtruara në përgjigje të komenteve të dorëzuara nga z. Shpend Ahmeti: (i) kontestojnë zotësinë procedurale të tij në procedurë para Gjykatës; (ii) paraqesin mospajtimin e tyre lidhur me argumentet e tij në favor të papranueshmërisë së kërkesës; (iii) paraqesin mospajtimin e tyre në lidhje me argumentet për mungesë të juridiksionit të Gjykatës për të trajtuar kërkesën në fjalë; dhe (iv) kundërshtojnë argumentet e tij kundër shkeljes të pretenduar nga parashtruesit e kërkesës.

92. Sa i përket çështjes së parë, përkatësisht zotësisë procedurale të z. Shpend Ahmeti në procedurë, parashtruesit e kërkesës theksojnë që Lëvizja VETËVENDOSJE! është palë procedurale para Gjykatës e jo z. Shpend Ahmeti, sepse Lëvizja VETËVENDOSJE! ka qenë palë në

procedurat para gjykatave të rregullta. Për më tepër, në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë që z. Shpend Ahmeti, para Gjykatës duhet të veprojë si person fizik dhe jo si Kryetar i Komunës së Prishtinës në emër të së cilës i ka dorëzuar komentet në Gjykatë.

93. Sa i përket argumenteve në favor të papranueshmërisë së kërkesës, parashtruesit e kërkesës pohojnë se komentet e z. Shpend Ahmeti janë "*shtrembërim i dispozitave ligjore dhe nuk përkojnë me pretendimet e parashtruesit të kërkesës*". Parashtruesit e kërkesës specifikisht kontestojnë argumentin e z. Shpend Ahmeti se parashtruesit e kërkesës nuk kanë shterur mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial, meqë në gjykata të rregullta parashtruesit e kërkesës nuk kishin kërkuar përsëritjen e balotazhit, e që është kërkesa në Gjykatë, por vetëm rinumërim të fletëvotimeve.

94. Sa i përket komenteve që ndërlidhen me jurisdiksionin e Gjykatës, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se komentet e z. Shpend Ahmeti ofrojnë arsyetim jorelevant dhe nuk kanë lidhshmëri me pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës. Pretendimet e Komunës së Prishtinës/z. Shpend Ahmeti se Gjykata nuk ka juridiksion për të vlerësuar kushtetutshmërinë e aktit individual por vetëm kushtetutshmërinë e ligjit, nuk qëndrojnë meqë neni 113.8 i Kushtetutës ka të bëjë me procedurën e kontrollit incidental e që dallon nga procedura e ankesave individuale. Sipas tyre, z. Shpend Ahmeti nuk ka arritur të kuptojë "*ankimin individual apo ankesat elektorale dhe si rrjedhojë argumentimi i tyre nuk lidhet fare me çështjen në shqyrtim*".

95. Në fund, parashtruesit e kërkesës kundërshtojnë argumentet e z. Shpend Ahmeti, të cilat pohojnë se ata nuk kanë argumentuar shkeljet e neneve 45 e 54 të Kushtetutës; ndërsa, sa i përket rastit të referuar të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë që z. Shpend Ahmeti ka keqkuptuar kontekstin në të cilin është parashtruar ky argument.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 45
[Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të

zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 123
[Parimet e Përgjithshme]

[...]

2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

[...]

Neni 139
[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 3 i Protokolli nr.1 të KEDNJ-së
(E drejta për zgjedhje të lira)

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Neni 13
(E Drejta për Zgjidhje Efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare.

LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE LIGJI NR. 03/L-256 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 103
[Ruajtja e fletëvotimeve dhe transportimi i materialit zgjedhor]

[...]

103.4 KQZ-ja me një vendim, pas certifikimit zyrtar të rezultatit të zgjedhjeve, shkatërron materialet e përmendura në kohën e përshtatshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP-i. [...]

[...]

Neni 105
[Ankesat për procesin e QNR]

105.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, neni 4).

105.2 Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose ndërpret procesin e numërimit.

105.3 Për të gjitha ankesat e marra nga PZAP-i vendoset jo më vonë se shtatëdhjetedy (72) orë nga momenti i pranimit të ankesave në zyrat qendrore të PZAP-it. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, neni 5).

[...]

Neni 106
[Rezultatet zgjedhore]

106.1 KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, neni 6).

106.2 Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë.

106.3 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.

[...]

Neni 117
[Procedurat e PZAP-it]

117.1 PZAP-i vendos rregullat dhe procedurat e tij.

117.2 Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme.

117.3 Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.

117.4 PZAP-i mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin.

Neni 118
[Vendimet]

[...]

118.2 PZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. PZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej shtatëdhjetedy (72) orëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e

rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera PZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje,
brenda pesë (5) ditëve kalendarike. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 12 paragrafi 1).

[...]

118.4 Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes vendimit nga PZAP-i , në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjet e dy (72) orëve pas paraqitjes së apelit. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 12 paragrafi 2).

118.5 Vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 12 paragrafi 3).

Neni 119
[Ankesat]

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 13).

119.2 Zyra mund të parashtrojë ankesë në PZAP sa i përket dështimit të subjektit politik për të vepruar në pajtim me këtë ligj ose rregullat e KQZ-së të cilat prekin procesin zgjedhor ose procesin e regjistrimit.

119.3 PZAP-i nuk merr parasysh një ankesë që ka të bëjë me vendim nga ana e KQZ-së, por do të mund të shqyrtojë një apel ndaj një vendimi të KQZ-s siç është saktësuar në nenin 122 të këtij ligji.

119.4 PZAP-i mund të vejë sanksione ndaj një subjekti politik për shkeljen e këtij ligji apo rregullave të KQZ-së të bëra nga anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët e subjektit. Një subjekt politik mund t'i ofrojë fakte PZAP-it për të treguar se ka bërë përpjekje të arsyeshme

për të parandaluar dhe dekurajuar anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët për të mos shkelur këtë ligj ose rregullat zgjedhore. PZAP-i i shqyrton këto fakte për të vendosur për sanksionet përkatëse, në rast se ka, për t'iu shqiptuar subjektit politik.

119.5 PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtojë çështje të cilat përndryshe janë nën jurisdiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.

119.6 Ofrimi i informatave të rrejshme PZAP-it paraqet shkelje të këtij ligji të cilën gjë PZAP-i mund ta sanksionoj sipas nenit 12.1 të këtij ligji.

Neni 120
[Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve]

120.1 Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të:

[...]

b) para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-ën ti përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 14).

[...]

Neni 122
[Apelimet Zgjedhore]

122.1 Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256, nenin 15).

a) përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;

c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji; dhe
f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

122.2 PZAP-i do të mbështesë apelin ndaj vendimit të KQZ-së nëse vlerëson se KQZ-ja nuk ishte e arsyeshme në marrjen parasysh të të gjitha rrethanave.

122.3 Nëse PZAP-i mbështet apelin ndaj vendimit të KQZ-së, mundet të:
a) udhëzojë KQZ-në ta rishqyrtojë vendimin e vet; dhe
b) udhëzojë KQZ-në të marrë masa kompensimi.

[...]

RREGULLAT DHE PROCEDURAT nr. 02/2015 të PZAP-it, të datës 4 dhjetor 2015

Neni 2
[Përkufizimet]

Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:

[...]

2.1 "Ankesë" – do të thotë mjet i rregullt juridik i dorëzuar me shkrim nga një person që ka interes ligjor apo të drejtat e të cilit janë shkelur gjatë procesit zgjedhor.
2.2 "Apel" do të thotë mjet i rregullt juridik kundër vendimeve të shkallës së parë.

[...]

ANKESAT
Neni 5
[Kushtet për dorëzimin e ankesave]

[...]

5.3 Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrohen pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit (Neni 119.1 i LZP-së).
5.4 Ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në Qendrën e numërimit dhe të Rezultateve duhet të dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i të kuptuarit nga ankuesi/ja për shkeljen e supozuar, në bazë të nenit 105.1 të LZP-së.
5.4 Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejte me votimin dhe ri-numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar.

[...]

APELET
Neni 10
[Kriteret për apelim]

[...]

10.5 Në lidhje me apelimin e një vendimi të KQZ-së, apeli duhet të dorëzohet brenda pesë (5) ditëve pas njoftimit me vendim të KQZ-së. Për të gjitha apelet tjera, përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, apelet duhet të dorëzohen brenda njëzetekatër (24) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-it nga parashtruesi/ja.

[...]

Neni 14
[Procedura për Administrimin e Hetimeve të Materialit Zgjedhor]

12.1 Kur PZAP-i pranon një ankesë që konsiderohet te jetë e rregullte, dhe kur një ankesë e tille është e dyshuar për veprimtari mashtruese qe përfshinë materialin zgjedhor, Paneli vendimmarrës do të autorizojë një anëtar të panelit si hetues kryesor dhe zyrtarin ligjor të ngarkuar me çështjen konrete që ti zhvillojë hetimet. [...]

RREGULLA ZGJEDHORE E KQZ-SË NR. 06/2013 QENDRA E NUMËRIMIT DHE E REZULTATEVE e datës 2 korrik 2013

Neni 8
Ankesat përkitazi me procesin në QNR

8.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR, sipas nenit 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e

Kosovës dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dorëzohen me shkrim në PZAP brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

8.2 Paraqitja e ankesës nuk pengon procesin e numërimit.

8.3 Në bazë të dispozitës së nenit 105.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për të gjitha ankesar në PZAP, do të vendoset jo më vonë se 72 orë pas marrjes së tyre në zyrat qendrore të PZAP-it.

[...]

Neni 9
Rezulatet e zgjedhjeve

[...]

9.3 Në raste të jashtëzakonshme para certifikimit të rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo Vendvotim, Qendër të Votimit, Qendër të Numërimit ose përsëritjen e votimit në një Qendër Votimi apo në një Komunë.

[...]

9.5. Para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëkonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-në t'i përsëritë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale.

[...]

RREGULLA ZGJEDHORE E KQZ-së Nr. 09/2013 VOTIMI, NUMËRIMI NË VENDVOTIM DHE MENAXHIMI I QENDRËS SË VOTIMIT

Neni 25
Ankesat

25.1.Ankesat përkitazi me procesin e votimit dhe numërimit në vendvotime duhet të dorëzohen në PZAP brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve dhe për ato do të vendos PZAP-i brenda 72 orëve pasi që ankesa është pranuar, në pajtim me nenin 119.1 të Ligjit për

Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe Rregullat e Punës së PZAP-it.

25.2.Dorëzimi i ankesës nuk do ta ndërpresë ose pezullojë procesin e numërimit.

25.3.Cilido anëtar i KKV-së i cili ankohet për rezultatet e shënuara në VV mund të shënojë mendimin e vet mospajtues në Librin e Votimit dhe mund të parashtrojë ankesën në PZAP.

[...]

Neni 26
Përsëritja e Votimit

26.1. Para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-në të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale, në përputhje me nënin 120.1 (b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale. Në këtë rast të njëjtat rregulla do të aplikohen për përsëritjen e votimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

96. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

97. Në këtë drejtim, Gjykata, duke aplikuar nenin 113 të Kushtetutës, dispozitat relevante të Ligjit për sa i përket procedurës në rastin e përcaktuar në nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës; dhe rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] e rregullin 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullorës së punës, do të shqyrtojë nëse: (i) kërkesa është dorëzuar nga palët e autorizuara; (ii) kontestohen vendime të autoriteteve publike; (iii) janë shteruar të gjitha mjetet juridike; (iv) janë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendohet se janë shkelur; (v) janë respektuar afatet kohore; (vi) kërkesa është qartazi e pabazuar; dhe (vii) ka ndonjë kriter shtesë të pranueshmërisë, sipas rregullit 39 (3) të Rregullores së punës, që nuk është plotësuar.

Lidhur me palët e autorizuara

98. Gjykata në këtë aspekt fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

99. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara me Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*

100. Gjykata në fund i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

> *(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*
> *(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.*

101. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata së pari vëren se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy parashtrues të kërkesës dhe secili prej tyre duhet të legjitimohet si palë e autorizuar në bazë të dispozitave përkatëse të cituara më lart, si parakusht për të shqyrtuar këtë kërkesë. Për sa i takon parashtruesit të parë të kërkesës, përkatësisht z. Arban Abrashi, Gjykata vëren se ai, në cilësinë e individit, përkatësisht të personit fizik, është palë e autorizuar për të parashtruar ankesë kushtetuese në Gjykatë. (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI73/09 parashtruesi *Mimoza Kusari- Lila,* Aktvendim i 19 shkurtit 2010; KI152/17 parashtrues *Shaqir Totaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018; KI157/17 parashtrues *Shaip Surdulli,* Aktvendim për papranueshmëri i 15 majit 2018). Për sa i takon parashtruesit të dytë të kërkesës, përkatësisht subjektit politik LDK, Gjykata vëren se, në bazë të paragrafit 4 të nenit 21 të Kushtetutës, edhe parashtruesi i dytë i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat kushtetuese që vlejnë për personat juridikë, për aq sa ato janë të zbatueshme. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI41/09, parashtrues *AAB-RIINVEST University L.L.C.,* Aktvendim për

papranueshmëri i 21 janarit 2010; shih po ashtu, rastin e GJEDNJ-së, *Partia për një Shoqëri Demokratike dhe të tjerët kundër Turqisë,* nr. 3840/10, Aktgjykim i 12 janarit 2016).

102. Për më tepër, dhe në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se GJEDNJ-ja, nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore, ka konstatuar se e drejta për t'u zgjedhur në kuadër të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është e drejtë që u garantohet edhe partive politike, si subjekte juridike, dhe se ato mund të ankohen pavarësisht nga kandidatët e tyre. (Shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *Partisë së Punës të Gjeorgjisë kundër Gjeorgjisë,* nr. 9103/04, Aktgjykim i 8 korrikut 2008, paragrafët 72-74, dhe referencat e tjera të përmendura në atë vendim). Rrjedhimisht, Gjykata konkludon që të dy parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara.

Lidhur me aktin e autoritetit publik

103. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutes, të cituar më lart, dhe nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

> *a. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> [...]

104. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit (2) të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës i cili, *inter alia*, përcakton:

[...]

> *(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht [...] cili është akti konkret i autoriteti publik i cili kontestohet.*

[...]

105. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë akte të një autoriteti publik, përkatësisht Vendimin e parë [Aktvendimi AA. nr. 52/2017] të 25 nëntorit 2017 dhe të dytë [Aktgjykimi A.A. U.ZH. nr. 62/2017] të 7 dhjetorit 2017 të Gjykatës

Supreme, siç është përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me dispozitat përkatëse të Ligjit dhe të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon që parashtruesit e kërkesës kontestojnë akte të një autoriteti publik.

Lidhur me shterimin e mjeteve juridike

106. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart; paragrafit 2 të nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit; dhe pikës (b), paragrafi (1), të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

[...]

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuara.

[...]

107. Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të *"të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 dhe vlen, si për personat fizikë ashtu edhe për personat juridikë, për aq sa është e aplikueshme.

108. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vërtetojë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike nga ana e parashtruesit të parë të kërkesës, në cilësi të individit, si personit fizik, si dhe nga parashtruesi i dytë, në cilësi të subjektit politik, si person juridik. Kriteret e vlerësimit nëse ky

detyrim është përmbushur janë mirë të përcaktuara në praktikën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

109. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që në Vendimin e parë të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimin [AA. nr. 52/2017], vetëm parashtruesi i dytë, përkatësisht LDK-ja si subjekt politik, përkatësisht person juridik, ka qenë palë në procedurë para PZAP-it dhe Gjykatës Supreme. Parashtruesi i parë i kërkesës nuk kishte qenë palë procedurale ndonëse ligji i aplikueshëm, përkatësisht LZP, nëpërmjet nenit 119.1 të tij, e parasheh këtë mundësi edhe për personat fizikë, pra kandidatët që kanë interes për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të tyre. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se vetëm parashtruesi i dytë i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe Gjykata do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Vendimit të parë të Gjykatës Supreme në raport me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë që i takojnë LDK-së si subjekt politik dhe person juridik. (Shih, *mutatis mutandis*, subjektet politike si parashtrues para GJEDNJ-së për konteste zgjedhore, *Refah Partisi (Partia e Mirëqenies Sociale) dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98, Aktgjykim i 13 shkurtit 2003; shih, po ashtu, rastin e *Partisë Konservatore Ruse e Ndërmarrësve dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 55066/00 dhe 55638/00, Aktgjykim i 11 janarit 2007, ku parashtrues ishte një subjekt politik së bashku me kandidatin që garonte nën siglën e po atij subjekti politik).

110. Më tutje, në lidhje me Vendimin e dytë dhe të fundit të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [A.A. U.ZH. nr. 62/2017], Gjykata rikujton që palë në procedurë ishin edhe parashtruesi i parë edhe i dyti. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se që të dy parashtruesit e kërkesës i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe Gjykata do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Vendimit të dytë të Gjykatës Supreme në raport me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë që i takojnë parashtruesit të parë si individ, përkatësisht si person fizik, si dhe parashtruesit të dytë si subjekt politik, përkatësisht si person juridik.

111. Rrjedhimisht, duke theksuar se në rastin në shqyrtim pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë të njejta, Gjykata vëren që parashtruesi i dytë i kërkesës ka shteruar të gjitha mjetet juridike për të kontestuar para kësaj gjykate Vendimin e parë të Gjykatës Supreme; ndërkaq për sa i takon Vendimit të dytë të Gjykatës Supreme, që të dy parashtruesit i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike.

Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe afatin

112. Në vazhdim, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. (...)

113. Gjykata rikujton që të njëjtat kritere janë të specikuara më tej në në pikat c dhe d të paragrafit 1 të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe paragrafët 2 dhe 4 të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës.

114. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë qartësuar saktësisht se cilat të drejtat dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendojnë se u janë cenuar dhe kanë specifikuar aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullorës së punës dhe e kanë parashtruar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullorës së punës.

Lidhur me kushtet e tjera të pranueshmërisë

115. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në kuadër të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës dhe nuk ka asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme, meqë

asnjë nga kushtet e përcaktuara me rregullin 39 (3) të Rregullores së punës nuk janë të aplikueshme në rastin konkret. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës nr. KO73/16, *Parashtrues Avokati i Popullit,* Aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 49).

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

116. Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara; kontestojnë vendime të autoriteteve publike; kanë shteruar mjetet juridike siç është elaboruar specifikisht më lart; kanë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendojnë se janë shkelur; kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit; kërkesa nuk është qartazi e pabazuar; dhe nuk ka asnjë kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar.

117. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

118. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

119. Në substancë, parashtruesit e kërkesës kryesisht pretendojnë se Gjykata Supreme, por edhe PZAP-i, në procedurat e zhvilluara për shqyrtimin e ankesave dhe apeleve të tyre, kanë dështuar të ofrojnë mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe për pasojë, këto autoritete publike i kanë shkelur të drejtat e tyre zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës.

120. Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata së pari do të trajtojë çështjet që ndërlidhen me juridiksionin e Gjykatës për sa i përket kontesteve zgjedhore. Më pas, Gjykata do të trajtojë në veçanti secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës, duke filluar me kategorinë e pretendimeve që ndërlidhen me: (i) shkeljet e së drejtës në mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, për të vazhduar më pas me kategorinë e pretendimeve që ndërlidhen me: (ii) shkeljet e të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës.

121. Gjykata, përtej aplikimit të garancive kushtetuese që ndërlidhen me të drejtat përkatëse, përgjatë shqyrtimit të të gjitha pretendimeve do të aplikojë gjithashtu: (i) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata mbi bazën e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë; dhe (ii) parimet themelore dhe të përbashkëta të trashëgimisë evropiane për zgjedhje të lira dhe demokratike, të përmbledhura në Opinionet e Komisionit të Venecias, përkatësisht në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore dhe Raportit Shpjegues, Opinioni nr. 190/2002, CDL-AD(2002)023rev2-cor, i miratuar në seancën plenare të 51-të nga Komisioni i Venecias, 5-6 korrik 2002, si dhe më pas, i aprovuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në pjesën e parë të sesionit të vitit 2003 (në tekstin e mëtejmë: Kodi i Praktikës së Mirë dhe/ose Raporti Shpjegues).

122. Gjykata thekson se Kodi i Praktikës së Mirë është i bazuar në parimet nënvizuese të trashëgimisë zgjedhore evropiane, të cilat përbëjnë bazamentin e një praktike të mirë në çështje zgjedhore. Në bazë të këtij Kodi, trashëgimia zgjedhore e Evropës përbëhet nga pesë parime nënvizuese dhe ato janë: (1) vota universale; (2) vota e barabartë; (3) vota e lirë; (4) vota e fshehtë; dhe (5) vota direkte. Përtej këtyre parimeve, Kodi i Praktikës së Mirë gjithashtu përcakton tri kushte, plotësimi i të cilave është parakusht për implementimin e mirëfilltë të parimeve nënvizuese dhe ato janë: (1) respektimi për të drejtat fondamentale; (2) niveli i rregullativës dhe stabiliteti i ligjit zgjedhor; dhe (3) garancitë procedurale.

123. Përtej kësaj, në rrethanat e rastit konkret Gjykata gjithashtu do të aplikojë Opinionet dhe Raportet e miratuara nga Komisioni i Venecias ndër vite për sa i takon praktikave më të mira për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, të përmbledhura në një dokument të veçantë, përkatësisht dokumentin e Komisionit të Venecias që njihet me emrin "*Përmbledhje e Raporteve dhe Opinioneve të Komisionit të Venecias lidhur me Zgjidhjen e Kontesteve Zgjedhore*", CDL-PI(2017)007, i datës 9 tetor 2017 (në tekstin e mëtejmë: Raporti për Zgjidhjen e Kontesteve) dhe Raportin e Komisionit të Venecias për Anulimin e Rezultateve Zgjedhore, CDL-AD(2009)054, të miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike, në takimin e tij të 31-të, dhe të miratuar nga Komisioni i Venecias, në takimin e tij plenar të 81-të, më 11-12 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejmë: Raporti për Anulimin e Rezultateve).

II. Juridiksioni i Gjykatës

124. Gjykata rikujton që çështja e juridiksionit të saj në vlerësimin e kontesteve zgjedhore është ngritur nga parashtruesit e kërkesës e të cilët pretendojnë se Gjykata duhet të bëjë "*vlerësimin e kushtetutshmërisë së tërë procesit zgjedhor*", duke vlerësuar edhe faktet edhe procedurën e zhvilluar dhe jo të kufizohet vetëm "*në natyrën e mbrojtes së lirive dhe të drejtave themelore*". Në mbështetje të këtij argumenti, parashtruesit e kërkesës i referohen Opinionit të Komisionit të Venecias (CDL-PI (2017) 007) dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Austrisë (E 17/2016-20) të 1 korrikut 2016. Këto pretendime i ka kundërshtuar nëpërmjet komenteve të dorëzuara në Gjykatë, z. Shpend Ahmeti, i cili pretendon se në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, Gjykata "*nuk ka kompetencë të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor*".

125. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se juridiksioni i saj është qartë i përcaktuar me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Ky nen përmban gjithsejt 10 pika me nënpikat e tyre përkatëse në të cilat përshkruhen palët e autorizuara për të dorëzuar kërkesa në Gjykatë si dhe çështjet për të cilat ato mund të paraqiten para saj. Përveç nenit 113 të Kushtetutës, kjo e fundit i përcakton Gjykatës edhe një kompetencë juridiksionale të përshkruar specifikisht në paragrafin 4 të nenit 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal] të Kushtetutës. Andaj, Gjykata thekson se juridiksioni i saj i vetëm buron nga nenet e lartcekura të Kushtetutës, përderisa ndonjë juridiksion shtesë nuk i caktohet me Ligj, sipas paragrafit 10 të nenit 113 të Kushtetutës.

126. Gjykata në këtë aspekt thekson se Kushetuta e Republikës së Kosovës përmes nënparagrafit (5) të paragrafit 3 të nenit 113, shprehimisht përcakton juridiksionin e Gjykatës për të vlerësuar nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit, nëse një çështje e tillë ngritet nga Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës ose Qeveria.

127. Përtej kësaj dispozite, Gjykata thekson se ajo nuk ka juridiksion të veçantë të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një procesi zgjedhor. Një juridiksion i tillë, nuk është i përcaktuar me Kushtetutë, as me Ligj dhe as me legjislacionin e aplikueshëm zgjedhor, që do të mund të përbënte juridiksion shtesë mbi bazën e paragrafit 10 të nenit 113 të Kushtetutës.

128. Kompetenca e Gjykatës për të shqyrtuar kontestet zgjedhore, sikurse që është rasti i tanishëm në shqyrtim, është e kufizuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se ankesat që ndërlidhen me konteste zgjedhore mund të shqyrtohen nga Gjykata pasi ato të jenë ngritur nga palët e autorizuara e të cilat kontestojnë një akt të një autoriteti publik, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë themelore përkatëse individuale dhe pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

129. Gjykata Kushtetuese, në këtë aspekt, shërben si instancë e fundit e cila vlerëson kushtetutshmërinë e vendimeve të autoriteteve publike të specializuara për ankesa zgjedhore. Sipas LZP-së, PZAP-i shërben si autoritet i parë pranë të cilit mund të dorëzohen ankesat në shkallë të parë, ndërsa Gjykata Supreme shërben si shkallë e dytë gjyqësore për të njëjtat. Kjo dyshkallshmëri institucionale e vendimmarrjes plotëson kërkesat institucionale që duhet t'i kenë organet që vendosin mbi kontestet zgjedhore sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Praktikës së Mirë.

130. Rrjedhimisht, kompetenca e kësaj Gjykate, në kontekst të kontesteve zgjedhore, përtej çështjeve që bien në fushëveprimin e nënparagrafit (5) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, është e kufizuar në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të këtyre autoriteteve publike, përkatësisht në vlerësimin nëse të njëjtat janë nxjerrë në përputhshmëri me të drejtat dhe me liritë themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumentet ndërkombëtare relevante të përcaktuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, e shkeljen e pretenduar të të cilave, Gjykata mbi bazën e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], e interpreton në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

131. Gjykata gjithashtu vëren që Opinioni i Komisionit të Venecias, të cilit i referohen parashtruesit e kërkesës, përkatësisht Kodi i Praktikës së Mirë, nuk mbështet argumentet e parashtruesve të kërkesës. Në fakt, në elaborimin e standardeve ndërkombëtare që ndërlidhen me një "*sistem efektiv të ankesave*", Kodi i Praktikës së Mirë përcakton gjykatat kushtetuese vetëm si njërën nga mundësitë për të shqyrtuar ankesa që ndërlidhen me kontestet zgjedhore. (Shih pikën 3.3., paragrafi 93, të Raportit Shpjegues). Sipas Kodit të Praktikës së Mirë, shtetet janë të lira të zgjedhin mekanizmat që shqyrtojnë këto ankesa në përputhje me Kushtetutat përkatëse, për aq sa respektojnë parimet e përgjithshme që ndërlidhen me të drejtat zgjedhore. Kjo është po ashtu në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

132. Për çështje krahasimore, është e rëndësishme të theksohet që, për dallim nga Kushtetuta e Republika së Kosovës, në të gjitha shtetet (Gjermani, Austri, Zvicër), vendimeve të të cilave parashtruesit e kërkesës i referohen në Gjykatë, kanë juridiksion të veçantë për t'u marrë me konteste zgjedhore. (Shih nenin 41 dhe 93 të Ligjit Bazik të Gjermanisë ku përcaktohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese Federale për ankesa zgjedhore/elektorale; shih nenin 80 [Ankesa në Gjykatën Federale Supreme] të Ligjit Federal për të Drejtat Politike të Zvicrës; dhe shih nenin 141 të Kushtetutës së Austrisë).

III. Vlerësimi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës

1.Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave për mbrojtje gjyqësore të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës

133. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme nëpërmes të dyja vendimeve të saj ua shkel atyre të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, sepse, sipas tyre, të njëjtat janë arbitrare. Në këtë drejtim, pretendimet e tyre mund të kategorizohen si në vijim: (i) "*konfirmimin e rezultatit zgjedhor*"; (ii) "*parregullsive në ditën e votimit dhe afatshmërisë së paraqitjes së tyre";* dhe (iii) "*parregullsive minimale dhe të balancuara"*. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë së Gjykata Supreme nëpërmjet vendimeve të saj ka bërë (iv) "*vlerësimin vetëm të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë së pretendimeve përkatëse*". (Shih pretendimet specifike të ngritura nga parashtruesit e kërkesës në paragrafët 57-61 të këtij Aktgjykimi). Në trajtimin e secilit pretendim, Gjykata do të aplikojë garancitë kushtetuese, praktikën përkatëse të GJEDNJ-së dhe parimet relevante të Komisionit të Venecias. Për më tepër, pasi të jenë shqyrtuar të gjitha pretendimet konkrete të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjithashtu do të vlerësojë (v) nëse procedurat e ndjekura në rrethanat e rastit konkret, në tërësinë e tyre, mund të kenë rezultuar në shkelje të parimeve të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave gjyqësore të garantuara më Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

(i) Sa i përket "konfirmimit të rezultatit zgjedhor"

134. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se arsyetimi i Gjykatës Supreme në Vendimin e saj të parë, përkatësisht Aktvendimin [AA. nr. 52/2017] se "*ligji nuk e parasheh rezultatin e ngushtë mes kandidatëve si kusht për rinumërim",* është kundërkushtetues sepse, sipas tyre, "*asnjë shtet nuk numëron kushte*

apo raste kur urdhërohet rinumërimi – sepse ajo është e drejtë në vetvete – për konfirmimin e procesit zgjedhor".

135. Gjykata fillimisht thekson që standardet evropiane lidhur me anulimin e rezultateve zgjedhore burojnë nga garancitë e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas Komisionit të Venecias, të njëjtat burojnë nga paragrafi b i nenit 25 të Konventës për të Drejtat Civile dhe Politike, e i cili përcakton parimet themelore për të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur. Gjykata rikujton që të dy këto instrumente ndërkombëtare mbi bazën e nenit 22 të Kushtetutës janë drejtpërdrejt të aplikueshme në rendin juridik të Kosovës.

136. Megjithatë, të drejtat për anulimin të rezultateve, të cilat në parim por me përjashtime, janë të aplikueshme edhe në kuptim të të drejtave aktive dhe pasive, në praktikë janë të aplikueshme vetëm në rast të shkeljeve substanciale të ligjit zgjedhor. Sipas Komisionit të Venecias, përderisa praktika për anulimin e rezultatit zgjedhor ndryshon shumë brenda shteteve, në parim numri i ankesave ndaj rezultatit zgjedhor është shumë i madh, ndërsa anulimi i rezultatit zgjedhor është zakonisht zgjidhja e fundit. (Shih pjesën II, paragrafi 5, të Raportit për Anulimin e Rezultateve). Sipas të njëjtit, anulime të rezultatit zgjedhor kanë ndodhur shumë rrallë në dekadat e fundit. (Shih pjesën V, paragrafi 77, të Raportit për Anulimin e Rezultateve Zgjedhore).

137. Pothuajse në të gjitha shtetet anëtare të Komisionit të Venecias, çështja e anulimit të rezultateve zgjedhore përcaktohet nëpërmjet dispozitave të përgjithshme. Praktika ndryshon nga shtetet që i kanë kriteret e përcaktuara përmes Kushtetutave, ligjeve, apo nuk janë të përcaktuara në asnjërën. (Shih pjesën III, pika A, paragrafi 8, të Raportit për Anulimin e Rezultateve). Për më tepër, ka shtete anëtare të Komisionit të Venecias që përcaktojnë se të gjitha kontestet gjyqësore, për sa i takon zgjedhjeve, duhet të mbyllen para se kandidati të marrë detyrën; dhe ka vende në të cilat nuk lejohet anulimi i mandatit pasi që të jetë dhënë betimi për kryerjen e detyrës. (Shih pjesën IV, pika C, paragrafët 70-75, të Raportit për Anulimin e Rezultateve).

138. Një emërues i përbashkët, megjithatë, është vendosur nga Komisioni i Venecias si pjesë përbërëse e "*sistemit efektiv të ankesave*", e i cili sipas Kodit të Praktikës së Mirë, Raportit Shpjegues dhe Raportit për Zgjidhje të Kontesteve përcakton: "*Organi i ankimit duhet të ketë kompetencë të anulojë zgjedhjet kur parregullsitë ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Mund të anulohen zgjedhjet në tërësi ose vetëm rezultatet në një zonë zgjedhore ose qendër votimi. Në rastin e anulimit, në zonën përkatëse duhet të organizohen zgjedhje të reja*".

139. Praktika e GJEDNJ-së, sa i përket vlerësimit të kontesteve zgjedhore, e e cila në mënyrë të vazhdueshme i referohet Kodit të Praktikës së Mirë, duke theksuar se ekzistenca e një sistemi kombëtar për "*sistem efektiv të ankesave*" është një nga garancitë themelore të zgjedhjeve të lira dhe të drejta, reflekton të njëjtin standard. Ajo gjithashtu përmban testin thelbësor të përcaktuar nga Komisioni i Venecias, përkatësisht vlerësimin nëse "*parregullsitë mund kenë ndikuar rezultatin përfundimtar*", ose, edhe më specifikisht, ekziston "*pamundësi të vërtetë për të përcaktuar dëshirat e zgjedhësve*". (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Kovach kundër Ukrainës* nr 39424/02, Aktgjykim i 7 shkurtit 2008; dhe *Riza dhe të tjerët kundër Bullgarisë,* 48555/10 dhe 48377/10, Aktgjykim i 13 tetorit 2015).

140. Megjithatë, GJEDNJ-ja gjithashtu thekson se nuk është roli i gjykatave të modifikojnë shprehjen e vullnetit të popullit. (Për më shumë kontekst sa i përket kësaj të fundit, shih vendimet e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, *I. Z. kundër Greqisë*, nr. 18997/81, Vendimi i 28 shkurtit 1994; dhe *Babenko kundër Ukrainës*, nr. 43476/98, Vendimi i 4 majit 1999). Ajo mban qëndrimin se liria që gëzojnë autoritetet vendimmarrëse duhet të kufizohet, me saktësi të mjaftueshme, me dispozitat e ligjit të brendshëm. Procedura duhet të jetë e tillë që të garantojë një vendim të drejtë, objektiv dhe të "*arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të parandalojë çdo shpërdorim të pushtetit nga ana e autoritetit përkatës*". (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Podkolzina kundër Letonisë*, nr. 46726/ 99, Aktgjykim i 9 prillit 2002, paragrafi 35; *Kovach kundër Ukrainës*, cituar më lart, paragrafët 54-55; *Kerimova kundër Azerbajxhanit*, nr. 20799/06 Aktgjykim i 30 shtatorit 2010, paragrafët 44-45; *Riza dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, cituar më lart, paragrafi 143).

141. Praktika e GJEDNJ-së gjithashtu vë theks në masa minimale mbrojtëse kundër arbitraritetit. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Davydov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 75947/11, Aktgjykim i 30 majit 2017, paragrafi 288). Në këtë kontest, kur përfshihet në një shqyrtim të tillë, GJEDNJ-ja kufizohet në vlerësimin nëse vendimi i marrë nga autoriteti i brendshëm ka qenë arbitrar ose qartazi i paarsyeshëm. (Shih rastet e GJEDNJ-së*, Riza dhe të tjerët kundër Bullgarisë,* cituar më lart, paragrafi 143; *Kerimli dhe Alibeyli kundër Azerbajxhanit* nr. 18475/06 dhe 22444/06, Aktgjykim i 10 janarit 2012, paragrafët 38-42; *Davydov dhe të tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 288).

142. Bazuar në elaborimet e mësipërme, standardeve të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias, për sa i përket anulimit të rezultatit zgjedhor

dhe praktikës përkatëse të GJEDNJ-së për sa i takon shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, Gjykata vëren se kriteret themelore që përbëjnë testin nëse shqyrtimi i ankesave për kontestimin e rezultatit zgjedhor do të mund të rezultonte në anulimin e të njëjtit, ndahen në dy kategori: (i) "*kompetencat e autoritetit që merr vendimin*"; dhe (ii) "*diskrecionin e saj dhe kufizimet përkatëse*".

143. Sa i përket të parës, Gjykata vëren se, sipas standardeve dhe praktikës së referuar, autoritetet që shqyrtojnë ankesat zgjedhore duhet të kenë: (i) mundësinë e anulimit të zgjedhjeve; (ii) kjo mundësi duhet të përdoret apo të kufizohet me saktësi të mjaftueshme në dispozitat e ligjit të aplikueshëm; (iii) detyra e tyre nuk është që të ndryshojnë vullnetin e zgjedhësve; dhe (iv) duhet të kufizohen në kuptim të evitimit të arbitraritetit. Ndërsa, sa i përket të dytës, Gjykata vëren që diskrecioni i autoriteteve vendimmarrëse duhet të fokusohet në vlerësimin nëse "*determinimi i dëshirës së votuesit është pamundësuar*" ose "*shkeljet dhe parregullsitë e tilla mund të kenë ndikuar në rezultatin zgjedhor*". Praktika e gjykatave evropiane e përmbledhur nga raportet e Komisionit të Venecias dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, siç është elaboruar më lart, tregon që ky test është interpretuar në mënyrë konservative dhe se rastet në të cilat gjykatat kanë anuluar rezultatin zgjedhor, janë raste të shkeljeve substanciale të ligjit dhe që reflektojnë arbitraritet të dukshëm.

144. Ka praktikë të mjaftueshme gjyqësore për vlerësimin nëse "*parregullsitë mund kenë ndikuar rezultatin përfundimtar*". Gjykatat evropiane të referuara nga Komisioni i Venecias kanë konstatuar se "*parregullsitë mund të kenë ndikuar rezultatin zgjedhor*" atëherë kur ka pasur: (i) dështim të përmbushjes së kërkesës së nevojshme për pjesëmarrje në zgjedhje; (ii) gabime në regjistrimin e votuesve ose nominimin e kandidatëve; (iii) shkelje të rregullimit të fushatës; (iv) shkelje të legjislacionit të zbatueshëm për procesin e votimit; (v) shkelje në numërim ose në raportim; dhe (vi) shkelje në ndarjen e mandateve. (Shih paragrafin 79 të Raportit për Anulimin e Rezultateve).

145. Kategoritë e lartreferuara nën (iv) dhe (v): "*shkelje të legjislacionit të aplikueshëm gjatë procesit të votimit*" dhe "*shkelje gjatë numërimit dhe raportimit*", përkojnë më për së afërmi me rrethanat e rastit konkret, andaj Gjykata do të përmbledhë edhe rastet kur gjykatat respektive kanë kontatuar shkelje.

146. Sipas Komisionit të Venecias, gjykatat evropiane të cilave ju referohet kjo e fundit, kanë konstatuar se është "*shkelur legjislacioni i zbatueshëm për procesin e votimit*" atëherë kur: (i) zgjedhjet nuk kanë

filluar për më shumë se 6 orë nga koha e përcaktuar; (ii) rendi publik është prishur në ditën e votimit; (iii) ka pasur mungesa të fletëvotimeve në vendvotime; (iv) disa votues kanë votuar disa herë apo për të tjerët dhe identiteti i tyre nuk është kontrolluar; (v) ka pasur votim familjar; (vi) personat zyrtarë përgjegjës në vendvotime nuk kanë pasur njohuritë e duhura për punën që duhet të kryejnë; (vii) diferenca dhe mospërputhshmëria në mes të fletëvotimeve në kuti të votimit dhe numrit të votuesve që kanë votuar ishte evidente; (viii) hapja e votave të hedhura nga personat e paautorizuar; (ix) manipulimi i votave gjatë votimit me postë; (x) fletëvotimet nuk janë nënshkruar dhe vulosur nga personat kompetentë; (xi) dhënia e ndihmës personave në vendvotim të cilët qartazi nuk kanë nevojë për ndihmë për të votuar; (xii) mungesë e dokumentimit për procesin e votimit; (xiii) votim pasi që vendvotimi është mbyllur; dhe (xiv) mospërfundim i procedurës zgjedhore nga ana e administruesit të zgjedhjeve. Ndërsa, sipas të njejtës praktikë gjyqësore, "*shkeljet gjatë numërimit apo raportimit*" janë konstatuar atëherë kur: (i) votat e hedhura para afatit (në ato vende ku lejohet) refuzohen në mënyrë jokorrekte nga administruesit e zgjedhjeve; (ii) fletëvotimet lihen të pambikëqyrura para se ato të numërohen; (iii) ekzaminimi i fletëvotimeve bëhet nga persona të paautorizuar; (iv) votat e njëjta numërohen dy herë; (v) ekzaminimi i vlefshmërisë të votave është bërë bazuar në kritere të ndryshme nga administruesit e zgjedhjeve; (vi) rezultati zgjedhor kalkulohet në mënyrë të gabuar; (vii) parregullsitë e bëra në raportin e zgjedhjeve të cilat nuk janë nënshkruar nga ana e komisionit zgjedhor; (viii) dokumentacioni dhe fletëvotimet janë dërguar të hapura te komisioni zgjedhor; dhe (ix) falsifikohen rezultatet. (Shih pjesën V, paragrafët 76-80, të Raportit për Anulimin e Rezultateve Zgjedhore). Të gjitha këto kategori rastesh, në tërësinë e tyre, reflektojnë shkelje substanciale të ligjit dhe rregullave zgjedhore si dhe arbitraritet të dukshëm.

147. Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e pretendimit konkret, Gjykata rikujton se Vendimi i parë i Gjykatës Supreme, e të cilin parashtruesit e kërkesës e kontestojnë përmes këtij pretendimi, ishte nxjerr si rezultat i ankesës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Gjykatën Supreme kundër Vendimit [ZL. A. nr. 1102/2017] të 22 nëntorit 2017 të PZAP-it, i cili kishte pranuar të bazuar ankesën e parashtruesit të dytë të kërkesës në PZAP kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve preliminare. PZAP-i kishte vendosur dhe kishte urdhëruar KQZ-në për rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve duke u bazuar në dy argumente kryesore: (i) "*numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta*" dhe (ii) "*rezultatin e ngushtë në mes të dy kandidatëve*". Gjykata Supreme, kishte ndryshuar këtë Vendim të PZAP-it, duke arsyetuar kryesisht, se arsyetimi i PZAP-i të nuk ishte i

bazuar në ligj, sepse sipas Gjykatës Supreme as (i) "*numri i madh i fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta*" dhe as (ii) "*rezultati e ngushtë në mes të dy kandidatëve*", nuk është i përcaktuar me ligj si kusht për të vendosur për "rinumërim" apo "rivotim".

148. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se dispozitat e përgjithshme të LZP-së përcaktojnë që "*përsëritja e zgjedhjeve*" është një nga parimet që qeverisin procedurën e numërimit të të fletëvotimeve. LZP-ja më tej përcakton mundësinë e vendosjes për "*rinumërim*" dhe "*rivotim*", dhe kjo kompetencë, sipas LZP-së, i është lënë: (i) KQZ-së, e cila mbi bazën e paragrafit 2 të nenit 106 mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë, para certifikimit të rezultateve; dhe (ii) PZAP-it, i cili mbi bazën e paragrafit 4 të nenit 117, ka kompetencën që të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin. Kjo kompetencë e PZAP-it më tej është e saktësuar nëpërmjet nenit 14 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së, përkatësisht pikës b të paragrafit 1 të nenit 120 të LZP-së, e, sipas të cilit, PZAP-i në "*raste të jashtëzakonshme*" dhe para certifikimit të rezultateve zgjedhore, mund të anulojë rezultatet e zgjedhjeve në një qendër votimi ose vendvotimit, duke e urdhëruar KQZ-në të përsëritë të njëjtat, nëse ai konsideron se "*shkeljet e identifikuara kanë ndikim në rezultatet finale*".

149. Gjykata rrjedhimisht vëren që mundësia e "*rinumërimit*" dhe "*rivotimit*" është e përcaktuar qartë në LZP dhe ndryshimet përkatëse dhe është e specikuar më tej në Rregullat e KQZ-së dhe të PZAP-it. Përderisa LZP nuk numëron saktë kriteret mbi të cilat shkeljet eventuale gjatë procesit zgjedhor do të rezultonin në rinumërim apo rivotim, ndryshimet dhe plotësimet e LZP-së përcaktojnë dy kushte, mbi bazën e të cilave PZAP-i mund të vendosë që të anulojë rezultatin zgjedhor dhe rrjedhimisht të urdhërojë përsëritjen e votimit, si në vijim: (i) "*rrethanat e jashtëzakonshme*" dhe (ii) "*nëse shkeljet e idenfikuara kanë ndikim në rezultatet finale*". Vlerësimi nëse këto dy kushte janë plotësuar është në diskrecion të: (i) KQZ-së në kontekstin e paragrafit 2 të nenit 106 të LZP-së në lidhje me nenin 6 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimit e LZP-së; (ii) të PZAP-it në kontekstin e paragrafit 4 të nenit 117 të LZP-së dhe nenit 120 të LZP-së në lidhje me nenin 14 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimit e LZP-së; dhe (iii) të gjykatave që vlerësojnë ankesat përkatëse.

150. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që standardet e mishëruara në legjislacionin e aplikueshëm zgjedhor, edhe sa i përket kompetencave të organeve vendimmarrëse dhe të përcaktimit të kufijve të

diskrecionit të tyre, janë në harmoni më praktikën e shteteve anëtare të Komisionit të Venecias dhe gjithashtu me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

151. Në këtë aspekt, Gjykata thekson që arsyetimi dhe konstatimi i Gjykatës Supreme se dy kriteret mbi bazën e të cilave PZAP-i kishte urdhëruar rinumërimin: (i) "*numri i madh të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta*" dhe as (ii) "*rezultatin e ngushtë në mes të dy kandidatëve*", nuk ishin baza të përcaktuara në ligj për të urdhëruar rinumërimin apo rivotimin, ishte i saktë dhe i bazuar në LZP dhe ndryshimet përkatëse.

152. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se Vendimi i parë [AA. nr. 52/2017] i datës 25 nëntor 2017, i Gjykatës Supreme të cilin parashtruesit e kërkesës e kontestojnë, nuk kishte aplikuar ligjin në mënyrë qartazi arbitrare dhe i njëjti nuk kishte shkelur të drejtat zgjedhore të parashtruesve të kërkesës. Kjo sepse: (i) autoritetet për shqyrtim të ankesave në rrethanat e rastet konkret, PZAP dhe Gjykata Supreme respektivisht, kishin konsideruar se parregullsitë *"nuk kanë ndikim në rezultatet finale*" dhe se (ii) rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet përkatëse nuk përbejnë "*rrethana të jashtëzakonshme*".

153. Për më tepër, Gjykata vlerëson se rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk gjejnë mbështetje në asnjë nga rastet e GJEDNJ-së e as në praktikën gjyqësore të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias, siç janë elaboruar më lart.

(ii) Sa i përket "parregullsive në ditën e votimit dhe afatshmërisë së paraqitjes së tyre"

154. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i dytë [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i Gjykatës Supreme nuk ka bazë ligjore. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që arsyetimi i Gjykatës Supreme se në procedurën ankimore ajo është kufizuar vetëm në vlerësimin e *"parregullsive që kanë të bëjnë me administrimin e të dhënave",* nuk ka mbështetje në ligjin e aplikueshëm. Çështjet që ndërlidhen me *"parregullsitë rreth administrimit të të dhënave në QNR",* sipas parashtruesve të kërkesës mbështeten vetëm në procedurën e veçantë të paraparë me nenin 105 të LZP-së, ndërsa parashtruesit e kërkesës kanë dorëzuar ankesat në bazë të nenit 119 të LZP-së. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë së nenet 118.4 dhe 119.1 të LZP-së dhe ndryshim-plotësimet përkatëse, njohin të drejtën e plotësimit të ankesave të dorëzuara në PZAP me prova dhe me fakte të reja. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Zgjidhjen e Kontesteve, duke

argumentuar se kriteret e pranueshmërisë në raste të tilla duhet të jenë qartazi të specifikuara në ligj, me qëllim që të parandalohet shpallja e ankesave si të palejueshme.

155. Gjykata vëren që, në thelb, ky pretendim i parashtruesve të kërkesës ka të bëjë me shpalljen e pasafatshme nga PZAP-i dhe nga Gjykata Supreme të pretendimeve për parregullsi në ditën e votimit, përkatësisht pretendimeve që ndërlidhen me (i) shfrytëzimin e shërbimeve të transportit rrugor/taksive; (ii) thirrjeve telefonike; dhe (iii) dërgimit të sms-ve nga ana e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, e të cilat ishin paraqitur në PZAP pas shpalljes së rezultatit përfundimtar.

156. Konteksti i këtij pretendimi ngrit katër çështje esenciale: (i) afatin kohor për ankesë; (ii) kushtet për ngritjen e një ankese; (iii) mundësinë e paraqitjes së provave të reja; dhe (iv) kompetencat e autoriteteve që shqyrtojnë ankesat. Në këtë aspekt, Gjykata sërish do t'i referohet Kodit të Praktikës së Mirë dhe Raportit përkatës Shpjegues. Ky i fundit, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e pretendimit konkret, në pjesën që adreson "*sistemet efektive të ankesave*", ndër të tjera i referohet edhe: (i) afateve kohore për ankesa; (ii) qasjes në mjete juridike; dhe (iii) kompetencave të organeve të ankimimit. (Shih me detajisht pikën 3.3, paragrafët 95, 96, dhe 97 të Raportit Shpjegues).

157. Për sa i përket të parës, përkatësisht "*afateve kohore për ankesa*", Raporti Shpjegues përcakton që ato duhet të jenë të shkurtëra dhe që trupat e apelimit duhet gjithashtu të vendosin sa më shpejt që është e mundshme. Një afat kohor prej 3 deri në 5 ditë për shkallën e parë (për ankesë dhe vendimmarrje) është i arsyeshëm për vendime në konteste zgjedhore sipas Raportit Shpjegues. Afatet kohore janë edhe më tej të specifikuara në Raportin për Anulimin e Rezultateve, duke përcaktuar se praktika evropiane njeh afate prej një (1) deri në pesë (5) ditë për ankesa që ndërlidhen me konteste zgjedhore. Sipas të njëjti raport, është e lejueshme që gjykatat kushtetuese të marrin më shumë kohë për vendimmarrjen e tyre (shih paragrafin 61 të Raportit për Anulimin e Rezultateve). Sa i përket të dytës, përkatësisht "*qasjes në mjete juridike*", Raporti Shpjegues përcakton që procedura e ankesës duhet të jetë e thjeshtë, është e nevojshme të evitohet formalizimi i tepruar dhe të evitohen vendimet e papranueshmërisë, posaçërisht në raste të ndieshme politikisht. Më speficikisht, procedurat e ankimimit duhet të jenë të thjeshta dhe që përgjegjësitë e organeve të ndryshme të përfshira në këtë proces të jenë të definuara mirë. Ndërsa, sa i përket të tretës, përkatësisht, "*kompetencave të organeve të ankimit*", Raporti Shpjegues përcakton që duhet të eliminohet rreziku që organet e njëpasnjëshme të refuzojnë të japin një vendim meritor, gjë

që, sipas Komisionit të Venecias, mund të ndodhë kur ekzistojnë në teori më shumë se një mundësi për të paraqitur ankesë në organe të caktuara, apo në rastet kur juridiksioni i gjykatave të ndryshme p.sh. gjykata të rregullta dhe gjykata kushtetuese – nuk janë të diferencuara në mënyrë të qartë. (Shih pjesën 3, pikën 3.3, paragrafi 97, të Raportit Shpjegues).

158. Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e pretendimit konkret, Gjykata rikujton se Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [A.A. U.ZH. nr. 62/2017], e të cilin parashtruesit e kërkesës e kontestojnë përmes këtij pretendimi, ishte nxjerrë si rezultat i ankesës së parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Supreme kundër Vendimit [A.ZL.nr.1125/2017] të 1 dhjetorit 2017 të PZAP-it, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare. Gjykata Supreme kishte konfirmuar Vendimin e PZAP-it i cili kishte refuzuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës që ndërlidheshin me shpalljen e rezultatit përfundimtar si të pabazuara, ndërsa kishte hedhur poshtë kategorinë e pretendimeve që ndërlidheshin me shpalljen e rezultatit preliminar, përkatësisht të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, me arsyetimin se këto pretendime ishin të pasafatshme.

159. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që LZP-ja dhe ndryshimet përkatëse përcaktojnë që, në parim, afatet e ankesave në PZAP dhe të PZAP-it në Gjykatën Supreme ushtrohen brenda afatit 24 orësh.

160. Gjykata vëren se: (i) neni 13 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin në lidhje me paragrafin 1 të nenit 119 të LZP-së përcakton se ankesat në PZAP duhet të paraqiten brenda 24 orëve nga mbyllja e qendrave të votimit; (ii) vendimet e PZAP-it, sipas nenit 12 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me paragrafin 4 të nenit 118 të LZP-së, apelohen gjithashtu brenda 24 orësh në Gjykatë Supreme, në rastet ku gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro dhe çështja prek një të drejtë themelore. Mbi bazën e të njëjtin nen, PZAP-i mund të "*rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar*"; dhe, në fund, (iii) neni 4 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me nenin 105 të LZP-së përcakton se për ankesa që ndërlidhen me procesin e administrimit të numërimit në QNR, afati është 24 orë nga "*nga ndodhja e shkeljes së supozuar*".

161. Gjykata gjithashtu vëren se inicimi i këtyre ankesave ndërlidhet me dy faza pas zgjedhjeve: fazën pas shpalljes së rezultateve preliminare dhe pas shpalljes së rezultateve përfudimtare, respektivisht në harmoni edhe me Kodin e Praktikës së Mirë. (Shih pjesën 3, pikën 3.3, paragrafin 95 e Raportit Shpjegues).

162. Në kontekstin e këtij pretendimi, Gjykata vëren që një ditë pas mbajtjes së raundit të dytë të zgjedhjeve dhe pas shpalljes së rezultateve preliminare nga KQZ-ja, parashtruesi i dytë i kërkesës kishte parashtruar ankesë në PZAP. Përmbajtja e ankesës kishte të bënte kryesisht me kontestimin e fletëvotimeve të shpallura të pavlefshme dhe të zbrazëta. Në këtë ankesë, parashtruesit e kërkesës nuk kishin ngritur pretendime të tjera që ndërlidhen me parregullsitë në ditën e votimit, specifikisht: (i) shfrytëzimin e shërbimeve të transportit rrugor/taksive; (ii) thirrjeve telefonike; dhe (iii) dërgimit të sms-ve nga ana e Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Parashtruesit e kërkesës arsyetojnë se këto parregullsi nuk i kishin pasur të njohura kur ishte mbyllur afati për ankesa dhe se të njëjtat i kishin kuptuar më 20 nëntor 2017, pas mbylljes së afatit për dorëzimin e së njëjtës.

163. Megjithatë, Gjykata vëren që të nesërmen, përkatësisht me 21 nëntor 2017, PZAP-i i kishte dhënë mundësi parashtruesve të kërkesës të plotësojnë kërkesën e tyre, sepse të njëjtën e kishin konsideruar të përgjithësuar. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur pretendimet e lartcekura e që ndërlidhen me parregullsitë në ditën e votimit, por kishin plotësuar kërkesën vetëm sa i përket pretendimeve që ndërlidheshin kryesisht me fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta. PZAP-i nxori vendimin të nesërmen, përkatësisht më 22 nëntor 2017, në favor të parashtruesit të kërkesës, duke urdhëruar rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve. Ky vendim u apelua në Gjykatën Supreme nga Lëvizja VETËVENDOSJE! më 23 nëntor 2017. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur këto pretendime as në përgjigje në ankesë në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme, më 25 nëntor 2017, nxori Vendimin e saj të parë, duke e pranuar ankesën e Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe duke e shfuqizuar vendimin e PZAP-it. Pas përfundimit të procedurave për kontestim të rezultateve preliminare në PZAP dhe në Gjykatë Supreme, më 29 nëntor 2017, KQZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë për Kryetar të Komunës së Prishtinës. Më 30 nëntor 2017, një ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në PZAP, duke kundërshtuar rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, duke pretenduar ndër të tjera shkelje të ligjit dhe të Kushtetutës, pretendim ky që ndër të tjera ishte arsyetuar edhe me pretendimet e lartcekura për parregullsi në ditën e votimit. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se këto parregullsi që pretendohet të jenë kuptuar më 20 nëntor 2017, sipas pretendimit 1 orë pas përfundimit të afatit për ankesa që ndërlidhen me shpalljen e rezultateve preliminare, i ishin paraqitur për herë të parë PZAP-it më 30 nëntor

2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, dhe 10 ditë pas mbylljes së qendrave të votimit.

164. Për më tepër, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se këto pretendime nuk duhej shpallur të pasaftshme sepse ankesat e tyre nuk ishin bazuar në nenin 105 të LZP-së dhe në ndryshimet përkatëse, por në nenet 118 dhe 119 të LZP-së dhe në ndryshimet përkatëse. Gjykata fillimisht vëren se: (i) ankesa e 20 nëntorit 2017 është bazuar në nenin 119 të LZP-së dhe në ndryshimet përkatëse; (ii) ankesa e 30 nëntorit 2017 është bazuar në nenet 105 dhe 119 të LZP-së dhe në ndryshimet përkatëse; ndërsa, (iii) ankesa e 5 dhjetorit 2017 gjithashtu është bazuar në nenet 105 dhe 119 të LZP-së dhe në ndryshimet përkatëse. Megjithatë, fakti që parashtruesit e kërkesës pretendojnë të kenë parashtruar ankesat mbi bazën e njërit nen dhe jo tjetrit, nuk ndryshon situatën në rrethanat e rastit konkret.

165. Kjo sepse neni 13 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me paragrafin 1 të nenit 119 përcakton që afati për paraqitjen e ankesës në PZAP është 24 orë nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit. Në këtë kontekst, neni 12 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me paragrafin 4 të nenin 118 të LZP-së saktësisht përcakton se vendimet e PZAP-it mund të apelohen brenda 24 orësh në Gjykatën Supreme. I njëjti nen, siç është cekur më lart, përcakton që PZAP-i mund "*të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar*". Megjithatë, Gjykata vëren që, para shpalljes së rezultati përfundimtar, parashtruesit e kërkesës nuk kishin shfrytëzuar asnjë nga këto mundësi për paraqitjen e pretendimeve përkatëse.

166. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kishin pasur disa mundësi që të paraqesin këto pretendime para PZAP-it dhe para Gjykatës Supreme para shpalljes së rezultatit përfundimtar: (i) nëpërmjet plotësimit të ankesës fillestare, mundësi kjo e dhënë nga PZAP-i më 21 nëntor 2017; (ii) nëpërmjet përgjigjes ndaj ankesës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Gjykatë Supreme para marrjes së vendimit të kësaj fundit; dhe (iii) në çdo kohë nga parashtrimi i ankesës së parë e edhe deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Supreme, bazuar paragrafin 2 të nenit 12 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e nenit paragrafit 4 të nenit 118 të LZP-së. Këto të fundit i mundësojnë PZAP-it të "*rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar*". Gjykata vëren që edhe Komisioni i Venecias njeh të drejtën e prezentimit të evidencës/fakteve, pasi një ankesë të jetë parashtruar. (Shih pjesën 6 pikën 3.3, paragrafin 65 pika (a) të Raportit për Zgjidhjen e Kontesteve). Në fakt, këto pretendime për parregullsi në ditën e

zgjedhjeve, sipas shkresave të lëndës, i ishin paraqitur PZAP-it vetëm pas 10 ditësh, pas marrjes së vendimit të parë nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht, pasi ishin përmbyllur të gjitha afatet për ankesa dhe vendim-marrje të nevojshme për shpalljen e rezultateve përfundimare.

167. Për më tepër dhe relevante për rrethanat e rastit konkret, është fakti se Raporti Shpjegues po ashtu përcakton që është e rëndësishme që të evitohen vendimet e papranueshmërisë apo që të refuzohet dhënia e vendimeve në merita, por këtë të fundit Raporti Shpjegues e ndërlidh me rrethanat kur mund të ketë konflikt jurisdiksionesh për ankesat zgjedhore apo për arsye të tjera formale mbi të cilat gjykatat përkatëse mund të refuzojnë të japin përgjigje në merita. Megjithatë, Gjykata vëren se Kodi i Praktikës së Mirë, Raporti Shpjegues, Raporti për Zgjidhjen e Kontesteve dhe as Raporti për Anulim Rezultatesh, e në këtë pikëpamje as praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, në kontekstin e kërkesave për mungesë formaliteti apo edhe të kërkesave për evitim të vendimeve të papranueshmërisë, nuk i referohen mosrespektimit të afateve për dorëzimin e ankesave që ndërlidhen me konteste zgjedhore. Përkundrazi, të njëjtat theksojnë rëndësinë e afateve të shkurtëra për të njëjtat. Përjashtim nga kjo bën vetëm e drejta e prezentimit të evidencës/fakteve, pasi një ankesë të jetë parashtruar dhe para se vendimi përkatës përfundimtarë të jetë marrë. (Shih pjesën 6, pikën 3.3, paragrafin 65, pika (a), të Raportit për Zgjidhjen e Kontesteve). Ankesat dhe evidencat/faktet e dorëzuara pas afateve të përcaktuara me ligj nuk bien në këtë kategori.

168. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjen se Vendimi i dytë [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i Gjykatës Supreme të jetë nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe as të ketë interpretuar ligjin e aplikueshëm zgjedhor në mënyrë arbitrare. Për më tepër, Gjykata vlerëson se rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk gjejnë mbështetje në asnjë nga rastet e GJEDNJ-së e as në praktikën gjyqësore të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias, siç janë elaboruar më lart.

(iii) Sa i përket "parregullsive minimale dhe të balancuara"

169. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konstatimet e Gjykatës Supreme janë arbitrare, sepse të njëjtat konstatojnë se *"gjatë numërimit të disa nga vendvotimet, janë vërejtur parregullsi, mirëpo kanë qenë minimale dhe të balancuara, sepse janë prekur të dy kandidatët"*. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"shkelja e të drejtave kushtetuese ekziston ose nuk ekziston – nuk mund të thuhet se është shkelur pak apo shumë"*.

170. Në trajtimin e këtij pretendimi, Gjykata fillimisht vëren se ajo nuk gjen që PZAP-i apo edhe Gjykata Supreme, të kenë arritur në këtë konkludim e as të kenë konstatuar se janë vërejtur parregullsi të cilat do të mund të ishin *"minimale dhe të balancuara"* – siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës.

171. Megjithatë, Gjykata vëren që një pretendim i tillë mund të jetë ndërlidhur me kontekstin e Vendimit të dytë të PZAP-it, përkatësisht me Vendimin [ZL. Anr. 1125/2017] e 1 dhjetorit 2017, dhe me Vendimin e dytë të Gjykatës Supreme, përkatësisht me Aktgjykimin [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] e 7 dhjetorit 2017, vendime këto që, ndër të tjera, kishin trajtuar gjetjet e ekipeve hetuese të PZAP-it për adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesave në lidhje me fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta.

172. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se PZAP-i, bazuar në nenin 14 të Rregullit nr. 02/2015, angazhoi ekipet hetuese për të shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesave, përkatësisht parregullsitë e fletëvotimeve të pavlefshme, të fletëvotimeve të zbrazëta dhe mungesën e zarfeve që përmbanin vota me kusht, e që mund të kenë rezultuar në parregullsi të karakterit zinxhiror të njohura si "*treni bullgar*", në 31 vendvotimet të cilat i kishin kontestuar parashtruesit e kërkesës. Gjykata rikujton që ky ekip hetues, sipas arsyetimit të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme, kishte shqyrtuar dhe rivlerësuar votat e pavlefshme në të gjitha vendvotimet e specifikuara nga parashtruesit e kërkesës dhe kishte konstatuar se 4 nga 183 fletëvotimet të cilat ishin shpallur të pavlefshme ishin, në fakt, të vlefshme. Ky dallim në numër të votave ishte përfshirë në rezultatin përfundimtar. Gjetjet e ekipeve hetuese të PZAP-it kishin treguar që, nga këto 4 vota të shpallura të pavlefshme fillimisht dhe që rezultuan të vlefshme, 2 kishin qenë në favor të parashtruesit të parë të kërkesës, ndërsa 2 në favor të z. Shpend Ahmeti.

173. PZAP-i dhe Gjykata Supreme kishin konstatuar se gjetjet e tilla nuk rezultojnë në "*pamundësi për të determinuar vullnetin e votuesve*" dhe se të njëjtat "*nuk kanë ndikuar në rezultatin final*". Siç është elaboruar më lart, në bazë të praktikës së GJEDNJ-së dhe parimeve të Komisionit të Venecias të përmbledhura në Kodin e Praktikës së Mirë, Raportit përkatës Shpjegues dhe Raportit për Zgjidhjen e Kontesteve, vlerësimi nëse parregullsitë kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar i takon autoriteteve që shqyrtojnë apelet zgjedhore dhe në rastin konkret, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme. Gjykata nuk gjen që arsyetimet e këtyre autoriteteve të jenë arbitrare.

174. Për më tepër dhe përtej arsyetimit dhe vlerësimit të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme, Gjykata gjithashtu i referohet Kodit të Praktikës së Mirë, për aq sa trajton çështjen e fletëvotimeve të pavlefshme, të zbrazëta apo edhe të dëmtuara. Duke adresuar çështjet që ndërlidhen me procesin e "*numërimit*", Kodi i Praktikës së Mirë mban se *"Është mirë që të shmanget shpallja e shumë fletëve të votimit si të pavlefshme ose të prishura. Në rast dyshimi, duhen bërë përpjekje shtesë për të mësuar se cili ka qenë qëllimi i votuesit"*. (Shih pikën 3.2., paragrafin 49, të Raportit Shpjegues).

175. Gjykata vëren që ky parim nuk nënkupton detyrimisht rinumërimin apo edhe anulimin e rezultatit zgjedhor, përkatësisht rivotimin. Plotësimi i kritereve që do të rezultonin në anulimin e rezultatit zgjedhor është elaboruar detajisht më lart. Ky parim, në fakt, nënkupton që në rast të votave të pavlefshme, të zbrazëta apo edhe të dëmtura, praktika e shteteve anëtare të Komisionit të Venecias përcakton që duhet të bëhet edhe një përpjekje shtesë për të rivlerësuar ato fletëvotime.

176. Gjykata gjen që kjo përpjekje në rrethanat e rastit konkret është bërë. Siç është cekur më lart, ekipet hetuese të PZAP-it jo vetëm që kanë rinumëruar të gjitha fletëvotimet në 31 qendrat e votimit të kontestuara pas shpalljes së rezultatit përfundimtar në PZAP nga parashtruesit e kërkesës, por kanë shqyrtuar dhe rivlerësuar të gjitha fletëvotimet e shpalluara të pavlefshme dhe të zbrazëta, duke konstatuar se dallimi ndërmjet votave të pavlefshme dhe të vlefshme është 4 vota nga 183 sosh.

177. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu i referohet udhëzimeve të GJEDNJ-së për sa i përket nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, e sipas të cilit: "*Një gabim i thjeshtë ose parregullsi në këtë fazë teknike nuk tregon në vetvete një padrejtësi të zgjedhjeve, nëse u respektuan parimet e përgjithshme të barazisë, transparencës, paanësisë dhe pavarësisë të administrimit të zgjedhjeve elektorale. Koncepti i zgjedhjeve të lira do të vihej në rrezik vetëm nëse ka dëshmi të shkeljeve procedurale që do të ishin në gjendje të pengonin shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve, për shembull nëpërmjet shtrembërimit flagrant të qëllimit të votuesve; dhe kur ankesa të tilla nuk kalojnë nëpër një ekzaminim efektiv në nivel vendi*". (shih rastin e GJEDNJ-së, *Davydov dhe të tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafët 287-288; shih gjithashtu Udhëzimin e GJEDNJ-së për sa i përket nenit 3 të Protokolit nr. 1 të KEDNJ-së, paragrafi 96).

178. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjen se Vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të jetë nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe as të ketë

interpretuar ligjin e aplikueshëm zgjedhor në mënyre arbitrare. Për më tepër, Gjykata vlerëson se rrethanat e këtij pretendimi nuk gjejnë mbështetje në asnjë nga rastet e GJEDNJ-së e as në praktikën gjyqësore të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias, siç janë elaboruar më lart.

(iv) Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë nga Gjykata Supreme

179. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, sepse nëpërmjet vendimeve të kontestuara është vlerësuar vetëm ligjshmëria e vendimeve të PZAP-it, pa u trajtuar kushtetutshmëria e tyre. Kjo ka rezultuar, sipas tyre, në shkeljen e parimit të *"supremacisë kushtetuese"*.

180. Në thelb, Gjykata vëren që ky pretendim ngërthen dy çështje esenciale: (i) detyrimin e gjykatave të rregullta që përgjatë vendimmarrjes së tyre të vlerësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, përtej të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj; dhe (ii) mungesën e arsyetimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkelje kushtetuese të parashtruesve të kërkesës.

181. Për sa i përket të parës, Gjykata thekson se, përtej Gjykatës Kushtetuese, është po ashtu detyrim i gjykatave të rregullta që përgjatë vlerësimit të shkeljeve të pretenduara të interpretojnë edhe të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Ky detyrim buron nga: (i) neni 21 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës, sipas të cilit, ndër të tjera, liritë themelore të njeriut janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtyre të drejtave hyjnë edhe ato të garantuara me marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës; dhe (ii) neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] i Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Rrjedhimisht, të drejtat e garantuara me Kushtetutë mbrohen nga të gjitha instancat gjyqësore dhe Gjykata Kushtetuese, e cila mbi bazën e nenit 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar i vlerësimit të shkeljeve të pretenduara nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.

182. Nenet kushtetuese të lartreferuara, po ashtu garantojnë parimin e "*supremacisë kushtetuese*", sipas të cilit Kushtetuta, në aspekt

hierarkik, qëndron në krye të piramidës dhe është burim i të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore në Republikën e Kosovës. Në këtë të fundit, "*supremacia*" e Kushtetutës po ashtu sigurohet përmes aplikimit të mekanizmit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe verifikimit të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën, gjithnjë sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë.

183. Megjithatë, në kontekstin e vlerësimit të të drejtave dhe lirive themelore, përkatësisht kërkesave individuale, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që kufiri në mes të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të rregullta në vlerësimin e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë nuk është gjithmonë saktësisht i definuar. Gjykata Kushtetuese por edhe gjykatat e rregullta janë shpesh në pozicion të bëjnë interpretimin e ligjit, Kushtetutës por edhe instrumenteve ndërkombëtare, siç janë ato të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës. Është parimi i subsidiaritetit dhe doktrina e shkallës së katërt, të cilat në parim, por varësisht nga rrethanat e veçanta të secilit rast, e bëjnë këtë dallim.

184. Në dritën e sqarimeve të mësipërme, dhe për të vlerësuar nëse Gjykata Supreme kishte shqyrtuar pretendimet thelbësore të parashtruesëve të kërkesës, Gjykata i referohet çështjes së dytë të shtruar më lart, përkatësisht mungesës së pretenduar të arsyetimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkelje kushtetuese të parashtruesve të kërkesës.

185. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht duhet të theksojë se garancitë e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ-së, në parim, mbi bazën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk janë të aplikueshme në konteste zgjedhore. (Shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Pierre-Bloch kundër Francës*, Aktgjykim i 21 tetorit 1997, paragrafi 50). Kjo nuk do të thotë që vendimet që ndërlidhen me konteste zgjedhore nuk duhet të jenë të arsyetuara. Përkundrazi. Megjithatë, arsyetimi i një vendimi gjyqësor në konteste zgjedhore duhet të vihet në kontekstin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse të GJEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, procedura e shqyrtimit të kontesteve zgjedhore duhet të përfshijë një "*vendim mjaftueshëm të arsyetuar*" në mënyrë që "*të parandalohet abuzimi i pushtetit nga autoriteti relevant vendimmarrës*". (Shih, ndër të tjera, *Kerimova kundër Azerbajxhanit,* cituar më lart, paragrafët 44-45; *Podkolzina kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 35; *Kovach kundër Ukrainës*, cituar më lart, paragrafët 54-55). Për më tepër, një vendim i arsyetuar në konteste zgjedhore gjithashtu kërkohet nga Opinionet e Komisionit të Venecias, specifikisht të Raportit për

Zgjidhjen e Kontesteve. (Shih pikën 11.2 të Pjesës C pika 1.6 e Raportit). Gjykata, në këtë aspekt, gjithashtu rikujton që afatet kohore për vendimmarrje në konteste zgjedhore janë në parim shumë të shkurtra, posaçërisht në shqyrtimin në shkallë të parë dhe të dytë.

186. Përtej kontesteve zgjedhore, koncepti i "*mjaftueshmërisë së arsyetimit*" edhe në rastet kur e dëshirueshme do të mund të ishte një arsyetim më i gjërë dhe më i detajuar, është koncept i zhvilluar dhe i përdorur edhe nga vet GJEDNJ. (Shih rastin *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 72508/13, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe [GC] i 28 nëntorit 2017, paragrafi 227 – ndonëse rrethanat e rastit nuk janë të njëjtat koncepti i "*mjaftueshmërisë së arsyetimit*" qëndron). Në këtë rast të Dhomës së Madhe (*"Grand Chamber"*), GJEDNJ në arsyetimin e saj kishte theksuar me sa vijon: *"Përderisa një arsyetim më i detajuar do të ishte i dëshirueshëm, Gjykata* [GJEDNJ] *është e kënaqur që ky* [arsyetim] *ishte i mjaftueshëm në këto rrethana."*

187. Për të vlerësuar saktësisht se a janë trajtuar pretendimet kushtetutese të parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Supreme dhe ka pasur "*arsyetim të mjaftueshëm*" nga Gjykata Supreme, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të rikujtojë saktësisht citatet përkatëse nga dy ankesat e dorëzuara nga parashtruesit e kërkesës para Gjykatës Supreme.

188. Së pari, sa i përket ankesës së parë të dorëzuar në Gjykatën Supreme, përkatësisht ankesës së 30 nëntorit 2017, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kishin theksuar me sa vijon: *"Kushtetuta e Republikës ë Kosovës në nenin 45 [...] në tri paragrafët e saj flet për tri të drejta kushtetuese të secilit qytetar të Kosovës. E para ka të bëjë me të drejtën për të qenë i zgjedhur dhe për të zgjedhur përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet me vendim gjyqësor; E dyta ka të bëjë me të drejtën për të garantuar shenjtërinë e votës, si një e drejtë personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë; E treta dhe e fundit ka të bëjë me të drejtëne secilit qytetar të Kosovës që të ketë garancione nga institucionet shtetërore se realizimi i të drejtës zgjedhore do të garantohet ashtu që secili të ketë të drejtë për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike."* Tutje parashtruesit e kërkesës kishin theksuar se: *"Këto të drejta zgjedhore janë të mishëruara në ligjet përkatëse zgjedhore të Kosovës, përfshirë këtu infrastrukturën për zgjedhjet lokale. Kështu është edhe me [LZP-në] i cili në nenin 3 [Parimet Themelore] parasheh shumë parime të zgjedhjeve dhe procesit zgjedhor në tërësi"*. Sipas parashtruesve të kërkesës, "*Parimet bazë të cilave të gjithë duhet t'u përmbahen me qëllim të garantimit të të drejtave zgjedhore nga paragrafi i parë i nenit 45 të Kushtetutës janë si vijon: zgjedhjet mbahen në bazë të*

votës së lirë, të barabartë, të fshehtë me rregullat e këtij ligji dhe rregullave të KQZ-së; votuesit me të drejtë vote janë të barabarta në ushtrimin e drejtës së tyre për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave; cdo qyetar ka të drejtë që të zgjidhet pa diskriminim; dhe liria e fshehtësia e votës është e garantuar". Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kishin theksuar se: *"Kodi është rregullativë implementuese zgjedhore e KQZ-së me nr. 11/2013 dhe e vetë nenit 45 të Kushtetutës dhe [LZP-së] si më sipër"*. Po ashtu, në pjesën e fundit të kësaj ankese, ata kishin theksuar se: *"E drejta zgjedhore e kandidatit [...] është shkelur në atë mënyrë që nga subjekti "Vetëvendosje" janë ndërmarrë disa veprime që cënojnë rëndë parimet themelore kushtetuese e ligjore lidhur me zgjedhjet. Mbi të gjitha është shkelur PARIMI I FSHEHTËSISË SË DHE E DREJTA E VOTËS SË LIRË, si dy komponentë të asaj që në demokracitë kushtetuese njihet si SHËNJTËRIA E VOTËS."*

189. Së dyti, sa i përket ankesës së dytë të dorëzuar në Gjykatë Supreme, përkatësisht ankesës së 5 dhjetorit 2017, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar anulim të Vendimit të PZAP-së për tri arsye: "*I. për shkak të zbatimit të gabuar nga ana e PZAP të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhje Lokale; II. për shkak të vlerësimit në mënyrë jo të drejtë të provave të ofruara nga ana e ankuesve solidar si më sipër dhe, së fundmi III.për shkak të shkeljes së tri të drejtave kushtetuese të votuesve për kryetar të Komunës së Prishtinës të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës: - të drejtën për të qenë i zgjedhur dhe për të zgjedhë;- të drejtën e garantuar të shenjtërisë së votës; dhe së fundmi – të drejtën e secilit qytetar të Kosovës që të ketë garancione nga institucionet shtetërore se realizimi i të drejtës zgjedhore do të garantohet ashtu që secili të ketë të drejtë për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike por jo në ditën e heshtjes zgjedhore."*

190. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në ankesat e tyre të dorëzuara në Gjykatë Supreme iu janë referuar shkeljes së nenit 45 të Kushtetutës, duke cituar dhe duke përmbledhur të drejtat që janë të garantuara nëpërmjet tre paragrafëve të këtij neni, por pretendimet konkrete për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre, parashtruesit e kërkesës i kishin ndërtuar nëpërmjet argumenteve dhe arsyetimeve të bazuar në ligjin e aplikueshëm zgjedhor dhe rregullat zgjedhore.

191. Gjykata konsideron se të gjitha pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës e të cilat ishin të argumentuara dhe të arsyetuara, ishin trajtuar dhe kishin marrë një përgjegje nga Gjykata

Supreme. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës nuk i referohen asnjë pretendimi konkret për të cilin pretendojnë të mos kenë marrë një përgjegje nga Gjykata Supreme.

192. Në linjë me praktikën e saj, Gjykata gjithashtu thekson se qëndrimi tashmë i konsoliduar i saj *se "vetëm përmendja e neneve përkatëse të Kushtetutës pa shtjelluar shkeljen e pretenduar të tyre, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese",* (shih, ndër të tjera, për këtë kontekst, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI54/18, *parashtrues Shaip Sylaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 tetorit 2018, paragrafi 61 dhe referencat në atë paragraf) vlen, *mutatis mutandis*, edhe për parashtresat me pretendime për shkelje kushtetuese që palët i bëjnë pranë organeve para-kushtetuese, në rastin konkret në PZAP dhe Gjykatë Supreme. Edhe këtyre të fundit, sikurse edhe në procedurat para Gjykatës Kushtetuese, duhet t'u paraqiten argumente të shtjelluara mbi pretendimet për shkelje kushtetuese, duke përforcuar kështu qëndrimin që nuk mjafton vetëm citimi i neneve përkatëse kushtetuese apo i parimeve themelore të një të drejte.

193. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme e të cilat janë nxjerrë në afat të shkurtër 72 orësh siç është e përcaktuar me ligj, janë vendime të cilat kanë "*arsyetuar mjaftueshëm*" pretendimet e parashtruesëve të kërkesës bazuar në ligjin e aplikueshëm zgjedhor, dhe i cili bazuar në hierarkinë e normave është në përputhje me Kushtetutën, përderisa kushtetushmërisa e tij të mos jetë konstestuar në Gjykatën Kushtetuese, bazuar mbi dispozitat përkatëse kushtetuese dhe përderisa të mos jetë vlerësuar e shpallur në të kundërtën nga ajo.

(v) Sa i përket parimeve të përgjithshme në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës dhe nëse pretendimet e parashtruesve të kërkesës në tërësinë e tyre mund të kenë rezultuar në cenimin e të njëjtave

194. Pas trajtimit të pretendimeve konkrete të parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu do të trajtojë edhe do të aplikojë, në rrethanat e rastit konkret, parimet e përgjithshme për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për mjet juridik, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së dhe në parimet themelore për një "*sistem efektiv ankesash*", siç janë përmbledhur nga raportet dhe opinionet relevante të Komisionit të Venecias, për të vlerësuar nëse proceduarat e ankesës në tërësinë e tyre në këtë kontest zgjedhor mund të kenë rezultuar në shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.

195. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që neni 54 i Kushtetutës, përbëhet nga dy rregulla por të cilat duhet lexuar së bashku dhe në ndërvarësi me njëra-tjetrën. Rregulli i parë është i përgjithshëm dhe thekson se *"çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj."* Në parim, ky rregull nënkupton që mbrojtja gjyqësore është e drejtë e garantuar për secilin individ, fizik apo juridik, të cilit mund të i jetë "*shkelur*" një e drejtë ekzistuese e garantuar me Kushtetutë ose me ligj apo mund të i jetë "*mohuar*" e drejta për të fituar apo për të gëzuar ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutë ose me ligj. Rregulli i dytë i këtij neni flet dhe garanton të drejtën për "*mjete efektive ligjore*" në rastet kur konstatohet se një e drejtë e mbrojtur me Kushtetutë apo me ligj është shkelur.

196. Neni 54 i Kushtetutës gjithashtu plotësohet dhe duhet të lexohet ngusht dhe në lidhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe me nenin 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, siç do të shpjegohet në paragrafët vijues.

197. Gjykata vëren që neni 32 i Kushtetutës plotëson të dy aspektet e nenit 54 të Kushtetutës, duke garantuar të drejtën e përdorimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore apo vendimeve administrative e të cilat kanë cenuar të drejtat e garantuara, por duke e kufizuar këtë përdorim në mënyrën e përcaktuar me ligj. Ndërsa, neni 13 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një "*zgjidhje efektive*" në rast të shkeljes së të drejtave të garantuara me KEDNJ, para një organi kombëtar, përkatësisht para një organi të përcaktuar me të drejtën vendëse.

198. Rrjedhimisht, në parim dhe në tërësinë e tyre, neni 54 i Kushtetutës për mbrojten gjyqësore të të drejtave, neni 32 i Kushtetutës për të drejtën në mjet juridik dhe neni 13 i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ.

199. Deri më sot, Gjykata në disa raste ka gjetur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës. Në të gjitha ato raste, shkelja është konstatuar në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës, respektivisht edhe me nenin 13 të

KEDNJ-së. Shkeljet në ato raste kanë konsistuar në dështimin/refuzimin e autoriteteve publike për të zbatuar një vendim të formës së prerë. Më specifikisht, praktika e deritashme e Gjykatës konsiston në gjetjen e shkeljeve kushtetuese që ndërlidhen me rregullin e dytë të nenit 54 të Kushtetutës. (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI47/12, parashtrues *Islam Thaçi*, Aktgjykim i 11 korrikut 2012, paragrafët 46 dhe 51; KI55/11, parashtrues *Fatmir Pireci,* Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafët 43-47; KI129/11, parashtrues *Viktor Marku*, Aktgjykim i 11 korrikut 2012, paragrafët 44-48; KI50/12, parashtrues *Agush Llolluni*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafët 39-45; KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykimi i 24 marsit 2014, paragrafi 90; KI112/12 parashtrues *Adem Meta*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, paragrafët 54-55; KI80/12 parashtrues *Sali Pepshi,* Aktgjykim i 5 korrikut 2013, paragrafët 49-50).

200. Megjithatë, esenca e të drejtave të garantuara me nenin 13 të KEDNJ-së, e në kontekstin e rendit kushtetues të Republikës se Kosovës, në ndërlidhje me nenin 32 e 54 të Kushtetutës, është e përcaktuar nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër të tjera, përmes rastit *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë,* e sipas të cilit: *"Neni 13 kërkon që kur një individ e konsideron veten të paragjykuar nga një masë që pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të ketë një mjet juridik përpara një autoriteti kombëtar për të vendosur lidhur me pretendimet e tij dhe nëse është e nevojshme/përshtatshme, për të marrë korrigjim ("redress"). Kështu, neni 13 duhet të interpretohet si garantues për një "mjet efektiv juridik përpara një autoriteti kombëtar" për të gjithë ata që pretendojnë se të drejtat dhe liritë e tyre sipas Konventës janë shkelur"."* (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë,* nr. 5029/71, Aktgjykim i 6 shtatorit 1979, paragrafi 64).

201. Në këtë kontekst, kur GJEDNJ-ja shqyrton nëse një mjet juridik i ofruar nga shteti përkatës është efektiv ose jo, në thelb ajo përgjigjet në pyetjen nëse mjeti i tillë juridik, në rast se do të ishte përdorur, a e ngërthen në vetvete mundësinë dhe kapacitetin që të parandalojnë shkeljen e pretenduar e cila ka ngjarë apo vazhdon të ngjajë, ose për shkeljen e cila ka tashmë ka ndodhur, a do të mundej ankuesi të gjente zgjidhje adekuate. Kjo është pyetja kryesore në të cilën GJEDNJ-ja përgjigjet kur vendos mbi efektshmërinë e një mjeti juridik.

202. Më konkretisht, nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dalin kërkesat kryesore për sa i takon një mjeti efektiv juridik: (i) kërkesat thelbësore të një mjeti efektiv juridik; (ii) kërkesat institucionale për një mjet efektiv juridik; dhe, (iii) çështja e kumulativitetit të procedurave. Duke

marrë parasysh që rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës ndërlidhen kryesisht me shkeljet e pretenduara për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe efektivitetin e mjetit juridik, Gjykata do t'i shtjellojë këto tri kritere më detajisht në vijim duke i aplikuar ato në rrethanat e rastit konkret.

203. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht "*kërkesave thelbësore të një mjeti efektiv juridik*", jurisprudenca e GJEDNJ-së tregon që për të konsideruar një mjet juridik efektiv ai duhet të jetë: (i) "*efektiv në praktikë dhe në ligj*"; (ii) efektiviteti duhet të jetë i tillë që të ketë mundësinë dhe kapacitetin që të parandalojë ndodhjen e një shkelje të pretenduar apo vazhdimin e asaj shkeljeje; ose (iii) të jetë një mjet juridik i cili mund të ofrojë korrigjim adekuat për çfarëdo lloj shkelje e cila ka ndodhur. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Kudla kundër Polonisë,* cituar më lart). Nuk ka mjet efektiv juridik asnjëherë në rast se fushëveprimi i rishikimit nga një gjykatë apo autoritet publik i autorizuar që të bëjë rishikim të tillë është aq i dobët sa që e ka të pamundshme të adresojë në mënyrë të duhur elementet kyç rreth asaj se a ka pasur apo jo shkelje të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Wainwright kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 12350/04, Aktgjykim i 26 shtatorit 2006, paragrafët 53-56).

204. Në këtë kuptim, Gjykata vëren që këto kritere janë të plotësuara në rrethanat e rastit konkret për arsyet në vijim: (i) mjeti juridik në konteste zgjedhore është i përcaktuar me LZP-në dhe me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin përkatës, përkatësisht në nenet 105, 118 dhe 119 të tij. Për më tepër, siç është elaboruar më lart, përtej ankesave që ndërlidhen me kontestet zgjedhore, LZP-ja dhe ndryshimet përkatëse gjithashtu përcaktojnë mundësinë e rinumërimit dhe rivotimit në "*raste të jashtëzakonshme*" dhe "*nëse shkeljet e idenfikuara kanë ndikim në rezultatet finale*", siç është përcaktuar me nenet 106, 117 dhe 120 të LZP-së dhe me ndryshimet përkatëse. Siç është elaboruar më lart, dispozitat ligjore që përcaktojnë mundësinë e anulimit të rezultatit zgjedhor janë në harmoni me praktikën e shteteve anëtare të Komisionit të Venecias, siç janë përmbledhur me Kodin e Praktikës së Mirë dhe në Raportin Shpjegues, në Raportin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe në Raportin për Anulimin e Rezulateve. Për më tepër, praktika e PZAP-it dhe e Gjykatës Supreme tregojnë që këto dispozita janë efektive, në rast se PZAP-i dhe Gjykata Supreme gjejnë që pretendimet e parashtruesve të kërkesave janë të bazuara. Raste të fundit të praktikës së PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme vërtejtojnë këtë. Gjykata thekson se, në zgjedhjet e fundit, votimi ishte përsëritur në Komunën e Parteshit, pas Vendimit të PZAP-it i cili kishte vërtetuar si të bazuara pretendimet në ankesë mbi bazën e raporteve të policisë dhe të shkresave të Prokurorisë Themelore (shih

Vendimin [ZL. Anr. 560/2017] e 2 nëntorit 2017) dhe në Komunën e Istogut, pas Vendimit të PZAP-it i cili kishte vërtetuar pretendimet si rezultat i hetimit të materialit zgjedhor (shih Vendimin [ZL. Anr. 1114/2017] e 27 nëntorit 2017 të PZAP-it). Në të njëjtën linjë argumenti, Gjykata thekson se mjeti juridik në dispozicion në konteste zgjedhore siç është i përcaktuar me ligjin e aplikueshëm zgjedhor, (ii) ka kapacitetin që të parandalojë ndodhjen e një shkelje të pretenduar apo vazhdimin e asaj shkeljeje dhe (iii) mund të ofrojë korrigjim adekuat për çfarëdo lloj shkelje e cila ka ndodhur. Gjykata gjithashtu rikujton se GJEDNJ-ja ka përcaktuar kur mjeti juridik nuk është efektiv. Rasti *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* e sqaron këtë kontekst. Në këtë rast, për dallim nga rrethanat e rastit konkret, GJEDNJ-ja, duke e konstatuar fuqinë e dobët të rishikimit gjyqësor që e kanë pasur gjykatat e rregullta me Ligjin për të Drejtat e Njeriut të vitit 1998 ("*Human Rights Act 1998"*), kishte vendosur të gjejë shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së pikërisht për shkak të perspektivës së dobët të suksesit që ofronte mjeti juridik në fjalë. (Shih rastin *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 14310/88, Aktgjykim i 28 tetorit 1994, paragrafi 100; shih po ashtu, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Wainwright kundër Mbretërisë së Bashkuar,* cituar më lart, paragrafët 53-56).

205. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht "*kërkesave institucionale*" për një mjet efektiv juridik, jurisprudenca e GJEDNJ-së tregon që autoriteti i cili referohet në nenin 13 të KEDNJ-së, nuk duhet patjetër të jetë një autoritet gjyqësor. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 22414/93, Aktgjykim i 15 nëntorit 1996). Por, në qoftë se nuk është autoritet gjyqësor, atëherë është e nevojshme që fuqia dhe garancitë që ofron të jenë relevante për të determinuar nëse mjeti para atij organi është efektiv apo jo. Në këtë aspekt, GJEDNJ-ja vlerëson çështjen e pavarësisë së atij autoriteti publik si dhe garancitë procedurale që ai ofron për të determinuar efektivitetin e një mjeti juridik. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *De Souza Ribeiro kundër Francës,* nr. 22689/07, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2012).

206. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që edhe këto kritere janë të plotësuara sepse autoriteti vendimmarrës në konteste zgjedhore në Republikën e Kosovës përfshin institucione më pavarësi të plotë institucionale, përfshirë KQZ-në, si organ, pavarësia e të cilit është e përcaktuar me nenin 139 të Kushtetutës; PZAP-in, si organ i përhershëm dhe i pavarur, siç parashihet me LZP-në dhe me ndryshim-plotësimet përkatëse, dhe organ kompetent për të vendosur në lidhje me parashtesat dhe ankesat që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor; dhe, në fund, një organ gjyqësor – Gjykatën Supreme, e cila shqyrton vendimet e PZAP-it sipas ankesave.

207. Dhe, në fund, sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht, "*kumulativitetit të procedurave*", jurisprudenca e GJEDNJ-së tregon që akumulimi i tërësishëm i procedurave dhe i kanaleve të korrigjimit *("redress")* në një sistem ligjor duhet të merret parasysh kur të vendoset lidhur me atë se a ka pasur parashtruesi një mjet efektiv në dispozicion apo jo. Në këtë aspekt, GJEDNJ-ja ka theksuar që edhe nëse asnjë mjet juridik në vetvete nuk mund të përmbushë të gjitha kërkesat e nenit 13 të KEDNJ-së – totali i mjeteve juridike mund të përmbushë ato kërkesa. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Surmeli kundër Gjermanisë,* nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; shih, po ashtu, *Leander kundër Suedisë*, nr. 9248/81, Aktgjykim i 26 marsit 1987).

208. Në këtë aspekt, Gjykata, duke marrë parasysh që ka tashmë ka kontastuar se kërkesat e dy kritereve të para janë përmbushur, gjithashtu konstaton se procedura në tërësinë e saj ka mundësuar dhe ka ofruar një mjet juridik efektiv në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kriteret për vlerësimin e efektivitetit të një mjeti efektiv juridik në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, janë përmbushur.

209. Në mbështetje të këtij konkludimi, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së GJEDNJ-së në rastet kur ajo ka gjetur shkelje të nenit 3 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, përkatësisht në raste kur ka gjetur shkelje të së drejtës në mjet juridik në lidhje me të drejtat zgjedhore, raste këto që përkojnë më pretendimet e parashtruesve të kërkesës.

210. Në rastin *Petkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (shih rastin e GJEDNJ-së, *Petkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 77568/01, 178/02 dhe 505/02 Aktgjykim i 11 korrikut 2009), parashtruesit pretendonin se atyre u ishte ndaluar kandidimi në zgjedhje parlamentare dhe se nuk kishin pasur mjet efektiv për të kontestuar një ndalesë të tillë. Ata ishin pjesë e listës së kandidatëve për zgjedhje, mirëpo ishin hequr nga lista nën dyshimin se kishin qenë kolaboratorë me ish-agjencitë sekrete shtetërore të sigurisë në kohën e komunizmit në Bullgari. Më vonë, Gjykata Supreme Administrative e Bullgarisë kishte urdhëruar që të tre parashtruesit të riktheheshin në listat e kandidatëve, mirëpo vendimet e asaj gjykate nuk ishin zbatuar dhe zgjedhjet parlamentare ishin mbajtur pa parashtruesit, si kandidatë. GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së pasi që vërejti se: (i) rregullat zgjedhore lidhur me deregjistrimin ishin nxjerrë vetëm 2 muaj e gjysmë para zgjedhjeve, gjë që binte ndesh me rekomandimet e Komisionit të Venecias; (ii) mekanizmi si i tillë

paraqiste vështirësi të theksuara praktike, ligjore dhe kohore; dhe (iii) çështjet praktike të kësaj iniciative ligjore ishin qartësuar nga KQZ-ja vetëm 12 ditë para zgjedhjeve e që kishin mundur të qartësoheshin shumë më herët. Pas vrojtimit të këtyre çalimeve, GJEDNJ-ja gjeti shkelje bazuar në dështimin e autoriteteve bullgare që të ndjekin vendimet përfundimtare të cilat kërkonin rivendosjen e parashtruesve të kërkesës në lista të kandidatëve. Shkelja e nenit 13 në rrethanat e këtij rasti u gjet për arsye se GJEDNJ-ja nuk u bind që procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë e kishin kapacitetin të jepnin një korrigjim të mjaftueshëm për parashtruesit.

211. Në rastin *Grosaru kundër Rumanisë* (shih rastin e GJEDNJ-së, *Grosaru kundër Rumanisë,* nr. 78039/01, Aktgjykim i 2 marsit 2010*)*, parashtrues ishte një kandidat nga radhët e minoritetit italian në Rumani, i cili garonte për një ulëse në Kuvend. Ai kishte fituar më së shumti vota në nivel kombëtar, ndërkaq një kandidate tjetër, po ashtu nga komunitetit i italianëve të Rumanisë, kishte fituar më së shumti vota në një zonë të caktuar zgjedhore (*"single contituency"*). Fitues i ulëses në Kuvend ishte shpallur kandidatja tjetër dhe jo parashtruesi i kërkesës. Problemi që GJEDNJ-ja gjeti në këtë rast kishte të bënte me faktin se ekuivalenti i KQZ-së në Rumani shpalli fituesin me aplikim arbitrar të ligjit, për arsye se ligji specifikisht nuk e theksonte se a duhej të shpallej fitues ai që fiton në nivel kombëtar apo në nivel të zonës zgjedhore. Pra, rasti kishte të bënte me mungesë të qartësisë së ligjit elektoral për sa i takon minoriteteve nacionale dhe mungesës së paanshmërisë së organeve që shqyrtuan kërkesën e parashtruesit, të cilat u konsideruan si shkelje që cenuan esencën e së drejtës së garantuar me nenin 3 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së. Ndërkaq, shkelja e nenit 13, u gjet pikërisht sepse asnjë gjykatë vendëse nuk kishte vendosur mbi interpretimin e asaj dispozite kontestuese ligjore të ngritur nga parashtruesi. Në njërën anë, Gjykata Supreme e Rumanisë e kishte deklaruar të papranueshme kërkesën e parashtruesit, meqë konsideronte se vendimet e KQZ-së ishin përfundimtare dhe, në anën tjetër, Gjykata Kushtetuese e Rumanisë e kishte deklaruar veten si jokompetente dhe pa juridiksion për të vendosur në çështje zgjedhore.

212. Në fund, në rastin *Paunović dhe Milovojević kundër Serbisë* (shih rastin e GJEDNJ-së*, Paunović dhe Milovojević kundër Serbisë, nr. 41683/06,* Aktgjykim i 24 majit 2016*)*, në një kohë të caktuar, përfaqësuesi i partisë së tyre politike kishte dorëzuar dorëheqjet e tyre nga mandati i deputetit, dorëheqje të cilat ata i kishin revokuar më pas. Përkundër revokimit të dorëheqjes dhe faktit që dorëheqja nuk ishte dorëzuar nga ata personalisht, mandati i tyre i deputetit u ishte ndërprerë. Rrjedhimisht, çështja kryesore para GJEDNJ-së kishte të

bënte me atë se a është ndërprerë mandati në përputhshmëri me rregullat e aplikueshme ligjore apo jo. GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 3 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së për arsye se i gjithë procesi i ndërprerjes së mandatit të deputetit ishte bërë jashtë kornizës ligjore dhe, si i tillë, ishte i paligjshëm. GJEDNJ-ja gjeti se mandati i tyre u ndërpre përkundër faktit që parashtruesit e kishin njoftuar Kuvendin personalisht se nuk duan të dorëzojnë mandatin e tyre dhe se kërkesën e tyre të parë për dorëheqje e konsiderojnë të tërhequr dhe jovalide. Ndërkaq, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja sqaroi se ekzaminimi i ndarë për këtë pretendim jepet vetëm për kontestet zgjedhore paselektorale, të cilat nuk kanë qenë subjekt i shqyrtimit nga gjykatat vendëse dhe jo për ato konteste zgjedhore ku pretendimet e parashtruesve ishin subjekt i shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat vendëse. Si rrjedhojë, duke qenë se në rastin konkret Gjykata Supreme dhe ajo Kushtetuese e Serbisë nuk i kishin shqyrtuar fare meritat e rastit, GJEDNJ-ja gjeti shkelje edhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

213. Gjykata vëren se përderisa rrethanat faktike të rasteve në fjalë nuk përkojnë me rrethanat faktike të rastit konkret, të njëjtat rezultojnë në një emërues të përbashkët të rasteve në të cilat GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së në ndërlidhje me të drejtat zgjedhore dhe ai është *arbitrariteti*. Në të tri këto raste, gjykatat kishin refuzuar të vlerësonin pretendime për shkelje serioze të ligjit zgjedhor. Në rastin konkret, kjo Gjykatë ka shqyrtuar meritat e pretendimeve të parashtruesve dhe mban qëndrimin se në rrethanat e rastit konkret nuk ka "*arbitraritet*" në kuptimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

214. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton se ajo do t'i referohet parimeve thelbësore për të drejtën në mjet juridik në kontestet zgjedhore, siç janë përmbledhur nga Komisioni i Venecias, dhe specifikishit rregullave të përcaktuara për "*një sistem efektiv ankesash*", si pjesë esenciale e "*garancive procedurale*", njëri nga tri kushtet ky për implementimin e pesë parimeve themelore që ndërlidhen me zgjedhje demokratike, të përmbledhura nga Kodi për Praktikën e Mirë, Raporti përkatës Shpjegues dhe Raporti për Zgjidhjen e Kontesteve.

215. Sipas Komisionit të Venecias, janë nëntë (9) parime themelore që përbëjnë një "*sistem efektiv ankesash*" në konteste zgjedhore. (Shih pjesën 3.3 të Kodit). Për rëndësinë e rrethanave të rastit konkret, Gjykata i referohet parimeve në vijim: (i) procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalitete, veçanërisht për sa i përket pranimit të kërkesës së ankesës/apelit; (ii) procedurat e ankimit dhe, në veçanti, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme, duhet të rregullohen qartë me ligj, në mënyrë që të shmangen konfliktet e

juridiksionit. As pala ankuese dhe as autoritetet nuk duhet të kenë të drejtë të zgjedhin organin e ankimit; (iii) organi i ankimit duhet të ketë kompetencë të anulojë zgjedhjet kur parregullsitë ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Mund të anulohen zgjedhjet në tërësi, ose vetëm rezultatet në një zonë zgjedhore ose në një qendër votimi. Në rastin e anulimit, në zonën përkatëse duhet të organizohen zgjedhje të reja; (iv) afatet kohore për ankimin dhe për marrjen e vendimeve për ankim duhet të jenë të shkurtra (tre deri në pesë ditë për çdo ankim në shkallë të parë); dhe (v) në rast se organi i ankimit është një komision më i lartë zgjedhor, ai duhet të ketë *ex officio* të drejtën për të korrigjuar ose për të anuluar vendimet e marra nga komisionet më të ulëta zgjedhore.

216. Gjykata rikujton se përgjatë arsyetimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ajo ka trajtuar të gjitha këto çështje. Dhe, është relavante të ritheksohet se ka sqaruar specifikisht, se përderisa parimet e Komisionit të Venecias rekomandojnë evitimin e kërkesave të papranueshme, e njëjta asnjëherë nuk është vendosur në kontekstin e humbjes së afatit për të dorëzuar ankesat apo edhe për të dorëzuar provat para organeve vendimmarrëse para marrjes së vendimit përkatës përfundimtar.

217. Bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura në rrethanat e rastit konkret dhe faktet e paraqitura, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe në standardet e përmbledhura nga Komisioni i Venecias, konstaton se: (i) Vendimi i parë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017, nuk është nxjerrë në shkelje dhe është në përputhshmëri me të drejtat për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54, të së drejtës në mjet juridik efektiv të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së, të subjektit politik LDK, përkatësisht parashtruesit të dytë të kërkesës; dhe se (ii) Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i 7 dhjetorit 2017, nuk është nxjerrë në shkelje dhe është në përputhshmëri me të drejtat për mbrotje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54, e të drejtës në mjet juridik efektiv të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së, të z. Arban Abrashi dhe të subjektit politik të LDK-së, përkatësisht parashtruesit të parë dhe të dytë të kërkesës.

2. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës

218. Në trajtimin e këtyre pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata së pari do të përmbledhë parimet e përgjithshme rreth të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës, dhe më pas do t'i aplikojë ato në rrethanat e rastit konkret. Sa i përket të parës, Gjykata do të elaborojë: (i) aplikueshmërinë e nenit 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret; (ii) garancitë e nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe, (iii) parimet themelore/kornizën e vlerësimit të kontesteve zgjedhore mbi bazën e praktikës së GJEDNJ-së dhe të Komisionit të Venecias. Më pas, Gjykata, nëpërmjet aplikimit të këtyre parimeve themelore, do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës sa i përket shkeljes së (i) "*votës së barabartë*"; (ii) "*votës së lirë*"; dhe, (iii) "*parimit të transparencës*".

Parime të përgjithshme

(i) Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

219. Të drejtat e garantuara sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë thelbësore për krijimin dhe për mbajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë të qeverisur nga sundimi i ligjit. (Shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2) [DHM], nr. 74025/01, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 58). Megjithatë, këto të drejta nuk janë absolute. Ato kanë hapësirë për "*kufizime të nënkuptuara*" dhe shteteve kontraktuese u jepet hapësirë e vlerësimit në këtë sferë. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt,* cituar më lart, paragrafi 52; *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24883/94, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 63, *Labita kundër Italisë*, nr. 26772/95, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 201; dhe *Podkolzina kundër Letonisë*, nr. 46726/99, paragrafi 33).

220. Është e rëndësishme të theksohet se garancitë e nenit 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dallojnë nga të drejtat e tjera të garantuara përmes KEDNJ-së dhe kjo reflektohet nga formulimi i vetë nenit i cili fokusohet në përcaktimin e detyrimit për shtetet kontraktuese që të mbajnë zgjedhje që sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të votuesve dhe nuk formulohet në pikëpamje të një të drejte apo lirie të veçantë. Rrjedhimisht, fokusi i nenit 3 të Protokollit nr.1 është te detyrimi që

ka shteti kontraktues dhe jo tek të drejtat dhe liritë e personave fizikë apo juridikë, ndonëse ato nuk përjashtohen, siç edhe tregon jurisprudenca e GJEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, nr. 9267/81, Aktgjykim i 2 marsit 1987, paragrafët 46-51).

221. Në këtë aspekt, Gjykata, gjithashtu vë theks në faktin se, sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk mbulon të gjitha kategoritë e zgjedhjeve dhe, në parim, garancitë e saj nuk aplikohen për zgjedhjet lokale. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Xuereb kundër Maltës,* nr. 52492/99, Vendim i 15 qershorit 2000). Kjo sepse teksti i nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së i referohet specifikisht "*organit ligjvënës*", përkatësisht "*shprehjes së lirë të mendimit të votuesit për zgjedhjen e organit ligjvënës*". Prandaj, në interpretimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, GJENDJ-ja, në parim, ka përjashtuar nga fushëveprimi i kontrollit të saj zgjedhjet presidenciale apo referendumet. Megjithatë, sipas GJENDJ-së, nuk duhet interpretuar "*organin ligjvënës*" si sinonim të "zgjedhjeve parlamentare". GJEDNJ-ja në fakt ka insistuar që ky term të interpretohet në dritën e strukturës kushtetuese të shtetit përkatës. (Shih *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 40). Nëpërmjet *Vito Sante Santoro kundër Italisë*, GJEDNJ-ja ka pranuar që këshillat rajonalë përbëjnë pjesë të "*organit ligjvënës*" sepse ato janë "*kompetente të nxjerrin akte nënligjore dhe rregullore, në kuadër të territorit që mbulojnë, në një numër fushash të rëndësishme në shoqëri demokratike [...].*" (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Vito Sante Santoro kundër Italisë,* nr. 36681/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2004, paragrafi 52). Megjithatë, sipas GJENDJ-së, fushëveprimi i nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk mbulon zgjedhjet e "*qeverive lokale*" e të cilave u mungon autoriteti i mjaftueshëm ligjvënës. (Shih rastet e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut: *X kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 7566/76, Vendim i 11 dhjetorit 1976; *Booth – Clibborn dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 11391/85, Vendim i 5 korrikut 1985; rastin e GJEDNJ-së, *Gorizdra kundër Moldavisë,* nr. 53180/99, Vendim i 2 korrikut 2002).

222. Bazuar në parimet e elaboruara më lart, Gjykata vëren që në rrethanat e rastit konkret që ndërlidhen me zgjedhjen e Kryetarit të Komunës, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parimisht nuk është i aplikueshëm. Kjo sepse, siç është cekur më lart, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në parim janë të aplikueshme në zgjedhje që ndërlidhen me një "*organ ligjvënës*" dhe se, në parim, nuk janë të aplikueshme në

zgjedhjet e "*qeverive lokale*" e të cilave u mungon autoriteti i mjaftueshëm ligjvënës.

223. Pavarësisht nga kjo, Gjykata konsideron se parimet e nxjerra nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përkitazi me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duhet të aplikohen në rrethanat e rastit konkret në kuptimin e definicioneve dhe të garancive që ndërlidhen me të të drejtat zgjedhore të mbrojtura përtej KEDNJ-së edhe me nenin 45 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata nuk do të kufizohet vetëm në aplikueshmërinë e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe në parimet themelore të ndërtuara nga GJEDNJ-ja në aspektin e shqyrtimit të kontesteve zgjedhore, por, për më tepër, do të aplikojë edhe parimet themelore të Komisionit të Venecias që do të elaborohen në pjesën vijuese të këtij Aktgjykimi.

(ii) Sa i përket garancive të nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

224. Gjykata vëren se neni 45 i Kushtetutës përbëhet nga 3 paragrafë të veçantë dhe secili prej tyre ka elementet dhe rregullat përkatëse. Në mbështetje të arsyetimit të pretendimeve në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të fokusohet vetëm në dy paragrafët e parë të nenit 45 të Kushtetutës.

225. Paragrafi i parë i nenit 45 të Kushtetutës përcakton të drejtën për të zgjedhur (të drejtën aktive të votës), si dhe të drejtën për t'u zgjedhur (të drejtën pasive të votës). E drejta e parë, pra ajo aktive e votës, i takon vetëm individëve, pra personave fizikë që janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe që kanë arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e votimit dhe në rast se e drejta e tyre nuk është e kufizuar me një vendim gjyqësor. E drejta tjetër, ajo pasive e votës, i takon kandidatëve si individë, përkatësisht si persona fizikë, të cilët garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror, si dhe subjekteve politike, përkatësisht personave juridikë që garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror. Edhe për të drejtën pasive të votës vlen kushti që të njëjtëve të mos i jetë kufizuar ushtrimi i kësaj të drejte me një vendim gjyqësor.

226. Ndërkaq, paragrafi i dytë i nenit 45 të Kushtetutës garanton që vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Të njëjtat garanci janë të përcaktuara edhe në kuptimin e vetëqeverisjes lokale e cila sipas nenit 123 të Kushtetutës ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Këto garanci kushtetuese janë po ashtu të përcaktuara më tej nëpërmjet LZP-së,

Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së edhe Ligjit nr. 03/l-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Për më tepër që të njëjtat janë në harmoni me pesë parimet themelore të trashëgimisë evropiane zgjedhore e të përmbledhura në Kodin e Praktikës së Mirë dhe në Raportin përkatës Shpjegues e të cilat, siç është përmbledhur më lart, përfshijnë votën universale, të barabartë, të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë.

227. Në interpretimin e garancive të mishëruara në nenin 45 të Kushtetutës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-e cila gjithashtu ka interpretuar nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së si garanci për "*të drejtën aktive të votës*" dhe "*të drejtën pasive të votës*". Të dyja ngërthejnë në vetvete garanci substanciale dhe procedurale. Megjithatë, Gjykata vëren që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të drejtat pasive janë pajisur me më pak mbrojtje sesa të drejtat aktive. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Zdanoka kundër Latvisë*, nr. 58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006, paragrafët 105-106). Praktika e GJEDNJ-së, në raport me të drejtat pasive është fokusuar dukshëm vetëm në verifikimin e mungesës së arbitraritetit në procedurat vendëse e që mund të kenë rezultuar në diskualifikimin e një personi fizik apo juridik për të kandiduar në zgjedhje. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Zdanoka kundër Latvisë* cituar më lart, paragrafi 115; *Melnitchenko kundër Ukrainës*, nr. 17707/02, Aktgjykim i 19 tetorit 2004, paragrafi 57).

228. Përtej të drejtave aktive dhe pasive të votës, sipas praktikës më të re të GJEDNJ-së, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përfshin edhe "*periudhën pas-zgjedhore*" apo "*të drejtat pas-zgjedhore*". Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka arsyetuar se esenca e zgjedhjeve të lira nënkupton një numër të drejtash zgjedhore që ngërthejnë standarde minimale e të cilat udhëheqin praktikat dhe institucionet e dizajnuara të administrojnë votimin, numërimin dhe përcaktimin e rezultatit zgjedhor. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Davydov dhe të tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafët 284-285).

229. Në dritën e këtyre të drejtave, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, ka shqyrtuar raste që përfshijnë ligjet që rregullojnë çështjet e regjistrimit të votuesve si parakusht për ushtrimin e lirë të të drejtave zgjedhore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Partia Gjeorgjiane e Punës kundër Gjeorgjisë,* nr. 9103/04, Aktgjykim i 8 korrikut 2008); detyrimin e shtetit për të organizuar zgjedhje të lira, përfshirë detyrimin e vendosjes së mekanizmave të cilët kanë kapacitetin të hetojnë pretendimet për parregullsi zgjedhore dhe për të përmirësuar dhe adresuar të njëjtat (shih rastin e GJEDNJ-së, *Namat Alijev kundër Azerbajxhanit,* nr. 18705/06, Aktgjykim i 8 prillit 2010); apo raste që

ndërlidhen me nevojën për ekzistimin e një procesi gjyqësor përgjegjës për të shqyrtuar ankesat dhe kontestet zgjedhore. I njëjti përcaktoi se esenca e një të drejte zgjedhore mund të kufizohet, rrjedhimisht të cenohet, nëse nuk ka mjaftueshëm garanci për një sistem efektiv apelimi dhe të paanshëm. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Grosaru kundër Romanisë,* cituar më lart).

(iii) Sa i përket kornizës së vlerësimit të kontesteve zgjedhore mbi bazën e praktikës së GJEDNJ-së edhe të Komisionit të Venecias

230. Në parim, testi që aplikon GJEDNJ-ja për të vlerësuar nëse është shkelur neni 3 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së është përcaktuar nëpërmjet *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës,* sipas të cilit*: "Gjykata duhet të bindet se kufizimet nuk i kufizojnë të drejtat në fjalë në një shtrirje të tillë sa të dëmtojnë thelbin e tyre dhe t'i privojnë ata nga efektiviteti i tyre; që ato janë të vendosura në ndjekje të një qëllimi legjitim; dhe se mjetet e përdorura nuk janë joproporcionale". Në veçanti, kufizimet e tilla nuk duhet të pengojnë shprehjen e lirë të opinionit të popullit në zgjedhjen e legjislaturës".* (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës,* cituar më lart, paragrafi 52).

231. Në këtë aspekt, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka ndërtuar edhe disa kritere të tjera mbi bazën e të cilave shqyrton shkeljet e pretenduara për të drejtat zgjedhore, përfshirë faktin që "*kufizimet në të drejtat zgjedhore duhet të reflektojnë ose të mos jenë në kundërshtim me nevojën për të siguruar integritetin dhe efektivitetin e procedurës së zgjedhjeve e cila ka për qëllim që të identifikojë vullnetin e popullit nëpërmjet votimit të lirë.*" (Shih *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar* (no. 2) cituar më lart, paragrafi 162; dhe *Lykourezos kundër Greqisë,* nr. 33554/03, Aktgjykim i 15 qershorit 2006, paragrafi 52). Në praktikë, sipas GJENDJ-së, kjo nënkupton që ajo shqyrton ankesat përkatëse në kuptim të mungesës së arbitraritetit apo të proporcionalitetit. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Yumak dhe Sadak kundër Turqisë,* nr. 10226/03, Aktgjykim i 8 korrikut 2008, paragrafi 109).

232. Në parim, në vlerësimin e përputhshmërisë me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja fokusohet kryesisht në dy çështje esenciale: (i) nëse në rrethanat e rastit në shqyrtim ka pasur arbitraritet ose mungesë të proporcionalitetit; dhe, (ii) nëse kufizimet kanë cenuar shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, cituar më

lart, paragrafi 52; *Ždanoka kundër Latvisë* [DHM], cituar më lart, paragrafët 103-104 dhe 115).

233. Në këtë aspekt, për të vënë edhe më shumë në kontekst praktik testin e GJENDJ-së në vlerësimin e arbitraritetit dhe joproporcionalitetit në konteste zgjedhore, Gjykata do t'i referohet dy rasteve të GJEDNJ-së në të cilat janë konstatuar shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në kontekst të të "*drejtave pas-zgjedhore*".

234. Në rastin *Namat Alijev kundër Azerbajxhanit* (cituar më lart), parashtruesi garonte për një ulëse në Kuvend të Azerbajxhanit. Ai ankohej se e drejta e tij për të garuar si kandidat në zgjedhje të lira ishte shkelur për shkak të parregullsive serioze dhe shkeljeve të ligjit elektoral që kishin ndodhur para dhe në ditën e votimit. Kushtet e krijuara, sipas parashtruesit, e kishin bërë të pamundur determinimin e saktë të opinionit të votuesit. GJEDNJ-ja konsideroi se parashtruesi i kërkesës ka ngritur pretendime jashtëzakonisht serioze lidhur me ndikimin joligjor në proces të votimit nga ana e autoriteteve përgjegjëse, ndikim në zgjedhjen e lirë të votuesit, mbushje të paautorizuar të kutive të votimit, keqtrajtim të vëzhguesve dhe mospërputhshmëri të qarta që tregonin për dështim të mundshëm lidhur me atë se çfarë ka ndodhur me mijëra fletëvotimeve të papërdorura. Gjykata konsideroi se pretendimet e tilla kishin potencialin të pengonin natyrën demokratike të zgjedhjeve. Për më tepër, GJEDNJ-ja u bazua edhe te raportimet zyrtare të vëzhguesve, të cilat kishin dhënë fakte të njëjta për parregullsi serioze sikurse edhe vetë parashtruesi. Ishin këto disa ndër arsyet – serioziteti i të cilave dërgoi në gjetjen e shkeljes së nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nga ana e GJEDNJ-së.

235. Në rastin tjetër, përkatësisht, *Partia Gjeorgjiane e Punës kundër Gjeorgjisë* (cituar më lart), parashtrues ishte subjekti politik i ashtuquajtur "Partia Gjeorgjiane e Punës". Ky subjekt politik ankohej, ndër të tjera, për faktin që me përjashtimin e votave nga 2 distrikte një numër i caktuar i popullsisë ishin deprivuar nga e drejta e tyre për të votuar – gjë që kishte ndikuar në të drejtën e tyre për të garuar në zgjedhje. Lidhur me këtë rast, GJEDNJ-ja shqyrtoi një mori pretendimesh të këtij subjekti politik, ndërkaq që shkeljen e nenit 3 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së e gjeti për faktin se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte marrë një vendim të ngutshëm për të përfunduar zgjedhjet në mbarë vendin pa ndonjë justifikim valid. Më pas, përjashtimi i dy distrikteve nga zgjedhjet vendëse, përkatësisht votuesve në distriktin Khulo dhe Kobuleti, konsiderohej si veprim që shpërfillte një numër të parakushteve esenciale të sundimit të ligjit dhe si i tillë kishte rezultuar në *de facto* privim nga vota *("de facto*

disfranchisement") të një numri të konsiderueshëm të popullsisë. Si rrjedhojë e përjashtimit të këtyre votuesve, në mënyrë kauzale ishte shkelur e drejta e subjektit politik për të garuar në zgjedhje (*"stand for election"),* e drejtë kjo e garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

236. Gjykata vëren se, përderisa rrethanat faktike të rasteve në fjalë nuk përkojnë më rrethanat faktike të rastit konkret, të njëjtat rezultojnë në një emërues të përbashkët të rasteve në të cilat GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Këto raste reflektojnë arbitraritet të dukshëm, mungesë proporcionaliteti, kufizime që kanë cenuar shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve dhe pamundësi për të vërtetuar vullnetin e votuesve.

237. Më tej dhe përtej praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, siç është theksuar edhe paraprakisht në këtë Aktgjykim, Gjykata do t'i referohet praktikës së Komisionit të Venecias, përkatësisht Kodit të Praktikës së Mirë, e i cili është i bazuar në parimet nënvizuese të trashëgimisë zgjedhore evropiane, dhe përbëhet nga pesë parime nënvizuese dhe ato janë: (1) vota universale; (2) vota e barabartë; (3) vota e lirë; (4) vota e fshehtë; dhe (5) vota e drejtpërdrejtë. Të njëjtat janë të garantuara edhe nëpërmjet nenit 45 të Kushtetutës dhe ligjeve të aplikueshme zgjedhore.

238. Për më tepër, Gjykata në këtë drejtim rikujton se Kodi i Praktikës së Mirë thekson gjithsej tri kushte, plotësimi i të cilave është parakusht për implementimin e mirëfilltë të këtyre pesë parimeve të këtij Kodi dhe ato janë: (1) respektimi për të drejtat fondamentale; (2) niveli i rregullativës dhe stabiliteti i ligjit zgjedhor; dhe (3) garancitë procedurale.

239. Lidhur me kushtin e parë implementues, përkatësisht "*respektimin e të drejtave fondamentale*"*,* Kodi i Praktikës së Mirë nënvizon se zgjedhjet demokratike nuk janë të mundshme pa respektimin e të drejtave të njeriut. Në veçanti, kërkohet respektimi i të drejtës për liri të shprehjes, të mediave, të lëvizjes brenda shtetit, të tubimit, të asociimit për qëllime politike, përfshi të drejtën për krijim të partive politike. Çdo lloj kufizimi i këtyre të drejtave duhet të parashihet me ligj dhe të jetë në interes publik në pajtueshmëri me parimin e proporcionalitetit. Në pjesën e Raportit Shpjegues theksohet që kufizimet e mundshme të këtyre të të drejtave duhet po ashtu të jenë në pajtueshmëri me KEDNJ-në. (Shih pjesën II të Raportit Shpjegues, pika 1).

240. Lidhur me kushtin e dytë implementues, përkatësisht "*niveli i rregullativës dhe stabiliteti i ligjit zgjedhor*", Kodi i Praktikës së Mirë nënvizon se anash rregullave teknike dhe detajeve të ngjashme të cilat mund të përfshihen në nivel më të ulët rregullues ligjor (akte administrative, rregullore), rregullat zgjedhore duhet të kenë të paktën nivelin e një ligji. Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat fondamentale të ligjit zgjedhor, në veçanti ato me vetë sistemin zgjedhor/elektoral dhe zonat elektorale, nuk duhet të jenë subjekt i plotësim-ndryshimeve ligjore një vit para mbajtjes së zgjedhjeve. Në rast se një gjë e tillë është e domosdoshme të ndodhë, të njëjtat duhet të parashihen me Kushtetutë apo me ndonjë akt tjetër që ka nivel më të lartë sesa ligji i zakonshëm. Raporti Shpjegues thekson që stabiliteti i ligjit është çështje kruciale për kredibilitetin e procesit zgjedhor, i cili në vetvete është proces vital për të konsoliduar demokracinë e një vendi. (Shih Pjesën II, pika 2, paragrafi 63, të Raportit Shpjegues).

241. Dhe, në fund, lidhur me kushtin e tretë, përkatësisht "*garancitë procedurale*", Kodi i Praktikës së Mirë nënvizon se organizimi i zgjedhjeve duhet të bëhet nga një organ i pavarur i cili është subjekt i vëzhgimeve nga vëzhguesit vendës dhe ndërkombëtarë si dhe duhet të sigurojë një "*sistem efektiv të ankesave*". Këto të fundit janë elaboruar dhe aplikuar në rrethanat e rastit konkret detajisht përgjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhen më shkeljet e pretenduara të të drejtave në mbrojtje gjyqësore të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës.

Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

242. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme, nëpërmjet të dyja Vendimeve të saj, ua shkel atyre të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, pretendimet e tyre mund të kategorizohen si në vijim: (i) "*shkelja e votës së barabartë*"; (ii) "*shkelja e votës së lirë";* dhe (iii) "*shkelja e parimit të transparencës".* (Shih pretendimet specifike të ngritura nga parashtruesit e kërkesës në paragrafët 62-73 të këtij Aktgjykimi).

243. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës ngrenë shkeljen e vetëm 2 nga 5 parimet nënvizuese që ndërlidhen me cilësinë e votës, "*votën e barabartë*" dhe "*votën e lirë*", respektivisht. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për më tepër hyjnë në fushëveprimin e kushtit të tretë, përkatësisht të "*garancive procedurale*". Rrjedhimisht, në kuptimin e parimeve themelore të Komisionit të Venecias, Gjykata do të vlerësojë nëse parimet themelore të ndërlidhura me "*votën e lirë*" dhe "*votën e barabartë*"

dhe "*garancitë procedurale*" përkatëse, mund të jenë cenuar. Ndërsa, në kontekstin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në kuptimin e të "*drejtave pas-zgjedhore*" të garantuara me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke e aplikuar testin e GJEDNJ-së në konteste zgjedhore, përkatësisht arbitraritetin, mungesën e proporcionalitetit dhe nëse kufizimet kanë cenuar shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve. Në vijim, Gjykata do të trajtojë secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës veç e veç.

(i) Sa i përket "votës së barabartë"

244. Parimi i "*votës së barabartë*", sipas Kodit të Praktikës së Mirë dhe Raportit Shpjegues përkatës, nënkupton: (i) të drejtën e votës së barabartë – përkatësisht të drejtën e çdo votuesi që në parim të ketë një votë dhe në sistemet elektorale ku votuesve u jepet e drejta për më shumë se një votë, secili votues duhet të ketë numrin e njejtë të votave; (ii) fuqinë e barabartë të votës në kuptimin që, sipas Kodit, ulëset duhet të distribuohen barabartë ndërmjet zonave zgjedhore; (iii) mundësitë të barabarta - përkatësisht garantimin që të gjitha palëve dhe kandidatëve t'u ofrohen mundësi të barabarta e që nënkupton se autoritetet shtetërore duhet të ruajnë neutralitetin e tyre në të gjitha aspektet, posaçërisht në kuptim të fushatës zgjedhore, mbulimit mediatik dhe financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore; (iv) barazinë dhe minoritetet kombëtare - partitë e minoriteteve kombëtare duhet të lejohen dhe se, në parim, rregullat e veçanta që garantojnë ulëse të rezervuara për minoritetet nuk janë në kundërshtim me parimin e votës së barabartë; dhe (v) barazia ndërmjet gjinive në aspektin që rregullat të cilat kërkojnë një përqindje minimale të kandidatëve të secilës gjini nuk duhet të konsideron që janë në kundërshtim me parimin e votës së barabartë përderisa ato kanë një bazë kushtetuese. (Shih pjesën 2 të Kodit të Praktikës së Mirë dhe pjesën 2 të Raportit Shpjegues).

245. Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen (i) barazisë strikte dhe formale; dhe (ii) barazisë së mundësive. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që Kodi i Praktikës se Mirë dhe Raporti Shpjegues përkatës e trajtojnë barazinë strike dhe proporcionale në kuadër të barazisë së mundësive. (Shih pjesën 2.3 të Raportit Shpjegues). Sipas tyre dhe siç është elaboruar më lart, barazia e mundësive sipas praktikës së shteteve anëtare të Komisionit të Venecias është e ndërtuar në kuptimin e neutralitetit dhe paanësisë së autoriteteve shtetërore dhe aplikimit të rregullave të njëjta për të gjithë në procese zgjedhore. Sipas Kodit, në këtë kuptim, ekzistojnë dy interpretime të barazisë: formale dhe proporcionale. E para

nënkupton që partitë politike duhet të trajtohen barabartë pa marrë parasysh fuqinë e tyre në parlament ose ndërmjet zgjedhësve dhe se kjo vlen edhe për përdorimin e mekanizmave publik që mbështesin fushatat zgjedhore; ndërsa e dyta nënkupton që partitë politike duhet të trajtohen në proporcion me numrin e votave. (Shih pikën 2.3 (b) të Kodit të Praktikës së Mirë).

246. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që, parashtruesit e kërkesës, shkeljen e parimit të "*votës së barabartë*", e arsyetojnë me faktin se Gjykata Supreme, PZAP-i dhe KQZ-ja kanë dështuar të garantojnë një proces zgjedhor ku "*pesha e votës*" është e barabartë sepse, sipas pretendimit, Gjykata Supreme në Vendimin e saj të dytë [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] konstaton që *"procesi zgjedhor është dëmtuar",* por nuk e ka konsideruar të nevojshme rinumërimin e kutive nga të gjitha vendvotimet. Sipas parashtruesve të kërkesës, kërkesa e tyre për rinumërim të kutive në të gjitha vendvotimet ishte refuzuar në mënyrë kundërkushtetuese. (Shih në këtë kontekst, pretendimin specifik të parashtruesve të kërkesës në paragrafin 61 e 66 të këtij Aktgjykimi).

247. Gjykata vëren që këto pretendime janë ngritur edhe në kuptimin e shkeljeve të pretenduara për të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe janë adresuar detajisht në paragrafët 167-176 të këtij Aktgjykimi.

248. Gjykata vëren që asnjë pretendim tjetër apo rrethanë e asociuar me të, i parashtruesve të kërkesës, nuk hyn në fushëveprimin e garancive të definuara me parimin e Komisionit të Venecias në kontekstin e "*votës së barabartë*", duke përfshirë "*barazinë së mundësive*". Përderisa, parashtruesit e kërkesës i referohen kësaj të fundit, Gjykata rikujton që barazia e mundësive sipas praktikës së shteteve anëtare të Komisionit të Venecias është ndërtuar në kuptimin e neutralitetit dhe paanësisë së autoriteteve shtetërore dhe aplikimit të rregullave të njëjta për të gjithë në procese zgjedhore. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk bien në këtë kategori.

249. Për më tepër, Gjykata vëren që vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në kuptimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së nuk reflekton arbitraritet, mungesë proporcionaliteti dhe, siç është trajtuar gjerësisht në kontekstin e vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhen me nenin 54 të Kushtetutës, gjithashtu nuk është nxjerrë në cenim të shprehjes së lirë të vullnetit të votuesve.

(ii) Sa i përket parimit të "votës së lirë"

250. Parimi i *"votës së lirë",* sipas Kodit të Praktikës së Mirë, nënkupton (i) lirinë e votuesit që të formojë një opinion (shih për më tepër pjesën 2.3 të Kodit të Praktikës së Mirë dhe pjesën 2.3, paragrafi 18, të Raportit Shpjegues); dhe (ii) lirinë e votuesit për të shprehur opinionin dhe mundësinë përkatëse për të luftuar mashtrimin zgjedhor. (Shih pjesën 3.1 dhe 3.2 të Kodit të Praktikës së Mirë). Në kontekstin e pretendimit konkret, është relevante vetëm e dyta.

251. Në këtë kontekst, Kodi i Praktikës së Mirë në parim përcakton që liria e votuesve për të shprehur vullnetin e tyre në mënyrë parësore kërkon vëzhgim të saktë të procedurave të votimit. Për më tepër, sipas Kodit të Praktikës së Mirë, votuesit (në cilësinë e votuesit dhe në cilësinë e kandidatit) kanë të drejtë në vlerësim të saktë të rezultateve të votimit dhe shteti është i detyruar që të sanksionojë çfarëdo mashtrimi zgjedhor. Kodi i Praktikës së Mirë dhe Raporti Shpjegues përcaktojnë një numër rregullash të mishëruara në këtë parim, e Gjykata do t'ju referohet vetëm atyre që janë relevante për rrethanat e rastit konkret, përkatësisht: (i) "*procedurës së votimit*" (shih Kodin e Praktikës së Mirë, pikën 3.2 (i-xi)) dhe (ii) "*numërimit*", respektivisht. (Shih Kodin e Praktikës së Mirë, pikën 3.2 (xii- xv)).

252. Për sa i përket "*procedurës së votimit*", Gjykata vëren që Raporti Shpjegues mban ndër të tjera se "*procedura e votimit ka rol krucial në procesin e përgjithshëm zgjedhor sepse mashtrimi zgjedhor ka më së shumti mundësi të ndodhë gjatë procesit të votimit*". (Shih pikën 3.2.2, paragrafi 32, i Raportit Shpjegues). Ndërsa, sa i përket "*numërimit*", theksohet ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, që është e kështillueshme "*të iket nga praktika e të konsideruarit të shumë votave si të pavlefshme apo të shkatërruara dhe, në rast të dyshimeve, duhet të bëhet një përpjekje shtesë për të determinuar vullnetin e votuesit të shprehur në atë votë*". (Shih pikën 3.2.2.4, paragrafi 49, të Raportit Shpjegues).

253. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës shkeljen e parimit të "*votës se lirë*" e arsyetojnë nëpërmjet provave të ofruara në gjykatat e rregullta mbi "*ndikimin e qytetarëve të Prishtinës përmes dërgimit të SMS-ve në emër të OJQ-ve, ofrimit të kuponëve për transport falas dhe ndikimit përmes aktivistëve*", e të cilat, sipas pretendimit, rezultojnë në shkelje të "*parimit të votës së lirë/lirisë së votimit*". Sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata Supreme në Vendimin e saj të dytë, përkatësisht Aktgjykimin [A.A.U.ZH.nr.62/2017], i kishte trajtuar këto pretendime si të reja, duke e evituar arsyetimin rreth tyre dhe jo si prova që duhej t'i

administronte. (Shih në këtë kontekst, pretendimin specifik të parashtruesve të kërkesës në paragrafin 63 dhe 64 të këtij Aktgjykimi).

254. Gjykata vëren që këto pretendime të parashtruesve të kërkesës ndërlidhen me "*garancitë procedurale*" për implementimin e parimit të "*votës së lirë*" në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht me parregullsitë në ditën e zgjedhjeve dhe pretendimet që ndërlidhen me votat e pavlefshme e të zbrazëta, e të cilat janë adresuar tashmë në kontekstin e pretendimeve për shkelje të të drejtave për mbrojtje gjyqësore të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, specifikisht në paragrafët 154-166 të këtij Aktgjykimi.

255. Gjykata gjithashtu rikujton që, në elaborimin e parimeve që ndërlidhen me "*votën e lirë*", ka theksuar se Kodi i Praktikës së Mirë dhe Raporti Shpjegues specifikisht përcaktojnë se është e këshillueshme që "*të iket nga praktika e të konsideruarit të shumë votave si të pavlefshme apo të shkatërruara dhe, në rast të dyshimeve, duhet të bëhet një përpjekje shtesë për të determinuar vullnetin e votuesit të shprehur në atë votë*". Gjykata gjithashtu ka adresuar specifikisht këtë çështje në paragrafët 172-175 të këtij Aktgjykimi.

256. Gjykata për më tepër vëren që asnjë pretendim tjetër apo rrethanë e asociuar me të, i parashtruesve të kërkesës, nuk hyn në fushëveprimin e garancive të definuara me dy parimet themelore të Komisionit të Venecias në kontekstin e "*votës së lirë*", përkatësisht lirisë së votuesit për të formuar opinion apo edhe lirisë së votuesit për të shprehur opinion dhe për të luftuar mashtrimin zgjedhor.

257. Për më tepër, Gjykata vëren që vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në kuptimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk reflekton arbitraritet, mungesë proporcionaliteti dhe, siç është trajtuar gjerësisht në kontekstin e vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhen me nenin 54 të Kushtetutës, gjithashtu nuk është nxjerrë në cenim të shprehjes së lirë të vullnetit të votuesve.

(iii) Sa i përket "parimit të transparencës"

258. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të parimit të transparencës. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se, në kontekstin e Kodit të Praktikës së Mirë, transparenca kryesisht përdoret në kuptimin e financimit të fushatave zgjedhore. Megjithatë, Kodi i Praktikës së Mirë e konsideron transparencën si të rëndësishme edhe për së paku tri aspekte të tjera.

259. Së pari, transparenca konsiderohet e rëndësishme në aspektin e numërimit të votave – proces ky i cili duhet të jetë në vetvete transparent. Për të siguruar një transparencë të tillë, vëzhguesit (vendës dhe ndërkombëtarë), përfaqësuesit e kandidatëve dhe mediat duhet të lejohen të jenë të pranishme përgjatë numërimit të votave. Së dyti, transparenca është po ashtu e rëndësishme në aspektin e mbrojtjes procedurale ashtu që organizimi i zgjedhjeve duhet të bëhet nga një trup i paanshëm. Vetëm transparenca, paanshmëria dhe pavarësia nga manipulimi i motivuar politikisht do të sigurojë administrim të duhur të procesit zgjedhor qysh nga periudha parazgjedhore e deri te fundi i procesimit të rezultatit zgjedhor. Së treti, në mënyrë që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, një proces zgjedhor duhet në mënyrë të qartë t'i ofrojë votuesve, kandidatëve dhe subjekteve politike të drejtën për procedura transparente të ankesës. (Shih Kodin e Praktikës së Mirë, pikën 3.2 (xiii), faqe 9; pikën 3.1, paragrafin 68, dhe Raportin për Zgjidhjen e Kontesteve Zgjedhore, pika 6, paragrafi 100). Këto të fundit janë elaboruar më detajisht në Raportin për Zgjidhjen e Kontesteve. Në këtë aspekt, Komisioni i Venecias rekomandon që procedurat para një organi gjyqësor që shqyrton ankesat dhe apelet lidhur me të drejtat zgjedhore duhet të jenë publike dhe palët duhet të kenë të drejtën të paraqesin rastin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor. Në garancitë minimale që duhet të ekzistojnë, sipas Komisionit të Venecias, hyn rrjedhimisht edhe e drejta për një dëgjim të drejtë, të paanshëm dhe publik të një ankese apo apeli. Sistemi i ankesave dhe apeleve duhet të jetë transparent dhe si i tillë duhet të përfshijë publikimin e ankesave, të apeleve, të përgjigjeve dhe të vendimeve. (Shih Raportin për Zgjidhjen e Kontesteve, pika 6, paragrafi 100).

260. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kodi i Praktikës së Mirë detyron institucionet shtetërore që të garantojnë transparencë të proceseve dhe të drejtën e rinumërimit të votave në raste të apelit. Ky konstatim qëndron. Gjykata ka shtjelluar përgjatë këtij Aktgjykimi parimet themelore për sa i përket të drejtës së apelimit në konteste zgjedhore si pjesë esenciale e "*sistemeve efektive të ankesave*" dhe "*garancive procedurale*", ky i fundit kusht themelor për jetësimin e pesë parimeve që ndërlidhen me cilësinë e votës në zgjedhje demokratike. Siç është theksuar gjithashtu, e drejta e apelimit në konteste zgjedhore dhe po ashtu edhe e "*drejta e verifikimit të rezultatit zgjedhor*", duke përfshirë edhe mundësinë e anulimit të rezultatit zgjedhor, janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin e aplikueshëm zgjedhor, në mënyrën e

përcaktuar me ligj, dhe e cila, siç është elaboruar, është gjithashtu në harmoni me praktikën e shteteve anëtare të Komisionit të Venecias.

261. Gjykata rikujton se specifikisht për sa i përket pretendimeve për shkelje të parimit të transparencës, parashtruesit e kërkesës ngrenë çështjet në vijim: (i) shkeljen e të drejtës për "*rinumërim dhe përsëritje të votimit*" e cila sipas tyre është e përcaktuar me nenet 101 dhe 106 të LZP-së; (ii) shkeljen e së drejtës në "*konfirmim dhe verifikim të rezultatit zgjedhor*", sepse sipas pretendimit *"në rast të rezultatit të ngushtë të zgjedhjeve"*, rinumërimi është e drejtë themelore i cili iniciohet nëpërmjet KQZ-së apo me kërkesë të palës; (iii) faktin se edhe pse PZAP-i dhe Gjykata Supreme "*konstatojnë se ka pasur parregullsi",* të njëjtat *i "konsiderojnë të balancuara në mes dy kandidatëve në garë*", duke rezultuar sipas pretendimit në vendimet arbitrare të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme; dhe se (iv) PZAP dhe Gjykata Supreme nuk kanë trajtuar provat e parashtruesve të kërkesës si "*prova të reja dhe të veçanta*" dhe nuk kanë trajtuar pretendimet e tyre për shkelje kushtetuese. (Shih specifikisht këto pretendime në paragrafët 67-73 të këtij Aktgjykimi).

262. Gjykata vëren që të gjitha këto pretendime janë ngritur edhe në kuptimin e shkeljeve të pretenduara për të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe janë adresuar detajisht në paragrafët 134-176 të këtij Aktgjykimi.

263. Megjithatë, Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës, në këtë kontekst, ngrenë edhe tri pretendime të reja e të cilat Gjykata do t'i shqyrtojë në vijim: (i) pretendimin që PZAP-i ka bërë vlerësimin/hetimin e fletëvotimeve në vendvotimet e kontestuara pa prezencën e palëve; (ii) pretendimin që Gjykata Supreme nëpërmjet Aktvendimit të saj të parë [AA. nr. 52/17] e ka shfuqizuar vetëm e Vendimin [ZL.A. nr.1102/2017] e 22 nëntorit 2017 të PZAP-it, por jo edhe Vendimin e KQZ-së [2343-2017] për rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve të rregullta në vendvotimet e përcaktuara me vendimin e lartëcekur; dhe (iii) pretendimin se parimi i transparencës është shkelur edhe me rastin e *"asgjësimit të materialit zgjedhor"* nga ana e KQZ-së, e me atë rast edhe e drejta e tyre për rinumërim.

264. Sa i përket të parës, Gjykata rikujton se pretendimi ka të bëjë me hetimet e bëra nga PZAP-i si rezultat i ankesës së parashtruesve të kërkesës së 30 nëntorit 2017. PZAP-i bazuar në: (i) paragrafin 4 të nenit 117 të LZP-së, e sipas të cilit, PZAP-i mund të urdhërojë shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve që ndërlidhen me ankesa; (ii) nenin 14 të Rregullit nr. 02/2015; dhe (iii) Rregullën nr. 04/2015 për procedurat e hetimit të materialit zgjedhor, me qëllim të

verifikimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për sa i takon mospërputhjeve të rezultatit përfundimtar, kishte themeluar ekipin hetues, sipas shkresave të lëndës, të përbërë nga 8 gjyqtarë dhe nga 10 zyrtarë të sekretariatit. Gjykata vëren se materialet zgjedhore dhe mënyra e hetimit të secilës kategori të materialit zgjedhor janë saktë të përcaktuara me rregulloret përkatëse të PZAP-it. Këto ekipe hetuese, pas përfundimit të hetimeve, janë të detyruara sipas rregullave përkatëse të përpilojnë procesverbal të mbështetur nga të gjitha materialet zgjedhore të hetuara. Ky material më pas i dorëzohet PZAP-it për shqyrtim të mëtejmë. Konstatimet e ekipeve hetuese mbi bazën e ligjit të cituar më lart, mund të rezultojnë në vendim të PZAP-it për rinumërim të fletëvotimeve. Vendimi [ZL.A.nr.1125/2017] i 1 dhjetorit 2017 i PZAP-it reflekton këtë procedurë dhe konstaton se pas shqyrtimit të materialit të ekipeve hetuese, sipas PZAP-it, rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ-ja është konfirmuar. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se procedura e kontestuar ka të bëjë me procedurë hetimi të PZAP-it dhe jo me procedurë rinumërimi apo numërimi, parimi i transparencës për të cilin i garantuar sipas nenit 101 të LZP-së.

265. Për më tepër që pretendimet e parashtruesit në këtë kontekst nuk hyjnë në fushëveprimin e garancive të tjera kushtetuese, ligjore apo atyre të përcaktuara nëpërmjet Komisionit të Venecias e që ndërlidhen me një "*sistem efektiv ankesash*", përfshirë edhe të drejtën për procedim transparent të ankesës (shih Raportin për Zgjidhjen e Kontesteve, pika 2, paragrafi 111); apo edhe publikimin e ankesave, të apeleve, të përgjigjeve dhe të vendimeve. (Shih Raportin për Zgjidhjen e Kontesteve, pika 6, paragrafi 100). Në fund, Gjykata po ashtu vëren që ky pretendim nuk është ngritur nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Supreme dhe kësaj të fundit nuk i është dhënë mundësia të përgjigjet lidhur me këtë pretendim.

266. Sa i përket të dytës, Gjykata rikujton që Gjykata Supreme nxori Vendimin e parë të saj [AA. nr. 52/2017] nëpërmjet të të cilit e pranoi si të bazuar ankesën e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, dhe ndryshoi Vendimin [ZL. A. nr. 1102/2017] e 22 nëntorit 2017 të PZAP-it, ashtu që ankesa e parashtruesit të dytë të kërkesës u refuzua si e pabazuar. Gjykata vëren që Gjykata Supreme nuk përcaktoi shprehimisht shfuqizimin e Vendimit të KQZ-së. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se mbi bazën e paragrafit 3 të nenit 12 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LZP-së në lidhje me paragrafin 5 të nenit 118 të LZP-së, vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe nëse Gjykata Supreme përcakton ndryshe.

267. Së treti dhe në fund, sa i përket asgjësimit të materialit zgjedhor dhe shkeljen respektive të parimit të transparencës, Gjykata vëren se: (i) parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë në Gjykatë vendimin përkatës të KQZ-së për shkatërrimin e materialit zgjedhor. Rrjedhimisht, çështjet e ngritura nëpërmjet këtij pretendimi nuk i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 47 e 48 të Ligjit; (ii) çështja e shkatërrimit të materialit zgjedhor është e përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 103 të LZP-së sipas të cilit *"KQZ-ja me një vendim, pas certifikimit zyrtar të rezultatit të zgjedhjeve, shkatërron materialet e përmendura në kohën e përshtatshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP-i*". Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar të ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në Gjykatë; dhe (iii) nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës asnjëherë nuk kanë kërkuar ruajtjen e materialit zgjedhor në KQZ, në PZAP, apo edhe në Gjykatë Kushtetuese mbi bazën e nenit 27 mbi Masat e përkohshme të Ligjit.

268. Bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e ngritura në rrethanat e rastit konkret dhe faktet e paraqitura, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe në standardet e përmbledhura nga Komisioni i Venecias, konstaton se: (i) Vendimi i parë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017, nuk është nxjerrë në shkelje dhe është në përputhshmëri me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjedhje të lira të garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të subjektit politik LDK, përkatësisht të parashtruesit të dytë të kërkesës; dhe se (ii) Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [A.A.U.ZH.nr.62/2017] i 7 dhjetorit 2017, nuk është nxjerrë në shkelje dhe është në përputhshmëri me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjedhje të lira të garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të z. Arban Abrashi dhe subjektit politik të LDK-së, përkatësisht, të parashtruesit të parë dhe të dytë të kërkesës.

IV. Kërkesa për seancë dëgjimore

269. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkuan nga Gjykata që të caktojë seancë dëgjimore.

270. Në arsyetimin e kërkesës së tyre për seancë dëgjimore, parashtruesit e kërkesës theksuan se *"parimi i oralitetit dhe publicitetit"* është ndër

parimet themelore në procedurën kushtetuese dhe si i tillë garantohet në të gjitha fazat e procedurës *"qoftë para organeve administrative, gjykatave të zakonshme apo edhe vet para Gjykatës Kushtetuese"*. Lidhur me këtë, ata theksuan se mund të vërehet nga shkresat e lëndës se parashtruesve të kërkesës *"nuk ju është dhënë rasti të parashtrojnë në seancë publike pretendimet e tyre"* dhe se *"është paraqitur një situatë në të cilën domosdoshmërisht kërkohet që të prezantohen para trupit gjykues aspektet faktike dhe ligjore, ashtu siç përcakton rregulli 42 paragrafi 2 i Rregullores së Piunës së Gjykatës Kushtetuese."*

271. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit (2) të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, *"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit."*

272. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI34/17, *parashtruese Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 - ku thuhet se "*Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast [...]"*).

273. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.

274. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesve për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

V. Çështje të tjera të rëndësishme

Lidhur me statusin e vendimeve të huaja dhe rolin e tyre në vendimmarrje

275. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës mbështesin pretendimet e tyre edhe duke iu referuar vendimeve të ndryshme të gjykatave të huaja, specifikisht Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë,

Gjykatës Kushtetuese të Austrisë dhe Gjykatës Federale Supreme të Zvicrës. Gjykata së pari shënon dallimin në juridiksion të kushtetutave përkatëse me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në trajtimin e kontesteve zgjedhore. Për më tepër, Gjykata vëren se të njëjtat nuk përkojnë me rrethanat faktike apo juridike të rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e gjykatave të tjera kushtetuese duhet të interpretohen në kontekstin e garancive kushtetuese dhe ligjore dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë.

276. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, përveç faktit që parashtruesit e kërkesës kanë cekur dhe kanë cituar këto vendime të gjykatave të huaja, ata nuk kanë elaboruar lidhshmërinë e tyre, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Për më tepër që statusin e burimit të së drejtës në sistemin juridik të Republikës së Kosovës e kanë vetëm vendimet e GJEDNJ-së.

277. Ndërsa, sa i përket raporteve të Komisionit të Venecias, përtej atyre të referuara nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata i ka trajtuar të gjitha raportet dhe opinionet relevante të Komisionit të Venecias dhe i ka aplikuar ato në rrethanat e rastit konkret.

VI. Përfundime

278. Gjykata ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës në veçanti dhe në tërësinë e tyre, duke aplikuar mbi këtë vlerësim: (i) garancitë kushtetuese që ndërlidhen me të drejtat e kontestuara, nenin 45 e 54 të Kushtetutës, respektivisht; (ii) parimet themelore që rezultojnë nga trashëgimia evropiane për zgjedhje demokratike të përmbledhura nga Komisioni i Venecias; dhe (iii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe ka konstatuar se Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimi [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i 7 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme, janë në përputhshmëri me nenin 54 dhe 45 të Kushtetutës.

279. Gjykata ka konstatuar se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk kanë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe të drejtën në mjet juridik të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së, sepse në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Supreme, drejtë kishte vlerësuar çështjet që ndërlidhen me: (i) konfirmimin/anulimin e rezultatit zgjedhor; (ii) shpalljen e pasaftshme të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidheshin me ditën e votimit, e të cilat ishin paraqitur për herë të parë në PZAP, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar; dhe (iii)

fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta, pasi PZAP-i kishte hetuar materialin zgjedhor në qendrat e kontestuara të votimit dhe kishte konstatuar se parregullsitë nuk *"kanë ndikim në rezultatin final*". Për më tepër, vendimet e Gjykatës Supreme ishin "*mjaftueshëm të arsyetuara*" në raport me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe në harmoni me standardet e përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias, për sa i përket arsyetimit të vendimeve në konteste zgjedhore. Konstatimet e Gjykatës Supreme janë në përputhshmëri me garancitë kushtetuese, me praktikën gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së dhe me parimet themelore të Komisionit të Venecias e që ndërlidhen me një "*sistem efektiv ankesash*", si pjesë përbërëse e "*garancive procedurale*", kusht ky thelbësor për jetësimin e pesë parimeve themelore që ndërlidhen me cilësitë e votës.

280. Gjykata ka konstatuar se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk kanë shkelur të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje të drejtën për zgjedhje të lira të garantuar me neni 3 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së, sepse, në rrethanat e rastit konkret, të njëjtat nuk janë nxjerrë në kundërshtim me: (i) kushtet për mbrojten e parimeve themelore për cilësitë e votës, siç janë të garantuara me Kushtetutë, ligje zgjedhore dhe Kodin e Praktikës së Mirë; (ii) kushtin e "*garancive procedurale*" për jetësimin e parimit të "*votës së lirë*" dhe "*votës së barabartë*"; (iii) "*parimin e transparencës*" në konteste zgjedhore, siç është përcaktuar nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të parimeve themelore të Komisionit të Venecias; dhe (iv) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të "*të drejtave pas-zgjedhore*".

281. Bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura në rrethanat e rastit konkret, dhe faktet e paraqitura, Gjykata konstaton se: (i) Vendimi i parë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017, nuk është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të subjektit politik LDK, përkatësisht parashtruesit të dytë të kërkesës, dhe është në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 45 e 54 të Kushtetutës; dhe se (ii) Vendimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [A.A.U.ZH.nr.62/2017] i 7 dhjetorit 2017, nuk është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të z. Arban Abrashi dhe të subjektit politik LDK, përkatësisht parashtruesit të parë dhe të dytë të kërkesës, dhe është në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 45 e 54 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 janar 2019, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi A.A. U.ZH. nr. 62/2017, i 7 dhjetorit 2017, i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se Aktvendimi A.A. nr. 52/2017, i 25 nëntorit 2017, i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

IV. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore si të pabazuar;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VII. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI01/18, Parashtrues i kërkesës: Gani Dreshaj-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. A. – U. ZH. nr. 64/2017, të 26 dhjetorit 2017

KI01/18, Aktgjykim i miratuar më 23 janar 2019, i publikuar më 4 shkurt 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, masë e përkohshme, raundi i dytë i votimit, e drejta zgjedhore, të drejtat aktive zgjedhore, të drejtat pasive zgjedhore, lista e votuesve, të drejtat paszgjedhore, shterimi i mjeteve juridike, zgjedhjet komunale*

Parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërisë e vendimeve të KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, me të cilat, sipas pretendimeve të tyre, janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesit e kërkesës, në thelb, u ankuan se për shkak të mosnumërimit të votave të 52 (pesëdhjetedy) votuesve në raundin e dytë të votimit të vlefshme për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës së Istogut, kandidatit të tyre (Gani Dreshaj) i ishte shkelur e drejta për t'u zgjedhur siç garantohet me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Gjykata së pari, duke u bazuar në praktikën e saj për kontestet zgjedhore komunale, konstatoi se njëri prej parashtruesve (Gani Dreshaj) nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike siç përcaktohet me nenin 113(7) të Kushtetutës. Gjykata po ashtu konstatoi se parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) kishte shteruar të gjitha mjetet juridike dhe se pretendimet e ngritura do t'i shqyrtojë në merita.

Gjykata vlerësoi se rasti konkret trajton çështje të ndërlidhjes së të drejtave aktive zgjedhore me të drejtat pasive zgjedhore, përditësim të listave zgjedhore ndërmjet dy raundeve të votimit dhe konteste për numërimin e votave në qendra të numërimit që përkojnë me periudhën paszgjedhore.

Gjykata, duke u mbështetur në praktikën e konsoliduar të GJEDNJ-së, vendosi të vlerësojë nëse vendimet e kontestuara të KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme mund t'i bëjnë ballë testit të GJEDNJ-së që përcakton nëse ato vendime: (i) janë në përputhje dhe të parashikuara me ligjin e zbatueshëm, (ii) nëse janë proporcionale dhe (iii) nëse janë të njollosura nga arbitrariteti apo të paarsyeshme. Mirëpo, së pari, Gjykata u shpreh se kuadri ligjor që rregullon të drejtën zgjedhore në Republikën e Kosovës nuk është

objekt i shqyrtimit kushtetues dhe se vlerësimi i saj kufizohet vetëm përbrenda kornizave të pretendimeve të ngritura në rastin konkret.

Gjykata më tej konstatoi: (i) mospërditësimi i listave të votuesve ka qenë fakt i ditur nga të gjithë pjesëmarrësit në garën zgjedhore - përfshirë dhe parashtruesit e kërkesës dhe (ii) mos numërimi i votave të 52 (pesëdhjetedy) votuesve nuk ka shtrirje të tillë sa të garantojë votën e një grupi të caktuar të votuesve - aq më tepër kur - merret parasysh se asnjëri prej atyre votuesve nuk ishte ankuar te organet kompetente për shkak të mosnumërimit të votave të tyre.

Gjykata, duke dhënë një vlerësim global të të gjitha çështjeve qendrore të rastit konkret, konsideroi se vendimet e kontestuara të KQZ-së, PZAP-së dhe Gjykatës Supreme janë në përputhje dhe të parashikuara nga ligji zgjedhor i zbatueshëm, janë proporcionale-dhe se nuk janë-të njollosura nga arbitrariteti ose të paarsyeshme.

Rrjedhimisht, Gjykata përfundoi se vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme janë në përputhshmëri me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata po ashtu refuzoi kërkesën e parashtruesve për caktim të masës së përkohshme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI01/18

Parashtrues

Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. A. – U. ZH. nr. 64/2017, të 26 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Gani Dreshaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Istogut në zgjedhjet lokale të vitit 2017 (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i parë i kërkesës), si dhe nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i dytë i kërkesës).

2. Parashtruesi i parë i kërkesës si dhe parashtruesi i dytë i kërkesës (në tekstin e mëtejmë kur Gjykata iu referohet bashkërisht: parashtruesit e kërkesës), përfaqësohen nga z. Arianit Koci, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. A. – U. ZH. nr. 64/2017, të 26 dhjetorit 2017 në lidhje me Vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa

dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), ZL. A. nr. 1142/2017, të 23 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartpërmendura, me të cilat, sipas pretendimit, parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë caktimin e masave të përkohshme duke kërkuar nga Gjykata që të ndalojë *"zbatimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për certifikimin e rezultatit të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës së Istogut të 27 dhjetorit 2017 deri në vendosjen meritore të kësaj çështje nga Gjykata Kushtetuese"*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 [Parimet e Përgjithshme] 113. 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe 116. 2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 27 [Masat e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

7. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

8. Më 3 janar 2018, parashtruesi i parë i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 3 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

10. Më 5 janar 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e parë të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua PZAP-it, Gjykatës Supreme dhe z. Haki Rugova, kandidat i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: LDK), për kryetar të Komunës së Istogut, me mundësinë për të dorëzuar komentet e tyre për pretendimet e ngritura në kërkesën nr. KI01/18.

11. Më 15 janar 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i parë i kërkesës që të qartësojë kërkesën e tij si dhe një kopje e kërkesës iu dërgua parashtruesit të dytë të kërkesës me mundësinë për të dorëzuar komentet e tyre për pretendimet e ngritura në kërkesën nr. KI01/18.

12. Më 11 dhe 17 janar 2018, PZAP-i dhe z. Haki Rugova dorëzuan komentet e tyre përkitazi me kërkesën nr. KI01/18.

13. Më 19 janar 2018, komentet e lartpërmendura iu dërguan parashtruesit të parë të kërkesës për ndonjë koment eventual.

14. Më 26 dhe 31 janar 2018, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan përgjigjet e tyre, me ç'rast ripërsëritën qëndrimet e tyre për proces jo të rregullt zgjedhor, adresuan komentet e PZAP-it dhe z. Haki Rugova dhe paraqitën argumentet e tyre për çështje të shterimit të mjeteve juridike dhe të legjitimitetit procedural *(standing)*.

15. Më 1 mars 2018, Gjykata në seancë shqyrtuese vendosi që vlerësimi i kërkesës të shtyhet për një datë tjetër.

16. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

17. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

18. Më 22 gusht 2018, Kryetarja nxori vendimin për caktimin e gjyqtarit Radomir Laban si gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Altay Suroy.

19. Më 28 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi, Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.

20. Më 1 tetor 2018, Gjykata ua dërgoi anëtarëve të Forumit të Komisionit të Venecias një kërkesë me disa pyetje për analizë krahasimtare lidhur me kërkesën në shqyrtim.

21. Më 17 tetor 2018, gjyqtari Bajram Ljatifi kishte kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës që të përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës nr. KI01/18, sepse më herët kishte qenë pjesë e vendimmarrjes për të njëjtën kërkesë përkitazi me procedurat e zhvilluara në KQZ.

22. Më 25 tetor 2018, Kryetarja në pajtim me nenin 18 të Ligjit dhe rregullin (9) të Rregullores së punës nxori vendimin për caktim të gjyqtares Gresa Caka-Nimani anëtare të Kolegjit shqyrtues, në kërkesën nr. KI01/18, në vend të gjyqtarit Bajram Ljatifi.

23. Më 23 janar 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës që kërkesën ta shpallë të pranueshme dhe të konstatojë se vendimet e kontestuara janë në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës, dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

24. Më 22 tetor 2017, u mbajt raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i parë i kërkesës, z. Gani Dreshaj, ishte kandidat i AAK-së për Kryetar të Komunës së Istogut. Parashtruesi i dytë i kërkesës, AAK, ishte subjekt politik i cili garonte në Komunën e Istogut nëpërmjet kandidatit të tij, z. Gani Dreshaj.

25. Rezultatet përfundimtare të raundit të parë zgjedhor përcaktuan se gara për Kryetar të Komunës së Istogut do të vendosej nga rezultati i raundit të dytë zgjedhor (balotazhit), që do të zhvillohej ndërmjet dy kandidatëve me më së shumti vota në raundin e parë, përkatësisht ndërmjet parashtruesit të parë të kërkesës, z. Gani Dreshaj, dhe z. Haki Rugova, kandidat i Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: LDK) për Kryetar të Komunës së Istogut.

26. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Istogut, ku për Kryetar të Komunës së Istogut garuan dy kandidatët e lartpërmendur.

27. Më 24 nëntor 2017, LDK-ja u ankua në PZAP duke kërkuar anulimin e raundit të dytë të zgjedhjeve të mbajtura më 19 nëntor 2017, duke pretenduar se kishte pasur abuzim të procesit të votimit me postë, sepse numri i votuesve me postë për Komunën e Istogut është tejet i lartë, ngase 58% të votave me postë në nivel të Kosovës janë vetëm për Komunën e Istogut.

28. Më 27 nëntor 2017, PZAP-i (Vendim ZL. A. nr. 1114/2017) pranoi si të bazuar ankesën e LDK-së, anuloi rezultatin për raundin e dytë të zgjedhjeve të 19 nëntorit 2017 dhe urdhëroi KQZ-në që ta përsëris votimin për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, për kryetar të Komunës së Istogut. PZAP-i kishte vlerësuar se fletëvotimet me postë për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Istogut janë përcaktuese në rezultatin final dhe se mënyra e votimit në këtë rast e dëmton dhe cenon seriozisht procesin zgjedhor të raundit të dytë për kryetar në Komunën e Istogut. PZAP-i përfundoi se zgjidhja e vetme dhe e drejtë është përsëritja dhe rivotimi në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Istogut në të gjitha vendvotimet e Komunës së Istogut.

29. Pjesa relevante e vendimit të lartpërmendur të PZAP-it përcakton: *"Nga krejt ajo çka u theksua më lart, lidhur me votimin me postë nga votuesit e Malit të Zi, Austrisë dhe Sllovenisë, për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, për kryetar të Komunës së Istogut, paneli vërtetoi se mënyra e votimit dhe dërgimi i pakove të fletëvotimeve, është bërë në mënyrë të organizuar, dhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton se votuesit në fjalë kanë votuar dhe kanë dërguar pako të fletëvotimeve personalisht. Andaj, mënyra e tillë e organizimit të votimit, vlerësohet nga paneli, si jo i ligjshëm dhe si i tillë e dëmton seriozisht dhe e minon procesin zgjedhor të raundit të dytë për kryetar në Komunën e Istogut ... Paneli vlerëson se në këtë situatë zgjidhja e vetme e drejtë, është që rundi i dytë i Zgjedhjeve Lokale, për kryetar të Komunës së Istogut, të përsëritet dhe të shkohet në rivotim, pasi nuk është e drejtë që të anulohen vetëm fletëvotimet me postë, ndonëse është e qartë që me këto vota është manipuluar, nuk e kemi sigurinë e plotë të themi se të gjitha janë të manipuluara, sepse ka mundësi që në mesin e këtyre votave ka pasur edhe vota të rregullta, me qëllim që çdo votë e qytetarëve të shkoj në destinimin e saj, e vetmja zgjidhje e drejtë dhe jodiskriminuese është rivotimi edhe atë në të gjitha vendvotimet e Komunës së Istogut".*

30. Si LDK-ja po ashtu edhe parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) u ankuan në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartpërmendur të PZAP-it. LDK-ja kërkoi anulimin vetëm të votimit me postë dhe përjashtimin e rezultatit nga votimi me postë nga rezultati i përgjithshëm dhe

përfundimtar të zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Istogut. Kurse, parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) kërkoi që të anulohet vendimi i kontestuar i PZAP-it dhe të urdhërohet KQZ-ja që të certifikojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në raundin e dytë për kryetar të Komunës së Istogut, duke i përfshirë edhe votat me postë.

31. Më 1 dhjetor 2017, Gjykata Supreme (Aktvendimi AA. nr. 55/2017), refuzoi si të pathemelta ankesat e LDK-së dhe të parashtruesit të dytë të kërkesës (AAK) të paraqitura kundër Vendimit ZL. A. nr. 1114/2017 të PZAP-it. Gjykata Supreme e vërtetoi vendimin e PZAP-it dhe konstatoi se: (i) PZAP-i drejtë ka vlerësuar se ka pasur abuzim të procesit të votimit me postë; (ii) abuzimi i procesit të votimit me postë është i kundërligjshëm dhe seriozisht cenon procesin zgjedhor të raundit të dytë për kryetar të Komunës së Istogut; (iii) PZAP-i në mënyrë të saktë dhe bindëse ka konstatuar se ka pasur dëmtim esencial të procesit zgjedhor për kryetar të Komunës së Istogut; dhe, se (iv) në rastin konkret, rivotimi është e vetmja "rrugë e drejtë ligjore" për ndreqjen e shkeljeve të këtij procesi zgjedhor.

32. Pjesa relevante e aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme përcakton: *"Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet ankimore të parashtruesve të ankesave si dhe ato përkitazi me vendimin e PZAP-it për rivotim dhe votat me postë. Mirëpo, këto pretendime edhe nga kjo Gjykatë refuzohen si të pathemelta për arsye se PZAP-ja në vendimin e sajë ka dhënë arsye ligjore të mjaftueshme të cilat i pranon edhe Gjykata Supreme e Kosovës. Kështu, për faktin sepse nga dëshmitë, përkatësisht nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, është vërtetuar katërçipërisht, në mënyrë të saktë dhe bindëse, se procesi zgjedhor i raundit të dytë, për kryetar të Komunës në Istog është dëmtuar nga shkeljet e konstatuara dhe të sipërpërmendura ligjore e të cilat veç tjerash edhe determinojnë dhe ndikojnë në rezultatin final zgjedhor. Kjo Gjykatë, vlerëson se me veprimet e ndaluara, të sipërtheksuara, rezulton, veç tjerash, se në rastin konkret, janë shkelur parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenit 3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut që kanë të bëjnë me garantimin e së drejtës së votimit të fshehtë, garantimin e të drejtës së votës së barabartë, etj."*.

33. Më 17 dhjetor 2017, u përsërit raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Istogut, ku kandidatë ishin parashtruesi i parë i kërkesës (Gani Dreshaj), kandidat i AAK-së, dhe z. Haki Rugova, kandidat i LDK-së.

34. Më 21 dhjetor 2017, KQZ-ja miratoi Raportin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (në tekstin e mëtejmë: QNR) për zgjedhjet e 17 dhjetorit 2017 në Komunën e Istogut. Bazuar në atë raport, z. Haki Rugova, kandidat i LDK-së, kishte fituar 10.033 kurse parashtruesi i parë i kërkesës (Gani Dreshaj) 10.019 të votave.

35. Ndërkohë, parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK - dega në Istog), e përfaqësuar nga zyrtari ligjor B. L., parashtroi ankesë në PZAP, duke kontestuar procesin e votimit dhe administrimin e numërimit nga Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve. Parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) u ankua për parregullsitë e paraqitura dhe rezultatin përfundimtar të rivotimit për kryetar të Komunës së Istogut të 17 dhjetorit 2017. Parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) kryesisht u ankua se nuk janë numëruar 52 (pesëdhjetë e dy) fletëvotime të votuesve që kishin arritur moshën madhore në periudhën ndërmjet datave 22 tetor 2017 dhe 17 dhjetor 2017.

36. KQZ-ja në përgjigjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit, mes tjerash, kishte theksuar se: *"... gjatë administrimit në QNR ku janë refuzuar votat e 52 (pesëdhjetë e dy) votuesve, për shkak se emrat e tyre nuk kanë qenë në Listën përfundimtare të Votuesve, por që kanë pasur moshën 18 vjeçare në zgjedhjet e datës 17.12.2017, në Komunën e Istogut, theksojnë se Ekstrakti i Regjistrit Qendror Civil ka përmbajtur të gjithë emrat e votuesve të regjistruar të moshës 18 vjeçare, duke përfshirë edhe ata që kanë mbushur 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017. Sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 02/2013 - Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3.3, me qëllim të krijimit të listës së votuesve, KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon tri 3 herë ekstraktin e regjistrit civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit të listës së votuesve, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit të LV-së. Të cilën listë votuesit kanë pasur mundësi që të kundërshtojnë gjatë periudhave të shqyrtimit të saj (listën e votuesve), nga ana e publikut dhe atë prej datës 29 gusht 2017 deri me datën 12 shtator 2017".*

37. Kurse për sa i përket votave me kusht, votave që janë refuzuar për shkak të parregullsisë së tyre gjatë tërë procesit zgjedhor për kryetar të Komunës së Istogut, KQZ-ja kishte shpjeguar: *"... është vërtetuar nga numri i përgjithshëm 481, i votave me kusht dhe votave VNPV, që i plotësojnë kriteret ligjore si fletëvotime të rregullta për numërim dhe procedim të mëtejmë janë 309 vota, ndërsa 172 vota janë*

refuzuar. Arsyeja pse janë refuzuar 172 fletëvotime ... është se të njëjtat nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore, ngase 108 fletëvotime të refuzuara kanë të bëjnë se personat të cilët kanë votuar por që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV); 61 fletëvotime të refuzuara janë sepse personat që kanë votuar nuk kanë qenë votues respektivisht qytetar të Komunës së Istogut ku është mbajtur procesi zgjedhor; 2 fletëvotime janë refuzuar sepse votuesit që kanë votuar nuk kanë qenë të regjistruar si votues me nevoja të veçanta dhe 1 fletëvotim është refuzuar sepse votuesi përveç që ka votuar me kusht është vërtetuar se i njëjti ka votuar edhe si votues në vendvotimin e tij të rregullt".

38. Shpjegimet e dhëna nga KQZ-ja ishin pranuar dhe miratuar nga PZAP-i - në tërësi - siç është paraqitur në vendimin e poshtëshënuar.

39. Më 23 dhjetor 2017, PZAP-i (Vendimi ZL. A. nr. 1142/2017) i hodhi poshtë si të palejueshme dhe të pabazuara pretendimet e parashtruesit të dytë të kërkesës (AAK), për parregullsitë dhe për rezultatin përfundimtar të rivotimit, përkatësisht, PZAP-i arsyetoi se lista e votuesve ka mundur të kundërshtohet brenda afatit të paraparë me ligj, dhe se pas kalimit të afatit për kundërshtim, lista e votuesve është certifikuar. Në këtë drejtim, PZAP-i po ashtu shtoi se lista e votuesve certifikohet vetëm një herë dhe është e vlefshme për tërë procesin zgjedhor, sepse kohëzgjatja e saj nuk mund të dihet paraprakisht. PZAP-i përfundoi se votuesit që kishin arritur moshën madhore në periudhën kohore prej 22 tetorit 2017 deri më 17 dhjetor 2017, nuk kanë mundur të jenë pjesë e listës së certifikuar të votuesve.

40. Për sa i përket numërimit të 52 (pesëdhjetë e dy) fletëvotimeve të votuesve që kishin arritur moshën madhore ndërmjet datave 22 tetor 2017 dhe 17 dhjetor 2017, pjesa relevante e vendimit të PZAP-it përcakton:

> "*Lidhur me pretendimet e apeluesit se janë 50 fletëvotime që nuk janë numëruar sepse votuesit kanë arritur moshën madhore për të votuar mes datave 20.10.2017 dhe 17.12.2017, e cilat vota nuk janë numëruar, këto pretendime janë vlerësuar nga paneli si të pabazuara sepse Ekstrakti i Regjistrit Qendror Civil ka përmbajtur të gjithë emrat e votuesve të regjistruar të moshës 18 vjeçare, duke përfshirë edhe ata që kanë mbushur 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017 [...] KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon tri (3) herë ekstraktin e regjistrit civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit të listës së votuesve, si*

dhe herën e tretë jo më vonë se dy ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit të LV-së. Të cilën listë votuesit kanë pasur mundësi që të kundërshtojnë gjatë periudhave të shqyrtimit të saj (listës së votuesve), nga ana e publikut dhe atë prej datës 29 gusht 2017 deri me datën 12 shtator 2017. Meqenëse lista e votuesve është certifikuar pasi ka kaluar afati i kundërshtimit, deri më datë 12.09.2017, dhe e njëjta listë e certifikuar është e vlefshme për një proces zgjedhor sepse certifikohet vetëm njëherë në një palë zgjedhje pavarësisht se sa zgjat periudha kohore e procesit zgjedhor, mbi këtë bazë votuesit që e kanë arritur moshën madhore gjatë periudhës kohore 22.10.2017 dhe 17.12.2017, nuk kanë mundur të jenë pjesë e listës së certifikuar të votuesve".

41. Parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme, duke kontestuar ligjshmërinë e vendimit të lartpërmendur të PZAP-it duke propozuar që ankesa e tyre të pranohet, që vendimi i kontestuar i PZAP-it të anulohet, të anulohet rezultati përfundimtar i rivotimit për kryetar të Komunës së Istogut i mbajtur më 17 dhjetor 2017 dhe të urdhërohet KQZ-ja për të përsëritur votimin në Komunën e Istogut.

42. Më 26 dhjetor 2017, Gjykata Supreme (Aktgjykim A. A. –U. ZH. nr. 64/2017), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të dytë të kërkesës (AAK) të paraqitur kundër Vendimit ZL. A. nr. 1142/2017 të PZAP-it. Gjykata Supreme vërtetoi vendimin e PZAP-it, duke konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të ankuesit (AAK-së). Gjykata Supreme shtoi se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe nuk mund të ndikojnë në konstatimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga PZAP-i.

43. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të dytë të kërkesës (AAK) për privimin e të drejtës së të gjithë votuesve për të votuar, pjesa relevante e arsyetimit të Gjykatës Supreme mund të përmblidhet si vijon:

"Kjo Gjykatë, po ashtu, vlerëson si të pabazuara pretendimet ku theksohet, se me vendimin e PZAP-it ju është privuar e drejta e votimit të gjithë votuesve për të votuar, e që është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së R. të Kosovës, ngase KQZ merr Ekstraktin e Regjistrit Civil, të fundit me të gjithë votuesit që kanë të drejtë vote edhe me ata votues që deri në ditën e votimit i mbushin 18 vjet dhe kanë të drejtë vote. Lista e votuesve për një palë zgjedhje certifikohet një herë dhe është e vlefshme për ato

zgjedhje, sepse askush nuk mund ta dijë se sa mund të zgjasin zgjedhjet, por mund të dihet vetëm dita kur do të mbahen zgjedhjet, siç ka qenë data 22.10.2017. Dispozita ligjore e nenit 6 të Rregullës Zgjedhore nr. 10 thotë se 'Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave përcakton se lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave'. Pra, lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për ditën e votimit në këto zgjedhje lokale me datën 22.10.2017 do të shfrytëzohet edhe për raundin e dytë të këtyre zgjedhjeve".

44. Më 27 dhjetor 2017, KQZ-ja certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Istogut. Me atë rast, z. Haki Rugova u shpall zyrtarisht Kryetar i Komunës së Istogut.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

45. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se PZAP-i dhe Gjykata Supreme kanë cenuar të drejtat e tyre, të drejtën për t'u zgjedhur, siç garantohet me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 (E drejta për zgjedhje të lira) të KEDNJ-së.

46. Për sa i përket dallimit në vota ndërmjet parashtruesit të parë të kërkesës z. Gani Dreshaj, kandidat i AAK-së, dhe z. Haki Rugova, kandidat i LDK-së, parashtruesit e kërkesës pohojnë: *"Rezultati nga raundi i dytë i zgjedhjeve në Komunën e Istogut ishte jashtëzakonisht i ngushtë. Sipas rezultatit të certifikuar nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor kandidati nga Lidhja Demokratike e Kosovës, z. Haki Rugova, kishte fituar zgjedhjet me vetëm 14 vota diferencë".*

47. Parashtruesit e kërkesës më tej shtojnë: "*Në raundin e dytë të votimeve, janë gjithsejtë 52 (pesëdhjetedy) fletëvotime të qytetarëve të cilëve nuk iu është numëruar vota. Këta qytetarë kishin votuar nëpërmjet formës së ashtuquajtur "votë me kusht", pasi që të njëjtit nuk figuronin në listën zgjedhore të certifikuar nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor".*

48. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: "*AAK në ankesat e bëra pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme kishte parashtruar se Lista përfundimtare e votimit është përditësuar për herë të fundit para zgjedhjeve komunale më dt. 22 shtator 2017. Si rezultat i kësaj, votat e 52 (pesëdhjetedy) qytetarëve të cilët kanë arritur moshën madhore ndërmjet datave 22 tetor 2017 (dita e zgjedhjeve) e deri më 17 dhjetor 2017 (përsëritja e votimit), nuk janë numëruar dhe nuk janë*

llogaritur në rezultatin përfundimtar, nga që emrat e tyre nuk kanë figuruar në Listën përfundimtare të votimit".

49. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se qëndrimi juridik i PZAP-it dhe Gjykatës Supreme se listat zgjedhore certifikohen vetëm njëherë, sepse: *"askush nuk mund ta dijë se sa mund të zgjasin zgjedhjet, por mund të dihet vetëm dita kur do të mbahen zgjedhjet, siç janë mbajtur më 22 tetor 2017"*, nuk është i saktë, sepse nuk është në përputhje me nenin 45.1 të Kushtetutës, që përcakton: *"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor".*

50. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Kushtetuta nuk bën dallimin ndërmjet raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve. Ata më tej pohuan se Kushtetuta ua garanton të gjithë individëve të drejtën për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur, 'qoftë dhe në ditën e zgjedhjeve', me kusht që ata të kenë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

51. Për sa i përket caktimit të masës së përkohshme, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata*: "... që të merr vendim për masë të përkohshme me anë të së cilës do të ndalohet zbatimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për certifikimin e rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës në Komunën e Istogut i dt. 27 dhjetor 2017, deri në vendosje meritore për këtë çështje nga Gjykata Kushtetuese".*

52. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) të shpall kërkesën të pranueshme; (ii) të caktohet masa e përkohshme deri në vendosje meritore të çështjes nga Gjykata; (iii) të ndalohet zbatimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Istogut të 27 dhjetorit 2017, deri në vendosje meritore të çështjes nga Gjykata; (iv) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 45.1 të Kushtetutës; (v) të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. A. - U.ZH. nr. 64/2017, të 27 dhjetorit 2017; dhe, (vi) të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të ripërsëritë votimin e raundit të dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Istogut.

Komentet e dorëzuara nga subjektet e interesuara

53. PZAP në përgjigjen e tyre që numëron 210 (dyqindedhjetë) faqe, përfshin ankesat e subjekteve politike AAK dhe LDK, vendime të KQZ-së, CD përkitazi me procedurat e zhvilluara, plotësim të ankesave të

AAK-së, dëshmi shtesë nga KQZ-ja, përgjigje ndaj ankesës së AAK-së në Gjykatën Supreme, etj.

54. PZAP-i u shpreh: *"... kërkesa e parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme ose qartazi e pabazuar dhe se në tërësi konfirmojnë arsyet e dhëna në Vendimin ZL. A. nr. 1142/2017, të 23 dhjetorit 2017 dhe në përgjigjen e PZAP-së përkitazi me ankesën e paraqitur në Gjykatës Supreme".*

55. Z. Haki Rugova, si subjekt i interesuar, në përgjigjen e tij të dorëzuar në Gjykatë ka pohuar se në rastin konkret të gjitha vendimet e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme janë nxjerrë në pajtim dhe duke respektuar Kushtetutën, ligjet dhe rregulloret përkatëse që rregullojnë sferën e të drejtës zgjedhore në Republikën e Kosovës.

56. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për parregullsi të Listës së votuesve, z. Haki Rugova pohon se askush nuk është ankuar brenda afateve ligjore ndaj listave të votuesve të certifikuara nga KQZ-ja dhe se 52 (pesëdhjetedy) vota, të pretenduara nga parashtruesi janë vota të pakonfirmuara dhe të panumëruara që nuk dihet se cilit kandidat i takojnë.

57. Z. Haki Rugova propozon që kërkesa e parashtruesit të shpallet e papranueshme, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, sepse: "*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. A. - U. ZH. nr. 64/2017 kushtetutshmëria e të cilit po sfidohet sipas kësaj kërkese të parashtruesit, z. Gani Dreshaj, por edhe Vendimi i PZAP-it që i ka paraprirë këtij aktgjykimi, janë nxjerrë duke u bazuar (siç edhe thuhet në Aktgjykimin e GJS dhe Vendimin e PZAP-it) duke u bazuar në ankesat e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës si subjekt politik dhe jo në bazë të ankesave individuale të parashtruesit të kësaj kërkese, kandidatit Gani Dreshaj ... prandaj, sikur edhe në rastin KI73/09 "Mimoza Kusari-Lila VS Komisioni Qendror i Zgjedhjeve", edhe në këtë rast konsiderohet se parashtruesi i kësaj kërkese nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike ... ".*

58. Më 26 dhe 31 janar 2018, parashtruesi i parë i kërkesës (Gani Dreshaj) përmes përfaqësuesit, avokatit, Arianit Koci dorëzoi dy përgjigje prej 11 (njëmbëdhjetë) faqesh, që mund të përmblidhen si vijon: parashtruesi i parë i kërkesës pohon (i) se është praktikë që ankesat në PZAP dhe Gjykatë Supreme të parashtrohen nga subjekti politik dhe jo nga kandidati që garon për pozitën e kryetarit të komunës; (ii) se ai është viktimë e drejtpërdrejtë kurse parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) është viktimë indirekte; (iii) se parashtruesi i parë i kërkesës, në cilësinë e kandidatit të AAK-së, i ka shteruar të gjitha mjetet

juridike në pajtim me legjislacionin në fuqi (iii) kërkesa e tij në Gjykatë është vazhdimësi e 'betejës' së AAK-së në PZAP dhe Gjykatë Supreme; (iv) se 52 (pesëdhjetedy) votuesve duhet dhënë mundësia për të votuar sepse dallimi në vota në garën për Kryetar të Komunës së Istogut ka qenë vetëm 14 (katërmbëdhjetë) sosh; (v) parashtruesi i parë i kërkesës pret përgjigje të detajuar nga Gjykata dhe përsëritje të raundit të dytë të votimeve për kryetar të Komunës së Istogut.

59. Më 31 janar 2018, parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) i përfaqësuar nga avokati Arianit Koci, dorëzoi një parashtresë prej 4 (katër) faqesh, me ç' rast kryesisht ngriti të njëjtat pretendime të ngritura më herët nga parashtruesi i parë i kërkesës (Gani Dreshaj). Parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) theksoi se, në rastin konkret, ai është viktimë indirekte, kurse z. Gani Dreshaj është viktimë e drejtpërdrejtë, dhe se jurisprudenca e Gjykatës dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ua njeh edhe personave juridik statusin e viktimës.

60. Në këtë drejtim, për sa i përket legjitimitetit të saj procedural (standing) në Gjykatë, parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) theksoi: *"AAK parashtron se kërkesa e z. Gani Dreshaj në cilësinë e kandidatit të AAK-së për kryetar të komunës së Istogut dhe në cilësinë e viktimës së drejtpërdrejtë të shkeljes së të Drejtës për t'u zgjedhur të garantuar me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, duhet të konsiderohet si vazhdimësi e betejës juridike të filluar nga personi juridik AAK-së nëpërmjet ankesës së parashtruar në PZAP, si dhe ankesës pranë Gjykatës Supreme, siç përcaktohet me ligjet relevante në fuqi".*

Komentet kryesore të pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias

61. Gjykata nga përgjigjet e pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias vëren se në shtetet që kanë dërguar përgjigje ekzistojnë situata juridike të ngjashme por që nuk janë identike me kërkesën në shqyrtim.

62. Gjykata kishte dërguar në Forumin e Komisionit të Venecias një listë me pyetje që kryesisht ndërlidheshin me konceptet e të drejtave zgjedhore aktive dhe pasive si dhe me ndërveprimin e tyre me sistemet kushtetuese zgjedhore të shteteve përkatëse dhe çështjen e përditësimit të listave zgjedhore ndërmjet raundeve të votimit.

63. Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë shpjegoi: (i) Shkelja e së "drejtës aktive" nuk shkakton automatikisht shkeljen e së "drejtës pasive". Po të ishte kështu, shkelja e tillë sigurisht se do të prekte të gjithë personat e kualifikuar për t'u zgjedhur, pra jo vetëm ndonjë ankues specifik por të gjithë kandidatët zgjedhor; (ii) çështja nëse

është shkelur ligji zgjedhor për shkak të mospërfshirjes së votuesit në listën zgjedhore, në masë të madhe varet nga shteti federal (*lander*) dhe nga rrethanat precize të rastit; (iii) në rast të përsëritjes së zgjedhjeve në Saksoninë e Ulët, listat e votuesve nuk do të përditësohen dhe do të përdoren listat fillestare, përveç nëse kanë kaluar 6 (gjashtë) muaj që nga mbajtja e zgjedhjeve të para; dhe, (iv) kontestet zgjedhore në Gjermani nuk shqyrtohen nëse individit i janë shkelur personalisht të drejtat e tij por nëse objektivisht mund të thuhet se zgjedhjet kanë qenë të parregullta.

64. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut u shpreh: (i) kandidati mbron interesin e vet, por edhe interesin e publikut. E drejta e tij është e pavarur dhe nuk varet nëse 52 (pesëdhjetedy) votuesit janë ankuar ose jo; (ii) të drejtat aktive dhe pasive janë të ndërlidhura por nuk janë të varura nga njëra-tjetra. Sipas të drejtës afrikano-jugore, çështja kryesore do të ishte korrektësia e zgjedhjeve dhe mosnumërimi i votave të 52 (pesëdhjetedy) votuesve mundet që materialisht ta paragjykojë rezultatin për ankuesin; (iii) shkelja e së drejtës aktive nuk është domosdoshmërisht shkelje automatike e të drejtës pasive; (iv) mosnumërimi i votave të 52 (pesëdhjetedy) votuesve nuk ka shkelur të drejtën e ankuesit për t'u zgjedhur, mirëpo, këtu bëhet fjalë për zgjedhje të padrejta në kuptimin material, dhe në këso raste, gjykatat e Afrikës së Jugut kanë prirje për të intervenuar; (v) listat e votuesve duhet të përditësohen për raundin e dytë; dhe, (vi) gjykatat afrikano-jugore do të urdhëronin përditësimin e listës sepse e drejta universale për të votuar duhet interpretuar në favor të së drejtës për të votuar dhe jo për heqjen e saj.

65. Gjykata Kushtetuese e Austrisë u shpreh: (i) sipas të drejtës zgjedhore austriake, shkelja e së drejtës aktive nuk nënkupton shkeljen e së drejtës së kandidatit për t'u zgjedhur, pra të drejtën e tij pasive; dhe, (ii) në parim, raundi i dytë i votimeve është vetëm pjesë e një procedure të vetme zgjedhore, në rast të mbajtjes së raundit të dytë të votimeve listat origjinale zgjedhore nuk përditësohen.

66. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë u shpreh: (i) sipas të drejtës zgjedhore bullgare, të drejtat aktive dhe pasive janë të ndërvarura, mirëpo, çdo shkelje e së drejtës aktive nuk çon në anulim të rezultatit zgjedhor; dhe, (ii) sa herë që mbahen dy raunde të votimit, krijohet një listë e re e votuesve para mbajtjes së raundit të dytë. Nëse një individ i mbush 18 vjet në të njëjtën ditë dhe nuk gjendet në listën e votuesve, ai prapë mund të votojë.

67. Gjykata Supreme e Irlandës u shpreh: (i) lista e votuesve publikohet në formë drafti më 1 nëntor dhe hyn në fuqi më 15 shkurt të vitit të

ardhshëm; (ii) është e vlefshme për 12 muaj; (ii) çdo individ që dëshiron të përfshihet në listën e votuesve duhet të ankohet te organet kompetente për t'u përfshirë në listë shtesë (*supplementary register*); dhe (iii) lista e votuesve e cila ka hyrë në fuqi më 15 shkurt përdoret për zgjedhje dhe referendume përgjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të ardhshëm.

68. Gjykata Kushtetuese e Çekisë u shpreh se "individi që nuk gjendet në listën e votuesve ka të drejtë ankese për mospërfshirje në listën e votuesve në gjykatën administrative".

69. Gjykata Kushtetuese e Letonisë u shpreh: (i) zgjedhjet komunale në Letoni zhvillohen në një raund të vetëm, mirëpo, zgjedhjet e përsëritura janë të mundshme në një rast ku gjykata ka anuluar rezultatet e zgjedhjeve; (ii) në rast të anulimit të zgjedhjeve, neni 45 i Ligjit për Zgjedhjet Komunale (*municipal election law*) parashikon se të njëjtit votues që kanë plotësuar kushtet për të votuar në zgjedhjet fillestare mund të votojnë në zgjedhjet e përsëritura; dhe, (iii) e drejta pasive për t'u zgjedhur nuk shkon aq larg sa t'i jep të drejtë një kandidati që të zgjedhet nga një grup specifik i votuesve.

70. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë u shpreh se "sipas të drejtës zgjedhore të Republikës së Kroacisë, në rast të mbajtjes së raundit të dytë të votimeve, listat e votuesve nuk përditësohen".

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike".

Neni 139 [Komisioni Qendrori Zgjedhjeve]

"1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

2. Komisioni përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë.

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të gjykatave me juridiksion apeli.

4. 6 (gjashtë) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe 3 (tre) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë".

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3 i Protokolli 1 të KEDNJ-së
(E drejta për zgjedhje të lira)

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-073, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256

Neni 9
Procedura e kundërshtimit

9.2 Personi që dëshiron të kundërshtojë një emër që mendon se nuk duhet të jetë në LV duhet të dorëzojë ankesë në gjykatën e shkallës së parë duke theksuar qartë faktet që mbështesin kundërshtimin, duke përfshirë provat tjera relevante.

9.3 Personi mund të ngritë ankesë në gjykatën e shkallës së parë nëse zbulon që emri i tij/saj nuk gjendet në LV. Një ankesë e tillë përfshinë çfarëdo provë relevante.

Neni 10
Procesi i vendosjes

10.1 Të gjitha vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë përfundimtare, përfshirë vendimet që kanë të bëjnë me përfshirjen apo përjashtimin e emrit nga LV-ja.
[...]
10.4 Ankesa lidhur me përjashtim të padrejtë nga Lista e Votuesve, e rregullt apo përmes postës, duhet të pranohet nga gjykata e shkallës së parë brenda dyzet (40) ditëve para ditës së zgjedhjeve.

Neni 105
[Ankesat për procesin e QNR]

105.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, neni 4).

105.2 Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose ndërpret procesin e numërimit.

105.3 Për të gjitha ankesat e marra nga PZAP-i vendoset jo më vonë se shtatëdhjetedy (72) orë nga momenti i pranimit të ankesave në zyrat qendrore të PZAP-it. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, neni 5).

Neni 106
[Rezultatet zgjedhore]

106.1 KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, neni 6).

106.2 Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të

numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë.

106.3 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja. [...]

Neni 117
[Procedurat e PZAP-it]

117.1 PZAP-i vendos rregullat dhe procedurat e tij.

117.2 Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme.

117.3 Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.

117.4 PZAP-i mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin.

Neni 118
[Vendimet]

118.2 PZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. PZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej shtatëdhjetedy (72) orëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera PZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve kalendarike. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, nenin 12 paragrafi 1).

118.4 Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes vendimit nga PZAP-i , në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjetedy (72) orëve pas paraqitjes së apelit. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, nenin 12 paragrafi 2).

118.5 Vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, nenin 12 paragrafi 3).

Neni 119
[Ankesat]

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, nenin 13). [...]

119.2 Zyra mund të parashtrojë ankesë në PZAP sa i përket dështimit të subjektit politik për të vepruar në pajtim me këtë ligj ose rregullat e KQZ-së të cilat prekin procesin zgjedhor ose procesin e regjistrimit.

119.3 PZAP-i nuk merr parasysh një ankesë që ka të bëjë me vendim nga ana e KQZ-së, por do të mund të shqyrtojë një apel ndaj një vendimi të KQZ-s siç është saktësuar në nenin 122 të këtij ligji.

119.4 PZAP-i mund të vejë sanksione ndaj një subjekti politik për shkeljen e këtij ligji apo rregullave të KQZ-së të bëra nga anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët e subjektit. Një subjekt politik mund t'i ofrojë fakte PZAP-it për të treguar se ka bërë përpjekje të arsyeshme për të parandaluar dhe dekurajuar anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët për të mos shkelur këtë ligj ose rregullat zgjedhore. PZAP-i i shqyrton këto fakte për të vendosur për sanksionet përkatëse, në rast se ka, për t'iu shqiptuar subjektit politik.

119.5 PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtojë çështje të cilat përndryshe janë nën jurisdiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.

119.6 Ofrimi i informatave të rrejshme PZAP-it paraqet shkelje të këtij ligji të cilën gjë PZAP-i mund ta sanksionoj sipas nenit 12.1 të këtij ligji.

Neni 120
[Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve]

120.1 Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të:

b) para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-ën ti përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, nenin 14).

Neni 122
[Apelimet Zgjedhore]

122.1 Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli. (Ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-073, nenin 15).

a) përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji; dhe
f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

122.2 PZAP-i do të mbështesë apelin ndaj vendimit të KQZ-së nëse vlerëson se KQZ-ja nuk ishte e arsyeshme në marrjen parasysh të të gjitha rrethanave.

122.3 Nëse PZAP-i mbështet apelin ndaj vendimit të KQZ-së, mundet të:

a) udhëzojë KQZ-në ta rishqyrtojë vendimin e vet; dhe
b) udhëzojë KQZ-në të marrë masa kompensimi.

Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-072

Neni 9
Zgjedhjet e Kryetarëve të Komunave

"9.5 Kandidati zgjidhet Kryetar i Komunës nëse ai apo ajo fiton më shumë se 50%, plus 1 (një) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë.

9.6 Nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50%, plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë, KQZ-ja organizon raundin e dytë të zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme. Raundi i dytë i zgjedhjeve mbahet ditën e diel katër (4) javë pas raundit të parë.

9.7 Kandidati i cili fiton shumicën e votave në rrethin e dytë zgjidhet Kryetar i Komunës".

Rregullat dhe Procedurat nr. 02/2015 të PZAP-it, të datës 4 dhjetor 2015

Neni 2
[Përkufizimet]

Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
[...]
2.1 "Ankesë" – do të thotë mjet i rregullt juridik i dorëzuar me shkrim nga një person që ka interes ligjor apo të drejtat e të cilit janë shkelur gjatë procesit zgjedhor.
2.2 "Apel" do të thotë mjet i rregullt juridik kundër vendimeve të shkallës së parë.

[...]

Neni 5
[Ankesat]

[...]
5.3 Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrohen pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit (Neni 113.1 i LZP-së).
5.4 Ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në Qendrën e numërimit dhe të Rezultateve duhet të dorëzohen me shkrim pranë

PZAP-it brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i të kuptuarit nga ankuesi/ja për shkeljen e supozuar, në bazë të nenit 105.1 të LZP-së.
5.4 Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejte me votimin dhe ri-numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar.
[...]

APELET
Neni 10
[Kriteret për apelim]

[...]
10.5 Në lidhje me apelimin e një vendimi të KQZ-së, apeli duhet të dorëzohet brenda pesë (5) ditëve pas njoftimit me vendim të KQZ-së. Për të gjitha apelet tjera, përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, apelet duhet të dorëzohen brenda njëzetekatër (24) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-it nga parashtruesi/ja.
[...]

Neni 14
[Procedura për Administrimin e Hetimeve të Materialit Zgjedhor]

12.1 Kur PZAP-i pranon një ankesë që konsiderohet te jetë e rregullte, dhe kur një ankesë e tille është e dyshuar për veprimtari mashtruese qe përfshinë materialin zgjedhor, Kryesuesi i PZAP-it apo kryesuesi i paneleve vendim-marrëse do te caktoje një anëtar te Sekretariatit te PZAP-it, si hetues kryesor ne lidhje me atë ankese.
[...]

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së nr. 02/2013 për Krijimin, Konfirmimin dhe Kundërshtimin e Listës së Votuesve, e datës 2 korrik 2013

"Neni 3
Procesi i krijimit të Listës së Votuesve

3.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhurnuar, dhe e njëjta përmban:

a) Ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote, të cilët janë regjistruar si qytetarë të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë;

b) Të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës.

3.2 Regjistri Qendror Civil pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim me afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.

3.3 Me qëllim të krijimit të listës së votuesve, KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon tri (3) herë ekstraktin e regjistrit civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të Listës së Votuesve, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy (2) ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së".

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së nr. 06/2013
Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve e datës 2 korrik 2013

Neni 8
Ankesat përkitazi me procesin në QNR

8.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR, sipas nenit 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dorëzohen me shkrim në PZAP brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

8.2 Paraqitja e ankesës nuk pengon procesin e numërimit.

8.3 Në bazë të dispozitës së nenit 105.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 26 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për të gjitha ankesat në PZAP, do të vendoset jo më vonë se 72 orë pas marrjes së tyre në zyrat qendrore të PZAP-it.

Neni 9
Rezultatet e zgjedhjeve

[...]
9.3 Në raste të jashtëzakonshme para certifikimit të rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo Vendvotim, Qendër të Votimit, Qendër të Numërimit ose përsëritjen e votimit në një Qendër Votimi apo në një Komunë.

[...]
9.5. Para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, që në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-në t'i përsëritë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale.
[...]

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së nr. 10/2013 për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, e datës 2 korrik 2013

Neni 1
Dispozitat e Përgjithshme

Kjo rregull ka për qëllim të rregullojë: vëzhguesit e zgjedhjeve, emërimin e këshillave të vendvotimit, Listën Votuese, Votimin dhe numërimin brenda vendvotimeve, votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, si dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimin financiar të partive politike për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Neni 3
Procedurat e Zbatueshme

Të gjitha dispozitat në rregullat përkatëse të zgjedhjeve të KQZ-së janë të zbatueshme gjatë zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, përveç nëse ato janë zëvendësuar ose ndryshuar në mënyrë specifike nga kjo Rregull.

Neni 5
Emërimi i Këshillave të Vendvotimeve

Të dy kandidatëve të cilët garojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave do t'iu lejohet t'i kenë përfaqësuesit e tyre në KVV, sipas vendimit të KQZ-së. Subjektet politike të kandidatëve duhet t'i nominojnë përfaqësuesit e tyre. Nëse nuk ka nominime të mjaftueshme të pranuara nga ai subjekt politik, atëherë përbërja e KVV-së mbetet ashtu siç përcaktohet në nenin 5.1 të kësaj rregulle.

Neni 6
Lista e Votuesve

Lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Pranueshmëria e kërkesës

71. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

72. Në këtë drejtim, Gjykata, duke aplikuar nenet 21.4 dhe 113 të Kushtetutës, dispozitat relevante të Ligjit për sa i përket procedurës në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7, të Kushtetutës; dhe rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe rregullin 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës, do të shqyrtojë nëse: (i) kërkesa është dorëzuar nga palët e autorizuara; (ii) kontestohen vendime të autoriteteve publike; (iii) janë shteruar të gjitha mjetet juridike; (iv) janë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendohet se janë shkelur; (v) janë respektuar afatet kohore; (vi) kërkesa është qartazi e pabazuar; dhe (vii) ka ndonjë kriter shtesë të pranueshmërisë, sipas rregullit 39 (3) të Rregullores së punës, që nuk është plotësuar.

Lidhur me palët e autorizuara

73. Gjykata në këtë aspekt fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar;*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

74. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *4. Të drejtat dhe liritë themelore te parashikuara me Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*

75. Gjykata në fund i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.

76. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve kushtetuese, Gjykata së pari vëren se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy parashtrues të kërkesës dhe secili prej tyre duhet të legjitimohet si palë e autorizuar në bazë të dispozitave përkatëse të cituara më lart, si parakusht për të shqyrtuar këtë kërkesë. Për sa i takon parashtruesit të parë të kërkesës, përkatësisht z. Gani Dreshaj, Gjykata vëren se ai, në cilësinë e individit, përkatësisht të personit fizik, është palë e autorizuar për të parashtruar ankesë kushtetuese në Gjykatë (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI73/09 parashtrues: *Mimoza Kusari- Lila,* Aktvendim i 19 shkurtit 2010; KI152/17 parashtrues: *Shaqir Totaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018; KI157/17 parashtrues: *Shaip Surdulli,* Aktvendim për papranueshmëri i 15 majit 2018). Për sa i takon parashtruesit të dytë të kërkesës, përkatësisht subjektit politik AAK, Gjykata vëren se, në bazë të paragrafit 4 të nenit 21 të Kushtetutës, edhe parashtruesi i dytë i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat kushtetuese që vlejnë për personat juridik, për aq sa ato janë të zbatueshme. (*Shih: Aktvendimi për papranueshmëri, AAB-RIINVEST University L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti KI41/09 i 21 janarit 2010;* shih po ashtu, rastin e GJEDNJ-së *Partia për një Shoqëri Demokratike dhe të tjerët kundër Turqisë,* nr. 3840/10, Aktgjykim i 12 janarit 2016).

77. Për më tepër, dhe në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se GJEDNJ-ja në praktikën e saj gjyqësore ka konstatuar se e drejta për t'u zgjedhur në kuadër të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është e drejtë që u garantohet edhe partive politike, si subjekte juridike, dhe se ato mund të ankohen pavarësisht nga kandidatët e tyre (shih, për shembull, rastin e *Partisë së Punës të Gjeorgjisë kundër Gjeorgjisë,* nr. 9103/04, GJEDNJ, Aktgjykim i 8 korrikut 2008, paragrafët 72-74, dhe referencat e tjera të përmendura në atë vendim). Rrjedhimisht, Gjykata konkludon që të dy parashtruesit janë palë të autorizuara.

Lidhur me aktin e autoritetit publik

78. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart dhe nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija

individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

79. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit (2) të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës i cili, *inter alia*, përcakton:

(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht [...] cili është akti konkret i autoriteti publik i cili kontestohet.

80. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë akte të autoriteteve publike, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [A.A.-U.ZH. nr. 64/2017] të 26 dhjetorit 2017 dhe Vendimin e PZAP-it [ZL.A.nr. 1142/2017] të 23 dhjetorit 2017, siç është përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me dispozitat e tjera të Ligjit dhe të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon që parashtruesit e kërkesës kontestojnë akte të autoriteteve publike.

Lidhur me shterimin e mjeteve juridike

81. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart dhe paragrafit 2 të nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

(...)

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuara.

82. Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të të *"gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 dhe vlen, si për personat fizik ashtu edhe për personat juridik, për aq sa është i aplikueshëm.

83. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vërtetojë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike nga parashtruesi i parë i kërkesës, në cilësi të individit, si person fizik, si dhe nga parashtruesi i dytë, në cilësi të subjektit politik, si person juridik. Kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur janë mirë të përcaktuara në praktikën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

84. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se vetëm parashtruesi i dytë, përkatësisht AAK-ja si subjekt politik, përkatësisht person juridik, ka qenë palë në procedurë para PZAP-it dhe Gjykatës Supreme. Parashtruesi i parë i kërkesës nuk kishte qenë palë procedurale ndonëse ligji i aplikueshëm, përkatësisht i LZP-së, nëpërmjet nenit 119.1 të tij, e parasheh një mundësi edhe për personat fizik, pra kandidatët që kanë interes për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të tyre. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se vetëm parashtruesi i dytë i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe Gjykata do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [A.A.-U.ZH. nr. 64/2017] në raport me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ që i takojnë AAK-së si subjekt politik dhe person juridik (Shih, *mutatis mutandis*, subjektet politike si parashtrues para GJEDNJ-së për konteste zgjedhore, *Refah Partisi (Partia e Mirëqenies Sociale) dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98, Aktgjykim i 13 shkurtit 2003; shih, po ashtu, rastin e *Partisë Konservatore Ruse e Ndërmarrësve dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 55066/00 dhe 55638/00, Aktgjykim i 11 janarit 2007, ku parashtrues ishte një subjekt politik së bashku me kandidatin që garonte nën siglën e po atij subjekti politik).

85. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në njërën anë, procedurat e apelimit në PZAP dhe në Gjykatën Supreme ishin iniciuar dhe zhvilluar në emër të parashtruesit të dytë të kërkesës (AAK), derisa nga përmbajtja

e dokumenteve të dorëzuara rezulton se parashtruesi i parë i kërkesës (Gani Dreshaj) nuk kishte paraqitur asnjë ankesë në emër të tij, nga ana tjetër. Ankesa e parashtruesit të parë të kërkesës në emrin e tij është paraqitur për herë të parë pikërisht në Gjykatën Kushtetuese, çka vërtetohet me autorizimin me të cilin ai e kishte pajisur përfaqësuesin e tij.

86. Mirëpo, parashtruesi i dytë i kërkesës (AAK) në parashtresën e dorëzuar më 31 janar 2018, ka njoftuar Gjykatën se kërkesën e parashtruesit të parë (Gani Dreshaj) e konsideron 'vazhdimësi të betejës' së zhvilluar në PZAP dhe Gjykatën Supreme; dhe se në rastin konkret, konsideron se parashtruesi i parë i kërkesës është viktimë e 'drejtpërdrejtë', kurse vetveten e cilëson 'viktimë indirekte'.

87. Gjykata thekson se ky rast dallon nga rastet e mëparshme nr. KI73/09 dhe nr. KI152/17, sepse në ato raste parashtruesit kishin dorëzuar kërkesat e tyre në Gjykatë individualisht, derisa procedurat e rregullta në KQZ, PZAP dhe Gjykatë Supreme ishin zhvilluar nga subjektet politike. Në rastet në fjalë, subjektet politike nuk patën dorëzuar kërkesë në Gjykatë për të mbështetur kandidatët e tyre (parashtruesit e kërkesës), çka në të vërtetë, përcakton dallimin në mes të rasteve në fjalë dhe rastit të tanishëm (Shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI73/09, *Parashtrues: Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor,* Aktvendim për palejueshmëri, i 24 marsit 2010, paragrafi 35 dhe po ashtu shih *mutatis mutandis* Rastin nr. KI152/17, *Parashtrues: Shaqir Totaj,* Aktvendim për papranueshmëri, i 8 shkurtit 2018, paragrafët 39-46 dhe referencat e përmendura në atë vendim).

88. Gjykata duke u mbështetur në shtjellimin e mësipërm, vëren se, në rastin në shqyrtim, parashtruesi i kërkesës AAK i ka shteruar të gjitha mjetet juridike siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës. Veç kësaj, Gjykata vlerëson, duke u mbështetur në jurisprudencën e saj, se parashtruesi i kërkesës z. Gani Dreshaj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet ankimore vetëm në lidhje me parashtruesin e dytë (AAK), pavarësisht nga fakti se pretendimet e të dy parashtruesve janë identike.

Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe afatin

89. Në vazhdim, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata

së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. (...)

90. Gjykata rikujton që të njëjtat kritere janë të specifikuara më tej edhe në pikat c dhe d të paragrafit 1 të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe paragrafët 2 dhe 4 të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës.

91. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendojnë se u janë cenuar dhe kanë specifikuar aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës dhe e kanë parashtruar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës.

Lidhur me kushtet tjera të pranueshmërisë

92. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës dhe nuk ka asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme, meqë asnjë nga kushtet e përcaktuara me rregullin 39 (3) të Rregullores së punës nuk janë të aplikueshme në rastin konkret (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës nr. KO73/16, *Parashtrues: Avokati i Popullit,* Aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 49).

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

93. Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara; kontestojnë vendime të autoritete publike; kanë shteruar mjetet juridike siç është elaboruar specifikisht më lart; kanë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendojnë se janë shkelur; kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit; kërkesa nuk është qartazi e pabazuar; dhe nuk ka asnjë kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar.

94. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall kërkesën të pranueshme.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

95. Në rastin konkret, Gjykata nuk do të vlerësojë *in abstracto* nëse kuadri ligjor që rregullon të drejtën zgjedhore në Republikën e Kosovës është i pajtueshëm ose i papajtueshëm me Kushtetutën. Fushëveprimi i Gjykatës, në këtë rast, përkufizohet vetëm në vlerësimin nëse vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme janë në përputhshmëri me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 (E drejta për zgjedhje të lira) të KEDNJ-së.

96. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 53 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

97. Gjykata i referohet nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.*
>
> *2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.*
>
> *3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike".*

98. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 (E drejta për zgjedhje të lira) të KEDNJ-së, që përcakton:

> *"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës".*

(a) Parime të Përgjithshme dhe Testi i GJEDNJ-së sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1

99. Neni 3 i Protokollit nr. 1 ndryshon nga të drejtat e tjera të garantuara me Konventë dhe protokollet e saj siç është formuluar në lidhje me detyrimin e Palës së Lartë Kontraktuese për të mbajtur zgjedhje që sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të njerëzve dhe jo në pikëpamje të një të drejte apo lirie të veçantë. Megjithatë, duke pasur parasysh punën përgatitore të nenit 3 të Protokollit nr. 1 dhe interpretimin e dispozitës në kontekstin e Konventës si tërësi, GJEDNJ ka vendosur që kjo dispozitë nënkupton gjithashtu të drejtat individuale, duke përfshirë të drejtën e votës dhe të kandidimit për zgjedhje (Shih, *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, 2 mars 1987, paragrafët 46-51, Seria A nr. 113).

100. Të drejtat e garantuara sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 janë thelbësore për krijimin dhe mbajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë të qeverisur nga sundimi i ligjit. Sidoqoftë, këto të drejta nuk janë absolute. Ka hapësirë për "kufizime të nënkuptuara", dhe Shteteve Kontraktuese duhet t'u jepet një hapësirë e vlerësimit në këtë sferë. GJEDNJ riafirmon se hapësira në këtë fushë është e gjerë (Shih, rastin *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, cituar më lart, paragrafi 52, *Matthews,* cituar më lart, paragrafi 63, *Labita*, cituar më lart, paragrafi 201 dhe *Podkolzina kundër Letonisë*, nr. 46726 / 99, paragrafi 33, GJEDNJ 2002-II). Ekzistojnë mënyra të shumta për organizimin dhe drejtimin e sistemeve zgjedhore dhe një mori dallimesh, ndër të tjera, në zhvillimin historik, diversitetin kulturor dhe mendimin politik brenda Evropës, që secili Shtet Kontraktues duhet ta fusë në vizionin e vet demokratik (Shih, rastin *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2) [DHM], nr. 74025/01, paragrafi 61, GJEDNJ 2005-IX).

101. Megjithatë, GJEDNJ duhet të përcaktojë në instancën e fundit nëse janë plotësuar kërkesat e nenit 3 të Protokollit nr. 1; ajo duhet të bindet se kushtet e imponuara për të drejtën e votës ose për të dalë në zgjedhje nuk e kufizojnë ushtrimin e këtyre të drejtave në atë masë sa të dëmtojnë thelbin e tyre dhe t'i privojnë nga efektiviteti i tyre; se ato

janë të vendosura në ndjekje të një qëllimi legjitim; dhe se mjetet e përdorura nuk janë joproporcionale (Shih, rastin *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, cituar më lart, paragrafi 52). Në veçanti, kushtet e tilla nuk duhet të pengojnë shprehjen e lirë të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës - me fjalë të tjera, duhet të reflektojnë ose të mos kundërshtojnë shqetësimin për të ruajtur integritetin dhe efektivitetin e një procedure zgjedhore që synon identifikimin e vullnetit të popullit nëpërmjet të drejtës së përgjithshme të votës (Shih, rastin *Hirst*, cituar më lart, paragrafi 62).

102. Në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me të drejtën e votës, përkatësisht me të ashtuquajturin aspektin "aktiv" të të drejtave sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1, GJEDNJ-së ka konsideruar se përjashtimi i çdo grupi ose kategorie të popullatës së përgjithshme duhet të jetë në pajtim me qëllimet themelore të nenit 3 të Protokollit nr. 1 (Shih, *mutatis mutandis, Aziz kundër Qipros*, nr. 69949/01, paragrafi 28, GJEDNJ 2004-V). Në veçanti, Gjykata ka konstatuar se legjislacioni i brendshëm që vendos kërkesat për moshë minimale ose kërkesat e vendbanimit për ushtrimin e së drejtës së votës është në parim në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 (Shih, rastin *Hilbe kundër Lihtenshtajnit* (vendim) 31981/96, GJEDNJ 1999-VI, shih, gjithashtu, rastin *Hirst*, cituar më lart, paragrafi 62).

103. Institucionet e Konventës gjithashtu kanë konstatuar se ishte çështje e hapur për legjislaturën që të heqë të drejtat politike nga personat e dënuar për krime të rënda ose financiare (Shih, *Holanda kundër Irlandës*, nr. 2487/94, Vendimi i Komisionit i 14 prillit 1998, DR 93-A, f. 15, dhe *MDU kundër Italisë* (vendim), nr. 58540/00, 28 janar 2003). Megjithatë, në rastin *Hirst* (paragrafi 82) Dhoma e Madhe theksoi se Shtetet Kontraktuese nuk kishin *carte blanche* për të diskualifikuar të gjithë të dënuarit e burgosur nga e drejta e votës, pa marrë parasysh çështjet relevante, si kohëzgjatja e dënimit të të burgosurit ose natyra dhe serioziteti i veprës. Një kufizim i përgjithshëm, automatik dhe pa dallim në të drejtën e votimit të të gjithë të burgosurve të ndaluar konsiderohej nga Gjykata të bie jashtë kufijve të pranueshëm të vlerësimit. Institucionet e Konventës kanë pasur më pak raste që të merren me një shkelje të pretenduar të së drejtës së individit për të marrë pjesë si kandidat për zgjedhje, përkatësisht me ashtuquajturin aspektin "pasiv" të të drejtave sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1. Në këtë drejtim, GJEDNJ ka theksuar se Shtetet Kontraktuese gëzojnë një gamë të gjerë në vendosjen e rregullave kushtetuese për statusin e anëtarëve të parlamentit, duke përfshirë kriteret që qeverisin të drejtën për t'u kandiduar për zgjedhje. Edhe pse ata kanë një origjinë të përbashkët në nevojën për të siguruar si pavarësinë e përfaqësuesve të zgjedhur dhe lirinë e

zgjedhjes së zgjedhësve, këto kritere ndryshojnë në përputhje me faktorët historik dhe politik që janë specifik për secilin shtet. Shumëllojshmëria e situatave të parashikuara në kushtetuta dhe në legjislacionin zgjedhor të shteteve të shumta anëtare të Këshillit të Evropës, tregon shumëllojshmërinë e qasjeve të mundshme në këtë fushë. Prandaj, për qëllim të zbatimit të nenit 3, çdo legjislacion zgjedhor duhet të vlerësohet në dritën e evolucionit politik të vendit përkatës (Shih, *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, paragrafi 54, dhe *Podkolzina*, paragrafi 33, të dy rastet e cituara më lart).

104. Në rastin Podkolzina, GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 në lidhje me kufizimet mbi të drejtën e një individi për të qenë kandidat në zgjedhje. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës u hoq nga lista e kandidatëve parlamentarë me pretendimin e njohurive të saj të pamjaftueshme të gjuhës zyrtare të shtetit. GJEDNJ pranoi se një vendim që përcaktonte një gjuhë pune të parlamentit ishte ai që në parim vetëm shteti kishte pushtetin për ta marrë, duke qenë një faktor i formuar nga konsideratat historike dhe politike të veçanta për vendin në fjalë. Megjithatë, është konstatuar shkelje e nenit 3 të Protokollit nr. 1, sepse procedura e zbatuar për ankuesin për të përcaktuar aftësinë e saj në gjuhën zyrtare ishte në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë procedurale dhe sigurisë juridike, duke rezultuar se përfundimi negativ i arritur nga autoritetet vendase në lidhje me këtë mund të konsiderohet i mangët (paragrafët 33-38).

105. Në rastin *Melnychenko kundër Ukrainës* (nr. 17707/02, paragrafët 53-67, GJEDNJ 2004-X), GJEDNJ gjithashtu pranoi se legjislacioni që krijon kushtet e qëndrimit të brendshëm për një kandidat parlamentar ishte, si i tillë, në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1. Në të njëjtën kohë, vendimi i autoriteteve ukrainase për t'ia mohuar ankuesit regjistrimin si kandidat parlamentar është konstatuar të jetë në shkelje të dispozitës së mësipërme, duke pasur parasysh se ligjit të brendshëm që rregullon dëshminë e qëndrimit të kandidatit i mungonte siguria e nevojshme dhe saktësia për t'i garantuar ankuesit mbrojtje adekuate kundër trajtimit arbitrar. GJEDNJ theksoi në atë rast se, ndërsa Shtetet Kontraktuese kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi kur përcaktojnë kushtet e pranueshmërisë në mënyrë abstrakte, parimi që të drejtat duhen të jetë efektive kërkon që vetë procedura e kualifikimit të përmbajë masa mbrojtëse të mjaftueshme për të parandaluar vendime arbitrare (paragrafi 59).

106. Në disa raste më të vjetra, ish-Komisionit iu kërkua në disa raste të shqyrtojë nëse vendimi për tërheqjen e të drejtave zgjedhore të ashtuquajtura "aktive" ose "pasive" të një individi për shkak të aktiviteteve të tij të mëparshme përbënte shkelje të nenit 3 të

Protokollit nr. 1. Në të gjitha ato raste, Komisioni konstatoi se nuk ishte i atillë. Kështu, në rastet *X kundër Holandës* (nr. 6573/74, vendimi i Komisionit i 19 dhjetorit 1974, DR 1, f. 87) dhe *X kundër Belgjikës* (8701/79, Vendimi i Komisionit i 3 dhjetorit 1979, DR 18, f. 250), i shpalli kërkesat të papranueshme nga dy persona të cilët ishin dënuar pas Luftës së Dytë Botërore për bashkëpunim me armikun ose për "sjelljen jo qytetare" dhe, për këtë arsye, u është hequr e drejta e përhershme për të votuar. Në veçanti, Komisioni konsideroi se "qëllimi i legjislacionit që i privon personat e dënuar për tradhti nga të drejta të caktuara politike dhe më konkretisht, nga e drejta e votës [ishte] që të sigurohej që personave që [kishin] abuzuar rëndë, në kohë lufte, e drejta e pjesëmarrjes në jetën publike të vendit të tyre të pengohej në të ardhmen nga keqpërdorimi i të drejtave të tyre politike në një mënyrë që dëmton sigurinë e shtetit ose themelet e një shoqërie demokratike" (Shih, *X kundër Belgjikës*, paragrafi 253).

107. Në rastin *Van Wambeke kundër Belgjikës* (nr. 16692/90, Vendimi i Komisionit i 12 prillit 1991, i paraportuar), Komisioni deklaroi të papranueshme, për të njëjtën arsye, një kërkesë nga një ish-anëtar i Waffen-SS, i dënuar për tradhti në vitin 1945, i cili u ankua se nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në zgjedhjet e Parlamentit Evropian në vitin 1989. Në rastin *Glimmerveen dhe Hagenbeek kundër Holandës* (nr. 8348/78 dhe 8406/78, Vendimi i Komisionit i 11 tetorit 1979, DR 18, f. 187), Komisioni i deklaroi të papranueshme dy kërkesa lidhur me refuzimin për të lejuar parashtruesit e kërkesës, të cilët ishin udhëheqës të një organizate të ndaluar me tendenca raciste dhe ksenofobike, të kandidonin në zgjedhje. Në atë rast, Komisioni iu referua nenit 17 të Konventës, duke vlerësuar se parashtruesit e kërkesës "kishin për qëllim të merrnin pjesë në këto zgjedhje dhe të shfrytëzonin të drejtën [në fjalë] për një qëllim të cilin Komisioni [e kishte] konstatuar të papranueshëm sipas nenit 17" (*ibid.*, f. 197). Në atë rast u theksua gjithashtu se standardi i tolerancës nuk pengon një shoqëri demokratike të ndërmarrë hapa për të mbrojtur veten nga veprimtaritë që synojnë të shkatërrojnë të drejtat ose liritë e përcaktuara në Konventë. Neni 3 i Protokollit nr. 1, që mishëron aftësinë e individit për të ndikuar në përbërjen e pushtetit ligjvënës, nuk përjashton në këtë mënyrë që kufizimet mbi të drejtat zgjedhore t'i vendosen një individi i cili, për shembull, ka abuzuar seriozisht një pozitë publike ose sjellja e të cilit kërcënoi të minonte sundimin e ligjit ose themelet demokratike.

108. Në kontekstin e kufizimeve të punësimit të vendosura ndaj zyrtarëve publik për arsye politike, GJEDNJ konstatoi se neni 10 i Konventës mund të zbatohet në lidhje me shkarkimin e tyre. Shkelje e nenit 10 u gjet në këtë aspekt në rastin *Vogt* (cituar më lart, paragrafët 43-44),

ku parashtruesi i kërkesës u shkarkua si nëpunës civil në lidhje me aktivitetet e saj specifike si anëtare e Partisë Komuniste në Gjermaninë Perëndimore. Megjithatë, në rastin *Volkmer kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 39799/98, 22 nëntor 2001) dhe *Petersen kundër Gjermanisë* (vendim) nr. 39793/98, GJEDNJ 2001-XII), Gjykata i deklaroi të papranueshme si të pabazuara ankesat e parashtruesve nëpunës civil, sipas nenit 10 lidhur me shkarkimin e tyre për shkak të bashkëpunimit të tyre me regjimin dhe shërbimet sekrete të ish-Republikës Demokratike Gjermane. Në rastin *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë* (nr. 55480/00 dhe 59330/00, paragrafët 51-62, GJEDNJ 2004-VIII), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 14 të marrë në lidhje me nenin 8 përkitazi me ekzistencën e kufizimeve të gjera që ua ndalonin ish-zyrtarëve të KGB-së në Lituani qasjen në fushat e ndryshme të punësimit në sektorin privat, të cilat u futën pothuajse një dekadë pas rivendosjes së pavarësisë së Lituanisë. Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet se shkarkimi i atyre parashtruesve nga pozitat e tyre, përkatësisht, një inspektor tatimor dhe prokuror, për shkak të punës së tyre të mëparshme në KGB nuk konsiderohej të përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas nenit 10 të Konventës *(ibid*, paragrafët 67-73).

109. Gjithashtu, në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet se neni 3 i Protokollit nr. 1, ose dispozitat e tjera të Konventës, nuk i pengojnë, në parim, Shtetet Kontraktuese që të fusin skema politike të përgjithshme nëpërmjet masave legjislative, ku një kategori apo grup i caktuar individësh trajtohet ndryshe nga të tjerët, me kusht që ndërhyrja në të drejtat e kategorive ose grupit ligjor në tërësi të mund të arsyetohet sipas Konventës (Shih, në kontekstin e një ndalimi legjislativ të një zyrtari policor nga përfshirja në aktivitete politike, të dëgjuar nga Gjykata sipas neneve 10 dhe 11 të Konventës, rasti *Rekvényi,* cituar më lart, paragrafët 34-50 dhe 58-62).

110. Në rastin *Rekvényi* nuk është konstatuar asnjë shkelje e Konventës në atë që legjislacioni vendas në fjalë është vlerësuar të jetë mjaft i qartë dhe i saktë sa i përket përcaktimit të kategorive të personave të prekur (pjesëtarë të forcave të armatosura, policisë dhe shërbimeve të sigurisë) dhe sa i përket fushëveprimit të zbatimit të kufizimit ligjor të kontestuar, qëllimi themelor i statutit për përjashtimin e të gjithë grupit nga aktivitetet politike në pajtim me kërkesat e proporcionalitetit sipas neneve 10 dhe 11 të Konventës. Prandaj, nuk ishte thelbësore për vlerësimin e GJEDNJ-së mbi përputhshmërinë e masave të kontestuara me Konventën, pavarësisht nëse parashtruesi i kërkesës në atë rast mund të kishte kërkuar nga gjykatat vendase që të shqyrtojnë nëse përfshirja e tij politike përbënte një rrezik të mundshëm për rendin demokratik (*ibid*). Në mënyrë të ngjashme, në

rastet *Podkolzina dhe Melnychenko*, të dyja cituar më lart, GJEDNJ nuk deklaroi që Konventa kërkoi që gjykatat vendase të autorizoheshin për të shqyrtuar raste të tilla siç është proporcionaliteti i detyrimeve ligjore të vendosura ndaj këtyre parashtruesve për të respektuar gjuhën dhe vendbanimin me qëllim që të ushtrojnë të drejtat e tyre për të kandiduar në zgjedhje, duke qenë se këto kërkesa ligjore ishin në vetvete krejtësisht të pranueshme nga pikëpamja e Konventës.

111. Nga analiza e mësipërme rrjedh se, përderisa vetë dallimi ligjor është proporcional dhe jodiskriminues për të gjithë kategorinë ose grupin e specifikuar në legjislacion, detyra e gjykatave të vendit mund të kufizohet në përcaktimin nëse një individ i veçantë i takon kategorisë së kontestuar ose grupit ligjor. Kërkesa për "individualizim", që është domosdoshmëri e mbikëqyrjes nga autoritetet gjyqësore vendase të proporcionalitetit të kufizimit ligjor të kontestuar në pikëpamje të karakteristikave specifike të secilit rast, nuk është parakusht i përputhshmërisë së masës me Konventën.

112. Neni 3 i Protokollit nr. 1 trajton vetëm zgjedhjen e organit ligjdhënës. Kjo shprehje, megjithatë, nuk përkufizon vetëm parlamentin shtetëror. Struktura kushtetuese e shtetit në fjalë duhet të shqyrtohet (*Timke kundër Gjermanisë*, Vendim i Komisionit). Në përgjithësi, fushëveprimi i nenit 3 të Protokollit nr. 1 nuk i mbulon zgjedhjet lokale, qoftë komunale (*Xuereb kundër Maltës*; *Salleras Llinares kundër Spanjës*) ose rajonale (*Malarde kundër Francës*). GJEDNJ-ja ka konstatuar se pushteti për të nxjerrë rregullore dhe nën-ligje, që i është akorduar autoriteteve lokale në shumë vende, duhet dalluar nga pushteti ligjdhënës, i cili përmendet në nenin 3 të Protokollit nr. 1, edhe pse pushteti ligjdhënës mund të kufizohet vetëm në parlamentin shtetëror (*Mółka kundër Polonisë* (Vendim)).

113. Pavarësisht nga kjo, Gjykata konsideron se parimet e nxjerra nga jurisprudenca e GJEDNJ-së përkitazi me garancitë e nenit 3 të Protokollit nr. 1 janë të dobishme për kontestet zgjedhore komunale në Republikën e Kosovës dhe posaçërisht për rastin në shqyrtim.

114. Të drejtat e garantuara me nenin 3 të Protokollit nr. 1 nuk janë absolute dhe iu nënshtrohen kufizimeve të nënkuptuara (*implied limitations*). Koncepti i kufizimeve të nënkuptuara do të thotë se GJEDNJ-ja nuk zbaton testet tradicionale të domosdoshmërisë (*necessity*) ose të nevojës së ngutshme shoqërore (*presing social need*) që përdoren në kontekst të neneve 8 dhe 11 të KEDNJ-së. Gjatë shqyrtimit nëse është respektuar neni 3 i Protokollit nr. 1, GJEDNJ-ja është përqendruar kryesisht në dy kritere: nëse ka pasur arbitraritet ose mungesë të proporcionalitetit dhe nëse kufizimi ka ndërhyrë në

lirinë e shprehjes së opinionit të popullatës. Veç kësaj, GJEDNJ-ja nënvizon nevojën për të vlerësuar çdo legjislacion zgjedhor duke marrë parasysh evolucionin politik të vendit në fjalë, çka do të thotë se tiparet e papranueshme në një sistem mund të justifikohen në tjetrin (*Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, paragrafi 52; *Ždanoka kundër Letonisë* [DHM], paragrafët 103-104 dhe 115).

115. Duke iu referuar rekomandimeve të Komisionit të Venecias, GJEDNJ-ja kishte konstatuar se fazat paszgjedhore duhet të rrethohen nga garanci procedurale precize; procesi duhet të jetë transparent dhe i hapur, dhe vëzhguesit nga të gjitha partitë duhet t'iu lejohet pjesëmarrja, duke përfshirë përfaqësuesit e opozitës. GJEDNJ-ja kishte theksuar se, megjithatë, neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk ishte parashikuar si kod për çështje zgjedhore i dizajnuar për t'i rregulluar të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Prandaj, niveli i shqyrtimit nga GJEDNJ-ja në një rast të caktuar varej nga aspekti i të drejtës për zgjedhje të lira. Shqyrtim më i shtrënguar duhet rezervuar për çdo shmangie nga parimi universal i të drejtës për të votuar, porse hapësirë më e gjerë e vlerësimit mund t'iu akordohet shteteve për masat që kanë parandaluar kandidatët në të drejtën e tyre për t'u zgjedhur. Shqyrtim edhe më pak shtrëngues duhet zbatuar në fazën teknike të numërimit të votave dhe hedhje të shënimeve në tabelë (*tabulation*). GJEDNJ-ja u ka akorduar liri të madhe të vlerësimit shteteve të paditura në çështjet zgjedhore dhe se ndonjë gabim ose parregullsi në vetvete nuk nënkupton shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Shkelje mund të konstatohet në rastet e pengimit të votuesve ku në mënyrë flagrante është shtrembëruar rezultati zgjedhor, nuk ka pasur shqyrtim efektiv (substancial) të ankesave apo në rast të vlerësimit qartazi arbitrar apo të paarsyeshëm (*Davydov kundër Rusisë,* paragrafët 283-288).

116. Gjykata konsideron se neni 45 i Kushtetutës nuk mund të lexohet i izoluar nga dispozitat tjera kushtetuese dhe se të drejtat që i mbron nuk janë absolute porse i nënshtrohen "kufizimeve të nënkuptuara". Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 64 të Kushtetutës që përcakton mënyrën e ndarjes së vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nenit 73 të Kushtetutës i cili përcakton se gjyqtarët, prokurorët dhe ushtruesit e tjerë të funksioneve publike të listuar shprehimisht në atë dispozitë, nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre. Pra, hartuesit e kushtetutës kanë vënë kushte që kufizojnë të drejtat zgjedhore çka lë të kuptohet se ato kufizime janë në pajtim me frymën e Kushtetutës lexuar si tërësi. Kushtetutëdhënësi kosovar po ashtu ka themeluar KQZ-së si organ të përhershëm për mbikëqyrjen e zgjedhjeve i cili, mes tjerash, ka për detyrë të respektojë dhe zbatojë

afatet ligjore për ankesa dhe aspektet e tjera teknike siç janë përditësimi i listave të votuesve, numërimi i votave me kusht etj. Kushtetuta, ligjet zgjedhore dhe rregulloret zgjedhore të nxjerra nga KQZ-ja, sipas Gjykatës, duhet lexuar si një tërësi kushtetuese-ligjore dhe në harmoni me njëra tjetrën që përveç se akordon të drejta zgjedhore po ashtu edhe i kufizon ato. Gjykata po ashtu konsideron se nëse ndonjë kufizim përbën cenim ose jo të vetë thelbit të të drejtave zgjedhore, është diçka që përcaktohet nga rasti në rast.

117. Gjykata vëren se neni 45 i Kushtetutës përbëhet nga 3 paragrafë të veçantë dhe secili prej tyre ka elementet dhe rregullat përkatëse. Që të tre paragrafët duhet të lexohen së bashku dhe në ndërvarësi me njëri-tjetrin. Në mbështetje të arsyetimit të pretendimeve në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të fokusohet vetëm në paragrafin e parë të nenit 45 të Kushtetutës.

118. Paragrafi i parë i nenit 45 të Kushtetutës përcakton të drejtën për të zgjedhur (të drejtën aktive të votës), si dhe të drejtën për t'u zgjedhur (të drejtën pasive të votës). E drejta e parë, pra ajo aktive e votës, i takon vetëm individëve, pra personave fizik që janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe që kanë arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e votimit dhe në rast se e drejta e tyre nuk është e kufizuar me një vendim gjyqësor. E drejta tjetër, ajo pasive e votës, i takon kandidatëve si individë, përkatësisht si persona fizik, të cilët garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror, si dhe subjekteve politike, përkatësisht personave juridik që garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror. Edhe për të drejtën pasive të votës vlen kushti që të njëjtëve të mos i jetë kufizuar ushtrimi i kësaj të drejte me një vendim gjyqësor.

119. Këto dispozita kushtetuese deri më sot nuk janë trajtuar në merita. Gjykata ka pasur një numër të vogël të rasteve në të cilat pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë ndërlidhur me nenin 45 të Kushtetutës. Në asnjërin prej këtyre rasteve, Gjykata nuk ka gjetur shkelje. Në fakt, në të gjitha ato raste, kërkesat e parashtruara janë refuzuar për njërin nga aspektet procedurale të pranueshmërisë (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI73/09, parashtrues *Mimoza Kusari-Lila,* Aktvendim i 19 shkurtit 2010; KI152/18, parashtrues *Shaqir Totaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018; KI157/17 parashtrues *Shaip Surdulli,* Aktvendim për Papranueshmëri i 15 majit 2018). Rasti i tanishëm është rasti i vetëm/i dyti deri më tani në të cilin Gjykata vlerëson meritat e kërkesës.

120. Megjithatë, Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së ka interpretuar nenin 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së si garanci për "*të drejtën aktive*

të votës" dhe "*të drejtën pasive të votës*". Në harmoni edhe me nenin 45 të Kushtetutës, e para nënkupton të drejtën për të zgjedhur, përkatësisht për të votuar, ndërsa e dyta të drejtën për t'u zgjedhur, përkatësisht për të kandiduar për pozitën e një përfaqësuesi të zgjedhur. Të dyja ngërthejnë në vetvete garanci substanciale dhe procedurale. Megjithatë, Gjykata vëren që të drejtat pasive janë pajisur me më pak mbrojtje nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së sesa të drejtat aktive (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Zdanoka kundër Latvisë*, nr. 58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006, paragrafët 105-106). Praktika e GJEDNJ-së, në raport me të drejtat pasive është fokusuar dukshëm vetëm në verifikimin e mungesës së arbitraritetit në procedurat vendëse që mund të kenë rezultuar në diskualifikimin e një personi fizik apo juridik për të kandiduar në zgjedhje (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Zdanoka kundër Latvisë* cituar më lart, paragrafi 115; *Melnitchenko kundër Ukrainës*, nr. 17707/02, Aktgjykim i 19 tetorit 2004, paragrafi 57).

121. Përtej të drejtave aktive dhe pasive të votës, sipas praktikës më të re të GJEDNJ-së, neni 3 i Protokollit nr. 1 përfshin edhe "*periudhën paszgjedhore*" apo "*të drejtat paszgjedhore*". Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka arsyetuar se esenca e zgjedhjeve të lira nënkupton një numër të drejtash zgjedhore që ngërthejnë standarde minimale e të cilat udhëheqin praktikat dhe institucionet e dizajnuara që të administrojnë votimin, numërimin dhe përcaktimin e rezultatit zgjedhor (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Davydov dhe të tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafët 284-285).

122. GJEDNJ-ja, ndër të tjera, ka shqyrtuar raste që përfshijnë ligjet që rregullojnë çështjet e regjistrimit të votuesve si parakusht për ushtrimin e lirë të të drejtave zgjedhore (*Partia Gjeorgjiane kundër Gjeorgjisë* nr. 9103/04, Aktgjykim i 8 korrikut 2008); detyrimin e shtetit për të organizuar zgjedhje të lira, përfshirë detyrimin e vendosjes së mekanizmave të cilët kanë kapacitetin të hetojnë pretendimet për parregullsi zgjedhore dhe për të përmirësuar dhe adresuar të njëjtat (*Namat Alijev kundër Azerbajxhanit,* nr. 18705/06, Aktgjykim i 8 prillit 2010); apo raste që ndërlidhen me nevojën për ekzistimin e një procesi gjyqësor përgjegjës për të shqyrtuar ankesat dhe kontestet zgjedhore. I njëjti përcaktoi se esenca e një të drejte zgjedhore mund të kufizohet, rrjedhimisht të cenohet, nëse nuk ka mjaftueshëm garanci për një sistem efektiv apelimi dhe të paanshëm (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Grosaru kundër Rumanisë,* cituar më lart).

(b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rastin konkret

123. Gjykata vëren kjo kërkesë ngre çështje të ndërlidhjes dhe ndërveprimit të të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore dhe përditësimit të listave të votuesve ndërmjet raundeve të votimit. Gjykata po ashtu vëren se pretendimet e ngritura në kërkesë janë shfaqur si rrjedhojë e kontesteve paszgjedhore, që në rastin konkret, kanë të bëjnë me numërimin e votave në raundin e dytë të votimeve që, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, janë përcaktuese për fituesin e zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Istogut.

124. Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, në rastin konkret, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve lidhur me të drejtat e garantuara me Kushtetutë si vijon i) sa i përket të së drejtës aktive të votimit, ii) sa i përket të së drejtës pasive të votimit, dhe, iii) sa i përket periudhës paszgjedhore apo të drejtave paszgjedhore.

Sa i përket të drejtës aktive të votuesve

125. Gjykata rikujton se neni 45 i Kushtetutës përcakton të drejtën e individit për të zgjedhë (e drejta aktive e votës), kjo e drejtë u takon vetëm individëve, gjegjësisht personave fizik, të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe i kanë mbushur 18 vjet, madje edhe në ditën e zgjedhjeve, dhe nëse kjo e drejtë nuk u është kufizuar me vendim gjyqësor.

126. Sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1, GJEDNJ-ja konsideron se përjashtimi i cilitdo grup apo kategori të popullatës së përgjithshme duhet të jetë në përputhje me qëllimet bazë të nenit 3 të Protokollit nr. 1 (shih: *mutatis mutandis, Aziz kundër Qipros,* nr. 69949/01, paragrafi 28, GJEDNJ 2004-V). Në veçanti, Gjykata gjeti se legjislacioni vendës me të cilin janë përcaktuar kushtet për moshën minimale apo kushtet për vendin e banimit për të realizuar të drejtën e votimit, në parim, është në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 (Shih, rastin *Hilbe kundër Lihtenshtajnit* (Vendim) 31981/96, GJEDNJ 1999-VI, shih, gjithashtu, rastin *Hirst*, i cituar në tekstin e mësipërm, paragrafi 62).

127. Në rastin konkret, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit nuk ka të bëj me mohimin e të drejtës së ndonjë individi për të votuar, gjegjësisht me kufizimin e të drejtës së votës me vendim të organit publik.

128. Gjykata rikujton se thelbi i ankesës së parashtruesve të kërkesës konsiston se mosnumërimi i votave të 52 (pesëdhjetedy) votuesve ka cenuar të drejtën aktive të 52 (pesëdhjetedy) votuesve që ka shkaktuar cenimin e të drejtës pasive të parashtruesit të parë të kërkesës (Gani Dreshaj), për t'u zgjedhur kryetar në Komunën e Istogut.

129. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nga dokumentacioni i parashtruar nga ana e organeve publike rezulton se bëhet fjalë për 108 (njëqindetetë) fletëvotime të refuzuara të personave që kanë votuar me kusht por që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesve të kërkesës duke pasur parasysh 108 (njëqindetetë) votuesit, votat e të cilëve janë refuzuar, dhe nuk do të kufizohet vetëm në 52 (pesëdhjetedy) votues.

130. Gjykata vlerëson se mosnumërimi i 108 (njëqindetetë) fletëvotimeve, në thelb, trajton çështjen e ndërvarësisë së të drejtës aktive të votuesve në fjalë me të drejtën pasive për t'u zgjedhur të pretenduar nga parashtruesit e kërkesës.

131. Për sa i përket pretendimit të lartpërmendur, Gjykata vëren se asnjëri prej atyre 108 (njëqindetetë) votuesve nuk është ankuar në PZAP përkitazi me administrimin dhe numërimin e votave në QNR, sipas procedurës së paraparë me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës nuk mbështetën me dëshmi pretendimet e tyre, ata nuk i ofruan Gjykatës dëshmi se ndonjëri nga votuesit e kontestuar ka nisur procedura para organeve përkatëse në lidhje me kufizimin e të drejtës së tyre aktive të votës.

132. Po ashtu, për sa i përket të njëjtit pretendim, Gjykata vëren se nga përgjigjet e pranuara nga Komisioni i Venecias, në pjesën dërrmuese të rasteve, e drejta pasive e parashtruesve të kërkesës për t'u zgjedhur nuk shkon aq larg sa kandidatit t'i jepet e drejta për t'u zgjedhur nga një grup i caktuar votuesish (Shih përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese të Austrisë, Bullgarisë dhe Letonisë).

133. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata vëren se vendimet e kontestuara të organeve publike në rastin konkret, janë të bazuara në dispozitat përkatëse të ligjit zgjedhor. Ky ligj është zbatuar si duhet në rrethanat e rastit të konkret. Kushtetutshmëria e kornizës ligjore nuk shqyrtohet para Gjykatës dhe as nuk është ngritur ne kuptimin e te drejtës aktive te votës.

134. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se e drejta pasive e parashtruesve të kërkesës nuk është në lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtën aktive të një grupi të caktuar votuesish e te cilët nuk kane kontestuar procedurat që kane rezultuar me anulimin e 108 (njëqindetetë) votave te tyre para organeve kompetente publike.

135. Duke marrë parasysh të gjitha që u thanë, Gjykata konkludon se në rastin konkret garancitë kushtetuese në lidhje me të drejtën aktive zgjedhore të parapara me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk janë të aplikueshme në kontekstin e pretendimeve që kanë ngritur parashtruesit e kërkesës, ngase lënda e kontestit nuk është mohimi i të drejtës së ndonjë individi për të votuar, gjegjësisht kufizimi i të drejtës për të votuar me vendim të organit publik.

Sa i përket të drejtës pasive të votuesve

136. Gjykata rikujton se "*e drejta pasive e votuesit*" sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nënkupton të drejtën për të qenë i zgjedhur, gjegjësisht për t'u kandiduar për pozitën e përfaqësuesit të zgjedhur. Kjo e drejtë nuk nënkupton të drejtën e ndonjë kandidati për të qenë i zgjedhur, kjo e drejtë nënkupton garancitë përmbajtësore dhe procedurale. Megjithatë, Gjykata vëren se të drejtat pasive janë më pak të mbrojtura përmes praktikës gjyqësore (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Zdanoka kundër Letonisë*, nr. 58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006, paragrafët 105-106).

137. Gjykata vëren se e drejta pasive e votuesve, u takon kandidatëve si individë, gjegjësisht personave fizik të cilët kandidojnë në zgjedhjet e nivelit lokal dhe qendror, si dhe subjekteve politike, gjegjësisht personave juridik të cilët janë në garë në zgjedhjet e nivelit lokal ose qendror.

138. Praktika e GJEDNJ-së në raport me të drejtat pasive është dukshëm e fokusuar vetëm në verifikimin e mungesës së arbitraritetit në procedurat vendore që mund të kenë rezultuar me diskualifikimin e personit fizik dhe juridik që të kandidohet në zgjedhje (Shih, rastin e lartpërmendur *Zdanoka kundër Letonisë*, paragrafi 115; *Melnitchenko kundër Ukrainës*, nr. 17707/02, Aktgjykim i 19 tetorit 2004, paragrafi 57).

139. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë asnjë vendim të organit publik me të cilin ka ardhur deri tek diskualifikimi i ndonjë personi fizik apo juridik për t'u kandiduar në zgjedhje.

140. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se në rastin konkret garancitë kushtetuese në lidhje me të drejtën pasive zgjedhore të parapara me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk janë të aplikueshme sepse objekt i kontestit nuk është diskualifikimi i ndonjë personi fizik apo juridik për t'u kandiduar në zgjedhje.

Sa i përket periudhës paszgjedhore apo të të drejtave paszgjedhore

141. Për qëllimet e këtij testi, Gjykata do të përdorë Kodeksin e Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore (Doracaku dhe Raporti Shpjegues) (CDL-AD (2002) 23 rev), të miratuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisioni i Venecias") në seancën e tij 51 dhe 52 (5-6 korrik dhe 18 dhe 19 tetor 2002) (në tekstin e mëtejmë: Kodi i Praktikës së Mirë).

142. Gjykata përsërit se Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias i kushton vëmendje të konsiderueshme procesit të numërimit, bartjes dhe tabelimit të rezultateve, duke insistuar që ky proces duhet të jetë transparent dhe i hapur, si dhe që vëzhguesit dhe përfaqësuesit e kandidatëve duhet të lejohen të jenë të pranishëm dhe të sigurojnë kopje të procesverbalit (Shih, seksionin I.3.2 të Kodit). Në të njëjtin kuptim, Raporti Shpjegues i Kodit përmban disa rekomandime shtesë të cilat lidhen me procesin e numërimit, evidentimit të rezultateve dhe bartjen e tyre në organin më të lartë (Shih, Arsyetimin, seksionet I.3.2.2.4. (Numërimi) dhe I.3.2.2.5 (Bartja e rezultateve)). Raporti propozon që vëzhguesit, mediet dhe të tjerët që janë të autorizuar për të qenë të pranishëm në vendvotimin kanë të drejtën të jenë të pranishëm gjatë numërimit dhe që duhet të ekzistojnë "kopje të mjaftueshme të procesverbalit për procedurën në mënyrë që të sigurohet se të gjithë personat e lartpërmendur e kanë marrë nga një kopje". Për më tepër bartja e rezultateve - "operacion vital rëndësia e të cilit shpesh anashkalohet" - gjithashtu duhet të zbatohet në mënyrë të hapur dhe të kontrolluar, ku personi i cili i bartë rezultatet, zakonisht kryesuesi i vendvotimit, duhet të jetë i shoqëruar nga anëtarët e tjerë të vendvotimit të cilët i përfaqësojnë partitë opozitare, e nëse është e nevojshme, me siguri të shtuar.

143. Këto rekomandime të detajuara pasqyrojnë rëndësinë e detajeve teknike, të cilat mund të jenë vendimtare për të siguruar një procedurë të hapur dhe transparente të vërtetimit të vullnetit të votuesve përmes numërimit të fletëvotimeve dhe evidentimit të saktë të rezultateve zgjedhore në të gjithë sistemin, nga votimi lokal deri në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ato konfirmojnë se në sytë e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, fazat pas votimit të cilat kanë të bëjnë me numërimin, evidentimin dhe bartjen e rezultateve zgjedhore përbëjnë një pjesë të domosdoshme të procesit zgjedhor. Si të tilla, ato duhet të jenë të shoqëruara me garancitë e qarta procedurale, të jenë të hapura dhe transparente dhe të lejojnë vëzhgimin nga ana e anëtarëve në të gjithë spektrin politik, duke përfshirë edhe opozitën,

në mënyrë që të sigurohet realizimi i parimit të lirisë së votuesve për të shprehur vullnetin e tyre dhe nevoja për luftimin e mashtrimit zgjedhor.

144. Është e saktë se neni 3 i Protokollit nr. 3 të Konventës nuk është konceptuar si kod për çështjet zgjedhore që synojnë rregullimin e të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor (Shih, Partia Komuniste e Rusisë dhe të tjerët kundër Rusisë, nr. 29400/05, paragrafi 108, 19 korrik 2012). Megjithatë, Gjykata tashmë ka konfirmuar se parimet e përbashkëta të trashëgimisë kushtetuese evropiane, të cilat e përbëjnë bazën e çdo shoqërie vërtet demokratike, përfshijnë të drejtën e votës në kuptim të mundësisë për të votuar në mënyrë universale, të barabartë, pa pagesë në zgjedhjet e fshehta dhe të drejtpërdrejta të cilat mbahen në intervale të rregullta (Shih, Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore). Neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës shprehimisht parashikon të drejtën për zgjedhje të lira në intervale të rregullta me votim të fshehtë dhe parimet e tjera gjithashtu janë njohur në praktikën gjyqësore të institucioneve të Konventës (Shih, Partia Konservatore Ruse e Ndërmarrësve dhe të tjerët, 70). Në këtë mjedis, zgjedhjet e lira duhet të kuptohen edhe si e drejtë individuale edhe si detyrim pozitiv i shtetit, i cili përbëhet nga një numër i caktuar garancish, duke filluar nga e drejta e votuesve për të formuar lirisht opinionin, i cili shtrihet në rregullimin e kujdesshëm të procesit në të cilin vërtetohen, përpunohen dhe evidentohen rezultatet e votimit.

145. Njëkohësisht, Gjykata përsërit se niveli i kontrollit vetanak do të varet nga aspekti i caktuar i të drejtës për zgjedhje të lira. Prandaj, mbikëqyrja më e rreptë duhet të rezervohet për çdo devijim nga parimi i të drejtës universale të votës (Shih, Hirst (nr. 2), cituar më lart, paragrafi 62). Shteteve në të cilat masat i pengojnë kandidatët për t'u kandiduar në zgjedhje mund t'u afrohet një liri më e gjerë e vlerësimit, por një ndërhyrje e tillë nuk duhet të jetë joproporcionale (Shih, Krasnov dhe Skuratov kundër Rusisë, nr. 17864/04 dhe 21396/04, f. 65, 19 korrik 2007, dhe Partia Konservatore Ruse e Ndërmarrësve dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafi 65).

146. Një kontroll edhe më pak i rreptë do të aplikohej në fazën teknike të numërimit dhe tabelimit. Duhet të merret parasysh fakti se ky është një proces i ndërlikuar, me shumë persona të përfshirë në disa nivele. Vetë gabimi ose parregullsia në këtë fazë vetvetiu do të nënkuptonte parregullsinë e zgjedhjeve, nëse respektohen parimet e përgjithshme të barazisë, transparencës, paanësisë dhe pavarësisë së administratës zgjedhore. Koncepti i zgjedhjeve të lira do të ishte i ekspozuar ndaj rrezikut vetëm nëse do të kishte dëshmi për shkeljet procedurale të cilat mund të pengonin shprehjen e lirë të opinionit të popullit, për

shembull, nëpërmjet minimit të madh të qëllimit të votuesve; dhe ku ankesat e tilla nuk janë pranuar në mënyrë efikase në nivelin vendor. Për më tepër, Gjykata do të duhej të jetë e kujdesshme në dhënien e statusit të pakufizuar për kontestimin e kësaj faze të zgjedhjeve për pjesëmarrësit e caktuar në procesin zgjedhor. Kjo është veçanërisht rasti kur legjislacioni i brendshëm përmban kufizime të arsyeshme për aftësinë e votuesve të caktuar për të kontestuar rezultatet në njësitë e tyre zgjedhore, siç është kërkesa për kuorumin e votuesve (Shih, seksionin II.3.3 (f) të Kodit të Praktikës së Mirë). Megjithatë, shtetet duhet të sigurojnë një qasje të tillë në sistemin e ankimit, e cila to të ishte e mjaftueshme që garancitë sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të jenë efektive gjatë gjithë ciklit zgjedhor. Në kontekstin rus, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 22 prillit 2013, konfirmoi se votuesit e caktuar mund të kontestojnë rezultatet në njësitë zgjedhore në të cilat kanë votuar; ndryshimet e mëvonshme ligjore e kanë siguruar një status të tillë.

147. Prandaj, Gjykata konfirmon se vetëm parregullsitë serioze në procesin e numërimit dhe tabelimit të votave të cilat kanë mbetur pa shqyrtim efikas në nivelin vendor mund të përbëjnë shkelje të së drejtës individuale për zgjedhje të lira të garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës, si në aspektin aktiv, ashtu edhe në aspektin pasiv. Në pajtim me rolin e saj subsidiar, detyra e Gjykatës është e kufizuar në atë që të sigurohet se shqyrtimi në nivelin vendor (legjislacioni i brendshëm i një vendi) ofron garanci minimale procedurale dhe se gjetjet e autoriteteve vendore (gjykatave të rregullta) nuk janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (Shih, Partia Komuniste e Rusisë dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafët 116-17). Gjykata do të vazhdojë të analizojë ankesat e parashtruesve të kërkesës në pajtim me këtë (*Davydov kundër Rusisë,* paragrafët 283-288).

148. Gjykata, gjithashtu, përsërit se testi i GJEDNJ-së në rastin konkret, zbatohet në sfondin e kontestit paszgjedhor (të drejtave paszgjedhore) që ndërlidhet me numërimin e votave në raundin e dytë të votimit dhe përditësimin e listave zgjedhore. Gjykata ripërsërit se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në thelb, duhet të trajtohen kundrejt sfondit paszgjedhor dhe paralel me testin e lartpërmendur i cili është zhvilluar në praktikën gjyqësore e GJEDNJ-së.

149. Në këtë kuptim, Gjykata do të përdorë testin e GJEDNJ-së për të vërtetuar: (i) nëse legjislacioni zgjedhor ofron garanci minimale procedurale dhe ii) nëse vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme.

(i) Nëse legjislacioni zgjedhor ofron garanci minimale procedurale

150. Gjykata thekson se në këtë rast, korniza ligjore e cila rregullon të drejtën zgjedhore në Republikën e Kosovës nuk është objekt i shqyrtimit nga Gjykata, pra, nëse kjo kornizë është në pajtim ose jo me Kushtetutën, por nëse korniza ligjore e legjislacionit zgjedhor ofron garanci minimale procedurale. Objekt i shqyrtimit janë vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme dhe nëse këto vendime mund të përballojnë testin e GJEDNJ-së, siç rezulton nga jurisprudenca e zhvilluar në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së të cekur në paragrafin paraprak.

151. Sa i përket garancive minimale procedurale të legjislacionit zgjedhor, Gjykata vëren se sipas ligjeve zgjedhore në fuqi ekziston mundësia e ankesës ndaj çdo vendimi të KQZ-së në PZAP. Më tej, është parashikuar dyshkallshmëria, respektivisht mundësia që pala e pakënaqur të ankohet në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të marra nga PZAP-i.

152. Gjithashtu, mund të parashtrohet ankesë ndaj çdo vendimi të Qendrës së Numërimit dhe Regjistrimit brenda afatit prej njëzetekatër (24) orësh nga ndodhja e shkeljes së pretenduar.

153. Për më tepër, sipas legjislacionit zgjedhor të zbatueshëm, para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-a mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim ose qendër të numërimit ose përsëritjen e votimit një qendër votimi ose në një komunë.

154. Më tej, Gjykata vëren se PZAP dhe Gjykata Supreme kanë mundësinë që në pajtim me legjislacionin në fuqi t'i anulojnë zgjedhjet në një ose në më shumë njësi zgjedhore nëse konsiderojnë se ekzistojnë parregullsi serioze zgjedhore.

155. Gjykata vëren se PZAP, pikërisht duke shfrytëzuar kompetencën e lartpërmendur për shkak të parregullsive të fletëvotimeve të pranuara përmes postës, kishte anuluar rezultatin e raundit të dytë të zgjedhjeve të 19 nëntorit 2017 dhe urdhëroi KQZ-në që ta përsërisë votimin për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Istogut. Çka është tregues se PZAP-i është treguar posaçërisht i vëmendshëm për të siguruar korrektësi objektive të zgjedhjeve me qëllim të shmangies së shkeljeve serioze të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar në Komunën e Istogut.

156. Nga sa më sipër, Gjykata konkludon e legjislacioni zgjedhor parashikon mundësinë e vendimmarrjes shumëshkallëshe sipas ankesave të organeve publike të pavarura dhe se ankesat janë efektive, si dhe që legjislacioni zgjedhor u ofron garanci të mjaftueshme procedurale palëve të pakënaqura për të kontestuar vendimet të cilat nuk janë në pajtim me legjislacionin zgjedhor.

ii) Nëse vendimet e PZAP-it dhe Gjykatës Supreme janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme

157. Për qëllime të testit të GJEDNJ-së, Gjykata sërish vë në spikamë arsyetimin e PZAP-it përkitazi me pretendimin për mosnumërimin e 52 (pesëdhjetedy) votave të votuesve, që në thelb thekson: "*Lidhur me pretendimet e apeluesit se janë 50 fletëvotime që nuk janë numëruar sepse votuesit kanë arritur moshën madhore për të votuar mes datave 20.10.2017 dhe 17.12.2017, e cilat vota nuk janë numëruar, këto pretendime janë vlerësuar nga paneli si të pabazuar sepse Ekstrakti i Regjistrit Qendror Civil ka përmbajtur të gjithë emrat e votuesve të regjistruar të moshës 18 vjeçare, duke përfshirë edhe ata që kanë mbushur 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017 [...] KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon tri 3 herë ekstraktin e regjistrit civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit të listës së votuesve, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit të LV-së. Të cilën listë votuesit kanë pasur mundësi që të kundërshtojnë gjatë periudhave të shqyrtimit të saj (listën e votuesve), nga ana e publikut dhe atë prej datës 29 gusht 2017 deri me datën 12 shtator 2017. Meqenëse lista e votuesve është certifikuar pasi ka kaluar afati i kundërshtimit, deri më datë 12.09.2017, dhe e njëjta listë e certifikuar është e vlefshme për një proces zgjedhor sepse certifikohet vetëm njëherë në një palë zgjedhje pavarësisht se sa zgjat periudha kohore e procesit zgjedhor, mbi këtë bazë votuesit që e kanë arritur moshën madhore gjatë periudhës kohore 22.10.2017 dhe 17.12.2017, nuk kanë mundur të jenë pjesë e listës së certifikuar të votuesve*".

158. Gjykata rikujton se PZAP-i e mori këtë vendim pas një shpjegimi të hollësishëm të KQZ-së në lidhje me pranimin dhe refuzimin e votave me kusht "*... është vërtetuar nga numri i përgjithshëm 481, i votave me kusht dhe votave VNPV, që i plotësojnë kriteret ligjore si fletëvotime të rregullta për numërim dhe procedim të mëtejmë janë 309 vota, ndërsa 172 vota janë refuzuar. Arsyeja pse janë refuzuar 172 fletëvotime ... është se të njëjtat nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore, ngase 108 fletëvotime të refuzuara kanë të bëjnë se personat*

të cilët kanë votuar por që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV); 61 fletëvotime të refuzuara janë sepse personat që kanë votuar nuk kanë qenë votues respektivisht qytetar të Komunës së Istogut ku është mbajtur procesi zgjedhor; 2 fletëvotime janë refuzuar sepse votuesit që kanë votuar nuk kanë qenë të regjistruar si votues me nevoja të veçanta dhe 1 fletëvotim është refuzuar sepse votuesi përveç që ka votuar me kusht është vërtetuar se i njëjti ka votuar edhe si votues në vendvotimin e tij të rregullt".

159. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte miratuar në tërësi arsyetimin e dhënë nga PZAP-i, prandaj, testi i GJEDNJ-së është i barasvlershëm për të dyja trupat gjykuese.

160. Gjykata vëren se KQZ-a ka certifikuar listën e votuesve bazuar në rregullin 3.3 të Rregullës Zgjedhore nr. 02/2013 të KQZ-së dhe se më vonë ka arsyetuar në detaje për ç'arsye votat e caktuara, 309 (treqindenëntë) sosh, janë pranuar si të rregullta, si dhe për ç'arsye 172 (njëqindeshtatëdhjetedy) vota janë refuzuar si të parregullta.

161. Gjykata vëren se një arsyetim i tillë i KQZ-së është mbështetur nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme, duke arsyetuar hollësisht bazuar në të cilat norma juridike kanë vepruar gjatë marrjes së vendimeve të kontestuara.

162. Prandaj, Gjykata konstaton se vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme janë në pajtim dhe të përcaktuara me ligj, të arsyetuara dhe se të njëjtat nuk janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme. Është çështje tjetër nëse dispozita e lartcekur ligjore është në pajtim me Kushtetutën ose jo. Për këtë çështje, Gjykata që në fillim deklaroi se korniza ligjore e cila rregullon të drejtën zgjedhore në Republikën e Kosovës nuk është objekt i shqyrtimit në këtë rast.

163. Për sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për përditësim të listave të votuesve, Gjykata vëren se vendimet e kontestuara të KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme me janë nxjerrë duke u mbështetur në nenin 6 të Rregullores nr. 10/2013 të KQZ-së përkitazi me listat e votuesve, që përcakton: "*Lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave*".

164. Gjykata rikujton se neni 3 i Rregullës Zgjedhore për Krijimin, Konfirmimin dhe Kundërshtimin e Listës së Votuesve, nr. 02/2013, specifikon: *"3.3 Me qëllim të krijimit të listës së votuesve, KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon tri (3) herë ekstraktin e regjistrit civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë*

pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të Listës së Votuesve, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy (2) ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së".

165. Gjithashtu, neni 10.4 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nr. 03/L-073, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, parashikon: "*10.4 Ankesa lidhur me përjashtim të padrejtë nga Lista e Votuesve, e rregullt apo përmes postës, duhet të pranohet nga gjykata e shkallës së parë brenda dyzet (40) ditëve para ditës së zgjedhjeve".*

166. Përdorimi i listës së njëjtë të votuesve nga KQZ-ja edhe për raundin e dytë të procesit zgjedhor, që më vonë u vërtetua si e ligjshme me vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme nuk përbën ndryshim të papritur dhe të paparashikuar të praktikës zgjedhore ose të bazës ligjore çka mund të ndikonte në shtrembërim flagrant të procesit zgjedhor. Për parashtruesin e kërkesës, sikurse për të gjithë pjesëmarrësit në garën zgjedhore, mospërditësimi i listës së votuesve për raundin e dytë të votimeve ka qenë fakt i njohur qysh nga fillimi i procesit zgjedhor duke pasur parasysh kushtin e përcaktuar nga neni 6 i Rregullores nr. 10 përkitazi me listat e votuesve (shih anasjelltas, *Paschalidis, Koutmeridis dhe Zaharakis v. Greqisë*). Veç kësaj, përdorimi i listës së njëjtë të votuesve nga KQZ-ja ka qenë i vlefshëm për të gjitha Komunat ku është mbajtur raundi i dytë i votimit dhe jo vetëm për zgjedhjet komunale në Istog.

167. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se vendimet e kontestuara, për sa i përket përditësimit të listave të votuesve, të PZAP-it dhe Gjykatës Supreme janë në përputhje me ligjin e përcaktuar, të arsyetuara dhe se të njëjtat nuk janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme.

168. Përkitazi me natyrën e shkeljeve që mund të çojnë në shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë kishte përcaktuar: *"Shpallja e zgjedhjeve të pavlefshme mund të kushtëzohet vetëm nga shkeljet posaçërisht serioze kurdo që Gjykata Kushtetuese konstaton se procesi zgjedhor ka qenë i papajtueshëm me parimet bazike demokratike e kushtetuese që janë relevante për të drejtën e votimit dhe janë flagrante dhe të shpeshta deri në atë masë sa që në tërësi e zhvleftësojnë procesin dhe rezultatin zgjedhor…Gjykata Kushtetuese konsideron se shkeljet e tilla mund të jenë si rrjedhojë e dështimit për t'i hapur vendvotimet; pengesat ndaj votuesve për të pasur qasje ndaj vendvotimeve; zëvendësimit të fletëvotimeve dhe listave të votuesve mu në ditën e zgjedhjeve për ta cenuar procesin e votimit; trysnia e fortë e ushtruar ndaj votuesve për t'i shkurajuar ata për të dalë në vendvotime ose për t'i detyruar ata që ta votojnë*

kandidaturën që nuk është zgjedhje e tyre" (shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Bullgarisë, Vendim nr. 5 i 9 qershorit 2013 në rastin kushtetues nr. 13/2013).

169. Nga sa më sipër, Gjykata përfundon se vendimet e kontestuara të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme janë në përputhshmëri me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

170. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme për të ndaluar: *"zbatimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për certifikimin e rezultatit të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës së Istogut të 27 dhjetorit 2017 deri në vendosje meritore të kësaj çështje nga Gjykata Kushtetuese"*.

171. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kërkojnë caktimin e masës së përkohshme sepse *"... është në interesin e përgjithshëm që të caktohet masa e përkohshme deri në marrjen e vendimit meritor për këtë çështje për arsye se, çdo shkelje e të drejtave kushtetuese gjatë procesit të votimit dhe/ose gjatë administrimit të numërimit në QNR padyshim ndikon në shtrembërimin e rezultatit prandaj rezultati aktual nuk e reflekton vullnetin e qytetarëve të Komunës së Istogut"*.

172. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parasheh:

> *1."Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik"*.

173. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 57 (4) të Rregullores së punës, që specifikon:

> *"Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:*
>
> > *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është*

vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të paripërueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik".

174. Duke marrë parasysh se parashtruesve të kërkesës nuk u janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, në kombinim me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata po ashtu refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 dhe 2 të Kushtetutës, me nenet 27, 47, 48 dhe 49 të Ligjit dhe rregullat 56 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, njëzëri më 23 janar 2019

VENDOS

I. TË DEKLAROJË njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË njëzëri se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (AA.-U ZH. nr. 64/2017) i 26 dhjetorit 2017 dhe Vendimi i PZAP-it (ZL. A. nr. 1142/2017) janë në përputhshmëri me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së;

III. TË REFUZOJË njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

V. TË PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VI. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Arta Rama-Hajrizi

KI87/18, Parashtruesi i kërkesës: Kompania e Sigurimeve „IF Skadeforsikring“, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018, i cili i është dorëzuar më 7 mars 2018

KI87/18, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, publikuar 15 prill 2019

Fjalët kyç: kërkesë individuale, aktgjykim, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

Parashtruesi pretendoi se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së janë shkelur për shkak të mungesës së arsyetimit të Aktgjykimit, përkatësisht se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat përkitazi me ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 191/2015, lidhur me kamatëvonesën, prandaj ai konsideron se me këtë është shkelur parimi i së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar, si dhe parimi i sigurisë juridike sepse gjykata nuk ka pasur një praktikë konsistente gjyqësore, dhe për këtë ai dorëzoi në Gjykatë disa vendime të Gjykatës Supreme.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, konkludoi se Gjykata Supreme në aktgjykimet krahasuese, të cilat korrespondojnë plotësisht me gjendjen juridike dhe faktike të aktgjykimit në fjalë, kishte nxjerrë aktgjykime me arsyetime juridike të cilat dallojnë nga aktgjykimi i kontestuar, dhe atë si për çështjen e llogaritjes së normës së interesit dhe llogaritjes së afateve kohore, ashtu edhe për çështjen e zbatueshmërisë së ligjit.
Për më tepër, Gjykata vërejti se Gjykata Supreme as në aktgjykimet krahasuese nuk mori një qëndrim konsistent lidhur me llogaritjen e normave të kamatës, ku në ato raste kishte dhënë edhe arsyetime të ndryshme juridike. Si të tilla, ato shpien në konkludimin se praktika e Gjykatës Supreme për këtë çështje nuk është konsistente, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në sigurinë juridike.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjeti se Gjykata Supreme si gjykatë e instancës së fundit për të vendosur në rastin konkret të parashtruesit të kërkesës, duke marrë një qëndrim të ndryshëm në Aktgjykimin e kontestuar në një rast i cili është plotësisht identik ose i ngjashëm me rastet e tjera, pa dhënë një arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm për këtë, ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, që çoi edhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike si një nga komponentët themelor të sundimit të ligjit, i cili gjithashtu është një element i pandashëm i së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI87/18

Parashtrues

„IF Skadeforsikring“

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kompania e Sigurimeve „IF Skadeforsikring“ (në tekstin e mëtejmë: „IF Skadeforsikring“), nga Norvegjia (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqësojnë Visar Morina nga Prishtina dhe avokati Besnik Z. Nikqi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018, i cili i është dorëzuar më 7 mars 2018.

3. **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 qershor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).

9. Më 27 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 27 shkurt 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë shkeljen.

11. Gjykata në përbërje të plotë, me shumicë votash, e aprovoi kërkesën si të pranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 26 korrik 2009, ka ndodhur një aksident i trafikut në të cilin ishin të përfshira dy automjete të pasagjerëve, dhe me atë rast automjeti i markës Mercedes me tabela të regjistrimit të Kosovës dhe me sigurimin e automjeteve të Kompanisë së Sigurimeve SIGMA (në tekstin e mëtejmë: SIGMA) i shkaktoi dëm automjetit të pasagjerëve të markës Audi me tabela të regjistrimit të Norvegjisë dhe me sigurimin e automjeteve CASCO të „IF Skadeforsikring".

13. Më 19 tetor 2010, parashtruesi i dërgoi një kërkesë kompanisë SIGMA, me të cilën kërkoi pagesën e dëmit mbi bazën e regresit, i cili është shkaktuar si rezultat i aksidentit të trafikut, por SIGMA nuk u përgjigj në këtë kërkesë.

14. Më 9 korrik 2012, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër kompanisë SIGMA, në të cilën kërkoi që në emër të dëmit të shkaktuar t'i paguhet shuma prej 23,609.24 €, me kamatëvonesën prej 12 %, dhe atë prej datës 19 tetor 2010.

15. Më 23 nëntor 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin I. C. nr. 281/2012, me të cilin e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit në tërësi. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

> *„Me nenin 939 paragrafi 1 të LMD-së është përcaktuar se me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi çfarëdo baze është përgjegjës për dëmin, ndërsa me nenin 3 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia është përcaktuar se siguruesi është përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave të tretë, nga përdorimi i automjetit të siguruar mbi bazën e autopërgjegjësisë.*
>
> *Nga dispozitat ligjore të lartcekura rrjedh se paditësi si sigurues i automjetit të aksidentuar mbi bazën e sigurimit auto kasko, ka qenë i detyruar ta kompensoj dëmin e shkaktuar mbi automjetin e siguruar, gjë të cilën edhe e ka bërë, dhe njëkohësisht gëzon të drejtën që të regresoj shumën e paguar nga i padituri si sigurues i automjetit "Audi A6", mbi bazën e sigurimit nga autopërgjegjësia për dëmet e shkaktuara personave të tretë.*
>
> *Gjykata e miratoj kërkesëpadinë edhe përkitazi me kamatën e kërkuar të vonesës, në shkallën prej 12 % në vit, duke vendosur*

kështu në përputhje me nenin 26.6 të Ligjit për sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia."

16. SIGMA paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit për kamatën, vendimit për shpenzimet e procedurës dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

17. Më 31 tetor 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ae. nr. 191/2015, me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e kompanisë SIGMA. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

„Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 939 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: LSD), për shkak se nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar ka qenë i siguruari i të padituës, paditësja ia ka paguar të siguruarit të saj kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar te paditësja.

Për gjykatën e shkallës së dytë nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të së padituës sa i përket lartësisë së kamatës dhe kohëzgjatjes së llogaritjes së saj ngase kamata llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë e që në rastin konkret drejtë është vlerësuar llogaritja e kamatës duke u bazuar nga neni 26 par. 6 i LSD-së.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së padituës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar ligjin material, ndërsa pretendimet e të padituës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës".

18. SIGMA paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, lartësisë së shumës monetare, si dhe për shkak të lartësisë së kamatës dhe periudhës kohore të llogaritjes së saj.

19. Parashtruesi iu përgjigj gjithashtu kërkesës për revizion, duke pretenduar "*se revizioni nuk lejohet sipas nenit 214. 2 të Ligjit 04/L-118 (për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-006 për*

procedurën kontestimore), me arsyetimin se revizioni tërësisht i referohet vetëm vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, respektivisht se pretendimet e të paditurës nga revizioni nuk trajtojnë ndonjë shkelje të dispozitave të LPK-së apo aplikimit të gabuar të së drejtës materiale".

20. Më 24 janar 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin E. Rev. nr. 27/2017, me të cilin:

> *„I. Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nr. 191/2015 datë 31.10.2017, në pjesën e cila ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që në emër të regresit nga baza e sigurimit kasko, paditësit t'ia paguaj shumën prej 23.609,24 €, në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit.*
>
> *II. Pranohet revizioni i të paditurës, ndryshohet aktgjykimi i goditur përkitazi me kamatën, ashtu që obligohet e paditura që paditësit shumën prej 23.609,24 €, t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga paraqitja e padisë më 19.11.2010, e deri në pagesën definitive".*

21. Gjykata Supreme në paragrafin e parë të dispozitivit, i cili ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për revizion e të paditurës, theksoi:

> *„Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Në aktgjykimet e tyre ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit".*

22. Gjykata Supreme në paragrafin e dytë të dispozitivit, i cili ka të bëjë me miratimin e revizionit të të paditurës dhe ndryshimin e Aktgjykimit, theksoi:

> *„Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit shumën prej 23.609,24 €, e paditura duhet t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga data 19.11.2010, e deri në pagesën*

definitive, kjo ngase Ligji për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia ka hyrë në fuqi në vitin 2011 ndërsa rasti ka ndodhur në vitin 2009 dhe si i tillë nuk gjen zbatim për rastin konkret".

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin E. Rev. nr. 27/2017 është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së janë shkelur për shkak të mungesës së arsyetimit të Aktgjykimit, përkatësisht se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat përkitazi me ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 191/2015, lidhur me kamatëvonesën, dhe ai konsideron se me këtë është shkelur parimi i së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.

25. Parashtruesi i kërkesës në veçanti thekson se nuk është e qartë se „*cila është baza juridike mbi të cilën Gjykata Supreme konstaton:*

- se Gjykatat e instancave më të ulëta kanë gabuar në zbatimin e të drejtës materiale dhe arsyetimi përkatës lidhur me këtë, si dhe
- cila është dispozita ligjore që kjo Gjykatë e konsideron meritore për gjykimin e kësaj çështje".

26. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se "*aktgjykimi i Gjykatës Supreme të cilin e konteston është në kundërshtim edhe me praktiken e saj gjyqësore të atëhershme, pasi referuar praktikës së saj gjyqësore në situata të njëjta rezulton se Gjykata Supreme pa rezervë i referohet dhe zbaton rregullativën respektive "lex specialis" nga kjo lëmi (BQK Rregulli Nr. 3 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë dhe Ligji 04/L-018 për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia) me rastin e trajtimit të institutit të kamatëvonesës.*" Me këtë, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, atij i shkelet edhe e drejta për siguri juridike.

27. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa aktgjykime të Gjykatës Supreme për të dëshmuar se Gjykata Supreme nuk e kishte ndjekur praktikën e saj gjyqësore. Aktgjykimet e dorëzuara të Gjykatës Supreme janë: "*[E. Rev. nr. 23/2017 të 23 dhjetorit 2017], [E. Rev. nr. 48/2014 të 13 majit 2014], [E. Rev. nr. 62/2014 të 21 janarit 2015], [E. Rev. nr. 14/2016 të 24*

marsit 2016], [E. Rev. nr. 06/2015 të 19 marsit 2015], [E. Rev. nr. 55/2014 të 3 nëntorit 2014], [E. Rev. nr. 20/2014 të 14 prillit 2014]".

28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 27/2017, për shkak të shkeljes së nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe ta kthej çështjen në rishqyrtim.

Ligji relevant

LIGJI nr. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA, i 29 korrikut 2011

Neni 26
Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

„[...]

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

"*4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*"

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

31. Fillimisht, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të cilat vlejnë për individët dhe për personat juridik (rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës: *AAB-RIINVEST University L.L.C.,* Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

32. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi që është palë e autorizuar e cila e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

33. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
Saktësimi i kërkesës

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
Afatet

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar

vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht... .”

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, të cilat pretendohet se janë shkelur, si dhe aktin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh të paraparë në nenin 49 të Ligjit.

35. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 (2) të Rregullores së punës:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij“.

36. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë ngre një pretendim kushtetues të arsyetuar *prima facie* dhe nuk është qartazi e pabazuar, në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës. Prandaj kërkesa duhet të deklarohet e pranueshme për shqyrtim të meritave të rastit.

Meritat e kërkesës

37. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme shkelet e drejta e tij për një vendim të arsyetuar, gjë që në vetvete çon edhe në shkeljen e së drejtës për siguri juridike. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, këto shkelje kanë ndodhur, sepse Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat lidhur me ndryshimin e qëndrimit përkitazi me llogaritjen e kamatëvonesës, qëndrimin të cilën deri atëherë e kishte zbatuar në mënyrë konsistente në praktikën e saj.

38. Parashtruesi i kërkesës në veçanti thekson faktin se Gjykata Supreme, në rastet e mëparshme identike të caktimit të lartësisë së kamatës, kishte ndjekur një praktikë të ndryshme gjyqësore, e cila ishte arsyetuar mbi bazën e ndryshme juridike. Lidhur me këtë,

parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë disa aktgjykime të Gjykatës Supreme.

39. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës mbetet i pasqaruar dhe i paarsyetuar fakti se mbi cilën bazë juridike Gjykata Supreme e ka mbështetur vendimin e saj për ndryshimin e kamatëvonesës së gjykuar nga gjykatat e instancës më të ulët.

40. Parashtruesi më tej pretendon se në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme mungon arsyetimi përkatës për qasjen e re të cilën ajo e mori në këtë rast, përkitazi me institutin e kamatëvonesës në raportet juridike të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, pasi që në praktikën e saj të deritanishme Gjykata Supreme kishte vendosur tërësisht ndryshe në rastet e njëjta.

41. Në dritën e këtyre sqarimeve, Gjykata në rastin konkret shqyrton meritat e kërkesës përkitazi me pretendimet lidhur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*

43. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, i cili përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."*

44. Gjykata thekson se në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (në pjesën që ka të bëj me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor), Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

45. Gjykata, para së gjithash, rikujton se garancitë e përmbajtura në nenin 6 paragrafin 1 të KEDNJ-së përfshijnë detyrën e gjykatave që të bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre. Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *H. kundër Belgjikës,* kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987).

46. Gjykata, gjithashtu, thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81.).

47. Lidhur me këtë, GJEDNJ shton se gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e pretendimeve dhe në lejimin e provave, por ajo gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsyetime për vendimet e saj (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa 37801/97, të 1 korrikut 2003, paragrafi 36).

48. Gjithashtu, Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61).

49. Gjykata dëshiron të theksojë se nocioni i një gjykimi të drejtë, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët. Kjo kërkesë është edhe më e rëndësishme në rast kur një palë në kontest nuk ka pasur mundësi për të paraqitur gojarisht rastin e saj në procedurën vendore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Helle kundër Finlandës,* kërkesa 157/1996/776/977, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60).

50. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur shqyrtohet prova e propozuar, nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI 96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017).

Zbatimi i parimeve të përmendura mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar në këtë rast

51. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në paragrafin e parë të dispozitivit të Aktgjykimit të saj, E. Rev. nr.27/2017, e refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, dhe për këtë dha një arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm.

52. Megjithatë, Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me të njëjtin Aktgjykim, në paragrafin e dytë të dispozitivit të Aktgjykimit, Gjykata Supreme pranoi revizionin e të paditurës dhe i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët, lidhur ekskluzivisht me mënyrën e caktimit të kamatës e cila tashmë ishte gjykuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Parashtruesi thekson se Gjykata Supreme nuk ka ofruar arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm për një vendim të tillë, që ka të bëj me mënyrën e caktimit të kamatës.

53. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston ekskluzivisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, lidhur me arsyetimin e pikës 2 të dispozitivit të Aktgjykimit E. Rev. nr.27/2017, e të cilin parashtruesi e ndërlidh me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, përkatësisht me të drejtën për një aktgjykim të arsyetuar.

54. Prandaj, duke pasur parasysh pretendimin kryesor ankimor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se duhet të analizohet nëse Gjykata Supreme kishte dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat e ka mbështetur vendimin e saj për ndryshimin e aktgjykimit të gjykatave të shkallës më të ulët, lidhur me lartësinë e kamatës në rastin e parashtruesit.

55. Gjykata përsërit se Gjykata Supreme pranoi pjesërisht revizionin e të padituës dhe nxori Aktgjykimin E. Rev. nr.27/2017, ku në pikën 2 të dispozitivit, thuhet:

> *"II. Pranohet revizioni i të padituës, ndryshohet aktgjykimi i goditur përkitazi me kamatën, ashtu që obligohet e paditura që paditësit shumën prej 23.609,24 €, t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga paraqitja e padisë më 19.11.2010, e deri në pagesën definitive."*

56. Gjykata më tej vëren se, sa i përket arsyetimit për pranimin e revizionit në lidhje me çështjen e kamatës dhe ndryshimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, Gjykata Supreme në arsyetimin e saj theksoi:

> *„Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit shumën prej 23.609,24 €, e paditura duhet t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga data 19.11.2010, e deri në pagesën definitive, kjo ngase Ligji për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia ka hyrë në fuqi në vitin 2011 ndërsa rasti ka ndodhur në vitin 2009 dhe si i tillë nuk gjen zbatim për rastin konkret".*

57. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin E. Rev. nr. 27/2017, gjeti se *„gjatë caktimit të lartësisë së kamatës,*

gjykatat e instancës më të ulët kanë marrë aktgjykime të cilat ishin të bazuara në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale...".

58. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në arsyetimin e saj nuk ka paraqitur se cila e drejtë materiale është zbatuar nga gjykatat e shkallës më të ulët dhe se si zbatimi i një të drejte të tillë, gjatë caktimit të kamatës, ka ndikuar në shkeljen e të drejtës materiale.

59. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në arsyetimin e saj nuk kishte specifikuar as se cili ligj, ose nen i tij, është zbatuar gabimisht nga gjykatat e rregullta të shkallës më të ulët.

60. Më tej, Gjykata vëren se si arsye për ndryshimin e vendimit në lidhje me caktimin e kamatës, Gjykata Supreme në arsyetimin e saj kishte paraqitur vetëm faktin se rasti ka ndodhur në vitin 2009, ndërsa Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ka hyrë në fuqi në vitin 2011, gjë që sipas qëndrimit të Gjykatës Supreme shpie në përfundimin se ai, si i tillë, nuk gjen zbatim në rastin konkret.

61. Lidhur me këtë, Gjykata nuk i konsideron kontestuese qëndrimet e Gjykatës Supreme lidhur me interpretimin e saj se cili ligj do të zbatohet në rastin konkret, sepse kjo është në juridiksionin e asaj gjykate. Megjithatë, ajo që Gjykata Supreme nuk ka arritur të shpjegoj është pikërisht raporti midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të ligjit në të cilin ajo është thirrur, gjegjësisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra-tjetrën dhe se si kanë ndikuar ato në vendimin e Gjykatës Supreme që t'i ndryshojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me mënyrën e caktimit të kamatës.

62. Përkitazi me një qëndrim të tillë të Gjykatës Supreme, Gjykata përsërit se GJEDNJ në Aktgjykimin *Hadjianastassiou kundër Greqisë,* në paragrafin 33, mori qëndrimin se gjykata kombëtare duhet *„të shpjegojë në mënyrë mjaft të qartë mbi cilat baza juridike e bazon vendimin e saj",* përkatësisht se pala ka të drejtë të njihet me arsyet e vendimit gjyqësor.

63. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh qëndrimin e mëparshëm të GJEDNJ-së, Gjykata e ka të paqartë mbi cilën dispozitë ligjore konkretisht Gjykata Supreme e mbështeti arsyetimin e saj për ndryshimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, lidhur me mënyrën e caktimit të kamatës. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme nuk ka paraqitur argumente dhe nuk e ka shtjelluar mjaftueshëm qëndrimin e ndryshuar juridik të gjykatave të shkallës më të ulët (shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61).

Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për sigurinë juridike siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

64. Gjykata, duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar, duke vendosur për një çështje të njëjtë faktike dhe juridike si në rastin konkret, kishte nxjerrë një vendim krejtësisht të ndryshëm në krahasim me praktikën e saj të mëparshme, gjen se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ngre edhe çështjen e respektimit të garancive të vendosura me të drejtën për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane, përkitazi me segmentin e sigurisë juridike.

65. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i shqyrtojë edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mospërputhjen e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, e cila, sipas mendimit të tij, ndikon në sigurinë juridike.

66. GJEDNJ rikujton se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë vendore, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventën Evropiane (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], numër 30544/96, paragrafi 28, ECHR 1999-I). Po ashtu, nuk është funksioni i saj as t'i krahasojë, përveç në rastet e arbitraritetit të dukshëm, vendimet e ndryshme të gjykatave kombëtare, madje edhe nëse ato janë nxjerrë në procedurat që janë dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e këtyre gjykatave duhet të respektohet (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, numër 3669/03, paragrafi 118, të 24 qershorit 2008).

67. Mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial. Një shmangie e tillë mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet e kundërt me Konventën (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Santos Pinto kundër Portugalisë*, numër 39005/04, paragrafi 41, të 20 majit 2008, dhe *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, numër 21911/03, paragrafi 29, të 24 marsit 2009).

68. Megjithatë, GJEDNJ në praktikën e saj ka vendosur kritere të cilat ajo i përdor për të vlerësuar nëse vendimet kundërthënëse (devijimet nga praktika) të gjykatave vendore, duke gjykuar në instancën e fundit, shkelin kërkesën për gjykim të drejtë të parashikuar me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane, e ato kritere janë: ***i)*** *përcaktimi*

nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, ***ii)*** *nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie*, ***iii)*** *nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe, nëse po, deri në çfarë mase* (shih aktgjykimet e GJEDNJ-së *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, numër 23530/02, par. 49-50, të 2 korrikut 2009; *Beian kundër Rumanisë* (numër 1), numër 30658/05, par. 34-40, ECHR 2007-V (ekstraktet); *Ştefan dhe Ştef kundër Rumanisë,* nr. 24428/03 dhe 26977/03, par. 33-36, të 27 janarit 2009; *Schwarzkopf dhe Taussik kundër Republikës Çeke* (vendim), numër 42162/02, të 2 dhjetorit 2008; *Tudor Tudor*, i cituar në tekstin e mësipërm, paragrafi 31; dhe *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë,* numër 38155/02, paragrafi 36, të 2 nëntorit 2010).

Zbatimi i parimeve të përmendura të sigurisë juridike në këtë rast

69. Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme, në rastet e mëparshme, të njëjta ose identike, me pothuajse të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, ka nxjerr aktgjykime krejtësisht të ndryshme, të cilat ai si shembuj i dorëzoi në Gjykatë në kërkesën e tij. Parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve specifike të Gjykatës Supreme, të cilat ai përmes kërkesës i paraqiti në Gjykatë si shembuj:

> *"[E. Rev. 23/2017 të 14 dhjetorit 2017], [E. Rev. 14/2016 të 24 marsit 2016], [E. Rev. nr. 62/2014 të 21 janarit 2015], [E. Rev. nr. 48/2014 të 27 tetorit 2014], [E. Rev. nr. 55/2014 të 10 majit 2014], dhe [E. Rev. nr. 20/2014 të 14 prillit 2014]".*

70. Lidhur me këtë, kjo Gjykatë, në dritën e parimeve të mësipërme, duhet të shqyrtojë nëse ka pasur shkelje të parimit të sigurisë juridike si një segment i së drejtës për një gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata do të përpiqet që përmes analizës krahasuese të aktgjykimeve të dorëzuara të Gjykatës Supreme të përcaktojë: *nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit; nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie; dhe nëse ky mekanizëm është zbatuar, dhe nëse po, në çfarë mase.*

i) përcaktimi nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit

71. Në fillim, Gjykata dëshiron të theksojë se ajo ka kryer një analizë të të gjitha aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të cilat janë dorëzuar nga

parashtruesi në Gjykatë. Gjykata vërejti faktin se në të gjitha rastet e përmendura, të gjitha aksidentet e trafikut kanë ndodhur në të njëjtën periudhë kohore kur ndodhi edhe aksidenti i trafikut në rastin konkret, që është viti 2009. Gjithashtu, në të gjitha rastet krahasuese, paditësit në vitin 2010 ua kanë dorëzuar palëve të paditura dhe gjykatave kërkesat për pagesën e kompensimit dhe paditë për dëmin e shkaktuar.

72. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, pavarësisht nga këto fakte, nxori aktgjykime me arsyetime të ndryshme juridike, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e lartësisë së kamatës së caktuar.

Analiza krahasuese e aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 48/2014, i 27 tetorit 2014

73. Gjykata vëren se në Aktgjykimin E. Rev. nr. 48/2014, të 27 tetorit 2014, Gjykata Supreme mori qëndrimin sipas të cilit:

> *"e detyroi të paditurën, Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, që paditëses t'ia rimbursoj – paguan regresin në shumë prej 87.000 €, me kamatë vjetore prej 20%, duke filluar nga data 19.11.2010 deri më 28.07.2011 dhe 12% duke filluar nga data 29.07.2011 e deri në pagesën definitive si dhe të i kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 963 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit".*

74. Gjykata Supreme e arsyetoi këtë qëndrim të saj në këtë mënyrë:

> *"Kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar edhe të drejtën materiale kur paditëses i kanë pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 20% vjetore duke filluar nga data 19.11.2010 e deri më datën 28.7.2011 dhe kamatën prej 12% duke filluar nga data 29.7.2011 e deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD si dhe nenit 26.6 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L–018 me të cilën dispozitë është paraparë se në rastin e mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe mos përmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4 i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë me vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke e ngarkuar me pagesë të*

interesit për vonesë, ky interes paguhet në lartësinë prej 12% të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme E. Rev. 23/2017, i 14 dhjetorit 2017

75. Gjykata më tej vëren se Gjykata Supreme e përdori të njëjtën praktikë edhe në Aktgjykimin E. Rev. 23/2017, të 14 dhjetorit 2017, në të cilin konkludoi:

"[...] sa i përket lartësisë së kamatës, ndryshohet aktgjykimi i goditur i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 53/2016 të datës 21.09.2017 dhe detyrohet e paditura që në shumën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ia paguaj paditësit kamatën në lartësi prej 20% duke filluar nga data 22.04.2010 si ditë e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të dëmit e deri më 29.07.2011, ndërsa nga data 30.07.2011 e deri në pagesën definitive kamatës në lartësi prej 12% në shumën e gjykuar".

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 62/2014, i 21 janarit 2015

76. Gjykata gjeti se Gjykata Supreme në Aktgjykimin E. Rev. nr. 62/2014, të 21 janarit 2015, mori një qëndrim të ndryshëm juridik për çështjen e lartësisë së kamatës e cila ishte caktuar nga Gjykata Themelore në lartësi prej 3.5%. Qëndrimin e saj, Gjykata Supreme e arsyetoi në këtë mënyrë:

"Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur të paditurës ia ka pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 12% duke ia llogaritur nga data 14.6.2010 deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD e lidhur me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L–018, parashihet kamata në lartësi prej 12% në vit e cila llogaritet për çdo ditë vonese deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi, duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Nga shkresat e lëndës del se paditësja të paditurës ia ka paraqitur kërkesën për rimbursim të dëmit nga data 14.06.2010".

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018

77. Gjykata gjithashtu rikujton edhe arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin Rev. nr. 27/2017, i cili kontestohet nga parashtruesi, në të cilin Gjykata Supreme përkitazi me çështjen e pranimit të revizionit lidhur me kamatën prej 12%, konkludoi:

> *"[...] obligohet e paditura që paditësit shumën prej 23.609,24 €, t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga paraqitja e padisë më 19.11.2010, e deri në pagesën definitive".*

78. Në bazë të kësaj rezulton se Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin në të cilin e ndryshoi kamatën prej 12%, e cila ishte caktuar me aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, duke e zëvendësuar me lartësinë e kamatës të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë.

79. Gjykata gjithashtu rikujton arsyetimin të cilin Gjykata Supreme e ofroi për këtë qasje të saj „të re":

> *„Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit shumën prej 23.609,24 €, e paditura duhet t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga data 19.11.2010, e deri në pagesën definitive, kjo ngase Ligji për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia ka hyrë në fuqi në vitin 2011 ndërsa rasti ka ndodhur në vitin 2009 dhe si i tillë nuk gjen zbatim për rastin konkret".*

80. Gjykata, në bazë të analizës së aktgjykimeve të përmendura të Gjykatës Supreme, gjen se ekzistojnë dallime të dukshme në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, të cilat kanë vendosur për çështjen e lartësisë së kamatës e cila duhet t'u caktohet paditësve. Gjithashtu, Gjykata nuk mund të mos vërejë se në të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Supreme ekzistojnë shmangiet dhe mospërputhjet në praktikën gjyqësore shumëvjeçare.

ii) nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie dhe iii) nëse ky mekanizëm është zbatuar, dhe nëse po, në çfarë mase

81. Sa i përket këtyre kritereve, Gjykata i referohet Ligjit për Gjykatat, nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin në juridiksionin e të cilit gjendet edhe çështja e përshtatjes dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore.

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]
2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika;...".

82. Nga kjo rezulton se mekanizmi i harmonizimit të praktikës gjyqësore është parashikuar me vetë dispozitën ligjore. Për më tepër, funksionimi i vetë mekanizmit të harmonizimit të praktikës nuk është i pamundësuar, apo i kufizuar me asgjë, gjë që do të zvogëlonte drejtpërdrejt zbatimin dhe efikasitetin e tij në vetë praktikën.

Përfundim

83. Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, konkludon se Gjykata Supreme në aktgjykimet krahasuese, të cilat korrespondojnë plotësisht me gjendjen juridike dhe faktike të aktgjykimit në fjalë, kishte nxjerrë aktgjykime me arsyetime juridike të cilat dallojnë nga aktgjykimi i kontestuar.

84. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos të theksojë në veçanti se Gjykata Supreme as në aktgjykimet krahasuese nuk mori një qëndrim konsistent lidhur me llogaritjen e normave të kamatës, ku në ato raste kishte dhënë edhe arsyetime të ndryshme juridike. Si të tilla, ato shpien në konkludimin se praktika e Gjykatës Supreme për këtë çështje nuk është konsistente, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në sigurinë juridike.

85. Gjykata Kushtetuese ka parasysh se gjykatat e rregullta, gjatë ndërtimit të praktikës gjyqësore, mund të marrin vendime të ndryshme, gjë që pasqyron zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Megjithatë, shmangiet nga konsistenca e praktikës gjyqësore duhet të kenë justifikime dhe shpjegime objektive dhe të arsyeshme, të cilat, në rastin konkret në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme mungojnë.

86. Gjykata Kushtetuese, në veçanti, thekson faktin se në rastin konkret vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është vendim përfundimtar kundër të cilit nuk ka mjete të tjera efektive juridike në dispozicion sipas ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, si gjykata më e lartë në hierarkinë gjyqësore, kishte një përgjegjësi të veçantë për të arsyetuar vendimin me të cilin do t'i shpjegonte të gjitha arsyet e shmangies nga praktika e deritanishme gjyqësore.

87. Duke pasur parasysh atë që u tha më sipër, Gjykata konkludon se mekanizmat ekzistues të unifikimit të praktikës gjyqësore në rastin konkret nuk kanë qenë efektiv.

88. Si përfundim, Gjykata Kushtetuese konsideron se Gjykata Supreme si gjykatë e instancës së fundit për të vendosur në rastin konkret të parashtruesit, duke marrë një qëndrim të ndryshëm në Aktgjykimin e kontestuar në një rast i cili është plotësisht identik ose i ngjashëm me rastet e tjera, pa dhënë një arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm për këtë, ka shkelur të drejtën e parashtruesit për një vendim të arsyetuar gjyqësor. Kjo çoi edhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike, si një nga komponentët themelor të sundimit të ligjit, i cili gjithashtu është një element i pandashëm i së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.

89. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 shkurt 2019, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018;

IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI31/18, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

KI 31/18, parashtruese: Komuna e Pejës

Aktgjykim i datës 12 prill 2019

Fjalët kyçe: *e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, arsyetim i vendimit gjyqësor, vendim për masë të përkohshme*

Kërkesa KI31/18 u parashtrua nga Komuna e Pejës. Kjo e fundit kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme – i cili kishte konfirmuar vendimet e gjykatave të rregullta në bazë të të cilave parashtruesja e kërkesës u detyrua t'i paguaj kompanisë private DPZ Gashi Towing Service shumën e të hollave në vlerë prej 392,515.00 EUR, në emër të dëmit kontraktues, si dhe shpenzimet procedurale.

Së bashku me kërkesën e saj kryesore, parashtruesja kishte paraqitur edhe kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme, në mënyrë që të parandalohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave të rregullta, përmes së cilave ajo ishte detyruar të paguaj shumën e lartcekur të të hollave. Gjykata Kushtetuese, më 27 shkurt 2019, kishte shqyrtuar ndaras kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme dhe, përmes një Vendimi për masë të përkohshme të publikuar më 4 mars 2019, kishte miratuar të njëjtën duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në Ligj dhe Rregullore të punës. Gjykata Kushtetuese kishte miratuar masën e përkohshme, deri më 30 prill 2019, *"pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxjerrë përkitazi me meritat e kërkesës"*.

Para skadimit të masës së përkohshme, përkatësisht më 12 prill 2019, Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi kërkesën e parashtrueses në tërësi dhe konsideroi që e njëjta ngre çështje të natyrës kushtetuese, vendosja e të cilave kërkon shqyrtimin e meritave të kërkesës. Pas shqyrtimit të meritave të kërkesës, Gjykata gjeti se në rastin konkret nuk kishte pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së dhe se parashtruesja e kërkesës kishte përfituar nga garancitë kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese trajtoi gjerësisht pretendimet kryesore të parashtrueses së kërkesës, se gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht nga gjykatat e rregullta dhe se Gjykata Supreme ka dështuar të ofrojë një vendim të

arsyetuar, duke mos u përgjigjur në disa argumente të saj të paraqitura në kërkesën për revizion.

Për sa i takon pretendimeve konkrete të parashtrueses së kërkesës, përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike, si dhe zbatimin e ligjit material dhe procedural, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Supreme (sikundër edhe gjykatat e shkallëve më të ulëta), i kishte kushtuar vëmendje të duhur standardeve gjegjëse dhe aspekteve të nevojshme të vërtetimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti se kishte arbitraritet në mënyrën sesi Gjykata Supreme kishte interpretuar ligjin material dhe procedural, të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.
Në këtë aspekt, Gjykata iu referua qëndrimit të saj të përgjithshëm se, parimisht, vërtetimi i saktë dhe i drejtë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse ligjore, bien në kompetencë të gjykatave të rregullta. Argumentet për shkelje kushtetuese janë të qëndrueshme vetëm nëse vërtetohet se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ – që nuk u konstatua në rastin konkret.

Për sa i takon pretendimit të parashtrueses së kërkesës përkitazi me mos arsyetim të vendimit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Supreme nuk ia kishte shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës për një vendim të arsyetuar – komponentë kjo qenësore e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Duke u thirrur në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit theksoi se, përkundër faktit që Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në çdo pikë të ngritur nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata Supreme me vendimin e saj ka adresuar argumentet dhe pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës dhe rrjedhimisht kishte përmbushur obligimin për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor.

Duke qenë se me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese u konstatua kushtetutshmëria e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme dhe rrjedhimisht e të gjitha vendimeve të tjera të ndërlidhur me të, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me praktikën e saj të përgjithshme, e shfuqizoi masën e përkohshme të vendosur paraprakisht.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI31/18

Parashtruese

Komuna e Pejës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, E. Rev. nr. 20/2017, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 20 nëntorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Komuna e Pejës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Virtyt Ibrahimaga, avokat në Prishtinë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017, përmes së cilit ishte refuzuar revizioni i saj si i pabazuar dhe ishin konfirmuar grupi i tretë i vendimeve të gjykatave të rregullta.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesja e kërkesës po ashtu ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme në mënyrë që të parandalohet ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Ek. nr. 587/2017, i 15 qershorit 2017, dhe aktgjykimeve të instancave më të larta të ndërlidhura me të.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 27 [Masat e Përkohshme], 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 5 mars 2018, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 6 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gresa Caka-Nimani.

9. Më 8 mars 2018, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë një autorizim që dëshmon se është i autorizuar që të dorëzojë këtë kërkesë në Gjykatë.

10. Më 19 mars 2018, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dorëzoi autorizimin e kërkuar në Gjykatë.

11. Më 21 mars 2018, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës edhe Policisë së Kosovës dhe DPZ Gashi Towing Service, në cilësinë e palëve të interesuara, duke i ftuar që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, jo më vonë se më 30 mars 2018.

12. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga Policia e Kosovës apo nga Gjykata Supreme. Ndërkaq, sa i përket DPZ Gashi Towing Service, Gjykata pranoi një flet-kthesë nga Posta e Kosovës me njoftimin që nuk kanë arritur të lokalizojnë adresën e DPZ Gashi Towing Service.

13. Më 30 mars 2018, Gjykata i dërgoi një njoftim të dytë DPZ Gashi Towing Service, në adresë të përmirësuar, si dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e saj, në rast se ka, jo më vonë se më 12 prill 2018.

14. Më 6 prill 2018, DPZ Gashi Towing Service dorëzoi komentet e saj.

15. Më 27 prill 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për komentet e pranuara nga DPZ Gashi Towing Service, si dhe i dërgoi një kopje të komenteve të pranuara.

16. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

17. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

18. Më 13 gusht 2018, DPZ Gashi Towing Service, me vetë iniciativë, dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

19. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu si gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Snezhana Botusharova.

20. Më 2 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).

21. Më 20 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë një kopje të të gjithë dosjes që ndërlidhet me rastin e parashtrueses së kërkesës.

22. Më 5 dhjetor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë kopjen e dosjes së kërkuar.

23. Më 31 dhjetor 2018, Gjykata kërkoi informata shtesë nga parashtruesja e kërkesës lidhur me atë se në cilën fazë ndodhet procedura e përmbarimit e cila ishte iniciuar nga DPZ Gashi Towing Service.

24. Më 9 janar 2019, parashtruesja e kërkesës e njoftoi Gjykatën se çështja gjyqësore në mes të saj dhe DPZ Gashi Towing Service gjendet akoma në procedurë përmbarimore dhe se Urdhri P. Nr. 197/17 i Përmbaruesit Privat, i datës 6 shtator 2017, *"ka mbetur akoma i pa ekzekutuar"*. Lidhur me këto procedura, parashtruesja e kërkesës dorëzoi dokumentacion shtesë në Gjykatë.

25. Më 14 shkurt 2019, parashtruesja e kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë si dhe kërkoi *"trajtim urgjent të propozimit për caktimin e masës së përkohshme",* duke qenë se Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës përmes së cilës kontestohej Urdhri i lartcekur i Përmbaruesit Privat e që rrjedhimisht e bënte këtë të fundit të zbatueshëm.

26. Më 19 shkurt 2019, DPZ Gashi Towing Service dorëzoi një shkresë në Gjykatë përmes së cilës e njoftoj Gjykatën se është refuzuar ankesa e parashtrueses së kërkesës, përmes së cilës kontestohej Urdhri i lartcekur i Përmbaruesit Privat, duke theksuar se një gjë e tillë vërteton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës janë të pabazuara.

27. Më 22 shkurt 2019, Gjykata, përmes adresës elektronike, ia konfirmoi parashtrueses së kërkesës dhe DPZ Gashi Towing Service, pranimin e njoftimeve të tyre lidhur me procedurën përmbaruese për rastin KI31/18, si dhe i njoftoi që kërkesa e tyre është në shqyrtim e sipër nga Gjykata. Po ashtu, Gjykata, duke theksuar që ajo nuk është njoftuar se a është ekzekutuar tashmë Urdhri i plotfuqishëm i Përmbaruesit Privat, kërkoi nga të dyja palët që të njoftojnë Gjykatën për ndonjë zhvillim të ri lidhur me rastin.

28. Më 25 shkurt 2019, Gjykata pranoi informata shtesë nga parashtruesja e kërkesës përmes së cilave u njoftua se Urdhri i lartcekur i Përmbaruesit Privat akoma nuk është ekzekutuar dhe se i njëjti pritet të ekzekutohet në fillim të muajit mars 2019.

29. Më 27 shkurt 2019, gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e Masës së përkohshme. Në të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi ta miratojë Masën e përkohshme, deri më 30 prill 2019, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që Gjykata do të nxjerrë përkitazi me meritat e kërkesës.

30. Më 27 shkurt 2019, Gjykata pranoi një shkresë tjetër të dorëzuar nga DPZ Gashi Towing Service e cila ishte dorëzuar në postë më 25 shkurt 2019.

31. Më 8 prill 2019, Gjykata pranoi edhe një shkresë tjetër të dorëzuar nga DPZ Gashi Towing Service, si përgjigje ndaj Vendimit të lartcekur të kësaj Gjykate për miratimin e masës së përkohshme.

32. Më 12 prill 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri votoi që të shpallë kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita.

33. Në të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi që të shpallë kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita dhe të deklarojë se nuk ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

34. Më 15 shtator 2005, parashtruesja e kërkesës, përkatësisht Komuna e Pejës, kishte hyrë në një marrëveshje kontraktuale trepalëshe me Shërbimin Policor të Kosovës, tashmë Policia e Kosovës dhe kompaninë private, DPZ Gashi Towing Service. Kontrata trepalëshe ishte kontratë për kryerje të shërbimeve (në tekstin e mëtejmë: Kontrata) dhe si e tillë përcaktonte obligimet, të drejtat dhe shpërblimet përkatëse për të tria palët. Objekti i kontratës trepalëshe ishte kryerja e shërbimeve nga DPZ Gashi Towing Service për rimorkim, përkatësisht tërheqje të automjeteve të parkuara në mënyrë jashtëligjore apo të aksidentuara dhe vendosjen e tyre në bazën e caktuar të parkingut. Kontrata përcaktonte që ky shërbim do të kërkohej nga Policia e Kosovës, në rastet kur ndodhte ndonjë aksident në trafik, apo kur për arsye të tjera ishte e nevojshme që të bëhej rimorkimi i automjeteve.

35. Më 18 shtator 2007, parashtruesja e kërkesës përmes Vendimit Nr. 400-8807/07, e vazhdoi kontratën trepalëshe nga data 15 shator 2007 deri *"në shpalljen e tenderit dhe zgjedhjes së përfituesit ma të volitshëm."*

36. Më 19 tetor 2009, parashtruesja e kërkesës përmes Vendimit Nr. 466-6964/2009, e vazhdoi kontratën trepalëshe edhe tre muaj. Në Vendim thuhej se kjo kontratë do të vazhdohet *"për tre muaj - deri në përfundim të zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjen e përfituesit me Tender për kryerjen e këtyre shërbimeve* [sipas Kontratës fillestare]."

37. Më 19 maj 2010, DPZ Gashi Towing Service iu ishte drejtuar parashtrueses së kërkesës me një letër, Nr. II-9-3658/2010, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar që të bëhet shpallja e ankandit publik për shitjen e automjeteve që janë konfiskuar nga Policia e Kosovës, e të cilat po mbaheshin në parkingun e DPZ Gashi Towing Service. Në letrën në fjalë thuhej: *"Siç jeni të informuar edhe më herët me shkresa të njëjta për kërkesat e kompanisë "Gashi" edhe një herë ju kërkoj nga ana e juaj që me këtë problematikë të merreni më seriozisht dhe të zgjidhet çështja e veturave të konfiskuara nga ana e Policisë dhe të dërguara në kompaninë tonë. Sipas Kontratës veturat që merren nga ana e Policisë pas 90 ditësh, për ato vetura jeni të obliguar ti vendosni në ankand publik. Në kompaninë tonë kemi një numër të madh të veturave që janë marrë për kundërvajtje, dhe qëndrojnë më shumë se 90 ditë në parkingun e kompanisë tonë dhe askush nuk është duke e trajtuar këtë problem për këto vetura."* Së bashku me këtë letër, DPZ Towing Service i dërgoi parashtrueses së kërkesës edhe një listë me vetura ku shihej data e konfiskimit të tyre dhe kostoja e mbajtjes së tyre në parkingun e DPZ Gashi Towing Service, pas kalimit të afatit 90 ditësh.

38. Më 25 maj 2010, parashtruesja e kërkesës iu përgjigj kërkesës së përsëritur të DPZ Gashi Towing Service dhe i rekomandoi me sa vijon: *"Pas analizimit të rikërkesës së juaj lidhur me çështjen që keni ngritur, Komuna e Pejës* [parashtruesja e kërkesës] *respektivisht Drejtori i Administratës ju Rekomandon që të procedoni në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2009 të Policisë së Kosovës neni 8 (Tjetërsimi) dhe në bazë të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, respektivisht nenit 35 (Heqja dorë nga pronësia) që pronari në mënyrë të qarte duhet të shprehet se heqë dorë nga pronësia e tij në atë send, me (vendim gjyqësor)."*

39. Më 1 korrik 2010, si pasojë e mospajtimeve lidhur me zbatimin e Kontratës, DPZ Gashi Towing Service parashtroi padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë [tashmë Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike] (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore në Prishtinë), kundër parashtrueses së kërkesës dhe Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë kur Gjykata iu referohet bashkërisht: të padituri).

40. Nëpërmjet kësaj padie, DPZ Gashi Towing Service kërkoi që palët e paditura të detyrohen të paguajnë dëmin prej 663,450.00 EUR, plus kamatën dhe shpenzime procedurale, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga Kontrata. Në padi theksohej se në parkingun e DPZ Gashi Towing Service vazhdojnë të qëndrojnë automjete të konfiskuara të cilat ia pamundësojnë zhvillimin e afarizmit normal dhe se sipas nenit 4 të Kontratës të padituri kanë qenë të obliguar që të kompensojnë DPZ Gashi Towing Service.

41. Në lidhje me padinë e parashtruar nga DPZ Gashi Towing Service, gjykatat e rregullta morën gjithsej tetë vendime. U morën tri vendime nga gjykata e shkallës së parë; një vendim për korrigjim të një vendimi të shkallës së parë; dy vendime në nivel apeli, si dhe dy vendime nga Gjykata Supreme në bazë të revizionit të parashtruar. Në Gjykatën Kushtetuese po kontestohet vendimi i fundit i grupit të tretë të vendimeve i marrë nga Gjykata Supreme, përkatësisht Aktgjykimi E. Rev. nr. 20/2017, i 20 nëntorit 2017. Hollësitë e secilit grup të vendimeve, për aq sa janë relevante për kërkesën në fjalë, do të paraqiten në vijim.

Grupi i parë i vendimeve të gjykatave të rregullta që vendosën lidhur me padinë e DPZ Gashi Towing Service

42. Më 4 prill 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë përmes Aktgjykimit, II. C. nr. 265/2010, e aprovoi pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e DPZ Gashi Towing Service.

43. Kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, të padituratë paraqitën ankesat e tyre dhe kërkuan që Aktgjykimi i shkallës së parë të prishet, ose lënda të kthehet në rigjykim. DPZ Gashi Towing Service paraqiti përgjigje në ankesat e të padituravе, me propozimin që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara dhe Aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

44. Më 26 qershor 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin e saj, Ae. nr. 167/2016, përmes së cilit i pranoi si të bazuara ankesat e të padituravе dhe e ktheu lëndën në rigjykim pranë Gjykatës Ekonomike e Qarkut

në Prishtinë (tashmë, me ndryshimet përkatëse ligjore, Gjykata Themelore në Prishtinë).

Grupi i dytë i vendimeve të gjykatave të rregullta që vendosën lidhur me kërkesëpadinë e DPZ Gashi Towing Service

45. Më 11 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit, C. nr. 420/2014, sërish e aprovoi si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e DPZ Gashi Towing Service.

46. Kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, të paditurat paraqitën ankesat e tyre dhe kërkuan që Aktgjykimi i shkallës së parë të prishet ose lënda të kthehet në rigjykim. DPZ Gashi Towing Service paraqiti përgjigje në ankesat e të paditurave me propozimin që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara dhe Aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

47. Më 8 korrik 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit, Ae. nr. 54/2016, i refuzoi ankesat e të paditurave si të pabazuara dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 420/2014] e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

48. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të paditurat paraqitën kërkesat e tyre për revizion para Gjykatës Supreme. E paditura e parë, përkatësisht Komuna e Pejës e paraqiti kërkesën e saj për revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe tejkalimit të kërkesëpadisë, me propozimin që vendimet e gjykatave më të ulëta të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim. E paditura e dytë, përkatësisht Policia e Kosovës, e paraqiti kërkesën e saj për revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të ndryshohet vendimi i shkallës së parë ashtu që kërkesëpadia kundër së padituës së dytë të refuzohet si e pabazuar.

49. DPZ Gashi Towing Service paraqiti përgjigje në kërkesat për revizion të të paditurave, me kërkesën që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara dhe vendimet e gjykatave më të ulëta të vërtetohen.

50. Më 7 dhjetor 2016, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit, Rev. E. nr. 35/2016, pranoi revizionet e të paditurave dhe prishi Aktgjykimin [Ae. nr. 54/2016] e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 420/2014] në Prishtinë dhe ia ktheu çështjen në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht Gjykatës Themelore në Prishtinë.

51. Gjykata Supreme konsideroi se revizionet e parashtruara nga të paditurat ishin të themelta me arsyetimin se aktgjykimet e instancave më të ulëta *"janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë [Ae. nr. 54/2016] me shkelje të nenit 194 lidhur me nenin 214.a pika b) të LPK dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale e që për pasojë, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e tyre, prandaj, për këtë shkak të dy aktgjykimet u dashtë të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim."*

Grupi i tretë i vendimeve të gjykatave të rregullta që vendosën lidhur me kërkesëpadinë e DPT Towing Group [vendimet e kontestuara]

52. Më 15 qershor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit të saj të tretë për të njëjtën çështje, Ek. nr. 587/2016, e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të DPZ Gashi Towing Service ku nga kërkesëpadia fillestare prej 663,450.00 EUR, tashmë DPZ Gashi Towing Service kërkonte 392,515.00 EUR. Gjykata Themelore në Prishtinë i detyroi të paditurat që, në mënyrë solidare, t'ia paguajnë DPZ Gashi Towing Service shumën prej 392,515.00 EUR në emër të dëmit kontraktues që rrjedh nga Kontrata, së bashku me kamatën ligjore dhe shpenzimet procedurale.

53. Gjykata Themelore e arsyetoi Aktgjykimin e saj me sa vijon:

> *"Aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë së palës paditëse gjykata paraprakisht e ka bazuar në kontratën e nënshkruar nga palët ndërgjyqëse të datës 15.09.2005, në vazhdimin e kontratave të datave 15.07.2007 dhe 19.10.2009 si dhe në ekspertizën hartuar nga eksperti financiar të datës 22.06.2015, andaj pasi ka analizuar këto prova ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse duke u bazuar në dispozitat e nenit 142 të LMD-së* [Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve], *e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se kushtet e përgjithshme të caktuara nga ana e një kontraktuesi qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale qofshin ato të invokuara nga kontrata plotësojnë ujdi të veçanta të përcaktuara midis kontraktuesve në të njëjtën kontratë dhe si rregull i obligojnë sikundër edhe kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të shpallën sipas mënyrës së zakonshme. Kushtet e përgjithshme e obligojnë palën kontraktuese në qoftë se kanë qenë të njohura për të ose është dashur ti njihte në çastin e lidhjes së kontratës.*

Kërkesën e palës paditëse [DPZ Gashi Towing Service] *të precizuar dhe të aprovuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi gjykata e ka bazuar kryesisht në fjalën përfundimtare të palës paditëse, i cili ka kërkuar shumën e përgjithshme prej 392,515.00 EUR (...) në emër të kompensimit vetëm për ditët për të cilat automjetet janë qëndruar dhe janë duke qëndruar në parkingun e paditësit, për të cilat nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga palët ndërgjyqëse e deri më sot nuk janë paguar paratë, e kjo është vërtetuar përmes mendimit dhe konstatimit të ekspertit financiar në ekspertizën e tij të hartuar me shkrim. [...]*

Duke iu referuar dispozitave të nenit 4 të Kontratës së datës 15.09.2005 të lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse ku edhe janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e tyre, konkretisht në nenin 4.3, 4.4 dhe 4.5 për çka e paditura e parë [parashtruesja e kërkesës] *ka shpallur ankande për shitjen e automjeteve me çka edhe drejtpërdrejt argumenton faktin se është në detyrim ndaj palës paditëse në këtë rast DPZ Gashi Towing Service me seli në Pejë, andaj gjykata duke u bazuar në të gjitha provat këto prova të shtjelluara më lart edhe ka vendosur ashtu si është cituar në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke aprovuar dhe duke detyruar të paditurat që konform nenit 413 të LMD-së në mënyrë solidare të paguajnë dëmin kontraktues kundrejt palës paditëse."*

54. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, paraqitën ankesë që të dy të paditurat. E paditura e parë, përkatësisht Komuna e Pejës paraqiti ankesë me kërkesë që Aktgjykimi shkallës së parë të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

55. Për sa i takon "vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike," parashtruesja e kërkesës paraqiti tri pretendime kryesore. Së pari, parashtruesja theksoi se vazhdimi i Kontratës, i datës 19 tetor 2009, nuk është nënshkruar në mes të dy palëve dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka treguar se sipas cilit dokument është vazhduar kontrata, me datën 19 tetor 2009. Së dyti, parashtruesja theksoi se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar që palët ndërgjyqëse kanë nënshkruar "Kushte të Përgjithshme Kontraktuese," por që nuk e ka provuar këtë fakt. Së treti, parashtruesja theksoi se ankandet e organizuara të cilave iu referohet gjykata e shkallës së parë nuk kanë pasur të bëjnë me veturat që janë objekt i kontestit.

56. Për sa i takon "shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore", parashtruesja e kërkesës pretendoi se Aktgjykimi i shkallës së parë është kundërthënës dhe nuk përmban arsyet të cilat e

justifikojnë një aktgjykim të tillë dhe nuk përmban faktet vendimtare të nevojshme. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës paraqiti disa argumente: Së pari, ajo theksoi se gjykata e shkallës së parë e ka miratuar precizimin e kërkesëpadisë së DPZ Gashi Towing Service të bërë në fjalën përfundimtare - pjesë në të cilën nuk lejohet të bëhet precizimi i padisë dhe se palëve paditëse nuk iu është mundësuar deklarimi lidhur me precizimin e padisë. Fjala përfundimtare është përmbledhje e kërkesave dhe nuk mund të përmbajë kërkesa të reja materiale ose procedurale. Së dyti, parashtruesja e kërkesës theksoi se gjykata e shkallës së parë konstaton se aktgjykimin e saj e ka nxjerrë edhe në bazë të ekspertizës, por nuk e bën vlerësimin e konstatimeve të ekspertizës në aktgjykim. Së treti, parashtruesja e kërkesës thekson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka shtjelluar fare ballafaqimin e argumenteve të palëve ndërgjyqëse në aktgjykimin e saj e as nuk i ka përshkruar faktet kontestuese dhe jokontestuese. Së katërti, parashtruesja theksoi se gjykata e shkallës së parë nuk e ka precizuar se në bazë të cilit nen të kontratës ose ligjit e ka akorduar dëmshpërblimin dhe se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh udhëzimet e dhëna nga Gjykata Supreme, kur çështjen e ktheu në rigjykim.

57. Për sa i takon "zbatimit të gabuar të ligjit material," parashtruesja e kërkesës së pari theksoi se gjykata e shkallës së parë, përkundër argumenteve të saj për interpretim të gabuar të dispozitave të Kontratës dhe të ligjit material, ajo nuk ka treguar se përse pretendimet dhe argumente e parashtrueses nuk janë të bazuara. Në këtë drejtim, parashtruesja së pari kishte theksuar se ajo e kishte kontestuar vazhdimin e kontratës me datë 19 tetor 2009 për arsye se kjo gjë ishte bërë në prag të zgjedhjeve nga Bordi i Drejtorëve të Kuvendit Komunal të Pejës. Mirëpo ai vendim nuk është ekzekutuar asnjëherë nga parashtruesja e kërkesës, meqë nuk është nënshkruar asnjë aneks kontratë nga zyrtarët komunal dhe se DPZ Gashi Towing Service nuk ka pranuar asnjë shkresë zyrtare për vazhdimin e kontratës. Pra, parashtruesja e kërkesës konsideronte se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar se ekziston një kontratë në mes të palëve pas datës 18 shtator 2009. Së dyti, parashtruesja e kërkesës kishte theksuar se konstatimi i Gjykatës se kontrata e cila është objekt i kontestit është kontratë formularë, në kuptim të nenit 142 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, nuk qëndron meqë Kontrata në fjalë është kontratë e negociuar dhe nuk është kontakte formularë me kushte të përgjithshme kontraktuese. Së treti, parashtruesja e kërkesës kishte theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk e kishte shqyrtuar fare argumenti që ajo kishte paraqitur lidhur me faktin që konform nenit 4.5 të Kontratës, DPZ Gashi Towing Service ka pasur të drejtës e shitjes së automjeteve por të njëjtën gjë

nuk e ka bërë dhe se përmes posedimit është bërë pronar i automjeteve.

58. Më 15 qershor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit, Ae. nr. 201/2017, i refuzoi si të pabazuara ankesat e të paditurave dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

59. Për sa i përket gjendjes faktike dhe mundësisë që ajo të jetë vërtetuar në mënyrë të gabuar, siç pretendonte parashtruesja e kërkesës, Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim:

> *"Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi me të paditurat ka lidhur kontratë mbi kryerjen e shërbimit për tërheqjen e veturave me datë 15.09.2005, e cila Kontratë me vendimin e bordit të së paditurës Komuna e Pejës, të datës 18.09.2007 dhe 19.10.2009, është vazhduar edhe nga 3 muaj. Paditësi si kryerës i shërbimeve* [DPZ Gashi Towing Service] *përmes kontratës ka marrë obligim që të bëjë tërheqjen dhe vendosjen e veturave në auto-parkingun e tij sipas kërkesës së të paditurave. Sipas nenit 3.2 të kontratës për rimorkimin dhe qëndrimin e veturave tek paditësi deri në 90 ditë, pagesën e tyre do ta bëjnë pronarët e veturave, ndërsa sipas nenit 3.5 të kontratës, për veturat të cilat nuk janë tërhequr në këtë afat, pagesën e shërbimeve për ditët tjera kanë pasur obligim ta bëjnë të paditurit, gjerë në lartësinë e shumës së fituar nga shitja e veturave, e paraparë me nenin 3.2 të kontratës. Për shitjen e veturave, të cilat sipas dispozitës së nenit 3.6 të kontratës, do të konsiderohen të braktisura dhe do të bëhen pronë shoqërore, sipas nenit 3.8 të kontratës do të 1 formohet komisioni i përbërë nga një përfaqësues i paditësit dhe nga një përfaqësues i të paditurave të cilët do ta bëjnë vlerësimin e vlerës së veturave për shitje dhe nga shuma e inkasuar do të paguhet paditësi për shërbimet e kryera. Sipas nenit 3.9 të kontratës, dispozitat e sipërcituara nuk aplikohen për veturat që gjenden në procedurë hetuese gjer në shqyrtimin definitiv të rastit nga organi përkatës. Sipas nenit 2.12 të kontratës, paditësi ka qenë i obliguar që veturat e marra për hetimin e rasteve, bartjen dhe ruajtjen e tyre ta bëjë pa shpërblim, ndërsa për veturat tjera sipas nenit 4.3 të kontratës, paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë nga të paditurit që këto vetura të shiten përmes ankandit publik për të realizuar kompensimin e tij, ndërsa sipas kontratës, palët kontraktuese brenda 60 ditësh nga data e kalimi të afatit kanë qenë të obliguara që ta bëjnë shitjen nga e cila do të kompensohet paditësi* [DPZ Gashi Towing Service]. *Nëse shitja nuk mund të realizohet sipas procedurës së paraparë me kontratë, shitja ka*

mundur të bëhet nga vet paditësi përmes shitjes së drejtpërdrejtë apo për pjesë 1 rezervë.

60. Për sa i përket pretendimeve të lartcekura të parashtrueses së kërkesës për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës konstestimore, Gjykata e Apelit arsyetoi me sa vijon:

"Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, dhe faktet e sipër cekura ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka aprovuar shumën e kompensimit prej 392,515.00€, dhe i ka detyruar të paditurat që këtë shumë t'ia paguajnë solidarisht paditësit, me arsyetim se paditësi i ka përmbushur detyrimet e tij kontraktuese dhe është krijuar detyrimi për 1 pagesën e kompensimit konform nenit 142 dhe 413 të LMD-së.
Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. [...]

61. Për sa i takon pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit theksoi me sa vijon:

"Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale për shkak se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk është kontestuese se paditësi i ka kryer shërbimet e kontraktuara, për të cilat është aprovuar shuma e kompensimit nga gjykata e shkallës së parë. Kjo shumë është vërtetuar edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar z. Ali Gagica në ekspertizën e datës 22.06.2015 dhe i cili konstatim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk është kontestuese se, të paditurat janë porositëse të shërbimeve, përpiluese dhe nënshkruese të kontratës dhe vazhdimit të saj, se kanë shfrytëzuar shërbimet e paditësit, por e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit duke u thi1rur në të metat e dispozitave kontraktuese të cilat vet i kanë përpiluar.
Ky qëndrim i të paditurave për mospagesën e shërbimeve të kryera nga paditësi bie në kundërshtim me të gjitha parimet e së drejtës kontraktuale si dhe me parimet e moralit dhe mirëbesimit të së drejtës afariste. Madje kjo del jashtë çdo logjikë juridike sepse është e pakuptimtë të kërkohet lirimi nga përmbushja e detyrimeve kontraktuale të njërës palë, kur pala tjetër i ka kryer shërbimet e kontraktuara.

Ky qëndrim mund të vlejë vetëm në rastet e ofrimit të shërbimeve humanitare respektivisht te kontratat me detyrime të njëanshme por asesi te kontratat në afarizëm ku vet qëllimi dhe Objekt i kontratës është kryerja e shërbimeve për përfitimin e kundërvlerës së kontraktuar. Paditësi me të drejtë ka pritur realizimin e kompensimit për shërbimet e kryera dhe kjo përbën të "drejtë të pritshme sipas rrjedhës normale të gjërave" të garantuar si me të drejtën pozitive ashtu edhe me instrumente ndërkombëtare, të cilën pala tjetër ka detyrim të përmbush."

62. Për sa i takon ligjshmërisë së Kontratës së lidhur në mes të parashtrueses së kërkesës dhe DPZ Gashi Towing Service, Gjykata e Apelit argumentoi se:

"Kontrata e lidhur ndërmjet palëve është kontratë për kryerjen e shërbimeve, me prestime të dyanshme dhe sipas ligjit krijon detyrime të dyanshme për palët kontraktuese respektivisht kryerjen e shërbimeve dhe kompensimin e këtyre shërbimeve. Kjo kontratë nuk përbën kontrate aleatore (kontratë mbi kushtin) ashtu që të krijohej detyrimi vetëm pas përmbushjes së kushtit të caktuar. Nuk është kontestuese se paditësi në tërësi i është përmbajtur kontratës dhe i ka kryer shërbimet e kontraktuara dhe i është drejtuar të paditurave në mënyrën e përcaktuar me kontratë për Shitjen e automjeteve dhe kompensimin e tij, por të paditurat në vazhdimësi i kanë neglizhuar detyrimet kontraktuese dhe asnjëherë nuk kanë ndërmarrë veprime për t'ia mundësuar paditësit kompensimin adekuat konform kontratës dhe pas kësaj, jashtë çdo parimi ligjor thirren në lëshimet e tyre, për t' iu shmangur detyrimeve të veta.
Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të paditurës së parë, se Komuna e Pejës nuk ka obligime kontraktuese për shpërblim sepse Komuna ia ka dhënë të drejtë për të operuar ndërsa shpërblimin do ta realizojnë nga pronarët e automjeteve sipas vlerësimit të kësaj gjykate është e pabazuar, për arsyet në vijim: paditësi të gjitha shërbimet i ka kryer vetëm sipas kërkesës së të paditurave për interes dhe llogari të tyre, e jo sipas vullnetit dhe në interes të vetin.
Realizimi i kompensimit nga ana e pronarëve të automjeteve është paraparë si mundësi e kompensimit por me Nenin 3 të kontratës qartë është precizuar se në rast të pamundësisë së kompensimit të kryerësit të shërbimeve nga pronarët e automjeteve, mënyra dhe lartësia e kompensimit të tij. Në kontratë është përcaktuar se për cilat shërbime paditësi nuk do të kompensohet andaj edhe gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin paraprak, me të drejtë e kishte refuzuar kërkesën e

paditësit për këto shërbime dhe paditësi në këtë procedurë nuk e ka kërkuar këtë kompensim. Por shërbimet që janë objekt shqyrtimi në këtë procedurë, e për të cilat gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë, nuk hyjnë në këtë kategori. Me asnjë dispozitë kontraktuese nuk është përcaktuar mos pagesa e shërbimeve për të cilat gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë por përkundrazi për këto shërbime me kontratë janë paraparë pagesat dhe mënyra e kompensimit."

63. Për sa i takon pretendimeve të tjera shtesë të parashtrueses së kërkesës, Gjykata e Apelit e arsyetoi Aktgjykimin e saj me sa vijon:

"Gjykata e Apelit e vlerëson të pabazuar edhe pretendimin ankimor se paditësi konform kontratës është dashur vetë t'i shes automjetet dhe ta realizojë kompensimin, sipas dispozitës së nenit 3.6 të kontratës, sipas të cilës automjetet të cilat nuk tërhiqen brenda 90 ditëve do të konsiderohen të braktisura dhe do të bëhen pronë shoqërore, sepse edhe sipas qëndrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të dhënë në aktgjykimin Rev. Nr. 191/2004, për çështje identike, por edhe sipas qëndrimit nga vendimi i mëparshëm i Gjykatës së Apelit në këtë çështje juridike Ae.nr.215/2012, kjo dispozitë kontraktuese është lidhur në kundërshtim me nenin 46 dhe 47 të LMD-së dhe nuk krijon efekte juridike sepse kontrata krijon efekte juridike vetëm ndërmjet palëve kontraktuese ndërsa nuk mund të krijojë efekte ndaj të drejtave pronësore të pronarëve të automjeteve respektivisht nuk mund të shërbejë si bazë për kalimin e pronësisë së automjeteve në pronësi shoqërore andaj edhe rrjedhimisht kjo dispozitë kontraktuese nuk i ka dhënë mundësi ligjore paditësit për shitjen e automjeteve për realizimin e kompensimit.

Me nenin 103 par 2 të LMD-së përcaktohet se: në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njërën anë kontrata do të mbetet në fuqi, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar diçka tjetër për rastin e caktuar ndërsa pala që e ka shkelur ndalesën ligjore do të pësojë pasoja përkatëse. Në rastin konkret të paditurat kanë shkelur normat imperative gjatë përpilimit dhe lidhjes së kontratës andaj ato i bartin pasojat përkatëse.

Kjo gjykatë vlerëson se dispozita e nenit 3.6 të kontratës së lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës është në kundërshtim me normat imperative dhe nuk prodhon efekt juridik andaj rrjedhimisht paditësi nuk ka mundur ta aplikojë nenin 4.5 të kontratës për realizimin e kompensimit përmes shitjes se drejtpërdrejtë të automjeteve. Sipas Nenit 105 të LMD-se nuliteti i një dispozitë kontraktuese nuk mund të ketë pasojë edhe

nulitetin e vet kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndrojë pa dispozitën nule..., andaj konform kësaj dispozite kjo gjykatë vlerëson se kontrata ndërmjet palëve kontraktuese pa këtë dispozitë mbetet në fuqi. Si rrjedhojë në rastin konkret, bazuar në dispozitën e Nenit 103 par 2 të LMD-së, kompensimi i paditësit është dashur të bëhet nga të paditurat, konform dispozitave tjera kontraktuese, respektivisht sipas çmimit të paraparë me nenin 3.1 dhe 3.2 të Kontratës. [...]"

64. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paraqitën kërkesë për revizion që të dy të paditurat. Parashtruesja e kërkesës kërkesën për revizion e mbështeti në pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të të drejtës materiale.

65. Konkretisht, parashtruesja në kërkesën për revizion paraqiti argumentet e përmbledhura si në vijim:

(i) Aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë nuk e kanë përfillur qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme, të paraqitur në Aktgjykimin Rev. E. nr. 35/2016 dhe nuk kanë mënjanuar të metat në procedurë të rigjykimit;

(ii) Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë qartësuar se në çfarë baze juridike i kanë mbështetur aktgjykimet e tyre, meqë nuk është e qartë se borxhi i akorduar a duhet të paguhet në emër të *"borxhit kontraktues apo shpërblimit të dëmit"* e që ka qenë edhe vërejtje e Gjykatës Supreme;

(iii) Kontrata nuk e ka detyruar DPZ Gashi Towing Service që të ruaj automjetet mbi afatin 90 ditor, prandaj është e palogjikshme se përse janë detyruar të paditurat të dëmshpërblejnë DPZ Gashi Towing Service për ruajtjen e automjeteve për kohën pas skadimit të afatit 90 ditor;

(iv) Gjykata e Apelit shkon përtej secilit interpretim të shkallës së parë dhe vendos pozitivisht mbi kërkesën e DPZ Gashi Towing Service mbi një bazë krejt tjetër juridike, pa seancë dhe pa vërtetimin e gjendjes faktike;

(v) Gjykata e Apelit konsideron gabimisht se pas shfuqizimit të nenin 3.6 të Kontratës dispozitat tjera të Kontratës mbetën në fuqi konform nenit 103.2 të LMD dhe se DPZ Gashi Towing Service duhet të kompensohet konform nenit 3.1 dhe 3.2 të Kontratës;

(vi) Gjykata e Apelit ka interpretuar fakte të cilat nuk janë vërtetuar gjatë procedurës në shkallën e parë dhe nxjerrë paralele në mes të këtij rasti me raste të tjera të cilat i vlerëson të ngjashme ndërkaq që dëshmitë konkret mungojnë;

(vii) Gjykata e Apelit, ashtu sikur edhe gjykata e shkallës së parë, nuk e bën fare ndërlidhjen e ekspertizës me dëmshpërblimin e akorduar, duke e bërë kështu aktgjykimin edhe më të pakuptimtë; dhe

(viii) Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk janë lëshuar fare në kontestimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me vazhdimin e kontratës dhe se nuk ekziston një detyrim i kontraktuar, meqë neni 4.5 i Kontratës parasheh që nëse të paditurat nuk e organizojnë ankandin, atëherë ankandi organizohet nga DPZ Gashi Towing Service.

66. Më 20 nëntor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017, refuzoi revizionin e parashtrueses së kërkesës, pra Komunës së Pejës, si palë e parë e paditur; ndërkaq revizionin e palë së dytë të paditur, përkatësisht Policisë së Kosovës e pranoi si të bazuar.

67. Gjykata Supreme vendosi që pagesa e *"dëmit kontraktues"* prej 392,515.00 EUR, tashmë të akorduar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duhet ta paguaj vetëm parashtruesja e kërkesës e vetme dhe jo në baza solidare së bashku me Policinë e Kosovës.

Procedura e përmbarimit të vendimeve të gjykatave të rregullta

68. Siç tregojnë faktet e paraqitura më lart, në bazë të vendimeve të gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës u obligua t'i paguaj kompanisë private DPZ Gashi Towing Service shumën prej 392,515.00 EUR, në emër të dëmit kontraktues që rrjedh nga Kontrata, së bashku me kamatën ligjore dhe shpenzimet procedurale.

69. Në një datë të pacaktuar, DPZ Gashi Towing Service paraqiti propozim për përmbarim të vendimeve të gjykatave të rregullta, ashtu që të bëhet pagesa përfundimtare sipas aktgjykimeve të lartcekura, që tashmë kishin marrë formën e prerë dhe ishin bërë të ekzekutueshme.

70. Më 6 shtator 2017, Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit P. Nr. 197/17 miratoi propozimin për përmbarim të DPZ Gashi Towing Service.

71. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi prapësim kundër Urdhrit të lartcekur të Përmbaruesit Privat.

72. Më 28 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktvendimit Ep. Nr. 142/2017 e refuzoi, si të pabazuar, prapësimin e parashtruar nga parashtruesja e kërkesës dhe e la në fuqi Urdhrin e lartcekur të Përmbaruesit Privat.

73. Më 10 janar 2018, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur.

74. Më 8 janar 2019, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Pejë dhe kësisoj konfirmoi Urdhrin [P. Nr. 197/17, të 6 shtatorit 2017] e Përmbaruesit Privat. Gjykata e Apelit konsideroi se Urdhri i Përmbaruesit Privat mund të zbatohet dhe vendimin e saj e arsyetoi më sa vijon:

> *"Në rastin konkret e nën këto kushte, në këtë çështje përmbarimore, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se nuk ka kurrfarë pengesa ligjore për zbatimin e përmbarimit, prandaj drejtë ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e debitores Komuna e Pejës* [parashtruesja e kërkesës], *e përzgjedhur nga kreditori në kuptim të nenit 398 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për përmbushjen e detyrimit të pagesës ndaj tij, (e që këtë përzgjedhje kjo debitorë nuk e ka kundërshtuar në mënyrë të specifikuar), me të cilin qëndrim juridik pajtohet edhe kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, duke marrë parasysh faktin se pretendimet ankimore të debitores tregohen si të pasuksesshme për të ndikuar në vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje përmbarimore.*
>
> *Përveç pretendimeve tjera, edhe pretendimi ankimor i debitores se, nuk mund të lejohet që shuma e kompensimit të derdhet në konton e të autorizuarit të kreditorit, që është avokati [...] nga Peja, nuk qon peshë sepse, bartja eventuale e mjeteve financiare në konton e tij, është vullnet i vet kreditorit, të cilin nuk mund ta ndryshoj as gjykata e as debitorja, dhe nuk kuptohet se kjo formë pagese në çfarë mënyre e dëmton pasurinë publike.*
>
> *Gjykata e shkallës së dytë nuk është kompetente e as e autorizuar me ligj, që në procedurë përmbarimore të vlerësojë ligjshmërinë e ndonjë aktgjykimi të formës së prerë, ashtu siç aludon në pretendimet ankimore debitorja* [parashtruesja e kërkesës], *vetëm se mund të vendos lidhur me vendimin për lejimin-eventualisht refuzimin e përmbarimit. [...]".*

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

75. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërisë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017. Ajo pretendon se ky Aktgjykim i shkel asaj të drejtën për *"barazi para ligjit"* të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës; të drejtën për *"gjykim*

të drejtë dhe të paanshëm", përkatësisht të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtën për *"mjete juridike"* të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës .

76. Në dritën e kësaj, parashtruesja e kërkesës paraqet dy lloje të pretendimeve kryesore. Grupi i parë ka të bëjë me pretendimet e saj se gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht; dhe grupi i dytë ka të bëjë me pretendimet e saj se Gjykata Supreme ka dështuar të ofrojë një vendim të arsyetuar, duke mos u përgjigjur në disa argumente të saj të paraqitura në kërkesën për revizion.

Lidhur me pretendimin për mos-vërtetim të plotë të gjendjes faktike

77. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"asnjëra nga instancat gjyqësore nuk e ka bërë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike"* dhe se kjo ka rezultuar në shkelje të së drejtave të saj kushtetuese të përmendura më sipër.

78. Sipas saj, gjykatat e rregullta asnjëherë nuk e kanë vërtetuar faktin se Kontrata e datës 18 shtator 2009 [vazhdimi i tretë i Kontratës] është lidhur në kuptim të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, për faktin se palët asnjëherë nuk kanë nënshkruar aneks të Kontratës por se vetëm ka ekzistuar një vendim i brendshëm i parashtrueses së kërkesës (Komunës së Pejës), i cili është marrë në mënyrë kundërligjore dhe pa prokurim në prag të zgjedhjeve. Nëse Kontrata është konsideruar si e vazhduar, pretendon parashtruesja, atëherë gjykatat e rregullta duhej të kishin arsyetuar bazën ligjore mbi të cilën kanë konsideruar së ajo është vazhduar pa nënshkrimin ligjor të të dyja palëve.

79. Më tutje, parashtruesja pretendon se asnjëherë nuk është vërtetuar fakti se DPZ Gashi Towing Service, si kryes i shërbimeve, i ka ruajtur me të vërtetë automjetet sikur është kontraktuar, në vendin e kontratuar dhe sipas kushteve të kontraktuara. Për më tepër, parashtruesja pretendon se gjykatat nuk e kanë vërtetuar faktin se automjetet tanimë janë shitur apo jo nga DPZ Gashi Towing Service edhe pse ky i fundit në një seancë dëgjimore kishte deklaruar si i kishte shitur ato.

80. Duke u thirrur në rastet e GJEDNJ-së, përkatësisht rastin *Schenk kundër Zvicrës* dhe *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, parashtruesja thekson se *"konstatimi i gjendjes faktike është qenësore për vendimin e drejtë"* dhe *"mos vërtetimi i gjendjes faktike domosdo do të rezultojë me një vendim të gabueshëm gjyqësor"*. Fakti që gjykatat e rregullta, sipas parashtrueses, i kanë injoruar vërejtjet e saj lidhur me gjendjen

faktike të pavërtetuar i kanë shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 24 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Lidhur me pretendim për mos-arsyetim të vendimit nga Gjykata Supreme

81. Duke u thirrur në vendimet e mëhershme të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht në rastin KI72/12, KI138/15 dhe KI97/16, dhe në vendimin e GJEDNJ-së, respektivisht rastin *Pronina kundër Rumanisë*, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtën për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

82. Në këtë drejtim, parashtruesja thekson se Gjykata Supreme i ka injoruar vërejtjet procedurale lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike të paraqitura në kërkesën për revizion dhe duke i injoruar ato i kanë shkelur të drejtën për vendim të arsyetuar.

83. Më tutje, parashtruesja pretendon se precizimi i padisë nga ana e DPZ Gashi Towing Service [nga 663,450.00 EUR në 392,515.00 EUR] është bërë në kundërshtim me dispozitat e procedurës kontestimore dhe Gjykata Supreme nuk e ka trajtuar këtë pretendim të saj në Aktgjykimin e kontestuar, përkundër faktit se ajo e ka parashtruar në kërkesën për revizion. Në Aktgjykimin e shkallës së parë [Ek. nr. 587/2017], Gjykata Themelore në Prishtinë ka konstatuar se padia është precizuar në fjalën përfundimtare; ndërkaq, Gjykata e Apelit [Ae. nr. 201/2017] konstaton se padia është precizuar përmes parashtresës së DPZ Gashi Towing Service të datës 25 qershor 2015 dhe seancës së datës 23 mars 2017. Parashtruesja e kërkesës e ka goditur këtë gjetje të Gjykatës së Apelit për arsye se precizimi i padisë ishte bërë në një tjetër moment dhe se nuk ishte ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me këtë precizim. Ky pretendim ankimor ka ngelur i pa-adresuar nga Gjykata Supreme sipas parashtrueses.

84. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme nuk e ka diskutuar pretendimin e saj për bazën e gabuar ligjore mbi të cilën është miratuar kërkesëpadia e DPZ Gashi Towing Service. Sipas saj, në njërën anë, gjykata e shkallës së parë ka përdorur nenin 142 të LMD-së, si bazë ligjore për të miratuar kërkesëpadinë, përkundër faktit që ky nen *"nuk flet për detyrimin e shpërblimit të dëmit kontraktues ose ligjor"*; ndërkaq, në anën tjetër, gjykata e shkallës së dytë kërkesëpadinë e ka miratuar *"në një bazë krejt tjetër ligjore përkatësisht në bazë të nenit 3.1 dhe 3.2 të Kontratës së lidhur midis palëve, si dhe neneve 15 dhe 17 të LMD-së."* Më tutje, parashtruesja thekson se Gjykata Supreme më pas *"miratimin e kërkesëpadisë e ka bazuar në nenin 4.4 të Kontratës"* ndërkohë që ajo është dashur, si

gjykata më e lartë, *"t'i trajtojë këto kontradikta lidhur me bazën ligjore të miratimit të kërkesëpadisë, në dritën e praktikës së GJEDNJ, përkatësisht rasteve: S.C. Unziexport S.A. kundër Rumunisë par.29 [...] dhe Zielinski dhe Pradal dhe Gonzalez dhe të tjerët k. Francës [GC]."*

85. Më tutje, parashtruesja pretendon se Gjykata Supreme nuk i ka adresuar pretendimet e saj për shkelje të së drejtës materiale, meqë nuk ka shpjeguar se si ka ardhur deri te interpretimi i tillë i nenit 4.5 të Kontratës. Sipas parashtrueses së kërkesës, interpretimi juridik i dispozitave të Kontratës ka qenë kontesti kryesor në këtë rast dhe *"ky interpretim nuk ka qenë unik nga instancat gjyqësore përgjatë tërë procedurës,"* ndërkaq që Gjykata Supreme me një fakt të vetëm e konstaton faktin e parashtrueses së kërkesës *"pa bërë fare elaborimin e gjendjes faktike dhe pretendimeve juridike të palëve."*

86. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon se Aktvendimi e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes së cilin ishte përmirësuar Aktgjykimi [Ek. nr. 587/2017, i 15 qershorit 2017] i Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt dhe kjo ia ka pamundësuar të drejtën e deklarimit lidhur me pretendimet e palës kundërshtare, siç parashihet me nenin 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

87. Lidhur me këtë, parashtruesja pretendon se është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe këtë pretendim të saj për shkelje procedurale Gjykata Supreme nuk e ka trajtuar fare. Mos informimi për këtë vendim me kohë, por vetëm në procedurën përmbarimore ia ka mohuar asaj të drejtën për përdorim të mjeteve juridike në mënyrë të efektshme, ashtu siç parashihet me nenin 32 të Kushtetutës. Një pretendimi i tillë themelor, sipas saj, nuk është dashur të ngelet një e metë e cila tejkalohet (nuk adresohet) nga ana e Gjykatës Supreme.

88. Në fund, parashtruesja po ashtu pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e kontestuar, e ka ndryshuar tërësisht qëndrimin e saj juridik për të njëjtën çështje të dhënë përmes Aktvendimit Rev. E. Nr. 35/2016. Në këtë të fundit, sipas parashtrueses, Gjykata Supreme kishte vendosur se një palë nuk mund të detyrohet për një obligim kontraktues nëse objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar. Pikërisht mbi bazën se parashtruesja e kërkesës e kishte të pamundur shitjen e automjeteve, Gjykata Supreme kishte konsideruar se *"neni 4.4 i Kontratës, që përmban këtë obligim është nul në bazë të nenit 46 dhe 47 të LMD."* Gjykata Supreme, sipas parashtrueses, *"fare nuk lëshohet në arsyetimin dhe trajtimin meritor të kësaj çështje."*

Kërkesa e parashtrueses së kërkesës

89. Nga kërkesa rezulton se parashtruesja e kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të shpallë si kundër kushtetuese vendimin e Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017, si dhe vendimet e shkallëve më të ulëta gjyqësore, të ndërlidhura me të.

90. Në kërkesën e saj para kësaj Gjykate, parashtruesja e kërkesës i referohet veçanërisht kërkesës për vendosje të masës së përkohshme. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të miratojë masën e përkohshme ngase Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [Ek. nr. 587/2016, i 15 qershorit 2017] është bërë vendim i cili mund të ekzekutohet dhe se ekzekutimi i tij mund të paraqitet situata që *"këto mjete nuk do të mund të kthehen asnjëherë"* tek parashtruesja e kërkesës, në qoftë se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese do të rezultojë si e suksesshme.

91. Parashtruesja e kërkesës konsideron se kërkesa për masë të përkohshme është në interes publik, ngase në rast të ekzekutimit këto mjete do të merren nga buxheti i Republikës së Kosovës dedikuar Komunës së Pejës dhe *"nëse këto mjete nuk do të mund të kthehen pas ekzekutimit eventual, atëherë Parashtruesja e kërkesës nuk do të ketë mundësi të realizojë projekte me interes publik."* Sipas parashtrueses së kërkesë, rreziku që mjetet të mos kthehen konkretizohet me kërkesën e DPZ Gashi Towing Service që *"mjetet të derdhen në llogarinë e avokatëve të tij dhe jo në llogarinë bankare të ndërmarrjes, çështje e cila momentalisht është pjesë kontesti në procedurën përmbarimore me numër P-197/17."*

Komentet e paraqitura nga DPZ Gashi Towing Service

92. Në cilësinë e palës së interesuar, DPZ Gashi Towing Service dorëzoi komentet e saj fillestare në Gjykatë duke theksuar që pretendimet e parashtrueses së kërkesës janë *"të pabazuara"*, *"të paargumentuara"*, *"nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet të cilat definohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës"* dhe për të tilla arsye kërkesa e parashtrueses është e *"papranueshme."*

93. DPZ Gashi Towing Service pohoi se parashtruesja e kërkesës *"tenton në mënyrë perfide që Gjykatën Kushtetuese të e trajtojë si Gjykatë të Shkallës së IV, duke provuar që Gjykatën të e involvojë në procedurë të trajtimit dhe shqyrtimit, përkatësisht marrjes me verifikimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, e çka është e palejueshme edhe me Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese edhe me LPK."*

94. Më tutje, për sa i takon pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për mos arsyetim të vendimit nga ana e Gjykatës Supreme, DPZ Gashi Towing Service thekson se Gjykata Supreme nuk ka qenë kompetente që të lëshohet në shqyrtimin e konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjen faktike dhe si rezultat *"nuk ka qenë as e obliguar që për këto kërkesa të jep arsyetim, e të cilën çështje e paditura [parashtruesja e kërkesës] në kërkesën e saj tenton të e trajtojë si mos adresim të pretendimeve të tyre dhe mos dhënie të arsyetimit, çka nuk qëndron si pretendim."*

95. Lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës se gjykatat nuk e kanë vërtetuar se a janë ruajtur automjetet sipas kushteve nga kontrata dhe se a janë shitur pjesët e veturave apo jo, DPZ Gashi Towing Service thekson se këto pretendime janë "të pavërteta" dhe se kjo "insinuatë e tyre do të jetë objekt shqyrtimi penal në procedurë të veçantë" që DPZ Gashi Towing Service do ta hap ndaj parashtrueses së kërkesës. Më tutje, lidhur me këtë, pala e interesuar thekson se edhe po të ishin të vërteta pretendimet e parashtrueses, gjendja e automjeteve nuk ka qenë objekt kontesti, por objekt kontesti kanë qenë të drejtat dhe obligimet nga Kontrata për kryerjen e shërbimeve.

96. Lidhur me pretendimin se palët asnjëherë nuk kanë nënshkruar aneks kontrate, ku shihet që parashtruesja e kërkesës *"nuk e mohon ekzistimin e kontratës"*, por që ka ekzistuar vetëm vendim i parashtrueses së kërkesës për vazhdim të kontratës dhe se kinse vendimi qenka i kundërligjshëm sepse është marrë pa prokurim dhe në prag të zgjedhjeve, DPZ Gashi Towing Service thekson se kjo është *"çështje e cila kryesit të shërbimeve e as Gjykatës [Kushtetuese] nuk i intereson për 2 arsye: a) Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e faktit dhe e shkallës së IV; dhe b) Kryesi i shërbimeve nuk ka pasur ndikim as në hartimin e përpilimin e vendimit për vazhdimin e kontratës dhe as marrjen e vendimit të tillë."*

97. Më tutje, DPZ Gashi Towing Service pohon se *"aspekti ligjor i vendimit për vazhdimin e kontratës është çështje e zyrës ligjore të Komunës së Pejës e cila ka hartuar edhe Kontratën edhe vendimin për vazhdimin e saj si kontratë tipe, kushtet e të cilave i ka hartuar e paditura* [parashtruesja e kërkesës] *dhe të cilat janë dhënë për nënshkrim kryesit të shërbimeve pa ndikim në përmbajtjen e tyre, dhe përveç kësaj kjo kontratë dhe ky vendim kanë qenë objekt shqyrtimi gjatë gjykimit 9 vjeçar dhe kontrollit të brendshëm të të padituës nga zyra ligjore, zyra e prokurimit dhe auditimi i rregullt."* Fundja, sipas pretendimeve të palës së interesuar, edhe po të ishte i tillë vendimi çfarë pretendon parashtruesja e kërkesës, përgjegjësia për një vendim joligjor dhe vënia

në lajthim të kryesit të shërbimeve dhe në dëm të tij sërish bie në barrën e parashtrueses së kërkesës dhe Prokurorisë kompetente.

98. Sa i përket pretendimeve se Gjykata e Apelit vërejtjet dhe ankesat [e datës 17 korrik 2017 – grupi i tretë i vendimeve] nuk i ka adresuar, ato nuk qëndrojnë për arsye se, sipas DPZ Gashi Towing Service, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin e saj [AE. nr. 201/17 të 23 gushtit 2017] me 7 faqe arsyetim ka adresuar të gjitha pretendimet ankimore dhe si i tillë ky pretendim i parashtrueses së kërkesës nuk qëndron.

99. Për sa i takon procedurave para Gjykatës Supreme, pala e interesuar, përkatësisht DPZ Gashi Towing Service, thekson se *"Gjykata Supreme në kuptim të Nenit 214/2 të LPK nuk ka qenë kompetente të merret me verifikim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, e të cilën e paditura tenton të e cilësojë si mungesë arsyetimi."* Gjykata Supreme nuk është marrë me ato pretendime për arsye se janë jo lëndore – *"edhe pse Gjykata Supreme ka dhënë sqarimin se vërejtjet e tilla janë jo vendimtare dhe nuk ka qenë e obliguar të jep arsye të mëtejme."* Më tutje, ajo thekson se gjendja faktike është vërtetuar 3 herë radhazi dhe është vërtetuar e drejta e DPZ Gashi Towing Service për "*kompensim dëmi të shkaktuar" nga parashtruesja e kërkesës.*

Komente shtesë të paraqitura nga DPZ Gashi Towing Service

100. Më 25 shkurt 2019, përmes postës, DPZ Gashi Towing Service dërgoi disa komente shtesë të cilat u dorëzuan dhe pranuan në Gjykatë më 27 shkurt 2019. Në komentet e tyre, u theksua që *"Kërkesa e debitorit Komuna Pejë duhet të refuzohet e papranueshme jo vetëm për shkaqet e cekura deri më tani por bazuar edhe në praktikën e kësaj Gjykate, në të cilën qartë dhe në mënyrë të vazhdueshme Gjykata ka ritheksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e Gjykatave të rregullta nga juridiksioni kushtetues."*

101. Më tutje, DPZ Gashi Towing Service theksoi se *"kjo Gjykatë ndaj vendimeve gjyqësore kufizohet vetëm në mbrojtje të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjedhjen e çështjeve konkrete, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues (shih Aktvendimi KI47-48/15.)"* Duke cituar rastin *Femetrebi kundër Gjeorgjisë* dhe rastin e kësaj Gjykate në KI170/11, DPZ Gashi Towing Service theksoi se: *"Gjykata mund të vlerësojë nëse procedurat e Gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare, dhe bazuar në parimin e subsidiaritetit Gjykata nuk mund të marr rolin e Gjykatës së shkallës së*

IV-ë dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore."

102. Në fund, DPZ Gashi Towing Service u shpreh se *"Debitori* [parashtruesja e kërkesës] *duhet ta ketë të qartë se nuk gëzon asnjë të drejtë më shumë edhe pse është subjekt juridik – pushtet lokal se një ndërmarrje tjetër e taksapaguesit të këtij shteti, dhe mbi privilegjin e të qenit pushtet lokal të kërkon më shumë të drejta se kreditori të cilit për 10 vite rradhazi e deri më sot janë duke ju mohuar të drejtat e tij ligjore me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Supreme nga debitori Komuna Pejë [...] në rastin konkret kreditorit dhe me çdo kusht tenton që vetëm nga fakti se është pushtet lokal të nxjerrë vendim të favorshëm nga Gjykata Kushtetuese e kjo pasi që në të gjitha instancat e gjykatave të rregullta nuk ka mundur të argumentojë pretendimet e veta."*

Komentet të tjera shtesë të paraqitura nga DPZ Gashi Towing Service pas Vendimit të Gjykatës për Masë të përkohshme

103. Më 8 mars 2019, pas vendimmarrjes së Gjykatës në lidhje me Masën e përkohshme, DPZ Gashi Towing Service dorëzoi disa komente shtesë.

104. Fillimisht, DPZ Gashi Towing Service pretendoi se është vënë në dijeni për Vendimin për masë të përkohshme përmes ueb faqes zyrtare të Gjykatës dhe se nuk iu është dërguar Vendimi direkt atyre.

105. Lidhur me Vendimin për miratim të masës së përkohshme, DPZ Gashi Towing Service theksoi se *"NE si palë e interesuar në këtë rast, e si palë në procedurë në kontestin civil deri më tani i cili ka zgjatur përmbi 10 vite, ndihem tejet të shqetësuar se përse Gjykata Kushtetuese e merr parasysh vetëm interesin publik ndërsa interesat e qytetarëve të saj dhe taksapaguesve të këtij Shteti nuk i vlerëson duke cenuar barazinë e palëve në procedurë."*

106. Më tutje, DPZ Gashi Towing Service theksoi se *"nëse për këto 10 vite 3 herë në Gjykatën Themelore, 2 herë në Apel dhe 2 herë në Supreme, e po ashtu edhe në Procedurën përmbarimore 2 herë nuk qenkan shqyrtuar të gjitha pretendimet dhe kërkesat e palëve në procedurë, në të cilën Komuna e Pejës ka marr pjesë aktive në çdo seancë, ka qenë e përfaqësuar nga Avokati, dhe ka përdorur të gjitha mjetet e rregullta juridike dhe të jashtëzakonshme, atëherë Komuna Pejë duhet të dije se Gjykata Kushtetuese nuk mund të i ofrojë mbrojtje kërkesave të Komunës vetëm për faktin se është pushtet komunal, dhe nuk duhet të lejojë Gjykata Kushtetuese që të shndërrohet në dritare dalëse, sepse ky Shtet ka Kushtetutë e cila mbron edhe shtetasit e jo vetëm Komunën [...]."*

107. Sipas DPZ Gashi Towing Service, të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e parashtrueses së kërkesës po bëhen me qëllim të zvarritjes së procedurës, dëmtimit të tyre si dhe *"futjen e Gjykatës Kushtetuese në lojë në mënyrë perfide që të e shndërrojnë në Gjykatë të shkallës së IV, e për të cilat kërkesa jo ligjore, jo të bazuara [...]."*

108. DPZ Gashi Towing Service po ashtu pohoi se pretendimet e pa faktuara dhe të supozuara se në rast të ekzekutimit mjetet nuk do të mund të kthehen menjëherë janë supozime dhe pretendime të paragjykuara për çka *"Gjykata mbi supozime nuk do të ishte dashur të veprojë, sidoqoftë lidhur me masën e përkohshme nuk kemi asgjë kundër, pasi kur kemi pritur 10 vite presim edhe deri më dt. 30.04.2019 të bindur që Gjykata Kushtetuese do të marr vendim i cili do te e Hudhë si të papranueshme kërkesën e Komunës Pejë."*

Pranueshmëria e kërkesës

109. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

110. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. [...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

111. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

112. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të saj, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesja e kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; shih po ashtu, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku parashtruese të kërkesave ishin

komunat, për shembull, rasti KI48/14 dhe KI49/14, *parashtruese Komuna e Vushtrrisë*, Aktvendim për papranueshmëri i 15 marsit 2016; rasti KI149/16, *parashtruese Komuna e Klinës*, Aktvendim për papranueshmëri i datës 20 tetorit 2017). Në rastin konkret, Komuna e Pejës, si parashtruese e kësaj kërkese, synon të mbrojë interesat e saj kushtetuese si person juridik dhe si palë e cila ka qenë e paditur në kontest civil, nga një kompani private me të cilën ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese.

113. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi është palë e autorizuar, që konteston akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 20/2017] e Gjykatës Supreme të 20 nëntorit 2017, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

114. Gjykata më tutje duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj dhe në Rregullore. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...].

115. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve ligjore, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka specifikuar saktë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, që pretendohet se i janë shkelur, si dhe aktin konkrete të autoritetit publik me të cilin pretendon se janë shkaktuar shkeljet e pretenduara (gjegjësisht vendimet e gjykatave të rregullta), siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Gjithashtu, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajve, të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

116. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtrueses, si dhe komenteve të paraqitura nga DPZ Gashi Towing Service si palë e interesuar në këtë rast, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje të natyrës kushtetuese, vendosja e të cilave kërkon shqyrtimin e meritave të saj. Prandaj, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës dhe nuk ka ndonjë bazë tjetër, të paraparë me rregullin 39 të Rregullores së punës, mbi të cilën kjo kërkesë do të mund të shpallej si e papranueshme.

117. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa KI31/18 duhet të deklarohet e pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

118. Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017, i ka shkelur të drejtat e saj të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ, përkatësisht të drejtat e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe të drejtën e garantuar me nenin 32 [E drejta në mjete juridike] të Kushtetutës.

119. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës paraqet dy lloje kryesore të pretendimeve.

120. Grupi i parë i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me pohimet e saj se gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht; ndërkaq, grupi i dytë i pretendimeve ka të bëjë me faktin se Gjykata Supreme ka dështuar të ofrojë një vendim të arsyetuar, duke mos u përgjigjur në disa argumente të saj të paraqitura në kërkesën për revizion.

121. Në këtë aspekt, Gjykata së pari do t'i përgjigjet pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për sa i takon të drejtës për *"një vendim të arsyetuar gjyqësor"*. Së dyti, Gjykata do t'i përgjigjet pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për sa i takon *"vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike"*.

Për sa i përket pretendimeve për "vendim të arsyetuar gjyqësor"

122. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës, në thelb, pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, për sa i takon të drejtës për një vendim të arsyetuar.

123. Ky pretendim i parashtrueses së kërkesës do të trajtohet nga Gjykata, duke iu referuar: (i) garancive specifike të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) parimeve të përgjithshme të ndërtuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës Kushtetuese. Më pas, parimet e cekura dhe praktika gjyqësore përkatëse do të trajtohen nga Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, ashtu që të vërtetohet se a ka pasë apo jo shkelje të këtyre garancive kushtetuese.

124. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

125. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së që përcakton:

> *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile [...].*

126. Gjykata rikujton se e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor, siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Në pajtim me këtë, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

127. Bazuar në praktikën e mësipërme të GJEDNJ-së, edhe Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një numër të caktuar vendimesh ku është gjetur shkelje e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të dështimit, në raste të caktuara, të gjykatave në Republikën e Kosovës për të përmbushur kërkesat dhe standardet e kërkuara për një vendim të arsyetuar gjyqësor (Shih disa nga Aktgjykimet e Gjykatës

Kushtetuese lidhur me "arsyetimin e vendimeve gjyqësore", KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI 134/14, *IKK Classic* [nr. 1], cituar më lart; KI97/16, *IKK Classic* [nr. 2], cituar më lart, dhe referencat në ato Aktgjykime). Andaj, gjatë shqyrtimit të rastit aktual, Gjykata do ti referohet edhe rasteve të saj që janë relevante në këtë drejtim.

(i) Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese

128. Gjykata rikujton që e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ theksoi se, sipas praktikës së saj të vendosur gjyqësore, e cila pasqyron parimet lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastet e Gjykatës Kushtetuese, IKK Classic [nr. 1] dhe IKK Classic [nr. 2] cituar më lart dhe referencat në ato dy Aktgjykime).

129. Përveç kësaj, përderisa GJEDNJ-ja gjithashtu ka konstatuar se autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet *"t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre"* (Shih, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).

130. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, funksioni themelor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (Shih *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së*, Hirvisaari kundër Finlandës*, nr 49684/99, paragrafi 30, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Tatishvili kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 58; *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, paragrafi 37; shih po ashtu, rastet e Gjykatës Kushtetuese, IKK Classic [nr. 1] dhe IKK Classic [nr. 2] cituar më lart dhe referencat në ato dy Aktgjykime).

131. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [Dhoma e Madhe], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999. paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 42).

132. Në hedhjen poshtë të një ankese, për shembull, një gjykatë apeli mundet, në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët (Shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, Raportet 1997-VIII, paragrafët 59-60). Gjykata ose autoriteti më i ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa 49684/99, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30). Në rastet kur një gjykatë e shkallë së tretë apo e apelit konfirmon vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – detyrimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta.

133. Megjithatë, GJEDNJ ka gjithashtu ka vërejtur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtresave të palëve, autoriteti përkatës është i detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsyet për vendimet e tij (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37007/97, Aktgjykim i 1 korrik 2003, paragrafi 36).

134. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61), argumentet dhe pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25).

135. Në fund, arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet gjetjeve të meritës dhe reflektimeve kur të merret parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe

marrëdhënien logjike midis tyre (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, citur më lart, paragrafi 61; KI135/14, *IKK Classic* [nr. 1], cituar më lart, paragrafi 58; dhe *IKK Classic* [nr. 2], cituar më lart).

(ii) Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

136. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës duke u thirrur në vendimet e mëhershme të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht në rastin KI72/12, KI138/15 dhe KI97/16, dhe në vendimin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rumanisë*, në mënyrë të përmbledhur pretendon se: Gjykata Supreme i ka injoruar vërejtjet procedurale lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike të paraqitura në kërkesën për revizion; precizimi i padisë nga ana e DPZ Gashi Towing Service është bërë në kundërshtim me dispozitat e procedurës kontestimore dhe Gjykata Supreme nuk e ka trajtuar këtë pretendim të saj; Gjykata Supreme nuk e ka trajtuar pretendimin e saj për bazën e gabuar ligjore mbi të cilën është miratuar kërkesëpadia e DPZ Gashi Towing Service; Gjykata Supreme është dashur që si gjykata më e lartë, *"t'i trajtojë këto kontradikta lidhur me bazën ligjore të miratimit të kërkesëpadisë, në dritën e praktikës së GJEDNJ, përkatësisht rasteve: S.C. Unziexport S.A. kundër Rumunisë par.29 [...] dhe Zielinski dhe Pradal dhe Gonzalez dhe të tjerët k. Francës [GC];* Gjykata Supreme nuk i ka adresuar pretendimet e parashtrueses për shkelje të së drejtës materiale meqë nuk shpjegon se si ka ardhur deri te interpretimi i tillë i nenit 4.5 të Kontratës; Gjykata Supreme ka konstatuar fakte *"pa bërë fare elaborimin e gjendjes faktike dhe pretendimeve juridike të palëve"*.

137. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që, në kërkesën e saj për revizion, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur pretendimet e përmbledhura si në vijim:

(i) Aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë nuk e kanë përfillur qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme të paraqitur në Aktgjykimin Rev. E. nr. 35/2016 dhe nuk kanë mënjanuar të metat në procedurë të rigjykimit;
(ii) Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë qartësuar se në çfarë baze juridike i kanë mbështetur aktgjykimet e tyre meqë nuk është e qartë se borxhi i akorduar a duhet të paguhet në emër të *"borxhit kontraktues apo shpërblimit të dëmit"* e që ka qenë edhe vërejtje e Gjykatës Supreme;
(iii) Kontrata nuk e ka detyruar DPZ Gashi Towing Service që të ruaj automjetet mbi afatin 90 ditor prandaj është e palogjikshme se përse janë detyruar të paditurat të dëmshpërblejnë DPZ Gashi Towing Service për ruajtjen e automjeteve për kohën pas skadimit të afatit 90 ditor;

(iv) Gjykata e Apelit shkon përtej secilit interpretim të shkallës së parë dhe vendos pozitivisht mbi kërkesën e DPZ Gashi Towing Service mbi një bazë krejt tjetër juridike, pa seancë dhe pa vërtetimin e gjendjes faktike.
(v) Gjykata e Apelit konsideron pas shfuqizimit të nenin 3.6 të Kontratës, dispozitat tjera të Kontratës mbetën në fuqi konform nenit 103.2 të LMD dhe se DPZ Gashi Towing Service duhet të kompensohet konform nenit 3.1 dhe 3.2 të Kontratës;
(vi) Gjykata e Apelit ka interpretuar fakte të cilat nuk janë vërtetuar gjatë procedurës në shkallën e parë dhe nxjerrë paralele në mes të këtij rasti me raste të tjera të cilat i vlerëson të ngjashme ndërkaq që dëshmitë konkret mungojnë;
(vii) Gjykata e Apelit ashtu sikur edhe gjykata e shkallës së parë nuk e bën fare ndërlidhjen e ekspertizës me dëmshpërblimin e akorduar duke e bërë kështu aktgjykimin edhe më të pakuptimtë; dhe
(viii) Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk janë lëshuar fare në kontestimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me vazhdimin e kontratës dhe se nuk ekziston një detyrim i kontraktuar, meqë neni 4.5 i Kontratës parasheh që nëse të paditurat nuk e organizojnë ankandin, atëherë ankandi organizohet nga DPZ Gashi Towing Service.

138. Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Supreme kishte arsyetuar vendimin e saj për sa i takon ligjshmërisë së Kontratës dhe kishte dhënë mendimin e saj përfundimtar, të bazur në ligj, lidhur me atë se cilat nene janë të aplikueshme dhe në bazë të cilave nene parashtruesja e kërkesës detyrohet të paguaj dëmshpërblimin e akorduar kundrejt DPZ Gashi Towing Service. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme, për sa i takon Kontratës e që ndërlidhet me kërkesat specifike në revizion për sa i përket aplikueshmërisë së neneve të caktuara të Kontratës:

> *"Sipas nenit 2 të kësaj Kontrate kryesi i shërbimeve, këtu paditësja* [DPZ Gashi Towing Service], *detyrohet që ti bartë veturat në parkingun e saj, ti vendosë në mënyrë të rregullt në mënyrë që të mos ndryshojë gjendja teknike e veturës, në të cilën dispozitë kontraktuese parashihen edhe detyrimet tjera të kryesit të shërbimeve.*
>
> *Në nenin 3 të kësaj Kontrate parashihen të drejtat dhe shpërblimi për punën që e kryen paditësja për llogarinë e të paditurave, ku në pikën 1. të këtij neni parashihet që kryesit të shërbimeve për çdo veturë të bartur – rimorkuar në zonën*

urbane ose në kuadër të qytetit i takon shpërblimi në lartësi prej 25 EUR, ndërsa jashtë zonës urbane, shpërblimi prej 40 EUR.

Në nenin 4 të kësaj Kontrate janë paraparë të drejtat dhe obligimet e porositësve të shërbimeve ku nuk është parë asnjë detyrim i të paditurës së dytë [Policisë së Kosovës].

Kjo Kontratë ka qenë e lidhur me afat njëvjeçar, është vazhduar edhe për tre muaj në vazhdim, mirëpo automjetet e bartura në parkingun e paditësit kanë mbetur edhe më tutje aty dhe paditësja nuk ka marrë për këtë kurrfarë kompensimi. [...]"

139. Lidhur me këtë aspekt, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme iu ishte përgjigjur pretendimeve të parashtrueses për sa i takon vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike duke arsyetuar vendimin e saj me sa vijon:

"Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja [DPZ Gashi Towing Service] *dhe të paditurat, më datë 15.09.2005 në Pejë, kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e shërbimeve, objekt i së cilës është kryerja e shërbimeve nga ana e paditëses* [DPZ Gashi Towing Service] *si kompani për rimorkimin e automjeteve të cilat do të barten gjer në vendin e caktuar, respektivisht në bazën e parkingut të paditëses, sipas kërkesës së të padituravе.*

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me detyrimin e paditëses së parë për pagesën e borxhit kontestues ndaj paditëses, por jo edhe për detyrimin solidar të paditurës së dytë për të paguar këtë borxh, kjo ngase lidhur me të paditurën e parë [parashtruesen e kërkesës], *këto aktgjykime nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat e paditura thirret në revizion, e as me shkelje tjera thelbësore procedurale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.*

140. Për sa i takon pretendimeve për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata vëren se Gjykata Supreme konsideroi që: "*Në revizionin e të paditurës së parë* [parashtrueses së kërkesës], *vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e gjykatave të lartpërmendura përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, andaj kjo Gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale."*

141. Për sa i takon pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata vëren se, edhe në këtë aspekt, Gjykata Supreme e ka arsyetuar vendimin e saj ashtu siç ajo ka konsideruar se është e nevojshme bazuar në rrethanat e rastit dhe në vërtetimin e saktë të gjendjes faktike. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton arsyetimin specifik të Gjykatës Supreme se:

> *Objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme, ishin pretendimet e revizionit se nga aktgjykimet e lartpërmendura nuk rezulton se cila është baza juridike për aprovim të kërkesëpadisë. Këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara, kjo ngase të dy gjykatat kanë dhënë arsye lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, të cilat janë të pranueshme edhe për Gjykatën e Revizionit. [...] të dy gjykatat me të drejtë kanë vlerësuar se ekziston obligimi për pagesën e këtij borxhi në shumën e gjykuar sepse paditësja me prova të besueshme ka vërtetuar se në cilësinë e ofruesit të shërbimeve, ka kryer shërbimet e porositura, të cilat nga të padituratedhe nuk janë kontestuar. Për më tepër nuk është kontestuar as lartësia e vlerës së këtyre shërbimeve.*

> *Për më tepër, për faktin se në kuptim të nenit 4.4 të kontratës së lartpërmendur e paditura e parë ka qenë e obliguar që të kryej punët teknike, siç është shpallja e ankandit publik për shitjen e veturave të cilat janë parkuar në parkingun e paditëses, pikërisht nga kjo dispozitë kontraktuese, rezulton obligimi i të padituës së parë për pagesën e borxhit kontestues, kjo ngase e paditura e parë nuk ka kryer obligimin e vet themelor kontraktues, me kryerjen e të cilit paditësja do të kishte realizuar borxhin, i cili lidhet me parkimin disavjeçar të veturave në parkingun e saj. Vetëm e paditura e parë, këtu Komuna e Pejës, ka qenë e obliguar të shpallë ankandin për shitjen e veturave, dhe mos veprimi i Komunës së Pejës ia ka pa mundësuar paditëses që të kryej shitjen e drejtpërdrejt të veturave, sepse shpallja e ankandit për shitjen e tyre ka qenë kusht paraprak. Për këto arsye, edhe Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pakontestueshëm detyrimi i të padituës së parë lidhur me pagesën e borxhit kontestues.*

142. Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme nuk la pa adresuar edhe pretendimet e tjera të parashtrueses së kërkesës duke theksuar me sa vijon:

> *"Pretendimet tjera të padituës së parë* [parashtruesja e kërkesës], *Gjykata Supreme i vlerëson si të pabazuara, dhe si të tilla pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje juridike*

në raport me të paditurën e parë. Për më tepër ato pretendime përfaqësojnë një tendencë të pa arsyeshme të paditurës së parë për shmangie nga përgjegjësia për pagesën e borxhit ndaj paditëses, kjo nga se neni 4.4 i Kontratës kontestuese, në mënyrë mjaft të qartë precizon obligimin e të paditurës së parë për kryerjen e punëve teknike rreth shitjes së veturave, si që është shpallja e ankandit publik për shitjen e tyre. Ndërsa, në kuptim të nenit 4.5 të kësaj Kontrate, vetëm nëse në këtë ankand publik nuk do të shiteshin këto vetura, atëherë paditësja do të kishte të drejtë, që drejtpërdrejtë ti shet këto vetura pa ankand publik, ose ti sheh si pjesë rezervë. [...] Për arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi."

143. Në këtë drejtim Gjykata rikujton se në hedhjen poshtë të një ankese, apo siç është rasti konkret, refuzimin e një kërkese për revizion si mjet i jashtëzakonshëm juridik, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët, në këtë rast Gjykatës së Apelit (Shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, Raportet 1997-VIII, paragrafët 59-60).

144. Ngjashëm dhe në po këtë linjë arsyetimi, Gjykata po ashtu rikujton se rastet kur një gjykatë e shkallë së tretë apo e apelit konfirmon vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta, për sa i përket ligjshmërisë së Kontratës apo faktit se dëmi kontraktues duhet t'i kompensohet palës së interesuar DPZ Gashi Towing Service. Në këtë rast, Gjykata Supreme ka vërtetuar ligjshmërinë e dy vendimeve të instancave më të ulëta, të cilat sipas Gjykatës Supreme në mënyrë të drejtë kishin vërtetuar gjendjen faktike dhe nuk i kishin marrë vendimet e tyre me shkelje procedurale, apo me mangësi në zbatimin e të drejtës materiale. Gjykata Supreme, me vendimin e kontestuar, kishte bërë vetëm një korrigjim dhe atë për sa i takon faktit që parashtruesja e kërkesës duhet e vetme të paguaj dëmin kontraktues dhe jo në baza solidare me Policinë e Kosovës.

145. Pra, Gjykata e konsideron si qenësore faktin që një gjykatë që ndryshon në mënyrë përmbajtjesore një vendim - ka për detyrim që të jep arsye të forta, bindëse dhe të hollësishme lidhur me atë se përse konsideron se vendimmarrja e gjykatave më të ulëta nuk ka qenë e duhura. Në anën tjetër, është po ashtu e vetëkuptueshme që një gjykata e shkallës së tretë,

si Gjykata Supreme në rastin konkret, e cila veçse ka vërtetuar vendimet e gjykatave më të ulëta të cilat i kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimet e tyre – ka për detyrim të përgjigjet në pretendimet kyçe të ankuesve por nuk e ka për detyrim që të përgjigjet në çdo pretendim që parashtruesi e ka konsideruar si të rëndësishëm dhe e ka vendosur në kërkesën e saj për revizion. Do të ishte e palogjikshme, e papërshtatshme dhe barrë e panevojshme mbi gjyqësorin e rregullt që të pritej nga një gjykatë, që veçse vërteton vendimet e një gjykate më të ultë, të jep përgjigje në secilin argument të ngritur në mënyrë të përsëritur.

146. Siç përcakton praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e kësaj Gjykate, gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtresave të palëve. Autoritetet përkatëse, në këtë rast Gjykata Supreme – si autoritet vendimi i së cilës po kontestohet për mosmjaftueshmëri të arsyetimit gjyqësor – ka qenë e detyruar të justifikojë vendimin e saj duke dhënë arsyet përkatëse për atë vendim(Shih rastin e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37007/97, Aktgjykim i 1 korrik 2003, paragrafi 36). Në rastin konkret, kjo Gjykatë konsideron që, përkundër faktit që Gjykata Supreme, si gjykatë e shkallës së tretë, e cila në parim ka mundur dhe ka të drejtë vetëm të vërtetojë vendimet e gjykatave më të ulëta me të cilat pajtohet – ajo ka shkuar tutje dhe është përgjigjur në pretendimet e ngritura në kërkesën për revizion. Testi kryesor të cilin Gjykata e bën në rastet sikurse ky në shqyrtim është të vërtetojë se a është përgjigjur Gjykata Supreme në pretendimet kyçe të parashtruesit të kërkesës. Në rastin konkret, të gjitha kriteret e këtij testi plotësohen, meqë Gjykata Supreme iu është përgjigjur pretendimeve kyçe të parashtrueses së kërkesës – siç edhe u shpjegua më lart.

147. Pra, Gjykata konsideron se, përkundër faktit që Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në çdo pikë të ngritur nga parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj për revizion (shih përshtatshmërisht *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61), ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtrueses së kërkesës (shih përshtatshmërish rastin e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25), dhe kështu është përmbushur obligimi për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës në lidhjen me nenin 6 të KEDNJ-së.

148. Në këtë drejtim, siç u theksua më lart, Gjykata Supreme shpjegoj gjendjen faktike dhe faktin se ajo është vërtetuar në mënyrë të drejtë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore. Gjykata Supreme, me një

përjashtim për sa i takon asaj se kush është debitori kryesor në rast, vërtetoi plotësisht faktin se në rastin konkret të drejtat procedurale dhe materiale janë respektuar dhe vendimet e gjykatave më të ulëta kanë qenë të bazuar në ligj dhe në një kontratë të vlefshme, bazuar në të cilën edhe duhet të bëhet pagesa e shumës së caktuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

149. Si përfundim, Gjykata konstaton se, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ka gëzuar garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe rrjedhimisht, Aktgjykimi E. Rev. nr. 20/2017 i Gjykatës Supreme, i 20 nëntorit 2017, nuk shkel të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Për sa i përket pretendimeve për "vërtetim të gabuar të gjendjes faktike"

150. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, duke qenë se, sipas saj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë nga asnjëra prej gjykatave të rregullta dhe një gjë e tillë më pas nuk është korrigjuar nga Gjykata Supreme.

151. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se: *"asnjëra nga instancat gjyqësore nuk e ka bërë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike"* dhe se gjykatat e rregullta asnjëherë nuk e kanë vërtetuar faktin se vazhdimi i kontratës është lidhur në kuptim të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore; asnjëherë nuk është vërtetuar fakti se DPZ Gashi Towing Service, si kryes i shërbimeve, i ka ruajtur me të vërtetë automjetet sikur është kontraktuar.

152. Gjykata vëren se pretendimet e saj, parashtruesja e kërkesës i mbështetë duke u thirrur në rastet e GJEDNJ-së: *Schenk kundër Zvicrës* dhe *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, ku thuhet se *"konstatimi i gjendjes faktike është qenësore për vendimin e drejtë"* dhe *"mos vërtetimi i gjendjes faktike domosdo do të rezultojë me një vendim të gabueshëm gjyqësor."*

153. Lidhur me këto dy raste të cituara, Gjykata është po ashtu e pajtimit që garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e në interpretim të tyre edhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e kësaj Gjykate, tregojnë që konstatimi i gjendjes faktike është qenësor për një vendim të drejtë dhe mos vërtetimi i plotë i saj rezulton në një vendim të gabueshëm gjyqësor. Mirëpo, në rastin konkret, siç edhe do të shpjegohet më tutje, nuk kemi të bëjë me një rast kur janë ofruar dëshmi të mjaftueshme se gjykatat i kanë marrë vendimet e tyre në mënyrë arbitrare dhe e kanë vendosur dhe vërtetuar gjendjen faktike në

shpërputhje me garancitë gjegjëse kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor.

154. Gjykata rikujton se, për sa i takon gjendjes faktike, fillimisht Gjykata Themelore në Prishtinë [shih paragrafët XX të këtij Aktgjykimi]; e më pas Gjykata e Apelit [shih paragrafët XX të këtij Aktgjykimi] – kishin theksuar në mënyrë të qartë dhe të gjerë qëndrimet e tyre për sa i takon gjendjes faktike për rastin konkret. Krejt në fund edhe Gjykata Supreme i kishte kushtuar vëmendje të veçantë aspekteve të vërtetimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike – ashtu siç ajo ka konsideruar se është mënyra më e drejtë për të aplikuar ligjin material dhe procedural të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.

155. Gjykata vëmendshëm vëren se Gjykata Supreme, në fund, në vendimin e saj thekson se ajo pajtohet me mënyrën se si dy gjykatat paraprake e kanë vërtetuar gjendjen faktike – përveç aspektit se kush nga dy të paditurat duhet të jetë përgjegjëse për të paguar borxhin e akorduar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe të vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Në këtë aspekt, pas analizimit të mënyrës se si ishte konstatuar dhe vërtetuar gjendja faktike, Gjykata Supreme theksoi se: "*Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me detyrimin e paditëses së parë për pagesën e borxhit kontestues ndaj paditëses, por jo edhe për detyrimin solidar të paditurës së dytë për të paguar këtë borxh, kjo ngase lidhur me të paditurën e parë* [parashtruesen e kërkesës], *këto aktgjykime nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat e paditura thirret në revizion, e as me shkelje tjera thelbësore procedurale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.*"

156. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet qëndrimit të saj të përgjithshëm se, parimisht, vërtetimi i saktë dhe i drejtë i gjendjes faktike bie nën kompetencë të gjykatave të rregullta. Nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të bëjë interpretimin e vërtetimit të gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta – përveç nëse vërtetohet që gjykatat e rregullta kanë bërë konstatime dhe vërtetime të gjendjes faktike duke shkelur Kushtetutën dhe parimet kushtetuese që ajo mbron.

157. Pra, Gjykata ripërsërit qëndrimin e saj tashmë të konsoliduar se nuk është detyrë e kësaj Gjykate të merret me gabimet e faktit apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë një gjykatë të rregullt të miratojë një vendim në

vend të një vendimi tjetër, apo të refuzojë një kërkesë mbi një bazë apo mbi një bazë tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte me tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Perala kundër Greqisë*, nr. 17721/04, Vendim i 22 majit 2017, paragrafi 25; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, për ilustrim, KI72/18, parashtrues *Shpejtim Zymeraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 nëntorit 2018, paragrafi 40).

158. Roli i Gjykatës në këtë rast nuk është që të vendosë se a i ka vlerësuar drejtë Gjykata Supreme faktet dhe a e ka zbatuar ligjin në mënyrë të drejtë kur e ka refuzuar kërkesën e parashtrueses për revizion si të pabazuar dhe kur ka vërtetuar faktin që parashtruesja është përgjegjëse për të dëmshpërblyer palën e interesuar DPZ Gashi Towing Service, por të vlerësojë nëse procedura para Gjykatës Supreme, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Donadze kundër Gjerogjisë*, nr. 76644/01, Vendim i 7 marsit 2006, paragrafët 30-31).

159. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e saj se gjatë procedurave gjyqësore nuk ka përfituar nga një procedurë kontradiktore; se nuk ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e asj; që nuk ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; që gjykatat nuk i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e saj, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar nuk janë paraqitur në hollësie nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata konsideron se procedura, shikuar në tërësinë e saj, ishte e drejtë. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 35394/97, Vendimi i 4 tetorit 2000).

160. Gjykata, më tej, konsideron se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta dhe të vërtetuara më pas nga Gjykata Supreme – si gjykata më e lartë për zbatimin e ligjshmërisë - nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo të drejtës për barazi para ligjit (Shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Vendimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

161. Si përfundim, Gjykata konstaton se, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ka gëzuar garancitë kushtetuese për vërtetim të gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta dhe rrjedhimisht, Aktgjykimi [E. Rev. nr. 20/2017] i Gjykatës Supreme i 20 nëntorit 2017 nuk shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

162. Parashtruesja e kërkesës, në kërkesën e saj fillestare të dorëzuar në Gjykatë, kërkoi nga kjo e fundit vendosjen e masës së përkohshme ashtu që të parandalohet ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Ek. nr. 587/2017, i 15 qershorit 2017, dhe aktgjykimeve të instancave më të larta të ndërlidhura me të.

163. Arsyet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës për miratim të masës së përkohshme; kundër-argumentet e dorëzuara nga DPZ Gashi Towing Service; dhe arsyetimi i Gjykatës për miratimin e asaj mase janë të reflektuara në Vendimin për Masë të Përkohshme të kësaj Gjykate (Shih rastin KI31/18, Vendim për Masë të përkohshme).

164. Bazuar në si më sipër, Gjykata kishte vendosur që të miratojë kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme *"pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxjerrë përkitazi me meritat e kërkesës."* Masa e përkohshme u miratua deri më 30 prill 2019.

165. Duke qenë se më 12 prill 2019, Gjykata vendosi për meritat e kërkesës dhe gjeti se në rastin konkret nuk ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se vazhdimi i mëtutjeshëm i masës së përkohshme është i panevojshëm.

166. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se masa e përkohshme e vendosur më 27 shkurt 2019 [publikuar më 4 mars 2019] nuk është më tutje e nevojshme për arsye se është vërtetuar kushtetutshmëria e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 20/2017, e 20 nëntorit 2017] dhe e të gjitha vendimeve të tjera të ndërlidhura me të.

Përfundim

167. Gjykata konstatoi se parashtruesja e kërkesës ka gëzuar garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe rrjedhimisht, Aktgjykimi E. Rev. nr. 20/2017 i Gjykatës Supreme, i 20 nëntorit 2017,

nuk shkel të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

168. Gjykata konstatoi se parashtruesja e kërkesës ka gëzuar garancitë kushtetuese përkitazi me vërtetim të gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta dhe rrjedhimisht, Aktgjykimi E. Rev. nr. 20/2017 i Gjykatës Supreme, i 20 nëntorit 2017, nuk shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

169. Gjykata konstatoi se, duke marrë parasysh që u vërtetuar kushtetutshmëria e Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017 të Gjykatës Supreme, të 20 nëntorit 2017, shfuqizohet masa e përkohshme e vendosur nga Gjykata Kushtetuese, si e panevojshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, nenet 20.2, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 59 (a) të Rregullores së punës, më 12 prill 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi E. Rev. nr. 20/2017, i 20 nëntorit 2017, është në përputhshmëri me nenet 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHFUQIZOJË, masën e përkohshme të vendosur nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës më 27 shkurt 2019;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VI. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI25/18, Parashtrues: Vasilije Antović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 24 prillit 2017

KI25/18, Aktgjykim i 20 qershorit 2019, publikuar më 11 korrik 2019

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, res judicata, kërkesë e pranueshme, mosshkelje e të drejtave kushtetuese*

Parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në Komunën e Zubin Potokut deri në vitin 1990, kur ishte larguar nga puna. Pas padisë së parashtruesit, Gjykata Komunale në Mitrovicë kishte obliguar Komunën e Zubin Potokut që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet. Pasi komuna e Zubin Potokut nuk i kishte paguar pagat për kohen që kishte qene i larguar nga puna, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi të re. Më 12 nëntor 1996, Gjykata Komunale në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, përmes Aktgjykimit P. nr. 345/96, aprovoi pjesërisht padinë e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi Komunën e Zubin Potokut, që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të pagave të humbura, t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar monetare. Ky Aktgjykim ishte bërë i formës së prerë.

Në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, parashtruesi i kërkesës që nga viti 1997 deri në vendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, kishte iniciuar tri procedura gjyqësore. Vendimi i parë për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, të 12 nëntorit 1996, ishte Aktvendimi nr. 82/97 i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, i 29 shtatorit 1997, me të cilin ishte aprovuar propozimi i parashtruesit të kërkesës. Vendimi i dytë përkitazi me përmbarimin e të njëjtit Aktgjykim ishte Aktvendimi P. nr. 329/2003 i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, i 16 majit 2003 me të cilin ishte caktuar përmbarimi i Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996. Së treti, sërish si rezultat i propozimit të parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktvendimin P. nr. 329/2003, të 19 dhjetorit 2014, shfuqizoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë P. nr. 329/2003, të 16 majit 2003, dhe vendosi të refuzojë propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarim dhe të përfundojë "*procedurën përmbarimore në kuptim të nenit 66, paragrafit 3 të LPK-së*". Ky vendim ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017.

Parashtruesi i kërkesës, konteston para Gjykatës Kushtetuese, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, duke theksuar se Komuna aktuale e Zubin Potokut "*ka mundur që ekzekutimin në fjalë ta kryej pa marrë parasysh rrethanat që kanë ndodhur gjatë 10-15 viteve të kaluara, duke pasur parasysh para së gjithash, trashëgiminë ligjore*".

Gjykata fillimisht ritheksoi njërin ndër parimet kryesore të së drejtës për një gjykim të drejtë, obligimin për zbatimin e vendimeve që janë bërë *res judicata*. Megjithatë, Gjykata theksoi se efektet *res judicata* të vendimeve, në këtë rast të Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, kanë kufizime *ad personam* (për një person të caktuar) dhe në fushëveprimin material (çështja e caktuar).

Në lidhje me rastin konkret, Gjykata vërejti se me Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të vërtetuar me Aktvendimin CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, të Gjykatës së Apelit, është shfuqizuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 329/2003, i 16 majit 2003, dhe ishte vendosur që të përfundojë procedura përmbarimore përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Mitrovicës, dega në Zubin Potok, P. 345/96, të 12 nëntorit 1996, ndaj Komunës aktuale të Zubin Potokut, pasi ishte konstatuar se përmbarimi ishte i pamundur pasi komuna aktuale e Zubin Potokut, nuk mund ti përmbush obligimet e Komunës së Zubin Potokut të para vitit 1999. Gjykata vëren se me vendimin e kontestuar Gjykata e Apelit vetëm kishte përfunduar procedurën e përmbarimit ndaj Komunës aktuale të Zubin Potokut (*ad personam)* dhe nuk kishte vënë në pikëpyetje Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

Rrjedhimisht, Gjykata mbështetur në karakteristikat e veçanta të rastit, faktet e paraqitura, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, arsyetimin e Gjykatës së Apelit, si dhe bazuar në standardet e vendosura dhe parimet e përcaktuara në praktikën e vet gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, nuk gjeti që me Aktvendimin CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, të jetë shkelur e drejta e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI25/18

Parashtrues

Vasilije Antović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 24 prillit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Vasilije Antović, me vendbanim në Zubin Potok (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, i 25 prillit 2017 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, E. nr. 329/2003, të 19 dhjetorit 2014. Vendimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 1 shkurt 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e

parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E drejta për mjete juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 21 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 23 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila tregon se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 1 shkurt 2018.

8. Më 22 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.

9. Më 14 mars 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës.

10. Më 28 mars 2018, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Komunës së Zubin Potokut.

11. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

13. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues.

14. Më 1 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban.

15. Më 20 qershor 2019, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

16. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri votoi që kërkesa është e pranueshme dhe nuk gjeti që me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Përmbledhja e fakteve

17. Parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në Komunën e Zubin Potokut. Si rrjedhojë e largimit të tij nga puna në vitin 1990, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, për kthim në punë dhe realizim të të drejtave që dalin nga marrëdhënia e punës.

18. Më 19 prill 1994, Gjykata Komunale në Mitrovicë kishte obliguar Komunën e Zubin Potokut që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet.

Procedura në lidhje me kërkesëpadinë për kompensimin e pagave

19. Më 13 dhjetor 1994, Komuna e Zubin Potokut kishte kthyer parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës,

mirëpo nuk kishte paguar pagat e tij të humbura si rrjedhojë e largimit të tij nga puna.

20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, në Gjykatën Komunale në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, paraqiti kërkesëpadi për kompensimin e pagave të humbura gjatë kohës kur kishte qenë i larguar nga puna.

21. Më 5 shkurt 1996, Gjykata Komunale në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, përmes Aktgjykimit P. nr. 103/95, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave të humbura, mirëpo kishte refuzuar kërkesën e tij për pagesën e kamatës.

22. Si rrjedhojë e ankesës së Komunës së Zubin Potokut, më 8 maj 1996, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë kishte kthyer lëndën në rivendosje në mënyrë që të konstatohej edhe njëherë shuma e saktë e kompensimit.

23. Më 12 nëntor 1996, Gjykata Komunale në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, përmes Aktgjykimit P. nr. 345/96, aprovoi pjesërisht padinë e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi Komunën e Zubin Potokut, që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të pagave të humbura, t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar monetare, përfshirë kamatën ligjore duke filluar nga 11 tetori 1995 deri në pagesën përfundimtare.

Përkitazi me procedurën përmbarimore për përmbarim të Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996

24. Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Komunale në Mitrovicë kishte parashtruar propozim për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96 të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, Dega në Zubin Potok, të 12 nëntorit 1996.

25. Më 29 shtator 1997, Gjykata Komunale në Mitrovicë, përmes Aktvendimit P. nr. 82/97, aprovoi propozimin e parashtruesit për përmbarim të Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

26. Nga shkresat e lëndës rezulton që Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, i 29 shtatorit 1997, nuk është përmbaruar para periudhës së vendosjes së Kosovës nën administrim ndërkombëtar.

Përkitazi me procedurën e dytë përmbarimore për përmbarim të Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996

27. Më 19 mars 2003, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë propozim për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996. Në propozimin e tij për përmbarim parashtruesi kërkoi kompensimin e pagave të humbura.

28. Më 16 maj 2003, Gjykata Komunale në Mitrovicë, me Aktvendimin I. nr. 329/03, aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

29. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktvendimit të lartcekur, Komuna e Zubin Potokut në cilësinë e debitorit parashtroi prapësim. Në prapësimin e saj, Komuna e Zubin Potokut kishte pretenduar se kurrë nuk e kishte pranuar Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996 dhe Aktvendimin nr. 82/97 të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, të 29 shtatorit 1997 përkitazi me përmbarimin e këtij aktgjykimi.

30. Më 26 qershor 2003, Gjykata Komunale në Mitrovicë, përmes Aktvendimit P. nr. 329/03, refuzoi si të pabazuar prapësimin e Komunës së Zubin Potokut.

31. Gjykata Komunale në Mitrovicë konstatoi se nuk kishte dëshmi që Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, nr. 82/97, i 29 shtatorit 1997 për përmbarimin e aktgjykimit të lartcekur P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996 i ishte dorëzuar Komunës së Zubin Potokut. Rrjedhimisht, Gjykata Komunale në Mitrovicë, arsyetoi se *"me qëllim që të mos i pamundësohet e drejta e debitorit [Komunës së Zubin Potokut] për kundërshtim"* kjo Gjykatë me Aktvendimin I. nr. 329/03, të 15 majit 2003 ka lejuar përmbarimin e aktgjykimit të lartcekur P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

32. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktvendimit të lartcekur, I. nr. 329/03 të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, të 26 qershorit 2003, Komuna e Zubin Potokut parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale. Komuna përmes ankesës po ashtu kishte kërkuar që aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Komunale në Mitrovicë të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së njëjtë për rivendosje ose që propozimi i parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, të refuzohet si i pabazuar.

33. Fillimisht, Komuna në mënyrë specifike kishte theksuar se në kundërshtim me nenin 354, paragrafi 2, pika 10 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) janë duke u zhvilluar dy procedura përmbarimore për përmbarimin e aktgjykimit

të njëjtë. Së dyti, Komuna kishte pretenduar se Aktvendimi P. nr. 329/03, i 26 qershorit 2003 është i paqartë dhe i pakuptueshëm për arsye se Gjykata Komunale nuk është thirrur në dispozitën e ligjit, gjegjësisht nenin 53 të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore. Në fund, Komuna theksoi se mungon vërtetimi i përmbarueshmërisë, i paraparë me nenin 36 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

34. Më 21 korrik 2003, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, përmes Aktvendimit GZ. nr. 318/2003, refuzoi si të pabazuar ankesën e Komunës së Zubin Potokut.

35. Gjykata e Qarkut, në lidhje me pretendimin e Komunës së Zubin Potokut për shkelje të nenit 354, paragrafi 2, pika 10 të LPK-së, vlerësoi se *"[...] nuk bëhet fjalë për shkelje të procedurës, për arsye se nuk ka dështmi se debitorit i është dorëzuar vendimi për lejimin e përmbarimit, i 29 shtatorit 1997, dhe për të mos ja mohuar të drejtën e debitorit për prapësim, Gjykata Komunale në Mitrovicë me të drejtë përsëri ka lejuar përmbarimin më 16.05.2003, ndërsa debitori me kohë ka parashtruar ankesë kundër vendimit për lejimin e përmbarimit [...]"*. Rrjedhimisht, Gjykata e Qarkut konstatoi se pretendimi i Komunës së Zubin Potokut se parashtruesi i kërkesës do të kompensohet dy herë është i pabazuar.

36. Ndërsa në lidhje me pretendimin e Komunës së Zubin Potokut se Aktvendimi I. nr. 329/03, i 26 qershorit 2003 është i paqartë dhe i pakuptueshëm për arsye se gjykata nuk është thirrur në dispozitën e ligjit sipas të cilës kundërshtimi është refuzuar, Gjykata e Qarkut vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar "*sepse vendimi është i drejtë, bazohet në ligj, konkretisht në nenin 53 të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore"*.

37. Në fund, përkitazi me pretendimin e Komunës së Zubin Potokut se mungon vërtetimi i përmbarueshmërisë, i paraparë me nenin 36 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Gjykata e Qarkut konstatoi se *"në rastin konkret propozimi për përmbarim i është parashtruar gjykatës së njëjtë [Gjykatës Komunale në Mitrovicë] e cila ka vendosur në shkallën e parë, andaj nuk është e nevojshme që në kuptim të këtij rregulli ligjor që propozimi për përmbarim të furnizohet edhe me vërtetim mbi përmbarueshmërinë"*.

38. Më 24 shtator 2003, parashtruesi i kërkesës iu drejtua edhe institucionit të Ombudspersonit, të cilin e njoftoi në lidhje me procedurën përmbarimore, si rrjedhojë e të cilës me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, Aktvendimit P. nr. 329/03, të 16 majit 2003, propozimi i tij për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr.

345/96, të 12 nëntorit 1996 ishte aprovuar. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu e informoi Ombudspersonin në lidhje me moszbatimin e këtij aktvendimi nga ana e debitorit, përkatësisht Komunës së Zubin Potokut.

39. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi ju drejtua Bankës Popullore të Serbisë *(Narodna Banka Srbije)* me kërkesën për ekzekutimin e Aktvendimit P. nr. 329/03, të 16 majit 2003

40. Më 14 tetor 2003, Banka Popullore e Serbisë *(Narodna Banka Srbije)*, filiali në Kragujevc, i ktheu përgjigje Gjykatës Komunale në Mitrovicë duke theksuar se Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, I. nr. 329/03, i 16 majit 2003 nuk mund të ekzekutohet për shkak se llogaria nga e cila kërkohet konfiskimi i mjeteve financiare është e diskutueshme.

41. Më 5 nëntor 2003, parashtruesi iu drejtua Bankës Popullore të Serbisë, filiali në Kragujevc, me kërkesën për marrjen e veprimeve lidhur me ekzekutimin e pagesës së borxheve sipas Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

42. Më 20 janar 2004, Banka Popullore e Serbisë, filiali në Kragujevc, i ktheu përgjigje parashtruesit në lidhje me kërkesën e tij duke e njoftuar si në vijim: *"Sipas Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, në kuptimin materialo financiar, komuna e Zubin Potokut funksionon nëpërmjet buxhetit të UNMIK-ut urdhërdhënësi dhe ekzekutuesi i të cilit është Administratori komunal i UNMIK-ut"*. Përmbarimi i aktvendimit sipas Bankës Popullore është *"kompetencë e Gjykatës Komunale në Mitrovicë dhe Administratorit Komunal të UNMIK-ut"*.

Përkitazi me propozimin e tretë të përmbarimit të aktgjykimit, Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996

43. Më 11 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me propozimin për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Dega në Zubin Potok, Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

44. Më 19 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), me Aktvendimin P. nr. 329/2003 vendosi që:

1) Të shfuqizojë Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 329/2003, të 16 majit 2003;

2) Të refuzojë propozimin e parashtruesit për përmbarim të kërkesës për përmbarim të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 329/2003, të 16 majit 2003 *"për shkak të titullit joadekuat përmbarues, në kuptim të nenit 27 par. 1 dhe nenit 66 par. 3 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën e përmbarimit".;* dhe
3) *"[...] përfundon procesi përmbarimor në kuptim të nenit 66, par. 3 të Ligjit nr. 04/L-139 mbi procedurën përmbarimore".*

45. Gjykata Themelore e arsyetoi aktvendimin e saj se *[...]* "*titulli përmbarues ka të meta, gjë që në rastin konkret përmbarimi nuk është i mundur për shkak të subjektivitetit procedural dhe se Komuna e tanishme e Zubin Potokut është formuar nga UNMIK-u/REG/2000/45 [Rregullorja e UNMIK-ut për Vetëqeverisjen e Komunave] dhe nuk paraqet vazhdimin e Komunës së atëhershme dhe me këtë nuk mund të ngarkohet me obligime të cilat janë krijuar para 24 marsit 1999, pra debitori mund të jetë themelues i Komunës së Zubin Potokut para 20 qershorit 1999".*

46. Në vijim, Gjykata Themelore konstatoi se *"përmbarimi i titullit është i pamundur, ashtu siç është paraparë me nenin 66 par. 3 të Ligjit nr. 04/ L- 139 për procedurën përmbarimore [...]".*

47. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore përfundoi se *"ka shfuqizuar veprimet e ndërmarra të përmbarimit dhe e ka refuzuar propozimin për përmbarim për shkak të titullit joadekuat përmbarues dhe e ka ndërprerë procesin e mëtutjeshëm, për shkak të pamundësisë së ekzekutimit".*

48. Më 31 mars 2016, parashtruesi i kërkesës kundër aktvendimit të lartcekur, të Gjykatës Themelore, P. nr. 329/2003, të 19 dhjetorit 2014 parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij parashtruesi pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, si dhe vërtetimin të gabuar të gjendjes faktike.

49. Më 6 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës së Apelit me një parashtresë përmes së cilës kërkoi zgjidhjen e problemit shumëvjeçar dhe lëndës së regjistruar në Gjykatën e Apelit t'i jepej prioritet për zgjidhje.

50. Më 25 prill 2017, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin CA. nr. 1952/2016, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 329/2003, të 19 dhjetorit 2014.

51. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit arsyetoi se "*Sa i përket qëndrimit ligjor të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në dispozitivin e vendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë e ka vlerësuar si të ligjshëm dhe të drejtë; për veprimet joligjore të cilat i ka ndërmarrë Republika e Serbisë gjatë kohës së administrimit të dhunshëm gjatë viteve 1990/1999 nuk janë përgjegjës organet vetëqeverisëse të Kosovës të cilat i ka themeluar UNMIK-u nr.2000/45, e as organet e Republikës së Kosovës, sipas dokumentit mbi përmbarimin nuk e kanë legjitimitetin e palës në këtë proces të përmbarimit*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

52. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

53. Parashtruesi i kërkesës thekson se *"[...] Përveç fakteve të paraqitura më lart të cilat kanë të bëjnë me afatin e pakuptueshëm prej më shumë se 20 viteve për zbatimin e procedurës së përmbarimit sipas aktgjykimit dhe vendimit të plotfuqishëm, Organi i shkallës së dytë, Gjykata e Apelit e Kosovës, kur e shqyrtoi ankesën e paditësit, përkatësisht të kreditorit, nuk i mori në shqyrtim plotësisht të gjitha rrethanat e cekura në ankesë. Në fakt, e paditura Komuna e Zubin Potokut, është një person juridik, e cila ka mundur që ekzekutimin në fjalë ta kryej pa marrë parasysh rrethanat që kanë ndodhur gjatë 10-15 viteve të kaluara, duke pasur parasysh para së gjithash, trashëgiminë ligjore"*.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji nr. 04/L – 139 për Procedurën Përmbarimore (publikuar në Gazetën Zyrtare, më 31 janar 2013)

Neni 27
Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë

do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrit për përmbarim, për 7 (shtatë) ditë.

3. Në rastin nga paragrafi 2 i këtij neni, organi përmbarues e cakton përmbarimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij.

Neni 66
Përfundimi i procedurës përmbarimore

1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i paefektshëm, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast është pezulluar dy herë dhe për herë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1, neni 65 të këtij Ligji.
2. Përmbarimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyrimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit.
3. Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim.
4. Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore.

Neni 74
Forma e prerë dhe përmbarueshmëria e vendimeve në procedurën e përmbarimit

1. Vendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbarueshëm.
2. Vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbarueshëm, e po që se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë.
3. Vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po që se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë.

Pranueshmëria e kërkesës

54. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

55. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

56. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

57. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

58. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës dhe se nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër, të përcaktuar me Rregulloren e punës. Rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme.

Meritat e kërkesës

59. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

60. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike thekson se Gjykata e Apelit gjatë shqyrtimit të ankesës së tij nuk mori parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat në lidhje me rastin, dhe sipas tij *"[…] Komuna e Zubin Potokut, është një person juridik, e cila ka mundur që ekzekutimin në fjalë ta kryej pa marrë parasysh rrethanat që kanë ndodhur gjatë 10-15 viteve të kaluara, duke pasur parasysh para së gjithash, trashëgiminë ligjore".*

61. Në këtë aspekt, Gjykata vë në pah se parashtruesi në kërkesën e tij ngritë çështjen e moszbatimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

62. Gjykata vëren se, ndonëse parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, thelbi i pretendimeve të tij ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje

me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

63. Prandaj, Gjykata do të analizojë dhe shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës bazuar në faktet e paraqitura dhe në provat e bashkëngjitura në kërkesën e tij, përkatësisht çështjen e vendimit të formës së prerë apo vendimit *res judicata*.

64. Rrjedhimisht, Gjykata do të fokusohet në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit për shkelje të drejtës së tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, që përcaktojnë:

Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".
[...]

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".
[...]

65. Në këtë aspekt, Gjykata thekson që çështjet përkitazi me vendimet e formës së prerë ose *res judicata* në kuptim, të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar në mënyrë të hollësishme përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

66. Gjykata po ashtu vë në dukje se standardet dhe parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së sa i përket respektimit apo shfuqizimit të një vendimi të formës së prerë, *res judicata*, tashmë janë konfirmuar dhe vendosur edhe përmes vendimeve gjyqësore të

Gjykatës Kushtetuese (shih, ndër të tjera, rastet, rasti nr. KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014, rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykim i 20 majit 2016, rasti nr. KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018).

67. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sa i përket shfuqizimit të një vendimi të formës së prerë, Gjykata do t'i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së.

68. Gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës, fillimisht do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi të formës së prerë, *res judicata*, bazuar në standardet dhe parimet e përcaktuara me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, të cilat në vijim do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë

69. Gjykata fillimisht rikujton se, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm gjithashtu nënkupton se një vendim i formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*) duhet të konsiderohet si i pakthyeshëm. Në të vërtetë, GJEDNJ-ja konstatoi se "*një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon ndër të tjera se aty ku gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje"* (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Brumărescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, par. 61, gjithashtu rastet e Gjykatës KI122/17, parashtrues *Ceska Exportni Banka A. S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, rastin KI67/16, parashtrues *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 87 dhe rastin KI94/13, *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014).

70. Rrjedhimisht, në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës Kushtetuese, është theksuar se njëri nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e vendimeve të formës së prerë, *res judicata*. (shih rastin *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999, paragrafi 62). Sipas GJEDNJ-së "*asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllimin e fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit. (*shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së

Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, par. 52, dhe *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafi 72; shih gjithashtu rastet e Gjykatës rastin nr. KI55/11, parashtrues *Fatmir Pirreci*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 16 korrikut 2012, par. 42 dhe rastin nr. KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014).

71. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se efektet *res judicata* të vendimeve kanë kufizime *ad personam* (për një person të caktuar) dhe në fushëveprimin material (çështja e caktuar) (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI67/16, parashtrues: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016, paragrafi 88; shih po ashtu rastet: *Esertas kundër Lituanisë*, Aktgjykim i GJEDNJ nr. 0208/06, i 31 majit 2012, paragrafi 22 dhe rastin *Kehaya dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së nr. 47797/99 dhe 68698/01, i 12 prillit 2006, paragrafi 66.)

Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rrethanat e rastit konkret

72. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës që nga viti 1997 deri në vendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, ka iniciuar tri procedura gjyqësore në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, përmes të cilit ishte aprovuar kërkesa e parashtruesit për kompensimin e pagave si rezultat i largimit të tij nga puna në vitet e 90-ta.

73. Vendimi i parë për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, të 12 nëntorit 1996, ishte Aktvendimi nr. 82/97 i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, i 29 shtatorit 1997, me të cilin ishte aprovuar propozimi i parashtruesit të kërkesës.

74. Vendimi i dytë përkitazi me përmbarimin e të njëjtit Aktgjykim ishte Aktvendimi P. nr. 329/2003 i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, i 16 majit 2003 me të cilin ishte caktuar përmbarimi i Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, i cili pas procedurave ankimore ishte bërë i formës së prerë. Gjykata vëren se përmes Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 329/2003, i 16 majit 2003, parashtruesi i kërkesës ka tentuar që Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996 ta ekzekutoj ndaj Republikës së Serbisë, duke ju drejtuar Bankës Popullore të Serbisë *(Narodna Banka Srbije)*. Banka Popullore e Serbisë theksoi se Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, I. nr.

329/03, i 16 majit 2003 nuk mund të ekzekutohet për shkak se llogaria nga e cila kërkohet konfiskimi i mjeteve financiare është e diskutueshme.

75. Së treti, sërish si rezultat i propozimit të parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin P. nr. 329/2003, të 19 dhjetorit 2014, shfuqizoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 329/2003, të 16 majit 2003, dhe vendosi të refuzojë propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarim dhe të përfundojë "*procedurën përmbarimore në kuptim të nenit 66, paragrafit 3 të LPK-së*". Ky vendim ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017.

76. Andaj, parashtruesi i kërkesës konteston para Gjykatës Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, duke theksuar se Komuna aktuale e Zubin Potokut "*ka mundur që ekzekutimin në fjalë ta kryej pa marrë parasysh rrethanat që kanë ndodhur gjatë 10-15 viteve të kaluara, duke pasur parasysh para së gjithash, trashëgiminë ligjore*".

77. Andaj, Gjykata do të vlerësojë nëse me vendimin e kontestuar është shkelur parimi *res judiakta*, në lidhje me Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, përkatësisht, nëse vendimi i kontestuar e ka rihapur çështjen e vendosur me Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, në kundërshtim me parimin *res judicata*.

78. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës argumentet e tij për moszbatimin e Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, i ndërton duke u thirrur në atë se Komuna e Zubin Potokut është trashëgimtare ligjore e Komunës së Zubin Potokut kundër së cilës është nxjerrë Aktgjykimi P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

79. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson edhe njëherë se efektet *res judicata* të vendimeve, në këtë rast të Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, kanë kufizime *ad personam* (për një person të caktuar) dhe në fushëveprimin material (çështja e caktuar) (Shih *Esertas kundër Lituanisë*, paragrafi 22, më sipër dhe rastin *Kehaya dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, paragrafi 66).

80. Sa i përket fushëveprimit material (çështja e caktuar), objekti i çështjes së vendosur me Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, është i njëjtë me atë që është vendosur me vendimin e

kontestuar dhe ka të bëjë me kompensimin për pagat e papaguara të parashtruesit të kërkesës si rrjedhojë e largimit të tij nga puna. Kjo çështje nuk ka qenë kontestuese në procedurat gjyqësore të zhvilluara në rastin e parashtruesit të kërkesës.

81. Në lidhje me kufizimet *ad personam,* Gjykata rikujton edhe njëherë se në lidhje me kufizimet *ad personam* vlerëson nëse vendimi në lidhje me të cilin kërkohet zbatimi, ka të bëjë me palë të njëjta që kanë qenë pjesë e procedurës kur është marrë vendimi në lidhje me substancën e kërkesës dhe deri në çfarë mase ato mund të zbatohen ndaj personave të tretë.

82. Në rastin e Gjykatës Kushtetuese KI67/16, parashtrues: *Lumturije Voca*, Gjykata kishte vlerësuar procedurat gjyqësore të zhvilluara në lidhje me kërkesën e parashtrueses në lidhje me banesën që ishte kontestuese mes palëve të ndryshme dhe pozicionin e parashtrueses së kërkesës dhe personave të tjerë në këtë procedurë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI67/16, parashtrues: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016).

83. Sa i përket në rastin konkret dhe kufizimit *ad personam* për zbatimin e vendimeve, Gjykata vëren se në lidhje me Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, palë në procedurë ishin parashtruesi i kërkesës dhe Komuna e Zubin Potokut e para korrikut 1999. Ky Aktgjykim P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996 nuk është kontestuar/rihapur nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin P. nr. 329/2003, të 19 dhjetorit 2014 të vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017.

84. Gjykata vëren se me Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të vërtetuar me, Aktvendimin CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, të Gjykatës së Apelit, është shfuqizuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, P. nr. 329/2003, i 16 majit 2003, dhe rrjedhimisht ishte vendosur që të përfundojë procedura përmbarimore përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Mitrovicës, dega në Zubin Potok, P. 345/96, të 12 nëntorit 1996, ndaj Komunës aktuale të Zubin Potokut.

85. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore e cila konstatoi se: [...] "*titulli përmbarues ka të meta, gjë që në rastin konkret përmbarimi nuk është i mundur për shkak të subjektivitetit procedural dhe se Komuna e tanishme e Zubin Potokut është formuar nga UNMIK-u/REG/2000/45 dhe nuk paraqet vazhdimin e Komunës së atëhershme dhe me këtë nuk mund të ngarkohet me obligime të cilat janë krijuar para 24 marsit 1999, pra*

debitori mund të jetë themelues i Komunës së Zubin Potokut para 20 qershorit 1999".

86. Në vijim, Gjykata rikujton arsyetimin e aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, me të cilin vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke theksuar: "*Sa i përket qëndrimit ligjor të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në dispozitivin e vendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë e ka vlerësuar si të ligjshëm dhe të drejtë; për veprimet joligjore të cilat i ka ndërmarrë Republika e Serbisë gjatë kohës së administrimit të dhunshëm gjatë viteve 1990/1999 nuk janë përgjegjës organet vetëqeverisëse të Kosovës të cilat i ka themeluar UNMIK-u nr. 2000/45, e as organet e Republikës së Kosovës, sipas dokumentit mbi përmbarimin nuk e kanë legjitimitetin e palës në këtë proces të përmbarimit".*

87. Andaj, Gjykata vëren se me vendimin e kontestuar Gjykata e Apelit vetëm kishte përfunduar procedurën e përmbarimit ndaj Komunës aktuale të Zubin Potokut (*ad personam)* dhe nuk kishte vënë në pikëpyetje Aktgjykimin P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

88. Kjo pasi kishte konstatuar, se Komuna e Zubin Potokut nuk ishte trashëgimtare e Komunës së Zubin Potokut në lidhje me të cilën, ishte nxjerrë Aktgjykimi P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, dhe si e tillë ky Aktgjykim nuk mund të ekzekutohet ndaj Komunës aktuale të Zubin Potokut pasi ajo nuk ka qenë palë në proceduarën që është zhvilluar për atë çështje. Andaj, Gjykata vlerëson se nuk ka ndonjë arsye bindëse për të detyruar Komunën aktuale të Zubin Potokut të zbatoj Aktgjykimin e vitit 1996, duke mos qenë palë në atë procedurë.

89. Rrjedhimisht, kriteri për përmbarim të Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996, *(ad personam)* nuk është cenuar pasi nuk e ka shfuqizuar apo rihapur çështjen e vendosur sipas Aktgjykimit të lartcekur të vitit 1996.

90. Si përfundim, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret, përfundimi i procedurës përmbarimore përmes Aktvendimit CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, në rastin e parashtruesit kundër komunës së Zubin Potokut nuk cenon vendimin e formës së prerë, *res judicata,* pasi ajo nuk ka rihapur apo rishikuar çështjen për të cilën është vendosur përmes Aktgjykimit P. nr. 345/96, të 12 nëntorit 1996.

91. Rrjedhimisht dhe bazuar në atë si më sipër, Gjykata mbështetur në karakteristikat e veçanta të rastit, faktet e paraqitura, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, arsyetimin e Gjykatës së Apelit, si dhe bazuar në standardet e vendosura dhe parimet e përcaktuara në

praktikën e vet gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, nuk gjen që me Aktvendimin CA. nr. 1952/2016, të 25 prillit 2017, të jetë shkelur e drejta e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TË NJOFTOJË që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI 24/17, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 janarit 2017

KI 24/17, Parashtrues Bedri Salihu

Aktgjykim i 27 majit 2019, publikuar më 24 korrik 2019

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, vendim i paarsyetuar gjyqësor, gjykatë e (pa)anshme*

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev. nr. 308/2015] i 12 janarit 2017, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës ne lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, sepse sipas parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i kontestuar (i) nuk kishte zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI16/18 dhe rrjedhimisht, vazhdonte të mos i plotësonte standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor; dhe (ii) ishte nxjerrë nga një gjykatë e anshme, sepse përbërja e Kolegjit vendimmarrës të Gjykatës Supreme ishte identike me Kolegjin që kishte vendosur edhe herën e parë në rastin e tij, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.308/2015] të 12 nëntorit 2015, dhe të cilin Gjykata e kishte shpallur të pavlefshëm në rastin KI18/16.

Përkitazi me pretendimin e parë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi [Rev.nr 308/2015] i 12 janarit 2017 të Gjykatës Supreme, nuk ka evituar të metat e evidentuara nga Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI18/16 dhe rrjedhimisht, vazhdon të mos i plotësojë standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor sic është garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen e parashtruesit të kërkesës për herë të dytë në rivendosje në Gjykatën Supreme.

Ndërsa përkitazi me pretendimin e dytë, përkatësisht pretendimit që ndërlidhet me një gjykatë të paanshme, Gjykata, ndër të tjera, elaboroj (i) parimet e përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me kriteret për vlerësimin e paanësisë së një gjykate; (ii) konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës; (iii) praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aspekt të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përkatësisht konceptin e "*dyshimeve legjitime*" dhe faktit që të njëjtat duhet të jenë "*objektivisht të justifikueshme*" në mënyrë që të konstatohet paanësia e një gjykate; (iv) praktikën përkatëse gjyqësore përkitazi me vendosjen e trupave gjykues/kolegjeve në përbërje të njejtë në të njejtat cështje gjyqësore; dhe në fund, konstatoi se (v) edhe pse Aktgjykimi

[Rev.nr.308/2015] i 12 janarit 2017 i Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë nga përbërja identike e Kolegjit, i cili gjithashtu kishte vendosur në Aktgjykimin paraprak, përkatësisht, Aktgjykimin [Rev.308/2015] e 12 nëntorit 2015, duke rezultuar kështu në "*dyshime legjitime*" për paanshmërinë e gjykatës, në vlerësimin e Gjykatës këto dyshime, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë "*objektivisht të justifikueshme*".

Si përfundim, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, në seancën e 27 majit 2019, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme, konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 308/2015] e 12 janarit 2017 të Gjykatës Supreme, për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI24/17

Parashtrues

Bedri Salihu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 janarit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bedri Salihu nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson z. Selman Bogiqi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 308/2015] e 12 janarit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e

Përgjithshme] dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata do të i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 mars 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka–Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

8. Më 20 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi autorizimin për përfaqësuesin ligjor para Gjykatës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës edhe Gjykatës Supreme.

9. Më 26 prill 2017, Gjykata pranoi dokumentin shtesë të kërkuar.

10. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

11. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Radomir Laban, Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

12. Më 8 tetor 2018, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH.KI24/17, për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

13. Më 27 maj 2019, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

14. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme, dhe (ii) Aktgjykimi [Rev. nr. 308/2015] i 12 janarit 2017 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 9 prill 2010, parashtruesi i kërkesës pësoi lëndime të rënda trupore në një aksident komunikacioni të shkaktuar nga shfrytëzuesi i sigurimit të Kompanisë së sigurimeve "SIGMA" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: "SIGMA").

16. Më 30 korrik 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C. nr. 1234/10] e aprovoi pjesërisht padinë e parashtruesit të kërkesës dhe e detyroi SIGMA-në që t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës: (i) dëmin material në vlerën e përgjithshme prej 3,176 euro duke përfshirë edhe rentën mujore në shumë prej 250 euro, duke filluar nga 30 korriku 2014 dhe deri në ekzistimin e kushteve ligjore; dhe (ii) dëmin jomaterial në vlerën e përgjithshme prej 32,000 euro të shkaktuar nga shfrytëzuesi i sigurimit.

17. Në një datë të pacaktuar, SIGMA parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 29 qershor 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4842/2014] e aprovoi pjesërisht ankesën e SIGMA-s duke e (i) anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore përkitazi me shumat që ndërlidhen

me kompensimin e shpenzimeve të terapisë fizikale, rentën mujore dhe shpenzimeve të procedurës; ndërsa (ii) vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore përkitazi me përcaktimin e shumës që ndërlidhet me dëmin jomaterial dhe një pjesë të dëmit material.

19. Në një datë të pacaktuar, SIGMA parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Supreme të aprovojë revizionin dhe t'i zvogëlojë shumat përkitazi me dëmin jomaterial ose të anulon Aktgjykimin e kontestuar duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

20. Më 12 nëntor 2015, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. Nr. 308/2015] e aprovoi pjesërisht si të bazuar kërkesën për revizion të parashtruar nga SIGMA, dhe, rrjedhimisht, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me atë të Gjykatës Themelore, duke zvogëluar në vlerën prej rreth 20,000 euro kompensimin financiar për dëmin e shkaktuar parashtruesit të kërkesës e të konfirmuar nga dy gjykatat paraprake.

21. Më 27 janar 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e parë në Gjykatë duke pretenduar se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

22. Më 20 maj 2016, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KI18/16 (Shih rastin e Gjykatës KI18/16, me parashtrues *Bedri Salihu*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 nëntorit 2015), konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, me arsyetimin se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk i përmbushte standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor.

23. Më 12 janar 2017, pas Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI18/16, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e ri, respektivisht, të dytë për rastin, Aktgjykimin [Rev.nr.308/2015], përmes të cilit përsëriti gjetjet e Aktgjykimit të parë, respektivisht Aktgjykimit [Rev. nr. 308/2015] të 12 nëntorit 2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi i saj i dytë, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim

të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi i kërkesës më specifikisht pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI18/16 nuk është zbatuar nga Gjykata Supreme. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev. nr. 308/2015] i 12 janarit 2017 është i njëjtë me Aktgjykimin e saj të parë, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 308/2015] e 12 nëntorit 2015, dhe sërish dështon të arsyetoi zvogëlimin e shumës prej 20,000 eurosh të kompensimit të dëmit të vërtetuar përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4842/14] të 29 qershorit 2015 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C. n. 1234/10] e 30 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore.

26. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë të Gjykatës Supreme, kjo e fundit nuk ka qenë e paanshme sepse Kryetari i kolegjit ka qenë sërish gjyqtari i njëjtë, përkatësisht, gjyqtari E.H.

27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpall kërkesën e pranueshme; të shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar [Rev. nr. 308/2015] të 12 janarit 2017 të Gjykatës Supreme duke e kthyer çështjen në rivendosje në Gjykatën Supreme; dhe që gjatë kësaj të fundit, të përjashtohet nga vendimmarrja gjyqtari E.H.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.308/2015] e 12 janarit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

32. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafi 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

33. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sic përcaktohet përmes paragrafit 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht ajo duhet deklaruar e pranueshme. (Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së

Alimuçaj kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat e kërkesës

34. Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Themelore i kishte përcaktuar parashtruesit të kërkesës një kompensim të caktuar për dëmet materiale dhe jomateriale të cilat i ishin shkaktuar si rezultat i aksidentit të 9 prillit 2010. Ky kompensim, me ndryshime të caktuara, ishte vërtetuar dhe nga Gjykata e Apelit. Gjykata Supreme në anën tjetër, duke vepruar sipas kërkesës për revizion të së paditurës, përkatësisht SIGMA-s, kishte ndryshuar Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, duke zvogëluar shumën e përcaktuar të kompensimit në vlerën prej rreth 20,000 euro. Gjykata kishte shpallur të pavlefshëm këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme, duke konstatuar së i njëjti ishte nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse nuk plotësonte standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar, përkatësisht Aktgjykimit [Rev. nr. 308/2015] të 12 janarit 2017, sërish konfirmoi vendimin saj të parë, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 308/2015] e 12 nëntorit 2015. Ky Aktgjykim është kontestuar sërish në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës, i cili pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme (i) nuk ka zbatuar Aktgjykim e Gjykatës në rastin KI18/16 sepse Aktgjykimi i saj vazhdon të mos jetë i arsyetuar; dhe (ii) ishte e anshme sepse kishte vendosur në përbërje të njëjtë të kolegjit në të dyja rastet.

35. Gjykata do të i trajtoj këto pretendime veç e veç dhe duke aplikuar në to praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, sa i përket vlerësimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me moszbatimin e Aktgjykimin të Gjykatës në rastin KI18/16 dhe mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor

36. Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet

Hadjianastassiou kundër Greqisë, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *"IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; dhe KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018.

37. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet "*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*". Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.

38. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që Aktgjykimi i parë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev.nr.308/2015] i 12 nëntorit 2015, dhe i cili ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata, kishte përmbajtur arsyetimin në vijim sa i përket ndryshimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta në lidhje me lartësinë e kompensimit:

> *"Sipas vlerësimi të Gjykatës Supreme të Kosovës, shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së instancës më të ulët, që kanë të bëjnë në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial në emër të dhimbjeve fizike dhe në emër të frikës së pësuar dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor për paditësin Bedri Salihu, nuk janë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jomaterial duke marrë parasysh rëndësinë e shkallës e së mirës dhe qëllimit që shërben ky shpërblim, sic është paraparë me nenin 200 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi Detyrimet". .....*

"Nisur nga kjo dhe duke pasur parasysh moshën e paditësit në kohën kur kanë pësuar pësuar fatkeqësinë, natyrën e lëndimeve si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jomaterial, kjo Gjykatë konsideron se me ndihmën e shumave të caktuara paditësi mund të përjetojë një satisfaksion të konsiderueshëm për dhimbjet fizike dhe të frikës së pësuar".

39. Në këtë aspekt, Gjykata specifikisht kishte konstatuar se Gjykata Supreme (i) nuk kishte sqaruar asnjë nga faktet që i ka shqyrtuar as ndonjë prej arsyeve të veçanta që ajo mund të ketë marrë parasysh, kur në mënyrë të konsiderueshme i kishte ndryshuar dhe zvogëluar shumat e miratuara më parë nga gjykatat e shkallëve më të ulëta (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI18/16, paragrafi 43); (ii) nuk i referohet ndonjë arsyeje faktike dhe ligjore në lidhje me atë se si dhe pse ai dallonte në mënyrë të konsiderueshme nga vendimi i gjykatave të shkallës më të ulët sa i përket shumës së kompensimit për dëmin jomaterial (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI18/16, paragrafi 46); dhe (iii) nuk kishte arsyetuar veçanërisht se përse shuma e ndryshuar e kompensimit monetar për dëmin jomaterial që i është shkaktuar parashtruesit të kërkesës ishte ndryshuar dhe zvogëluar në raport me qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulëta (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI18/16, paragrafi 50).

40. Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme, i nxjerrë si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI18/16, në adresimin e vërejtjeve të Gjykatës, kishte dhënë arsyetimin e mëposhtëm:

"Me rastin e caktimit të shpërblimit të dëmit jomaterial në emër të dhimbjeve fizike të pësuara, frikës së pësuar, kjo gjykatë ka marrë parasysh intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës së pësuar nga lëndimi, siç parashikohet me dispozitën e nenit 200 par. 2 të LMD. Përpos këtyre elementeve me rendësi në caktimin e shumës së shpërblimit e dëmit duhen marrë parasysh edhe të gjitha rrethanat tjera te rastit, e veçanërisht përjetimet e pakëndshme dhe komplikimet mundshme gjatë mjekimit. Me rastin e caktimit të shpërblimit të dëmit jo material në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, kjo gjykatë ka marr parasysh kohëzgjatjen e tyre, moshën e paditësit, profesionin e tij si kamerier' ku kërkohet qëndrimi i gjatë në këmbë që shkaktojnë dhimbje të vazhdueshme për shkak të natyrës së lëndimit dhe pasojat që kanë pasur të paditësi si dhe qëllimin e shpërblimit të këtij dëmi jo material. Në këtë rast janë marrë për bazë karakteristikat personale të paditësit si dhe praktikën e kësaj gjykate në caktimin e lartësisë së dëmit jo material."

41. Gjykata në këtë kontekst rikujton që bazuar në praktikën e gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm. Në rastin konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me zvogëlimin e konsiderueshëm të kompensimit, Gjykata i kishte konsideruar si thelbësore në Aktgjykimin e saj të parë, duke kërkuar specifikisht nga Gjykata Supreme që gjatë rivendosjes të i sqaroj arsyet në të cilat ajo është bazuar për uljen e shumës së kompensimit.

42. Gjykata verën se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj të dytë, kishte dështuar sërish të ofroj një arsyetim që i përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse (i) vendimi i gjykatës kishte përdorur një arsyetim të përgjithshëm dhe i cili nuk ishte i bazuar në rrethanat e veçanta dhe të gjendjes faktike të rastit konkret dhe për më tepër, (ii) përderisa vendimi i gjykatës i është referuar nenit 200 të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978, ai nuk sqaron se si ky nen apo edhe praktika e Gjykatës Supreme, të cilës ajo vet i referohet, është aplikuar në rrethanat e rastit konkret. Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës Supreme, edhe më tej nuk sqaron për parashtruesin e kërkesës dhe as për publikun, se për çfarë arsye faktike dhe ligjore, ajo ka zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme vlerën e kompensimit të dëmit, të vërtetuar nga dy gjykatat e shkallës më të ultë.

43. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev.nr.308/2015] i 12 janarit 2017, nuk ka korrigjuar shkeljet e konstatuara me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI18/16 dhe rrjedhimisht nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtruesit të kërkesës për uljen e kompensimit të dëmit të përcaktuar nga gjykatat e instancës më të ulët, duke rezultuar kështu në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë*, Aktgjykimi i 8 prillit 2008, paragrafi 115).

Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me paanshmërinë e gjykatës

44. Në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me paanshmërinë e gjykatës, Gjykata fillimisht rikujton se paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të përcaktohet sipas (i) testit subjektiv, rrjedhimisht në bazë të bindjes dhe sjelljes

personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar se një gjyqtar mund të ketë pasur paragjykime personale apo anshmëri në një rast të caktuar; dhe (ii) testit objektiv, rrjedhimisht konstatimit nëse vet gjykata, mes tjerash, përbërja e saj, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. (Shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Miracle Europe KFT kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 12 prillit 2015, paragrafët 54 dhe 55; *Gautrin dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 58; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 58; *Thomann kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 30; *Wettstein kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2000, paragrafi 42*; Korzeniak kundër Polonisë*, Aktgjykim i 10 janarit 2017, paragrafi 46; dhe rastin e Gjykatës KI06/12, me parashtrues *Bajrush Gashi*, Aktgjykim i 9 majit 2012, paragrafi 45).

45. Më specifikisht, sa i përket testit subjektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 30 nëntorit 2005, paragrafi 30; *Padovani kundër Italisë*, Aktgjykim i 26 shkurt 1993, paragrafi 26; *Morel kundër Francës*, paragrafi 41; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 59; *Hauschildt kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989, paragrafi 47; *Driza kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 75; dhe *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 47). Për sa i përket llojit të provave të nevojshme për të dëshmuar një gjë të tillë, GJEDNJ, për shembull, është përpjekur që të vërtetojë nëse një gjyqtar tregon armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 26 tetorit 1984, paragrafi 25). Megjithatë, parimi në të cilin duhet të supozohet se gjykata është e liruar nga paragjykimet apo njëanshmëria personale është i vendosur për një kohë të gjatë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kyprianou kundër Qipros*, cituar më lart, paragrafi 119; *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 93-94; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 33).

46. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përderisa në disa raste mund të jetë e vështirë të gjenden faktet bazuar në të cilat mund të përmbyset prezumimi i paanësisë subjektive të një gjyqtari, kriteret dhe kërkesat për paanësinë objektive përcaktojnë një garaci shtesë për një gjykim të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës,* cituar më lart, paragrafët 95 dhe 101). Duhet të theksohet se në shumicën e rasteve që ndërlidhen me cështje të paanshmërisë, GJEDNJ është fokusuar dhe ka gjetur shkelje në

aspektin e testit objektiv. (shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë,* Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 146; dhe *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 48).

47. Për sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kur aplikohet mbi një trup gjykues, duhet të determinohet nëse ndaras nga sjellja personale e cilitdo gjyqtarë, mund të ketë fakte të mjaftueshme të cilat mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e gjykatës. Në këtë aspekt edhe dukja/perceptimi mund të ketë rëndësi, sepse "*drejtësia jo vetëm duhet të zbatohet, por ajo duhet të shihet që po të zbatohet*". (Në këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafi 26). Çështja esenciale është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të reflektojnë në publik. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Castillo Algar kundër Spanjës*, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 45; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; dhe *Golubović kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 49). Prandaj, cilido gjyqtar për të cilin mund të ketë arsye legjitime për të dyshuar në mungesë paanshmërie, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 98).

48. Për më tepër, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, situatat në kuadër të të cilave mund të ngrihen çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë, mund të jenë të (i) natyrës funksionale dhe (ii) personale.

49. E para, ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti person ose të natyrës hierarike apo të ndonjë natyre tjetër, në mes gjyqtarit dhe akterëve tjerë në procesin e caktuar gjyqësor. Përkitazi me këto të fundit, niveli dhe natyra e kësaj lidhje duhet të ekzaminohet. Këto situata të natyrës funksionale, mund të përfshijnë shembuj të rasteve kur në të njejtin rast janë ushtruar funksione (i) këshillëdhënëse dhe gjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Procola kundër Luxembourgut*, Aktgjykim i 8 shtatorit 1995, paragrafi 45; *Kleyn dhe të Tjerët kundër Holandës,* Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 200; *Sacilor Lormines kundër Francës*, Aktgjykim i 9 nëntorit 2006, paragrafi 74); (ii) gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *McGonnell v. the United Kingdom*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2000, paragrafët 52-57); dhe (iii) të ndryshme gjyqësore. Në këtë kontekst, GJEDNJ thekson se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procesit gjyqësor mund të ketë rezultuar në shkelje të kërkesave që ndërlidhen me paanësinë e gjykatës, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe varet

nga rrethanat e secilit rast. Ndërsa e dyta, përkatësisht, çështjet e natyrës personale, kryesisht ndërlidhen me mënyrën e sjelljes së një gjyqtari përkitazi me një rast ose ekzistencën e lidhjeve me njërën nga palët apo përfaqësuesit të tij/saj në një rast.

50. Gjykata gjithashtu thekson, se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerësimi i paanësisë së gjykatës në kuptim të testin subjektiv dhe objektiv nënkupton që duhet të determinohet nëse në një rast të caktuar mund të ketë dyshime legjitime për tu frikësuar që një trupi të caktuar gjykues i mungon paanshmëria. Megjithatë, për të vendosur nëse në një rast konkret ka bazë të mjaftueshme për të determinuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, pikëpamja e parashtruesit është e rëndësishme, por jo vendimtare. Ajo që ka rëndësi është vlerësimi i gjykatës nëse një dyshim e tillë mund të justifikohet objektivisht. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 31; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 gushtit 1996, paragrafi 58; *Wettstein kundër Zvicrrës*, cituar më lart, paragrafi 44; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 49 dhe *Tozicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 33).

51. Në aplikimin e këtyre parimeve në kontekst të rrethanave të rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës Supreme, E.H, në të dy rastet e tij, si Kryetar i kolegjit, ngrit frikën dhe dyshimet e tij për paanshmërinë e gjykatës. Megjithatë, Gjykata vëren, që përpos faktit që gjyqtari E.H ishte Kryetar i kolegji në të dyja rastet e parashtruesit të kërkesës, edhe përbërja e kolegjit në Gjykatën Supreme ishte e njëjtë. Aktgjykimi i parë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev.nr.308/2015] i 12 nëntorit 2015, ishte vendosur nga kolegji i përbërë nga gjyqtarët E.H; G.S; dhe M.R. Ky Aktgjykim ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata përmes rastit KI18/16. Aktgjykim i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev.nr.308/2015] i 12 janarit 2017, i cili ishte nxjerrë si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës, ishte vendosur sërisht nga përbërja e njëjtë e kolegjit, nga gjyqtarët E.H; G.S; dhe M.R, respektivisht.

52. Në dritën e këtyre fakteve, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës për anshmërinë e Gjykatës nën testin subjektiv dhe objektiv.

53. Sa i përket testit subjektiv, Gjykata rikujton se paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë e e cila do të mund të vinte në dyshim paanshmërinë e Kryetarit të kolegjit në

Gjykatën Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se në nxjerrjen e Aktgjykimit [Rev.nr.308/2015] të 12 janarit 2017, asnjë fakt nuk mund të mbështet konstatimin se gjykata nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv.

54. Prandaj, Gjykatës i mbetet të vlerësoj paanshëmërinë e gjykatës në kuptimin e testit objektiv, dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, nëse (i) ka fakte dhe rrethana të mjaftueshme e të cilat mund të ngrenë dyshime legjitime sa i përket paanshmërisë së gjykatës; dhe (ii) këto dyshime për paanshmërinë e gjykatës në rrethanat e rastit konkret, mund të jetë objektivisht e justifikueshme.

55. Në kontekst të rrethanave të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht në rrethana kur Gjykata Supreme ka vendosur dy herë nga një kolegj me përbërje identike, për të aplikuar testin objektiv, përtej parimeve të përgjithshme të elaboruara më lart, Gjykata thirret edhe në praktikën konkrete të GjEDNJ-së, përmes të cilës ajo kishte vendosur esencialisht mbi çështje të ngjashme, përkatësisht nëse vendosja dy herë nga një përbërje identike e gjykatave përkatëse mund të cenoi testin objektiv për paanësinë e gjykatës dhe në çfarë rrethana.

56. Në këtë aspekt, GJEDNJ ka mbajtur se jodetyrimisht përbërja e njëjtë e trupave gjykuese në shqyrtimin e një çështje të njëjtë në faza të ndryshme të procesit, rezulton në shkelje të së drejtës në gjykim të paanshëm dhe se shkelje të tilla të mundshme varen nga rrethanat specifike të një rasti. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se si rregull i përgjithshëm, në rastet kur një gjykatë më e lartë e cila kthen një çështje në rishqyrtim, është e detyruar që çështjen të kthej te një kolegj me një tjetër përbërje. (Shih, rastin e GJENDJ-së, *Ringeisen kundër Austrisë*, Aktgjykim i 17 korrikut 1971, paragrafi 97).

57. Më specifikisht, në rastet *Ringeisen kundër Austrisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 17 korrikut 1971); *Diennet Kundër Francës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 26 shtatorit 1995) e *Ilnseher kundër Gjermanisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 4 dhjetorit 2018), Gjykata kishte mbajtur se "*nuk mund të konstatohet si rregull i përgjithshëm, që në aspekt të detyrimit për të qenë i paanshëm, që një gjykatë më e lartë që e kthen një çështje në rishqyrtim, është e detyruar të kthej çështjen te një trup me përbërje të re*". Gjykata kishte theksuar se "*nuk ka bazë për dyshime legjitime që mund të rrjedhin vetëm nga fakti që gjyqtarët që kishin marrë pjesë në nxjerrjen e vendimit të parë, nuk mund të marrin pjesë edhe në të dytin*". Një qëndrim të tillë, Gjykata kishte mbajtur edhe në rastin *Thomman kundër Zvicrës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 majit 1996). Në këtë rast, Gjykata nuk kishte gjetur shkelje në përbërjen e një kolegji që kishte vendosur dy herë përkitazi

me çështjen e të njëjtit parashtrues. Gjykata në këtë rast kishte theksuar se me kthimin e çështjes në rigjykim, "*gjyqtarët e bëjnë një shqyrtim të ri dhe të tërësishëm të çështjes*". (Shih, për më tepër, rastin e GJEDNJ-së, *Thomman kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 33 dhe referencat në të).

58. Megjithatë, në kontekst të trupave gjykues/kolegjeve vendimmarrëse me përbërje të njëjtë, GJEDNJ, në rrethana të caktuara ka gjetur shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Rastet e GJEDNJ-së *Driza kundër Shqipërisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 13 nëntorit 2007) dhe *San Leonard Band Club kundër Maltës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 29 korrikut 2004), hyjnë në këtë kategori.

59. Në rastin e parë, përkatësisht në rastin *Driza kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, ndër të tjera, shqyrtoi pretendimet e parashtruesit përkatës përkitazi me mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Lartë, sepse, sipas pretendimit (i) tre prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues; dhe (ii) Kryetari i Gjykatës së Lartë kishte luajtur rol të dyfishtë gjatë procesit të rekursit të ligjit. Përkitazi me të parën, GJEDNJ gjeti se të tre gjyqtarët që kishin marrë pjesë në trupin gjykues, dy herë kishin vendosur në disfavor të ankuesit dhe si rezultat, një situatë e tillë, mund të ketë ngritur dyshime legjitime tek ankuesi në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Lartë. GJEDNJ më tej kishte vlerësuar nëse këto dyshime ishin objektivisht të justifikueshme. GJEDNJ gjeti ky të jetë rasti sepse të tre anëtarët e turpit gjykues në fakt kishin vendosur përkitazi me një ankesë që ndërlidhej me çështje ligji dhe se të njëjtit "*do të vendosnin nëse kishin gabuar në vendimin e tyre të mëparshëm apo jo*". Ndërsa përkitazi me rolin e Kryetarit të Gjykatës, GJENDJ kishte theksuar se procedurat e rekursit në interes të ligjit kishin filluar me kërkesë të të njëjtit dhe i cili tashmë kishte vendosur njëherë në disfavor të ankuesit, prandaj ajo kishte konstatuar se "*kjo praktikë nuk ishte e pajtueshme me kriterin e paanësisë subjektive të një gjyqtari*" sepse "*askush nuk mund të jetë në të njëjtën çështje paditës dhe gjyqtar*".

60. Ndërsa në rastin e dytë, përkatësisht rastin *San Leonard Band Club kundër Maltës*, GJEDNJ, ndër të tjera, shqyrtoi pretendimet e parashtruesit përkatës përkitazi me mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Apelit, që kishte vendosur përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës së tij për rigjykim. Parashtruesi përkatës pretendoi se i njëjti panel i Gjykatës së Apelit që kishte vendosur përkitazi me Aktgjykimin e 30 dhjetorit 1994, përmes Aktgjykimit të 13 marsit 1995 e kishte refuzuar edhe kërkesën e tij për rigjykim të arsyetuar përmes pretendimeve për aplikim qartazi të gabuar të ligjit. Përputhshmëria me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ishte konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese Malteze, e cila kishte

anuluar një Aktgjykim të Gjykatës Civile dhe e cila kishte trajtuar pretendimet kushtetuese të parashtruesit dhe kishte gjetur shkelje të së drejtës në gjykim të paanshëm si rezultat i përbërjes së njëjtë të panelit të Gjykatës së Apelit. (Shih për më tepër paragrafët 19 deri me 28 të rastit *San Leonard Band Club kundër Maltës*).

61. Në vlerësimin e përputhshmërisë me garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ së pari u lëshua në vlerësimin nëse rrethanat e rastit konkret mund të ngrenë dyshime legjitime përkitazi me paanësisë e gjykatës. Në këtë aspekt, ajo gjeti se fakti që paneli i Gjykatës përkatëse të Apelit kishe vendosur dy herë në të njëjtën përbërje, përbënte një situatë e cila mund të ngrinte dyshime legjitime për paanshmërinë e saj (Shih, arsyetimin e detajuar në këtë kontekst në paragrafët 60, 61 dhe 62 të këtij rasti të GJEDNJ-së). Pas këtij determinimi, GJEDNJ, së dyti, u lëshua në vlerësimin nëse këto dyshime janë objektivisht të justifikueshme. GJEDNJ gjeti ky të jetë rasti. Ajo arsyetoi këtë gjetje bazuar në faktin se gjyqtarët e panelit të Gjykatës së Apelit, herën e dytë ishin të thirrur të vendosin përkitazi me një ankesë që ndërlidhej me çështje të aplikimit të ligjit dhe rrjedhimisht ishin të thirrur vet të vlerësojnë nëse ata kishin aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabueshme, përkatësisht nëse ata vet kishin aftësinë për të aplikuar ligjin në mënyrë të drejtë. (shih për më tepër, paragrafin 63 të rastit konkret).

62. Gjykata vëren se në të dyja rastet, GJEDNJ kishte theksuar dhe kishte pranuar se në rrethana kur trupi i njëjtë gjykues ka vendosur dy herë në të njëjtën çështje, mund të ketë dyshime legjitime nga perspektiva e palëve në proces përkitazi me paanshmërinë e gjykatës dhe se në rrethana të tilla, më tej duhet të vlerësohet nëse këto dyshime mund të jenë në objektivisht të justifikueshme. Sipas GJEDNJ-së, siç është theksuar më lart, ky vlerësim duhet të bëhet në çdo rast veç e veç. (Shih, rastet e GJEDNJ-së *Driza kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafi 80; dhe *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 62).

63. Në vlerësimin nëse në rrethana të tilla dyshimet e parashtruesve të kërkesës mund të jenë objektivisht të justifikueshme, GJEDNJ mbajti se testi esencial ndërlidhet me natyrën e mjetit juridik që është përdorur dhe nëse në specifikat e një rasti, trupi përkatës gjykues është i thirrur për të vlerësuar dhe përcaktuar të metat e pretenduara të vendimit të tyre paraprak ose edhe më specifikisht, nëse aplikimi që ky trup gjykues ia kishte bërë paraprakisht ligjit, është adekuat dhe i mjaftueshëm. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart paragrafi 64). Në rrethana të tilla, GJEDNJ kishte gjetur se frika e palëve sa i përket paanësisë së gjykatave përkatëse është objektivisht e justifikueshme.

64. Në kontest të rrethanave të rastit konkret, Gjykata, duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, vëren se fakti që kolegji në Gjykatën Supreme kishte përbërje identike në të dy rastet, mund të ngritë dyshime legjitime nga perspektiva e palëve në proces përkitazi me paanshmërinë e gjykatës. Rrjedhimisht, në rrethana të tilla, duhet vazhdoj me vlerësimin nëse këto dyshime mund të jenë në objektivisht të justifikueshme.

65. Për të qenë këto dyshime objektivisht të justifikueshme, Gjykata duhet të shqyrtoj natyrën e çështjes që ky kolegj ka vendosur për herën e dytë. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton, që Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e saj të dytë, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.308/2015] e 12 janarit 2017, pas shpalljes së pavlefshme të Aktgjykimit të saj të parë, përkatësisht, Aktgjykimit [Rev.nr.3018/2015] të 12 nëntorit 2015, nga Gjykata në rastin KI18/16. Kjo e fundit, siç është cekur më lart, kishte konstatuar se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj të parë, kishte nxjerrë një vendim i cili nuk përmbushte standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor.

66. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI18/16 kishte të bëj ekskluzivisht me mungesën e arsyetimit të Aktgjykimit paraprak të Gjykatës Supreme, përkatësisht, Aktgjykimit [Rev.nr.308/2015] të 12 nëntorit 2015. Gjykata nuk kishte gjetur shkelje përkitazi me aplikimin qartazi të gabuar apo arbitrar të ligjit. Në rrethanat e rastit konkret, në nxjerrjen e Aktgjykimit të dytë, përkatësisht Aktgjykimit [Rev.nr.308/2015] të 12 janarit 2017, anëtarët e kolegjit të Gjykatës Supreme (i) nuk kanë qenë të thirrur të vlerësojnë dhe determinojnë nëse ata kanë aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar, apo edhe më specifikisht, vet të vlerësojnë aftësinë e tyre për aplikimin e duhur dhe të mjaftueshëm të ligjit; por (ii) kanë qenë të detyruar që të arsyetojnë më tej vendimin e tyre bazuar në specifikat dhe udhëzimet e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI18/16.

67. Rrjedhimisht, rrethanat e rastit konkret dallojnë me ato të rasteve *Driza kundër Shqipërisë* dhe *San Leonard Band Club kundër Maltës*. Kjo sepse në rastin e parë, duke vepruar sipas ankesës, i njëjti kolegj i Gjykatës së Lartë herën e dytë ishte i thirrur të vlerësojë nëse kishte aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar herën e parë, përtej faktit që Kryetari i kolegjit përkatës kishte luajtur rol të dyfishtë në procesin e rekursit të ligjit. Ndërsa, në rastit e dytë, ngjashëm, një kolegj Gjykate Apeli që kishte vendosur një herë në disfavor të parashtruesit përkatës, vendosi edhe herën e dytë për të refuzuar kërkesën e tij për rigjykim, duke qenë i thirrur kështu që herën e dytë të vlerësoj vet nëse ka aplikuar ligjin në mënyrë të drejtë herën e parë.

68. Prandaj, përderisa përbërja e njëjtë e kolegjit në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar në rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është arsye e mjaftueshme për të (i) ngritur dyshime legjitime për parashtruesin e kërkesës për paanshmërinë e kësaj gjykate; megjithatë, (ii) këto dyshime, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë objektivisht të justifikueshme.

69. Kjo sepse, në rrethanat e rastit konkret, siç është cekur më lart, bazuar në konstatimin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI18/16, Gjykata Supreme ka qenë e detyruar vetëm të (i) arsyetoj më tej vendimin e saj paraprak bazuar në udhëzimet e Gjykatës në mënyrë që i njëjti, të plotësoj standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor; dhe (ii) jo të vlerësoj nëse vet ai kolegj herën e parë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar apo thënë ndryshe, të vlerësoj nëse vet ai ka qenë në gjendje të aplikoj ligjin në mënyrë të duhur.

70. Përfundimisht, dhe siç është arsyetuar në këtë Aktgjykim, Gjykata ka gjetur se (i) Gjykata Supreme edhe herën e dytë ka dështuar të arsyetoj mjaftueshëm vendimin e saj, duke konstatuar kështu se edhe Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor në kundërshtim me garancitë e përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; por megjithatë nuk ka gjetur se (ii) ky Aktgjykim është nxjerrë nga një gjykatë e anshme në kuptimin e testit subjektiv dhe objektiv të përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

71. Gjykata në fund vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të paragrafit 4 të nenit 21 të Kushtetutës dhe të cilin vetëm e ka përmendur dhe cituar përmbajtjen e tij pa dhënë shpjegime se si dhe në cilat rrethana të rastit kjo dispozitë mund të jetë cenuar. Për më tepër, kjo dispozitë kushtetuese në substancën e saj në mënyrë specifike iu referohet "*personave juridikë*", duke përcaktuar se të drejtat themelore vlejnë edhe për ata për aq sa janë të zbatueshme, duke nënkuptuar mundësinë që edhe personave juridikë mund t'u cenohen të drejtat dhe liritë themelore kur ato gjejnë zbatim në atë rast konkret. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kanë paraqitur një kërkesë individuale dhe në këtë kontekst, Gjykata nuk gjen se ka ndonjë lidhshmëri në mes të kërkesës së tyre dhe dispozitës përkatëse kushtetuese. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 qershorit 2018, paragrafi 75).

Përfundim

72. Gjykata thekson se (i) e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe (ii) pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, çështje këto të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në rrethanat e rastit konkret, janë çështje esenciale kushtetuese.

73. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka gjetur se Aktgjykimi [Rev.nr 308/2015] i 12 janarit 2017 i Gjykatës Supreme nuk ka evituar të metat e evidentuara nga Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI18/16 dhe rrjedhimisht, vazhdon të mos i plotësojë standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

74. Megjithatë, Gjykata nuk ka gjetur se Aktgjykimi [Rev.nr 308/2015] i 12 janarit 2017 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë nga një gjykatë e anshme në kuptimin e testit subjektiv dhe objektiv të paanshmërisë së gjykatës të përcaktuar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, sepse edhe pse i njëjti është nxjerrë nga përbërja identike e kolegjit dhe i cili kishte vendosur dhe kishte nxjerrë edhe Aktgjykimin paraprak, përkatësisht, Aktgjykimin [Rev.308/2015] e 12 nëntorit 2015, duke rezultuar kështu në dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës, në vlerësimin e Gjykatës këto dyshime, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë objektivisht të justifikueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, në seancën e 17 majit 2019:

I. DEKLARON që kërkesa është e pranueshme.

II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

III. DEKLARON të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 janarit 2017.

IV. KTHEN Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. MBETET e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të urdhrit;

VI. URDHËRON që ky Aktgjykim t'u kumtohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VII. DEKLARON që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI145/18, Parashtruesit: Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018

KI145/18, Aktgjykimi i miratuar më 19 korrik 2019 dhe i publikuar më 15 gusht 2019

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, procedurë civile, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë, kërkesë e pranueshme, shkelje e nenin 31 të Kushtetutës.*

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se gjykatat e rregullta, duke mos ua njohur të drejtën e pronësinë mbi paluajtshmëritë kontestuese, kanë bërë shkelje të barazisë para ligjit, dhe të nenit 6 të Konventës, sepse "*...nga e njëjta bazë juridike si refugjatë të Republikës së Shqipërisë, në të njëjtën kohë, iu është dhënë në shfrytëzim paluajtshmëria (shtëpi dhe tokë), nga e njëjta gjykatë iu është njohur pronësia familjes F. I. nga fshati Babush i Muhaxherëve, nga e njëjta bazë iu është dhënë edhe familjes së E. M., A. M., A. M., A. M. dhe F. D. që të gjithë nga fshati Bregu i Zi i K. Lipjan, pastaj familjes Bresa nga Gracka e Vogël K. Lipjan".* Në mbështetje të pretendimit të tyre, parashtruesit, kërkesës ia kanë bashkëngjitur tre aktgjykime të ish Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 164/2003, të 25 shkurt 2003, C. nr. 146/2009, të 12 nëntor 2007 dhe C. nr. 98/2010, të 21 janar 2014.

Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotësonte kushtet e pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe që janë të saktësuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës. Gjykata konsideroi se Gjykata e Apelit nuk e kishte adresuar fare pretendimin e parashtruesve, të cilët kërkuan qe rasti i tyre të trajtohej ngjashëm, me rastet e tjera ku familjet e tjera, si refugjatë të ardhur nga Republike e Shqipërisë, në vitet e 60-ta, kishin fituar të drejtën e pronësisë mbi pronat kontestuese me posedim faktik me anë të parashkrimit fitues. Pas vlerësimit të procedurave në tërësi, dhe posaçërisht nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata konstatoi se mosadresimi i pretendimit të parashtruesve të kërkesës përbën një të metë të pakapërcyeshme të aktgjykimit dhe si rrjedhojë është në shpërputhje me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.

Si përfundim, Gjykata gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, i 18 qershorit 2018, me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesve të kërkesës, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 të Konventës.[E drejta për një proces të rregullt].

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI145/18

Parashtrues

Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi, me vendbanim në fshatin Babush i Muhaxherëve, komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016 të Gjykatës së Apelit, të 18 qershorit 2018, të cilin e kanë pranuar më 12 korrik 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me nenin 3 dhe

24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), në ndërlidhje me nenin 31 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i Kërkesës], 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 tetor 2018, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 9 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).

7. Më 26 tetor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Një kopje e kërkesës, më 8 maj 2019, iu dërgua Gjykatës së Apelit.

8. Më 10 maj 2019, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, përkitazi me aktgjykimet të cilat parashtruesit ia kanë bashkëngjitur kërkesës.

9. Më 22 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan informoi Gjykatën se aktgjykimet C. nr. 164/2003 (25 shkurt 2003) dhe C. nr. 146/2009 (12 nëntor 2007) janë të formës së prerë, pasi u vërtetuan nga ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi C. nr. 98/2010 (21 janar 2014) të cilit po ashtu i janë referuar parashtruesit e kërkesës *"është kthyer në riprocedurë ku tani udhëhiqet me numër të ri të lëndës C. nr. 526/18 dhe gjendet në procedurën e shqyrtimit gjyqësor"*.

10. Më 19 korrik 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të vlerësojë përmbajtjen e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Kërkesa në fjalë ka të bëjë me disa paluajtshmëri, përkatësisht ngastrat kadastrale nr. 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të evidentuara në fletën poseduese nr. 169 ZK Babush i Muhaxherëve, komuna e Lipjanit. Paluajtshmëritë në fjalë janë blerë nga Komuna e Lipjanit, nga disa pronarë privat (në vitet e 1960-ta). Mjetet për blerjen e tyre i kishte siguruar Fondi Ndërkombëtar për Refugjat të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me seli në Gjenevë të Zvicrës, me qëllim të strehimit dhe integrimit të refugjatëve të ardhur nga Shqipëria në vitet e 1960-ta. Këto paluajtshmëri iu janë dhënë më pas në shfrytëzim, me mirëbesim, parashtruesve të kërkesës në vitin 1969. Megjithatë, pronësia mbi këto paluajtshmëri që nga ajo kohë kishte mbetur e regjistruar në emër të Komunës së Lipjanit.

12. Më 25 shkurt 2009, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan, me të cilën kërkuan vërtetimin e pronësisë së paluajtshmërive të sipërcekura, me pretendimin se të njëjtat i kanë fituar me posedim të ligjshëm nga viti 1969, nga Komuna e Lipjanit, në bazë të kontratës Vr. nr. 248/68, të 17 qershorit 1968.

13. Më 16 gusht 2010, Gjykata Komunale në Lipjan, me Aktgjykimin C. nr. 48/2009, aprovoi padinë e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e posedimit të ligjshëm mbi paluajtshmëritë nr. 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të regjistruara në fletën poseduese nr. 169 ZK Babush i Muhaxherëve. Me këtë aktgjykim gjykata e detyroi të padituren, Komuna e Lipjanit, që parashtruesve të kërkesës t'ua njohë të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë në fjalë dhe të lejojë regjistrimin e tyre në pronësi të parashtruesve të kërkesës, në regjistrat e paluajtshmërive në Komunën e Lipjanit, zona kadastrale Babush i Muhaxherëve.

14. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyetoi si në vijim: *"Mbi bazën e [këtyre] fakteve gjykata në mbështetje të dispozitave nga neni 28 al. 4 të Ligjit për Marrëdhënie Pronësoro-Juridike vjen në përfundim se paditësit si posedues të ndërgjegjshëm e kanë fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese të përshkruar në pikën I të dispozitivit me kalimin e kohës prej 20 viteve si posedues me mirëbesim, edhe përkundër faktit se kjo paluajtshmëri është e regjistruar në librat e Operatit Kadastral në emër të padituresë, pasi që me nenin 16 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Bazë Pronësoro-Juridike nr. 29 të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSJ-së nr. 29/1996 me të cilën dispozitë është fshirë neni 29 i Ligjit në fjalë i cili ka paraparë se në sendet në pronësi shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me mbajtje, ashtu që pas*

fshirjes së kësaj dispozite ligjore prona shoqërore dhe ajo private janë barazuar në pikëpamje të fitimit të së drejtës së pronësisë me mbajtje".

15. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Lipjanit parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

16. Më 14 nëntor 2014, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 1855/12 e prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të njëjtin e kthen në rigjykim dhe rivendosje, me arsyetimin se "... *vlerësimi juridik i gjykatës të shkallës së parë se në bazë të institutit të parashkrimit fitues pala paditëse e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të nenit 28 par. 4 të LMTHJP-së, e lidhur me nenin 16 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, nuk mund të qëndron, për arsye se edhe në bazë të dispozitave të Ligjit të punës së bashkuar, rregullave juridike të së drejtës civile dhe nenit 29 të LMTHJP-së e drejta e pronësisë në pronësinë shoqërore nuk mund të fitohet në bazë të parashkrimit fitues".*

17. Më 11 nëntor 2015, Gjykata e Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, bashkoi dy padi, atë të parashtruesve të kërkesës dhe të disa paditësve të tjerë, të cilët po ashtu kërkuan vërtetimin e pronësisë së paluajtshmërive të sipërcekura, dhe me një lëndë të vetme vendosi të:

1) refuzojë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës me të cilën kërkuan vërtetimin e pronësisë së ngastrave me nr. 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të regjistruara në ZK Babush i Muhaxherëve, në fletën poseduese me numër 169, me arsyetimin se "*Meqenëse në rastin konkret paditësit Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi, nga fsh. Babush i Muhaxherëve, me asnjë provë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nuk e kanë argumentuar mënyrën e fitimit të pronësisë për paluajtshmërinë e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, siç parashohin dispozitat e lartcekura për këtë arsye gjykata e refuzoj kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi".*

2) refuzojë kërkesëpadinë e paditësve A. L., M. L. dhe A. L., nga Babushi i Muhaxherëve, të cilët po ashtu kërkuan vërtetimin e pronësisë së ngastrave me numër 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të regjistruara në ZK Babush i Muhaxherëve, mbi bazën e kontratës së shitblerjes së vitit 1966, me pretendim se paraardhësi

i tyre ka paguar çmimin në emër të kaparit nga 1/3 e çmimit të përgjithshëm në lidhje me paluajtshmëritë në fjalë.

18. Më 29 dhjetor 2015, parashtruesit e kërkesës, kundër aktgjykimit të shkallës së parë, të 11 nëntorit 2015, paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurave kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesit në mënyrë të veçantë kërkuan nga gjykata në fjalë që rasti i tyre të trajtohet ngjashëm me disa raste të njëjta (të disa familjeve tjera), të cilët kishin fituar të drejtën e pronësisë me anë të parashkrimit fitues.

19. Më 18 qershor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 530/18, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 19/2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, të 11 nëntorit 2015, me arsyetimin si në vijim:

> *"Për fitimin e të drejtës së pronësisë në mënyrë komplete duhet të plotësohen dy kushtet ligjore, të ekzistojë baza e vlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë (nenin 20 i ligjit të lartpërmendur), por përveç kësaj e drejta e pronësisë fitohet edhe me regjistrim në librat publike të patundshmërisë ose në mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj (neni 33 i po këtij ligji). Nga kjo rrjedh, se përveç bazës juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë duhet të ekzistojë edhe mënyra juridike e fitimit, e në këtë rast nuk ekziston nga fakti se patundshmëria ende evidentohet si pronësi shoqërore në emër të Komunës së Lipjanit.*
>
> *Gjykata e shkallës së dytë e pranon vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, se në bazë të institutit të parashkrimit fitues, paditësit e parë nuk kanë mundur ta fitojnë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese edhe pse me dispozitën e nenit 16 të Ligjit mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e LMTHPJ-së, "Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/26, i cili ka hyrë në fuqi më 05.07.1996 është përcaktuar se fshihet neni 29 i këtij ligji, mirëpo kjo dispozitë nuk mund të aplikohet në këtë çështje konkrete juridike por eventualisht ka mundësi të aplikohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në çështjen e paditësve kjo dispozitë nuk ka qenë në fuqi, kurse vlen parimi se në raportet juridike-civile aplikohet ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil. Sipas këtyre dispozitave duke marrë edhe për bazë dispozitat e Ligjit të Punës së Bashkuar, e drejta e pronësisë në pronësi shoqërore në asnjë rrethanë nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit. Nga arsyet e paraqitura gjykata vlerëson*

se paditësit e parë nuk kanë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për t'iu njohur e drejta e pronësisë sipas parashkrimit fitues dhe atë në bazë të nenit 28 të LMTHJP-së".

20. Më 9 gusht 2018, parashtruesit e kërkesës pranë Prokurorisë së Shtetit paraqitën kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 18 qershorit 2018, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 27 gusht 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me Njoftimin KMLC. nr. 117/2018, njofton parashtruesit e kërkesës se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për të paraqitur kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

22. Më 31 gusht 2018, parashtruesit e kërkesës paraqesin kërkesë për rishqyrtim pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të propozimit për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke u thirrur në diskriminim, përkatësisht trajtim të pabarabartë.

23. Në një datë të paspecifikuar, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit shqyrton kërkesën e parashtruesve dhe arsyeton: "*... përsëri ju njoftojmë se ne kemi konstatuar se nuk kemi bazë ligjore për paraqitjen e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, sepse ky mjet nga ana jonë mund të paraqitet vetëm nëse shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po që se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po që se është vendosur për kërkesën rreth së cilës kontestimi i çështjes në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore ose nëse është bërë shkelja e të drejtës materiale". Në rastin konkret, sipas gjetjeve tona nuk qëndron asnjëra nga këto kushte ligjore për paraqitjen e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta, duke mos ua njohur të drejtën e pronësinë mbi paluajtshmëritë kontestuese, kanë bërë shkelje të barazisë para ligjit, dhe të nenit 6 të Konventës, nga shkaqet dhe arsyet vijuese:

"paditësit janë me përkatësi ashkalinjë, pakicë, ndërsa nga e njëjta bazë juridike si refugjatë të Republikës së Shqipërisë, në të njëjtën kohë, iu është dhënë në shfrytëzim paluajtshmëria (shtëpi dhe tokë), nga e njëjta gjykatë iu është njohur pronësia familjes F. I. nga fshati Babush i Muhaxherëve, nga e njëjta bazë iu është dhënë

edhe familjes së E. M., A. M., A. M., A. M. dhe F. D. që të gjithë nga fshati Bregu i Zi i K. Lipjan, pastaj familjes Bresa nga Gracka e Vogël K. Lipjan". Gjykatës Kushtetuese së bashku me këtë kërkesës ia bashkëngjisim edhe një aktgjykim ku është vendosur për njohjen e pronësisë nga e njëjta gjykatë për Xh.H. nga fsh. Babush i Muhaxherëve, K. Lipjan, ku rasti është identik si për nga gjendja faktike dhe ajo juridike. Dhe në këtë mënyrë për rastin identik gjykata për shkak se janë ashkalinjë paditësve nuk ua ka njohur të drejtën e pronësisë, ndërsa të gjitha rasteve tjera po. Më ketë ka shkelur barazinë para ligjit".

25. Në mbështetje të pretendimit të tyre, parashtruesit, kërkesës ia kanë bashkëngjitur tre aktgjykime të ish-Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 164/2003, të 25 shkurt 2003, C. nr. 146/2009, të 12 nëntorit 2007 dhe C. nr. 98/2010, të 21 janarit 2014.

26. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata të ndryshojë Aktgjykimin C. nr. 19/2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, të 11 nëntorit 2015 dhe të aprovojë kërkesëpadinë e tyre për njohje të pronësisë së paluajtshmërive të kontestuara, ose të prishet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, C. nr. 19/2015, të 11 nëntorit 2015 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, i 18 qershorit 2018 dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
>
> *[...]".*

29. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47

[Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

30. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara; kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion; kanë qartësuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e kontestojnë dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendojnë se u janë cenuar, si dhe kanë dorëzuar kërkesën në kohë.

31. Më tej, Gjykata shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 39 (1) (d) dhe 39 (2) të Rregullores, që përcaktojnë:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) "Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese".

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

32. Gjykata konsideron se kërkesa ngre një pretendim kushtetues të arsyetuar *prima facie*, ndërkohë që ajo nuk është qartazi e pabazuar, në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores.

33. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë meritat e rastit, duke shqyrtuar pretendimet ashtu sikur janë paraqitur në kërkesë.

Meritat e kërkesës

34. Fillimisht, Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës detyron Gjykatën Kushtetuese që "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

35. Përkitazi me të drejtat e kërkuara nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), që përcakton se*: "Një ankesë është e karakterizuar nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet"* (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Ştefanica dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimin i 2 nëntorit 2010, paragrafi 23).

36. Prandaj, Gjykata do të analizojë ankesat e parashtruesve të kërkesës, duke u mbështetur në faktet e pretenduara dhe provat e bashkëngjitura në kërkesë, në mënyrë që t'u përgjigjet pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.

37. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018, me të cilin u konfirmua Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, C. nr. 19/2015, i 11 nëntorit 2015. Ata pretendojnë se këto aktgjykime kanë shkelur të drejtën e tyre për "barazi para ligjit", të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe të drejtën për një "proces të rregullt gjyqësor", të garantuar me nenin 6 të Konventës.

38. Në lidhje me këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës si pretendim kryesor në Gjykatë e ngrenë çështjen e trajtimit ndryshe të rastit të tyre, në krahasim me disa raste identike të tjera. Parashtruesit theksojnë se e njëjta gjykatë (duke aluduar në ish-Gjykatën Komunale në Lipjan), ua njohu disa familjeve të tjera të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, ndërsa në rastin e tyre gjykatat nuk i morën parasysh rrethanat e njëjta faktike dhe juridike. Në mbështetje të këtij pretendimi, ata kërkesës ia kanë bashkëngjitur tri vendime të gjykatave të njëjta, për raste identike (shih paragrafin 25 të këtij Aktgjykimi).

39. Gjykata në bazë të parimit të subsidiaritetit, përkatësisht shterimit të mjeteve efektive juridike në kuptimin thelbësor, do të vlerësojë nëse pretendimi i parashtruesve të kërkesës, në lidhje me trajtimin ndryshe të rasteve me rrethana të njëjta faktike dhe juridike, është ngritur para gjykatave të rregullta dhe nëse është adresuar nga ana e tyre, në pajtueshmëri me të drejtën për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës.

40. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 31 të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës, përcaktojnë:

Neni 31 [E drejta për Gjykim te Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës

1. "Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".

2. "Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Neni 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] i Konventës

1."Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

41. Gjykata, para së gjithash, rikujton se garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafin 1 të Konventës, përfshijnë detyrën e gjykatave që të bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre. Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *H. kundër Belgjikës,* kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987).

42. Gjykata, gjithashtu, thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 6, paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81.).

43. Lidhur me këtë, GJEDNJ shton se gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e pretendimeve dhe në lejimin e provave, por ajo gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsyetime për vendimet e saj (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa 37801/97, të 1 korrikut 2003, paragrafi 36).

44. Gjithashtu, Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61).

45. Gjykata dëshiron të theksojë se nocioni i një gjykimi të drejtë, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët. Kjo kërkesë është edhe më e rëndësishme në rast kur një palë në kontest nuk ka pasur mundësi për të paraqitur gojarisht rastin e saj në procedurën vendore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Helle kundër Finlandës,* kërkesa 157/1996/776/977, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60).

46. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017).

Zbatimi i parimeve të përmendura mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar në këtë rast

47. Gjykata rikujton se gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe *B. Vidal kundër Belgjikës,* 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235).

48. Siç u përmend më sipër, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimi i parashtruesve të kërkesës është adresuar nga gjykatat e rregullta në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm.

49. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata, vëren se, parashtruesit e kërkesës pretendimin për trajtim të pabarabartë para gjykatave të rregullta e kishin ngritur fillimisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, e cila me Aktgjykimin C. nr. 19/2015 të 11 nëntorit 2015, arsyetoi se:

> "*... në rastin konkret ka gjykuar dhe vendosur në bazë të Ligjit e jo sipas praktikës gjyqësore dhe duke i respektuar poashtu edhe udhëzimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës*".

50. Gjykata vëren se pretendimin e njëjtë parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur edhe në Gjykatën e Apelit, ku në mënyrë specifike ata në ankesën e tyre theksuan se:

> "*... gjykatës i kanë prezantuar edhe aktgjykimin e plotfuqishëm, ku nga e njëjta bazë është fituar e drejta e pronësisë ndaj rastit identik të ngjashëm si refugjatë, në fshatin e njëjtë, mirëpo*

gjykata nuk e ka marrë për bazë këtë aktgjykim, me arsyetimin se ka vendosur në bazë të ligjit e jo sipas praktikës gjyqësore".

51. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, C. nr. 19/2015, të 11 nëntorit 2015, pa e adresuar fare pretendimin e parashtruesve të kërkesës, përkitazi me vendosjen e rastit të tyre në linjë me praktikën gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, siç kishte vendosur në rastet e familjeve tjera në rrethana identike.

52. Gjykata vëren se të njëjtin pretendim parashtruesit e kërkesës e kishin ngritur edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Kjo kërkesë iu ishte refuzuar, me arsyetimin se nuk ekzistonte baza ligjore për ushtrimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni tjetër i një vendimi të arsyetuar është t'u dëshmojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u ofrojë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI72/12, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012).

54. Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta nuk janë të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës. Megjithatë, ato duhet të adresojnë pretendimet kryesore që janë themelore për çështjen në shqyrtim - për më tepër nëse ato ngrihen në fazat të ndryshme të procedurës, siç ka ndodhur me kërkesën e tanishme (shih përshtatshmërisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese: KI135/14, Aktgjykim i 8 shkurtit 2016 dhe KI22/16, Aktgjykimi i 2 majit 2017).

55. Gjykata përsërit se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbi të gjitha, përfshin obligimin e gjykatave për të ofruar arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre, si në aspektin procedural po ashtu edhe në aspektin material (shih Gjykata Kushtetuese, rasti KI135/14, Aktgjykimi i 8 shkurtit 2016 dhe rasti KI22/16, Aktgjykimi i 2 majit 2017).

56. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata nga rasti në rast, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse

vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Masa deri në të cilën aplikohet detyra për ta arsyetuar vendimin mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (*Hirvisaari kundër Finlandës,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 27 shtatorit 2001, par. 30).

57. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për trajtim të pabarabartë para gjykatave, i cili ishte ngritur para gjykatave të rregullta ishte thelbësor dhe i mbështetur me dëshmi materiale i cili ngrente çështje nga neni 24 i Kushtetutës, përkatësisht çështjen e pabarazisë së palëve para ligjit. Adresimi i duhur i pretendimit në fjalë nga ana e gjykatave të rregullta do të forconte bindjen e parashtruesve të kërkesës se ata janë dëgjuar në mënyrë të duhur, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të Konventës.

58. Sikur Gjykata e Apelit të adresonte pretendimin thelbësor të parashtruesve të kërkesës për trajtim të pabarabartë nga ana e gjykatës së shkallës së parë - pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej këtij pretendimi (pra, pavarësisht nëse ky pretendim do të pranohej si i arsyetuar apo do të refuzohej si i pabazë), atëherë do të përmbushej kushti i "palës së dëgjuar" dhe i administrimit të duhur të drejtësisë.

59. Gjykata vë në pah se nuk është në detyrën e Gjykatës Kushtetuese të ekzaminojë deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale e kërkon që pretendimeve themelore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur – posaçërisht nëse kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme sikurse në rastin konkret është barazia para ligjit. Kjo vlen veçanërisht për arsyetimin e vendimeve ku gjykatat vendosin të ndryshojnë qëndrimin juridik të tyre, për raste me rrethana të njëjta faktike dhe juridike, d.m.th., kur devijojnë nga praktika e mëparshme gjyqësore.

60. Pas vlerësimit të procedurave në tërësi, dhe posaçërisht nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata konstaton se mosadresimi i pretendimit të parashtruesve të kërkesës përbën një të metë të pakapërcyeshme të aktgjykimit dhe si rrjedhojë është në shpërputhje me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.

61. Gjykata sapo ka konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, i 18 qershorit 2018, është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata e konsideron të panevojshme që në këtë fazë të trajtojë pretendimet e parashtruesve

për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të Konventës.

62. Si përfundim, Gjykata gjen se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, i 18 qershorit 2018, me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesve të kërkesës, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 të Konventës [E drejta për një proces të rregullt].

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit, rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 19 korrik 2018, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË shkelje të nenit 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të KEDNJ-së;

III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës se Apelit, Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018, dhe KTHEN të njëjtin për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës;

IV. MBETET e përkushtuar ndaj çështjes, në pritje të respektimit të këtij urdhri;

V. URDHËRON që Aktgjykimi i saj KI145/18 t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VI. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI128/17, Parashtrues i kërkesës: Naser Husaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2017, të 23 gushtit 2017

KI128/17, Aktgjykim i miratuar më 29 korrik 2019, i publikuar më 28 gusht 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së*

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse Kolegji vendimmarrës në Gjykatën Supreme ishte i anshëm për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtares G. S., kundër të cilës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kallëzim penal në vitin 2015 për shkak të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore dhe konfliktit të interesit, vepra penale këto të përcaktuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kallëzimi përkatës penal sipas shkresave të lëndës ndërlidhej me një rast tjetër të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht, Aktgjykimin [Rev. nr. 335/2015] e 14 dhjetorit 2015 dhe i cili më pas, përkatësisht më 9 qershor 2017, ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata në rastin nr. KI22/16.

Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës e që ndërlidhen me një gjykatë të paanshme, Gjykata, ndër të tjera, elaboroj (i) parimet e përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me kriteret për vlerësimin e paanësisë së një gjykate; (ii) konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës; dhe (iii) praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aspekt të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përkatësisht konceptin e "*dyshimeve legjitime*" dhe faktit që të njëjtat duhet të jenë "*objektivisht të justifikueshme*" në mënyrë që të konstatohet paanësia e një gjykate.

Në aplikimin e parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret, Gjykata theksoi se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse (i) përkundër faktit që Kryetare e Kolegjit që nxori Aktgjykimin e kontestuar ishte një gjyqtare kundër së cilës parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kallëzim penal, asnjë provë apo argument tjetër i parashtruesit të kërkesës nuk përmbys prezumimin e paanësisë së gjyqtares përkatëse; dhe për më tepër, (ii) përkundër faktit që pjesëmarrja e gjyqtares përkatëse në Kolegjin e Gjykatës Supreme mund të

ketë ngritur dyshime legjitime për paanësinë e gjykatës nga ana e parashtruesit të kërkesës, këto dyshime, në vlerësimin e Gjykatës, nuk janë objektivisht të justifikueshme në kuptimin e testit objektiv për paanësinë e gjykatës.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se kallëzimi penal kundër gjyqtares G. S., dhe i pambështetur nga rrethana dhe argumente tjera, nuk është i mjaftueshëm për të determinuar se gjyqtarja G. S. ka qenë e anshme në kuptimin e testit subjektiv dhe se Kolegji i Gjykatës Supreme që ka nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, të ketë qenë i anshëm në kuptimin e testit objektiv.

Në fund, Gjykata shpalli kërkesën të pranueshme dhe konstatojë se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI128/17

Parashtrues

Naser Husaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2017, të 23 gushtit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Husaj, avokat nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 170/2017] të 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [CA. nr. 3235/2013] e 6 shtatorit 2016 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 171/07] e 12 marsit 2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 1 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 3 nëntor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović, Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 8 nëntor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 22 gusht 2018, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin nr. GJR. KI128/17 për zëvendësimin e Gjyqtarit raportues dhe Gjyqtare raportuese u caktua Gresa Caka-Nimani. Ndërsa, më 25 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori Vendimin nr.KSH.KI128/17 për zëvendësimin e kryesuesit të Kolegjit shqyrtues dhe kryesuese u caktua: Arta Rama-Hajrizi.

12. Më 29 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

13. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme është në përputhje me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës ushtronte profesionin e avokatit dhe njëherësh ishte anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Oda e Avokatëve).

Në lidhje me procedurën penale dhe administrative

15. Gjatë periudhës sa ishte duke e ushtruar profesionin e avokatit, ndaj parashtruesit të kërkesës filloi të zhvillohej procedura penale për shkak të veprës penale të mashtrimit të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 140 të Ligjit Penal të Kosovës.

16. Më 3 korrik 2002, Gjykata Komunale në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) përmes Aktgjykimit [P. nr. 155/2002] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të mashtrimit të përcaktuar me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), duke i shqiptuar dënimin me 9 (nëntë) muaj burgim, me kusht që brenda 2 (dy) viteve të mos kryejë ndonjë vepër penale tjetër.

17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 5 gusht 2002, Oda e Avokatëve, duke u bazuar në nenin 46 të Ligjit mbi Avokaturën dhe Ndihmën tjetër Juridike të 24 dhjetorit 1979 (në tekstin e mëtejmë: Ligji mbi Avokaturën), përmes Aktvendimit pezulloi të drejtën e ushtrimit të profesionit të parashtruesit të kërkesës deri në përfundimin e procedurës disiplinore dhe procedurës penale kundër tij. Kundër këtij Aktvendimi, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme.

19. Më 21 prill 2004, Gjykata e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut) përmes Aktgjykimit [AP.nr.1/2003] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale.

20. Sipas shkresave të lëndës, në po të njëjtën datë, përkatësisht më 21 prill 2004, Oda e Avokatëve, përmes Aktvendimit nr. 111, e ndërpreu masën e pezullimit ndaj parashtruesit të kërkesës dhe lejoi vazhdimin e ushtrimit të profesionit të avokatit përkatës. Oda e Avokatëve arsyetoi se (i) procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës kishte përfunduar në formë të prerë përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut; dhe (ii) procedura disiplinore nuk ishte zhvilluar.

21. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

22. Më 16 dhjetor 2004, Gjykata Supreme duke vendosur në konflikt administrativ sipas padisë së parashtruesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [A. nr. 442/2002] e anuloi Aktvendimin e Odës së Avokatëve, ndër të tjera, me arsyetimin se i njëjti (i) ishte në kundërshtim me Ligjin e aplikueshëm të Procedurës së Përgjithshme Administrative; (ii) ishte nxjerrë në bazë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) nuk përmbante arsyetim të mjaftueshëm.

23. Më 18 mars 2005, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PKL.nr.16/2004] e miratoi pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe ndryshoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Qarkut, vetëm sa i përket cilësimit juridik të

veprës penale, duke përcaktuar se veprimet e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, përmbushin elementet e veprës penale të mashtrimit, siç përcaktohet me paragrafin 1 të nenit 261 (Mashtrimi) të KPPK-së.

Në lidhje me procedurën civile

24. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se më 28 shkurt 2005, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar padinë kundër Odës së Avokatëve për kompensim dëmi. Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [C. nr. 286/05] të 22 marsit 2005, kishte shpallur vetën jokompetente përkitazi me kompetencën territoriale, duke urdhëruar që çështja të dorëzohet në kompetencë të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Kundër këtij Aktvendimi parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë. Gjykata e Qarkut, përmes Aktvendimit [CA.nr.121/05] të 4 dhjetorit 2006, kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale përkitazi me kompetencën territoriale.

25. Përmes kërkesës për kompensim dëmi, parashtruesi i kërkesës kërkoi kompensimin e dëmit material dhe jomaterial. Përkitazi me të parin, kërkoi që Oda e Avokatëve t'i paguaj shumën prej 210,000 euro për shkak të fitimit të humbur, ndërsa përkitazi me të dytin, kërkoi që Oda e Avokatëve t'i paguaj shumën prej 510,000 euro për shkak të cenimit të integritetit moral dhe profesional, duke përfshirë kamatën prej 4.5% nga 27 prilli 2004.

26. Më 12 mars 2013, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 171/07] refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar, ndër të tjera, se nuk ishin përmbushur kushtet e përcaktuara me nenet 154 (Bazat e përgjegjësisë), 155 (Dëmi), 189 (Dëmi i thjeshtë dhe përfitimi i munguar) dhe 198 (Mbi kompensimin e dëmit material në rast të shkeljes së nderit dhe të përhapjes së thënieve të rreme) të Ligjit për Marrëdhëniet të Detyrimeve të 30 marsit 1978 (në tekstin e mëtejmë: LMD).

27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ose i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

28. Më 2 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit kundër gjyqtarit A. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore, gjyqtarit Q. A., gjyqtar në Gjykatën e Apelit, dhe kundër gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, M. R., G. S., E. H., për kryerjen e veprave penale të (i) nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore të përcaktuar me nenin 432 dhe (ii) të konfliktit të interesit të përcaktuar me nenin 424 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK). Kallëzimi penal përkitazi me gjyqtarët e Gjykatës Supreme, ndërlidhej, ndër të tjera, me pjesëmarrjen e tyre në një kolegj i cili përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 335/2015] të 14 dhjetorit 2015, refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion në një rast tjetër të parashtruesit të kërkesës.

29. Më 6 shtator 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA. nr. 3235/2013] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

30. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

31. Më 23 gusht 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.170/2017] e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 170/2017] të 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

33. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë nga një gjykatë e anshme sepse pjesë e kolegjit vendimmarrës ka qenë edhe gjyqtarja G. S., kundër të cilës parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kallëzim penal më 2 shkurt 2015 në lidhje më Aktgjykimin [Rev. nr. 335/2015] e 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme dhe i cili më pas, përkatësisht më 9 qershor 2017, ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata në rastin nr.

KI22/16. (Shih rastin e Gjykatës nr. KI22/16 me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017).

34. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesën e tij të shpallë të pranueshme, dhe që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të shpallet i pavlefshëm, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në*
> *mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> [...]
>
> *" 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

37. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë*".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ".

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.170/2017] e 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

39. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kritereve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

40. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

[...]

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KREU III

PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI

Neni 67

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

b) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë

se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo;

c) në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;

d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;

e) në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;

f) në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;

g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

Meritat

41. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit në korrik të vitit 2002 nga Gjykata Komunale. Si rezultat i këtij Aktgjykimi, Oda e Avokatëve, kishte pezulluar të drejtën e tij për ushtrimin e profesionit të avokatit. Përgjatë vitit 2004, ishin nxjerrë tri vendime relevante që ndërlidheshin me procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës por edhe me procedurën administrative përkitazi me Aktvendimin e Odës së Avokatëve. Së pari, Gjykata e Qarkut kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale përkitazi me veprën penale të mashtrimit. Së dyti, si rezultat i këtij Aktgjykimi, Oda e Avokatëve kishte ndërprerë masën e pezullimit të ushtrimit të profesionit kundër parashtruesit të kërkesës. Së treti, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, kishte shpallur të paligjshëm Aktvendimin e Odës së Avokatëve. Gjykata vëren megjithatë, që i njëjti ishte anuluar nga Oda e Avokatëve para Aktgjykimit përkatës të Gjykatës Supreme përkitazi me procedurën administrative, duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut përkitazi me procedurën penale. Në vitin 2005, Gjykata Supreme, kishte miratuar Aktgjykimet e gjykatave të ulëta përkitazi me veprën penale të mashtrimit, duke e përfunduar rrjedhimisht procesin penal kundër parashtruesit të kërkesës.

42. Duke filluar nga viti 2005, parashtruesi i kërkesës kishte paditur Odën e Avokatëve për kompensim dëmi material dhe jomaterial si rezultat i Aktvendimit përmes të cilit ishte pezulluar e drejta e tij për ushtrim të profesionit. Kërkesa e tij për kompensim dëmi ishte refuzuar përmes tri Aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktgjykimit [C. nr. 171/07] të 12 marsit 2013 të Gjykatës Themelore, të vërtetuar përmes Aktgjykimit [CA. nr. 323/2013] të 6 shtatorit 2016 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit [Rev. nr. 170/2017] të 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme. Këtë të fundit parashtruesi i kërkesës e konteston në Gjykatë, duke e kontestuar përbërjen e Kolegjit përkatës vendimmarrës, në të cilin kryetare e Kolegjit ishte gjyqtarja G. S., kundër të cilës, parashtruesi i kërkesës në vitin 2015 kishte paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit. Sipas parashtruesit të kërkesës, pjesëmarrja e gjyqtares G. S. në Kolegjin e Gjykatës Supreme, rezulton në shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

43. Gjykata vëren se kallëzimi penal kundër gjyqtares G. S., sipas shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ndërlidhet me pjesëmarrjen e saj në Kolegjin vendimmarrës të Gjykatës Supreme përkitazi me Aktgjykimin [Rev. nr. 335/2015] e 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme dhe të cilin Gjykata, më 9 qershor 2017, përmes rastit KI22/16 e kishte shpallur të pavlefshëm.

44. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se objekti i çështjes të cilin Gjykata e kishte trajtuar në rastin KI22/16 përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev.nr.335/2015] të 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme dhe objekti i çështjes në rastin e tanishëm, përkitazi me vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 170/2017] të 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme, janë të ndryshme dhe nuk janë të ndërlidhura. Në të parin, përkatësisht në rastin KI22/16, çështja kishte të bëj me një vërtetim pronësie, ndërsa pretendimet e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë ndërlidheshin me pjesëmarrjen e gjyqtarit Q. A. në Kolegjin e Gjykatës së Apelit dhe kundër të cilit, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte paraqitur kallëzim penal. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se Kolegji i Gjykatës Supreme, pjesë përbërëse e të cilit ishte gjyqtarja G. S., kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për revizion, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 335/2015] të 14 dhjetorit 2015, pa i arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për gjykim të anshëm në nivel apeli, për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit Q. A. në Kolegjin përkatës.

45. Përmes Aktgjykimit në rastin KI22/16, Gjykata kishte shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, për shkak të vendimit të paarsyetuar gjyqësor në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, specifikisht sepse Gjykata Supreme nuk kishte trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pjesëmarrjen e gjyqtarit Q. A. në vendimmarrje në Gjykatën e Apelit. (Shih, rastin KI22/16, cituar më lart, paragrafët 39, 45, 46, 50 dhe 51).

46. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI22/16 kishte shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev.nr.335/2015] e 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme, vetëm sa i përket mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI22/16 nuk ndërlidhet në asnjë mënyrë me përbërjen e Kolegjit vendimmarrës në Gjykatën Supreme dhe as me pjesëmarrjen e gjyqtares G. S. në përbërjen e tij.

47. Për më tepër, për dallim nga rasti KI22/16 në të cilin parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar pjesëmarrjen e gjyqtarit Q. A. në vendimmarrje në Gjykatën e Apelit, sepse kundër të njëjtit, kishte paraqitur kallëzim penal, në rrethanat e rastit të tanishëm, parashtruesi i kërkesës konteston pjesëmarrjen e gjyqtares G. S. në Kolegjin e Gjykatës Supreme dhe kundër të cilës, parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kishte paraqitur kallëzim penal.

48. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse Kolegji vendimmarrës në Gjykatën Supreme, sipas pretendimit, ishte i anshëm për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtares G. S., do të shqyrtohen duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

49. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton se paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të përcaktohet sipas (i) testit subjektiv, rrjedhimisht në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar se një gjyqtar mund të ketë pasur paragjykime personale apo anshmëri në një rast të caktuar; dhe (ii) testit objektiv, rrjedhimisht konstatimit nëse vet

gjykata, mes tjerash, përbërja e saj, ka ofruar garancione të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Miracle Europe KFT kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 12 prillit 2015, paragrafët 54 dhe 55; *Gautrin dhe të Tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 58; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 58; *Thomann kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 30; *Wettstein kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2000, paragrafi 42*; Korzeniak kundër Polonisë*, Aktgjykim i 10 janarit 2017, paragrafi 46; dhe rasti i Gjykatës KI06/12, me parashtrues *Bajrush Gashi*, Aktgjykim i 9 majit 2012, paragrafi 45).

50. Më specifikisht, sa i përket testit subjektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 30 nëntorit 2005, paragrafi 30; *Padovani kundër Italisë*, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 26; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 59; *Hauschildt kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989, paragrafi 47; *Driza kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 75; dhe *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 47). Për sa i përket llojit të provave të nevojshme për të dëshmuar një gjë të tillë, GJEDNJ, për shembull, është përpjekur që të vërtetojë nëse një gjyqtar tregon armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale. Në determinimin nëse në një rast të caktuar mund të ketë dyshime legjitime për mungesën e paanshmërisë së një gjyqtari, qëndrimi i palës përkatëse është më rëndësi, por jo vendimtar. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 26 tetorit 1984, paragrafi 25). Megjithatë, parimi mbi bazën e të cilit duhet të supozohet se gjykata është e liruar nga paragjykimet apo njëanshmëria personale, është i vendosur për një kohë të gjatë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kyprianou kundër Qipros*, cituar më lart, paragrafi 119; *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 93-94; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 33).

51. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përderisa në disa raste mund të jetë e vështirë të gjenden faktet bazuar në të cilat mund të përmbyset prezumimi i paanësisë subjektive të një gjyqtari, kriteret dhe kërkesat për paanësinë objektive të gjykatës, përcaktojnë një garanci shtesë për një gjykim të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës,* cituar më lart, paragrafët 95 dhe 101). Duhet të theksohet se në shumicën e rasteve që ndërlidhen me çështje të paanshmërisë, GJEDNJ është fokusuar dhe ka gjetur shkelje

në aspektin e testit objektiv të paanshmërisë së gjykatës. (Shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë,* Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 146; dhe *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 48).

52. Për sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kur aplikohet mbi një trup gjykues, duhet të determinohet nëse ndaras nga sjellja personale e cilitdo gjyqtarë, mund të ketë fakte të mjaftueshme të cilat mund të ngrenë dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës. Në këtë aspekt edhe dukja/perceptimi mund të ketë rëndësi, sepse "*drejtësia jo vetëm duhet të zbatohet, por ajo duhet të shihet që po zbatohet*". (Në këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafi 26). Çështja esenciale është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të reflektojnë në publik. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Castillo Algar kundër Spanjës*, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 45; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; dhe *Golubović kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 49). Prandaj, cilido gjyqtar për të cilin mund të ketë arsye legjitime për të dyshuar në mungesë paanshmërie, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 98).

53. Për më tepër, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, situatat në kuadër të të cilave mund të ngriten çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë, mund të jenë të (i) natyrës funksionale; dhe (ii) personale. E para, ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti person ose të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër, në mes gjyqtarit dhe akterëve tjerë në procesin e caktuar gjyqësor. Përkitazi me këto të fundit, niveli dhe natyra e kësaj lidhje duhet të ekzaminohet. Këto situata të natyrës funksionale, mund të përfshijnë shembuj të rasteve kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione (i) këshillëdhënëse dhe gjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Procola kundër Luxembourgut*, Aktgjykim i 8 shtatorit 1995, paragrafi 45; *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës,* Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 200; dhe *Sacilor Lormines kundër Francës*, Aktgjykim i 9 nëntorit 2006, paragrafi 74); (ii) gjyqësore dhe jashtëgjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *McGonnell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2000, paragrafët 52-57); dhe (iii) të ndryshme gjyqësore. Në këtë kontekst, GJEDNJ thekson se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procesit gjyqësor mund të ketë rezultuar në shkelje të kërkesave që ndërlidhen me paanësinë e gjykatës, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe varet nga rrethanat e secilit rast. Ndërsa e dyta, përkatësisht,

çështjet e natyrës personale, kryesisht ndërlidhet me mënyrën e të sjellurit të një gjyqtari përkitazi me një rast ose ekzistencën e lidhjeve me njërën nga palët apo përfaqësuesit të tij/saj në një rast. (Shih për më tepër në këtë kontekst, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë (aspekti civil), Pjesa III. Kërkesat Institucionale, C. Pavarësia dhe Paanësia, 3. Gjykata e Paanshme).

54. Gjykata gjithashtu thekson se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerësimi i paanësisë së gjykatës në kuptim të testit subjektiv dhe objektiv, nënkupton që duhet të determinohet nëse në një rast të caktuar mund të ketë dyshime legjitime për t'u frikësuar që një gjyqtari dhe/ose trupi të caktuar gjykues i mungon paanshmëria. Megjithatë, përtej dyshimeve legjitime, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është më rëndësi të determinohet nëse dyshime të tilla mund të justifikohen objektivisht. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 31; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 gushtit 1996, paragrafi 58; *Wettstein kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 44; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 33).

55. Në dritën e këtyre parimeve të përgjithshme dhe aplikimin e tyre në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se fakti që gjyqtarja G. S. kishte marrë pjesë në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, ka rezultuar në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi nga një gjykatë e anshme, në shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata në vijim, do të shqyrtojë fillimisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës nën kriteret e përcaktuara nga praktika e GJEDNJ-së përkitazi me testin subjektiv.

56. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se (i) paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta; (ii) kjo e fundit mund të vërtetohet ndër të tjera, përmes fakteve të cilat do të provonin se një gjyqtar tregon armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale; dhe se (iii) në shqyrtimin nëse mund të ketë dyshime legjitime përkitazi me një gjyqtar përkatës sa i përket paanësisë së tij/saj, qëndrimet e parashtruesit janë të rëndësishme, por jo vendimtare.

57. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjyqtarja G. S. ka qenë e anshme, sepse kundër të njëjtës

parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kallëzim penal në vitin 2015. Parashtruesi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës në kallëzimin e tij penal, kishte pretenduar se një numër gjyqtarësh, përfshirë gjyqtaren G. S., kishin nxjerrë vendime të kundërligjshme gjyqësore.

58. Gjykata fillimisht vëren se përtej faktit se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kallëzimin penal përkatës kundër gjyqtares G. S., në Gjykatë nuk ka paraqitur asnjë argument shtesë se gjyqtarja përkatëse mund të ketë treguar vullnet të keq ose armiqësi ndaj parashtruesit të kërkesës, prova këto të nevojshme për të përmbysur prezumimin e paanshmërisë së gjyqtarit bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

59. Për më tepër, natyra e kallëzimit penal ndërlidhet me vendimmarrjen e gjyqtares G.S., përkatësisht dhe sipas pretendimit, me nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore të përcaktuara me nenin 432 dhe në konflikt interesi të përcaktuar me nenin 424 të KPRK-së. Gjykata gjithashtu vëren që bazuar në shkresat e lëndës, kallëzimi penal ishte bërë më 2 shkurt 2015 dhe rrjedhimisht ende pa vendosur Kolegji përkatës lidhur me Aktgjykimin [Rev. nr. 335/2015] e 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme, në lidhje me të cilin, përkitazi me gjyqtaren G. S., parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur këtë kallëzim penal.

60. Gjykata thekson se trajtimi dhe vlerësimi i kallëzimit penal të parashtruesit të kërkesës është në kompetencë të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës, megjithatë ajo gjithashtu thekson se paraqitja e kallëzimeve penale ndaj gjyqtarëve si rezultat i pakënaqësisë së palëve me rezultatet e vendimeve gjyqësore, dhe pa mbështetjen e fakteve dhe rrethanave tjera, që do të mund të justifikonin objektivisht dyshimet legjitime për paanshmërinë e një gjykate në vendimmarrjen e saj, nuk mund të mbështesin në vetvete pretendimet e një parashtruesi të kërkesës për paanshmërinë e një gjykate dhe as të përmbysin prezumimin e paanshmërisë së një gjyqtari.

61. Siç është cekur më lart, në vlerësimin e paanshmërisë së gjyqtarit përkatës, qëndrimi i një parashtruesi është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Gjykata vlerëson së në shkresat e lëndës dhe për më tepër, në vlerësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 170/2017] të 23 gushtit 2017 të kontestuar të Gjykatës Supreme, kryetare e Kolegjit të së cilit ishte gjyqtarja G. S., nuk ka asnjë indikacion që do të mund të rezultonte në dyshime legjitime dhe objektivisht të justifikueshme se gjyqtarja G. S. në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, ka vepruar me paragjykime apo armiqësi personale ndaj parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht,

Gjykata vëren se në nxjerrjen e Aktgjykimit [Rev. nr. 170/2017] të 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme, asnjë fakt nuk mund të mbështet konstatimin se gjyqtarja G. S., në rrethanat e rastit konkret, nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv.

62. Gjykata njeh faktin se është e vështirë të gjenden dhe paraqiten argumentet dhe provat dhe të cilat do të mund të përmbysnin prezumimin e paanësisë së gjyqtarit nën testin subjektiv. Të njëjtin fakt e ka njohur edhe GJEDNJ dhe e cila si rezultat, përtej aplikimit të testit subjektiv, në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, gjithashtu aplikon edhe parimet e testit objektiv, si garanci shtesë për të determinuar nëse një vendim i caktuar është marrë nga një gjykatë e paanshme. (Shih në këtë kontest, rastet e GJEDNJ-së, *Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 32; *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 95; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 49).

63. Prandaj, Gjykata më tej, do të vlerësojë paanshmërinë e gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, edhe në kuptimin e testit objektiv, dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, do të shqyrtojë nëse (i) ka fakte dhe rrethana të mjaftueshme e të cilat mund të ngrenë dyshime legjitime sa i përket paanshmërisë së gjykatës; dhe (ii) këto dyshime për paanshmërinë e gjykatës në rrethanat e rastit konkret, mund të jenë objektivisht të justifikueshme.

64. Fillimisht, Gjykata shënon se fakti që në një Kolegj të Gjykatës Supreme ka marrë pjesë, si kryetare Kolegji, një gjyqtare, kundër të cilës parashtruesi i kërkesës, kishte paraqitur kallëzim penal, paraqet një rrethanë e cila mund të ngre dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse këto dyshime, në rrethanat e rastit konkret, janë objektivisht të justifikueshme.

65. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që praktika e konsoliduar gjyqësore e GJEDNJ-së në kuptimin e aplikimit të testit objektiv ka përcaktuar se pretendimet e një pale përkitazi me paanshmërinë e gjykatës mund të jenë të natyrës funksionale ose personale. Siç është cekur më lart, e para, në parim, ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme të një gjyqtari në të njëjtin proces gjyqësor; ndërsa e dyta, në parim, ndërlidhet me sjelljen e një gjyqtari ose ekzistencën e lidhjeve me njërën nga palët apo përfaqësuesit e tij/saj në një rast.

66. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, gjyqtarja G. S. dhe asnjë nga anëtarët e tjerë të Kolegjit dhe të cilët nxorrën Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, nuk kanë ushtruar funksione të

ndryshme brenda të njëjtit proces gjyqësor. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk pretendon dhe rrethanat e rastit nuk rezultojnë të ketë pasur lidhje të natyrës personale me parashtruesin e kërkesës.

67. Megjithatë dhe më tej, Gjykata gjithashtu rikujton faktin se GJEDNJ ka mbajtur se çështjet organizative janë relevante në vlerësimin e paanshmërisë së një gjykate. (Shih në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së, *Piersack kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 1 tetorit 1982, paragrafi 30). Në këtë aspekt, ekzistenca e procedurave që e sigurojnë paanshmërinë, përkatësisht, rregullave dhe procedurave që e rregullojnë edhe tërheqjen/përjashtimin e një gjyqtari, janë faktorë relevant. Gjykata rrjedhimisht, duhet të merr parasysh rregullat e tilla që e sigurojnë paanshmërinë, kur vlerëson nëse një gjykatë është e paanshme.

68. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se Kreu III i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) rregullon përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi. Neni 67 i këtij ligji, përcakton rrethanat nën të cilat një gjyqtar nuk mund të procedojë shqyrtimin e një çështje juridike dhe rrjedhimisht duhet të përjashtohet me ose pa kërkesën e palës.

69. Përkitazi me mundësinë e parë, përkatësisht përjashtimin e një gjyqtari me kërkesën e palës, Gjykata vëren se neni 68 i LPK-së përcakton detyrimin e palës për të kërkuar përjashtimin e një gjyqtari në rast se ekzistojnë rrethanat e përcaktuara me nenin 67 të të njëjtit ligj. Neni 68, i mundëson cilës do palë, që duke e arsyetuar kërkesën, paraprakisht të emërtoj gjyqtarin që nuk mund të marrë pjesë në dhënien e vendimit për shkak të ekzistimit të rrethanave nga neni 67 i këtij ligji. LPK specifikisht në nenin 69 të tij, përcakton edhe rastet kur nuk është e lejuar një kërkesë e tillë, duke përfshirë edhe ato rrethana, kur kërkohet përjashtimi i një numri gjyqtarësh e që rezulton në pamundësinë e gjykatës për të marrë vendime. Kjo e fundit është po ashtu e mbështetur nga praktika e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së. (Shih, Aktvendimin e Gjykatës për papranueshmëri të 19 dhjetorit 2016 në rastin KI108/16 me parashtrues *Bojana Ivković, Marija Perić dhe Miro Jaredić*, paragrafët 34, 35 dhe 36 dhe referencat e përdorura në to).

70. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë kërkesë për përjashtimin e gjyqtares G. S. Megjithatë, Gjykata njeh faktin se procedura që ka të bëj me shqyrtimin e një kërkese për revizion nuk parashikon procedurë publike në të cilën parashtruesi mund të marrë pjesë, sepse bazohet vetëm në parashtresat me shkrim. Prandaj, Gjykata në raste të ngjashme

parimisht ka mbajtur se parashtruesit e kërkesës nuk mund të mbahen përgjegjës për moskërkimin e përjashtimit të një gjyqtari sepse, nuk kanë mundur të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e gjykatës, se gjyqtari përkatës ishte pjesë në Kolegjin e Gjykatës Supreme.

71. Gjykata megjithatë thekson se pa marrë parasysh (i) nëse parashtruesi i kërkesës, mund të ketë qenë ose jo në dijeni për përbërjen e Kolegjit të Gjykatës Supreme, dhe specifikisht pjesëmarrjen e gjyqtares G. S. në të; dhe (ii) faktin që parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë kërkesë për përjashtimin e gjyqtares përkatëse, çdo gjyqtar duhet vet të kërkoj përjashtimin nga vendimmarrja, nëse ekzistojnë rrethanat e përcaktuara me nenin 67 të LPK-së.

72. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton mundësinë e dytë të përcaktuar përmes LPK-së, përkatësisht detyrimin e çdo gjyqtari, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 71 të LPK-së, që të njoftoj kryetarin e gjykatës dhe të kërkoj përjashtimin nga vendimmarrja nëse ekzistojnë rrethanat e përcaktuara përmes nenit 67 të LPK-së. Gjykata megjithatë vëren se, në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk argumenton asnjë rrethanë të përcaktuar me nenin 67 të LPK-së dhe mbi bazën e të cilës gjyqtarja G. S., duhet të kishte kërkuar vet përjashtimin e saj nga pjesëmarrja në Kolegjin e Gjykatës Supreme e që ka rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar.

73. Gjykata rithekson se vetëm fakti që parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kallëzim penal kundër gjyqtares G. S., dhe i pambështetur nga rrethana dhe argumente tjera, nuk është i mjaftueshëm për të determinuar se gjyqtarja G. S. ka qenë e anshme në kuptimin e testit subjektiv të paanshmërisë së gjykatës dhe se Kolegji i Gjykatës Supreme që ka nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, të ketë qenë i anshëm në kuptimin e testit objektiv të paanshmërisë së gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë se dyshimet për paanshmërinë e Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë objektivisht të justifikueshme.

Përfundime

74. Gjykata thekson se pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, çështje këto të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në rrethanat e rastit konkret, janë çështje esenciale kushtetuese.

75. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 i Gjykatës Supreme është nxjerrë

nga një gjykatë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv dhe objektiv të përcaktuar nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rrjedhimisht, është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse (i) përkundër faktit që Kryetare e Kolegjit e cila nxori Aktgjykimin e kontestuar, ishte një gjyqtare kundër së cilës parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kallëzim penal, asnjë provë apo argument tjetër i parashtruesit të kërkesës nuk e përmbys prezumimin e paanësisë së gjyqtares përkatëse; dhe për më tepër, (ii) përkundër faktit që pjesëmarrja e gjyqtares përkatëse në Kolegjin e Gjykatës Supreme mund të ketë ngritur dyshime legjitime për paanësinë e gjykatës nga ana e parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e Gjykatës, vlerësim ky i bazuar në parimet dhe kriteret e përcaktuara nga praktika përkatëse gjyqësore e GJEDNJ-së, këto dyshime, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë objektivisht të justifikueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [Rev. nr. 170/2017] i 23 gushtit 2017 i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

Rastet nr. KI87/18 dhe KI11/19, Parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 226/2018, të 16 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018

KI87/18 dhe KI11/19, Aktgjykim i 29 korrik 2019, publikuar më 29 gusht 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, akuzë penale, përbërja e trupit gjykues, e drejta për gjykim të drejtë, paanshmëria e gjykatës*

Parashtruesi i kërkesës, përmes Aktgjykimit [P.nr.25/2009] të 8 qershorit 2009 të Gjykatës së Qarkut, fillimisht ishte liruar nga akuzat për kryerjen e veprës penale sipas nenit 147 (Vrasje e rëndë) në lidhje me nenet 20 (Tentativa) e 23 (Bashkëkryerja) të KPPK-së përmes Aktgjykimit [P. nr. 25/2009] të 8 qershorit 2009 të Gjykatës së Qarkut. Ky Aktgjykim ishte anuluar përmes Aktvendimit [AP. nr. 393/2012] të 7 marsit 2012 të Gjykatës Supreme dhe çështja ishte kthyer në rigjykim. Në vitin 2017, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.107/2012] të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës u dënua me tri (3) vite burgim për kryerjen e veprës së lartcekur penale.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u konfirmua nga Gjykata e Apelit. Kundër këtij të fundit në Gjykatën Supreme ishin parashtruar dy kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. E para ishte parashtruar nga avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës si rezultat i së cilës ishte nxjerrë Aktgjykimi [PML. nr. 226/2018] i 18 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme dhe i cili refuzon si të pabazuar këtë kërkesë. E dyta ishte parashtruar nga vet parashtruesi i kërkesës si rezultat i së cilës ishte nxjerrë Aktgjykimi [PML. nr. 293/2018] i 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme dhe i cili gjithashtu refuzon të pabazuar kërkesën për vlerësimin e ligjshmërisë.

Në Gjykatë janë dorëzuar dy kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve përkatëse. E para, përkatësisht, kërkesa KI187/18 është dorëzuar nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës dhe kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [PML. nr. 226/2018] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme. Ndërsa, e dyta, përkatësisht, kërkesa KI11/19 është dorëzuar nga vet parashtruesi i kërkesës dhe kërkon vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme.

Lidhur me kërkesën KI187/18, parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje esenciale të

dispozitave të procedurës penale. Lidhur më këtë, Gjykata vërejti se parashtruesi i kërkesës në kërkesën KI187/18 nuk kishte qartësuar se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendonte se i ishin cenuar përmes aktit të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimit [PML. nr. 226/18] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk kishte qartësuar saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kërkesa KI187/19, nuk plotësoi kriteret e pranueshmërisë siç janë përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës, andaj deklaroi këtë kërkesë të papranueshme.

Lidhur me kërkesën KI11/19, parashtruesi kontestoi Aktgjykimin [PML.nr.293/2018] e 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme, duke pretenduar, se ndër të tjera, Aktgjykimi është nxjerrë nga një gjykatë e anshme në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata konstatoi se kjo kërkesë i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe shqyrtoi meritat e saj.

Në shqyrtimin e meritave, Gjykata, ndër të tjera, elaboroj (i) parimet e përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me kriteret për vlerësimin e paanësisë së një gjykate; (ii) konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës; (iii) praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aspekt të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përkatësisht konceptin e "*dyshimeve legjitime*" dhe faktit që të njëjtat duhet të jenë "*objektivisht të justifikueshme*" në mënyrë që të konstatohet paanësia e një gjykate; (iv) praktikën përkatëse gjyqësore përkitazi pjesëmarrjen e një gjyqtari në faza të ndryshme të të njejtës cështje penale; dhe në fund, konstatoi se (v) Aktgjykimi [PML.nr.293/2018] i 3 dhjetorit 2018 i Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë nga përbërja e Kolegjit, në të cilin kishte marrë pjesë gjyqtari i cili edhe në faza të mëhershme të të njejtës cështje penale kishte qenë pjesë e kolegjeve vendimarrëse, duke rezultuar kështu në "*dyshime legjitime*" për paanshmërinë e gjykatës, e të cilat në vlerësimin e Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, janë "*objektivisht të justifikueshme*".

Andaj, Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme. Ndërsa, Gjykata refuzoi kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme, duke thekuar ndër të tjera se Aktgjykimi [PAKR.nr.108/2018] i 19 prillit 2018 i Gjykatës së Apelit, në rrethanat e rastit konkret, është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, derisa të mos jetë vendosur ndryshe nga Gjykata Supreme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI187/18 dhe KI11/19

Parashtrues

Muhamet Idrizi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 226/2018, të 16 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI187/18 është dorëzuar nga Shemsedin Pira, avokat nga Gjilani si përfaqësues i Muhamet Idrizit, me vendbanim në Komunën e Viti-së; ndërsa kërkesa KI11/19 është dorëzuar personalisht nga Muhamet Idrizi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar përmes kërkesës KI187/18 është Aktgjykimi [PML. nr. 226/2018] i 16 tetorit 2018 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), ndërsa vendimi i kontestuar përmes kërkesës KI11/19 është Aktgjykimi [PML. nr. 293/2018] i 3 dhjetorit 2018 i Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të kontestuara. Në kërkesën KI187/18, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit të kontestuar. Ndërsa, përmes kërkesës KI11/19, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *"të ndalon fillimin e vuajtjes së dënimit të shqiptuar* [ndaj tij] *me Aktgjykimin PKR. nr. 107/2012"* e 22 nëntorit 2017 të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Themelore), deri në vendosjen e rastit në Gjykatë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 30 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të tij, dorëzoi kërkesën KI187/18 në Gjykatë.

7. Më 12 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

8. Më 4 janar 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës KI187/18.

9. Më 14 janar 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI11/19 në Gjykatë.

10. Më 17 janar 2019, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI11/19 me kërkesën KI187/18. Përmes këtij urdhri, u vendos që Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jetë e njëjtë me atë që ishte vendosur nga Kryetarja për caktimin e Gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues në rastin KI187/18.

11. Më 22 janar 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës, parashtruesin e kërkesës, si dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës KI11/19 dhe bashkimin e kërkesave përkatëse.

12. Më 28 maj 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri vendosi që vendimmarrja përkitazi më kërkesat e parashtruesve të kërkesës, të shtyhet për shqyrtim në njërën nga seancat e radhës.

13. Më 28 maj 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme, përkatësisht, të ndaloj fillimin e vuajtjes së dënimit të shqiptuar ndaj tij përmes Aktgjykimit [PKR.nr.107/2012] të 22 nëntorit 2017 të Gjykatës Themelore, deri në vendosjen e rastit të tij para Gjykatës.

14. Më 29 korrik 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të shpallë kërkesën KI187/18 të papranueshme, ndërsa kërkesën KI11/19 të pranueshme për shqyrtim dhe të vlerësojë meritat e saj.

15. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se Aktgjykimi [PML. nr. 293/2018] i 3 dhjetorit 2018 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 29 dhjetor 2008, Prokuroria e Qarkut në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria e Qarkut), ngriti Aktakuzën [PP. nr. 168/08] ndaj parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se ai në bashkëveprim me Sh. I. dhe i ndihmuar nga E. I., kishte kryer veprën penale të përcaktuar në nenin 147 (Vrasje e rëndë) në lidhje me nenet 20 (Tentativa) e 23 (Bashkëkryerja) dhe nenin 328 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e

mëtejmë: KPPK), pasi më 2 shtator 2008, kishte tentuar të privojnë nga jeta R. E. dhe Sh. E.

17. Më 8 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut) përmes Aktgjykimit [P. nr. 25/2009] e liroi parashtruesin e kërkesës nga akuzat e cekura më lart, ndërsa personin që pretendohej se kishte ndihmuar kryerjen e veprës penale, përkatësisht, E. I. e liroi nga akuza për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 147 i KPPK-së, ndërsa e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 328 i KPPK-së.

18. Prokuroria e Qarkut parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që çështja të rikthehet për rigjykim. Parashtruesi i kërkesës dhe E. I. paraqitën përgjigje në ankesën e Prokurorisë së Qarkut, duke kërkuar që ajo të refuzohet si e pabazuar.

19. Më 7 mars 2012, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [AP. nr. 393/2012] e aprovoi ankesën e Prokurorisë së Qarkut si të bazuar dhe e anuloi Aktgjykimin [P. nr. 25/2009] e Gjykatës së Qarkut sa i përket parashtruesit të kërkesës dhe çështjen e ktheu në rigjykim.

20. Më 22 nëntor 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 107/2012], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 147 (Vrasje e rëndë) në lidhje me nenin 20 (Tentativa) dhe 23 (Bashkëkryerja) të KPPK-së dhe e dënoi me 3 (tri) vite burgim. Ndërsa, akuza për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 328 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) të KPPK-së u refuzua. Përmes të njëjtit Aktgjykim, i akuzuari E. I., u lirua nga akuza.

21. Ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur parashtruan edhe parashtruesi i kërkesës edhe Prokuroria Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Themelore). I pari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal; ndërsa i dyti, përkatësisht Prokuroria Themelore, për pjesën liruese të Aktgjykimit për të akuzuarin E.I., dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në lidhje me sanksionin penal për veprën penale për të cilën parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor.

22. Më 19 prill 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018], refuzoi ankesat e Prokurorisë Themelore dhe të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, përkatësisht Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e 22 nëntorit 2017.

23. Parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij, ndaras, parashtruan kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal. Në kërkesat e tyre ata pretenduan, ndër të tjera, se Gjykata Themelore, duke ndryshuar përshkrimin e veprës penale dhe duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës veprën penale e *"ka kryer me persona tani për tani të panjohur"*, ka tejkaluar akuzën në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPRK). Prokurori i Shtetit përmes parashtresës [KMLP. nr. 155/2018], paraqiti përgjigje në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, duke propozuar që ato të refuzohen si të pabazuara.

24. Më 18 tetor 2018, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [PML.nr.226/2018] e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e Gjykatës Themelore.

25. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga i dënuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, përmes Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] gjithashtu e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR.nr.107/2012] e Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

Pretendimet e ngritura përmes kërkesës KI187/18

26. Në kontekst të kësaj kërkese, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit [PML. nr. 226/2018] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme.

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, më specifikisht: (i) të pikës 1.10 të paragrafit 1 të nenit 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale) për shkak të tejkalimit të aktakuzës; (ii) pikës 1.12 të paragrafit 1 të nenit 384; dhe (iii) paragrafit 1 të nenit 360 (Identiteti subjektiv dhe objekti i aktgjykimit me aktakuzën) të KPPRK-së.

Pretendimet e ngritura përmes kërkesës KI11/19

28. Parashtruesi në kërkesën KI11/19 pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018, i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

29. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se të drejtat e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë shkelur sepse (i) Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 39 (Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve) të KPPRK-së, sepse njëri nga gjyqtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut, përkatësisht gjyqtari R. R., që ka nxjerrë Aktgjykimin [P. nr. 25/09] e 8 qershorit 2009, po ashtu ka marrë pjesë si anëtar i Kolegjit të Gjykatës Supreme që ka vendosur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përmes Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018; dhe (ii) përfaqësuesi i tij nuk e ka mbrojtur në mënyrën e duhur gjatë procesit gjyqësor dhe sipas parashtruesit të kërkesës, mbrojtjen e ka bërë në kundërshtim me paragrafin 7 të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-117 për Avokatinë të 25 marsit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Avokatinë), sepse ka pasur konflikt interesi, fakt ky për të cilin, parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë i informuar. Sipas parashtruesit të kërkesës, avokati i çështjes Sh. P., ka qenë gjithashtu mbrojtës i personit R. E. në një çështje tjetër penale, por i cili gjithashtu ka qenë dëshmitari kryesor në procesin penal kundër parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, avokati në fjalë ka reflektuar neglizhencë të dukshme dhe të vazhdueshme gjatë mbrojtjes së tij.

30. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e KPPRK-së, sepse (i) gjykatat kishin bërë tejkalimin e aktakuzës fillestare në kundërshtim me pikën 10 të paragrafit 1 të nenit 384 të KPPRK-së,

duke e shpallur të akuzuarin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë në bashkëkryerje me "*me disa persona të tjerë, tani për tani të panjohur*", përderisa bashkëkryesit e pretenduar të cilët ishin të përfshirë në aktakuzën fillestare, ishin liruar nga akuza. Ndaj të parit, përkatësisht personit, SH. I., kishin pushuar hetimet përmes Aktvendimit [PP.nr.168/08 dhe 231/09] të 26 korrikut 2011 të Prokurorisë Publike të Qarkut, ndërsa i dyti, përkatësisht, personi E. I., ishte liruar nga akuza përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 107/2012] të 22 nëntorit 2017 të Gjykatës Themelore.

31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesën e tij të pranueshme; të anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe, ta kthej çështjen e tij në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata rikujton që në rastin konkret në Gjykatë janë dorëzuar dy kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve përkatëse. E para, përkatësisht, kërkesa KI187/18 është dorëzuar nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës dhe kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [PML. nr. 226/2018] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme. Ndërsa, e dyta, përkatësisht, kërkesa KI11/19 është dorëzuar nga vet parashtruesi i kërkesës dhe kërkon vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimit [PML.nr.293/2018] të 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme. Gjykata më tej do të shqyrtojë vlerësimin e pranueshmërisë së të dy kërkesave veç e veç.

Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës KI187/18

33. Në lidhje me kërkesën KI187/18, Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara*

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në lidhje me kërkesën KI187/18, është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 226/2018] e 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

37. Megjithatë, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me ligj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parashtruesit të kërkesës i përcakton detyrimin që në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon se i janë cenuar.

38. I njëjti kriter është qartë i përcaktuar në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39, paragrafi (1) (d) përcakton:

> *(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*
>
> > *(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

39. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se për të konsideruar se një kërkesë plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon se i janë cenuar dhe në mënyrë adekuate të paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. (Shih në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI91/17, *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31).

40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën KI187/18 nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon se i janë cenuar përmes aktit të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimit [PML. nr. 226/18] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, të cilin ai e konteston në Gjykatë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk qartëson saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese.

41. Rrjedhimisht, kërkesa KI187/18, është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenet 47 dhe 49 të Ligjit. Megjithatë, kjo kërkesë nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë siç janë përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

42. Si përfundim, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës, kërkesa KI187/19, është e papranueshme.

Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës KI11/19

43. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në lidhje me kërkesën KI11/19, është palë e autorizuar e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

44. Gjykata rrjedhimisht konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës gjithashtu plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

45. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht ajo duhet deklaruar e pranueshme. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat e rastit në lidhje me kërkesën KI11/19

46. Në trajtimin e meritave të kësaj kërkese, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit [P. nr. 25/2009] të 8 qershorit 2009 të Gjykatës së Qarkut, parashtruesi i kërkesës fillimisht ishte liruar nga akuzat për kryerjen e veprës penale sipas nenit 147 (Vrasje e rëndë) në lidhje me nenet 20 (Tentativa) e 23 (Bashkëkryerja) të KPPK-së. Ky Aktgjykim ishte anuluar përmes Aktvendimit [AP. nr. 393/2012] të 7 marsit 2012 të Gjykatës Supreme dhe çështja ishte kthyer në rigjykim. Në vitin 2017, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 107/2012] të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës u dënua me 3 (tri) vite burgim për kryerjen e veprës së lartcekur penale. Dy persona tjerë, përkatësisht, SH. I. dhe E. I., të cilët ishin bashkëkryes të pretenduar të veprës penale, ishin liruar nga akuzat përgjatë procedurave të gjykatave të rregullta.

47. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u konfirmua nga Gjykata e Apelit. Kundër këtij të fundit në Gjykatën Supreme ishin parashtruar dy kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. E para, ishte parashtruar nga avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës, si rezultat i së cilës ishte nxjerrë Aktgjykimi [PML. nr. 226/2018] i 18 tetorit 2018 të Gjykatës

Supreme dhe i cili refuzon si të pabazuar këtë kërkesë. E dyta, ishte parashtruar nga vet parashtruesi i kërkesës, si rezultat i së cilës ishte nxjerrë Aktgjykimi [PML.nr.293/2018] i 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme dhe i cili gjithashtu refuzon të pabazuar kërkesën për vlerësimin e ligjshmërisë.

48. Përkitazi me këtë të fundit, përkatësisht, Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që i njëjti (i) është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse është nxjerrë nga një gjykatë e anshme; (ii) mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë, duke dëmtuar rrjedhimisht interesat e tij; dhe (iii) Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e caktuara të procedurës penale.

49. Në trajtimin e pretendimit të parë të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata do të aplikojë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

50. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të përcaktohet sipas (i) testit subjektiv, rrjedhimisht në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar se një gjyqtar mund të ketë pasur paragjykime personale apo anshmëri në një rast të caktuar; dhe (ii) testit objektiv, rrjedhimisht konstatimit nëse vet gjykata, mes tjerash, përbërja e saj, ka ofruar garancione të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. (Shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Miracle Europe KFT kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 12 prillit 2015, paragrafët 54 dhe 55; *Gautrin dhe të Tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 58; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 58; *Thomann kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 30; *Wettstein kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2000, paragrafi 42*; Korzeniak kundër Polonisë*, Aktgjykim i 10 janarit 2017, paragrafi 46; dhe rastin e Gjykatës KI06/12, me parashtrues *Bajrush Gashi*, Aktgjykim i 9 majit 2012, paragrafi 45).

51. Më specifikisht, sa i përket testit subjektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 30 nëntorit 2005, paragrafi 30; *Padovani kundër Italisë*, Aktgjykim i 26 shkurt 1993, paragrafi 26; *Morel kundër Francës*, paragrafi 41; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 59; *Hauschildt kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989, paragrafi 47; *Driza kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 75; dhe *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 47). Për sa i përket llojit të provave të nevojshme për të dëshmuar një gjë të tillë, GJEDNJ, për shembull, është përpjekur që të vërtetojë nëse një gjyqtar tregon armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale. Megjithatë, për të vendosur nëse në një rast konkret ka bazë të mjaftueshme për të determinuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, pikëpamja e parashtruesit është e rëndësishme, por jo vendimtare. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 26 tetorit 1984, paragrafi 25). Megjithatë, parimi në të cilin duhet të supozohet se gjykata është e liruar nga paragjykimet apo njëanshmëria personale, është i vendosur për një kohë të gjatë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kyprianou kundër Qipros*, cituar më lart, paragrafi 119; *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 93-94; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 33).

52. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përderisa në disa raste mund të jetë e vështirë të gjenden faktet bazuar në të cilat mund të përmbyset prezumimi i paanësisë subjektive të një gjyqtari, kriteret dhe kërkesat për paanësinë objektive përcaktojnë një garanci shtesë për një gjykim të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës,* cituar më lart, paragrafët 95 dhe 101). Duhet të theksohet se në shumicën e rasteve që ndërlidhen me çështje të paanshmërisë, GJEDNJ është fokusuar dhe ka gjetur shkelje në aspektin e testit objektiv. (Shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë,* Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 146; dhe *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 48).

53. Për sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kur aplikohet mbi një trup gjykues, duhet të determinohet nëse ndaras nga sjellja personale e cilitdo gjyqtarë, mund të ketë fakte të mjaftueshme të cilat mund të ngrisin dyshime për paanshmërinë e gjykatës. Në këtë aspekt edhe dukja/perceptimi

mund të ketë rëndësi, sepse "*drejtësia jo vetëm duhet të zbatohet, por ajo duhet të shihet që po të zbatohet*". (Në këtë kontekst, shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafi 26). Çështja esenciale është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të reflektojnë në publik. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Castillo Algar kundër Spanjës*, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 45; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; dhe *Golubović kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 49). Prandaj, cilido gjyqtar për të cilin mund të ketë arsye legjitime për të dyshuar në mungesë paanshmërie, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 98).

54. Për më tepër, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, situatat në kuadër të të cilave mund të ngritën çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë, mund të jenë të (i) natyrës funksionale; dhe (ii) personale. E para, ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti person ose me lidhje të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër, në mes gjyqtarit dhe akterëve tjerë në procesin e caktuar gjyqësor. Përkitazi me këto të fundit, niveli dhe natyra e kësaj lidhjeje duhet të ekzaminohet. Këto situata të natyrës funksionale, mund të përfshijnë shembuj të rasteve kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione (i) kështillëdhënëse dhe gjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Procola kundër Luxembourgut*, Aktgjykim i 8 shtatorit 1995, paragrafi 45; *Kleyn dhe të Tjerët kundër Holandës,* Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 200; dhe *Sacilor Lormines kundër Francës*, Aktgjykim i 9 nëntorit 2006, paragrafi 74); (ii) gjyqësore dhe jashtëgjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *McGonnell v. the United Kingdom*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2000, paragrafët 52-57); dhe (iii) të ndryshme gjyqësore. Në këtë kontekst, GJEDNJ thekson se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procesit gjyqësor mund të ketë rezultuar në shkelje të kërkesave që ndërlidhen me paanësinë e gjykatës, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe varet nga rrethanat e secilit rast. Ndërsa e dyta, përkatësisht, ato të natyrës personale, kryesisht ndërlidhen me mënyrën e sjelljes të një gjyqtari përkitazi me një rast ose ekzistencën e lidhjeve me njërën nga palët apo përfaqësuesit të tij/saj në një rast. (Shih për më tepër në këtë kontekst, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019, për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë (aspekti penal), Pjesa IV. Garancionet e Përgjithshme: Kriteret Procedurale, C. Pavarësia dhe Paanësia, 2. Gjykata e Paanshme, a. Kriteret për vlerësimin e paanësisë).

55. Në aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon pikërisht ushtrimin e funksioneve të ndryshme të një gjyqtari brenda të njëjtit proces gjyqësor, përkatësisht faktin që gjyqtari R. R. kishte marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues edhe në (i) nxjerrjen e Aktgjykimit [P. nr. 25/09] të 8 qershorit 2009 të Gjykatës së Qarkut; edhe (ii) nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme, dhe që sipas parashtruesit të kërkesës, ka rezultuar në shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

56. Në këtë kontekst dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata së pari do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me paanësinë e gjykatës nën kriteret e testit subjektiv.

57. Gjykata rithekson se sa i përket testit subjektiv, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë e cila do të mund të vinte në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit R. R. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018, asnjë fakt nuk mund të mbështet konstatimin se gjykata nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv.

58. Rrjedhimisht në vijim, në përputhje me parimet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe si garanci shtesë për rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës nën kriteret e testit objektiv dhe rrjedhimisht, fillimisht (i) nëse rrethanat e rastit konkret mund të ngrisin dyshime legjitime nga ana e parashtruesit të kërkesës në lidhje me paanshmërinë e gjykatës; dhe nëse ky është rasti (ii) nëse këto dyshime janë objektivisht të justifikueshme. Determinimi i këtyre çështjeve bëhet në secilin rast veç e veç. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 31; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 gushtit 1996, paragrafi 58; *Wettstein kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 44; dhe *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; *Korzeniak kundër Polonisë,* cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 33).

59. Në këtë aspekt, dhe siç është theksuar më lart, ushtrimi i funksioneve të ndryshme brenda të njëjtit proces gjyqësor nga gjyqtari i njëjtë, dhe që ndërlidhet me rrethanat e rastit konkret, paraqet kategori çështjesh të natyrës funksionale dhe të cilat janë relevante në vlerësimin e paanshmërisë së një gjykate. Në raste të tilla, GJEDNJ në parim ka

mbajtur se ka dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 51 dhe 52). Të njëjtin qëndrim do të mbaj edhe Gjykata. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata në vijim do të vlerësoj nëse dyshimet e tilla, në rrethanat e rastit konkret, mund të jenë objektivisht të justifikueshme.

60. Në kuptim të vlerësimit të dyshimeve legjitime në kontekst të rrethanave kur një gjyqtar ka ushtruar më shumë se një funksion në të njëjtën çështje gjyqësore, dy kategori çështjesh janë të rëndësishme. Së pari, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet karakteristikave të ligjit dhe rregullave që janë të aplikueshme në një rast konkret. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Warsicka kundër Polanisë*, Aktgjykim i 16 janarit 2007, paragrafi 40; *Toziczka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 36; dhe *Korzeniak kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 50). Në këtë kontekst, GJEDNJ ka theksuar se të rëndësishme janë edhe çështjet organizative. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Piersack kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 1 tetorit 1982, paragrafi 30). Për shembull, ekzistenca e procedurave që e sigurojnë paanshmërinë, përkatësisht, rregullave dhe procedurave që e rregullojnë edhe tërheqjen/përjashtimin e një gjyqtari, është faktorë relevant. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Pfeifer and Plankl kundër Austrisë*, Aktgjykim i 25 shkurtit 1992, paragrafi 6; *Oberschlick kundër Austrisë (nr. 1)*, Aktgjykim i 23 majit 1991, paragrafi 50; dhe *Pescador Valero kundër Spanjës*, Aktgjykim i 24 shtatorit 2003. paragrafët 24-29). Së dyti, është e nevojshme të vlerësohet nëse ndërlidhja në mes çështjeve përmbajtjesore të shqyrtuara nga i njëjti gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës është aq e afërt/dukshme sa që vë dyshim në paanësinë e gjyqtarit që ka marrë pjesë në vendimmarrje përgjatë këtyre fazave. Ky determinim gjithashtu bëhet nga rasti në rast dhe duke marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e veçanta të tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Warsicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 40; *Toziczka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 36; dhe *Korzeniak kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

61. Në këtë aspekt, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe të elaboruar më lart, duhet të shtjellojë fillimisht çështjet ligjore dhe rregullative. Gjykata rikujton se procedurat të cilat e rregullojnë tërheqjen/përjashtimin e një gjyqtari nga vendimmarrja janë të një rëndësie të veçantë.

62. Në këtë kontekst, Gjykata vëren që në rastin e parashtruesit të kërkesës në procedurat lidhur me kërkesat për mbrojte të ligjshmërisë, Gjykata Supreme ka aplikuar dispozitat e KPPRK-së. Ky

i fundit, në nenet 39 dhe 40 (Procedura për përjashtim) të tij, specifikisht rregullon çështjen dhe rrethanat në të cilat përjashtohen gjyqtarët nga vendimmarrja përkatëse. Gjykata thekson që paragrafi 2 i nenit 39 të KPPRK-së, shkeljen e të cilit parashtruesi i kërkesës e pretendon, përcakton që *"Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i Kolegjit të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë".*

63. Ky formulim i nenit të lartcekur të KPPRK-së dhe i cili vë theks në pjesëmarrjen e një gjyqtari në "*procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal",* dallon nga përmbajtja e neneve 40 dhe 41 të Kodit paraprak të procedurës penale, përkatësisht Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK), ku rrethanat e përjashtimit të gjyqtarëve në këtë kontekst ishin më të kufizuara. Më specifikisht, pika 5 e paragrafit 1 të nenit 40 të KPPPK-së, përcaktonte që gjyqtari përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur *"në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose nëse në gjykatën e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili kundërshtohet me ankesë".*

64. Gjykata në këtë kontekst thekson që ligjvënësi përmes miratimit të Kodit të ri të Procedurës Penale, përfshiu një dispozitë më gjithëpërfshirëse në kuptim të përjashtimit të gjyqtarit nga ushtrimi i funksioneve të ndryshme në të njëjtin proces penal. Gjykata thekson se dispozitat e KPPRK-së manifestojnë brengën e ligjvënësit për t'i hequr të gjitha dyshimet e arsyeshme sa i përket paanshmërisë së gjykatës. (Shih në këtë kontekst, edhe rastin e Gjykatës KI06/12, me parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin e GJEDNJ-së *Oberschlick kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

65. Gjykata duhet gjithashtu të thekson se në rrethanat e rastit konkret, në mes të marrjes pjesë të gjyqtarit R. R. në Kolegjin e Gjykatës së Qarkut, përkatësisht nxjerrjes së Aktgjykimit [P. nr. 25/2009] të 8 qershorit 2009, dhe pjesëmarrjes së tij në Kolegjin e Gjykatës Supreme, përkatësisht, nxjerrjes së Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018, përmes Aktvendimit [AP. nr. 393/2012] të 7 marsit 2012 të Gjykatës Supreme, çështja e parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim. Në gjykimin e ri, gjyqtari R. R. kishte marrë pjesë vetëm në Kolegjin e Gjykatës Supreme i cili ka shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PAKR.nr.108/2018] të 19 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata thekson, se përmbajtja e paragrafit 2 të nenit 39 të KPPRK-së, përkatësisht

"*marrja pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal*", dhe e aplikueshme në rrethanat e rastit konkret, është gjithëpërfshirëse dhe e ka detyruar gjyqtarin R. R. që të përjashtohet nga vendimmarrja në kolegjin përkatës të Gjykatës Supreme.

66. Gjykata gjithashtu thekson se në rrethana të tilla, përjashtimi i gjyqtarit nuk është i varur detyrimisht nga kërkesa e palëve në procedurë. Bazuar në dispozitat e KPPRK-së, gjyqtari vet duhet të kërkoj përjashtimin nga vendimmarrja. Kjo është e përcaktuar në nenet 39 deri me 42 të KPPRK-së, dhe gjithashtu mbështetet nga praktika gjyqësore e GJENDJ-së, dhe e cila, duke theksuar rëndësinë e perceptimit dhe besimit që gjykatat duhet të reflektojnë në publik në një shoqëri demokratike, në mënyrë të vazhdueshme kanë theksuar se cilido gjyqtar që beson që pjesëmarrja e tij ose saj në një çështje gjyqësore, mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e gjykatës, duhet të përjashtohet nga vendimmarrja.

67. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton se, procedura që ka të bëjë me mbrojtjen e ligjshmërisë nuk parashikon procedurë publike në të cilën parashtruesi mund të marrë pjesë. Kjo procedurë bazohet vetëm në parashtresat me shkrim. Andaj, për shkak të natyrës së shkruar të procedurës, as parashtruesi i kërkesës dhe as mbrojtësi i tij, nuk kanë mundur të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme, se i njëjti gjyqtar që ishte pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut mori pjesë edhe në Kolegjin e Gjykatës Supreme që vendosi për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, përgjegjësia për mospërjashtimin e gjyqtarit përkatës nuk mund t'i atribuohet parashtruesit të kërkesës dhe të konkludohet që ai ka hequr dorë nga e drejta që çështja e tij të vendoset nga një gjykatë e paanshme. (Shih, në këtë kontekst edhe rastin e Gjykatës KI06/12, parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 36 e edhe rastin e GJEDNJ-së, *Oberschlick kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 51).

68. Gjykata rikujton se çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të vendosur për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, është çështje krejtësisht nën juridiksion, dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe organeve tjera përgjegjëse. Përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon institucioneve relevante dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës. (Në këtë kontekst, shih rastin e Gjykatës, KI06/12, parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 51; dhe rastin KO4/11, parashtrues: *Gjykata Supreme e Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nr. 03/L-139, Aktgjykim i 1 marsit 2012).

69. Rrjedhimisht dhe në rrethana të tilla, Gjykata duhet të konstatojë se dyshimet legjitime për paanshmërisë e gjykatës e që rrjedhin si rezultat i ushtrimit të funksioneve të ndryshme të një gjyqtari brenda një procesi gjyqësor janë objektivisht të justifikueshme. Gjykata, gjithashtu duhet të konstatojë se në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] të 3 dhjetorit 2018, gjykata nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit objektiv dhe se rrjedhimisht, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një gjykatë e paanshme, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

70. Gjykata, siç është cekur më lart, rikujton që në kontekst të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përtej çështjeve ligjore dhe rregullative, ndërlidhja në mes çështjeve përmbajtjesore të shqyrtuara nga i njëjti gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës, është po ashtu relevante. Megjithatë, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar së në rrethanat e rastit konkret, dyshimet për paanshmërinë janë objektivisht të justifikueshme, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen aspektet tjera përkitazi me paanshmërinë e gjykatës në kuptimin e testit objektiv.

71. Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018, nga këndvështrimi i paanësisë së gjykatës në kuptimin e testit objektiv, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

72. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu ngre pretendime tjera përkitazi me Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës i referohet shkeljes së nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës, ndërsa përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjithashtu dhe siç është cekur më lart, pretendon që (i) mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë, duke dëmtuar rrjedhimisht interesat e tij; dhe (ii) Aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e caktuara të procedurës penale.

73. Përkitazi me nenin 30 të Kushtetutës, Gjykata thekson se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në

ketë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33). Ndërsa, duke marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar se Aktgjykimi përkatës është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të pavlefshëm këtë Aktgjykim dhe rrjedhimisht duke e kthyer çështjen përkatëse në rivendosje në Gjykatën Supreme, ajo nuk do të shqyrton pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me këto nene.

74. Në fund, Gjykata thekson së përmes këtij Aktgjykimi, ka shpallur të pavlefshëm vetëm njërin nga Aktgjykimet e Gjykatës Supreme, përkatësisht, Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018, të nxjerrë si rezultat i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së të pandehurit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të 19 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit. Ndërsa nuk ka trajtuar pretendimet përkitazi me Aktgjykimin [PML. nr. 226/2018] e 18 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, sepse kërkesën përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së të njëjtës, e ka shpallur të papranueshme. Ky rezultat i shqyrtimit të kushtetutshmërisë së dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme që trajtojnë kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë kundër të njëjtit Aktgjykim të Gjykatës së Apelit, buron nga fakti që Gjykata Supreme, në rrethanat e rastit konkret, ka trajtuar ndaras kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruara nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, duke vendosur përmes dy Aktgjykimeve.

75. Gjykata vëren se KPPRK në nenin 433 (Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë) të tij, përcakton personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke përfshirë Kryeprokurorin e Shtetit, të pandehurin dhe mbrojtësin e tij. KPPRK nuk parasheh, në mënyrë specifike, nëse kërkesat për mbrojte të ligjshmërisë të parashtruara nga personat e autorizuar, të cekur më lart, dhe në rrethanat e rastit konkret, ndaras i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, domosdoshmërisht duhet të trajtohen së bashku në një vendim të vetëm nga Gjykata Supreme. Në rast të trajtimit ndaras të tyre, secili prej vendimeve të Gjykatës Supreme, ka efektin përkatës në vendimin i cili kontestohet përmes mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Kërkesa për masë të përkohshme

76. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme duke kërkuar që të pezullohet fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg derisa të merret një vendim nga Gjykata.

77. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me kërkesën e tij për masë të përkohshme thekson si në vijim: "*Duke marrë parasysh, se i gjykuari është në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rreth kërkesës së tij, përmes kësaj kërkese kërkoj nga gjykata që të cakton masën e përkohshme dhe të ndalon fillimin e vuajtjes së dënimit të shqiptuar me aktgjykimin PKR nr. 107/2012 i datës 22.11.2017, deri në vendosjen e kësaj çështje*".

78. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton se bazuar në nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit, Gjykata mund të vendosë masë të përkohshme, ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës (i) nëse masa është e nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme; ose (ii) nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik. Këto kritere më tej janë të specifikuara në paragrafin 4 të rregullit 57 të Rregullores së punës.

79. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, Gjykata e ka shpallur të papranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [PML.nr.226/2018] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, ndërsa e ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018, duke e kthyer të njëjtin në rivendosje në Gjykatën Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme, në përputhje me këtë Aktgjykim, do të shqyrtojë edhe një herë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga i pandehuri, përkatësisht parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata vëren se ky i fundit, përkatësisht Aktgjykimi [PAKR. nr. 108/2018] i 19 prillit 2018 i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm bazuar në nenin 485 (Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit) e KPPRK-së, dhe në rrethanat e rastit konkret, derisa të mos jetë vendosur ndryshe nga Gjykata Supreme bazuar në dispozitat e nenit 418 (Mjetet e jashtëzakonshme juridike) të KPPRK-së.

80. Ky Aktgjykim i Gjykatës, ka shpallur të pavlefshëm vetëm Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme dhe nuk ndikon drejtpërsëdrejti në efektin juridik që prodhon, sipas legjislacionit në fuqi, Aktgjykimi [PAKR. nr. 108/2018] i 19 prillit 2018 i Gjykatës së Apelit në lidhje Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e 22 nëntorit 2017 të Gjykatës Themelore. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 57 (4) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

Përfundime

81. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka gjetur se Aktgjykimi [PML. nr. 293/2018] i 3 dhjetorit 2018 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse (i) është nxjerrë nga përbërja një e Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të procedurës penale, dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e të Gjykatës, kishte marrë pjesë gjyqtari i cili gjithashtu ishte pjesë e vendimmarrjes në fazat e mëhershme të çështjes së njëjtë penale, përkatësisht kishte marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut kur është vendosur për akuzën penale të parashtruesit të kërkesës e edhe si anëtar i Kolegjit kur është vendosur për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme; dhe në rrethana të tilla, (ii) dyshimet legjitime për mungesën e paanësisë së gjykatës janë objektivisht e justifikueshme.

82. Ndërsa, Gjykata ka shpallur të papranueshme kërkesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [PML. nr. 226/2018] të 16 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, sepse i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur, më 29 korrik 2019, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën KI187/18 të papranueshme;

II. TË DEKLAROJË kërkesën KI11/19, të pranueshme për shqyrtim në merita;

III. TË KONSTATOJË se në Aktgjykimin PML. nr. 293/2018, e 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

IV. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018;

V. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

VI. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme, që në pajtim me rregullin 66 (4) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën, brenda 6 (gjashtë) muajve nga publikimi i këtij aktgjykimi, në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;

VII. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

VIII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me këtë urdhër;

IX. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u kumtohet palëve, dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

X. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI10/18, Parashtrues: Fahri Deqani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017

KI10/18, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, publikuar më 22 tetor 2019

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, e drejta për liri dhe siguri, vazhdim i paraburgimit në pritje të gjykimit, mos arsyetim i vendimeve, masat alternative, kërkesë e pranueshme, shkelje e të drejtës kushtetuese*

Parashtruesi i kërkesës, pas arrestimit të tij më 31 korrik 2010, ishte vendosur në paraburgim. Paraburgimi i tij në pritje të gjykimit kishte zgjatur deri më 3 shtator 2012, kur Gjykata e Qarkut kishte nxjerrë vendimin, me të cilin ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës se Qarkut, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë. Gjykata e Apelit kishte aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe duke e kthyer çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim.
Gjatë periudhës ndërmjet 3 shtatorit 2012 dhe 26 nëntorit 2013 paraburgimi i parashtruesit ishte paraburgim pas aktgjykimit dënues në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 367 [Paraburgimi pas shpalljes së Aktgjykimit], paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Përderisa, si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin rasti ndaj parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim, periudha e dytë e paraburgimit në pritje të gjykimit në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), kishte filluar me 26 nëntor 2013 dhe ka vazhduar deri më datën e nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR nr. 155/15], të 6 prillit 2018, me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim efektiv.
Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimet e gjykatave të rregullta për vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës, respektivisht vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri], paragrafi 4, dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
Gjykata, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit, i konfirmuar nga Gjykata Apelit dhe ajo Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar nuk justifikon vendimin e saj për vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës. Së

këndejmi, gjykatat e rregullta dështuan të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm se pse masat alternative nuk ishin të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017 me të cilin u refuzua kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR. nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017 nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 29, paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së.

Gjykata ka parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim efektiv përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR. nr. 155/15 të 6 prillit 2018], në kuadër të procedurës penale të zhvilluar kundër tij. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që kjo procedurë nuk ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata, dhe se objekt i shqyrtimit është vetëm vlerësimi i Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme përkitazi me procedurën e vazhdimit të paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

Në këtë kontekst, Gjykata përmes këtij Aktgjykimi përçon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë kërkesën dhe udhëzimin që duhet t'iu shërbejë gjykatave të rregullta, se për të qenë në përputhje me kërkesat kushtetuese të nenit 29 të Kushtetutës, dhe po ashtu edhe me kërkesat e nenit 5 të KEDNJ-së, siç është interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore, arsyetimet e tyre për vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit duhet të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe vlerësim të individualizuar në pajtueshmëri me rrethanat dhe faktet e rastit, ku shpjegohet dhe dëshmohet se pse paraburgimi në pritje të gjykimit është i domosdoshëm dhe se pse masat tjera alternative nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e papenguar dhe të suksesshëm të procedurës penale.

Gjykata, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kohëzgjatjen e masës së paraburgimit në pritje të dënimit të tij konstatoi se nuk bien në kuadër të fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI10/18

Parashtrues

Fahri Deqani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fahri Deqani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ekrem Shabani, avokat në Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore në Ferizaj), PKR. nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 28 dhjetor 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 janar 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 19 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 23 janar 2018, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të paraqesë autorizimin për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese, si dhe dokumentet shtesë dhe informatat që kanë të bëjnë me kërkesën. Një

kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

10. Më 6 shkurt 2018, parashtruesi dorëzoi vetëm autorizimin për përfaqësim.

11. Më 8 shkurt 2018, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (në tekstin e mëtejmë: QKRMT) paraqiti një shkresë, të titulluar " *Shkresë në cilësinë e palës së tretë lidhur me kërkesën KI10/18 të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese lidhur me çështjen penale kundër Fahri Deqanit*".

12. Më 1 mars 2018, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës të dorëzojë vendimet e gjykatave të rregullta përkitazi me vazhdimin e paraburgimit dhe informatave lidhur me fazën e procedurës penale kundër parashtruesit të kërkesës.

13. Më 9 mars 2018, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës dorëzoi dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

14. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

15. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

16. Më 22 gusht 2018, Kryetarja caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues.

17. Më 1 tetor 2018, Kryetarja caktoi Kolegjin e ri, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi, (kryesuese), Selvete Gërxhaliu – Krasniqi dhe Safet Hoxha.

18. Më 19 tetor 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta njoftojë lidhur me zhvillimet më të fundit përkitazi me procedurën e vazhdimit të paraburgimit dhe procedurën penale kundër tij. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës nuk dorëzoi informatat e kërkuara nga Gjykata.

19. Më 22 korrik 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj që t'ia dorëzojë vendimet tjera lidhur me rastin.

20. Më 7 gusht 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj dorëzoi në Gjykatë: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR nr. 155/15 të 6 prillit 2018, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 324/2018 të 7 gushtit 2018, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. Nr. 19/2019 të 19 shkurtit 2019.

21. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

22. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë votash konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017, nuk është në pajtueshmëri me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], paragrafi 1, pika (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri), paragrafi 3 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

Procedura penale fillestare

23. Më 31 korrik 2010, filloi zbatimi i masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

24. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ngriti Aktakuzën PP nr. 283/2010 kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se kishte kryer veprat penale të "*shtytjes në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë*" sipas nenit 147 [Vrasja e rëndë], paragrafi 1, nënparagrafit 4, lidhur me nenin 24 [Shtytja] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) dhe "vrasje në tentativë" sipas nenit 146 [Vrasja] në lidhje me nenet 20 [Tentativa] dhe 23 [Bashkëkryerja] të KPPK-së.

25. Më 3 shtator 2012, me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut) P. Nr. 137/2011, parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor për kryerjen e veprave penale "shtytje në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë " dhe "vrasje në tentativë" dhe u dënua me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim.

26. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut, parashtruesi paraqiti ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin.

27. Më 26 nëntor 2013, Gjykata e Apelit me Aktvendimin PAKR. nr. 100/2013, aprovoi ankesën e parashtruesit, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu çështjen penale në Gjykatën Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore në Pejë), për rigjykim. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit vendosi ta vazhdojë masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

28. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte nxjerrë në shkelje të ligjit penal dhe procedurës penale. Së pari, Gjykata e Apelit konstatoi se dispozitivi i Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ishte i paqartë, i pakuptueshëm dhe kontradiktor në raport me përmbajtjen e Aktgjykimit. Së dyti, Gjykata e Apelit vërejti se nuk është e qartë se në bazë të cilës aktakuzë, Gjykata e Qarkut ka gjykuar në këtë çështje penale. Së treti, Gjykata e Apelit theksoi se Gjykata e Qarkut nuk qartësoi se në cilat fakte apo prova mbështetë aktgjykimin e saj. Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit vërejti se Gjykata e Qarkut vetëm kishte përshkruar deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmive të pranuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pa vlerësuar saktësinë e tyre. Rrjedhimisht, në lidhje me këtë konstatim, Gjykata konkludoi se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut përfshinte shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht nenit 403, paragrafi 12, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK). Së katërti, Gjykata e Apelit gjeti se Gjykata e Qarkut nuk kishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Në fund, Gjykata e Apelit konkludoi se gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit, duke vlerësuar dhe shqyrtuar të gjitha provat me saktësi dhe të nxjerrë një vendim të drejtë dhe ligjor.

29. Në bazë të parashtresave të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës më 9 mars 2018, Gjykata Themelore në Pejë kishte mbajtur tetëmbëdhjetë (18) seanca, mirëpo deri më datën e lartcekur, gjegjësisht 9 mars 2018 nuk kishte nxjerrë vendim përkitazi me parashtruesin e kërkesës.

Procedura përkitazi me vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës

30. Gjykata rikujton se më 26 nëntor 2013, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR. nr. 100/2013, të 26 nëntorit 2013, vendosi të vazhdojë masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, nga 26 nëntori 2013 deri në këtë datë, paraburgimi i parashtruesit të kërkesës është vazhduar çdo dy muaj nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

31. Në kërkesën e tij, parashtruesi dorëzoi vetëm vendimet e gjykatës në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të tij, të nxjerra në vitin 2017 dhe 2018, përkatësisht vendimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR. nr. 155/15, të 30 marsit 2017; të 29 majit 2017; të 27 korrikut 2017; të 26 shtatorit 2017; të 24 nëntorit 2017; dhe 23 janarit 2018.

32. Në secilën nga vendimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj, të dorëzuara në Gjykatë, arsyetimi i Gjykatës Themelore ishte si në vijim:

> *"Sipas vlerësimit të kryetarit të trupit gjykues kundër të pandehurit Fahri Deçani, ende ekzistojnë arsye ligjore për vazhdimin e paraburgimit, siç parashihet në nenin 187 par. 1, nën. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, pasi ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me Aktakuzë, dhe që ky dyshim rezulton nga parashtresat e bashkangjitura në aktakuzë të cilat janë pjesë integrale të dosjes së lëndës.*
>
> *Kryetari i trupit gjykues konsideron se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit kundër të akuzuarit konform nenit 187 par.1 nënpar. 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos faktin se ende janë të acaruar marrëdhëniet në mes të familjes së pandehurit Fahri Deçani dhe familjes së të ndjerit [B.K.] lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale ose veprave të ngjashme.*
>
> *Kryetari i trupit gjykues mori gjithashtu parasysh masat e tjera të parapara me nenin 173 paragrafi 1 i KPPK-së, por sipas vlerësimit të gjykatës nuk do të ishte e mjaftueshme për zbatimin e suksesshëm të procedurave penale dhe për parandalimin e përsëritjes së veprave penale nga i pandehuri."*

33. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore në Ferizaj në Gjykatën e Apelit.

34. Në ankesat e tij kundër Aktvendimeve të Gjykatës Themelore, të parashtruara gjatë vitit 2018, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Themelore *"nuk ka dhënë asnjë bazë ligjore për të cilën do te mund te vazhdohej kjo mase"* dhe se arsyetimi i Gjykatës Themelore se ai mund të përsërisë veprat penale është i paqëndrueshëm. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendoi se pas tetë (8) viteve në paraburgim

"ka pushuar cdo arsye per te cilin eshte caktuar ky paraburgim [...]". Në fund, parashtruesi i kërkesës specifikon se vazhdimi i paraburgimit ndaj tij është shkelje e të gjitha të drejtave themelore të përcaktuara si *"me akte vendore gjithashtu edhe me konventa ndërkombëtare"*, për arsye se *"[...] qendrimi nen masen e paraburgimit per rreth 8 vite perben shkelje themelore te parimit te gjykimit te drejte dhe ne kohe te arsyeshme si dhe suprimon parimin e prezumimit te pafajsis [...]."*

35. Gjykata e Apelit i refuzoi ankesat e parashtruesit të kërkesës si të pabazuara. Në katër (4) Aktvendimet e Gjykatës së Apelit [PN1. nr. 2156/2017, 5 prillit 2017; të 2 gushtit 2017; të 5 tetorit 2017 dhe të 6 dhjetorit 2017] në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, arsyetimi i gjykatës ishte si në vijim:

> *"[...] se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryrës i veprës penale se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar. 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos faktin se ende janë të acaruar marrëdhënien në mes të familjes së pandehurit Fahri Deçani dhe familjes së të ndjerit [B.K.] lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale e të njëjtës natyrë apo ndonjë vepër penale tjetër; [...]."*

36. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se Gjykata Themelore në Ferizaj ka vepruar në mënyrë të drejtë kur e vazhdoi paraburgimin e parashtruesit të kërkesës.

37. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN1. nr. 2156/2017, me pretendimin për shkelje të procedurës penale dhe të ligjit penal, parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që t'i anulojë vendimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Gjykatës së Apelit, të ndërpresë masën e paraburgimit dhe të vendosë një masë tjetër alternative, përkatësisht arrestin shtëpiak.

38. Më 22 dhjetor 2017, me Aktgjykimin PML. nr. 357/2017, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

39. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme vlerësoi se:

"Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e lendes, kryesisht nga kallëzimi penal, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të dëshmitarëve, si dhe provat tjera të mbledhura në bazë të cilave është ngritur aktakuza rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryrës i veprës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nen par.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par. 1 nënpar. 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos faktin se ende janë të acaruar marrëdhënien në mes të familjes së pandehurit Fahri Deçani dhe familjes së të ndjerit Bekim Krasniqi , lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale."

40. Në fund, Gjykata Supreme përfundoi se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës *penale "sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë."*

41. Bazuar në vendimet në dispozicion të Gjykatës, Gjykata Themelore në Ferizaj vazhdoi paraburgimin e parashtruesit të kërkesës deri më 23 mars 2018.

Procedura penale ndaj parashtruesit të kërkesës pas kthimit të rastit të tij në rigjykim

42. Në bazë të parashtresave të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës më 9 mars 2018, Gjykata Themelore në Pejë që nga momenti i kthimit të procedurës në rigjykim deri më datën e lartcekur, gjegjësisht 9 mars 2018, kishte mbajtur tetëmbëdhjetë (18) seanca.

43. Ndërkohë që në bazë të parashtresave të dorëzuara nga Gjykata Themelore në Ferizaj, të kërkuar nga Gjykata, parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR nr. 155/15], të 6 prillit 2018, ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale vrasje

e rëndë në shtytje nga neni 147, pika 4 lidhur me nenin 24 të KPK-së, dhe në bashkëkryerje për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe e dënoi atë me burgim.

44. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Ferizaj, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë.

45. Më 7 gusht 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [PAKR. Nr. 324/2018,] refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

46. Më 19 shkurt 2019, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [PML. Nr. 19/2019,] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

47. Në kërkesën e tij, parashtruesi shprehimisht konteston vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR. nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017.

48. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e kontestuara kanë shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri], paragrafi 4, dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

49. Lidhur me nenin 31, paragrafi 2 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] me vendimet e lartcekura qe më shumë se 7 vite i është vazhduar masa e paraburgimit, me pretendimin se ekziston dyshimi i bazuar e në fakt [nuk] janë shpërfillur të drejtat e tij themelore kushtetuese, pasi që kësaj lënde tanimë nuk po i dihet fundi, se kur do të përfundojë."*

50. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se: "*qëndrimi edhe më tutje i të pandehurit nën masën e paraburgimit është shkelje e të gjitha të drejtave themelore të përcaktuara si me akte vendore gjithashtu edhe me konventa ndërkombëtare si dhe qëndrimi në masën e*

paraburgimit me mbi shtatë vjet përbën shkelje themelore të parimit për gjykim të drejtë si dhe suprimon parimin e prezumimit të pafajësisë, duke pasur parasysh se i pandehuri po e vuan një dënim dhe jo masë të sigurisë siç është përcaktuar me ligj."

51. Në fund, parashtruesi kërkoi nga Gjykata: *"[...] që të konstatojë se në rastin e të akuzuarit Fahri Deqani ka pasur shkelje flagrante të të drejtave të tij themelore kushtetuese, dhe atë të neneve 29 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që të shpallë të pavlefshëm vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me shqiptimin e masës së paraburgimit dhe që [parashtruesi i kërkesës] të lirohet nga [paraburgimi]."*

Dispozitat relevante ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] i Kushtetutës:

"1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një

periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

[...]
4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit."

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me

ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 5 (E drejta për liri dhe siguri) i KEDNJ-së:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
[...]
c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

[...]

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm."
[...]

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në

sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtare më 28 dhjetor 2012)

Neni 5
Gjykimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm

1. Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.

2. Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.

3. Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.

4. Kushdo që është privuar nga liria me arrest menjëherë njoftohet në gjuhën që e kupton për arsyet e heqjes së lirisë. Kushdo që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës sillet para gjyqtarit të gjykatës themelore në juridiksionin e arrestimit brenda dyzet e tetë (48) orëve. Gjyqtari vendos për caktimin e paraburgimit, në pajtim me Kapitullin X të këtij Kodi.

Neni 187
Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit

1. Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:
1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:
1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.
1.3. masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.

[...]

Neni 193
Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

1. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë. Gjyqtari i vetëm

gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht.

2. Pasi të kalojnë dy (2) muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht.

Neni 367
Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit

1. Me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues:
1.1. cakton, vazhdon paraburgim kur ekzistojnë kushtet nga neni 187paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
1.2. ndërprenë paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur.
2. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shqipton dënim prej pesë (5) ose më shumë vjet burg të akuzuarit ia cakton paraburgimin, nëse ai nuk gjendet në paraburgim, ose ia vazhdon atë kur i akuzuari gjendet në paraburgim.

Pranueshmëria e kërkesës

52. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të përcaktuara në Rregullore të punës.

53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

54. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik."

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."

55. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me

kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

56. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (1) (d), në mënyrë specifike përcakton që:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

57. Në lidhje me këtë, pasi që shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të fakteve dhe të ligjit të cilat janë të një kompleksiteti të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave.

58. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë është e pranueshme në kuptim të rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës, dhe se nuk është e papranueshme në asnjë bazë tjetër të përcaktuar me Rregulloren e punës (shih, rastet e GJEDNJ-së, rasti *A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55, rastin *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafin 144, si dhe shih rastet e Gjykatës, rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 20 majit 2016 dhe rastin KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i datës 9 janar 2018, paragrafi 38).

Meritat e kërkesës

59. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vazhdimi i paraburgimit të tij i shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 29 dhe nenin 31 të Kushtetutës.

I. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës

60. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson, se "*qëndrimi edhe më tutje i të pandehurit nën masën e paraburgimit është shkelje e të gjitha të drejtave themelore të përcaktuara si me akte vendore gjithashtu edhe me konventa ndërkombëtare [...].*"

61. Gjykata fillimisht thekson se të drejtat dhe standardet që duhet garantuar në rastin e privimit nga liria janë interpretuar gjerësisht nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

62. Prandaj, përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, Gjykata i referohet parimeve dhe standardeve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së që kanë të bëjnë me caktimin dhe kohëzgjatjen e paraburgimit.

1. Kriteret e përcaktuara lidhur me caktimin e paraburgimit

63. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që, për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ, arrestimi ose heqja e lirisë duhet të bazohet në një nga arsyet për heqjen e lirisë të parapara në nenin 29, paragrafin 1, të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.

64. Gjykata rikujton nenin 29, paragrafin 1, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës që përcakton:

> *1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:*
>
> *(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;*

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...].”

65. Gjykata vëren, se në bazë të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës dhe nenit 5. 1 (c) të KEDNJ-së, privimi i lirisë mund të bëhet në rast të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale, dhe kur një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale ose largimin pas kryerjes se saj.

66. Prandaj, Gjykata thekson që për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, caktimi i paraburgimit, duhet të ketë mbështetje në njërën nga bazat për privimin e lirisë të përcaktuara me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5, paragrafin 1 (c) të Konventës.

67. GJENDJ, në praktiken e saj gjyqësore, ka përcaktuar tri kritere themelore, që duhet ekzaminuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë, është i ligjshëm dhe jo arbitrar (shih rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, [DHM] kërkesa nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 183).

68. Së pari, duhet të ekzistoj "dyshimi i bazuar" që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, [DHM] kërkesa nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 184). Së dyti, qëllimi i privimit të lirisë “ është që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale” (shih, rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 nëntorit 2017, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së, *Ostendorf kundër Gjermanisë,* nr. 15598/08, Aktgjykimi i 7 marsit 2013, paragrafi 68), dhe që për me tepër, duhet te jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm “për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse” (shih, rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 nëntorit 2017, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e lartcekur të GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 185). Së treti, privimi i lirisë apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj (shih rastin e lartcekur të GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 186) .

1.1. Zbatimi i kritereve lidhur me caktimin e paraburgimit në rastin e parashtruesit të kërkesës

69. Duke u bazuar në atë që u theksua më lart, Gjykata vëren që caktimi i paraburgimit në fjalë, është i bazuar në nenin 29.1.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5.1 (c) të KEDNJ-së.

2. Parimet e përgjithshme lidhur me paraburgimin në pritje të gjykimit

70. Fillimisht, Gjykata thekson se përkitazi me kriteret themelore ligjore në lidhje me mbajtjen në paraburgim në pritje të dënimit do t'iu referohet parimeve dhe standardeve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, brenda kuptimit të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së. Specifikisht, në kontekstin e rastit të parashtruesit, gjykata do ta fokusohet në parimet dhe standardet e GJEDNJ-së në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafit 3 të KEDNJ-së, që kanë të bëjnë me paraburgimin në pritje të gjykimit.

71. Gjykata, thekson se në përcaktimin e kohëzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjykimit sipas nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafit 3 të KEDNJ-së, periudha e paraburgimit fillon ditën kur i akuzuari merret në paraburgim dhe mbaron në ditën kur është liruar apo gjykata e shkallës së parë ka vendosur në lidhje me aktakuzën (shih rastet e GJEDNJ-së, *Štvrtecký kundër Sllovakisë*, kërkesa nr. 55844/12, Aktgjykim i 5 qershorit 2018, paragrafi 55; *Solmaz kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27561/02, Aktgjykim i 16 janarit 2017, paragrafët 23 dhe 24).

72. Gjykata duke iu referuar nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafit 3 të KEDNJ-së, thekson se dyshimi i bazuar që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale konsiderohet si elementi thelbësor për caktimin e paraburgimit dhe/apo për vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit.

73. GJEDNJ, në praktikën e saj ka nënvizuar se arsyeshmëria e një periudhe kohore të kaluar në paraburgim nuk mund të vlerësohet në terma abstraktë, por duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilit rast individual dhe sipas karakteristikave specifike të rastit. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka dëshmi të një kërkese reale të interesit publik, e cila pavarësisht prezumimit të pafajësisë, është e një peshe më të madhe se norma për respektimin e lirisë individuale, e përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së

(shih, rastin e GJEDNJ-së, *Buzadji kundër Moldovës*, kërkesa nr. 23755/07, Aktgjykim i 5 korrikut 2016, paragrafi 90, shih po ashtu rastin *Labita kundër Italisë,* [DHM], kërkesa nr. 26772/95, paragrafi 152, si dhe rastin *Kudła kundër Polonisë* [DHM], kërkesa nr. 30210/96, paragrafi 110).

74. Sipas praktikës dhe vlerësimit të GJEDNJ-së nuk ekziston një afat kohor i caktuar që do të mund të aplikohej si standard për secilin rast (shih rastin e GJEDNJ-së McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar, [DHM] kërkesa nr. 543/03, Aktgjykim i 3 tetorit 2006, paragrafët 41-45).

75. GJEDNJ-a nënvizon që gjykatat vendore duhet të shqyrtojnë dhe përcaktojnë se përveç dyshimit të bazuar ekzistojnë edhe arsye tjera, të cilat vazhdojnë ta justifikojnë paraburgimin në pritje të gjykimit (shih rastet e GJEDNJ-së, rastin *Letellier kundër Francës*, kërkesa nr. 12369/86, Aktgjykimi i 26 qershorit 1991, paragrafi 35; dhe rastin *Yağcı dhe Sargın kundër Turqisë*, kërkesat nr. 16419/90 dhe 16426/90, Aktgjykim i 8 qershorit 1995, paragrafi 50).

76. Kësisoj, gjykatat vendore duhet të shqyrtojnë dhe adresojnë të gjitha rrethanat të cilat flasin në favor apo kundër masës së paraburgimit (gjegjësisht ekzistimit të interesit publik në atë kuptim), duke u kujdesur njëkohësisht edhe për prezumimin e pafajësisë. Pikërisht në bazë të arsyetimeve që japin gjykatat vendore, GJEDNJ vlerëson nëse ka ndodhur shkelja e nenit 5, paragrafit 3 të KEDNJ (shih Peša kundër Kroacisë, Aktgjykimi i GJEDNJ i 8 prillit 2010, paragrafi 91; dhe Perica Oreb kundër Kroacisë, Nr. 20824/09, paragrafi 107).

77. Si rrjedhojë, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka përcaktuar katër arsye themelore të rëndësishme për vazhdimin e paraburgimit, përkatësisht: 1) rrezikun e arratisjes; 2) ndërhyrjen në gjykatë; 3) parandalimin e krimit; dhe 4) nevojën për të ruajtur rendin publik (shih rastet e GJEDNJ-së, rastin Tiron kundër Rumanisë, kërkesa nr. 17689/03, Aktgjykimi i 7 prillit 2009, paragrafi 37; rastin Smirnova kundër Rusisë, kërkesa nr. 46133/99 dhe 48183/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafi 59; rastin Piruzyan kundër Armenisë, kërkesa nr. 33376/07, Aktgjykimi i 26 shtatorit 2012, paragrafi 94).

78. Gjithashtu, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka pohuar vazhdimisht se ekzistenca e dyshimit të bazuar që i paraburgosuri është kryes i veprës penale është thelbësore (conditio sine qua non) për vazhdimin e paraburgimit, por jo e mjaftueshme pas një periudhe të caktuar kohore (shih rastet e GJEDNJ, rastin Stögmüller kundër

Austrisë, kërkesa nr. 1602/62, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969 dhe rastin Clooth kundër Belgjikës, kërkesa nr. 12718/87, Aktgjykimi i 12 dhjetorit 1991, paragrafi 36).

79. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, këto arsye themelore, mbi bazën e të cilave mund të vendoset masa e paraburgimit, duhet të shqyrtohen dhe vendosen në frymën e detyrimit të autoriteteve përgjegjëse publike që të kenë parasysh edhe masat tjera alternative për sigurimin e pranisë së të pandehurit në funksion të përbylljes me sukses të procedurës penale respektive. (shih, rasti i GJEDNJ-së Idalov kundër Rusisë, kërkesa nr. 5826/03, Aktgjykimi i 22 majit 2012, paragrafi 40).

80. Në lidhje me këtë, dhe, në pajtim me parimet e zhvilluara nga GJEDNJ, arsyetimi i vendimit të gjykatave për vazhdimin e paraburgimit në pritje të dënimit duhet të jetë gjithnjë evident, përkatësisht të jetë një arsyetim i detajuar dhe i bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit. Në këtë kontekst, GJEDNJ në mënyrë të vazhdueshme ka nënvizuar se *"vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të ketë një kontroll publik të administrimit të drejtësisë"* (shih rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, Kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003 paragrafi 37, Tase kundër Rumanisë, kërkesa nr. 29761/02, Aktgjykimi i 10 qershorit 2008, paragrafi 41).

81. Në dritën e kësaj që u theksua më lartë, GJEDNJ po ashtu ka konstatuar se "zgjatja pothuajse automatike e paraburgimit është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara" në nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, rastin e cituar më lartë Tase kundër Rumanisë, paragrafi 40). Prandaj, GJEDNJ ka vlerësuar se edhe nëse arsyet e lartcekura kanë ekzistuar në momentin e caktimin të paraburgimit, natyra e këtyre arsyeve apo rrethanave mund të ndryshojë me kalimin e kohës (shih rastin e cituar më lartë të GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 234).

2.1 Zbatimi i kritereve të GJEDNJ-së në lidhje me vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit në rastin e parashtruesit të kërkesës

82. Në vijim, bazuar në shpjegimin e mësipërm të parimeve kryesore të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimet për shkeljen e garancive procedurale të përcaktuara në Kushtetutë dhe KEDNJ lidhur me vazhdimin e paraburgimit të tij.

83. Fillimisht, Gjykata rithekson që paraburgimi i parashtruesit të kërkesës është i bazuar në nenin 29, paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës dhe nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së, gjegjësisht paraburgimit në pritje të gjykimit.

84. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"qëndrimi edhe më tutje i të pandehurit nën masën e paraburgimit është shkelje e të gjitha të drejtave themelore të përcaktuara si me akte vendore gjithashtu edhe me konventa ndërkombëtare [...]."* Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendoi se pas tetë (8) viteve në paraburgim *"ka pushuar çdo arsye për të cilin është caktuar ky paraburgim."*

85. Prandaj, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se vendimet që kanë të bëjnë me vazhdimin e paraburgimit të tij janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës, Gjykata fillimisht do ti referohet periudhës së mbajtjes së parashtruesit të kërkesës në paraburgim në pritje të gjykimit, në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së dhe kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

(a) mbajtja e parashtruesit të kërkesës në paraburgim në pritje të gjykimit

86. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, pas arrestimit të tij, me datë 31 korrik 2010 është vendosur në paraburgim. Paraburgimi i tij në pritje të gjykimit zgjati deri më 3 shtator 2012, kur Gjykata e Qarkut mori vendimin [Aktgjykimi P. Nr. 137/2011, i 3 shtatorit 2012], me të cilin parashtruesi ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim.

87. Gjykata rikujton që kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës se Qarkut, parashtruesi kishte parashtruar ankesë. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit PAKR. nr. 100/2013, më 26 nëntor 2013, aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim.

88. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjatë periudhës ndërmjet 3 shtatorit 2012 dhe 26 nëntorit 2013, përkatësisht pas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut deri në marrjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit për ta kthyer çështjen penale për rishqyrtim në Gjykatën Themelore, paraburgimi i parashtruesit të kërkesës nuk bie brenda paraburgimit në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafit 3 të KEDNJ-së.

89. Prandaj, Gjykata konsideron se gjatë periudhës ndërmjet 3 shtatorit 2012 dhe 26 nëntorit 2013, paraburgimi i parashtruesit ishte paraburgim pas aktgjykimit dënues në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 1, të Kushtetutës dhe nenin 367 [Paraburgimi pas shpalljes së Aktgjykimit], paragrafit 2 të KPPK-së.

90. Gjykata, rikujton se Gjykata e Apelit me Aktvendimin PAKR. nr. 100/2013, të 26 nëntorit 2013, përmes së cilit e ktheu çështjen penale në Gjykatën Themelore për rishqyrtim, gjithashtu vendosi ta vazhdojë paraburgimin e parashtruesit të kërkesës.

91. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se periudha e dytë e paraburgimit në pritje të gjykimit në kuptim të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës , në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së, ka filluar me 26 nëntor 2013 dhe ka vazhduar deri me datën e nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR nr. 155/15], të 6 prillit 2018, me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim efektiv.

92. Rrjedhimisht, që nga 26 nëntori 2013 deri më 6 prill 2018 [data kur është nxjerrë Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR nr. 155/15], paraburgimi i parashtruesit të kërkesës në pritje të gjykimit të rastit të tij ishte vazhduar çdo dy muaj nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

(b) Vlerësimi në lidhje me arsyetimin për vazhdim të paraburgimit në pritje të gjykimit

93. Në rastin konkret, Gjykata fillimisht rikujton se KPPK, përkatësisht neni 187, përcakton procedurën dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së paraburgimit, përfshirë: 1) ekzistimin e "dyshimit të bazuar"; 2) përmbushjen e kushteve për vazhdimin e paraburgimit që duke marrë për bazë rrethanat e kryerjes së veprës penale ekziston rreziku që parashtruesi i kërkesës mund të përsërisë veprën penale; si dhe 3) masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale (shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 nëntorit 2017 , paragrafi 68).

94. Gjykata rikujton se GJEDNJ po ashtu ka përcaktuar katër arsye themelore të rëndësishme për vazhdimin e paraburgimit të personave në pritje të gjykimit, përkatësisht: 1) rrezikun e arratisjes; 2) ndërhyrje

në gjykatë; 3) parandalimi i krimit; 4) nevoja për të ruajtur rendin publik (shih rastet e larteckura të GJEDNJ-së, rastin Tiron kundër Rumanisë, paragrafi 37; rastin Smirnova kundër Rusisë, paragrafi 59; dhe rastin Piruzyan kundër Armenisë, paragrafi 94).

95. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, këto baza të paraburgimit duhet të shqyrtohen dhe shihen së bashku me mundësinë e shqyrtimit të masave tjera, të parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

96. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore në Ferizaj duke iu referuar nenit 187 të KPPK-së konstatoi se përveç që ekziston dyshimi i bazuar për kryerjen e veprës penale, po ashtu konstatoi se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit për arsyet si në vijim: 1) marrë për bazë peshën e rëndë të veprës penale; 2) mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe rrethanat dhe mjedisin në të cilat është kryer vepra penale; 3) faktin se ende janë të acaruara marrëdhëniet në mes të familjes së parashtruesit të kërkesës dhe familjes së viktimës; dhe se 4) ekziston rreziku se me lëshimin e parashtruesit të kërkesës në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale ose veprave të ngjashme.

97. Këtë arsyetim të Gjykatës Themelore e kanë vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar.

98. Gjykata rikujton Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, në të cilin është dhënë arsyetimi në vijim:

> *"Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e lendes, kryesisht nga kallëzimi penal, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të dëshmitarëve, si dhe provat tjera të mbledhura në bazë të cilave është ngritur aktakuza rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryrës i veprës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nen par.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.*
>
> *Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par. 1 nënpar. 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos faktin se ende janë të acaruar marrëdhënien në mes të familjes së pandehurit Fahri*

Deçani dhe familjes së të ndjerit [B.K.], lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale."

99. Në lidhje më këtë, Gjykata vëren se në lidhje me vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme përveç që vërtetoi arsyetimin dhe konstatimin e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, përdori saktësisht të njëjtin arsyetim sikurse ai i dhënë me Aktvendimin e sipërcekur të Gjykatës Themelore PKR. Nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017.

100. Në këtë kuptim, sa u përket arsyetimeve të gjykatave të rregullta lidhur me çështjen e paraburgimit, Gjykata konstaton se pesha e akuzës për veprën penale të kryer dhe mundësia e kryerjes së serishme të veprës penale, mund të jenë faktorë të rëndësishëm në vazhdimin e paraburgimit, porse në vetvete nuk mund të jenë arsye për tejzgjatjen e paraburgimit. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mundësia e përsëritjes së veprës penale duhet të bazohet në fakte konkrete dhe po ashtu të marrë parasysh edhe parimin e prezumimit të pafajësisë (shih rastin *Perica Oreb kundër Kroacisë, Aktgjykimi i GJEDNJ i 13 tetorit 2013*, paragrafi 113).

101. Gjykata gjithashtu vë në pah se argumenti i dhënë në vendimet e tri gjykatave të rregullta "*sidomos faktin se ende janë të acaruar marrëdhëniet në mes të familjes së pandehurit Fahri Deçani dhe familjes së të ndjerit [B.K.], lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale",* nuk mund të jetë pafundësisht bazë për vazhdimin e paraburgimit. Për më tepër, duhet theksuar se siç është përcaktuar edhe në praktikën gjyqësore të GJENDJ, *"njëra ndër obligimet themelore pozitive të shteteve ku zbatohet KEDNJ është që autoritetet përgjegjëse shtetërore kanë për detyrë të garantojnë të drejtën për jetë përmes sanksionimit të legjislacionit penal efektiv dhe krijimin e mekanizmave ligj-zbatues me qëllim të parandalimit të cenimit të individit dhe gjithashtu, edhe detyrimin që të marrin masa paraprake dhe praktike për të mbrojtur individin, jeta e të cilit vihet në rrezik nga veprimet kriminale të individëve të tjerë"(shih Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i GJEDNJ i 28 tetorit 1998, paragrafi* 115).

102. Gjykata arrin në përfundimin që kryesisht gjatë vitit 2017 vazhdimi i paraburgimit ndaj parashtruesit nga Gjykata Themelore pushoi të jetë i bazuar në arsyetim relevant dhe të mjaftueshëm. Konkretisht, Gjykata gjen se Gjykata Themelore në pesë Aktvendimet e saj të fundit (të 30

marsit 2017; të 29 majit 2017; të 27 korrikut 2017; të 26 shtatorit 2017; të 24 nëntorit 2017) në vazhdimësi kishte dhënë arsyetimin identik.

103. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 5 (3) të KEDNJ-së në një numër të madh rastesh në të cilat gjykatat vendase kishin përdorur formulime stereotipe për vazhdimin e paraburgimit, pa marrë parasysh dhe pa argumentuar bindshëm nevojën e vazhdimit të paraburgimit mbi bazën e fakteve dhe rrethanave specifike të rastit (shih, *Orban kundër Kroacisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ i 19 dhjetorit 2013, paragrafi 59; *Sulaoja kundër Estonisë*, Nr. 55939/00, 15 shkurt 2005, paragrafi 64; *Tsarenko kundër Rusisë*, Nr. 5235/09, 3 mars 2011, paragrafi 70).

104. Prandaj, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës Themelore në këto Aktvendime, i konfirmuar nga Gjykata Apelit dhe ajo Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar është një arsyetim i përgjithësuar dhe jo mjaftueshëm i arsyetuar, ku qartësisht mungon një analizë dhe vlerësim i argumentuar dhe bindës i fakteve dhe rrethanave konkrete të rastit.

105. Për më tepër, gjykatat e rregullta dështuan të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm se pse vazhdimi i paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës ishte i domosdoshëm dhe pse masat alternative nuk ishin të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.

106. Prandaj, një arsyetim dhe elaborim i mirëfilltë i të gjitha rrethanave konkrete, përfshirë edhe arsyetimin e detajuar se pse masat tjera alternative nuk mund të gjenin zbatim në rastin e parashtruesit të kërkesës do të ishin dëshmi e qartë e vlerësimit të individualizuar në përputhje me specifikat e rastit, si dhe arsyetime të qëndrueshme për nevojën e vendosjes sikurse me rastin e vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, lidhur me vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në pritje të gjykimit.

107. Andaj, edhe nëse arsyet për vazhdimin e paraburgimit vazhdojnë të jenë ende të pranishme, Gjykata rithekson se këto arsye secilën herë kërkojnë një shqyrtim të vazhdueshëm dhe të individualizuar në përputhje me specifikat e rastit konkret, pasi që natyra e këtyre arsyeve apo rrethanave të cilat në fillim kanë justifikuar caktimin dhe/apo vazhdimin e paraburgimit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

108. Në lidhje me këtë, Gjykata duke rikujtuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila ka konstatuar se "zgjatja pothuajse automatike e

paraburgimit është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara" në nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, Rasti i GJEDNJ-së i cituar më sipër Tase kundër Rumanisë, paragrafi 40), vlerëson se mungesa e arsyetimit konkret dhe të detajuar, si dhe vazhdimi i paraburgimit në pritje të gjykimit nga gjykatat e rregullta me arsyetimin e njëjtë nuk është në pajtim me parimet dhe standardet e vendosura nga GJENDJ.

109. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vazhdimi i paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në pritje të gjykimit të tij, i konfirmuar me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme Pml. nr. 357/2017, e 22 dhjetorit 2017 përbën shkelje të nenit 29, paragrafit 1, pikës (2) të Kushtetutës, në lidhje nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së.

II. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës

110. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] me vendimet e lartcekura qe më shumë se 7 vite i është vazhduar masa e paraburgimit, me pretendimin se ekziston dyshimi i bazuar në fakt [nuk] janë shpërfillur të drejtat e tij themelore kushtetuese, pasi që kësaj lënde tani më nuk po i dihet fundi, se kur do të përfundojë."*

111. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës shprehimisht pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës për shkak të vazhdimit të paraburgimit ndaj tij çdo dy muaj nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk ngriti pretendime për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës për shkak se Gjykata Themelore në Pejë, në kuadër të procedurës për gjykim ende nuk kishte vendosur për rastin e tij.

112. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së sqaroi se shqyrtimi i kërkesave "brenda një kohe të arsyeshme" të paraqitura nga një person që mbahet në paraburgim, që kanë të bëjnë vetëm me fazat e procedurës për të cilat zbatohet neni 5, paragrafi 3 i KEDNJ-së, më saktësisht, prej arrestimit deri te dënimi nga gjykatat, bien vetëm brenda fushëveprimit të nenit 5 dhe jo brenda fushëveprimit të nenit 6 (1) të KEDNJ-së (shih rasti i GJEDNJ-së *Abdoella kundër Holandës*, Kërkesa nr. 12728/87, Aktgjykimi i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24).

113. Prandaj, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kohëzgjatjen e masës së paraburgimit në pritje të dënimit të tij nuk bien në kuadër të fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës.

Përfundim

114. Gjykata, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, vlerëson se arsyetimi i Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit, i konfirmuar nga Gjykata Apelit dhe ajo Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar nuk justifikon vendimin e saj për vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës. Së këndejmi, gjykatat e rregullta dështuan të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm se pse masat alternative nuk ishin të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.

115. Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017 me të cilin u refuzua kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR. nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017 nuk është në pajtueshmëri me nenin 29, paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së.

116. Gjykata ka parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim efektiv përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR. Nr. 155/15 të 6 prillit 2018], në kuadër të procedurës penale të zhvilluar kundër tij. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që kjo procedurë nuk ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata, dhe se objekt i shqyrtimit është vetëm vlerësimi i Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme përkitazi me procedurën e vazhdimit të paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

117. Andaj, është e kuptueshme që ky aktgjykim nuk mund të prodhojë asnjë efekt në lidhje me statusin e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, Gjykata vlerëson se është shumë e rëndësishme që përmes këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese do të vendoset një standard i ri në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës dhe, rrjedhimisht gjykatat e rregullta, në të ardhmen do të duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe standardet e elaboruara në këtë Aktgjykim,

të cilat janë interpretuar në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

118. Në këtë kontekst, Gjykata përmes këtij Aktgjykimi përçon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë kërkesën dhe udhëzimin që duhet t'iu shërbejë gjykatave të rregullta, se për të qenë në përputhje me kërkesat kushtetuese të nenit 29 të Kushtetutës, dhe po ashtu edhe me kërkesat e nenit 5 të KEDNJ-së, siç është interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore, arsyetimet e tyre për vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit duhet të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe vlerësim të individualizuar në pajtueshmëri me rrethanat dhe faktet e rastit, ku shpjegohet dhe dëshmohet se pse paraburgimi në pritje të gjykimit është i domosdoshëm dhe se pse masat tjera alternative nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e papenguar dhe të suksesshëm të procedurës penale.

119. Gjykata, më tej sqaron se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji apo mënyre të kompensimit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, në rastin konkret nenit 29 të Kushtetutës (shih edhe rastin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI108/18, parashtrues Blerta Morina, Aktvendim për Papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 196). Gjykata po ashtu rikujton që në praktikën e GJEDNJ-së, bazuar në rrethanat specifike të rastit, GJEDNJ konsideron se vet gjetja e shkeljes paraqet "*shpërblim të drejtë*" edhe për dëmin jo-material që një parashtrues mund të ketë pësuar. (Në lidhje me këtë, shih pjesën operative të rastit të GJEDNJ-së, *Roman Zaharov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2015, shih po ashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI108/18, parashtrues Blerta Morina, paragrafi 197).

120. Megjithatë, arsyet e theksuara më sipër nuk nënkuptojnë që individët nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuara në ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI108/18, parashtrues Blerta Morina, Aktvendim për Papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 197).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit, rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 8 tetor 2019:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË me shumicë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017, nuk është në pajtueshmëri me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], paragrafi 1, pika (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri), paragrafi 3 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama -Hajrizi

MENDIM MOSPAJTUES i Gjyqtares Selvete Gërxhaliu – Krasniqi në rastin KI10/18

E respektoj vendimin e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: shumica). Megjithatë, nuk mund të pajtohem me këtë vendim të shumicës për arsyet në vijim:

Unë nuk pajtohem me vendimin e shumicës për shkak të:

1. Dështimit të shumicës që ta përkufizojë qartë cilën periudhë të qëndrimit në paraburgim të parashtruesit të kërkesës e shpallë në kundërshtim me kushtetutën;

2. Dështimit të shumicës që ta adresojë të drejtën e kompensimit në bazë të paragrafit 5, nenit 29 të Kushtetutës; si dhe

3. Shumica nuk ka arritur që ta bëjë vlerësimin e arsyeve për vazhdimin e masës së paraburgimit, në bazë të praktikës së GJEDNJ-së.

FUSHËVEPRIMI I KËRKESËS

1. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së qëndrimit të tij në paraburgim, duke u shprehur*: "Qëndrimi edhe më tutje i të pandehurit nën masën e paraburgimit është shkelje e të gjitha të drejtave themelore të përcaktuara si me akte vendore gjithashtu edhe me konventa ndërkombëtare, si dhe qëndrimi në masën e paraburgimit me mbi shtat vjet burg , përbën shkelje themelore të parimit për gjykim të drejtë si dhe suprimon parimin e prezumimit të pafajësisë, duke pasur parasysh se i pandehuri po e vuan një dënim dhe jo masë të sigurisë siç është përcaktuar me ligj".*

2. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: "*me vendimet e gjykatave të rregullta , përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR. nr. 155/15, kundërligjshëm është vendosur lidhur me paraburgimin e të akuzuarit [....].".*

3. Në rastin konkret parashtruesi i kërkesës *pretendon se "[...] me vendimet e lartcekura qe më shumë se 7 vite i është vazhduar masa e paraburgimit, me pretendimin se ekziston dyshimi i bazuar e në fakt*

[nuk] janë shpërfillur të drejtat e tij themelore kushtetuese, pasi që kësaj lënde tanimë nuk po i dihet fundi, se kur do të përfundojë."

4. Parashtruesi pretendon se me anë të këtyre vendimeve, të akuzuarit i janë cenuar dhe shkelur të drejtat e tij themelore kushtetuese, "***ligjshmërinë e arrestit ose ndalimit***", neni 29, paragrafi 1. pika (2) e Kushtetutës në lidhje me nenin 5 paragrafi 1 i KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon vlerësimin e të drejtave të tij kushtetuese: "***vendosja e rastit në kohë sa më të shkurtër***", neni 29, paragrafi 4 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 paragrafi 4 i KEDNJ-së.

5. Në pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të bëjë vlerësimin e të drejtës: "[...] ***kushtetuese për gjykim në afat të caktuar kohor të arsyeshëm".***

6. Vendimi i shumicës me të drejtë identifikon se "[...] *shqyrtimi i kërkesave "brenda një kohe të arsyeshme" të paraqitura nga një person që mbahet në paraburgim, që kanë të bëjnë vetëm me fazat e procedurës për të cilat zbatohet neni 5, paragrafi 3 i KEDNJ-së, më saktësisht, prej arrestimit deri te dënimi nga gjykatat, bien vetëm brenda fushëveprimit të nenit 5 dhe jo brenda fushëveprimit të nenit 6.1 të KEDNJ-së (shih rasti i GJEDNJ-së Abdoella kundër Holandës, Kërkesa nr. 12728/87, Aktgjykimi i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24)*"[1]

7. Si rrjedhojë e gjithë kësaj, kërkesa kushtetuese duhet trajtohet në kuadër të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së. Në vazhdim do t'i shtjelloj në pika të shkurta arsyet e mospajtimit tim me vendimin e shumicës, duke i specifikuar dështimet e shumicës në trajtimin e kërkesës kushtetuese, në bazë të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.

Cilën periudhë të qëndrimit në paraburgim të parashtruesit të kërkesës, e shpallë në kundërshtim me kushtetutën, vendimi i shumicës

8. Nga shkresat e lëndës del se parashtruesi i kërkesës është arrestuar me datën 31.07.2010. Parashtruesi i kërkesës nga Gjykata ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së ndalimit dhe mbajtjes dhe paraburgimit deri me datën *22 dhjetor 2017.*[2] *Me këtë rast*

[1] Aktgjykimi, paragrafi 112.

[2] Gjykata nuk e ka trajtuar periudhën pas datës 22 dhjetor 2017 deri më 6 prill 2018, kjo periudhë e cila ka të bëjë me vendimet me të cilat gjykatat e rregullta kanë vendosur në lidhje me përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës, si dhe periudhën e shqyrtimit të ankesave deri më datën 19 shkurt 2019;

parashtruesi i kërkesës thekson se "*qëndrimi edhe më tutje i të pandehurit nën masën e paraburgimit është shkelje e të gjitha të drejtave themelore të përcaktuara si me akte vendore gjithashtu edhe me konventa ndërkombëtare [...].*"[3]

9. *Vendimi i shumicës ka konstatuar se "... Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017, nuk është në pajtueshmëri me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], paragrafi 1, pika (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri), paragrafi 3 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut."*[4]

10. Shtrohet pyetja, cilën periudhë kohore prej datës 31 korrik 2010 deri me datën 22 dhjetor 2017 të qëndrimit në paraburgim të parashtruesit të kërkesës e mbulon aktgjykimi i shumicës i cili është shpallur në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.

11. Konsideroj se, për shkak të rëndësisë specifike të së drejtës në liri dhe siguri në kuadër të të drejtave dhe lirive individuale, si dhe për shkak të periudhës së gjatë të qëndrimit në paraburgim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të deklarohet qartë se cila është kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim, të cilën Gjykata e ka shpallur që nuk është në pajtim me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ.

12. GJEDNJ-ja në praktikën e saj e ka trajtuar dhe sqaruar rëndësinë e të drejtës për liri dhe siguri në shoqërinë demokratike, raportet me parimin e sigurisë juridike dhe sundimin e ligjit, duke specifikuar se qëllimi i përgjithshëm i të drejtës për liri dhe siguri është që të sigurohet që askujt nuk mund t'i kufizohet liria në mënyrë arbitrare (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ -së i 13 dhjetorit 2013, *El-Masri kundër ish-Republikës Juogosllave të Maqedonisë,* nr. 39630/09, paragrafi 230).[5]

13. GJEDNJ-ja në po të njëjtin Aktgjykim, në pikën 7 "[...] *vendos që ndalimi i parashtruesit në hotel për njëzet e tre ditë ishte arbitrar, në kundërshtim me nenin 5 të Konventës, (shih* Aktgjykimi i GJEDNJ -së i 13 dhjetorit 2013, *El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave t*ë *Maqedonisë,* nr. 39630/09, pika 7).

Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR nr. 155/15 të 6 prillit 2018, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 324/2018 të 7 gushtit 2018, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. Nr. 19/2019 të 19 shkurtit 2019.

[3] Aktgjykimi, paragrafi 60.

[4] Aktgjykimi, pika II.

[5] Shih, rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri, 16 nëntorit 2017, paragrafi 47.

14. E drejta në liri dhe siguri në demokracitë kushtetuese, është e drejtë thelbësore e individit. Ndalimi dhe paraburgimi si formë e heqjes së lirisë zë vend të veçantë në Kushtetutë dhe në KEDNJ. Çdo vendim në bazë të cilit individi është ndaluar ose i është vazhduar paraburgimi i nënshtrohet kontrollit gjyqësor, bazuar në kriteret e qarta të praktikës së GJEDNJ-së.

Dështimi i Gjykatës që ta adresojë të drejtën e kompensimit në bazë të paragrafit 5, nenit 29 të Kushtetutës

15. Përcaktimi i saktë i periudhës së qëndrimit në paraburgim të parashtruesit të kërkesës, e cila në vendimin e shumicës është shpall në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, është thelbësore për shkak të:

a) përcaktimit të saktë të së drejtës në kompensim të individit, në rast të shpalljes së vendimeve të gjykatave të rregullta në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës, si dhe

b) ndikimit të Aktgjykimit në avancimin e rendit kushtetues, dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës, gjatë zbatimit të nenit 29 paragrafit 5 të Kushtetutës.

16. Në lidhje me të drejtën e kompensimit. Kushtetuta në nenin 29 paragrafi 5 në mënyrë shprehimore përcakton se: ”*Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.”*

17. Vendimi i shumicës, në mënyrë jo të drejtë e vlerëson çështjen e kompensimit në rastin e parashtruesit të kërkesës. Vendimi i shumicës thekson :“[…]*Gjykata, më tej sqaron se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji apo mënyre të kompensimit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, në rastin konkret nenit 29 të Kushtetutës (shih edhe rastin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI108/18, parashtrues Blerta Morina, Aktvendim për Papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 196*).”[6]

18. Konstatimi i shumicës se Gjykata, nuk ka autorizime ligjore për përcaktimin e ndonjë lloji apo mënyre të kompensimit duke iu referuar rastit KI108/18,është i paqëndrueshëm. Rasti KI108/18, absolutisht nuk ka të bëjë me nenin 29 të Kushtetutës, përkatësisht në të drejtën e lirisë dhe të sigurisë. Në rastin KI108/18 objekt i çështjes

[6] Aktgjykimi , paragrafi 119.

ka qenë vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; nenit 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNJ-së.[7]

19. Më keqardhje konstatoj, se vendimi i shumicës as që e merr në konsideratë ekzistencën e normës kushtetuese, e cila është e mishëruar në vet nenin 29 të Kushtetutës, paragrafi 5. Detyra primare e Gjykatës është interpretimi dhe, në rastin konkret, vënia në funksion e normës kushtetuese. Po ashtu vlen të theksohet se Aktgjykimi KI10/18, është Aktgjykimi i parë i Gjykatës në kuadër të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ.

20. Në këtë Aktgjykim, të drejtën në kompensim të parashtruesit të kërkesës, shumica e ka anashkaluar dhe ka dështuar që të marrë parasysh dhe ta trajtojë në kuadër të normës kushtetuese. Kushtetuta ia njeh të drejtën personit të ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 29, të gëzojë të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

21. Gjithashtu, shumica në këtë Aktgjykim ka dështuar që ta sjellë në vëmendjen e autoriteteve kompetente obligimin pozitiv që të nxjerrin ligj,[8] me të cilin do të kompensoheshin individët e ndaluar ose të arrestuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 29 të Kushtetutës .

22. Është e pakuptueshme, mëdyshja e shumicës ndaj vendimit të cilin e ka nxjerrë vetë; në vendimin e shumicës theksohet: '[...] *Andaj, është e kuptueshme që ky* aktgjykim *nuk mund të prodhojë asnjë efekt në lidhje me statusin e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, Gjykata vlerëson se është shumë e rëndësishme që përmes këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese do të vendoset një standard i ri në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës dhe, rrjedhimisht gjykatat e rregullta, në të ardhmen do të duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe standardet e elaboruara në këtë Aktgjykim, të cilat janë interpretuar në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së."* [9] Cili standard i ri për praktikën gjyqësore është vendos me këtë aktgjykim?

Shumica nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e arsyeve, për vazhdimin e masës së paraburgimit në bazë të praktikës së GJEDNJ-së

---

[7] Aktvendim për Papranueshmëri rasti KI108/18, parashtrues Blerta Morina, i 1 tetorit 2019, paragrafi 4.
[8] Kuvendi i Republikës së Kosovës si organ legjislativ është i obliguar në bazë të Kushtetutës që të nxjerrë ligj të posaçëm në zbatim të paragrafit 5 , neni 29 i Kushtetutës.
[9] Aktgjykimi , paragrafi 117.

23. Shumica konstaton se, *"[...] Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017 me të cilin u refuzua kërkesa e* parashtruesit *për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR. nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017 nuk është në pajtueshmëri me nenin 29, paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së."*[10]

24. Shumica konsideron, se vendimet e tri gjykatave të rregullta nuk janë në pajtueshmëri me nenin 29, paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së duke arsyetuar se " [...] *Gjykata gjithashtu vë në pah se argumenti i dhënë në vendimet e tri gjykatave të rregullta "sidomos faktin se ende janë të acaruara marrëdhëniet në mes të familjes së* pandehurit *Fahri Deçani dhe familjes së të ndjerit [B.K.], lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale", nuk mund të jetë pafundësisht bazë për vazhdimin e paraburgimit".*[11]

25. A do të thotë kjo se vetëm këto tri vendime (24 nëntor 2017 -22 dhjetor 2017) [12] të gjykatave të rregullta, nuk janë të arsyetuara sipas nenit 29 paragrafin 1, pikën (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së !

26. Parashtruesi ka kërkuar, që Gjykata të vlerësojë se a janë në pajtim me Kushtetutën vendimet e gjykatave të rregullta me të cilat i është caktuar dhe vazhduar masa a paraburgimit për 7 vite. Parashtruesi i kërkesës këtë pretendim e ka ngritur në kuadër të së drejtës, **që rasti të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër, dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm të urdhërohet lirimi i personit**. Kjo kërkesë e parashtruesit bie në kuadër të nenit 29, paragrafin 4 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 paragrafin 4 të KEDNJ-së. Trajtimi i kërkesës në kuptim të paragrafit 4 të nenit 29 të Kushtetutës, do ta sillte në binarë vendimin e shumicës, në një *corpus habeas,* në kuadër të kritereve të nenit 5 të KEDNJ-së.

27. Megjithatë, t'i kthehemi linjës së arsyetimit të vendimit të shumicës. Shumica në vendim asnjëherë nuk ka trajtuar çështjen, se a janë të bazuara dhe të dëshmuara faktet dhe arsyetimi ligjor i tri gjykatave të

---

[10] Aktgjykimi , paragrafi 115.
[11] Aktgjykimi, paragrafi 101.
[12] Aktgjykimet të cilët janë shpallë se nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën: Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017 me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN1. nr. 2156/2017, të 6 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR. nr. 155/15, të 24 nëntorit 2017.

rregullta[13], dhe nëse ato janë të bazuara dhe dëshmuara, cilat janë obligimet e autoriteteve përgjegjëse kur është në pyetje siguria fizike, dhe e drejta në jetë e një personi të arrestuar, i cili gjendet në paraburgim në pritje të gjykimit.

28. Nëse faktet dhe arsyetimi ligjor i tri gjykatave të rregullta janë të bazuara, atëherë a ka bazë të mjaftueshme që vendimet e tri gjykatave të rregullta të shpallen të papajtueshme me Kushtetutën vetëm për shkak të formulimeve "*stereotipe*"? [14]

29. Me qëllim t'i sqarohet parashtruesit të kërkesës, se cilat janë arsyet themelore për vazhdimin e paraburgimit në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, të aplikueshme edhe në rastin konkret, si dhe me qëllim që të vendoset një standard i trajtimit të së drejtës në liri dhe siguri në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës, në këtë Aktgjykim, shumica është dashur që vet t'i shqyrtojë dhe t'i shpjegojë katër arsyet themelore të cilat shërbejnë si parime bazë për vazhdimin e paraburgimit të personave në pritje të gjykimit.

30. Vlen të theksohet se shumica në mënyrë të duhur i ka identifikuar arsyet themelore për vazhdimin e paraburgimit, megjithatë, edhe pse në Aktgjykim i përsërit dy herë arsyet e vazhdimit të paraburgimit sipas praktikës së GJEDNJ-së, ato arsye nuk i shqyrton fare.[15]

31. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, arsyet themelore për vazhdimin e paraburgimit të personave në pritje të gjykimit janë:*[...] 1) rrezikun e arratisjes; 2) ndërhyrje në gjykatë; 3) parandalimi i krimit; 4) nevoja për të ruajtur rendin publik (shih rastet e lartcekura të GJEDNJ-së, rastin Tiron kundër Rumanisë, paragrafi 37; rastin Smirnova kundër Rusisë, paragrafi 59; dhe rastin Piruzyan kundër Armenisë, paragrafi 94".*[16]

32. Katër arsyet themelore për vazhdimin e paraburgimit, të personave në pritje të gjykimit kërkohet që të plotësohen në mënyrë kumulative, në secilin rast ku shqyrtohet masa e caktimit dhe e vazhdimit të paraburgimit.

Përfundimi:

Me respekt shpreh mospajtimin tim ndaj vendimit të shumicës:

---

[13] Aktgjykimi, paragrafi 101.
[14] Aktgjykimi, paragrafi 103.
[15] Aktgjykimi, paragrafët 77 dhe 94.
[16] Për me tepër shih. Udhëzuesi rreth Nenit 5 të Konventës , E Drejta për Lirinë dhe Sigurinë Personale , Këshilli i Evropës / GJEDNJ, 2014 , fq.27-29.

1. Sepse, Gjykata e ka lëshuar rastin që Aktgjykimi KI10/18, të prodhojë efekt pozitiv në përmirësimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, në kuptim të mbrojtjes së të drejtave individuale dhe parandalimit të arbitraritetit gjatë zbatimit të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së;

2. Vendimi i shumicës, është i paqartë rreth përkufizimit se cilën periudhë të qëndrimit në paraburgim të parashtruesit të kërkesës e shpallë në kundërshtim me Kushtetutën;[17]

3. Vendimi i shumicës, ka dështuar që ta vë në lëvizje paragrafin 5 të nenit 29 të Kushtetutës. Neni 29 është e vetmja normë kushtetuese, e mishëruar në Kushtetutën me dispozitat e këtij neni. e Republikës së Kosovës në të cilin në mënyrë shprehimore parashihet e drejta e kompensimit në rast se dikush është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim

4. Shumica në rastin konkret, nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e parimeve themelore për vazhdimin e masës së paraburgimit në bazë të praktikës së GJEDNJ-së.

Dorëzoi me respekt,

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Gjyqtare

[17] Parashtruesi i kërkesës i ka kaluar 7 vite në paraburgim; shprehur në ditë 2555, ndërsa nëse shprehemi në muaj, 84 muaj.

KI32/18 Parashtrues i kërkesës: SH.A. „Kosvik“, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I.-17-0469, të 26 tetorit 2017

KI32/18, Aktvendim për papranueshmëri i 11 dhjetorit 2018, publikuar më 28 janar 2018

Fjalët kyçe: person juridik, kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, qartazi e pabazuar

Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.
Parashtruesi i kërkesës është një kompani, e cila u themelua në prill të vitit 1992 si një ndërmarrje shoqërore.
Pas themelimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), AKP filloi procedurën e likuidimit të parashtruesit të kërkesës.
Parashtruesi i kërkesës parashtroi padi pranë Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar), duke kërkuar konfirmimin e statusit të saj si një kompani private, e cila nuk është nën administrimin e AKP-së, anulimin e vendimit për likuidim, si dhe vendosjen e masës së përkohshme.
Kolegji i Specializuar e hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke konsideruar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte përmbushur kushtet për kalim nga një ndërmarrje në pronësi shoqërore në një ndërmarrje private.
Kolegji i Apelit vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.
Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i vlerësuan gabimisht faktet dhe interpretuan gabimisht ligjin, gjë që shkaktoi shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar me prova se vendimet e kontestuara shkelin të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se vendimet e gjykatave të rregullta kanë shkaktuar në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.
Prandaj, Gjykata konsideron, se në baza kushtetuese, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI32/18

Parashtrues

SH.A. „Kosvik“

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I.-17-0469 të 26 tetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania SH. A. „Kosvik“ nga Zubin Potoku, (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqëson Habib Hashani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin AC-I.-17-0469 të 26 tetorit 2017 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit). Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 8 nëntor 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 mars 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 9 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 19 mars 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, me mandat 9 (nëntë) vjeçar.

11. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, në vend të gjyqtarit Ivan Čukalović.

12. Më 22 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendim për zëvendësimin e gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues, si kryesues të Kolegjit shqyrtues, dhe në vend të tij për kryesuese të Kolegjit shqyrtues caktoi Arta Rama-Hajrizin.

13. Më 22 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës mori vendim për caktimin e gjyqtarit Radomir Laban për anëtar të ri të Kolegjit shqyrtues.

14. Më 11 dhjetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Parashtruesi i kërkesës është një kompani e themeluar në vitin 1992, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pronësi shoqërore "Kosvik", me seli në Zubin Potok.

16. Në vitin 1993, statusi i parashtruesit të kërkesës u ndryshua në shoqëri aksionare, e cila u regjistrua në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (Fi 11338/93, 30.12.1993).

17. Më 21 maj 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) miratoi Ligjin nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për AKP-në). Neni 1 i Ligjit për AKP-në thotë se "Agjencia themelohet si një organ i pavarur publik ..." dhe "...themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

18. Më 14 shkurt 2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë AKP) filloi procesin e likuidimit të parashtruesit të kërkesës.

19. Më 18 maj 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar), duke kërkuar konfirmimin e statusit të tij si kompani private, e cila nuk është nën administrimin e

AKP-së, anulimin e vendimit për likuidim, si dhe vendosjen e masës së përkohshme.

20. Më 11 korrik 2017, Kolegji i Specializuar [Aktvendimi C-I-17-0012] aprovoi kërkesën për futjen e masës së përkohshme dhe ndërpreu procesin e mëtejshëm të likuidimit të parashtruesit të kërkesës në AKP.

21. Më 3 gusht 2017, AKP-ja parashtroi ankesë ndaj aktvendimit të Kolegjit të Specializuar në nën-Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Nën-kolegji i Specializuar), duke përmendur shkeljen e dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

22. Më 18 gusht 2017, nën-Kolegji i Specializuar duke vendosur për meritat e padisë [Aktgjykimi C-I-17-0012] e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke konkluduar që *„vlerësimi i aksioneve të NSH-së (ndërmarrjes shoqërore) janë elemente të rëndësishme të privatizimit, asnjëra prej tyre nuk janë dëshmuar si objektivisht të sakta, andaj gjykata konkludon se paditësi nuk ka dëshmuar se transformimi nga NSH-ja në shoqëri aksionare (shoqëri aksionare private) është bërë në pajtim me dispozitat ligjore.* [...] *pasi që statusi i ndërmarrjes N.SH, është e pakontestueshme se transformimi i ndërmarrjes nga N.SH në Sh.A. përmes regjistrimit, në pajtim me nenin 5 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk e ndalon të paditurën që ta merr kontrollin mbi ndërmarrjen, kërkesa e parashtruesit të kërkesës që të anulohet vendimi i fundit dhe të vërtetohet statusi i ndërmarrjes në N.SH. është e pabazuar.“*

23. Më 11 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit ndaj aktgjykimit të nën-Kolegjit të Specializuar.

24. Më 26 tetor 2017, Kolegji i Apelit [Aktgjykimi AC-I-17-0469] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, e shfuqizoi masën e përkohshme dhe vërtetoi aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar atij: “*i është shkelur e drejta e pronës nga neni 46 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë nga neni 31 pika 1 e Kushtetutës, të drejta këto të mbrojtura edhe me*

dispozitën e nenit 6 (e dispozitat të tjera përkatës) të Konventës, lidhur me nenin 1, Protokolli nr. 1 të kësaj Konvente."

26. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës deklaron se statusi i *kompanisë private* gjatë gjithë procesit gjyqësor është vërtetuar *me paraqitjen dhe tregimin* e një numri provash të cilat ai deklaroi se mund *të gjendeshin në organet shtetërore të Serbisë.*
"*Por Gjykata të gjitha provat e propozuara ose nuk i ka marrë në konsiderim - pa arsyetim relevant juridik, ose nuk ka tentuar që provat në fjalë, ti trajtoj në mënyrë të parashikuar me ligj."*

27. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*me aktet e Gjykatës, si me aktgjykimet e saj (atë të shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë), ashtu edhe me aktvendimin e kontestuar të saj, janë mohuar në tërësi të gjitha të drejtat e fituara pronësore e të drejtat e tjera materiale të tyre,, duke u shkelur edhe e drejta në gjykim të drejtë."*

28. Parashtruesi pret që Gjykata të anulojë të tri vendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe atë:

1. Aktgjykimin e shkallës së dytë AC-I-17-0469 të 26.10.2017.
2. Aktgjykimin e shkallës së parë, C-I-17-0012 të 18.08.2017 dhe
3. Aktvendimin AC-I-17-0690-A0001 të 28.12.2017.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

30. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 21

"[...]
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.
[...]."

Neni 113

„(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]
„(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

31. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.“

32. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe e ka dorëzuar kërkesën në afat të paparë.

33. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

34. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 (2), [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, i cili përcakton:

„(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.“

35. Gjykata vëren, para së gjithash, se parashtruesi i kërkesës shkeljen e pretenduar të nenit 31 para. 1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, i sjell në lidhje me faktin se gjykatat e rregullta nuk e pranuan dëshminë e tij që ai e kishte *paraqitur dhe treguar*.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se neni 31 paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës parasheh:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
[...].”

37. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i është referuar edhe nenit 6 të KEDNJ-së, por nga pretendimet e tij në fakt rrjedh se ai konsideron se ai nuk ka pasur proces të rregullt sepse nuk u respektuan garancitë në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, prandaj Gjykata këto pretendime të parashtruesit do t'i shqyrtojë së bashku (shih, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) *Popov kundër Rusisë*, parashtresa nr. 26853/04, e 13 korrikut 2006, paragrafi 175).

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 6.1 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së thekson:

> *1." Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.*
> *[...]."*

39. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës me të cilat tregon se e drejta për gjykim të drejtë i është shkelur për shkak të refuzimit të propozimit të tij për prova, Gjykata thekson se neni 6 i KEDNJ-së nuk garanton të drejtën se të gjitha provat që i janë propozuar kolegjit duhet të pranohen. Gjithashtu, e drejta për një gjykim të drejtë nuk kërkon që të ndiqet ndonjë rregull i posaçëm në vlerësimin e provave në gjykata (shih, *inter alia*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, i 6 dhjetorit 1988. Seria A, nr. 146, pika 68).

40. Gjykata gjithashtu rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së kërkon nga gjykata vetëm të tregojë arsyet pse ka vendosur të mos administrojë dëshmitë e propozuara të kërkuara në mënyrë eksplicite nga parashtruesi i kërkesës (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Vidal kundër Belgjikës*, i 22 prillit 1992, Seria A, nr. 235, para 34).

41. Duke i sjellë paragrafët e lartcekur në lidhje me faktet e rastit konkret, Gjykata vëren se nën-Kolegji i Specializuar për shqyrtimin e provave të tij të propozuara, në mënyrë të qartë dhe të argumentuar deklaroi se: *"Paditësi nuk ka paraqitur dëshmi konkrete në bazë të të cilave mund të vërtetohet se aksionarëve të rinj u është paguar pjesa e tyre. Dokumentet e dorëzuara nga paditësi që tregojnë se sa duhet të paguhet nuk paraqesin prova relevante se asetet e NSH-se ne fakt janë paguar. Fletëpagesa nuk është dorëzuar. Pagesa është*

kontestuar (përgjigja ndaj ankesës, 19 qershor 2017, fq. 174 [shq] / 211 [ang]) dhe në këtë rast barra e provës për të vërtetuar këto fakte dhe paraqitja e provave bie mbi paditësin. Çështja nëse aksionarët e cekur janë kualifikuar apo jo si dëshmitarë për pagesën e pjesës së tyre mund të mbetet e hapur për shkak se nuk kanë qenë të pranishëm në seancë dhe as paditësi nuk ka kërkuar në afatin ligjor dhe në mënyrën e duhur, siç parasheh neni 36, nënpika 1.2 i Shtojcës të Ligjit të DHPGJS-së, që të thirren këta aksionarë, duke dhënë emrin dhe mbiemrin e tyre të plotë."

42. Për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit gjithashtu u mor me këtë çështje në procedurën e ankesës, me ç'rast konkludoi që: *"Provat e reja, në bazë të nenit 65 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS, në këtë fazë të procedurës nuk mund të pranohen, ngase provat e përmendura kanë mund të sigurohen gjatë procedurës në shkallë të parë dhe paditësi nuk ka arritur ta bëjë atë. Por edhe nëse Kolegji i Apelit do të pranonte prova të reja, kjo nuk do ta ndihmonte paditësin. Fletëpagesat në lidhje me pagesat e bëra në Llogarinë e Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror, të bashkangjitura në ankesë, siç konstatohej nga ankuesi në ankesë, nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se vlera e tërësishme e kapitalit shoqëror të NSH-së ishte mbuluar me pagesat e aksionarëve"*, duke dhënë një arsyetim të plotë ligjor për një qëndrim të tillë, të cilin kjo Gjykatë nuk e konstaton si të parregullt, arbitrar ose diskriminues, që do të ishte në dëm parashtruesit të kërkesës.

43. Prandaj, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre sipas nenit 31 par. 1 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, dhe prandaj pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me vendimet e kontestuara është shkelur e drejta për gjykim të drejtë janë të pabazuara në atë segment.

44. Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit të kërkesës i është mohuar ndonjë garanci procedurale, gjë që do të çonte në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht nenin 6 të KEDNJ-së.

45. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë me shkelje të lirisë së garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së. Megjithatë, parashtruesi i

kërkesës nuk e arsyeton pretendimin se e drejta kushtetuese e tij në pronë i është shkelur.

46. Gjykata rikujton se neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së dhe neni 46 i Kushtetutës nuk garantojnë të drejtën për fitimin e pronës (shih: *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003).

47. Parashtruesi i kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "*pronën*" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite "*pronë"* mund të jetë *"pasuri ekzistuese*", duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të të cilave parashtruesi mund të pretendojë "*pritshmëri legjitime*" që do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës së njëjtë.

48. Nuk mund të thuhet se lind ndonjë "*pritje legjitime*" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtresat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).

49. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi *prima facie*, dhe as nuk i ka mbështetur pretendimet se si dhe pse me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e pronës e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

50. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se vendimet e gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë kanë shkaktuar shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.

51. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 dhjetor 2018, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin
20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI96/18,KI97/18,KI98/18, KI99/18,KI100/18,KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, Parashtrues: Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së 16 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 26 marsit dhe 12 prillit 2018

KI96/18, KI97/18,KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18 Aktvendim i publikuar më 27.02.2019

Fjalët kyç: Kërkesë individuale, kërkesës qartazi e pabazuar

Parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, kundër Qeverisë së Republikës së Serbisë, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial që iu shkaktua atyre gjatë luftës.

Gjykatat e rregullta u shpallën jokompetente për të vendosur në këtë çështje dhe, në fund, Gjykata Supreme duke iu referuar dispozitave përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kishte arsyetuar se për këto raste vlejnë normat e së drejtës ndërkombëtare, për të cilat konteste gjykatat e vendit nuk janë kompetente për të vendosur, por kompetente në këtë çështje juridike është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë.

Parashtruesit e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese pretenduan se u janë shkelur të drejtat e tyre të parapara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 21, 22, 53 dhe 54. Parashtruesit e kërkesës kishin tri kategori të pretendimeve kryesore: (i) zbatimin e parimit "*per loci*" [*ratione loci*] (ii) detyrimin për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe (iii) të drejtën e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për qasje në drejtësi.

Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës arsyetoi se përfundimet e gjykatave të rregullta janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve dhe interpretimeve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës dhe atyre iu është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesin argumentet dhe interpretimet ligjore të cilat i konsiderojnë të rëndësishme për rastet e tyre. Gjykata Kushtetuese, gjithashtu rikujtoi dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në disa raste ku janë potencuar barrierat procedurale që imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve, në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër.

Gjykata, po ashtu, e konsideroi të rëndësishme të theksojë faktin se gjykatat e rregullta të Kosovës nuk kanë gjykuar mbi të drejtën e parashtruesve të kërkesës për të kërkuar kompensimin e dëmit, por vetëm lidhur me kompetencën territoriale të gjykatave të Kosovës për të zhvilluar procedurë kundër një shtetit tjetër.

Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme, ndërsa në njërën kërkesë (KI125/18) konstatoi se ajo është dorëzuar jashtë afatit ligjor.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI96/18, KI97/18,KI98/18, KI99/18,KI100/18,KI101/18, KI102/18,KI103/18, KI104/18, KI105/18,KI106/18, KI107/18, KI116/18,KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18

Parashtrues

Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së 16 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 26 marsit dhe 12 prillit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KI96/18 është dorëzuar nga Fehmi Hoti; Kërkesa KI97/18 është dorëzuar nga Kada Gjinovci; Kërkesa KI98/18 është dorëzuar nga Avdie Mehmeti; Kërkesa KI99/18 është dorëzuar nga Hamze Fekaj; Kërkesa KI100/18 është dorëzuar nga Brahim Hasani; Kërkesa KI101/18 është dorëzuar nga Ramadan Azemi; Kërkesa KI102/18 është dorëzuar nga Hamdi Sejdiu; Kërkesa KI103/18 është dorëzuar nga Xhevat Hoti; Kërkesa KI104/18 është dorëzuar nga Enver Osaj; Kërkesa KI105/18 është dorëzuar nga Bahtir Meziu; Kërkesa KI106/18 është dorëzuar nga Mursel Shala; Kërkesa KI107/18 është dorëzuar nga Haki Rushiti; Kërkesa KI116/18 është dorëzuar nga Hafiz Gjinovci; Kërkesa KI117/18 është dorëzuar nga Fazli Ramadani; Kërkesa KI119/18 është dorëzuar

nga Xhafer Hetemi dhe kërkesa KI125/18 është dorëzuar nga Nuhi Dibrani.

2. Të gjithë të lartcekurit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës) janë me banim në Komunën e Skenderajt.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë 16 vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), si në vijim:

9. Fehmi Hoti - Aktvendimi Rev nr. 91/2018, i 5 prillit 2018;

10. Kada Gjinovci- Aktvendimi Rev nr. 82/2018, i 12 prillit 2018;

11. Avdie Mehmeti- Aktvendimi Rev nr. 87/2018, i 3 prillit 2018;

12. Hamze Fekaj- Aktvendimi Rev nr. 70 /2018, i 26 marsit 2018 (i cili i është dorëzuar atij më 3 maj 2018);

13. Brahim Hasani - Aktvendimi Rev nr. 71/2018, i 3 prillit 2018;

14. Ramadan Azemi - Aktvendimi Rev. nr. 74/2018, i 11 prillit 2018;

15. Hamdi Sejdiu - Aktvendimi Rev nr. 88/2018, i 26 marsit 2018 (i cili i është dorëzuar atij më 17 prill 2018);

16. Xhevat Hoti- Aktvendimi Rev. nr. 67/2018, i 26 marsit 2018 (i është dorëzuar atij më 18 prill 2018);

17. Enver Osaj - Aktvendimi Rev. nr. 85/2018, i 5 prillit 2018;

18. Bahtir Meziu - Aktvendimi Rev nr. 73/2018, i 26 marsit 2018 (i është dorëzuar atij më 7 prill 2018);

19. Mursel Shala - Aktvendimi Rev. nr. 106/2018, i 12 prillit 2018;

20. Haki Rushiti - Aktvendimi Rev. nr. 89/2018, i 3 prillit 2018;

21. Hafiz Gjinovci - Aktvendimi Rev. nr. 81/2018, i 3 prillit 2018 (i cili i është dorëzuar atij më 5 maj 2018);

22. Fazli Ramadani - Aktvendimi Rev nr. 64/2018, i 3 prillit 2018 (i cili i është dorëzuar atij më 2 maj 2018);

23. Xhafer Hetemi - Aktvendimi Rev nr. 76/2018, i 12 prillit 2018 (i cili i është dorëzuar atij më 8 maj 2018);

24. Nuhi Dibrani- Aktvendimi Rev nr. 86/2018, i 26 marsit 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe neni 15 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës Fehmi Hoti parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 27 korrik 2018, parashtruesit Kada Gjinovci, Avdie Mehmeti, Hamze Fekaj, Brahim Hasani, Ramadan Azemi, Hamdi Sejdiu, Xhevat Hoti, Enver Osaj, Bahtir Mziu dhe Mursel Shala dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatë.

8. Më 30 korrik 2018, parashtruesi Haki Rushiti dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 9 gusht 2018, parashtruesi Hafiz Gjinovci dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

10. Më 13 gusht 2018, parashtruesi Fazli Ramadani dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

11. Më 14 gusht 2018, parashtruesi Xhafer Hetemi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

12. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu- Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtar).

13. Të njëjtën ditë, në pajtim me rregullin 40.1 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI97/18, KI99/18, KI100/18, KI 101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 me KI 96/18.

14. Më 17 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave dhe kërkoi që të dorëzojnë dokumente shtesë në Gjykatë.

15. Më 17 gusht 2018, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesave. Në po të njëjtën datë, Gjykata dërgoi një kërkesë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë -Dega në Skenderaj, për të paraqitur dëshmi lidhur me datën e pranimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme nga tre (3) parashtrues të kërkesës.

16. Në të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesja Avdie Mehmeti ta nënshkruajë formularin e kërkesës si dhe të bashkëngjisë dokumente shtesë. Ndërsa nga parashtruesit Hamdi Sejdiu, Enver Osaj dhe Bahtir Meziu kërkoi nënshkrimin e formularit, si dhe nga ky i fundit të bashkëngjisë dokumente shtesë.

17. Më 27 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës Nuhi Dibrani parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

18. Më 24 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës Bahtir Meziu njoftoi me shkrim Gjykatën se djali i tij S.M. është i autorizuar të sjellë dokumentet dhe të nënshkruajë formularin.

19. Më 27 shtator 2018, parashtruesja e kërkesës Avdie Mehmeti njoftoi me shkrim Gjykatën se bashkëshorti i saj A.M., është i autorizuar të sjellë dokumentet dhe të nënshkruaj formularin.

20. Në një datë të pacaktuar, dy parashtruesit tjerë nënshkruan formularin sipas kërkesës së Gjykatës.

21. Më 28 shtator 2018, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesat të cilat tregojnë datat kur tre (3) parashtrues (Hafiz Gjinovci, Fazli Ramadani dhe Xhafer Hetemi) kishin pranuar vendimet e kontestuara, siç u kërkua nga Gjykata më 18 gusht 2018.

22. Më 30 tetor 2018, në pajtim me rregullin 40.1 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI125/18 me kërkesat KI 96/18 KI97/18, KI99/18, KI100/18, KI 101/18, KI102/18, KI 103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18 dhe KI119/18.

23. Më 1 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin Nuhi Dibrani dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesës KI125/18 me 15 (pesëmbëdhjetë) kërkesat e mëparshme.

24. Më 27 dhjetor 2018, Gjykata dërgoi një kërkesë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, për të paraqitur dëshmi lidhur me datën e pranimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme nga 4 (katër) parashtrues të kërkesës (Hamze Fekaj, Hamdi Sejdiu, Bahtir Meziu dhe Xhevat Hoti).

25. Më 10 janar 2019, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesat të cilat tregojnë datat kur katër parashtrues kishin pranuar vendimet e kontestuara, siç u kërkua nga Gjykata më 27 dhjetor 2018.

26. Me 10 janar 2019, J.B., në cilësinë e drejtorit të shoqatës "Ngritja e Zërit" dorëzoi në Gjykata një shkresë e cila, edhe pse nuk i referohet shprehimisht asnjë rasti konkret në Gjykatë, përsëritë pretendimet dhe argumentet që përmban kërkesa e parashtruesve.

27. Më 30 janar 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

28. Ndërmjet 17 majit 2010 dhe 25 majit 2015, parashtruesit e kërkesës në mënyrë individuale parashtruan padi në Gjykatën Themelore në

Mitrovicë, Dega në Skenderaj (më tutje: Gjykata Themelore), kundër Qeverisë së Republikës së Serbisë, për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale që iu shkaktuan atyre gjatë luftës, ndërmjet viteve 1998 dhe 1999.

29. Përgjatë periudhës 22 korriku 2013 - 10 shkurt 2016, Gjykata Themelore, me vendime individuale, hodhi poshtë paditë e parashtruesve të kërkesës dhe u deklarua jokompetente për të vendosur.

30. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesa individuale ndaj vendimeve të Gjykatës Themelore, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Parashtruesit kërkuan që vendimet e Gjykatës Themelore të anulohen dhe kërkesat e parashtruesve të kërkesës të shpallen të pranueshme.

31. Ndërmjet 16 janarit 2016 dhe 17 janarit 2018, Gjykata e Apelit nxori vendime të ndara duke refuzuar secilën nga ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe duke vërtetuar vendimet e Gjykatës Themelore.

32. Secili nga parashtruesit e kërkesës, në mënyrë individuale, parashtroi kërkesë të veçantë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Ata kërkuan që kërkesat e tyre për revizion të aprovohen, vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore të anulohen dhe çështja juridike e tyre të referohet për rishqyrtim në Gjykata Themelore. Parashtruesit e kërkesës pretenduan se ekzistojnë dispozita të tjera të Ligjit për Procedurën Kontestimore me të cilat rregullohet çështja e kompetencës për rastet e tyre. Në këtë rast, sipas tyre, do duhej të zbatohej, ndër të tjera, dispozita e nenit 28 të Ligjit për Procedurën Kontestimore e cila ka të bëje me kompetencën e gjykatave në kontestet me element ndërkombëtar.

33. Në mes të datave 26 mars dhe 12 prill 2018, Gjykata Supreme nxori vendime të ndara (siç janë dhënë në paragrafin 3) , duke refuzuar kërkesat për revizion të secilit prej parashtruesve të kërkesës si të pabazuara. Argumentet kryesore të Gjykatës Supreme, në secilin prej këtyre vendimeve, ishin si në vijim:

> "*Duke pasur parasysh [dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore] LPK si dhe faktin se me padi është paditur Republika e Serbisë- Qeveria R.S. ne Beograd, [...] në rastin konkret fjala është për kontest juridiko-pasuror në shtetin e huaj, vlejnë normat e së drejtës ndërkombëtare, për të cilin kontest*

gjykata e vendit nuk është kompetente për të vendosur, andaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e nenit 18.3 dhe nenit 39 par. 1 e 2 të LPK-së, me rastin kur janë shpallë inkompetente për të gjykuar këtë çështje juridike dhe kanë hedhe poshtë padinë [e parashtruesve të kërkesës], ngase e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë, [dhe] selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë si palë e paditur nuk ndodhet në territorin e Gjykatave të Republikës së Kosovës.
[...]
Dispozita e nenit 28 të LPK-së, në të cilën thirren parashtruesit e kërkesës, e me të cilën caktohet kompetenca e gjykatave tona në kontestet me element ndërkombëtar (të huaj), nuk mund të zbatohet në rastin konkret, nga se këtu nuk kemi të bëjmë as me persona fizik të huaj e as me persona juridik të huaj, por me shtet të huaj, me të cilin deri ne momentin aktual shteti i Kosovës, në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka të lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare [...] për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve. [...] Nuk qëndron as pretendimi i revizionit [të parashtruesve të kërkesës] se në rastin konkret kemi të bëjmë me kompetencën territoriale të zgjedhur sipas nenit 47, 51 dhe 61 të LPK-së, nga se sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, këto dispozita nuk kanë të bëjnë me rastin konkret [...], gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë aplikuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, duke marrë parasysh edhe arsyet tjera qe u theksuan më lartë".

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

34. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet: 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 15 të DUDNJ-së.

35. Parashtruesit e kërkesës kanë tri kategori të pretendimeve kryesore: (i) zbatimin e parimit *"per loci"* [*ratione loci*], i cili, sipas parashtruesve të kërkesës, nënkupton që gjykatat e rregullta kanë kompetencë për shqyrtimin e padive në bazë të vendit ku është

shkaktuar dëmi; (ii) detyrimin për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e gjykatave të rregullta; (iii) të drejtën e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për qasje në drejtësi.

36. Parashtruesit e kërkesës fillimisht i referohen çështjes se juridiksionit territoral, (përkatësisht parimit *"per loci"*) dhe pretendojnë se gjykatat e rregullta "*kanë zbatuar gabimisht ligjin e aplikuar referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore [...], nga se, gjykata territorialisht kompetente për gjykime të çështjeve juridike, kurdoherë është gjykata në territorin e së cilës është kryer krimi, dëmtimi moral përkatësisht material! " Ky definicion e qëndrim juridik valid përkon edhe me interesin e palës së dëmtuar, parimin e ekonomisë në procedurat gjyqësore dhe administrative, si dhe në përputhje me principin ndërkombëtar –per loci, drejtimi i aktpadive në bazë të vendit ku është kryer krimi".*

37. Tutje, parashtruesit e kërkesës iu referohen disa shembujve nga praktika ndërkombëtare ku, sipas tyre, viktimat e Luftës së Dytë Botërore janë lejuar *"të dorëzojnë padi individuale në gjykatat vendore për kompensim të dëmit të shkaktuar nga Gjermania".* Në këtë drejtim, ata specifikojnë se në rastet e Greqisë, Italisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, individëve u është dhënë mundësia për të kërkuar kompensim për *"dëmet e shkaktuara nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore në pajtim me parimin ndërkombëtar 'për loci'."*

38. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 21 paragrafi 1 të Kushtetutës, pretendojnë se gjykatat e rregullta *"nuk i kanë aplikuar standardet e avancuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Njëra nga standardet është dhënia e mundësisë palës së dëmtuar për inicimin e çështjes së kompensimit të demit moral dhe material të shkaktuar si rezultat i veprimit direkt nga ana e autoriteteve serbe".*

39. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pohojnë se *"Obligimi për Aplikimin e Konventave të Gjenevës [...] është paraparë edhe me Ligjin Ndërkombëtar Humanitar të Kosovës".* Sipas parashtruesve, gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat kushtetuese sepse nuk kanë aplikuar dispozitat e konventave ndërkombëtare, si kategori të rendit juridik të brendshëm.

40. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 54 të Kushtetutës, gjithashtu deklarojnë se *"u është mohuar e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, e drejta për qasje në drejtësi në nivel*

kombëtar si dhe garancitë institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut".

41. Parashtruesi i kërkesës Nuhi Dibrani (KI125/18) ka bashkangjitur dhe një shkresë, me të cilën kërkon kthim në gjendjen e mëparshme, për sa i përket afatit për të parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Ai arsyeton se për shkak të mos-informimit i ka kaluar afati për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë. Ai thekson se *"[...] nuk ka qenë i informuar për mundësinë e të drejtuarit Gjykatës Kushtetuese [...] për 14 ditë ka kaluar afati ligjor."*

42. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që anulojë vendimet e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj.

Dispozitat përkatëse ligjore

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 18

[...]
18.3 Kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet inkompetente, do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë. Mirëpo, gjykata nuk do të veprojë ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të padituri, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet.
[...]

Neni 28

28.1 Në pikëpamje të kompetencës së gjykatave tona për zgjidhjen e kontesteve të shtetasve të huaj, që gëzojnë të drejtën e imunitetit dhe për zgjidhjen e kontesteve të shteteve të huaja dhe të organizatave ndërkombëtare, vlejnë rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

28.2 Gjykata e vendit është kompetente për zgjidhjen e kontestit kur kompetenca e saj në kontestin me element ndërkombëtar është caktuar shprehimisht me anë të ligjit apo me anë të kontratës ndërkombëtare.

28.3 Në qoftë se në ligjin tonë, apo në kontratën ndërkombëtare nuk ka dispozita decidive për kompetencën e gjykatës së vendit për llojin

e caktuar te kontesteve, gjykata e vendit është kompetente të gjykojë në llojin e tillë të kontesteve edhe kur kompetenca e saj rezulton nga dispozitat e këtij ligji mbi kompetencën territoriale te gjykatës së vendit.

Neni 39

39.1 Për gjykimin në kontestet kundër Kosovës, njësisë së vetëqeverisjes lokale, si dhe formave tjera të organizimit territorial, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e kuvendit të saj.

39.2 Për gjykimin në kontestet kundër personave juridik të tjerë e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar.

Neni 47

47.1 Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit.

Neni 51

Për gjykimin e çështjes në kontestet kundër personit juridik, njësia e të cilit ndodhet jashtë selisë së tij, në qoftë se kontesti rezulton nga marrëdhënia juridike e kësaj njësie të personit juridik, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet ajo njësi e personit juridik.

Neni 61

Për kontestet kundër personit fizik apo juridik që e ka vendbanimin respektivisht selinë jashtë vendit tonë, në pikëpamje të detyrimeve që janë krijuar në Kosovë, apo që duhet të përmbushën në Kosovë, padia mund t'i paraqitet gjykatës në territorin e së cilës ndodhët përfaqësia e përhershme e tij për Kosovën, apo qendra e organit të cilit i është besuar kryerja e punëve të tija.

Pranueshmëria e kërkesave

43. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës i cili përcakton se:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

45. Në vazhdim, Gjykata i referohet edhe kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."

46. Më tutje, Gjykata i referohet edhe Rregullores së punës, konkretisht paragrafëve 1 (c) dhe (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], të cilët përcaktojnë si në vijim:

"(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit,

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

Sa i përket 15 parashtruesve të kërkesës

47. Gjykata konstaton se 15 parashtruesit e kërkesës (duke mos përfshirë Nuhi Dibranin, rasti i të cilit do të trajtohet veçmas), janë palë të autorizuara, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë sqaruar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe 39.1 (c) të Rregullores së punës.

48. Më tutje, Gjykata shqyrton se a plotëson kërkesa e parashtruesve kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta u kanë shkelur disa të drejta të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ, duke vënë theksin posaçërisht në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe në të drejtën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.

49. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta e kanë interpretuar gabimisht ligjin në fuqi kur i janë referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore. Ata, më tej, pretendojnë se gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi është gjykatë kompetente për gjykim në çështjet e tyre. Si rrjedhojë, sipas parashtruesve, atyre u është mohuar *"e drejta në mbrojtje gjyqësore dhe qasje në drejtësi.*

50. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin nga gjykatat e rregullta të dispozitave përkatëse ligjore që rregullojnë kompetencën e tyre territoriale, gjegjësisht kompetencën për t'u marrë me paditë e parashtruesve.

51. Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse

ligjore, parimisht, hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" (Shih *mutatis mutandis,* Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, paragrafi 65, shih po ashtu *mutatis mutandis,* rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 prillit 2012 paragrafi 33).

52. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesve lidhur me interpretimin e bërë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore, të dispozitave përkatëse ligjore lidhur me kompetencën për gjykim në rastet e parashtruesve.

53. Gjykata Supreme, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, arsyetoi se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, kur kanë konstatuar se nuk kanë pasur juridiksion për të gjykuar në këto raste gjyqësore. Prandaj, Gjykata Supreme hodhi poshtë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, duke arsyetuar se juridiksioni i përgjithshëm territorial është në gjykatën në territorin e së cilës është selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë e cila nuk është në territorin e gjykatave të Kosovës.

54. Kështu, në disa prej vendimeve të saj (shih, për shembull, Aktvendimin në rastin Rev nr. 91/2018), Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se:

> *"[...] në bazë të dispozitës së nenit 28.2 të LPK, kur është fjala për kontestet me element të huaj, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kjo kompetencë ndërkombëtare rrjedhë shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet ligji [...] Me nenin 39.1 të LPK, është paraparë se "për gjykimin në kontestet kundër Kosovës [...] e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e kuvendit të saj. Kurse në paragrafin 2 është paraparë se 'për gjykimin në konteste kundër personave juridik të tjerë e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar.' Kështu edhe me dispozitën e nenit 54.1 të Ligjit mbi Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjit me dispozitat e shteteve tjera parashihet se në kontestet juridiko-pasurore kompetenca e gjykatës së vendit ekziston në qoftë se në vendin tonë ndodhet pasuria e të paditurit apo sendi që kërkohet me padi."*

55. Gjykata Supreme, më tej, ka specifikuar se në rastin e parashtruesve të kërkesës *"kemi të bëjmë me shtet të huaj, me të cilin deri ne momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve"*.

56. Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve dhe interpretimeve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesve iu është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesin argumentet dhe interpretimet ligjore të cilat i konsiderojnë të rëndësishme për rastet e tyre.

57. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe se nuk mund të argumentohet pretendimi për interpretime arbitrar ligjore nga ana e gjykatave të rregullta.

58. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me *"të drejtën e tyre në mbrojtje gjyqësore dhe qasje në drejtësi"*, Gjykata vë në pah praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në të cilën është e detyruar të referohet sipas nenit 53 të Kushtetutës. Gjykata vëren se GJEDNJ në disa raste ka potencuar barrierat procedurale që imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve – si një nga parimet themeltare të së drejtës ndërkombëtare publike – në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër (Shih, *mutatis mutandis*, rastet: *Jones dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 14 janarit 2014; *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i 21 nëntorit 2001*).

59. Për më tepër, në rastin *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ ka argumentuar si në vijim: "*E drejta e qasjes në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve, nëse nuk preket thelbi i së drejtës. Kufizime të tillë duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale [...] Njohja e imunitetit sovran të shteteve në procedura civile ndjekë qëllimin legjitim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare [...]. Për sa i përket proporcionalitetit, për sa është e mundur, Konventa duhet të interpretohet në harmoni me rregullat tjera të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me imunitetin e shteteve. Kështu, masat e ndërmarra nga shteti të cilat pasqyrojnë rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin e shteteve, në parim, nuk mund të*

shikohen si kufizim jo-proporcional i të drejtës për qasje në gjykatë." Një qëndrim të tillë, për sa i përket tensionit në mes të parimit të imuniteti sovran të shteteve dhe të drejtës për qasjes në drejtësi (gjykatë), e ka theksuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (shih, për shembull, rastin: *Gjermania kundër Italisë; Greqia si palë intervenuese*, Aktgjykimi i 3 shkurtit 2012).

60. Në dritën e argumenteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksoj faktin se gjykatat e rregullta të Kosovës nuk kanë trajtuar, përkatësisht nuk kanë gjykuar mbi të drejtën e parashtruesve të kërkesës për të kërkuar kompensimin e dëmit, por vetëm lidhur me kompetencën territoriale të gjykatave të Kosovës për të zhvilluar procedurë kundër një shtetit tjetër.

61. Ndërsa duke iu referuar dhe pretendimeve të parashtruesve rreth aplikimit të Konventës së Gjenevës në rastet e tyre gjyqësore, Gjykata vëren se parashtruesit vetëm i janë referuar kësaj Konvente por nuk kanë ofruar argumente të mëtutjeshme në lidhje me këtë pretendim.

62. Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese(Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).

63. Gjykata gjithashtu verën se faktet e paraqitura dhe pretendimet e parashtruesve janë pothuajse identike me disa kërkesa të mëhershme, për të cilat Gjykata pati vendosur se janë të papranueshme, si qartazi të pabazuar mbi baza kushtetuese (Shih *mutatis mutandis* rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI73/17 KI78/17 dhe KI85/17, *Istref Rexhepi dhe 28 te tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 tetorit 2017 dhe rastet KI KI97/17, KI99/17, K115/17 dhe KI121/17 *Mala Mala, Ali Salihu, Nurije Beka dhe Xhevat Xhinovci,* Aktvendim për papranueshmëri i 10 janarit 2018).

64. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesat e parashtruesve nuk dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të

Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 tw KEDNJ-së ose nenin 15 të DUDNJ-së.

Sa i përket parashtruesit të kërkesës Nuhi Dibrani

65. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës Nuhi Dibrani (KI125/18) është palë e autorizuar dhe ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

66. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatë Supreme, Rev. nr. 86/2018, të 26 marsit 2018, ndërsa ai ka parashtruar kërkesën KI125/18 në Gjykatë, me 27 gusht 2018.

67. Lidhur me vonesën e parashtrimit të kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi kërkon kthim në gjendjen e mëparshme me arsyetimin se për shkak të mos-informimit i ka kaluar afati për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, mirëpo për këtë kërkesë nuk ka ofruar argumente apo dokumente mbështetëse.

68. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur kërkesën e tij për kthimin e afatit në gjendjen e mëparshme, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe, për rrjedhojë, kërkesa e tij duhet të refuzohet.

69. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005 dhe po ashtu, shih rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi,* Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

70. Bazuar në sa më sipër, rezulton se kërkesa (KI125/18) e parashtruesit Nuhi Dibrani është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës dhe si e tillë është e papranueshme.

71. Si përfundim, Gjykata arrin në konstatimin se

i) përkitazi me të gjithë 15 parashtruesit e kërkesës, kërkesat e tyre (KI96/18,KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18,

KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18) janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës;

ii) përkitazi me parashtruesin e kërkesës Nuhi Dibrani (KI125/18), kërkesa e tij është dorëzuar jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48, 49 dhe 50 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) dhe (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 janar 2019, njëzëri

VENDOS

I. T'I DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI06/18, Parashtrues: Shkumbin Mehmeti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 94/2017, të 13 nëntorit 2017

KI06/18 Aktvendim për papranueshmëri, miratuar më 16 janar 2019, publikuar më 27 shkurt 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë, të drejtat e të akuzuarit, ratione materiae, kërkesë e papranueshme.*

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ia kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Gjykata pasi vlerësoi rastin në tërësi, erdhi në përfundim se edhe në rastet kur kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk është e suksesshme, neni 31 i Kushtetutës në dritën e interpretimit të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk është i zbatueshëm. Prandaj, Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe siç parashihen me Ligj dhe me Rregullore të punës. Rrjedhimisht, Gjykata në këtë rast konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, andaj si e tillë, kërkesa u deklarua e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI06/18

Parashtrues

Shkumbin Mehmeti

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Pzd. nr. 94/2017] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 13 nëntorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shkumbin Mehmeti, nga Podujeva (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Besian Syla.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Pzd. nr. 94/2017] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 13 nëntorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për

Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 janar 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 16 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 18 janar 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 6 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës e informon Gjykatën për zëvendësimin e avokatit S. M., dhe në vend të tij autorizoi avokatin Besian Syla, nga komuna e Podujevës.

12. Më 31 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Nexhmi Rexhepi.

13. Më 16 janar 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës për herë të dytë parashtron kërkesë në Gjykatë.

Faktet në lidhje me kërkesën e parë KI145/11

15. Më 10 nëntor 2011, parashtruesi paraqiti në Gjykatën Kushtetuese kërkesën KI145/11, me të cilën kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së: 1) Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, P. nr. 2003/2006, të 9 nëntorit 2007; 2) Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AP. nr. 190/2009, të 27 janarit 2010; 3) Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, API. nr. 1/2010, të 26 nëntorit 2010, dhe 4) Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL-36/n, të 10 gushtit 2011. Me këto aktgjykime, parashtruesi i kërkesës u dënua për një numër të veprave penale dhe iu shqiptua dënimi unik për të gjitha aktakuzat me 30 (tridhjetë) vjet burgim.

16. Ndër të tjera, parashtruesi në kërkesën KI145/11, pretendonte se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të dispozitave esenciale të procedurave penale, ankohej se gjykimi ka qenë i padrejtë dhe i anshëm, ankohej se i është shkelur e drejta për mjete efektive juridike. Më 12 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese me Aktvendimin për papranueshmëri e refuzoi si qartazi të pabazuar kërkesën KI145/11.

Faktet në lidhje me kërkesën e tanishme KI06/18

17. Në një datë të pacaktuar, prokurori i EULEX-it paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me propozim që gjykata kundër parashtruesit të kërkesës *"të*

caktojë një dënim prej jo më shumë se 20 (njëzet) vite burgim konform nenit 71, par. 2 të KPPK-së si ligj më i favorshëm për të pandehurin", me pretendimin se gjykatat e rregullta me interpretimin e dispozitave ligjore: *"... kanë bërë shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 33.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila dispozitë parashikon që shkalla e dënimit nuk mund të jetë joproporcionale me veprën penale"*.

18. Në të njëjtën kohë, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar dhe parashtruesit t'i shqiptohet një dënim më i butë, duke arsyetuar se: *"... se i dënuari ndodhet në vuajtje të dënimit qe 13 vite e 30 ditë, dhe gjatë kësaj periudhe është rehabilituar në tërësi dhe si rezultat i këtij rehabilitimi i dënuari, ka filluar të bashkëpunojë me Prokurorinë e EULEX-it, për çka ai ka pranuar se ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale së bashku me disa persona tjerë, si dhe ka dhënë emrat e shtatë pjesëmarrësve që kanë marrë pjesë në kryerjen e këtyre veprave penale, me ç'rast ka përshkruar në mënyrë detale llojin e armatimit që e kanë përdorur, vendin e ngjarjes, pozicionet e secilit pjesëmarrës dhe veprimet e ndërmarra në mënyrë individuale të secilit prej tyre.(...)"*

19. Më 8 shtator 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë me propozimin Kp. nr. 921/2017, i propozoi Gjykatës Supreme të Kosovës që ta refuzojë kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit si të pabazuar.

20. Më 21 shtator 2017, Prokuroria e Shtetit, me shkresën nr. 120/2017 propozoi që kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar.

21. Më 13 nëntor 2017, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pzd. nr. 94/2017, refuzoi, si të pabazuara, kërkesat të prokurorit të EULEX-it, si dhe të mbrojtësit të parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, "*të shqiptuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 203/2005 të datës 9.11.2007 i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. Kz. nr. 190/2009 të datës 27.01.2010 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Api. Kzi. nr. 1/2010 të datës 26.11.2010"*.

22. Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pzd. nr. 94/2017, arsyetoi: *"Me dispozitën e nenit 429 të KPPK-së, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar në formë të prerë lejohet kur paraqiten*

rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë."(...)

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se "*Aktvendimi Pzd. nr. 94/2017 të datës 13.11.2017 është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për shkak se nuk është garantuar gjykimi i drejtë dhe i paanshëm*".

24. Parashtruesi i kërkesës konsideron se në kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit arriti të paraqes prova të reja, në veçanti ato të siguruara nga Prokuroria e EULEX-it me shenjën PPS. nr. 10-2013 dhe PPRKR. nr. 30/2013.

25. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur një numër i dispozitave ligjore dhe janë paraqitur dëshmi të reja për rolin e parashtruesit në kryerjen e veprës penale dhe armën që ka pasur parashtruesi, që nuk ishin të njohura për gjykatën e shkallës së parë dhe të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit, do të ndikonin në shqiptimin e dënimit më të ulët.

26. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"pa zbatimin e dispozitave të Kushtetutës e në mënyrë të veçantë nenit 31 dhe 33 nuk mund të realizohet gjykimi i drejtë dhe sundimi i ligjit të cilat kontribuojnë në sigurinë se asnjë personi nuk do t'i shkelen të drejtat përmes gjykimeve arbitrare, procedurave jo të rregullta gjyqësore, të cilat përpiqen të shtrembërojnë paraqitjen e fakteve dhe provave të reja dhe atyre ekzistuese e që janë në përputhje të plotë me dispozitat e KPPRK-së të nenit 429, 431 paragrafi 1"*.

27. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme nuk i vlerësoi dhe arsyetoi mjaftueshëm provat e reja të paraqitura nga ai, me çka sipas pretendimit të parashtruesit është shkelur neni 31 i Kushtetutës, që rezultoi me shkelje të mëtejshme të neneve 22, 32, 33 dhe 102 të Kushtetutës si dhe neneve 6 dhe 14 të KEDNJ-së.

28. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Në rast se do të kishim një proces të drejtë gjyqësor dhe do të respektohej dispozita e nenit 22 par. 1, 2, 3, 5, neni 31 par. 1, neni 32 dhe neni 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit do të aprovohej pasi që i ka plotësuar kushtet ligjore që kërkohen me KPPRK neni 429, 430 dhe 431 par. 6*

për shkak se janë paraqitur prova të reja për të cilat gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë në dijeni në kohën e gjykimit, kërkesa është paraqitur nga personat e autorizuar siç janë Prokurori dhe Mbrojtësi, Gjykatës Supreme të Kosovës i është propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin".

29. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata: *"... që të anulohet Aktvendimi Pzd. nr. 94/2017 i Gjykatës Supreme të Kosovës i cili është marrë me shkelje të dispozitave kushtetuese si dhe ndryshimin e Aktgjykimit P. nr. 203/2005 sa i përket vendimit mbi dënimin".*

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> *[...]*

32. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet së pari neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara; kanë shterur mjetet juridike në dispozicion; kanë specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e kontestojnë në Gjykatë dhe kanë dorëzuar kërkesën në kohë.

34. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores, që përcakton:

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]
(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
[...]

35. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës për herë të dytë parashtron kërkesë në Gjykatë dhe se aktgjykimet me të cilat parashtruesi është shpallur fajtor dhe është dënuar me 30 (tridhjetë) vite burgim u shqyrtuan nga Gjykata në rastin KI145/11, prandaj Gjykata nuk do të lëshohet në vlerësimin e këtyre aktgjykimeve.

36. Në fakt, në kërkesën e tanishme KI06/18, parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 94/2017, të 13 nëntorit 2017, me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 22, 31, 32, 33 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6 dhe 14 të KEDNJ-së.

37. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i bazon pretendimet e tij në vlerësimin e gabuar të provave të reja dhe në interpretimin e gabuar të normave ligjore, të cilat sipas parashtruesit janë në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt

gjyqësor) të KEDNJ-së. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se nenet e tjera 22, 32, 33 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe neni 14 i KEDNJ-së, janë shkelur në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës arsyeton se shkelja e këtyre neneve, ndërlidhët me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

38. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës vetëm në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

39. Gjykata, para se të shqyrtojë kërkesën rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

Zbatueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së

40. Fillimisht, Gjykata përsëritë se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së zbatohet gjatë gjithë procedurës në të cilën vendoset për "akuzat për vepër penale", duke përfshirë edhe procedurën e shqiptimit të dënimit (për shembull: procedurën e sekuestrimit të pronës, që i mundëson gjykatave nacionale për të vlerësuar shumën e pasurisë që do të sekuestrohet: (shih, *Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, nr. 41087/98, të 5 korrikut 2001, paragrafi 39).

41. Përveç kësaj, neni 6 i KEDNJ-së zbatohet gjithashtu në të gjitha rastet ku me mjete të jashtëzakonshme është lejuar rishikimi a përsëritja e procedurave penale, pas lejimit të të cilave kërkohet zhvillimi i proceduarve të reja. (shih GJEDNJ, rasti *Vanyan kundër Rusisë*, aplikimi nr. 53203/99, Vendimi i 15 marsit 2006, paragrafi 56, i cili iu referohet rasteve *Löffler kundër Austrisë,* aplikimi nr. 30546/96, paragrafët 18-19, Vendimi i 3 tetorit 2000 dhe *José Maria Ruiz Mateos dhe të tjerët kundër Spanjës,* aplikimi nr. 24469/94, Vendimi i komisionit i 2 dhjetorit 1994, vendimet dhe raportet 79, faqe 141).

Mos-zbatueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së

42. Gjykata përsëritë se neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet në procedurën për përafrimin e dënimit me dispozita më të favorshme të ligjit të ri penal (Shih, *Nurmagomedov kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, nr. 30138/02, të 7 qershorit 2007, paragrafi 50).

43. Gjithashtu, neni 6 i KEDNJ-së nuk është i zbatueshëm në procedurat lidhur me ekzekutimin e vendimeve për dënim, siç është procedura për zbatimin e faljes (shih, *Montcornet de Caumont kundër Francës*, Vendimi i GJEDNJ-së nr. 59290/00, i 13 majit 2003), procedura e faljes (shih, *Aldrian kundër Austrisë*, Vendimi i Komisionit nr. 16266/90, i 7 majit 1990, shih, gjithashtu *Macedo da Costa kundër Luksemburgut*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 26619/07, i 5 qershorit 2012).

44. Më tej, neni 6 i KEDNj-së nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti, sepse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij, ai/ajo gjatë kësaj procedure nuk është "akuzuar për vepër penale" brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës (shih, rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë,* ankesa nr. 27569/02, vendimi, i 6 majit 2003).

45. Për më tepër, neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet edhe në rastet kur me mjete të jashtëzakonshme refuzohet kërkesa për anulimin e vendimit, me të cilën një i akuzuar është shpallur fajtor, dhe për shkak të mospjesëmarrjes së tij në gjykim, kërkon rikthimin e afatit në gjendje të mëparshme. (shih, GJEDNJ, rasti *Zois Kokkonis kundër Greqisë* dhe *Nikolitsa Chalilopoulou kundër Greqisë*, aplikimet 76386/11 dhe 76408/11, të 23 nëntorit 2017, paragrafi 14).

46. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu rikujton se edhe në rastet kur një parashtrues kërkon dënimin e një pale të tretë, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, neni 6 të KEDNJ-së nuk është i zbatueshëm. (shih, rastin *Perez kundër Francës,* nr., Aktgjykimi (47287/99) i 12 shkurtit 2004, paragrafët 70-71; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI97/14*, parashtrues Vlibor Jevtić* , Aktvendimi për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2014, paragrafët 35-38).

Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

47. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, ushtruar në Gjykatën Supreme, në fakt ka të bëjë me pretendimin se në rastin e tij janë krijuar rrethana të reja të cilat lejojnë rihapjen e procedurave, sa i përket vendimit për dënimin, gjegjësisht ndikojnë si rrethanë lehtësuese për zbutjen e dënimit.

48. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar Gjykata Supreme, arsyetoi se: *"Me dispozitën e nenit 429*

të KPPK-së, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar në formë të prerë lejohet kur paraqiten rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë".

49. Më tej, Gjykata Supreme arsyeton *"Andaj, këto rrethana nuk mund të jenë bazë për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, sepse nuk e kanë karakterin e rrethanave nga neni 429 të KPRK-së e të cilat sipas ligjit nuk mund të kontestohen dhe lejohen me këtë mjet juridik. (...)"*

50. Siç mund të vërehet nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Supreme, kjo e fundit refuzoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, pasi erdhi në përfundim se nuk ishin përmbushur kushtet ligjore, të cilat lejojnë rihapjen e procedurave, sa i përket vendimit për dënimin.

51. Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se edhe kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, kërkon gjithashtu përmbushjen e kritereve ligjore për rihapjen e procedurave, përkatësisht të vendimeve të plotfuqishme në lidhje me dënimin.

52. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në të gjitha rastet kur nëpërmjet mjeteve të jashtëzakonshme është kërkuar rishikimi ose përsëritja e procedurave të përfunduara (civile, penale, përmbarimore) me vendime të plotfuqishme, kur gjykatat e rregullta janë marrë vetëm me kriteret e lejueshmërisë së kërkesave e jo me meritat e çështjes, Gjykata në pajtueshmëri me jurisprudencën e GJEDNJ-së ka konstatuar, se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk janë të aplikueshme. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, *Sabri Ferati,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, *Rrahim Hoxha,* Aktvendim për papranueshmëri i 27 dhjetorit 2016, dhe KI07/17, *Pashk Mirashi,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017).

53. Prandaj, edhe kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit bie në kategorinë e kërkesave që janë të papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, sepse neni 31 i Kushtetutës, shikuar në dritën e nenit 6 të KEDNJ-së nuk është i zbatueshëm për shkak se nuk janë plotësuar kushtet që lejojnë rihapjen procedurave, sa i përket vendimit për dënimin.

54. Për më tepër, mjetet juridike të jashtëzakonshme me të cilat kërkohet zbutje e jashtëzakonshme e dënimit zakonisht nuk implikojnë vërtetimin e "të drejtave dhe obligimeve civile" apo bazueshmërinë e

"çfarëdo akuze penale", dhe rrjedhimisht neni 6 nuk zbatohet për ta (shih, inter alia, *X kundër Austrisë*, numër 7761/77, Vendimi i Komisionit i 8 majit 1978, *D. R.* 14, f. 171, *Zawadzki kundër Polonisë* (vendimi) numër 34158/96 i 6 korrikut 1999, *Hurter kundër Zvicrës* (vendimi), numër 4811/07 i 15 majit 2012, *Dybeku kundër Shqipërisë* (vendimi) numër 557/12, paragrafi 30, i 11 marsit 2014).

55. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkese me Kushtetutë rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta (at) në të cilat thirret parashtruesi (t) duhet të mbrohen me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën (shih, Gjykata Kushtetuese, rastin KI07/17 me parashtrues *Pashk Mirashi,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017, paragrafi 66).

56. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe siç parashihen me Ligj dhe me Rregullore të punës.

57. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, andaj si e tillë, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (3) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 janar 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI 09/18 Parashtrues: „FINCA“ Kosovë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, CML. nr. 3/2017, të 21 shtatorit 2017

KI09/18, Aktvendim për papranueshmëri i 30 janarit 2019, publikuar më 14 mars 2019

Fjalët kyç: personat juridikë, kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, qartazi e pabazuar

Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.
Parashtruesi i kërkesës, në vitin 2010, pas procedurës disiplinore, ia ndërpreu marrëdhënien e punës punëtorit të tij M.B.
Pas kësaj, punëtori me padi inicioi procedurën administrative kundër parashtruesit, e cila ka kaluar nëpër të gjitha fazat para gjykatave të rregullta.
Në procedurën përmbarimore, punëtori i realizoi pretendimet nga kërkesëpadia.
Sipas revizionit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ktheu të njëjtin në rivendosje në pjesën e cila ka të bëjë me pretendimet financiare nga kërkesëpadia.
Në procedurën e sërishme, punëtori e tërhoqi kërkesën e tij lidhur me pretendimet pronësore nga kërkesëpadia. Pas kësaj, parashtruesi inicioi procedurën e kundërpërmbarimit me qëllim të realizimit të kërkesës së tij pronësore. Procedura sipas kërkesës për kundërpërmbarim është lejuar nga gjykata e shkallës së parë dhe të njëjtën e vërtetoi edhe Gjykata e Apelit, por Gjykata Supreme, sipas kërkesës për vlerësim të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit anuloi si vendimin e shkallës së parë, ashtu edhe atë të shkallës së dytë sipas kërkesës për kundërpërmbarim, në lidhje me realizimin e kërkesës pronësore të parashtruesit.
Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregulla i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 102 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në thelb ngre edhe pretendimin për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, por nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti, megjithatë, Gjykata konkludon se parashtruesi gjithashtu thirret edhe në shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur me prova se me vendimet e kontestuara janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se vendimet e gjykatave të rregullta kanë shkaktuar në ndonjë mënyrë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.

Prandaj, Gjykata konsideron se, kërkesa në baza kushtetuese, është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI09/18

Parashtrues

„FINCA" Kosovë

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, CML. nr. 3/2017, të 21 shtatorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga „FINCA" Kosovë, institucion mikrofinanciar me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar Auberon Kelmendi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, CML. nr. 3/2017, të 21 shtatorit 2017, me të cilin është miratuar, si e bazuar, kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 1176/2015, të 16 dhjetorit 2016 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, CP. nr. 1856/2013, të 26 janarit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në thelb ngre edhe pretendimin për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, por nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 janar 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 16 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 29 janar 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues, dhe në vend të tij emëroi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues.

12. Më 10 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gerxhaliu-Krasniqi dhe Nexhmi Rexhepi.

13. Më 30 janar 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 23 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës, në bazë të vendimit të Komisionit Disiplinor ia ndërpreu marrëdhënien e punës punëtorit të tij M.B. (në tekstin e mëtejmë: M.B.).

15. Në një datë të pacaktuar, M.B. paraqiti padinë në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar anulimin e këtij vendimi dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe pagesën e të ardhurave personale për periudhën gjatë së cilës marrëdhënia e tij e punës ishte e ndërprerë.

16. Më 28 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prizren (me Aktgjykimin C. nr. 531/10) aprovoi kërkesëpadinë e M.B., anuloi vendimin e parashtruesit të kërkesës me të cilin M.B. i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe detyroi parashtruesin që ta kthejë punëtorin në vendin e mëparshëm të punës dhe t'ia paguajë të ardhurat personale për periudhën gjatë së cilës marrëdhënia e tij e punës ishte e ndërprerë.

17. Parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën e Qarkut ankesën ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren *"për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*".

18. Më 5 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut (me Aktgjykimin Ac. nr. 519/11) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

Procedura e përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale

19. Pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit (C. nr. 531/10) të Gjykatës Komunale, M.B., tani para Gjykatës Themelore, inicioi procedurën e përmbarimit të aktgjykimit në fjalë, konkretisht të pjesës e cila ka të bëjë me pagesën e të ardhurave personale për periudhën gjatë së cilës marrëdhënia e tij e punës ishte e ndërprerë.

20. Më 11 shkurt 2013, Gjykata Themelore (me Aktvendimin E. nr. 2192/12) lejoi përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

21. Më 27 maj 2013, Gjykata Themelore (me Aktvendimin E. nr. 2192/12) urdhëroi bankën kompetente që t'i bartë mjetet financiare nga llogaria e parashtruesit të kërkesës në llogarinë e punëtorit, në emër të pagesës së të ardhurave personale të mbetura dhe shpenzimeve gjyqësore.

22. Pas kësaj është bërë pagesa e të hollave nga llogaria e parashtruesit të kërkesës në llogarinë e M.B.

Procedura sipas kërkesës për revizion të parashtruesit të kërkesës

23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 519/11, të 5 nëntorit 2012.

24. Më 11 korrik 2013, Gjykata Supreme (me Aktgjykimin Rev. nr. 66/2013) pranoi pjesërisht revizionin e parashtruesit të kërkesës në atë mënyrë që vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallë së parë në pjesën e cila ka të bëjë me kthimin e punëtorit në vendin e mëparshëm të punës, ndërsa aktgjykimin në pjesën e cila ka të bëjë me pagesën e të ardhurave personale për periudhën gjatë së cilës marrëdhënia e tij e punës ishte e ndërprerë e ktheu në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

25. Pjesa operative e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme thotë:

> *„I. Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 519/2011 datë 5.11.2012 dhe aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prizren, C. nr. 531/2010 datë 28.10.2011, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës i datës 22.6.2010, me të cilin paditësit iu është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe është*

detyruar e paditura që ta kthejë në vendin e tij të punës, në pozitën në të cilën ka qenë duke punuar, në afat prej 7 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Pranohet si i bazuar revizioni i të padituës në pjesën e cila ka të bëjë me detyrimin e të padituës që paditësit t'i njihen të gjitha të drejtat që i ka pasur para ndërprerjes së marrëdhënies së punës si dhe t'ia kompensoj të ardhurat personale sipas kontratës së punës prej datës së largimit nga puna si dhe në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej 500 €, dhe në këto pjesë aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, Ac. nr. 519/2011 datë 05.11.2012 dhe ai i Gjykatës Komunale Prizren, C. nr. 531/2010 datë 28.10.2011, prishen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim."

26. Pas kësaj është përsëritur procedura në Gjykatën Themelore në bazë të kërkesëpadisë së M.B., konkretisht pjesës e cila ka të bëj me pagesën e të ardhurave personale për periudhën gjatë së cilës marrëdhënia e tij e punës ishte e ndërprerë.

27. Më 21 janar 2014, punëtori në shqyrtimin kryesor deklaroi *"se e tërheqë padinë ndaj të padituës, me arsyetim se të ardhurat personale që i kanë takuar i ka realizuar në procedurën përmbarimore E. nr. 2192/12, ndërsa tani nuk ka interes juridik që të vazhdoj më tutje me këtë procedurë*".

28. Më 22 janar 2014, Gjykata Themelore në procedurën e sërishme (me Aktvendimin C. nr. 721/13) vërtetoi se padia e punëtorit është tërhequr sepse *"bazuar në nenin 261 pika 2 dhe 3 të LPK-së, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se paditësi e ka tërhequr padinë."*

Procedura e kundërpërmbarimit pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të 11 korrikut 2013

29. Pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 66/2013, parashtruesi, gjithashtu, inicioi në Gjykatën Themelore në Prizren, procedurën e kundërpërmbarimit në lëndën e përmbarimit (Aktvendimi E. nr. 2192/12) të Gjykatës Komunale në Prizren.

30. Më 19 shtator 2013, Gjykata Themelore (me Aktvendimin CP. nr. 1856/13) lejoi kundërpërmbarimin në lëndën e përmbarimit (E. nr. 2192/12) të Gjykatës Komunale në Prizren.

31. Në një datë të pacaktuar, punëtori paraqiti prapësimin kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, të 19 shtatorit 2013.

32. Më 18 prill 2014, Gjykata Themelore (CP. nr. 1856/13), refuzoi si të pabazuar prapësimin e punëtorit dhe vërtetoi Aktvendimin e mëparshëm.

33. Kundër këtij Aktvendimi, punëtori ushtroi ankesën në Gjykatën e Apelit për shkak të *„shkeljes së procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale“*.

34. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit (me Aktvendimin CA. nr. 1754/14) aprovoi ankesën e punëtorit, anuloi Aktvendimin e lartcekur dhe e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore në Prizren për rivendosje. Gjykata e Apelit *„pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se pjesë e kësaj lënde është edhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C. nr. 721/13 i dt. 22.01.2014, e me të cilin aktvendim në procedurën e vendosjes (C. nr. 721/13) është konstatuar se është tërhequr padia (...)“*.

35. Më 26 janar 2015, në procedurën e sërishme, Gjykata Themelore (me Aktvendimin CP. nr. 1856/13) shqyrtoi përsëri propozimin për kundërpërmbarim të parashtruesit të kërkesës dhe gjeti se: *„është i pabazuar prapësimi i av. Ymer Koro nga Prizreni, i autorizuar i debitorit të kundërpërmbarimit M.B nga Prizreni i ushtruar kundër aktvendimit të kësaj gjykate CP. nr. 1856/13 i dt. 19.09.2013 për lejimin e kundërpërmbarimit“,* dhe rrjedhimisht e la në fuqi Aktvendimin (CP. nr. 1856/13) e Gjykatës Themelore të datës 19.09.2013 për lejimin e kundërpërmbarimit.

36. Në një datë të pacaktuar, punëtori paraqiti në Gjykatën e Apelit ankesën kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore të 26 janarit 2015 *„për shkak të shkeljes së procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale“*.

37. Më 16 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit (me Aktvendimin AC. nr. 1176/15) refuzoi si të pabazuar ankesën e punëtorit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren (CP. nr. 1856/13) të datës 26 janar 2015. Në arsyetimin thuhet:

> *„Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të*

gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, për arsye se në aktvendimin nuk janë vërtetuar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së."

38. Më 15 mars 2017, sipas propozimit të punëtorit, Prokurori i Shtetit paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë (KMLC nr. 21/2017).

39. Më 21 shtator 2017, Gjykata Supreme e Kosovës (me Aktvendimin CML. nr. 3/2017), aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit, duke arsyetuar:

„Aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLC. nr. 21/2017 datë 15.3.2017, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës AC. nr. 1176/2015 datë 16.12.2016 dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore Prizren, CP. nr. 1856/2013 datë 26.1.2015, ashtu që refuzohet si i pabazuar propozimi për kundërpërmbarim i kreditorit IMF „Finca - Kosovë", me seli në Prishtinë, për realizimin e borxhit në shumë prej 17.703,12 €, ndaj këtu debitorit M.B, nga Prizreni."

40. Gjykata Supreme e aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës. Gjykata Supreme me Aktvendimin ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, si dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren dhe refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për kundërpërmbarim.

41. Në fakt, Gjykata Supreme gjeti se *„sipas dispozitës së nenit 21 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, është përcaktuar se Organi Përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me ligj nuk është parashikuar diçka tjetër".*

Pretendimet e parashtruesit

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i kontestuar *"është jokushtetues sepse bie ndesh edhe me nenin 102, pika 3 dhe 4 të*

Kushtetutës, i cili garanton gjykim të drejtë dhe të paanshëm të bazuar në Kushtetutë dhe Ligj".

43. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ia mohon të drejtat në *"kundërpërmbarim për kthimin e pasurisë së saj - pasi nuk ka dhe nuk ka pasur vendim gjyqësor që e obligon të paguajë shumën – bie ndesh me Protokollin nr. 1, nenin 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (...), zbatimi i të cilit dhe epërsia e të cilit dokument garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*".

44. Në fakt, parashtruesi i kërkesës konsideron se *„vendimi 3/2017 ia mohon gëzimin e sigurisë juridike dhe të parimeve kushtetuese dhe flet se gjykata thirret në vendimin 66/2013, mirëpo në mënyrë selektive, sepse merr parasysh vetëm pikën 1 (me të cilën refuzohet, si i pabazuar revizioni i IMF kundër kthimit në punë), mirëpo e injoron plotësisht pikën II të vendimit përkitazi lartësisë së kompensimit dhe arsyet për të cilat është kthyer në ri-gjykim".*

45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata ta shpallë kërkesën të pranueshme, ta shpallë të pavlefshëm Aktvendimin (CML. nr. 3/2017) e Gjykatës Supreme dhe të merren masat e nevojshme për t'ia siguruar se ai i gëzon të drejtat e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

"[...]

5. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

Neni 113

„(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

„(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

48. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor."

49. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar.

50. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

51. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë], i cili parasheh:

„(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

52. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e garantuara sipas nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

53. Gjykata rikujton se neni 102 i Kushtetutës bie në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se dispozitat e nenit 102 të Kushtetutës nuk përmbajnë të drejta dhe liri individuale të mbrojtura me dispozitat e përmbajtura në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se neni 102 nuk mund të jetë bazë për kërkesat të cilat parashtrohen në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës (shih, Gjykata Kushtetuese në rastin KI46/17,

parashtruesi i kërkesës: *Agjencia Kosovare e Privatizimit,* Aktvendim për papranueshmëri i 7 shtatorit 2017, paragrafi 39).

54. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu në thelb ngre edhe pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa specifikuar dispozita konkrete kushtetuese. Gjykata rikujton se e drejta për gjykim të drejtë është e mbrojtur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

55. Gjykata rikujton nenin 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

56. Gjykata i referohet nenit 6.1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht [...] nga një gjykatë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile".*

57. Gjykata merr parasysh nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton: "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

58. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila, *mutatis mutandis,* ka konstatuar *se "juridiksioni i Gjykatës për të verifikuar se ligjet vendore janë interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë është i kufizuar dhe se nuk është funksioni i saj që të zëvendësojë gjykatat vendase, por roli i saj është të sigurojë që vendimet e gjykatave vendase të mos jenë arbitrare apo në ndonjë mënyrë qartazi të paarsyeshme"* (shih, rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë,* kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83).

59. Gjykata gjithashtu rikujton: *„[...] [GJEDNJ] nuk do ta vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendor nga gjykatat vendase, përveç në rastet e arbitraritetit të dukshëm (shih, mutatis mutandis, Adamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, paragrafi 118, 24 qershor 2008), me fjalë të tjera, kur vëren se zbatimi i ligjit nga gjykatat vendase në rastin e caktuar është qartazi i gabuar ose ishin marrë konkluzione arbitrare dhe/ose ishte mohuar drejtësia (shih, mutatis mutandis, Farbers dhe Harlanova kundër Letonisë (dec.), nr. 57313/00, 6 shtator 2001, dhe, në kontekstin e nenit 1 të Protokollit nr. 1, Beyeler kundër Italisë [DHM] nr. 10, 33202/96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-1; shih edhe rastin e GJEDNJ-së Anđelković kundër Serbisë, kërkesa nr. 1401/08, Aktgjykim i 9 prillit 2013, paragrafi 24)".*

60. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).

61. Gjykata vëren se në Aktvendimin e saj, Gjykata Supreme arsyetoi: *"Në rastin konkret në procedurën e sërishme në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 22.01.2014, paditësi (këtu debitori) ka deklaruar se tërheqë padinë ndaj të padituës (këtu kreditor), me arsyetim se të ardhurat personale të cilat i kanë takuar i ka realizuar në procedurën përmbarimore E. nr. 2192/12, ndërsa tani nuk ka interes juridik të vazhdojë më tutje me këtë procedurë, ndërsa përfaqësuesi i të padituës IMF „Finca" nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë [...] Debitori IMF „Finca – Kosovë" ka paguar diçka çka në kuptim të nenit 315 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, ka qenë i detyruar të paguaj. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore kur kanë gjetur se gjykata përmbarimore ka përmbaruar titullin ekzekutiv në pjesën në të cilën ai titull ekzekutiv është prishur nga ana e Gjykatës Supreme".*

62. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e vendosjes lidhur me kërkesat e parashtruesit është i qartë, gjithëpërfshirës dhe koherent dhe se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih,

Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06).

63. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është parashikuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

64. Në kuptim të pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës, ai gjithashtu pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është marrë në shkelje të lirisë së garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk justifikon pretendimin se e drejta e tij kushtetuese në pronë është shkelur.

65. Gjykata rikujton se neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neni 46 i Kushtetutës nuk garantojnë të drejtën për fitimin e pronës (shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës,* paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983; *Slivenko dhe të tjerët kundër Lituanisë,* paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 9 tetorit 2003).

66. Më tej, parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 46 të Kushtetutës vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me *"pasurinë"* e tij; në kuptim të kësaj dispozite "*pasuria"* mund të jetë *"pasuria ekzistuese",* duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë për "*pritshmëri legjitime"* se do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronësisë.

67. Nuk mund të thuhet se ndonjë "*pritshmëri legjitime"* lind atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtresat e parashtruesve janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih, *Kopecký kundër Sllovakisë,* paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 2004).

68. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi *prima facie* dhe as nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se si dhe pse Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën e tij në pronë, siç garantohet me këtë dispozitë.

69. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se vendimet e gjykatave të rregullta kanë shkaktuar në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.

70. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 janar 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Arta Rama-Hajrizi

KI138/18, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Urdhrit, I. GJA. nr. 1/2018-141, të Kryetarit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, z. Ymer Hoxha, të 8 gushtit 2018

KI138/18, Gent Gjini

Aktvendim për papranueshmëri i 23 janarit 2019

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e parakohshme, mosshterje e mjeteve juridike, kërkesë për masë të përkohshme, kërkesë për seancë dëgjimore, procedurë administrative*

Parashtruesi i kërkesës është avokat i cili ushtron profesionin e tij të avokatisë në Prizren.

Objekt i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së një Urdhri të nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, përmes së cilit *"Urdhërohet* [shin] *punëtorët e sigurimit dhe recepcionistja, që të mos lejojnë hyrjen e avokatëve dhe palëve në objektin e gjykatës, pa ftesa ose leje gojore të kryetarit të gjykatës, apo gjyqtarit, me përjashtim në zyrën e dorëzimit të shkresave"*.

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se ky Urdhër i ka shkelur atij të drejtat e garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës. Ai po ashtu pretendonte shkelje të nenit 41 të Ligjit për Avokatinë, të nenit 25 të Ligjit për Gjykatat, si dhe nenit 6.1 të Statutit të Odës së Avokatëve. Në lidhje me këto pretendime, parashtruesi i kërkesës kërkoi edhe caktimin e masës së përkohshme për të ndaluar zbatimin e Urdhrit të kontestuar si dhe caktimin e një seance dëgjimore ku do të paraqiteshin argumentet lidhur me këtë rast.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të papranueshme, duke qenë se ajo ishte parashtruar para se parashtruesi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative dhe, si e tillë, ishte e parakohshme. Për të arritur në këtë konkluzion, Gjykata theksoi të gjitha dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore që qartazi tregonin se parashtruesi kishte pasur mundësi që të kontestojë Urdhrin në fjalë në procedurë administrative. Gjykata iu referua parimeve themelore për shterim të mjeteve juridike të ndërtuara ndër vite nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe praktikës së vet gjyqësore. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu theksoi që parashtruesi i kërkesës nuk kishte argumentuar që mjetet juridike të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore ishin joefektive në rastin e tij. Ai thjesht kishte konsideruar, edhe pas kërkesës së Gjykatës për sqarim, që Gjykata Kushtetuese është i vetmi mjet juridik.

Për një mori arsyesh të elaboruara gjerësisht në aktvendim, Gjykata nuk u pajtua me këtë pohimin e parashtruesit se nuk ka mjete juridike në dispozicion dhe si rrjedhojë e shpalli kërkesën të papranueshme për arsye të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës. Duke qenë se kërkesa u shpall e papranueshme, Gjykata gjithashtu refuzoi kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme dhe për seancë dëgjimore – duke i konsideruar ato si të pabazuara dhe të panevojshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI138/18

Parashtrues

Gent Gjini

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit, I. GJA. nr. 1/2018-141, të Kryetarit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, z. Ymer Hoxha, të 8 gushtit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gent Gjini, avokat nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Urdhrin [I. GJA. nr. 1/2018-141] e Kryetarit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, të 8 gushtit 2018 (në tekstin e mëtejmë: Urdhri).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Urdhrit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe

Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të nenit 41 të Ligjit për Avokatinë, të nenit 25 të Ligjit për Gjykatat, si dhe shkelje të nenit 6.1 të Statutit të Odës së Avokatëve.

4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që të vendoset masë e përkohshme ndaj Urdhrit të kontestuar me arsyetimin se *"me lënien e këtij Urdhri në fuqi pasojat do të jenë të pariparueshme dhe të pakorrigjueshme"* dhe se mund të paraqiten situata të eskalimit të *"dhunës fizike dhe verbale nga gardianët e gjykatës, të cilët janë të autorizuar të përdorin dhunën"*.

5. Parashtruesi i kërkesës kërkon edhe caktimin e seancës dëgjimore ku do të diskutoheshin *"gojarisht dhe në tërësi"* rrethanat e rastit dhe ku do të argumentohej kërkesa e tij *"në ligj dhe në fakte"*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 shtator 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 19 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 26 shtator 2018, Gjykata informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë pjesët e mbetura të formularit zyrtar të Gjykatës, përkatësisht të specifikojë vendimin e kontestuar si dhe të deklarohet lidhur me shterimin e mjeteve juridike, duke u përgjigjur në pyetjen se a ka ndërmarrë ndonjë hap procedural për kontestimin e Urdhrit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren. Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që formularin e plotësuar dhe sqarimet e kërkuara t'i dorëzojë në Gjykatë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës së Gjykatës.

10. Më 8 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sqarimet e kërkuara në Gjykatë. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës theksoi se Urdhri i kontestuar *"përfundimisht nuk mund të atakohet respektivisht për të nuk ka mjet juridik"*. Së bashku me sqarimet e kërkuara, parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe kërkesë për masë të përkohshme.

11. Më 11 tetor 2018, Gjykata e njoftoi Kryetarin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, z. Ymer Hoxha (në tekstin e mëtejmë: pala kundërshtare), lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe e ftoi që të dorëzojë komentet e tij, nëse ka, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës së Gjykatës.

12. Më 19 tetor 2018, pala kundërshtare dorëzoi komentet e tij në Gjykatë.

13. Më 22 tetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për pranimin e komenteve nga pala kundërshtare, dhe i dërgoi një kopje të tyre.

14. Më 23 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dërgoi një letër elektronike në adresën elektronike të Gjykatës përmes të cilës përsëriti kërkesën e tij lidhur me nevojën e caktimit të masës së përkohshme.

15. Më 1 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti komente shtesë, si përgjigje ndaj komenteve të dorëzuara nga pala kundërshtare.

16. Më 19 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi edhe një letër në Gjykatë përmes të cilës kërkoi që *"kërkesa kushtetuese të procedohet sa më shpejt në kohë të arsyeshme"* sepse urdhri i kontestuar është ende në fuqi.

17. Më 27 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi palën kundërshtare për pranimin e komenteve shtesë nga ana e parashtruesit të kërkesës si përgjigje ndaj komenteve të tij, si dhe i dërgoi një kopje të tyre.

18. Të njëjtën ditë, Gjykata po ashtu e njoftoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe e ftoi që të dorëzojë komente, nëse ka, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës së Gjykatës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk dorëzoi komente.

19. Më 4 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një letër tjetër shtesë përmes së cilës përsëriti kërkesën që rasti i dorëzuar në Gjykatë të shqyrtohet me urgjencë.

20. Më 14 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi edhe një letër shtesë në Gjykatë, duke kërkuar që të vendoset *"lidhur me masën e përkohshme, sepse situata është shumë e ndjeshme"*.

21. Më 23 janar 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

22. Parashtruesi i kërkesës është avokat nga Prizreni, i cili e ushtron veprimtarinë e tij të avokaturës në Komunën e Prizrenit.

23. Më 8 gusht 2018, Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, z. Ymer Hoxha, nxori Urdhrin [I. GJA. nr. 1/2018-141], përmes të cilit ka ndaluar hyrjen e avokatëve dhe të palëve në objektin e Gjykatës Themelore në Prizren, pa ftesa apo pa leje gojore paraprake, përveç qasjes në zyrën e dorëzimit të shkresave. Më konkretisht, Urdhri në fjalë, kushtetutshmëria e të cilit po kontestohet para kësaj Gjykate, ka përmbajtjen e poshtëshënuar:

> *"GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetari i Gjykatës Ymer Hoxha, me qëllim të vendosjes së rendit në gjykatë, me datën 08.08.2018, nxjerr këtë:*
>
> *URDHËR*
>
> *Urdhërohen punëtorët e sigurimit dhe recepcionistja, që të mos lejojnë hyrjen e avokatëve dhe palëve në objektin e gjykatës, pa ftesa ose leje gojore të kryetarit të gjykatës, apo gjyqtarit, me përjashtim në zyrën e dorëzimit të shkresave.*
>
> *Nëse avokatët apo palët nuk e zbatojnë urdhrin atëherë, personeli i sigurimit i largon me detyrim.*
>
> *Nëse personeli i sigurimit apo recepcionistja nuk e zbatojnë urdhrin, ndaj tyre do të iniciohet procedura disiplinore"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kryetari i Gjykatës së Prizrenit, z. Ymer Hoxha, përmes Urdhrit [I. GJA. nr. 1/2018-141, të 8 gushtit 2018], i ka shkelur atij të drejtat e garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës po ashtu

pretendon shkelje të nenit 41 të Ligjit për Avokatinë, nenit 25 të Ligjit për Gjykatat si dhe nenit 6.1. të Statutit të Odës së Avokatëve.

25. Parashtruesi i kërkesës thekson se Urdhri në fjalë është *"i paapelueshëm, nuk ka këshillë juridike dhe nuk ka instancë që vlerëson ligjshmërinë"* e tij. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës thekson se mjeti i vetëm në këtë rast është paraqitja e një kërkese pranë Gjykatës Kushtetuese.

26. Për sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 23 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se kjo dispozitë kushtetuese i garanton secilit njeri që të trajtohet me respekt, të mos ofendohet, fyhet apo nënçmohet. Urdhri i kontestuar, sipas parashtruesit të kërkesës, i ofendon avokatët me fjalën "*do nxjerrën me dhunë"*. Ai më tutje thekson se avokatët e Prizrenit janë profesionist dhe kanë ndërgjegje, se ata dinë si të sillen dhe se është qesharake të thuhet se *"ne mund të prishim rendin në gjykatë"* dhe se dhuna ndaj avokatëve nuk do të tolerohet.

27. Për sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi thekson se me këtë Urdhër vihet në pikëpyetje barazia *"nëse do të mendohet në mendësinë e Kryetarit të Gjykatës* [Themelore në Prizren]" për arsye se Urdhri paraqet vija të kuqe për avokatët dhe qytetarët në lidhje me prishjen e rendit dhe qetësisë dhe nuk vlen si i tillë për disa gjyqtarë dhe staf administrativ të cilët, sipas parashtruesit të kërkesës shkaktojnë zhurmë në korridoret e gjykatës me sjelljet e tyre. Më tutje, parashtruesi konsideron se Urdhri i kontestuar e trajton gjykatën si pronë të disa gjyqtarëve dhe stafit administrativ, duke i lejuar ata që të hyjnë dhe të dalin kurdo që ata duan – e duke harruar që *"Gjykata është e shtetit, shoqërisë qytetarëve neve avokatëve"* që paguajmë taksa për shtetin e Kosovës. Ne jemi ata [avokatët] që më së shumti e mirëmbajnë gjykatën duke korrigjuar veprimet e tyre pothuajse për çdo ditë.

28. Për sa i takon pretendimit për shkelje të nenit 55 të Kushtetutës, parashtruesi thekson se është pikërisht ky nen që *"e demanton Urdhrin"* për arsye se, sipas tij, mjafton vetëm një Urdhër i tillë arbitrar i palës kundërshtare që të cenojë këtë parim kushtetues. Ky i fundit, sipas parashtruesit të kërkesës, cenohet meqë Urdhri nuk ka mbështetje ligjore dhe se nuk ekziston asnjë ligj, nen apo statut në të cilin mund të gjendet shprehja *"largim me detyrim (dhunë) të avokatëve"* për prishje të rendit dhe qetësisë. Paragrafi 4 i nenit 55, thekson parashtruesi i kërkesës, i jep autoritetin ligjor vetëm një gjykate që të bëjë kufizimin e lirisë dhe ato brendapërbrenda parakushteve të caktuara. Ai përfundon duke theksuar se ky Urdhër

është *"antikushtetues", "tendencioz"* dhe, si i tillë, është Urdhri më *"skandaloz"* në drejtësinë kosovare.

29. Në lidhje me shkeljet e tjera të pretenduara, parashtruesi i kërkesës thekson se ky Urdhër shkel edhe nenin 41 të Ligjit për Avokatinë, si dhe Statutin e Odës së Avokatëve, meqë i njëjti *"ndërhyn në pavarësinë e veprimtarisë së avokatëve dhe në ushtrimin e rregullt të punës sonë."* Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se në bazë të nenit 25 të Ligjit për Gjykatat, Urdhri i kontestuar shkelë edhe vet Rregulloren e organizimit të brendshëm të gjykatave, meqë ky Urdhër *"nuk ka miratimin apo lejen nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës"*. Sipas parashtruesit të kërkesës, vetëm Këshilli Gjyqësor i Kosovës mundet që me votën e të gjithë anëtarëve të jep miratimin *"për vënien e kushtit për largimin me detyrim (forcë) të avokatëve nga gjykatorja nga gardianët e saj"*.

30. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se reagimi i tij i paraqitur në këtë kërkesë kushtetuese *"ka mbështetje edhe nga shoqëria civile e Prizrenit, dhe intelektualët e qytetit të Prizrenit"* dhe se ky reagim është në koordinim me të *"gjithë akterët intelektual"*.

31. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të shfuqizojë Urdhrin e kontestuar për shkak të mospërputhjes së tij me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës si dhe për shkak të kundërligjshmërisë së tij.

Komentet e dorëzuara nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, z. Ymer Hoxha, në cilësinë e palës kundërshtare

32. Lidhur me kërkesën e parashtruesit, Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, z. Ymer Hoxha, si palë kundërshtare në këtë rast, nëpërmjet komenteve të tij ka deklaruar se në rastin konkret nuk ka shkelje të nenit 23, 24 apo 55 të Kushtetutës.

33. Lidhur me nenin 23 të Kushtetutës, pala kundërshtare theksoi se Urdhri i tij nuk cenon dinjitetin e askujt, as të stafit të gjykatës, as të palëve në procedurë e as të avokatëve të cilët përfaqësojnë klientët e tyre. Se çfarë dinjiteti më konkretisht është cenuar, sipas tij, parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar por vetëm ka ngritur dyshime hipotetike. Urdhri në fjalë, vijon pala kundërshtare, është lëshuar në funksion të krijimit të rendit në gjykatë ku avokatëve me ftesa për përfaqësim të klientëve të tyre iu jepet mundësia për përfaqësim, e në raste të caktuara edhe nëpërmjet lejes gojore mund t'i qasen zyrës së gjyqtarit, vetëm e vetëm që të krijohet një rend dhe

rregull në gjykatë, ku askush nga qytetarët nuk vuan për shkak të mosmbajtjes së rendit dhe rregullit.

34. Lidhur me nenin 24 të Kushtetutës, pala kundërshtare pohon që barazinë para ligjit e mishëron edhe Urdhri i kontestuar në përmbajtjen dhe qëllimin e tij. Ky urdhër, sipas tij, nuk bën dallim ndaj asnjë kategorie qytetare apo profesionistësh, por përcakton që në gjykatë pa ftesa nuk mund të hyj askush, e as avokatët. Më tutje, pala kundërshtare thekson se askush në gjykatë nuk duhet të futet pa ftesa sepse dëmtohet komunikimi i gjykatës me palët, duke rrezikuar kështu që të ketë komunikim të njëanshëm *ex-parte*. Për të eliminuar rrezikun e një komunikimi të tillë, i cili do të përbënte shkelje të Kodit të Etikës së Gjyqtarëve, gjykata me Urdhër ka ndaluar futjen e palëve pa ftesa, duke përfshirë avokatët. Si përjashtim është paraparë rasti kur komunikimi dhe kontakti verbal me gjykatën mundësohet kur një gjyqtar e kërkon apo lejon një gjë të tillë. Sipas palës kundërshtare, shtrohet pyetja se cili nga avokatët individualisht është favorizuar ose cili është cenuar, përderisa Urdhri zbatohet njëjtë ndaj të gjitha palëve, pa privilegjuar asnjë dhe pa vënë në dyshim barazinë ligjore.

35. Lidhur me nenin 55 të Kushtetutës, pala kundërshtare thekson se parashtruesi i kërkesës ka përdorur një qasje dhe interpretim të gabuar në raport me nenet kushtetuese dhe atë se cilat të drejta dhe liri i janë kufizuar. Sipas tij, asnjë dispozitë themelore e mbrojtur nga legjislacioni vendor apo ndërkombëtar nuk është cenuar me Urdhrin e kontestuar. Në këtë drejtim, ai pyet se si mund të konsiderohet kufizim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut *"nëse nuk i lejohet një personi që nuk ka asnjë punë dhe të futet në gjykatë vetëm pse iu ka tekur"*. Sipas tij, moslejimi i hyrjes në gjykatë pa pasur ndonjë punë nuk mund të konsiderohet shkelje sepse përmes kësaj ndalese ruhet rendi, qetësia, integriteti dhe siguria e gjykatës dhe gjyqtarëve të saj. Për më tepër, qasja në gjykatë, vazhdon ai, nuk është e kufizuar meqë të gjithë pa përjashtim kanë qasje në shërbimin e administratës për të realizuar të drejtat e tyre duke dorëzuar shkresa dhe duke marrë vërtetime e dëshmi të ndryshme.

36. Sipas palës kundërshtare, të gjitha institucionet shtetërore kanë një rend dhe rregull dhe nuk lejojnë anarki që do të mundësonte shkaktim të kaosit apo vënies në dyshim të pavarësisë së gjykatës dhe kështu humbjes së besimit tek publiku. Pra, askush nuk mund të futet lirshëm pa asnjë kufizim në institucione të caktuara pa qenë të lejuar nga zyrtari përkatës. Urdhri në fjalë nuk është i drejtuar kundër avokatit Gent Gjini [parashtruesit të kërkesës], por vlen për avokatët, palët, prokurorët. Futja e avokatëve pa ftesa në gjykatë dhe pengimi që ata i bëjnë punës së gjyqtarëve është trajtuar edhe në kolegjiumin e

gjyqtarëve të mbajtur më 5 shtator 2018, ku të gjithë gjyqtarët njëzëri kanë mbështetur Urdhrin e kontestuar. Kjo po ashtu sepse ekzistonte mundësia e keqpërdorimeve dhe bartja e informatave jo të sakta tek palët se *"kinse është rregulluar çështja me gjyqtarin"*.

37. Për sa i takon kërkesës së parashtruesit për masë të përkohshme, pala kundërshtare thekson se e njëjta nuk duhet të miratohet sepse është e pabazë dhe nuk ka asnjë lloj pasoje të paripërueshme që mund të shkaktohet.

Komentet shtesë të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës

38. Si përgjigje ndaj komenteve të dorëzuara nga pala kundërshtare, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar disa komente shtesë.

39. Në këtë drejtim, parashtruesi thekson se pala kundërshtare merret personalisht me të dhe bën përpjekje që, në mungesë të fakteve, të arsyetojë *"Urdhrin e tij" "duke u marrë me gjëra që dalin jashtë kërkesës së tij"*. Më tutje ai deklaron që në kërkesën e tij dorëzuar në Gjykatë ai fokusohet tek papranueshmëria e përdorimit të forcës-dhunës ndaj avokatëve, e cila i lejon gardianët dhe i autorizon ata që të përdorin dhunë ndaj avokatëve.

40. Për më tepër, në komentet e tij shtesë, parashtruesi thekson se pala kundërshtare merret me të personalisht, pavarësisht që me kërkesën dorëzuar në Gjykatë "*unë sigurisht që e përfaqësoj komunitetin e avokatëve të Prizrenit [...] dhe jo* [vetëm] *veten time"*. Ky Urdhër, sipas parashtruesit është shpallur vetëm në Gjykatën Themelore të Prizrenit dhe nuk figuron si i tillë në gjykatat e tjera themelore në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës, më tutje, thekson se kërkesën e tanishme të dorëzuar në Gjykatë e ka bërë *"në interes të avokatëve të Prizrenit"* dhe se *"të gjithë ne [avokatët] prekemi nga ky Urdhër"*. Ai më tutje vazhdon duke pohuar se: *"unë e kam mbështetjen dhe po ashtu janë solidarizuar gjithë avokatët, këtë e them me përgjegjësi më të madhe si profesionale dhe njerëzore"*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i 25 majit 2016, i shpallur më dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës më 13 qershor 2016

Neni 13
[Parimi i të drejtës në mjete juridike]

1. Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik.

Neni 52
[Paligjshmëria e aktit administrativ]

1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:
1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2, të nenit 4 të këtij Ligji;
1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;
1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
1.5. është në kundërshtim me ligjin material;
1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo
1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.

Neni 83
[Fillimi i një procedure administrative]

1. Procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik. [...]

PJESA VII
MJETET JURIDIKE ADMINISTRATIVE
KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR MJETET JURIDIKE ADMINISTRATIVE

Neni 124
[Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative]

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. [...]

2. Përveç nëse caktohet ndryshe me ligj, mjetet juridike administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.

3. Mjetet juridike administrative, të rregullta, janë:

3.1. ankesa;
3.2. kundërshtimi administrativ;
4. Mjet juridik administrativ përjashtimor është rihapja e procedurës administrative.
5. Pala mund t'i ushtrojë vetëm një herë mjetet juridike administrative të rregullta për të njëjtën çështje.
6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste:
6.1. nuk ekziston organi epror;
6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ
që zgjidh ankesën, apo
6.3 parashikohet shprehimisht me ligj.

KAPITULLI II
ANKESA
NËNKAPITULLI I
Rregullat e përgjithshme dhe kushtet e pranueshmërisë së ankesës

Neni 125
[Ankesa]

1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"). [...]

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

Lidhur me palët e autorizuara dhe kontestimin e një vendimi të autoritetit publik

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

43. Lidhur me përmbushjen e kërkesave të nenit 113.1 dhe 113.7, Gjykata vëren dy elemente të rëndësishme që duhet t'i shqyrtojë.

44. Elementi i parë ka të bëjë me atë se a është parashtruesi i kërkesës palë e autorizuar për të dorëzuar këtë kërkesë kushtetuese në (i) emrin e tij personal, si person fizik, dhe (ii) në emër të të gjithë avokatëve të Prizrenit.

45. Për sa i takon pikës (i) të elementit të parë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur fillimisht kërkesën e tij në cilësinë e personit fizik, përkatësisht si avokat që ushtron profesionin e tij të avokatisë, ku kërkon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë, e të cilat pretendon se i janë shkelur. Në këtë aspekt, Gjykata e konsideron atë si palë të autorizuar për të dorëzuar këtë kërkesë individuale.

46. Për sa i takon pikës (ii) të elementit të parë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se kërkesën e tij e ka paraqitur edhe në emër të të gjithë avokatëve të Prizrenit të cilët preken nga ky Urdhër dhe se për këtë kërkesë ai ka edhe mbështetjen e intelektualëve dhe të shoqërisë civile të Prizrenit. Lidhur me këtë pjesë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar të ngrejë pretendime në emër të të gjithë avokatëve të Prizrenit dhe se një përfaqësim të tillë nuk e ka dëshmuar në Gjykatë në asnjë mënyrë. Për

më tepër, kërkesat e tilla janë kërkesa të karakterit *actio popularis* për të cilat Gjykata veç është shprehur se nuk ka juridiksion t'i trajtojë. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të shpallur si të papranueshëm në aspektin e *actio popularis* meqë kërkesa ishte dorëzuar në emër të personave të tretë dhe si rrjedhojë ata nuk ishin palë të autorizuara për të ngritur pretendime për palët e treta, KI03/11, *Organizata Çohu*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2011, paragrafët 16-18).

47. Si rrjedhojë, Gjykata do ta trajtojë këtë kërkesë vetëm për sa i takon parashtruesit të kërkesës si individ, respektivisht person fizik, dhe jo si përfaqësues i të gjithë avokatëve të Prizrenit. Andaj, Gjykata konkludon se elementi i parë i nenit 113 për sa i takon kërkesës individuale plotësohet pjesërisht dhe atë vetëm për sa i takon pikës (i) të lartreferuar.

48. Elementi i dytë ka të bëjë me determinimin se çfarë vendimi po kontestohet para kësaj Gjykate dhe se a është ai vendim, vendim i një autoriteti publik. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se Urdhri [I. GJA. nr. 1/2018-141, i 8 gushtit 2018] i nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, z. Ymer Hoxha, është vendim i një autoriteti publik. Andaj, Gjykata konkludon se ky element i nenit 113 plotësohet tërësisht.

~~49.~~ Si përmbledhje e përmbushjes së kritereve për palë të autorizuar dhe kontestim të një vendimi të autoritetit publik, kushte këto të parapara me nenin 113 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që të dorëzojë këtë kërkesë në emrin e tij personal dhe për sa i takon të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe se ai konteston një vendim të një autoriteti publik.

Lidhur me shterimin e mjeteve juridike

50. Gjykata vëren se përveç dy elementeve të lartpërmendura, neni 113.7 i Kushtetutës përmban edhe një kërkesë shumë të qartë, e që është shterimi i të gjitha mjeteve juridike *"të përcaktuara me ligj"*.

51. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet edhe nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili e konkretizon edhe më tutje nenin 113.7 të Kushtetutës lidhur me shterimin e mjeteve juridike, që përcakton si në vijim:

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

52. Përveç kësaj, Gjykata i referohet në fund edhe pikës (b) të paragrafit (1), të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,"

53. Rrjedhimisht, duke iu referuar bazës kushtetuese për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës; bazës ligjore të përcaktuar me nenin 47.2 të Ligjit; dhe bazës rregullative të përcaktuar me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës - Gjykata do të përgjigjet në pyetjen se në rastin konkret, a i ka shteruar parashtruesi i kërkesës të gjitha mjetet juridike efektive që kishte në dispozicion, të përcaktuara me ligj, para se të dorëzojë kërkesën e tij individuale në Gjykatën Kushtetuese.

54. Për të arritur te kjo përgjigje, Gjykata do t'i referohet edhe praktikës së mirë përcaktuar gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Përveç praktikës së GJEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet edhe vet praktikës së saj e cila tashmë mund të konsiderohet një praktikë e konsoliduar gjyqësore për sa i takon çështjes së shterimit të mjeteve juridike.

55. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se kërkesa është parashtruar nga avokati Gent Gjini, në cilësinë e tij si individ dhe person fizik, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Urdhrit [I. GJA. nr. 1/2018-141, të 8 gushtit 2018] të nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, z. Ymer Hoxha.

56. Gjykata fillimisht rikujton se në pjesën e formularit ku kërkohet të shpjegohet se a janë shteruar të gjitha mjetet juridike, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se Urdhri i kontestuar është *"i paapelueshëm, nuk ka këshillë juridike dhe nuk ka instancë që vlerëson ligjshmërinë"* e tij. Më tutje, parashtruesi kishte theksuar se

"mjeti juridik në këtë rast është vetëm Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës".

57. Pas pranimit të kërkesës së parashtruesit, Gjykata, në bazë të procedurave të rregullta për shqyrtimin e kërkesave individuale, e kishte njoftuar parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe, për qëllim të konfirmimit, e kishte pyetur se *"a ka ndërmarrë ndonjë hap procedural drejt kontestimit të Urdhrit"*. Në përgjigjen e tij dorëzuar në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës u përgjigj duke theksuar se Urdhri i kontestuar *"përfundimisht nuk mund të atakohet respektivisht për të nuk ka mjet juridik"*.

58. Gjykata pra vëren se qëndrimi përfundimtar i parashtruesit të kërkesës është që nuk ka mjet juridik ligjor përmes së cilit mund të kontestohet ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e këtij Urdhri.

59. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje dispozitat ligjore relevante (shih pjesën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të cituar në mes të paragrafëve 40-41 të këtij Aktvendimi) të aplikueshme në Republikën e Kosovës – sipas të cilave mund të kontestohet paligjshmëria e pretenduar e çdo akti administrativ të nxjerrë nga një autoritet publik. Ato dispozita ligjore në mënyrë shumë të qartë përcaktojnë që *"secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore [...] kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik"*. (Shih, ndër të tjera, nenet 13, 52, 83, 124, 125 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

60. Prandaj, Gjykata mban qëndrimin se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi ligjore, në bazë të ligjit në fuqi, të paraqes të gjitha pretendimet e tij për shkelje të ligjit apo të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 23, 24 dhe 55 të Kushtetutës – pretendime që po i bën për herë të parë kësaj Gjykate. Pra, ai ka pasur mundësi ligjore që të kontestojë *"veprimin"* e ndërmarrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, z. Ymer Hoxha, veprimi i të cilit në këtë rast është i karakterit administrativ. Ai po ashtu ka mundur që ankesat e tij t'i paraqes para Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kontestimi i veprimeve administrative ka rrugë të qartë ligjore dhe kontestimi i tyre në procedurë administrative është e drejtë e njohur ligjore për të gjitha palët që konsiderojnë se të drejtat e tyre janë cenuar.

61. Për më tepër, kontestimi i akteve të tilla garantohet edhe nëpërmes nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës i cili parasheh që secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër *"vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat*

e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj". Edhe vet Kushtetuta i referohet "ligjit" për të treguar se personat që pretendojnë shkelje kushtetuese dhe ligjore duhet të ndjekin procedurat e parapara ligjore për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre.

62. Vetëm pasi që të kishte shteruar mjetet e tilla juridike parashtruesi i kërkesës do të mund të paraqiste, në Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë individuale për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve përfundimtare të gjykatave të rregullta, në rast se ai akoma do të ngelej i pakënaqur me mënyrën se si janë trajtuar apo vendosur pretendimet e tij. Këtë gjë do të mund ta bënte pastaj në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

63. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion, të parapara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, duke dorëzuar kështu një kërkesë të parakohshme para kësaj Gjykate. (Shih rastet e ngjashme të Gjykatës Kushtetuese, nr. KI84/17, parashtrues *Bahri Maxhuni,* Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri i 19 prillit 2018, paragrafët 28-30; KI38/17, parashtruese *Meleq Ymeri*, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, paragrafët 26-28).

64. Gjykata rikujton se rregulli i shterimit të mjeteve juridike është pasqyrim i parimit të subsidiaritetit, si parim themelor në gjyqësinë kushtetuese, i cili ka për qëllim që t'i ofrojë gjykatave të rregullta, apo autoriteteve publike përkatëse, mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar kushtetuese. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese. (Shih: GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, kërkesa nr. 25803/94, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 74 dhe, ndër të tjera, shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; rasti nr. KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35, rasti nr. KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST Sh.P.K.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe rasti nr. KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).

65. Gjykata në vazhdimësi ka respektuar parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit duhet që të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurën e rregullt, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore. Gjykata rithekson se kjo qasje kërkon që para se të drejtohen në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale, brendapërbrenda institucioneve të cilat pretendohet të kenë shkelur ndonjë të drejtë, në procedura administrative ose gjyqësore, në procedurat e rregullta, për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar një shkelje të tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. (Shih: si autoritet më i freskët, rasti i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, nr. KI84/17, parashtrues *Bahri Maxhuni,* cituar më lart, paragrafët 28-30; rasti nr. KI62/16, parashtrues *Bekë Lajçi,* Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2017, paragrafët 59-60, dhe gjithashtu shih rastin nr. KI07/09, parashtrues: *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19; rasti nr. KI109/15, parashtrues: *Milazim Nrecaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2016, paragrafët 27-28; KI148/15, parashtrues: *Xhafer Selmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 prillit 2016, paragrafët 27-28).

66. Më tutje, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike është parakusht procedural i cili patjetërsisht duhet të përmbushet në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë një kërkesë. Ndonëse pala kundërshtare nuk e ka ngritur si pretendim faktin që kjo kërkesë është e papranueshme në aspekt procedural, Gjykata, në çdo instancë dhe në çdo kohë, e vlerëson *ex officio* se a janë të aplikueshme të gjitha kushtet e pranueshmërisë për një rast. Në parim, përveç shterimit të rregullt të mjeteve juridike të parapara me ligj, e vetmja mënyrë tjetër se si mund të tejkalohet ky kusht procedural – pa shterim - është nëse një parashtrues dëshmon se mjetet juridike të ofruara me ligj nuk janë efektive.

67. Në këtë aspekt, është qëndrim i njohur nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate dhe e GJEDNJ-së që detyrimi për të shteruar mjetet juridike është i kufizuar në përdorimin e vetëm atyre mjeteve juridike, ekzistenca e të cilave është mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë; të cilat janë në dispozicion, të arritshme dhe efektive; dhe të cilat janë në gjendje të korrigjojnë drejtpërdrejt shkeljet e supozuara të Konventës (Shih, ndër të tjera, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 71-81, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, paragrafët 55-77; *Demopolous dhe të tjerët kundër Turqisë*, paragrafët

50-129; *Ocalan kundër Turqisë*, paragrafët 63-72; dhe *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, paragrafët, 155-162). Një parashtrues nuk mund të konsiderohet se nuk i ka shteruar mjetet juridike vendore nëse ai mund të tregojë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar, ishte i detyruar të dështojë. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, paragrafi 156, dhe referencat e përmendura aty).

68. Gjykata vëren se, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë argument dhe dëshmi se ka shfrytëzuar ndonjë mjet juridik ose nëse mjetet juridike ligjore në dispozicion të tij janë të papërshtatshme dhe joefektive, përmes të cilave ai do të mund të argumentonte se rregulli i shterimit të mjeteve juridike duhet të konsiderohet i plotësuar dhe hequr dorë në atë rast specifik. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI116/14, parashtrues *Fadil Selmanaj,* Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015, §§ paragrafët 45-46 dhe referencat e cituara në atë vendim). Ai thjesht ka mbajtur qëndrimin se nuk ka fare mjet juridik dhe që Gjykata Kushtetuese është i vetmi mjet juridik – qëndrim ky që, për arsyet e cekura më lart, nuk del të jetë i saktë.

69. Si përfundim, Gjykata konstaton që kërkesa është parashtruar para se parashtruesi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe, si e tillë, është e parakohshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

70. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata me sa vijon: *"Bazuar në nenin 57 pika (a), (b), (c) Vendimi për masë të përkohshme, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ne avokatët në parim po ashtu kërkojmë që ndaj këtij Urdhri të vendoset edhe masa e përkohshme."* Përveç kërkesës për masë të përkohshme, parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe 4 shkresa të tjera të cilat ai i quajti *"urgjenca"* dhe në të gjitha përsëritej nevoja, sipas tij, që Gjykata të vendos lidhur me kërkesën e tanishme në një afat sa më të shpejtë kohor.

71. Për të mbështetur kërkesën për masë të përkohshme, parashtruesi i kërkesës thekson se "*me lënien e këtij Urdhri në fuqi pasojat do jenë të paripërueshme dhe të pakorrigjueshme, që mund të hasen situata deri në eskalimit e dhunës fizike dhe verbale nga gardianët e gjykatës, të cilët janë të autorizuar të përdorin dhunën".*

72. Gjykata përsëritë konstatimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës u deklarua e papranueshme për shkak se ai ka dorëzuar një kërkesë të parakohshme dhe si rrjedhojë nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

73. Prandaj, në pajtim me konstatimet e mësipërme si dhe në pajtim me nenin 116. 2 të Kushtetutës, nenin 27. 1 të Ligjit dhe rregullin 57 (1) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa për seancë dëgjimore

74. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata të caktojë seancë dëgjimore ku do të diskutoheshin *"gojarisht dhe në tërësi"* faktet e rastit dhe ku do të argumentohej kërkesa e tij, sipas tij, e bazuar *"në ligj dhe në fakte"*.

75. Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit (2), të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, Gjykata urdhëron mbajtjen e seancës dëgjimore vetëm *"në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit"*.

76. Gjykata përsëritë konstatimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës u deklarua e papranueshme për shkak se ai nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në këtë aspekt dhe duke qenë se nuk ka asnjë çështje të provave apo të ligjit që duhet qartësuar, Gjykata e refuzon kërkesën për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 23 janar 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. TA REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI78/18 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS-së), nr. AC-I-17-0466-A001, të 12 prillit 2018

KI78/18, parashtrues Pashk Malota

Aktvendim për Papranueshmëri i datës 27 shkurt 2019

Fjalët kyqe: *Kërkesë individuale, taksë gjyqësore, qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës kontestonte kushtetutshmërinë e një Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Ky i fundit kishte konstatuar se ankesa e parashtruesit duhej të konsiderohej e tërhequr meqë ai nuk kishte paguar taksën gjyqësore prej 20 EUR.

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se një vendim i tillë i ka shkelur atij të drejtat e garantuara me nenet 21, 22, 53, 46 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, ai pretendonte se Kolegji i Apelit në kundërshtim me dispozitat ligjore e ka konsideruar ankesën e parashtruesit të tërhequr dhe gjithashtu i ka mohuar atij të drejtën e qasjes në drejtësi, përkatësisht qasjes në Gjykatë.

Duke u thirrur në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata përsëriti dhe ritheksoi se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Është në rolin e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se shuma e taksës gjyqësore për të cilën është obliguar parashtruesi, mundësitë e tij për të paguar atë si dhe rrethanat e rastit të tij në përgjithësi kanë ndikuar në të drejtën e tij për qasje në gjykatë, ashtu siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Si rrjedhojë, kërkesa e parashtruesit u refuzua si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe u deklarua e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI78/18

Parashtrues

Pashk Malota

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës
për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. AC-I-17-0466-A001, të 12 prillit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Pashk Malota nga fshati Zhdrellë, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), nr. AC-I-17-0466-A001, të 12 prillit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 qershor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

8. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga

gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

10. Më 14 shtator 2018, Gjykata informoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës, si dhe të dorëzojë autorizimin për përfaqësimin e parashtruesit para Gjykatës, brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës.

11. Më 1 tetor 2018, brenda afatit të përcaktuar, parashtruesi dorëzoi dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

12. Më 9 tetor 2018, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

13. Më 27 shkurt 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

14. Në vitet e 90-ta, parashtruesit të kërkesës iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës në ndërmarrjen shoqërore "Bec" (në tekstin e mëtejmë: Ndërmarrja shoqërore), pa pëlqimin e tij. Lidhur me anulimi e marrëdhënies së punës edhe Gjykata Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), kishte nxjerrë Aktvendimin [Nr. 125/94] të 6 shtatorit 1994.

15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozim për anulimin e aktvendimit të lartpërmendur.

16. Më 27 janar 1998, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C. nr. 242/94] e aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktvendimin [Nr. 125/94] e Gjykatës Komunale. Me atë rast, Gjykata Komunale urdhëroi ndërmarrjen shoqërore që ta kthejë parashtruesin në punë.

17. Më 18 prill 1998, ndërmarrja shoqërore paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit [C. nr. 242/94] të Gjykatës Komunale.

18. Më 9 qershor 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë [Ac. nr. 125.02] anuloi Aktgjykimin [C. nr. 242/94] e Gjykatës Komunale dhe ia ktheu çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

19. Më 18 maj 2012, Gjykata Komunale [Aktvendimi C. nr. 486/06), u deklarua jokompetente për ta vendosur rastin dhe padia iu dërgua Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar).

20. Më 21 janar 2016, Kolegji i Specializuar ia përcolli padinë dhe dokumentacionin përcjellës AKP-së.

21. Më 2 shkurt 2016, AKP-ja, si përfaqësuese e ndërmarrjes shoqërore, e dorëzoi përgjigjen në padi dhe parashtroi kërkesë për pezullimin e procedurës në këtë lëndë, pasi ndërmarrja shoqërore ishte duke iu nënshtruar procedurës së likuidimit.

22. Më 18 korrik 2017, Kolegji i Specializuar me Aktvendimin C-II-14-0036-C0001 vendosi që: procedura në lidhje me lëndën e parashtruesit të pezullohet pasi ndërmarrja shoqërore është në procedurë të likuidimit; se çdo kërkesë për rihapje të një lënde të pezulluar do të trajtohet si lëndë e re; dhe se lënda e pezulluar për shkak të likuidimit të ndërmarrjes shoqërore konsiderohet lëndë e mbyllur. Kolegji i Specializuar theksoi se parashtruesi është dashur t'i drejtohet Komisionit të Likuidimit të ndërmarrjes shoqërore, duke qenë se ky autoritet i likuidimit është i vetmi entitet që ka të drejtë të kontrollojë, të trajtojë, dhe t'ju përgjigjet padive/kërkesave në të cilat palë e paditur është ndërmarrja shoqërore në likuidim.

23. Më 2 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar [C-II.-14-0036-C0001] në Kolegjin e Apelit, duke kërkuar që të prishet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

24. Më 30 janar 2018, Dhoma e Posaçme i dërgoi parashtruesit të kërkesës vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 20 (njëzet) euro.

25. Më 12 prill 2018, Kolegji i Apelit, me Aktvendimin nr. AC-I-17-0466-A0001, konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar [C-II.-14-0036-C0001] konsiderohet e tërhequr pasi parashtruesi i kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore. Kolegji i Apelit, ndër të tjera, arsyetoi:

> *"Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), përcaktimi i taksës gjyqësore për t'u paguar në kohën kur është paraqitur kërkesa, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e kërkesës.*

Neni 2.4 i UA-së e përcakton se shprehja 'kërkesë' përdoret për padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për ekzekutim. Ky udhëzim administrativ, i aplikueshëm prej 1 majit 2017 për unifikimin e taksave gjyqësore të DHPGJS-së, përcakton që ankuesi duhet të paguajë shumën fikse prej 20 euro kur e parashtron ankesën.

Pasi që ankuesi [parashtruesi i kërkesës] nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai, përmes njoftimit (vërejtjes) së datës 30 janar 2018, e cila iu është dorëzuar përfaqësuesit të ankuesit më 31 janar 2018, dhe ai nuk ka paraqitur kërkesë për t'u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa është tërhequr".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit me Aktvendimin [AC-I-17-0466-A0001], i ka shkelur atij të drejtat e garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore] të Kushtetutës si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

27. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon aplikim të gabuar të legjislacionit nga Kolegji i Apelit, duke theksuar se kërkesa e Kolegjit të Apelit qe afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve që të paguajë taksën gjyqësore në lidhje me ankesën e parashtruar në Kolegjin e Apelit është e paligjshme pasi gabimisht është interpretuar Udhëzimi Administrativ nr. 1/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili [në nenin 5.5.1 dhe 5.5.2] parasheh: *"nëse taksa për parashtresë nuk paguhet deri në datën përfundimtare sipas këtij neni dhe kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin nga detyrimi për pagesën e saj, gjykata do të hedh poshtë parashtresën, me përjashtim të parashtresave lidhur me mjetet e goditjes".* Lidhur me këtë, parashtruesi pretendon se atij iu është shkelur e drejta për "qasje në drejtësi" e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së".

28. Sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës për mbrojte të pronës, parashtruesi i kërkesës i referohet çështjes së kthimit të pronave në Kosovë, duke pohuar se ato duhet t'i kthehen ish-pronarëve. Ai pohon se "*Gjykata duhet të ketë parasysh Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës [Pakon Ahtisaari] dhe në veçanti nenit*

8.6 që përcakton, ndër të tjera, se "Kosova do t'i trajtojë me prioritet të gjitha çështjet e kthimit të pronave [...], siç parashihet me Aneksin VII" të Pakos Ahtisaari.

29. Sipas parashtruesit të kërkesës, Pakoja Ahtisaari kërkon po ashtu që Kuvendi i Kosovës të miratojë, ndër të tjera "*Ligjin për Kthimin e Pronës"*. Ai pohon, se sipas nenit 1.1 të Kushtetutës*, "Kushtetuta në të gjitha dispozitat e saj duhet të jetë në përputhje me Pakon Ahtisaari dhe duhet të interpretohet në pajtim me Pakon Ahtisaari*". Gjithashtu, ai i referohet nenit 46 të Kushtetutës që garanton mbrojtjen e pronës duke specifikuar më tej se, fakti që nuk është nxjerrë ende një ligj për kthimin e pronave përbën shkelje të Kushtetutës dhe të Pakos Ahtisaari dhe mohon kështu të drejtën e kthimit të pronës të garantuar me KEDNJ.

30. Lidhur me këtë pikë, parashtruesi thekson se *"kthimi i pronës"* është e drejtë themelore e garantuar me KEDNJ dhe marrë parasysh nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet t'i interpretojë të drejtat e tij në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: GJEDNJ).

31. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që t'i anulojë dhe t'i deklarojë jokushtetues Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar [C-II.-14-0036-C0001] dhe Aktvendimin e Kolegjit të Apelit [AC-I-17-0466-A0001].

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

34. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]".*

35. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën si individ dhe si palë e autorizuar, kërkesën e ka parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

36. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

37. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit (2), të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon se Kolegji i Apelit [Aktvendimi nr. AC-I-17-0466-A0001] ia ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në lidhje me këtë, ai pretendon se Kolegji i Apelit në kundërshtim me dispozitat ligjore e ka konsideruar ankesën e parashtruesit të tërhequr dhe gjithashtu i ka mohuar atij të drejtën e qasjes në drejtësi, përkatësisht qasjes në Gjykatë.

39. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të paraqitura në kërkesën e tanishme, Gjykata vëren se ato janë pothuajse identike me pretendimet e ngritura në kërkesën KI62/18, për të cilën Gjykata tashmë ka vendosur. Edhe faktet e rastit e edhe procedurat e zhvilluara pranë autoriteteve publike janë pothuajse identike me ato në rastin e tanishëm. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 shtatorit 2018, paragrafët 22-28 për sa i takon pretendimeve dhe paragrafët 36-49 për sa i takon arsyetimit të Gjykatës).

40. Në këtë drejtim, sikurse në rastin KI62/18, Gjykata përsëritë dhe rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28; shih po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, cituar më lart).

41. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt". (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012 dhe KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, cituar më lart).

42. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Kolegji i Apelit konsideroi ankesën e tij të tërhequr thjeshtë për arsye procedurale dhe nuk trajtoi fare ankesën e parashtruesit kundër Kolegjit të Specializuar në përmbajtje, pasi që ai përkundër vërejtjes së dërguar nga Kolegji i Apelit nuk e kishte paguar taksën gjyqësore të paraparë në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që përcakton se për *"ankesat e ish-punëtorëve kundër vendimeve të shkallës së parë lidhur me pagat e papaguara nga ana e ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë në proces të privatizimit/likuidimit* [taksa gjyqësore është] *20 Euro"*.

43. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i ka vlerësuar dhe interpretuar dispozitat ligjore në lidhje me taksën gjyqësore dhe vendimin e tij e kishte arsyetuar duke u bazuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore, dhe në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këtë aspekt, Kolegji i Apelit kishte arsyetuar se parashtruesi i kërkesës *"nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai, përmes njoftimit (vërejtjes) së datës 30 janar 2018, e cila iu është dorëzuar përfaqësuesi të ankuesit më 31 janar 2018"* dhe, për më tepër *"nuk ka paraqitur kërkesë për t'u liruar nga taksa gjyqësore"*.

44. Gjykata konsideron se përfundimet e Kolegjit të Apelit janë arritur pas një shqyrtimi të dispozitave relevante në lidhje me taksat gjyqësore dhe faktit që parashtruesi i kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore dhe nuk kishte bërë kërkesë për lirim nga kjo pagesë.

45. Të gjitha çështjet, të cilat ishin relevante për vendosjen në lidhje me mospagesën e taksës gjyqësore nga parashtruesi i kërkesës, ishin shqyrtuar siç duhet nga Kolegji i Apelit. Të gjitha arsyet materiale dhe ligjore që lidhen me vendimin e kontestuar u analizuan dhe si rrjedhojë, Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre ishin të drejta. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, cituar më lart).

46. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës së saj për qasje në gjykatë si rezultat i kërkesës së Kolegjit të Apelit për pagesën e taksës gjyqësore, Gjykata rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, kërkesa për të paguar taksë gjyqësore për çështje civile në lidhje me paditë apo ankesat, për të cilat gjykatat duhet të vendosin, nuk mund të konsiderohet si kufizim i të drejtës për qasje në gjykatë që është e papajtueshme, *per se*, me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 30 nëntorit 2005, *Podbielski dhe PPU Polpure kundër Polonisë,* nr. 39199/98, paragrafi 64).

47. Andaj, shuma e taksës gjyqësore e vlerësuar nën dritën e rrethanave të rastit të caktuar, duke përfshirë mundësinë e parashtruesve për ta paguar atë dhe faza e procedurës në të cilën taksa gjyqësore është vendosur, janë faktor që duhet të merren parasysh kur të vendoset nëse personit i është respektuar e drejta për qasje në gjykatë. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Podbielski dhe PPU Polpure kundër Polonisë,* nr. 39199/98, të 30 nëntorit 2005, paragrafi 64).

48. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se shuma e taksës gjyqësore për të cilën është obliguar parashtruesi, mundësitë e tij për të paguar atë si dhe rrethanat e rastit të tij në përgjithësi kanë ndikuar në të drejtën e tij për qasje në gjykatë, ashtu siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, parashtruesi përkundër vërejtjes së dërguar nga Kolegji i Apelit as nuk kishte paraqitur kërkesë për lirimin nga taksa gjyqësore, ashtu siç ishte paraparë me kornizën ligjore në fuqi. Përkitazi me shkeljet e

pretenduara të parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutë dhe të drejtën e kthimit të pronës për ish-pronarët, përkatësisht kërkesës së parashtruesit për nxjerrjen e një ligji për kthimin e pronave, përveç referencave në Kushtetutë, nuk paraqet ndonjë fakt apo dëshmi se si këto dispozita janë relevante për rastin e tij.

49. Gjithsesi, Gjykata e sheh të nevojshme të sqarojë çështjen e kthimit të pronës në dritë të pretendimeve të përgjithshme të parashtruesit si dhe ekskluzivisht në linjë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në këtë aspekt. Rrjedhimisht, për sa i takon pretendimit të parashtruesit se *"kthimi i pronës është e drejtë fondamentale e garantuar me KEDNJ"*, përkatësisht nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata në vazhdim do t'i referohet vendimeve kryesore të GJEDNJ-së në të cilat është diskutuar çështja e kthimit të pronës, aplikueshmëria e garancive të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në aspekt të kthimit të pronës, dhe obligimet që Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtejmë: Shtetet Kontraktuese) kanë në këtë drejtim. (Shih, mes autoriteteve tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 4 marsit 2003, *Jantner kundër Sllovakisë*, nr. 39050/97, paragrafi 34; Aktgjykimin e GJEDNJ-së [DHM], të 10 korrik 2002, *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr. 39794/98, paragrafët 70-74.)

50. Gjykata vëren se në vendimet e lartpërmendura të GJEDNJ-së, në paragrafët specifik të cituar më lart, *inter alia*, thuhet që neni 1 i Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së nuk mund të interpretohet sikur imponon obligime të përgjithshme mbi Shtetet Kontraktuese që të rikthejnë pronën e cila iu është transferuar atyre para se të ratifikonin KEDNJ-në. Ky është parimi i parë bazë. Ky nen po ashtu nuk mund të interpretohet ashtu që i njëjti i kufizon lirinë e Shteteve Kontraktuese të determinojnë fushëveprimin e kthimit të pronës apo zgjedhjen e kushteve nën të cilat do të bëhet rikthimi i pronës tek ish-pronarët e tyre. Ky është parimi i dytë bazë. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Jantner kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 34).

51. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së më tutje tregon që, në veçanti, Shtetet Kontraktuese gëzojnë një "hapësirë të gjerë vlerësimi" ("*wide margin of appreciation*") në lidhje me përjashtimin e disa kategorive të ish-pronarëve nga një e drejtë e tillë. Aty ku kategoritë e caktuara të pronarëve janë përjashtuar në këtë mënyrë, kërkesat e tyre për kthim nuk mund të konsiderohet se përbëjnë një "pritje legjitime" ("*legitimate expectation*") që tërheq/zgjon kështu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ky është parimi i tretë i rëndësishëm. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së [DHM], të 10 korrikut 2002,

Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke, nr. 39794/98, paragrafët 70-74). Në anën tjetër, si parim i katërt bazë, është e rëndësishme të potencohet që, në momentin që një Shtet Kontraktues i cili e ka ratifikuar KEDNJ-në, përfshirë dhe Protokollin nr. 1, e nxjerr një ligj në bazë të të cilit parasheh kthim të tërësishëm apo të pjesshëm të pronës së konfiskuar nga një regjim i kaluar, atëherë legjislacioni i tillë konsiderohet si legjislacion i cili gjeneron një të drejtë të re pronësie e cila mbrohet, në këtë rast, nga nenin 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për të gjithë ata persona të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me atë ligj. (Shih vendimet e GJEDNJ-së të cituara më lart).

52. Pra, si konkluzion, Gjykata vëren se KEDNJ dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së: (i) nuk i obligon Shtetet Kontraktuese që të nxjerrin një Ligj për kthimin e pronës; (ii) iu lejon Shteteve Kontraktuese liri të konsiderueshme në vendosjen dhe determinimin e fushëveprimit të kthimit të pronës dhe zgjedhjen e kushteve të aplikueshme për një gjë të tillë; (iii) iu mundëson Shteteve Kontraktuese të përcaktojnë dhe/ose përjashtojnë kategori të caktuara nga e drejta për kthim të pronës; dhe (iv) i obligon Shtetet Kontraktuese që, në rastet kur vet kanë vendosur që të nxjerrin ligj për kthimin e pronës, të respektojnë të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 1 të Protokolli nr. 1 të KEDNJ-së meqë në raste të tilla mbrojtja nga ky nen është e drejtë e garantuar me KEDNJ. Këto janë katër parimet e përgjithshme lidhur me çështjen e "kthimit të pronës", në bazë të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, tashmë të konsoliduar në këtë drejtim.

53. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në Republikën e Kosovës nuk ka një ligj të veçantë për kthim të pronave dhe si rrjedhojë kërkesat për kthim të pronave nuk mund të bazohen në garancitë që i ofron neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së apo, *mutatis mutandis*, në garancitë e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Kjo, siç u shpjegua më lart, për arsyen e vetme që kërkesat për kthim të pronave nuk mund të konsiderohen se përbëjnë një "pritje legjitime" përderisa nuk ekziston një ligj për kthim të pronave.

54. Po ashtu, përkitazi me shkeljet e tjera të pretenduara të parashtruesit të kërkesës në lidhje me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore], Gjykata vëren se përveç referencave në dispozitat e Kushtetutës, parashtruesi nuk paraqet ndonjë fakt apo dëshmi se si atij i janë shkelur këto të drejta nga Kolegji i Apelit.

55. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes pretendimet në mënyrë të arsyetuar dhe me argumente bindëse. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI136/14, parashtrues *Abdullah Bajqinca,* Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

Përmbledhje

56. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat para Kolegjit të Apelit kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës.

57. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 27 shkurt 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Arta Rama-Hajrizi

KI59/18 Parashtrues i kërkesës: Strahinja Spasić, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme AA–UŽ. nr. 58/2017, të 1 dhjetorit 2017

KI59/18, aktvendim për papranueshmëri i 27 marsit 2019, publikuar më 15 prill 2019

Fjalët kyç: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i paafatshëm.

Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 dhe rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

Më 22 tetor 2017, në Republikën e Kosovës u mbajtën zgjedhjet për organet vetëqeverisëse lokale. Parashtruesi i kërkesës ishte kandidat i Listës Serbe për Kryetar të Komunës së Kllokotit.

Pas raundit të parë të zgjedhjeve, parashtruesi i kërkesës dhe një kandidat tjetër shkuan në raundin e dytë. Pas raundit të dytë të zgjedhjeve, parashtruesi paraqiti ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP) me pretendime se kishte pasur parregullsi në procesin zgjedhor.

Pas shqyrtimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe të gjitha provave relevante, PZAP e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, ky vendim i PZAP u pranua plotësisht dhe u mbështet nga Gjykata Supreme. Pas kësaj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet e zgjedhjeve sipas të cilave parashtruesi i kërkesës nuk fitoi numrin më të madh të votave. Kundër këtij vendimi të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve, parashtruesi parashtroi ankesë në PZAP me pretendime identike, si dhe në ankesën e parë. PZAP e refuzoi këtë ankesë të parashtruesit si të palejuar dhe *res judicata* sepse tashmë ishte vendosur për këtë çështje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më pas shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, duke konfirmuar rezultatet paraprake të zgjedhjeve.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se PZAP dhe Gjykata Supreme kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Gjykata vëren se Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2017, nxori Aktvendimin përfundimtar AA. UŽ. nr. 58/2017 lidhur me ankesën [1112], të cilën parashtruesi i kërkesës e inicioi para PZAP-it.

Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës më pas parashtroi përsëri ankesë [1127] në PZAP, me pretendimet identike në lidhje me Vendimin [nr. 2470-2017] e KQZ-së, të 7 dhjetorit 2017. PZAP-i, pas shqyrtimit të kësaj ankese të parashtruesit të kërkesës, nxori Vendimin ZL. A. nr. 1127/2017, të 8 dhjetorit 2017, në të cilin theksoi se këto pretendime të parashtruesit i kishte shqyrtuar dhe arsyetuar në vendimin e mëparshëm, dhe rrjedhimisht për këtë çështje tashmë është vendosur dhe për këtë arsye kjo ankesë e parashtruesit është e palejuar.

Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konsideron se vendimi përfundimtar në kërkesën e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme AA. UŽ. nr. 58/2017, i 1 dhjetorit 2017. Prandaj, afati kohor fillon të ecë prej 1 dhjetorit 2017, që është data kur aktvendimi i lartpërmendur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij më 12 prill 2018. Periudha 4 (katër) mujore për parashtrimin e kërkesës ka skaduar më 1 prill 2018.

Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 59/18

Parashtrues

Strahinja Spasić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme AA–UŽ. nr. 58/2017, të 1 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesën e dorëzoi Strahinja Spasić nga Kllokoti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, AA–UŽ. nr. 58/2017, të 1 dhjetorit 2017, në lidhje me Vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), ZL. Anr. 1127/2017,të 8 dhjetorit 2017 dhe Vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor (në tekstin e mëtejmë: KQZ), nr. 2585-2017, të 14 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme],nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 prill 2018, parashtruesi nëpërmjet postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 18 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 30 prill 2018, Gjykata informoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dorëzua PZAP-it, Gjykatës Supreme dhe KQZ-së, ku ju dha mundësia për të paraqitur komentet e tyre për pretendimet e ngritura në kërkesën nr. KI59/18.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 18 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë në të cilat më detajisht precizoi kërkesën e tij.

11. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

12. Më 22 gusht 2018, Kryetarja nxori Vendimin për caktimin e gjyqtares Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese në vend të gjyqtares Snezhana Botusharova.

13. Më 1 shkurt 2019, Gjykata njoftoi subjektin politik Lista Serbe (në tekstin e mëtejmë: Lista Serbe) për regjistrimin e kërkesës. Gjykata u dërgoi një kopje të kërkesës dhe kërkoi nga ata që brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga data e pranimit të këtij njoftimi të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën. Lista Serbe nuk dorëzoi komente në lidhje me këtë kërkesë.

14. Më 5 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci.

15. Më 19 shkurt 2019, gjyqtari Bajram Ljatifi kishte kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës që të përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës nr. KI59/18, sepse më herët kishte qenë pjesë e vendimmarrjes për të njëjtën kërkesë përkitazi me procedurat e zhvilluara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ).

16. Më 25 shkurt 2019, Kryetarja, në pajtim me nenin 18.1 (1.3) të Ligjit dhe me rregullin (9) të Rregullores së punës, nxori vendim nëpërmjet të cilit u aprovua kërkesa për përjashtim nga procesi i shqyrtimit dhe i vendimmarjes lidhur me rastin KI59/18.

17. Më 27 mars 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 22 tetor 2017, në Republikën e Kosovës u mbajtën zgjedhjet për organet vetëqeverisëse lokale. Parashtruesi i kërkesës ishte kandidat i Listës Serbe për Kryetarin e Komunës së Kllokotit.

19. Në raundin e parë të zgjedhjeve për organet vetëqeverisëse lokale, asnjëri prej kandidatëve për Kryetarin e Komunës së Kllokotit nuk ka

fituar më shumë se 50% plus 1 (një) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë, siç është përcaktuar në nenin 9.5 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (nr. 03/L-072).

20. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Kllokotit, ku kandidatë ishin parashtruesi i kërkesës, kandidat i Listës Serbe dhe Božidar Dejanović, kandidat i Iniciativës Qytetare Kllokot-Vërbovc.

21. Më 24 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë [nr.1112] në PZAP, duke kërkuar që të anulohet raundi i dytë i zgjedhjeve lokale për Kryetarin e Komunës së Kllokotit, i mbajtur më 19 nëntor 2017, duke pretenduar se ka pasur parregullsi në rinumërimin e votave të pranuara përmes postës.

22. Më 26 nëntor 2017, Lista Serbe e njoftoi PZAP-in që po tërhiqet nga procedura ankimore, ndërsa parashtruesi i kërkesës mbeti pranë ankesës së tij.

23. Më 27 nëntor 2017, PZAP-i [me Vendimin ZL. A. nr. 1112/2017]e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. PZAP-i vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk arriti që në mënyrë të sigurt dhe bindëse t'i vërtetojë pretendimet nga ankesa në lidhje me parregullsitë në rinumërimin e votave të dërguara përmes postës.

24. Pjesa relevante e vendimit të lartcekur të PZAP-it, përcakton: *"Nga hetimet të cilat i ka kryer ekipi hetues i PZAP-it, në kutinë e votimit BM 137/001, është konstatuar se në kuti gjendeshin 19 pliko të hapura. Këto pliko kanë qenë të tri llojeve të ndryshme, prej të cilave 11 të tipit të njëjtë, 5 të një tipi tjetër të njëjtë si dhe 3 të tipit tjetër të njëjtë. Në kuti ishin 19 fletëvotime, dhe të gjitha fletëvotimet ishin të shënuara me laps kimik dhe me shenjën (√), dhe nuk ishin të kopjuar, të shënuar për Božidar Dejanović-in, kandidatin e subjektit politik IQ Kllokot – Vërbovc, derisa kandidati Strahinja Spasić nga radhët e subjektit politik Lista Serbe nuk e kishte asnjë votë".*

25. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartcekur të PZAP-it, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa të miratohet, ndërsa Vendimi i PZAP-it të anulohet.

26. Më 1 dhjetor 2017, Gjykata Supreme me Aktvendimin AA–UŽ. nr. 58/2017e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Gjykata Supreme vërtetoi se gjendja faktike është vërtetuar drejtë, si dhe që nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të kërkesës.

27. Në pjesën relevante të arsyetimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme theksohet: *"PZAP gjatë vendimmarrjes ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante dhe në bazë të kësaj i ka zbatuar dispozitat e ligjit, sidomos kur merret parasysh se në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk arriti t'i vërtetojë pretendimet e veta me prova relevante dhe të bindshme. Deklaratat e dëshmitarëve të bashkangjitura në ankesë, kjo Gjykatë i konsideron jo relevante dhe nuk mund të kenë ndikim në vendimmarrje ndryshe, duke marrë parasysh se deklaratat e tilla mund të jenë të kundërta me vullnetin e votuesve, e që është vërtetuar gjatë kontrollit të fletëvotimeve nga ana e PZAP-it"*.

28. Më 7 dhjetor 2017, KQZ-ja, me Vendimin nr. 2470-2017, shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë të votimit në zgjedhjet lokale për Kryetarin e Komunës së Kllokotit.

29. Parashtruesi i kërkesës kundër Vendimit të KQZ-së [nr. 2470-2017] paraqiti ankesë [nr. 1127]në PZAP, duke pretenduar se ka pasur parregullsi në rinumërimin e votave të pranuara përmes postës.

30. Më 8 dhjetor 2017, PZAP-i me Vendimin ZL. A. nr. 1127/2017, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetim se PZAP-iu përgjigj ndaj këtyre pretendimeve të parashtruesit me Vendimin [ZL. A. nr. 1112/2017]e 27 nëntorit2017, dhe rrjedhimisht, PZAP-i konkludoi se për këtë çështje tashmë është vendosur (*res judicata*) dhe se kjo ankesë duhet të refuzohet si e palejuar.

31. Më 14 dhjetor 2017, KQZ-ja, me Vendimin nr. 2585-2017, certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë të votimit në zgjedhjet lokale për Kryetarin e Komunës së Kllokotit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme],nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike],nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

33. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *"Me mosrespektimin e rregullave pozitive nga ana e PZAP-it, me presionet që kam pasur nga Zyra për*

Kosovën dhe Metohinë të tërhiqem nga kandidatura, si dhe me presionet e medias, më është shkelur e drejta kushtetuese sipas nenit 21 (Të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore).”

34. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“PZAP, si organi i shkallës së parë, jo vetëm që nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të ankuesit, por ankesën e ka shpallur si të palejueshme dhe po ashtu nuk është lejuar as ankesa në organin e shkallës së dytë, me çka është shkelur neni 32 i Kushtetutës së Kosovës (E drejta për mjete juridike)”.*

35. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 45 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Duke manipuluar dhe abuzuar me 19 votat e marra përmes postës nga lista e veçantë e votuesve për votim jashtë Kosovës nga Zyra për Kosovë e Metohi në Beograd, mua po me merret një fitore zgjedhore dhe fiton me vota të manipuluara kandidati sipas vullnetit të Zyrës në Beograd”.*

36. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“PZAP-ja me procedurë nuk e ka respektuar Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe të Përgjithshme, as rregullat zgjedhore në të cilat në mënyrë të qartë është rregulluar mënyra e raportimit dhe votimit të votuesve nga lista e veçantë zgjedhore e Kosovës, por në të njëjtën ditë kur është dorëzuar ankesa e ankuesit nxori Vendimin e pakuptuar nr. ZL. Anr. 1127/2017, të 08.12.2017, si të palejuar, pa të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës si organ i shkallës së dytë”.*

37. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

> *“-Që të anulohen fletëvotimet e arritura nëpërmes të postës nga lista e posaçme për votim jashtë Kosovës.*
> *-Që të prishet vendimi i KQZ-së nr. 2470/2017 të dt. 07.12.2017, mbi publikimin e rezultateve përfundimtare, vendimi i PZAP-it ZL. A. nr. 1127/2017 të dt. 08.12.2017 dhe vendimi i KQZ-së nr. 2585/2017 të dt. 14.12.2017 mbi konfirmimin e rezultatit përfundimtar të raundit të dytë për Komunën e Kllokotit.*
> *-Që të ngarkojë PAZP-in dhe KQZ-në ta ndryshojnë vendimin mbi konfirmimin e rezultateve përfundimtare në favor të ankuesit”.*

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji nr. 003/L-073

Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

i 5 qershorit 2008

[...]

Kreu XX

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

[...]

Neni 118
Vendimet

118.1 KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

118.2 KZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. KZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej dy (2) ditëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera KZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve të punës.

18.3 Vendimet e KZAP-it publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e KZAP-it.

118.4 Mund të apelohet vendimi i KZAP-it, sikurse që KZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës pranohet në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme u jep përparësi këtyre apeleve.

118.5 Vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar sipas këtij ligji ose Kushtetutës parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe gjykata më e lartë përcakton ndryshe.

Rregulli nr. 02/2015

Rregullat dhe procedurat Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa i 4 dhjetorit 2015

[...]

Neni 6 Shqyrtimi i ankesave

6.1 Çdo ankesë e pranuar në PZAP do të regjistrohet me numër të protokollit dhe do të jetë pjesë e lëndës dhe e regjistrit të përhershëm të PZAP-it.

6.2 Deri në marrjen e vendimit kryesor, për shqyrtimin e ankesës palët mund ta tërheqin ankesën e parashtruar.

6.3 Ankesa e cila nuk i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 5.7 të këtyre rregullave, i kthehet palës ankuese në përmirësim dhe plotësim në afat prej njëzetekatër (24) orëve. Do të konsiderohet si e tërhequr ankesa po që se nuk i kthehet PZAP-it brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, ankesa do të hidhet poshtë.

6.4 Ankesat të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim.

6.5 PZAP-i, me vendim aprovon-refuzon ankesat në përputhje me dispozitat ligjore.

6.6 Në rastet kur PZAP-i konsideron se ankesa është e rregullt, pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa do të njoftohet dhe do t'i sugjerohet se ka të drejtë të përgjigjet në ankesë në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i pranimit të ankesës së bashku me provat.

6.7 Pala e cila është njoftuar nga PZAP-i se është bërë ankesë ndaj saj, e njëjta mund të ndërmarrë masa përmirësuese brenda afatit të caktuar nga PZAP-i prej njëzetekatër (24) orëve nga pranimi i urdhrit për përmirësim.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit113, paragrafëve 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

„(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
„(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

40. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

41. Sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vërteton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila e konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Vendimin e PZAP-it, ZL. A. nr. 1127/2017, parashtruesi i kërkesës gjithashtu qartësoi saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon të janë shkelur në pajtim me kriteret nga neni 48 të Ligjit.

42. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...].

43. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

"[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit [...].

44. Në fillim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2017, nxori Aktvendimin përfundimtar AA. UŽ. nr. 58/2017 lidhur me ankesën [1112],të cilën parashtruesi i kërkesës e inicioi para PZAP-it.

45. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës më pas paraqiti përsëri ankesën [1127] në PZAP, me pretendimet identike në lidhje me Vendimin [nr. 2470-2017] e KQZ-së, të 7 dhjetorit 2017. PZAP-i, pas shqyrtimit të kësaj ankese të parashtruesit të kërkesës, nxori Vendimin ZL. A. nr. 1127/2017, të 8 dhjetorit 2017, në të cilin theksoi se këto pretendime të parashtruesit i kishte shqyrtuar dhe arsyetuar në vendimin e mëparshëm, dhe rrjedhimisht për këtë çështje tashmë është vendosur dhe për këtë arsye kjo ankesë e parashtruesit është e palejuar.

46. Pas kësaj, KQZ-ja, me Vendimin nr. 2585-2017, të 14 dhjetorit, certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale të vitit 2017 për Kryetarin e Komunës së Kllokotit.

47. Për më tepër, Gjykata rikujton se ankesën e parashtruesit PZAP-ja e ka refuzuar si të palejuar, sepse nuk ishte dorëzuar në pajtim me nenin118.1të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, i cili përcakton: "*KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*".

48. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës tentoi t'i shfrytëzojë mjetet juridike për të cilat kishte njohuri, ose është dashur të ketë njohuri, se ato mjete juridike në këtë rast nuk janë të parapara me ligj dhe rrjedhimisht nuk kanë qenë të lejueshme.

49. Gjykata rithekson se "*mund të merren parasysh vetëm ato mjete të cilat janë efektive, pasi që parashtruesit nuk mund të zgjasin afatin kohor strikt të cilin e imponon Konventa, duke u përpjekur të ushtrojnë kërkesa të papërshtatshme apo të dërguara gabimisht në organet apo institucionet të cilat nuk kanë mundësi për të ofruar mjetin juridik efektiv për ankesën e dhënë*". Shih: *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), rasti *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 14881/04, Vendim për pranueshmëri i 5 janarit 2006.

50. Gjykata rikujton se afati 4 (katër) mujor fillon të ecë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar. Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Paul dhe Audrey Edwards kundër MB,* kërkesa nr. 46477/99, Aktgjykim i 14 marsit 2002.

51. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se periudha4 (katër) mujore fillon të ecë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar i cili është rezultat i shterjes së mjeteve juridike të cilat janë adekuate dhe efektive në lidhje me rastin i cili është objekt i ankesës. Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Norkin kundër Rusisë*, kërkesa nr. 20156/11, Vendim për pranueshmëri, i 5shkurtit 2013; shih, gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI201/13, parashtruese e kërkesës: *Sofa Gjonbalaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 prillit 2014, paragrafi 32.

52. Gjykata rikujton se *„në qoftë se asnjë mjet juridik nuk është i disponueshëm apo nëse vlerësohet se ato janë joefektive*“, afati kohor 4 (katër) mujor i paraparë me nenin 49 të Ligjit në parim ecë nga data e dorëzimit të aktit i cili është objekt i ankesës. Shih: rastin e GJEDNJ-së, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë,* kërkesa nr. 38587/97, vendim i 29 janarit 2002.

53. Gjykata, më tej, rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4(katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike, duke siguruar se rastet që ngrenë çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda një afati të arsyeshëm dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin e GJEDNJ-së, *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 23274/04, Vendim për pranueshmëri, i 25 gushtit 2005).

54. Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konsideron se vendimi përfundimtar në kërkesën e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, AA. UŽ. nr. 58/2017, i 1 dhjetorit 2017. Prandaj, afati kohor fillon të ecë prej1 dhjetorit 2017, që është data kur aktvendimi i lartpërmendur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij më 12 prill 2018. Periudha 4(katër) mujore për parashtrimin e kërkesës ka skaduar më 1 prill 2018.

55. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

56. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe të rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 27 mars 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama Hajrizi

KI113/17, Parashtrues: X, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 13/2017, të 4 gushtit 2017

KI113/17, Aktvendim, kërkesë e papranueshme, publikuar më 23 prill 2019

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtat e fëmijëve, qartazi e pabazuar*

Më 29 qershor 2011, parashtruesi është kthyer nga autoritetet suedeze në Kosovë, pasi që kishte kaluar rreth 1 (një) vit në përpjekje për të përfituar nga statusi i refugjatit atje.

Pas kthimit parashtruesi kishte paraqitur kërkesë tek autoritet e Komunës ku jetonte dhe ato të nivelit qendror për të realizuar përfitimet nga statusi i të riatdhesuarit dhe, njëkohësisht ka kërkuar edhe ndërtimin e një shtëpie banimi.

Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror për Riintegrim (KQR) dhe më 22 korrik 2014, Komisioni i Ankesave për Riintegrim, si organ i shkallës së dytë kanë refuzuar kërkesën e parashtruesit.

Parashtruesi i pakënaqur me vendimet administrative të komisioneve të MPB-së ka iniciuar me padi procesin e konfliktit administrativ dhe më 24 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin A. nr. 1643/2014, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, ndërsa më 31 maj 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA. nr. 91/2017, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Parashtruesit iu refuzuan edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike: kërkesa për revizion nga Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. A. (U) nr. 13/2017, e 4 gushtit 2017, e cila u hodh poshtë si e palejuar si dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, e cila me njoftimin KMLA. nr. 12/17, të 15 shtatorit 2017, u shpall e pabazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, Gjykata nuk gjeti se vendimet e kontestuara, as ato administrative dhe as ato të gjykatave të rregullta, nuk janë tregues i shkeljeve kushtetuese, andaj në përputhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesën e shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI113/17

Parashtrues

X

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 13/2017, të 4 gushtit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga X, nga Podujeva (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 13/2017, të 4 gushtit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 22.1 të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] lidhur me nenin 25.1 të Deklaratës Universale të të

Drejtave të Njeriut si dhe nenin 50.4 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës.

4. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që të mos i zbulohet identiteti për shkak të gjendjes së tij materiale dhe "*turpit që do të ndiente tek rrethi ku ai jeton*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 22 shtator 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 22 shtator 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 2 tetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

11. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj:
Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

12. Më 18 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues, ku gjyqtare raportuese u caktua Remzije Istrefi-Peci, ndërsa në kolegj u caktuan gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).

13. Më 13 mars 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 5 qershor 2010, parashtruesi ka shkuar në Suedi, me familje.

15. Më 29 qershor 2011, parashtruesi është kthyer nga autoritetet suedeze në Kosovë.

16. Më 29 qershor 2011 e deri më 1 shkurt 2013, parashtruesi ka jetuar në shtëpinë e vëllait të tij në një dhomë banimi.

17. Më 18 maj 2012, parashtruesi pohon se ka paraqitur një kërkesë në Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) të Komunës së Podujevës për ndërtimin e shtëpisë dhe ndihmë urgjente për strehim, për shkak të kushteve të rënda të jetesës dhe pamundësisë që ai vetë ta zgjedhë çështjen e banimit për të dhe familjen e tij.

18. Më 18 maj 2012, po të njëjtën ditë, ZKKK-Podujevë zyrtarisht kishte dërguar kërkesën e parashtruesit në Bordin Ekzekutiv për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (DRPR i MPB-së), ku potencohej se parashtruesi ka kërkuar "*strehim, pako ushqimore dhe pastaj ndërtimin e shtëpisë*".

19. Parashtruesi pohon se ai personalisht lidhur me këtë kërkesë nuk ka pranuar asnjë vendim dhe as ZKKK-Podujevë nuk e ka lajmëruar të jetë marrë ndonjë përgjigje.

20. Më 1 shkurt 2013, parashtruesi është akomoduar në banesë me qira nga ana e DRPR i MPB-së. Kontrata për akomodim ka skaduar në fund të muajit korrik 2014.

21. Më 18 korrik 2014, Kryetari i Komunës së Podujevës nxjerr vendim me të cilin parashtruesit i miratohet kërkesa për përfitim nga Programi për Riintegrim, për vazhdimin e strehimit edhe për 6 (gjashtë) muaj.

22. Më 30 korrik 2014, DRPR i MPB-së, me shkresë i drejtohet Komisionit Komunal për Riintegrim në Komunën e Podujevës me të cilën konstaton se parashtruesi ... *[" X i ka kaluar të gjitha afatet kohore të parapara për banim përmes qerasë" ...] dhe ..."Kërkon që ky vendim të rishqyrtohet nga Komisioni Komunal për Riintegrim, dhe të vendoset për këtë rast sipas Rregullores 20/2013 të nenit 7 pika 5" ...].*

23. Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror për Riintegrim (KQR), nxjerr vendim me të cilin parashtruesit i refuzohet kërkesa për ndërtim shtëpie, sipas kërkesës së parashtruar, nga Komuna e Podujevës.

24. Më 27 qershor 2014, parashtruesi ka ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave kundër vendimit të Komisionit Qendror për Riintegrim.

25. Më 22 korrik 2014, Komisioni i Ankesave për Riintegrim, si organ i shkallës së dytë, nxjerr vendim me të cilin refuzon ankesën e parashtruesit dhe e lë në fuqi vendimin e Komisionit të shkallës së parë.

26. Më 21 gusht 2014, parashtruesi ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në procedurën e konfliktit administrativ për shkak të: 1. Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; 2. Zbatimit të gabuar të së drejtës procedurale; dhe 3. Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

27. Më 12 janar 2015, Ministria e Drejtësisë, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqiti përgjigje në padi.

28. Më 24 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A. nr. 1643/2014, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit.

29. Më 7 shkurt 2017, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: shkeljes së dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

30. Më 31 maj 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA. nr. 91/2017, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

31. Më 14 korrik 2017, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke kërkuar rishikimin e të gjitha vendimeve që kanë të bëjnë me çështjen juridike ku ai është palë në procedurë.

32. Më 4 gusht 2017, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. A. (U) nr. 13/2017, me të cilin hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për revizionin e parashtruesit.

33. Më 12 shtator 2017, parashtruesi përmes Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

34. Më 15 shtator 2017, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me njoftimin KMLA. nr. 12/17, i ka bërë të ditur parashtruesit "*se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë",* andaj nuk ka aprovuar propozimin e tij për paraqitjen e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me vendimet e kontestuara atij i janë shkelur nenet 22.1 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 50.4 [të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës dhe neni 25 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut por pa specifikuar mënyrën dhe kushtet nën të cilat këto shkelje të pretenduara kanë ndodhur.

36. Parashtruesi ka kërkuar që "*të kem një kulm mbi kokë*" sepse ai nuk ka mundësi ta ndërtoj vetë, dhe se është i bindur se gjatë shqyrtimit të rastit të tij janë bërë "*shkelje procedurale".*

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *" Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

39. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]".*

40. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret e nenit 113.7 sa i përket palës së autorizuar dhe shterjes së mjeteve juridike, kërkesa është parashtruar brenda afateve të nenit 49 të Ligjit, andaj në vijim Gjykata do të vlerësojë nëse kërkesa i ka plotësuar kriteret e rregullit 39 (2) të Rregullores së punës [Kriteret e pranueshmërisë], i cili parasheh:

> *"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

41. Gjykata rikujton se parashtruesi ka pretenduar se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 13/2017, të 4 gushtit 2017, atij i janë shkelur të drejtat e njeriut si në kërkesë dhe këtë veçanërisht sepse pa arsye i është refuzuar kërkesa për ndërtim të shtëpisë nga fondi për riatdhesim të personave të kthyer në Kosovë.

42. Gjykata konstaton se parashtruesi në kërkesën e tij vetëm sa i ka përmendur dispozitat e nenit 22.1 të Kushtetutës dhe të nenit 25.4 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

43. Gjykata rikujton se neni 22 i Kushtetutës përcakton se cilat Marrëveshje dhe Instrumente Ndërkombëtare janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Si e tillë, kjo dispozitë kushtetuese në raport me parashtruesin nuk mund të jetë objekt i një *"shkelje nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive"* individuale, të garantuara me Kushtetutë, sikur përcakton neni 113.7 i Kushtetutës.

44. Gjykata vë në dukje se në lidhje me nenin 50.4 të Kushtetutës, parashtruesi vetëm e ka theksuar në kërkesë dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo ka bashkëngjitur ndonjë provë se si, dhe në ç' mënyrë, është shkelur kjo dispozitë kushtetuese dhe cilat të drejta të fëmijëve janë cenuar me veprimin e autoritetit publik.

45. Gjykata më tej konstaton se edhe organet administrative edhe gjykatat e rregullta kur kishin vendosur për kërkesën e parashtruesit, ku ai ishte palë në procedurë, vendimet refuzuese i kishin nxjerrë mbi bazën

e veprimeve procedurale të parashtruesit (mosaplikimi me kohë dhe çështja e titullarit të pronësisë) dhe jo, mbi bazën e përcaktimit të gabuar të fakteve apo zbatimit të gabuar të ligjit sikur pretendon parashtruesi. Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të konstatojë se "*veprimet ... të ndërmarra ... nga institucionet e pushtetit publik*" nuk janë "*në interesin më të mirë të fëmijëve*", sikur parasheh neni 50. 4 i Kushtetutës, sepse në çështjen juridike përgjatë tërë procesit vendosej për "*një të drejtë të parashtruesit dhe jo drejtpërsëdrejti të fëmijëve, edhe pse rezultati përfundimtar i çështjes padyshim që afekton edhe fëmijët*".

46. Lidhur me nenin 25 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, parashtruesi edhe për këtë shkelje të supozuar nuk ka dhënë ndonjë shpjegim apo paraqitur ndonjë provë se si është shkelur kjo e drejtë. Në fakt, Gjykata konstaton se nga vendimet e paraqitura në kërkesë, parashtruesit dhe familjes së tij i është ofruar mbështetje "*duke përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin", ...* qoftë edhe në baza të përkohshme. Për më tepër, duket se parashtruesi supozon se të drejtat e parapara me këtë deklaratë janë cenuar me vet rezultatin përfundimtar të rastit të tij, gjë që Gjykata e ripërsëritë se nuk ka kompetencë të vlerësojë këtë përfundim të procedurave gjyqësore dhe administrative.

47. Gjykata rikujton se në bazë të nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" [GJEDNJ],* andaj gjatë shqyrtimit të rasteve para saj, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

48. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se edhe pse parashtruesi shprehimisht nuk e kishte përmendur në kërkesë nenin 31 të Kushtetutës *[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm],* përgjatë gjithë arsyetimit të kërkesës së tij në gjykatë i referohet çështjes së aplikimit të ligjit dhe lëshimeve procedurale që kanë bërë organet administrative dhe gjyqësore. Parashtruesi këto çështje i ka ngritur edhe në ankesat që ka bërë në institucionet përkatëse, e që bazuar në praktikën e gjykatës janë elemente që lidhen me nenin 31 të Kushtetutës, gjegjësisht bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së janë elemente që lidhen me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNJ].

49. Rrjedhimisht, Gjykata, duke marrë parasysh praktikën e vet ligjore, praktikën ligjore të GJEDNJ-së, substancën e kërkesës së parashtruesit dhe fakteve të paraqitura bashkë me kërkesën (kopja e

padisë në Gjykatën Themelore, përmbajtjen e ankesave në gjykatat e rregullta, vendimeve gjyqësore etj.) konstaton se duhet t'i referohet edhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, që përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

dhe

Neni 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së, që përcakton:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij".

50. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të të drejtave të njeriut për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe B. *Vidal kundër Belgjikës,* 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235).

51. Gjykata vëren se argumentimi i parashtruesit lidhur me shkeljet kushtetuese konsistojnë në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimeve procedurale si dhe faktit që ai nuk ishte fajtor për lëshimin e një afati në procedurë administrative e i cili sipas tij, rezultoi me refuzimin e kërkesës së tij.

52. Gjykata konstaton se MPB-KQR si organ i shkallës së parë në procedurë administrative kur ka refuzuar kërkesën e parashtruesit për

ndërtim të shtëpisë, ndër të tjera, ka arsyetuar: "*Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe sipas dëshmive të paraqitura komisioni konstaton: se i riatdhesuari nuk i plotëson kriteret për mbështetje nga programi i riintegrimit të përcaktuara me Rregulloren QRK-së nr. 20/2013 ... (neni 13, par. 1)*".

53. Gjykata më tej vëren se Komisioni i Ankesave i MPB-KQR-së, si organ i shkallës së dytë në procedurë administrative, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar kundër vendimit të shkallës së parë, kishte vendosur ta refuzojë këtë ankesë dhe, ndër të tjera, ka arsyetuar *"kur i referohemi nenit 2, paragrafi 4 të Rregullores QRK. nr. 20/2013 Për riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe menaxhimin e Programit të Riintegrimit në bazë të së cilës komisioni i ankesave ka mandate për të shqyrtuar dhe vendosur për ankesat e personave të riatdhesuar, shihet se i riatdhesuari sipas kësaj dispozite kërkesën e dytë për përfitim nga programi për riintegrim, përkatësisht për ndërtim shtëpie e ka paraqitur jashtë afatit ligjor, përkatësisht kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit prej 12 muajve nga dita e riatdhesimit"*.

54. Komisioni i Ankesave i MPB-KQR-së më tej ka arsyetuar edhe çështjen e kërkesës së parë të parashtruesit për të cilën ai pohon se e kishte dorëzuar me kohë. Komisioni thekson në vendim se në atë kohë, në fuçi, ishte Rregullorja për Menaxhimin e Programit nr. 10/2012, e cila kërkonte që parashtruesi të prezantonte pronë në emër të tij për të përfituar nga programi dhe, se parashtruesi për arsye të procedurave të tejzgjatura administrative e edhe për mungesë të mjeteve financiare nuk kishte mundur ta bartë pronën e paluajtshme në emër të tij, andaj as me rastin e kërkesës së parë nuk i kishte plotësuar kushtet që kërkoheshin me rregullore.

55. Gjykata më tej konstaton se parashtruesi i kërkesës vendimin përfundimtar në procedurë administrative e kishte kontestuar me padi në procedurën e konfliktit administrativ, duke kaluar nëpër të gjitha instancat e sistemit të rregullt gjyqësor.

56. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A. nr. 1643/2014 kishte vendosur që të *"Refuzohet kërkesëpadia e paditësit (parashtruesit) si e pabazuar, me të cilën ai ka kërkuar nga Gjykata, që të anulohet vendimi i të padituës, Qeveria e Republikës se Kosovës, Komisioni i Ankesave për Riintegrim, nr. 108/2014, i 22 korrikut 2014"*.

57. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me

padi iu referua Rregullores së QKR-së, nr. 20/2013, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, nenit 2, paragrafi 4 të të njëjtës, i cili përcakton se, *"Për përfitimet e përkufizuara në nenin 13 dhe 17 të kësaj rregulloreje, personat e riatdhesuar mund të dorëzojnë kërkesat për përfitim brenda 12 muajve nga data e riatdhesimit"*. Gjykata tutje konstaton se *"paditësi, ka bërë kërkesë tek e paditura jashtë afatit prej 12 muajve, pas afatit të përcaktuar nga paragrafi 4, të nenit 2 të Rregullores së QKR-së nr. 20/2013"*.

58. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A. nr. 1643/2014 *"vlerëson se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të 27.06.2014, përkatësisht Komisionit Qendror për Riintegrim të MPB-së"*.

59. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës së parashtruesit, me Aktgjykimin AA. nr. 91/2017, vendosi që të refuzojë ankesën e tij si të pabazuar dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative, A. nr. 1643/2014, të 24 nëntorit 2016, e vërtetoi.

60. Gjykata e Apelit në aktgjykimin e vet kishte arsyetuar si në vijim "*Qëndrimin juridik të gjykatës se shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar"*.

61. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

62. Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. A. (U). nr. 13/2017, ndër të tjera, arsyetoi *"Neni 24 i Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) thotë se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës se dytë, pala mund t'i parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të*

jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të së drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes".

63. Gjykata Supreme, duke zbatuar ligjin në fuqi për Konflikte Administrative në rastin konkret, kishte konstatuar se parashtruesi ka ushtruar mjetin juridik të gabueshëm që nuk korrespondon me dispozitat e ligjit, andaj edhe e ka hedhur poshtë kërkesën e tij.

64. Parashtruesi më tej kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, por nga kjo zyrë kishte marrë njoftimin KMLA. nr. 12/17 me të cilin kërkesa e tij ishte refuzuar me arsyetimin se "*Pas shqyrtimit të propozimit tuaj si dhe shkresave të lëndës A.nr.1643114, ju njoftojmë se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, andaj nuk ka aprovuar propozimin tuaj për paraqitjen e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik".*

65. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta apo organet administrative, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

66. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih *Fe Metrebi v Georgia,* par. 31, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 31 korrikut 2007, shih gjithashtu Aktvendimin e Gjykatës për rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, të 16 dhjetorit 2011) .

67. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta që ta paraqes rastin e tij në organet administrative-komisionet përkatëse të MPB-së, si dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Gjykata konstaton se duke përdorur mjetet e ankimit parashtruesi ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore, andaj, procesi në tërësinë e tij nuk mund të cilësohet si arbitrar apo i padrejtë.

68. Në rrethanat e rastit, Gjykata nuk gjen se vendimet e gjykatave të rregullta janë arbitrare apo janë tregues i shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, aq më tepër, kur të gjitha

pretendimet e parashtruesit kishin të bënin për shkelje ligjore dhe jo të natyrës kushtetuese me ç'rast, edhe kur parashtruesi vetëm sa i theksoi në kërkesë normat kushtetuese, ai në asnjë mënyrë nuk paraqiti prova se si dhe në cilat rrethana e drejta e pretenduar kushtetuese është shkelur.

69. Si përfundim, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Andaj, në përputhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

70. Duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit dhe shpjegimin për gjendjen e tij materiale, Gjykata aprovoi kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit në pajtim me rregullin 39 (6) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, përgjatë tërë procedurës atij i referohet si parashtruesi X.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe (6) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 13 mars 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Arta Rama-Hajrizi

KI94/18, Parashtrues: Miodrag Šešlija, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-211/15

KI94/18, Aktvendim për papranueshmëri i 10 prillit 2019, publikuar më 15 maj 2019.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, Aktvendim për papranueshmëri, qartazi e pabazuar

Parashtruesi në kërkesë pretendoi se KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së gabimisht interpretuan dhe zbatuan dispozitat e nenit 11.4. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, dhe rrjedhimisht ata nuk kanë mundur t'i shqyrtojnë argumentet dhe provat e tij të cilat i ka paraqitur dhe bashkëngjitur, dhe me të cilat ai provon se i takon e drejta mbi pronën lëndore.

Parashtruesi i kërkesës më tej pretendoi se me këtë qëndrim KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e përcaktuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës zhvilloi dy procedura gjyqësore lidhur me pronën lëndore.

Sa i përket procedurës së parë gjyqësore, Gjykata konstatoi se ajo filloi në vitin 2005, dhe përfundoi më 26 mars 2007, kur lënda e kontestit të parashtruesit të kërkesës ishte zgjidhur me vendim të formës së prerë HPCC/REC/94/2007. Me atë vendim, parashtruesit të kërkesës iu dha një formë shpërblimi, të cilën ai mund ta realizojë si parashtrues i kategorisë C, sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Gjykata më tej vërejti se parashtruesi i kërkesës e inicioi procedurën e dytë gjyqësore më 23 nëntor 2007, kur e paraqiti kërkesën në AKP, me të cilën kërkoi vërtetimin e së drejtës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht banesën. Gjykata konkludon se procedura e dytë gjyqësore përfundoi më 21 shkurt 2018, me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së, GSK-KPA-A-211/15, me të cilën kërkesa e parashtruesit u refuzua si e pabazuar.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ofroi argumente relevante që do të arsyetonin pretendimet e tij se në procedurën

e dytë gjyqësore ishin shkelur në ndonjë mënyrë të drejtat kushtetuese në të cilat ai ishte thirrur, përveç se ai ishte i pakënaqur me rezultatin e procedurave në të cilat u mor vendimi dhe aktgjykimi i kontestuar.

Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, dhe si e tillë duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI94/18

Parashtrues

Miodrag Šešlija

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-211/15

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtaredhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Miodrag Šešlija nga Prishtina, me adresë të përhershme në Kragujevc, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-211/15 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i AKP-së), të 21 shkurtit 2018, i cili i është dorëzuar më 23 mars 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar dhe aktgjykimit, me të cilët pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

7. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

8. Më 27 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të saj ia dërgoi Kolegjit të Apelit të AKP-së.

9. Më 10 prill 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës që nga viti 1999 ka jetuar në banesë e cila gjendej në lagjen Dardania në Prishtinë.

11. Parashtruesi i kërkesës gjatë vitit 1999 u largua nga banesa.

12. Parashtruesi i kërkesës gjatë vitit 2005 paraqiti kërkesë në Drejtoria për kërkesa banesore dhe pronësore (në tekstin e mëtejmë: HPD), me të cilën kërkoi kthimin e të drejtës pronësore mbi banesën në të cilën ka jetuar deri më 1999. HPD e shënoi kërkesën e parashtruesit si kërkesë e kategorisë C, dhe e regjistroi me shenjën DS001562.

13. Gjithashtu, personi M.R., gjatë vitit 2005 parashtroi kërkesë në HPD, me të cilën kërkoi kthimin e të drejtave banesore mbi të njejtën banesë si parashtruesi i kërkesës. HPD-ja kërkesën e personit M.R., e shënoi si kërkesë të kategorisë A dhe e regjistroi me shenjën DS002602.

14. Më 30 prill 2005, Komisioni për kërkesa pronësore dhe banesore (në tekstin e mëtejmë: KKPB), nxori Vendimin HPCC/d/180/2005/A&C, me të cilin kërkesën DS001562, të personit M.R., e refuzoi, duke pretenduar *„se kërkesa e personit të kategorisë A është refuzuar sepse nuk i plotëson kriteret e Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe seksionit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60."*Në arsyetimin e vendimit theksohet:

> *„Parashtruesi i kërkesës me shenjën DS001562, ka marre një vendim për ndarjen e banesës, ka hyrë në pronën lëndore dhe ka nënshkruar një kontratë të shfrytëzimit me Ndërmarrjen Publike Banesore. Megjithatë, ai nuk e humbi të drejtën e tij të pronësisë si rezultat i diskriminimit, por sepse ai pushoi së përdoruri banesën për më shumë se një vit në kundërshtim me nenin 29.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore."*

15. Me të njëjtin Vendim, KKPB parashtruesit të kërkesës ia paranoi ri-posedimin mbi banesën lëndore.

16. Personi M.R., i paraqiti kërkesë organit të shkallës së dytë të KKPB-së, me të cilën kërkoi rishqyrtimin e Vendimit të shkallës së parë HPCC/d/180/2005/A&C,të 30 prillit 2005.

17. Më 26 mars 2007, KKPB-ja e aprovoi kërkesën për rishqyrtim të vendimit të personit M.R, dhe nxori Vendimin e ri HPCC/REC/94/2007. Me këtë vendim, personit M.R., i është kthyer e drejta pronësore mbi banesën lëndore. Në arsyetimin e vendimit theksohet:

„Personi M.R., në kërkesën për rishqyrtimin e vendimit theksoi se 15 vite ka punuar në të njejtën firmë si parashtruesi i kërkesës dhe rrjedhimisht bazuar në këtë vend të punës iu nda prona lëndore. Megjithatë, përshkaktë vendosjes të masave të përkohshme ai është larguar nga puna dhe është zhvendosur nga prona lëndore, ndërsa firma e atëhershme e cila ishte bartës i së drejtës të shfrytëzimit të kësaj banese vendosi që atij t'ia anuloj të drejtën banesore. Sipas mendimit të KKPB-së ky veprim ishte diskriminator. Prandaj, KKPB-ja kërkesën e kategorisë A të personit M.R. të regjistruar me shenjën DS002602ia aprovoi dhe urdhëroi t'i kthehet e drejta banesore mbi banesën lëndore."

18. Sa i përket parashtruesit të kërkesës, KKPB-ja në të njëjtin vendim theksoi:

„Parashtruesi i kërkesës i kategorisë A (personi M.R.) me kërkesën DS002602 ka të drejtën e kthimit të pronës, dhe për të ushtruar të drejtën e tij për kthim, ai duhet t'ia paguajë Drejtorisë shumën nga neni 4.2 (a) brenda 120 ditëve nga data e vendimit të Komisionit për të drejtën e kthimit.

Nëse parashtruesi i kërkesës i kategorisë A (personi M.R), me kërkesën DS002602, e paguan shumën nga paragrafi më lartë, Komisioni do të nxjerrë urdhër përfundimtar dhe do t'ia jep pronësinë ndaj pronës. Parashtruesi i kërkesës i kategorisë C me kërkesën DS001562 (parashtruesi i kërkesës), do të ketë të drejtë pasi ta paraqesë kërkesën në kompensim për dëmin e tij i cili do t'i paguhet nga shuma të cilën e ka paguar parashtruesi i kërkesës i kategorisë A në pajtim me nenin 4.2(c) të Rregullores së UNMIK /2000/60."

19. Më 23 nëntor 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP) kërkesë me të cilën kërkoi vërtetimin e të drejtës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Parashtruesi në kërkesë theksoi se ai është pronar i banesës lëndore, që këtë banesë e ka uzurpuar personi M.R., dhe në emër të uzurpimit kërkoi t'i kompensohet shfrytëzimi i pa autorizuar i banesës.

20. Më 7 tetor 2008, personi M.R., iu drejtua AKP-së, duke pretenduar që banesa lëndore i është ndarë me vendimin e KKPB-së.

21. Më 18 qershor 2014, KKPK-ja nxori Vendimin KPCC/D/A/247/2014,me të cilin kërkesën e parashtruesit e hodhi poshtë. Në arsyetimin e vendimit theksohet:"[...]*Provat e paraqitura nga palët në procedurë dhe të verifikuara nga Sekretaria Ekzekutive*

tregojnë se prona e paluajtshme lëndore është kthyer me aktgjykim të formës së prerë, dhe në pajtim me dispozitën e nenit 11.4 të UNMIK 2006/50, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin nr. 03/L/076, kërkesa e KKPK-së duhet të refuzohet, sepse ajo tashmë është vendosur."

22. Më 17 qershor 2015, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së kundër vendimit të KKPK-së të 18 qershorit 2014, duke pretenduar *„[...] se nuk pajtohet me vendimin e KKPK-së, se ajo nuk është kompetente për të trajtuar çështjen, sepse rasti tashmë është vendosur për këtë çështje.*"Parashtruesi i kërkesës në ankesë pretendon se ai në vitin 2007 dorëzoi padi për njohjen e të drejtave pronësore mbi pronën lëndore dhe se ajo kërkesë nuk është e njëjtë si kërkesa e mëparshme në bazë të cilës gjykatat tashmë kanë vendosur.

23. Më 21 shkurt 2018, Kolegji i Apelit i AKP-së nxori Aktgjykimin GSK-KPA-A-211/15, me të cilin ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar dhe në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

> *"Neni 2.7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 definon se " Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë". Prandaj, vendimi i KKPK për të e konsideruar rastin e përfunduar me vendim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm është i drejtë dhe i bazuar në ligj.*"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi në kërkesë para së gjithash pretendon se ai në vitin 2005 paraqiti kërkesë në HPD për riposedim mbi pronën, dhe në vitin 2007 paraqiti kërkesën e dytë me të cilën kërkoi vërtetimin e së drejtës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, dhe se rrjedhimisht qëndrimi i KKPK-së dhe i Kolegjit të Apelit të AKP-së, se në lidhje me kërkesën e tij tashmë është vendosur në procedurën e mëhershme, është i gabuar.

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së gabimisht interpretuan dhe zbatuan dispozitat e nenit 11.4. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, dhe rrjedhimisht ata nuk kanë mundur t'i shqyrtojnë argumentet dhe provat e tij të cilat i ka paraqitur dhe bashkëngjitur, dhe me të cilat ai provon se i takon e drejta mbi pronën lëndore.

26. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se me këtë qëndrim KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së i kanë shkelur të drejtat e tij të

garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

27. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që t'ia kthej pronën lëndore në posedim ose t'i paguhet kompensimi i drejtë në shumën e vlerës së tregut të pronës.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> (...)
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirivetë tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjithamjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

30. Gjykata në vijim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç është përcaktuar në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

Neni 49 [Afatet]

> *„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."*

31. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafin (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

32. Sa i përket plotësimit të këtyre kritereve, Gjykata përcakton se parashtruesi ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së, GSK-KPA-A-211/15, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka saktësuar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendon se janë shkelur, në pajtim me kriteret nga neni 48 të Ligjit dhe e dorëzoi kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

33. Gjykata në fillim të analizës së bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe të drejtave të garantuara me KEDNJ, vëren se parashtruesi i kërkesës zhvilloi dy procedura gjyqësore lidhur me pronën lëndore dhe se të dy procedurat gjyqësore përfunduan me vendime dhe aktgjykime të formës së prerë.

34. Sa i përket procedurës së parë gjyqësore, Gjykata konstaton se ajo filloi në vitin 2005, dhe përfundoi më 26 mars 2007, kur lënda e kontestit të parashtruesit të kërkesës ishte zgjidhur me vendim të formës së prerë HPCC/REC/94/2007. Me atë vendim, parashtruesit të kërkesës iu dha një formë shpërblimi, të cilën ai mund ta realizojë si parashtrues i kategorisë C, sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

35. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës e inicioi procedurën e dytë gjyqësore më 23 nëntor 2007, kur e paraqiti kërkesën në AKP, me të cilën kërkoi vërtetimin e së drejtës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht banesën. Gjykata konkludon se procedura e dytë gjyqësore përfundoi më 18 qershor 2018, me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së, GSK-KPA-A-211/15, me të cilën kërkesa e parashtruesit u refuzua si e pabazuar.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 dhe nenit 46 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-

së,do t'i shqyrtojë vetëm lidhur me procedurën e dytë gjyqësore, e çka është në pajtim me dispozitat kushtetuese.

37. Rrjedhimisht, Gjykata para së gjithash vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së ia kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, sepse bënë gabim dhe nuk interpretuan në mënyrë të drejtë Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50, saktësisht nenin 11.4, gjë që rezultoi që ata të konkludojnë se për këtë rast tashmë është vendosur, dhe se rrjedhimisht është nxjerrë vendim i formës së prerë. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, kjo ua ka pamundësuar atyre t'i shqyrtojnë provat me të cilat ai vërteton që prona lëndore i takon atij.

38. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të pretenduara në radhë të parë kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

39. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e faktit dhe ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata nuk mund të përfshihet në vlerësime të tilla që tërheqin hipotezat në lidhje me atë se çfarë e çoi gjykatën e rregullt për të arritur në atë pikë, që të marrë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Përndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e „shkallës së katërt", që do të ishte në kundërshtim me bazën e parimit të subsidiaritetit dhe kufizimet e përcaktuara me Kushtetutë në lidhje me juridiksionin e saj.

40. Në të vërtetë, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih: rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96,te 21 janarit 1999, paragrafi 28, dhe shih,gjithashtu rastin: KI70/11, Parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, të 16 dhjetorit 2011).

41. Gjykata Kushtetuese është e obliguar nga kompetencat kushtetuese për të vlerësuar dhe vendosur në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata vlerëson nëse mënyra në të cilën gjykatat e rregullta kanë zbatuar ligjin është qartazi e gabuar ose në ndonjë mënyrë tjetër arbitrare ose diskriminuese (shih, për shembull: rastet e GJEDNJ-së, *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i 10 majit 2007, nr. 48191/99; *Anheuser-BuschInc kundër Portugalisë*, Aktgjykimi i 11

janarit 2007, nr. 73049/01, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë,*Aktgjykimi i 11 janarit 2007, nr. 184/02, *Khamidov kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2007, nr. 72118/01, *Andelković kundër Serbisë*, Aktgjykimi i 9 prillit 2013, nr. 1401/08, *Dulaurens kundër Francës*, Aktgjykimi i 21 marsit 2000, nr. 34553/97).

42. Gjykata, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta qartazi kanë gabuar dhe në mënyrë arbitrare zbatuan nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50,kur e refuzuan kërkesën e tij për vërtetimin e së drejtës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, konstaton se KKPK-ja kërkesën e parashtruesit e refuzoi vetëm për arsye procedurale, duke mos u lëshuar në vet thelbin e kërkesës i cili kishte të bënte me pronën lëndore.

43. Gjykata vëren se KKPK-ja këtë qëndrim e ka marrë në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, i cili përcakton:

> *„Komisioni do ta refuzojë padinë në tërësi*
> *[...]*
> *c) nëse kërkesa është shqyrtuar më parë dhe është vendosur me vendim të formës së prerë administrative ose gjyqësore.“*

44. Për më tepër, Gjykata vëren se i njëjti konkluzion u arrit edhe nga Kolegji i Apelit të AKP-së në Aktgjykimin GSK-KPA-A-211/15, duke iu përgjigjur pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës.

45. Gjykata gjithashtu vëren se qëndrimet e tilla të KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së janë marrë në bazë të procedurës së parë gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në vitin 2005 dhe të përfunduar në vitin 2007, e cila rezultoi me aktgjykim të formës së prerë lidhur me çështjen e pronës lëndore.

46. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata nuk gjen të arsyeshëm pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

47. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në KKPK dhe në Kolegjin e Apelit të AKP-së ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se thelbi i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur ose që parashtruesit të kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, që do të rezultonte në shkelje të kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

48. Gjithashtu, parashtruesi në kërkesë pretendon se me vendimin e kontestuar të KKPK-së dhe aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së janë shkelur të drejtat e tij në pronë sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

49. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata thekson një praktikë të qëndrueshme të KEDNJ-së, sipas të cilës "prona" në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së mund të jetë ose "prona ekzistuese" ose "të mirat", përfshirë edhe pretendimet në lidhje me të cilat personi së paku ka "pritje legjitime" që do t'i realizojë (shih: Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Peter Gratzinger dhe Eva Gratzingerova kundër Republikës Çeke,*Vendim për pranueshmëri, të 10 korrikut 2002, kërkesa nr. 39794/98, paragrafi 69).

50. Në lidhje me këtë, dhe në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, prona lëndore, nuk mund të konsiderohet si "pronë" brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, sepse nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara, gjegjësisht, për shkak se për pronën lëndore tashmë është vendosur gjatë procedurës së parë gjyqësore dhe për të cilën është marrë vendim i formës së prerë, në pajtim me vendimet dhe aktgjykimet e KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit te AKP-së.

51. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka fituar pronën lëndore sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Megjithatë, në pajtim me Vendimin KPCC/D/A/247/2014 të KKPK-së dhe Aktgjykimin GSK-KPA-A-211/15, të Kolegjit të Apelit të AKP-së, Gjykata vëren se i është pranuar një formë e "*shpërblimit adekuat për pronën lëndore që ai mund ta realizojë*".

52. Në këtë drejtim, siç është nënvizuar në aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së, GSK-KPA-A-211/15, të 21 shkurtit 2018, gjatë nxjerrjes së vendimeve në procedurat gjyqësore në lidhje me pronën në fjalë, janë mbështetur pretendimet e parashtruesit të kërkesës të kategorisë A, se ai kishte humbur pronën e tij në bazë të legjislacionit diskriminues dhe, mbi këtë bazë, i është njohur e drejta e kthimit të pronës kontestuese, ndërsa parashtreusit të kërekës i është dhënë e drejta e kompensimit adekuat siç parashihet në nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së i gjen si të pabazuara.

54. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se parashtruesi nuk ofroi argumente relevante që do të arsyetonin pretendimet e tij se në procedurën e dytë gjyqësore ishin shkelur në ndonjë mënyrë të drejtat kushtetuese në të cilat ai ishte thirrur, përveç se ai ishte i pakënaqur me rezultatin e procedurave në të cilat u mor vendimi dhe aktgjykimi i kontestuar.

55. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që të mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih: rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* të 5 dhjetorit 2013).

56. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, dhe si e tillë duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 prill 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI185/18, Parashtrues: Limak Kosovo International Airport SH.A. "Adem Jashari", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 271/2018, të 10 tetorit 2018

KI185/18, Aktvendim i 27 majit 2019, publikuar më 10 korrik 2019

Fjalët kyç: kërkesë individuale, person juridik, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës kishin nënshkruar Marrëveshje të Partneritetit Publiko Privat (PPP) dhe, bazuar në këtë marrëveshje, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që të gjithë punëtorët t'i mbajë në marrëdhënie të punës edhe për 3 (tri) vjet të tjera.

Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës, e kishte njoftuar punëtorin F. M. se nuk do t'i përtërihet kontrata e punës. Punëtori F. M. kishte parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë dhe padia e tij u aprovua. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës pranë gjykatave të rregullta pretendonte se gjykatat e rregullta nuk kishin marrë për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr për obligim që punëtorët t'i mbajë në punë për 3 (tri) vjet.

Gjatë procedurave pranë gjykatave të rregullta, këto të fundit i kishin sqaruar parashtruesit të kërkesës se meqenëse punëtori F. M. kishte më shumë se dhjetë (10) vjet pune, në bazë të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore kështu që edhe për ndërprerjen e kontratës së punës duhet të respektohen procedurat e përcaktuara ligjore, procedura këto që, sipas gjykatave të rregullta. parashtruesi i kërkesës nuk i kishte respektuar.

Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij pranë Gjykatës Kushtetuese pretendoi shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës për shkak të vendimit të paarsyetuar, si dhe të neneve 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës dhe përsëriti pretendimet e tij si pranë gjykatave të rregullta.

Gjykata Kushtetuese, duke i adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, konstatoi se ky i fundit dështoi të paraqesë prova, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe Gjykata nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtruesit të kërkesës për shkak që shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me nenet 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës i pretendon si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI185/18

Parashtrues

Limak Kosovo International Airport J.S.C. "Adem Jashari"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 271/2018, të 10 tetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport SH. A. "Adem Jashari"(në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, e cila përfaqësohet me autorizim nga Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 271/2018 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 10 tetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 nëntor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.

7. Më 20 dhjetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë të titulluar *"[...] lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese dhe në veçanti për lëndën e regjistruar me [...] numër KI132/18"* si dhe bashkëngjiti në Gjykatë Marrëveshjen e Partneritetit Publiko Privat (në tekstin e mëtejmë: PPP).

9. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtresë të titulluar "*Parashtresë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese",* në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që kishte bërë më parë.

10. Më 27 maj 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

11. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar PPP-në. Para nënshkrimit të marrëveshjes së PPP-së, Aeroporti i Prishtinës quhej Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: ANP).

12. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se punëtori F. M. (në tekstin e mëtejmë: punëtori) kishte qenë i punësuar tek ANP-ja. Bazuar në Marrëveshjen e PPP-së, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që të gjithë punëtorët t'i mbajë në marrëdhënie të punës edhe për 3 (tri) vite të tjera.

13. Punëtori ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune te parashtruesi i kërkesës nga 4 prilli 2011 deri më 3 prill 2014. Më 3 mars 2014, respektivisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës, parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar punëtorin se "*... në pajtim me politikat e Bordit të Drejtorëve dhe Ligjit të Punës së Kosovës si dhe vendimin për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore, të njëjtit nuk do t'i vazhdohet Kontrata e Punës pas datës 03.04.2014*".

14. Më 17 mars 2014, punëtori ka parashtruar ankesë tek parashtruesi i kërkesës "*... me propozim që njoftimi i të paditurës për mospërtëritje të kontratës së punës i dt. 03.03.2014, të anulohet si joligjor dhe paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga mardhënia e punës*".

15. Më 24 mars 2014, parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e punëtorit.

16. Punëtori paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), ku kërkoi që të anulohet Njoftimi i 3 marsit 2014, i lëshuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës që punëmarrësin ta

kthejë në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet, si dhe t'i kompensohet dëmi i shkaktuar material.

17. Më 15 maj 2015, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit (C. nr. 201/2014),(i) aprovoi kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar; (ii) anuloi njoftimin e parashtruesit të kërkesës të 3 marsit 2014, si dhe përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të 24 marsit 2014 për mosvazhdimin e kontratës së punës; (iii) obligoi parashtruesin e kërkesës që ta kthejë në punë punëtorin; (iv) obligoi parashtruesin e kërkesës që punëtorit t'ia paguajë shumën përkatëse në emër të dëmit material; dhe (v) obligoi parashtruesin të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.

18. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (C. nr. 201/2014), duke theksuar që aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

19. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij në thelb theksoi se Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës së punëtorit, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se tri vjet përvojë pune, parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të kësaj gjendje faktike të vërtetuar gabimisht ka ardhur deri zbatimi i gabuar i të drejtës materiale dhe procedurale dhe se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është në kundërshtim me nenin 9.18 të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat, të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar Limak i Kosovës nga 12 gushti 2010.

20. Më 18 qershor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit (Ac. nr. 3644/2015) kishte refuzuar, si të pathemeltë, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin (C. nr. 201/2014), të Gjykatës Themelore, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm, dhe duke e potencuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare dhe duke dhënë shpjegime adekuate për një vendosje të këtillë të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.

21. Më 11 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të

gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se gjykatat e instancave më të ulëta nuk kishin marrë për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr për obligim që punëtorët t'i mbajë në punë për 3 (tri) vite. Për më tepër, parashtruesi pretendonte se *"gjykata ka bërë bashkimin e punës nga dy punëdhënës të ndryshëm"*.

22. Më 10 tetor 2018, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Rev. nr. 271/2018, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar "*thëniet e revizionit janë të pabazuara, nga fakti se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike të cilat janë të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së të paditurës, ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, për të njëjtat ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat janë të pranuara edhe nga gjykata e revizionit*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 272/2018, [...], ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, duke pohuar më tej se "Si pasojë e mungesës së arsyetimit, vendimi i kontestuar e privoi parashtruesin e kërkesës nga e drejta kushtetuese për mjet efektiv juridik" dhe me këtë atij i është shkelur edhe e drejta e garantuar kushtetuese me nenin 32 dhe nenit 24 [Barazia para ligjit, si pasojë e këtyre shkeljeve, parashtruesit i është cenuar edhe e drejta e pronës sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi pohon gjithashtu, se ka shkelje të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së*".

24. Parashtruesi i kërkesës në thelb arsyeton kërkesën e tij duke theksuar se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe se ka ardhur deri te aplikimi i gabuar i të drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk kanë arsyetuar në masë të mjaftueshme si në vijim:

(i) Se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës të punëtorëve,

duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 (tri) vjet përvojë pune;
(ii) Se parashtruesi i kërkesës ka pasur të drejtë që me njoftim ta ndërprenë marrëdhënien e punës në pajtim me kontratën e punës, nenin 1.1 dhe nenin 67 paragrafi 1.3, si dhe nenin 71, paragrafi 2 të Ligjit të punës nr. 03/L-212;
(iii) Se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, sepse ai nuk mund të zbatohet për ndërmarrjen Limak, meqë punëtori nuk ka 10 (dhjetë) vite përvojë pune të vazhdueshme me të paditurin;
(iv) Se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr përsipër detyrimin për të mbajtur punëtorët në punë brenda 3 (tri) viteve.

25. Parashtruesi gjithashtu citon Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese dhe pohon se *"aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate porse Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material"*.

26. Parashtruesi i kërkesës kërkon që "*Gjykata Kushtetuese duhet të vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, mutatis mutandis, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe B. Vidal kundër Belgjikës, 22 pri111992. f. 33, seria A. nr. 235).*

27. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe që çështja të kthehet në rigjykim.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 10
Kontrata e Punës
[...]

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 67

[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

[...]

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

Neni 70

[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajnojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuari është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejmë me shkrim.

Neni 71
[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Marrëveshja për Partneritet Publiko privat për Operimin dhe Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

9.18 [*Përfundimi i Personelit]*

Partneri Privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP-së (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuar (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët, dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të datës së hyrjes në fuqi".

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

30. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, par. 14).

32. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afati]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]"

33. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i cili konteston aktet e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur përmes këtyre vendimeve, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

34. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2), i Rregullores së punës, përcakton:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

35. Gjykata vëren së pari se parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme, përderisa shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ i pretendon si rezultat i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

36. Në thelb, parashtruesi i kërkesës e arsyeton kërkesën e tij duke përsëritur të njëjtat pretendime që ai i ka paraqitur edhe në gjykatat e rregullta në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme si në vijim:

(i) Se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës të punëtorëve,

duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 (tri) vjet përvojë pune.
(ii) Se parashtruesi i kërkesës ka pasur të drejtë që me njoftim ta ndërprenë marrëdhënien e punës së tij në pajtim me kontratën e punës, nenin 1.1 dhe nenin 67, paragrafi 1.3, si dhe nenin 71, paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.
(iii) Se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, sepse ai nuk mund të zbatohet për ndërmarrjen Limak, meqë punëtori nuk ka 10 (dhjetë) vite përvojë pune të vazhdueshme me të paditurin.
(iv) Se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr përsipër detyrimin për të mbajtur punëtorët në punë brenda 3 (tri) viteve.

37. Gjykata Kushtetuese do të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta në lidhje me pretendimin e parashtruesit se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe i referohen secilit pretendim individual të parashtruesit të kërkesës.

38. E para, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës (i) se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kohëzgjatjen e përvojës së punës të të punësuarve duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 (tri) vjet përvojë pune.

39. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore arsyetoi se "*Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara si më lart, e të cilave gjykata në tërësi ua fali besimin, është vërtetuar se paditësi tek paraardhësja e të paditurës ANP "Adem Jashari" sh. a., ka themeluar marrdhënie pune që nga dt. 21.11.2003 dhe tek e njëjta ka punuar pandërprerë deri më 03.04.2011, ndërsa që nga 04.04.2011, e deri më 03.04.2014,në mënyrë të pandërprerë ka punuar tek e paditura dhe me këtë ka plotësuar mbi 10 vite punë te pa ndërprerë tek paraardhësja e te paditurës dhe tek e paditura, e bazuar në dispozitën e nenit 10.5 të Ligjit të Punës, gjykata erdhi deri tek përfundimi se marrdhënia e punës në kohë të caktuar tek e paditura, konsiderohet marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, andaj gjykata konsideron se në këtë situatë, e paditura për me ja shkëput marrëdhënien e punës në kohë të pa caktuar paditësit, ka qenë i obliguar që të udhëheqë procedurë të brendshme për ndërprerje të marrëdhënies së punës, procedurë kjo e cila nuk është udhëhequr tek e paditura, por paditësi vetëm është njoftuar me njoftimin për*

mospërtëritjen e kontratës së punës". Gjykata Themelore gjithashtu "... vlerëson se njoftimi i të paditurës për mospërtëritjen e kontratës së punës paditësit, pa zhvilluar asnjë procedurë të brendshme për ndërprerje të marrëdhënies së punës është joligjor".

40. E dyta, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (ii) se parashtruesi ka pasur të drejtë ta ndërprenë marrëdhënien e punës me njoftim në pajtim me kontratën e punës, nenin 1.1 dhe nenin 67, paragrafi 1.3 dhe nenin 71, paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

41. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore së pari konkludoi se *"... njoftimi i të paditurës për mospërtëritjen e kontratës së punës paditësit, pa zhvilluar asnjë procedurë të brendshme për ndërprerje të marrëdhënies së punës është joligjor".*

42. Me të njëjtin aktgjykim Gjykata Themelore arsyetoi më tutje se kur dhe nën cilat kushte punëdhënësi mund ta shfrytëzojë këtë mundësi, duke arsyetuar në detaje se cilat masa ligjore të mëparshme duhet të ndërmerren, duke theksuar se "*... nëse eventualisht ndërprerja e marrëdhënies së punës ka të bëj me arsyet teknike, ekonomike ose organizative, konform dispozitave të n. 70 e lidhur me nenin 76 të Ligjit të Punës, e paditura ka qenë e obliguar të harton program me shkrim si dhe t'i zbatojë këto dispozita te LP, dhe përveç që ta njoftoj paditësin një muaj para se t'ia ndërpresë marrëdhënien e punës, ka qenë e obliguar edhe ta njoftoj sindikatën e të punësuarve lidhur me ndryshimet e planifikuara, duke bërë përpjekje paraprakisht risistemimin e brendshëm të të punësuarve, kufizimin e orëve jashtë orarit të punës, zvogëlimin e orëve të punës së punëtorëve, ofrimin e riaftësimit profesional dhe masat tjera të përcaktuara me ligj, masa këto të cilat asnjërën prej këtyre nuk e ka bërë e paditura, përkatësisht deri në përfundimin e procedurës nuk ka ofruar prova se ka vepruar diçka në këtë drejtim".*

43. Gjithashtu, lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit iu përgjigj në mënyrë të detajuar kur i refuzoi si të pabazuar "*pretendimin ankimor se prej momentit të nënshkrimit të Marrëveshjes në mes të Qeverisë së Kosovës dhe të paditurës, paditësi nuk ka më tepër se 3 vite përvojë pune, kjo për Gjykatën e Apelit është pa ndikim, sepse me rëndësi është që paditësi në të njëjtin vend pune, punon më tepër se 10 vite dhe se Kontrata e tij e punës konsiderohet në kuptim të nenit 10, paragrafi 5 të Ligjit të Punës si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore, kështu që të njëjtit ka pasur mundësi që t'i ndërpritet marrëdhënia e punës vetëm nën kushtet e*

përcaktuara me dispozitën e nenit 70 të Ligjit të Punës, e kurrsesi në bazë të nenit 67 paragrafi 1 dhe 3 të këtij ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës".

44. E treta, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës (iii) se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, sepse ai nuk mund të zbatohet për ndërmarrjen Limak, meqë punëtori nuk kishte 10 (dhjetë) vite përvojë pune të pandërprerë me të paditurën.

45. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit arsyetoi se *"Pretendimi ankimor se në rastin konkret bëhet fjalë për marrëdhënie pune të karakterit të përkohshëm në kohëzgjatje prej tri viteve është i pabazuar, sepse Limak Kosovo ka vazhduar subjektivitetin juridik të ish-Aeroportit të Prishtinës dhe është trashëgimtar juridik i tij, që do të thotë se ka marrë përgjegjësi ndaj punëtorëve të Aeroportit, kështu që paditësit duhet t'i merret parasysh puna e tij në këtë aeroport që nga data 21.11.2003. Duke pasur parasysh që ky vend i punës në të cilin ka punuar paditësi edhe më tutje ekziston dhe se paditësi këto punë i ka kryer për 10 vite, rezulton se ato janë të karakterit të përhershëm".*

46. E katërta në lidhje me pretendimin e parashtruesit (iv) Se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP, sipas të cilës parashtruesi i kërkesës merr detyrimin për të mbajtur punëtorët në punë brenda 3 (tri) viteve.

47. Lidhur me pretendimet konkrete të parashtruesit të kërkesës për zbatueshmërinë e nenit 9. 18 të MPPP-së, Gjykata Supreme arsyetoi se "*Gjykata vlerësoi edhe thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë nuk kanë marrë për bazë faktin ligjor dhe atë të nenit 9.18 të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kompanisë Private "Limak" të datës 12.8.2010, në bazë të kësaj marrëveshje Kompania "Limak" merr obligim që punëtorët t'i mban në punë për 3 vite, ku pas kësaj periudhe nuk mbart asnjë përkufizim pas përvjetorit të tretë të datës së hyrjes në fuqi të kontratës së punës, gjykata vlerëson si të pabazuara pasi që e paditura ka vazhduar subjektiviteti e ish Aeroportit të Prishtinës duke marrë përgjegjësinë ndaj punëtorëve të Aeroportit dhe se nuk ka asnjë arsye ligjore dhe se e paditura ka mundur ta ndërprenë marrëdhënien e punës vetëm në kushtet e parapara me nenin 70 të Ligjit të Punës e kurrsesi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij Ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës.*

Në rastin konkret me njoftim, ashtu siç ka vepruar e paditura, nuk ka pas mundësi që paditëses të mos i vazhdohet kontrata e punës ku kontrata e saj e punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar".

48. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu thirret në Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese, duke pohuar se "aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e Aktgjykimit të asaj gjykate por se Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material".

49. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se rasti në fjalë dallon nga rasti pranë nesh për arsyet si në vijim: (i) çështja e procedurës disiplinore ndaj punëtorit të parashtruesit në atë rast ishte trajtuar në mënyra të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) ishte e paqartë baza juridike me të cilën është zhvilluar procedura disiplinore; dhe (iii) kishte elemente kontradiktore në vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta. Për më tepër, Gjykata e Apelit kishte zbatuar dhe kishte përdorur për arsyetim një Udhëzim Administrativ i cili derivonte nga një Rregullore për Shërbyesit Civilë, e jo nga Ligji i Punës. Ky argument edhe pse ishte i ngritur nga parashtruesi i kërkesës në atë rast, nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH,* Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).

50. Gjykata së pari thekson se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e gjendjes faktike apo aplikimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç nëse gabimet dhe zbatimi i gabuar i ligjit nuk janë të tilla që shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë *(Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, GJEDNJ, 1999-I).

51. Megjithatë, para së gjithash është detyrë e gjykatave të rregullta t'i zgjidhin çështjet e interpretimit të rregullave të brendshme ligjore. Kjo veçanërisht vlen për interpretimin e të drejtës materiale dhe procedurale nga ana e gjykatave (*Pekinel kundër Turqisë*, nr. 9939/02, paragrafi 53, 18 mars 2008). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën në tërësi dhe me parimin e sigurisë juridike, të garantuara me nenin 6 të KEDNJ-së

52. Gjykata përsërit se neni 6 i Konventës dhe neni 31 i Kushtetutës, i obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të parashtruesit të kërkesës. (Shih *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, Seria A. nr. 288, f. 20, para. 61). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmërinë e parashtresave të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Prandaj, pyetja nëse gjykata ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.

53. Gjykata si rrjedhojë, konstaton se parashtruesi ka mundur të përfitojë nga një procedurë kontradiktore, ai ka mundur, në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesë pretendime dhe dëshmi që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij, kishte mundësi që të kundërshtonte në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta kishin dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, të shikuara objektivisht, konsideroheshin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, arsyet faktike dhe ligjore të vendimit të kontestuar ishin paraqitur në mënyrë të detajuar, prandaj procedurat, të marra si tërësi, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).

54. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është shkelur me vendimet e autoriteteve publike.

55. Duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës dështoi të paraqesë prova, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata nuk do të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtruesit të kërkesës për shkak që shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me nenet 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës i pretendon si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

56. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).

57. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 27 maj 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Arta Rama-Hajrizi

KI02/19, KI03/19, KI04/19 dhe KI05/19, Parashtrues: Halil Mustafa dhe 3 të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së 4 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 27 korrikut 2011 dhe 14 tetorit 2013

Halil Mustafa (KI02/19), Zeqir Rexhepi (KI03/29), Remzi Rushiti (KI04/19), Hasan Geci (KI05/19), Aktvendim për papranueshmëri, miratuar më 20 qershor 2019, publikuar me 17 korrik 2019

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, "Ngritja e Zërit", dëmet e luftës, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, kundër Qeverisë së Serbisë, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial që iu shkaktua atyre gjatë luftës.

Gjykatat e rregullta u shpallën jokompetente për të vendosur në këtë çështje dhe në fund, Gjykata Supreme duke iu referuar dispozitave përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kishte arsyetuar se për këto raste vlejnë normat e së drejtës ndërkombëtare, për të cilat konteste gjykatat e vendit nuk janë kompetente për të vendosur, por kompetente në këtë çështje juridike është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Kuvendit të Serbisë.

Parashtruesit e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese pretenduan se u janë shkelur të drejtat e tyre të parapara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 21, 22, 53 dhe 54. Parashtruesit e kërkesës kishin tri kategori të pretendimeve kryesore: (i) zbatimin e parimit "*per loci*" [*ratione loci*] (ii) detyrimin për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe (iii) të drejtën e tyre për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për qasje në drejtësi.

Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, arsyetoi se përfundimet e gjykatave të rregullta janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve dhe interpretimeve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës dhe atyre iu është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesin argumentet dhe interpretimet ligjore të cilat i konsiderojnë të rëndësishme për rastet e tyre. Gjykata Kushtetuese, gjithashtu rikujtoi dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në disa raste ku janë potencuar barrierat procedurale që imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër. Gjykata, po ashtu, e konsideroi të rëndësishme të theksojë faktin se gjykatat e rregullta të Kosovës nuk kanë gjykuar mbi të drejtën e parashtruesve të kërkesës për të kërkuar kompensimin e dëmit, por vetëm lidhur me

kompetencën territoriale të gjykatave të Kosovës për të zhvilluar procedurë kundër një shtetit tjetër.

Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme, ndërsa në njërën kërkesë (KI05/19) konstatoi se ajo është dorëzuar jashtë afatit ligjor.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI02/19, KI03/19, KI04/19 dhe KI05/19

Parashtrues

Halil Mustafa dhe 3 të tjerë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së 4 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të nxjerra ndërmjet 26 marsit dhe 10 tetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KI02/19 është dorëzuar nga Halil Mustafa; Kërkesa KI03/19 është dorëzuar nga Zeqir Rexhepi; Kërkesa KI04/19 është dorëzuar nga Remzi Rushiti dhe Kërkesa KI05/19 është dorëzuar nga Hasan Geci.

2. Të gjithë të lartcekurit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës) janë me banim në Komunën e Skenderajt dhe përfaqësohen nga Jahir Bejta, drejtor i shoqatës "Ngritja e Zërit".

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë 4 vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), si në vijim:

25. Halil Mustafa - Aktvendimi Rev.nr. 279/2018, i 6 shtatorit 2018;

26. Zeqir Rexhepi - Aktvendimi Rev.nr. 305/2018, i 10 tetorit 2018;

27. Remzi Rushiti - Aktvendimi Rev.nr. 221/2018, i 31 korrikut 2018;

28. Hasan Geci - Aktvendimi Rev.nr. 65/2018, i 26 marsit 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 15 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 janar 2019, parashtruesit dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Me 10 janar 2019, Jahir Bejta në cilësinë e të autorizuarit të parashtruesve të kërkesës dhe në cilësi të drejtorit të shoqatës "Ngritja e Zërit" dorëzoi në Gjykatë një shkresë e cila, edhe pse nuk i referohet shprehimisht asnjë rasti konkret në Gjykatë, përsëritë pretendimet dhe argumentet që përmbajnë kërkesat e parashtruesve.

8. Më 1 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi për rastin KI02/19 gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të

përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Bajram Ljatifi.

9. Të njëjtën ditë, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI03/19, KI04/19, KI05/19 me kërkesën KI02/19.

10. Më 19 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.

11. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre.

12. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Ndërmjet 27 korrikut 2011 dhe 14 tetorit 2013, parashtruesit e kërkesës në mënyrë individuale parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj (më tutje: Gjykata Themelore) kundër Qeverisë së Republikës së Serbisë, për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale që iu shkaktuan atyre gjatë luftës, ndërmjet viteve 1998 dhe 1999.

14. Përgjatë periudhës 17 shtator 2013 - 27 tetor 2015, Gjykata Themelore, me vendime individuale, hodhi poshtë paditë e parashtruesve të kërkesës dhe u deklarua jokompetente për të vendosur.

15. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesa individuale ndaj vendimeve të Gjykatës Themelore, pranë Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Parashtruesit kërkuan që vendimet e Gjykatës Themelore të anulohen dhe kërkesat e parashtruesve të kërkesës të shpallen të pranueshme.

16. Ndërmjet 28 gushtit 2017 dhe 5 korrikut 2018, Gjykata e Apelit nxori vendime të ndara duke refuzuar secilën nga ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe duke vërtetuar vendimet e Gjykatës Themelore.

17. Secili nga parashtruesit e kërkesës, në mënyrë individuale, parashtroi kërkesë të veçantë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Ata kërkuan që kërkesat e tyre për revizion të

aprovohen, vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore të anulohen dhe çështja juridike e tyre të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën Themelore. Parashtruesit e kërkesës pretenduan se ekzistojnë dispozita të tjera të Ligjit për Procedurën Kontestimore me të cilat rregullohet çështja e kompetencës për rastet e tyre. Ndër të tjera, sipas tyre në këtë rast do duhej të zbatohej dispozita e nenit 28 të Ligjit për Procedurën Kontestimore e cila ka të bëje me kompetencën e gjykatave në kontestet me element ndërkombëtar.

18. Në mes të datave 26 mars dhe 10 tetor 2018, Gjykata Supreme nxori vendime të ndara [shih paragrafin 3 të këtij Aktvendimi], duke refuzuar kërkesat për revizion të secilit prej parashtruesve të kërkesës si të pabazuara. Argumentet kryesore të Gjykatës Supreme, në secilin prej këtyre vendimeve, ishin si në vijim:

> "*Duke pasur parasysh* [dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore] *LPK si dhe faktin se me padi është paditur Republika e Serbisë- Qeveria R.S. ne Beograd, […] në rastin konkret fjala është për kontest juridiko-pasuror në shtetin e huaj, vlejnë normat e së drejtës ndërkombëtare, për të cilin kontest gjykata e vendit nuk është kompetente për të vendosur, andaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e nenit 18.3 dhe nenit 39 par. 1 e 2 të LPK-së, me rastin kur janë shpallë inkompetente për të gjykuar këtë çështje juridike dhe kanë hedhe poshtë padinë* [e parashtruesve të kërkesës], *ngase e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë, ashtu që, [dhe] selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë si palë e paditur nuk ndodhet në territorin e Gjykatave të Republikës së Kosovës.*
> *[…]*
> *Dispozita e nenit 28 të LPK-së, në të cilën thirren parashtruesit e kërkesës, e me të cilën caktohet kompetenca e gjykatave tona në kontestet me element ndërkombëtar (të huaj), nuk mund të zbatohet në rastin konkret, nga se këtu nuk kemi të bëjmë as me persona fizik të huaj e as me persona juridik të huaj, por me shtet të huaj, me të cilin deri ne momentin aktual shteti i Kosovës, në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka të lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare […] për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve. […] Nuk qëndron as pretendimi i revizionit* [të parashtruesve të kërkesës] *se në rastin konkret kemi të bëjmë me kompetencën territoriale të zgjedhur sipas nenit 47, 51 dhe 61 të LPK-së, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, këto dispozita nuk kanë të bëjnë*

me rastin konkret [...], gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë aplikuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, duke marrë parasysh edhe arsyet tjera qe u theksuan më lartë".

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

19. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë identike, prandaj, Gjykata i prezanton ato si pretendime të njëjta për të gjithë parashtruesit e këtyre kërkesave të bashkuara.

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 21, [Parimet e Përgjithshme], 22, [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 15 të DUDNJ-së.

21. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta "*kanë zbatuar gabimisht ligjin e aplikuar referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore [...], nga se, gjykata territorialisht kompetente për gjykime të çështjeve juridike, kurdoherë është gjykata në territorin e së cilës është kryer krimi, dëmtimi moral përkatësisht material! Ky definicion e qëndrim juridik valid përkon edhe me interesin e palës së dëmtuar, parimin e ekonomisë në procedurat gjyqësore dhe administrative, si dhe në përputhje me principin ndërkombëtar –per loci, drejtimi i aktpadive në bazë të vendit ku është kryer krimi".*

22. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 21 paragrafi 1 të Kushtetutës, pretendojnë se gjykatat e rregullta "*nuk i kanë aplikuar standardet e avancuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Njëra nga standardet është dhënia e mundësisë palës së dëmtuar për inicimin e çështjes së kompensimit të demit moral dhe material të shkaktuar si rezultat i veprimit direkt nga ana e autoriteteve serbe [...]".*

23. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 22 të Kushtetutës pretendojnë që përderisa *"të drejtat e njeriut të garantuara me Konventat, Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare kanë prioritet në rast konflikti ndaj ligjeve dhe dispozitave tjera të organeve publike"*, rrjedhimisht, *"paraqitja e aktpadive pranë gjykatave vendore është e mbështetur edhe në nenin 6 të KEDNJ-së dhe pikën 15 të DUDNJ-së [...]".*

24. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pohojnë se *"Obligimi për Aplikimin e Konventave të Gjenevës të vitit 1994 është paraparë edhe me Ligjin Ndërkombëtar Humanitar të Kosovës"*. Sipas parashtruesve, gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat kushtetuese sepse nuk kanë aplikuar dispozitat e konventave ndërkombëtare, si kategori të rendit juridik të brendshëm.

25. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 54 të Kushtetutës, gjithashtu deklarojnë se *"u është mohuar e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, e drejta për qasje në drejtësi në nivel kombëtar si dhe garancitë institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut"*.

26. Parashtruesit e kërkesës iu referohen disa shembujve nga praktika ndërkombëtare ku, sipas tyre, viktimat e Luftës së Dytë Botërore janë lejuar *"të paraqesin aktpadi individuale në gjykatat vendore për kompensim të dëmit të shkaktuar nga Gjermania"*. Në këtë drejtim, ata specifikojnë se në rastet e Greqisë dhe Italisë, individëve u është dhënë mundësia për të kërkuar kompensim për *"dëmet e shkaktuara nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore në pajtim me parimin ndërkombëtar 'per loci'."*

27. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata, anulimin e vendimeve të Gjykatave të rregullta si dhe *"të kërkoj nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – dega Skenderaj për të riproceduar dhe gjykuar konform me ligjin e aplikueshëm dhe praktikat e mira gjyqësore çështjen juridike për kompensimin e dëmit moral e material [...]."*

28. Përveç të gjithë parashtruesve tjerë, parashtruesi i kërkesës Hasan Geci (KI05/19) ka bashkangjitur dhe një shkresë, me të cilën kërkon që afati të kthehet në gjendjen e mëparshme në pajtim me Nenin 50 [Kthimi në gjendje të mëparshme] të Ligjit, duke theksuar se *"nga data 1 qershor 2018 deri me 3 shtator ka qenë me qëndrim jashtë vendit tek vëllai në Gjermani"* dhe kështu nuk kishte mundur ta parashtronte kërkesën brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajve.

Pranueshmëria e kërkesave

29. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

30. Si shënim fillestar, Gjykata vëren se objekti i çështjes së këtyre kërkesave të bashkuara si dhe pretendimet e ngritura në këto kërkesa,

janë të ngjashme me një mori kërkesash tjera për të cilat Gjykata veçse ka vendosur. (Shih, *mutatis mutandis,* rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17, *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 tetorit 2017, rastet KI KI97/17, KI99/17, K115/17 dhe KI121/17 *Mala Mala, Ali Salihu, Nurije Beka dhe Xhevat Xhinovci,* Aktvendim për papranueshmëri i 10 janarit 2018 dhe rastet nr. KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, *Fehmi Hoti dhe 15 te tjerë,* Aktvendim për papranueshmëri i 19 shkurtit 2019, të gjitha rastet e "Ngritja e Zërit"; shih po ashtu dispozitat ligjore relevante të cituara në ato raste).

31. Duke iu kthyer rrethanave të rasteve konkrete, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës të cilët përcaktojnë se:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

32. Në vazhdim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës], 49 [Afatet] dhe 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 48
> [Saktësimi i kërkesës]
>
> *Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*
>
> Neni 49
> [Afatet]
>
> *Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."*
>
> Neni 50

[Kthimi në gjendjen e mëparshme]

Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.

33. Më tutje, Gjykata i referohet edhe Rregullores së punës, konkretisht pikës (c) të nën paragrafit (1) dhe paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], të cilët përcaktojnë si në vijim:

(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit,

(...)

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

Sa i përket 3 parashtruesve të kërkesës [KI02/19, KI03/19 & KI04/19]

34. Gjykata konstaton se te tre parashtruesit e kërkesës [duke mos përfshirë kërkesën KI05/19 që do të trajtohet veçmas], janë palë të autorizuara, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë sqaruar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

35. Më tutje, lidhur me këto tri kërkesa, Gjykata duhet të shqyrtojë se a plotësohet kriteri i pranueshmërisë i përcaktuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta iu kanë shkelur disa të drejta të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ, duke vënë theksin posaçërisht në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe në të drejtën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta e kanë interpretuar gabimisht ligjin në fuqi kur i janë referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore. Ata, më tej, pretendojnë se gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi është gjykatë kompetente për gjykim në çështjet e tyre.

37. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin nga gjykatat e rregullta të dispozitave përkatëse ligjore që rregullojnë kompetencën e tyre territoriale, gjegjësisht kompetencën për t'u marrë me paditë e parashtruesve.

38. Gjykata rithekson qëndrimin e saj se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse ligjore, parimisht, hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt". (Shih *mutatis mutandis,* Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), të 21 janar 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28; shih po ashtu *mutatis mutandis,* në lidhje me doktrinën e "shkallës së katërt", rastet e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 prillit 2012 paragrafi 33; si dhe rastet e bashkuara KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17 Parashtrues të kërkesës *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 nëntorit 2017, paragrafët 46 dhe 47).

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesve lidhur me interpretimin e bërë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore, të dispozitave përkatëse ligjore lidhur me kompetencën për gjykim në rastet e parashtruesve.

40. Gjykata Supreme, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, arsyetoi se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë

zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, kur kanë konstatuar se nuk kanë pasur juridiksion për të gjykuar në këto raste gjyqësore. Prandaj, Gjykata Supreme hodhi poshtë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, duke arsyetuar se juridiksioni i përgjithshëm territorial është në gjykatën në territorin e së cilës është selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë e cila nuk është në territorin e gjykatave të Kosovës.

41. Kështu, në disa prej vendimeve të saj (shih, për shembull, Aktvendimin në rastin Rev nr. 305/2018), Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se:

> *"[...] në bazë të dispozitës së nenit 28.2 të LPK, kur është fjala për kontestet me element të huaj, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kjo kompetencë ndërkombëtare rrjedhë shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet ligji [...] Me nenin 39.1 të LPK, është paraparë se "për gjykimin në kontestet kundër Kosovës [...] e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e kuvendit të saj. Kurse në paragrafin 2 është paraparë se 'për gjykimin në konteste kundër personave juridik të tjerë e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar.' Kështu edhe me dispozitën e nenit 54.1 të Ligjit mbi Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjit me dispozitat e shteteve tjera parashihet se në kontestet juridiko-pasurore kompetenca e gjykatës së vendit ekziston në qoftë se në vendin tonë ndodhet pasuria e të paditurit apo sendi që kërkohet me padi."*

42. Gjykata Supreme, më tej, ka specifikuar se në rastin e parashtruesve të kërkesës "*kemi të bëjmë me shtet të huaj, me të cilin deri ne momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve*".

43. Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të të gjitha argumenteve dhe interpretimeve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesve iu është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesin argumentet dhe interpretimet ligjore të cilat i konsiderojnë të rëndësishme për rastet e tyre.

44. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se procedurat në gjykata të rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe se nuk

mund të argumentohet pretendimi për interpretime arbitrare ligjore nga ana e gjykatave të rregullta.

45. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me *"të drejtën e tyre në mbrojtje gjyqësore dhe qasje në drejtësi"*, Gjykata vë në pah edhe praktikën e GJEDNJ, në të cilën është e detyruar të referohet sipas nenit 53 të Kushtetutës. Mbi këtë të fundit, Gjykata po ashtu vë në pah edhe praktikën e saj gjyqësore të ndërtuar mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku është potencuar se ekzistojnë barriera procedurale të cilat i imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve – si një nga parimet themeltare të së drejtës ndërkombëtare publike – në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër. (Shih rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, parashtrues Fehmi Hoti dhe 15 të tjerë, Aktvendim për papranueshmëri i 30 janarit 2019, paragrafët 58 dhe 59, shih, *mutatis mutandis*, edhe rastet e GJEDNJ-së të cituara në rastin e sipërpërmendur të Gjykatës Kushtetuese, *Jones dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat 34356/06 dhe 40528/06, Aktgjykimi i 14 janarit 2014 dhe *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa 35763/97 *Aktgjykimi i 21 nëntorit 2001*).

46. Për më tepër, në rastin *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ ka argumentuar si në vijim: "*E drejta e qasjes në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve, nëse nuk preket thelbi i së drejtës. Kufizime të tillë duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale. Njohja e imunitetit sovran të shteteve në procedura civile ndjekë qëllimin legjitim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare [...]. Për sa i përket proporcionalitetit, për sa është e mundur, Konventa duhet të interpretohet në harmoni me rregullat tjera të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me imunitetin e shteteve. Kështu, masat e ndërmarra nga shteti të cilat pasqyrojnë rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin e shteteve, në parim, nuk mund të shikohen si kufizim jo-proporcional i të drejtës për qasje në gjykatë.*" Një qëndrim të tillë, për sa i përket tensionit në mes të parimit të imuniteti sovran të shteteve dhe të drejtës për qasjes në drejtësi (gjykatë), e ka theksuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. (Shih, për shembull, rastin: *Gjermania kundër Italisë; Greqia si palë intervenuese*, Aktgjykimi i 3 shkurtit 2012).

47. Në dritën e argumenteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksoj faktin se vendimet e gjykata të rregullta të

Kosovës, në rastet e parashtruesve të kërkesës, nuk kanë trajtuar të drejtën e tyre për të kërkuar kompensimin e dëmit, por vetëm kompetencën territoriale të gjykatave të Kosovës për të zhvilluar procedurë kundër një shtetit tjetër.

48. Ndërsa duke iu referuar dhe pretendimeve të parashtruesve rreth aplikimit të Konventës së Gjenevës në rastet e tyre gjyqësore, Gjykata vëren se parashtruesit vetëm i janë referuar kësaj Konvente por nuk kanë ofruar argumente të mëtutjeshme në lidhje me këtë pretendim. (Shih, për autoritetin e fundit në këtë drejtim, rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, cituar më lart, paragrafi 45).

49. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo të gjykatave të tjera të rregullta, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, paragrafi 33).

50. Gjykata gjithashtu verën se faktet e paraqitura dhe pretendimet e parashtruesve janë pothuajse identike me disa kërkesa të mëhershme, për të cilat Gjykata ka vendosur se janë të papranueshme, si qartazi të pabazuar mbi baza kushtetuese. (Për autoritetin më të fundit në këtë drejtim, shih rastet e bashkuara të Gjykatës Kushtetuese, KI96/18, KI97/18, KI98/18, KI99/18, KI100/18, KI101/18, KI102/18, KI103/18, KI104/18, KI105/18, KI106/18, KI107/18, KI116/18, KI117/18, KI119/18 dhe KI125/18, cituar më lart, rastet KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17, rastet KI97/17, KI99/17, K115/17 dhe KI121/17). Të gjitha këto kërkesa kanë ngritur pretendime pothuajse identike me kërkesat e trajtuara në këtë vendim dhe, sikurse për ato raste, edhe në këto raste të bashkuara Gjykata konsideron se të njëjtat duhet të shpallura të pabazuara mbi baza kushtetuese.

51. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesat e parashtruesve nuk dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ-së ose DUDNJ.

Sa i përket parashtruesit të kërkesës Hasan Geci [KI05/19]

52. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata konstaton parashtruesi është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik dhe ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Megjithatë, para se të kalojë në kushtet e tjera të pranueshmëri, Gjykata duhet të vlerësojë përmbushjen e kriterit të parashtrimit të kërkesës brenda afatit katër (4) mujor, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

53. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kësaj kërkese konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 65/2018] të Gjykatë Supreme të 26 marsit 2018, ndërsa ai e ka parashtruar kërkesën KI05/19 në Gjykatë, me 9 janar 2019, pra pas afatit prej 4 (katër) muajsh.

54. Lidhur me vonesën e parashtrimit të kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi kërkon kthim në gjendjen e mëparshme në pajtim me nenin 50 të Ligjit, me arsyetimin se "*nga data 1 qershor 2018 deri me 3 shtator ka qenë me qëndrim jashtë vendit tek vëllai në Gjermani*."

55. Për të mbështetur argumentet e tij për mos prezencë fizike në Kosovë gjatë periudhës së lartpërmendur, parashtruesi paraqiti edhe mundësinë e vërtetimit përmes 2 (dy) dëshmitarëve.

56. Ne rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë që do të dokumentonte se për shkak të rrethanave objektive, që janë jashtë kontrollit të tij, nuk ka arritur që ta dorëzojë kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka siguruar dëshmi që tregojnë se kërkesa është parashtruar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mënjanimi i pengesës e që do të arsyetonte kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme, siç kërkohet me nenin 50 të Ligjit.

57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur kërkesën e tij për kthimin e afatit në gjendjen e mëparshme, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe për rrjedhojë, kërkesa e tij duhet të refuzohet.

58. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 23274/04, Aktvendim i 25

gushtit 2005 dhe po ashtu, shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI140/13, *Ramadan Cakiqi,* Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

59. Bazuar në sa më sipër, rezulton se kërkesa [KI05/19] e parashtruesit Hasan Geci është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe si e tillë është e papranueshme.

60. Si përfundim, Gjykata konstaton se:

(i) përkitazi me 3 parashtrues të kërkesës [KI02/19, KI03/19 dhe KI04/19], kërkesat e tyre janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës;

(ii) përkitazi me parashtruesin e kërkesës Hasan Geci [KI05/19], kërkesa e tij është dorëzuar jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 48 dhe 49 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (c) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI 111/18, Parashtrues të kërkesës: Dragomir Vlasačević dhe të tjerët, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0519-0001/0003, të 15 marsit 2018

KI 111/18, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, i publikuar më 30 korrik 2019.

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procesi i privatizimit, dhoma e posaçme e gjykatës supreme, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se në procedurën e zhvilluar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme atyre u ishte shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak se disa nga ankesat-sipas tyre-nuk ishin shqyrtuar fare.

Pas shikimit të dosjes së plotë të lëndës, Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk kanë provuar se ankesat e tyre nuk janë shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme apo se për shkak të "vëllimit të lëndës" këto të fundit janë "ngatërruar" dhe rrjedhimisht nuk janë vlerësuar.

Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesve është e papranueshme qartazi e pabazuar në baza kushtetuese siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI111/18

Parashtrues

Dragomir Vlasačević dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0519-0001/0003, të 15 marsit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Dragomir Vlasačević, Liljana Ivič, Slobodanka Savić, Slađana Paunović, Nataša Maksimović, Tihomir Bojković, Zlatica Nedeljković, Milorad Đokić, Desanka Nikolić, Slavica Janković, (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Žarko Gajič, avokat nga Graçanica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0519-0001/0003, të 15 marsit 2018.

3. Vendimi i lartpërmendur iu dorëzua përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës më 5 prill 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenet 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

7. Më 3 gusht 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

8. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.

9. Më 19 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

10. Më 12 mars 2019. Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që ta dorëzojë dosjen e plotë të lëndës.

11. Më 15 mars 2019, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dorëzoi dosjen e lëndës por mungonte Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015, së bashku me ankesat kundër këtij aktgjykimi.

12. Më 20 mars 2019, Gjykata sërish kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që të dorëzon Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015, së bashku me ankesat kundër këtij aktgjykimi.

13. Më 22 mars 2019, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dorëzoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, të 31 marsit 2015, së bashku me ankesat kundër këtij aktgjykimi.

14. Më 5 prill 2019, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesve që t'i dorëzon të gjitha ankesat e paraqitura kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015.

15. Më 5 prill 2019, Gjykata njoftoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit për regjistrim të kërkesës dhe po ashtu kërkoi që të dorëzon të gjitha ankesat e paraqitura kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015.

16. Më 12 prill 2019, Agjencia Kosovare e Privatizimit dorëzoi dokumente në Gjykatë por theksoi se dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me parashtruesit e kërkesës.

17. Më 23 prill 2019, përfaqësuesi i parashtruesve solli dokumente që edhe më herët kanë qenë në dispozicion të Gjykatës.

18. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesit e kërkesës kishin qenë punëtorë të ndërmarrjes shoqërore NSH "Gërmia" në Prishtinë.

20. Më 5 korrik 2007, filloi procesi i likuidimit të NSH "Gërmia". Në këtë drejtim, në të gjitha dokumentet me shkrim që u janë dërguar punonjësve, është theksuar që 5 korriku 2007 do të konsiderohet si dita e fundit e punës në NSH "Gërmia".

21. Më 20 maj 2008, ndërmarrja shoqërore NSH "Gërmia" është privatizuar.

22. Më 15, 16 dhe 17 dhjetor 2011, ishte publikuar lista përfundimtare e punëtorëve që kishin fituar të drejtën në pjesëmarrje në 20% të fitimeve nga privatizimi i NSH "Gërmia". Afati për dorëzimin e ankesave ndaj listës përfundimtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ishte caktuar 7 janari 2012.

23. Privatizimi ishte kryer në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, neni 10.4 përcakton se punëtorët që konsiderohen legjitim për pjesëmarrje në 20% të fitimit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të dëshmojnë: (i) janë punëtorë të regjistruar të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në kohën e privatizimit; dhe, (ii) se kanë qenë në listën e pagave të ndërmarrjes shoqërore për jo më pak se 3 (tri) vite.

24. Parashtruesit e kërkesës nuk ishin në listën përfundimtare të punëtorëve që kishin realizuar të drejtën për të marrë pjesë në 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Gërmia".

25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit parashtruan ankesa në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme ndaj Listës përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë realizuar të drejtën e pjesëmarrjes në 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Gërmia".

26. Më 31 mars 2015, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme (Aktgjykim SCEL-11-0070-C0001/C0115) ka refuzuar të pabazuara ankesat e parashtruesve të kërkesës për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta ndaj 20 % të fitimeve nga privatizimi i NSH "Gërmia".

    (i) Për parashtruesin Dragomir Vlasačević, (C-0044/4) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka ofruar asnjë "dëshmi themelore" për të dëshmuar marrëdhënien e punës me NSH "Gërmia" të paktën deri në vitin 1999;

(ii) Për parashtruesen Liljana Ivić, (C-0044/5) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka dëshmuar se ka punuar në NSH "Gërmia" së paku 3 (tri) vite;

(iii) Për parashtruesen Slobodanka Savić, (C-0044/7) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

(iv) Për parashtruesen Slađana Paunović, (C-0044/8) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nga viti 1996 deri 1998 ka punuar në NSH "Gërmia" porse më 8 dhjetor 1998 ka themeluar marrëdhënie pune të reja në një ndërmarrje tjetër dhe se nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

(v) Për parashtruesen Nataša Maksimović, (C-0044/13) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vlerësoi se dokumentet e dorëzuara flasin për një person tjetër dhe jo për parashtruesen e kërkesës dhe konstatoi se ajo nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për marrëdhënie pune në NSH "Gërmia".

(vi) Për parashtruesin Tihomir Bojković, (C-0044/16) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka asnjë dëshmi lidhur me të dhënat e përgjithshme të parashtruesit dhe se ai nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

(vii) Për parashtruesen Zlatica Nedeljković, (C-0044/17) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vlerësoi se dokumentet e dorëzuara flasin për një person tjetër dhe jo për parashtruesen e kërkesës dhe se ajo nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

(viii) Për parashtruesin Milorad Djokić, (C-0044/32) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka asnjë dëshmi për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe se ai nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

(ix) Për parashtruesen Desanka Nikolić, që ishte ankuar në emër të burrit të saj të ndjerë S. N., (C-0044/68) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vlerësoi se ajo/ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për marrëdhënie pune në NSH "Gërmia" dhe se nuk i

plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

(x) Për parashtruesen Slavica Janković, (C-0084) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se ankesa e saj ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor.

27. Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme në pajtim me nenin 10.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dha këshillën juridike duke ua kujtuar se mund të paraqesin ankesë me shkrim brenda 21 (njëzetenjë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit me shkrim.

28. Më 8 prill 2015, aktgjykimi i lartpërmendur iu dorëzua përfaqësuesit për të gjithë parashtruesit e kërkesës kurse për parashtruesen Slavica Janković iu dorëzua më 5 maj 2015.

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kanë parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe e kanë bashkëngjitur ankesën e 27 prillit 2015 dhe konfirmimin e pranimit të ankesës nga Posta e Kosovës, e cila ishte e 21 prillit 2015.

30. Më 27 korrik 2017, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi AC-I-15-0062-A0033) kishte marrë vendim për të gjitha ankesat që ishin paraqitur lidhur me aktgjykimin e lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme nuk kishte vendosur fare për parashtruesit e kërkesës. Çështja e mosvendosjes nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme për ankesën e parashtruesve përbën thelbin e kërkesës së tyre në Gjykatë dhe do të shtjellohet në paragrafët në vijim.

31. Më 29 gusht 2017, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme ndaj aktgjykimit të lartpërmendur, duke theksuar se përmes postës në Prishtinë më 21 prill 2015 në të njëjtin zarf janë vënë dy ankesa të ndryshme me dokumentacion shtesë. Ai shtoi se për shkak të vëllimit të lëndës dhe me siguri për shkak të ndonjë gabimi teknik ankesa për parashtruesit e kërkesës ka ngelur pa u vlerësuar me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017. Për atë arsye, sipas përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, është vendosur për një grup prej 5 (pesë) ankuesish gjersa për 11 (njëmbëdhjetë) ankues tjerë (parashtruesit e kërkesës), Dhoma e Posaçme nuk ka vendosur fare. Si dëshmi, përfaqësuesi i parashtruesve, ofroi: (i) Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017; (ii) kopja e vërtetimit të pranuar nga posta nr. 027570 e 21 prillit 2015 e lëshuar në Prishtinë. Në fund,

përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, kishte kërkuar që të merret një vendim meritor dhe që ata të përfshihen në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën në 20% nga privatizimi i NSH "Gërmia" në Prishtinë.

32. Më 15 mars 2018, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (Aktvendim AC-I-17-0519-0001/0003) e hodhi poshtë të papranueshme ankesën e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme arsyetoi: *"... Kolegji i apelit ka vërtetuar që aktgjykimi i kontestuar dërguar përfaqësuesit të ankuesve A0001 më 4 prill 2015, respektivisht 5 tetor 2015, derisa ankesat e parashtruara DHPGJS-së të 29 gushtit 2017, qartë janë jashtë afatit ligjor. Prandaj, në bazë të nenit 10 pika 6 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, ankesat e ankuesve hidhen poshtë si të papranueshme, kurse vërtetohet aktgjykimi i kontestuar".*

Dispozitat ligjore relevante

UNMIK/Rreg/2003/13, 9 maj 2003, mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore

> *10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.*
>
> *10.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga individi apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të

Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

34. Parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë: *"... në të njëjtin zarf janë vënë dy ankesa të ndryshme me dokumentacion shtesë [...] se për shkak të vëllimit të lëndës dhe me siguri për shkak të ndonjë gabimi teknik ankesa për parashtruesit e kërkesës ka ngelur pa u vlerësuar me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017".*

35. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: "*Arsyetim i tillë, ligjërisht është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me arsyet e marrjes së aktgjykimit. Gjegjësisht, gjykata, gjatë procedurës, me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar AC-I-15-0062/A0033 të 27.07.2017, plotësisht e ka anashkaluar faktin që ankesa në aktgjykimin e shkallës së parë SCEL-11-0070-C44 të 31.03.2015, është parashtruar në kohën e duhur në përputhje me dispozitat e nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në afat prej 21 ditësh nga dita e pranimit dhe me këtë, ka mohuar të drejtën e palëve të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës, e cila garanton barazi para Ligjit, si dhe nenit 32 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën në mjet juridik të barabartë para Ligjit si dhe nenit 54 të Kushtetutës lidhur me nenin 6.1, me të cilin garantohet e drejta në gjykim të drejt dhe ligjin 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, me të cilin garantohet e drejta për mjetin efektiv juridik, gjë që në këtë rast nuk është garantuar, duke marrë parasysh që ankesa, deri më sot nuk është marrë në shqyrtim".*

36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: "*Përfaqësuesi i autorizuar i tregon gjykatës që me trajtimin e kërkesës për gjetje dhe vendimmarrje sipas ankesës së paraqitur, si ankesën e paraqitur, gjykata ka krijuar pasiguri ligjore, duke marrë parasysh që me vendimet e përmendura vjen në përfundim që ankesa nuk ekziston fare si e paraqitur ndonjëherë dhe me të cilën janë shkelur të gjitha parimet e Ligjit, Kushtetutës dhe Konventës Evropiane e cila garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Po ashtu, me marrjen e këtij aktvendimi, parashtruesve iu është mohuar edhe e drejta në pjesën e 20% nga privatizimi, duke pasur parasysh që kjo e drejtë bie në konceptin e pasurisë e përfaqësuesi i autorizuar është i mendimit që parashtruesit posedojnë të drejtën në pagesën e kësaj pjese, duke marrë parasysh që në rastin e parashtruesve tjerë pas marrjes së vendimit përfundimtar AC-I-15-0062-A0033 të 27.07.2017, e gjendja faktike në procedurë dhe faktet e ofruara janë pothuajse identikë, kështu që përfaqësuesi i autorizuar është i mendimit që ka ardhur deri te shkelja e të drejtave për gëzim paqësor të pasurisë së*

garantuar me Protokollin 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut".

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> *[...]*

39. Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që parashikon:

> *[Kërkesa individuale]*
>
> *"1.Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike nëse pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *"2.Individi mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

40. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

41. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-17-0519-0001/0003] e 15 marsit 2018 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

42. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

43. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

44. Parashtruesit e kërkesës, specifikisht pretendojnë: *"... në të njëjtin zarf janë vënë dy ankesa të ndryshme me dokumentacion shtesë [...] se për shkak të vëllimit të lëndës dhe me siguri për shkak të ndonjë gabimi teknik ankesa për parashtruesit e kërkesës ka ngelur pa u vlerësuar me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017"*.

45. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë se për shkak të lëndës së tyre voluminoze, ankesa drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme "ka pasur mundësi të jetë ngatërruar" në shkresat e lëndës dhe kështu ka mbetur e pagjykuar. Parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të mosvendosjes sipas ankesës së tij, ka ardhur deri te shkelja e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

46. Ndërsa shkeljet e neneve të tjera 24 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6.1 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i arsyeton si pasojë e shkeljes së nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata do të lëshohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës.

47. Gjykata vëren se, në rastin konkret, barra e të provuarit bie mbi parashtruesit e kërkesës. Nga dokumentet e dorëzuara, parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të provojnë se mosgjykimi i ankesës së tyre nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, nëse ka pasur të tillë, mund t'i ngarkohet këtij të fundit.

48. Gjykata thekson se ka kryer shikimin e dosjes së plotë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe se në dosjen e plotë të rastit nuk është regjistruar ankesa, të cilën përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës pretendon se e ka parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, të 31 marsit 2015.

49. Gjykata po ashtu vëren se ankesa kundër aktgjykimit në fjalë nuk është regjistruar as pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila ishte palë kundërshtare në kontest, dhe e cila, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, i është drejtuar edhe atyre.

50. Më tej, Gjykata vëren se ka një mospërputhje ndërmjet pretendimit të përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës dhe gjendjes faktike bazuar në dokumentet e dorëzuara me kërkesën nr. KI111/18. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës pretendon se më 21 prill 2015 ka paraqitur

ankesë kundër Aktgjykimit nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, të 31 marsit 2015, kurse nga dokumentet e dorëzuara rezulton se ankesën kundër aktgjykimit në fjalë, figuron data 27 prill 2015. Ndërsa fletëkthesa, të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar në Gjykatë, mbante datën e 21 prillit 2015.

51. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se ankesa për të cilën përfaqësuesi i parashtruesve pretendon se është dorëzuar në të "njëjtin zarf" së bashku me ankesën tjetër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme apo se për shkak të "vëllimit të lëndës" kjo e fundit është "ngatërruar" dhe nuk ka arritur ta vlerësojë ankesën e pretenduar.

52. Gjykata gjithashtu vëren se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës,* nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

53. Në rastin konkret, duke i vlerësuar procedurat në tërësi, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi i 31 marsit 2015) kishte konstatuar se parashtruesit e kërkesës nuk i kishin plotësuar kushtet ligjore për t'u konsideruar punëtorë me të drejta ndaj 20% të fitimit nga privatizimi i NSH "Gërmia". Kurse, në njërën anë, çështja e gabimit teknik që pretendohet se ka çuar te mosgjykimi i ankesës nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (Aktgjykim AC-I-1S-0062-A0033, 27 korrik 2017) nuk është provuar nga parashtruesit e kërkesës, derisa, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme ka konstatuar se ankesat e parashtruesve të kërkesës janë të paafatshme, në anën tjetër.

54. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesve të kërkesës iu është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ata kanë mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsideruan relevante për rastin e tyre; se atyre u është dhënë mundësia që të kontestojnë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tyre janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet

faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

55. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (*Ibidem*, rasti nr. KI118/17; po ashtu shih, rastin e Gjykatës nr. KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi,* Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).

56. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se "drejtësia" që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi "substanciale", por drejtësi "procedurale". Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).

57. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

58. Gjykata më tej vëren se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës

nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

59. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

60. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Arta Rama-Hajrizi

KI18/19, Parashtrues: Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA". Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Ministrisë së Administratës Publike, KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018

KI18/19, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, publikuar më 30 korrik 2019.

Fjalët kyç: Kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, Aktvendim për papranueshmëri, kërkesë e parakohshme

Parashtruesi i kërkesës është regjistruar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut në fuqi në kohën e Administratës së UNMIK-ut (nr. 1999/22) në Kosovë më 9 dhjetor 2004, ndërsa më 11 dhjetor 2009 ai ka kryer para-regjistrimin në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) të Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin e ri nr. 03/L-134 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Parashtruesi i kërkesës ka kryer aktivitetet e tij ~~pa pengesë~~ deri më 17 shtator 2014, kur MAP-i nxori vendimin për pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë së tij, me arsyetimin se*: "Organi kompetent i sigurisë ka parashtruar kërkesë për pezullimin e aktiviteteve të OJQ-së "Asociacioni për kulturë, edukim dhe arsim (AKEA)"*

Në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018, MAP-i nxori 4 vendime me të cilat kishte vazhduar pezullimin e punës së parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës kontestoi çdo vendim të MAP-it për pezullimin e kryerjes së veprimtarisë së tij duke u ankuar pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, megjithatë të gjitha ankesat e parashtruesit të kërkesës u refuzuan.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka iniciuar dy procedura (administrative dhe gjyqësore) në lidhje me anulimin e vendimeve të MAP-it.

Procedura e parë administrative e 18 nëntorit 2014, lidhur me anulimin e vendimit të parë të MAP-it të 17 shtatorit 2014, rezultoi në 3 vendime gjyqësore në dy instanca gjyqësore, gjë që çoi që lënda sipas aktgjykimit [A. nr. 2369/2018] të Gjykatës Themelore në procedurë të përsëritur të gjendet aktualisht prapë pranë MAP-it.

Gjykata Themelore, ndër të tjera, në aktgjykim konkludoi se kishte mangësi në vendimet e MAP-it dhe se ato *"pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe në atë drejtim, gjykata e obligoi autoritetin e*

paditur (MAP) që në procedurë të përsëritur të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe më pas të korrigjojë mangësitë e cekura, të marrë vendim të drejtë të bazuar në ligj".

Në procedurën e dytë gjyqësore, të cilën parashtruesi i kërkesës e inicioi në Gjykatën Themelore më 1 nëntor 2018, ~~dhe~~ kërkoi që të ndalohej ekzekutimi i vendimit të MAP-it të 25 shtatorit 2018, derisa MAP-i të nxjerrë vendim të ri sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Kjo procedurë gjyqësore gjendet aktualisht në Gjykatën e Apelit.

Parashtruesi i kërkesës deklaroi në Gjykatën Kushtetuese se me vendimet e MAP-it i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 2 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 44 [Liria e Asociimit], paragrafi 3 i nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe organizimit), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Parashtruesi i kërkesës veçanërisht theksoi se "*ai nuk ka mjete efektive juridike në dispozicion të tij me të cilat do të kishte mbrojtur të drejtat e tij kushtetuese, dhe në pajtim me këtë ai kërkoi që Gjykata Kushtetuese ta pranojë kërkesën dhe të hyjë në thelb të lëndës, si dhe të vlerësojë nëse procedurat e deritanishme të MAP-it dhe gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ".*

Gjykata, për t'iu përgjigjur kërkesës së parashtruesit nëse në rastin konkret ai duhet të përmbushë kushtet formale të kërkuara për shterimin e të gjitha mjeteve juridike, ose mund të lirohet nga ky detyrim, shqyrtoi si praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së po ashtu edhe praktikën e saj gjyqësore, në të cilën janë vendosur parimet themelore dhe parimet e shterimit të mjeteve juridike.

Në lidhje me këtë, Gjykata mori parasysh *"Konceptin e shterimit të mjeteve juridike"* i cili është përcaktuar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe konkludoi se së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës në rastin konkret kishte në dispozicion mjetet juridike të parapara me ligj dhe me përdorimin e të cilave ai do të mund të mbronte të drejtat e tij kushtetuese, si dhe të drejtat e parapara me KEDNJ, para se ta parashtrojë kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese.

Në pajtim me këtë, Gjykata trajtoi çështjen e efektivitetit të mjeteve juridike në rastin konkret të cilat i kishte parashtruesi i kërkesës në dispozicion të tij, në pajtim me ligjin, dhe në lidhje me këtë, Gjykata bazuar në ~~mori~~ testin e GJEDNJ-së ka analizuar këto pyetje.

a) a ka qenë mjeti juridik në rastin e parashtruesit të kërkesës i paraparë me ligjin, i cili ishte i zbatueshëm;

b) a ka qenë mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës;

c) a ka qenë mjeti juridik efektiv në praktikë, si dhe

d) a ka ekzistuar ndonjë pengesë dhe rrethana të veçanta në shfrytëzimin e mjetit juridik.

Në bazë të testit të analizuar në mënyrë të detajuar nga Gjykata në aktvendimin e saj për papranueshmërinë e kërkesës, konstatoi a) se parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion gjatë gjithë procedurës mjetin juridik të paraparë me ligj, b) i cili ishte në çdo kohë i qasshëm, c) i cili në pajtim me ligjin e zbatueshëm parasheh efikasitetin dhe efektivitetin e tij në praktikë, dhe d) se shfrytëzimi i mjetit juridik të paraparë me ligj nuk është i kushtëzuar nga ndonjë rrethanë ose pengesë e veçantë.

Në këtë rast Gjykata gjeti se, procedurat e iniciuara nga parashtruesi i kërkesës janë ende në fazën e vendimmarrjes, dhe nga kjo konkludoi se kërkesa e parashtruesit në Gjykatën Kushtetuese ishte e parakohshme.

Gjykata veçanërisht theksoi faktin se *"dhënia e përparësisë mbrojtjes gjyqësore të të drejtave pranë gjykatave të rregullta dhe organeve të tjera kompetente është një aspekt shumë i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut që Gjykata Kushtetuese gjithmonë e merr parasysh. Në lidhje me këtë, Gjykata veçanërisht theksoi se të gjitha vendimet e organeve shtetërore, duke përfshirë vendimet administrative të MAP-it për pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor".*

Në fund, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës ende nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me nenin 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI18/19

Parashtrues

Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Ministrisë së Administratës Publike KSHA-OJQ/4-2018 të 25 shtatorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA" (në tekstin e mëtejmë: „OJQ AKEA") (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës „OJQ AKEA", sipas autorizimit të kryetarit të „OJQ AKEA", në Gjykatë përfaqësohet nga avokatët, Arianit Koci dhe Nora H. Veliu nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Ministrisë së Administratës Publike (në tekstin e mëtejmë: MAP) KSHA-OJQ/4-2018, të 25 shtatorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 2 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 44 [Liria e Asociimit], paragrafin 3 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe organizimit), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe neni 1 i Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Gjithashtu, parashtruesi në kërkesë kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, duke pretenduar që *"refuzimi i kërkesës për masë të përkohshme do të rezultojë në dëm të pariparueshëm dhe se vendosja e masës së përkohshme është në interesin publik"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 22 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës MAP-it.

9. Më 12 prill 2019, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë raportin me rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit.

11. Më 20 qershor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 9 dhjetor 2004, parashtruesi i kërkesës ("OJQ AKEA") ishte regjistruar në institucionet e përkohshme të UNMIK-ut në Kosovë. Bazuar në statutin e "OJQ AKEA", Gjykata vëren se ai është regjistruar për kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

> *"Promovimi dhe ruajtja e vlerave kulturore të qytetarëve;*
> *Ruajtja dhe kultivimi i vlerave njerzore të bazuara në humanitet e solidaritet te ndërsjellë të qytetarëve;*
> *Ngritja e nivelit edukativo-arsimor të qytetarëve në përgjithësi dhe brezit të ri në veçanti;*
> *Forcimi i tolerancës dhe i mirëkuptimit ndërmjet qytetarëve;*
> *Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për dukuritë negative dhe luftimi i tyre;*
> *Angazhimi i të rinjve në aktivitete kulturore dhe edukative;*
> *Ndërtimi i paqes, tolerancës dhe të mirëkuptimit rinor,*
> *Ngritja e zërit ndaj rrezikimit të vlerave civile;*
> *Ngritja e zërit në mbrojtje nga rrezikimi i dinjitetit të personalitetit, familjes dhe shoqërisë;*
> *Ndërtimi dhe ngritja e personit, familjes dhe shoqërisë së shëndoshë;*
> *Aktivitet për të ndihmuar zhvillimin e OJQ-ve dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet OJQ-ve të regjistruara në Kosovë;*
> *Mbështetje për zhvillimin e demokracisë dhe shoqërisë civile dhe çdo aktivitet tjetër që është në funksion të së mirës së përbashkët".*

13. Më 11 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës (OJQ "AKEA"), bëri një regjistrim të sërishëm në Ministrinë e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin e ri për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare nr. 03/L-134 të 25 marsit 2009.

14. Në bazë të shkresave të lëndës, rrjedh se parashtruesi i kërkesës "OJQ AKEA", i ka kryer aktivitetet e tij deri më 17 shtator 2014.

Vendimi i parë i MAP-it në lidhje me pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

15. Më 17 shtator 2014, MAP mori vendimin e parë (Pos. në nr. 06/207/2014), me të cilin pezullohet veprimtaria e "OJQ AKEA".

16. Në arsyetimin e vendimit të saj MAP, ndër të tjera, theksoi:

> *„Autoriteti kompetent i sigurisë paraqiti kërkesë për pezullimin e veprimtarisë së OJQ-së "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim (AKEA)" me numër të regj. 5110087 - 1, i regjistruar më 09.12.2004, kërkesa sipas nr. të protokollit 300 i datës 15.09.2014.*
>
> *Kërkesa për pezullim të veprimtarisë së OJQ-ve "Asociacioni për kulturë, edukim dhe arsim - (AKEA)" me numër të regjistrimit 511087 - 1 të regjistruar më 09.12.2004 bazohet në informatat e institucioneve përkatëse të sigurisë se ekziston dyshimi i bazuar se veprimtaria e OJQ-së "Asociacioni për Kulturë Arsim dhe Edukim (AKEA) nuk përkon me rendin juridik dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ka shkelur normat ligjore të Statutit në bazë të të cilave është regjistruar.*
>
> *Vendimi për pezullimin e veprimtarive të kësaj organizate është i vlefshëm derisa nuk është marrë një vendim tjetër".*

17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës me qëllim të anulimit të vendimit të parë të MAP-it (Pos. në nr. 06/207/2014) për ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të tij, ka iniciuar disa procedura në institucionet kompetente të MAP-it dhe në gjykatat e rregullta.

18. Në lidhje me këtë, me qëllim të përcjelljes më të lehtë kronologjike të gjendjes faktike, Gjykata në vazhdim të raportit do të paraqesë veçmas faktet, në lidhje me të gjitha veprimet në veçanti, të cilat parashtruesi i kërkesës i ka ndërmarrë me qëllim të anulimit të vendimit të MAP-it për pezullimin e kryerjes së aktiviteteve.

Procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës pranë MAP-it për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve në lidhje me anulimin e vendimit të MAP-it (Pos. në nr. 06/207/2014) të 17 shtatorit 2014

19. Më 24 shtator 2014, parashtruesi parashtroi ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, ndaj vendimit (Pos. në nr. 06/207/2014), të 17 shtatorit 2014.

20. Më 23 tetor 2014, Komisioni për shqyrtimin e ankesave të OJQ-së nxori vendimin [nr. 2/14], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e vendimit, ndër të tjera, thuhet:

> *„Me vendimin pos. në nr. 06/270/2014 të 17.09.2014 të Departamentit të OJQ-ve, kërkesa e organit kompetent të sigurisë nr. 300 nga 15-09-2014 për pezullimin e aktiviteteve të OJQ-ve" Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim - AKEA".*
>
> *Komisioni për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të tjera të lëndës ..... nxori vendimin për pezullimin e veprimtarisë së OJQ-ve "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim - AKEA".*

Procedura e parë gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me anulimin e vendimit të parë të MAP-it (Pos. në nr. 06/207/2014) të 17 shtatorit 2014

21. Më 18 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore ndaj Aktvendimit të MAP-it (Pos. në nr. 06/270/2014], të 17 tetorit 2014, si dhe vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, (nr. 02/2014) të 23 tetorit 2014.

Vendimi i dytë i MAP-it në lidhje me pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

22. Më 23 tetor 2015, MAP nxori vendimin të dytë (Pos. në nr. 06/342/2015) në të cilin thuhet: "*duke vendosur sipas kërkesës së organit kompetent të sigurisë për OJQ-të, është miratuar vendimi për vazhdimin e pezullimit të punës së "OJQ AKEA" deri në marrjen e një vendimi tjetër".*

Procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës pranë MAP-it për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve në lidhje me anulimin e vendimit të MAP-it (Pos. në nr. 06/342/2015) të 23 tetorit 2014

23. Më 24 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, ndaj vendimit të dytë të MAP-it [Pos. në nr. 06/342/2015].

24. Më 16 dhjetor 2015, Komisioni i MAP-it për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve mori vendimin (Nr. KRŽ - OJQ/5 – 2015), me të cilin ka refuzuar ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

Vendimi i tretë i MAP-it në lidhje me pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

25. Më 8 nëntor 2016, MAP-i nxori vendimin të tretë [Pos. në nr. 06/470/2015], me të cilin vazhdoi pezullimin e aktiviteteve të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e vendimit të MPA, ndër të tjera, theksohet:

> *„Kërkesa për pezullim të veprimtarisë së OJQ-ve "Asociacioni për kulturë, edukim dhe arsim - (AKEA)" me numër të regjistrimit 511087 - 1 të regjistruar më 09.12.2004 bazohet në informatat e institucioneve përkatëse të sigurisë se ekziston dyshimi i bazuar se veprimtaria e OJQ-së "Asociacioni për Kulturë Arsim dhe Edukim (AKEA) nuk përkon me rendin juridik dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ka shkelur normat ligjore të Statutit në bazë të të cilave është regjistruar".*

Procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës pranë MAP-it për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve në lidhje me anulimin e vendimit të tretë të MAP-it (Pos. në nr. 06/342/2015) të 8 nëntorit 2014

26. Më 24 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të OJQ-së kundër vendimit të MAP-it [Pos. në nr. 06/470/2015], në të cilin theksoi: "*Askund në ligj ose në Kushtetutë nuk theksohet e drejta të pezullojë aktivitetet e OJQ-ve, por vetëm ndalimin e saj nga gjykata kompetente (neni 44.3 i Kushtetutës dhe neni 20 paragrafi 1 4. LLOJQ). Askund nuk përmenden kompetencat e autoritetit shtetëror për të pezulluar aktivitetet organizative, për më tepër shkelin të drejtën themelore të njeriut të garantuara me nenin 44.1 për të marrë pjesë në aktivitetet organizative. Rrjedhimisht, vendimet bazohen në aktet kushtetuese, si dhe ato vetë janë kundër kushtetuese".*
27. Bazuar në situatën faktike, Gjykata vëren se procedurat ligjore të iniciuara nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me anulimin e vendimit të dytë dhe të tretë të MAP-it, përfundojnë me vendimet e Komisionit të MAP-it për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve.

Vendimet e gjykatave të rregullta sipas kërkesëpadisë së parë të parashtruesit të kërkesës të 18 nëntorit 2014

28. Gjykata, në vazhdim të raportit do të theksojë gjendjen faktike në lidhje me procesin gjyqësor, të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës pranë gjykatave të rregullta lidhur me anulimin e vendimit të parë të MAP-it të 17 shtatorit 2014.

29. Më 9 nëntor 2017, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [A. nr. 2345/2014], me të cilin pranoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi vendimin e MAP-it [nr. 0/2014] të 23 tetorit 2014, dhe e ktheu rastin në rivendosje në MAP. Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet:

> *„Vendimi i kontestuar është ligjërisht i paqartë dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij, nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare që kushtëzuan nxjerrjen e vendimit të kontestuar. Në arsyetimin e vendimit, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt që tregon se veprimtaria e OJQ "AKEA" është pezulluar me arsyetimin se në bazë të të dhënave të lëndës është vërejtur se organizata AKEA ka kryer aktivitete në kundërshtim me rendin ligjor dhe të drejtën ndërkombëtare. Megjithatë, organi i shkallës së dytë nuk ka specifikuar se cilat veprimtari janë kryer në kundërshtim me rendin juridik dhe kushtetues dhe nëse ai ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha shkeljet e pretenduara gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe nëse ajo është kryer në përputhje me dispozitat ligjore, duke vlerësuar provat me të cilat ka vërtetuar faktet vendimtare".*

30. Më 18 janar 2018, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të 9 nëntorit 2017, duke pretenduar se Gjykata Themelore nuk ka nxjerrë aktgjykimin për meritat, nuk ka hyrë në analizën e nenit 18 të Udhëzimit Administrativ nëse ka institute të pezullimit të OJQ-ve. Gjykata e shkallës së parë është dashur të shpallte vendimet e kontestuara absolutisht të pavlefshme, të paligjshme dhe të pabazuara në ligj, sepse Ligji 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare njeh vetëm themelimin dhe mbylljen e një organizate joqeveritare dhe jo pezullimin.

Vendimi i katërt i MAP-it në lidhje me pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës

31. Më 10 gusht 2018, MAP nxori vendimin të katërt [Pos. në nr. 06-108/2018], me të cilin vazhdoi pezullimin e veprimtarisë së parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e vendimit thuhet:

> *„Në bazë të organit kompetent të sigurisë, më 8 gusht 2018, për pezullimin e aktiviteteve të OJQ-së "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim – AKEA" nën. nr. e regj. 5110087 - 1 e regjistruar me 19.12.2004 , Departamenti për OJQ/MAP vendosi të pezullojë aktivitetin e organizatës. Kërkesa u bazua në informatat e institucioneve kompetente se kjo OJQ po kryen aktivitete që janë në kundërshtim me qëllimin dhe fushën e veprimtarive të saj dhe se është në konflikt me interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës".*

Vazhdimi i procedurës gjyqësore në Gjykatën e Apelit në lidhje me kërkesëpadinë e parë të parashtruesit të kërkesës të 18 nëntorit 2014

32. Më 13 shtator 2018, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin [AA. nr. 76/18], me të cilin ankesa e parashtruesve të kërkesës ishte pranuar si e bazuar dhe anuloi aktgjykimin e Gjykatës Themelore të 9 nëntorit 2017, ndërsa çështja u kthye në rivendosje. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit thuhet:

> *„Dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i plotë sepse është pjesë e aktgjykimit nga i cili duhet të shihet qartë se si vendosi gjykata kompetente për çështjen që ishte objekt i procedurës. Nga dispozitivi i aktgjykimit kuptohet se kërkesëpadia është pranuar, por nuk mund të kuptohet pse gjykata e shkallës së parë e ka shkruar të autorizuarit e paditësit në pjesën operative të aktgjykimit ndaj të cilit ai ankohet, sepse mund të kuptohet shumë qartë se paditësi në këtë rast konkret OJQ "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim (AKEA) me seli në Prishtinë, dhe dispozitivi i aktgjykimit lë të kuptohet që gjykata e ka vendosur si paditës dhe përfaqësues të paditësit. Prandaj, për momentin, kjo gjykatë nuk mund të pranojë si të drejtë një konstatim të tillë që paraqitet në dispozitivin e aktgjykimit, për të cilin ankohem, sepse ka të mangësi për shkak të të cilave nuk mund të zbatohet dhe është ligjërisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm".*

Procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës pranë MAP-it për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve në lidhje me anulimin e vendimit të katërt të MAP-it (Pos. në nr. 06/342/2015) të 10 gushtit 2018

33. Më 18 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, në vendimin e MAP-it, të 10 gushtit 2018.

34. Më 19 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi pranë Institucionit të Avokatit të Popullit "*Kërkesë për hapjen e rastit të OJQ-së AKEA*" kundër Ministrisë së Administratës Publike".

35. Më 25 shtator 2018, Komisioni për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve mori vendimin [nr. 4-2018] me të cilin hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e vendimit thuhet:

> *"Pas prezantimit të provave në pajtim me nenin 23 të Ligjit nr. 04 / L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe neni 1 i Rregullores nr. 02/2012 të MAP për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, Komisioni vendosi ta refuzojë ankesën."*

Procedura e dytë gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës për ta shfuqizuar vendimin e katërt të MAP-it (Pos. në nr. 06-108/2018), të 10 gushtit 2018

36. Më 1 nëntor 2018, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Themelore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MAP-it (Pos. në nr. 06-108/2018), të 10 gushtit 2018, derisa Gjykata Themelore të sjell një aktgjykim të ri meritor sipas udhëzimit të Gjykatës së Apelit, e cila është dhënë në aktgjykimin e 13 shtatorit 2018.

Vazhdimi i procedurës gjyqësore në lidhje me kërkesëpadinë e parë të parashtruesit të kërkesës të 18 nëntorit 2014

37. Më 9 dhjetor 2018, Gjykata Themelore, duke vepruar në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të 13 shtatorit 2018, nxori aktgjykimin [A. nr. 2369/2018], me të cilin e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, anuloi vendimin [nr. 02/2014] të 23 tetorit 2014, dhe e ktheu rastin në rivendosje në MAP. Në aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ndër të tjera, thuhet:

> *"Në rigjykim, duke i marrë si bazë të dhënat nga Gjykata e Apelit, Gjykata korrigjoi dispozitivin e vendimit gjyqësor, me qëllim që vendimi të jetë i qartë dhe i zbatueshëm, dhe në arsyetimin e këtij vendimi gjykata dha konstatimet e saj mbi pretendimet e palëve ndërgjyqëse.*

Gjykata, në arsyetimin e vendimit të kontestuar, konstaton se i padituri nuk ka marrë fare parasysh pretendimet ankimore të paditësit se të gjitha veprimtaritë e paditësit ishin në përputhje me kushtet e regjistrimit dhe në përputhje me normat ligjore të statusit të saj. Në vendimin e saj, i padituri nuk ka specifikuar se cilat aktivitete që i ka kryer paditësi janë në kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor. Gjykata vëren se vendimi i të padituri përmban shkelje esenciale të dispozitave të nenit 84, paragrafi 2, të Ligjit 02/L-028 për procedurën administrative, i cili parasheh që akti administrativ duhet të përmbajë ndër të tjera një përmbledhje të gjetjeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procesit administrativ ose fakteve të cilat sigurohen nga administrata, duke përcaktuar bazën ligjore në të cilën është bazuar akti.

Shkeljet e sipërpërmendura janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe në atë drejtim, gjykata e obligon autoritetin e paditur që të veprojë në procedurë të përsëritur në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe më pas të korrigjojë mangësitë e cekura, të marrë vendim të drejtë në bazë të ligjit".

Vendimet e gjykatave të rregullta në lidhje me procedurën e dytë gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës më 1 nëntor 2018

38. Më 10 dhjetor 2018, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 2859/18] lidhur me kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës më 1 nëntor 2018. Në Aktvendimin e Gjykatës Themelore thuhet: "*parashtruesit të kërkesës i kthehet plotësimi i padisë/propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke treguar saktësisht se çfarë vendimi dëshiron ta anulojë, sepse në këtë procedurë gjykata do ta shqyrtojë ligjshmërinë e vetëm vendimit përfundimtar në procedurën administrative*".

39. Më 19 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadinë e specifikuar- propozimin në Gjykatën Themelore në të cilën kërkoi shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Komisionit të ankesave të OJQ-ve [nr. 4-2018], të 25 shtatorit 2018.

40. Më 4 janar 2019, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 2859/18], me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Komisionit të ankesave të OJQ-ve [nr. 4-

2018], të 25 shtatorit 2018. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore thuhet:

"Pas shqyrtimit të propozimit të paditëses lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar konstaton se e njëjta nuk i ka bashkëngjitur propozimit të saj ndonjë fakt të bazuar në ndonjë provë që mund të bëjë pretendimet e saj të besueshme, se si ekzekutimi i vendimit që u kundërshtua me padi e dëmton të njëjtën, se dëmi është i vështirë për t'u riparuar dhe se vonesa nuk është në kundërshtim me interesin publik, kjo kërkesë ligjore duhet të vërtetohet nga paditësja, në mënyrë që gjykata pastaj të vendosë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit."

41. Më 30 janar 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të Gjykatës Themelore [A. nr. 2859/18], të 4 janarit 2019, ku, ndër të tjera, thuhet se "*ekzekutimi i vendimit të kontestuar të Komisionit të Ankesave të OJQ-ve nr. 4-2018 të 25 shtatorit 2018, kanë shkaktuar dëme të paripërueshme në Organizatë, sepse ndër të tjera për 4 vitet e fundit atyre u është ndaluar puna. Banka TEB, në bazë të kërkesës së MAP, gjithashtu kërkoi nga Organizata që të tërheqë të gjitha mjetet nga llogaria në këtë bankë nën kërcënimin e mbylljes së llogarisë, por me këtë rast nuk e ka pritur vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente*".

Procedura para institucionit jogjyqësor të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës e 1 shkurtit 2019

42. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Institucionin e Avokatit të Popullit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të MAP-it të 25 shtatorit 2018, si dhe nenit 18 të Udhëzimit Administrativ VRK nr. 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare, duke theksuar se "*në vendimet e saj të kontestuara, Ministria e Administratës Publike, në periudhën nga viti 2014 e tutje, ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të specifikuara në kërkesë, ndër të tjera, lirinë e asociimit sipas nenit 44 të Kushtetutës, barazia para ligjit nga neni 24 (2) i Kushtetutës dhe mbrojtjen e pronës nga neni 46 (3) i Kushtetutës*".

43. Më 1 prill 2019, Avokati i Popullit lëshoi një raport me rekomandime lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në raport, Avokati i Popullit ka konstatuar se "*subjekti aktiviteti i të cilit është pezulluar i shkelet e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të zvarritjes në vendosjen e rastit, të përcaktuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e*

Njeriut (KEDNJ) neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 13 të KEDNJ-së.“

44. Në Raportin e tij me rekomandime, Avokati i Popullit gjithashtu i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës “*Ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare, i miratuar në mbledhjen e 195-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 01/195, i datës 3.9. 2014, përkatësisht fshirjen e nenit 18”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

45. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet arbitrare, të kundërligjshme dhe antikushtetuese të organit administrativ të MAP-it të vitit 2014 dhe më tej, konkretisht me vendimin e katërt të MAP-it [aktvendimi i MAP Ref. KSHA-OJQ/4-2018] të 25 shtatorit 2018 i është shkelur liria e asociimit sipas nenit 44 të Kushtetutës në lidhje me nenin 11 të KEDNJ-së.

46. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se në periudhën që nga viti 2014, organizata nuk kryen asnjë nga aktivitetet e saj për shkak të vendimeve të lartpërmendura të Autoritetit Menaxhues të MAP-it, aktivitetet e organizatës pezullohen përkohësisht për një periudhë një (1) vjeçare, me arsyetimin se janë në përputhje me kërkesën e organit kompetent të sigurisë dhe aktivitetet janë në kundërshtim me qëllimin dhe fushëveprimin e punës së organizatës dhe që, si të tilla, janë në kundërshtim me interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës, dhe duke vepruar kështu, Autoriteti Menaxhues i MAP-it ka shkelur nenin 55 para. 1 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj.

47. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, për të arsyetuar pretendimet e tij për shkeljet e pretenduara të neneve 44 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenit 11 të KEDNJ-së, ka përmendur një numër të caktuar të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ). Në mesin e tyre janë aktgjykimet e GJEDNJ-së *Partia e Bashkuar Komuniste dhe të tjerët kundër Turqisë*, kërkesa 133/1996/752/951, vendimi i 30 janarit 1998 dhe *Zhechev kundër Bullgarisë* kërkesa nr. 57045/00, vendimi i 21 qershorit 2007.

48. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon që me vendimet arbitrare, të paligjshme dhe antikushtetuese të organit qeverisës të MAP-it nga viti 2014 e tutje, dhe në veçanti me vendimin e katërt të MAP-it (Aktvendimi i MAP-it Ref. KSHA-OJQ/4-2018) të 25 shtatorit, është

shkelur neni 24 para. 2 i Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.

49. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e gëzimit paqësor të pronës, e garantuar me nenin 46.3 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

50. Parashtruesi gjithashtu i referohet në këtë pjesë një numri të aktgjykimeve të GJEDNJ-së me qëllim të ndërtimit të pretendimeve të tij për shkeljen e nenit 24 para. 2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, si dhe shkeljen e nenit 46/3 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

51. Parashtruesi më tej pretendon se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i kishte në dispozicion në lidhje me vendimin e parë të MAP-it të 23 tetorit 2014, me të cilin për herë të parë është pezulluar veprimtaria e organizatës. Megjithatë, që nga 20 nëntori 2014, kur ai parashtroi padi kundër MAP-it dhe deri më 1 shkurt 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë ende nuk ka nxjerrë një vendim meritor lidhur me ligjshmërinë e aktvendimit të MAP-it të vitit 2014.

52. Në këtë drejtim, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që çështjen që e ka paraqitur në këtë kërkesë ta shqyrtojë ngjashëm me praktikën gjyqësore të saj në rastet: KI 06/10; KI 11/09; KI 99/14 dhe KI 100/14 dhe në pajtim me nenin 54 të Kushtetutës, nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenin 2 të Protokollit 4 të KEDNJ-së.

Pretendimet e parashtruesit lidhur me kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme

53. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme sepse konsideron se "*ka treguar rastin prima facie për meritat dhe pranueshmërinë e kërkesës*".

54. Parashtruesi i kërkesës konsideron se do të shkaktohet dëm i paripareshëm nëse nuk lejohet masa e përkohshme, në këtë kontekst, parashtruesit e theksojnë:

„Në rrethanat e çështjes konkrete, organi administrativ i MAP-it me vendimet kontestuese për pezullimin e veprimtarisë së organizatës nga viti 2014 deri më sot, ndonëse vendimet kishin karakter të përkohshëm ku secili vendim kishte efektin juridik të pezullimit të veprimtarisë së organizatës vetëm për një (1) vit, meqenëse vendimet

e tilla janë ripërtërirë në mënyrë të vazhdueshme për pesë (5) vite me radhë, të njëjtat kanë prodhuar efekt të gjatë dhe të qëndrueshëm që ka çuar në ngrirjen e tërësishme të veprimtarisë së organizatës, gjë që është praktikisht është e barabartë me "shuarjen" faktike të saj ".

55. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës konsideron se masa e përkohshme është në interesin publik, dhe në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon:

„...se caktimi i masës së përkohshme ndaj zbatimit të mëtejshëm të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ QRK. Nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare dhe rrjedhimisht caktimin e masës së përkohshme ndaj zbatimit te Aktvendimit Ref. KSHA-OJQ/4-2018 të dt. 25.09.2018 të Ministrisë së Administratës Publike është në interesin publik të të gjitha organizatave të shoqërisë civile dhe jo vetëm në interesin personal të parashtruesve të kërkesës".

56. Duke pasur parasysh të gjitha pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës, gjen se në fakt ai kërkon që Gjykata të konstatojë shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së, pasi që nuk ka të njëjtin trajtim para ligjit, shkelje të nenit 44 të Kushtetutës dhe nenit 11 të KEDNJ-së, për shkak se me vendimet e MAP-it u pezullua e drejta për kryerjen e aktiviteteve, shkelje e të drejtës për mjet juridik nga neni 13 i GJEDNJ-së, pasi mjetet juridike të mëparshme që ai kishte përdorur në procedurat që ai zhvilloi nuk çuan në vendimin e pezullimit, duke shkelur kështu të drejtat pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

57. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parashikuara me Rregullore të punës.

58. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 21 paragrafit 4 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 113 paragrafëve 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

59. Në fillim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të saj, të zbatueshme për individë dhe persona juridikë (rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtrues: *Universiteti AAB-RIINVEST Sh.P.K*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

60. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] që përcakton:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

61. Sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës qartë ka theksuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, që pretendohet se i janë shkelur, si dhe aktin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston në pajtim me nenin 48 të Ligjit.

62. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar."

63. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kronologjinë e veprimtarive që ka ndërmarrë, si dhe vetë thelbin e kërkesës, Gjykata konstaton se ai e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese pavarësisht nga fakti se të dyja procedurat (administrative dhe gjyqësore), të cilat ai i kishte iniciuar për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese, janë ende në fazën e vendimmarrjes pranë institucioneve dhe gjykatave kompetente

64. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës e arsyeton veprimin e tij duke deklaruar se "*ai nuk ka mjete efektive juridike në dispozicion të tij me të cilat do të kishte mbrojtur të drejtat e tij kushtetuese*", dhe në pajtim me këtë ai kërkon që Gjykata Kushtetuese ta pranojë kërkesën dhe të hyjë në substancë të lëndës, si dhe të vlerësojë nëse procedurat e mëparshme të MAP-it dhe gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me paragrafin 2 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 44 [Liria e Asociimit], paragrafin 3 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës si dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe organizimit), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe neni 1 i Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

65. Duke pasur parasysh dispozitat e lartcekura kushtetuese, dispozitat ligjore dhe rregullat e Rregullores së punës, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse kërkesa konkrete e parashtruesit i plotëson kushtet formale të pranueshmërisë në lidhje me shterimin e mjeteve juridike.

66. Në lidhje me këtë, Gjykata, për t'iu përgjigjur pyetjes nëse parashtruesi i kërkesës në rastin konkret duhet të përmbushë kushtet formale të kërkuara për shterimin e të gjitha mjeteve juridike, ose mund të lirohet nga ky detyrim, duhet ta shqyrtojë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së se dhe praktikën e saj gjyqësore, në të cilën janë vendosur parimet dhe principet themelore të detyrimit të shterimit të mjeteve juridike.

Koncepti i shterimit të mjeteve juridike

67. Gjykata thekson se vet koncepti i shterimit ose detyrimi për shterimin e mjeteve juridike rrjedh dhe bazohet në praktikën e GJEDNJ-së, sipas së cilës "qëllimi i detyrimit për shterjen e mjeteve juridike është që t'u ofrojë gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar apo

korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Në kontekstin e GJEDNJ-së, ky obligim bazohet në supozimin se rendi i brendshëm juridik siguron një mjet efektiv juridik për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe të drejtave nga KEDNJ, dhe ky është një aspekt i rëndësishëm i natyrës subsidiare të KEDNJ-së (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13378/05, e 29 prillit 2008, paragrafi 42, e tutje).

68. Gjykata gjithashtu rikujton që, në praktikën e saj të deritashme, "*përveç disa përjashtimeve të justifikuara*" ajo u ishte përmbajtur këtyre parimeve, dhe me atë rast konstatoi se parimi i subsidiaritetit kërkon që të gjithë parashtruesit e kërkesës të shterojnë të gjitha mjetet juridike, në rastin konkret të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt me qëllim të parandalimit të shkeljes së të drejtave kushtetuese, ose korrigjimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive kushtetuese, nëse ka (shih Aktvendimi për papranueshmëri në rastin KI139/12, *Besnik Asllani*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, paragrafi 45, Aktvendimi për papranueshmëri KI24/16,parashtrues *Avdi Haziri vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*).

69. Gjykata gjithashtu shton se në praktikën e GJEDNJ-së janë përcaktuar gjithashtu përjashtimet në zbatimin e parimeve kur një individ mund të lirohet nga detyrimi për të shteruar mjetet e rregullta juridike. Në rastin *Akdivar kundër Turqisë* (kërkesa 21893/93, vendimi i 16 shtatorit 1996, para. 65-66), GJEDNJ konstatoi se parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë vetëm mjetet juridike të brendshme të cilat janë në dispozicion, të mjaftueshme dhe efektive. Në aktgjykimin e *Van Ostervijk kundër Belgjikës*, GJEDNJ gjithashtu konkludoi se, në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, mund të ketë rrethana të veçanta kur parashtruesi i kërkesës lirohet nga detyrimi që paraprakisht të shterë të gjitha mjetet juridike të brendshme. (shih aktgjykimin GJEDNJ-së *Van Ostervijk kundër Belgjikës* i 6 nëntorit 1980, Seria A nr. 40, fq. 18 dhe 19, paragrafët 36 deri 40).

70. Gjykata rikujton që në praktikën e saj GJEDNJ gjithashtu theksoi që parashtruesi i kërkesës duhej të tregojë dhe dëshmojë se mjeti juridik i brendshëm i cili ishte në dispozicion të tij ishte shteruar me të vërtetë ose, që mjeti juridik për shkaqe të caktuara, në rrethanat e rastit në fjalë, ishte joadekuat dhe i paefektshëm ose se ka pasur arsye të veçanta për shkak të të cilave parashtruesi i kërkesës nuk ishte i detyruar të përmbushë këtë kërkesë në rastin konkret (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, f. 1211, par. 68).

71. Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se gjatë praktikës së saj shumëvjeçare ajo ka pasur kërkesa në të cilat ka konkluduar se parashtruesit në "*rrethanat e dhëna kanë bërë gjithçka*" sa i përket shterimit të mjeteve juridike dhe se janë përmbushur detyrimet e shterimit ose rastet në të cilat parashtruesit e kërkesës "*janë liruar*" nga obligimi i shterimit të mjeteve juridike, duke marrë parasysh specifikat e rastit konkret, si dhe përmbajtjen e kërkesave të atyre parashtruesve (shih aktgjykimin KI 56/09, *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, aktgjykimi në rastin nr. KI06/10, *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme*, i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, aktgjykimet në rastet KI99/14 dhe KI100/14, parashtrues Shyqyri Syla dhe Laura Pula).

72. Në pajtim me të lartcekurat, rrjedh se Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse në rastin konkret parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion mjetet juridike të cilat janë të parapara me ligj dhe me shfrytëzimit e të cilave, ai do të mund t'i mbronte të drejtat e tij kushtetuese, siç parashihet në KEDNJ, para se ta parashtrojë kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese.

Koncepti i efektivitetit të mjeteve juridike në rastin konkret

73. Gjykata vëren nga vetë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, se parashtruesi konsideron se nuk ka kuptim të vazhdojë me procedurat gjyqësore të mëtejshme, pasi që ato deri më tani nuk kanë rezultuar në mënyrë të tillë që t'i mundësojnë atij të zbulojë arsyet për pezullimin e kryerjes së veprimtarisë së tij, përkatësisht të marrë vendimet për meritat e kërkesëpadisë.

74. Në lidhje me këtë, Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se nuk ka në dispozicion mjete efektive juridike me të cilat do të kishte mundur të mbrojë të drejtat e tij kushtetuese, dhe kjo mund të konkludohet në bazë të vendimeve të gjykatave të rregullta. Rrjedhimisht, ai kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta pranojë kërkesën dhe të vendosë për thelbin e çështjes, si dhe të vlerësojë nëse procedurat e mëparshme të MAP-it dhe të gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me paragrafin 2 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], neni 44 [Liria e Asociimit], paragrafi 3 i nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe neni 11 (Liria e tubimit dhe organizimit), neni 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe neni 1 i Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

75. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, i cili në pjesën përkatëse thekson:

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."

76. Gjithashtu, Gjykata rikujton nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, i cili në pjesën përkatëse thekson:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare"

77. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se rregullin e shterimit të mjeteve juridike parashtruesi e bazon në supozimin se nuk ka mjet juridik efektiv në dispozicion në lidhje me shkeljen e pretenduar, si të drejtave të tij kushtetuese, po ashtu dhe të drejtave nga KEDNJ, në procedurat e mëtejshme pranë gjykatave të rregullta.

78. Gjykata rikujton që, sa i përket çështjes së mjeteve juridike, GJEDNJ në mënyrë të veçantë theksoi faktin se shteti duhet të ofrojë mjete juridike dhe të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme për zbatimin e tyre (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Vernijo kundër Francës*, të 20 shkurtit 1991, A, Nr. 198, f. 11 dhe 12, par. 27).

79. Në lidhje me këtë, Gjykata, duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se, duke u marrë me çështjen e shterimit të mjeteve juridike, ka gjetur se **a)** ekzistenca e mjeteve juridike duhet të përcaktohet me ligj dhe ato duhet të jenë të sigurta në masë të mjaftueshme jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, **b)** kur përcaktohet nëse një mjet i caktuar juridik plotëson kriteret e disponueshmërisë dhe efektivitetit, duhet të merren parasysh rrethanat specifike të secilit rast individual, **c)** Gjykata duhet në mënyrë reale të marrë parasysh jo vetëm mjetet formale juridike të cilat janë në dispozicion në sistemin e brendshëm juridik, por duhet të marrë parasysh edhe kontekstin e përgjithshëm juridik dhe politik në të cilin funksionojnë këto mjete juridike, **d)** nëse gjatë shfrytëzimit të mjetit juridik kanë ekzistuar disa pengesa (shih, aktgjykimi i GJEDNJ-së *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, par. 68 -69; si dhe aktgjykimi i GJEDNJ-së *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, par. 116-17).

80. Në lidhje me këtë, Gjykata, duke pasur parasysh parimet dhe praktikën e GJEDNJ-së, duhet në rastin konkret të përcaktojë a) a ka qenë mjeti juridik në rastin e parashtruesit të kërkesës i përcaktuar me ligjin, i cili ishte në përdorim, b) a ka qenë mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, c) a ka qenë mjeti juridik efektiv në praktikë, dhe d) a ka pasur disa pengesa dhe rrethana të veçanta në përdorimin e tij.

a) a ka qenë mjeti juridik në rastin e parashtruesit të kërkesës i përcaktuar me ligjin, i cili ishte në përdorim

81. Sa i përket parimit të parë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës është i detyruar t'i shterojë vetëm mjetet juridike që janë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë që ato mjete juridike janë në dispozicion, ashtu që të mund të sigurojnë kompensim juridik lidhur me padinë dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (shih rastin e GJEDNJ-së *Sejdović kundër Italisë*, kërkesa nr. 56581/00 e 1 marsit 2006, par. 46).

82. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në procedurat e deritanishme gjyqësore kishte përdorur mjetet juridike që i kishte në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, me ç'rast kishte arritur t'i marrë tri vendime në dy instanca gjyqësore që ishin në favor të tij.

83. Përveç kësaj, Gjykata vëren se më 9 dhjetor 2018, Gjykata Themelore, në procedurën e përsëritur, nxori një aktgjykim të ri, ndaj të cilit, në qoftë se parashtruesi i kërkesës nuk ishte i kënaqur, ai mund ta shfrytëzojë prapë mjetin juridik në Gjykatën e Apelit në formën e një ankese.

84. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton nenin 195 (Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë mbi ankesën) të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i cili në pjesën përkatëse, thekson:

Neni 195

"1. Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj :
a) ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;
b) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;
c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;
d) ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur;
e) ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë nuk është e lidhur për propozimin e parashtruar ne ankesë."

85. Për më tepër, Gjykata vëren se neni 211 (Revizioni) i të njëjtit ligj në pjesën përkatëse thekson:

"211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi..
[...]
211.4 Përjashtimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar".

86. Prandaj, në bazë të ligjit në fuqi, Gjykata konstaton se, në rastin e parashtruesit të kërkesës, nuk ka një, por dy mjete juridike të parapara me ligjin e zbatueshëm dhe se të dy mjetet juridike janë teorikisht dhe praktikisht në dispozicion në kohën përkatëse dhe, me të cilat ai mund për të kontestojë si vendimet e gjykatës po ashtu edhe vendimet e MAP-it. Gjykata gjithashtu vëren se përdorimi i këtyre mjeteve juridike varet vetëm nga vullneti i parashtruesit të kërkesës.

b) a ka qenë mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës

87. Sa i përket parimit të disponueshmërisë së mjetit juridik, Gjykata, duke pasur parasysh procedurat e parashtruesit të kërkesës, vëren se parashtruesi në pjesën e tanishme të procedurës, si para autoriteteve kompetente të MAP-it, po ashtu edhe para gjykatave të rregullta, ka përdorur mjetet juridike të parashikuara me ligj.

88. Përveç kësaj, Gjykata vëren nga veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës se, në të vërtetë, në vazhdim të procedurës kishte përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parapara me ligj, dhe me këtë konkludohet se ato ishin në çdo kohë në dispozicion të tij.

89. Përveç kësaj, Gjykata nuk konstaton se në rastin konkret kanë ekzistuar ose, në ndërkohë, janë krijuar disa rrethana specifike të caktuara të cilat në ndonjë mënyrë do të ndikonin në disponueshmërinë e mëtutjeshme të mjeteve juridike, të cilat parashtruesi i kërkesës mund t'i përdorë në vazhdim të procedurës.

c) a ka qenë mjeti juridik efektiv në praktikë

90. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës specifikon në mënyrë të veçantë faktin se mjetet juridike të parapara me ligj nuk janë efektive në praktikë. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se ai vazhdon t'i përdorë ato, gjë që vë në dyshim pretendimet e tij për mos efektivitetin e tyre në praktikë.

91. Edhe përkundër kësaj, Gjykata duke analizuar efektivitetin e mjeteve juridike në praktikë, vë në dukje se ajo mund ta shqyrtojë këtë çështje në dy intervale kohore, e të cilat janë, efektiviteti i mjeteve juridike të cilat parashtruesi i kërkesës tashmë i ka shfrytëzuar pranë MAP-it dhe gjykatave të rregullta dhe efektivitetin e mjeteve juridike të cilat parashtruesi i kërkesës mund t'i përdorë në procedurat gjyqësore të mëtejshme, duke i kontestuar vendimet e MAP-it ose të gjykatave të rregullta.

92. Sa i përket efektivitetit të mjeteve juridike të cilat parashtruesi i kërkesës i ka përdorur në procedurën e tanishme, Gjykata konstaton se, sipas natyrës së tyre dhe rezultateve në procedurën e deritanishme ato ishin efektive, ndoshta jo në mënyrën dhe masën në të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte pritur, sepse efektiviteti i mjetit juridik nuk përcaktohet në bazë të faktit nëse parashtruesi i kërkesës me përdorimin e tij arriti të realizojë qëllimet e tij në mënyrën si ai do të donte, por nëse ai e kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai e përdorë të paraqiste argumentet që do të shqyrtohen nga autoritetet kompetente (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar* seria A nr. 161, i 7 korrikut 1989, paragrafi 120).

93. Për më tepër, sa i përket çështjes së efikasitetit të mjeteve juridike të cilat parashtruesi i kërkesës mund t'i përdorë në vazhdim të procedurës, *Gjykata mundet vetëm të rikujtojë se që nga koha* kur parashtruesi i kërkesës ka përdorur mjete juridike për herë të fundit deri më sot, nuk ka pasur ndryshime të rrethanave të përgjithshme juridike dhe shoqërore që do të ndikonin në efektivitetin e mjeteve juridike të parapara me ligj.

94. Gjithashtu, efikasiteti i deritanishëm i shfrytëzimit të mjeteve juridike të parashtruesit të kërkesës e ka justifikuar vetë "parimin e efikasitetit në praktikë", që gjithashtu mund të shihet në bazë të rezultateve të procedurave gjyqësore të deritanishme, duke hequr çdo dyshim se mjetet juridike të parapara me ligj janë joefektive në procedurën e mëtejshme gjyqësore.

95. Për më tepër, duke marrë parasysh udhëzimet ligjore të nenit 159 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se, sipas ankesës, Gjykata e Apelit mund:

e) *"ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;* dhe të cilën ai e kishte bërë një herë dhe gjithashtu edhe Gjykata e Apelit mundet edhe:

c) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë."

d) a ka pasur disa pengesa dhe rrethana të veçanta në shfrytëzimin e mjetit juridik

96. Gjykata duke i sjellë procedurat dhe veprimet që parashtruesi i kërkesës i kishte ndërmarrë në pjesën e deritanishme të procedurës, në lidhje me mjetet juridike që ai kishte përdorur, konstaton se parashtruesi i kërkesës i kishte ndërmarrë të gjitha veprimet me vullnetin e tij dhe jo me vullnetin e ndonjë të treti nga veprimet e të cilit (veprime ose mos veprime) do të varej vetë efektiviteti i mjetit juridik, dhe një situatë e tillë do të shkaktonte pengesa të drejtpërdrejta në procedurën për përdorimin e këtyre mjeteve juridike.

97. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos e vërejë se as ligji i cili është i zbatueshëm dhe me të cilin parashihen mjetet juridike, të cilat parashtruesi i kërkesës mund t'i përdorë në vazhdimin e procedurës nuk përcakton ose kërkon ndonjë kusht të veçantë që ai duhet të plotësojë si parakusht për t'i shfrytëzuar ato, përveç atyre kushteve të cilat përcaktojnë afatet kohore për shfrytëzimin e tyre.

98. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata është e mendimit se në rastin e parashtruesit të kërkesës, nuk ka pasur ndonjë pengesë gjyqësore në pjesën e deritanishme të procedurës dhe gjithashtu pengesat nuk ekzistojnë as në vazhdimin e procedurës gjyqësore, të cilat do të ndikonin ose do të kufizonin përdorimin e mjetit juridik të paraparë me ligj në dëm të parashtruesit të kërkesës.

Procedura në institucionin jogjyqësor

99. Gjykata vëren se më 19 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe se Avokati i Popullit, duke vepruar sipas kërkesës, kreu një hetim lidhur me pretendimet e parashtruesit dhe se më 1 prill 2019 ai e dorëzoi Raportin me rekomandime në të cilën konstatoi se: "*subjekti aktiviteti i të cilit është pezulluar i shkelet e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për*

shkak të zvarritjes në vendosjen e rastit, të përcaktuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 13 të KEDNJ-së.

100. Sa i përket rekomandimeve, Avokati i Popullit, në raportin e tij i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës "*Ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare, i miratuar në mbledhjen e 195-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 01/195, i datës 3.9. 2014, përkatësisht fshirjen e nenit 18*".

101. Sa i përket Raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit GJEDNJ-theksoi që ankesa te Avokati i Popullit nuk është në parim një mjet juridik që duhet të shterohet sipas nenit 35 të KEDNJ-së (shih vendimin e GJEDNJ-së *Egmez kundër Qipros, kërkesa* e 21 dhjetorit 2000, paragrafët 66-73, shih, *mutatis mutandis, Montion kundër Francës*, kërkesa nr. 11192/84, Vendimi i Komisionit i 14 majit 1987, Vendimet dhe Raportet (DR) 52, f. 227), për arsye se Avokati i Popullit nuk ka autorizim të urdhërojë ndonjë masë ose të vendosë sanksione, përveç rekomandimeve për institucionet kompetente.

Gjetjet e Gjykatës

102. Gjykata vëren, dhe nga analiza e situatës faktike konstaton se, parashtruesi i kërkesës aktualisht zhvillon dy procedura, nga të cilat, njëra është procedurë administrative dhe tjetra gjyqësore.

103. ***Procedura administrative*** e cila aktualisht është në MAP, rrjedh nga procedura e parë gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me anulimin e vendimit të parë të MAP-it (Pos. në nr. 06/207/2014) të 17 shtatorit 2014. Vetë rrjedha e procedurës së parë gjyqësore rezultoi me 3 vendime gjyqësore në dy instanca gjyqësore, gjë që çoi në atë që rasti sipas Aktgjykimit [A. nr. 2369/2018] të Gjykatës Themelore në procedurë të përsëritur gjendet përsëri pranë MAP-it. Gjykata Themelore në Aktgjykimin [A. nr. 2369/2018] konstatoi se: *"i padituri MAP nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet ankimore të paditëses se të gjitha aktivitetet e paditëses kanë qenë në pajtim me kushtet e regjistrimit dhe në pajtim me normat juridike të statusit të saj. I padituri në vendimin e tij nuk ka specifikuar se cilat janë ato aktivitete që janë ushtruar nga paditësja në kundërshtim me rendin kushtetues dhe juridik. Gjykata konstaton se vendimi i të padituri t përmban shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 84 paragrafit 2 të Ligjit 02/L-028 për Procedurën Administrative, të cilat parashikojnë*

se akti administrativ, ndër të tjera, duhet të përmbajë edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata dhe në deklarim të bazës ligjore në të cilën bazohet akti."

104. Për më tepër, Gjykata Themelore konkludoi se pikërisht këto mangësi në vendimet e MPA-së "*pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, dhe në këtë drejtim, gjykata obligon organin e paditur që në procedurë të përsëritur të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pastaj të korrigjojë mangësitë në fjalë dhe të nxjerrë një vendim të bazuar në ligj."*

105. ***Procedura gjyqësore***, e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore më 1 nëntor 2018, me kërkesën për ndalimin e ekzekutimit të vendimit të MAP-it të 25 shtatorit 2018, është aktualisht në Gjykatën e Apelit sipas ankesës të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte parashtruar kundër vendimit të Gjykatës Themelore të 4 janarit 2019.

106. Gjykata, duke pasur parasysh gjetjet e saj, arrin në përfundim se të dy procedurat (administrative dhe gjyqësore) të iniciuara nga parashtruesi i kërkesës janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, dhe janë ende në fazën e vendimmarrjes. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se këto janë procedura gjyqësore të ndara që kanë specifikat dhe kompleksitetin e vet.

107. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata nuk mund të mos vërejë se gjykatat e rregullta në pjesën e deritanishme të procedurës, nuk kanë qëndruar joaktive kur u ballafaquan me pretendimet nga kërkesëpaditë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata rikujton nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, i cili parasheh "*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".*

108. Nga kjo rezulton se dhënia e përparësisë së mbrojtjes gjyqësore të drejtave në gjykatat e rregullta është një aspekt shumë i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut që Gjykata Kushtetuese e merr parasysh. Lidhur me këtë, Gjykata dëshiron të theksojë se të gjitha vendimet administrative i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.

109. Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha ato që u thanë më sipër, gjen se procedurat e iniciuara nga parashtruesi i kërkesës janë ende në fazën e

vendosjes, dhe nga kjo mund të konkludohet se kërkesa e parashtruesit para Gjykatës Kushtetuese është e parakohshme.

110. Prandaj, Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, administrative ose gjyqësore, me qëllim të parandalimit të shkeljes së Kushtetutës ose, nëse ka, që të korrigjojë një shkelje të tillë të një të drejte të garantuar me Kushtetutë (Shih rasti i GJEDNJ-së *Sejdović kundër Italisë*, kërkesa nr. 56581/00, 1 mars 2006, paragrafi 46, shih:, rasti *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19).

111. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ende nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

112. Gjykata sapo ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe rrjedhimisht nuk do të merret me pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

113. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, duke pretenduar se *"refuzimi i kërkesës për masë të përkohshme do të rezultojë në dëm të pariparueshëm, dhe se vendosja e masës së përkohshme është në interes publik"*.

114. Gjykata sapo ka konkluduar se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese.

115. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, pasi që e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit, duke qenë se kërkesa është deklaruar e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1, 7, të Kushtetutës, të nenit 47 të Ligjit dhe të rregullave 39 (1) (b) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI154/17 dhe KI05/18 Parashtrues: Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 3917/17, të 25 tetorit 2017

KI154/17 dhe KI05/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, publikuar më 21 gusht 2019.

Fjalët kyç: *persona juridikë, kërkesë individuale, vlerësim i aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, qartazi e pabazuar*

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesit e kërkesës dhe Banka Raiffeisen, kishin lidhur Marrëveshje për kredi në vlerën prej 100,000 euro. Si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga debitori, kreditori kishte kërkuar fillimin e procedurës së përmbarimit për vlerën e mbetur të kredisë, përkatësisht 78,709.68 euro. Gjykata Komunale kishte lejuar përmbarimin dhe lënda ishte transferuar te Përmbaruesi Privat. Ky i fundit, përmes konkluzioneve përkatëse, kishte caktuar ankandet publike për shitjen e palujatshmërisë së përcaktuar me Marrëveshje në vlerën prej 151,600.00 euro. Sipas shkresave të lëndës, paluajtshmëria i është shitur RBK-së, në ankandin publik të 21 korrikut 2017, në një të tretën (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, përkatësisht 50,535.00 euro. Si rezultat, Përmbaruesi Privat kishte nxjerrë Urdhrin për shitjen e paluajtshmërisë. Debitorët, përkatësisht parashtruesit e kërkesës, kishin kontestuar këtë Urdhër në Gjykatën e Apelit, e cila përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3917/2017] të 25 tetorit 2017 e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorëve. Në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë këtë të fundit, duke pretenduar, në esencë, se "*procedura përmbarimore ishte kundërkushtetuese dhe kundërligjore*".

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, duke përfshirë ato sipas të cilave (i) shitja publike ishte realizuar mbi bazën e ligjit që nuk ishte në fuqi në kohën kur kishte filluar procedura përmbarimore, përkatësisht Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore, duke rezultuar kështu në rezultat të ndryshëm dhe më të pafavorshëm për parashtruesit e kërkesës, sesa po të ishte zbatuar Ligji për Procedurën Përmbarimore; (ii) Përmbaruesi Privat kishte refuzuar caktimin e një eksperti që do të vërtetonte shumën e detyrimit ndaj kreditorit, përkatësisht Bankës Raiffeisen; (iii) Marrëveshja është në kundërshtim me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore; dhe (iv) Ligji për Procedurën Përmbarimore është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata i shqyrtoi duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata konstatoi se pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me (i) aplikimin dhe interpretimin qartazi të gabuar të ligjit, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme bazuar në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; (ii) refuzimin e përcaktimit të ekspertit dhe mungesës së arsyetimit për këtë refuzim, si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; (iii) kundërligjshmërinë e Marrëveshjes, si të papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në kuptimin substancial në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2, të nenit 47 të Ligjit, dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe (iv) mospërputhshmërinë e LPP-së me Kushtetutën si të papranueshme sepse të njëjtat nuk janë ngritur nga një palë e autorizuar në pajtim me nënparagrafin (1) të paragrafit (2) të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

rastet nr. KI154/17 dhe KI05/18

Parashtrues

Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 3917/17, të 25 tetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI154/17 është dorëzuar nga Basri Deva dhe Afërdita Deva nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i parë i kërkesës).

2. Kërkesa KI05/18 është dorëzuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS", me themeluesin Basri Deva, me seli në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i dytë i kërkesës).

3. Kur Gjykata i referohet bashkërisht parashtruesit të parë dhe të dytë të kërkesës, do t'ju referohet si parashtruesit e kërkesës.

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin [AC. nr. 3917/17] e 25 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Urdhrin [P. nr. 330/16] e 22 gushtit 2017 të Përmbaruesit Privat.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) si dhe me nenet 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

7. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

8. Më 15 dhjetor 2017, parashtruesi i parë e dorëzoi kërkesën (KI154/17) në Gjykatë.

9. Më 19 dhjetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

10. Më 12 janar 2018, parashtruesi i dytë e dorëzoi kërkesën (KI05/18) në Gjykatë.

11. Më 31 janar 2018, parashtruesi i parë i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të plotësuar të Gjykatës.

12. Më 8 shkurt 2018, duke pasur parasysh faktin se në të dyja kërkesat, bëhet fjalë për procesin e njëjtë gjyqësor, Kryetarja në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, urdhëroi bashkimin e kërkesave KI154/17 dhe KI05/18. Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues, në të dyja rastet, mbetën të njëjta.

13. Më 13 shkurt 2018, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për bashkimin e kërkesave dhe kërkoi që të dorëzohen dokumente shtesë në Gjykatë.

14. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

15. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

16. Më 11 janar 2019, Gjykata u dërgoi parashtruesve të kërkesës shkresën e dytë dhe i njoftoi se brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese duhet të dorëzojnë në Gjykatë dokumentet në vijim: (i) Marrëveshjen mbi huanë [nr. 6278] e 23 korrikut 2004; (ii) Aktvendimin [E. nr. 305/06] e 9 majit 2006 të Gjykatës Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), si dhe të gjitha vendimet gjyqësore që i kanë paraprirë këtij aktvendimi dhe procedurës ankimore, nëse ka; (iii) Aktvendimin [E. nr. 166/2012] e 5 marsit 2012 të Gjykatës Komunale; dhe (iv) Aktvendimin [In. nr. 330/2004] e 23 korrikut 2017 të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

17. Më 14 janar 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH. KI154/17 për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

18. Më 15 janar 2019, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit dhe Përmbaruesin Privat Gj. R. (në tekstin e mëtejmë: Përmbaruesi Privat) për regjistrimin e kërkesës.

19. Më 23 janar 2019, Përmbaruesi Privat dorëzoi dokumentacionin shtesë lidhur me këtë kërkesë.

20. Më 25 janar 2019, parashtruesit e kërkesës dorëzuan dokumente të caktuara në Gjykatë.

21. Më 22 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 23 korrik 2004, parashtruesit e kërkesës lidhën Marrëveshjen [nr. 6278] mbi huanë (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja) me "Raiffeisen Bank" në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: RBK) në vlerë prej 100,000.00 euro. Në të njëjtën ditë, sipas kërkesës së RBK-së, përmes Aktvendimit [In. nr. 268/2004], Gjykata Komunale, lejoi regjistrimin e hipotekës në pasurinë e paluajtshme e cila ishte objekt i Marrëveshjes në fjalë.

23. Në një datë të paspecifikuar, duke u bazuar në (i) Marrëveshjen; dhe (ii) Aktvendimin [In. nr. 268/2004] e 23 korrikut 2004 të Gjykatës Komunale, RBK inicioi në Gjykatën Komunale procedurën përmbarimore kundër parashtruesve të kërkesës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të tyre, duke kërkuar që të shpallet shitja publike e paluajtshmërisë me qëllim të përmbushjes së detyrimit në shumën prej 78,709.68 euro.

24. Më 9 maj 2006, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [E. nr. 305/06] e lejoi zbatimin e procedurës përmbarimore përmes shitjes publike të pasurisë së paluajtshme të parashtruesve të kërkesës, në cilësi të debitorëve, në bazë të dokumenteve përmbarimore të lartpërmendura.

25. Më 1 mars 2012, kreditori, përkatësisht RBK, iu drejtua Gjykatës Komunale me kërkesën për tërheqje të propozimit për përmbarim kundër debitorëve, përkatësisht parashtruesve të kërkesës. Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E. nr. 305/06] të 8 marsit 2012 e miratoi këtë propozim dhe e pezulloi procedurën përmbarimore.

26. Megjithatë, më pas, RBK paraqiti në Gjykatën Komunale kërkesën e re për inicimin e procedurës përmbarimore, duke u bazuar në (i) Marrëveshjen; dhe (ii) Aktvendimin [In. nr. 268/2004] e 23 korrikut 2004 të Gjykatës Komunale, duke kërkuar sërish të shpallet shitja publike e paluajtshmërisë, me qëllim të përmbushjes së detyrimit të debitorëve në shumën prej 78,709.68 euro.

27. Më 5 mars 2012, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [E. nr. 166/12], e lejoi zbatimin e procedurës së re përmbarimore, përmes shpalljes së shitjes publike të paluajtshmërisë, siç është përcaktuar me Marrëveshje.

28. Më 12 mars 2012, debitorët, përkatësisht, parashtruesit e kërkesës paraqitën kundërshtim përkitazi me aktvendimin e lartcekur.

29. Më 20 maj 2016, Gjykata Themelore, duke vepruar sipas kërkesës së kreditorit, përkatësisht RBK-së, përmes Konkluzionit ia transferoi lëndën përmbarimore Përmbaruesit Privat.

30. Më 23 maj 2016, Përmbaruesi Privat i njoftoi palët në procedurë për vazhdimin e procedurës përmbarimore përmes shitjes publike të paluajtshmërisë, siç është përcaktuar me Marrëveshje.

31. Më 22 korrik 2016, Përmbaruesi Privat nxori Konkluzionin për shitjen e parë publike të paluajtshmërisë dhe e caktoi të njëjtën më 22 gusht 2016. Me kërkesë të kreditorit, përkatësisht RBK-së, shitja e parë publike ishte shtyrë dhe e njëjta u caktua më 9 shtator 2016. Shitja e parë publike nuk u realizua.

32. Më 9 shtator 2016, Përmbaruesi Privat përmes Konkluzionit caktoi shitjen e dytë publike të paluajtshmërisë së përcaktuar me Marrëveshje në vlerën e caktuar të pasurisë së paluajtshme prej 151,600.00 euro.

33. Më 10 tetor 2016, Përmbaruesi Privat, meqë nuk kishte asnjë të interesuar për të blerë paluajtshmërinë, e shpalli ankandin të dështuar.

34. Në të njëjtën datë, Përmbaruesi Privat përmes Konkluzionit caktoi shitjen e tretë publike të paluajtshmërisë së përcaktuar me Marrëveshje në vlerën e caktuar të pasurisë së paluajtshme prej 151,600.00 euro më 11 nëntor 2016.

35. Kreditori, përkatësisht RBK, kërkoi tri herë radhazi, më 7 nëntor 2016, 19 janar 2017 dhe 4 prill 2017, respektivisht, që kjo shitje të mos mbahet sepse sipas arsyetimit "*palët të qartësohen lidhur me parcelën 3085/3, e cila është në fazën e ankandeve*". Këto kërkesa ishin miratuar nga Përmbaruesi Privat përmes konkluzioneve përkatëse dhe përmbarimi ishte shtyrë deri më 4 qershor 2017.

36. Më 20 qershor 2017, sipas shkresave të lëndës, Përmbaruesi Privat nxori Konkluzion përmes të cilit caktoi shitjen publike më 21 korrik 2017.

37. Më 21 korrik 2017, pasi që u konstatua se janë plotësuar kushtet procedurale për mbajtjen e shitjes publike dhe pasi u konstatua se nuk ekziston asnjë ofertues tjetër për blerjen e pasurisë së paluajtshme në fjalë, Përmbaruesi Privat përmes Konkluzionit [P. nr. 330/16] konstatoi se janë përmbushur kushtet për pranimin e ofertës së RBK-së në vlerën prej 50,535.00 euro.

38. Më 23 korrik 2017, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [In. nr. 330/2004] e ri për regjistrimin e hipotekës në bazë të Marrëveshjes.

39. Më 22 gusht 2017, Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit [P. nr. 330/16] shpalli se pasuria e paluajtshme e cila ishte objekt i Marrëveshjes i është shitur RBK-së për vlerën prej 50,535.00 euro.

40. Në një datë të paspecikuar, kundër Urdhrit të lartcekur, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

41. Më 25 tetor 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3917/2017], refuzoi si të pabazuar ankesën e debitorëve, përkatësisht, parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Urdhrin [P. nr. 330/16] e 22 gushtit 2017 të Përmbaruesit Privat.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin [Ac. nr. 3917/2017] e 25 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Urdhrin [P. nr. 330/16] e 22 gushtit 2017 të Përmbaruesit Privat, me pretendimin se të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe me nenet 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

43. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në rastin e tyre është aplikuar ligji i gabueshëm. Sipas pretendimit, në shitjen publike të paluajtshmërisë së tyre janë aplikuar dispozitat e Ligjit nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së), i cili u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 11 maj 2017 dhe hyri në fuqi më

26 maj 2017. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kërkesat e kreditorit, përkatësisht RBK-së për shtyrjen e shitjes publike ishin të qëllimshme, sepse sipas pretendimit, aplikimi i nenit 22 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së në shitjen publike dhe e cila ishte organizuar vetëm pasi ligji i ri kishte hyrë në fuqi, në vend të nenit 234 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: LPP), që ishte i aplikueshëm në kohën kur kishte filluar procedura përmbarimore, kishte rezultuar në zvogëlimin e pragut të vlerës së shitjes së paluajtshmërisë në dëm të parashtruesve të kërkesës dhe në favor të RBK-së.

44. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se në rrethanat e rastit të tyre është llogaritur gabimisht (i) shuma e detyrimit për shkak të llogaritjes së gabuar të kamatës së aplikueshme; dhe (ii) vlera e paluajtshmërisë së tyre. Parashtruesit e kërkesës në këtë aspekt theksojnë se kërkesa e tyre për caktimin e një ekspertize është refuzuar pa arsyetim nga Përmbaruesi Privat dhe Gjykata e Apelit, duke rezultuar kështu në shkelje të së drejtës së tyre në vendim të arsyetuar gjyqësor. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit të Gjykatës KI31/17, me parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktgjykim i 14 qershorit 2017 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI31/17).

45. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Marrëveshja është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore dhe "*me parimet* dhe *aktet e Bankës Qendrore të Kosovës*", posaçërisht përkitazi me kamatën ndëshkuese. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës i referohen një numri vendimesh të gjykatave të rregullta, Aktgjykimit [Rev. E. nr. 23/2012] të 1 korrikut 2013 të Gjykatës Supreme; Aktvendimit [Ae. nr. 45/2014] të 10 marsit 2015 të Gjykatës së Apelit; dhe Aktgjykimit [III. C. 163/2015] të 9 marsit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, respektivisht, të cilat i kishin shpallur në kundërshtim me paragrafin 3, të nenit 270 të Ligjit të aplikueshëm për Marrëdhëniet Detyrimore, nenet e marrëveshjeve specifike kreditore që ndërlidhen me kamatën ndëshkuese.

46. Parashtruesit e kërkesës përfundimisht gjithashtu pretendojnë se LPP është në kundërshtim me nenet 22, 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 e nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesit e kërkesës në këtë kontekst, specifikisht theksojnë se ligji përkatës është kundërkushtetues sepse i njëjti (i) mundëson shitjen e paluajtshmërisë së debitorit në ankand publik në një të tretën (1/3) e vlerës së përcaktuar; dhe (ii) nuk lejon përdorimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

47. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe të shpall të pavlefshëm Aktvendimin [AC. nr. 3917/17] e 25 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Urdhrin [P. nr. 330/16] e 22 gushtit 2017 të Përmbaruesit Privat dhe ta kthej çështjen në rivendosje në Gjykatën e Apelit.

Dispozitat Relevante Ligjore

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 234 Çmimi i shitjes së paluajtshmërisë

1. Në seancën e parë të ankandit të shitjes paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se 80% (tetëdhjetë përqind) e vlerës së përcaktuar. Ofertat fillestare për seancën e parë, që janë më të vogla se 80% (tetëdhjetë për qind) e vlerës së përcaktuar nuk do të shqyrtohen.
2. Pa pëlqimin e personave të cilët në procedurën përmbarimore e kanë të drejtën që t'i realizojnë kreditë e tyre para kreditorit, paluajtshmëria në seancën e ankandit nuk mund të shitet për çmimin i cili nuk e mbulon as pjesërisht shumën e kredisë së propozuesit të përmbarimit.
3. Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë, organi përmbarues do ta caktojë seancën e dytë brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh.
4. Organi përmbarues e cakton seancën e dytë brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh edhe kur 3 (tre) ofertuesit më të volitshëm në seancën e parë nuk e kanë paguar çmimin blerës, brenda afateve të caktuara.
5. Në seancën e dytë paluajtshmëria nuk mund të shitet për çmimin që është më i vogël se gjysma e vlerës së përcaktuar me konkluzionin për shitjen. Oferta fillestare në seancën e dytë nuk mund të jetë më e vogël se gjysma e vlerës së përcaktuar.
6. Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet në seancën e dytë, organi përmbarues e cakton seancën e tretë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) deri 30 (tridhjetë) ditë. Në këtë seancë, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.
7. Po që se nuk ekzistojnë persona me të drejtë parablerjeje ligjore, apo kontraktuale, atëherë personi i cili sipas këtij ligji e ka të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë së tij nga çmimi i shitjes, e fiton të drejtën e parablerjes së paluajtshmërisë me çmimin e arritur në seancën e tretë.

LIGJI Nr. 05/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 22
Neni 234 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Në seancën e parë të shitjes publike, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se 50% (pesëdhjetë për qind) e vlerës së përcaktuar me vlerësimin e paluajtshmërisë. Ofertat fillestare në seancën e parë të shitjes publike, të cilat janë më të vogla se 50% (pesëdhjetë për qind) e vlerës së përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.
2. Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë të shitjes publike, organi përmbarues e cakton seancën e dytë të shitjes publike, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 30 (tridhjetë) ditë. Në këtë seancë, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.
3. Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet as në ankandin e dytë, atëherë me propozim të kreditorit, organi përmbarues merr vendim që paluajtshmëria t'i dorëzohet kreditorit duke kaluar në pronësi të tij, me ç'rast edhe kërkesa ndaj debitorit konsiderohet si e përmbushur në tërësi.
4. Po qe se nuk ekzistojnë persona me të drejtë parablerjeje ligjore, apo kontraktuale, atëherë personi i cili sipas këtij ligji e ka të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë së tij nga çmimi i shitjes, e fiton të drejtën e parablerjes së paluajtshmërisë me çmimin e arritur në seancën e dytë.

Pranueshmëria e kërkesës

48. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe të përcaktuara me Rregulloren e punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21
[Parimet e Përgjithshme]

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

50. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

51. Më tej, Gjykata gjithashtu do t'u referohet rregullave relevante të Rregullores së punës, si në vijim:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,

(…)

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dështon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

52. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë nëse kërkesa e parashtruesve të kërkesës i plotëson kriteret e lartcekura të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

53. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që debitorët, përkatësisht parashtruesit e kërkesës dhe kreditori, përkatësisht RBK, kishin lidhur Marrëveshje për kredi në vlerën prej 100,000 euro. Si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga debitori, kreditori kishte kërkuar fillimin e procedurës së përmbarimit për vlerën e mbetur të kredisë, përkatësisht 78,709.68 euro. Gjykata Komunale kishte lejuar përmbarimin dhe lënda ishte transferuar te Përmbaruesi Privat. Ky i fundit, përmes konkluzioneve përkatëse, kishte caktuar ankandet publike për shitjen e palujatshmërisë së përcaktuar me Marrëveshje në vlerën prej 151,600.00 euro. Sipas shkresave të lëndës, paluajtshmëria i është shitur RBK-së, në ankandin publik të 21 korrikut 2017, në një të tretën (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, përkatësisht 50,535.00 euro. Si rezultat, Përmbaruesi Privat kishte nxjerrë Urdhrin për shitjen e paluajtshmërisë. Debitorët, përkatësisht parashtruesit e kërkesës, kishin kontestuar këtë Urdhër në Gjykatën e Apelit, e cila përmes

Aktvendimit [Ac. nr. 3917/2017] të 25 tetorit 2017 e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorëve. Në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë këtë të fundit, duke pretenduar, në esencë, se "*procedura përmbarimore ishte kundërkushtetuese dhe kundërligjore*".

54. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton pretendimet esenciale të parashtruesve të kërkesës duke përfshirë ato sipas të cilave: (i) shitja publike ishte realizuar mbi bazën e ligjit që nuk ishte në fuqi në kohën kur kishte filluar procedura përmbarimore, përkatësisht Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, duke rezultuar kështu në rezultat të ndryshëm dhe më të pafavorshëm për parashtruesit e kërkesës, sesa po të ishte zbatuar LPP; (ii) Përmbaruesi Privat kishte refuzuar caktimin e një eksperti që do të vërtetonte shumën e detyrimit ndaj kreditorit, përkatësisht RBK-së; (iii) Marrëveshja është në kundërshtim me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore; dhe (iv) LPP është në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

55. Gjykata thekson së në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

56. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se praktika e GJEDNJ-së mban se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër* Spanjës, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

57. Në vijim, Gjykata do të trajtoj secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës veç e veç, duke aplikuar mbi këtë vlerësim standardet dhe praktikën përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës.

(i) Sa i përket zbatimit të ligjit të gabuar

58. Në adresimin e këtij pretendimi, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura përmbarimore është zhvilluar duke u bazuar në LPP-në deri në momentin kur hyri në fuqi Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, përkatësisht më 26 maj 2017,

pas të cilës datë në procedurën e tyre përmbarimore, përkatësisht në ankandin publik në të cilën ishte shitur paluajtshmëria e tyre, ishte aplikuar ligji i ri, dhe i cili, sipas pretendimit ishte i pafavorshëm dhe kishte rezultuar në rezultat të ndryshëm dhe arbitrar për parashtruesit e kërkesës.

59. Në kontekst të pretendimeve për interpretim dhe aplikim qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit, Gjykata siç ka cekur më lart, do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

60. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të shqyrtojë ato. (Shih rastin e Gjykatës nr. KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; dhe rastin KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).

61. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57).

62. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë,* Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët,* cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).

63. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatibile me KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).

64. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur vëren se një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të* paarsyeshme" për parashtruesin e kërkesës. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë,* Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2005, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 25 korrikut 2002, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2005, paragrafi 108; dhe shih gjithashtu, rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 40; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 59).

65. Bazuar në parimet e elaboruara më lart, Gjykata fillimisht do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, ligji është aplikuar dhe interpretuar në mënyrë qartazi të gabuar dhe arbitrare dhe nëse ky interpretim ka rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesit e kërkesës.

66. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që Përmbaruesi Privat kishte caktuar tri shitje publike, përmes konkluzioneve të 22 korrikut 2016, 9 shtatorit 2016 dhe 10 tetorit 2016, respektivisht. Dy shitjet e para publike nuk ishin realizuar, ndërsa e treta, ishte shtyrë tri herë me kërkesë të kreditorit. Përmes Konkluzionit të 20 qershorit 2017, e njëjta ishte caktuar dhe ishte mbajtur më 21 korrik 2017, me ç'rast paluajtshmëria e debitorit ishte blerë nga kreditori, përkatësisht RBK, në një të tretën (1/3) e vlerës së saj.

67. Gjykata gjithashtu vëren se pas nxjerrjes së Konkluzionit për shitjen e tretë publike të 10 tetorit 2016 dhe para Konkluzionit të 20 qershorit 2017 i cili kishte rezultuar në realizimin e shitjes publike, kishte hyrë në fuqi Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së. Ky i fundit, ndryshoi procedurën përkitazi me shitjet publike, ndër të tjera, duke

ndryshuar dhe zvogëluar (i) vlerat minimale për shitjen e paluajtshmërisë nëpër shitje publike; dhe (ii) numrin e shitjeve publike nga tri në dy.

68. Më specifikisht, neni 234 i LPP-së u ndryshua përmes nenit 22 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e tij, duke rezultuar në zvogëlimin e pragut për çmimin e shitjes në ankandet publike si në vijim (i) në ankandin e parë, sipas të parit, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se 80 (tetëdhjetë) për qind e vlerës së përcaktuar; ndërsa sipas të dytit, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se 50 (pesëdhjetë) për qind e vlerës së përcaktuar; (ii) në ankandin e dytë, sipas të parit, paluajtshmëria nuk mund të shitet për çmimin që është më i vogël se gjysma e vlerës (1/2) së përcaktuar me konkluzionin për shitjen; ndërsa sipas të dytit, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar. Ndërsa në ankandin e tretë, sipas të parit, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, ndërsa sipas të dytit, ankandi i tretë nuk mbahet por me propozim të kreditorit, organi përmbarues merr vendim që paluajtshmëria t'i dorëzohet kreditorit duke kaluar në pronësi të tij.

69. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, duke marrë parasysh që para organizimit të shitjes publike në të cilin është shitur paluajtshmëria e tyre, hyri në fuqi Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, në këtë shitje publike u aplikuan dispozitat e Ligjit të ri, që nuk ishin në fuqi në kohën kur filloi procedura përmbarimore kundër parashtruesve të kërkesës, dhe se i njëjti ishte më i dëmshëm për debitorët, përkatësisht parashtruesit e kërkesës dhe rrjedhimisht më i favorshëm për kreditorin, përkatësisht RBK-në. Kjo sepse, sipas parashtruesve të kërkesës, nëse do të aplikohej ligji në fuqi në kohën kur kishte filluar procedura përmbarimore, përkatësisht LPP, në shitjen e dytë publike, paluajtshmëria nuk do të mund të shitej në vlerë më të ulët se gjysma (½) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë; ndërsa me dispozitat e Ligjit të ri, paluajtshmëria mund të shitej në një të tretën (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.

70. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se edhe Urdhri [P. nr. 330/16] i 22 gushtit 2017 i Përmbaruesit Privat e edhe Aktvendimi [Ac. nr. 3917/2017] i 25 tetorit 2017 së Gjykatës së Apelit i referohen vetëm dispozitave të LPP-së dhe jo të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e tij. Megjithatë, paqartësia në lidhje me ligjin e aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet me faktin që Urdhri i lartcekur i Përmbaruesit Privat i referohet shitjes publike në të cilën u shit paluajtshmëria e debitorit, si shitje e dytë publike, përkundër faktit që

(i) shitja e dytë publike e caktuar përmes Konkluzionit të 9 shtatorit 2016 ishte shpallur e dështuar; dhe (ii) shitja e tretë publike e përcaktuar përmes Konkluzionit të 10 tetorit 2016 ishte caktuar dhe e njëjta ishte shtyrë tri herë më kërkesë të kreditorit.

71. Gjykata në këtë aspekt rikujton arsyetimin e Urdhrit [P. nr. 330/16] të 22 gushtit 2017 të Përmbaruesit Privat, i cili ndër të tjera, mban:

> *"Në ankandin për shitjen e dytë publike të mbajtur më dt. 10.10.2016, pasi që u konstatua se nuk kishte asnjë të interesuar për blerjen e paluajtshmërisë ankandi u shpall i dështuar, u caktua ankandi për shitjen e tretë publike për dt. 11.11.2016, mirëpo i njëjti ankand nuk është mbajtur pasi që kreditori përmes adresës elektronike të dt. 07.11.2016 ka kërkuar që ky ankand të shtyhet në afat prej 2 muajve, përkatësisht deri me dt. 07.01.2017 në mënyrë që të sqarohet çështja e hipotekës lidhur me parcelën nr. 3085/3, i njëjti ankand për të njëjtën çështje, sipas kërkesës së kreditorit është shtyrë edhe dy herë deri me dt. 20.03.2017 si dhe deri me dt. 04.06.2017.*
>
> *Sipas emailit të dt. 19.06.2017 nga ana e kreditorit, pas shqyrtimit të parcelës në fjalë e cila është hipotekë në këtë lëndë dhe pas takimeve me debitorët, të cilët deri më tani nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje për pagesën e borxhit, sipas kërkesës së kreditorit, Përmbaruesi ka nxjerrë konkluzion me dt. 20.06.2017 dhe ka caktuar ankandin për shitjen e dytë publike me dt. 21.07.2017.*
>
> *Meqenëse në ankandin për shitjen e dytë publike të paluajtshmërisë, kreditori shfrytëzoj të drejtën ligjore për të qenë blerës, Përmbaruesi ka pranuar që paluajtshmëria lëndore t'i shitet kreditorit dhe pas përfundimit të ankandit publik, është nxjerrë konkluzioni i dt. 21.07.2017, me të cilin paluajtshmëria lëndore i është shitur ofertuesit, këtu kreditorit për çmimin prej 50,353.00 euro"***.**

72. Gjykata vëren që arsyetimi i Urdhrit të Përmbaruesit i referohet si shitje e dytë publike shitjes në të cilën u shit paluajtshmëria, megjithatë, në të njëjtin dokument, sqarohet se në fakt, shitja e dytë publike e caktuar përmes Konkluzionit të 9 shtatorit 2016, kishte dështuar, dhe se ishte shitja e tretë publike ajo në të cilën u shit paluajtshmëria e debitorit. Në këtë aspekt, ky Urdhër, mban:

> *"Në ankandin për shitjen e dytë publike të mbajtur me dt. 10.10.2016, pasi që u konstatua se nuk kishte asnjë të interesuar për blerjen e paluajtshmërisë ankandi u shpall i dështuar, u*

caktua ankandi për shitjen e tretë publike për dt. 11.11.2016, mirëpo i njëjti ankand nuk është mbajtur pasi që kreditori përmes adresës elektronike të dt. 07.11.2016 ka kërkuar që ky ankand të shtyhet në afat prej 2 muajve, përkatësisht deri me dt. 07.01.2017 në mënyrë që të sqarohet çështja e hipotekës lidhur me parcelen:1085/3, i njëjti ankand për të njëjtën çështje, sipas kërkesës së kreditorit është shtyrë edhe dy herë deri me dt. 20.03.20 17 si dhe deri me dt. 04.06.2017.

Sipas e-mailit të dt. 19.06.2017 nga ana e kreditorit, pas shqyrtimit të parcelës në fjalë e cila është hipotekë në këtë lëndë dhe pas takimeve me debitorët, të cilët deri më tani nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje për pagesën e borxhit, sipas kërkesës së kreditorit, Përmbaruesi ka nxjerrë konkluzion me dt. 20.06.2017 dhe ka caktuar ankandin për shitjen e dytë publike me dt. 21.07.2017".

73. Rrjedhimisht, Gjykata thekson që përkundër faktit që Urdhri [P. nr. 330/16] i 22 gushtit 2017 i Përmbaruesit Privat i referohet shitjes së dytë publike, e cila bazuar në LPP përcakton se paluajtshmëria nuk mund të shitet nën gjysmën (½) e vlerës së saj, ashtu siç pretendon parashtruesi i kërkesës, nga shkresat e lëndës dhe procedura përmbarimore në rrethanat e rastit konkret në tërësi, rezulton se në fakt, shitja e paluajtshmërisë është bërë në shitjen e tretë publike, në të cilën bazuar në LPP, paluajtshmëria nuk mund të shitet nën një të tretën (1/3) e vlerës të saj, aq sa edhe është shitur paluajtshmëria e debitorëve, përkatësisht parashtruesve të kërkesës. Kjo sepse, siç është cekur më lart, sipas shkresave të lëndës, shitja e dytë publike e përcaktuar përmes Konkluzionit të 9 shtatorit 2016, është shpallur e dështuar, dhe është shitja e tretë publike e cila ishte caktuar përmes Konkluzionit të 10 tetorit 2016 dhe, e cila ishte shtyrë disa herë për t'u realizuar përfundimisht më 21 korrik 2017.

74. Një konstatim i tillë mbështetet edhe nga arsyetimi i Aktvendimit [Ac. nr. 3917/17] të 25 tetorit 2017 i Gjykatës së Apelit, i cili ndër të tjera, sqaron:

"Përmbaruesi privat ka caktuar ankandin e parë dhe të dytë publik për shitjen e paluajtshmërisë ku nuk është paraqitur asnjë ofertues, në ankandin e tretë publik të datës 21.07.2017, si ofertues i vetëm dhe më i favorshëm është shpallur kreditori "Raiffeisen Bank".

"Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për ekzekutim, në bazë të dokumentit përmbarues,

gjykata e shkallës së parë ka lejuar përmbarimin në bazë Aktvendimit për regjistrimin e hipotekës In.nr.330/2004 të datës 23.07.2017, të Gjykatës Komunale në Gjakovë, si dhe marrëveshjes mbi huanë Nr.6278 të datës 23.07.2004, duke u bazuar në nenin 22 paragrafi I, pika 1.7 të LPP-së. Nga kjo rezulton se përmbaruesi privat ka vepruar drejtë, kur ka zhvilluar procedurën për shitjen publike të paluajtshmërisë dhe ka caktuar si blerës këtu kreditorin "Raiffeisen Bank".

75. Gjykata, rrjedhimisht, vëren se në rrethanat e rastit konkret, në shitjen publike në të cilën ishte shitur paluajtshmëria e debitorit, (i) është aplikuar neni 234 i LPP-së dhe jo neni 22 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, siç pretendon parashtruesi i kërkesës; dhe (ii) paluajtshmëria e parashtruesit të kërkesës është shitur në shitjen e tretë publike, në një të tretën (1/3) e vlerës së saj, siç është përcaktuar me LPP.

76. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimin e ngritur nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, sepse në rrethanat e rastit konkret (i) ligji nuk është aplikuar në mënyrë qartazi të gabuar dhe arbitrare dhe se rrjedhimisht, (ii) aplikimi dhe interpretimi i tij nuk ka rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesit e kërkesës.

77. Prandaj, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për aplikimin e ligjit të gabuar në rrethanat e rastit të tij, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Sa i përket refuzimit të caktimit të ekspertit të kërkuar

78. Gjykata rikujton që Marrëveshja për kredinë është nënshkruar në vlerën prej 100,000 euro. Sipas shkresave të lëndës rezulton se në kohën e fillimit të përmbarimit, detyrimet e mbetura ndaj RBK-së, përfshirë kamatën, kanë pasur vlerën e 78,709.68 euro, ndërsa parashtruesi i kërkesës pretendon se ky detyrim në fakt ishte 33,414.06 euro. Për më tepër, për sa i përket vlerës së paluajtshmërisë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vlera e paluajtshmërisë në ndërkohë kishte ndryshuar dhe duhet të vlerësohet në shumën prej 300,000 euro, dhe jo në vlerën e përcaktuar sipas Marrëveshjes fillimisht, përkatësisht në vlerën prej 151,600.00 euro.

79. Sipas shkresave të lëndës rezulton se çështja e angazhimit edhe të një ekspertize ishte ngritur në seancën për shitjen publike të 9 shtatorit 2016, ku sipas Urdhrit [P. nr. 330/16] të 22 gushtit 2017 të Përmbaruesit Privat, kërkesa e parashtruesve të kërkesës ishte trajtuar dhe refuzuar.

80. Në këtë kontekst, Urdhri i Përmbaruesit Privat, përmban sqarimin si në vijim:

> *"Nga parashtresa e debitorëve e dorëzuar në këtë zyrë përmbarimore me dt. 23.08.2016 është kërkuar që lidhur me këtë lëndë të caktohen ekspert për lartësinë e borxhit si dhe caktimi e vlerës së pasurisë së hipotekuar.*
>
> *Në seancën për shitjen publike të mbajtur me dt. 09.09.2016, i autorizuari i kreditorit i kundërshton në tërësi propozimet e debitorëve pasi që kreditori si institucion financiar ka staf të mjaftueshëm për llogaritjen e shumës së kërkesës po ashtu pretendimet se vlera e paluajtshmërisë ka ndryshime nuk qëndron dhe nuk është bazë e mjaftueshme për caktimin e ekspertit për vlerësim, pasi që vlera e paluajtshmërive është e caktuar me marrëveshje në mes të palëve me rastin e lejimit të kredisë, andaj i kundërshton të gjitha kërkesat e debitorëve nga kjo parashtresë, për arsye se janë qëllim për zvarritjen e lëndës, andaj kërkon nga Përmbaruesi që të vazhdohet me mbajtjen e ankandit të dytë, njëkohësisht u caktua ankandi për shitjen e dytë për dt. 10.10.2016".*

81. Për më tepër, këtë çështje e kishte trajtuar edhe Gjykata e Apelit, e cila në këtë kontekst, përmes Aktvendimit [AC. nr. 3917/17] të 25 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit, kishte mbajtur:

> *"Gjykata e Apelit vlerëson se është i pabazuar pretendimi ankimor i debitorëve se vlera e borxhit të papaguar është 33.414.04 euro, e jo siç pretendohet në konkluzion, për faktin se debitorët tek organi përmbarues nuk kanë bashkëngjitur asnjë provë si dëshmi që do të vërtetonte se borxhi është ashtu siç pretendohet. Pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj Urdhrit për shitjen e paluajtshmërisë, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, andaj, organi përmbarues drejtë ka vepruar kur ka mbajtur ankandet dhe ka*

shitur paluajtshmërinë e debitorëve konform dispozitave të LPP-së".

82. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me mungesën e arsyetimit të vendimeve të kontestuara në lidhje me refuzimin e ekspertizës së propozuar, Gjykata do t'i shqyrtojë bazuar në praktikën e saj tashmë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, *i* 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; dhe KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018.

83. Sipas kësaj praktike, në parim GJEDNJ dhe Gjykata theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet "*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre".* Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.

84. Në rrethanat e rastit konkret, Urdhri i Përmbaruesit dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, i referohen (i) vlerës së kredisë të përcaktuar me Marrëveshje; (ii) faktit se vlera e paluajtshmërisë nuk kishte ndryshuar dhe se e njëjta ishte caktuar me Marrëveshjen fillestare; dhe (iii) mungesës së dëshmive që do të vërtetonin një vlerë tjetër të detyrimit apo edhe të paluajtshmërisë.

85. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se Urdhri i kontestuar i Përmbaruesit Privat dhe Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit kanë adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës në kuptimin e garancive procedurale përkitazi me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor e të mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje më nenin 6 të KEDNJ-së dhe janë "*mjaftueshëm të arsyetuara*". Koncepti i "*mjaftueshmërisë së arsyetimit*" edhe në rastet kur e dëshirueshme do të mund të ishte një arsyetim më i gjerë dhe më i detajuar, është koncept i zhvilluar dhe i përdorur edhe nga vetë GJEDNJ. (Shih, në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe i 28 nëntorit 2017, paragrafi 227).

86. Gjykata gjithashtu vëren se, parashtruesit e kërkesës në mbështetje të pretendimit të tyre për refuzimin e kërkesës për caktimin e një eksperti dhe mosarsyetimit të këtij refuzimi, i referohen rastit të Gjykatës KI31/17. Megjithatë, përveç faktit që parashtruesit e kërkesës kanë cekur dhe kanë cituar këtë vendim, ata nuk kanë elaboruar lidhshmërinë e tij, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë. (Shih, në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; dhe rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80).

87. Gjykata megjithatë vëren që rrethanat e rastit të cilit i referohen parashtruesit e kërkesës, përkatësisht rastit KI31/17, nuk përkojnë me rrethanat e tyre, sepse në këtë rast, Gjykata kishte gjetur shkelje të së drejtës në gjykimin të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i shkeljes së parimit të barazisë së armëve dhe vendimit të arsyetuar gjyqësor e që ndërlidhej me (i) refuzimin për dëgjimin e një dëshmitari dhe më me rëndësi, (ii) me identitetin dhe legjitimitetin e palës kundërshtare.

88. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimin e ngritur nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesit e kërkesës nuk dëshmojnë dhe nuk kanë mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tyre për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre sa i përket vendimit të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

89. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(iii) Sa i përket Marrëveshjes së kundërligjshme

90. Sa i përket pretendimit të tretë, përkatësisht kundërligjshmërisë së Marrëveshjes kreditore, Gjykata vëren që nga shkresat e lëndës, nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës të ketë ngritur këtë pretendim në procedurat para gjykatave të rregullta. Për dallim nga rastet të cilave parashtruesit e kërkesës iu referohen në mbështetje të pretendimit të tyre, Aktgjykimit [Rev. E. nr. 23/2012] të 1 korrikut 2013 të Gjykatës Supreme; Aktvendimit [Ae. nr. 45/2014] të 10 marsit 2015 të Gjykatës së Apelit; dhe Aktgjykimit [III. C. 163/2015] të 9 marsit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, paditësit në të gjitha rastet tjera, përgjatë procedurave në gjykatat e rregullta kishin kontestuar ligjshmërinë e nenit 4 të Kontratave Kreditore përkitazi me kamatat ndëshkuese dhe i njëjti nga gjykatat përkatëse ishte shpallur në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 270 të Ligjit të aplikueshëm për Marrëdhëniet Detyrimore.

91. Ky nuk rezulton të jetë rasti nga shkresat e lëndës në rastin e parashtruesve të kërkesës dhe rrjedhimisht, në një kontekst të tillë, Gjykata i referohet praktikës të saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial.

92. Gjykata fillimisht thekson se, përderisa në kontekstin e makinerisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar, ky rregull zakonisht kërkon që ankesat e pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 korrikut 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, cituar më lart, paragrafi 71).

93. Edhe më specifikisht, GJEDNJ mban qëndrimin se, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në

Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72).

94. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "*substancë*" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet. (Shih po ashtu, rastin e Gjykatës, KI71/18, *parashtrues Kamer Borovci*, *Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafit 57; dhe rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73).

95. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesve të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesit e kërkesës nuk u kanë dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatës e Apelit, të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesit e kërkesës i ngrisin drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; dhe rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74).

96. Si rrjedhojë, për sa i përket këtij pretendimi të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konstaton se ai duhet të refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të

paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. (Shih, rastin e Gjykatës KI119/17, cituar më lart, paragrafin 75).

(iv) Sa i përket ligjit kundërkushtetues

97. Në fund, dhe sa i përket pretendimit të katërt të parashtruesve të kërkesës, përkatësisht pretendimit se LPP është në kundërshtim me Kushtetutën, Gjykata rikujton nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, sipas të cilit Kushtetuta ka përcaktuar palët e autorizuara që mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Avokatin e Popullit, respektivisht. Kushtetuta nuk ka përcaktuar individët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret, si palë të autorizuara për të kontestuar kushtetutshmërinë e një ligji. Një mundësi e tillë, është e përcaktuar vetëm në rrethanat dhe nën kushtet e përcaktuara përmes paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe dispozitave përkatëse ligjore dhe të Rregullores së punës.

98. Gjykata rrjedhimisht thekson se parashtruesit e kërkesës si individ përjashtohen nga lista shteruese e palëve të autorizuara, të cilat kanë të drejtë në pajtim me Kushtetutën për të ngritur në Gjykatë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, duke përfshirë edhe vet LPP-në e kontestuar.

99. Gjykata rikujton se individët janë palë të autorizuara të ngrenë vetëm çështjet e shkeljeve nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI38/17, me parashtrues *Meleq Ymeri,* Aktvendim për papranueshmëri, i 10 korrikut 2017).

100. Prandaj, Gjykata konstaton se në kontekstin e këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar e cila mund të iniciojë vlerësimin e përputhshmërisë së LPP-së me Kushtetutën në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatë dhe rrjedhimisht, bazuar në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, dhe nënparagrafin (a) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës, këto pretendime nuk janë të pranueshme për shqyrtim para Gjykatës.

101. Rrjedhimisht dhe në fund, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me (i) aplikimin dhe interpretimin qartazi të gabuar të ligjit, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme bazuar në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës; (ii) refuzimin e përcaktimit të ekspertit dhe mungesës së arsyetimit për këtë refuzim, si qartazi të pabazuara në

baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës; (iii) kundërligjshmërinë e Marrëveshjes, si të papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në kuptimin substancial në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe (iv) mospërputhshmërinë e LPP-së me Kushtetutën si të papranueshme sepse të njëjtat nuk janë ngritur nga një palë e autorizuar në pajtim me nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (a) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (2); 39 (1) (a); dhe 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2019, njëzëri:

VENDOS

I. T'I DEKLAROJË kërkesat e papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI133/17, Parashtrues i kërkesës: Ali Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 96/2017, i 1 qershorit 2017

KI133/17, Aktvendim i miratuar më 29 korrik 2019, i publikuar më 29 gusht 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, autoritetet publike, konfesionet fetare, qasja në gjykatë, parimi i proporcionalitetit, ratione materiae, e drejtë civile, mosmarrëveshje serioze dhe e vërtetë, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesi i kërkesës kishte shërbyer si Kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame në Pejë dhe ishte pensionuar në 27 gusht 2009. Bazuar në vendimet e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës, ai kishte përfituar nga pensioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, deri më 30 dhjetor 2011, datë kjo më të cilën KBI në Pejë kishte ndërprerë të ardhurat e parashtruesit të kërkesës. Ky i fundit kishte kontestuar këtë Vendim të BIK-ut në Pejë, fillimisht brenda strukturave të Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe më pas, përmes gjykatave të rregullta. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kishin miratuar, përkatësisht vërtetuar, padinë e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, këto Aktgjykime, ishin anuluar nga Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [Rev. nr. 96/2017] të 1 qershorit 2017, e cila kishte konstatuar se gjykatat në Republikën e Kosovës nuk kanë juridiksion për të shqyrtuar ndërgjyqësinë ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë, bazuar në paragrafin 2 të nenit 39 të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të nenit 5 dhe paragrafin 2 të nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut për Liritë Fetare. Këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës e kontestoi në Gjykatë duke pretenduar se i njëjti, ndër të tjera, është nxjerrë në shkelje të së drejtës së tij për gjykatë të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari vuri në pah parimet e përgjithshme nga praktika gjyqësore e konsoliduar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtën për qasje në gjykatë duke shpjeguar: (i) natyrën juridike dhe fushëveprimin e të drejtës për qasje në gjykatë; (ii) kushtet që duhen plotësuar për ta pretenduar të drejtën për qasje në gjykatë; dhe (iii) kufizimet, në rrethana të caktuara, ndaj të drejtës për qasje në gjykatë.

Duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka "*një të drejtë civile*", sepse e drejta e tij në "*pension-ndihmë materiale*", ishte e rregulluar me rregullat dhe vendimet e brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe

nuk ishte e bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Gjykata po ashtu vlerësoi nëse kufizimi i të drejtës për qasje në gjykatë kishte "*ndërlidhje të arsyeshme proporcionaliteti në mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet*".

Gjykata më tej theksoi se bazuar në nenin 39 të Kushtetutës, ndër të tjera (i) Konfesionet Fetare kanë autonomi; dhe (ii) janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm. Megjithatë, Gjykata u shpreh se autonomia dhe pavarësia organizative e konfesioneve fetare nuk rezulton detyrimisht në kufizim të së drejtës për qasje në gjykatë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me individët që shërbejnë në Konfesione Fetare. Gjykata theksoi se aplikueshmëria e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duhet të vlerësohet në secilin rast për të konstatuar nëse është e përfshirë një "*e drejtë civile*" dhe nëse ekziston një "*kontest*", rrethanat këto të cilat ua garantojnë të drejtën e qasjes në gjykatë edhe të gjithë individëve që shërbejnë në Konfesione Fetare.

Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konkludoi se nuk është e përfshirë "*një e drejtë civile*" e përcaktuar me ligjet civile të Republikës së Kosovës dhe si rezultat, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk janë të aplikueshëm. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është në pajtueshmëri *ratione materiae* me Kushtetutën dhe bazuar në pikën (b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës, duhet të shpallet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI133/17

Parashtrues

Ali Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 96/2017, i 1 qershorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ali Gashi nga fshati Vërmicë, Komuna e Malishevës, i përfaqësuar nga Xhevdet Krasniqi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 96/2017] të 1 qershorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [CA. nr. 902/2014] e 7 shkurtit 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 432/13] e 24 janarit 2014 të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 korrik 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [CA.nr. 902/2014] e 7 shkurtit 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 432/13] e 24 janarit 2014 të Gjykatës Themelore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

7. Më 14 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 16 nëntor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

9. Më 29 nëntor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë dëshminë (fletëkthesën) që tregon datën e pranimit të Aktvendimit të kontestuar dhe bazuar në nenin 21 (Përfaqësimi) të Ligjit dhe rregullin 32 të Rregullores së punës, kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim në procedurën para Gjykatës. Të njëjtën datë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Themelore.

10. Më 12 dhjetor 2017, Gjykata Themelore dorëzoi dokumente shtesë dhe fletëkthesën që tregon ditën e pranimit të Aktvendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.

11. Më 13 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

12. Më 24 janar 2018, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KBIK) dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë (në tekstin e mëtejmë: KBI në Pejë) për komente eventuale përkitazi me kërkesën nr. KI133/17.

13. Më 30 janar 2018, KBI në Pejë dorëzoi komentet përkatëse në Gjykatë.

14. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

15. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

16. Më 7 maj 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH. KI133/17, për zëvendësimin e anëtarëve të Kolegjit shqyrtues Altay Suroy dhe Ivan Čukalović dhe Kolegji shqyrtues u ricaktua në përbërje të gjyqtarëve: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Bajram Ljatifi.

17. Më 29 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte punuar si Kryeimam në BIK në Pejë.

19. Më 26 nëntor 2002, KBIK-ja përmes Njoftimit [nr. 469/02] informoi të gjitha organet e Bashkësisë Islame të Kosovës se në mungesë të ligjit për pensionet në Republikën e Kosovës dhe deri në miratimin e të njëjtit, punëtorët e Bashkësisë Islame që i plotësojnë kushtet e pensionimit, në emër të pensionit do të kompensohen në vlerën prej 60% të rrogës përkatëse.

20. Më 27 gusht 2009, marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës me KBI në Pejë u ndërpre për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe KBIK, përmes Aktvendimit [nr. 396/09] ia njohu

parashtruesit të kërkesës të drejtën për '*pension-ndihma materiale*' në shumën prej 60% të të ardhurave personale mujore, përkatësisht 300 euro në muaj.

21. Më 30 dhjetor 2011, KBI në Pejë përmes Vendimit [nr. 226/11] e shfuqizoi Aktvendimin e lartpërmendur dhe nga 1 janari 2012, parashtruesit të kërkesës ia ndërpreu përfundimisht '*pensioninndihmën materiale*'. KBI në Pejë, ndër të tjera, Vendimin e saj e kishte arsyetuar me mundësitë e kufizuara buxhetore.

Në lidhje me procedurat brenda strukturave të Bashkësisë Islame të Kosovës

22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në KBI në Pejë, përkitazi me Vendimin e saj për ndërprerjen e kompensimit përkatës.

23. Më 21 mars 2012 dhe 22 janar 2013, respektivisht, KBIK-u iu drejtua KBI-së në Pejë duke (i) theksuar se Vendimi [nr. 226/11] i 30 dhjetorit 2011 është në kundërshtim me Aktvendimin [nr. 396/06] e KBIK-ut; dhe (ii) kërkuar nga e njëjta që të shfuqizoj Vendimin [nr. 226/11] e 30 dhjetorit 2011.

24. Më 8 maj 2013, KBI në Pejë refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Në lidhje me procedurat gjyqësore

25. Në vitin 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi kundër KBI në Pejë në Gjykatën Themelore.

26. Më 24 janar 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.432/13] miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar duke (i) arsyetuar se ekziston raporti juridik-civil në mes të paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës dhe të paditurit, përkatësisht BIK në Pejë bazuar në paragrafin 1 të nenit 262 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978 (në tekstin e mëtejmë: LMD); dhe (ii) detyruar KBI në Pejë që parashtruesit të kërkesës në emër të borxhit për pensionet e papaguara t'ia kompensoi shumën prej 7.200 euro dhe shpenzimet e procedurës.

27. Më 19 shkurt 2014, KBI në Pejë paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së

drejtës materiale dhe propozoi që Aktgjykimi i lartpërmendur të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

28. Ndërkohë, më 6 maj 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Pensionet), ndërsa më 2 dhjetor 2014, KBIK komunikoi Vendimin [Nr. 1068/14] e miratuar më 4 shtator 2014 dhe përmes të cilit e kishte shfuqizuar Vendimin e saj përkitazi me pensionet, duke e ndërprerë zbatimin e të njëjtit nga 1 janari 2015.

29. Më 7 shkurt 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA. nr. 902/2014], refuzoi të pathemeltë ankesën e KBI në Pejë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

30. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për përmbarim duke u bazuar në Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit. Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit për Përmbarim [P.nr.53/2017] lejoi përmbarimin. Sipas shkresave të lëndës, ky Urdhër është përmbaruar.

31. Më 14 mars 2017, KBI në Pejë paraqiti kërkesë për revizion kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, respektivisht, në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, parashtroi përgjigje në revizion.

32. Më 1 qershor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 96/2017] e pranoi të bazuar revizionin e KBI në Pejë, anuloi Aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe e hodhi të papranueshme kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme, mes tjerash, arsyetoi se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë juridiksion për të shqyrtuar ndërgjyqësinë ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe KBI në Pejë. Konstatimin për mungesë të juridiksionit të gjykatave, Gjykata Supreme e bazoi në paragrafin 2 të nenit 5 (Neutraliteti Fetar) dhe paragrafin 2 të nenit 7 (Vetëpërcaktimi dhe vetërregullimi] të Rregullores së UNMIK-ut nr. 02/31 për Liritë Fetare (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut) dhe paragrafin 2 të nenit 39 [Konfesionet Fetare] të Kushtetutës.

Komentet e dorëzuara nga KBI në Pejë

33. Përfaqësuesi i autorizuar i KBI në Pejë theksoi para Gjykatës se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është i drejtë sepse (i) pavarësia e Konfesioneve Fetare, duke përfshirë organizimin e brendshëm, është

e garantuar përmes paragrafit 2 të nenit 5 dhe paragrafin 2 të nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut dhe paragrafit 2 të nenit 39 të Kushtetutës; dhe (ii) gjykatat nuk kanë juridiksion që të gjykojnë çështje që ndërlidhen me organizimin, administrimin e pavarësinë e Konfesioneve Fetare. Në mbështetje të këtyre argumenteve, KBI në Pejë iu referua Aktvendimit të Gjykatës për papranueshmëri të 28 janarit 2016 në rastin nr. KI63/15, me parashtrues *Bedri Haxhi Halili*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit [Rev. nr. 96/2017] të 1 qershorit 2017 të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 8 [Shteti Laik], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ky Aktvendim është nxjerrë në shkelje të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Deklarata Universale).

35. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij për qasje në gjykatë; ndërsa përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve të Gjykatës KI04/12, parashtrues *Esat Kelmendi*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012 (në tekstin e mëtejmë: rasti KI04/12) dhe KI89/13, parashtruese *Arbresha Januzi,* Aktgjykim i 15 majit 2014 (në tekstin e mëtejmë: rasti KI89/13).

36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpall kërkesën e tij të pranueshme dhe të shpall të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 96/2017] e 1 qershorit 2017 të Gjykatës Supreme, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

39. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

40. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 96/2017]

e 1 qershorit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

41. Gjykata në këtë aspekt gjithashtu vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ka plotësuar kriteret e përcaktuara me pikat (a), (b) dhe (c) të paragrafit 1 të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

42. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata gjithashtu i referohet pikës (b) të paragrafit 3 të rregullit 39, sipas të cilës, Gjykata duhet të shpallë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

43. Gjykata në këtë kontekst, rikujton që esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me të drejtën e tij kushtetuese për gjykatë, përkatësisht të drejtën për qasje në gjykatë. Kjo e drejtë është e garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Por kjo e drejtë, dhe siç do të shtjellohet në vijim, nuk është absolute dhe i nënshtrohet kufizimeve të caktuara. Duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret, kontesti i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet më një Konfesion Fetar, autonomia e të cilit është e garantuar më Kushtetutë, Gjykata fillimisht duhet të trajtoj nëse, në rrethanat e rastit konkret, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të aplikueshëm.

44. Për të përcaktuar këtë aplikueshmëri, Gjykata në vijim, do të (i) shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) përkitazi me të drejtën për gjykatë, në harmoni me të cilën bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore; dhe me pas (ii) do të aplikojë këto parime në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me të "drejtën për gjykatë"

45. E drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6 të KEDNJ-së është përkufizuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36). Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GJEDNJ-ja ka konstatuar se "*e drejta për qasje në gjykatë*" është

aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së. (Përkitazi me parimet e përgjithshme të së drejtës në gjykatë, shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesën II, E drejta në Gjykatë dhe gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Zubac kundër Kroacisë,* Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GJEDNJ-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me "*të drejta dhe detyrime civile*" para një gjykate. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të).

46. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që u mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës,* Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).

47. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë '*padi*' lidhur me të "*drejtat dhe detyrimet civile*" përkatëse, tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së mishërojnë të "*drejtën për gjykatë*", përkatësisht të "*drejtën e qasjes në gjykatë*", e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar,* cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave të tij/saj civile dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t'i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.

48. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, së pari duhet të ekzistojë një "*e drejtë civile*" dhe së dyti, një "*kontest*" lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e "*të drejtës civile*" të mbrojtur. Definicioni i të dy këtyre koncepteve, duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Gorou kundër Greqisë (nr.2),* Aktgjykim i 20 marsit

2009, paragrafi 29; dhe *Boulois kundër Luksemburgut,* Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). "*Kontesti*", megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të jetë (i) i "*vërtetë dhe serioz*" (shih, në këtë kontest, rastet e GJEDNJ-së *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81 dhe *Cipolletta kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe (ii) rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë "*vendimtare*" për të drejtën civile në fjalë. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Ulyanov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, "*lidhjet e paqëndrueshme*" ose "*pasojat e largëta*" në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Lovrić kundër Kroacisë,* Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51 dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të).

49. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një "*të drejtë civile*" dhe një "*kontest*", neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së i garantojnë individit të afektuar edhe të drejtën "*që ajo çështje të zgjidhet nga një tribunal*". (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë procedurale themelore të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, kufizon qasjen e tyre në gjykatë. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës,* Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).

50. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, KEDNJ nuk synon të garantojë të drejta që janë "*teorike dhe të rreme*", por të drejta që janë "*praktike dhe efektive*". (Shih, për më tepër rreth të drejtave "*praktike dhe efektive*", Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesa II. E Drejta në Gjykatë, A. E Drejta dhe Qasja në Gjykatë, 1. Një e drejtë praktike dhe efektive; dhe rastet e GJEDNJ-së *Kutić kundër Kroacisë,* cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).

51. Prandaj dhe me rëndësi, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të "*kontestit*" përkatës nga një gjykatë. (Shih rastet e

GJEDNJ-së, *Kutić kundër Kroacisë,* Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Aćimović kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).

52. Parimet e lartpërmendura megjithatë nuk nënkuptojnë që drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNJ-së e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, dhe specifikisht përkitazi me kufizimet në të drejtën në gjykatë, Pjesën II. E drejta në Gjykatë, A. E drejta dhe në qasja në Gjykatë. 2. Kufizimet). Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit ashtu që të cenohet vetë thelbi i të drejtës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë,* Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një "*qëllim legjitim*" dhe nëse ekziston "*një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet*". (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; *Lupeni Greek Catholic Parish kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89; *Naït-Liman kundër Zvicrës,* cituar më lart, paragrafi 115; *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe *Marković dhe të tjerët kundër Italisë,* Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99).

(ii) Zbatimi i këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

53. Bazuar në si më sipër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se e drejta në gjykatë, në parim, është e garantuar përkitazi me "*kontestet*" në lidhje me një "*të drejtë civile*".

54. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se janë dy çështje esenciale për të përcaktuar aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së. E para ndërlidhet me "*të drejtën civile*", ndërsa

e dyta me ekzistencën e një "*kontesti*". Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht do të shqyrtojë nëse të njëjtat ngërthejnë në vetvete një "*të drejtë civile*".

55. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës ishte pensionuar më 27 gusht 2009. Bazuar në vendimet e KBIK-së, përkatësisht (i) Njoftimin [nr. 469/02] e 26 nëntorit 2002; dhe (ii) Aktvendimin [nr. 396/09] e 27 gushtit 2009, ai kishte përfituar nga pensioni i Bashkësisë Islame të Kosovës deri më 30 dhjetor 2011, datë kjo më të cilën KBI në Pejë përmes Vendimit [nr. 226/11] kishte ndërprerë të ardhurat e parashtruesit të kërkesës. Ky i fundit kishte kontestuar këtë Vendim të KBI-së në Pejë, fillimisht brenda strukturave të Bashkësisë Islame të Kosovës. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata vëren se KBIK kishte kërkuar nga KBI në Pejë që të shfuqizonte Vendimin e 30 dhjetorit 2011, kërkesë kjo që nuk u respektua nga KBI në Pejë. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës iu drejtua gjykatave të rregullta. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kishin miratuar, përkatësisht vërtetuar, padinë e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, këto Aktgjykime, ishin anuluar nga Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [Rev. nr. 96/2017] të 1 qershorit 2017, e cila kishte konstatuar se bazuar në paragrafin 2 të nenit 39 të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të nenit 5 dhe paragrafin 2 të nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut, gjykatat në Republikën e Kosovës nuk kanë juridiksion për të shqyrtuar ndërgjyqësinë ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe KBI në Pejë. Parashtruesi i kërkesës e konteston këtë Aktvendim në Gjykatë, duke pretenduar se i njëjti i kufizon atij të drejtën për qasje në gjykatë.

56. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht vëren që në rrethanat e rastit konkret, e drejta e parashtruesit për pension, buron nga rregullat dhe vendimet e brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës. Sipas shkresave të lëndës, rezulton që vendimi i kësaj të fundit për të mundësuar pensionimin e anëtarëve të saj, ishte bërë pikërisht në mungesë të dhe duke mos u bazuar në Ligjin për Pensionet, dhe i cili u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 maj 2014. Më specifikisht, Gjykata rikujton që e drejta e parashtruesit të kërkesës në pensionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, buron fillimisht nga Njoftimi [nr. 469/02] i 26 nëntorit 2002 të KBIK-së, dhe më pas nga Aktvendimi [nr. 396/09] i të njëjtës, përmes të cilit, parashtruesit të kërkesës iu mundësua e drejta për '*pension-ndihma materiale*'. Sipas shkresave të lëndës, pas miratimit të Ligjit për Pensionet, më 4 shtator 2014 KBIK kishte shfuqizuar Vendimin e saj përkitazi me pensionet për anëtarët e saj.

57. Rrjedhimisht, "*e drejta*" e parashtruesit të kërkesës për pension dhe kontesti i tij me KBI në Pejë, ishte e bazuar dhe e rregulluar me rregullat e brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës, pavarësia organizative e të cilës, është e mbrojtur dhe e garantuar me Kushtetutë, ndërsa nuk ishte e bazuar dhe as nuk ishte e rregulluar me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

58. Gjykata më tej thekson se përkundër konstatimit të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj, përmes të cilit kishte pranuar revizionin e të paditurës, përkatësisht KBI në Pejë si të lejuar, kishte arsyetuar se e drejta e parashtruesit të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, buron nga marrëdhënia e punës së tij të rregulluar përmes rregullave të brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës, çështjet e organizimit të së cilës, sipas arsyetimit të Gjykatës Supreme, nuk hyjnë në fushëveprimin e gjykatave të rregullta, dhe rrjedhimisht këto të fundit, nuk kanë kompetencë për t'i zgjidhur kontestet përkatëse që ndërlidhen me to. Më specifikisht, në këtë aspekt, Gjykata Supreme, kishte theksuar:

> "*Gjykata Supreme vlerëson se revizioni i të paditurës Këshilli Bashkësisë Islame në Pejë është i palejuar për faktin "se, gjykatat e rregullta nuk kanë juridiksion për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit përkitazi me realizimin e pagave mujore në emër të pensionit të pleqërisë tek e paditura. Kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë me realizimin e të drejtës nga marrëdhënia e punës në Bashkësinë Islame të Kosovës përcaktuar me Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës në bazë të vendimit të kryesisë të kësaj Bashkësie. Organizimi i brendshëm i bashkësive fetare nuk bije në juridiksionin e gjykatave të rregullta, Bashkësitë Fetare janë të ndara nga autoritetet publike dhe rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur organizimin e tyre të brendshëm. Rrjedhimisht, kërkesëpadia e paditësit është e mbrojtur ne Bashkësinë Islame të Kosovës me Kushtetutën e Bashkësisë Islame*".

59. Megjithatë, përkundër (i) faktit që "*e drejta*" e parashtruesit të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, nuk është e bazuar në ligjin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës, por buron nga rregullativa e brendshme e një Konfesioni Fetar; dhe (ii) arsyetimit të Gjykatës Supreme, Gjykata, në përcaktimin nëse "*e drejta*" e parashtruesit të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, është një "*e drejtë civile*", do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Kjo e fundit, ka shqyrtuar një numër rastesh që ndërlidhen me konfesione fetare, por në rastin *Karoly Nagy kundër Hungarisë* (Aktgjykim i 14 shtatorit

2017), shqyrtoi një çështje shumë të ngjashme me rrethanat e rastit konkret. Duhet theksuar se Kushtetuta Hungareze, rasti i të cilës u shqyrtua në këtë kontekst nga GJEDNJ, po ashtu specifikisht përcakton autonominë dhe pavarësinë e Kishës dhe ndarjen e saj nga Shteti. (Shih, dispozitat e Kushtetutës Hungareze relevante për rrethanat e rastit në pjesën II të Aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin *Karoly Nagy kundër Hungarisë,* cituar më lart*).*

60. Në këtë rast, parashtruesi përkatës kishte pretenduar shkelje të të drejtave të tij për qasje në gjykatë të garantuara me KEDNJ, duke kontestuar vendimet e gjykatave Hungareze e të cilat kishin refuzuar të trajtonin çështjen e tij në merita, duke marrë parasysh se sipas tyre, e drejta e tij në kompensim nuk ishte e përcaktuar në ligjet e shtetit, por me rregullat e Kishës Reformatore Hungareze, ku ai ishte punuar si pastor.

61. Më specifikisht, kontesti i parashtruesit të kërkesës me Kishën përkatëse kishte lindur si rezultat i një procedure disiplinore, të iniciuar nga kjo e fundit dhe e cila kishte rezultuar fillimisht në suspendimin e parashtruesit duke i zvogëluar të ardhurat për 50%, dhe më pas në largimin e tij nga detyra. (Për rrethanat faktike të rastit konkret, shih, rastin përkatës të GJEDNJ-së *Karoly Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart*,* paragrafët 8 deri më 24). Organet e brendshme të Kishës përkatëse kishin refuzuar ankesat e tij. Gjykatat e rregullta Hungareze gjithashtu refuzuan kërkesën e tij, duke theksuar se të ardhurat e tij ishin përcaktuar përmes rregullave të brendshme të Kishës përkatëse Hungareze, dhe nuk i plotësonin kriteret për t'u konsideruar marrëdhënie kontraktuale bazuar në të drejtën përkatëse civile, dhe se rrjedhimisht, gjykatat e rregullta nuk kishin juridiksion për të zgjidhur kontestin përkatës.

62. Çështja më tej ishte shqyrtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese Hungareze. Kjo e fundit, përmes Vendimit të saj nr. 32/2003, shqyrtoi ndërlidhshmërinë e të drejtës në qasje në gjykatë dhe individëve në shërbim në konfesione fetare. Gjykata Kushtetuese Hungareze theksoi se këta individë kanë të drejtë në qasje në gjykatë përkitazi me të gjitha kontestet që ndërlidhen me të drejta që burojnë nga ligjet shtetërore. Gjykata përkatëse më tej theksoi se gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë në të gjitha rastet, në kontekst të rrethanave të tilla, nëse një e drejtë që pretendohet të jetë cenuar, është e rregulluar me ligje shtetërore. Është me rëndësi të theksohet së Gjykata Kushtetuese Hungareze konstatoi se (i) parimi i ndarjes së Kishës nga Shteti nuk mund të rezultojë në cenim të të drejtave të individëve për qasje në gjykatë; megjithatë (ii) e drejta në gjykatë u garanton këtyre individëve vetëm zgjidhjen e kontesteve të cilat kanë bazë në legjislacionin

shtetëror; dhe (iii) që përgjatë zgjidhjes së këtyre kontesteve, gjykatat, përkatësisht Shteti, duhet të respektoj edhe autonominë e Kishës. (Shih arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese Hungareze në paragrafin 29 të rastit të GJEDNJ-së *Karoly Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart).

63. Çështja përfundimisht u shqyrtua edhe nga GJEDNJ. Dhoma e Madhe e saj, konfirmoi vendimet e gjykatave Hungareze, duke i shpallur pretendimet e parashtruesit përkitazi me të drejtën për qasje në gjykatë si *ratione materiae* të papajtueshme me KEDNJ-në. GJEDNJ theksoi, ndër të tjera, se shërbimi, kompensimi dhe benefitet e parashtruesit, ishin të përcaktuara përmes akt-emërimit bazuar në rregullat e brendshme të Kishës; dhe se rrjedhimisht e drejta e parashtruesit në kompensimin e kontestuar, nuk buronte nga ligjet e aplikueshme civile të Shtetit Hungarez. (Shih, arsyetimin e GJEDNJ-së, në paragrafët 64-77, në rastin *Karoly Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart). Si rezultat, GJEDNJ konstatoi se në rrethanat e rastit nuk kishte një "*të drejtë civile*", dhe prandaj garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, nuk ishin të aplikueshme dhe rrjedhimisht kërkesa u parashtruesit u shpall e papajtueshme *ratione materiae* me KEDNJ-në. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Karoly Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 78).

64. Gjykata thekson se ngjashëm si me rastin e lartcekur të GJENDJ-së, e drejta e parashtruesit të kërkesës për pensionin e përcaktuar përmes Aktvendimit të KBIK-së, buron dhe e është e përcaktuar përmes rregullave të brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe nuk është e bazuar në ligjet civile të Republikës së Kosovës. Në rrethana të tilla, Gjykata duhet të konstatoj se, në rrethanat e rastit konkret, nuk është e përfshirë një "*e drejtë civile*" dhe e cila, së bashku me ekzistimin e një "*kontesti*", do t'i garantonte parashtruesit të kërkesës edhe të drejtën për qasje në gjykatë, dhe më specifikisht të drejtën e zgjidhjes së këtij "*kontesti*" nga një gjykatë, si një ndër garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata gjithashtu thekson se fakti që një marrëveshje ose e drejtë që buron nga rregullat e brendshme të një Konfesionit Fetar, mund të ketë ngjashmëri me një marrëveshje kontraktuale që buron nga e drejta civile, jo domosdoshmërisht rezulton në konstatimin se në rrethanat e një rasti ka një të "*drejtë civile*", ekzistenca e të cilës, nuk do të kufizonte të drejtën e qasjes në gjykatë.

65. Gjykata megjithatë duhet gjithashtu të rikujtoj e theksoj se kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore përkatësisht, i të drejtës për gjykatë në rrethanat e rastit konkret, duhet të jetë i përcaktuar në ligj dhe nuk

mund të kufizoj të drejtën përkatëse deri në atë masë, sa të dëmtohet esenca e saj dhe se çdo kufizim, për të qenë kompatibil me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duhet (i) të ndjek një "*qëllim legjitim*"; dhe (ii) të ketë një "*ndërlidhje të arsyeshme proporcionaliteti në mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet*". Këto kritere, janë po ashtu të mishëruara në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

66. Gjykata konsideron se në rrethanat e rastit konkret, një kufizim i tillë ka "*një qëllim legjitim*" dhe ngërthen "*proporcionalitet në mes mjeteve të përdoruara dhe qëllimit që synohet të arrihet*".

67. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në nenin 39 të Kushtetutës, ndër të tjera (i) Konfesionet Fetare kanë autonomi; dhe (ii) janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm. Kjo autonomi dhe pavarësi organizative nuk rezulton detyrimisht në kufizim të së drejtës për qasje në gjykatë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me individët që shërbejnë në Konfesione Fetare. E drejta kushtetuese për qasje në gjykatë u garantohet edhe individëve që shërbejnë në Konfesione Fetare, si cilido qytetarë tjetër, me kushtin që objekti i kontestit të burojë dhe të jetë i rregulluar me ligje të aplikueshme shtetërore, e që, siç është shtjelluar më lart, nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret.

68. Marrë parasysh që autoritetet publike në Republikën e Kosovës janë të ndara nga Konfesionet Fetare, ato nuk mund të përdoren për të zbatuar të rregullat dhe vendimet e brendshme të Konfesioneve Fetare. Për më tepër, parimi i ndarjes së Konfesioneve Fetare nga autoritetet publike, i pamundëson kësaj të fundit të ndërhyjë në çështje të brendshme të të parës.

69. Thënë këtë, dhe përkundër arsyetimit të Gjykatës Supreme, i cili nuk përcakton vetëm mungesën e juridiksionit të gjykatave të rregullta për të zgjidhur rastin e parashtruesit të kërkesës, por edhe juridiksionin gjykatave të rregullta për të zgjidhur të gjitha kontestet që ndërlidhen me çështje të brendshme të Konfesioneve Fetare, Gjykata rithekson se (i) parimi i autonomisë së Konfesioneve Fetare dhe pavarësia e tyre e brendshme organizative, nuk mund të rezultojë në cenim të të drejtave të individëve për qasje në gjykatë të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) gjykatat duhet të vlerësojnë aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e secilit rast për të përcaktuar nëse ka një "*të drejtë civile*" dhe një "*kontest*"; (iii) "*e drejta civile*"

përkatëse duhet të jetë e bazuar në ligjet e aplikueshme civile të Republikës së Kosovës; dhe (iv) që përgjatë zgjidhjes së këtyre kontesteve, gjykatat, duhet të respektojnë edhe autonominë e Konfesionit përkatës Fetarë, siç është e përcaktuar me Kushtetutë.

70. Gjykata në fund gjithashtu rikujton faktin se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të argumenteve të tij i referohet dy rasteve të Gjykatës, përkatësisht rasteve KI04/12 dhe KI89/13. Megjithatë, përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur këto vendime, ai nuk ka shtjelluar lidhshmërinë e tyre, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë. (Shih, në këtë kontekst, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI48/18, të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; dhe rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80). Për më tepër, Gjykata thekson se asnjëri prej rasteve të referuara nga parashtruesi i kërkesës nuk përkon me rrethanat e rastit e tij dhe as nuk ndërlidhen me Konfesione Fetare.

71. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, nuk është e përfshirë "*një e drejtë civile*" e përcaktuar me ligjet civile të Republikës së Kosovës dhe si rezultat, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk janë të aplikueshëm. Prandaj, Gjykata duhet të konstatoj se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është në pajtueshmëri *ratione materiae* me Kushtetutën dhe bazuar në pikën (b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës, duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (3) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI108/18 – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 64/04 të Agjencisë së Regjistrimit Civil, të 13 qershorit 2018

KI108/18, parashtrues i kërkesës: Blerta Morina

Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2019, publikuar më 1 tetor 2019

Fjalët kyqe: *Kërkesa individuale, kërkesë e parakohshme, e drejta për jetë private, të drejtat e personave transgjinor*

Kërkesa është parashtruar nga Blerta Morina. Pa paragjykim të meritave të rastit para gjykatave të rregullta, Gjykata Kushtetuese, në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për sa i përket personave transgjinor, iu referua parashtruesit të kërkesës në gjininë mashkullore, duke respektuar kështu vetidentifikimin e tij me atë gjini.

Objekt i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil përmes së cilit ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për ndërrim ligjor të emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe ndërrim ligjor të shënuesit të gjinisë nga gjinia femërore "F" në gjininë mashkullore "M". Parashtruesi i kërkesës pretendonte se Agjencia e Regjistrimit Civil i ka shkelur atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përveç kësaj, kërkesë kryesore procedurale e parashtruesit të kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, ishte që ai të lirohet nga detyrimi për të shteruar mjetin juridik të përcaktuar me ligj, përkatësisht "*padinë për konflikt administrativ*", në rrethanat e rastit të tij.

Në vlerësim të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht artikuloi (i) parimet e përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Kushtetuese për sa i takon shterimit të mjeteve juridike (shih paragrafët 148-159 të Aktvendimit); dhe, më pas, të njëjtat i (ii) aplikoi në rrethanat e rastit konkret (shih paragrafët 160-191 të Aktvendimit). Aplikimi i parimeve në fjalë dhe zbatimi i testeve të krijuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të përbrendësuara nga Gjykata Kushtetuese, e shpie këtë të fundit në vendimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për lirim nga detyrimi për shterim të mjetit juridik të përcaktuar me ligj, duhet të refuzohet dhe për rrjedhojë, kërkesa KI108/18 duhet të deklarohet e papranueshme si e parakohshme.

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e një mjeti juridik efektiv në rrethanat e rastit të tij dhe duke marrë

parasysh "*rrethanat e veçanta*" të parashtruesit të kërkesës, Gjykata shqyrtoi specifikisht nëse padia për konflikt administrativ është efektive dhe mjaftueshëm e sigurt përtej teorisë edhe në praktikë. Siç është shtjelluar në këtë Aktvendim, në determinimin e efektivitetit dhe sigurisë së mjaftueshme të një mjeti juridik në praktikë, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, praktika gjyqësore relevante për rrethanat e rastit në shqyrtim, është e një rëndësie të veçantë. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese mori parasysh që Gjykata Themelore, pranë të cilës ishte në pritje edhe padia për konflikt administrativ e parashtruesit të kërkesës, veçse kishte praktikë relevante gjyqësore, përmes të cilës, në rrethana të ngjashme, kishte miratuar kërkesën e një personi tjetër transgjinor për ndërrim ligjor të emrit dhe ndërrim ligjor të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M". Vendimi i Gjykatës Themelore ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit. Gjykatat e rregullta ishin thirrur në Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kishin urdhëruar organet përkatëse që korrigjimet në fjalë t'i bëjnë në librat e regjistrimit civil.

Në dritë të këtyre rrethanave, Gjykata konstatoi se padia për konflikt administrativ është "*efektive*" dhe "*mjaftueshëm e sigurt në teori dhe në praktikë*", dhe se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta, ky mjet juridik "*është në gjendje të ofrojë zgjidhje*" përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë si dhe të "*ofrojë mundësi të arsyeshme për sukses*".

Në të tilla raste kur efektiviteti i një mjeti juridik, përtej teorisë, konfirmohet edhe në praktikë përmes praktikës relevante gjyqësore, Gjykata, bazuar në parimin e subsidiaritetit, nuk mund t'ua marrë gjykatave të rregullta kompetencën e tyre kushtetuese për të vendosur mbi pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të mundshme të neneve të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Do të ishte në kundërshtim të plotë me frymën subsidiare të mekanizmit të kontrollit kushtetues nëse Gjykata do të deklaronte një mjet juridik joefektiv kur në fakt i njëjti e ka dëshmuar efektivitetin e tij në praktikë. Respektimi i parimit të subsidiaritetit kërkon pikërisht lejimin e rrugës dhe hapësirës së nevojshme për gjykatat e instancave më të ulëta që ta kryejnë detyrën e tyre për zbatim të drejtpërdrejtë të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në rast se ato dështojnë në këtë detyrë, Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje nga palët respektive në përputhje me juridiksionin e saj.

Në fund të Aktvendimit të saj, Gjykata po ashtu theksoi se deklarimi i kërkesës KI108/18 si të parakohshme në vetvete nënkupton që parashtruesi i kërkesës e ka të garantuar me Kushtetutë dhe dispozitat përkatëse të Ligjit

dhe Rregullores së punës së Gjykatës, mundësinë që t'i drejtohet sërish asaj me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të autoriteteve publike, qoftë të veprimeve apo mosveprimeve të tyre, e të cilat ai mund të pretendojë se konsistojnë në shkelje të ndonjë të drejte apo lirie themelore të garantuar me Kushtetutë, Konventë Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo edhe instrumente të tjera ndërkombëtare të garantuara me Kushtetutë.

Si përfundim, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar kriterin e pranueshmërisë së shterimit të mjeteve juridike të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Krejt në fund, Gjykata e adresoi edhe kërkesën e parashtruesit për kompensim të dëmit jomaterial në vlerë prej 5,000.00 € për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këtë kërkesë të parashtruesit, Gjykata e refuzoi për faktin se kërkesa KI108/18 u shpall e papranueshme në baza procedurale si dhe për faktin se Gjykata nuk ka autorizim që të akordojë "*shpërblim të drejtë*" apo "*dëmshpërblim",* siç një të drejtë të tillë e ka Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në pajtim me nenin 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rregullin 60 të Rregullores së saj të punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI108/18

Parashtrues

Blerta Morina

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit, nr. 64/04 të Agjencisë së Regjistrimit Civil, të 13 qershorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Blerta Morina, përfaqësuar nga avokatja Rina Kika (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

2. Duke respektuar vetidentifikimin e tij me gjininë mashkullore, Gjykata do t'i referohet parashtruesit të kërkesës në po atë gjini (shih rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për sa i përket praktikës së respektimit të vetidentifikimit të personit, *X. kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë,* tashmë Maqedonia e Veriut, Aktgjykim i 17 janarit 2019, paragrafi 1).

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin [nr. 64/14] e 13 qershorit 2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave kundër Vendimeve të Zyrave të Gjendjes Civile, që funksionon si pjesë e Agjencisë së Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të

Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Agjencia e Regjistrimit Civil).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon lirimin nga detyrimi për të shteruar mjetin juridik të përcaktuar me ligj, detyrim ky i përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 30 korrik 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 26 shtator 2018, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatë, me vetë-iniciativë, një kërkesë për t'u paraqitur si *Amicus Curiae* ("*Mik i Gjykatës*") lidhur me rastin KI108/18. Së bashku me kërkesën e tij, Avokati i Popullit dorëzoi një parashtresë me shkrim, përkatësisht një Mendim Juridik, në cilësi të *Amicus Curiae*, lidhur me rastin në fjalë.

10. Më 27 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Agjencisë së Regjistrimit Civil.

11. Më 9 tetor 2018, në bazë të paragrafit (1) të rregullit 55 [*Amicus Curiae*] të Rregullores së punës, Gjyqtarja raportuese u konsultua me Kolegjin shqyrtues lidhur me miratimin e kërkesës së Avokatit të Popullit për t'u paraqitur si *Amicus Curiae* lidhur me rastin KI108/18.

12. Më 11 tetor 2018, Gjyqtarja raportuese, pas konsultimit me Kolegjin shqyrtues, miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit që të paraqitet si *Amicus Curiae,* duke pranuar kështu Mendimin Juridik të dorëzuar nga Avokati i Popullit si pjesë përbërëse të dosjes në rastin KI108/18. Në të njejtën ditë, Gjyqtarja raportuese, në bazë të paragrafit (2) të rregullit 55 të Rregullores së punës, njoftoi të gjithë gjyqtarët e Gjykatës mbi vendimin për lejimin e pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në cilësinë e *Amicus Curiae* në rastin KI108/18.

13. Më 16 tetor 2018, Gjykata njoftoi Avokatin e Popullit, se kërkesa e tij për t'u paraqitur si *Amicus Curiae* është shqyrtuar nga Gjykata dhe është miratuar në bazë të rregullave të lartcekura të Rregullores së punës. Në këtë aspekt, Avokatit të Popullit iu konfirmua se Mendimi Juridik i dorëzuar në Gjykatë tashmë është pjesë përbërëse e dosjes së rastit KI108/18.

14. Në të njejtën datë, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Agjencinë e Regjistrimit Civil lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit që të paraqitet si *Amicus Curiae* për rastin KI108/18. Gjykata po ashtu i njoftoi ata për vendimin mbi lejimin e pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit si *Amicus Curiae* dhe i dërgoi një kopje të Mendimit Juridik të dorëzuar nga Avokati i Popullit.

15. Në të njejtën datë, Gjykata njoftoi dhe iu drejtua Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK) (i) për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës; (ii) lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit që të paraqitet si *Amicus Curiae* për rastin KI108/18, për vendimin mbi lejimin e pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit si *Amicus Curiae* dhe i dërgoi një kopje të Mendimit Juridik të dorëzuar nga Avokati i Popullit; dhe (iii) me kërkesën që deri më 31 tetor 2018, të dorëzoi komente përkatëse përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe mbështejtes së këtyre pretendimeve nga Avokati i Popullit, se në rrethanat e rastit konkret, padia për konflikt administrativ nuk paraqet mjet efektiv juridik. Gjykata iu drejtua KGJK-së me katër pyetje specifike lidhur me vlerësimin e "*efektivitetit*" të mjetit juridik, të ndërtuara mbi praktikën gjyqësore

të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), si në vijim:

(i) A konsideroni se padia për inicim të konfliktit administrativ si mjet juridik, i përmbush standardet e të qenurit "mjaftueshëm i sigurtë, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë", në rrethanat e rastit konkret; (ii) A konsideroni se padia për inicim të konfliktit administrativ si mjet juridik, i plotëson standardet e duhura për t'u konsideruar si i "disponueshëm" për parashtruesin, i "qasshëm" për të dhe "efektiv" në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesën KI108/18. Shembuj nga praktika gjyqësore në këtë drejtim do të ishin të dobishëm; (iii) A konsideroni se padia për inicim të konfliktit administrativ si mjet juridik, ofron "mundësinë e korrigjimit" përkatës dhe "mundësinë e arsyeshme për sukses" në lidhje me pretendimet e parashtruesin të ngritura në kërkesën KI108/18. Shembuj nga praktika gjyqësore në këtë drejtim do të ishin të dobishëm; dhe (iv) A konsideroni se ekzistojnë "rrethana të veçanta" në rastin e parashtruesit së kërkesës e që potencialisht do përmbushnin kriteret për lirimin e parashtruesit nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike."

16. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi përgjigje apo ndonjë koment nga KGJK.

17. Më 2 nëntor 2018, Gjyqtarja raportuese, pas konsultimit me Kolegjin Shqyrtues dhe pas njoftimit të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës, i dërgoi disa pyetje në Forumin e Komisionit të Venecias lidhur me rastin KI108/18, si në vijim:

a. *Cila është praktika në Gjykatën tuaj për të shqyrtuar pranueshmërinë e rasteve, në të cilat parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, por pretendojnë se të njëjtat nuk janë efektive në rrethanat e rastit të tyre?; (ii) A ka liruar Gjykata juaj ndonjëherë ndonjë parashtrues, për shkak të "rrethanave specifike/të veçanta" ose argumenteve të tij/saj për "dëm të paripareushëm", nga nevoja për të shteruar të gjitha mjetet juridike para parashtrimit të ankesës kushtetuese (apo ndonjë ankese të ngjashme) në Gjykatën tuaj? Nëse po, do të vlerësonim të na dërgonit linkun me vendimet përkatëse, mundësisht në gjuhën angleze; dhe (iii) A ka shqyrtuar ndonjëherë Gjykata juaj meritat e një rasti për të drejtat transgjinore? Nëse po, a mund të na siguroni një link të kopjes së një vendimi të tillë, mundësisht në gjuhën angleze?.*

18. Ndërmjet 2 dhe 23 nëntorit 2018, Gjykata pranoi gjithsejt 16 (gjashtëmbëdhjetë) përgjigje/komente lidhur me kërkesën e Gjykatës për informata shtesë mbi praktikën gjyqësore. Një përgjigje u pranua nga Departamenti i Hulumtimit i GJEDNJ-së dhe përgjigjet e tjera u pranuan nga disa gjykata kushtetuese/supreme anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, përkatësisht Gjermania, Bullgaria, Republika Çeke, Hungaria, Letonia, Meksika, Portugalia, Sllovakia, Suedia, Lihtenshtajni, Finlanda, Holanda, Estonia, Kroacia dhe Maqedonia e Veriut. Përgjigjet e pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias reflektohen në paragrafët 105-138 të këtij Aktvendimi për papranueshmëri.

19. Më 8 nëntor 2018, Gjykata i dërgoi një kërkesë të përsëritur për komente KGJK-së duke i rikujtuar se përgjigjet/komentet e tyre lidhur me aspektin procedural të shterimit të mjeteve juridike janë të dobishme për të trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës të mbështetura nga Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit. Gjykata, në këtë drejtim, i dha KGJK-së një afat shtesë prej shtatë (7) ditësh për të paraqitur përgjigjet dhe komentet e tyre në lidhur me pyetjet e shtruara nga Gjykata, të listuara më lart.

20. Më 20 nëntor 2018, KGJK dorëzoi përgjigjet dhe komentet e saj në Gjykatë. Përgjigjet dhe komentet e pranuara nga KGJK reflektohen në paragrafët 84-88 të këtij Aktvendimi për papranueshmëri.

21. Në të njejtën datë, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që ta informojë atë *"sa më shpejtë të jetë e mundur për statusin e procedurës"* në rastin KI108/18.

22. Më 29 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për statusin e procedurës në rastin KI108/18, duke e informuar për hapat procedural të cilët ishin ndërmarrë deri me atë datë. Përmes së njëjtës shkresë, Gjykata po ashtu e njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me pyetjet e saj drejtuar KGJK-së dhe përgjigjet që kjo e fundit i kishte dorëzuar në Gjykatë, duke i dërguar kështu një kopje të shkresës së Gjykatës drejtuar KGJK-së si dhe përgjigjet e KGJK-së dorëzuar në Gjykatë. Me atë rast, Gjykata i dha mundësinë parashtruesit të kërkesës që të paraqes komentet e tij lidhur me komentet e dorëzuara nga KGJK. Krejt në fund, Gjykata po ashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta njoftojë Gjykatën, brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i shkresës, lidhur me dy çështje shtesë duke u përgjigjur në pyetjet vijuese: (i) *A keni paraqitur ndonjë kërkesë për përshpejtim të procedurës apo ndonjë kërkesë ekuivalente në Gjykatën Themelore në Prishtinë? Nëse po, luteni që të dorëzoni një kopje të dokumentit përkatës dhe çdo dokument tjetër, informatë shtesë apo përgjigje që*

mendoni se është relevante në këtë drejtim; dhe (ii) A ka ndërmarrë Gjykata Themelore në Prishtinë ndonjë hap, deri më tani?

23. Më 10 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës u përgjigj në dy pyetjet e lartcekura të Gjykatës si dhe parashtroi komente lidhur me komentet e dorëzuara nga KGJK më 20 nëntor 2018. Përgjigjet dhe komentet shtesë të pranuara nga parashtruesi i kërkesës reflektohen në paragrafët 89-93 të këtij Aktvendimi për papranueshmëri.

24. Më 12 dhjetor 2018, Gjykata i dërgoi KGJK-së, për informatën e saj, një kopje të komenteve shtesë të pranuara nga parashtruesi i kërkesës si komente shtesë kundrejt përgjigjeve dhe komenteve të KGJK-së të dorëzuara në Gjykatë.

25. Më 23 mars 2019, parashtruesi i kërkesës, me vetë-iniciativë, e njoftoi Gjykatën se Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) nga momenti kur është dorëzuar padia e tij për konflikt administrativ më 24 korrik 2018 e deri në momentin e raportimit të fundit në Gjykatë, ende nuk ka dërguar *"asnjë ftesë, thirrje, apo kërkesë tjetër"* në lidhjen me padinë e iniciuar. Parashtruesi i kërkesës theksoi se, për rrjedhojë, më 22 mars 2019 ai ka dorëzuar kërkesën e tij të dytë për *"përshpejtimin e procedurës"* lidhur me padinë e tij si dhe i dërgoi Gjykatës një kopje të kërkesës së tij për përshpejtim të procedurës të drejtuar Gjykatës Themelore. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që ta njoftojë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i kërkesës KI108/18.

26. Më 28 mars 2019, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore përmes së cilës e njoftoi atë për regjistrimin e kërkesës si dhe i kërkoi që ta njoftojë Gjykatën, jo më vonë se më 9 prill 2019, lidhur me fazën e procedurës në të cilën ndodhet shqyrtimi i padisë për konflikt administrativ të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës më 24 korrik 2018.

27. Më 12 prill 2019, Gjykata Themelore iu përgjigj kërkesës së Gjykatës, duke e njoftuar këtë të fundit me sa vijon: *"Duke iu referuar kërkesës suaj, ju informojmë se për lëndën A.nr.1822/2018 të dt.24.06.2018 sipas padisë së paditëses, Blerta Morina, enda nga ana kësaj gjykate nuk është ndërmarr ndonjë veprim procedural përkundër që gjykata është në dijeni të urgjencës së çështjes që të trajtohet. Kjo krejt për arsye të numërit të madh të lëndëve që kemi në pritje që të trajtohen sipas prioritetit të pranimit në gjykatë."*

28. Në të njejtën datë, Gjykata e njoftoi parashtruesin që kërkesa KI108/18 është në fazë të shqyrtimit, duke e njoftuar konkretisht për hapat e mëtejmë procedural të cilat ishin ndërmarrë deri me atë datë.

29. Më 16 prill 2019, 5 qershor 2019, dhe 4 korrik 2019, respektivisht parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën që në po ato data e kishte dorëzuar kërkesën e tij të tretë, të katërt dhe të pestë, për përshpejtim të procedurës para Gjykatës Themelore.

30. Më 21 gusht 2019, raportimet në medie vënë në pah faktin që Gjykata Themelore, pranë së cilës është në shqyrtim e sipër edhe padia për konflikt administrativ e parashtruesit të kërkesës, më 27 dhjetor 2018 kishte marrë vendim meritor për një rast të ngjashëm me rastin në shqyrtim para kësaj Gjykate. Kjo e fundit, nga të njëjtat raportime në medie kuptoi se edhe Gjykata e Apelit, më 2 gusht 2019, e kishte konfirmuar plotësisht vendimarrjen e Gjykatës Themelore e cila kishte urdhëruar organet administrative të Komunës së Prizrenit që t'ia ndryshojnë personit "Y" [identiteti i saktë nuk do t'i zbulohet nga Gjykata, *ex officio*, bazuar në paragrafin (6) të rregullit 32 të Rregullores së punës] emrin sipas kërkesës së tij dhe shënuesin e gjinisë nga "F" (Femër) në "M" (Mashkull). Detajet e këtij rasti reflektohen në paragrafin 167 të këtij Aktvendimi për papranueshmëri.

31. Më 5 shtator 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, njëzëri, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit KI108/18

32. Parashtruesi i kërkesës ka lindur në Gjakovë. Në momentin e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, në librat e regjistrit civil të Republikës së Kosovës, parashtruesi i kërkesës është i regjistruar me emrin "Blerta Morina" dhe me shënuesin e gjinisë femërore, përkatësisht "F".

33. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës gjithnjë ka pasur tendenca të identifikohet me gjininë mashkullore dhe jo atë femërore të përcaktuar në lindje. Si i rritur, ai pohon se jeton dhe paraqitet si *"burrë në të gjitha sferat e jetës: në punë, në qytet, gjatë kohës që e kalon me familjen, në shtëpi, gjatë kohës që e kalon me miqtë dhe në të gjitha situatat e rrethanat tjera të jetës së përditshme."* Ai po ashtu pohon se emri dhe gjinia e shënuar në dokumentet e tij të identifikimit nuk përkon me emrin me të cilin ai prezantohet dhe me gjininë me të cilin ai identifikohet. Një gjë e tillë,

sipas pretendimit, e detyron atë *"që të kalojë nëpër përvoja të vështira e diskriminuese në jetën e tij të përditshme."*

34. Më 27 dhjetor 2017, sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës ishte vizituar tek psikologu dhe psikoterapeuti me qëllim të diskutimit të çështjes së trajtimit hormonal për "*tranzicion*" fizik nga femër në mashkull. (Për definicionin e "*tranzicionit*" (shih, ndër të tjera, publikimin e referuar nga parashtruesi i kërkesës të World Professional Association for Transgjender Health, "*Standards of Care for the Health of Transexual, Transgender, and Gender Nonconforming People*"). Parashtruesi i kërkesës kishte marrë rekomandim pozitiv nga eksperti mjekësor që kishte vizituar. Në janar të vitit 2018, parashtruesi i kërkesës kishte kryer një vizitë tjetër mjekësore në një klinikë në Maqedoninë e Veriut, ku edhe kishte filluar trajtimin hormonal përkitazi me tranzicionin.

35. Më 4 prill 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në Zyrën e Gjendjes Civile, Departamenti për Punë të Përgjithshme Administrative në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: Zyra e Gjendjes Civile). Kërkesa e parashtruesit përmbante dy komponentë. Komponenti i parë i kërkesës kishte të bëjë me kërkesën specifike të parashtruesit të kërkesës për ndërrim të emrit personal nga "Blerta" në "Blert"; ndërsa komponenti i dytë i kërkesës kishte të bëjë me kërkesën specifike të parashtruesit të kërkesës për ndërrim të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M".

36. Parashtruesi kishte kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile që emri personal dhe shënuesi i gjinisë të ndryshoheshin sipas propozimit të tij në të gjitha dokumentet e identifikimit në mënyrë që *"emri dhe shënuesi i gjinisë të jenë në harmoni me identitetin e tij gjinor"*. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kishte shpjeguar që ai, qysh nga fëmijëria, ka tendenca të vishet si mashkull dhe të identifikohet me gjininë mashkullore dhe jo atë femërore të përcaktuar në lindje. Kërkesën e tij për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të gjinisë, parashtruesi i kërkesës e kishte argumentuar duke theksuar se ai ndihet i diskriminuar dhe i përjashtuar nga shoqëria për shkak të mospërputhjes së identitetit të tij gjinor me shënuesin e gjinisë në dokumentet e tij të identifikimit. Ai kishte deklaruar se emri "Blerta" e pengon integrimin e tij në shoqëri sepse nuk ia mundëson që të jetojë lirshëm dhe në përputhje me identitetin e tij gjinor, përkatësisht atë të gjinisë mashkullore. Si rrjedhojë, ai kishte argumentuar se ndërrimi i emrit përbënte kusht esencial për integrimin e tij në shoqëri. Për sa i takon kërkesës së tij për shënuesin e gjinisë, ai kishte argumentuar se seksi që i është përcaktuar personit në lindje nuk është përcaktues kryesor meqë rëndësi ka perceptimi personal i gjinisë apo gjinia të

cilën personi e konsideron si të vetën. Andaj, sipas tij, kërkesa për ndryshimin e shënuesit të gjinisë është e bazuar meqë përcaktimi i gjinisë në dokumente duhet të përshtatet me gjininë me të cilën personi identifikohet. Në mbështetje të argumenteve të tij, parashtruesi kishte cituar dhe ishte thirrur në aktet/praktikat vijuese të aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës: nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës; (ii) nenin 8 të KEDNJ-së; (iii) nenet 3, 6 dhe 12 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ); (iv) nenin 17 të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejmë: PDCP); (v) rastet e GJEDNJ-së: *B. kundër Francës* (Aktgjykim i 25 marsit 1992) dhe *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i 11 korrikut 2002); (vi) nenet 12 (Mënyra e ndërrimit të emrit personal) dhe 17 (Procedura për ndërrimin e emrit personal në bazë të kërkesës) të Ligjit nr. 02/L-118 për Emrin Personal (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Emrin Personal); (vii) paragrafin 1.8 të nenit 6 (Arsyet për ndërrimin e emrit personal) të Udhëzimit Administrativ nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi Administrativ për Emrin Personal); (viii) paragrafin 1.9 të nenit 3 (Përkufizimet) të Ligjit nr. 05-L-020 për Barazi Gjinore (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Barazi Gjinore); (ix) nenin 1 (Qëllimi) të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi); dhe (x) Mendimin Juridik të Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (*Amicus Curiae*) për Gjykatën Themelore në Prishtinë në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë në Kosovë të 2 majit 2017 (në tekstin e mëtejmë: Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë në Kosovë).

37. Më 26 prill 2018, Zyra e Gjendjes Civile përmes Vendimit [nr.02-201-02-8319] e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës në lidhje me të dy komponentët e lartcekur. Në arsyetim të Vendimit të saj, Zyra e Gjendjes Civile theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ për Emrin Personal. Sipas Zyrës së Gjendjes Civile, arsyeshmëria e ofruar nga parashtruesi i kërkesës nuk qëndron dhe nuk e përmbush qëllimin e nën-paragrafit 1 të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij Udhëzimi Administrativ për Emrin Personal pasi që emri "Blerta" nuk e pengon integrimin e personit në shoqëri në Republikën e Kosovës. Zyra e Gjendjes Civile nuk arsyetoi refuzimin e kërkesës për ndërrimin e shënuesit të gjinisë.

38. Më 29 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Vendimit [nr. 02-201-02-8319] të 26 prillit 2018 të Zyrës së Gjendjes

Civile pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Agjencia e Regjistrimit Civil që të anulojë Vendimin e kontestuar të Zyrës së Gjendjes Civile sepse, sipas pretendimit, i njëjti është i *"paligjshëm dhe diskriminues."* Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës theksoi tri arsye. Së pari, sipas parashtruesit të kërkesës, ky Vendim ishte nxjerrë në mungesë të një autorizimi në ligj dhe rrjedhimisht nuk kishte bazë ligjore. Së dyti, sipas parashtruesit të kërkesës, ky Vendim ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të një akti administrativ sepse, ndër të tjera, Zyra e Gjendjes Civile kishte dështuar të ofrojë arsyetim në përputhje me nenin 48 (Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim) të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në tekstin e mëtejmë: LPA). Së treti, sipas parashtruesit të kërkesës, ky Vendim ishte i paligjshëm sepse ishte nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën, KEDNJ-në dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, DUDNJ-në, PDCP-në, Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

39. Më 13 qershor 2018, Agjencia e Regjistrimit Civil përmes Vendimit [nr. 64/04] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Agjencia e Regjistrimit Civil konsideroi se Vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile ishte nxjerrë në përputhje me (i) nenin 12 të Ligjit për Emrin Personal dhe Udhëzimin Administrativ për Emrin Personal; dhe (ii) nenin 11 (Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore) dhe 32 (Dokumentet bazë të lindjes) të Ligjit për Gjendjen Civile.

40. Për sa i takon komponentit të parë, përkatësisht ankesës së parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-miratimin e ndërrimit të emrit personal nga "Blerta" në "Blert", Agjencia e Regjistrimit Civil theksoi se arsyeja e dhënë nga parashtruesi i kërkesës për ndërrimin e emrit personal nuk qëndron sepse nuk është *"dhënë asnjë dëshmi, shkrese, shënim tjetër apo fotografi, dokument arkivor që tregon se emri personal Blerta Morina po e pengon personin në integrimin e saj në shoqëri."*

41. Për sa i takon komponentit të dytë, përkatësisht ankesës së parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-miratimin e kërkesës së tij për ndërrim të shënuesit të gjinisë, Agjencia e Regjistrimit Civil theksoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është e bazuar *"sepse sipas ligjit nënkuptohet që vërtetimi i ogjinisë dhe eventualisht ndërrimi apo korrigjimi i këtij përbërësi të gjendjes civile bëhet vetëm me një raport apo vendim mjekësor."* Më tutje, Agjencia e Regjistrimit Civil theksoi që *"personi duhet që ndryshimet eventuale të përbërësve të gjendjes civile që janë fakte që rrjedhin nga ngjarje natyrore ku*

përfshihet edhe gjinia e personit si fakt natyror duhet të rregullohen me raport mjekësor pastaj raporti mjekësor prodhon pasoja juridike në përbërësit e gjendjes civile." Agjencia e Regjistrimit Civil përfundoi arsyetimin e saj duke theksuar që parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë dëshmi bindëse *"që ka të drejtë në ndërrimin e emrit personal [...] dhe të gjinisë si fakt natyror."*

42. Më 24 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës ngriti padi për konflikt administrativ kundër Vendimit [nr. 64/04] të Agjencisë së Regjistrimit Civil të 13 qershorit 2018, pranë Gjykatës Themelore.

43. Më 30 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tanishme në Gjykatë.

44. Më 4 dhjetor 2018, 22 mars 2019, 16 prill 2019, 5 qershor 2019 dhe 4 korrik 2019, respektivisht, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë për përshpejtim të procedurës lidhur me padinë për konflikt administrativ të ngritur në Gjykatën Themelore.

45. Deri më sot, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës si dhe nga vet shkresat e lëndës dhe informacioneve të dorëzuara në Gjykatë, rezulton që Gjykata Themelore nuk ka vendosur mbi padinë për konflikt administrativ të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Vendimi [nr. 64/04] i 13 qershorit 2018 i Agjencisë së Regjistrimit Civil është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare) të KEDNJ-së. Në pretendimet e tij të paraqitura në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës fillimisht (i) kërkon shpalljen e kërkesës së tij të pranueshme dhe rrjedhimisht paraqet argumentet e tij përkitazi më kërkesën për lirimin nga detyrimi i shterimit të mjeteve jurdike të përcaktuara me ligj; më tej paraqet pretendimet e tij përkitazi me shkeljet e pretenduara të neneve të lartcekura si rezultat i Vendimit të kontestuar të Agjencisë së Regjistrimit Civil, përkatësisht (ii) ndërrimin e emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe (iii) ndërrimit të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M"; ndërsa në fund, ai gjithashtu paraqet (iv) argumentet e tij përkitazi më kërkesën për kompenzimin e dëmit jo-material që i ka shkaktuar Republika e Kosovës me rastin e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të tij. Në vijim, Gjykata do

të paraqes pretendimet e parashtruesit të kërkesës duke u fokusuar në këto katër kategori çështjesh.

a. Për sa i përket shterimit të mjeteve juridike

47. Për sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi i kërkesës e fokusoi argumentimin e tij në kushtin procedural të shterimit të të gjitha mjeteve juridike para dorëzimit të një kërkese në Gjykatë, duke qenë se në mendimin e tij, të gjitha kushtet e tjera të pranueshmërisë janë të plotësuara.

48. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës u referua në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, duke theksuar që kjo e fundit, në shumë raste e ka sqaruar rëndësinë e detyrimit për të shteruar mjetet juridike dhe faktin që ky detyrim përmbrendëson parimin e subsidiaritetit e që nënkupton se organet shtetërore dhe gjykatat duhet të kenë fillimisht mundësinë të parandalojnë apo korrigjojnë shkeljet kushtetuese. Në të njejtën kohë, parashtruesi i kërkesës theksoi se, në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, detyrimi për shterimin e mjeteve juridike bazohet në supozimin se ky rend juridik siguron mjete efektive për adresimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se mjetet juridike në dispozicion janë *"jo-efektive për adresimin e shkeljeve"* përkatëse dhe rrjedhimisht kërkon që bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, të lirohet nga përmbushja e këtij detyrimi të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

49. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se palët janë të detyruara të shterojnë vetëm mjetet juridike "*e qasshme*" dhe "*të mjaftueshme*" dhe se ekzistenca e mjeteve të tilla duhet të jetë "*e sigurtë edhe në praktikë dhe jo vetëm në teori*". Në të kundërtën mjetet e tilla do të cilësohen si "*të papërshtatshme dhe jo-efektive*". Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistimi i "*rrethanave të veçanta*" mund të rezulton në lirimin e parashtruesëve të kërkesave nga detyrimi i shterjes së mjeteve juridike. Në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në rastet *Selmouni kundër Francës* (Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 75 dhe referencave në të) dhe *Van Oosterwijck kundër Belgjikës* (Aktgjykim i 6 nëntorit 1980, paragrafi 36 dhe referencave në të).

50. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se në rrethanat e rastit të tij: (i) mjeti juridik në të vërtetë është përdorur; (ii) mjeti juridik është i papërshtatshëm dhe "*joefektiv*"; dhe (iii) ekzistojnë "*rrethana të veçanta*" për lirimin e tij nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike e përcaktuara me ligj.

51. Për sa i takon argumentit të parë (i) dhe të dytë (ii), respektivisht, parashtruesi i kërkesës thekson se ai i ka përdorur mjetet juridike në dispozicion. Ai thekson se ka shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative duke ushtruar ankesë ndaj Vendimit të Zyrës për Gjendje Civile dhe duke e kontestuar të njëjtin para Agjencisë së Regjistrimit Civil, e cila ka vërtetuar Vendimin e të parës. Parashtruesi i kërkesës thekson se ai po ashtu ka iniciuar padi për konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore. Megjithatë, dhe përkundër faktit që padia e tij është në pritje para Gjykatës Themelore, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet ta lirojë parashtruesin e kërkesës nga detyrimi i shterjes së këtyre mjeteve juridike, sepse sipas pretendimit, të njëjtat janë papërshtatshme dhe "*jo-efektive*" sepse *"mjetet në dispozicion ofrojnë siguri vetëm teorike e jo edhe praktike për rastin e parashtruesit"*.

52. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se pa paragjykuar vendimin që do të merrte Gjykata Themelore apo Gjykata e Apelit, *"periudha e stërgjatë kohore për shqyrtimin dhe zgjidhjen e një lënde administrative në rastin e parashtruesit e bën mjetin juridik të papërshtatshëm dhe joefektiv pikërisht për shkak të rrethanave të veçanta të rastit konkret."* Prandaj, parashtruesi i kërkesës pohon se ngritja e padisë për konflikt administrativ e më pas potencialisht ankesa pranë Gjykatës së Apelit *"nuk paraqet mjet juridik efektiv sepse nuk e siguron adresimin e shkeljes së të drejtave të parashtruesit brenda një kohe të arsyeshme siç garantohet me Kushtetutë dhe KEDNJ."*

53. Në argumentimin se mjetet juridike në dispozicion janë "*joefektive*" në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës fillimisht i referohet Raportit të Përgjithshëm Vjetor të vitit 2017 të KGJK-së sipas të cilit në Gjykatën Themelore, ku edhe është parashtruar padia, janë gjithsejt 5,304 lëndë të pazgjidhura. Gjatë vitit 2017 janë zgjidhur gjithsej 2,268 lëndë administrative, ndërkaq që sipas raportit tremujor të KGJK-së të vitit 2018 është konstatuar se gjithsej janë 5,297 lëndë të pazgjidhura. Koha e llogaritur e zgjidhjes së lëndëve administrative në vitin 2017, sipas këtyre të dhënave, për një rast llogaritet të jetë përafërsisht 853 ditë në shkallë të parë. Më tutje, në Gjykatën e Apelit llogaritjet tregojnë se duhen 412 ditë për tu zgjidhur një rast në shkallë të dytë. Rrjedhimisht, sipas pretendimit, i bie që për

zgjidhjen e një lënde administrative e cila procedohet në Gjykatë Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, nevojiten mesatarisht tre (3) vjet e katër (4) muaj. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën të publikuar në prill të vitit 2018, ka vlerësuar se numri i madh i lëndëve administrative të pazgjidhura në Gjykatën Themelore "*vështirë se do të zvogëlohet në të ardhmen*".

54. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se ekziston mundësia reale që Gjykata Themelore të mos e vendos rastin në merita, por vetëm ta kthejë në procedurë administrative pranë organeve administrative që veçse kanë vendosur, gjë që e bën kohëzgjatjen e procedurës së paku dyfish më të gjatë. Në theksimin e këtij problemi të trajtimit të lëndëve administrative, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe konstatimeve të Avokatit të Popullit, në Raportin e tij nr.425/2015 të 22 gushtit 2016 lidhur me mungesën e mjeteve juridike efektive, drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Themelore. Avokati i Popullit, sipas parashtruesit të kërkesës, në këtë raport ka konstatuar se në kontestet administrative gjykatat nuk janë lëshuar në shqyrtimin e meritave të rastit por vetëm i kanë konstatuar shkeljet procedurale dhe si pasojë të njëjtat, janë kthyer në rishqyrtim tek organi i cili e ka marrë fillimisht vendimin, përderisa ai vendosë sërish në mënyrë të njejtë. Ndër të tjera, sipas pretendimit, Avokati i Popullit, në këtë Raport po ashtu *"ka konstatuar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga paditë e ushtruara nga ankuesit të cilëve për shkak se mjetet juridike ishin joefektive dhe nuk siguronin realizimin e të drejtës që u takonte ankuese."*

55. Lidhur me kohëzgjatjen e procedurave, parashtruesi i kërkesës thekson se GJEDNJ dhe Gjykata kanë theksuar tashmë se kohëzgjatja e procedurave në vetvete *"nuk e bën mjetin efektiv joefektiv dhe se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet sipas rrethanave të rastit"*, përkatësisht, sipas parashtruesit të kërkesës, bazuar në "*ndërlikueshmërinë e rastit*"; "*sjelljen e autoriteteve relevante*" dhe "*çështjes në shqyrtim*" për parashtruesin në atë kontest.

56. Për sa i takon "*ndërlikueshmërisë së rastit*", parashtruesi i kërkesës pohon se rasti konkret ka të bëjë vetëm me një palë e cila kërkon të drejtën e tij për ta ndërruar emrin dhe shënuesin e gjinisë dhe të gjitha provat me rëndësi i janë bashkëngjitur kërkesës. Kërkesat e parashtruesit të kërkesës nuk ndërlidhen me ndonjë ndërlikueshmëri të madhe ligjore. Identiteti gjinor është kategori e mbrojtur ligjore sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe paragrafit 1.9 të nenit 3 të Ligjit për Barazi Gjinore dhe *"hyn në kuadër të obligimeve*

pozitive të shtetit për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë sipas nenit 36, nenit 22, nenit 53 të Kushtetutës". Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në një mori rastesh specifikon detyrimin pozitiv të shtetit për njohjen ligjore të identitetit gjinor me të cilën identifikohet personi dhe ofron një praktikë të gjerë rreth asaj se *"çfarë mund të konsiderohet si shkelje e të drejtës së privatësisë në kontekstin e njohjes ligjore të identitetit gjinor e çka jo."* Sipas parashtruesit të kërkesës, fakti që ky është rasti i parë i paraqitur nga ndonjë person transgjinor që kërkon ti njihet identiteti i tij gjinor ligjërisht dhe emri i tij të ndërrohet ashtu që të përkojë me identitetin e tij gjinor, nuk do të duhej të konsiderohet karakteristikë që e bën rastin e ndërlikuar. Në mbështetje të pretendimeve të tij parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve të GJEDNJ-së: *B. kundër Francës*, cituar më lart; *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart; dhe *A.P. Garçon dhe Nicot kundër Francës* (Aktgjykim i 6 prillit 2017).

57. Për sa i përket "*sjelljes së parashtruesit dhe të autoriteteve relevante*", parashtruesi i kërkesës thekson se ai ka ushtruar padi brenda afatit ligjor dhe nuk ekziston asnjë rrethanë apo provë për të konsideruar se sjella e parashtruesit të kërkesës ka ndikuar apo do të ndikonte në zvarritjen e procedurës. Parashtruesi i kërkesës e sheh ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë së tij si *"çështje esenciale për zhvillimin e tij personal dhe shoqëror, andaj është i gatshëm ti shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike deri në njohjen ligjore të identitetit të tij gjinor."*

58. Ndërsa, për sa i përket "*sjelljes së autoriteteve*", parashtruesi i kërkesës thekson se në këtë kontekst është e aplikueshme kohëzgjatja e trajtimit të çështjeve administrative në Gjykatën Themelore dhe rreziku që në të shumtën e rasteve kërkesat nuk vendosen në merita, por vendoset që çështja t'i kthehet organeve të administratës për rivendosje, e këto të fundit, sipas parashtruesit të kërkesës dhe duke iu referuar raporteve përkatëse të Avokatit të Popullit, në të shumtën e rasteve vendosin sikurse në herën e parë. Rrjedhimisht, thekson parashtruesi i kërkesës *"përgjegjësia për zvarritjen bie mbi autoritetet përkatëse."*

59. Në fund, për sa i përket "*çështjes në shqyrtim*" për parashtruesin e kërkesës, ai thekson se ndryshimet e pësuara nga "*procesi i tranzicionit*" përmes terapisë hormonale, janë gjithnjë e më të dukshme në aspektin fizik. Çështja e ndërrimit të emrit dhe të shënuesit të gjinisë *"është esenciale për parashtruesin."* Mos trajtimi i lëndës në kohë të arsyeshme *"do të shkaktonte shkelje të të drejtave të tij, pasi që do të vazhdonte gjendja e mos-përputhjes së emrit dhe gjinisë me të cilin parashtruesi identifikohet dhe paraqitet, me emrin*

dhe shënuesin e gjinisë që figuron në dokumentet e tij të identifikimit ndërsa Gjykata nuk do të arrijë ta shqyrtojë lëndën e tij brenda kohës së arsyeshme."

60. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se GJEDNJ në një numër të caktuar të rasteve e kishte vlerësuar *"çështjen në shqyrtim për parashtruesin"* si "*rrethanë të veçantë*" për vlerësimin e shkeljes të së drejtës në gjykim brenda një kohe të arsyeshme të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. Kriterin e tillë, thekson parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ e ka përdorur edhe në rastet që kishin të bëjë me gjendjen civile, siç janë rastet e GJEDNJ-së: *Bock kundër Gjermanisë* (Aktgjykim i 21 shkurtit 1989)*; Laino kundër Italisë* (Aktgjykim i 18 shkurtit 1999) dhe *Mikulić kundër Kroacisë* (Aktgjykim i 7 shkurtit 2002). GJEDNJ ka vlerësuar se *"rastet që kanë të bëjnë me gjendjen civile të parashtruesve, kërkohet një kujdes i veçantë për shqyrtimin e tyre brenda një kohe të arsyeshme",* duke konstatuar shkelje e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, në të tri rastet e lartpërmendura.

61. Në fund, dhe përkitazi me argumentin e tretë (iii) të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht ekzistimin e "*rrethanave të veçanta*" në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës iu referohet rasteve të GJEDNJ-së *Van Ooserwijck kundër Belgjikës* (Akgjykim i 6 nëntorit 1980 dhe referencat përkatëse në të) dhe *Selmouni kundër Francës* (Aktgjykim i 28 korrikut 1999 dhe referencat përkatëse në të) sipas të cilëve, sipas parashtruesit të kërkesës, ekzistimi i "*rrethanave të veçanta*", mund ta liroj parashtruesin nga detyrimi i shterjes së mjeteve juridike të cilat ai i ka në dispozicion. GJEDNJ po ashtu, sipas parashtruesit të kërkesës, ka theksuar se zbatimi i rregullit të shterimit duhet të përfshijë edhe kontekstin. Në aspekt të kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës si "*rrethanë të veçantë*" në rastin e tij thekson "*mospërputhjen e dukjes dhe sjelljes së tij me gjininë e paraqitur në dokumentet e identifikimit*" dhe "*kontekstin ligjor dhe politik*" të ndërlidhur me komunitetit të cilin ai e përfaqëson.

62. Përkitazi më të parën "*rrethanë të veçantë*", parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se përcaktimi i shënuesit të gjinisë femërore e jo mashkullore dhe njëherësh emri "Blerta" dhe jo "Blert" në dokumentet e tij të identifikimit paraqesin *"pengesa të cilat nuk ia lejojnë atij gëzimin e të drejtës në jetë private dhe e vendosin në situata që e cenojnë dinjitetin e tij njerëzor."*

63. Në këtë kontekst, ai rithekson se në janar të vitit 2018, ka filluar procesin e tranzicionit fizik, dhe si rezultat i trajtimit hormonal, ai "*tashmë ka filluar të ketë ndryshime të dallueshme fizike duke i*

humbur karakteristikat femërore". Për më tepër, duke marrë parasysh që në Republikën e Kosovës mungon përkujdesja dhe shërbimet tjera mjekësore për personat transgjinor, parashtruesi i kërkesës trajtohet në Maqedoninë e Veriut, dhe bën vizita mjekësore çdo katër (4) muaj. Si rezultat, ai duhet të kaloj pikën kufitare dhe kontrollin e dokumenteve të identifikimit, dallimi me të cilat në raport me dukjen e tij fizike është gjithnjë më i madh, dhe e nënshtron atë në mënyrë të vazhdueshme në shkelje të të drejtave të tij të garantuara kushtetuese kundër diskrimiminit dhe mbrojtjes së privatësisë, posaqërisht. Trajtimi degradues në pika kufitare, sipas parashtruesit të kërkesës, është i vazhdueshëm edhe si rezultat i pjesëmarrjes së tij në konferenca ndërkombëtare, duke marrë parasysh që ai është edhe drejtor i organizatës jo-qeveritare CEL, që merret me avokim, mbrojtje dhe përmirësim të jetës së komunitetit LGBT *("Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender").*

64. Përkitazi me të dytën "*rrethanë të veçantë*", përkatësisht "*kontekstin ligjor dhe politik*", parashtruesi i kërkesës thekson se "*duhet pasur parasysh faktin se komuniteti transgjinor është kategori tejet e margjinalizuar dhe e paragjykuar në shoqërinë Kosovare."* Ky fakt, sipas parashtruesit të kërkesës është *"fakt notor"* dhe si i tillë është konfirmuar nga Avokati i Popullit në *Amicus Curiae* dërguar Gjykatës Themelore në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë në Kosovë si dhe në Raportin Vjetor për vitin 2017.

65. Për të ilustruar këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se është e rëndësishme të përmenden dy ngjarjet më të rëndësishme në historinë e komunitetit LGBTI *("Lesbian, Gay, Bisexual, Transgender and Intersex")* në Kosovë, përkatësisht sulmi ndaj gazetës Kosovo 2.0 në vitin 2012 dhe organizimi i Paradës së Krenarisë në vitin 2017 [Sqarim: parashtruesi i kërkesës në disa raste i referohet akronimit LGBT e në disa raste akronimit LGBTI.]. Parashtruesi i kërkesës thekson se këto ngjarje shpërfaqin *"homofobinë dhe transfobinë e shoqërisë Kosovare."* Përkundër disa zhvillimeve pozitive, është e qartë, sipas parashtruesit të kërkesës, se *"autoritetet shtetërore nuk i shfrytëzojnë ligjet në fuqi për ti adresuar në mënyrë të mirëfilltë shkeljet dhe rastet që kanë të bëjë me komunitetin LGBTI."*

66. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se *"pranimi i shqyrtimit të kushtetutshmërisë së Vendimit të ARC* [Agjencisë së Regjistrimit Civil] *nga Gjykata Kushtetuese është i nevojshëm dhe i rëndësishëm për t'i reflektuar ndryshimet pozitive shoqërore në kontekstin ligjor të trajtimit të komunitetit LGBT nga institucionet vendore në Kosovë."* Me pranimin e vlerësimit të kushtetutshmërisë të Vendimit të kontestuar, sipas pretendimit, Gjykata *"do ta vendoste një standard*

shumë të nevojshëm në Kosovë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të komunitetit LGBTI në Kosovë." Prandaj, sipas pretendimit, *"edhe konteksti ligjor e politik në lidhjen me mbrojtjen e komunitetit LGBTI në Kosovë duhet të konsiderohet në favor të kërkesës së parashtruesit për tu liruar nga detyrimi i shterjes së të gjitha mjeteve juridike."*

(ii) Për sa i përket meritave, përkatësisht kërkesës së parashtruesit për ndërrim të emrit nga "Blerta" në "Blert"

67. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi [nr.64/04] i Agjencisë së Regjistrimit Civil është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 23, 24 dhe 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.

68. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se refuzimi i ndërrimit të emrit të tij ka cenuar të drejtën e tij në privatësi, e cila, sipas praktikës së GJEDNJ-së e përfshinë edhe identitetin gjinor. Parashtruesi i kërkesës thekson se elementet si identifikimi gjinor, emri, orientimi seksual dhe jeta seksuale, hyjnë brenda sferës personale të mbrojtur me nenin 8 të KEDNJ-së. Për më tepër, vazhdon parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ ka theksuar se *"nocioni i autonomisë personale është princip i rëndësishëm që përcakton interpretimin e garancave nën nenin 8 KEDNJ dhe që, duke qenë se në vet esencën e KEDNJ qëndron respekti për dinjitetin dhe lirinë njerëzore, e drejta e personave transgjinor në zhvillim personal, siguri fizike dhe morale është e mbrojtur nga Konventa."*. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës iu referohet rasteve të GJENJD-së *B. kundër Francës*, cituar më lart; *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart; dhe *A.P. Garçon dhe Nicot kundër Francës,* cituar më lart. Prandaj, në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Vendimi i lartcekur është nxjerrë edhe në shkelje të së drejtave të tij të garantuara me nenin 23 të Kushtetutës.

69. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Vendimi [nr.64/04] i Agjencisë së Regjistrimit Civil është nxjerrë në shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht është diskriminues. Në mbështetje të këtij pretendimi parashtruesi i kërkesës bazohet në arsyetimin e Agjencisë së Regjistrimit Civil e sipas të cilit *"dhënia e arsyetimit se personi dëshiron ta ndërrojë emrin për shkak të identitetit të tij gjinor, nuk përbën arsye të mjaftueshme për qytetarët e Kosovës që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre në ndërrimin e emrit"*. Sipas parashtruesit të kërkesës, ky arsyetim përjashton parashtruesin e kërkesës, mbi bazën e identitetit gjinor, nga përfitimi i të drejtave të garantuara për të gjithë qytetarët tjerë. Duke mos e trajtuar identitetin gjinor si kategori të mbrojtur kushtetuese dhe ligjore, Vendimi i

kontestuar, përtej shkeljes së nenit 24 të Kushtetutës, sipas pretendimit, është nxjerrë edhe në shkelje të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

70. Për më tepër, sipas parashtruesit të kërkesës, Vendimi i kontestuar, është nxjerrë edhe në shkelje të LPA-së, Ligjit për Emrin Personal dhe Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit Personal. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës shtron dy kategori argumentesh (i) "*mungesën e arsyeshmërisë*" dhe (ii) "*mungesën e dokumenteve shtesë*".

71. Sa i përket të parës kategori, Vendimi i kontestuar kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për ndërrimin e emrit duke u bazuar në "*mungesën e arsyeshmërisë*" së kësaj kërkese. Sipas parashtruesit të kërkesës, "*mungesa e arsyeshmërisë*" nuk është bazë ligjore mbi bazën e të cilës mund të refuzohet kërkesa për ndërrimin e emrit.

72. Më specifikisht, sipas parashtruesit të kërkesës, neni 12 i Ligjit për Emrin Personal garanton se emri personal mund të ndërrohet në bazë të kërkesës së një personi dhe procedura për ndërrimin e emrit përcakton edhe kufizimet përkatëse të cilat parashihen taksativisht në nenin 18 të Ligjit për Emrin Personal. Ky i fundit, nuk përcakton "*mungesën e arsyeshmërisë*" si njërën nga bazat mbi të cilën mund të refuzohet një kërkesë. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, "*mungesa e arsyeshmërisë*" nuk përbën bazë ligjore mbi të cilën mund të refuzohet një kërkesë. I njejtë është rasti edhe me Udhëzimi Administrativ për Emrin Personal e edhe me vet Formularin që është në dispozicion të palëve me rastin e paraqitjes së kërkesave për ndërrimin e emrit. Dokumentacioni që kërkohet përmes këtij të fundit, është i kufizuar në kriteret e nenit 18 të Ligjit për Ndërrimin e Emrit Personal.

73. Për më tepër, Formulari përkatës përcakton dhënien e arsyeve në mënyrë deklarative, në rastin konkret për arsye se emri personal "*pengon integrimin e personit në shoqëri",* por nuk kërkon paraqitjen e shpjegimeve narrative. Megjithatë, dhe përkundër faktit që dhënia e shpjegimeve narrative nuk është e kërkuar me Ligjin për Ndërrimin e Emrit, Udhëzimin Administrativ për Emrin Personal dhe as Formularin përkatës, dhe përkundër konstatimeve të Agjencisë së Regjistrimit Civil, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesën e tij edhe në formë narrative ku kishte shpjeguar se është person transgjinor dhe kishte paraqitur arsyet mbi bazën e të cilave emri i tij "*pengon integrimin e personit në shoqëri."*

74. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se përtej faktit që "*mungesa e arsyeshmërisë*" e përdorur nga Agjenica e Regjistrimit Civil në refuzimin e kërkesës së tij nuk përkon më gjendjen faktike sepse parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar arsyet përkatëse me rastin e paraqitjes së kërkesës, e njëjta, përkatësisht "*mungesa e arsyeshmërisë*", është në kundërshtim me dhe nuk ka bazë ligjore në Ligjin për Emrin Personal, dhe rrjedhimisht është në kundërshtim edhe me LPA-në. Kjo sepse bazuar në nenin 52 (Paligjshmëria e aktit administrativ) në lidhje me nenin 4 (Parimi i ligjshmërisë) së tij, një akt administrativ është i paligjshëm nëse është nxjerrë në mungesë të autorizimit të bazuar në një ligj.

75. Sa i përket të dytës kategori, përkatësisht, "*mungesës së dokumenteve shtesë*", parashtruesi i kërkesës thekson se pjesa e Vendimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil ku theksohet se *"parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi, fotografi dhe dokumente tjera që do të dëshmonin se emri e pengon integrimin e personit në shoqëri",* është në kundërshtim me Ligjin për Ndërrimin e Emrit Personal dhe Udhëzimin Administrativ për Emrin Personal. Për më tepër që, sipas parashtruesit të kërkesës, edhe po të ishte ky rasti, Agjencia e Regjistrimit Civil ka vepruar në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPA-së, duke mos i kërkuar parashtruesit të kërkesës të njëjtat, para nxjerrjes së Vendimit të saj. Kjo sepse, sipas parashtruesit të kërkesës, neni 11 (Parimi i informimit dhe ndihmës aktive) i LPA-së, detyron Agjencinë e Regjistrimit Civil që përgjatë zhvillimit të procedurës administrative, të ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, duke përfshirë sqarimin rreth "*kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar*". Kjo kërkesë është e mishëruar edhe në paragrafin 4 të nenit 73 (Forma dhe përmbajtja e kërkesës) të LPA-së, mbi bazën e të cilit, "*Organi publik përpiqet të kuptojë çfarë kërkohet në kërkesën e parashtruar dhe nëse është e nevojshme kontakton kërkuesin për sqarime të mëtejshme apo për plotësimin e saj*", gjë të cilën Agjencia e Regjistrimit Civil ka dështuar të bëjë. Në të njëjtin kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) dhe nenit 132 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror) të LPA-së.

(iii) Për sa i përket meritave, përkatësisht kërkesës së parashtruesit për ndërrim të shënuesit gjinor nga "F" në "M"

76. Parashtruesi i kërkesës thekson se Agjencia e Regjistrimit Civil e ka refuzuar kërkesën për ndërrimin e shënuesit të gjinisë si të pabazuar sepse ai nuk ka paraqitur raport mjekësor e i cili do të dëshmonte ndërrimin e gjinisë si përbërës i gjendjes civile. Këtë Vendim, Agjencia e Regjistrimit Civil e kishte nxjerrë në bazë të nenit 11 (Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore) dhe 32 (Dokumentet bazë të lindjes) të Ligjit për Gjendjen Civile. Sipas parashtruesit të kërkesës, kushtëzimi i njohjes të identitetit gjinor me raport mjekësorë i cili fakton dhe evidenton ndyrshimet në gjininë e përcaktuar në lindje, është në kundërshtim me nenin 36 të Kushtetutës në lidhje më nenin 8 të KEDNJ-së, nenin 23 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së dhe nenin 53 të Kushtetutës, mbi bazën e të cilës të drejtat dhe liritë themelore, duhet të interpretohen bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

77. Praktikën gjyqësore të kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës e elaboroi duke u thirrur në disa vendime specifike të GJEDNJ-së, përkatësisht rastin *A.P. Garçon dhe Nicot kundër Francës* (cituar më lart) dhe *Van Kück kundër Gjermanisë* (Aktgjykim i 12 qershorit 2003). Në këto raste, theksoi parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ kishte konstatuar se jo të gjithë personat transgjinor dëshirojnë, dhe jo të gjithë munden t'i nënshtrohen trajtimit mjekësor apo ndërhyrjeve kirurgjike dhe kërkesat që të bëhen ndërhyrje të tilla për t'ju njohur ligjërisht identiteti gjinor, nuk janë praktika në *"përputhshmëri me respektin për lirinë njerëzore dhe dinjitetin që njëherësh janë ndër parimet kryesore të KEDNJ."* Pra, argumenton parashtruesi i kërkesës, praktika gjyqësore e GJEDNJ ka *"vlerësuar se kushtëzimin e njohjes ligjore të identitetin gjinor edhe brenda të drejtës në pacenueshmërinë e integritetit fizik",* e që nënkupton edhe mos-imponimin e trajtimit mjekësor. Si rrjedhojë, kushtëzimi i njohjes së identitetit gjinor të personave transgjinor me ndërhyrje kirurgjike sterilizuese apo trajtim mjekësor, ose ndërhyrje kirurgjike apo trajtim mjekësor që ka mundësi të mëdha të shkaktojë sterilizim *"e pengon personin të gëzojë të drejtën e tij apo saj në identitet gjinor dhe në zhvillim personal i cili është aspekt fondamental i të drejtës për respektim të jetës private."*

78. Në kontekst të raportit mjekësor dhe i cili do të vërtetonte ndërrimin e gjinisë të përcaktuar në lindje të parashtruesit të kërkesës, ky i fundit i referohet edhe Ligjit për Barazi Gjinore, mbi bazën e të cilit identiteti gjinor "*mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi ka pasur në lindje*". Sipas parashtruesit të kërkesës, Ligji për Barazi Gjinore është i detyrueshëm për Agjencinë e

Regjistrimit Civil në trajtimin e kërkesës së tij për ndërrimin e gjinisë sepse (i) *lex specialis derogat legi gjenerali*, dhe rrjedhimisht Ligji për Barazi Gjinore si *lex specialis* që e rregullon në mënyrë të veçantë çështjen e gjinisë, ka përparësi ndaj ligjeve të tjera të përgjithshme; dhe (ii) *lex posterior derogat legi priori,* dhe rrjedhimisht si ligj i miratuar në vitin 2015 kundrejt Ligjit për Gjendjen Civile të miratuar në vitin 2011, do të duhej të kishte përparësi në interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij.

79. Parashtruesi i kërkesës në kontekst të Ligjit për Barazi Gjinore gjithashtu thirret në dhe pretendon shkelje të paragrafit 1.3 të nenit 3 (Përkufizimet) dhe i cili përcakton definicionin e gjinisë mashkullore si *"çdo person që e konsideron vetën si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor."* Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës argumenton se në këtë definicion nuk hyn përcaktimi i seksit që personi e ka pasur në lindje, por me rëndësi është *"perceptimi subjektiv i gjinisë apo gjinia të cilin personi e konsideron si të vetën."*

80. Në këtë drejtim, parashtruesi përfundon pretendimin e tij duke theksuar se baza kryesore mbi të cilën mbështetet Agjencia e Regjistrimit Civil se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar raport mjekësor që evidenton ndryshimet në gjini, është kushtëzim i njohjes ligjore të identitetit gjinor të parashtruesit dhe si i tillë është kushtëzim kundërkushtetues dhe në mos-përputhje me praktikën e lartpërmendur gjyqësore të GJEDNJ-së, praktikë kjo që përbën burimin kryesor për interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore në bazë të nenit 53 të Kushtetutës.

(iv) Për sa i përket kërkesës së parashtruesit për kompensim të dëmit jomaterial

81. Parashtruesi i kërkesës kërkon kompensimin e dëmit jo-material për shkak të *"shkeljes së lirive dhe të drejtave të personalitetit, sipas nenit 183, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve."* Ai thekson se mosnjohja e identitetit gjinor të parashtruesit të kërkesës përmes Vendimit refuzues për ndërrim të emrit dhe shënuesit të gjinisë *"ka shkaktuar shqetësim dhe vuajtje psiqike te parashtruesi duke e bërë atë të ndihet i përjashtuar dhe i refuzuar nga shoqëria dhe shteti të cilit ai i takon."* Refuzimi i tillë e ka vënë parashtruesin e kërkesës në situatë që e shkelë vazhdimisht të drejtën e tij në privatësi, ndër të tjera, çdoherë që i kërkohet të tregojë dokumentin e identifikimit.

82. Parashtruesi i kërkesës thekson se e drejta në kompensim i takon sipas nenit 41 (Shpërblimi i drejtë/"*Just Satisfaction*") të KEDNJ-së, ku

përcaktohet kompensimi në rast se Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore. Në shumë raste të shkeljes së drejtës së privatësisë, parashtruesi i kërkesës thekson se GJEDNJ ka vendosur se palës i takon e drejta në kompensim të dëmit jo-material. Për shembull, në rastet *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë* (Aktgjykim i 16 shtatorit 1996) dhe *B. kundër Francës* (cituar më lart), GJEDNJ iu dha palëve të drejtë në kompensim jo-material pasi që kishte gjetur se e drejta e tyre në privatësi ishte shkelur nga shteti turk, respektivisht shteti francez. Për këtë të fundit, GJEDNJ kishte akorduar një shumë kompensimi prej 100,000.00 frangash franceze për shkak se parashtrueses përkatëse nuk iu ishte njohur identiteti i saj gjinor.

83. Më tutje, parashtruesi pohon se në rastin *Dolenec kundër Kroacisë* (Aktgjykim i 26 nëntorit 2009), GJEDNJ kishte ritheksuar se shëndeti mendor është pjesë esenciale e jetës private dhe lidhet me aspektin e integritetit moral të personit. Ruajtja e stabilitetit mendor në këtë kontekst është parakusht i domosdoshëm i respektimit të së drejtës në jetë private. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës theksoi se ai vazhdon të përjetojë shqetësim dhe presion psikik për shkak të mosnjohjes së identitetit të tij gjinor nga shteti. Rrjedhimisht, ai pohon se shteti duhet ta kompensojë dëmin jo-material të shkaktuar për shkak të shkeljes së të drejtës në privatësi dhe të drejtës në jetë të dinjitetshme, bazuar në paragrafin 1 të nenit 13 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejmë: LMD). Në emër të këtij kompensimi, parashtruesi i kërkesës kërkon që t'i kompensohet shuma në lartësi prej 5,000.00 EUR.

Kërkesa përfundimtare e parashtruesit drejtuar Gjykatës

84. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:

(i) të shpallë kërkesën të pranueshme për shqyrtim; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës së privatësisë, siç përcaktohet me nenin 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë se ka pasur shkelje të dinjitetit, siç përcaktohet me nenin 23 të Kushtetutës; (iv) të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës për mbrojtje të barabartë nga diskriminimi, siç përcaktohet me nenin 24 të Kushtetutës; (v) të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil të pranojë si të bazuar kërkesën për ndërrimin e emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M" në regjistrin qendror të gjendjes civile; dhe (vi) të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil t'ia kompensojë parashtruesit dëmin jo-material në vlerë prej 5,000.00 EUR si dhe shpenzimet procedurale dhe ato të avokates.

Përgjigjet dhe komentet e KGJK-së

85. Gjykata i ishte drejtuar KGJK-së me kërkesë për të paraqitur komente në katër pyetjet specifike të listuara në pjesën e procedurës para Gjykatës (shih paragrafët 15, 19 dhe 20 të këtij Aktvendimi për papranueshmëri). Gjykata ia kishte komunikuar KGJK-së se çështjet specifike të ngritura nga kërkesa KI108/18 ishin të ndërtuara mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për sa i takon aspektit të shterimit të mjeteve juridike, si parakusht procedural për të trajtuar meritat e një kërkese. Gjykata iu kishte drejtuar KGJK-së me një kërkesë të tillë dy herë. Herën e parë, me 16 tetor 2018, dhe duke marrë parasysh që KGJK nuk ishte përgjegjur në pyetjet e Gjykatës, Gjykata iu kishte drejtuar KGJK-së me të njëjtat pyetje, edhe herën e dytë, më 8 nëntor 2018. Kësaj radhe KGJK kishte dorëzuar përgjigjet dhe komentet e tyre në Gjykatë.

86. Për sa i përket pyetjes së parë të Gjykatës, lidhur me atë se a mund të konsiderohet padia për konflikt administrativ si mjet juridik që i përmbush standardet e të qenurit mjet juridik "*mjaftueshëm i sigurtë, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*" në rrethanat e rastit konkret, KGJK shprehu mendimin se *"padia si mjet i rregullt juridik për inicimin e konfliktit administrativ i përmbush të gjitha standardet për të qenë mjaftueshëm i sigurtë për rastin konkret dhe rastet e tjera marrë parasysh atë se gjykatat janë të pavarura, apolitike, të paanshme dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë."* Më tutje, KGJK citoi paragrafi 4 të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës: *"Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë ti kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël."* [Shënim sqarues: KGJK e përmend numerikisht paragrafin 5 të nenit 55 të Kushtetutës por në tekst e ka cituar fjalë-për-fjalë paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës]. KGJK nuk dorëzoi ndonjë shembull nga praktika gjyqësore, siç ishte kërkuar nga Gjykata.

87. Për sa i përket pyetjes së dytë të Gjykatës, lidhur me atë se a mund të konsiderohet padia për konflikt administrativ si mjet juridik që i plotëson standardet e duhura për t'u konsideruar si i "*disponueshëm*" për parashtruesin e kërkesës, i "*qasshëm*" për të dhe "*efektiv*" në lidhje me pretendimet e ngritura, KGJK theksoi se*: "padia për inicimin e konfliktit administrativ si mjet juridik i plotëson standardet e duhura për tu konsideruar si mjet i disponueshëm për parashtruesin, pasi që*

gjykatat mundësojnë dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë dhe gjithnjë bëjnë përpjekje të jenë sa më efektive dhe efikase në zgjidhjen e rasteve përkundër asaj që ballafaqohen me një numër të madh të rasteve të pazgjidhura të cilat janë grumbulluar nga një serë faktorësh siç [janë] *rastet e mbetura nga vitet paraprake, rastet e reja të pranuara në punë, numëri i pamjaftueshmë i gjyqtarëve etj."* KGJK nuk dorëzoi ndonjë shembull nga praktika gjyqësore, siç ishte kërkuar nga Gjykata.

88. Për sa i përket pyetjes së tretë të Gjykatës, lidhur me atë se a mund të konsiderohet padia për konflikt administrativ si mjet juridik që ofron "*mundësinë e korrigjimit*" përkatës dhe "*mundësinë e arsyeshme për sukses*" në lidhje me pretendimet e ngritura, KGJK theksoi se: *"vetëm vendimi i gjykatës mund të vërtetojë këtë, pasi që KGJK është organ i mandatuar që të bëjë vetëm administrimin e gjyqësorit, por që nuk ka kompetencë të ndërhyjë në punën e gjyqtarëve, të cilët në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, janë të pavarur në rastin e vendosjes në çështje që zhvilohen pranë gjykatave."* KGJK nuk dorëzoi ndonjë shembull nga praktika gjyqësore, siç ishte kërkuar nga Gjykata.

89. Për sa i përket pyetjes së katërt të Gjykatës, lidhur me atë se a mund të konsiderohet se ekzistojnë "*rrethana të veçanta*" në rastin e parashtruesit të kërkesës që potencialisht do përmbushnin kriteret për lirimin e parashtruesit të kërkesës nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike, KGJK theksoi se: *"konsiderojmë se është në mandatin e Gjykatës Kushtetuese që të vendos se "a ekzistojnë rrethana" të veçanta në rastin e parashtruesit të kërkesës KI108/18 që potencialisht do të përmbushnin kriterin për lirimin e parashtruesit nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike."*

Komentet shtesë të parashtruesit të kërkesës ndaj komenteve të KGJK-së dhe përgjigjet e parashtruesit të kërkesës ndaj pyetjeve shtesë të Gjykatës

90. Gjykata e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për përgjigjet e pranuara nga KGJK dhe i kishte ofruar mundësinë që të paraqes komentet e tij ndaj tyre.

91. Për sa i përket përgjigjes së KGJK-së ndaj pyetjes së parë të Gjykatës, lidhur me atë se a mund të konsiderohet padia për konflikt administrativ si mjet juridik që i përmbush standardet e të qenurit mjet juridik "*mjaftueshëm i sigurtë, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*", në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës theksoi se KGJK është përgjigjur duke thënë se përmbushen standardet e kërkuara dhe këtë e ka arsyetuar me argumentin se

"gjykata janë të pavaruara, apolitike, të paanshme dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë". Mirëpo, sipas parashtruesit të kërkesës, argumentimi i tillë i KGJK-së nuk lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e mjetit juridik dhe nuk lidhet fare me sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm si një ndër bazat kryesore që e bën *"joefektiv konfliktin administrativ në rastin konkret."* Më tutje, parashtruesi i kërkesës theksoi se referenca e KGJK-së në paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës që flet për kufizimin e të drejtave të njeriut nga institucionet publike është *"krejtësisht i parëndësishëm për pyetjen e parashtruar nga Gjykata Kushtetuese"*. Parashtruesi i kërkesës konsideroi se KGJK nuk e ka adresuar standardin për të cilin është pyetur nga Gjykata, por vetëm ka dhënë konstatimin se konflikti administrativ *"i përmbush të gjitha standardet e mjaftueshme për të qenë mjaftueshëm i sigurtë në rastin konkret dhe rastet e tjera."* Sipas pretendimit, ky konstatim i KGJK-së është deklaratë që "*nuk bazohet në asnjë fakt apo të dhënë konkrete."*

92. Për sa i përket përgjigjes së KGJK-së ndaj pyetjes së dytë të Gjykatës, lidhur me atë se a mund të konsiderohet padia për konflikt administrativ si mjet juridik që i plotëson standardet e duhura për t'u konsideruar si i "*disponueshëm*" për parashtruesin e kërkesës, i "*qasshëm*" për të dhe "*efektiv*" në lidhje me pretendimet e ngritura, parashtruesi i kërkesës theksoi se KGJK ka ofruar konstatime të pabazuara dhe kundërthënëse të cilat nuk qëndrojnë. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se ofrimi i qasjes së barabartë, sipas pretendimit të KGJK-së, nuk e bën mjetin juridik "*të disponueshëm, të qasshëm dhe efektiv*" në lidhje me pretendimet e rastit KI108/18. Kundërthënia e KGJK-së qëndron në atë se *"në njërën anë konsideron se konflikti administrativ i plotëson standardet e duhura për tu konsideruar si mjet i disponueshëm e efektiv juridik, ndërsa në anën tjetër i numëron arsyet që e pengojnë zgjidhjen e lëndëve brenda një afati të arsyeshëm, siç janë: numri i madh i rasteve të pazgjidhura si pasojë e grumbullimit të rasteve nga vitet paraprake, rastet e reja të pranuara në punë, numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, etj."* Në aspekt të kohëzgjatjes së procedurave, parashtruesi i kërkesës thekson se në nëntëmujorin e vitit 2018, tregohet se është rritur numri i rasteve të pazgjidhura në Gjykatën Themelore për 16.2% nga fundi i vitit 2017, dhe tashmë koha e llogaritur për zgjidhjen e një rasti në procedurë administrative në shkallë të parë është 1,521 ditë apo mesatarisht katër (4) vjet e një (1) muaj.

93. Gjykata po ashtu kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të përgjigjej në dy pyetje specifike të Gjykatës lidhur me atë se a është paraqitur ndonjë kërkesë për përshpejtim të procedurës pranë

Gjykatës Themelore dhe se a ka ndërmarrë kjo e fundit ndonjë hap deri me tani për procedimin e padisë së iniciuar nga parashtruesi i kërkesës më 22 korrik 2018.

94. Për sa i takon të parës, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se është dorëzuar një kërkesë për përshpejtim më 4 dhjetor 2018 ku është kërkuar që për shkak të "*rrethanave të veçanta*" të rastit, i njejti duhet të trajtohet me prioritet. Në këtë aspekt, po ashtu u theksua se nuk është pranuar ndonjë thirrje apo ftesë nga Gjykata Themelore. Ndërsa, për sa i takon të dytës, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se Gjykata Themelore *"nuk ka ndërmarrë asnjë hap deri më tani dhe ende nuk kemi pranuar asnjë ftesë, thirrje, apo kërkesë tjetër nga gjykatësi i çështjes."*

***Amicus Curiae* e Avokatit të Popullit**

95. Në Mendimin Juridik të dorëzuar në Gjykatë, Avokati i Popullit theksoi se qëllimi kryesor i këtij intervenimi është që të argumentohet dhe të ofrohet një analizë ligjore përkitazi me rastin KI108/18. Përgjatë tekstit të Mendimit Juridik, Avokati i Popullit deklaroi se do t'i referohet parashtruesit të kërkesës, si z. Blert Morina, përkatësisht si parashtrues i gjinisë mashkullore, për shkak se kjo është gjinia me të cilën ai identifikohet, dhe këtë referencë do ta përdorë pa paragjykuar vendimin e Gjykatës lidhur me këtë kërkesë.

96. Qëllimi i këtij Mendimi Juridik, sipas shkresave të lëndës, është mbështetja e kërkesës për lirim nga detyrimi i shterjes të mjeteve juridike, sepse sipas Avokatit të Popullit, "*rrethanat e rastit e bëjnë pritjen e procedimit të padisë nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departmenti për Çështje Administrative, mjet joefektiv dhe të papërshtatshëm*".

97. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet t'i shterojnë mjetet juridike "*efektive*" që i kanë në dispozicion *"para se çështja të kalojë në Gjykatën Kushtetuese, por ato duhet të garantojnë efektivitet dhe efikasitet."* Ky rregull, sipas GJEDNJ-së, duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar, duke qenë se rregulli i shterimit nuk është absolut dhe nuk duhet të zbatohet në mënyrë automatike, *"por është më me rëndësi të merren parasysh rrethanat e veçanta të secilit rast individual."* Duke cituar rastin e GJEDNJ-së *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë* (cituar më lart), Avokati i Popullit theksoi se në rastin konkret duhet të merret parasysh edhe konteksti i përgjithshëm ligjor dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës.

98. Sipas Avokatit të Popullit, kërkesa e parashtruesit të kërkesës që të lirohet nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike bazuar në mungesën e mjetit efektiv në lidhje me rastin e tij, është e bazuar edhe në Raportin e Përgjithshëm Vjetor të KGJK-së, ku statistikat tregojnë për 5,304 lëndë të pazgjidhura dhe faktin që koha mesatare e llogaritur për zgjidhjen e një lënde administrative për një rast që procedohet në Gjykatën Themelore dhe atë të Apelit është tre (3) vjet e katër (4) muaj. Një vonesë e tillë e tejzgjatur, sipas Avokatit të Popullit, nuk mund të cilësohet si mjet efektiv në kontekstin e kërkesës KI108/18.

99. Avokati i Popullit po ashtu theksoi se praktika gjyqësore e Gjykatës e vërteton një konstatim të tillë në rastet KI99/14 dhe KI100/14 (parashtrues *Shyqyri Syla dhe Laura Pula*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese i 3 korrikut 2014), ku ishte konstatuar se: *"edhe në qoftë se ka mjete juridike, në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marrë parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim."* Në mbështetje të këtij argumenti, Avokati i Popullit thirret edhe në dy raste të tjera të kësaj Gjykate, respektivisht rastin KI11/09 (parashtrues *Tomë Krasniqi*, Vendim për Heqje nga Lista i 17 majit 2011) dhe KI06/10 (parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010).

100. Lidhur me këtë praktikë gjyqësore, Avokati i Populli është i mendimit se rasti i parashtruesit të kërkesës është i ngjashëm në dy aspekte relevante. Së pari, sikurse në rastin e zgjedhjes së Kryeprokurorit, edhe në rastin e parashtruesit të kërkesës, edhe në qoftë se ka mjete juridike, në rastin e tij nuk janë dëshmuar si efikase. Përkundrazi, në bazë të statistikave, thekson Avokati i Popullit, *"jo vetëm se mjetet juridike nuk janë dëshmuar si efikase, por edhe se mjetet juridike janë dëshmuar pozitivisht joefikase."* Së dyti, në rastin e zgjedhjes së Kryeprokurorit, Gjykata ka theksuar "*domosdoshmërinë*" që procedura e zgjedhjes të bëhet në kohën e duhur dhe për shkak të asaj urgjence ishte vendosur se nuk ka mjete juridike për shterim. Rasti i parashtruesit të kërkesës, sipas Avokatit të Popullit, është rast urgjent dhe prandaj është e domosdoshme që rasti të zgjidhet *"në kohën e duhur dhe sa më shpejt që të jetë e mundur"*.

101. Më tej, Avokati i Popullit thekson se edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk iu është nënshtruar ndërhyrjes kirurgjike, megjithatë dëshmohet se ai *"është duke përjetuar po të njëjtat ndjenja të cenueshmërisë, poshtërimit dhe ankthit që krijohen kur gjendja e ligjit të brendshëm bie në konflikt me një aspekt të rëndësishëm të identitetit personal."*

Dëshmitë e dhëna nga parashtruesi i kërkesës për situatat ku i kërkohet paraqitja e dokumenteve të identifikimit dhe vërehet mospërputhja si dhe situatat traumatike të kalimit të pikave kufitare, e bëjnë Avokatin e Popullit që të konstatojë se: "*mospërputhja e statusit ligjor të z. Morina me identitetin e tij personal gjinor ka ndikim jashtëzakonisht të rëndë në një sërë situatash të shpeshta në jetën e tij të përditshme.*" Në rrethana të tilla, Avokati i Popullit konsideron se t'i kërkohet parashtruesit të kërkesës që të pres *"tre vjet e katër muaj"* është e paarsyeshme, duke marrë parasysh edhe mundësinë reale që Gjykata Themelore të mos vendosë fare në bazë të meritave, por vetëm ta kthejë rastin në rishqyrtim.

102. Avokati i Popullit po ashtu iu referua Raportit të tij me rekomandime të lëshuar për rastin A.nr.72/2015 lidhur me mungesën e mjeteve efektive juridike të 17 tetorit 2016, ku ndër të tjera ishte konstatuar se në kontestet administrative gjykatat në asnjërën nga procedurat përkatëse nuk janë lëshuar në shqyrtimin e meritave të rastit, por vetëm kanë konstatuar shkeljet procedurale dhe kanë vendosur që rastet të kthehen në rishqyrtim tek organi administrativ që fillimisht kishte marrë vendimin e që më pas, rasti ishte vendosur sërish njësoj. Në rastet e tilla, Avokati i Popullit ka konstatuar se *"ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga se paditë e ushtruara nga ankuesit në cilësi të mjetit efektiv juridik ishin joefikase dhe nuk siguronin realizimin e të drejtës që u takonte me ligj."*

103. Për sa i takon meritave të kërkesës, Avokati i Popullit thekson detyrimin e përcaktuar me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duhet të interpretohen në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Në këtë aspekt, u theksua se interpretimi i KEDNJ-së nga GJEDNJ ka krijuar një hapësirë për zbatimin e ndalimit të diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Është detyrim i veçantë i një shteti që të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të vet ligjor, duke ofruar kështu garanci që të drejtat të mund të gëzohen në mënyrë efektive.

104. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit thekson se Gjykata duhet ta ketë parasysh rastin e *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (cituar më lart), në të cilin GJEDNJ kishte theksuar se: *"Duhet pranuar se mund të krijohet ndërhyrje serioze në jetën private kur gjendja e ligjit të brendshëm bie në konflikt me një aspekt të rëndësishëm të identitetit personal [...] Kjo për arsye se stresi dhe tjetërsimi të cilat rrjedhin prej një mospërputhje ndërmjet pozitës në shoqëri të adoptuar nga një transeksual pas operimit dhe statusit të imponuar nga ligji që refuzon të njohë ndryshimin në gjini, nuk mund*

[...] të shihen si një shqetësim i parëndësishëm që rrjedh prej një formaliteti [...] Përkundrazi krijohet një konflikt ndërmjet realitetit shoqëror dhe ligjit që e vë transeksualin në një pozitë të çrregullt, në të cilën ai ose ajo mund të përjetojë ndjenja të cenueshmërisë, poshtërimit dhe ankthit (po aty, theks i shtuar.)."

105. Në përfundim, Avokati i Popullit konkludoi duke u shprehur se parashtruesi i kërkesës ka ofruar prova të mjaftueshme në mbështetje të kërkesës së tij për tu liruar nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike për shkak të *"rrethanave të rastit që e bëjnë pritjen e procedimit të padisë nga Gjykata Themelore mjet jo-efektiv dhe të papërshtatshëm."* Avokati i Popullit theksoi se, praktika gjyqësore e Gjykatës tregon se në disa raste ajo kishte *"qasje fleksibile dhe kishte konstatuar se parashtruesit nuk kishin mjet juridik efektiv prandaj kishte lejuar shfrytëzimin e këtij juridiksioni pa i shteruar mjetet juridike."*

Përgjigjet e pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias

106. Siç u reflektua në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit iu drejtua me disa pyetje specifike Forumit të Komisionit të Venecias. Gjykata pranoi gjithsejt 16 përgjigje, përmbajtja e të cilave do të paraqitet në vijim.

107. Si shënim paraprak, Gjykata qartëson se Forumi i Komisionit të Venecias është një forum i cili ia mundëson gjykatave anëtare të Komisionit të Venecias që të pyesin gjykatat e tjera anëtare për informata specifike lidhur me praktikën e tyre gjyqësore. Kësisoj, Forumi i Komisionit të Venecias nuk duhet të kuptohet si një opinion zyrtar i ofruar nga Komisioni i Venecias si i tillë, duke qenë se procedura për të kërkuar një opinion të tillë dallon nga procedura jo-formale që e karakterizon Forumin. Ky i fundit shërben si inkubator informatash të cilat ia mundësojnë gjykatave që të hulumtojnë lidhur me praktikat gjyqësore të njëra-tjetrës, me synim të përfitimit nga eksperiencat e ndërsjella me raste të ngjashme. Në këtë drejtim, është e vetëkuptueshme që përgjigjet e marra nuk janë obligative për asnjërën gjykatë që kërkon informata shtesë nga gjykatat simotra. Të vetmet përgjigje të cilat janë obligative për Gjykatën janë ato që ndërlidhen me vendimet e marra nga GJEDNJ, duke qenë se sipas nenit 53 të Kushtetutës, të gjitha të drejtat dhe liritë themelore duhet të interpretohen në harmoni me vendimet e GJEDNJ-së.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

108. Në përgjigjet e saj drejtuar kësaj Gjykate, Departamenti i Hulumtimit dhe Librarisë së GJEDNJ-së, nën monitorimin e Juristkonsultit (*"Juristconsult"*) dorëzoi një dokument të emëruar si "*kontribut mbi praktikën gjyqësore*", përmes së cilës u theksuan rastet më të rëndësishme të vendosura nga GJEDNJ në fushën e të drejtave transgjinore. Si shënim për vëmendje, po ashtu u theksua si në vijim: *"Ky dokument u përgatit nga Divizioni i Hulumtimit dhe Librarisë, nën udhëheqjen e Juristkonsultit. Nuk e obligon Gjykatën* [GJEDNJ-në]*."*

109. Lidhur me njohjen e identitetit të ri gjinor, GJEDNJ theksoi rastin e *Christine Goodwin kundër Mbretërisë të Bashkuar* (cituar më lart, paragrafët 90, 91 dhe 103) ku, ndër tjerash, ishte konstatuar se *"mungesa e njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë"* përbënte shkelje e nenit 8 të KEDNJ-së; ndërkaq që pamundësia e personit transeksual që të martohet ishte konsideruar si shkelje e nenit 12 (E drejta për martesë) të KEDNJ-së. Po ashtu, GJEDNJ, për linjë të ngjashme të arsyetimit, rekomandoi që të shikohen edhe rastet vijuese të saj: (i) *I. Kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 11 korrikut 2002, paragrafët 69-73); (ii) *Grant kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 23 majit 2006, paragrafët 40-43), në të cilin GJEDNJ kishte vendosur se refuzimi i njohjes ligjore të ndryshimit të identitetit gjinor dhe refuzimi i pensionit në bazë të moshës që ishte e aplikueshme për gratë e tjera, përbënte shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së; (iii) *L. Kundër Lituanisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 11 shtatorit 2007, paragrafi 59), ku u konsiderua se ka ekzistuar shkelje e nenit 8 të KEDNJ-së për shkak të dështimit të autoriteteve që të paraqesin legjislacion zbatues për t'i mundësuar personave transeksual që të kryejnë operacione për ndryshim të gjinisë dhe të ndryshojnë gjininë në dokumentacionet zyrtare të identifikimit; dhe (iv) *Y.Y. kundër Turqisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 10 marsit 2015, paragrafët 118-122), ku është konstatuar shkelje e nenit 8 të KEDNJ-së meqë operacioni për ndryshimin e gjinisë duhet të dështmonte se personi nuk do të mund të lindte më (*"procreate"*), gjë që, në vetvete, u konsiderua si kërkesë e tepruar.

110. Lidhur me ndryshimin e emrit në dokumentet zyrtare të identifikimit, GJEDNJ nënvizoi disa raste relevante në këtë aspekt. Fillimisht, GJEDNJ u referua në rastin *S.V. kundër Italisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 11 tetorit 2018, paragrafët 70-75), ku shteti Italian u konsiderua se nuk i ka përmbushur detyrimet pozitive të parapara me KEDNJ, duke qenë se pamundësia e parashtruesit që, në atë rast, të bëjë ndryshimin e emrit ("*forname"*) për një periudhë dy vjeçare e gjysmë, me arsyetimin se procesi i tranzicionit gjinor nuk ishte kompletuar përmes një operacioni për ndryshim të gjinisë, konsistonte në shkelje

të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për respektim të së drejtës private të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së. Më tutje, GJEDNJ iu referua, ndër tjerash, edhe rasteve *Schlumpf kundër Zvicrrës* (Aktgjykim i 8 janarit 2009, paragrafi 57), ku u ripërsërit që determinimi i nevojës për ndërmarrjen e masave për ndryshim seksi, nuk është çështje që i takon një vlerësimi gjyqësor; dhe *B. kundër Francës* (cituar më lart, paragrafi 63), ku u theksua se mos njohja në ligj e identitetit seksual të një personi transeksual pas operacionit, paraqet shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.

111. Më tutje, GJEDNJ iu referua edhe rastit *Kück kundër Gjermanisë* (cituar më lart, paragrafët 56, 59, 63 dhe 84) në të cilët specifikisht u tha që:

> *"Identiteti gjinor është një prej fushave më intime të jetës private të një personi. Barra e vendosur në situatën e tillë mbi një person që të provojë nevojën mjekësore për trajtim, përfshirë operacion të pakthyeshëm, duket rrjedhimisht të jetë jo proporcionale.*
> *Duke marrë parasysh numrin e madh të intervenimeve të dhimbshme të përfshira në një operacion për ndryshimin e gjinisë dhe nivelin e përkushtimit dhe të bindjes së kërkuar për të arritur një ndryshim në rolin gjinor në shoqëri, nuk mund të thuhet se ka diçka arbitrare apo kapriqoze në vendimin e marrë nga një person për të ndryshuar gjininë.* [Kjo u tha duke e cituar rastin e *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart].
> *Në mungesë të ndonjë të të gjeturave shteruese shkencore për sa i takon shkakut të transeksualitetit dhe, në veçanti, se a është tërësisht psikologjike apo e ndërlidhur me ndonjë ndryshim fizik në tru, qasja e ndërmarrë nga Gjykata e Apelit në ekzaminimin e pyetjes se parashtruesi a në mënyrë deliberative e ka shkaktuar konditën e saj duket të jetë i papërshtatshëm.*
> *Barra e vendosur mbi një person që të dëshmojë nevojën për trajtim mjekësor, duke përfshirë operacion të pakthyeshëm, në pjesën më intime të jetës private, duket të jetë jo proporcionale. ... [N]uk është goditur balanci i drejtë në mes të interesave të kompanisë private të sigurimeve në njërën anë dhe në mes të interesave të individit në anën tjetër."*

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë

112. Për sa i përket shterimit të mjeteve juridike, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë theksoi se, në parim, parashtruesit duhet të shterojnë të gjitha mjetet juridike. Megjithatë, ajo theksoi se ekzistojnë dy mundësi të cilat përbëjnë përjashtim nga ky rregull dhe nëse përjashtimet e tilla

janë të aplikueshme, parashtruesit mund t'i drejtohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë me ankesë kushtetuese. Përjashtimi i parë ka të bëjë me rastet kur një gjykatë e rregullt nuk ka vendosur rastin brenda një afati të arsyeshëm. Në rastet e tilla, parashtruesit mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuse të Kroacisë. Përjashtimi i dytë ka të bëjë me rastet kur vendimi i kontestuar në mënyrë të rëndë shkel të drejtat kushtetuese dhe është krejtësisht e qartë që do të shkaktohet një dëm serioz dhe i paripareushëm në rast se nuk iniciohet rast pranë Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë. Në këtë drejtim, kjo e fundit i paraqiti para kësaj Gjykate rastet kur përjashtimet e lartcekura kishin qenë të aplikueshme. (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, U-IIIN-1005/2004 të 8 korrikut 2004; U-IIIB-4366/2005 të 5 majit 2006 dhe U-IIIB-1373/2009 të 7 korrikut 2009; U-IIIB-369/2016 të 15 dhjetorit 2015).

113. Për sa i përket të drejtave transgjinore, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë konfirmoi se në praktikën e saj gjyqësore dy herë ka vendosur për raste të tilla dhe madje, në një rast, kishte vendosur para se parashtruesi të shteronte të gjitha mjetet juridike. (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, U-IIIB-3173/2012 të 18 marsit 2014 dhe U-III-361/2014 të 21 nëntorit 2017). Në njërin rast, parashtruesja kishte lindur si mashkull dhe ishte regjistruar si i tillë në librat e regjistrimit civil. Pasi që kishte bërë ndryshimin e gjinisë nga "F" në "M" përmes operacionit, ajo kishte arritur të marrë një vendim që i kishte njohur ndryshimin e emrit dhe të gjinisë bazuar në dokumentacionet mjekësore që kishte paraqitur. Pasi që kishte arritur të ndryshojë emrin dhe gjininë, parashtruesja në fjalë kishte arritur të krijojë, edhe ligjërisht, një identitet të ri në dokumentet e identifikimit, përfshirë çertifikatën e re të shtetësisë që figuronte ndryshimet e bëra. Tentimi i saj i mëtutjeshëm që këto ndryshime t'i reflektojë edhe në diplomën e marrë nga Universiteti i Zagrebit kishte qenë i pasuksesshëm dhe për rrjedhojë, ajo ishte paraqitur para Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë. Kjo e fundit kishte konsideruar se qasja skajshmërisht formaliste e Universitetit të Zagrebit që ia kishte refuzuar kërkesën për ndryshim të të dhënave në diplomën e saj, nuk ishte e pranueshme dhe për rrjedhojë, ishte konstatuar se refuzimi i tillë kishte shkelur të drejtën e parashtrueses për jetë private në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

114. Për sa i përket ndryshimit të emrit, po ashtu u theksua se në Kroaci çdo person ka të drejtë të ndryshojë emrin, pa dhënë asnjë arsye se përse dëshiron ta ndryshojë atë. Kur ligji i tillë kishte qenë në shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, në aspekt të konrollit incidental, ishte theksuar se: *"është më se e qartë se baza e tanishme*

ligjore siguron një mbrojtje të lartë për jetën private dhe jetën personale për të gjithë personat të cilët kanë ndryshuar gjininë dhe emrin personal ose kanë ndryshuar emrin para se të ndryshojnë gjininë."

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke

115. Në parim, të gjitha kërkesat e dorëzuara para shterimit të mjeteve juridike refuzohen si të papranueshme, theksoi Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke. Megjithatë, ekziston një përjashtim nga kjo rregull e përgjithshme në të cilën thuhet se Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke nuk do të refuzojë një kërkesë të papranueshme edhe nëse nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike, nëse rëndësia e ankesës kushtetuese shkon në mënyrë substanciale përtej interesave personale të parashtruesit që e ka parashtuar atë rast.

116. Në praktikën gjyqësore mund të vërehen disa grupe të argumenteve të cilat janë ngritur bazuar në këtë përjashtim. Grupi i parë i argumenteve përfshin ato që theksojnë se mjetet juridike nuk ishin efektive, mirëpo argumentet e tilla mund të pranohen vetëm në rast se vëretohet se ka një ineficiencë që është rezultat i një problemi sistemik dhe që në raste të tilla, vendimi i Gjykatës do të kishte ndikim të përgjithshëm. Grupi i dytë i argumenteve ka të bëjë me rastet kur autoritetet publike kanë përdorur një ligj jo-kushtetues ose kanë përdorur ndonjë ligj i cili veçse është anuluar. Në raste të tilla është e paarsyeshme që të refuzohet një kërkesë për moshterim të mjeteve juridike.

117. Për sa i takon asaj se a njeh praktika e tyre gjyqësore rast të ngjashëm me atë të kësaj Gjykate, Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke theksoi se ata kanë shqyrtuar një rast shumë të ngjashëm. Parashtrues në atë rast kishte qenë një person i cili vetvetës i referohej si neutral për sa i takon gjinisë dhe kishte kërkuar që në dokumentet e identifikimit t'i refektohej një gjë e tillë. Ministria përkatëse e kishte njoftuar se nuk lejohet ndryshimi i numrit personal të identifikimit dhe as inicimi i një procedure të tillë pa paraqitur një raport mjekësor që dëshmon kompletimin e ndryshimit të gjinisë ("*gender reassignment*"). Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke nuk i kishte shqyruar meritat e asaj kërkese meqë kishte konsideruar se nuk ishin shteruar të gjitha mjetet juridike dhe se ankesa nuk shkonte përtej interesit personal të parashtruesit përkatës, ashtu që të aplikohej përjashtimi i mësipërm për lirim nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike. Më vonë, parashtruesi kishte arritur deri tek Gjykata Supreme Administrative e Republikës Çeke dhe rasti është akoma në pritje për tu vendosur nga ajo gjykatë.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë

118. Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë theksoi se ankesa kushtetuese është një mjet i jashtëzakonshëm juridik i cili është subjekt i parimit të subsidiaritetit, në pajtim me të cilin ankesat kushtetuese, përgjithësisht, mund të dorëzohen vetëm pasi që të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike. Arsyeshmëria e këtij rregulli qëndron në atë se iu takon gjykatave të rregullta të zgjidhin të gjitha çështjet faktike dhe ligjore të një rasti.

119. Megjithatë, duke qenë se rekursi tek një gjykatë e rregullt jo gjithherë mund të jetë i mundshëm, njihen dy përjashtime nga parimi i subsidiaritetit dhe të njëjtat janë të përcaktuara në ligj. Përjashtimi i parë është që ankesa kushtetuese të jetë e një *"rëndësie të përgjithshme"* dhe përjashtimi i dytë që rekursi në gjykata të tjera do të shkaktonte "*disavantazh të pashmangshëm dhe të rëndë"*. Gjykata Kushtetuese Federale i interpreton të dyja përjashtimet në mënyrë strikte.

120. Më specifikisht për sa i takon përjashtimit të parë, Gjykata Kushtetuese Federale e ka përdorur këtë përjashtim atëherë kur një rast ngrit pyetje fondamentale të së drejtës kushtetuese dhe rrjedhimisht, vendimi i saj për atë ankesë kushtetuese do të jepte qartësi edhe për një numër të madh të rasteve të ngjashme. Nuk është konsideruar e mjaftueshme që një rast akoma nuk është zgjidhur nga një gjykatë. Duke qenë se aplikohen kufizime strikte në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese Federale rrallëherë ka vendosur që nuk është e nevojshme të shterohen mjetet juridike bazuar në këtë përjashtim.

121. Për sa i takon përjashtimit të dytë, Gjykata Kushtetuese Federale rrallëherë e ka përdorur këtë përjashtim dhe në praktikën e saj gjyqësore ka qartësuar se "*disavantazhi i pashmangshëm dhe i rëndë*" nënkupton një interferencë të veçantë dhe të rëndë në një të drejtë fondamentale e cila është e pariparueshme në aspektin që edhe një mjet i suksesshëm juridik nuk do të mund ta rregullonte interferencën e tillë. (Shih rastet e referuara nga Gjykata Kushtetuese Federale në përgjigjet e dorëzuara kësaj Gjykate: *"cf. BVerfG, Urdhër i Dhomës së Dytë të Senatit të Parë i 17 janarit 2013 - 1 BvR 1578/12 -; cf. BVerfGE 19, 268 <273>).; cf. BVerfGE 75, 78 <106>; 87, 1 <43>; 101, 239 <270>; BVerfG, Aktgjykim i Senatit të parë i 24 prillit 1991 – 1 BvR 1341/90; cf. BVerfG, Urdhër i Dhomës së Tretë të Senatit të Parë i 28 dhjetorit 2004, - 1 BvR 2790/04 -, paragrafët 17 dhe 185, me referenca në BVerfGE 38, 105 <110>, BVerfGE 9, 3 <7 dhe 8>)."*).

122. Lidhur me argumentin se shterimi i mjeteve juridike mund të jetë joefektiv apo procedura mund të marrë shumë kohë, ligji procedural i Gjermanisë përcakton mjete të tjera juridike për të kundërshtuar tejzgjatjen e një procedure. Për shembull, mund të dorëzohet një shkresë paraprake në gjykata në rast se ekziston frika se rasti nuk do të përfundohet në kohë të arsyeshme dhe, nëse ka pasur tejzgjatje, parashtruesit mund të kërkojnë kompensim monetar në bazë të ligjit në fuqi.

123. Për sa i takon pyetjes së tretë të Gjykatës lidhur me meritat e kërkesës, Gjykata Kushtetuese Federale theksoi se ajo tashmë ka gjykuar një numër të konsiderueshëm rastesh për sa i takon të drejtave të transgjinorëve. (Shih rastet e referuara nga Gjykata Kushtetuese Federale në përgjigjet e dorëzuara kësaj Gjykate: *"Urdhër i Senatit të Parë i 11 tetorit 1978 - 1 BvR 16/72 – cf. Vendime të Gjykatës Kushtetuese Federale, BVerfGE 49, 286; Urdhër i Senatit të Parë të 16 marsit 1982, – 1 BvR 938/81; cf. BVerfGE 60, 123; Urdhër i Senatit të Parë i 26 janarit 1993 – 1 BvL 38/92 – cf. BVerfGE 88, 87; Urdhër i Dhomës së Dytë të Senatit të Parë i 15 gushtit 1996 - 2 BvR 1833/95 –; Urdhër i Senatit të Parë i 6 dhjetorit 2005 – 1 BvL 3/03 cf. BVerfGE 115, 1); Urdhër i Senatit të Parë i 18 korrikut 2006 - 1 BvL 1/04 -, - 1 BvL 12/04 – cf. BVerfGE 116, 243) ; Urdhër i Senatit të Parë i 27 majit 2008 - 1 BvL 10/05 – cf. BVerfGE 121, 175; Urdhër i Senatit të Parë i 11 janarit 2011 – 1 BvR 3295/07 cf. BVerfGE 128, 109); Urdhër i Dhomës së Dytë të Senatit të Parë i 17 tetorit 2017 - 1 BvR 747/17 -; Urdhër i Dhomës së Dytë të Senatit të Parë of 6 dhjetorit 2016 - 1 BvQ 45/16 – ".).*

124. Në njërin prej atyre vendimeve, Gjykata Kushtetuese Federale kishte vendosur që refuzimi i autoriteteve shtetërore që të ndryshojë/korrektojnë të dhënat e gjinisë në çertifikatë të lindjes në rastet kur një person transeksual ka ndryshuar gjininë përmes operacionit, ishte shpallur jokushtetues. Me atë rast, Gjykata Kushtetuese Federale theksoi se refuzimi i tillë ishte inkompatibil me nenin 1 të Ligjit Bazik të Gjermanisë që mbron dinjitetin e njeriut dhe mënyrën se si njerëzit e kuptojnë vetveten si individë. Dinjiteti njerëzor rrjedhimisht u interpretua të nënkuptojë edhe të drejtën e një individi për zhvillim të lirë personal dhe të personalitetit, përfshirë edhe caktimin e statusit civil të gjinisë me të cilën ai individ identifikohet.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Supreme e Meksikës

125. Gjykata Supreme e Meksikës e shpjegoi procedurën e gjykimit të ashtuquajtur "*amparo*", sipas të cilës mund të kontestohen akte jo-kushtetuese dhe jo-ligjore të ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit. Parimi bazë është që një procedurë "*amparo*" mund të inicohet vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligjin në fuqi; mirëpo, ekzisojnë disa përjashtime nga ky rregull i përgjithshëm. Gjithsejt u numëruan 10 përjashtime me nën-përjashtimet përkatëse të cilat janë të aplikueshme në sistemin juridik të Meksikës dhe si arsye kryesore, ishte fakti që akti i kontestuar duhet të shkaktojë dëm të pariparueshëm.

126. Për sa i takon të drejtave transgjinore, Gjykata Supreme e Meksikës theksoi se ka pasur një rast të tillë faktet e të cilit ishin me sa vijon. Një person transgjinor, i lindur si mashkull por që identifikohej me gjininë femërore, kishte bërë operacion për të ndyshuar gjininë dhe më pas kishte kërkuar që të korrigjohet çertifikata e saj e lindjes ashtu që të reflektohet ndryshimet e bëra. Po ashtu, ajo kishte kërkuar që informatat mbi ndryshimin e gjinisë së saj të mbaheshin si konfidenciale dhe të mos shpërfaqej fakti që ajo është person transeksual. Rasti i saj ishte vendosur nga një gjyqtar i cili e kishte miratuar kërkesën e saj për korrigjim të çertifikatës së lindjes por që informatat e reja kishte urdhëruar të shtohen si "shtesa", përkatësisht si "korrigjime" në çertifikatën origjinale të lindjes. Parashtruesja e kërkesës kishte konsideruar se një gjë e tillë i shkelë të drejtat e saj për barazi para ligjit, mos-diskriminim, privatësi, dinjitet njerëzor dhe shëndet. Gjykata Supreme e Meksikës, pas ankesës së saj, kishte vendosur se vendimi i gjyqtarit ishte jo-kushtetues dhe, me atë rast, kishte urdhëruar që ndryshimet të bëhen në çertifikatën origjinale dhe ndryshimet e bëra të mos jenë publike, përveç në procedura gjyqësore dhe në polici, nëse është e nevojshme. Arsyetimi i përdorur nga Gjykata Supreme ishte me sa vijon: *"Çdo individ jeton identitetin përkatës gjinor. Ata e zhvillojnë personalitetin bazuar në të, ashtu që seksi psikosocial duhet të ketë superioritet mbi seksin morfologjik. Si rrjedhojë, ndryshimi i seksit i vendosur nga një person është pjesë e të drejtës së tyre për zhvillim të lirë të personalitetit dhe është në kundërshtim me të drejtat fondamentale të mbahet një person në seksin me të cilin ata nuk ndihen që është i tyri."*

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Supreme e Holandës

127. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike, Gjykata Supreme e Holandës theksoi se tejkalimi i fazave të apelit dhe dërgimi i një rasti direkt tek ajo njihet me termin *"sprongcassatie"* apo në përkthimin literal *"jump cassation"/"kapërcim tek kasacioni"* dhe një hap i tillë është i mundshëm të bëhet vetëm në rast se të gjitha palët e

interesuara në një rast pajtohen, por që rastet e tilla janë më shumë të karakterit kontraktual dhe nuk përkojnë me rrethanat e rastit të shpjeguar nga Gjykata. Si rrjedhojë, u theksua që praktika e tyre nuk njeh ndonjë rast të ngjashëm ku për arsye të rrethanave të veçanta të parashtruesit, i njejti është liruar nga detyrimi për të shteruar të mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

128. Për sa i takon të drejtës për të ndryshuar gjininë, u theksua se Kodi Civil i Holandës e parasheh në mënyrë eksplicite këtë mundësi dhe për atë arsye Gjykata Supreme e Holandës nuk ka pasë një rast ku është dashur të deklarohet për këtë çështje. Më tutje, u theksua se deri së voni nuk ishte e mundur që në dokumentet e identifikimit (çertifikatë lindje/pasaportë) të theksohej që një person nuk ka gjini të përcaktuar, ndonjë indikacion që personi është intersex apo që gjinia nuk mund të përcaktohet dhe për këtë arsye në vitin 2007, Gjykata Supreme e Holandës me vendim theksoi se kjo gjë nuk parashihet me ligjin në fuqi. Po ashtu, në atë rast, Gjykata Supreme e Holandës theksoi që përderisa, në njërën anë, neni 8 i KEDNJ-së vendos mbi Shtetet Kontraktuese një detyrim pozitiv që të ofrojë mekanizma për ndryshimin e indikacionit të gjinisë së një personi; në anën tjetër, Shtetet Kontraktuese kanë një margjinë të vlerësimit në këtë aspekt dhe duke e përdorur një margjinë të tillë, Gjykata Supreme në vitin 2007 kishte vendosur se, deri në atë moment, nuk kishte ndonjë bazë për të pranuar bindjen e një individi që nuk i përket asnjë gjinie. Megjithatë, në një rast të mëvonshëm të vitit 2018, Gjykata e Distriktit të Limburgut kishte vendosur se qëndrimet e shoqërisë kanë ndryshuar, kështuqë tanimë kërkesa që një person të mos ketë asnjë indikacion të gjinisë duhet të miratohet. Në praktikë, pasaporti i një personi të tillë do të lexonte: *"gjinia nuk mund të determinohet*" dhe dispozita ligjore e tanishme është hartuar për rastet kur gjinia nuk mund të determinohet në lindje, e që nuk është rasti në fjalë. Kuvendi është në proces të diskutimit a duhet të ndryshohet ligji ashtu që të akomodohen personat që nuk identifikohen me asnjërën nga dy gjinitë. Në këtë aspekt u theksua se gjykata holandeze nuk e ka pranuar se ekziston një *"gjini e tretë",* mirëpo ka deklaruar se është e mundur që dokumentet identifikuese të theksojnë se *"gjinia nuk mund të determinohet."*

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Hungarisë

129. Për sa i përket shterimit të mjeteve juridike, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë theksoi se parashtruesit mund të paraqiten para saj vetëm kur të shterojnë të gjitha mjetet juridike apo kur nuk ekziston një mjet juridik. Më tutje, u theksua se ekziston një përjashtim në bazë të të cilit parashtruesit mund të drejtohen direkt tek Gjykata Kushtetuese e

Hungarisë dhe atë nëse një dispozitë ligjore aplikohet në kundërshtim me Ligjin Fundamental të Hungarisë apo kur një dispozitë ligjore behet joefektive dhe të drejtat shkelen drejtpërsëdrejti pa një vendim gjyqësor. Mënyra tjetër përjashtimore është kur nuk ka një procedurë që ofron mjet juridik të dizajnuar për të riparuar shkeljen e të drejtave përkatëse.

130. Për sa i përket asaj se a kanë pasur rastet të ngjashme, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë theksoi se ata kanë pasur një rast shumë të ngjashëm me rastin i cili është duke u shqyrtuar nga Gjykata. Rasti në fjalë nuk është i përkthyer në gjuhën angleze, por përmbledhja e të njëjtit, është e dorëzuar në databazën e rasteve tek Komisioni i Venecias.

131. Rasti në fjalë kishte të bëjë me një person refugjat, i cili edhe ishte transeksual, dhe kishte aplikuar për azil në Hungari. Ai kishte kërkuar që në dokumentet e tij të identifikimit të shkruhet që është mashkull meqë ai nuk identifikohej me gjininë femërore që figuronte në dokumentet e tij. Autoritetet hungareze fillimisht ia kishin refuzuar këtë kërkesë, duke u thirrur në atë se këto të drejta iu takojnë vetëm shtetasve hungarez dhe jo azil-kërkuesve. Megjithatë, në fund të procesit të litigimit, ankesa kushtetuese e parashtruesit ishte pranuar dhe Gjykata Kushtetuese e Hungarisë dhe e cila kishte vendosur që e drejta e kërkuar nga parashtruesi, ndonëse refugjatë dhe azil-kërkues, ishte e drejtë universale që u takon të gjithëve. Në këtë aspekt, ishte konstatuar se ai ishte diskriminuar në bazë të origjinës së shtetësisë duke qenë se e drejta në një emër buron nga e drejta në dinjitet njerëzor dhe si e tillë kjo e drejtë është e pashkelshme. Të drejtën e personave transeksual për të ndërruar emrin, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë e konsideroi si një të drejtë fondamentale të bazuar në të drejtën e personit për integritet personal dhe dinjitet të barabartë njerëzor.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Letonisë

132. Gjykata Kushtetuese e Letonisë theksoi se ekziston vetëm një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm që të shterohen të gjitha mjetet juridike para paraqitjes së një ankese kushtetuese. Përjashtimi i tillë ka të bëjë me rastet kur ankesa kushtetuese është e një interesi të përgjithshëm ose në rast se mjetet e përgjithshme do ta kishin të pamundur të evitojnë dëmin substancial të parashtruesit. Koncepti i "*dëmit substancial*" është interpretuar të nënkuptojë një pasojë negative dhe të pakthyeshme për parashtruesin e ankesës kushtetuese. Ky i fundit e mbartë barrën e provës për të dëshmuar një gjë të tillë.

133. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Letonisë tregon se ajo ka treguar vetë-përmbajtje për sa i takon përdorimit të këtij përjashtimi, ndonëse si i tillë është i mundur. Në këtë aspekt, ekziston vetëm një rast kur është përdorur ky përjashtim. Në atë rast ishte konsideruar se mjetet e përgjithshme nuk e kishin kapacitetin të evitonin dëmin substancial të parashtruesit të kërkesës, (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Letonisë, nr. 2003-19-0103 të 14 janarit 2004), dhe në të cilin nuk u dha arsyetim i gjërë lidhur me këtë pikë, mirëpo u theksua se vetë të dhënat e rastit tregojnë që të drejtat dhe liritë e parashtruesit nuk mund të mbrohen nga mjetet e përgjithshme në të cilat kishte qasje ai dhe se dëmi substancial do të ishte i pakthyeshëm.

Kontributet e tjera të dërguara në Gjykatë

134. Gjykata e Shtetit të Principatës së Lihtenshtajnit theksoi se parashtruesit duhet të shterojnë të gjitha mjetet e mundshme të ankimimit dhe se nuk është bërë ndonjëherë ndonjë përjashtim nga ky rregull. Ndërkaq për sa i takon të drejtave të transgjinorëve, u konfirmua se nuk kanë pasur raste të tilla.

135. Gjykata Supreme e Finlandës theksoi se ata nuk kanë pasur ndonjë rast të ngjashëm me rastin të cilin e ka përshkruar Gjykata dhe se në Finlandë të gjitha gjykatat e kanë për obligim që t'i japin përparësi Kushtetutës në rastet kur një ligj nuk është në pajtim me Kushtetutën. Ndërkaq për sa i takon të drejtave të transgjinorëve, u konfirmua se nuk kanë pasur raste të tilla.

136. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut theksoi ndryshimet në juridiksion që ekzistojnë në gjykimin kushtetues për sa i takon shterimit të mjeteve juridike. Në këtë aspekt, u theksua se individët kanë të drejtë të paraqiten drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut në rastet kur pretendohet se një autoritet publik ka shkelur ndonjë të drejtë të individit, mirëpo, sipas saj, kjo dispozitë shkakton probleme në praktikë duke qenë se juridiksioni i tillë e vendos atë në pozicionin që të shërbejë si gjykatë e shkallës së parë. Për sa i përket "*rrethanave të veçanta*", u theksua se nuk është paraqitur ndonjë rast i ngjashëm mirëpo që, sipas tyre, të gjitha rastet që kanë të bëjë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut konsiderohen si raste "*të veçanta*", për të cilat duhet të veprohet me një diligjencë të veçantë.

137. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë theksoi se në Bullgari nuk ekziston mundësia ligjore për të paraqitur një kërkesë individuale e cila do të mund të cilësohej ekuivalente me kërkesën që është paraqitur para

kësaj Gjykate. Për sa i takon të drejtave të transgjinorëve, u konfirmua se nuk kanë pasur raste të tilla.

138. Gjykata Supreme e Estonisë theksoi se e ka pasur vetëm një rast në të cilin është konkluduar se nuk ka ekzistuar mjet efektik juridik për të adresuar pretendimet e një parashtruesi për shkelje të të drejtave dhe lirive fondamentale. Megjithatë, duke theksuar diferencat juridiksionale në mes të kësaj Gjykate dhe asaj të Estonisë, u theksua që individët në Estoni nuk mund të dorëzojnë kërkesa kushtetuese direkt pa i shteruar të gjitha mjetet juridike. Për sa i takon rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat e transgjinorëve, u theksua se nuk kanë pasur raste të tilla.

139. Gjykata Kushtetuese e Portugalisë theksoi se nuk ka pasur ndonjë rast me të drejtat e transgjinorëve dhe se nuk ka pasur ndonjë rast kur për arsye të veçanta apo për rrethana të veçanta, ndonjë parashtrues është liruar nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike.

Pranueshmëria e kërkesës

140. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

141. Në këtë drejtim, Gjykata, duke aplikuar nenin 113 të Kushtetutës, dispozitat relevante të Ligjit për sa i përket procedurës në rastin e përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës; rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] dhe rregullin 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës, fillimisht do të shqyrtojë nëse: (i) kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar; (ii) kontestohet një akt i autoritetit publik; dhe nëse (iii) janë shteruar të gjitha mjetet juridike. Në varësi të plotësimit të këtyre kritereve fillestare, Gjykata do të vendosë se a është e nevojshme të vazhdojë me shqyrtimin e kritereve të tjera të pranueshmërisë.

Lidhur me palën e autorizuar dhe aktin e autoritetit publik

142. Gjykata në këtë aspekt fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. [...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

143. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i
cili përcakton: "*Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. [...].*"

144. Gjykata po ashtu i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton: *"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse: (a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar."*

145. Gjykata i referohet edhe paragrafit (2) të rregullit 76 të Rregullores së punës i cili, ndër të tjera, përcakton: *"(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht [...] cili është akti konkret i autoriteti publik i cili kontestohet."*

146. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se kërkesa është (i) dorëzuar nga një palë e autorizuar, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, në cilësi të individit, i cili kërkon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës; dhe (ii) ka kontestuar një akt të një autoriteti publik në Republikën e Kosovës, përkatësisht Vendimin [nr.64/04] e 13 qershorit 2018 të Agjencisë së Regjistrimit Civil.

147. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik.

Përkitazi me shterimin e mjeteve juridike

148. Përkitazi me shterimin e mjeteve juridike, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart; paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

[...]

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.

149. Marrë parasysh kërkesën e parashtruesit të kërkesës për t'u liruar nga detyrimi i shterimit të "*padisë për konflikt administrativ*" si mjet juridik i përcaktuar me ligj në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të (i) paraqes parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i takon shterimit të mjeteve juridike; dhe, më pas, do t'i (ii) aplikojë të njejtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i takon shterimit të mjeteve juridike

150. Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të *"të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me nenin 47 të Ligjit përmes së cilit kërkohet që të shterohen të *"gjitha mjetet juridike"* dhe, më tutje me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, ku veçanërisht theksohet detyrimi për të shteruar paraprakisht të gjitha mjetet *"efektive"* të përcaktuara me ligj.

151. Kriteret e vlerësimit nëse detyrimi për shterimin e të gjitha mjeteve "*efektive*" juridike është përmbushur, janë mirë të përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

152. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se koncepti i shterimit dhe/ose detyrimit për shterimin e mjeteve juridike rrjedh dhe bazohet në

rregullat "*përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare*" (shih, ndër të tjera, rastin *Zvicrra kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës,* Aktgjykim i 21 marsit 1959, i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë). E njëjta vlen edhe për GJEDNJ-në, e cila sipas nenit 35 (Kushtet e pranueshmërisë) të KEDNJ-së, mund *"të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuara të të drejtës ndërkombëtare [...]"*.

153. Qëllimi dhe arsyetimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është t'ju ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të KEDNJ-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 74; *Kudła kundër Polonisë,* Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 152; dhe, ndër të tjera, shih edhe rastet e Gjykatës: KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST Sh.P.K.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).

154. Gjykata në vazhdimësi e respekton parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë. Gjykata po ashtu ka pohuar në vazhdimësi se parashtruesit e kërkesës janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI139/12, parashtrues *Besnik Asllani*, Vendim për Kërkesën për Masë të Përkohshme dhe Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2013, paragrafi 45; KI07/09, parashtrues *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19; KI89/15, parashtrues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, paragrafi 35; KI24/16, parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016,

paragrafi 39; dhe KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafët 35-37).

155. Lirimi nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, në nivel të GJEDNJ-së, bëhet vetëm përjashtimisht dhe vetëm në raste specifike me rastin e analizimit të këtij kriteri të pranueshmërisë në dritë të rrethanave faktike, juridike dhe praktike të një rasti konkret. Edhe në nivel të kësaj Gjykate, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe në harmoni më praktikën e Gjykatave Kushtetuese të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias, lirimi nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, mund të bëhet vetëm përjashtimisht (shih rastet e Gjykatës në të cilat është aplikuar një përjashtim i tillë: Kl56/09, parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, paragrafët 44-55; Kl06/10, parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010, paragrafët 50-56 dhe paragrafi 60; KI41/12, parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013; paragrafët 64-74; Kl99/14 dhe KI100/14, cituar më lart, paragrafët 47-50; KI55/17, parashtrues *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017, paragrafët 53-58; dhe KI34/17, parashtruese *Valdete Daka,* Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 68-73).

156. Fakti që lirimi nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, edhe pse i mundur, bëhet vetëm përjashtimisht, konfirmohet edhe nga përgjegjet e dorëzuara në Gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, pa paragjykuar dallimet në Kushtetutat dhe ligjet përkatëse të aplikueshme të këtyre shteteve.

157. Përjashtimet, përkatësisht lirimi nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, janë të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, thekson se rregulli i shterimit, duhet zbatohet me një "*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*", duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (në lidhje me konceptin e "*fleksibilitetit dhe mungesën e formalizmit të tepruar*", shih Udhëzuesin Praktik për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019, I. Bazat Procedurale për Papranueshmëri, A. Mos-shterja e mjeteve juridike, 2. Aplikimi i këtij rregulli, A. Fleksibiliteti, faqe 22 dhe, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Ringeisen kundër Austrisë*, Aktgjykim i 16 korrikut 1971, paragrafi 89). Në parim, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, detyrimi për të shteruar mjetet juridike, është i kufizuar në përdorimin e atyre mjeteve juridike, (i) ekzistenca e të cilave është "*mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*", dhe rrjedhimisht të njejtat, duhet të jenë në gjendje "*të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi*" dhe "*të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses*"; dhe (ii) të cilat janë në "*dispozicion, të qasshme dhe efektive*",

karakteristika këto të cilat duhet të jenë mjaftueshëm të konsoliduara në praktikën gjyqësore të sistemit përkatës juridik (shih rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 71-81; *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, shih Seksionin B. lidhur me shterimi e mjeteve juridike të brendshme, paragrafët 55-77; *Demopolous dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2010, Seksionet: A. Parashtresat para Gjykatës për shterimin e mjeteve të brendshme juridike dhe B. Shterjen e mjeteve juridike vendore, respektivisht, paragrafët 50-129; *Öcalan kundër Turqisë*, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafët 63-72; dhe *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafët 155-162).

158. Në të dy kategoritë e lartcekuara, praktika gjyqësore është e një rëndësie të veçantë. Rrjedhimisht, argumentet rreth "*efektivitetit*" ose mungesës së *"efektivitetit"* të mjetit juridik duhet të mbështeten edhe përmes praktikës gjyqësore, ose, respektivisht, mungesës së saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Kornakovs kundër Latvisë,* Aktgjykim i 15 qershorit 2006, paragrafët 83-85). Rëndësinë e praktikës gjyqësore, e dëshmon edhe rasti i GJEDNJ-së, *Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë*, në të cilin ankesa në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë nuk konsiderohej si efektive, përderisa ajo gjykatë nuk kishte dëgjuar raste që kishin të bëjë me shkeljet përkatëse të të drejtave të njeriut dhe derisa ajo gjykatë nuk kishte nxjerrë dhe publikuar vendime të tilla në merita (shih *Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë,* Aktgjykim i 1 dhjetorit 2009, paragrafi 51). Pra, edhe pse në teori ekzistonte mundësia që parashtruesit t'i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, në nivel të GJEDNJ-së, në mungesë të praktikës gjyqësore, mjeti i tillë juridik ishte konsideruar si jo-efektiv deri në vërtetimin e të kundërtës. Në një stad të mëvonshëm dhe vetëm pas e dëshmive konkrete mbi efektivitetin në praktikë të mjetit juridik, GJEDNJ kishte pranuar argumentet e paraqitura për efektivitetin e krijuar të mjetit juridik dhe si rezultat kishte ndryshuar qasjen e saj duke pranuar dhe kërkuar që shterimi i mjetit të tillë juridik duhet të ndodhë para se një kërkesë të parashtrohet para GJEDNJ-së.

159. Megjithatë, dhe përtej këtyre mundësive përjashtimi, në të gjitha rastet dhe në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesi duhet të dëshmojë se "*ai ka bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*" (shih rastin e GJEDNJ-së *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007 paragrafi 116 dhe referencat e përmendura aty). GJEDNJ potencon se është në interes të parashtruesit të kërkesës që t'i drejtohet gjykatës kompetente për t'i dhënë asaj mundësinë që të ushtrojë të drejtat ekzistuese përmes fuqisë së saj të interpretimit (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Ciupercescu kundër*

Rumanisë, Aktgjykim i 15 qershorit 2010, paragrafi 169). Kjo me përjashtim të rasteve kur një parashtrues mund të tregojë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion e të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar, do të dështonte (shih rastet e GJEDNJ-së: *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 156 dhe referencat e përmendura aty, dhe *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 74-77). Në këtë aspekt, është e rëndësishme të theksohet se "*dyshimet e thjeshta*" të një parashtruesit rreth jo-efikasitetit të një mjeti juridik nuk vlejnë si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike (shih, ndër të tjera, rastet e GJENDJ-së; *Milošević kundër Holandës*, Vendim i 19 marsit 2002, paragrafi i fundit të faqës 6; dhe *MPP Golub kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 tetorit 2005, paragrafi i fundit i Seksionit C. mbi Vlerësimin e Gjykatës).

160. Gjykata gjithashtu thekson se vlerësimi fleksibil i karakteristikave të nevojshme të mjetit juridik, duhet të bëhet duke marrë parasysh rrethanat e secilit rast individual. Në këtë drejtim, GJEDNJ gjithashtu ka përvetësuar konceptin e "*rrethanave të veçanta"*, përmes të cilit e bën vlerësimin, nëse ka ndonjë bazë të veçantë që e liron parashtruesin nga përmbushja e detyrimit të shterjes së mjetit juridik. Në bërjen e këtij vlerësimi, GJEDNJ merr parasysh edhe (i) kontekstin e përgjithshëm *"ligjor dhe politik"*; dhe (ii) "*rrethanat e veçanta*" të një parashtruesi (për konceptin e "*rrethanave të veçanta*", ndër të tjera, shih rastet e GJEDNJ-së: *Van Oosterijck kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafët 36-40 dhe referencat përkatëse në të; *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 71-81 dhe referencat përkatëse në të; *Öcalan kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 67-68 dhe referencat në të. Më tej, lidhur me shqyrtimin e kontekstit të përgjithshëm ligjor dhe politik, ndër të tjera, shih *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 68-69 dhe referencat në të; dhe *Selmouni kundër Francës,* cituar më lart, paragrafi 77). Në rastet në të cilat rezulton se detyrimi i një parashtruesi për të përdorur një mjet juridik mund të jetë i paarsyeshëm në praktikë dhe do të paraqite një pengesë joproporcionale për të ushtruar efektivisht të drejtën e tij, GJEDNJ liron parashtruesin nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: *Veriter kundër Francës*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 1997, paragrafi 27; *Gaglione dhe të tjerët kundër Italisë*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2010, paragrafi 22; dhe *M.S. kundër Kroacisë (nr.2)*, Aktgjykim i 19 shkurtit 2015, paragrafët 123-125).

161. Në fund, Gjykata thekson, se duke marrë parasysh parimin e vlerësimit fleksibil të shterimit të mjeteve juridike dhe përshtatjen e këtij vlerësimi "*rrethanave të veçanta*" të secilit rast veç e veç, GJEDNJ ka zhvilluar testin e "*barrës së të provuarit*", proces ky i përcaktuar qartë në praktikën e saj gjyqësore. Sipas kësaj të fundit, në kontekst të GJEDNJ-së, shpërndarja e barrës së të provuarit ndahet midis parashtruesit të kërkesës dhe qeverisë përkatëse që pretendon mos-shterimin. (Për një diskutim më të detajuar mbi *shpërndarjen e barrës së provës*, ndër të tjera, shih rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 76 dhe referencat në të; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 68 dhe referencat në të). Në parim, pas pretendimeve të parashtruesit përkatës për mungesë të mjetit juridik, pala kundërshtare, përkatësisht shteti përkatës në kontekst të GJEDNJ-së, mban barrën e të provuarit se ekziston një mjet juridik që nuk është përdorur dhe i cili është "*efektiv*", ndërsa, parashtruesi më tej do të duhet të argumentojnë të kundërtën, përkatësisht se mjeti i referuar është përdorur apo që i njejti nuk është "*efektiv*" në rrethanat e rastit përkatës. Siç është theksuar më lart, mbështetja në praktikë përkatëse gjyqësore është relevante në të dyja rastet.

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura dhe vlerësimi i Gjykatës përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në rrethanat e rastit konkret

162. Bazuar në parimet e mësipërme, Gjykata, në vijim do të shqyrtojë kërkesën dhe argumentet e parashtruesit të kërkesës për lirimin nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës ka iniciuar padi për konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore më 24 korrik 2018. Megjithatë, vetëm një javë më pas, përkatësisht më 30 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar edhe kësaj Gjykate, duke kërkuar lirimin nga detyrimi për shterimin e këtij mjeti juridik me pretendimin se i njejti nuk është "*efektiv*" dhe "*mjaftueshëm i sigurtë në teori dhe praktikë*".

163. Parashtruesi i kërkesës e argumenton mungesën e pretenduar të karakteristikave të lartcekura të mjetit juridik, duke u bazuar në (i) "*rrethanat e veçanta*" të tij, përfshirë kontekstin ligjor dhe politik të komunitetit të cilit ai i përket; dhe (ii) kohëzgjatjen e procedurave në gjykatat e rregullta. Këto pretendime të parashtruesit të kërkesës mbështeten edhe nga Avokati i Popullit. Ndërsa, siç është sqaruar më lart, përgjegje në këto pretendime dhe pyetjet përkatëse të Gjykatës, ka dhënë edhe KGJK.

164. Gjykata rikujton që në përgjegje përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe pyetjet e Gjykatës, KGJK, ndër të tjera, theksoi, se mjeti përkatës juridik *"i përmbush të gjitha standardet për të qenë mjaftueshëm i sigurtë për rastin konkret dhe rastet e tjera marrë parasysh atë se gjykatat janë të pavarura, apolitike, të paanshme dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë."* Më tutje, KGJK në kontekst të së drejtës të parashtruesit të kërkesës për një mjet juridik "*mjaftueshëm të sigurtë jo vetëm në teori por edhe në praktikë*", siç është cekur më lart, i është referuar paragrafit 4 të nenit 55 të Kushtetutës. Ndërsa përkitazi me "*disponueshmërinë*", "*qasshmërinë*" dhe "*efektivitetin*" e mjetit juridik, KGJK theksoi se *"padia për inicimin e konfliktit administrativ si mjet juridik i plotëson standardet e duhura për tu konsideruar si mjet i disponueshëm për parashtruesin, pasi që gjykatat mundësojnë dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë dhe gjithnjë bëjnë përpjekje të jenë sa më efektive dhe efikase në zgjidhjen e rasteve përkundër asaj që ballafaqohen me një numër të madh të rasteve të pazgjidhura të cilat janë grumbulluar nga një serë faktorësh siç* [janë] *rastet e mbetura nga vitet paraprake, rastet e reja të pranuara në punë, numëri i pamjaftueshmë i gjyqtarëve etj."* KGJK nuk dorëzoi ndonjë shembull nga praktika gjyqësore, siç ishte kërkuar nga Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës ka kontestuar argumentet e KGJK-së, ndër të tjera duke theksuar se kjo e fundit vetëm ka bërë një konstatim se konflikti administrativ *"i përmbush të gjitha standardet e mjaftueshme për të qenë mjaftueshëm i sigurtë në rastin konkret dhe rastet e tjera",* por i cili konstatim, "*nuk bazohet në asnjë fakt apo të dhënë konkrete.*"

165. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se përderisa KGJK ka theksuar se mjeti përkatës juridik është mjaftueshëm i sigurtë në teori dhe praktikë, ajo në mbështetje të argumenteve të saj, i referohet paragrafit të 4 të nenit 55 të Kushtetutës, përkitazi me kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Përderisa një argument i tillë është i paqartë, Gjykata gjithashtu vëren që KGJK nuk jep ndonjë arsyetim shtesë, elaborim të mëtutjeshëm apo provë që do të dëshmonte efektivitetin e këtij mjeti juridik në rrethanat e rastit konkret. Për më tepër, pohimet e saj nuk i ka mbështetur me asnjë praktikë gjyqësore relevante, gjë që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është e nevojshme për determinim praktik të sigurisë të mjaftueshme dhe efektivitetit të mjetit juridik.

166. Në këtë kontekst, dhe duke u bazuar në pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe komentet përkatëse të Avokatit të Popullit dhe KGJK-së, Gjykata fillimisht do të trajtojë pretendimet përkitazi me mungesën e efektivitetit dhe pamjaftueshmërinë e sigurisë së mjetit juridik në teori

dhe praktikë, si rezultat i "*rrethanave të veçanta*" të parashtruesit të kërkesës.

167. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me joefektivitetin e mjetit juridik ndërlidhen me natyrën e shkeljes së pretenduar të së drejtës së privatësisë dhe kontekstin e ligjor e politik të komunitetit të cilit i përket parashtruesi i kërkesës, si një ndër komunitetet më të margjinalizuara në Republikën e Kosovës edhe sipas argumenteve të Avokatit të Popullit. Gjykata gjithashtu vëren se në kohën dhe rrethanat e dorëzimit të kërkesës, përkatësisht pretendimeve përkatëse nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatë, nuk ka ekzistuar asnjë praktikë gjyqësore për të dëshmuar se padia për konflikt administrativ do të mund të ishte efektive dhe mjaftueshëm e sigurtë përpos në teori edhe në praktikë për "*rrethanat e veçanta*" të parashtruesit të kërkesës.

168. Gjykata më tej vëren se edhe pse shqyrtimi i një padie të ndërlidhur me një rast të ngjashëm ishte në pritje pranë Gjykatës Themelore kundër Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe e cila gjithashtu e kishte refuzuar kërkesën e një personi "Y" për ndërrimin e emrit dhe shënuesit të gjinisë nga "F" në "M", deri më 9 tetor 2018 dhe 20 nëntor 2018, data këto në të cilat Avokati i Popullit dorëzoi Mendimin Juridik dhe KGJK dorëzoi komentet e saj Gjykatë, respektivisht, bazuar në shkresat e lëndës, gjykatat e rregullta nuk kishin praktikë gjyqësore përkitazi me ndërrimin e emrit dhe shënuesit të gjinisë të personave transgjinor.

169. Rasti i lartcekur i ndërlidhur me personin "Y" rezulton të jetë rasti i parë i vendosur nga Gjykata Themelore më 27 dhjetor 2018, ndërsa vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 2 gusht 2019. Gjykata thekson se kjo praktikë gjyqësore përkitazi me të drejtat e personave transeksual/transgjinor për ndërrimin e emrit dhe shënuesit të gjinisë, ndërron kontekstin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe vlerësimin e tyre nga Gjykata, sepse e njejta dëshmon se padia për konflikt administrativ, në rrethanat e rastit konkret, përpos që është efektive, është gjithashtu mjaftueshëm e sigurtë përtej teorisë edhe në praktikë.

170. Gjykata në këtë kontekst më specikisht thekson se rasti i vendosur përmes Aktgjykimit [A.nr.2196/2017] të 27 dhjetorit 2018 të Gjykatës Themelore dhe të vërtetuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA.nr.244/2109] të 2 gushtit 2019, përfshinë një person "Y" dhe i cili kishte lindur femër dhe kishte një emër që qartazi i përkiste gjinisë femërore. Në një fazë të mëvonshme, personi "Y" iu ishte nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjike për ndryshim të gjinisë nga femër në mashkull.

Intervenimet e tilla i kishte përfunduar me sukses. Si rrjedhojë, në vitin 2017, personi "Y" kishte paraqitur një kërkesë në Zyrën e Gjendjes Civile në Komunën e Prizrenit për ndërrim ligjor të emrit personal dhe shënuesit të gjinisë. Zyra e Gjendjes Civile e kishte refuzuar kërkesën e tij. Agjencia e Regjistrimit Civil, duke vepruar mbi ankesën e personit "Y", po ashtu e kishte refuzuar kërkesën e tij. Personi "Y" kishte iniciuar proces gjyqësorë kundër Agjencisë së Regjistrimit Civil duke ushtruar kështu padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore, respektivisht para të njëjtës Gjykatë Themelore ku edhe ndodhet tashmë në pritje zgjidhja e padisë për konflikt administrativ të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore, e pranoi si të bazuar padinë e personit "Y". Me atë rast, ajo urdhëroi Drejtorinë e Përgjithshme të Komunës së Prizrenit që (i) të bëjë korrigjimin e emrit personal të personit "Y" në bazë të kërkesës së tij; dhe (ii) të bëjë ndërrimin e shënjuesit të gjinisë së personit "Y" nga gjinia femërore "F" në gjininë mashkullore "M". Kundër vendimit të Gjykatës Themelore ishte ankuar Agjencia e Regjistrimit Civil në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit e kishte refuzuar atë ankesë dhe e kishte konfirmuar vendimmarrjen e Gjykatës Themelore. Procedurat para gjykatave të rregullta në këtë rast kishin zgjatur mesatarisht një (1) vit e tetë (8) muaj nga momenti i paraqitjes së padisë përkatëse deri te vërtetimi i vendimit të Gjykatës Themelore nga Gjykata e Apelit.

171. Më tej, Gjykata fillimisht thekson se rasti i lartcekur reflekton rrethana shumë të ngjashme me rrethanat e rastit konkret, në të paktën dy aspektet në vijim: (i) një kërkesë për ndërrim emri dhe shënjuesi të gjinisë nga "F" në "M" në librat e regjistrit civil drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile fillimisht; dhe (ii) një kërkesë të refuzuar nga Zyra e Gjendjes Civile në komunat përkatëse e të vërtetuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil.

172. Në rastin tashmë të zgjidhur nga gjykatat e rregullta, përkatësisht rastin e personit "Y", Gjykata vëren se padia e tij e ushtruar më 27 dhjetor 2017 në Gjykatën Themelore kundër vendimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe i cili kishte vërtetuar vendimin e Zyrës përkatëse të Gjendjes Civile për refuzimin e kërkesës për ndërrimin e emrit dhe shënuesit të gjinisë të personit "Y", u zgjidh në favor të këtij të fundit, përmes Aktgjykimit [A.nr.2196/2017] të 27 dhjetorit 2018 të Gjykatës Themelore dhe u vërtetua nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA.nr.244/2109] të 2 gushtit 2019. Gjykatat përkatëse urdhëruan, përkatësisht konfirmuan që (i) të bëhet korrigjimi i emrit personal të personit "Y" në bazë të kërkesës së tij; dhe (ii) të bëhet ndërrimin i gjinisë së personit "Y" nga gjinia femërore "F" në gjininë mashkullore "M".

173. Gjykata gjithashtu vëren që gjykatat e rregullta, në nxjerrjen e Aktgjykimeve të lartcekura gjithashtu i referohen praktikës së mëparshme të ndërrimit të emrit personal si dhe ndërrimin e shënuesit të gjinisë nga "M" në "F" nga vet zyrat përkatëse komunale. Më specfikisht, bazuar në shkresat përkatëse, rezulton se më 18 prill 2012, Komuna e Suharekës, përmes Aktvendimit përkatës ia lejoi personit transgjinor "Z" [identiteti i saktë nuk do t'i zbulohet nga Gjykata, *ex officio*, bazuar në paragrafin (6) të rregullit 32 të Rregullores së punës], ndërrimin e emrit personal si dhe ndërrimin e shënuesit të gjinisë nga "M" në "F", bazuar në preferencën dhe kërkesën e saj.

174. Gjykata për më tepër thekson se vendimet e lartcekura të gjykatave të rregullta nuk janë objekt shqyrtimi para kësaj Gjykate, dhe rrjedhimisht ajo nuk është duke e vlerësuar përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën. Megjithatë, për qëllime të vlerësimit të shterimit të mjetit juridik në rrethanat e rastit konkret, dhe efektshmërisë dhe sigurisë së mjaftueshme të padisë për konflikt administrativ në "*teori dhe praktikë*", Gjykata verën që gjykatat e rregullta, përgjatë vendimarrjes përkatëse dhe vënies në funksion në praktikë të mjetit përkatës juridik ishin referuar në (i) Kushtetutë, përkatësisht nenet 21, 24 dhe 36 të saj; (ii) praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së, specifikisht *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (cituar më lart), duke u bazuar në nenin 53 të Kushtetutës; (iii) në KEDNJ, përkatësisht nenin 8 të saj; dhe (iv) rregullativën ligjore të përcaktuar me LPA, Ligjin për Emrin Personal në lidhje me Udhëzimin Administrativ për Emrin Personal, Ligjin për Gjendjen Civile dhe Ligjin për Barazi Gjinore.

175. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që ajo në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se padia për konflikt administrativ paraqet mjet juridik "*efektiv*" jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Përtej përjashtimeve të kufizuara dhe të cekura në pjesën e parimeve të përgjithshme, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka refuzuar kërkesa duke i shpallur të njëjtat të papranueshme pikërisht me arsyetimin e mosshterimit të këtij mjeti juridik. (Shih, ndër të tjera, rastin KI131/17, parashtrues *Uran Halimi*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 tetorit 2018, paragrafët 48-49). Në rrethanat e rastit konkret, është efektiviteti dhe siguria e mjaftueshme e tij "*në praktikë*" i cili është kontestues, duke marrë parasysh "*rrethanat e veçanta*" të parashtruesit të kërkesës.

176. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, riktheson rëndësinë e praktikës gjyqësore në vlerësimin e efektivitetit dhe sigurisë së mjaftueshme të një mjeti juridik në praktikë. Përkitazi më

këtë të fundit, dhe pas informacioneve të marra nga Gjykata më 21 gusht 2019, kur edhe u raportua për vendimarrjen e Gjykatës Themelore dhe të Apelit për një rast të ngjashëm me rastin e tanishëm, përkatësisht rastin e personit "Y", Gjykata nuk mund të mos e vërejë dhe ta shënojë faktin që në Republikën e Kosovës tashmë ka një praktikë gjyqësore, ndonëse jo të konsoliduar por gjithsesi të rëndësishme, përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore të personave transeksual dhe transgjinor e të cilët synojnë ndërrimin e emrit personal dhe shënuesit të gjinisë.

177. Siç është theksuar më lart, Aktgjykimi [A.nr.2196/2017] i 27 dhjetorit 2018 i Gjykatës Themelore dhe i vërtetuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA.nr.244/2109] të 2 gushtit 2019, në rrethana të ngjashme personale dhe në kontekst të ngjashëm ligjor e politik, kishin urdhëruar autoritet relevante publike që të bëjnë korrigjimin e emrit personal dhe ndërrimin e shënuesit të gjinisë të personit përkatës në librat e regjistrimit civil. Gjykata vëren dhe thekson se për dallim nga rrethanat e rastit konkret, personi "Y" i ishte nënshtruar paraprakisht një intervenimi kirurgjik për ndryshimin e gjinisë. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se ky fakt nuk ishte determinues në vlerësimin e Gjykatës Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.2196/2017] të 27 dhjetorit 2018, dhe i cili specifikisht kishte arsyetuar ndër të tjera se bazuar në Kushtetutë, praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Ligjin për Barazinë Gjinore, ndërhyrjet kirurgjike nuk janë përcaktues për njohjen ligjore të identitetit gjinor.

178. Rrjedhimisht, dhe në dritë të të tillave rrethana, Gjykata duhet të konstatojë se padia për konflikt administrativ është "*efektive*" dhe "*mjaftueshëm e sigurtë* [edhe] *në praktikë*", dhe se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore përkatëse, "*është në gjendje të ofrojë zgjidhje*" përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë si dhe të "*ofrojë mundësi të arsyeshme për sukses*".

179. Në rastet të tilla kur, bazuar në praktikën relevante gjyqësore, një mjet i rregullt juridik është "*efektiv" dhe "mjaftueshëm i sigurtë në teori dhe në praktikë*", dhe rrjedhimisht është në "*gjendje të ofrojë zgjidhje*" përkitazi me pretendimet e parashtruesit dhe "*ofron një mundësi të arsyeshme për sukses*", Gjykata, bazuar në parimin e subsidiaritetit, nuk mund t'ua marrë gjykatave të rregullta kompetencën e tyre kushtetuese për të vendosur mbi pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të mundshme të neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Siç është theksuar më lart, është pikërisht qëllimi dhe arsyetimi i detyrimit për të shteruar mjetet

juridike që tu ofrojë gjykatave të rregullta mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës.

180. Do të ishte në kundërshtim të plotë me frymën subsidiare të mekanizmit të kontrollit kushtetues nëse Gjykata do të deklaronte një mjet juridik jo-efektiv kur në fakt i njejti e ka dëshmuar efektivitetit e tij në praktikë, siç edhe dëshmon rasti i cituar më lart i personit "Y". Respektimi i parimit të subsidiaritetit kërkon pikërisht lejimin e rrugës dhe hapësirës së nevojshme për gjykatat e instancave më të ulëta që ta kryjnë detyrën e tyre për zbatim të drejtpërdrejtë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

181. Gjithsesi, parimi i subsidiaritetit në asnjë mënyrë nuk i parandalon parashtruesit përkatës që t'i drejtohen Gjykatës duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së (i) akteve të autoriteteve publike pasi t'i kenë shterruar mjetet juridike të përcaktuar me ligj siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës; dhe (ii) mungesës së një vendimi brenda një afati të arsyeshëm ose procedurës së pretenduar të tejzgjatur gjyqësore në kundërshtim me garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në kontekst të tejzgjatjes së pretenduar të procedurave gjyqësore, Gjykata rikujton që, në rrethana të caktuara, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe jo vetëm, por edhe praktika gjyqësore e gjykatave përkatëse të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias, mundëson lirimin e parashtruesve përkatës nga detyrimi për shterrimin e mjeteve jurdike.

182. GJEDNJ ka praktikë të mjaftueshme gjyqësore në këtë aspekt. Megjithatë Gjykata do t'i referohet rastit më të fundit të GJEDNJ-së përkitazi të drejtat transgjinore, *X kundër Maqedonisë së Veriut*. Gjykata thekson se në këtë rast, GJEDNJ kishte refuzuar pretendimet e Maqedonisë së Veriut se rasti ishte i parakohshëm para GJEDNJ-së sepse çështja ishte ende duke u trajtuar nga gjykatat në Maqedoninë e Veriut. (Shih argumentet e Qeverisë dhe parashtruesit përkatës përkitazi me shterimin e mjeteve jurdike në paragrafët 40 dhe 41 të rastit *X kundër Maqedonisë së Veriut*, cituar më lart). GJEDNJ kishte refuzuar këto argumente dhe kishte pranuar rastin e parashtruesit për shqyrtim në merita, përkundër mosshterrimit të mjeteve juridike, duke arsyetuar se tejzgjatja e procedurave gjyqësore mund të përbëjë bazë për lirimin e parashtruesëve përkatës nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike dhe se në rrethanat përkatëse, çështja e parashtruesit ishte në pritje para autoriteteve dhe gjykatave Maqedonase për shtatë (7)

vjet me radhë dhe pa indikacione se kur të njejtat mund të përfundonin. Sipas GJEDNJ-së, tejzgjatja e procedurave në ndërlidhje me rrethanat e parashtruesit dhe faktit se i njejti i nënshtrohej një situate tejet paragjykuese përkitazi me të drejtën e tij për jetë private, mundësonin lirimin e parashtruresit përkatës nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike. (Shih arsyetimin përkatës të GJEDNJ-së, në paragrafët 43-46 të rastit *X kundër Maqedonisë së Veriut*, cituar më lart).

183. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton se para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendon se duhet të lirohet nga detyrimi për shterimin e mjeteve jurdike për shkak të "*mundësisë*" së tejzgjatjes së procedurave gjyqësore në rrethanat e rastit të tij. Gjykata rikujton se një pjesë e konsiderueshme e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës bazohen në raportet e KGJK-së për të argumentuar se zgjidhja e çështjes së tij para gjykatave të rregullta do të rezultonte në procedura të tejzgjatura gjyqësore dhe mesatarisht tre (3) deri në katër (4) vite, nën rrezikun që çështja e tij të mos vendoset fare në merita nga gjykatat e rregullta por të kthehet për rishqyrtim tek organet fillestare administrative. Këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, mbështeten gjithashtu nga Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit.

184. Megjithatë dhe në këtë aspekt, Gjykata duhet të sqarojë se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave tashmë të tejzgjatuara gjyqësore në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 e KEDNJ-së dhe rrjedhimisht edhe lirimin përkatës nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Përkundrazi, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në procedurë të rregullt ndërlidhen me "*mundësinë*" e tejzgjatjes se tyre në të ardhmen.

185. Më specifikisht, Gjykata rithekson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë është dorëzuar me 30 korrik 2018, vetëm gjashtë (6) ditë pas dorëzimit të padisë në Gjykatën Themelore më 24 korrik 2018. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk pretendon se procedurat para Gjykatës Themelore tashmë konsistojnë në tejzgjatje të procedurave dhe shkelje të së drejtës së tij për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm siç është e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ngjashëm, kriteret e referuara nga ana e parashtruesit të kërkesës e të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e që ndërlidhen me "*ndërlikueshmërinë e rastit*";, "*sjelljen e autoriteteve relevante*" dhe

"*çështjes në shqyrtim*", ndërlidhen me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe shërbjenë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një procedure që pretendohet të jetë tashmë e tejzgjatur gjyqësore. Të njejtat (i) nuk mund të aplikohen në një diferencë kohore prej gjashtë (6) ditësh nga momenti i dorëzimit të padisë në Gjykatën Themelore dhe dorëzimit të kërkesës në Gjykatë; dhe (ii) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk shërbejnë si kritere për të vlerësuar "*mundësinë*" e tejzgjatjes së një procedure në të ardhmen.

186. Pretendimet e tilla, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, i konsideron si "*dyshime të thjeshta*" për "*joefektivitetin*" e padisë për konflikt administrativ si mjet juridik dhe rrjedhimisht, si të tilla, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk vlejnë si arsye për ta liruar parashtruesin e kërkesës nga detyrimi për të shteruar një mjet juridik. Për më tepër që, nga informacionet e fundit të marra nga Gjykata, rezulton që, përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të njejtës Gjykatës Themelore në një rast të ngjashëm, iu janë dashur afërsisht një (1) vit për të vendosur në merita; ndërkaq, Gjykatës së Apelit afërsisht tetë (8) muaj për të vendosur në shkallë të dytë dhe për të konfirmuar vendimarrjen e Gjykatës Themelore.

187. Gjykata vëren që prej momentit kur parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar padinë përkatëse në Gjykatën Themelore, përkatësisht më 24 korrik 2018, ai i ka dorëzuar Gjykatës Themelore edhe pesë (5) kërkesa për përshpejtim, më 16 tetor 2018, 22 mars 2019, 16 prill 2019, 5 qershor 2019 dhe 4 korrik 2019, respektivisht, dhe bazuar në shkresat e lëndës dhe deri në vendosjen e këtij rasti nga kjo Gjykatë, nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës të ketë pranuar ndonjë përgjegje nga Gjykata Themelore. Për më tepër, në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë, Gjykata Themelore kishte konfirmuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës se nuk është ndërmarrë ndonjë hap procedural drejt trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 23, 24 dhe 36 të Kushtetutës në lidhje me nenit 8 të KEDNJ-së.

188. Megjithatë, dhe siç është theksuar më lart, çështja para Gjykatës nuk është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurave para Gjykatës Themelore, por vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Agjencisë së Regjistrimit Civil. Për të bërë vlerësimin e këtij të fundit, Gjykata do të duhet të miratojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lirim nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, duke konstatuar se padia për konflikt

administrativ në rrethanat e rastit konkret dhe marrë parasysh "*rrethanat e veçanta*" të parashtruesit të kërkesës, (i) nuk është efektive; dhe (ii) nuk është mjaftueshëm e sigurtë në teori dhe praktikë.

189. Siç është elaboruar më lart, një konstatim i tillë nga Gjykata, në rrethana kur padia për konflikt administrativ është dëshmuar efektive dhe mjaftueshëm e sigurtë përpos në teori edhe në praktikë, në rastin e personit "Y" të vendosur nga e njejta Gjykatë Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.2196/2017] të 27 dhjetorit 2018 dhe në rrethana të ngjashme me ato të parashtruesit të kërkesës, do të ishte në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit, parim ky i mishëruar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe praktikën gjyqësore të vet Gjykatës dhe GJEDNJ-së.

190. Gjykata tashmë ka përcaktuar në jurisprudencën e saj se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta atëherë kërkesa e parashtruesve konsiderohet e parakohshme. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI23/10, parashtrues *Jovica Gadzic*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013; KI32/11, parashtrues *Lulzim Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 prillit 2012; KI113/12, parashtrues *Haki Gjocaj,* Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2013, paragrafi 34; KI114/12, parashtrues *Kastriot Hasi,* Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2013, paragrafi 33; KI07/13, parashtrues *Ibish Kastrati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 korrikut 2013, paragrafët 28-29; KI58/13, parashtrues *Sadik Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 nëntorit 2013, paragrafi 31; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha,* Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).

191. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e detyruar që kërkesën e parashtruesit të kërkesës ta deklarojë si të papranueshme për shkak së është e parakohshme, duke u ofruar në këtë mënyrë mundësinë dhe përparësinë gjykatave të rregullta që t'i trajtojnë çështjet që ngritën në kërkesën e tij.

192. Deklarimi i kësaj kërkese si të parakohshme në vetvete nënkupton që parashtruesi i kërkesës e ka të garantuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës mundësinë që t'i drejtohet sërisht kësaj Gjykate me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të autoriteteve publike, qoftë të veprimeve apo mosveprimeve të tyre, e të cilat ai mund të pretendon se konsistojnë në shkelje të ndonjë të

drejtë apo lirie themelore të garantuar me Kushtetutë, KEDNJ apo instrumente të tjera ndërkombëtare.

193. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar kriterin e pranueshmërisë së shterimit të mjeteve juridike të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafi (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht kërkesa e tij duhet të shpallet e papranueshme

Kërkesa e parashtruesit për kompensim të dëmit jo-material

194. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata që t'i akordojë atij kompensim për dëmin jo-material në vlerë prej 5,000.00 euro për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Kërkesën e tij për kompensim të dëmit jo-material, parashtruesi i kërkesës e bazon në nenin 41 (Shpërblimi i drejtë) të KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, respektivisht në rastet *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë* (cituar më lart), *B. kundër Francës* (cituar më lart) dhe *Dolenec kundër Kroacisë* (Aktgjykimi i 26 shkurtit 2010).

195. Gjykata vëren dhe konstaton se neni 41 i KEDNJ-së, i cili bën pjesë në Titullin II [Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] të KEDNJ-së, nuk mund të shërbejë si bazë për të kërkuar "*shpërblim të drejtë*" apo kompensim për dëm jo-material para Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se ky nen i referohet kompetencave të GJEDNJ-së dhe jo kompetencave të gjykatave vendore pjesë anëtare të mekanizmit mbrojtës të garantuar me KEDNJ. Palët kontraktuese janë të obliguara të garantojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Titullin I [Të Drejtat dhe Liritë] të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, Gjykata e ka parasysh faktin që GJEDNJ akordon "*shpërblim të drejtë*" apo kompensim për dëm jo-material, mirëpo një gjë të tillë e bën bazuar në kompetencat e saj specifike të përshkruara në nenin 41 të KEDNJ-së dhe rregullin 60 të Rregullores së saj të punës.

196. Përkundër faktit që GJEDNJ ka autorizim specifik për të caktuar "*shpërblim të drejtë*", kjo Gjykatë, është e lidhur dhe e kushtëzuar që të veprojë vetëm në bazë të rregullativës ligjore dhe procedurale që e rregullon punën e saj. Në asnjërin nga dokumentet të cilat e rregullojnë fushëveprimtarinë dhe procedurat para kësaj Gjykate dhe veprimet që kjo e fundit mund të ndërmarrë, nuk parashihet një autorizim ekuivalent për të akorduar "*shpërblim të drejtë*", ashtu siç një kompetencë e tillë qartazi i përshkruhet GJEDNJ-së me dispozitat e lartcekura.

197. Të lartcekurat nuk nënkuptojnë që individët nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuar në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Përkundrazi, vet GJEDNJ thekson se në mënyrë që një e drejtë e mbrojtur me KEDNJ të riparohet në maksimumin e mundshëm të riparimit, parashtruesit përkatës duhet të dëmshpërblehen dhe atë në lartësinë e duhur dhe në përputhje të drejtë me të drejtën e cila iu është cenuar. (Shih, për shembull, njërin nga rastet e GJEDNJ-së në këtë aspekt: *Gavriliță kundër Moldavisë*, Aktgjykim i 22 korrikut 2014). Megjithatë, ka edhe të tilla raste kur, bazuar në rrethanat specifike të atij rasti, GJEDNJ konsideron se vet gjetja e shkeljes paraqet "*shpërblim të drejtë*" edhe për dëmin jo-material që një parashtrues mund të ketë pësuar. (Shih në këtë aspekt pjesën operative të rastit të GJEDNJ-së, *Roman Zaharov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2015).

198. Rrjedhimisht, për arsyet e lartcekura, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet për faktin se kërkesa e tij u shpall e papranueshme si dhe për faktin se Gjykata nuk ka autorizim që të akordojë "*shpërblim të drejtë*" apo "*dëmshpërblim*". (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI177/14, parashtrues *Miodrag Janković*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 korrikut 2015, paragrafi 44).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2019, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

IV. TË DEKLAROJË se ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI91/18 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ. UZV. nr.1/2018, i datës 25 janar 2018

KI91/18, parashtrues: Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi

Aktvendim për Papranueshmëri i 10 shtatorit 2019

Fjalët kyç: *Kërkesa individuale, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, marrëdhënie pune, qartazi e pabazuar*

Kërkesa ishte dorëzuar nga katër parashtrues të cilët bashkërisht kontestonin kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme.

Parashtruesit e kërkesës kishin aplikuar në një konkurs të shpallur nga Ministria e Shëndetësisë për "Inspektor Shëndetësor". Ata ishin përzgjedhur si kandidatë të suksesshëm nga Komisioni Rekrutues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe për rrjedhojë kishin nënshkruan akt-emërimet përkatëse dhe kishin filluar marrëdhënien e punës me Ministrinë e Shëndetësisë. Disa kandidatë të pasuksesshëm në atë konkurs fillimisht kishin ushtruar ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe më pas, edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ["KPMSHCK"]. Ky i fundit i kishte miratuar ankesat e tyre dhe kishte anuluar në tërësi konkursin në fjalë dhe përzgjedhjen e parashtruesve të kërkesës si kandidatë fitues. Kundër vendimeve të KPMSHCK-së, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar konflikt administrativ mbi të cilën padi kishin vendosur gjykatat e rregullta. Gjykata Themelore e kishte refuzuar padinë e tyre si të pabazuar; Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e tyre po ashtu si të pabazuar dhe, së fundmi, edhe Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e tyre për rishqyrtim të jashtëzakonshëm si të pabazuar. Me fjalë të tjera, gjykatat e rregullta kanë konsideruar që akt-emërimet e parashtruesve të kërkesës nuk kanë qenë të ligjshme dhe që KPMSHCK ka vendosur drejtë kur ka anuluar rezultatet e konkursit në fjalë. Para Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit e kërkesës kontestuan vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, duke pretenduar se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenet 31, 49 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

Pas trajtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata erdhi në përfundimin se:

(i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ përkitazi me arsyetim të vendimeve gjyqësore

janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;

(ii) pretendimet për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës përkitazi me të drejtën në punë dhe ushtrim të profesionit janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punë; dhe

(iii) pretendimet për shkelje të nenit 55 të Kushtetutës për sa i përket çështjes së kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nuk janë të qartësuara në mënyrë adekuate dhe si të tilla duhet të refuzohen në bazë të nenit 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI91/18

Parashtrues

Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.UZV.nr.1/2018 i datës 25 janar 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga Njazi Gashi, respektivisht njëri nga parashtruesit e kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [ARJ.UZV.nr.1/2018] e 25 janarit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [A.A.nr.244/2017] e 20 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr.1144/14] e 9 marsit 2017 të Gjykatës

Themelore në Prishtinë – Departamentit për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 9 mars 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili, sipas pretendimit, shkel të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 korrik 2018, parashtruesit e kërkesës, bashkërisht, dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Me 10 korrik 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan një autorizim për përfaqësim në Gjykatë përmes së cilit autorizuan Njazi Gashin – njërin nga parashtruesit - që t'i përfaqësojë të gjithë parashtruesit e kërkesës në procedurat para Gjykatës.

8. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Bajram Latifi.

9. Më 12 tetor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe iu kërkoi që të dorëzojnë kopje të fletëkthesave për të dëshmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

10. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHCK).

11. Në të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi edhe Ministrinë e Shëndetësisë për regjistrimin e kërkesës, në cilësi të palës së interesuar, duke i ofruar mundësinë që të paraqes komente lidhur me kërkesën KI91/18 brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit të Gjykatës.

12. Me 18 tetor 2018, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar ku dëshmohej që përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 9 mars 2018.

13. Me 30 tetor 2018, Ministria e Shëndetësisë i dorëzoi komentet e saj në Gjykatë.

14. Me 7 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për pranimin e komenteve nga Ministria e Shëndetësisë dhe u dërgoi një kopje të tyre.

15. Më 28 qershor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë në Gjykatë një kopje të të gjithë dosjes së rastit që ndërlidhet me parashtruesit e kërkesës.

16. Më 1 korrik 2019, Gjykata Themelore e dorëzoi kopjen e dosjes së kërkuar në Gjykatë.

17. Më 10 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Hyrje

18. Parashtruesit e kërkesës kishin aplikuar në një konkurs të shpallur nga Ministria e Shëndetësisë për "Inspektor Shëndetësor". Ata ishin përzgjedhur si kandidatë të suksesshëm nga Komisioni Rekrutues i

Ministrisë së Shëndetësisë dhe për rrjedhojë kishin nënshkruan akt-emërimet përkatëse dhe kishin filluar marrëdhënien e punës me Ministrinë e Shëndetësisë. Kandidatët e pasuksesshëm në atë konkurs fillimisht kishin ushtruar ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe më pas, edhe në KPMSHCK. Ky i fundit i kishte miratuar ankesat e tyre dhe kishte anuluar në tërësi konkursin në fjalë dhe përzgjedhjen e parashtruesve të kërkesës si kandidatë fitues. Kundër vendimeve të KPMSHCK-së, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar konflikt administrativ mbi të cilën padi kishin vendosur gjykatat e rregullta. Gjykata Themelore e kishte refuzuar padinë e tyre si të pabazuar; Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e tyre po ashtu si të pabazuar; dhe, së fundmi, edhe Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e tyre për rishqyrtim të jashtëzakonshëm si të pabazuar. Nga e gjithë kjo përmbledhje hyrëse e fakteve rezulton që gjykatat e rregullta kanë konsideruar që akt-emërimet e parashtruesve të kërkesës nuk kanë qenë të ligjshme dhe që KPMSHCK ka vendosur drejtë kur ka anuluar rezultatet e konkursit në fjalë. Para Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, duke pretenduar se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenet 31, 49 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

Procedurat e rekrutimit dhe ato të ankesave të zhvilluara brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe para KPMSHCK-së

19. Më 12 shtator 2013, Ministria e Shëndetësisë shpalli konkurs për 5 (pesë) pozita të lira të punës me titull: "Inspektor Shëndetësor".

20. Më 14 nëntor 2013, Komisioni Rekrutues i Ministrisë së Shëndetësisë, i formuar për qëllime të këtij konkursi, paraqiti Raportin Final të Rekomandimit i cili u miratua nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të rekrutimit, Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Udhëheqësi i Personelit, përmes një Njoftimi [pa numër] e shpalli listën përfundimtare të fituesve të këtij konkursi, ku të katër parashtruesit e kësaj kërkese ishin përzgjedhur si kandidatë të suksesshëm të konkursit në fjalë. Në Njoftimin e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë citohej këshilla juridike sipas së cilës: *"Palët e pakënaqura mund të bëjnë ankesë brenda afatit prej 30 ditësh [...]" në* Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për ZKA).

21. Ndërmjet 15 nëntorit 2013 dhe 19 nëntorit 2013, disa kandidatë të pasuksesshëm në konkursin në fjalë, respektivisht, F.V.H., N.K.D., dhe T.J.M., parashtruan ankesat e tyre pranë Komisionit për ZKA.

22. Më 18 dhjetor 2013, Komisioni për ZKA, përmes Vendimit [nr. 05-6834/2] i refuzoi ankesat e kandidatëve të lartpërmendur si të pabazuara dhe la në fuqi vlerësimin e Komisionit Rekrutues të Ministrisë së Shëndetësisë – sipas të cilit parashtruesit e kërkesës ishin përzgjedhur si fitues të konkursit në fjalë.

23. Ndërmjet 19 dhjetorit 2013 dhe 30 dhjetorit 2013, parashtruesit e kërkesës dhe Ministria e Shëndetësisë, në cilësi të punëmarrësit dhe punëdhënësit, nënshkruan akt-emërimet për themelimin e marrëdhënies së punës në cilësinë e "Inspektorit Shëndetësor". Në të gjitha akt-emërimet për të gjithë parashtruesit e kërkesës si datë e fillimit të marrëdhënies së punës figuronte data 5 janar 2014, ndërkohë që kohëzgjatja dhe lloji i emërimit ishte kontratë "pa afat".

24. Që nga data 5 janar 2014, parashtruesit e kërkesës kanë filluar punën e tyre si "Inspektor Shëndetësor".

25. Ndërmjet 16 janarit 2014 dhe 14 shkurtit 2014, kandidatët e pasuksesshëm në konkursin në fjalë [F.V.H.; N.K.D.; dhe T.J.M.] parashtruan ankesa kundër Vendimit të Komisionit për ZKA, në KPMSHCK. Ata kundërshtuan përzgjedhjen e parashtruesve të kërkesës si fitues dhe kërkuan anulimin e konkursit në fjalë.

26. Ndërmjet 28 shkurtit 2014 dhe 10 marsit 2014, KPMSHCK, duke vepruar në bazë të ankesave të kandidatëve të pasuksesshëm për pozitën "Inspektor Shëndetësor", nxori Vendimet [nr. A/02/10/2014; A/02/11/2014; A/02/42/2014] përmes së cilëve anuloi të gjithë procedurën e rekrutimit për "Inspektor Shëndetësor". Arsyet në të cilat bazoheshin vendimet e KPMSHCK-së konsistonin, në mes tjerash, në atë që: (i) *"vazhdimi i konkursit për pozitën Inspektor Shëndetësor është bërë në kundërshtim me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës";* (ii) "*Me rastin e shpalljes së dytë të rekrutimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për pozitën Inspektor Shëndetësor (5 pozita) janë ndryshuar kushtet e konkursit, që është në kundërshtim me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës";* (iii) Arsyetimi i Vendimeve të Komisionit për ZKA nuk i plotësonte kriteret e nevojshme siç parashihet me paragrafin 3 të nenit 86 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (në tekstin e mëtejmë: LPA); (iv) *"përpilimi i testit me shkrim nga Komisioni Përzgjedhës nuk është bërë në* përputhje *me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil"*. Në fund të këtyre vendimeve thuhej që pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ brenda 30 ditësh, por që inicimi i të njëjtës

procedurë nuk e ndalon ekzekutimin e vendimeve të KPMSHCK-së. Kjo e fundit e obligoi Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë që të zbatojë vendimet e KPMSHCK-së brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimeve dhe ta mbajë KPMSHCK-në të informuar për ndërmarrjen e veprimeve drejt zbatimit të këtyre vendimeve.

27. Me 22 prill 2014, Ministria e Shëndetësisë, përmes Vendimit [nr. 112/IV/2014] anuloi procedurat e rekrutimit për pozitat "Inspektor Shëndetësor" në përputhje me Vendimet e lartcekura të KPMSHCK-së. Me atë rast, Ministria e Shëndetësisë revokoi akt-emërimet për të emëruarit në këtë konkurs, përkatësisht parashtruesve e kërkesës dhe këtë gjë e bëri, siç thuhet në vet Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, *"në ekzekutim të vendimeve"* të KPMSHCK-së.

28. Me 29 prill 2014, respektivisht pas revokimit të akt-emërimeve të tyre nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan kësaj të fundit me kërkesë për anulimin e Vendimit të lartcekur me të cilin iu ishin revokuar akt-emërimet e tyre për "Inspektor Shëndetësor". Nga shkresat e lëndës rezulton që Ministria e Shëndetësisë nuk iu është përgjigjur kësaj kërkese të parashtruesve.

29. Me 5 qershor 2014, pasi që Ministria e Shëndetësisë nuk ktheu përgjigje, të gjithë parashtruesit e kërkesës, veç e veç, paraqitën ankesë në KPMSHCK ku edhe kërkuan anulimin e Vendimit [nr. 112/IV/2014] të 22 prillit 2014 të Ministrisë së Shëndetësisë për revokimin e akt-emërimeve të tyre.

30. Ndërmjet 16 qershorit 2014 deri më 20 qershorit 2014, KPMSHCK nxori Vendimet [nr. A/02/237/2014; A/02/238/2014; A/02/240/2014; dhe A/02/239/2014] përmes së cilave refuzoi, veç e veç, të gjitha ankesat e parashtruesve të kërkesës si të pabazuara. Në arsyetimin e vendimeve të KPMSHCK-së për të gjithë parashtruesit e kërkesës, ndër të tjerash, u theksua se: *"[...] Ministria e Shëndetësisë, edhe pse ka qenë në dijeni që procedura për rekrutim është atakuar me ankesë nga kandidatët konkurrent të pakënaqur* [F.V.H., N.K.D., dhe T.J.M.] *me përzgjedhjen e kandidatëve fitues, me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës nuk ka respektuar nenin 80 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku qartë është përcaktuar se: "Të gjitha efektet e veprimeve administrative kundër të cilave është paraqitur ankesë ose të cilat janë në shqyrtim nga organet kompetente për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave pezullohen deri në marrjen e vendimit përfundimtarë"."* Gjithashtu, në vendimet e KPMSHCK-së, për të gjithë parashtruesit, ishte kishte theksuar se *"[...] shkeljet esenciale të*

dispozitave ligjore nga ana e organit të punësimit [Ministrisë së Shëndetësisë] *[...] kanë prodhuar pasoja juridike, kështu që për pasojë ka rrjedhur edhe revokimi i aktit të emërimit [...] i cili është lidhur në mënyrë të jashtëligjshme."* Në fund u theksua se kundër këtyre vendimeve të KPMSHCK-së, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ.

Procedurat në gjykatat e rregullta pas inicimi të konfliktit administrativ nga parashtruesit e kërkesës kundër vendimeve të KPMSHCK-së

31. Me 10 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi për konflikt administrativ kundër vendimeve të KPMSHCK-së, në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për Çështje Administrative, ku kërkuan kthimin e tyre në vendet e punës dhe kompensimin e pagave.

32. Me 9 mars 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A.nr.1144/14] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, të paraqitur kundër vendimeve të KPMSHCK-së, me të cilat iu ishin revokuar akt-emërimet për "Inspektor Shëndetësor". Me atë rast, Gjykata Themelore arsyetoi se KPMSHCK e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e refuzimit të ankesave të tyre si të pabazuara për faktin se *"paditësve* [parashtruesve të kërkesës] *iu ka rënë baza juridike, përkatësisht është anuluar konkursi i datës 12 shtator 2013, me të cilin është themeluar marrëdhënie pune në Ministrinë e Shëndetësisë dhe mbi këtë bazë, në bazë të vlerësimit të Gjykatës Themelore organi i punësimit – Ministria e Shëndetësisë, drejtë ka vendosur kur ka anuluar akt-emërimet e paditësve* [parashtruesve të kërkesës]*, duke zbatuar kështu vendimet e të padituës* [KPMSHCK-së]*."*

33. Me 28 prill 2017, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesat e tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të ndryshohet dhe kërkesëpadia e tyre të aprovohet si e bazuar ose i njejti të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

34. Më 20 tetor 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [A.A.nr.244/2017] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore. Ndër të tjera, Gjykata e Apelit e arsyetoi vendimmarrjen e saj duke theksuar që: *"[...] organi i paditur* [KPMSHCK] *në bazë të provave të administruara, i ka vërtetuar në mënyrë të plotë faktet vendimtare në baza ligjore, me refuzimin e ankesave të paditësve dhe lënien në*

fuqi të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë [për anulimin e akt-emërimeve], *sepse me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës së paditësve* [parashtruesve të kërkesës], *Ministria si organ punëdhënës, nuk ka respektuar nenin 80 paragrafi 3 të Ligjit për Shërbimin Civil, ku përcaktohet se të gjitha efektet e veprimeve administrative kundër të cilave është paraqitur ankesë ose janë në shqyrtim nga organet kompetente pezullohen deri në marrjen e vendimit përfundimtarë."* Gjithashtu, Gjykata e Apelit kishte theksuar po ashtu se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe me bazë të drejtë ligjore lidhur me refuzimin e ankesave të parashtruesve të kërkesës *"[...] për shkak se me anulimin e konkursit të organit të paditur – Ministria e Shëndetësisë nga ana e Këshillit* [KPMSHCK-së] *është zhvlerësuar baza juridike në bazë të cilës paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune në Ministrinë e Shëndetësisë, andaj, organi i punësimit drejtë ka vendosur me anulimin e akt emërimeve të paditësve në zbatim të vendimeve të padituës lidhur me anulimin e akt emërimeve të paditësve në zbatim të vendimeve të padituës lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit [...]."*

35. Me 7 dhjetor 2017, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, me propozim që aktgjykimet e dy gjykatave më të ulëta të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës si tërësisht e bazuar.

36. Më 25 janar 2018, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 1/2018] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31, 49 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Pra, parashtruesit pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për (i) "gjykim të drejtë dhe të paanshëm"; (ii) "të drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit" dhe (iii) "kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore".

38. Së pari, lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pohojnë se aktet administrative japin arsye kontradiktore lidhur me anulimin e konkursit dhe revokimin e akt-emërimeve, gjë që, sipas tyre, bie ndesh me paragrafin 1 të nenit 86 [Mënyrat e Arsyetimit] të LPA-së që ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimeve ku parashihet që: *"Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe*

faktike të aktit." Më tutje, parashtruesit po ashtu theksojnë se në të njejtin Ligj parashihet se: *"Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit."*

39. Në këtë kuptim, theksojnë parashtruesit, duke qenë se kemi të bëjë me arsyetim kontradiktor të vendimeve të kontestuara, veçanërisht të arsyetimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, *"mbetet ende e paqartë për paditëset* [parashtruesit e kërkesës] *se cila është arsyeja e anulimit të konkursit dhe revokimit të aktemërimeve të tyre."* Më tutje ata shtrojnë pyetjen se *"A janë arsyet e cekura në vendimet e KPMSHCK-së nr. A/02/11/2014, A/02/2014 dhe A02/10/2014 në të cilat është bazuar vendimi i MSH-së* [Ministrisë së Shëndetësisë] *për anulim të konkursit dhe akt emërimeve apo janë arsyet e dhëna me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme dhe vendimin e KPMSHCK-së si shkallë e dytë ndaj ankesës së paditësve."*

40. Në ndërlidhje me pretendimet për detyrimin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se *"Gjykata Supreme nuk është përgjigjur në asnjë nga pretendimet e palës paditëse* [parashtruesve të kërkesës]*, por është mjaftuar me vetëm një paragraf, ku thotë që* pretendimet *e paditësve ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje[...]."* Si rrjedhojë, parashtruesit pretendojnë se ata kanë ngelur *"pa marr sqarimin se mbi cilën bazë ligjore është ndërprerë marrëdhënia e tyre e punës në Ministrinë e Shëndetësisë, ku siç u theksua më lartë vendimet e organit administrativ dhe vendimet e gjykatave kanë arsyetime të ndryshme dhe janë në kontradiktë me njëri tjetrin. Shkeljet eventuale që ka mund t'i bëj organi administrativ në një procedurë të rekrutimit, ku të punësuarit nuk kanë pasur asnjë ndikim në to, nuk do të duhej të sanksiononte të punësuarit, duke shpirë në ndërprerjen e marrëdhënies së tyre të punës pa asnjë të drejtë."*

41. Së dyti, lidhur me të drejtën në punë dhe ushtrim të profesionit nenin 49 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pohojnë se ndonëse ata kanë filluar punën si "Inspektor Shëndetësor" që nga 5 janari 2014, kur edhe i kanë pranuar akt-emërimet e tyre dhe i kanë kryer detyrat e tyre pa asnjë vërejtje, atyre më pas iu është *"shkëputur një-anshëm"* marrëdhënia e punës. Kjo ndërprerje, sipas pretendimit, e konfirmuar me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme ka rezultuar në shkelje të nenit 49 të Kushtetutës meqë ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim.

42. Tutje në këtë aspekt, parashtruesit theksojnë se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar, ka bërë zbatim të gabuar të drejtës

materiale pasi që ajo e ka mbështetur vendimin e saj në paragrafin 3 të nenin 80 të Ligjit për Shërbimin Civil, ku thuhet se *"Të gjitha efektet e veprimeve administrative kundër të cilave është paraqitur ankesë ose të cilat janë në shqyrtim nga organet kompetente për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave pezullohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar"* – duke qenë se, sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata Supreme *"nuk arsyeton se cila është baza ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në këtë kuptim."* Është vet Ligji për Shërbimin Civil që ka paraparë shprehimisht rastet se kur mund të ndërpritet marrëdhënia e punës e një shërbyesi civil e në rastin konkret asnjëra nga ato rrethana nuk është përmbushur.

43. Së treti, për sa i takon nenit 55 të Kushtetutës me të cilin rregullohet çështja e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, parashtruesit e kërkesës nuk qartësojnë asnjë pretendim por vetëm pretendojnë se neni në fjalë është shkelur.

44. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë Aktgjykim me të cilin:

(i) E shpallë kërkesën të pranueshme;
(ii) Konstaton se ka shkelje të nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], neni 55 [Kufizimin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Kosovës;
(iii) Konstaton që ka shkelje të nenit 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
(iv) E shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr.1/2018] e Gjykatës Supreme; Aktgjykimin [A.A.nr.244/2017] e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [A.nr.1144/14] e Gjykatë Themelore në Prishtinë.

Komentet e Ministrisë së Shëndetësisë

45. Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e palës së interesuar, dorëzoi komente në Gjykatë pas mundësisë që i dha kjo e fundit.

46. Ministria e Shëndetësisë theksoi se pas përfundimit të procedurave të rekrutimit për pesë vende të lira të punës për "Inspektor Shëndetësor", është shpallur lista përfundimtare e kandidatëve të suksesshëm në të cilën bënin pjesë edhe të katër parashtruesit e kësaj kërkese. Më pas, ankesat e disa kandidatëve të pakënaqur me rezultatin e konkursit ishin miratuar dhe si rrjedhojë e gjithë procedura e rekrutimit e

shpallur me 12 shtator 2013 ishte anuluar. Së bashku me të ishin anuluar edhe të gjitha vendimet që kishin rrjedhur nga ajo procedurë.

47. Më tutje, Ministria e Shëndetësisë thekson se ajo ka zbatuar vendimet e KPMSHCK-së dhe më 18 prill 2014 ajo ka nxjerrë Vendim [Nr. 112/IV/2014], përmes të cilit ka anuluar procedurën e rekrutimit të shpallur me 12 shtator 2013 dhe ka revokuar akt-emërimet për të emëruarit nga ky konkurs ku bëjnë pjesë edhe parashtruesit e kërkesës. Këtë gjë, Ministria e Shëndetësisë thekson ta ketë bërë pasi që vendimit e KPMSHCK-së *"janë vendime të formës së prerë dhe të njëjta duhet të ekzekutohen brenda afatit prej 15 ditësh nga ana e personit përgjegjës [...]."*

48. Në fund, Ministria e Shëndetësisë thekson se Gjykata Themelore ka refuzuar kërkesëpaditë e parashtruesve të kërkesës ndërkaq që, në mungesë të Aktgjykimit [ARJ.UZVP. nr. 1/2018] të 25 janarit 2018 të Gjykatës Supreme ajo *"nuk ka mundur të komentoj Aktgjykimin në fjalë."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

49. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

51. Në vazhdim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. *"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje*

juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor."

52. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara të cilët kontestojnë akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin [ARJ.UZV.nr.1/2018] e 25 janarit 2018 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Lidhur me të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 49 të Kushtetutës. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës i kanë sqaruar pretendimet e tyre për ato të drejta dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur përmes vendimeve gjyqësore, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit. Ata gjithashtu, e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

53. Ndërkaq, për sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 55 të Kushtetutës ku rregullohet çështja e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë argument se si kjo dispozitë kushtetuese është shkelur nga autoritetet publike. Ata thjeshtë e kanë cekur këtë nen dhe kanë kërkuar nga Gjykata që të gjejë shkelje të këtij neni.

54. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që vetëm citimi i një neni të Kushtetutës nuk mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor që rrjedh nga neni 48 i Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës ku kërkohet nga parashtruesit e kërkesës të qartësojnë "*saktësisht dhe në mënyrë*

adekuate [...] pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese." Andaj dhe rrjedhimisht, në linjë me praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, kjo e fundit, pretendimin e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 55 të Kushtetutës nuk do e trajtojë më tutje duke qenë se parashtruesit e kërkesës nuk kanë qartësuar saktësisht pretendimin e tyre për shkeljen e kësaj dispozite kushtetuese (shih, në këtë aspekt, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI02/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë]*, paragrafët 40-41).

55. Më tutje, lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe ato për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata duhet të shqyrtojë gjithashtu nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

56. Lidhur me këto procedura të zhvilluara para gjykatave të rregullta, parashtruesit e kërkesës, në thelb, ankohen se në rastin e tyre:

> (i) Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit i kanë shkelur atyre të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket detyrimit për arsyetim të vendimeve gjyqësore, duke mos ofruar arsyetim të mjaftueshëm e që ka rezultuar, sipas pretendimit, në ngeljen akoma të paqartë të faktit se përse është anuluar konkursi në fjalë; dhe
> (ii) gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtën e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës duke lejuar shkëputjen e njëanshme të marrëdhënies së punës të formuar në mes tyre dhe Ministrisë së Shëndetësisë përmes akt-emërimeve përkatëse.

Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ për sa i përket arsyetimit të vendimeve gjyqësore

57. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, ku ata kryesisht theksojnë se Gjykata Supreme dhe e Apelit nuk i ka arsyetuar mjaftueshem vendimet e tyre dhe për rrjedhojë ata akoma nuk e dinë arsyen e anulimit të konkursit

në fjalë. Kjo gjë, sipas pretendimit, ka shkelur të drejtën e tyre për vendim të arsyetuar gjyqësor. Ata po ashtu theksojnë se Gjykata Supreme nuk ka qartësuar bazën ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

58. Në dritë të këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ua kishte refuzuar ankesën e tyre të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe më pas Gjykata Supreme ua kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Sipas kësaj Gjykate, të dyja gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe praktikën gjyqësore të vet kësaj Gjykate. Të dyja këto gjykata të rregullta arsyetimin e të cilit parashtruesit e kërkesës e kontestojnë për pamjaftueshmëri ishin përgjigjur në mënyrë të qartë se përse kanë konfirmuar Vendimet e KPMSHCK-së për anulim të konkursit në fjalë. Andaj, edhe kjo Gjykatë konsideron se nuk qëndron pretendimi i parashtrueseve të kërkesës se ata akoma nuk e kanë të qartë se *"përse është anuluar konkursi"*.

59. Më konkretisht, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, lidhur me arsyen e anulimit të konkursit kishte theksuar se *"[...] me anulimin e konkursit të organit të paditur – Ministria e Shëndetësisë nga ana e Këshillit* [KPMSHCK-së] *është zhvlerësuar baza juridike në bazë të cilës paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune në Ministrinë e Shëndetësisë, andaj, organi i punësimit drejtë ka vendosur me anulimin e akt emërimeve të paditësve në zbatim të vendimeve të padituës lidhur me anulimin e akt emërimeve të paditësve në zbatim të vendimeve të padituës lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit[...]."*

60. Më tutje, edhe Gjykata Supreme e kishte arsyetuar vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe rrjedhimisht e kishte konfirmuar atë plotësisht duke dhënë arsyetim edhe për aplikimin e ligjit material e edhe për ligjshmërinë e anulimit të konkursit dhe akt-emërimeve të parashtruesve të kërkesës. Arsyetimi relevant i Gjykatës Supreme në këtë drejtim lexon si në vijim:

> *"Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshi me shkelje esenciale siç pretendon paditësi në kërkesë.*

Neni 80.3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës parashikon që të gjitha efektet e veprimeve administrative kundër të cilave është paraqitur ankesë ose të cilat janë në shqyrtim nga organet kompetente për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave pezullohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Është vërtetuar se paditësve [parashtruesve të kërkesës] *me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë u janë revokuar akt-emërimet për pozitat "Inspektor Shëndetësor", për shkak të anulimi të Konkursit [...] dhe shkeljeve të Rregullores nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, andaj sipas vlerësimit të gjykatës, Ministria e Shëndetësisë drejtë ka vepruar duke zbatuar vendimet e të padituri [KPMSHCK] [...].*

Në këtë kuptim, kjo Gjykatë ka konstatuar se gjykatat e instancës më të ultë drejtë kanë vendosur kur kanë refuzuar si të pabazuara ankesën e paditësve [parashtruesve të kërkesës] lidhur me anulimin e vendimit të padituresh MSH [...] pasi që organi administrativ gjatë procedurës së përsëritur ka revokuar aktet e emërimit, e që janë konstatuar nga ama e KMP[...] se janë lidhur në mënyrë të kundërligjshme e në kundërshtim me nenin 36 të Rregullores nr. 02/2010 dhe me nenin 80/2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil."

61. Në fund, Gjykata Supreme po ashtu theksoi se Aktgjykimi i atakuar i Gjykatës së Apelit *"është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsyet e mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme"* dhe Gjykata e Apelit, sipas Gjykatës Supreme ka bërë aplikim *"të drejtë të drejtës materiale"* dhe *"ligji nuk është shkelur në dëm të paditësve* [parashtruesve të kërkesës]."

62. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, refuzimin e një kërkese për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët, në këtë rast Gjykatës së Apelit (shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, Raportet 1997-VIII, paragrafët 59-60).

63. Ngjashëm dhe në po këtë linjë arsyetimi, Gjykata po ashtu rikujton se rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë apo e apelit konfirmon vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të

Gjykatës Themelore – me të cilat është refuzuar padia për konflikt administrativ e parashtruesve të kërkesës - por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme në mënyrë të drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike dhe vendimmarrja në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore ishte në përputhje me të drejtën materiale dhe procedurale për sa i përket anulimit të një konkursi sipas rregullave të shërbimit civil në Republikën e Kosovës. Pra, Gjykata Supreme ka konfirmuar plotësisht se anulimi i konkursit në fjalë është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe se me rastin e refuzimit të ankesave të parashtruesve të kërkesës KPMSHCK-ja kishte vendosur drejtë kur kishte anuluar konkursin dhe kur kishte miratuar Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë për revokim të akt-emërimeve të parashtruesve të kërkesës.

64. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në çdo pikë të ngritur nga parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtrueseve të kërkesës për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale dhe shkeljes së mundshme siç ishte pretenduar nga parashtruesit e kërkesës (shih, *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Duke vepruar kështu, Gjykata Supreme e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe të vet kësaj Gjykate.

65. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dështmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në Gjykatën e Apelit kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës materiale apo procedurale. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, interpretimi i ligjit, material dhe procedural, është detyrë primare e gjykatave të rregullta dhe, si e tillë, është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës, KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).

66. Pakënaqësia e parashtruesve të kërkesës me rezultatin e procedurave para gjykatave të rregullta, dhe para organeve administrative, përkatësisht në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, e edhe para Ministrisë së Shëndetësisë dhe KPMSHCK-së, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër* Hungarisë, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

67. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre se procedurat përkatëse për anulimin e konkursit në fjalë në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

68. Gjykata po ashtu konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës ngrisin çështje të ligjshmërisë, meqë të njëjtat kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave ligjore dhe me vlerësimin e provave në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës do të duheshin të vazhdonin punën si "Inspektor Shëndetësor" dhe të mos revokoheshin emërimet e tyre – siç pretendojnë ata *"njëanshëm"* nga Ministria e Shëndetësisë. Gjykata rikujton se të tilla pretendime i përkasin fushës së ligjshmërisë dhe nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata.

69. Siç edhe është e ditur nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, nuk është detyrë e kësaj të fundit që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

70. Andaj, si rezultat, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese për sa i përket nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 49 të Kushtetutës

71. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës ku ata kryesisht theksojnë se shkëputja e njëanshme e kontratës së punës dhe revokimi i akt-emërimeve të tyre nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ka rezultuar në shkelje të së drejtës së tyre "në punë dhe ushtrim të profesionit".

72. Gjykata rikujton se në kuptimin e kësaj të drejte konkrete, neni 49 i Kushtetutës përkufizon një standard që përcakton garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI46/15, parashtrues *Zejna Qosaj,* Aktvendim për Papranueshmëri i 20 tetorit 2015, paragrafi 26; KI70/17, parashtrues *Rrahim Ramadani*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 majit 2018, paragrafi 48; dhe KI140/17, parashtruese *Merita Dervishi,* Aktvendim për Papranueshmëri i 28 majit 2019, paragrafët 65-68).

73. Gjykata thekson se pretendimi i parashtrueseve të kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në rastin konkret, nuk kanë të bëjë me mohimin e të drejtës në punë dhe ushtrim të profesionit, sipas kuptimit të nenit 49 të Kushtetutës.

74. Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk i ndalon parashtruesit e kërkesës të punojnë ose të ushtrojnë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimet e parashtruesve të kërkesës që do të arsyetonte konkludimin se janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës (shih, *ndër të tjera,* rastet e Gjykatës: KI136/14, parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 34; KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj,* Aktvendimi për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 53; si dhe KI140/17, parashtruese *Merita Dervishi,* cituar më lart, paragrafi 68).

75. Gjykata vëren se në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit theksohet që me anulimin e konkursit për pozitat "Inspektor Shëndetësor", është zhvlerësuar baza juridike në bazë të së cilës parashtruesit e kërkesës kanë themeluar marrëdhënie punë në Ministrinë e Shëndetësisë, rrjedhimisht ka rënë poshtë baza e themelimit të marrëdhënies së tyre të punës. Gjithashtu, Gjykata po ashtu vëren se edhe Gjykata Supreme, siç u citua më lart, ka adresuar arsyet në bazë të së cilave janë hedhur poshtë pretendimet e parashtruesve të kërkesës kur është konkluduar se është bërë aplikimi i drejtë i të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të parashtruesve të kërkesës.

76. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe në pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nuk gjen të jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesve të kërkesës përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme që ata kontestojnë në Gjykatë, e as përmes vendimeve të tjera të gjykatave të rregullta.

77. Si rezultat, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese edhe për sa i përket nenit 49 të Kushtetutës, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përmbledhje

78. Gjykata, si përfundim vendos që:

(i) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ përkitazi me arsyetim të vendimeve gjyqësore janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;

(ii) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës përkitazi me të drejtën në punë dhe ushtrim të profesionit janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe si të tilla duhet të refuzohen si të papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës;

(iii) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 55 të Kushtetutës për sa i çështjes së kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nuk janë të qartësuara në mënyrë adekuate dhe si të tilla duhet të refuzohen në bazë të nenit 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (d) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

V. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VII. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin
20.4 të Ligjit; dhe

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI96/19, Parashtrues: Đeljalj Kazagić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pzd. nr. 820/2019, të 5 shkurtit 2019

KI96/19 Aktvendim për papranueshmëri, miratuar më 8 tetor 2019, publikuar më 31 tetor 2019

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë, ratione materiae, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesat e tij për zbutje te jashtëzakonshme te dënimit, kanë bërë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, me pretendimin se atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e Gjykatës së Apelit.

Gjykata, pasi vlerësoi rastin në tërësi, erdhi në përfundim se neni 31 i Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6 të Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal, sepse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij gjatë kësaj procedure, nuk është akuzuar për vepër penale brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Për këtë arsye, Gjykata konsideroi se pretendimet e parashtruesit në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për zbutje te jashtëzakonshme të dënimit nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, për shkak se neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës nuk zbatohen. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI96/19

Parashtrues

Đeljalj Kazagić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PZD. nr. 820/2019, të 5 shkurtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Đeljalj Kazagić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Mitrovicë, i cili aktualisht ndodhet në vuajte të dënimit me burg.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PZD.nr.820/2019 të 5 shkurtit 2019 (në tekstin e mëtejmë: aktvendimi i kontestuar), i cili i është dorëzuar atij më 5 shtator 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës

pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 17 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).

7. Më 5 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kësaj kërkese ia dërgoi Gjykatës Supreme, në pajtim me ligjin.

8. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës për herë të katërt parashtron kërkesë në Gjykatë.

Faktet në lidhje me kërkesën e parë, KI82/16

10. Më 24 maj 2016, parashtruesi i kërkesës e parashtroi në Gjykatë kërkesën KI82/16, me të cilën kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme, Pml.nr.13/2016, të 13 nëntorit 2016,

me të cilin pretendonte se i ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues në rastet Penale], 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale] të Kushtetutës.

11. Më vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat i kontestonte, parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me dënim unik, në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgimi.

12. Më 1 mars 2017, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, me të cilin kërkesa e parashtruesit u deklarua qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, për shkak se i njëjti nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Faktet përkitazi me kërkesën e dytë, KI50/18

13. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën KI50/2018, me të cilën kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 110/2017, të 13 nëntorit 2017, duke pretenduar se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesat e tij për rishikim të procedurës penale, kanë bërë shkelje të nenit 30 [Të drejtat e të akuzuarit], paragrafin 3 të Kushtetutës, "*për shkak të mohimit të së drejtës për të siguruar mbrojtjen e tij dhe mundësisë për t'i kundërshtuar deklaratat e dëshmitarëve dhe provat në ngarkim të tij*", si dhe shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë], paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës, me pretendimin se *"atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e Dhomës së Gjykatës së Apelit"*.

14. Më 16 janar 2019, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri, pasi konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, duke qenë se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, nuk zbatohen në të tilla raste.

Faktet përkitazi me kërkesën e tretë, KI186/18

15. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI186/2018, me të cilën kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 168/201, të 3 gushtit 2018, me pretendimin se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesat e tij për

rishikim të procedurës penale, kanë bërë shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë] të Kushtetutës, për shkak se atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e shqyrtimit të Gjykatës së Apelit.

16. Më 8 maj 2019, pasi vlerësoi rrethanat e rastit, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, dhe konkludoi se neni 6 i Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal. Për këtë arsye, Gjykata konsideroi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale, si të tilla, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës është e papranueshme.

Faktet përkitazi me kërkesën e tanishme, KI96/19

17. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin P.nr. 42/14, parashtruesin e kërkesës e kishte shpallur fajtor për kryerjen e disa veprave penale dhe e kishte dënuar atë me burgim unik në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) vjetësh.

18. Më 7 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e apeloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, P.nr. 42/14 të 12 shkurtit 2015, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi masën e dënimit.

19. Më 7 shtator 2015, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktgjykimin PAKR. nr. 220/15, e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me vendimin për dënimin, duke e ndryshuar masën e dënimit me burgim nga 14 (katërmbëdhjetë) vjet në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burg. Në pjesët tjera Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë mbeti i pandryshuar.

20. Më 27 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimeve të mësipërme, ushtroi kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar në rrethana lehtësuese të cilat nuk u konsideruan nga gjykatat e rregullta përgjatë shqyrtimit kryesor.

21. Më 5 shkurt 2019, Gjykata Supreme me Aktvendimin Pzd.nr.8/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me arsyetimin se i njëjti e kishte ushtruar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit pa ndonjë

propozim konkret dhe se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës në fjalë konform dispozitës së nenit 431 par. 6 të KPPK.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktvendimin e kontestuar, shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, për shkak se nuk i mori parasysh faktet dhe rrethanat lehtësuese për zbutje të dënimit.

23. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se, "*Gjykata Supreme e Kosovës, me vendimin e saj Pzd.nr.8/2019 të datës 05.02.2019..., në mënyrë shumë të vrazhdët dhe jonjerëzore, të pashembullt dhe më brutale i ka shkelur "Të drejtat njerëzore dhe liritë" e mia të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës..."*

24. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se, *"Siç shihet në Vendimin e Gjykatës Supreme, nuk është respektuar asnjë rrethanë e vetme me arsyetimin se në Kërkesë nuk janë përshkruar- theksuar rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën kur aktgjykimi është sjellë apo për të cilat gjykata nuk ka pasur dijeni, ndërsa e len jashtë pjesën kruciale të dispozitës ligjore edhe pse kanë ekzistuar, të cilat do të sillnin deri tek dënimi më i butë, dhe kështu e refuzon të tërë kërkesën si të pabazë."*

25. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që, "*1. Të anuloj Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pzd. nr. 8/2019 të datës 05.02.2019 me të cilin është refuzuar kërkesa e ime për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe që i njëjti t'i kthehet Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim të serishëm dhe rivendosje për shkak të shkeljeve të përshkruara në detaje të dispozitave kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut për "Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm", apo: 2. Të ndryshoj Aktgjykimin e prerë të Gjykatës së Apelit: PAKR nr.230/15 të datës 07.09.2015 me të cilin jam shpallur fajtor për katër(4) vepra penale, ashtu që së paku në mënyrë simbolike dënimin e shqiptuar, në bazë të rrethanave të paraqitura në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, unik prej 11 viteve burgim ta zvogëloj së paku për një(1) vjet, në lidhje me cilëndo vepër penale, dhe të shqiptoj dënimin e ri unik për të katër veprat penale për të cilat jam shpallur fajtor, në zgjatje të përgjithshme prej dhjetë(10) viteve burgim. [...]."*

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]

28. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike në dispozicion; e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe të drejtat kushtetuese që pretendon se i janë cenuar, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë.

30. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullore dhe për rastin konkret i referohet nënrregullit (3) (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:

"(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[…]
(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
[…]."

31. Gjykata, në këtë rast, nuk do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës të cilat ishin objekt i vlerësimit nga Gjykata në vendimet KI82/16, KI50/18 dhe KI86/18. Gjykata në rastin konkret do të vlerësojë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të kontestuar Pzd.nr.8/2019 të Gjykatës Supreme, të 5 shkurti 2019, më të cilin kjo e fundit vendosi lidhur me kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet dhe pretendon se Aktvendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me neni 6 të Konventës, për arsye se Gjykata Supreme nuk i mori parasysh rrethanat lehtësuese, sipas të cilave parashtruesit do i mundësohej zbutja e dënimit.

33. Në këtë kontekst, Gjykata verën se përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës "për zbutje të jashtëzakonshëm të dënimit" Gjykata Supreme vlerësoi vetëm aspektet procedurale, përkatësisht lejueshmërinë e kërkesës, pa e prekur substancën e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 220/15 të 7 shtatorit 2015, me të cilin

parashtruesit i ishte ulur masa e dënimit nga 14 (katërmbëdhjetë) vjet në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burg.

34. Gjykata, para se të shqyrtojë kërkesën konkrete, rikujton se, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

35. Në këtë kuptim, Gjykata, duke iu referuar praktikes gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rikujton se neni 6 i Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti, nëse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe ai ose ajo gjatë kësaj procedure nuk është "akuzuar për ndonjë vepër penale" brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës (shih rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë,* ankesa nr. 27569/02, vendimi, i 6 majit 2003).

36. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ushtruar në Gjykatën Supreme, në fakt kërkon rihapjen e procedurave të përfunduara me vendim të plotfuqishëm, sa i përket vendimit për dënimin. Megjithatë, siç mund të vërehet nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Supreme, kjo e fundit refuzoi si të pabazuar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, pasi erdhi në përfundim se e njëjta nuk i përmbushte kushtet ligjore, për rihapjen ose ndryshimin e vendimit të fuqisë së prerë, sa i përket vendimit për dënimin.

37. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në të gjitha rastet kur nëpërmjet mjeteve të jashtëzakonshme është kërkuar rishikimi ose përsëritja e procedurave të përfunduara (civile, penale, përmbarimore) me vendime të plotfuqishme, kur gjykatat e rregullta janë marrë vetëm me kriteret e lejueshmërisë së kërkesave e jo me meritat e çështjes, Gjykata, në pajtueshmëri me jurisprudencën e GJEDNj-së, ka konstatuar se neni 31 i Kushtetutës ne lidhje me nenin 6 të Konventës nuk është i zbatueshëm (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, *Sabri Ferati,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, *Rrahim Hoxha,* Aktvendim për papranueshmëri i 27 dhjetorit 2016, dhe KI07/17, *Pashk Mirashi,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017).

38. Prandaj, edhe kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, sikurse kërkesat për rishikim dhe përsëritje të procedurave të përfunduara, bie në kategorinë e kërkesave që janë të papajtueshme

ratione materiae me Kushtetutën, për shkak të pazbatueshmërisë së nenit 31 të Kushtetutës, kur ky i fundit interpretohet në dritën e nenit 6 të Konventës.

39. Për më tepër, mjetet juridike të jashtëzakonshme me të cilat kërkohet zbutje e jashtëzakonshme e dënimit zakonisht nuk implikojnë vërtetimin e "të drejtave dhe obligimeve civile" apo bazueshmërinë e "çfarëdo akuze penale", dhe rrjedhimisht neni 6 nuk zbatohet për ta (shih, inter alia, *X kundër Austrisë*, numër 7761/77, Vendimi i Komisionit i 8 majit 1978, *D. R.* 14, f. 171, *Zawadzki kundër Polonisë,* vendimi numër 34158/96 i 6 korrikut 1999, *Hurter kundër Zvicrës,* vendimi numër 4811/07 i 15 majit 2012, *Dybeku kundër Shqipërisë,* vendimi numër 557/12, paragrafi 30, i 11 marsit 2014).

40. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkese me Kushtetutë rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. Të drejtat, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, duhet të mbrohen me Kushtetutë në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI07/17, me parashtrues *Pashk Mirashi,* Aktvendimi për papranueshmëri i 29 majit 2017, paragrafi 66).

41. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe siç parashihen me Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, andaj si e tillë, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (3) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi.

KI78/19, Parashtrues i kërkesës: Miodrag Pavić, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 270/2018 të Gjykatës Supreme të 18 dhjetorit 2018

KI78/19, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, i publikuar më 1 nëntor 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Supreme, qartazi i pabazuar*

Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03 / L-121 dhe Rregullin 32 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese.
Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në Gjykatë për herë të dytë, në kërkesën e parë parashtruesi i kërkesës pretendoi që Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e shkallës së parë pa e njoftuar atë. Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë e mbrojtur me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi që parashtruesi i kërkesës, si i pandehur, nuk ishte informuar për seancën e Gjykatës së Apelit dhe kësisoj atij iu mohua e drejta e tij për të paraqitur argumentet e tij. Kjo kërkesë ishte regjistruar me numrin KI 104/16.
Në lëndën KI 104 16, Gjykata konkludoi që duke mos e ftuar parashtruesin e kërkesës të ishte i pranishëm në seancën e Gjykatës së Apelit në të cilën u konstatua faji i tij, parashtruesit të kërkesës iu mohua mundësia që të mbrohej kundër akuzave që ishin ngritur kundër tij. Si pasojë, Gjykata konstaton se e drejta e kërkuesit për një gjykim të drejtë është shkelur dhe, në përputhje me këtë, e urdhëron Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit të rishikojnë vendimet në përputhje me rekomandimin e Gjykatës.
Duke vepruar në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese KI104 / 16, Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 110/2016 e përsëriti procedurën në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, e miratoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe e anuloi aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015] të Gjykatës Supreme të datës 1 dhjetor 2015 dhe Aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015] të Gjykatës së Apelit të datës 15 korrik 2015 dhe ia ktheu çështjen Gjykatës së Apelit për rishqyrtim, duke e urdhëruar Gjykatën e Apelit që në procedurën e përsëritur ta ftojë parashtruesin që të marrë pjesë në seancë.
Duke vepruar në përputhje me vendimin e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit e përsëriti procedurën dhe mbajti një seancë të trupit gjykues për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Në seancën e trupit gjykues, parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij u ftuan sipas rregullit dhe në përputhje me rekomandimin e Gjykatës Supreme. Ditën e njëjtë, Gjykata e Apelit e solli aktgjykimin e saj [PAKR. nr. 521/2017], me të cilin e miratoi ankesën e Prokurorisë dhe e ndryshoi aktgjykimin [K. nr. 82-2013] të Gjykatës

Themelore të datës 29 janar 2015. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi atë me një vit burgim.
Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës deklaron para gjykatës se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI104/16 nuk është zbatuar, se gjykata e shkallës së dytë ka qenë e detyruar të caktojë-zhvillojë një seancë gjyqësore dhe të informojë palët në procedurë dhe se gjykatat e rregullta e shkelën ligjin procedural dhe material.
Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit e kanë eliminuar shkeljen e përmendur procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një gjykim të drejtë] të KEDNJ-së, dhe me këtë e ka respektuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI104/16, prandaj gjykata konkludon se pretendimet e kërkuesit në lidhje me shpërfilljen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese janë qartazi të pabazuara mbi baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme.
Gjykata gjithashtu vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit, në procedurën e përsëritur e solli vendimin e saj pa e ftuar parashtruesin e kërkesës dhe mbrojtësin e tij ishin qartazi të pabazuara mbi baza kushtetuese dhe se duhet të deklarohen të papranueshme.
Si përmbledhje, Gjykata konkludon se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se parashtruesit të njejtat nuk janë arsyetuar fare nga parashtruesi i kërkesës dhe se parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon se cilat fakte vendimtare përmbajnë kontradikta, ai vetëm konkludon se ka ardhur deri tek zbatimi i gabuar i ligjit procedural dhe material.
Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është qartazi e pabazuar mbi baza kushtetuese, prandaj duhet të deklarohet e papranueshme në tërësinë e saj, bazuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI78/19

Parashtrues

Miodrag Pavić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 270/2018 të 18 dhjetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Miodrag Pavić nga fshati Koretishtë, Komuna e Novobërdës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. nr. 270/2018 të 18 dhjetorit 2018, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PA-II. nr. 6/2015 të 7 majit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 521/2017 të 12 dhjetorit 2017.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 janar 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës to garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 maj 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 23 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 17 qershor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren të dorëzojë një kopje të vërtetimit për pranimin e aktgjykimit të kontestuar (Pml. nr. 270/2018 të Gjykatës Supreme të 18 dhjetorit 2018) nga ana e parashtruesit të kërkesës.

9. Më 24 qershor 2019, Gjykata Themelore në Prizren dorëzoi në Gjykatë vërtetimin për pranimin e aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës, me datën e dorëzimit 25 janar 2019.

10. Më 8 tetor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi parashtron kërkesë për herë të dytë në Gjykatë.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parë KI104/16

12. Më 9 nëntor 2012, Prokuroria Themelore në Prizren parashtroi propozim akuzë në Gjykatën Themelore në Prizren kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit.

13. Më 29 janar 2015, Gjykata Themelore mori Aktgjykimin [K. nr. 82-2013], me të cilin e liroi parashtruesin e kërkesës nga propozim akuza për shkak të mungesës së dëshmive.

14. Prokuroria parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë çështjen në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit, ka dorëzuar përgjigje ndaj ankesës së Prokurorisë.

15. Më 15 korrik 2015, Gjykata e Apelit mbajti seancën për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Bazuar në pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe shkresat e lëndës, rezulton se në pajtim me nenin 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), parashtruesi i kërkesës nuk ishte informuar për seancën e Gjykatës së Apelit.

16. Gjatë seancës së 15 korrikut 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015], me të cilin aprovoi ankesën e Prokurorisë dhe ndryshoi Aktgjykimin [K. nr. 82-2013] të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej një viti.

17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015], parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme duke pretenduar, *inter alia*, se Gjykata e Apelit mbajti seancë në të cilën ai u shpall fajtor, pa e njoftuar parashtruesin në lidhje me seancën, dhe kështu nxori vendim në shkelje të KPPK-së.

18. Më 1 dhjetor 2015, Gjykata Supreme mori Aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

19. Parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

[PAKR. nr. 222/2015] dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015].

20. Më 16 maj 2016, Gjykata Supreme mori Aktgjykimin [PML-KZZ nr. 110/2016], me të cilin e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.

21. Më 9 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke pretenduar se Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e shkallës së parë pa e njoftuar atë. Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të mbrojtur me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, pasi që parashtruesi i kërkesës, si i paditur, nuk ishte njoftuar për seancën e Gjykatës së Apelit dhe kështu atij iu mohua e drejta e tij për të paraqitur argumentet e tij. Kjo kërkesë është regjistruar me numër KI 104/16.

22. Më 29 maj 2017, Gjykata nxori aktgjykimin e saj, duke gjetur se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kishin shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata e shpalli të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML-KZZ nr. 110/2016] të 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015 dhe e ktheu rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës.

23. Gjykata konkludoi që duke mos e ftuar parashtruesin e kërkesës të jetë i pranishëm në seancën e Gjykatës së Apelit në të cilën ishte vërtetuar faji i tij, parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar mundësia që të mbrohej ndaj akuzave të ngritura kundër ndaj tij. Si pasojë, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe, në pajtim me këtë, urdhëron Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit të rishikojnë vendimet në përputhje me rekomandimin e Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e tanishme KI78/19

24. Më 9 tetor 2017, duke vepruar në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI104/16, Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 110/2016 përsëriti procedurën në lidhje me kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, aprovoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe prishi aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015] e Gjykatës Supreme të 1 dhjetorit 2015 dhe aktgjykimin [PAKR. nr.

222/2015] e Gjykatës së Apelit të 15 korrikut 2015 dhe ktheu rastin në Gjykatën e Apelit për rivendosje, duke urdhëruar Gjykatën e Apelit që në procedurën e përsëritur ta ftojë parashtruesin e kërkesës në seancë.

25. Më 12 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit përsëriti procedurën dhe mbajti seancën e kolegjit për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Paditësi dhe mbrojtësi i tij u thirrën në mënyrë të rregullt në seancën e trupit gjykues, në përputhje me rekomandimin e Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin [PAKR. nr. 521/2017], me të cilin e aprovoi ankesën e Prokurorisë dhe prishi aktgjykimin [K. nr. 82-2013] e Gjykatës Themelore të 29 janarit 2015. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi me një vit burg.

26. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 521/2017] duke pretenduar, ”*shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së të drejtës penale dhe vendimit mbi sanksionin penal.*”

27. Më 7 maj 2018, Gjykata Supreme nxori aktgjykimin [PA-II. nr. 1/2018], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

28. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 521/2017] dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015].

29. Më 18 dhjetor 2018, Gjykata Supreme nxori aktgjykimin [PML nr. 270/2018], me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

30. Në pjesën përkatëse të arsyetimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme theksohet se, *“I pabazuar është pretendimi që gjykata e shkallës së dytë ka marrë aktgjykimin e saj pa shqyrtim duke pasur parasysh që nga shkresat e lëndës, dmth. nga shikimi në procesverbal nga dëgjimi publik të Gjykatës së apelit të mbajtur më 12.12.2017, mund të përfundohet që në seancë ka marrë pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij [...].Gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë pa marrë parasysh propozimin ankimor duke miratuar bazën ankimore të ligjit penal edhe pse propozim i tillë nuk është dhënë në mënyrë eksplicite. [...] pretendimi i cili ka të bëjë me mosrespektimin e nenit 6.3 të KEDNJ-së, duke marrë parasysh të drejtat e të akuzuarit të respektuara në përputhje me standardet e parashikuar me nenin e përmendur, dhe*

që të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij i është mundësuar të jenë pjesë aktive e të gjithë procedurës gjyqësore, duke filluar nga veprimet hetimore e deri tek mjetet juridike. Në bazë të rrjedhës së seancë gjyqësore dhe procesverbalit, mund të konstatohet që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi të barabarta në raport me Prokurorin e shtetit kur është fjala për shqyrtimin e provave të dëshmitarëve".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në procedurën e përsëritur në gjykatat e rregullta janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

32. Parashtruesi i kërkesës arsyeton se në procedurën e përsëritur aktgjykimi PAKR. nr. 521/2017 i Gjykatës së Apelit, "*siç është përshkruar në tërësi nga aktgjykimi paraprak i parë i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 222/2015 i 15.07.2015, i cili nga ana e Gjykatës kushtetuese të Kosovës, me aktgjykimin e Rastit nr. KI104/16 të 04.08.2017, është shpallur i PAVLEFSHËM*".

33. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se, "*gjykata e shkallës së dytë ka marrë aktgjykim në kundërshtim me nenin 403 par. 1 i LPP-së së RK-së, sepse për ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka qenë e obliguar të caktojë – mbajë shqyrtim gjyqësor dhe me këtë të lajmërojë palët në procedurë në mënyrë që në mënyrë të duhur të vërtetohen/vlerësohen provat materiale.*"

34. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se, "*Në kuptim të dispozitave nga neni 382 par. 2 i LPP-së, prokurori i shtetit ka propozuar që me ankesën e miratuar të anulohet aktgjykimi lirues i gjykatës së shkallës së parë në procedurën e përsëritur, e gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim në lidhje me propozimin e lartpërmendur të prokurorit dhe aktgjykimin e anuluar e ka ndryshuar, derisa të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar.*"

35. Parashtruesi i kërkesës në fund pretendon se, në pajtim me nenin 384 par. 1 pika 1 dhe 12 të LPP-së "*aktgjykimet e anuluara të gjykatës së shkallës së dytë dhe të Gjykatës Supreme, janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse nuk janë paraqitur – treguar arsyet për provat vendimtare dhe për provat vendimtare ekzistojnë kundërthënie të konsiderueshme.*"

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

38. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet, nenit 47 [Kërkesa Individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

39. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion; se ka saktësuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe se e ka parashtruar kërkesën brenda afatit kohor.

40. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

„(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij ".

41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, por nuk i arsyetojnë të njëjtat.

42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në thelb janë i) që nuk është zbatuar aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI104/16; ii) që gjykata e shkallës së dytë ka qenë e obliguar të caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe për këtë t'i njoftojë palët në procedurë; dhe iii) që gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën procedurale dhe materiale sepse *„nuk janë paraqitur – treguar arsyet për provat vendimtare dhe për provat vendimtare ekzistojnë kundërthënie të konsiderueshme ".*

(i) Sa i përket pretendimeve se nuk është zbatuar aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI104/16

43. Në lidhje me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se pretendimet ankimore për shkelje të të drejtave kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit zbatuan vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI104/16 të 4 gushtit 2017.

44. Duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës, Gjykata Supreme përsëriti procedurën në lidhje me kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, aprovoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe anuloi aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015] e Gjykatës Supreme të 1 dhjetorit 2015 dhe aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015] e Gjykatës së Apelit të 15 korrikut 2015 dhe ktheu çështjen në Gjykatën e Apelit për rivendosje, duke urdhëruar Gjykatën e Apelit që në procedurën e përsëritur ta ftojë parashtruesin e kërkesës në seancën e kolegjit (shih: Aktgjykimi PML nr. 110/2016 i 9 tetorit 2017).

45. Duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit përsëriti procedurën dhe mbajti seancën e trupit gjykues për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij u thirrën në mënyrë të rregullt në seancën e trupit gjykues, në pajtim me rekomandimin e Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin, duke aprovuar ankesën e Prokurorisë dhe duke e ndryshuar aktgjykimin [K. nr. 82-2013] e Gjykatës Themelore të 29 janarit 2015. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi me një vit burg (shih: Aktgjykimin PAKR. nr. 521/2017, të 12 dhjetorit 2017).

46. Gjykata vëren se Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 110/2016 e 9 tetorit 2017 si dhe Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR. nr. 521/2017 e 12 dhjetorit 2017, korrigjoi shkeljet e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, të cilat Gjykata i kishte konstatuar në vendimin e Gjykatës Supreme PML-KZZ. nr. 110/2016 të 16 majit 2016, kur shqyrtoi kërkesën e parashtruesit nr. KI104/16 të 4 gushtit 2017.

47. Gjykata konstaton se, sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit përsëri mbajti një shqyrtim më 12 dhjetor 2017, në të cilin u ftuan paraprakisht të gjitha palët në procedurë dhe morën pjesë personalisht parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij.

48. Prandaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit korrigjuan shkeljen procedurale të lartpërmendur të nenit 31 [E Drejta

për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, dhe me këtë respektoi aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI104/16, prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mosrespektim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme në bazë të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

(ii) Lidhur me pretendimet se gjykata e shkallës së dytë ishte e obliguar të caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i njoftojë palët në procedurë

49. Në lidhje me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës se gjykata e shkallës së dytë ishte e obliguar ta caktojë seancën gjyqësore dhe t'i njoftojë palët në procedurë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme urdhëroi përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit.

50. Më tej Gjykata vëren se më 12 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit përsëriti procedurën dhe mbajti seancën e kolegjit për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij u thirrën në mënyrë të rregullt në seancën e kolegjit dhe ishin të pranishëm në pajtim me rekomandimin e Gjykatës Supreme.

51. Përveç kësaj, Gjykata Supreme me aktgjykimin (Pml. nr. 270/2018), refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në detaje iu përgjigj saktësisht këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, si dhe secilit prej pretendimeve të parashtruesit veç e veç: " *... nga shikimi në procesverbal nga dëgjimi publik të Gjykatës së apelit të mbajtur më 12.12.2017, mund të përfundohet që në seancë ka marrë pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij [...]. Gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë pa marrë parasysh propozimin ankimor duke miratuar bazën ankimore të ligjit penal edhe pse një propozim i tillë nuk është dhënë në mënyrë eksplicite. [...] pretendimi i cili ka të bëjë me mosrespektimin e nenit 6.3 të KEDNJ-së është i paqëndrueshëm...*".

52. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit, në procedurën e përsëritur, nxori vendimin pa ftuar parashtruesin e kërkesës dhe mbrojtësin e tij janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe se ato duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(iii) Sa i përket pretendimeve se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën procedurale dhe materiale sepse *„nuk janë paraqitur – treguar arsyet për provat vendimtare dhe për provat vendimtare ekzistojnë kundërthënie të konsiderueshme “*.

53. Gjykata fillimisht vëren se, në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, i njëjti nuk është arsyetuar fare nga parashtruesi i kërkesës dhe se parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon se në cilat fakte vendimtare ekzistojnë kundërthënie, por ai thjesht konstaton se e drejta procedurale dhe materiale janë aplikuar në mënyrë të gabuar.

54. Gjykata rikujton, se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse lloje të veçanta të provave janë të pranueshme, dhe as çfarë provash duhet të paraqiten ose të tregojë se çfarë prova janë të pranueshme dhe çfarë jo, ky është roli i gjykatave të rregullta. Çështja në të cilën Gjykata Kushtetuese duhet përgjigjur është nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën ishin marrë provat, ishin të drejta.*”* (Shih edhe rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 35394/97, paragrafi 34-35, GJEDNJ, Aktgjykim i 12 majit 2000).

55. Duke shikuar procesin në tërësi, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në vendimet e tyre kishin përshkruar në mënyrë të detajuar dhe të plotë përfundimet e tyre, duke dhënë arsye të shumta në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55).

56. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo të gjykatave të tjera të rregullta, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, paragrafi 33).

57. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk dëshmon se procedurat në gjykatat e rregullta shkaktuan shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve

Ndërkombëtare], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

58. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në tërësi, në bazë të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Arta Rama-Hajrizi

KI73/18, Parashtrues i kërkesës është N. S. i cili kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme CML. nr. 36/2018 të 10 prillit 2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CN. nr. 89/2015, të 14 gushtit 2015

KI73/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, publikuar më 1 nëntor 2019

Fjalët kyç: Aktvendim për papranueshmëri, ratione materiae, kërkesë për moszbulim të identitetit

Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë për herë të dytë në Gjykatën Kushtetuese.

Në kërkesën e parë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike, prandaj, duke marrë parasysh aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës kishte shteruar të gjitha mjetet juridike dhe për herë të dytë ishte paraqitur si palë para Gjykatës.

Pasi shqyrtoi kërkesën e dytë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vërejti se, megjithëse kishte shteruar të gjitha mjetet juridike, përkatësisht kishte marrë aktvendimin e Gjykatës Supreme, ai në thelb konteston aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me të cilin ishte njohur vendimi gjyqësor i një gjykate të huaj, më konkretisht i gjykatës në Shqipëri.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore në Mitrovicë me rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 24 dhe 31 të Kushtetutës si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata duke marrë parasysh esencën e pretendimeve ankimore për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, konstatoi se kushti për zbatimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së është që në procedurën në fjalë të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet civile. Prandaj, në këtë rast, lind pyetja nëse gjatë shqyrtimit nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë a janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e vendimit të huaj, dhe se a ekziston ndonjë pengesë për njohjen e një vendimi të një gjykate të huaj, a janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet civile dhe, rrjedhimisht, nëse në procedurën e shqyrtimit të propozimit për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj janë të zbatueshëm neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Pasi analizoi dhe zbatoi parimet dhe standardet e GJEDNJ-së, Gjykata konkludoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, pasi që në rastin konkret nuk kishte kontest në të cilin ishin përcaktuar të drejtat dhe liritë civile të parashtruesit të kërkesës. Në thelb, Gjykata Themelore në Mitrovicë në pajtim me ligjin ka përcaktuar se kërkesa për njohjen e një vendimi të gjykatës së huaj plotëson të gjitha kërkesat ligjore për njohjen e saj, përkatësisht, gjykata ka trajtuar vetëm çështjen procedurale. Prandaj, Gjykata Themelore nxori aktvendimin me të cilin vendimi gjyqësor i formës së prerë në Shqipëri bëhet vendim i formës së prerë dhe bëhet pjesë e sistemit juridik të Kosovës.
Gjykata hodhi poshtë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës si të pabazuar, ndërsa Gjykata nuk është marrë me vendimet tjera, sepse parashtruesi në kërkesë nuk e kishte kërkuar këtë.
Sa i përket kërkesës për moszbulim të identitetit, Gjykata e aprovoi kërkesën e parashtruesit si të bazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI73/18

Parashtrues

N. S.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme CML. nr. 36/2018 të 10 prillit 2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CN. nr. 89/2015 të 14 gushtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga N. S. nga Mitrovica (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme CML. nr. 36/2018 të 10 prillit 2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CN. nr. 89/2015 të 14 gushtit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë

e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 25 maj 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

10. Më 27 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

11. Më 18 janar 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë që t'i dorëzojë të gjitha shkresat e lëndës në rastin KI73/18. Gjykata

Themelore në Mitrovicë dorëzoi të gjitha shkresat e kërkuara të lëndës brenda afatit.

12. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues
i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën për herën e dytë para Gjykatës Kushtetuese.

14. Me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se në rastin konkret ekzistojnë dy grupe të procedurave gjyqësore. Grupi i parë i procedurave ka të bëjë me njohjen e vendimit të gjykatës së huaj (Aktvendimi nr. 5799 i Gjykatës së Rrethit në Tiranë), ndërsa grupi i dytë i procedurave ka të bëjë me procedurën përmbarimore. Prandaj, Gjykata do t'i paraqesë ato veçmas në këtë raport.

Procedura në lidhje me njohjen e vendimit të gjykatës së huaj

15. Më 3 dhjetor 2012, Gjykata e Rrethit në Tiranë nxori Aktvendimin nr. 5799, me të cilin kishte zgjidhur martesën në mes të parashtruesit të kërkesës dhe ish-bashkëshortes së tij, e cila e ka vendbanimin në Tiranë.

16. Më 14 gusht 2015, ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, përmes përfaqësuesit ligjor, kishte parashtruar propozim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, me të cilin kishte kërkuar njohjen dhe përmbarimin e Aktvendimit nr. 5799 të Gjykatës së Rrethit në Tiranë .

17. Më 14 gusht 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi CN. nr. 89/2015) konstatoi se *"propozimi është i bazuar"* dhe kishte njohur Vendimin e Gjykatës së Rrethit në Tiranë "*duke u thirrur në nenet 86-101 të Ligjit mbi zgjidhjen e konfliktit të ligjeve vendore me dispozitat e vendeve te huaja mbi bazën e reciprocitetit.*"

Procedura në lidhje me përmbarimin e Aktvendimit CN. nr. 89/2015 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë

18. Më 21 gusht 2015, fëmijët e mitur të parashtruesit të kërkesës, të përfaqësuar nga nëna e tyre (ish bashkëshortja e parashtruesit të

kërkesës), paraqitën propozim në Gjykatën Themelore për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës së Rrethit në Tiranë. Në kërkesën për përmbarim, ata kërkuan realizimin e detyrimit të pashlyer monetar nga parashtruesi i kërkesës.

19. Më 5 tetor 2015, Gjykata Themelore nxori aktvendimin për përmbarim P. nr. 133/2015, me të cilën ai lejoi ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës së Rrethit në Tiranë.

20. Brenda afatit ligjor, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj aktvendimit për përmbarim të Gjykatës Themelore P. nr. 133/2015 të 5 tetorit 2015, me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshojë vendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke refuzuar propozimin për përmbarim dhe ta urdhërojë nënën e fëmijëve që t'i kthejë fëmijët në Kosovë ose t'i dorëzojë në kujdes të babait të tyre në Kosovë.

21. Më 29 nëntor 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 4970/15, me të cilën e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit thuhet:

> *"Gjykata e shkallës së parë konstatoi saktë se vendimi i Gjykatës së Rrethit në Tiranë nr. 5799 i 21.07.2010, që është i formës së prerë që nga 03.12.2012, me të cilin është zgjidhur martesa, sipas të cilit autoriteti përmbarues urdhëroi përmbarimin, paraqet dokument përmbarimor, siç parashikohet në nenin 22 par. 1.5. të LPP-së "Aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujditë gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujditë e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës", në këtë rast vendimi i Gjykatës së Rrethit në Tiranë është njohur me vendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë CN. nr. 89/2015 të 14.08.2015, gjithashtu "dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese" dhe paraqet bazën ligjore për përcaktimin e përmbarimit, në përputhje me nenin 21, nëse ajo i plotëson kërkesat e nenit 24 para. 1 dhe 27 par. 1 i të njëjtit ligj, ku thuhet se "Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit", prandaj nuk ka asnjë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e lejimit të përmbarimit".*

22. Më 1 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të cilën Gjykata e regjistroi me numër KI08/17.

23. Ne kërkesën KI08/17, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë Ac. nr. 4970/15 ka shkelur te drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

24. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata *"që të shpallet i pavlefshëm vendimi për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj (...), për shkak të miratimit me shkelje të procedurës dhe dispozitës së ligjit në fuqi."*

25. Më 5 shtator 2017, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmërinë e kërkesës në rastin KI08/07, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

26. Më 15 dhjetor 2017, Prokurori i Shtetit parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë (KMLC. nr. 137/2017) për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit (CN. nr. 89/2015) të Gjykatës Themelore, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sipas nenit 247 paragrafi 1 pika a të LPK-së, përkatësisht për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me propozim që Aktvendimi i kontestuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

27. Më 10 prill 2018, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin (CML. nr. 36/2018), me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së Prokurorit te Shtetit (KMLC. nr. 137/2017) e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (CN. nr. 89/2015, të 14 gushtit 2015).

28. Në Aktvendimin e Gjykatës Supreme thuhet:

> *i) "Në këtë çështje aplikohen dispozitat e Ligjit mbi zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve te tjera në marrëdhëniet e caktuara "Fletorja Zyrtare e RSFJ nr. 43 e datës 23.07.1982". Me nenin 101 paragrafi 3 të këtij ligji parashihet "Kundër aktvendimit mbi njohjen, përkatësisht ekzekutimin e vendimit palët mund të parashtrojnë ankesë brenda 15 ditëve nga data e dërgimit të aktvendimit".*
>
> *Në rastin konkret kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk është paraqitur ankesa edhe pse pala ka pasur*

dijen për te qysh më parë (Kërkesa e Gjykatës Kushtetuese e datës 01.02.2017 dhe Procedura e Përmbarimit) e as pas dorëzimit të rregullt të aktvendimit me datë 07.12.2017.

*ii) Sipas dispozitës së nenit 101 paragrafi 3 e lidhur me nenin 96 paragrafi 2 të këtij ligji, vendimi i Gjykatës së huaj njihet-**pranohet me aktvendim**. Kundër këtij aktvendimi pala mundet vetëm të parashtroj ankesë në kuptim të dispozitës së nenit 101 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit. Prandaj në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje jo kontestimore ku vlerësohet se a janë përmbushur kushtet për njohjen e vendimit gjyqësor.*

Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, qartë del se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur për shkelje thelbësore të dispozitave te procedurës kontestimore të përcaktuara me dispozitën e nenit 182.1 të LPK, e lidhur me nenin 177 dhe 206 te LPK-së. Mirëpo me dispozitën e nenit 247.1 pika (a) të LPK-së, mundësia e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kufizohet vetëm në disa shkelje të cilat mund të shërbejnë si shkaqe."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore me rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj është thirrur në nenet 86-101 të Ligjit mbi zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve te tjera mbi bazën e reciprocitetit. Sipas parashtruesit, neni 92 i këtij Ligji thotë: *"Një vendim i Gjykatës së huaj nuk mund të njihet nëse nuk ka reciprocitet"*.

31. Rrjedhimisht, parashtruesi shton se *"Gjykata Themelore e Mitrovicës ka neglizhuar faktin se nuk ka marrëveshje reciprociteti për njohjen e aktvendimeve për çështje civile mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës"*.

32. Parashtruesi pretendon se *"njohjen e vendimit të Gjykatës së Tiranës nuk e kam kërkuar unë si shtetas i Kosovës, por shtetasja e*

Shqipërisë. Prandaj, Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk ka pasur asnjë bazë për të njohur këtë aktgjykim".

33. Parashtruesi pretendon se *"është njohur nga ana e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës Supreme vendimi i falsifikuar i Gjykatës së një shteti të huaj duke anashkaluar procedurën e rregullt (përmes Ministrisë së Drejtësisë). Qellimisht une si shtetas i Kosoves jam prezantuar me vendim te Gjykates si shtetas i huaj e shtetasja e huaj si shtetase e Kosovës."*

34. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Gjykata Themelore nuk është kompetente për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor, dhe se procedura për njohjen e një vendimi të gjykatës së huaj do të duhej të kalonte përmes Ministrisë së Drejtësisë.

35. Parashtruesi konsideron se *"ky vendim nuk eshte dashte te njihet, ai me afekton dyfish para Gjykatave te Kosoves dhe Shqiperise."*

36. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë (CN. nr. 89/2015) të 14 gushtit 2015, me të cilin është njohur Aktgjykimi i Gjykatës së Rrethit në Tiranë, të anulohet si aktvendim i cili është në kundërshtim me ligjet e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës kërkon të kompensohet *"për te gjitha efektet juridike që ka prodhuar ky vendim".*

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

39. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa Individuale]

"1, Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49 [Afatet]

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."

40. Sa i përket plotësimit të këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu qartësoi të drejtat dhe liritë që pretendon se janë shkelur në përputhje me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatin e paraparë në nenin 49 të Ligjit.

41. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë], paragrafët 2 dhe (3) (b) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dështon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse janë të pranishme ndonjë nga kushtet në vijim:

[...]
(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën.“

42. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse:

a) Gjykata Themelore nuk ka juridiksion për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj per shkak te mos egzistimit te reciprocitetit ne mes te Republikes se Kosoves dhe Republikës se Shqipërisë.

b) Gjykata Supreme dhe Gjykata Themelore kane njohur një vendim të falsifikuar të gjykatës së huaj, duke anashkaluar proceduren e rregullt permes Ministrise se Drejtesise.

c) Gjykata Supreme perkunder faktit se i ishte tërhequr vëmendja për vendin e tij të lindjes e ndryshon vendlindjen nga Mitrovica ne Tirane.

43. Gjykata së pari konstaton se parashtruesi i kërkesës paraqitet për herë të dytë si parashtrues i kërkesës në Gjykatë.

44. Konkretisht, në lidhje me kërkesën e parë, Gjykata rikujton se më 1 shkurt 2017, parashtruesi parashtroi kërkesë dhe në të kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit CN. nr. 89/2015 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të 14 gushtit 2015. Gjykata e refuzoi atë kërkesë më 5 shtator 2017, me Aktvendimin për papranueshmëri, për arsye thjesht procedurale, përkatësisht për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike, dhe me këtë rast Gjykata nuk është marrë me përmbajtjen dhe bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

45. Gjykata konstaton se, përkundër faktit se parashtruesi ne ndërkohë ka marrë vendime të tjera të gjykatave të rregullta, të cilat lidhen drejtpërdrejt me aktvendimin që ai e konteston, parashtruesi edhe në kërkesën e re KI73/18, përsëri kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së aktvendimit CN. nr. 89/2015 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të 14 gushtit 2015, që ishte rezultat i procedurës së parë gjyqësore, të zhvilluar në lidhje me njohjen e vendimit të gjykatës së huaj.

46. Prandaj, Gjykata do të vlerësojë kërkesën e parashtruesit dhe, në pajtim me këtë, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së re KI73/18, do të

kufizohet vetëm në vlerësimin e bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, që është "*që me Aktvendimin CN. nr. 89/2015 e Gjykatës Themelore të 14 gushtit 2015 janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit] dhe neni 31 [E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së*".

47. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës që mund të analizohen duke iu referuar praktikës së GJEDNJ, Gjykata rikujton detyrimin e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta të Njeriut] të Kushtetutës, i cili thotë:

> "*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

48. Duke pasur parasysh vetë thelbin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljet e pretenduara, të cilat ai i sjell në lidhje me gjykimin e drejtë, Gjykata e sheh të nevojshme që së pari të përgjigjet në pyetjen nëse, në rastin konkret, janë të zbatueshme garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së.

49. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 31 paragrafi 2 i Kushtetutës në pjesën përkatëse thotë:

> *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...]."*

50. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 6.1 të KEDNJ-së, i cili parasheh:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."*

51. Nga sa u tha më sipër është e qartë se kushti për zbatimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së është që në procedurën në fjalë të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet civile. Prandaj, në këtë rast, lind pyetja nëse gjatë shqyrtimit nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë se a janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e vendimit të huaj, dhe se a ekziston ndonjë pengesë për njohjen e një vendimi të një

gjykate të huaj, a janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet civile dhe, rrjedhimisht, nëse në procedurën e shqyrtimit të propozimit për njohjen e vendimit të huaj janë të zbatueshëm neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Zbatueshmëria e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së

52. Gjykata thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, zbatueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në fushën *civile* (*të drejtave dhe detyrimeve*), nënkupton prezencën kumulative të kushteve në vijim: **a)** duhet të ekzistojë një "kontest" rreth ndonjë "të drejte" ose "detyrimi" të cilat duhet të kenë bazë në të drejtën e brendshme (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Benthem kundër Holandës,* kërkesa nr. 8848/80, të 23 tetorit 1985, par. 32–36, dhe *Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 32555/96, të 10 tetorit 2005, par. 116–126); dhe, **b)** e drejta ose detyrimi duhet të jenë të natyrës "civile" (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Ringeisen kundër Austrisë,* kërkesa 2614/65, të 16 korrikut 1971, par. 94).

53. Në bazë të asaj që u tha, rrjedh se Gjykata së pari duhet të vërtetojë nëse procedura gjyqësore e cila është iniciuar me kërkesën për njohjen e aktgjykimit të huaj gjyqësor është *a)* një *"kontest"* dhe *b) nëse në kontestin është vendosur për "të drejtat dhe detyrimet civile"?*.

Nocioni "kontest"

54. Sa i përket vetë nocionit "kontest", Gjykata thekson se "kontesti" është një procedurë gjyqësore në të cilën gjykata e rregullt shqyrton dhe vendosë për kontestet nga marrëdhëniet personale dhe familjare, nga marrëdhëniet e punës (me punëdhënësin), si dhe nga marrëdhëniet pronësore dhe marrëdhëniet e tjera civilo-juridike të personave civil fizikë dhe juridikë, bashkësive shoqëroro-politike, organizatave të punës së bashkuar dhe personave të tjerë juridik shoqëror.

55. Gjykata gjithashtu rikujton se për të pasur procedura gjyqësore karakterin e kontestit, ajo duhet t'i plotësojë kriteret e caktuara, përkatësisht, duhet të përmbajë veprimin e tre subjekteve – paditësit, të padituri dhe gjykatës. Paditësi është subjekti i cili paraqet kërkesën që gjykata t'i ofrojë mbrojtjen për një "të drejtë e tij civile", ndërsa i padituri është ai ndaj të cilit paditësi kërkon këtë mbrojtje. Paditësi dhe i padituri janë palë në kontest, pra, subjektet për të drejtën dhe detyrimin e të cilëve bëhet fjalë. Gjykata është subjekti i tretë në kontest, i cili shqyrton nëse kërkimi i mbrojtjes është i justifikuar dhe, sipas rezultatit të shqyrtimit, i ofron paditësit mbrojtjen ose e refuzon.

Të gjitha veprimet e palëve dhe të gjykatës kanë për synim, pra, qëllimin e fundit – aktgjykimin.

56. Gjykata më tej konstaton se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, shprehja "kontest" rreth "të drejtave dhe detyrimeve civile" përfshin të gjitha procedurat, rezultati i të cilave është vendimtar për të drejtat dhe detyrimet private, madje edhe nëse procedura ka të bëjë me kontestin ndërmjet një individi dhe një autoriteti publik i cili vepron në mënyrë të pavarur dhe pa marrë parasysh nëse ato, sipas sistemit të brendshëm juridik të shtetit të paditur, hyjnë në sferën e të drejtës private apo publike apo janë vërtetë me karakter të përzier (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Ringeisen kundër Austrisë,* të 16 korrikut 1971, kërkesa nr. 2614/65, faqe 39, paragrafi 94, si dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së *König kundër Gjermanisë*, seria A, numër 27, faqe 30 dhe 32, par. 90 dhe 94).

57. Gjykata gjithashtu rikujton disa vendime të tjera të GJEDNJ-së, në të cilat përcaktoi nocionin dhe natyrën e kontestit, përkatësisht çfarë duhet të plotësojë një procedurë gjyqësore për ta përmbushur atë kriter. Në rastin *Ringeisen kundër Austrisë*, të 16 korrikut 1971, GJEDNJ konstatoi se *"... termi" kontestimi kundër "(des) droits et oblig de caractere civil" [kontestet për të drejtat civile dhe detyrimet] mbulon të gjitha procedurat rezultati i të cilave është vendimtar për [ato] të drejta dhe detyrime" (Seria A nr. 13, f. 39, paragrafi 94). Megjithatë, "lidhja e dobët ose pasojat e largëta nuk janë të mjaftueshme për nenin 6, paragrafi 1 (nenet 6-1) ..., të drejtat dhe detyrimet civile duhet të jenë objekt - ose një nga objektet - e "kontestimit" (rezultati i procedurës duhet të jetë drejtpërdrejt përcaktues për një të drejtë të tillë*" (shih aktgjykimin e cituar më lart, *Le Compte, Van Leuven dhe De Meiere kundër Belgjikës* Seria A nr. 43, f. 21, paragrafi 47).

58. Gjykata gjithashtu thekson se në rastin *Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë* GJEDNJ, konkludoi se "kontestimi" (kontesti) duhet të jetë autentik dhe serioz (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë*, të 23 shtatorit 1982, Seria A nr. 52, f. 30, paragrafi 81).

59. Në lidhje me këtë, Gjykata në rastin konkret duhet të përcaktojë nëse procedura e zhvilluar me rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj në Gjykatën Themelore në Mitrovicë i përmbushë elementet e një kontesti gjyqësor.

Përcaktimi i nocionit "kontest" në rastin konkret

60. Në bazë të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata vëren se ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës ka parashtruar padi për shkurorëzim në Gjykatën e Rrethit në Tiranë, në bazë të së cilës Gjykata e Rrethit u thirr për të vendosur për shkurorëzim, si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga një bashkësi e tillë.

61. Prandaj, Gjykata e Rrethit zhvilloi procedurën e shkurorëzimit ku përfshiheshin bashkëshortët martesor (parashtruesi i kërkesës dhe ish-bashkëshortja e tij), dhe rrjedhimisht, Gjykata e Rrethit nxori gjithashtu një vendim që zgjidhte çështjen e bashkësisë martesore. Me të njëjtin vendim, Gjykata përcaktoi gjithashtu fushën e të drejtave dhe detyrimeve të të dy subjekteve në procedurën e shkurorëzimit.

62. Nga shkresat e lëndës rrjedh se Aktvendimi nr. 5799, i Gjykatës së Rrethit në Tiranë mori formën e prerë, në të cilin u përcaktuan të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve të përfshira në procedurën e shkurorëzimit.

63. Më tej, sa i përket procedurës gjyqësore në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës, përkatësisht Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Gjykata së pari vëren se kërkesa për njohjen e një vendimi të gjykatës së huaj (Aktvendimi nr. 5799 i Gjykatës së Rrethit në Tiranë) u paraqit nga tani ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, e cila në cilësi të palës së interesuar ka interes ligjor për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj në Republikën e Kosovës, me të cilin asaj i krijohen kushte dhe i mundësohet të realizojë të drejta të caktuara, të cilat janë të përcaktuara në vendimin e gjykatës së huaj.

64. Rrjedhimisht, në mënyrë që ajo të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtat e saj në mënyrë të plotë në mënyrën e përcaktuar nga gjykata e vendit të huaj në vendimin e saj, ato të drejta duhet të njihen edhe nga gjykata e shtetit në territorin e të cilit pala e interesuar (në rastin konkret, ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës), kërkon njohjen e këtij vendimi të gjykatës së huaj.

65. Gjykata rikujton se një e drejtë e tillë rrjedh nga dispozita ligjore e nenit 101 të "*Ligjit mbi zgjedhjen e kolizionit te ligjeve me dispozitat e vendeve tjera*" që parasheh:

> *"njohjen e vendimeve te gjykatave të huaja në lidhje me çështjet e gjendjes (statusit) personal është e autorizuar ta bëj kushdo që ka interes ligjor".*

66. Gjykata gjithashtu rikujton se në mënyrë që një vendim i një gjykate të huaj të prodhojë efekte juridike në territorin e Kosovës, përkatësisht të drejtat dhe pasojat e përcaktuara në të, ai duhet të njihet nga një gjykatë kompetente në territorin e Kosovës.

67. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se çështja e juridiksionit për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja rregullohet me nenin 11 të Ligjit për Gjykatat nr. 03/L - 199,

Neni 11
Juridiksioni i Gjykatës Themelore sipas Lëndës

[...]
2. Gjykatat themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.“

68. Nga kjo rrjedh edhe fakti se është në juridiksionin e Gjykatës Themelore, si gjykatë kompetente, të përcaktojë nëse një vendim i një gjykate të huaj plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj që ai të njihet. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se “*Ligji mbi zgjedhjen e kolizionit te ligjeve me dispozitat e vendeve tjera*” parasheh të gjitha kushtet që Gjykata Themelore duhet të përcaktojë përpara se të vendosë nëse vendimi i një gjykate të huaj plotëson kushtet për t'u njohur si i tillë.

69. Gjykata, duke i sjellë dispozitat ligjore në lidhje me faktet konkrete në kërkesë, konstaton se në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, si gjykatë kompetente, ishte një çështje thjesht procedurale në lidhje me njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të ngritur nga një palë e interesuar.

70. Kështu, sipas mendimit të kësaj gjykate, Gjykata Themelore në Mitrovicë ishte thirrur të përgjigjet ekskluzivisht në pyetjen nëse vendimi i gjykatës së huaj, njohjen e të cilit e kërkon ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, i plotëson të gjitha kushtet formale për njohjen e tij. Në këtë drejtim, mund të konkludohet se në këtë procedurë gjyqësore ekzistojnë vetëm dy palë, përkatësisht ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës si palë e interesuar që kërkon njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, si dhe shteti, përkatësisht Gjykata Themelore në Mitrovicë, e cila, si gjykatë kompetente, duhet t’i japë përgjigje kësaj çështjeje procedurale.

71. Në bazë të lartcekurave, mund të konkludohet se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës nuk ishte palë në procedurën para Gjykatës Themelore në Mitrovicë me rastin e njohjes së vendimit të një gjykate

të huaj, dhe me këtë Gjykata Themelore në Mitrovicë as nuk ka vendosur për të drejtat ose detyrimet e tij civile, që mund të lindin nga kjo procedurë gjyqësore.

72. Gjykata, duke krahasuar kriteret e përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (*Ringeisen kundër Austrisë*) me rastin konkret në lidhje me nocionin "kontest", konstaton se procedura gjyqësore konkrete në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ishte zhvilluar ekskluzivisht midis dy subjekteve, me çka konkludohet që mungesa e një subjekti të tretë në këtë procedurë gjyqësore ndikon në vet natyrën e procedurës, duke e përkufizuar atë si procedurë gjyqësore së cilës, sipas këtij kriteri dhe natyre, i mungon elementi i "kontestit".

73. Gjithashtu, sipas kriterit të dytë të GJEDNJ-së, Gjykata konstaton se procedura gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë nuk është "kontest", për arsye se Gjykata Themelore nuk ishte thirrur të vendosë mbi të drejtat civile të një pale të tretë (parashtruesit të kërkesës), dhe e cila mbrohet në ndonjë mënyrë me të drejtën e brendshme, dhe rrjedhimisht Gjykata Themelore as nuk ka mundur të vendosë drejtpërdrejt lidhur me të.

74. Po ashtu, Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk ka nxjerrë vendim vendimtar për të drejtat dhe detyrimet civile të parashtruesit të kërkesës, porse ato si të tilla, në fushëveprimin e tyre, tashmë janë vendosur në një procedurë gjyqësore të shkurorëzimit, përkatësisht "kontesti" i cili është zhvilluar në gjykatat e një vendi të huaj ku në bazë të shkresave të lëndës mund të konstatohet se parashtruesi i kërkesës ishte pjesëmarrës aktiv. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se edhe kriteri i tretë që përcakton natyrën e kontestit në këtë rast nuk është përmbushur.

75. Më tej në lidhje me kriterin e vendosur nga GJEDNJ në rastin *Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë*, se *"kontestimi" (kontesti) duhet të jetë autentik dhe serioz",* Gjykata konstaton se procedura gjyqësore jashtëkontestimore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ka elemente të autenticitetit dhe seriozitetit, të cilat pasqyrohen në faktin se me këtë aktvendim (CN. nr. 89/2015 i 14 gushtit 2015 i Gjykatës Themelore) realizohen të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në vendimin e gjykatës së huaj, dhe se me këtë aktvendim njëkohësisht mundësohet mbrojtja e të drejtave dhe zbatimi i të gjitha detyrimeve ndaj palës e cila e ka parashtruar kërkesën për njohjen e tyre.

76. Gjykata rikujton në veçanti, se do të ishte padrejtësi që pala që ka një vendim të formës së prerë, që kishte rezultuar nga një proces gjyqësor që kishte karakterin e një 'kontesti', në të cilin janë përcaktuar të gjitha "'të drejtat dhe detyrimet", nuk mund t'i ushtrojë si të tilla; dhe t'i gëzojë në masën në të cilën ato përcaktohen. Sidomos kur kemi parasysh që natyra e kontestit ishte procedurë e shkurorëzimit me ç'rast të drejtat e përcaktuara ndikojnë drejtpërdrejt, përveç te palët në procedurë (bashkëshortët), po ashtu edhe te subjektet të cilat në mënyrë të tërthortë ishin palë në procedurë (fëmijët e bashkëshortëve), por preken drejtpërdrejt nga të drejtat e përcaktuara.

77. Prandaj, Gjykata dëshiron të theksojë në mënyrë të veçantë që nga momenti kur një gjykatë vendase nxjerr një vendim, me të cilin njeh një vendim të formës së prerë të një gjykate të huaj, ajo në bazë të ligjit gjithashtu merr një vendim të formës së prerë në sistemin juridik të atij shteti, gjykata e të cilit e kishte njohur atë si të tillë.

78. Për më tepër, njohja e një vendimi të gjykatës së huaj nuk është vetëm detyrim ligjor i një gjykate që ka një detyrim ligjor në pajtim me juridiksionin e saj ta njohë atë (me kusht që të përmbushen të gjitha kërkesat procedurale të përcaktuara me ligj), por është gjithashtu një detyrim i shtetit sipas ligjit ndërkombëtar privat.

79. Në bazë të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstaton se procedura gjyqësore jashtëkontestimore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj nuk përbën një "kontest" në kuptimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së.

Nocioni "të drejtat dhe detyrimet civile".

80. Gjykata rikujton se nocioni i "të drejtave dhe detyrimeve civile" fillon nga shpjegimi i nocionit "te drejta civile˝. Ky nocion ka të bëjë me mbrojtjen e të gjitha të drejtave të cilat një individ do t'i gëzonte sipas ligjit kombëtar të zbatueshëm. Nga ana tjetër, nocioni "te drejtat civile" shtrihet konsiderueshëm përtej rasteve civile në kuptimin e ngushtë. Në Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Ringeisen kundër Austrisë* është vërtetuar se çdo procedurë rezultati i së cilës është "vendimtar për përcaktimin e një të drejte civile" duhet të jetë në pajtim me kërkesat nga neni 6 i KEDNJ-së (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Ringeisen kundër Austrisë,* kërkesa nr. 2614/65, të 16 korrikut 1971, Seria A, nr. 13).

81. Neni 6 i KEDNJ-së zbatohet pavarësisht nga statusi i palëve, si dhe pavarësisht nga karakteri i legjislacionit i cili e rregullon mënyrën në të cilën do të kategorizohet kontesti; ajo që është e rëndësishme është karakteri i së drejtës në fjalë, si dhe nëse rezultati i procedurës do të ndikonte drejtpërsëdrejti në *të drejtat dhe detyrimet* në kuadër të së drejtës private (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Baraona kundër Portugalisë*, kërkesa 10092/82, të 8 korrikut 1987, par. 38–44).

82. Gjithashtu, GJEDNJ kërkon që rreth përmbajtjes së "të drejtave dhe detyrimeve civile" të ekzistojë një "kontest", të paktën në kuptimin e gjerë të kësaj fjale, siç është përcaktuar në Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës,* ku neni 6 i KEDNJ-së në parim nuk do të zbatohej në rastet me karakter të pastër administrativ dhe procedural, në të cilat nuk ka veprime substanciale as për çështje faktike, as për çështje juridike (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës,* kërkesa 6878/75;7238/75, 23 qershorit 1981. para 41).

83. Gjykata, duke i sjellë parimet e lartpërmendura të GJEDNJ në lidhje me rastin konkret, konstaton se nuk është kontestues fakti që ka ekzistuar procedura gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, por gjithashtu kjo Gjykatë nuk e konteston as faktin se Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk vendosi për fushëveprimin e të drejtave dhe lirive civile siç përcaktohet në rastin e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*.

84. Për më tepër, Gjykata konstaton se sa i përket të drejtave dhe detyrimeve civile të parashtruesit të kërkesës, ndikim vendimtar në fushëveprimin e tyre kishte procedura gjyqësore që ishte zhvilluar në Gjykatën e Rrethit në Tiranë në lidhje me procedurën e shkurorëzimit, dhe ku ai mori pjesë si palë. Në lidhje me këtë, Gjykata dëshiron të shtojë se gjatë procedurës së shkurorëzimit, parashtruesi i kërkesës pati mundësinë, që në rast se ishte i pakënaqur me mënyrën në të cilën të drejtat dhe liritë e tij civile u trajtuan nga gjykatat kompetente, t'i drejtohej institucioneve kompetente në Republikën e Shqipërisë për t'i mbrojtur ato të drejta.

85. Gjykata në rastin konkret tashmë kishte konkluduar se parashtruesi i kërkesës nuk ka iniciuar një "kontest" në lidhje me "të drejtat" që janë të parashikuara me legjislacionin e brendshëm brenda kuptimit të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, prandaj nuk janë përmbushur kushtet kumulative për zbatueshmërinë e nenit 6.1 të KEDNJ-së, siç është përcaktuar me Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Ringeisen kundër Austrisë*. Më konkretisht, gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim

substancial as për çështjet faktike, as për çështjet juridike, dhe rrjedhimisht nuk kanë vendosur për "të drejtat ose detyrimet civile" të parashtruesit të kërkesës, të cilat do të kishin rezultuar nga një "kontest" i tillë.

86. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se në rastin konkret procedura për njohjen e një vendimi të gjykatës së huaj nuk përbën në vetvete një "kontest" për "të drejtat ose detyrimet civile" brenda kuptimit të nenit 31 para. 2 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së, sepse rasti në fjalë, nuk ka të bëjë me vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve civile të cilat kërkohen me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, përkatësisht nuk janë shqyrtuar meritat e padisë (p.sh. lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë apo bazueshmërinë e akuzës penale, në procedurën e zgjidhjes së martesës ose ndonjë të drejte ose detyrim që do të kishte pasoja të drejtpërdrejta për parashtruesin e kërkesës), por vetëm ka shqyrtuar një çështje thjesht procedurale, *dhe kjo është nëse janë plotësuar kërkesat procedurale për njohjen e vendimit të një gjykate të huaj*.

87. Megjithatë, Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë që GJEDNJ, në praktikën e saj shumëvjeçare, konkludoi se neni 6 i KEDNJ-së mund të zbatohet për procedurat e iniciuara nga parashtruesit e kërkesave, në të cilat pretendoi se ka pasur lëshim (*pakujdesi*) të gjykatave kur kanë vendosur për "të drejtat civile" të tij në procedurën gjyqësore që ka natyrën e një "*kontesti*", edhe në rastet kur vëllimi i të drejtave tashmë është vendosur. Në raste të tilla, Gjykata vendase është e obliguar të shqyrtojë nëse janë respektuar kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së në këto procedura gjyqësore.

88. Kështu, për shembull, në rastin Golder *(Golder)*, GJEDNJ konsideroi se garancitë procedurale të dhëna në nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me drejtësinë, publicitetin dhe shpejtësinë do të ishin të pakuptimta nëse nuk do të kishte mbrojtje të parakushteve për të gëzuar ato garanci, më konkretisht - qasje në gjykatë. Gjykata konstatoi se kjo ishte një formë e patjetërsueshme e garancive të përfshira në nenin 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në parimet e sundimit të ligjit dhe duke iu shmangur autorizimeve diskrecionale që shtrihen në themel të pjesës dërmuese të Konventës (shih GJEDNJ në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975, Seria A nr. 18, faqe 13-18, paragrafët 28-36).

89. Më tej, në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së "*mund të mbështetet kushdo që konsideron se ndërhyrja në ushtrimin e të drejtave të tij (civile) ishte e kundërligjshme dhe nuk kishte pasur mundësi që të*

parashtrojë padi ose ankesë në gjykatë që plotëson kërkesat e nenit 6.1" (shiko aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, i 23 qershorit 1981, Seria A Nr 43, paragrafi 44).

90. Gjithashtu, kur ekziston një "kontest" serioz dhe autentik për sa i përket ligjshmërisë së kësaj ndërhyrjeje, në lidhje me vetë ekzistencën ose shkallën dhe shtrirjen e "të drejtës civile" të kontestuar, neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së autorizon një individ "*që kjo çështje e ligjit të brendshëm të vendoset nga një gjykate vendase*" (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, 23 shtator 1982, Seria A nr. 52, paragrafi 81; shih gjithashtu aktgjykimin në rastin *Tre Traktörer AB kundër Suedisë*, të 7 korrikut 1989, Seria A nr. 159, paragrafi 40).

91. Gjithashtu, kur qasja në gjykatë e një individi është e kufizuar, qoftë me ligj ose faktikisht, me ç'rast ai nuk mund të marrë pjesë në "*kontestin*", në të cilin vendoset drejtpërdrejt për "*të drejtat e tij civile*", Gjykata është e obliguar të shqyrtojë nëse kufizimi i vendosur prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një qëllim legjitim dhe nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 28 majit 1985), Seria A nr. 93, faqe 24-25, paragrafi 57). Nëse kufizimi është në përputhje me këto parime, nuk do të ketë shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

92. Megjithatë, duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese nuk kontestoi asnjë prej garancive të parapara në nenin 6 të KEDNJ-së, në një procedurë ku në një "*kontest*" ishte vendosur për vëllimin e "*të drejtave civile"* të tij, por ai para gjykatës ekskluzivisht konteston vetë procedurën e njohjes së vendimit të formës së prerë të një gjykate të huaj, të cilin, në pajtim me juridiksionin e saj, Gjykata Themelore në Mitrovicë e ka njohur me aktvendim, çon në konkludimin se pretendimet e tij nuk mund të kualifikohen në parimet dhe praktikat e lartpërmendura të GJEDNJ-së (referuar në paragrafët 86, 87, 88, 89 dhe 90 të raportit), gjë që do të mundësonte shqyrtimin nëse në një "*kontest*" gjyqësor me rastin e vendosjes për të "*të drejtat e tij civile*", janë respektuar të gjitha garancitë e tij sipas nenit 6 të KEDNJ-së.

93. Bazuar në sa më sipër, si dhe në bazë të përfundimeve të nxjerra, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, që

sipas pretendimeve të tij, rezultoi nga njohja e vendimit të gjykatës së huaj, nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

94. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e sqaroi shkeljen e pretenduar me asnjë fjalë dhe as nuk ofroi asnjë argument të vlefshëm që do të arsyetonte "*dhe mbështeste kërkesën*".

95. Prandaj, Gjykata e hedh poshtë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës si të pabazuar, në pajtim me rregullin 39.2 të Rregullores së punës.

96. Gjykata më tej vëren se ka edhe vendime tjera të gjykatave të rregullta në lidhje me procedurën përmbarimore, por që parashtruesi në kërkesë nuk kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre, dhe prandaj, Gjykata nuk do të merret me to.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

97. Gjykata rikujton që parashtruesi kishte kërkuar që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht, "*për shkakun se emri im është irelevant në trajtimin e rastit dhe publiciteti në mënyrë të tërthortë do të mund të afektonte fëmijët e mi.*"

98. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. [...]."*

99. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8.1. të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, i cili përcakton se:

> *"Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme."*

100. Gjykata konsideron se në një rast familjar publiciteti mund, madje edhe në mënyrë tërthortë, të ndikojë në identitetin, emrin dhe marrëdhëniet familjare të fëmijëve.

101. Prandaj, në pajtim me nenin 8.1. të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rregullin 32 (6) të Rregullores së punës, Gjykata e aprovon kërkesën e parashtruesit për mos zbulimin e identitetit të tij publikisht.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 32.6 dhe 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 tetor 2019, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA MIRATOJË njëzëri kërkesën për zbulim të identitetit;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Arta Rama-Hajriz

KI81/19, Parashtruesi i kërkesës: Skender Podrimqaku, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-19-0007, të 14 marsit 2019

KI81/19, Aktvendim për papranueshmëri, i miratuar më 7 nëntor 2019, publikuar më 9 dhjetor 2019

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme, masë e përkohshme, procedurë paraprake.*

Objekti i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 10 [Ekonomia], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Parashtruesi i kërkesës, pretendimin kryesor të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese e ka vendosjen e masës së përkohshme për ndalimin e shitjes së një prone për të cilën Agjencia Kosovare e Privatizimit e kishte njoftuar se është anuluar tenderi për rastin në fjalë. Masa e përkohshme u kërkua deri në momentin kur Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) të vendoste për meritat e padisë së tij.

Për pretendimin e lartpërmendur, Gjykata vlerësoi se për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 6 të Konventës dhe nenit 31 të Kushtetutës në procedurat paraprake, duke marrë parasysh se e drejta e përfshirë në "procedurat paraprake" është një e drejtë civile dhe se masa e përkohshme është përcaktuese për të drejtën civile në fjalë, ajo konstatoi që në rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, përmbushen kriteret për aplikimin e garancive procedurale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata konstatoi se pretendimet dhe argumentet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës nuk tregojnë se procedurat pranë Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS ishin të padrejta apo arbitrare, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit të kërkesës i është mohuar ndonjë garanci procedurale, që do të çonte në shkelje të së

drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 46, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohen konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (nenit 31 të Kushtetutës).

Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 para. 1 të KEDNJ-së, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesi ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.

Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 10, Gjykata vëren se ky nen nuk hyn në kategorinë e të Drejtave dhe Lirive Themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të këtij neni duhet të ndërlidhet dhe të argumentohet me ndonjë të drejtë tjetër të paraparë në kapitullin II. Ndërsa sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 32 të Kushtetutës, Gjykata vëren se parashtruesi vetëm ka përmendur shkeljen e këtij neni të Kushtetutës në rastin e tij, por një pretendim të tillë nuk e ka shtjelluar dhe mbështetur me argumente.

Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

Përfundimisht, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa deklarohet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI81/19

Parashtrues

Skender Podrimqaku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-19-0007, të 14 marsit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Skender Podrimqaku me vendbanim në Komunën e Pejës, të cilin e përfaqëson Armend Deskaj, avokat (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit të DHPGJS), AC-I-19-0007, të 14 marsit 2019, i cili iu dorëzua atij më 19 mars 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 10 [Ekonomia], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon që Gjykata Kushtetuese e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme dhe të bëjë "ndalimin e shitjes së Njësisë nr. 50: KB Kooperimi – Toka Bujqësore Sigë 1," (në tekstin në vijim: prona e kontestuar).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 maj 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 23 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

8. Më 17 qershor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 17 qershor 2019, Gjykata njoftoi Kolegjin e Apelit të DHPGJS për kontestimin e Aktvendimin AC-I-19-0007 dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.

10. Më 4 Korrik 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti plotësim të kërkesës në Gjykatë.

11. Më 24 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese.

12. Më 4 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e solli autorizimin për përfaqësim në Gjykatë përmes postës.

13. Më 7 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 11 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës u njoftua nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) se është shpallur ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar, sa i përket pjesëmarrjes në procesin e shitjes së një prone. Ky njoftim i AKP-së sqaronte se *"sipas Rregullave të përgjithshme të Tenderit, çmimi më i lartë i ofruar në asnjë mënyrë nuk paraqet Vendim mbi shitjen e asetit, por Vendimin për aprovimin apo refuzimin e shitjes do ta marr Bordi i Drejtorëve të AKP-së."*

15. Me 27 dhjetor 2017, AKP e njoftoi parashtruesin e kërkesës rreth Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, lidhur me anulimin e tenderit për pronën e kontestuar. Njoftimi përmbante edhe udhëzimin për mjet juridik kundër vendimit për anulim, përkatësisht për inicimin e procedurës gjyqësore pranë DHPGJS.

16. Më 27 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës parashtron padi në DHPGJS, duke kërkuar: (i) anulimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së lidhur me anulimin e shitjes të pronës së kontestuar; (ii) të vërtetohet se paditësi është blerës i pronës së kontestuar; (iii) të obligohet AKP që në afat prej 30 ditësh të përmbyllte procedurat e shitjes (së pronës së kontestuar) dhe të mbulonte shpenzimet e procedurës kontestimore. Përveç kësaj, me të njëjtën padi parashtruesi kërkoi lëshimin e Urdhrit Paraprak Gjyqësor (në tekstin e mëtejmë: UPGJ), përmes të cilit do t'i ndalohej AKP-së ndërmarrja e veprimeve për tenderimin e pronës kontestuese, gjer në vendimin përfundimtar.

17. Në një datë të pasaktësuar, AKP paraqiti komentet e saj në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, duke kundërshtuar propozimin për lëshimin e UPGJ-së si të pa mbështetur në ligj, me argumentin se vendimi i

Bordit të AKP-së ishte në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

18. Më 13 prill 2018, Kolegji i Specializuar i DHPGJS mori Aktvendimin C-III-18-0038, përmes të cilit e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lëshimin e UPGJ-së. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi, ndër të tjera, theksohet se paditësi (parashtruesi) nuk ka dhënë prova të besueshme se do pëson *"dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm financiar"*, nëse nuk miratohet kërkesa për UPGJ.

19. Më 3 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së ndaj Aktvendimit C-III-18-0038, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe konstatimit të gabuar të gjendjes së fakteve.

20. Më 31 maj 2018, Kolegji i Apelit të DHPGJS, përmes Aktvendimit AC-I-18-0271, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuat të DHPGJS-së C-III-18-0038, të 13 prillit 2018. Në këtë Aktvendim, Kolegji i Apelit arsyetoi se: "*Ankuesi (parashtruesi) vetëm verbalisht pretendon se dëmi do të jetë i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, mirëpo ai as para Kolegjit të Specializuar as para Kolegjit të Apelit nuk ka asnjë provë me të cilën do të vërtetonte dëmin që i është shkaktuar atij me vendimin për anulimin e këtij tenderi. Për më tepër çdo pjesëmarrës në një procedurë tenderimi e ka të qartë, sipas nenit 17 të Rregullave të tenderit se vetëm Bordi i AKP-së e ka autoritetin përfundimtar për aprovimin e një shitje*". Në fund, Kolegji i Apelit theksoi se ky Aktvendim nuk paragjykon zgjidhjen e meritave të padisë.

21. Më 13 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti përsëri kërkesë për lëshimin e UPGJ-së, pasi që AKP-ja kishte shpallur valën e 39 të privatizimit të shitjes së pronës së kontestuar.

22. Më 19 dhjetor 2018, Kolegji i Specializuar i DHPGJS mori Aktvendimin C-III-18-0038, përmes të cilit e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lëshimin e UPGJ-së (me arsyetim të njëjtë sikur në Aktvendimin e datës 13 prill 2018).

23. Më 10 janar 2019, parashtruesi i kërkesës përsëri paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kundër Aktvendimit C-III-18-0038, të 19 dhjetorit 2019, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe konstatimit të gabuar të gjendjes së fakteve.

24. Më 14 mars 2019, Kolegji i Apelit të DHPGJS, përmes Aktvendimit AC-I-19-0007, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin C-III-18-0038, të 19 dhjetorit 2018, të Kolegjit të Specializuat të DHPGJS-së (me arsyetim të njëjtë sikur në Aktvendimin e datës 31 maj 2018). Kolegji i Apelit përsëri theksoi se ky Aktvendim nuk prejudikon *'zgjidhjen përfundimtare të padisë'*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit të DHPGJS, përmes Aktvendimit AC-I-19-0007, duke refuzuar kërkesën e tij për urdhër paraprak gjyqësor, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 10 [Ekonomia], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

26. Parashtruesi i kërkesës thekson që me (ri)tenderimin e pronës së kontestuar, *'janë plotësuar kushtet ligjore për lëshimin e Urdhrit paraprak gjyqësor (masës së përkohshme).'* Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, nga procesi i tenderimit mund të pasojë shitja e pronës së kontestuar, me ç' rast do i shkaktohej një dëm i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm. Pra, *'shitja eventuale e asetit do e rrezikonte kërkesën kryesore të paraqitur me padi, me të cilën është kërkuar të vërtetohet se Vendimi i të padituës [AKP] për anulimin e tenderit ishte i kundërligjshëm.'*

27. Parashtruesi i kërkesës argumenton që kërkesa e tij është kërkesë pronësore dhe se e drejta e pronësisë është kategori kushtetuese dhe po ashtu një e drejtë e garantuar edhe me konventa ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, sipas tij, refuzimi i kërkesës për masë të përkohshme do t'i humbiste kuptimin e kontestit lidhur me kërkesëpadinë e cila është në proces në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, ndalimi i shitjes deri në vendosjen meritore të çështjes është në interesin juridik të palës paditëse por edhe në interes të drejtësisë në përgjithësi.

28. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për anulimin e tenderit për pronën e kontestuar, është në kundërshtim me nenin 10 të Kushtetutës, sepse sipas tij Kosova është përcaktuar si shtet me ekonomi të lirë të tregut. Ai pretendon se rëndësi të veçantë paraqet parimi i njohur se në shtetet ku gjen zbatim ekonomia e lirë e tregut oferta dhe kërkesa janë rregullator të çmimit të tregut, andaj edhe në këtë drejtim përderisa

parashtruesi e kishte ofertuar çmimin më të lartë është dashur të aprovohej shitja e pronës së kontestuar.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *"të interpretojë"* kushtetutshmërinë e Aktvendimit të kontestuar AC-I-19-0007, si dhe vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së për anulimin e tenderit për pronën e kontestuar.

30. Parashtruesi nga Gjykata kërkon gjithashtu që të vendosë masë të përkohshme, duke kërkuar që "*deri në sqarimin e kërkesave, në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese lidhur me Masat e Përkohshme [...] me Aktgjykim të ndalojë shitjen e aseteve nr. 39 [...]*".

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> 7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 113 (7) të Kushtetutës, pasi është palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktvendimin AC-I-19-0007 të 14 marsit 2019, të Kolegji të Apelit të DHPGJS dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara ne nenin 49 të Ligjit.

35. Megjithatë, në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmerisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmerisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2), në veçanti përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

36. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 10 [Ekonomia], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të

Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

37. Mirëpo, në dritën e fakteve të rastit konkret, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me:

(i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe
(ii) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

(i) Aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në "procedurat paraprake"

38. Gjykata vë në pah se në rastin konkret pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me procedura paraprake gjyqësore, përkatësisht me refuzimin e kërkesës së tij për UPGJ nga ana e dy shkallëve gjyqësore, në kuadër të DHPGJS.

39. Prandaj, Gjykata fillimisht do të përcaktojë nëse në rastin e parashtruesit zbatohet neni 6 i Konventës në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës.

40. Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 6 të Konventës dhe nenit 31 të Kushtetutës në procedurat paraprake – siç janë ato me të cilat është vendosur për kërkesën e parashtruesit për UPGJ, Gjykata vëren se një zbatim i tillë është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore. Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për te Drejta të Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

41. Rrjedhimisht, Gjykata do e përcaktojë aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (Shih gjithashtu Aktgjykimin në rastin nr. KI122/17, parashtrues, *Ceska Exportni Banka A. S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 124 dhe KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 Dhjetorit 2018, paragrafi 62).

42. Gjykata së pari vëren se fushëveprimi i nenit 6 të KEDNJ-së shtrihet në procedurat që përcaktojnë të *"drejtat ose detyrimet civile"* (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringeisen kundër Austrisë*, kërkesa nr. 2614/65, Aktgjykim i 22 qershorit 1972). GJEDNJ ka konstatuar se për të qenë neni 6 i aplikueshëm në procedura civile, *"duhet të ekzistojë një kontest*

në lidhje me një 'të drejtë civile', për të cilën mund të thuhet, të paktën në baza të argumentueshme, që është e njohur në të drejtën vendore, pavarësisht se a është e mbrojtur edhe me Konventë. Kontesti duhet të jetë i vërtetë dhe serioz; ai mund të ndërlidhet jo vetëm me vetë ekzistencën e së drejtës, por edhe me fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të saj; dhe së fundi, rezultati i procedurave duhet të jetë drejtpërsëdrejti përcaktues për të drejtën në fjalë; lidhjet e paqarta ose pasojat e largëta nuk janë të mjaftueshme për aktivizimin e nenit 6 paragrafi 1" (Shih rastet e GJEDNJ-së*: Mennitto kunder Italisë,* kërkesa nr. 33804/96*,* Aktgjykim i 5 tetorit 2000, paragrafi 23*; Giilmez kundër Turqisë,* kërkesa nr. 16330/02, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 28; dhe *Micallef kundër Maltës,* kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 74).

43. Gjykata më tutje vë në pah qëndrimin e përgjithshëm të GJEDNJ-së se, parimisht, *"procedurat paraprake"*, si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/mase të sigurisë - nuk konsiderohen që përcaktojnë të "drejta dhe detyrime civile" dhe për këtë arsye, në parim, nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së: *Wiot v. Francës*, kërkesa nr. 43722/98, Aktgjykimi i 7 janarit 2003; *APIS a.s. kundër Sllovakisë*, kërkesa nr. 39754/98, Aktgjykimi i 13 janarit 2000; *Verlagsgruppe NEWS GmbH kundër Austrisë*, kërkesa nr. 62763/00, Aktgjykim i 23 tetorit 2003; *Libert kundër Belgjikës*, kërkesa nr.44734/98, Aktgjykim i 8 korrikut 2004; *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 83, shih gjithashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI 122/17, Parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 126 dhe KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 Dhjetorit 2018, paragrafi 64).

44. Megjithatë, në raste të caktuara, GJEDNJ ka aplikuar nenin 6 të KEDNJ-së në "procedura paraprake", kur konsideroi se masat e sigurisë ishin vendimtare apo përcaktuese për të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së; *Aerts kundër Belgjikës*, kërkesa nr, 25357/94, Aktgjykimi i 30 korrikut 1998; *Boca kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 50615/99, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2012; *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 75; shih gjithashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI 122/17, Parashtrues *Česká Exportní Banka A.S,* Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 127 dhe KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 Dhjetorit 2018, paragrafi 65).

45. Përmes Aktgjykimit *Micallef kundër Maltës* (të vitit 2009), GJEDNJ kishte ndryshuar qëndrimin e saj të mëparshëm përkitazi me mos aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në "procedurat paraprake". Ndryshimin e këtij qëndrimi, GJEDNJ e kishte arsyetuar si në vijim:

"Përjashtimi i masave të përkohshme nga fushëveprimi i nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet kur shumë Shteteve Kontraktuese u duhet të përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që çon në procese të tej-zgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër ndalues shpesh ndodhë që është i barasvlershëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë edhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodhë që procedurat për masa të përkohshme dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat "detyrime dhe të drejta civile" dhe japin të njëjtat efekte afatgjata apo edhe të përhershme (Shih rastin e GJEDNJ-së: Micallef kundër Maltës, kërkesa. nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 79).

46. Bazuar në këtë Aktgjykim, Gjykata vërense, sipas praktikës së GJEDNJ-së, jo të gjitha masat e sigurisë/masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe zbatueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së për procedurat paraprake varet nga fakti nëse janë përmbushur disa kushte.

47. Së pari, e drejta në fjalë (që është objekt kontesti) duhet të jetë *"civile"*, si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së (Shih, *inter alia*, rastet e GJEDNJ-së: *Rafineritë Greke dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, nr. 13427/87, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 39, *Konig kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 6232/73, Aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafët 89-90, *Ferrazzini kundër Italisë*, kërkesa nr. 44759/98, Aktgjykimi i 15 korrikut 1999, paragrafët 24-31, *Roche v. Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 32555/96, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 119, *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 84).

48. Së dyti, GJEDNJ-ja thekson se duhet të vlerësohet natyra e masës së përkohshme/masës së sigurisë, meqenëse sa herë që një masë e tillë konsiderohet që përcakton (ndikon) në mënyre efektive të drejtën civile ose detyrimin në fjalë, neni 6 i KEDNJ-së do të jetë i zbatueshëm (Shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kunder Maltës*, Ibidem, paragrafi 85).

(ii) Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

49. Gjykata vëren se përmbajtja e të drejtës së pretenduar në rastin në fjalë, gjegjësisht kërkesa për UPGJ, ka të bëje me anulimin e vendimit për shitjen e pronës së kontestuar, përmes (ri)tenderimit në procesin e privatizimit. Kjo është një e drejtë e karakterit civil sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

50. Qëllimi i UPGJ, të kërkuar nga parashtruesi, ishte sigurimi i pretendimit kryesor të parashtruesit, që ka të bëjë me pronën e kontestuar. Parashtruesi e konsideron UPGJ-në masë të domosdoshme për ndalimin e shitjes së pronës së kontestuar, ndërkohë që gjykatat nuk kishin vendosur ende për meritat e çështjes (përkatësisht padinë e ushtruar me 27 shkurt 2018). Për më tepër, sa i përket kushtit të dytë, Gjykata vëren se UPGJ përcakton në mënyre efektive të drejtën civile në fjalë.

51. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh se e drejta e përfshirë në "procedurat paraprake" është një e drejtë civile dhe se UPGJ është përcaktuese për të drejtën civile në fjalë, Gjykata konstaton që rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, i përmbushin kriteret për aplikimin e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

52. Kësisoj, Gjykata do vlerësojë respektimin e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjatë procedurave të zhvilluara në DHPGJS, lidhur me kërkesën e parashtruesit për UPGJ .

(A) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

53. Gjykata vë në pah se Kolegji i Specializuar dhe ai i Apelit të DHPGJS kanë vendosur vetëm për kërkesën e paditësit (parashtruesit të kërkesës) për UPGJ, ndërsa nuk është marre ende një vendim për meritat e kërkesëpadisë.

54. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtoj vetëm pretendimet e parashtruesit përkitazi me vendimet e DHPGJS për kërkesën për UPGJ.

55. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje se parashtruesi pretendon se vendimet e DHPGJS kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 10, 31, 32, 46, 53, 54 të Kushtetutës.

56. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi në DHPGJS kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, ku kërkoi: (i) anulimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së lidhur me anulimin e shitjes të pronës së kontestuar; (ii) vërtetimin se paditësi është blerës i pronës së kontestuar; (iii) të obligohet AKP që në afat prej 30 ditësh të përmbyllte procedurat e shitjes (së pronës së kontestuar) dhe të mbulonte shpenzimet e procedurës kontestimore dhe (iv) lëshimin e Urdhrit Paraprak Gjyqësor (UPGJ), përmes të cilit do t'i ndalohej AKP-së ndërmarrja e veprimeve për tenderimin e pronës kontestuese, gjer në vendimin përfundimtar.

57. Por, Gjykata sjellë në vëmendje se thelbi i pretendimeve të parashtruesit ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në ndërlidhje me të drejtën e pronës.

58. Për sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi pretendon se gjatë procedurave në DHPGJS atij nuk i është ofruar mbrojtje adekuate dhe kështu ka ardhur deri te shkelja nga neni 31 i Kushtetutës, lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së.

59. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyeja kryesore për refuzimin e kërkesës për UPGJ të parashtruesit të kërkesës në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS ka qenë që *"[... paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin e UPGJ. Paditësi nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrojë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm do të shkaktohej në qoftë se UPGJ nuk do të lëshohej."*

60. Më tej Gjykata vëren që Kolegji i Apelit të GJPGJS ka arsyetuar si në vijim: *"Paditësi ka ofruar DHPGJS-së dëshmi e cila tregon se ai është shpallur fitues i përkohshëm i patundshmërisë në fjalë. Por kjo nuk do të thotë se ai e ka blerë këtë patundshmëri. Është bordi i drejtorëve të AKP-së, që në përputhje me autorizimet e tij sipas ligjit për AKP-në nr. 03/L-67 në mbështetje të rregullave të aplikueshme vendos për aprovimin apo anulimin e një shitje* [...] *Prandaj përkundër pritshmërive të ankuesit sidomos pas shpalljes së ofertës me çmim më të lartë, anulimi i tenderit nuk mund të konsiderohet si dëm i shkaktuar dhe për këtë nuk mund të kërkohet dëmshpërblim pikërisht për shkak*

të nenit 14 të Rregullave të tenderit të cilat parashohin anulimin e shitjes për shkak të çmimit të pa arsyeshëm."

61. Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe i Apelit të DHPGJS u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me interpretimin dhe zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

62. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu vëren që procedurat para Kolegjit të Specializuar dhe të Apelit të DHPGJS nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih rastin e GJEDNJ: *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).

63. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata përsërit që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara në aplikimin e ligjeve përkatëse që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykate e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do te vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave te rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih: *Garcia Ruiz kunder Spanjes,* paragrafi 28 i Aktgjykimit te GJEDNJ-se, te 21janarit 1999).

64. Gjykata me tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht në Kolegjin e Specializuar dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, apo për barazi para ligjit (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI91/18, me parashtrues: *Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019, paragrafi 66; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Mezőtúr-Tiszazugi Vízgazdálkodási Társulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

65. Gjykata konsideron se pretendimet dhe argumentet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës nuk tregojnë se procedurat pranë Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS ishin të padrejta apo

arbitrare, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit të kërkesës i është mohuar ndonjë garanci procedurale, që do të çonte në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(B) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

66. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe se refuzimi i kërkesës për masë të përkohshme do t'i humbiste kuptimin e kontestit lidhur me kërkesëpadinë e cila është në proces në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, ndalimi i shitjes së pronës së kontestuar deri në vendosjen meritore të çështjes është në interesin juridik të palës paditëse, por edhe në interes të drejtësisë në përgjithësi.

67. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI201/18, me parashtrues *Selami Taraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; KI83/18, me parashtrues *Ivica Milosevic*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; Shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: *Van der Mussele kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).

68. Në këtë kuadër, Gjykata i referohet interpretimeve të GJEDNJ, ku vihet në pah se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ-së vlen vetëm për "zotërimet" ekzistuese të një personi (shih *Marckx kundër Belgjikës*, paragrafi 50, Aktgjykim i 13 qershorit 1979; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* paragrafi 64).

69. Parashtruesi i kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e tij; brenda kuptimit te kësaj dispozite "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë "pritshmëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.

70. Në rrethana të caktuara, një "pritje legjitime" për të marrë një pronë mundet gjithashtu të gëzojë mbrojtje nga Neni 1 i Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së (*Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 17849/91, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31; *Grazinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 39794/98, Vendim për papranueshmëri i 10 korrikut 2002, paragrafi 73).

71. Por, sipas praktikës së GJEDNJ, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme (lidhur me konteste pronësore) dhe atje ku parashtresat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecky kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).

72. Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohen konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (nenit 31 të Kushtetutës). Kjo për faktin se, sipas parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Specializuar dhe ai i Apelit i DHPGJS kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur për kërkesën e tij për UPGJ.

73. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 para. 1 të KEDNJ-së, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesi ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.

74. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar fakte që do të tregonin se vendimet e gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.

75. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 10, Gjykata vëren se ky nen nuk hyn në kategorinë e të Drejtave dhe Lirive Themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të këtij neni duhet të ndërlidhet dhe të argumentohet me ndonjë të drejtë tjetër të paraparë në kapitullin II (Shih *mutatis mutandis* rastin e

Gjykatës: KI108/18, parashtrues Blerta Morina, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019, paragrafët 195-197).

76. Gjithashtu, sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 32të Kushtetutës, Gjykata vëren se parashtruesi vetëm ka përmendur shkeljen e këtij neni të Kushtetutës në rastin e tij, por një pretendim të tillë nuk e ka shtjelluar dhe mbështetur me argumente. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI 78/19, parashtrues i kërkesës *Miodrag Pavic*, Aktvendim për papranushmëri i 1 nëntorit 2019, paragrafi 56; KI136/14, parashtrues i kërkesës *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

77. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

78. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës si pretendim kryesor paraqiti vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej shitja e pronës së kontestuar deri në vendosjen meritore të çështjes nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS.

79. Gjykata tani më konstatoi se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

80. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa deklarohet e papranueshme (Shih në këtë kontekst rastin e Gjykatës: KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi* dhe *Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20, 27 të Ligjit dhe rregullin 39 (2), 57 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 9 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim ne Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI76/19, Parashtrues A. C., D. C., dhe F C., Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 48/2019, të datës 27 Mars 2019

KI76/19, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, publikuar më 19 dhjetor 2019

Fjalë kyçe: *Aktvendim për papranueshmëri, procedurë civile, kërkesë për mos-zbulim të identitetit, qartazi e pabazuar*

Objekti i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kundërshtuar, me të cilin pretendohet se shkelën të drejtat dhe liritë e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), si dhe nenin 41 (Shpërblimi i drejtë) e KEDNJ-së.

Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet për publikun, duke thënë *"se rasti konkret ka të bëjë me kompensimin që ndërlidhet drejtpërdrejt me humbjen tragjike të burrit dhe babait të parashtruesve të kërkesës, dhe prandaj konsiderojmë se ky rast është i ndjeshëm"*.

Në thelb, parashtruesit e kërkesës e ngritën një procedurë kontestimore përpara Gjykatës Themelore kundër kompanisë së sigurimeve për vdekjen, e bashkëshortit përkatësisht babait, si rrjedhojë e një fatkeqësie të trafikut.

Parashtruesit e kërkesës konsideruan se ekzistonte edhe përgjegjësia e pjesëmarrësit tjetër në fatkeqësinë e trafikut dhe, se prandaj, ata kishin të drejtë në kompensim monetar. Gjatë procedurës gjyqësore, gjykatat konkluduan se nuk kishte asnjë përgjegjësi të përbashkët për shkaktimin e fatkeqësisë së trafikut dhe se, prandaj, parashtruesit e kërkesës nuk mund të realizonin të drejtën e tyre për kompensim.

Parashtruesit e kërkesës u paraqitën para Gjykatës duke pretenduar se gjykatat e rregullta i bazuan vendimet e tyre në dispozitat e gabuara ligjore, dhe se në këtë mënyrë shkelën nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, shkresat e lëndës dhe vendimet e gjykatave, konstatoi se Gjykata Themelore, e Apelit dhe ajo Supreme në aktgjykimet e tyre i kanë trajtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me faktet, me ç'rast kanë konkluduar se faktet ishin vërtetuar drejtë nga Gjykata Themelore, dhe se prandaj, edhe

dispozita e nenit 154 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në lidhje me këtë, Gjykata erdhi në përfundim që parashtruesve të kërkesës nuk u ishin shkelur të drejtat nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në bazë të së cilit rrjedh se nuk ka pasur as shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.

Sa i përket pretendimeve të tjera në lidhje me nenin 41 të KEDNJ-së, gjykata konkludoi se ai nuk mund të shërbejë si bazë për të kërkuar "kompensim të drejtë" ose kompensim për dëmin jo material përpara Gjykatës Kushtetuese sepse ky nen ka të bëjë me kompetencat e GJEDNJ-së, dhe nuk është në juridiksionin e gjykatave vendore si pjesë përbërëse e mekanizmit mbrojtës të KEDNJ-së.

Sidoqoftë, sa i përket kërkesës për mbrojtjen e identitetit, Gjykata e miratoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës si të bazuar, duke marrë parasysh specifikën e procedurës konkrete.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI76/19

Parashtrues

A.C., D. C. dhe F. C.

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 48/2019, të 27 marsit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga A. C., D.C. dhe F. C. nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen nga Zaim Istrefi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 48/2019, të 27 marsit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3488/2014, të 14 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 1851/08, të 15 prillit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se parashtruesve të kërkesës u

janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6(E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 41 (Shpërblimi i drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht, duke pretenduar se "*në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin i cili është drejtpërdrejtë i ndërlidhur me humbjen tragjike të bashkëshortit dhe babait të parashtruesve të kërkesës, dhe rrjedhimisht konsiderojmë se ky rast është i ndjeshëm*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32.6 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më13 maj 2019, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 17maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu(kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më18 qershor 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin juridik të parashtruesve për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 7 nëntor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më11 dhjetor 2007, në rrugën Shtime-Prizren, kishte ndodhur një aksident i komunikacionit, në të cilin personi E. C., përndryshe bashkëshorti dhe babai i parashtruesve të kërkesës, humbi jetën.

11. Në bazë të raportit të policisë rezulton se deri te aksidenti ka ardhur në atë mënyrë që bashkëshorti dhe babai i parashtruesve të kërkesës, tani më i ndjerë, duke tejkaluar në vijën e plotë, e goditi automjetin "Volvo" i cili ishte duke lëvizur në shiritin e kundërt, dhe me këtë rast ai kishte pësuar lëndime trupore, nga të cilat ndërroi jetë në vendin e ngjarjes.

12. Parashtruesit e kërkesës, duke konsideruar se në këtë aksident ka ekzistuar edhe kontributi dhe përgjegjësia e drejtuesit të automjetit "Volvo", i cili ishte i siguruar në Kompaninë e Sigurimeve "Sigal" (në tekstin e mëtejmë: e paditura), paraqitën padinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër të padituës për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial. Parashtruesit e kërkesës në padinë e tyre kërkuan që e paditura t'iu paguajë shumën nga 7,000 € secilit prej parashtruesve të kërkesës, si dhe që t'iu kompensohet dëmi material në shumë prej 800 €, i cili do të zbritet për 60% për shkak të përgjegjësisë së të ndjerit.

13. Më 15 prill 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin C. nr. 1851/08, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore konkludoi:

> *"...nga provat e administruara gjykata konstatoi se deri te aksidenti i komunikacionit, ka rezultuar me fajin ekskluziv të tani të ndjerit E. C. dhe mbi bazën e kësaj paditësit nuk kanë të drejt kompensimi për dëmin jomaterial, për dhimbjet shpirtërore të pësuara për shkak të vdekjes së bashkëshortit përkatësisht babait si dhe për kompensimin e dëmit material për shkak të shpenzimeve të varrimit dhe ngritjes së lapidarit, në kuptim të nenit 154 të LMD-së ku është përcaktuar se "kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë të kompensoi në qoftëse provon se dëmi ka lindur për fajin e tij" e poashtu në kuptim të nenit 1.8 të Rregullës 3 të BQK-së, për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, akt ky i cili ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjes së siguruar, e në të cilën rregull është përcaktuar "shoferi përgjegjës për dëmin nuk ka drejtë të zhdëmtimit", përkatësisht nuk e ka statusin e personit të tretë".*

14. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 1851/08, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

15. Më 14 nëntor 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 3488/2014, me të cilin e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesve të kërkesës, duke theksuar se:

> *„Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, për këtë arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.*
>
> *Ekzistimi i fajësisë si basë për ekzistimin e të drejtës për kompensim të dëmit kërkohet edhe në bazë të nenit 154 të LMD-së, "kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij", si dhe nenit 178 të LMD-së, është përcaktuar se "Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë", që do të thotë se e paditura në rastin konkret nuk ka obligim që paditësve ti kompensoj dëmin e pësuar, pasi nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë dhe as me fajësi të vozitësit të automjetit të kamionit të markës Volvo, të siguruar te e paditura".*

16. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të procedurës kontestimore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

17. Më27 mars 2019, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 48/2019, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruese të kërkesës. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme theksoi:

> *"Në kërkesën për revizion thuhet se gabimisht është zbatuar e drejta materiale, nga se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë marrë parasysh faktin se drejtuesi i automjetit Volvo të siguruar te e paditura ka lëvizur me shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar.*

Këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara për të njëjtat shkaqe dhe arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë dhe ... sipas mendimit të ekspertit ky automjet ka lëvizur në shiritin e vet të djathtë të rrugës, ndërsa shpejtësia e lëvizjes së tij nuk është shkaktar i aksidentit....

Përndryshe nuk mund të detyrohet e paditura për kompensim të dëmit pasi që është provuar se dëmi është shkaktuar pa fajin e të siguruarit të saj, kështu që nuk janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e të paditurës për kompensim dëmi të parashikuara me nenin 154 të LMD-së".

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duke vepruar në kundërshtim me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, ua mohuan atyre të drejtën për kompensim të dëmit për shkak të humbjes së anëtarit të familjes, sepse e vërtetuan gabimisht gjendjen faktike dhe zbatuan gabimisht të drejtën materiale.

19. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se e drejta për kompensim të dëmit material dhe jomaterial është e drejtë kushtetuese e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, nenin 200 të LMD-së dhe me nenin 6 dhe nenin 41 të KEDNJ-së.

20. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se ata nuk mund ta pranojnë konstatimin e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit, si dhe të Gjykatës Supreme se kërkesëpadia e tyre refuzohet për shkak se bashkëshorti dhe babai i parashtruesve të kërkesës, tani më i ndjerë, ka qenë shkaktar i aksidentit të komunikacionit dhe se mbi bazën e kësaj, ata nuk kanë të drejtë për kompensim, duke u mbështetur në dispozitat ligjore nga neni 154 të LMD-së.

21. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, me aktgjykimet e lartcekura, kanë bërë interpretim të gabuar të dispozitave të LMD-së, kur kanë konstatuar se parashtruesve të kërkesës nuk iu takon e drejta për kompensim.

22. Parashtruesit, gjithashtu, pretendojnë se me konstatimet e tilla të gjykatave *"iu kanë shkelur të drejtat dhe liritë individuale të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut e që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës*

(kushtetutshmëria e aktgjykimeve), respektivisht neni 6 "E drejta për proces të rregullt" i KEDNJ, neni 41 "Shpërblimi i drejtë" i KEDNJ-së, si dhe neni 54 "Mbrojtja gjyqësore e të drejtave", neni 31 "E drejta për Gjykim të drejtë dhe të paanshëm" i Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

23. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata të aprovojë kërkesën e tyre, të anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta, ta kthejë çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore, ku do t'iu njihej e drejta për kompensim të dëmit për shkak të vdekjes tragjike të bashkëshortit, përkatësisht babait të tyre.

24. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht, duke pretenduar se "*në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin i cili është i ndërlidhur me humbjen tragjike të bashkëshortit dhe babait të parashtruesve të kërkesës, dhe rrjedhimisht konsiderojnë se ky rast është i ndjeshëm*".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Interesuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 48/2019, të 27 marsit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë theksuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën e tyre në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

29. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

30. Gjykata, duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesve, konstaton se shkeljet e neneve 54 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe të neneve 6 dhe 41 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës i ndërlidhin me faktin se

gjykatat e rregullta nuk e pranuan kërkesëpadinë e tyre me të cilën kishin kërkuar kompensimin monetar për shkak të humbjes së fatkeqe të bashkëshortit, përkatësisht babait.

31. Më konkretisht, Gjykata vëren se edhe përkundër faktit se parashtruesit e kërkesës kanë deklaruar shkeljen e shumë neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, thelbi i kërkesës së parashtruesve ka të bëjë me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

Pretendimet e shkeljes së Nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

32. Lidhur me këtë, Gjykata, para së gjithash, vëren se procedura në fjalë ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave civile të parashtruesve të kërkesës, më konkretisht, të së drejtës për kompensimin monetar në lidhje me kërkesëpadinë të cilën e kishin iniciuar para Gjykatës Themelore lidhur me aksidentin e komunikacionit. Prandaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me një çështje të natyrës civile-juridike dhe nga kjo rezulton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së janë të zbatueshëm.

33. Me analizën e mëtejme të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës me të cilat ata tentojnë t'i arsyetojnë shkeljet e të drejtave kushtetuese dhe të drejtave të garantuara me KEDNJ, Gjykata vëren se si bazë për të gjitha këto shkelje, ata përmendin faktin se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe se me këtë janë sjellë në një situatë ku ata nuk mund ta realizojnë të drejtën për kompensimin monetar.

34. Lidhur me këtë, Gjykata, para së gjithash, tregon se sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese, detyra e këtyre gjykatave nuk është rishikimi i konkluzioneve të gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë,* të 30 qershorit 2005, kërkesa numër 65167/01).

35. Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për të zëvendësuar gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, por në përgjithësi, është detyrë e gjykatave të rregullta që të vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i administruan (shih, GJEDNJ, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykimi i 10 majit 2005, kërkesa numër 19354/02). Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të shqyrtojë nëse, eventualisht, janë shkelur ose neglizhuar të drejtat kushtetuese

(e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht, arbitrar ose diskriminues.

36. Prandaj, Gjykata do të lëshohet përjashtimisht në shqyrtimin e mënyrës në të cilën gjykatat kompetente i kanë vërtetuar faktet dhe zbatuar rregulloret pozitive juridike, atëherë kur është evidente se në një procedurë të caktuar ka ekzistuar mënyra arbitrare e veprimit të gjykatës së rregullt, si në procedurën e vërtetimit të fakteve, ashtu edhe në procedurën e zbatimit të rregulloreve relevante pozitive juridike.

37. Lidhur me këtë, Gjykata, duke sjellë në lidhje pretendimet e parashtruesve për shkelje të të drejtave nga neni 31 i Kushtetutës, të cilat, sipas pretendimeve të tyre, si pasojë çuan edhe në shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, gjen se ata, me qëllim të realizimit të kompensimit monetar për shkak të aksidentit të komunikacionit, i cili rezultoi me një përfundim tragjik, iniciuan procedurën civile me kërkesëpadinë.

38. Gjykata vëren se Gjykata Themelore, me qëllim të vërtetimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, i zbatoi të gjitha veprimet dhe i administroi provat, si dhe raportet dhe mendimet e ekspertëve, dhe me atë rast konkludoi se kërkesëpadia nuk mund të realizohet për faktin se në mënyrë të pakundërshtueshme është vërtetuar përgjegjësia e personit i cili u bë viktimë për aksidentin e komunikacionit.

39. Gjykata më tej vëren se vërtetimi i një gjendje të tillë faktike, për rrjedhojë ndikoi në Gjykatën Themelore që të konkludojë se në rastet e tilla, siç është rasti i parashtruesve të kërkesës, zbatohen dispozitat e nenit 154 të LMD-së, me të cilat rregullohet se kush, në cilat raste dhe në cilat kushte duhet të kompensojë dëmin, respektivisht e ka të drejtën për kompensim monetar.

40. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në aktgjykimet e tyre janë marrë me pretendimet ankimore të parashtruesve të kërkesës në lidhje me gjendjen faktike dhe me atë rast kanë konkluduar se faktet janë vërtetuar drejtë nga Gjykata Themelore dhe se rrjedhimisht është zbatuar drejtë edhe dispozita e nenit 154 të LMD-së.

41. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos e vërejë se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme janë marrë edhe me çështjen e ngritur para tyre nga parashtruesit të kërkesës në lidhje me "*përgjegjësinë e ndarë të pjesëmarrësve në aksidentin e komunikacionit*", si me bazën e

mundshme e cila do t'iu kishte mundësuar atyre fitimin e të drejtës për kompensimin monetar.

42. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme e shpjeguan këtë pretendim ankimore me qëndrimin se gjatë procedurës gjyqësore nuk është vërtetuar përgjegjësia e ndarë e pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit, dhe për këtë arsye nuk ekziston as përgjegjësia e tyre e ndarë në shkaktimin e aksidentit, dhe kështu nuk ekziston as faji i drejtuesit të automjetit "Volvo" i cili ishte i siguruar në Kompaninë e Sigurimeve e cila është paditur nga parashtruesit e kërkesës. Nga kjo rezulton se në këtë rast zbatohet neni 178 i LMD-së, në të cilin përcaktohet se: *"Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë"*. Në bazë të kësaj mund të konkludohet se e paditura në këtë rast nuk ka asnjë obligim ndaj parashtruesve të kërkesës.

43. Nga të gjitha që u thanë më lart, Gjykata gjen se në aktgjykimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme nuk ka asgjë që do të çonte në përfundimin se ka ekzistuar mënyra arbitrare e veprimit të gjykatave, si në procedurën e vërtetimit të fakteve, ashtu edhe në procedurën e zbatimit të rregulloreve relevante pozitive juridike.

44. Në kontekstin e asaj që u tha më lartë, Gjykata gjithashtu konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës, janë të pabazuara, sepse mbi bazën e të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstatoi se në këtë proces gjyqësor të cilin ajo e kishte analizuar parashtruesit e kërkesës kishin mbrojtje gjyqësore në shkallën në të cilën ajo ishte e mundur dhe e parashikuar në një fazë të caktuar, duke marrë parasysh specifikën e kërkesëpadisë, gjë e cila gjithashtu mund të shihet nga të gjitha veprimet e ndërmarra nga gjykatat. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata nuk arriti të vërejë se mbrojtja gjyqësore e parashtruesve ishte e kufizuar ose e ndaluar me vendim të ndonjë autoriteti (shih vendimin e Gjykatës në çështjen KI 159/18, me parashtrues të kërkesës *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmërinë, i datës 6 maj 2019, paragrafi 84).

45. Në lidhje me këtë, Gjykata konkludon se e drejta e parashtruesve të kërkesës nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është shkelur, kështu që rrjedh se nuk ekziston as shkelje e nenit 54 të Kushtetutës.

46. Gjithashtu, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk ofrojnë fakte që mund të justifikojnë pretendimin se ekziston shkelja e të drejtave kushtetuese në të cilat thirren, prandaj, nuk ekzistojnë as elementet të cilat *prima facie* tregojnë se shkelja e të drejtave kushtetuese nga neni 54, 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së është e mundur dhe se do të ishte i nevojshëm një shqyrtim meritor.

47. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesve të kërkesës t'i mbështesin pretendimet e tyre kushtetuese dhe të paraqesin ndonjë provë *prima facie* që tregon për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* të 5 dhjetorit 2013).

48. Prandaj, kërkesa e parashtruesve është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet e tjera

49. Gjykata në kërkesë gjen se parashtruesit e kërkesës pretendojnë edhe shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 41 (Shpërblimi i drejtë) të KEDNJ-së, prandaj ata kërkuan shpërblim te drejtë. Gjykata citon paragrafin 41 i cili në pjesën relevante thotë:

> *„Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar".*

50. Gjykata, në këtë aspekt vëren dhe konstaton se neni 41 i KEDNJ-së nuk mund të shërbejë si bazë për të kërkuar "shpërblim të drejtë" apo kompensim për dëm jo-material para Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se ky nen i referohet kompetencave të GJEDNJ-së dhe jo kompetencave të gjykatave vendore pjesë anëtare të mekanizmit mbrojtës të garantuar me KEDNJ.

51. Megjithatë, Gjykata është e lidhur dhe e kushtëzuar që të veprojë vetëm në bazë të rregullativës ligjore dhe procedurale që e rregullon punën e saj. Në asnjërin nga dokumentet të cilat e rregullojnë fushë-veprimtarinë dhe procedurat para kësaj Gjykate dhe veprimet që kjo e fundit mund të ndërmarrë, nuk parashihet një autorizim ekuivalent për të akorduar "shpërblim të drejtë", ashtu siç një kompetencë e tillë

qartazi i përshkruhet GJEDNJ-së me nenin 41 të KEDNJ-së në lidhje me rregullin 60 të Rregullores së punës së GJEDNJ-së.

52. Gjykata, duke pasur parasysh përmbajtjen e tekstit të nenit 41 të KEDNJ-së, konstaton se i njëjti nuk është i zbatueshëm në rastin konkret, prandaj ajo nuk do t'i trajtojë pretendimet në fjalë.

Kërkesa për moszbulimin e identitetit

53. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht, duke pretenduar se "*në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin i cili është i ndërlidhur me humbjen tragjike të bashkëshortit dhe babait të parashtruesve të kërkesës, dhe rrjedhimisht konsiderojnë se ky rast është i ndjeshëm*".

54. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë [...]."*

55. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8.1. të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, i cili përcakton:

> *"Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme".*

56. Gjykata, duke marrë parasysh tërë procedurën kontestimore, vëren se në kohën kur filloi procedura, disa parashtrues të kërkesës i përkisnin kategorisë së personave të mitur dhe se ata kishin pasur këtë status gjatë kohëzgjatjes së procedurës kontestimore. Bazuar në dosja e rastit del gjithashtu se, duke marrë parasysh këtë fakt, si dhe vlerësimet e dëshmitarëve ekspertë dhe shërbimet përkatëse sociale, gjykatat konkluduan se ata, si të tillë gjatë rrjedhës së procesit gjyqësor pësuan dhimbje mendore dhe psikike për shkak të humbjes së babait të tyre, dhe kësisoj bien në kategorinë grupit veçanërisht të ndjeshëm.

57. Prandaj, në përputhje me këtë duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës, shkresat e lëndës, si dhe gjetjet e gjykatave të rregullta, Gjykata konsideron se në rastin konkret ka rrethana të veçanta të cilat mund të merren parasysh dhe të pranojë kërkesën për mbrojtje të identitetit, pasi që në çështjen familjare publiku mund,

madje edhe në mënyrë të tërthortë, të ndikojnë në identitetin, emrin dhe marrëdhëniet familjare të fëmijëve.

58. Prandaj, në pajtim me nenin 8.1. të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rregullin 32 (6) të Rregullores së punës, Gjykata e aprovon kërkesën e parashtruesve të kërkesës për moszbulimin e identitetit të tyre në publik.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 32.6 dhe 39.2 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TË MIRATOJË njëzëri kërkesën për moszbulim të identitetit;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Arta Rama-Hajrizi

KI122/18, Parashtrues: Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.128/2018, 23 prillit 2018

KI122/18, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 nëntorit 2019, publikuar më 19 dhjetor 2019

Fjalët kyçe*: kërkesë individuale, person juridik, qartazi e pabazuar,*

Parashtruesi i kërkesës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës kishin nënshkruar Marrëveshje të Partneritetit Publiko Privat (PPP), dhe bazuar në këtë marrëveshje parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që të gjithë punëtorët t'i mbajë në marrëdhënie të punës edhe për 3 (tre) vite të tjera.

Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës, e kishte njoftuar punëtorin XH.S.. se nuk do t'i përtërihet kontrata e punës. Punëtori XH.S. kishte parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë dhe padia e tij u aprovua. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës pranë gjykatave të rregullta pretendonte se gjykatat e rregullta nuk kishin marrë për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës merr për obligim që punëtorët t'i mbajë në punë edhe për 3 (tre) vjet.

Gjatë procedurave pranë gjykatave të rregullta, këto të fundit i kishin sqaruar parashtruesit të kërkesës se meqenëse punëtori XH.S. kishte më shumë se dhjetë (10) vite pune, në bazë të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore kështu që edhe për ndërprerjen e kontratës së punës duhet të respektohen procedurat e përcaktuara ligjore, procedura këto që sipas gjykatave të rregullta parashtruesi i kërkesës nuk i kishte respektuar.

Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij pranë Gjykatës Kushtetuese, pretendoi shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës për shkak të vendimit të paarsyetuar, si dhe neneve 32 dhe 46 të Kushtetutës, dhe përsëriti pretendimet e tij si pranë gjykatave të rregullta.

Gjykata Kushtetuese, duke i adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, konstatoi se ky i fundit dështoi të paraqesë prova, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe Gjykata nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtruesit të kërkesës për shkak që shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me nenet 32 dhe 46 të Kushtetutës ai i pretendoi si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI122/18

Parashtrues

Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.128/2018, 23 prillit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport "Adem Jashari"(në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, Komuna e Lipjanit, të përfaqësuar me autorizim nga Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 128/2018 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 23 prillit 2018.

3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 16 maj 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 23 gusht 2018, në pajtim me rregullin 40.1 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18. Gjyqtar raportues në të gjitha rastet u caktua gjyqtari Bekim Sejdiu.

8. Më 11 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, për të gjitha kërkesat e bashkuara, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban.

9. Më 13 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për bashkimin e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.

10. Më 14 shtator 2018, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin dhe bashkimin e rasteve dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesat lidhur me lëndët: KI36/18, KI81/18, KI82/18 dhe KI124/18.

11. Më 1 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë i dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat e kërkuara.

12. Më 17 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë në Gjykatë, ku kërkoi që kërkesa me nr. KI109/18 të shqyrtohet ndaras nga kërkesa me nr. KI36/18, duke pretenduar se rastet nuk janë të së njëjtës natyrë.

13. Më 5 prill 2019, Gjykata shqyrtoi dhe e miratoi kërkesën e parashtruesit lidhur me ndarjen e kërkesës KI109/18 nga kërkesa me numër KI36/18. Po ashtu, Gjykata në përputhje me rregullin 40 (3) të Rregullores së punës vendosi që kërkesat KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18 të shqyrtohen ndaras, me të njëjtin gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues.

14. Më 11 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për ndarjen e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.

15. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi në Gjykatë një parashtresë të titulluar "*Parashtresë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese, dhe në veçanti për lëndën e regjistruar në Gjykatën Kushtetuese me numër 132/18",* në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që i kishte bërë më parë.

16. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi në Gjykatë, një parashtresë të titulluar "*Parashtresë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese",* në të cilën ai i ripërsëriti pretendimet që i kishte bërë më parë.

17. Më 6 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

18. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar një Marrëveshje të Partneritetit Publiko Privat (në tekstin e mëtejmë: MPPP). Para marrëveshjes së MPPP-së, Aeroporti i Prishtinës është quajtur Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës " Adem Jashari" (në tekstin e mëtejmë: ANP). Bazuar në Marrëveshjen e MPPP-së, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që punëtorët t'i mbajë në punë edhe për 3 (tre) vite të tjera.

19. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se XH.S. (në tekstin e mëtejmë: punëtori) kishte qenë i punësuar tek ANP-ja nga data 1 dhjetor 1999 deri më 3 prill 2011.

20. Pas nënshkrimit të MPPP-së, punëtori ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune te parashtruesi i kërkesës nga 4 prilli 2011 deri më 3 prill 2014.

21. Më 3 mars 2014, përkatësisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës, parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar punëmarrësin se nuk do t'i ofrohet kontratë e re e punës pas skadimit të kontratës ekzistuese me arsyetimin se kontrata nuk po i vazhdohet me *"[...] politikat e Bordit të Drejtorëve për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore"*.

22. Më 13 mars 2014, punëtori ka parashtruar ankesë tek parashtruesi i kërkesës (punëdhënësi) lidhur me njoftimin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, duke kërkuar që i njëjti të anulohet.

23. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e punëtorit.

24. Sipas shkresave të lëndës, vërehet se më 27 mars 2014, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës i Kosovës, përmes Vendimit Vn.45/2014, kishte urdhëruar parashtruesin e kërkesës "*që të zbatonte dispozitat e neneve 10.5dhe 71 ë Ligjit të Punës Nr.03/L-212*".

25. Në një datë të pasaktësuar, punëtori paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), ku kërkoi që të anulohet Njoftimi i 3 marsit 2014, i lëshuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës që punëtorin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet dhe shpërblim të dëmit.

26. Më 25 maj 2015, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit C. nr.208/2014, ka aprovuar kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar dhe detyroi parashtruesin e kërkesës (gjegjësisht punëdhënësin) që: (i) ta kthejë në punë punëtorin (ii) t'ia paguajë shumën përkatëse punëtorit në emër të dëmit material dhe (iii) punëtorit t'ia paguajë shumën e të ardhurave për periudhën prej 4 prillit 2014 deri më 31 maj 2015 (iv) të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.

27. Gjykata Themelore kishte arsyetuar se punëtori në mënyrë të pandërprerë ka punuar për 10 (dhjetë) vjet te parashtruesi i kërkesës dhe paraardhësi i tij në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari". Më tutje, Gjykata Themelore konstatoi se "*në bazë të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, Gjykata erdhi deri te përfundimi se mardhënja e punës ne kohë të caktuar e paditëses tek e paditura konsiderohet mardhënje e punës në kohë të pacaktuar, andaj gjykata konsideron se me këtë situatë e paditura për me ja shkëpute kontratën e punës paditëses ka qen e obliguar që të udhëheqë procedurë të brendshme për ndërprerje të mardhënjes se punës, procedurë kjo e cila nuk është udhëhequr tek e paditura, por paditësja vetëm është njoftuar me njoftimin për mospërtritjen e kontratës së punës.*"

28. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr.208/2014, në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

29. Më 11 janar 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AC.nr.3625/2015 kishte refuzuar, si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (C. nr.208/2014) duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e Apelit kishte arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhënë shpjegime adekuate për një vendosje të këtillë të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.

30. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

31. Më 23 prill 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev.nr.128/2018, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke e vlerësuar vendimin e goditur si të drejtë dhe se janë

dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje.

32. Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ndër të tjera, theksohet se "*[...] refuzon pretendimet se prej momentit të nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Qeverisë së Kosovës dhe të paditurës, paditësja nuk ka më tepër se 3 vite përvojë pune. Ky fakt është pa ndikim, ndërsa me rëndësi është që paditësi në të njëjtin vend pune punon më tepër se 10 vite, dhe kontrata e saj e punës konsiderohet në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohor, kështu që të njëjtës ka pasur mundësi t'i ndërpritet marrëdhënia e punës vetëm nën kushtet e parapara në nenin 70 të Ligjit të cekur, e kurrsesi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës. Në rastin konkret me njoftimin ashtu siç ka vepruar e paditura, nuk ka pas mundësi që paditëses mos t'i vazhdohet kontrata e punës kur ligjërisht kontrata e saj e punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.*"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në vendimin e saj. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi thekson se: "*aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka arsyetim të mjaftueshëm, sidomos në lidhje me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (erores in procedanto) të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*"

35. Parashtruesi i kërkesës, pohon se Gjykata Supreme në aktgjykimin përkatës ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale "*erores in judicando*" dhe ka interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 dhe MPPP-së sepse, sipas parashtruesit, punëmarrësi nuk kishte 10 (dhjetë) vjet pune të pandërprerë tek parashtruesi.

36. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme do të duhej të kishte marrë parasysh nenin 9.18 të MPPP-së sipas së cilit

parashtruesi i kërkesës merr për obligim t'i mbajë punëtorët në punë me afat prej tre (3) vitesh.

37. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu citon Aktgjykimin KI138/15 e Gjykatës Kushtetuese dhe pohon se *"aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate porse Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material"*.

38. Andaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin e saj dhe nuk i ka trajtuar çështjet e ngritura me aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

39. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe që çështja të kthehet në rigjykim.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 10
[Kontrata e Punës]

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

2.1. një periudhë të pacaktuar;

2.2. një periudhë të caktuar; dhe

2.3. për punë dhe detyra specifike.

3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.

4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të

punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 67
[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:
[...]
1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

Neni 70
[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1.Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:
1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;
1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajnojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;
1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:
1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe
1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.
1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;
1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:
1.6.1. i punësuari është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;
1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.
2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e

performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejmë me shkrim.
[...]

Neni 71
[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:
1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;
1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;
1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.
2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Marrëveshja për Partneritet Publiko privat për Operimin dhe Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

9.18 [Përfundimi i Personelit]

"Partneri Privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet , rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuar (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët , dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të Datës së hyrjes në fuqi."

Pranueshmëria e kërkesës

40. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

42. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës (si person juridik) ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par.14).

44. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

3. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

4. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afati]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]."

45. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston aktet e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur përmes vendimit të kontestuar, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

46. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

47. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, ndërsa shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ parashtruesi i paraqet si pasojë e shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

48. Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës është që Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm Aktgjykimin e saj dhe ka interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 sepse

sipas parashtruesit, punëmarrësi nuk kishte 10 (dhjetë) vjet pune të pandërprerë tek parashtruesi. Më tutje, parashtruesi i kërkesës e kishte argumentuar këtë duke u mbështetur në nenin 9.18 të MPPP-së sipas së cilit ky i fundit merr për obligim t'i mbajë punëtorët në punë me afat prej 3 (tre) vitesh. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon në shkelje të së drejtës së tij kushtetuese për mjete efektive juridike si pasojë e mungesës së arsyetimit të vendimit të kontestuar.

49. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta e kanë interpretuar gabimisht ligjin kur i janë referuar përvojës së punës së punëtorit, duke pretenduar se gjykata në rastin në fjalë do të duhej të konsideronte se bëhet fjalë për dy punëdhënës të ndryshëm (duke iu referuar kështu Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari", para dhe pas nënshkrimit të MPPP) dhe duke theksuar se punëtori nuk i kishte më shumë se 10 (dhjetë) vjet pune tek parashtruesi i kërkesës.

50. Përkitazi me këto pretendime të parashtruesit, Gjykata fillimisht vë në pah se Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të kërkesës për revizion të parashtruesit arsyetoi se "*paditësja në të njëjtin vend pune punon më tepër se 10 vite, dhe kontrata e saj e punës konsiderohet në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohor, kështu që të njëjtës ka pasur mundësi t'i ndërpritet marrëdhënia e punës vetëm nën kushtet e parapara në nenin 70 të Ligjit të cekur, e kurrsesi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës.*"

51. Lidhur me pretendimet konkrete të parashtruesit të kërkesës për zbatueshmërinë e nenit 9. 18 të MPPP-së, Gjykata Supreme arsyetoi "*Në këtë dispozitë të të kësaj marrëveshje, parashihet që partneri privat (këtu i padituri) mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP-së në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara sipas marrëveshjes së përbashkët dhe pa kufizime pas përvjetorit të tretë të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje. Nga kjo dispozitë rezulton se nuk parashihet ndërprerja e kontratave të ngjashme të punësimit sikur tek rasti i paditëses, në kundërshtim me ligjet ekzistuese në Kosovë."*

52. Në dritën e këtyre argumenteve të Gjykatës Supreme, Gjykata konstaton se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të cilat ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit të tij, janë parashtruar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjykata

konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI128/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019, KI129/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, KI130/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019).

53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thirret në Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese, duke pohuar se *"aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e Aktgjykimit të asaj gjykate por se Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material."*

54. Sa i përket këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se rasti i përmendur dallon nga rasti i cili gjendet para nesh, për shkak të këtij arsyetimi: (i) çështja e procedurës disiplinore kundër të punësuarit tek parashtruesi i kërkesës në atë rast është shqyrtuar në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) nuk ka qenë e qartë baza juridike, sipas së cilës është zhvilluar procedura disiplinore; (iii) kanë ekzistuar elementet kontradiktore në vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit e aplikoi dhe shfrytëzoi për arsyetim Udhëzimin Administrativ i cili rezultoi nga Rregullorja për Shërbimin Civil, e jo nga Ligji i Punës. Ky argument, edhe pse është ngritur nga parashtruesi i kërkesës në këtë rast, nuk është shqyrtuar nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH,* Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).

55. Në dritën e trajtimeve të mësipërme, Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, para. 28).

56. Vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejtë i ligjit është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis,* rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).

57. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur nga vendimet e autoriteteve publike.

58. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesave nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme (dhe gjykatave të shkallës më të ulët) nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

59. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, gjegjësisht me nenet 24, 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

60. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 6 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT	NUMRI I FAQEVE
A	
ad personam	441, 446, 447, 457, 461, 463, 464, 465
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	589, 599, 753, 765, 974, 978, 990, 993, 994, 996, 1002, 1003
Agjencia e Regjistrimit Civil	331, 332, 373, 807, 842, 854, 855, 859, 864, 865, 866, 868, 878, 895, 908, 909
Aktgjykim	13,25,55,123,157,185,214,228, 319, 373, 396, 440, 483, 499, 521, 545
Aktvendim për Papranueshmëri	586, 597, 616, 628, 643, 664, 667, 691, 704, 717, 734, 750, 765, 795, 842, 904, 926, 937, 951, 974, 993
Amendament i propozuar kushtetues	133, 134, 137, 192
Autoritete(t) publike	68, 71, 90, 120, 263, 271, 286, 297345, 355, 381, 421, 425, 467, 490, 507, 529, 561, 576, 591, 609, 621, 637, 655, 670, 687, 696, 697, 711, 726, 742, 759, 782, 806, 820, 822, 830, 836, 839, 878, 886, 903, 916, 917, 932, 945, 959, 981, 1000, 1018
Avokati i Popullit	32, 34, 55, 58, 62, 63, 64, 66, 67, 68, 69, 71, 73, 79, 88, 89, 90, 100, 113, 113, 114, 116, 136, 171, 173, 179, 185, 187, 193, 222, 268, 350, 778, 779, 790, 791, 847, 848, 858, 861, 871, 872, 873, 874, 892
B	
Barazia para Ligjit	25, 26, 27, 31, 40, 41, 51, 53, 104, 107, 121, 399, 425, 435, 483, 485, 497, 582, 643, 645, 648, 719, 721, 752, 757, 760, 766, 769, 778, 783, 785, 829, 842, 846, 855, 926, 954, 957, 958, 961, 962, 972

D

Delegacioni Shtetëror	125, 126, 140, 145, 146, 147 148, 149, 150, 151, 152
Deputetët	113, 115, 118, 124, 127, 130, 131, 133, 135, 138, 141, 142, 145, 157, 158, 159, 160, 162, 163, 164, 166, 168, 171, 172, 174, 176, 177, 178, 183, 188, 194, 217, 218, 224, 290, 297, 336, 358
Dëmet e luftës	745
Dorëheqja e Kryeministrit	214, 210, 219, 224, 225, 230

DH

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS)	8, 594, 663, 667, 668, 669, 750, 752, 753, 756, 757, 974, 976, 977, 978, 979, 980, 982, 983, 986, 987, 988, 989, 990, 991

E

E Drejta

aktive zgjedhore	319, 320, 363
e Lirisë dhe Sigurisë	545, 548, 550, 556. 564, 575, 577, 580, 929
e punës dhe ushtrimit të profesionit	71, 907, 915, 923
pasive zgjedhore	319, 320, 361, 363
për jetë private	842, 877, 899
në pronë	34, 41, , 44, 46, 185, 207, 210, 595, 641, 674, 715
për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	116, 287, 375, 379, 380, 382, 383, 394, 396, 399, 425, 426, 435, 437, 440, 441,

443, 444, 453, 454, 460, 461, 464, 465, 466, 467, 472, 482, 483, 495, 498, 499, 500, 503, 506, 508, 520, 524, 525, 528, 536, 540, 548, 555, 525, 557, 588, 592, 594, 610, 616, 617, 618, 623, 624, 628, 631, 639, 641, 666, 669, 691, 673, 704, 707, 711, 717, 719, 722, 727, 732, 744, 750, 757, 760, 764, 798, 802, 829, 832, 877, 907, 913, 922, 926, 928, 929, 938, 947, 948, 954, 974, 975, 982, 983, 987, 988, 989, 990, 1000, 1008, 1010, 1014, 1019

për mjete juridike 94, 235, 291, 399, 443, 450, 453, 617, 619, 653, 619, 653, 659, 678, 681, 684, 720, 753, 758, 761, 762, 787, 830, 957, 975, 977, 981, 984, 1011, 1015

për pension 826, 827, 828, 835, 836

për proces të rregullt 380, 382, 383, 394, 396, 399, 425, 426, 435, 437, 440, 441, 443, 444, 453, 454, 460, 461, 464, 465, 466, 467, 470, 482, 483, 495, 498, 499, 500, 502, 506, 509, 520, 524, 525, 528, 543, 558, 593, 601, 603, 616, 618, 623, 639, 666, 704, 707, 711, 719, 722, 737, 740, 752, 757, 760, 798, 802, 816, 829, 907, 915, 918, 958, 961, 962, 993, 1000, 1010, 1014

për shitblerje 487

për vendim të arsyetuar 373, 382, 384, 385, 394, 396, 397, 398, 416, 417, 425, 426, 427, 434, 435, 438, 469, 470, 472, 480, 481, 493, 495, 496, 568, 803, 816, 817, 919, 921

F

Forumi i Komisionit të Venecias 333, 848, 849, 874, 889

G

Grupet parlamentare 157, 158, 159, 164, 165, 160, 167, 169, 170, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182

Gjuhët 185, 188, 191, 195, 196, 197, 199, 212, 213, 1031

Gjykatë e (pa)anshme 461

GJ

Gjykata

e Apelit 465, 469, 183, 187, 488, 496, 496, 506, 521, 527, 532, 545, 551, 553, 555, 569, 570, 571, 604, 605, 611, 628, 635, 636, 695, 401, 721, 729, 730, 738, 739, 744, 775, 776, 790, 802, 803, 815, 826, 828, 835, 843, 851, 857, 876, 894, 895, 897, 904, 906, 909, 912, 913, 919, 920, 930, 937, 938, 941. 942, 943, 947, 948, 949, 956, 998, 999, 1003, 1004

Themelore 900, 904, 907, 908, 909, 912, 916, 930,940, 941, 952, 954, 955, 956, 958, 959, 961, 966, 967, 969, 971, 993, 997,999, 1003, 1011, 1012, 1013

Supreme 5, 25, 27, 31, 32, 38, 40, 228, 229, 323, 337, 238, 239, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 256, 257, 268, 271, 272, 276, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 286, 287, 288, 289, 290, 293, 295, 296, 297, 306, 308, 309, 312, 313, 316, 326, 329, 330, 334, 337, 338, 339, 367, 369,373378, 379, 382, 383, 385, 386, 387, 388, 389, 390, 391, 392, 393, 394, 396, 397, 398, 400, 404, 405, 406, 408, 414, 416, 417, 418, 420, 421, 425, 429, 430, 431, 432, 433, 434, 435, 436, 437, 463, 466, 467, 469, 471, 472, 476, 479, 480, 501, 504., 506, 510, 512, 522, 523, 526, 527, 528, 530, 537, 539, 541, 542, 549, 553, 554, 555, 571, 572, 600, 604,

605, 611, 612, 620, 621, 625, 626, 628, 633, 636, 640, 641, 677, 678, 682, 683, 685, 688, 691, 696, 701, 702, 718, 722, 723, 730, 731, 734, 736, 739, 744, 745, 822, 824, 826, 835, 836, 879, 880, 881, 882, 884, 885, 904, 906, 909, 913, 914, 915, 918, 919, 920, 920, 921, 924, 930, 931, 933, 937, 938. 941, 942, 943, 947, 948, 949, 957, 961, 998, 999, 1003, 1003, 1013, 1014, 1015, 1013, 1020, 1021

M

Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave — 228,232, 235, 243, 254, 568, 443, 450, 453, 450, 453, 601, 605, 613, 614, 677, 680, 683, 737, 740, 752, 757, 760, 792, 798, 802, 829, 940, 944, 946, 950, 974, 977, 980, 983, 993, 996, 99, 1000, 1004, 1032

Mendim Mospajtues — 7, 578

I

Imunitet funksional — 115, 118

Institucionet e Pavarura — 62, 65, 68, 70, 71, 72, 73, 85, 88, 92, 93, 94, 96, 98, 120, 179

J

Jurisdiksioni i Gjykatës Kushtetuese — 214

K

Kërkesë e bashkuar — 723, 741, 744, 1002

Kërkesë e paafatshme — 677, 678, 690, 762

Kërkesë e papranueshme — 214, 616, 691, 822, 926, 974, 1026

Kërkesë e pranueshme 13, 25, 440, 483, 545, 1026

Kërkesë individuale 319, 373, 440, 461, 480, 483, 499, 521, 545, 586, 597, 616, 628, 643, 655, 659, 664, 677, 691, 704, 717, 734, 765, 795, 822, 884, 926, 937, 974, 1008

Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë 504, 527, 553, 941

Kërkesë qartazi e pabazuar 37, 249, 252, 262, 267, 268, 345, 350, 382, 453, 468, 492, 508, 532, 563, 586, 592, 597, 610, 613, 615, 619, 621, 626, 628, 638, 639, 642, 644, 671, 676, 691, 697, 703, 704, 705, 712, 716, 717, 733, 734, 735, 745, 747, 749, 750, 764, 814, 818, 820,904, 918 923, 929, 938, 950, 975, 991, 1026

Këshilli i Evropës 16, 22, 584

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) 55, 73, 74, 98, 904, 908, 909, 910, 911, 912, 913, 914, 916, 916, 919, 920, 921, 922, 1027

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) 157, 158, 159, 161, 162, 163, 164, 165, 160, 167, 168, 169, 170, 171, 174, 175, 176, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 218, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 245, 246, 247, 248, 249, 252, 254, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 276, 277, 281, 289, 294, 296, 304, 331, 336, 343, 344, 358, 359, 367, 368, 369, 370, 371, 678, 679, 677, 680, 681, 683, 684, 685, 68

Kompetencat

e Qeverisë 124, 125, 128, 133, 139, 149, 153, 154, 155, 214, 217, 218, 220

e Kuvendit 124.125.133, 139, 148, 153, 154, 155, 214, 217, 218, 220

e Presidentit 143, 144, 214

Konfesionet fetare 822, 823, 828, 839

Kontest zgjedhor 228, 290

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 19, 21, 254, 336, 357, 612, 719

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje 13, 15, 16, 19, 20

Kryeministri i Republikës së Kosovës 5, 77, 110, 132, 214, 1027

Kryetar Komune 228

Kryqi i Kuq 28,29, 30, 33, 34, 35, 39, 41, 46, 49, 50

Kufizim i të drejtave 185, 651

Kuvendi i Republikës së Kosovës 50, 125, 137, 139, 140, 141, 148, 150, 191, 589, 828, 835, 1027, 582

L

Ligji

për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës 955, 55, 58, 122 , 123

për Noterinë 5, 185, 187, 188, 190, 191

M

Masa e Përkohshme 331, 371, 372, 438, 439, 661, 780, 781, 974, 1028

Mbrojtja e pronës 25, 26, 28, 31, 40, 42, 53, 185, 186, 188, 191, 195, 200, 211,212, 213, 331, 371, 372, 438, 439, 661, 780, 781, 974, 1028, 588,594,631, 641 666, 669, 675, 704, 707, 711, 719, 722, 758, 760, 766, 769, 783, 785, 798, 802, 803, 829, 974, 977, 980, 983, 989, 1010, 1014, 1031

Mendim mospajtues 7, 578

Ministria (ministri) 70, 72, 88, 173, 179, 695, 778, 878, 904, 908, 909, 910, 911, 912, 913, 915, 916, 918, 919, 920, 922, 1028, 195

Mjet juridik efektiv 293, 295, 298, 786, 857, 874

N

Ndalimi i diskriminimit 42, 616, 618, 766, 769, 783, 785

Ndarja e pushtetit 124, 126, 128, 133, 137, 146, 153, 154, 155

P

Paanshmëria e gjykatës 481, 519, 521

Palët/Pala e Autorizuar/a 35, 55, 59, 79, 128, 161, 171, 172, 188, 193, 214, 217, 219, 222, 226, 229, 232, 262, 263, 270, 271, 322, 345, 346, 375, 380, 399, 423, 443, 452, 464, 467, 490, 502, 507, 524, 529, 548, 561, 601, 609, 618, 622, 655, 666, 670, 687, 696, 711, 719, 725, 737, 742, 752, 759, 769, 781, 782, 798, 805, 806, 820, 825, 830, 846, 885, 907, 916, 928, 932, 940, 945, 959, 977, 981, 1010, 1017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) 228, 229, 232, 234, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 251, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 266, 268, 271, 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 289, 290, 293, 294, 308, 312, 313, 314,

316, 317, 319, 320, 322, 323, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 347, 348, 349, 351, 362, 366, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 677, 678, 679, 680, 682, 683, 684, 686, 687, 688

Paraburgim(i) 545, 546, 549, 550, 551, 552, 553, 554, 555, 556, 560, 561, 564, 565, 566, 567, 568, 569, 570, 571, 572, 573, 574, 575, 576, 578, 579, 580, 581, 582, 583, 584, 585

Parashkrim 488, 489, 493

Parimet e Përgjithshme 17, 18, 25, 26, 28, 31, 32, 40, 42, 43, 44, 53, 88, 90, 114, 136, 144, 145, 148, 201, 232, 245, 254, 263, 271, 285, 286, 290, 299, 322, 345, 365, 375, 380, 384, 388, 399, 423, 427, 455, 461, 463, 464, 466, 493, 499, 522, 566, 601, 605, 613, 616, 669, 675, 677, 680, 683, 719, 726, 737, 740, 769, 781, 784, 798, 805, 822, 831, 832, 842, 887, 1010, 1018

Parimi

i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale 616, 618, 929

i Proporcionalitetit 616, 618, 653, 746, 822, 834, 929

i Sigurisë Juridike 373, 455

i subsidiaritetit 287,421,493,659,660,702,713,784,793,843,856,879, 888, 898, 901

Pension/pensionimi 185, 206, 207, 209, 210, 211, 826, 835, 836

Person(a) Juridik(ë) 112, 228, 265, 266, 333, 348, 424, 450, 453, 586, 605, 717, 739, 782, 795, 1008, 1018

Përbërja e trupit gjykues 521

Përmbarimi 78, 110, 111, 112, 390, 401, 414, 415, 440, 441, 445, 446, 447, 448, 449, 450, 451, 456, 457, 458, 459, 628, 633, 634, 635, 636, 795, 801, 804, 807, 814, 828, 955, 956, 958

Presidenti i Republikës së Kosovës 61, 79, 137, 138, 146, 171, 193, 221, 222, 224, 225, 234, 270, 323, 336, 375, 400, 444, 465, 503, 549, 589, 619, 632, 666, 681, 693, 707, 799, 826, 954

Pritje(t) legjitime 185, 186, 208, 595, 674, 675, 715, 990

Privatizimi 38, 586, 587, 589, 590, 591, 639, 664, 665, 667, 668, 672, 750, 753, 754, 757, 758, 761, 974, 976, 978, 979, 986

Procedura

Administrative 653, 660, 791

Civile 612, 746, 983

Penale 503, 504, 550, 554

Prokurori i Shtetit 527, 636, 944, 957

Prokurori Publik 550

Q

Qasja në gjykatë 651, 822, 833, 834, 971

Qeveria e Republikës së Kosovës 717, 720, 721, 730, 918, 1008, 1012

R

Ratione materiae 219, 616, 623, 626, 627, 822, 823, 831, 838, 840, 926, 929, 930, 933, 935, 951, 952, 961, 972

Res judicata 440, 441, 454, 455, 456, 457, 459, 677, 683

Rigjykim 404, 405, 406, 407, 408, 413, 429, 477, 479, 487, 490, 521, 526, 532, 538, 545, 551, 554, 569, 634, 667, 723, 776, 787, 790, 941, 998, 1015

S

Seancë dëgjimore 154, 155, 230, 235, 256, 314, 318, 338, 416, 643, 644, 662

Sundimi i Ligjit 198, 299, 352, 621

SH

Shërbimi Civil 55, 56, 65, 69, 71, 82, 83, 84, 85, 91, 95, 120

T

Taksë gjyqësore 664, 673

Të drejtat

e fëmijëve 691

e personave transgjinor 842

zgjedhore dhe të pjesëmarrjes 228, 229, 232, 235, 238, 243, 245, 253, 268, 289, 314, 317, 319, 320, 322, 330, 335, 351, 371, 372, 677, 680, 683

V

Veprim retroaktiv i ligjit 185

Vlerat demokratike 144, 145, 147

Z

Zgjedhjet lokale/ komunale 228, 231, 234, 261, 262, 288, 300, 302, 321, 326, 341, 343, 357, 682, 683, 684

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni	Titulli/Emërtimi	Numri i faqes
	KAPITULLI I DISPOZITAT THEMELORE	
5	Gjuhët	185, 188,191, 195, 196, 197, 199, 212, 213, 214, 215
7	Vlerat	18, 22, 125, 127, 129, 134, 143, 144, 145, 154, 155, 157
	KAPITULLI II TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE	
21	Parimet e përgjithshme	18, 43, 235, 266, 290, 350, 379, 385, 404, 429, 460, 472, 611, 615, 624, 677, 680, 687, 689, 691, 695, 730, 737, 748, 794, 810, 818, 1026, 1034
22	Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare	13, 16, 19, 20, 39, 271,286, 601, 605, 613, 616, 669, 675, 692, 669 675, 692, 696, 737, 740, 798, 802, 853, 940, 944, 946, 949
24	Barazia para ligjit	25, 26, 27, 31, 40, 41, 51, 53, 104, 107, 121, 399, 425, 435, 483, 485, 497, 582, 643, 645, 648, 719, 721, 752, 757, 760, 766, 769, 778, 783, 785, 829, 842, 846, 855, 926, 954, 957, 958, 961, 962, 972
27	Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshterues	929
29	E drejta e lirisë dhe sigurisë	544, 548, 550, 556, 564, 575, 577, 580, 929

30	Të drejtat e te akuzurit	537, 549, 533, 942
31	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	116, 379, 380, 382, 383, 394, 396, 399, 425, 426, 435, 437, 440, 441, 443, 444, 453, 454, 460, 461, 464, 465, 466, 467, 472, 482, 483, 495, 498, 499, 500, 503, 506, 508, 520, 524, 525, 528, 536, 540, 548, 555, 525, 557, 588, 592, 594, 610, 616, 617, 618, 623, 624, 628, 631, 639, 641, 666, 669, 691, 673, 704, 707, 711, 717, 719, 722, 727, 732, 744, 750, 757, 760, 764, 798, 802, 829, 832, 877, 907, 913, 922, 926, 928, 929, 938, 947, 948, 954, 974, 975, 982, 983, 987, 988, 989, 990, 1000, 1008, 1010, 1014, 1019
32	E drejta për mjete juridike	94, 235, 291, 399, 443, 450, 453, 617, 619, 653, 619, 653, 659, 678, 681, 684, 720, 753, 758, 761, 762, 787, 830, 957, 975, 977, 981, 984, 1011, 1015
33	Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale	626, 628, 943
45	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	230, 231,232, 235, 238, 241, 246, 248, 256, 271, 293, 318, 321, 323, 324, 326, 334, 335, 339. 375, 376, 377, 689, 691, 695
46	Mbrojtja e pronës	18, 25, 26, 28, 32, 41, 42, 45, 47, 53, 54, 139, 187, 188, 1190, 193, 194, 197, 2020, 203, 214, 598, 604, 605, 641, 651, 677, 680, 681, 715, 718, 722, 730, 778. 781, 791, 793, 795, 798, 810, 815, 842, 989, 990, 992, 995, 998, 1005
49	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	921, 929, 937

53	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	18, 43, 117, 266, 269, 271, 293, 348, 352, 384,426, 454, 469.492, 512, 533, 601, 605, 612, 613, 639, 657, 666, 669, 670, 675, 678, 737, 740, 746, 808, 831, 853, 859, 866, 929, 934, 962, 974, 977, 980, 983, 987
54	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	230, 231, 235, 238, 246, 257, 271, 448, 455, 459, 611, 615, 624, 689 , 691, 695, 748, 805, 810, 835, 842, 954, 958, 961, 965, 989, 992, 995, 998, 1009, 1011, 1015, 1020

KAPITULLI IV
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

65	Kompetencat e Kuvendit	65, 124, 125, 127, 129, 134, 140, 149, 154, 155, 157
66	Zgjedhja dhe Mandati	
67	Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve	178

KAPITULLI V PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

83	Statusi i Presidentit	
84	Kompetencat e Presidentit	143, 144, 214, 164, 176, 214, 221, 225, 791, 832

KAPITULLI VI QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

92	Parimet e Përgjithshme	17, 18, 25, 26, 28, 31, 32, 40, 42, 43, 44, 53, 88, 90, 114, 136, 144, 145, 148, 201, 232, 245, 254, 263, 271, 285, 285, 286, 290, 299, 322, 345, 365, 375, 380, 384, 388, 399, 523, 427, 455, 461, 463, 464, 466,

		493, 499, 522, 566, 601,605, 613, 616, 631, 638, 660,669, 675, 680, 683, 719, 726, 735, 737, 740, 769, 781 784, 798, 805, 822, 931, 832, 842, 887, 1010,1018, 1028, 1031
93	Kompetencat e Qeverisë	124, 125, 126, 128, 133, 135, 143, 149, 150, 151, 153, 154, 155, 514, 217, 218, 219, 221
94	Kompetencat e Kryeministrit	83, 124, 126, 128, 133, 139, 143, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155
101	Shërbimi Civil	55, 56, 65, 69, 71, 82, 83, 84, 85, 91,

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102	Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor	114, 286, 616, 621, 623, 624, 628, 6331, 638, 1032

KAPITULLI VIII GJYKATA KUSHTETUESE

112	Parimet e Përgjithshme	17, 143, 176, 286, 17, 18, 25, 26, 28, 31, 32, 40, 42, 43, 44, 53, 88, 90, 114, 136, 144, 145, 148, 201, 232, 245, 254, 263, 271, 285, 285, 286, 290, 299, 322, 345, 365, 375, 380, 384, 388, 399, 523, 427, 455, 461, 463, 464, 466, 493, 499, 522, 566, 601,605, 613, 616, 631, 638, 660,669, 675, 680, 683, 719, 726, 735, 737, 740, 769, 781 784, 798, 805, 822, 931, 832, 842, 887, 1010,1018, 1028, 1031, 1032
113	Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara	35, 55, 59, 79, 124 128, 141, 165, 214, 217, 219, 222, 270, 271, 314, 345, 346, 347, 348, 375, 380, 399, 423, 439, 443, 452, 464, 467, 485, 490, 502, 507, 524, 529, 530, 531, 548, 561, 601, 609, 618, 622, 642,

		655, 656, 660, 670, 696, 711, 719, 725, 737, 742, 752, 759, 769, 781, 782, 796, 798, 805, 806, 819, 820, 821, 825, 830, 844, 846, 856,885, 886, 887, 898, 901, 902, 907, 916, 928, 932, 945, 950, 959, 977, 981, 982, 100, 1010, 1017
115	Organizimi i Gjykatës Kushtetuese	90

Kapitulli IX MARËDHËNIET EKONOMIKE

119	Parimet e Përgjithshme	25, 26, 28, 29, 31, 32, 40, 41, 43, 47, 51, 53

Kapitulli XII INSTITUCIONET E PAVARURA

132	Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit	55, 59, 81, 85
133	Zyra e Avokatit të Popullit	89
136	Auditori i Përgjithshëm i Kosovës	65, 85
140	Banka Qendrore e Kosovës	41, 85
141	Komisioni i Pavarur Medieve	98
142	Agjencitë Pavarura	

SHKELJE TË NENEVE 4, 7, 24, 29, 31, 46, 65, 93, 94 dhe 119 DHE TË KUSHTETUTËS

4	Forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit	155
7	Vlerat	155

24	Barazia para Ligjit	53, 121
29	E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	577
31	E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	394, 482, 498, 543
46	Mbrojtja e Pronës	53
65	Kompetencat e Kuvendit	155
93	Kompetencat e Qeverisë	155
94	Kompetencat e Kryeministrit	155
119	Parimet e Përgjithshme	53